



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16, 17, 18, 26 PRILL, 31 MAJ DHE 1, 4, 5, 6, 8 DHE
28 QERSHOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16, 17, 18, 26. APRILA, 31. MAJA, 1, 4, 5, 6, 8. I 28. JUNA
2018. GODINE**

**PRILL/MAJ/QERSHOR - APRIL/MAJ/JUN
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
11. Shqyrtimi i raportit të operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut - KOSTT sh. a,
12. Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
14. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,
15. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,
16. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,
17. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë,
18. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës,
19. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar Deputetët e Pavarur, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017,
20. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës,

21. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës,
22. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjimimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror,
23. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetëve Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Driton Çausi, në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë,
24. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues, në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave, dhe
25. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 5 deputetë nënshkrues, në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje N/zakona br. 06/L-061 o ratifikaciji Traktata Republike Kosova i Mađarske o transferisanju osuđenih lica,
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o sudovima,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o tužilačkom savetu Kosova,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sudskom savetu Kosova,
8. Prvo razmatranje Nacrt zakona o hidrometeorološkoj delatnosti,
9. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-036 o zvaničnim statistikama Republike Kosova,
10. Prvo razmatranje Nacrt zakona o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova,
11. Razmatranje Izveštaja operatera sistema, transmisije i tržišta KOSTT-a sh. A.,
12. Izbor kandidata za sudije Ustavnog suda Republike Kosova,
13. Razmatranje predloga odluke Vlade Republike Kosova za imenovanje šest (6) članova Borda Kosovske agencije za privatizaciju,
14. Izbor direktora Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova,
15. Izbor tri (3) člana Nezavisne komisije za medije,
16. Formiranje ad hoc komisije za izbor dva (2) člana Nezavisne komisije za medije
17. Interpelacija premijera Republike Kosova g-dina Ramush Haradinaj, na zahtev PG Pokreta VV, u vezi redukcije električne energije i situacija u sektoru energije,

18. Interpelacija premijera Republike Kosova g-dina Ramush Haradinaj, na zahtev PG Demokratskog saveza Kosova, u vezi odluke Vlade Kosova br. 02/34, od 5. 3. 2018, o dodeljivanju finansijskih sredstva u iznosu od 1 miliona evra KOSTT-u, za pokrivanje troškova snabdevanja električnom energijom četiri opština severa Kosova,
19. Interpelacija premijera Republike Kosova Ramush Haradinaj, na zahtev PG Nezavisni poslanici, u vezi potpisivanja komercijalnog Sporazuma između kompanije “Contour Global” i Vlade Kosova o projektu Termocentrale “Kosova e Re” potpisan 20. decembra 2017,
20. Interpelacija premijera Republike Kosova Ramush Haradinaj, na zahtev PG Pokreta Vetevendosje, u vezi korupcije visokih javnih zvaničnika i organizovanog kriminala u institucijama Republike Kosova,
21. Interpelacija ministra zdravstva Uran Ismaili, na zahtev PG Pokreta Vetëvendosje, u vezi zdravstvenog informativnog sistema i zdravstvenog osiguranja u Republici Kosova,
22. Parlamentarna rasprava, na zahtev PG VV, u vezi nalaza Izveštaja državne komisije za obeležavanje i održavanje državne granice,
23. Parlamentarna rasprava, na zahtev poslanika Ganimete Musliu, Salih Salihu i Driton Çausi, u vezi skandala pokvarenog mesa uvezenog iz Belgije (Kompanija Veviba), i kvaliteta i sigurnost hrane na Kosovu,
24. Parlamentarna rasprava, na zahtev poslanice Shqipe Pantina, podržan i od 11 poslanika potpisnika, u vezi korupcije kao kriterijum vizne liberalizacije,
25. Parlamentarna rasprava, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržan od 5 poslanika potpisnika o bezbednosti dece u toku korišćenja interneta na Kosovu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018. Në sallë jemi 61 deputetë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fjalën e ka Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në emër të grupit.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Elemente të korrupsionit dhe kapjes së shtetit vërehen në nivele të larta të institucioneve të Kosovës. Çdo ditë po shkelen standardet e vendosura nga Qeveria Mustafa, që zyrtarët e lartë, për të cilët organet e drejtësisë ngritin aktakuzë, të lirohen nga detyra.

Në këtë Qeveri janë tre ministra që kanë aktakuzë të ngritur tanimë. Është edhe një ministër që e ka shkelur Kodin Penal, duke rrezikuar sigurinë publike, por që është mbajtur në Qeveri me votat e deputetëve të partive në koalicion. Dhe, një tjetër ministër me akuza edhe më të rënda për keqtrajtim të shqiptarëve në Prishtinë gjatë luftës, por që zoti Haradinaj u detyrua ta mbante në Qeveri.

Ta kemi të qartë, ne e respektojmë parimin e pafajësisë të secilit derisa nuk ka një vendim përfundimtar të gjykatës që e vërteton fajësinë e atyre personave. Por, nuk mund të pajtohemi që këta persona me aktakuzë të vazhdojnë të kryejnë detyrën e tyre zyrtare. Është e qartë se në kryerjen e detyrave zyrtare këta persona nuk mund të jenë të paanshëm, ndërkohë që hetohen.

Të nderuar deputetë,

Nesër Komisioni Evropian publikon raportin për secilin vend të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën.

Sigurisht se këto akuza ndaj ministrave do të zënë vend në këtë raport, përfshirë këtu edhe përpjekjen e partive të koalicionit për t'iu ikur obligimeve ndërkombëtare lidhur me Dhomat e Specializuara të Gjykatave dhe Prokurorin e Specializuar në Hagë.

Mandej, nismën e deputetëve për amnisti për ata që kanë përdorur dhunë dhe gaz lotsjellës në Kuvend, si dhe dështimin e institucioneve të respektojnë të drejtat elementare njerëzore me rastin e dëbimit të shtetasve turq.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka mbështetur Qeverinë në ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, si kusht për liberalizimin e vizave.

Por, tash ne nuk mund t'ju ndihmojmë që të pastroni radhët tuaja nga njerëz që po akuzohen çdo ditë për vepra të ndryshme. Është e qartë se ky koalicion ka humbur legjitimitetin në çdo aspekt për ta qeverisur vendin.

Sa më parë që mbështetet nisma e Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhje të parakohshme, por të organizuara mirë, është më mirë për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Kabinet i Qeverisë,

Telekomi i Kosovës aktualisht është në krizë, por si biznes. Situata e këtillë financiare nuk është rastësi apo pasojë e rrethanave jashtë përgjegjësive të kësaj Qeverie të Kosovës dhe vendimeve të marra prej vitit 2007 e deri sot.

Z. Mobile si ide, si projekt dhe si manipulim, përveç fitimit të pronarëve të tyre, shërben po ashtu si nismë për rrënimin e Telekomit.

Çfarë s'u arrit dikur me AXOS-in, u përmbush me arbitrazhin dhe gjobën mbi Telekomin nga një marrëveshje e paligjshme dhe mafioze me Z. Mobile.

Ndërmarrjen publike Telekomit i Kosovës, nga e cila buxheti do të kishte siguruar veçse fitim, po e kthejnë në ndërmarrjen së cilës ia kanë bërë arkitekturën e krizës financiare që të kenë alibinë e përkryer për t'ia justifikuar publikut zgjidhjen me privatizim, përkatësisht shitje.

Mbipunësimet, kryesisht në administratë, jo në staf teknik profesional, janë klientelizëm dhe shërbim për rrjetin e partive në pushtet.

Por, në kuptimin e qeverisjes së ndërmarrjes publike, ato janë porosia e qartë e rrënimit të afarizmit të saj. Ka pasur dhe ka plan për ta dobësuar dhe, madje diskredituar Telekomin e Kosovës deri në pikën që publiku i gjerë me vetëdëshirë ta mbështesë shitjen e saj.

Posta dhe Telekom i Kosovës si pasuri me infrastrukturë postare e telekomunikuese dhe me gjithçka tjetër që posedon, është ashtu dhe aty si ka qenë gjithmonë dhe mbetet ndër pasuritë më të vlefshme që ka vendi ynë dhe me rëndësi jetike për shtetin tonë.

Shkaktarët që e sollën Telekomin dhe Postën në këtë gjendje duhet të përballen e do të përballen me drejtësinë.

Sot duket e vakët kjo mundësi, për shkak të sistemit të drejtësisë që e ka Kosova. Por gjurmët e kimit në PTK nuk mund të fshihen, as të humbin dhe as emrat që i kanë shkaktuar.

Profesor Ismet Hamiti para katër muajsh i ka dërguar një letër të dytë kryeprokurorit të shtetit, me ç'rast po e lexoj vetëm njërin paragraf.

“Nga kallëzimi im i para një viti më parë te ju keni të gjitha hollësitë e këtij krimi, i keni individët që e kanë nisur dhe që e kanë miratuar në bordet e njëpasnjëshme të PTK-së, e keni personin me emër e mbiemër që e ka nënshkruar licencën në kundërshtim me ligjin. E dini personin që e ka nënshkruar kontratën, i keni zyrtarët e lartë që e kanë mbështetur këtë krim, qoftë duke mos bërë asgjë për ta penguar, e qoftë duke arsyetuar atë në Kuvend, i keni të gjitha”.

Kjo thuhet në letrën e profesor Hamitit që e mban datën 20 dhjetor 2017.

Synimi ynë sot njëkohësisht është të propozojmë zgjidhje të kësaj situate, sepse Telekom i si biznes nuk dhe patjetër duhet të shpëtohet.

Posta edhe Telekom i Kosovës si biznes është para falimentimit dhe rrezikohet funksionimi i shërbimeve postare dhe telekomunikuese në vend.

Kuvendi i Kosovës është i detyruar të ndërhyjë për të siguruar ofrimin e pandërprerë të këtyre shërbimeve dhe të propozojë një rezolutë, pas një debati që do ta zhvillonim në këtu.

E para, të emërohet menaxhmenti i krizës për dy vjet,

E dyta, ristrukturim i thellë i biznesit të Telekomit me qëllim të daljes nga kriza,

E treta, profili i anëtarëve dhe termat e referencës me detyra dhe përgjegjësitë e menaxhmentit të krizës të hartohen nga një grup punues i përbashkët,

E katërta, menaxhmentit t'i jepen të gjitha autorizimet që i duhen për të kryer detyrat e veta,

E pesta, menaxhmenti i krizës i raporton Kuvendit të Kosovës çdo tre muaj për progresin, dhe

E gjashta, Kuvendi i Kosovës diskuton dhe miraton raportet e menaxhmentit të krizës.

Mirëpo, siç e dimë e siç e shohim e siç e ndjejmë përditë, Qeveria po shkon në drejtim tjetër.

Bordi i zgjedhur më 28 mars, në përbërje Besa Shatri, Skender Hoti, Osman Ejupi, Sead Ujkani, Fidel Krasniqi dhe Suzana Angjelkoviq, dominohet nga persona jokompetentë dhe të lidhur me pushtetin.

Kulmi u mbërri javën që shkoi në mbledhjen e parë të Bordit, kur u emërua ushtrues i detyrës kryeshefi ekzekutiv Zeqir Kiqina, kryetar i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në Drenas.

Pra, Telekom i Kosovës ka gjetur një ekspert të nivelit të lartë për të menaxhuar krizën e madhe financiare nga filiali në Drenas, i cili qëllon të jetë edhe kryetar i degës së AAK-së në Drenas. Faleminderit!

KRYETARI: Driton Çausi, nga Grupi i Deputetëve të Pavarur, në emër të Grupit Parlamentar.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Siç edhe jeni të njoftuar, në kuadër të kësaj agjende të sotme që do të vazhdojë gjatë javës, është paraparë edhe një debat në lidhje me sigurinë ushqimore dhe skandalet e ditëve të fundit në lidhje me mishin e importuar.

Mbi të gjitha, konsideroj që ky debat është tashmë i vonuar dhe duke pasur parasysh dinamikën e punës së Kuvendit, duhet të ketë një trajtim shumë urgjent dhe të menjëhershëm.

E vlerësoj të vonuar, për shkak se vendi për një kohë të gjatë gjendet në një situatë alarmante të sigurisë së shëndetit publik.

Do të ishte e pasaktë që rasti i mishit të importuar nga Belgjika të merrej si përshkrues i duhur i gjendjes së rëndë të sigurisë ushqimore në Republikën e Kosovës.

Kjo për shkak se gjatë gjithë periudhës së pasluftës nuk kemi pasur asnjë moment, as më të voglin kontroll mbi cilësinë dhe sigurinë e ushqimit që konsumojmë.

Kjo, në radhë të parë, për shkak se një institucion që funksionon në Zyrën e Kryeministrit ka dështuar totalisht në misionin e tij, i cili është, citoj: “Të mbrojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve duke siguruar nivel të lartë të sigurisë së ushqimit”. Pra fjala është për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Vetëm disa ditë pas publikimit të skandalit të mishit të importuar nga Belgjika, në disa qytete të Republikës së Kosovës u gjetën dhe u konfiskuar nga inspektoratet komunale tonelata të tëra mish të skaduar dhe pa dokumentacion.

Raste të tilla tani po bëhen gati të përditshme, kjo tregon më së mirë dështimin total të kësaj agjencie në detyrën e saj.

Kosova, sa për informacion, importon në vit rreth 40 milionë kilogramë mish dhe mund të paramendoni se sa është kontrolli ose vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë së këtij mishi. Pra, gjatë vitit 2017 nga kjo sasi janë marrë vetëm 375 mostra.

Por, do të ishte gabim sikur ky të trajtohej si dështimi i vetëm i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky institucion ka dështuar në secilin aspekt që lidhet me përgjegjësitë e tij në sigurinë ushqimore.

Produktet që përfundojnë në tryezat tona, si nga importi, por edhe ato që prodhohen në Kosovë, nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli serioz për hormone, toksina, pesticide, metale të rënda, antibiotikë dhe mbetje të tjera të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin publik.

Thertoret janë përgjegjësi e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe kontrolli i domosdoshëm gjatë therjes nuk ndodh fare gati në këto thertore të licencuara dhe të gjitha mbetjet nga të gjitha thertoret në Republikën e Kosovës përfundojnë në deponitë e zakonshme të mbeturinave.

Pra, mund të paramendoni se çfarë rreziku i ekspozohen qytetarët në baza ditore. Andaj, edhe nuk është për t'u çuditur që kemi në vazhdimësi në spitalet tona pacientë me tuberkuloz, me brucelozë, me sakonelozë e ekinokokozë, sëmundje që në një pjesë të madhe të vendeve të Evropës Perëndimore ose janë të çrrenjosura, ose janë dukuri tepër të rralla.

Deputetë të pranishëm,
Është shokuese që deri më sot nuk ka pasur as edhe një reagim të vetëm nga kryeministri Haradinaj përballë kësaj situatë.

Kujtoj edhe një herë që është një agjenci në Zyrën e Kryeministrit.

Njëjtë e konsideroj të papranueshme heshtjen e ministrit të Shëndetësisë, për shkak se kjo çështje ka të bëjë me rrezikimin serioz të shëndetit publik.

Konsideroj që hap i parë, urgjent dhe i domosdoshëm, në këtë situatë është shkarkimi i menjëhershëm i kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Bordit menaxhues të këtij institucioni.

Nën dy, nisjen e hetimeve nga prokuroria për aktivitetin e këtij institucioni të një rëndësie vitale.

Kjo agjenci mund të jetë në shërbim të bizneseve, siç janë importuesit e mëdhenj dhe pronarët e supermarketeve ose zinxhirëve të supermarketeve dhe partive në pushtet, por asnjëherë në shërbim të sigurisë dhe interesit të qytetarit të Republikës së Kosovës.

Unë vetëm mund t'ju ftoj që këtë çështje urgjente ta trajtojmë bashkërisht me seriozitetin që e meriton dhe në shërbim të qytetarit të Republikës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ganimete Musliu e ka fjalën, si deputete.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Nuk e pata ndërmend ta marr fjalën në këtë pikë të rendit të ditës, po sinqerisht po më bën shumë përshtypje hipokrizia e kolegut tim, deputetit Driton Çausi, i cili sapo foli në këtë foltore.

Siç e dini, para një muaj e kam bërë kërkesën për të debatuar pikërisht për çështjen e mishit ose skandalit të mishit që tashmë po quhet në Kosovë.

Menjëherë, një javë pas, kolegët tanë nga Grupi i Pavarur i Deputetëve e kanë kopjuar idenë dhe kanë bërë kërkesë për ta bërë një debat të tillë. Mirë shumë, nuk ka asgjë, sa më shumë kërkesë le të bëhen, po të mos e fëlliqim këtë vend, të mos e shkatërrojmë këtë institucion!

Dhe, sot, kur ne e kemi në rend të ditës të diskutojmë në mënyrën më të mirëfilltë të mundshme dhe thjesht t'i japim një drejtim kësaj çështjeje, prapë çohet dhe e shfrytëzon foltoren në këtë 30-minutësh kishe unë po flas i pari në Kuvend dhe po them diçka për mishin e prishur.

Unë mendoj që nuk duhet të keqpërdoret foltorja veç sa për të thënë diçka.

Thjesht, ne sot e kemi në rend të ditës, është pika e 23-të e rendit të ditës kur ne do të diskutojmë.

I kemi pranuar dy kërkesa për debat dhe kërkesa ime me mbështetjen e 14 deputetëve të fuzionohet në një pikë të vetme, kur ne për qëllimin më të mirë të diskutojmë për këtë problem, për shkak që është një çështje shumë e ndjeshme dhe na preokupon secilin. Por, të dashur kolegë, nëse mendoni se çdo temë duhet të bëhet vetëm sa për të bërë politikë ditore, për të marrë një votë aty-këtu diku, e keni shumë gabim, se asnjëherë s' do të mund t' u japim zgjidhje problemeve në mënyrën e duhur dhe në mënyrë institucionale.

Prandaj, keni vëmendje dhe thjesht të bëhemi pak më seriozë si kolegë deputetë, ju lutem, sepse ju e dini që ne e kemi trajtuar këtë çështje edhe me komisionin parlamentar dhe e keni marrë, po besoj, e ke rendin e ditës që sot është kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet. Prandaj, mos banalizoni gjithçka dhe mos u mundoni që nga gjithçka të përfitoni për politika ditore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton, kërkoj falje, po as Ganimetes nuk ia jap fjalën për replikë, nuk kam të drejtë në bazë të Rregullores, kemi debat tash, do ta kemi debat më vonë, e vazhdoni.

Milaim Zeka e ka fjalën, nga Nisma.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë po flas në emrin tim personal, po e filloj pak me zotin Albin Kurti, pa të keq, por ma merr mendja që nja gjashtë muaj kam qenë iniciator i parë që kam kërkuar hetime në Postë-Telekomin e Kosovës, në Valë, kam thënë se pistat e krimit janë PTK-ja, Vala, KEK-u, Agjencia e Privatizimit, s' di ku s' ka këtu pistë të krimit. Unë kam qenë gjithmonë kundër hetimit të SHIK-ut, për arsye se disave nga ju u ishte bërë sëmundje puna e SHIK-ut, e lëmë me një anë UTB-në, në qoftë se duam t' i fusim të gjitha këto shërbime me një vend, i fusim, i hetojmë edhe ato, por ma merr mendja që këto janë çështje urgjente, për të cilat unë pajtohem në mënyrë absolute.

Pa e paragjykuar drejtuesin aktual, zotin Zeqir Kiçina, për të cilin unë kam respekt të jashtëzakonshëm, është një djalë i luftës, mua s' më intereson fare përkatësia politike e asnjë njeriut dhe ne si Nismë, të jeni shumë të bindur që as s' po mund të futim askënd nëpër borde, se s' po na i lanë, e as drejtues të këtyre ndërmarrjeve publike, se ne jemi ende “peshk i vogël”. E patëm një ditë një takim me Bashkimin Evropian, më thanë, njëri më pyeti bash i Partisë Vetëvendosje, tha pse s' i keni arrestuar “peshqit e mëdhenj”. I thashë se “peshqit e mëdhenj” janë në EULEX dhe s' ka mundur peshku i madh ta kapë të madhin, peshku i madh e kap të voglin. Arsyja pse dola në foltore është, përpos kësaj, t' ju tregoj që ne ju mbështesim, një shqetësim shumë i madh, unë e kam paraqit privatisht me ministrin tonë të Arsimit, por po e them tash publikisht, është duke ndodhur një skandal nëpër shkollat e Kosovës.

Mësuesit po i marrin fëmijët, vetëm pse qeshin në bankë ose pse nuk i kanë bërë detyrat, po i qesin te dërrasa e zezë, po i mbajnë në këmbë 45 minuta, po i shtinë për çantën 20 kg, se unë

vajzën e dërgoj në shkollë publike, nuk e kam pasur në “Mehmet Akif” dhe, përpos kësaj, po i fotografojnë. Turpi më i madh, po i fotografojnë nxënësit, merreni me mend, kjo është fyerje, kjo është shkelje e të drejtave të fëmijëve. Prandaj, e kisha lutur ministrin tonë të Brendshëm, të cilit i uroj shumë sukses, mbase s’ë ha edhe ky pa faj si Flamuri, që të bëjë një hulumtim, një statistikë, së bashku me ministrin e Arsimit dhe të na vijë me një raport, për arsye se ky është shqetësim shumë serioz. Unë kam pasur bisedë me shumë prindër që e paraqesin këtë shqetësim. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi, pa grup parlamentar!

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Želim u ovom parlamentu govoriti o jednom decenijskom starom problemu medicinskom fenomenu, velikom problemu familijarno centra, zdravstvenog centra u Rečanu, koji radi samo prvu smenu i sa nedovoljnim brojem doktora, stomatologa i medicinskih tehničara, odnosno postao je kazna no popravnim centar za osoblje koje dolazi iz prizrenskog regiona koje se rehabilituje gore i posle 6. meseci i ponovo se vraća u Prizrenu i zauzima svoja radna mesta, a radna mesta koja su Ustavom zagarantovana za bošnjačku nacionalnu zajednicu u tom području su za sada i dalje nedovoljne i nedostupna svima.

Naime Župski kraj ima više od 12. bošnjačkih sela, ambulanta u Gornjem Lubinju koje, kao selo broji više od tri hiljade i trista građana uopšte i ne funkcioniše, takođe ambulanta u Donjem Lubinju, da ne govorim u Nebregoštu i u Lokvici, gde uopšte nema nikakvih zdravstvenih usluga svim našim starim ljudima koje gore žive.

Pružanje zdravstvenih usluga naših građana je u jakom niskom nivou. Što se tiče ambulanti i celokupne infrastrukture, mi smo u prethodnom mandatu sa strukturama opštinske vlasti opštine Prizren to izgradili, međutim to nije dovoljno za funkcionisanje tih ambulanti i za pružanje zdravstvenih usluga svim našim građanima zbog nedostatka doktora, zbog nedostatka stomatologa, zbog nedostatka medicinskih kadrova.

Takođe zahtevam od Ministra zdravlja, Predsednika opštine Prizren i direktorijata zdravstvenog centra u Prizrenu hitno intervencije, odnosno reakciju radi zapošljavanja doktora i medicinskih tehničara u svim našim selima koje sam gore pomenula.

Od familijarnog zdravstvenog centra u Rečenu tražim da funkcioniše 24. sata, a u Gornjem Lubinju, u Donjem Lubinju, planinu u Grnčaru kao najvećim bošnjačkim selima ambulanta radi bar u dve smene i pruža zdravstvene usluge našim bolesnim građanima koji svakodnevno trebaju putovati više od 20. km da dođu do grada Prizrena, pa čak i za jednu injekciju. Pozivam i

međunarodnu organizaciju, zatim ambasade švajcarski KARITAS da nam pomognu u rešavanju ovog goruđeg problema koje kao bošnjačka zajednica imamo u Prizrenu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deri në orën 11 e 12 minuta e kemi 30-minutëshin. Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dua të flas sot për të gjitha aktakuzat që kanë vërshuar ditët e fundit Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera të vendit, pa përjashtim dhe kujtoj se vetëm javën e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë për rastin famoz "Pronto" dhe në këtë aktakuzë, ndonëse ishin kursyer aktorët kryesorë të saj, pra shefat e vetë klanit, ishin përfshirë megjithatë disa zyrtarë të lartë shtetërorë që edhe sot ushtrojnë veprimtari publike. Ndër të tjera, ishin përfshirë një ministër i Qeverisë, një deputet i Kuvendit të Kosovës dhe një këshilltar i kryetarit të këtij Kuvendi.

Dhe, çështja e parë që të shkon ndërmend kur sheh një lajm të tillë është të pyesësh se si është e mundur që një kryetar partie, pra i PDK-së, zgjedh kaq shumë individë me aktakuzë rreth vetes? Pra, si është e mundur që nga të gjithë këta njerëz të mirë në vend që ka Kosova, të mbash në rrethin tënd madje deri në këshilltar personal njerëz me kaq shumë aktakuza për krim, për kapje, për korrupsion?

Dhe, çështja e dytë që të shkon ndërmend, më e rëndësishmja, është të pyesësh veten se si kryeministri i një qeverie mund të punojë me kaq shumë individë në aktakuzë? Si mund të ndjehet i sigurt për veprimet e tyre?!

Sot Qeveria e Kosovës i ka tre ministra në aktakuzë për korrupsion dhe krim, i ka edhe dy të tjerë nën hetime: njëri për shtënie me armë zjarri, e tjetri për tortura ndaj civilëve shqiptarë. Pra, i ka pesë ministra në peshoren e drejtësisë, i ka 25% të Kabinetit nën hetime me aktakuzë. Ky, zonja dhe zotërinj, është rekord i ri. Asnjë qeveri, në asnjë vend tjetër të Evropës nuk i ka tre ministra nën aktakuzë e dy të tjerë nën hetime. Asnjë qeveri, në asnjë vend tjetër nuk lejon që brenda vetes të mbajë zyrtarë që mund të jenë të komprometuar dhe kjo tolerancë është legjitimim i vetë kriminit. E kuptoj klisheën që secili është i pafajshëm deri në shpalljen e vendimit final, por në të njëjtën kohë, e shoh si të domosdoshme që njerëzit që kanë bazë minimale për dyshim, sado i vogël të jetë ai dyshim, të mos ushtrojnë asnjë funksion publik.

Kosova, qytetarët e saj, meritojnë së paku një Qeveri me duar të pastra dhe pa asnjë dyshim nga aktorët e saj. Dhe, kaq pak duhet dhe mund t'u japim qytetarëve tanë. Prandaj, sot i bëj thirrje

kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit që të shkarkojnë të gjithë njerëzit rreth vetes që kanë aktakuzë e përfitojnë financiarisht nga fondet e kosovarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetit Lumir i isha përgjigjur, po s'kam të drejtë as unë për replikë. S'kam të drejtë, po do t'i përgjigjem më vonë, kur të mundem në pjesën çka ka të drejtë, si është e drejtë dhe në pjesën që mendoj se ishte pak e shtuar, e ekzagjeruar. Pjesën çka është e drejtë, i qëndroj edhe unë.

Po shkojmë tutje, Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje, i kemi edhe katër deputetë, po folën këta katër, flas edhe unë i pesti, pas orës 11.12 minuta, ju vendosni si të doni. Atëherë, ta kryejmë njëherë deri në 11 e 12 minuta.

Glauk, fjala për ju!

GLUAK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sa ishte Ramush Haradinaj në opozitë, së bashku me Vetëvendosjen nuk kalonte as demarkacioni dhe nuk kalonte as 'Zajednica'. Në momentin që Ramush Haradinaj u bë me Thaçin dhe me pushtetin, kaloi edhe demarkacioni dhe i është hapur rrugë që të themelohet edhe 'Zajednica'. Pas dhjetorit të vitit 2016, kur Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë marrëveshje antikushtetuese në 23 pika të saj, ajo që do të duhej të ndodhte është dhënia e përgjegjësisë për shkelësit e Kushtetutës.

Siç dihet, kjo marrëveshje ishte nënshkruar nga Isa Mustafa, së bashku me Aleksandër Vuçiqin. Jo vetëm që askush nuk dha përgjegjësi për këto shkelje, por tash po veprojnë thujse nuk ka ndodhur asgjë dhe Qeveria e Presidenti po nguten që ta themelojnë Asociacionin e Komunave me shumicë serbe. Një gjë duhet ta dinë shumë mirë edhe Presidenti edhe Qeveria: çfarëdo entiteti politik serb që krijohet në Kosovë dhe që ka karakter mbikomunal, e ndan Kosovën dhe përgjegjësia do të duhej t'u faturohej drejtpërdrejt kryeministrit dhe presidentit. Kjo tash është një Qeveri e pakicës, siç po e shohim dhe po kuptohet dita-ditës më mirë pse ekziston vetë Qeveria Haradinaj. Unë mendoj që, nëse e keni përcjellë me vëmendje veprimtarinë e saj, atëherë reduktohet në tri prioritete: kjo qeveri është themeluar për ta kaluar demarkacionin, për ta themeluar 'Zajednicën' edhe për ta menaxhuar Gjykatën Speciale.

Pra, s'ka lidhje as me zhvillim ekonomik, as me zhvillim të arsimit, as me përmirësim të shëndetësisë. Kurse, sa i përket kësaj që po thonë që është jopatriotike të rrëzohet kjo Qeveri me Listën serbe, si është e mundur të thuhet kështu, kur Lista serbe është në Qeveri. Lista serbe krejt çka ka bërë, e ka ndërruar vendin ku po ulet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dy ditë pasi tha që nuk janë në Qeveri, zëvendëskryeministri Jevtiq mori pjesë në mbledhjen e Qeverisë! Pra, të thuash që është e pandershme të rrëzohesh me Listën serbe, kurse qenka e ndershme të

qeverisësh me Listën serbe, kjo me të vërtetë nuk do komente dhe kjo Qeveri pa dyshim që do të duhet të rrëzohet sa më shpejt.

KRYETARI: Faleminderit! U bënë 12 minuta, a të vazhdojmë? Jemi edhe pesë, katër dhe unë i pesti, i fundit. Kryetarët e grupeve deklarohuni shpejt, Avdullah Hoti, a vazhdojmë edhe pesë deputetë, më shumë jo. Edhe Driton, replikë, jo të lutem! Del keqpërdorim, për besë. Të kisha lënë të flasësh sa të dush, ta jap fjalën. Nëse ke ndonjë pyetje, e shfrytëzon, por mos, mos se tani i bie keqpërdorim. Do të thotë, pa Dritonin, jemi Haxhi Avdyli, Armend Zemaj, Islam Pacolli, Bilall Sherifi dhe unë. Në qoftë se po, shkojmë.

AVDULLAH HOTI: Unë pajtohem të vazhdojmë edhe pesë minuta, por të mësohen qytetarët ta...

KRYETARI: Jo, jo, këta pesë deputetë... të tjerë të mos futen asnjë.

AVDULLAH HOTI: Por, të mësohemi njëherë e përgjithmonë të respektohet Rregullorja, sepse seancat po fillojnë me një orë vonesë...

KRYETARI: Kryetar i grupit, a ta respektojmë Rregulloren, a të vazhdojmë, se kjo nuk është...

AVDULLAH HOTI: Mendoj që si kryetar i Kuvendit e keni për obligim respektimin e Rregullores. Jo t'i merrni opinionet e kryetarëve të grupeve, a të respektojmë Rregulloren apo jo, sepse përgjigjja jonë është saktë e qartë, duhet të respektohet Rregullorja.

KRYETARI: Si ishte, a të vazhdojmë? Konsensus?

AVDULLAH HOTI: Duhet të respektohet Rregullorja. Vetëm kaq!

KRYETARI: Memli Krasniqi, kryetar nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Edhe në emër të grupit të PDK-së, mendoj se duhet të respektohet Rregullorja. Mund të flasim në seancën tjetër kush ka mbetur në radhë.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje? Atëherë, po e mbyllim me kaq. Kërkoj falje! Shkojmë në pikat tjera.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 29 pyetje parlamentare.

Deputeti Haxhi Avdyli, pyetjet e bartura nga seancat e mëparshme, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Deputet fjala është për ju, pasi ministri nuk qenka i pranishëm. Urdhëroni!

HAXHI AVDYLI: Meqenëse ministri nuk është i pranishëm, nëse më lejohet do ta kisha thyer pakëz rendin, duke ia bërë një pyetje ministrit të ri të Punëve të Brendshme, nëse më lejohet, për shkak të vdekjes së një të riu...

KRYETARI: Jo, të lutem, me Rregullore! Shfrytëzoje rastin ndonjëherë tjetër.

HAXHI AVDYLI: Atëherë, pyetjen për ministrin Uran Ismajli po e lë në interpelancë, të cilën e kemi për sistemin e informimit shëndetësor dhe të sigurimet shëndetësore, që e kemi diku pikën 21.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Avdyli po ashtu, dy pyetje i paske pasur. A shkohet në të dyja njësoj? Të dyja njësoj.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Pyetja është deponuar dy muaj më parë dhe përfshin tre ministra, në fakt është një për ministrin Lekaj, një për ministren Reshitaj dhe një për ministrin Gashi lidhur me vizitën e tyre në Gjakovë më 7 shkurt 2018.

Ministër, gjatë kësaj vizite ju para medieve keni deklaruar, mes tjerash, se do t'i ndihmoni Komunës së Gjakovës në projektin e stërzgatur të impiantit të ujërave të zeza, projekt ky me një vlerë prej 16 milionë euro.

Pyetja është: Buxheti i miratuar i Kosovës për vitin 2018 në ministrinë tuaj përmban investime nga ministria për impiantin e ujërave të zeza në Prishtinë, 2 milionë e 700 mijë euro investim; impiantin e ujërave të zeza në Pejë, 3 milionë e 800 mijë euro investim, por nuk ka asnjë vijë buxhetore për projektin e impiantit të ujërave të zeza në Gjakovë. Nga cila kategori, ministre, do t'i ndihmoni ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza të Gjakovës dhe nëse do t'i ndihmoni, me çfarë vlere është ajo ndihmë?

KRYETARI: Zonja ministre, fjala për ju!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Fabrika e ujërave të zeza në Gjakovë është projekt i bashkëfinancuar nga donatorët dhe Komuna e Gjakovës. Ky projekt është bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Gjakovës, Qeverisë Gjermane, KFV-së dhe Konfederatës zvicerane - Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe, normalisht, siç e thatë edhe ju, ka vlerë prej 16 milionë e 800 mijë euro. Komuna e Gjakovës e financon këtë projekt me vlerë prej 3 200 mijë euro, KFV-ja financon këtë projekt me vlerë prej 6 milionë euro, kurse Konfederata zvicerane SEKO financon këtë projekt me vlerë prej 7 milionë e 600 mijë eurove.

Gjendja aktuale e projektit, sa për informacionin tuaj, është që projektin e zhvillon KRU Gjakova. Është përzgjedhur operatori ekonomik, kontraktori për implementimin e projektit, mirëpo kontrata ende nuk është nënshkruar, sepse Komuna i ka disa obligime paraprake, të cilat nuk i ka realizuar. Andaj, ndoshta edhe do të lindë pyetja pse janë vonuar, duke mos përfunduar procedurat e buxhetit dhe shpronësimit nga Komuna e Gjakovës.

Shpronësimi i pronave për zbatim të projektit, posa të kryhen këto obligime nga Komuna, fillohet me zbatimin e projektit, ndërsa obligimet që dalin nga kjo marrëveshje për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë në mbështetje institucionale të projektit, e cila nuk do të mungojë asnjëherë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Bashkëpunimi i Ministrisë së Mjedisit ka qenë në nivelin e duhur dhe po vazhdon. Brenda afateve ligjore projekti është pajisur me pëlqim mjedisor dhe me pëlqim ujor. Ka mbetur që në ministri të bëhet aplikimi për leje ndërtimore, proces i cili nuk mund të mbyllet pa u kryer tërësisht procesi i shpronësimit nga Komuna e Gjakovës.

Komuna e Gjakovës ndërkohë ka bërë kërkesë për financim të segmenteve, të cilat nuk janë të përfshira në Projektin e KFV-së dhe SEKO-s, dhe do të inkorporohen në projektin gjeneral sipas rekomandimeve të ekspertëve të fushës. Ky projekt parashihet rregullimin gjeneral të shtratit të lumit Krena, në të cilin do të përfshihen edhe kolektorët përgjatë lumit, që janë pjesë e kësaj fabrike, përkatësisht këtij gjiganti të madh për trajtimin e ujërave të zeza. Vetëm për shtratin e lumit Krena, Ministria e Mjedisit ka ndarë 220 000 euro. Konsideroj se është një ndër projektet e mëdha kapitale për Komunën e Gjakovës dhe do të lusja që të mos kemi prolongime të procedurave dhe përgjegjësi që i ka Komuna e Gjakovës. Ne si ministri, mendoj që edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila ka përgjegjësi për ndërtimin, përkatësisht për infrastrukturën ujore, t'i kryejmë të gjitha procedurat tjera dhe sa më shpejtë të fillojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zonja deputete e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit ministre për krejt sqarimet!

Jam shumë mirë e informuar për obligimet e secilit aktor në këtë projekt. E kam udhëhequr Komunën e Gjakovës, siç jeni të informuara. Problemi që ju e cekët është problem, i cili ka qenë evident dhe është kërkuar ndihma e Ministrisë së Mjedisit, po ju çfarë më thatë është se Ministria e Mjedisit nuk planifikon t'i ndihmojë Komunës së Gjakovës, përkundrajt çfarë keni deklaruar. Sikur të dëshironte t'i ndihmonte, do t'i ndihmonte me mjete financiare në shpronësim, kërkesë e Komunës së Gjakovës prej vitit 2014, për shkak të obligimeve të rënda financiare. Njëjtë sikur që Ministria e Mjedisit i keni ndihmuar në mandatin e kaluar Komunës së Pejës dhe njëjtë sikur planifikon t'i ndihmojë Komunës së Prishtinës. Prandaj, konsideroj se duhet të jeni e kujdesshme kur thoni se do t'i ndihmoni projektit të stërzgatur. Stërzgjatja ka ndodhur në mungesë të mjeteve financiare dhe nëse doni t'i ndihmoni shkurtimit të realizimit të projektit, ndihmoni me mjete financiare Komunës së Gjakovës, e jo me retorikë, e cila nuk ka mbështetje të mirëfilltë.

Projekti i lumit Krena është projekt i nisur në vitin 2013 dhe është në fazën finale dhe me mundësinë që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja ministre, urdhëro!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

Deputete,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është duke i realizuar të gjitha përgjegjësitë që ka marrë për trajtimin e ujërave të zeza në gjithë Republikën e Kosovës. Konsideroj se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merret me pjesën e pëlqimeve mjedisore, lejeve mjedisore, ujore dhe ndërtimore. Konsideroj që nëse Komuna e Gjakovës në të kaluarën ka marrë përgjegjësi për t'u marrë me këto çështje, me shpronësimin dhe me përgatitjen e vendit për ndërtimin dhe për krijimin e impiantit, atëherë është dashur dhe do të duhej të kërkohej llogari nga menaxhimi dhe nga politikat që janë bërë në Komunën e Gjakovës.

Unë konsideroj se jemi në rrugë të mirë dhe do të mundohemi për të gjithë, në bazë të kompetencave që kemi si ministri ta realizojmë gjithë punën që ne e kemi, mirëpo është një projekt i madh, i cili nën përgjegjësi ka edhe institucionet tjera, që duhet të jenë përgjegjëse dhe të japin llogari, qoftë edhe, ashtu siç e thatë, në stërzgjatjen e këtij realizimi të këtij projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, pyetje për ministrin Rustem Berisha. Kur të kthehet, ia japim mundësinë. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. As deputetja Ganimete s'është këtu. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Mahir Jaghillar.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Në kuadër të ministrisë që ju drejtoni vepron edhe Instituti Kosovar për Administratë Publike, i cili, siç e dimë, ka për detyrë trajnimin e shërbyesve civilë për tema të ndryshme, që janë nevojë e shërbyesve civilë. Ata tashmë e dinë që në kuadër të strategjisë së tyre e kanë hartuar edhe katalogun e trajnimeve që ofrojnë, mirëpo shumë shpesh ne kemi parë që zyrtarë të ndryshëm të institucioneve publike, si ata të ministrive, por edhe të komunave, marrin pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara nga organizata të ndryshme, e të cilat nuk e dimë nëse janë të certifikuara apo jo për temat për të cilat ofrojnë trajnime, e për të njëjtat tema është përgjegjës dhe ka mundësi t'i ofrojë edhe Instituti Kosovar për Administratë Publike.

Ne e kemi shtruar këtë çështje, siç e di, shumë shpesh edhe në komision, por tani do të doja të dija nëse këtë e keni adresuar edhe në kuadër të Qeverisë që zyrtarët tanë të shërbimit civilë për temat të cilat i ofron Instituti Kosovar për Administratë Publike të mos marrin pjesë në trajnime me pagesë, do të thotë trajnime për të cilat paguajnë institucionet tona, e për të cilat nuk mund të dimë se me çfarë kualiteti ofrohen. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI MAHIR JAGXHILLAR: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete, zonja Pantina, faleminderit për pyetjen dhe vërtet në njëfarë mënyre edhe qëndron ky konstatim, sepse pa marrë parasysh që këto çështje i kemi shtruar edhe në takimet e Qeverisë, por gjithashtu kemi propozuar në njëfarë mënyre nëpërmjet strategjisë së trajnimeve të shërbyesve civilë që këto çështje të rregullohen dhe të realizohen nëpërmjet Institutit të Administratës Publike, ende ekzistojnë projektet ose trajnimet të cilat realizohen edhe jashtë sistemit të strategjisë, ose trajnimet individuale nëpërmjet institucioneve të ndryshme.

Kjo çështje është shtruar disa herë në takime të Qeverisë dhe ekziston gjithashtu vendimi i Qeverisë që këto çështje të mos realizohen në këtë aspekt, por pas vendimit të Qeverisë mund të deklaroj se është zvogëluar numri i realizimit të trajnimeve të tilla, por disa institucione, sidomos institucionet e pavarura, institucione që janë jashtë Administratës Shtetërore që kanë shërbyes civilë ende realizohen këso të lloj trajnimeve, për të cilat edhe unë mendoj që nuk ka nevojë. Ne si Qeveri duhet ta përforcojmë statusin e institutit të Administratës Publike, por e cila duhet të realizohet edhe nëpërmjet përkrahjes edhe më të madhe financiare. Ne jemi në fazën e riorganizimit edhe të ministrisë, por sidomos riorganizimit të statusit të Institutit të Administratës Publike, me çka do të synojmë që këto dukuri negative t'i eliminojmë, sepse në qoftë se bëhen trajnime të ndryshme, atëherë efekti i profesionalizimit të stafit, ose Administratës Publike, ose

shërbyesve civilë, do të jetë i mangët. Në këtë aspekt, duhet të veprojmë sipas sistemit, i cili është përfshirë në strategjinë e trajnimeve të shërbyesve civilë.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Ministër,

Është në rregull që ju konstatooni se gjendja është kështu, por nga Qeveria kërkohet që të rregullohet problemi. Kjo po vazhdon të jetë problem. Nuk ka asgjë të keqe që shërbyesit civilë t'i ngrenë kapacitetet e tyre dhe nëse duan ta bëjnë atë jashtë Institutit Kosovar për Administratë Publike, për këtë ata duhet të paguajnë nga xhepi i vet, apo forma tjera të financimit, e jo të paguajë Qeveria, përkatësisht komunat apo institucionet tjera publike. Dhe, një fenomen tjetër, që po ashtu po ndodh nëpër institucione, shpresoj që është zvogëluar, por, për fat të keq, ende ekziston, është se për pozita të caktuara për të cilat kërkohen kualifikime shtesë në aspektin akademik, shpeshherë njerëzve që janë shkolluar me paratë e tyre u pamundësohet, sepse për këto pozita paguan veç Qeveria, kemi raste kur Qeveria për zyrtarët e vet ka paguar edhe studime master, e këta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI MAHRI YAGCILAR: Sa i përket pjesës së parë të konstatimit të pyetjes shtesë, unë mund të ritheksoj se ekziston vendimi i Qeverisë për mosrealizimin e kësaj lloji trajnimeve, por ka nevojë për një disiplinë më të madhe edhe për brenda institucioneve, brenda zyrtarëve që udhëheqin institucionet e i zbatojnë vendimet, por nuk është vetëm të kesh një vendim, është një pretendim që përmes IKAP-it do të përfitojnë të gjitha institucionet e shërbyesve civilë.

Sa i përket konstatimit të pjesës tjetër, çështjet janë realizuar prapë me rregullore, ndoshta nuk ekziston ndonjë ligj bazik, i cili rregullon këto çështje, por unë sa e di, institucionet në ato raste, ku kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve përbrenda institucioneve dhe kur janë raste që ndihmojnë zhvillimin e institucionit, atëherë lejohet, por janë situata të veçanta, të cilat nuk janë të rregulluara.

Besoj që në plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbimin civil do të trajtohen edhe këto çështje dhe çështjen deri tash që e kemi pasur sa u përket kuadrove të reja, të cilat studiojnë dhe realizojnë masterin edhe përmes përkrahjes së Komisionit Evropian, por edhe në raste të tjera ose në projekte të tjera këto çështje të rregullohen në një farë mënyre përmes dispozitave ligjore dhe me ligjin e ri e kemi propozuar një zgjidhje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Adem Mikullovc i ka pyetje për ministrin Skender Reçica.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kisha pasur këtë pyetje më tepër për kryeministrin dhe për ministrin e Drejtësisë, ata të dytë po mungojnë, kështu që e kisha lënë për seancën e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Si deputet me përvojë, shtroje pyetjen më herët se pastaj nuk të përgjigjen ata, edhe po të ishin sot, nuk kisha pasur mundësi, e parashtron pyetjen më herët apo po e lë për herën tjetër?

ADEM MIKULLOVCI: E kam parashtruar me kohë, moti, ka qenë kërkesë, e kam parashtruar edhe një herë për pensionin artistik njerëzve që kanë lënë gjurmë në art dhe në kulturë. E kam parashtruar si kërkesë, e jo si pyetje, formulimi është i gabuar, si duket.

KRYETARI: Nuk prish punë, të mos hyjmë në procedura.

Ministër, deputeti e ka pasur një pyetje edhe publike, edhe shqetësim, e ka parashtruar edhe pyetje zyrtare për artistët.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Mikullovc,

Faleminderit edhe për pyetjen, edhe për çështjen që e keni ngritur që artistët në përgjithësi, edhe komuniteti kulturor dhe i artit të trajtohen me një ligj të veçantë për pensionet e tyre.

Unë konsideroj se trajtimi i artistëve dhe i komunitetit të artit me një ligj të veçantë do të na bëjë nder në radhë të parë ne si shtet, por edhe komunitetin e artit në përgjithësi.

Më lejo të theksoj se aktualisht sistemi pensional në Kosovë është ndërtuar në disa shtylla dhe është rregulluar me disa ligje të ndryshme.

Me të marrë mandatin si ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, kam futur në program legjislativ reformën pensionale, sepse sistemi pensional në Kosovë ka hasur dhe është duke hasur në vështirësi të vazhdueshme.

Tash kemi identifikuar problemet me të cilat ballafaqohen pensionistët tanë. Duke u nisur nga pranimi i stazhit të punës, pensionet e dyfishta, por gjithashtu edhe vështirësitë për mbulimin e pagesave të pensioneve nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në programin legjislativ të Qeverisë për këtë vit ka paraparë hartimin e koncept-dokumentit për Ligjin e pensioneve. Për të realizuar këtë tashmë kemi formuar grupin punues dhe ky grup ka nisur të hedhë në letër idetë e shohitura nga analizat që janë bërë nga ekspertët e brendshëm në bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me ekspertët ndërkombëtarë.

Gjithashtu në këtë kontekst grupi punues është duke shikuar edhe përvojat e vendeve të rajonit, por edhe vendeve të Bashkimit Evropian, që reforma pensionale të jetë afatgjate, t'i mbijetojë kohës dhe njëkohësisht të jetë në të mirë të pensionistëve dhe shtetit të Kosovës në përgjithësi.

Në kuadër të këtij procesi ne do të konsultojmë të gjitha palët e interesit, duke u ndërlidhur konkretisht me pyetjen tuaj, natyrisht se në këtë proces do të konsultohemi edhe me Ministrinë e Kulturës dhe me komunitetin e artistëve për të shikuar mundësinë që pensionet e artistëve kombëtarë, por edhe pensionet e kategorive që kanë dhënë kontribut të veçantë për vendin, të trajtohen në mënyrë meritore.

Unë si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale jam i përkushtuar të punoj me të gjithë, për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme për secilin kontribuues të shoqërisë tonë, çdo herë duke pasur parasysh edhe mundësitë buxhetore të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, fjala është për ju. Ka pyetje shtesë.

ADEM MIKULLOVCI: Kam frikë, zoti ministër, ndoshta edhe nuk jemi kuptuar mirë, sepse ndoshta unë nuk po di ta artikuloj.

Këtu është një çështje tjetër, duhet marrë një ligj, një vendim, për krijuesit, për njerëzit që kanë lënë gjurmë në artë e kulturë, numri është shumë i vogël, shumë i kufizuar. Ky pension nuk është harxhim i madh për shtetin, është dyfishi, trefishi i pensionit të zakonshëm. Por është nderim për krijuesin dhe është një numër shumë i vogël.

Nuk po di si ta formuloj, po ky duhet të jetë një farë lloj Nobeli për Kosovën, duhet pasur shumë kujdes që t'u jepet vetëm atyre që vërtet kanë lënë gjurmë dhe me veprat e veta kanë bërë diçka në art, e jo secilit. Ju po flisni në përgjithësi, kjo në rregull në përgjithësi, sa të mundni t'i rrisni pensionet, po këtu do të kërkohet një nderim, një status i veçantë për njerëz të rrallë.

Unë atë ditë kur fola thashë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ministri ka përgjigje shtesë.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Deputet Mikullovc, Faleminderit edhe një herë!

Unë shpjegova që çka jemi duke bërë ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale rreth pensioneve të të gjitha kategorive, përfshirë edhe komunitetin e artistëve dhe natyrisht nuk e kontestoj aspak idenë që artistët, njerëzit, qytetarët e kulturës, kontribuuesit e kulturës të trajtohen me një ligj të veçantë.

Përderisa ju bëni pyetje shtesë, shfrytëzova rastin e bisedova me ministrin e Kulturës që e kisha pranë dhe po më shpjegon që e kanë në procedurë hartimin e një rregulloreje, e mandej të një ligji për trajtimin e artistëve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, për respekt, ministri i Kulturës jep përgjigje për të njëjtën çështje.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Mikullovc,

Edhe njëherë prej seancave të fundit e keni ngritur këtë çështje, por edhe me kërkesë të kryetarit i kemi filluar procedurat, e kemi themeluar edhe grupin punues dhe së shpejti do ta hartojmë një rregullore, e cila ka për qëllim trajtimin e të gjithë njerëzve të artit dhe të kulturës në Kosovë, duke u ndarë çmime, po në të njëjtën kohë edhe duke i trajtuar në pjesën e kohës së moshuar deri te pjesa e pensionit. Pra do ta kemi dokument të përbashkët, ku do ta përfshijmë edhe komunitetin artistik në hartimin e kësaj rregulloreje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Duda Balje ka pyetje për ministrin Nenad Rikallo. Deputete, ministri nuk është. E lë për më vonë.

Deputeti Arbër Rexhaj ka pyetje për ministren Albena Reshitaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë do ta ngre çështjen e deponisë së mbeturinave në Landovicë dhe, si fillim, do ta bëj një pyetje të shkurtër: A je në dijeni për këtë deponi dhe, së dyti, a e di shkaqet e problemeve të kësaj deponie deri te sjellja e sëmundjeve të ndryshme që po hasin qytetarët e fshatit Landovicë?

KRYETARI: Zonja ministre, fjala për ju!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Rexhaj,

Faleminderit për pyetjen.

Po, jam e informuar për këtë deponi legale, ashtu siç jam informuar për të gjitha deponitë legale dhe ilegale në gjithë Republikën e Kosovës.

Ajo çfarë kam bërë në marrje të mandatit në këtë ministri ka qenë llogaridhënia dhe përgjegjësia ndaj asaj se çfarë është bërë deri më tani me këto deponi.

Konsideroj se është shumë e rëndësishme që ne të fillojmë nga baza nëse duam t'i qasemi një problematike dhe të kemi sukses dhe rezultate konkrete.

Kam kërkuar nga Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor raporte se çfarë kanë bërë për të inspektuar gjendjen dhe menaxhimin e të gjitha deponimeve legale në vendin tonë, më pastaj kam kërkuar nga inspektoratet komunale se çfarë ata kanë bërë dhe nëse ka ekzistuar një bashkëpunim dhe bashkërendim në mes të inspektorateve që mendoj se është kyçe për sukses në menaxhim të deponive legale në vendin tonë dhe më pastaj kemi filluar planin, strategjinë e intervenimeve emergjente, sepse ka nevojë për intervenime emergjente në deponitë legale në gjithë vendin tonë, por edhe në plane afatgjate, në strategji të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave në gjithë Republikën e Kosovës.

Jam e shqetësuar me gjendjen në të cilën ekzistojnë deponitë legale dhe menaxhimi i tyre. Është një shqetësim i madhe edhe institucional, por edhe i shoqërisë civile dhe i gjithë qytetarëve. Jemi duke punuar në rikuperimin e tyre që e konsideroj se nuk është e mjaftueshme të bëhet vetëm rikuperimi. Ato deponi legale duhet të trajtohen thellësisht nga baza. Konsideroj se për disa nga to duhet të rishikohet studimi i fizibilitetit, i cili është bërë nga ekspertë të ndryshëm, vendorë dhe ndërkombëtarë, sepse konsideroj se disa prej tyre duhet t'u ndërrohet pozicioni i tyre dhe menaxhimi i tyre të jetë i duhur.

Ajo çka unë dua t'ju jap si informacion është se tashmë Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është në dijeni edhe për shqetësimet e qytetarëve, janë duke inspektuar gjendjen në deponinë legale në Landovicë.

Sa u përket deponive ilegale, ne kemi filluar shkatërrimin e të gjitha atyre.

Dua të falënderoj në këtë rast edhe shoqërinë civile që është duke ndihmuar jashtëzakonisht shumë, Ambasadën Amerikane, Komisionin Evropian, gjithashtu USAID-in dhe shumë organizata të tjera joqeveritare në mbrojtje të mjedisit, të cilave ua kemi hapur derën që bashkërisht, sepse mbrojtja e mjedisit, gjegjësisht trajtimi i menaxhimit të mbeturinave në një farë mënyre është përgjegjësi e të gjithëve, andaj duhet të gjithë aktorët të jenë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti ka ende pyetje shtesë? Urdhëroni, fjala për ju!

ARBËR REXHAJ: Ministre, në këtë fshat, në spitalin e Prizrenit janë të lajmëruara dhjetë raste për shkak të infeksionit dhe po ashtu tashmë edhe uji atje është i ndotur dhe shpeshherë qytetarët kanë problem edhe me ujin e pijshëm.

Prandaj, unë publikisht të ftoj që së bashku me mua, në një ditë të zakonshme të vini atje dhe të shikojmë e t'i shikojmë hallet e qytetarëve atje.

Së dyti, përmendet me shqetësim numrin e madh të deponive ilegale, mirëpo thatë që ka shqetësim edhe për deponitë legale. Pra, sa është numri i këtyre ilegale? Dhe sa shqetësuese janë këto deponi legale, po në epiqendër e pata Landovicën. Prandaj, edhe një herë po e përsëris, të ftoj që së bashku të shikojmë atje dhe ta shikojmë gjendjen e qytetarëve.

KRYETARI: Zonja ministre, fjala për ju!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar deputetë, Gjithsesi do të shikojmë dhe do ta vizitojmë, mirëpo unë kam qenë në vendin e ngjarjes dhe e kam vizituar jo vetëm deponinë legale të Landovicës, por edhe deponitë e tjera.

Mendoj që është mirë të jemi sa më transparent para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe jam duke punuar në një projekt në ministri për incizimin e situatës me dron të të gjitha deponive legale në vendin tonë, sepse deponitë ilegale nuk është problem të shkatërrohen, problem është menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave në vendin tonë.

Ne si institucione duhet të punojmë më shumë në atë që t'i japim një projekt, një strategji menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave. Prandaj, jemi duke punuar jashtëzakonisht shumë në këtë çështje.

Jam e vetëdijshme për problematikat e ujërave të zeza që rrjedhin nga deponia. Prandaj, e theksova në fillim, ne duhet të kërkojmë llogari, sepse asgjë nuk mund të ketë sukses nëse nuk kërkojmë llogari pse jemi në këtë situatë të cilën jemi sot, sepse nëse ne vazhdojmë të merremi tërë kohën me rikuperime, atëherë nuk do të kemi mundësi të kemi një rezultat konkret dhe të suksesshëm në përfundim.

Prandaj, nëse nuk i qasemi me seriozitet dhe nuk kërkojmë përgjegjësi dhe llogari edhe për stërzgjatje të ndryshme të projekteve, mendoj që është e kotë nëse ne mendojmë që po bëjmë diçka.

Prandaj, mendoj që duhet të jemi shumë vigjilentë sa i përket kësaj çështjeje. Po them që jemi në rrugë të duhur, dua t'i falënderoj të gjithë ekspertët që tashmë janë duke punuar, falënderoj edhe GIZ-in gjerman të gjitha këto statistika sa u përket numrit dhe vendndodhjes së dopinive ilegale i kemi marrë nga GIZ-i gjerman, të cilin dua ta falënderoj shumë, sepse është duke punuar jashtëzakonisht shumë në këtë çështje.

Dua të ju informojë edhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Na paska ndihmuar GIZ-i, por ministria jonë më mirë është t'i ketë. Faleminderit prej GIZ-it.

Pyetjet e parashtruara për herë të parë. Unë do të mundohem t'i lexoj, u mundova t'i shikoj deputetët, edhe ministrat të cilët janë këtu. Do të shkoj një herë vetëm tek ata, pastaj do të kaloj te të gjithë të tjerët me rend, po do të shkoj, do t'i lexoj të gjitha emrat. Në fillim po shkoj me ato pyetje për të cilat janë edhe ministrat.

Deputeti Valentina Bunjaku-Rexhepi ka pyetje për ministrin Rrustem Berisha, më herët deputetja nuk qe e pranishme. Urdhëroni!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje, ju deputetë dhe ju deputete,

Pyetja ime për ministrin është: Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e 7.3 hektarëve të tokës dhe një shume fillestare prej 600 mijë eurosh për ndërtimin e kampusit të Universitetit "Kadri Zeka", i cili është në harmoni të plotë me planin rregullues urban, të aprovuar edhe nga Kuvendi Komunal i Gjilanit.

Ju si ministër keni bërë një shkresë për pezullimin e këtij vendimi, duke rënë në kundërshtim edhe me Qeverinë, edhe me planin rregullues urban të Komunës së Gjilanit.

Çfarë keni bërë konkretisht për ta zgjidhur përplasjen tuaj si ministër me shkresën e pezullimit të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e kampusit "Kadri Zeka", në parcelën ku tani më është FSK-ja?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Çështja që ngriti deputetja, faleminderit për pyetjen.

Së pari është një çështje shumë e rëndësishme për FSK-në dhe ky vendim realisht prek hapësirën ku është i vendosur Batalioni i Tretë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë.

Ky batalioni është i vendosur që nga viti 2009, në këtë hapësirë janë bërë shumë investime milionëshe dhe arsyeja pse e kemi bërë shkresën ka të bëjë që ne bashkërisht ta gjejmë një zgjidhje, e cila do të jetë edhe në pajtim me Kuvendin Komunal të Gjilanit, por ta shqyrtojmë, ta gjejmë zgjidhjen më të mirë që do të jetë edhe në favor të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Siç e dini, sipas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, po ashtu sipas planit gjithëpërfshirës për transformim, kjo njësi ose njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të dyfishohen. Ne në këtë hapësirë e kemi ngritur batalionin model, i cili është bërë edhe në pajtim me partnerët tanë strategjikë edhe ne kemi afruar gatishmërinë që në bashkëpunim edhe me Kuvendin Komunal të Gjilanit ta gjejmë një zgjidhje adekuate, por deri atëherë mendoj se duhet të analizohen mirë këto fakte, është një hapësirë strategjike për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në të njëjtën kohë kemi afruar gatishmëri që ta gjejmë zgjidhjen adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, deputete? Fjala për ju!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Zoti ministër,

Ju keni parasysh se për momentin ku qëndron FSK-ja është e papërshtatshme edhe për FSK-në, sepse ka ndërtime të larta aty përreth dhe helikopterët, në qoftë se ka nevojë nuk mund të zbresin aty për shkak të ndërtimit të lartë.

Dhe, ju e dini që hapësira për Universitetin “Kadri Zeka” është më se e domosdoshme dhe kampusin “Kadri Zeka”, e ai vend është i përshtatshëm.

Ne nuk jemi kundër FSK-së, po besoj që ka mundësi të gjendet një zgjidhje më e mirë për FSK-në në ndonjë hapësirë tjetër, qoftë edhe jashtë komunës së Gjilanit.

Reagimet tuaja apo përgjigjja juaj konkrete: çka keni ndërmarrë dhe çka do të ndërmerrni sa më shpejt që është e mundur që Universiteti “Kadri Zeka” të kalojë te FSK-ja dhe FSK-ja të zhvillohet me një hapësirë tjetër në Gjilan apo edhe jashtë Gjilanit. Ne e kemi dhënë edhe si propozim, si deputetë, që edhe në pjesën e Kamenicës mund të bëhet një hapësirë e madhe për FSK-në. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, deputete!

Realisht, vendimi i Kuvendit Komunal të Gjilanit është që nga viti 2013, kur ishte edhe në atë kohë ka qenë kryetari i Komunës i partisë tuaj, po në të njëjtën kohë ka qenë edhe ministri i FSK-së i LDK-së, edhe është trajtuar kjo çështje, edhe në atë kohë e kanë marrë përgjigjen negative nga ministri Haki Demolli.

Duhet ta kemi parasysh se hapësira për të cilën bëhet fjalë është pronë e ish-armatës jugosllave.

Komuna e Gjilanit deri më tani e ka marrë edhe hapësirën ku ka qenë shtëpia e ish- armatës jugosllave, e ka marrë edhe hapësirën ku ka qenë mbrojtja territoriale, ku tani është Kuvendi Komunal, edhe ne duhet ta vlerësojmë në aspektin strategjik. Nuk jemi në kundërshtim që kjo hapësirë të shfrytëzohet për kampusin universitar, po ne duhet të analizojmë hapësirën në aspektin strategjik, a është më e rëndësishme për Forcën e Sigurisë, apo për kampusin universitar, mendoj që zgjidhja do të gjendet.

Disa herë e kemi ftuar kryetarin, Lutën, në takim, por ai nuk po përgjigjet, sigurisht se ka problemet me telefon. Faleminderit!

KRYETARI: Do të kalojmë me pyetjet e parashtruara. Ganimetja nuk qenka, të gjithë deputetët i kam thirrur.

Shkojmë vetëm në pyetjet ku janë ministrat dhe deputetët, pastaj për të gjithë.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila ka pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Ministër, njëjtë sikur edhe ministrja Reshitaj, në vizitën tuaj më 7 shkurt 2018 keni përmendur projektet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për komunën e Gjakovës. Në mesin e tyre edhe kompleksin e tenisit, projekt ky i tenderuar dhe me kontratë të nënshkruar në vlerë prej 489 mijë eurosh.

Për informatën tuaj, ministria që ju e drejtoni për vitin 2018 ia ka hequr po të njëjtit projekt 350 mijë euro, duke e lënë me vetëm 100 mijë euro të destinuar për ndërtimin e saj.

Sikur kjo të mos ishte e mjaftueshme, ju dhe Komuna e Gjakovës bashkërisht jashtëligjshëm keni sjellë vendim të ndërhyri në territorin e projektit të tenderuar dhe planifikoni të ndërtoni një terren sintetik të futbollit, gjithashtu bashkëfinancim me ministrinë tuaj.

Ministër, si planifikoni të financoni punimet e terrenit të tenisit, pasi keni tërhequr shumën prej 350 mijë eurosh nga vlera fillestare edhe nënshkrimi i kontratës? Si dhe a jeni konsultuar bashkë

me Komunën e Gjakovës kur keni ndërhyrë në projektin e fushave të tenisit? Rrjedhimisht, si e shpjegoni faktin se ndërhyrjet në territorin e projektit, përkundër që kontrata është e nënshkruar prezantojnë shkeljet e Ligjit të prokurimit, Udhëzimi administrativ numër 06/2011, neni 33, specifikimet e sasive në tender dhe në kontrata.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete zonja Kusari,

Lidhur në pyetjen tuaj më duhet t'ju vej në dijeni se gjatë vitit 2017 në këtë buxhet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pasur të planifikuara 150 mijë euro për ndërtimin e kompleksit të fushave të tenisit në komunën e Gjakovës.

Mirëpo, me vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 2.08.2017, me numër 08/151, ka pasur reduktime të fondeve. Andaj, nga ky fond janë reduktuar 120 mijë euro për projektin e fushave të tenisit në komunën e Gjakovës, por këtë reduktim e ka bërë ish-Qeveria, jo Qeveria aktuale.

Ndërsa sa i përket buxhetit për vitin 2018, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka të ndara dhe të planifikuara 100 mijë euro për këtë projekt dhe pjesën tjetër mendojmë që ta ndajmë me rastin e rishikimit të buxhetit në qershor të këtij viti.

Kurse sa i përket ndërhyrjes në projekt, ne për këto nuk kemi informata, sepse procedurat janë zhvilluar në Komunën e Gjakovës. Ne çka kemi informacione ose ju kemi drejtuar me një kërkesë Komunes së Gjakovës për të ndarë hapësirë për ndërtimin e fushës me barë sintetik dhe kemi marrë përgjigjen se Komuna e Gjakovës, në një prej mbledhjeve të Kuvendit të Komunes e ka ndarë hapësirën për ndërtimin e këtij stadiumi, i cili ka për qëllim rregullimin e infrastrukturës për klubin e futbollit të Gjakovës, i cili është në super ligën e Kosovës.

Sa i përket ndërhyrjes në projekt, këto janë tërësisht në kompetencën e Komunes së Gjakovës.

Pra, Ministria e Kulturës nuk ka ndërhyrë në projekt dhe nuk ka informata që ka lëvizje në këtë projekt.

Kurse mjetet, thashë që janë dhe do të ndahen me rastin e rishikimit të buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre, pyetje shtesë, urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Nejse, deputete jam për momentin.

KRYETARI: Kërkoj falje!

MIMOZA KUSARI-LILA: Zoti ministër!

Faleminderit për sqarimin,

Për informatën tuaj jo që është ndërhyrë në projekt, po jashtëligjshëm është lëshuar leje mbi leje, që do të thotë se me projektin e parë ju mbani përgjegjësi gjithashtu, për arsye se duhet menaxheri i projektit për mjetet e shpenzuara nga ministria t'ju informojë se në kuadër të parkingut të fushave të tenisit planifikohet të ndërtohet fusha sintetike e futbollit.

Jashtëligjshëm gjithashtu, se nuk ka precedent, mund ta konsultoni ministren Reshitaj, nëse ka mundësi që në një hapësirë të njëjtë të lëshohen dy leje ndërtimi një përmbi një. Domethënë, kjo është për momentin situata në komunën e Gjakovës, në terrenin e njëjtë ku janë planifikuar fushat e tenisit dhe ku është planifikuar terreni sintetik i futbollit.

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, edhe një herë!

Thashë, kjo është ndërhyrje nga Komuna e Gjakovës, jo nga Ministria e Kulturës.

Ne kemi një anëtar në organin mbikëqyrës të projektit dhe të njëjtin do ta autorizojmë që të shohë nga afër se çka ka ndodhur, nëse është ndërhyrë në këtë projekt.

Përndryshe, Ministria e Kulturës nuk mban përgjegjësi për ndërhyrjet në projekte nga Komuna e Gjakovës, sepse ne jemi të zotuar dhe jemi të vendosur që të ndajmë fondin dhe ta mbështesim projektin, kurse procedurat, edhe një herë po e përsëris, i ka zhvilluar Komuna e Gjakovës.

Kurse te pjesa e ndërtimit të fushës me barë sintetik ne kemi kërkuar dhe Kuvendi Komunal i Gjakovës e ka marrë vendimin, kryetari i komunës na ka njoftuar se hapësirën e kanë caktuar. Kurse sa i përket nëse është marrë vendim mbi vendim, ne do ta analizojmë dhe do ta shqyrtojmë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha ka pyetje për ministren Albena Reshitaj.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Siç e dimë të gjithë, ka kohë që Serbia në pjesën veriore të Kosovës është duke e ndërtuar një koloni që quhet "Lugina e Diellit". Në bazë të një prononcimi publik të kryeinspektorit, del se komuna përgjegjëse për atë hapësirë të Kosovës nuk bashkëpunon me ministrinë dhe nuk ofron dokumente të mjaftueshme se çka është duke ndodhur.

Ministre, çfarë masash shtesë jeni duke marrë që të mos realizohet një projekt i financuar nga Serbia që mendojmë se i takon të kaluarës për kolonizimin e asaj pjese dhe në cilën situatë gjendet ajo hapësirë, për të cilën ka vjet që është duke u folur dhe për folur publikisht, po nuk ka ndonjë të dhënë detale as Kuvendi dhe as opinioni i gjerë?

KRYETARI: Urdhëroni, fjala për ju, zonja ministre!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Berisha,

Lidhur me punimet në Luginën e Diellit, të ashtuquajtur, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kryer mbikëqyrje me procesverbal në Drejtorinë e Urbanizmit në Zveçan, me ç' rast ka kërkuar nga kjo drejtori që të prezantojë dokumentacionin teknik rreth ndërtimit në fjalë.

Drejtorja e Urbanizimit në ditën e inspektimit nuk ka qenë e gatshme të ofrojë dokumentacionin e kërkuar nga Inspektorati i Ministrisë. Prandaj, me procesverbal ka urdhëruar Drejtorinë e Urbanizmit që dokumentacioni i kërkuar të sillet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në afatin e caktuar.

Drejtorja e Urbanizmit të Komunës së Zveçanit nuk i është përgjigjur urdhëresës së Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Nga të gjitha këto sa u përmend më lart, nga Inspektorati i ministrisë është konstatuar se Komuna e Zveçanit si dhe Drejtorja e Urbanizmit të kësaj komune janë përgjegjëse për moszbatimin e urdhëresës së dhënë nga Inspektorati i ministrisë, veprim i cili është shkelje e Ligjit për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit me numër 04/L-175, për të cilin gjë është bërë inicim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë kundër Komunës së Zveçanit si person juridik dhe drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit të kësaj komune, si person përgjegjës.

Ju rikujtojmë se për objektet e kategorisë së parë dhe të dytë komuna është kompetente për dhënien e lejes ndërtimore. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Berisha?

ZAFIR BERISHA: Ministre, siç e dimë edhe nga praktika në të kaluarën, në momentin që komuna nuk bashkëpunon ju keni bërë një kallëzim penal, i cili do të myket në sirtar të gjykatave. Çfarë masash konkrete keni marrë, meqë organet e nivelit të dytë të pushtetit nuk bashkëpunojnë, nuk funksionojnë, ju keni kompetenca që të ndërmerrni masa të drejtpërdrejta për t'ua rikujtuar diçka të ngjashme.

Në komunën të Prizrenit drejtpërdrejt ministria në të kaluarën ka ndërmarrë masa të veprimit për t'i ndalë punimet pa leje në zonat e caktuara. A keni plan apo keni bërë veprime konkrete pa Komunën e Zveçanit? Se në fund të fundit, Komuna e Zveçanit është ajo që i zbaton politikat e Vuçiqit.

Unë e di që ky projekt i tejkalon kompetencat tuaja dhe fuqinë e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar deputet Berisha, E kuptoj shqetësimin tuaj edhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Politikat e gabuara të Serbisë, sidomos ashtu siç e potencuat viteve të fundit, janë të involvuara drejtpërdrejt edhe në këtë problematikë, në këtë çështje të cilën ju po e theksoni.

Ne duhet të presim përgjigje, për shkak se ne kemi vepruar në bazë të përgjegjësive dhe kompetencave që kemi si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ekzistojnë afatet kohore të caktuara me ligj, sa neve na duhet të presim për përgjigje ose për reagim institucional, e më pastaj do të vazhdojmë në bazë të përgjegjësive që kemi të kërkojmë të drejtat tona ligjore sa i përket kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Uran Ismajli nuk është këtu, sipas pyetjeve që kanë zoti Rrahmani, Kadrijaj, zoti Kurteshi.

Vazhdojmë me pyetjen për ministrin Shyqiri Bytyqi nga Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Në kuadër të raportit vjetor të Qeverisë në fund të vitit kalendarik Ministria e Arsimit është e obliguar, bazuar në Ligjin për arsim parauniversitar, neni 5, pika 4 të raportojë për zbatimin e Ligjit të arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit në Kosovë.

Sipas këtij ligji, ju duhet të raportoni edhe për mësimin në gjuhën serbe në shkollat e Kosovës.

Zoti ministër,

A ju vijnë raportet nga shkollat me mësim në gjuhën serbe? Nëse po, a zbatohet Ligji për arsim parauniversitar në shkollat me mësim në gjuhën serbe?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Kurteshi, faleminderit për pyetjen!

Konsideroj që është një pyetje me rëndësi të veçantë dhe shqetësuese për situatën që jemi aktualisht, pavarësisht që në dokumentet e arsimit komuniteti zë një hapësirë të mirë dhe ka mundësi që të gjitha të drejtat e tyre të jenë të aplikueshme dhe të zhvillohen. Po ashtu, bëhet një përpjekje e jashtëzakonshme që të gjitha komunitetet të jenë të integruara në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës. Këto janë planifikuar në dokumentin strategjik për të gjitha mundësitë që çdo komunitet ta gjejë hapësirën e duhur për integrim dhe për t'i zhvilluar dhe edukuar të rinjtë është më se e domosdoshme.

Deri më tani, fatkeqësisht, të gjitha shkollat të cilat mësojnë në gjuhën serbe vazhdojnë ta aplikojnë sistemin e Republikës së Serbisë dhe jo sistemin e Republikës së Kosovës. Aktualisht, ajo çka ne kemi bërë është ngarkuar zëvendësministri, zoti Bajrush Cezari, si zëvendësministër i MASHT-it, për t'u marrë me çështjen e komuniteteve veçanërisht për shkollat, të cilat nuk janë të integruara në sistemin e Republikës së Kosovës. Ai është duke e bërë një punë në terren, ka filluar nga pjesa jugore, sepse edhe në pjesën jugore kemi shkolla, të cilat nuk janë të integruara në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, për të parë se cilat janë pengesat dhe cilat janë mundësitë që pastaj në bashkëpunim edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë ta gjejmë mënyrën që vërtet të gjitha komunitetet të integrohen në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, asnjë shkollë e cila mëson në gjuhën serbe deri më tani nuk raporton në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përjashtoj Komunën e Kamenicës që jep disa informacione në sistemin SMIA, ndërsa sipas Ligjit të arsimit parauniversitar nuk kemi raporte që marrim deri më tani. Pasi t'i kemi rezultatet nga terreni, që udhëhiqen nga zëvendësministri i Arsimit, ne do të shkojmë tutje që ta kemi një komision shtetëror, siç është edhe planifikuar për ta parë mundësinë e ri integritit të këtyre shkollave në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti deputet Kurteshi, dëshironi pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Po, ministër! Përveçse nuk i respektojnë ligjet e Kosovës, shkollat në gjuhën serbe përdorin edhe tekste shkollore që janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e

Republikës së Kosovës, ku për shqiptarët flitet në mënyrën më të keqe të mundshme. Çka keni ndërmarrë që të pengohen këto tekste? A keni provuar ndonjëherë ta vizitoni ndonjë institucion shkollor në gjuhën serbe dhe a keni ndërmarrë masa që janë në dorën tuaj? Së paku financiarisht mund t'ia merrni dikujt ndonjë mëditje ose diçka dhe, krejt në fund, a keni kërkuar ndihmën e deputetëve të Listës serbe, ose të ministrave serbë, të cilët janë në Qeverinë e Kosovës dhe të cilët do të duhej që të angazhohen që ta futin sistemin e arsimit në kuadër të arsimit të përgjithshëm.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputetë,

E theksova që është një çështje e rëndësishme dhe jo e lehtë, është përtej mundësive të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, megjithatë ne jemi duke pritur një raport nga terreni, thamë është i ngarkuar zëvendësministri me këtë çështje, dhe pasi të na vijë raporti ne do të shohim se çfarë hapash dhe mundësish mund t'i ndërmarrim.

Ne jemi të interesuar që të bashkëpunojmë edhe me deputetët e komunitetit serb, patjetër që ta gjejmë mënyrën dhe formën e integritit. Nuk është e lehtë, duhet ta pranojnë, veçanërisht situatat, të cilat janë të krijuara tani. Megjithatë, përpjekjet tona nuk do të ndalen dhe konsideroj që ne duhet të kalojmë në komision shtetëror ashtu siç ka qenë i planifikuar më herët. Komisioni shtetëror pastaj duhet të merret edhe me çështjen e teksteve, por në veçanti me formën e integritit, se po qe se ne arrijmë që shkollat në gjuhën serbe t'i integrojmë në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, konsideroj se atëherë çdo gjë do të jetë e rregulluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Bytyqi! E radhës është pyetja e zonjës Arbërie Nagavci për ministrin Shqyri Bytyqi. Zonja deputete Nagavci, e keni fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, më 15 nëntor 2017, MASHT-i e kishte shpallur konkursin "Shkencëtari i vitit 2017" dhe "Shkencëtari i ri i vitit 2017". Në pyetjen time me shkrim në lidhje me këtë çështje, ju keni njoftuar se anulimi i këtyre konkurseve ishte bërë me arsyetimin se Këshilli Shkencor i MASHT-it e kaloi numrin prej 7 anëtarëve siç ishte përcaktuar me ligj.

Pyetja ime është: A mund të na tregoni se çfarë keni ndërmarrë në raport me këtë shkelje, pra me faktin se komisioni ishte i jashtëligjshëm dhe a mban dikush përgjegjësi për këtë rast, kur kihet parasysh se ky është dështim i ministrisë, por nga ky gabim kanë pësuar kandidatët, të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs duke plotësuar edhe aplikacionet sipas kërkesave të konkursit dhe duke kërkuar dhe në mjaft raste edhe nominim nga institucionet ndërkombëtare.

Po ashtu, ju lutem, a mund të na njoftoni se kur do të rishpallet konkursi, konform Ligjit 4-04/L për veprimtari kërkimore shkencore, pasi në konkursin e kaluar theksohej se ministria e kishte krijuar një fond për çmimet vjetore. Pra, mjetet për shpërblimin e shkencëtarëve ekzistojnë dhe nuk do të ketë implikime financiare në këtë drejtim dhe a do t'i merrni parasysh aplikacionet që i kanë dorëzuar tashmë shkencëtarët e rinj apo duhet që ata të riaplikojnë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete Nagavci, faleminderit për pyetjen!

Siç e kemi sqaruar edhe herën e kaluar, konkursi për shkencëtarin e vitit është anuluar për arsye se Këshilli Shkencor nuk ka qenë në përputhje me ligjin, është përbërë nga tetë anëtarë, ndërsa ligji kërkon që të jetë me shtatë anëtarë.

Nga ajo që ne e kemi ndërmarrë është që tani jemi duke i plotësuar nënkomisionet e Këshillit Shkencor, sepse ka pas zbrazëtirë të madhe në komisione dhe, po ashtu, Komisioni Shkencor do të kalojë në formën e organizuar sipas ligjit me 7 anëtarë. Nuk kemi marrë ndonjë masë adekuate, sepse që të bëhemi realë ky ka qenë një vendim i ish-ministrit të kaluar që i ka emëruar tetë anëtarë, që nuk është në përputhje me ligjin, dhe nuk kemi mundësi ta ndërmarrim ndonjë masë të caktuar. Ajo çka ne duhet të bëjmë tani, ne nuk do të lejojmë që të kemi anëtarë jashtëligjorë, do të jenë në përputhje të plotë me ligjin, dhe po ashtu do të shpallet konkursi sipas procedurave të përcaktuara me ligjin dhe do të jetë në fazën kur është përcaktuar në fundin e vitit.

Për vitin e kaluar, do të jetë e pamundur që të rishpallim konkurs, sepse tanimë ka kaluar viti 2017 dhe Ligji i Buxhetit nuk na lejon që ta bartim në vitin 2018, kështu që për 2017 ka qenë e pamundur të rishpallet. Tani jemi në fazën kur janë kompletuar pothuajse të gjitha nënkëshillat dhe do të fillojë hapja e konkursit për vitin 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Nagavci?

ARBËRIE NAGAVCI: Do të thotë ministër, për shkak të gabimit të ish-ministrit, përkatësisht të ministrisë, të gjitha aplikacionet dhe puna e shkencëtarëve të rinj nuk do të merret parasysh dhe fondi që ishte ndarë për këtë destinacion nuk do të shfrytëzohet fare?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën?

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Fatkeqësisht po, kjo është e saktë, sepse konkursi ka qenë në fundin e vitit. Deri në finalizimin e konkursit kur na ka ardhur për shqyrtim është parë që kemi të bëjmë me një konkurs jashtëligjor, vendimi për anulimin e konkursit, pastaj është mbyllur viti dhe ka qenë e pamundur të rikthehet edhe një herë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetja tjetër është e zotit Sami Kurteshi për ministren Albena Reshitaj.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është për zotin Skender Reçica, ministrin, këtu e paskan shkruar gabimisht, për ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, po thotë zonja Reçica. S'ka zonja Reçica, gabimi është teknik, nuk e di ku, por është fjala për ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

KRYESUESI: Në rregull!

SAMI KURTESHI: Domethënë, gabimi është këtu teknik, nuk e di kush e ka bërë, po unë e kam pyetjen për zotin Reçica.

KRYESUESI: Ok! Tash, a doni ta shtyni këtë pyetje për një seancë tjetër, t'ia dërgoni ministrit në fjalë?

SAMI KURTESHI: Jo, jo, ia kam dërguar zotit Reçica, s'ka zonja Reçica si ministre, por s'di çka paska ndodhur.

KRYESUESI: Mirë, vazhdojmë me tjerët, tani merruni vesh ju. Deputeti Shemsi Syla, pyetje për ministrin Rustem Berisha. Zoti Syla, e keni fjalën.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, kryesues!

Bazuar në Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në nenin 10, paragrafi 10.2, nëpërmjet të cilit është themeluar FSK-ja, përcaktohet se Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda siç janë tanket, artileria e rëndë, apo kapacitetet sulmuese ajrore.

I nderuar ministër,

Duke marrë për bazë Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës me anë të të cilit FSK-ja përcaktohet si forcë e armatosur lehtë, si dhe duke marrë parasysh dokumentet dhe protokollat ndërkombëtare nëpërmjet të cilave definohen armët e lehta, atëherë pyetja ime është: Pse nuk është pajisur asnjëherë as me armët që në fakt i ka të lejuara përtej atyre që i ka aktualisht në inventar?

KRYESUESI: Zoti ministër Berisha, e keni fjalën.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Shemsi Syla, faleminderit për pyetjen e parashtruar!

Forca e Sigurisë së Kosovës, në kuadër të mandatit dhe misionit, ashtu siç është paraparë me nenin 5, aneksi 8 i Pakos së Ahtisarit, si dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 126, me të cilin është përcaktuar misioni aktual kushtetues, në kuadër të këtij misioni aktual kushtetues është pajisur me pajisje individuale dhe kolektive, përfshirë këtu edhe armatimin dhe municionin në përmbushje të këtij mandatit kushtetues.

Andaj, unë si ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës e konfirmoj se Forca e Sigurisë së Kosovës është pajisur sipas misionit aktual kushtetues dhe ligjor, duke e ruajtur transparencën dhe bashkëpunimin me partnerët tanë strategjikë me synim të ngritjes së kapaciteteve dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe partnerëve. Po ashtu, të nderuar deputetë, dua të ju njoftoj se Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar intensivisht që në kuadër të planifikimeve afatmesme dhe afatgjata zhvillimore të pajiset me të gjitha pajisjet e nevojshme, përfshirë këtu edhe pajisjet që do t'i ketë në misionin e ardhshëm që do të përcaktohet në të ardhmen.

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

SHEMSI SYLA: Po, zoti ministër, meqë nuk është plotësuar e gjithë ajo që është në formë ligjore, unë po drejtohem kështu se mendoj që nga deklarimi juaj mund të konkludohet se kësaj qeverie i mungon vullneti, sikur edhe aftësia për ta përmbushur misionin aktual që i lejohet. E nëse arsytimi është se nuk ka bazë ligjore për ta shndërruar FSK-në në forcë të armatosur, atëherë çfarë mungon pos vullnetit dhe aftësisë për ta përmbushur misionin aktual për të cilin kemi bazë ligjore, që t'i kemi ato armë në përdorim?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: I nderuar deputet Syla,

Ju edhe vetë keni qenë pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, jeni pjesë e ndërtimit të kapaciteteve operacionale. Unë dua të jua konfirmoj edhe një herë se Forca e Sigurisë së Kosovës i ka përmbushur kapacitetet e plota operacionale dhe me këtë armatim që posedon është e gatshme ta përmbushë misionin aktual kushtetues dhe ligjor, ndërsa për misionin në të ardhmen ju njoftova se jemi duke punuar me planifikimet afatmesme dhe afatgjata zhvillimore.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër dhe zoti Syla! Radha është e deputetes Besa Baftiu, pyetje për ministrin Skender Reçica.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Reçica,

Siguria në punë në aspektin legjislativ në Kosovë rregullohet me dy ligje: Ligjin e punës dhe Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë. Mirëpo, niveli i sigurisë në punë është ndër faktorët kryesorë që punëtorët po e humbin jetën në vendin e punës, veçanërisht në ndërtimtari, por nuk përjashtohen rastet edhe në sektorë të tjerë. Vetëm vitin e kaluar nga lëndimet e rënda në punë e kanë humbur jetën 16 punëtorë. Edhe këtë vit, për tre muaj nga lëndimet e kanë gjetur vdekjen tre persona në vendin e punës.

Ministër, pyetja ime është: A janë hetuar këto raste nga institucionet e drejtësisë? Sa vendpunishte janë inspektuar nga Inspektorati i Punës? Sa gjoba janë vendosur për kompanitë që nuk i plotësojnë kushtet e punës?

KRYESUESI: Zoti ministër Reçica, fjala është për ju.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Shumë e nderuar deputete Baftiu,

Çështja e sigurisë dhe e shëndetit në punë është një nga preokupimet kryesore të mia si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe unë ju falënderoj që sot më dhatë mundësinë që bashkërisht të diskutojmë për këtë çështje mjaft të ndjeshme.

Inspektorati i Punës është në mbikëqyrje sistematike të zbatueshmërisë së legjislacionit që e rregullon fushën e marrëdhënies së punës, por edhe sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjatë vitit 2017, Inspektorati i Punës ka realizuar 8 128 inspektime, me ç'rast janë inspektuar 38 767 të punësuar në vendet e tyre të punës. Në këtë kuadër, vetëm në sektorin e ndërtimtarisë janë realizuar përafërsisht mbi 1 500 inspektime. Gjatë vitit 2017 janë shqiptuar 233 gjoba punëdhënësve që nuk e kanë respektuar legjislacionin në fuqi.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti për fat të keq kanë qenë tri raste me fatalitet në vendin e punës. Si pasojë e aksidenteve në punë dhe përafërsisht 17 deri në 18 persona janë lënduar gjatë këtij tremujori të parë. Për të gjitha këto raste Inspektorati i Punës ka ndërmarrë masa ligjore dhe ka shqiptuar edhe gjoba konform legjislacionit në fuqi.

Gjatë këtij tremujori të parë të këtij viti, Inspektorati i Punës ka realizuar gjithsej 2 453 inspektime, nga të cilat 1 460 janë inspektime sipas planit të punës; 614 inspektime të përsëritura, me ç'rast inspektorët kanë evidentuar eliminimin e shkeljeve të konstatuara me rastin e inspektimit paraprak; 304 inspektime sipas ankesës së palëve, të cilat kanë konsideruar që po u

shkelen të drejtat e tyre juridike, si dhe 85 inspektime në bashkëpunim me institucionet tjera të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Në këtë kohë janë shqiptuar afërsisht 50 gjoba.

Duke marrë parasysh se sektori i ndërtimtarisë po konsiderohet si vend me rrezikshmëri të lartë për sigurinë dhe shëndetin në punë, nga ky muaj Inspektorati i Punës ka ndërmarrë fushatë inspektuese në sektorin e ndërtimtarisë bazuar në të gjeturat nga inspektimet paraprake dhe tashmë angazhimi i inspektoratit është ngritur në nivel edhe më të lartë.

Në këto inspektime, fokus themelor u kushtohet ndërtimeve të larta, si dhe inspektimit të ligjeve lidhur me këto ndërtime, sidomos vendosjes së skeleve dhe rrethojave mbrojtëse sipas standardeve të kërkuara me qëllim të krijimit të sigurisë në vendet e punës. Në vazhden e ngritjes së vetëdijes për respektimin e legjislacionit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Shtoja minutat regjia, sa ta përfundojë fjalën!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Në vazhden e ngritjes së vetëdijes për respektimin e legjislacionit dhe avancimit të kushteve, sigurisë dhe shëndetit në punë, Ministria e Punës në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës e kanë përgatitur fushatën vetëdijësuese për siguri dhe shëndet në punë me moton “Siguria dhe shëndeti në punë, mbi të gjitha”.

Kjo fushatë do të lansohet brenda pak ditëve. Qëllimi i kësaj fushate është vetëdijesimi i punëdhënësve dhe punëmarrësve për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe do të tregohet se Ministria e Punës dhe Inspektorati janë të përkushtuar në zbatimin e ligjit në përpikëri. Për më tepër, Ministria e Punës, në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës janë duke bërë certifikimin e personave fizikë, të cilët kryejnë punë nga siguria dhe shëndeti në punë, si dhe licencimin e subjekteve juridike, të cilat kryejnë vlerësimin e rrezikut në vendin e punës, si parakusht për vend të punës më të sigurt dhe më të shëndetshëm.

Inspektorati i Punës çdo vit bën inspektime ekskluzivisht në ndërtimtari, nga muaji qershor deri në shtator, ndërsa këtë vit kemi filluar nga muaji prill, në mënyrë që të parandalohen aksidentet në vendin e punës.

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja Baftiu,

Në fund të vitit 2017 kemi miratuar 10 rregullore për sigurinë dhe shëndetin në punë, ndërsa viti 2018 është vit i cili do të karakterizohet me mbikëqyrje të fortë të zbatimit të këtyre rregulloreve dhe legjislacionit, në përgjithësi. Për ne jeta dhe shëndeti i punonjësve në vendin e punës janë mbi të gjitha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIU: Faleminderit!

E falënderoj ministrin për këto informata, edhe të sakta, edhe të shumta që m'i dha lidhur me pyetjen që e bëra, mirëpo ministër më intereson ta di se çka keni bërë deri më tani për familjet e viktimave, apo çka planifikoni të bëni në këtë drejtim? Dhe, a mjafton kapaciteti i inspektorëve të punës që i keni deri më tani?

KRYESUESI: Zoti Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuar deputete,

E kam thënë edhe në një prezantim timin publik më herët, po e përsëris edhe këtu, nuk ka kompensim që mund t'i bëhet ndonjë familjes kur anëtari i asaj familje nuk kthehet në shtëpi nga vendi i punës, prandaj qëllimi ynë kryesor është parandalimi i rasteve me fatalitet në vendin e punës, parandalimi i aksidenteve.

Natyrisht që Inspektorati i Punës, pas rasteve me fatalitet, i ka ndërmarrë të gjitha masat, të cilat janë të parapara me legjislacionin në fuqi, por po e përsëris edhe një herë - nuk ka kompensim që mund t'i bëhet familjes në rast se familjari i tij gjen vdekjen në vendin e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Slobodan Petroviq, pyetje për kryeministrin Haradinaj. Kryeministri s'është këtu, zoti Petroviq dëshiron ta marrë fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Ja sam uputio pitanje i za Premijera i za Ministra Unutrašnjih poslova, dok ja stigao na red i Ministar Unutrašnjih poslova je napustio salu, tako da ovo pitanje je bilo upućeno mnogo ranije, još 14. marta, tako da sada već ministar ostavci, bivši ministar, mada to pitanje može da uputi svima nama. Radi se danas tačno 3. meseca kako je ubijen Oliver Ivanović. Tri meseca ne znamo absolutno ništa vezano za to ubistvo. Da ironija bude veća, i čitav proces dijaloga između Beograda i Prištine bio je doveden u pitanje, uprave zbog te činjenice, upravo i uslov je bio vezan za istragu o ubistvo Oliver Ivanovića. Neznam kako se prešlo preko toga, ali u svakom slučaju mislim da svi mi zajedno imamo deo odgovornosti, naravno oni koji imaju mandat za pronalaženje počinioca imaju još veći odgovor i obaveze.

Koristim ovu priliku da još jednom apelujem ne samo na Vladu, nego na sve institucije da se što pre pronadu počinioci i izvedu pred licem pravde, jer ovaj zločin je sam po sebi više nego veliki, ali svakako pronalaženje počinioca jeste alternativa da se ne bi desilo nešto slično.

Još jednom sa ove govornice želim da uputim saučešće porodici i njegovim prijateljima koji su svih ovih meseci,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Shtoja edhe një minutë!

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se!

Da iskoristim ovu priliku da i uputim reči ohrabrenja i onoga što znači da, izvinjavam se kolege, ako možete da sednete, budite pristojan. Kolega, možete da budete malo pristojni? Ovaj odnos prema ovom pitanju, verujem da neće da se čeka dugo na pronajenje počinioca. Apelujem na sve na one koji imaju mogućnost da se uključuju u ovaj proces. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e kemi një pyetje të zonjës Veselaj-Gutaj për ministrin Bytyqi.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me edukimin e fëmijëve në sistemin parashkollor. Zoti ministër, edukimi i fëmijëve në mënyrë të institucionalizuar është një ndër faktorët kyçë për arritjen e cilësisë në arsim, prandaj konsideroj se kopshtet janë një ndër faktorët kyçë të edukimit të fëmijëve në periudhën parashkollore.

Qasja në çerdhe dhe në shkollimin e hershëm vlerësohet me një rëndësi shumë të veçantë për dhënien e shanseve të barabarta fëmijëve. Ne në Prizren e kemi një situatë krejt ndryshe nga ajo që duhet të ishte. Ka disa herë që unë e kam shtruar këtë shqetësim, kam bërë edhe pyetje parlamentare, në Prizren edukimi parashkollor ndodhet në një gjendje të mjerueshme. Edhe pse Prizreni është qyteti i dytë për nga numri i banorëve, në Prizreni nuk e kemi asnjë kopsht publik. Në vitin 2017, unë kam kërkuar nga ministri Bajrami në projekt-buxhetin e vitit 2017 që të parashihet një kopsht publik për qytetin e Prizrenit dhe është ndarë buxheti prej 100 mijë eurove, duke pasur parasysh që pjesa tjetër do të jetë nga IPA fondi 2, dhe është bërë një memorandum nga Komuna e Prizrenit me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Pyetja ime është kjo: Zoti ministër, në këtë projektligj që janë ndarë 100 mijë euro, ne e dimë që këto mjete janë bartur për vitin 2018, çka po ndodh tani dhe çka do të ndodhë me memorandumun e nënshkruar në vitin 2018 ndërmjet Komunës së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Po, sa është për ju shqetësuese, është edhe për ne, në fakt edhe ne e kemi marrë informacionin që nuk ka çerdhe publike në Prizren, kjo ka qenë befasuese, por i kalon së kaluarës. Lidhur me pyetjen konkrete, më 2017 është ndarë buxheti për çerdhen publike në Prizren, nuk është projekt i IPA-s, është direkt vetëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, mirëpo me vendimin nr. 2236, datë 27. 4. 2017, kjo i është bartur Ministrisë së Administratës Publike dhe tani Ministria e Administratës Publike e ka për obligim që t'i kryejë e gjitha implementimin e këtij projekti dhe ta përcjellë deri në përfundimin e tij. Nga informacionet që ne i kemi deri më tani, Ministria e Administratës së Publike në vitin 2016 i ka filluar procedurat, ka pasur disa probleme me pjesën e gjetjes së hapësirës për ndërtimin e kësaj çerdheje dhe nëse ju dëshironi ta keni informacionin më të detajuar duhet që këtë pyetje t'ia parashtroni ministrit të Administratës Publike, sepse tani Ministria e Administratës Publike e ka për obligim ta përcjellë projektin dhe zbatimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Veseli?

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Do të kërkoj, zoti ministër, që ta thelloni bashkëpunimin edhe me ministrin e Administratës Publike, por edhe me Komunën e Prizrenit, që të fillojë sa më shpejt zbatimin e këtij projekti, sepse është domosdoshmëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë zonja Veselaj-Gutaj, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Zonja Veselaj, e keni fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

E nderuar zonja ministre,

Çështja ime ka të bëjë me rrjetëzimin e gypave të ujit në rrugën “Janina” dhe rrugën “Nënë Tereza”, në Prizren. Për momentin, në këto dy rrugë, në rrugën “Janina” dhe rrugën “Nënë Tereza” në Prizren, ka shumë humbje fizike dhe komerciale, si dhe mundësi të interferimit të ndotësve biologjikë si shkak se në këto rrugë gypat e ujësjellësit janë instaluar para disa viteve dhe janë nga materiali PVC dhe ACC azbest çimento, që përmban elemente kancerogjene, dhe instalimi i gypit PVC në disa pjesë të linjës së ujësjellësit është bërë në të njëjtin kanal me atë të kanalizimit.

Në Projektligjin për vitin 2018 kemi kërkuar zëvendësimin e tubave të PVC dhe ACC-së azbest çimento për shkak të vjetërsisë me tuba të rinj nga materiali PE. Pyetja ime është: Kur do të

fillojë realizimi i këtij projekti zonja ministre, pra ndërrimi i gyp-sjellësit për rrugët “Janina” dhe “Nënë Tereza” në Prizren?

KRYESUESI: Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E falënderoj deputeten Luljeta Veselaj-Gutaj për këtë pyetje dhe aq më shumë për ngritjen e kësaj çështjeje sa u përket gypave të azbestit në vendin tonë.

Ne jemi në vitin 2018 dhe ende flasim për azbestin dhe përdorimin e tij në gypat e ujës-jellësit në gjithë vendin tonë. Konsideroj se duhet të jetë një shqetësim më i madh institucional, por edhe i të gjithë deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe i të gjithë ekspertëve, të cilët i dinë pasojat që shkakton azbesti, i cili qoftë pjesë e gypave të ujës-jellësit, apo edhe çative dhe pjesëve tjera, të cilat mund të jenë materiale përdoruese që ende përdoren në vendin tonë. Ky projekt, ndonëse është i vogël, e ka një rëndësi të veçantë, sepse do të ndikojë në mirëqenien dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve, e aq më shumë do të ndikojë në shëndetin e tyre. Jemi duke punuar jashtëzakonisht shumë në mundësinë reale të ndërrimit të të gjitha materialeve që përmbajnë azbest, qoftë në gypat, qoftë çati, ose materialet tjera, të cilat ende përdoren në Republikën e Kosovës. Ndonëse, në vendet tjera të zhvilluara kjo është pjesë e historisë së kaluar, një historie të dhimbshme, ne ende si shtet e përdorim azbestin dhe ende nuk jemi të vetëdijshëm për problematikat shëndetësore, të cilat janë fatale nëse arrijnë ta dëmtojnë shëndetin e qytetarëve.

Sa i përket projektit, jemi duke proceduar me këtë projekt. Ky projekt do të realizohet sivjet dhe për një informacion do të realizohet ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe KRU-së të regjionit, që në këtë rast për Prizrenin është Hidroregjioni Jugor. Po i presim vetëm procedurat e prokurimit dhe që të fillojë implementimi i këtij projekti. Këtë vit do të realizohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Jo! Në rregull! Atëherë, konsideroj që koha për pyetjet parlamentare ka përfunduar, sepse kemi shfrytëzuar pak më shumë kohë se që e kemi në Rregullore.

Ato pyetje që s’kanë marrë përgjigje, dihet.

Të nderuar deputetë, në bazë të nenit 44, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, e kemi një kërkesë-propozim me shkrim nga Komisioni për Arsim për plotësimin e rendit të ditës. E ftoj zotin Ismajl Kurteshi, si kryetar i Komisionit, që ta paraqesë dhe arsyetojë propozimin.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Dëshiroj ta njoftoj Kuvendin se Komisioni i Arsimit, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2018, e ka shqyrtuar dhe miratuar vendimin e Qeverisë nr. 9/39 të datës 4 prill 2018 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Duke pasur parasysh faktin se propozimi për plotësimin e rendit të ditës konsiderohet çështje e ngutshme, komisioni propozon amendament për plotësimin e rendit të ditës të datës 16 prill 2018, dhe kërkon që të shqyrtohet ratifikimi i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Pra, kërkojmë që kjo çështje të futet në rend të ditës për shkak të urgjencës shumë të madhe që e ka Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë do të kërkoja deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare për këtë çështje, për këtë propozim. Mendoj që kryetarët kanë autorizim dhe mund të vendosin në emër të grupeve nëse do të jetë në rend dite, apo jo. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Hoti, që ta japë mendimin e tij në emër të grupit parlamentar.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ne jemi dakord që kjo të renditet si pikë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj zotin Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne e mbështetim përfshirjen e kësaj pike në rend të ditës.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Pajtohem me këtë propozim.

KRYESUESI: Deputetët e Pavarur, kush e do fjalën?

VISAR YMERI: Edhe ne jemi dakord që të futet në rend të ditës.

KRYESUESI: Në rregull! Grupi Parlamentar i AAK-së. Besoj se edhe këta janë.

AHMET ISUFI: Pajtohem që të hyjë në rendin e ditës.

KRYESUESI: Lista serbe s'është këtu. Grupi Parlamentar Nisma?

HAXHI SHALA: Edhe ne pajtohem.

KRYESUESI: Dakord! Grupi Parlamentar “6+”?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” pajtohet me këtë propozim.

KRYESUESI: Atëherë mendoj që pika e rendit të ditës në fjalë duhet të radhitet diku ku ta këtë vendin. Për të votuar nuk kemi kuorum të duhur. Nëse e pranoni propozimin unë jam që, meqenëse kryetarët e grupeve parlamentare janë deklaruar, atëherë ne po presim mos po bëhet kuorumi, por nuk ka kuorum. Zoti Hoti, urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Kryesues!

Unë e kam një çështje për t’u futur në rend dite, nëse mund ta prezantoj tash, është themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq.

Në seancën e datës 4 prill 2018, ne të gjitha grupet parlamentare jemi dakorduar për rekomandimin që e kemi votuar aty dhe aty thuhet qartë që pika e parë është të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar. Pra, mund të konsiderohet se është formuar ai komision me votat e të gjithë deputetëve që kanë qenë të pranishëm. Gjithashtu, në rekomandimin e dytë thuhet se grupet parlamentare brenda tri ditësh ia dërgojnë Kryesisë së Kuvendit emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komision në përputhje me Ligjin për hetime parlamentare. Ndërkohë, ne e kemi pasur një takim të kryetarëve të grupeve parlamentare. Jemi dakorduar që përbërja e këtij komisioni të jetë 11 anëtarë dhe të reflektojë përbërjen siç është në komisionet tjera të rregullta të Kuvendit. Me sa e di unë, të gjitha grupet parlamentare i kanë dërguar propozimet për këtë komision.

Ne si iniciator i formimit të këtij komisioni hetimor propozojmë që kjo të radhitet si pikë e rendit të ditës dhe të formalizohet ky komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ky ishte mocion i Lidhjes Demokratike për t’u futur në rend dite. Sipas rregullave, unë duhet ta hedh në diskutim dhe ta marr mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Zoti Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Siç ju kujtohet, ne e kemi pasur një votim të këtyre rekomandimeve pas dakordimit që e kemi bërë të gjitha grupet parlamentare bashkë dhe besoj që kjo frymë deri tash e ka definuar çështjen që ndërlidhet me krijimin e këtij komisioni hetimor dhe besojmë apo shpresojmë që edhe në të ardhmen do të jetë kështu.

Ndoshta zoti Hoti harroi ta thotë, është që ne këtë çështje pastaj, ju kujtohet, e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e Kryesisë dhe mbledhja e Kryesisë ka marrë një vendim që t’ia kërkojë opinionin

Komisionit për Legjislacion në lidhje me çështjet që ndërlidhen me kryesimin e këtij grupi dhe me atë që sipas ligjit kush mund ta udhëheqë këtë grup. Ne e dimë që duhet ta udhëheqë opozita, jo dikush i koalicionit dhe jo propozuesi, por meqenëse në iniciativën për seancë të jashtëzakonshme kanë qenë nënshkrues të gjitha grupet parlamentare opozitare, atëherë ka pasur paqartësi se si interpretohet kjo çështje. Për fat të keq, apo jo, Kuvendi i Kosovës nuk ka ndonjë përvojë shumë të madhe me komisionet parlamentare hetimore dhe në këtë kuadër pas diskutimeve që kemi bërë edhe ne si shefa të grupeve bashkë, e pastaj edhe me ju si Kryesi, ne e kemi marrë një vendim dhe nuk besoj se mund ta futim në seancë pa e marrë atë interpretim. Kështu që unë besoj se në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë do të duhej që kjo çështje të definohej dhe pastaj të vijë në procedurë të rregullt, ashtu siç jemi pajtuar.

Konsideroj se nëse e futim tash në rend dite, i bie që jemi jashtë marrëveshjes që kemi bërë bashkë si shefa të grupeve parlamentare edhe në mbledhjen e Kryesisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Megjithatë, çështjet për të cilat ka pasur dilema janë teknike, konsideroj unë. I vetmi problem ka qenë që të gjitha grupet e përfshira në nënshkrimin e këtij komisioni janë në përbërje të tij dhe tash e vetmja çështje është se kush do ta udhëheqë këtë komision. Megjithatë, unë mendoj se kjo nuk ka të bëjë shumë dhe aq me Komisionin për Legjislacion, sa ka të bëjë me një marrëveshje të nevojshme politike ndërmjet grupeve parlamentare për t'u dakorduar për udhëheqjen e këtij komisioni.

Ne besojmë që kjo duhet të kryhet sa më shpejt dhe e mbështetim edhe idenë bile që të kryhet edhe gjatë kësaj seance, pse jo? Nëse renditet si pikë e fundit e rendit të ditës, atëherë do ta kemi parasysh që kjo seancë ka shumë pika të rendit të ditës, këto nuk do të mund t'i kryejmë sot. Janë edhe 5 interpelanca në pritje, do të na shkojë krejt java, kështu që nuk ka asgjë të keqe që kjo të renditet si pikë në këtë seancë plenare.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur?

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, edhe ne e përkrahim idenë që kjo pikë të futet në rend dite për këtë seancë dhe gjithashtu mendoj që mund ta krijojmë një situatë të pafavorshme për komisionet e ardhshme hetimore duke e trajtuar secilin përkrahës të një mocioni si iniciues të mocionit për krijimin e komisionit hetimor. Rrjedhimisht, me këtë komision hetimor mendoj që mund të ecim përpara dhe duhet të ecim përpara sa më shpejt dhe, gjithashtu, nëse veç kështu siç e tha edhe zoti Konjufca, kjo seancë zgjat dy-tri ditë, atëherë edhe mund të kemi opinionin e pritur nga Zyra Ligjore, të cilën zoti Krasniqi e përmendi.

Rrjedhimisht, ne e përkrahim këtë mocion të zotit Hoti dhe këtë ide të zotit Hoti për ta futur këtë në rend dite.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, edhe një herë e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Jo, kisha nevojë t'i them vetëm dy çështje për sqarim. E para, pajtohem që kjo çështje duhet të vazhdojë, por nuk besoj se mund ta futim në rend dite me paragjykimin që mund ta kemi opinionin brenda dy ose tri ditësh, sepse s'e dimë. Nëse e kemi, ne mund menjëherë pastaj ta thërrasim një seancë dhe ta votojmë komisionin, siç jemi dakorduar.

E dyta, është e vërtetë që ne mund të bëjmë marrëveshje politike si grupe parlamentare, gjë që e kemi bërë, sepse kështu i kemi dakorduar edhe rekomandimet, por ne s'mund të bëjmë marrëveshje ndërmjet nesh e në kundërshtim me ligjin. Kjo është çështja. Dhe, për të qenë të sigurt që s'jemi në kundërshtim me ligjin, të gjithë jemi pajtuar që të kemi një opinion edhe prej Administratës, më saktësisht, edhe prej Komisionit për Legjislacion, që ka përgjegjësi për interpretimin dhe mbikëqyrjen e respektimit të Rregullores. Kjo është çështja.

Tash, e vërtetë është që në krahasim me rekomandimet, disa grupe janë vonuar. Grupi i PDK-së i ka dërguar propozimet e veta, besoj se edhe të tjerët tashmë e kanë përfunduar këtë pjesë të obligimeve, që dalin nga rekomandimet, dhe unë besoj që edhe për shkak të mbarëvajtjes së punës së këtij komisioni dhe për shkak të moskontestimit të tij dhe të punës së tij që ta bëjë në të ardhmen, do të duhej të jemi të kujdesshëm, që hapat që i marrim të jenë në pajtim me ligjin dhe të mos rrezikojmë ta shkelim ligjin në çfarëdo forme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së. Sqarim? Zoti Dardan ka sqarim.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, çështja është thjeshtë, ata që e kanë iniciuar dhe ata që e kanë përkrahur. Nëse përkrahësi trajtohet si iniciues, atëherë asnjëherë asnjë komision nuk mund ta shtyjë përpara. Kjo është kështu. Dhe, mendoj se këtu e kemi të qartë situatën. Iniciues e dimë kush është dhe e dimë në fakt kush janë edhe përkrahësit e kësaj nisme. Rrjedhimisht, mendoj se duhet ta vendosim në rend dite dhe të mos e trajtojmë çdo nënshkrim të secilit deputet individualisht si përkrahje e një subjekti për temën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Meqë ne jemi dakorduar që Administrata dhe Komisioni për Legjislacion ta bëjnë interpretimin nuk ka nevojë të ngutemi, sepse nuk është çështje aq e ngutshme. Por, më mirë është ta kryejmë ashtu si duhet sipas Rregullores dhe të mos bëjmë shkelje ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe s'është këtu. Nga Nisma, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është inkurajuese kjo. Kujdesi i jashtëzakonshëm për të mos e shkelur Rregulloren dhe ligjin është i mirëpritur, por ajo që unë kam për të thënë është se në parim jemi marrë vesh që Komisioni për Legjislacion të japë një mendim lidhur me këtë. Unë nuk i shoh këto dyja në kundërtënie me njëra-tjetrën. Të hyjë sot në rend dite, dhe edhe një herë zonja Haxhiu, si kryetare e komisionit, ta thërrasë sot një mbledhje, sepse e tëra që kemi të bëjmë në këtë rast si komision është që ta pranojmë njërin nga versionet, interpretimet, njërin nga interpretimet. A konsiderohen iniciues të gjithë deputetët, përkatësisht a konsiderohen të gjitha grupet si iniciues në rastin në momentin kur një deputet i atij grupi bëhet përkrahës i një komisioni hetimor, apo jo?

Këtu jemi ndarë. Dikush mendon që nga momenti kur një deputet, edhe pa marrëveshje me grupin parlamentar nënshkruan, apo e përkrah një komision hetimor, e përfshin apo e inkuadron me automatizëm edhe grupin parlamentar, gjë që, sipas mendimit tim, nuk është interpretim i drejtë. Por, sidoqoftë, e kemi lënë, jo edhe Zyra Ligjore, sepse thamë që nëse kërkojmë nga dy instancat, edhe nga komisioni, edhe nga Zyra Ligjore dhe na vijnë interpretime të ndryshme, atëherë na del telashi se cilin ta pranojmë. Edhe u mor vendim që të shkojë vetëm në komision.

Prandaj them, ne mund ta futim sot në rend dite. Zonja Haxhiu, si kryetare e komisionit, unë si anëtar dhe të gjithë të tjerët mund të mblidhemi sot 15 minuta, 20 a 30, të marrim një vendim dhe t'ia bashkëngjijim shkresës mendimin apo sugjerimin e komisionit parlamentar. Nuk shoh që këto të dyja janë në kundërtënie me njëra-tjetrën. Mund t'i kryejmë të dyja sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”-i, zoti Kinolli a ke fjalë...

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Qëndrimi i Grupit Parlamentar “6+” është që të mos ngutemi me këtë pikë të rendit të ditës, meqenëse edhe ashtu e kemi agjendën mjaft të ngarkuar dhe presim që fillimisht, siç jemi dakorduar më herët, të mblidhet Komisioni për Legjislacion, dhe pastaj në bazë të Rregullores të veprojmë për më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e kryetares së Komisionit për Legjislacion, zonjës Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari më duhet ta theksoj faktin se sot paradite jam njoftuar se ka ardhur një shkresë për Komisionin për Legjislacion, në mënyrë që jemi ngarkuar për të njoftuar lidhur me procedurat

për Komisionin Hetimor për dëbimin apo deportimin e shtetasve turq. E para, unë nuk e kuptoj se pse jemi ngarkuar për shkak se konsideroj që është komplet një marrëveshje ndërmjet shefave të grupeve parlamentare për të vendosur se kush do të jetë kryesuesi i këtij Komisioni Hetimor. Në këtë drejtim, unë menjëherë, të enjten, domethënë ashtu siç e kam paraparë edhe në mbledhjen e komisionit të rregullt, e kam vendosur këtë si pikë të rendit të ditës, për shkak se konsideroj që është urgjente, por meqë këtu po kërkohet që ta shqyrtojmë edhe më herët, natyrisht që si komision do të mblidhemi nesër, duke qenë se sot kemi shumë projektligje që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë dhe nesër Komisioni për Legjislacion mund të mblidhet urgjentisht për ta trajtuar këtë çështje.

Por, po ashtu, më duhet ta them mendimin tim si kryetare e Komisionit për Legjislacion. Për mua, është e pakuptimtë që të mendohet se iniciuesit janë njësoj sikur mbështetësit apo përkrasit e një komisioni hetimor. Situata aktuale është që të gjitha grupet parlamentare, shumica e grupeve parlamentare, përjashtuar më duket “6+”-in, e kanë mbështetur kërkesën për komisionin hetimor për këtë çështje, prandaj edhe secili prej përfaqësuesve të grupeve parlamentare mund ta kryesojë. Por, kemi pasur situata kur dy apo tri grupe parlamentare e kanë mbështetur një komision hetimor, e jo edhe grupet tjera parlamentare. Është e pakuptimtë që ne të presim që një grup parlamentar që s’e mbështet komisionin hetimor të jetë kryesues i këtij komisioni hetimor. Kjo s’ka logjikë.

Prandaj, po them se këtu ndalohet iniciuesi, ta zëmë në raste konkrete Glauk Konjufca, por lejohen deputetët nënshkrues, të cilët e kanë mbështetur kërkesën për komision hetimor. Prandaj, pak a shumë kjo do të jetë edhe përgjigja e Komisionit për Legjislacion dhe prandaj po them që nesër menjëherë do ta keni përgjigjen e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë shpresoj që Komisioni për Legjislacion në kuadër të amendamentimit të Rregullores së re të Kuvendit do ta kopjojë variantin më të mirë të parlamenteve, sepse s’kemi nevojë ta zbulojmë “ujin e nxehtë” dhe të rregullohet kjo çështje nëpërmjet Rregullores, siç e kanë parlamentet tjera, e jo të kemi nevojë të bëjmë marrëveshje për çështjet që dihen nga çdonjëri që merr vesh pak në veprimtarinë e parlamentarizmit.

Që nga koha kur është krijuar Parlamenti i Kosovës, vetëm një komision ka funksionuar. Asnjëherë për shkak të rregullave që janë të paqarta dhe nuk janë të sakta dhe lihet mundësia e sabotimit nga njëra palë, ose tjetra palë, asnjë propozim deri sot për komision hetimor nuk ka punuar, nuk ka funksionuar. Veç një! Komisioni atëherë që krijuar për atë shtëpinë e famshme të Kuvendit në Gërmi. Prandaj, unë shpresoj që, siç jeni marrë vesh, ashtu duhet ta lëmë. Por, megjithatë, ka kuorum për ta votuar edhe këtë çështje. Nuk e di, t’i bjerë ziles dikush, për t’i thirrur deputetët që vijnë këtu.

Zoti Selmanaj, a deshe të thuash diçka? Zoti Selmanaj deshi edhe diçka të thotë.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë po e shoh që ka një tendencë për t'u futur në labirinte të procedurave pa nevojë. Absolutisht pa nevojë.

Nismëtar, iniciator i debatit parlamentar ka qenë LDK-ja, e mbështetur prej deputetëve. Mandati i deputetëve është individual. Nuk kemi kërkuar, nuk ka qenë thirrja ose iniciuesi i debatit LDK-ja, Vetëvendosje dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur, dhe më pas për t'iu bashkuar edhe deputetët tjerë. Jo! LDK-ja ka qenë si grup parlamentar, e më pas deputetët e opozitës na kanë mbështetur. Dhe tash, kjo çështje është krejtësisht e qartë. Ne jemi iniciuesit, na kanë mbështetur deputetët individualë dhe tash kushdo, qoftë nga Vetëvendosja, qoftë nga Deputetët e Pavarur, mund ta kryesojë këtë komision.

Por, unë tash po shoh diçka tjetër, tendencën për ta shtyrë edhe më shumë, sepse dikush ndoshta ka ndërruar qëndrim pas miratimit të rezolutës dhe po hapen tash tema të panevojshme. As Komisioni Parlamentar s'ka punë këtu, ju mund ta mblidhni sa herë të doni. Por jo, kjo çështje është krejtësisht e qartë. Nismëtar është Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetët individualisht e kanë mbështetur dhe kjo çështje tash i takon vetëm kryesuesit që mund të jetë ose nga Vetëvendosja, ose nga Grupi i Deputetëve të Pavarur. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë s'e di çka doni të arrini me këtë komision, por sidoqoftë... Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues!

Këtu më e lehta është që ne të gjithë të bëhemi ekspertë ligjorë këtu, por ky Kuvend nuk është themeluar tash, është Legjislatura VI. Është e vërtetë dhe e thashë në fillim të fjalës sime që s'ka ndonjë përvojë shumë të madhe me komisione hetimore, por ato që kanë qenë, ato e kanë krijuar një precedent dhe e kanë krijuar një përvojë. Edhe është krejt e kuptimtë sot kush do ta ndërrojë përvojën, ose interpretimin, dhe ne s'kemi asgjë kundër. Veç po them, kur të merremi vesh është mirë t'i respektojmë marrëveshjet deri në fund, sepse, në fund të fundit, pavarësisht se si e interpreton Administrata deri tash, ose në të kaluarën, ose komisioni, nismëtarin, atë ditë rekomandimet i kemi votuar ne bashkërisht, bile ato rekomandime me 61 votë kanë kaluar. Në fund, ju e dini, me dorë, me vota të deputetëve të PDK-së. Kështu që lëreni tendencën e të mundoheni, kushdo qoftë, t'i japë pikëpyetje kësaj pune. Koalicioni qeveritar bashkë me opozitën jemi 100% në linjat e njëjta, e kemi dakorduar çdo fjalë bashkërisht dhe jemi të interesuar të shkojmë përpara. Nëse dikush tjetër është i interesuar prej fillimit t'ia japë të mbrapshtën këtij komisioni, që t'i japë hapësirë për kontestim në të ardhmen, atëherë këtu mund të jetë ndoshta qëndrimi i ngulisë për ta futur në rend dite. Por, unë nuk e di nëse është kështu!

Përndryshe, Kryesia duhet ta procedojë në seancë ashtu siç është Rregullorja dhe Kryesia mund ta bëjë këtë punë nesër a pasnesër, ose të enjten. Ne besoj do të jemi çdo ditë këtu në këtë seancë

të gjatë me shumë pika dhe kurdo që vendos Kryesia ne mund të shmangemi gjatë pauzës, ose gjatë seancës e të takohemi dhjetë minuta, siç kemi bërë edhe herëve tjera. Por, më e rëndësishme është të respektohet procedura, edhe e Ligjit për hetime parlamentare, edhe e Rregullores përkatëse, se sa të mundohemi e të themi “hajt se po kryejmë diçka shpejt e shpejt”, e pastaj t’i jepen njëqind pikëpyetje asaj pune. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Kryesues!

Unë mendoj që bëhet fjalë për një komision hetimor që e themelon Kuvendi dhe për këtë çështje Komisioni për Legjislacion është më adekuat se çdokush tjetër për ta dhënë një mendim rreth kësaj, nëse konsiderohen iniciues edhe grupet parlamentare deputetët të cilët kanë marrë pjesë në nënshkrim apo jo dhe le të mblidhemi. Unë prej tash po e deklaroj votën time që jo nuk konsiderohen, dhe nga 6-5 për mazhorancën, 6-5 për opozitën, shkojmë dhe e zgjidhim këtë. Ecim përpara, e themelojmë komisionin sot, se nuk kemi nevojë të shtyhem tash se cili është më jurist dhe interpretimi i cilit duhet të vlejë gjithsesi.

Jemi marrë vesh në parim si Kryesi e Kuvendit, të shkojmë në Komisionin për Legjislacion dhe ta themi atë që kemi për ta thënë. Unë mendoj se deputetët nuk mund ta përfshijnë grupin parlamentar nëpërmjet veprimeve të tyre individuale. Grupi përfshihet vetëm kur në emër të grupit deklarohet kryetari, deklarohen nënkryetarët dhe deklarohen në tërësi deputetët e grupit parlamentar, e jo një deputet i veçantë të nënshkruajë një iniciativë dhe dashur e pa dashur ta përfshijë grupin në atë që quhet iniciator apo nismëtar për themelimin e një komisioni hetimor.

Le të mblidhemi sot pesë minuta. Zonja Haxhiu mund ta thërrasë komisionin dhe vijmë me një letër, që këtu në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një iniciues. Cili është iniciuesi? Është Lidhja Demokratike e Kosovës, të tjerët janë mbështetës dhe mbyllet ky kapitull. Faleminderit! Hapet tjetri, fillon punën komisioni, nëse jemi të interesuar, nëse nuk jemi, atëherë do të shtyhem kështu në procedura si në labirint, cili ka të drejtë, cili s’ka të drejtë... Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sërish zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Mendoj se tani u qartësua çdo gjë, por veç për hir të informimit të drejtë të të gjithë deputetëve. Në rekomandimet që i kemi votuar së bashku më 4 prill 2018 në preambulë thotë, “Në mbështetje të nenit 65.9 të Kushtetutës dhe nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, pas debatit parlamentar të zhvilluar në seancën plenare më 4 prill, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe harmonizimit të tekstit edhe me grupet tjera parlamentare”. Pra, është më se e qartë që LDK-ja është iniciatore e formimit të këtij komisioni dhe është mbështetur nga deputetët e grupeve të tjera parlamentare.

E vetmja çështje e hapur është kryesimi i këtij komisioni. Unë prapë kërkoj që të renditet si pikë e rendit të ditës dhe deri atëherë, duke qenë se ishte kërkesë e Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Haxhiu besoj e thërret Komisionin për Legjislacion dhe e jep një opinion për ta përmbushur këtë kërkesë të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe, në ndërkohë, derisa të vijë në rend dite, derisa të vijmë te kjo pikë e rendit të ditës, ne do të pajtohemi edhe për atë se kush do ta kryesojë këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Memli, e ke kërkuar prapë fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Jo, veç për saktësim. Nuk është kërkesë e Grupit Parlamentar të PDK-së, është kërkesë e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen ku kemi qenë bashkë unë dhe Avdullah Hoti dhe të gjithë shefat e grupeve. Lexoje transkriptin pra, nëse s'po të kujtohet. Në mbledhje, Kryesia ia ka deleguar këtë çështje komisionit për të marrë opinion, bile edhe Administratës fillimisht, pastaj komisionit. Nuk është kërkesë e jona, as nuk është kërkesë e një grupi të veçantë. Është çështje që është ngritur prej Administratës, edhe në takimin që e kemi pasur bashkë ne, edhe në mbledhjen e Kryesisë.

Kështu që për saktësim, nuk jemi duke e kërkuar ne këtë punë, ky është përfundim i Kryesisë. Për këtë arsye i ka shkuar letra komisionit që e konfirmoi kryetarja e komisionit, e jo pse kemi kërkuar ne. Nuk po e kërkojmë ne, po kjo është në procedurë tashmë. Nëse duam t'i ikim procedurës, ta shkelim ose ta anashkalojmë, është çështje kujt do t'ia anashkalojmë, unë nuk mund ta marr atë përgjegjësi. Nëse duam t'i respektojmë procedurat dhe marrëveshjen, atëherë mund të presim edhe dy ditë e të futet në rend dite në një moment tjetër, ose në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi e ka kërkuar fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Ne po themi që marrëveshje e kryetarëve të grupeve parlamentare ka qenë që të kërkohet interpretimi nga komisioni. Komisioni si të dojë tash mund ta thërrasë mbledhjen, të na e sjellë interpretimin dhe e futim në rend dite, nuk ka problem. S'di pse po bëhet problem kur kemi kaq shumë pika të rendit të ditës, e që komisioni gjatë ditës mund ta kryejë këtë punë dhe mund ta votojmë.

KRYESUESI: Tani unë jam pak në dilemë. Si drejtues i seancës, Rregullorja më obligon ta hedh në votim. Marrëveshja ju obligon të gjitha grupet parlamentare, meqenëse jeni marrë vesh, unë mendoj që do të duhej t'i përmbaheni marrëveshjes çfarë e keni bërë, meqenëse unë s'kam qenë në atë mbledhje dhe s'e di, tani po dëgjoj. Ndoshta është më mirë që të mos futemi në situatën në të cilën përpiqemi të eskivojmë nga çështja kryesore.

Zoti Hoti, unë mendoj që do të duhej ta shtyjmë për dy ditë, dhe t'i lëmë hapësirë edhe komisionit që ta analizojë dhe ta vendosim në variantin çfarë e keni marrëveshjen. Unë për vete s'kam kundër që të futet në rend dite, edhe sot, edhe nesër, edhe pasnesër, edhe të futet menjëherë në rend dite si pikë e parë e kësaj seance. Besoj se asnjëri s'ka. Dilemat po dihet për çfarë qenkan. Mirë është që krahas komisionit, edhe kryetarët e grupeve parlamentare të takoheshin bashkë, pa Kryesinë, që të dilnin me një konkluzion siç e kanë bërë atë që e dhanë mbështetjen dhe e bënë atë deklaratën e përbashkët, edhe për këtë çështje të arrijmë nëpërmjet një komisioni, që e quajmë “mbipartizan të pavotuar”, në të cilin marrin pjesë të gjithë dhe të merremi vesh, në qoftë se jo, atëherë unë mund ta nxjerr në votim. Unë po e shoh disponimin çfarë është në sallë, mund të mos kalojë dhe kjo është situata.

Si të doni, zoti Avdullah! Unë e kam obligim ta hedh në votim, s'kam të drejtë të mos e bëj këtë. Nëse ju kërkoni të mos e hedh në votim, unë e lë në fuqi marrëveshjen e juaj. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Kryesues,

Dakordimi me kryetarët e grupeve parlamentare jashtë mbledhjes së Kryesisë, në takimin që e kemi pasur, ka qenë që komisioni t'i ketë 11 anëtarë, ta reflektojë përbërjen e komisioneve të tjera. Vetëm Grupi Parlamentar i PDK-së, kryetari i këtij grupi, ka shprehur dilema nëse mund të bëhet dallimi ndërmjet iniciuesit dhe mbështetësve për themelimin e këtij komisioni parlamentar.

Në mbledhje të Kryesisë nuk ka pasur dakordim të kryetarëve të grupeve parlamentare. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së ka shprehur prapë dilemat e tij për këtë çështje, bile zoti Sherifi ka thënë se ne duhet të pajtohemi e të shkojmë përpara. Kushdo që ka dilema për këtë çështje, janë rrugët ligjore dhe kushtetuese për ta kontestuar këtë vendim. Unë pra, kërkoh që kjo të radhitet si pikë e rendit të ditës dhe kërkoh nga zonja Haxhiu që ta thërrasë komisionin dhe të japë opinionin e komisionit lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, prapë. Unë jam i detyruar t'ua jap fjalën, ndoshta në kundërshtim me rregullat, që s'i kemi praktikuar, për shkak se jemi të gjithë të interesuar...

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues!

Unë po befasohe me sinqerisht, po befasohe për të keq me Avdullah Hotin sot, se është duke i keqinterpretuar, po shpresoj jo qëllimshëm. Nuk kam shprehur unë hezitime, Avdullah, Sekretaria e Kuvendit ka shprehur, jo unë. Dhe, unë si deputet nuk mund të vendos arbitrarisht kundër interpretimeve që ua jep ligji njerëzve më të thirrur se unë dhe ti për ta interpretuar ligjin. Kështu që, të lutem, mos keqinformo, sepse nuk është e drejtë. Nuk kam shprehur unë hezitim, hezitimi ka ardhur prej interpretimit të Sekretarisë së Administratës së Kuvendit dhe na ka obliguar të mos vendosim arbitrarisht dhe, po ashtu, në mbledhjen e Kryesisë nuk vendosin shefat e grupeve parlamentare, atë punë e di. Ne e kemi të drejtën e fjalës, s'e kemi të drejtën e

votës. Ka vendosur Kryesia unanimitisht për ta dërguar tutje dhe aty për shkak apo pas rekomandimeve të Sekretarisë së Administratës. Kështu që, të lutem, të jesh korrekt të paktën në interpretim dhe kur ia përmend emrin, kujtdo qoftë.

KRYESUESI: Zoti Hoti, edhe një herë.

AVDULLAH HOTI: Për saktësim të zotit Krasniqi, ne mund ta shohim transkriptin e mbledhjes së Kryesisë për ta qartësuar atë që jemi duke kërkuar. Sot këtu është që të mos ikim asnjëherë nga qëndrimi i Kryesisë. Le të kërkojmë opinionin nga Komisioni për Ligje, le të radhitet kjo pikë e rendit të ditës, derisa të vijmë te kjo pikë do të veprojmë sipas opinionit që del nga Komisioni për Ligje. Kaq!

KRYESUESI: Sipas rregullave, në qoftë se s'ka dakordancë në Kryesi, e drejta për ta hedhur çështjen në votim është e deputetëve në Kuvend, ose e grupit parlamentar. Ju e nxorët propozimin, por e keni nxjerrë propozimin, të paktën siç po e dëgjoj Memlin, që Kryesia ka vendosur në mënyrë unanime të dëgjohet rekomandimi i Komisionit dhe i Administratës bashkë, nuk e di si është ajo, se s'e kam lexuar as procesverbalin e mbledhjes.

Unë e hedh në votim, por nuk kemi kuorum dhe unë nuk po them kot, më mirë të presim edhe dy ditë, sesa të shtyhem me fjalë dhe të mos kemi kuorum për ta votuar, se unë po e shoh që i kemi 57 deputetë në sallë. Duhet të jenë të paktën...

Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

Në qoftë se ka kuorum vazhdojmë me votimin siç e lamë seancën në gjysmë. Vërtet është mirë që ta gjeni një pesëminutësh kohë, e të uleni kryetarët e grupeve parlamentare për ta harmonizuar këtë çështje, sepse unë mendoj se edhe Komisioni për Legjislacion nuk do ta zgjidhë problemin. Është problem i Rregullores dhe i Ligjit për komisionet hetuese.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po e vazhdojmë seancën. Kemi kuorum të mjaftueshëm në sallë. E kemi raportin e komisionit, sekretaria është duke ua shpërndarë deputetëve.

Sipas Rregullores dhe sipas diskutimeve që bënë, meqenëse kemi kuorum, unë ju ftoj të votojmë propozimin e Komisionit për Arsim, fillimisht, meqenëse të gjithë ishin dakord.

Për t'iu shmangur Rregullores së Kuvendit kemi vendosur më herët, por sipas Rregullores, duhen 2/3 për shmangie.

Tani unë jam në dilemë, e di që askush nga deputetët nuk është kundër. Mirëpo, rregullat janë të tilla dhe unë nuk mund ta hedh në votim, sepse kemi 63 deputetë në sallë.

Ju lus që t'i zini vendet. Janë 64 deputetë.

Të nderuar deputetë, ju lutem t'i zini vendet, sepse do të hyjmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Dëgjoni, unë qe tri herë po e përsëris të njëjtën gjë.

Propozimin e Komisionit për Arsim, për ta futur në rend të ditës çështjen që ka të bëjë me plotësimin e rendit të ditës, shmangie nga Rregullorja, shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë anëtarëve të Këshillit të Cilësisë dhe shmangie nga afat procedurale, me nene, me ligje.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Duhet 2/3 e të pranishmit.

Kanë votuar 62 deputetë, 60 deputetë janë për, një është kundër dhe një abstenim.

Konstatoj që miratohet propozimi i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për plotësimin e rendit të ditës me pikën:

Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e nëntë anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

Kjo pikë radhitet diku kah fundi. Menjëherë, po thoni. Meqenëse është me interes të veçantë, e fusim si pikë të parë të rendit të ditës, pas miratimit të procesverbalit.

Tani kemi çështjen e mocionit, që ngelëm në gjysmë.

Kemi deklarin e komisionit, lus zonjën Haxhiu që të na sqarojë, e kemi edhe letrën përpara, e kemi lexuar, po sidoqoftë, është mirë që ta lexojë qëndrimin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion sot në orën 14:00, në një mbledhje të jashtëzakonshme e ka shqyrtuar përfundimin e Kryesisë së Kuvendit numër 06/F-039 lidhur me kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar që ka të bëjë me dëbimin e gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë nga Kosova dhe duke vepruar në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, por po ashtu edhe me Ligjin për hetimin parlamentar, vlerësoj se iniciuesi i debatit parlamentar në lidhje me rastin e deportimit të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë është Lidhja Demokratike e Kosovës dhe mbi këtë bazë është formuar edhe Komisioni Hetimor, kryesimi i të cilit nuk mund të bëhet nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për shkak se komisioni e ka vlerësuar se është grup parlamentar, i cili e ka iniciuar kërkesën për debat parlamentar dhe pastaj pas kësaj ka dalë edhe Komisioni Hetimor.

Pra, sipas Ligjit për hetimin parlamentar, neni 10 i tij, këtë kryesim nuk mund ta bëjë grupi parlamentar iniciues dhe po ashtu sipas këtij ligji këtë Komision Hetimor nuk mund as ta kryesojë përfaqësuesi i partisë apo koalicioni qeverisës. Në këtë drejtim, në situatën siç jemi, këtë kryesim mund ta bëjë ose Lëvizja Vetëvendosje, ose përfaqësuesit e GDP-së, pra jemi në një situatë të tillë dhe ky është interpretimi i ligjit që ka qenë diskutim edhe në mbledhjen e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A jeni dakord që ta hedhim në votim? Zoti Beqa e ka kërkuar fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në komision e dhashë mendimin tim, konsideroj që ky është një komision i rëndësishëm dhe duhet të bëhet një harmonizim i plotë me Ligjin për hetimin parlamentar.

Nëse e marrim dhe e shikojmë materialin, të cilin ne e kemi shqyrtuar në komision, respektivisht flas se për kërkesën që është bërë në Kuvend me numër 06/989 e arsyetimi thotë, te pjesa e fundit e arsyetimit thotë: “Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me mbështetjen

e grupeve parlamentare të Vetëvendosjes dhe deputetëve pa grup thirrën seancë të jashtëzakonshme”.

Ne të gjithë jemi pajtuar që ta kemi një komision hetimor dhe atë ditë kanë votuar deputetët, por ne sot po flasim kujt i takon kryesuesi apo kryetari i komisionit.

Ligji për hetimin parlamentar e thotë, neni 10 e shpjegon mirë kujt nuk i takon. Nuk i takon as iniciuesit, as partive që janë në pushtet, në këtë rast të mazhorancës.

Por unë mendoj dhe e kam mendimin tim që nëse e themi atë çka ka thënë komisioni, konsideroj që është shkelje ligjore dhe nuk është mirë nga fillimi të bëjmë një komision me shkelje ligjore.

Unë do të konsultoj edhe përgjegjësit juridikë dhe do të mendoj se këtë çështje, si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ta dërgoj për interpretim në organin kompetent për interpretim ligjor, në këtë rast, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është mirë të deklarohen kryetarët e grupeve sa i përket çështjes. Kërkesa është që ky komision të miratohet dhe të futet në rend të ditës çështja e komisionit sipas radhës që e ka në fund të rendit të ditës për këtë seancë parlamentare.

Ftoj Grupin Parlamentar të LDK-së që ta bëjë deklarimin e tij. Zoti Armend Zemaj është paraqitur apo Avdullahu, cili të doni. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Tash është evidente dhe janë në pah se siç duket ka ndonjë indikacion që nuk dëshirohet të themelohet apo të nisë punën ky Komision Hetimor.

Sa u përket procedurave dhe praktikave është e qartë, ne mund të kemi konkluzione qysh nga fillimi i inicimit të kësaj çështjeje dhe dokumentet duhet të lexohen në tërësi, jo vetëm shkarazi apo ndonjë pikë e caktuar, e cila mund të ketë interpretime të ndryshme.

Inicimi për seancë të jashtëzakonshme, me 40 nënshkrime, e ka pasur orën dhe ditën e mbajtjes së seancës. Kryesia nuk ka pasur vullnet apo, po e lehtësoj, mundësi që të mblidhet dhe të thirret seanca, ku edhe do të kishim po atë ditë themelimin e Komisionit Hetimor.

Ripërtëritja e kërkesës ka qenë me insistimin e iniciuesit, por e bashkangjitur nga dy grupe politike dhe debati ka derivuar një konsensus të përgjithshëm që të kemi një Komision Hetimor, duke u bazuar gjithnjë ma materien që ka ekzistuar nga 40 iniciuesit, në këtë rast në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Kështu që unë kisha lutur që ta vendosni në rend të ditës dhe të hyjë themelimi i këtij komisioni. Kjo është pjesë procedurale, nuk ka ndonjë mandat fuqiplotë as kryesuesi, as zëvendëskryesuesi, janë të gjithë anëtarët e barabartë dhe materiali dhe materia prapë do të vijnë në seancë plenare për votim apo për mosvotim.

Kështu që ne jemi që kjo pikë të renditet, të themelohet komisioni, të mos kemi si neglizhencë, ta quaj, ndoshta edhe e paqëllimshme, po sido që të jetë, t'i japim rrugë hetimit parlamentar për ngjarjen, e cila është konsideruar një ndër skandalet më të mëdha të këtij viti, apo që ka ndodhur në institucionet e sigurisë së vendit tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Besoj që po shihet që kur ka vullnet të respektohen ligji dhe Rregullorja, gjithçka është e mundshme, sepse së paku në Kuvend të Kosovës nuk kemi nevojë të kemi yrysh për ta kryer një punë e të rrezikojmë shkeljen e ligjeve që i kemi miratuar vetë.

Ne e kemi marrë tashmë rekomandimin siç është kërkuar prej Komisionit Hetimor Parlamentar, edhe komisioni, sipas këtij interpretimi, ka vlerësua që vetëm LDK-ja është iniciuese dhe nga kjo rrjedh që janë dy grupe të tjera që mund ta kenë kryesimin.

Ne nuk kemi kundër që të përfshihet tash në rend të ditës, por me një qartësim, sepse jemi duke dashur të fusim në rend të ditës diçka që duhet të votohet, pavarësisht kur i vjen radha, është pika e fundit, ndoshta, e rendit të ditës. Por sido që të jetë, për ta votuar një komision, duhet ditur kush është kryesuesi, kush është zëvendëskryesuesi, kush janë anëtarët.

Nëse kemi qartësim për këtë farë çështjeje, ne jemi absolutisht në favor të votojmë, po nëse e fusim në rend të ditës pa e ditur çka po votojmë, i bie sikur të shtihet një ligj pa i kryer procedurat, sepse nuk dimë çka po votojmë saktësisht. Përveç që emrat ne i kemi dorëzuar secili grup për anëtarë, por tash me këtë sqarim të komisionit dua të di kush janë kryesuesi dhe zëvendësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Kërkoj mirëkuptim, kryesues,

Nëse merr mbështetjen e deputetëve dhe kjo hyn në rend të ditës, ne si iniciues të kësaj çështjeje, kur të vijmë te rendi i ditës, unë do të dal në foltore dhe do të propozoj kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Vetëvendosja, a ka nevojë dikush të diskutojë? Zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është e qartë që ka një tendencë për të zvarritur e të bllokuar Komisionin Hetimor që do të hetonte gjithçka që ka ndodhur me deportimin e gjashtë shtetasve të Turqisë nga Kosova.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet kërkesën që kjo çështje të radhitet si pikë e rendit të ditës në këtë seancë parlamentare.

Por po ashtu më duhet të bëj një ndërhyrje, sepse opinioni i Komisionit për Legjislacion nuk votohet në seancë, është opinion që ka kërkuar Kryesia e Kuvendit dhe këtu nuk ka nevojë të votohet si i tillë. Këtu duhet ta votojmë vetëm mocionin që e nga ngritur zoti Hoti në emër të LDK-së.

Po ashtu sa i përket Ligjit për hetimin parlamentar lidhur me zëvendëskryesuesin, ligji thotë shumë qartë se zëvendëskryesuesi emërohet nga Kuvendi, me propozim të iniciatorit, që do të thotë, në këtë rast, me propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike ose grupit iniciator të komisionit, thotë ligji më tutje, por është e qartë që i takon Grupit Parlamentar të LDK-së.

Ne i kemi propozuar po ashtu emrat, tash mbetet që derisa ajo pikë të vijë në rend të dite ne të koordinohemi që kush të jetë kryesues, po ashtu i përket Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendës. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur, zoti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne jemi të pajtimit që kjo të futet në rend të ditës sot dhe kur bëhet diskutimi, deri atëherë të dakordohen rreth kryesimit, që me gjasë, duhet t'i takojë Lëvizjes Vetëvendosje.

KRYESUESI: Faleminderit, Zoti Nitaj, në emër të AAK-së.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

Ju pak më herët thatë që nuk e di çka e keni ndërmend të bëni me këtë komision.

Nëse doni që ky komision të bëjë diçka, është mirë të mos thirreni shumë në procedura, iniciuesi e paska të drejtën e propozimit edhe të kryesuesit të këtij Komisioni Hetimor, edhe të zëvendësit të tij, a përfaqësuesi i Grupit të Deputetëve të Pavarur u pajtua që kjo t'i takojë deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Prandaj, nuk shoh asnjë arsye që të mos vendoset kjo çështje si pikë e rendit të ditës dhe të votohet kur t'i vijë radha.

Grupi i deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetjen një propozimi të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Lista serbe nuk është, Nisma, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Po edhe deputetët e Nismës mbështesin që kjo pikë të hyjë sot në rendin e ditës, ashtu siç u deklaruan të gjitha grupet e tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Sa i përket rekomandimit në lidhje me kryesimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, ne e përkrahim rekomandimin e komisionit.

Ndërsa sa i përket çështjes që të hyjë në rend të ditës si pikë e rendit të ditës, duke pasur parasysh se agjenda është shumë e ngjeshur, ne u deklaroam edhe më herët që nuk jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të hyjë sot në rend dite. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, mbetet që unë ta hedh në votim, që çështja e Komisionit Hetimor të futet në rend të ditës në seancën e sotme si pikë e fundit të rendit të ditës.

Në sallë kemi 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

A doni të përsëritet votimin? Dikush nuk ka dashur të votojë.

E përsëris edhe një herë, ju lus që të votoni për ose kundër, nuk është me rëndësi, por me rëndësi është kuorumi, të votojnë të gjithë.

Edhe një herë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

67 deputetë janë në sallë, përgatitemi për votim, regjia e përsërisim votimin, votojmë tash:

Gjendja është e tillë, 59 deputetë kanë votuar, 58 për, një abstenim. Nuk ka vendim, meqenëse po konsiderohet kështu.

Meqenëse u shtua numri i deputetëve dhe po kërkohet nga iniciuesi i kësaj çështjeje, edhe një herë e përsëris votimin. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum, kështu që unë nuk mund të shkojmë tutje në votim. Kurdo që të kërkohet prapë, s'ka problem për mua.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje për procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 8, 9, 22, 23, 28 shkurt, 1, 2, 7, 8, 13, 14, 15, 16, 20, 21, 23, 30 mars dhe 4 prill 2018?

A ka dikush vërejtje? Nuk ka!

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 8, 9, 22, 23, 28 shkurt, 1, 2, 7, 8, 13, 14, 15, 16, 20, 21, 23, 30 mars dhe 4 prill 2018.

Zoti Sami Kurteshi ka vërejtje në procesverbal.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë.

Unë kam një çështje për procesverbalin e datës 23 shkurt 2018, për vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme.

Në tekstin e datës 28 shkurt 2018, në tekstin e këtij procesverbali janë vënë një varg çështjes, por një çështje, me sa shoh unë, janë cekur edhe vendimet që i ka marrë edhe Kryesia atë ditë, meqenëse ka qenë një seancë e jashtëzakonshme me plot ngjarje, këtu janë cekur edhe vendimet e Kryesisë. Mirëpo, ajo çka unë vërej është se nuk janë cekur ose janë cekur në mënyrë selektive dhe nuk janë cekur të gjitha vendimet e Kryesisë që janë marrë atë ditë. Një prej atyre vendimeve që atë ditë ka marrë Kryesia e Kuvendit është Vendimi Nr. 06/5-114, me të cilin Kryesia ka vendosur që deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ali Lajçi, Sami Kurteshi, Ismajl Kurteshi, Arbërie Nagavci, Valon Ramadani, Arbër Rexhaj, Shemsi Sylja për hedhje të gazit lotsjellës në seancën plenare të mbajtur më 21 mars 2018 u shqiptohet masa disiplinore: ndalimi i pjesëmarrjes në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 21 mars 2018.

Unë konstatoj se ky vendim nuk është futur fare në procesverbal, nuk është cekur, është e obligueshme, sepse është vendim zyrtar i Kryesisë së Kuvendit, dhe ka të bëjë me seancën, një. E dyta, të konstatohet se një numër i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës me një vendim të jashtëligjshëm dhe të padrejtë kanë përjashtuar një numër të deputetëve dhe deputeteve nga pjesëmarrja në seancë, në mesin e tyre jam edhe unë, me arsyetimin për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës. Ky fakt nuk mund të vërtetohet në asnjë mënyrë, sidomos në rastin tim. Edhe unë mendoj se kjo shkelje e Kryesisë së Kuvendit duhet të futet në procesverbal. Kjo është e domosdoshme, janë edhe dy vendime të tjera, por ky është një vendim që unë e prek.

Çështja tjetër që unë dua ta ngre, në të njëjtën seancë nga foltorja e kryetarit të Kuvendit, derisa mikrofoni ka qenë i hapur, është dëgjuar një shprehje banale në formë të sharjes, e cila nuk është futur fare në këtë procesverbal. Unë mendoj se ajo është një moment që duhet të ceket dhe të futet në procesverbal. Nëse ajo ka qenë një lëshim i rastit, unë kërkoj që kryetari i Kuvendit ta sqarojë shprehjen e tij derisa ka qenë mikrofoni i hapur, edhe nga cilësia e kryetarit të Kuvendit, edhe nga vendi i kryetarit të Kuvendit, nëse konstatohet, e ajo është konstatuar se shprehja banale është thënë gjatë seancës, të kërkohej marrja e masave adekuata siç është e paraparë në Rregulloren të Kuvendit, edhe deri atëherë kryetari i Kuvendit të kërkojë falje zyrtarisht për përdorimin e shprehjeve të tilla, ose ta sqarojë cila ka qenë arsyeja dhe çka është dashur të thuhet me ato shprehje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vendimi është i Kryesisë dhe vendimet e Kryesisë nuk hyjnë në proces të Kuvendit, të seancës. Sidoqoftë, ti ke të drejtë në vërejtjet tua, unë nuk mund t'i fus në procesverbal personalisht, ti mund t'i ndjekësh të gjitha procedurat që i keni në dispozicion. Në qoftë se do të duhej të ishin në procesverbal, me siguri që do të jenë. Ky është interpretimi im, besoj që nuk ka nevojë më shumë të diskutojmë.

Mendoj që ato që i ngriti Samiu janë e drejtë e tij dhe po besoj që rregullat janë të përcaktuara, të mos i marr unë përsipër çështjet që s'janë në dorën time.

A është procesverbal a transkript? Në rregull! Në procesverbal futen vendimet. Sami, ti e ke me procesverbalin a transkriptin?

SAMI KURTESHI: Unë mendoj se është fjala për procesverbalin, edhe ky është një vendim zyrtar i Kryesisë së Kuvendit, i një institucioni kushtetues, edhe nëse vendimet e shkruara të një institucioni kushtetues nuk hyjnë në procesverbal, kjo është një risi. Unë jam deputet i ri, ndoshta nuk e di, po unë e di që çdo vendim zyrtar i shkruar duhet të jetë pjesë e procesverbalit. Kurse, në transkript unë po shpresoj që ato çka janë dëgjuar, edhe vendimet, ato nuk mund të humbin nga transkripti e të fshihen, sepse ajo do të ishte një veprim i kundërligjshëm dhe ilegal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Do ta merrni me siguri përgjigjen në kohën e duhur, në interpretim të Rregullores dhe të ligjit. Të mos e zgjasim për diçka që s'është as në dorën time, as në dorën tënde.

- Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë nr. 9/39, datë 4. 4. 2018, për ratifikimin e nëntë

anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, respektivisht ministrin e Arsimit që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë vendimin e Qeverisë për ratifikimin e nëntë anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Zoti ministër, fjala është për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Para se të filloj ekspozenë në lidhje me rrjedhat e emërimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, më lejoni që fillimisht t'i falënderoj të gjithë aktorët për një bashkëpunim të sinqertë që kanë bërë gjatë gjithë këtyre ditëve për ta formuar dhe për ta bërë sa më shpejt aktiv Këshillin Shtetëror të Cilësisë, gjegjësisht Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

E njëjta gjë, të nderuar deputetë, ishte edhe një seriozitet juaji i shtuar lidhur me këtë çështje me vetë votimin që jeni dakorduar që sot kjo pikë të futet në rendin e ditës dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë të dalë para jush për votim. Më lejoni shkurtimisht t'ju informoj për rrjedhjen e ngjarjes për emërimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, menjëherë pas rekomandimeve që Kuvendi i Kosovës në mbledhje të jashtëzakonshme dha për Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Unë si ministër kam thirrur komisionin për hartimin e Udhëzimit administrativ. Në këtë komision kanë qenë të përfshirë të gjithë aktorët e interesit, ku ka qenë Komisioni Parlamentar për Arsim i ftuar si anëtarë i komisionit, Akademia e Shkencave, universiteti, organizatat ndërkombëtare, shoqëritë civile, pra të gjithë aktorët ishin të përfshirë që të hartohet një Udhëzim administrativ cilësor.

Pas hartimit të Udhëzimit administrativ dhe vendosjes së kushteve për t'i plotësuar një anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, ne kemi bërë thirrje publike që të interesuarit të aplikojnë për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Pas përfundimit të afatit të publikimit dhe shpalljes publike për thirrje të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjithsej kanë aplikuar 35 kandidatë dhe komisioni, i cili ishte formuar mbi bazën e këtij Udhëzimi administrativ kishte hartuar listën e ngushtë prej 16 anëtarëve. Lista e ngushtë është hartuar mbi kushtet, të cilat janë përcaktuar në Udhëzimin administrativ, duke pasur parasysh katër fushat profesionale të ndara sipas Udhëzimit administrativ. Më pas, në listën e ngushtë janë emëruar gjashtë anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, emërimi nga ana ime të gjashtë anëtarëve të Këshillit të Cilësisë është bërë duke u bazuar në dy kritere kryesore të Udhëzimit administrativ. Në kriterin e fushës, ku secila fushë minimumi duhet ta ketë një profesionist dhe në kriterin e gjinisë. Nga gjashtë profesionistët, të cilët janë emëruar në Këshillin Shtetëror të Cilësisë vendor, 50% janë femra dhe 50% janë meshkuj.

Ndërsa, pjesa prej tre profesionistëve të huaj sipas Udhëzimit administrativ të emërohen në koordinim me faktorin ndërkombëtar dhe kjo është realizuar dhe tani kemi listën e plotë të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të cilët sot e keni ju para vetes, të nderuar deputetë.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e funksionalizimit të Agjencisë, sot po kërkoj mbështetjen tuaj për ratifikimin e listës të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Në bazë të fushëveprimit dhe mandatet e saj, respektivisht në bazë të nenit 7, të paragrafit 4, të Ligjit nr. 04/ L- 037, për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011, si dhe Udhëzimin administrativ të MASHT-it me nr. 05/2018, mbi kriteret dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të Agjencisë Kosovare për Akreditim, si dhe udhëzimin e miratuar me nr. 9/2017 të datës 2. 9. 2017 për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka paraparë dërgimin e vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Objektivi kryesor për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit është se me ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, kjo agjenci do të funksionalizohet dhe do të jetë pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, në funksionalizimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë do të krijohen bazë e mirë e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Krejt në fund, dëshiroj të theksoj se është fjala për një vendim të rëndësishëm, i cili do të ndikojë në funksionalizimin dhe rritjen e efikasitet në akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës. Prandaj, kërkoj nga ju që të jepni mbështetjen tuaj për të votuar dhe ratifikuar anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, gjegjësisht funksionalizimin e Agjencisë së Akreditimit.

Ju falënderoj dhe kërkoj votimin nga ju, të nderuar deputetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e komisionit, zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2018 shqyrtoi Vendimin e Qeverisë nr. 9/39 të datës 4 prill 2018 për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë ratifikimin e nëntë anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në këtë përbërje: profesor i asociuar, doktor Vjollca Krasniqi, profesor i asociuar doktor Arta Jakupi, doktor specialist Rozafa Koliqi-Lila, profesor doktor Magdalena Ziolo, profesor doktor Gazmend Luboteni, profesor doktor Herberd Amato, profesor doktor Xhavit Rexha, profesor msc. Xhefri Butell dhe profesor i asociuar doktor Dukagjin Zeka.

Pra, komisioni i rekomandon Kuvendit që ta ratifikojë Vendimin e Qeverisë nr. 9/39 të datës 4 prill 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e diskutueshme, respektivisht e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket Këshillit Shtetëror të Cilësisë, ne kemi parë përgjegjësinë e kësaj Qeverie në raport me këtë këshill që nga vendimi për shkarkim, ku pastaj suspendimi edhe i Republikës së Kosovës për këtë arsye, edhe nga debati që kemi nxjerrë, por mbi të gjitha te ne mbizotëron arsyeja institucionale që kjo është e rëndësishme që ne të kemi ratifikim të Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Paraprakisht ju më herët deklaruat që janë 67 deputetë të pranishëm dhe ne i dhamë përkrahje që kjo pimë të renditet si pikë e parë, ndërsa u sabotua vendimi për themelimin e Komisionit Hetimor, i iniciuar nga Lidhja Demokratike dhe i mbështetur nga 40 deputetë. Kështu që ne nuk do të marrim pjesë në këtë votim, derisa të kalojë apo të futet në rend dite Komisioni Hetimor, i cili është më se imediate që të fillojë punën mbi ngjarjen e cila ka ndodhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Faktikisht jemi para një akti të kryer, për arsye se më 19 të këtij muaji do të mbahet Asambleja e Përgjithshme e ENKA-s dhe ne patjetër duhet ta ratifikojmë në Kuvend sot këtë Këshill Shtetëror të Cilësisë, duke pasur parasysh, edhe në emrin timin personal si deputet, edhe si pjesë e Komisionit për Arsim, sinqerisht kam menduar se me rekomandimet e seancës në datën kur është diskutuar për këtë Këshill, por edhe në bazë të asaj që janë marrë rekomandimet nga kjo seancë, duke pasur parasysh edhe involvimin e Akademisë së Shkencave, universitetit, ministrisë, shoqërisë civile do të ketë një cilësi shumë të madhe të këtij Këshilli, por e them me plot përgjegjësi, jam plotësisht i zhgënjyer nga lista dhe nga emrat që gjenden në këtë listë, por për hir të asaj duke e ditë rëndësinë që çfarë përgjegjësie e ka dhe çka nënkupton funksionalizimi sa më shpejtë i këtij Këshilli, ne do ta votojmë dhe do ta mbështesim, por uroj që ky Këshill sa më shpejt të bie.

KRYESUESI: Faleminderit! Vetëvendosje, zoti Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Si anëtar i komisionit unë e kam votuar këtë listë, por dua të tërheq vërejtjen dalëngadalë po na paraqitet një problem me pasoja. Njerëzit e duhur, njerëzit profesionistë, njerëz të aftë nuk po konkurrojnë nëpër komisione dhe s' di si t'ia bëjmë që t'i marrim njerëzit që na duhen për një vend të caktuar, ku vërtet do të kontribuonin me aftësitë e veta, me kualifikimet e veta.

Me keqardhje po them, kjo listë ka mundur të jetë shumë më e volitshme, më e fuqishme, por jemi detyruar, si tha edhe zoti deputet para meje, jemi detyruar ta votojmë. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Atëherë duke pasur parasysh se situata është shumë e ndjeshme dhe emergjente, tashmë Agjencia Kosovare e Akreditimit është jofunksional dhe rrezikon të mos përmbushen edhe afatet për akreditimin e programeve në universitete dhe kolegje, po ashtu duke pasur parasysh edhe faktin e rrezikut të përjashtimit edhe nga ENKA, Lëvizja Vetëvendosje në këtë pjesë, domethënë te ky ligj, e shoh të rëndësishme që të mos pengojë punën e funksionalizimit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, pikërisht edhe për faktin se me urgjencë duhet të iniciohen edhe ndryshimet ligjore.

Udhëzimi administrativ që e përmendi ministri është vetëm një gjë që ka mundur të bëhet në kuadër të ligjit ekzistues, por në mënyrë që të kemi Këshillin Shtetëror të Cilësisë, sikur edhe bordet e tjera të popolitizuara, atëherë duhet të iniciohen ndryshimet ligjore, të cilat ne presim prej ministrit që të nisen sa më parë, në mënyrë që të sigurohemi që vërtet persona profesionistë të kemi në këtë këshill, ashtu sikur edhe në organet e tjera drejtuese.

Pra, duke pasur parasysh se kjo është një situatë emergjente, ne në këtë pikë e përkrahim si Lëvizje, ndërsa në pikat e tjera nuk do të marrim pjesë në votim për shkak të bojkotit që iu bë pikës paraprake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetët e Pavarur, Dardan, shtypeni butonin, se nuk po di kënd ta thërras. Zoti Sejdiu e ka fjalën!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, situata në të cilën ndodhemi sot është situatë, e cila më së thjeshti mund të përshkruhet si zjarrfikje të një zjarri që vetë e keni ndezur. Pra, me shkarkimi e komisionit, ju keni krijuar një situatë, në të cilën është dashur në mënyrë të shpejtë të gjendet një rrugë për të mos rrezikuar dëmet e mëtutjeshme karshi, thënë të pjesëmarrjes sonë në institucionet e rëndësishme që ndërliken me arsimin e lartë.

Duke e pasur parasysh këtë situatë, po i sillni edhe deputetët para një akti, në të cilin po duket thajse deputetët janë përgjegjës për gabimet në hapat që i keni bërë si Qeveri. Pra, në vend se të bëni një analizë të mirëfilltë të punës dhe pastaj të merren vendime, e ato vendime të vendoseshin apo të pozicionoheshin karshi interesit të arsimit të lartë, vendimi ka qenë i ngutshëm për shkak të një përfitimi politik e medial që iu ka dashur Qeverisë dhe këtu përsëri po na e sillni një listë, e cila duhet në mënyrë të ngutshme të votohet, sepse po ekziston një presion tashmë prej përjashtimit të Kosovës nga institucionet, të cilat u përmendën edhe më herët.

Rrjedhimisht, çdo votim këtu i kësaj liste është votim për të mos cenuar pjesëmarrjen e Kosovës në këto institucione, e jo për cilësinë e listës dhe jo për a ka qenë procesi në rregull dhe pse kemi ardhur në këtë pozicion. Pra, në këtë aspekt, ministër, arsimit nuk trajtohet me intervenime të tilla ad hoc e me zgjidhje, të cilat gjithashtu janë në kuadër të një të themi kështu afati kohor të paracaktuar prej tjerëve. Unë po i dëgjoj edhe anëtarët e komisionit dhe të njëjtën brengë po e shprehin edhe ata, jo që janë të kënaqur me listën, por se janë pozicion jo të mirë. Kësi pozicione një qeveri e përgjegjshme nuk duhet ta sjellë asnjë deputet të Republikës së Kosovës, e aq më shumë ta sjellë arsimin e lartë në këtë Republikë. Rrjedhimisht për shkak të situatës në të cilën ndodhemi, ne si Grup i Deputetëve të Pavarur do ta japim votën meritore që e ka kjo listë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me shumicën e diskutimeve që u thanë pak më parë, pra jemi në një situatë kur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkohet ratifikimi i kësaj liste dhe tani secili prej nesh duhet të ndalemi së pari në një debat të thirrur këtu, pikërisht për shkak të bordit të shkarkuar, nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Dhe, në fund, në të gjitha rekomandimet që kanë dalë, ku të gjitha subjektet politika bashkërisht kemi punuar në rekomandime, që janë shtatë sosh. Nga këto rekomandime, pra në vazhdimësi, Ministria e Arsimit ka qenë shumë e hapur dhe në këtë kohë, pra në afatet kohore, ashtu siç janë paraparë me pikat që janë nxjerrë nga Kuvendi, është hartuar udhëzimi administrativ, e në punën gjatë hartimit të tij kemi qenë pjesë unë dhe kryetari i komisionit, zoti Kurteshi, dhe duke qenë të pranishëm dhe duke qenë pjesë e asaj pune, flas për një transparencë mbi të gjitha për mundësinë që ka pasur në udhëzim administrativ edhe për t'u vetënominar kandidatët.

Dhe tani, a jemi të kënaqur me një listë që ka ardhur në Kuvend? Edhe unë personalisht i kam vërejtjet e mia dhe shumë me bazë për individë të caktuar brenda listës, por lista që duhet të ratifikohet e plotë si listë komplet, atëherë neve na pamundëson për t'i dhënë vërejtjet tona për individë të caktuar. Por, edhe në mosmarrjen e obligimeve të shumë kandidatëve, për të cilët unë jam shumë e sigurt se ka të shumtë në Kosovë që janë shumë profesionistë, por thashë edhe një

herë, mundësitë kanë qenë që edhe institucionet t'i dominojnë, por kanë qenë edhe mundësitë e vetënomimit. Dhe, personalisht jam interesuar shumë edhe për të gjithë kandidatët, të cilët kanë thjesht kanë aplikuar. Në listën e ngushtë prej 16 sish që i kanë shkuar ministrit, sepse mbi të gjitha në Komisionin e Përzgjedhjes vetëm një kandidat ka qenë i ministrisë. Kanë qenë kandidatë tjerë nga shoqëria civile, nga organizata të ndryshme dhe në fund ka ardhur kjo listë.

Jam interesuar për disa individë dhe kam parë që disa prej tyre kanë pasur edhe konflikt interesi, por unë mendoj që lista që na ka ardhur neve është edhe mosinteresim i kandidatëve dhe, sinqerisht, gjatë kohës kur kemi punuar në udhëzim administrativ unë e kam parë një pagesë minimale prej 150 eurosh, që është diskutuar që marrin këta kandidatë në Agjencinë për Akreditim dhe për çfarë cilësie flasim, kur mendoj personalisht që aty është mundësia edhe të mos them në ekstrem, por korrupsion, sepse ta marrin një pagesë minimale prej 150 eurosh në një institucion më të rëndësishmin për cilësinë e arsimit, kjo për mua është “no comment!”.

Prandaj, edhe një herë i lus të gjithë deputetët, por edhe deputetët e LDK-së ngase vetë e kanë iniciuar një debat që sinqerisht ka qenë shumë i frytshëm dhe kanë dalë rekomandimet që sot t'i bashkohen dhe të mos flasim për proceset tjera dhe humbjen e rastit, ndoshta edhe për t'u ankuar në institucionet kredibile ndërkombëtare.

Mbi të gjitha, pajtohem që me urgjencë të hartohet Ligji për Agjencinë për Akreditim dhe pastaj në bazë të ligjit të bëhet përzgjedhja jo në listë të plotë prej të gjithë anëtarëve, por ta kemi mundësinë edhe të përzgjedhjes dhe të zgjedhjes si individë, pra në veçanti. Duhet të flasim për një listë ndoshta për shkak të gjinisë femërore, që lista prej 9 anëtarëve ka katër femra, për fat të mirë, dhe prandaj ndoshta nuk është lista më e mirë, por në mesin e atyre që kanë aplikuar unë them që ka qenë më e mira e mundshme.

Prandaj, edhe një herë i lus të gjithë deputetët, duke i ftuar edhe deputetët e LDK-së, që për hir të transparencës për proceset që ndodhën më herët, t'i bashkohen votimit, ngase ky proces nuk është për interesin e asnjë subjekti politik, por është për interesin e institucionit në fjalë, ngase presin shumë e shumë programe të universiteteve dhe kolegjeve private që presin për akreditim. Andaj, në fund, pas ratifikimit, edhe unë them që një hetim i plotë, apo thënë më mirë një auditim i plotë i institucionit për të gjitha të gjeturat që ne si individë mund t'i kemi, edhe fakte kemi për gjithë atë që ka ndodhur në atë bord dhe është mirë edhe opinioni ta dijë. Këtu i ftoj të gjithë që vërtet t'i bëjmë transparente të gjitha të gjeturat, ngase ka të shumta, ka edhe lëndë, siç e ka përmendur ministri, që janë dërguar në institucionet për hetim dhe ato duhet të bëhen publike. Por, jemi para një procesi dhe kërkojmë edhe një herë që ky bord të kompletohet dhe i lus edhe deputetët, për hir të këtij institucioni dhe detyrave dhe obligimeve që i ka, pra ta votojmë dhe normalisht të mos ndalemi së kërkuari në çdo institucion, e mbi të gjitha edhe në këtë institucion, pra të kërkohet auditim dhe të gjeturat të vijnë në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Desha t'i them disa fjalë rreth asaj arsyes, argumentit, që e ngriti apo e ngritën kolegët nga Lidhja Demokratike e Kosovës për mospjesëmarrjen në votim.

Shihe, ata mund të bëjnë çfarë të duan, të marrin pjesë apo të mos marrin pjesë në votim. Është e drejtë e secilit deputet apo grup parlamentar. Ama ta fillosh një debat, të ngresh një çështje, madje me seancë të jashtëzakonshme, të rrjedhë seanca sipas orientimit të skenarit të tyre, të ngrihet një komision që do të nxirrte përfundime të përbashkëta, po ashtu në shumicën e pjesës sipas asaj që ata parashikuan, dhe tash në fund të mos votojnë për produktin që ata vetë e kishin iniciuar, ata vetë kishin insistuar, vetëm e vetëm sepse një parti, në këtë rast PDK-ja nuk e votoi një çështje të tyre, është e padrejtë. Është e padrejtë edhe në raport me ministrin, i cili në vazhdimësi ka qenë bashkëpunues, jo vetëm me Lidhjen Demokratike të Kosovës, por me të gjitha grupet parlamentare, me shoqërinë civile, me Zyrën e Bashkimit Evropian, me të gjithë ka qenë bashkëpunues dhe fare nuk ka qenë imponues, e dinë mirë kolegët nga LDK-ja, sa i përket imponimit apo përfshirjes së emrave. Kjo sa i përket Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Sa u përket kolegëve deputetë, të cilët po i japin vetes të drejtë t'i paragjykojnë anëtarët e komisionit, u them se atëherë mos u befasoni nëse ENK-a vjen në këtë përfundim se nuk i keni kridibilë, nuk i keni të aftë, nuk i keni të paanshëm, kur ne nga foltorja e Kuvendit u themi atyre "Shih çfarë, ne po e kënaqim një formë, të cilën ju na e keni kërkuar, se këta nuk vlejné". Këtu duhet të vijmë në një përfundim, a janë më të mirët nga ata që kanë konkurruar, se a janë më të mirët në Kosovë, besoni se 120 deputetët që jemi këtu jemi më të mirët në Kosovë? Jo, por ne jemi ata që na ka zgjedhur dikush, na ka sjellë këtu. Edhe ata janë nga ata që kanë kandiduar, janë nga ata që janë vetënominuar, janë nominuar nga dikush, është bërë përzgjedhja, jo nga ministri, por nga një ekip më i gjerë se ministri dhe ministria dhe le t'i lëmë njerëzit të punojnë, le t'i gjykojmë ata në kohën kur të vijë për t'u gjykuar. Le të bëjnë njëherë diçka, pastaj të flasim a paskan qenë të zotët, apo nuk paskan qenë të zotët. Pra, të mos i paragjykojmë, por le t'ua japim rastin të punojnë, pastaj t'i gjykojmë në bazë të punëve që kanë bërë.

Kjo do të duhej të ishte fryma që do duhej ta karakterizonte këtë seancë si përmbyllje e tërë kësaj sage, që na shoqëroi që nga momenti kur janë shkarkuar ata, që pastaj pasoi me seancën e jashtëzakonshme, me debatin e gjerë dhe të thellë rreth arsimit dhe jo vetëm rreth arsimit të lartë, por në përgjithësi, dhe erdhëm deri te ky moment. Tash, kur kemi ardhur t'i korrim të gjithë frutat, themi "Jo, nuk i duam! Nuk duam, sepse nuk na kaloi edhe një pikë tjetër". Ajo pikë nuk kaloi sot, do të kalojë nesër, nuk ka kah të shkojë. Nuk ka, le të rezistojnë sa të duan ata të cilët po bëjnë përpjekje për ta shtyrë, le ta zvarritin sa të duan, dy ditë, tri ditë, katër ditë, se në fund të fundit ajo çështje filloi me seancë të jashtëzakonshme, është duke u zhvilluar me "slow motion" me "xhirim të ngadalësuar", por prapë do ta ketë një fund, nuk ka kah ia mban.

Komisioni hetimor do ta marrë rrugën e vet, komisioni hetimor do ta kryejë punën e vet. Pra, të mos e bllokojmë çështjen e arsimit, vetëm sepse sot nuk kaloi çështja që insistuan kolegët nga LDK-ja. Le t'i ndajmë këto dyja, ashtu siç janë të ndara. Kemi të bëjmë me çështjen e arsimit, që na prek të gjithëve dhe kemi të bëjmë me çështjen e hetimit të dëbimit, për të cilin kemi debatuar një ditë të tërë. Pra, le t'i trajtojmë veç e veç, nuk kanë kah shkojnë të dyja. Sot le ta mbyllim arsimin, pas dy-tri ditësh do ta mbyllim, në fakt do ta hapim, sepse komisioni hetimor, miratimi i tij, formalizimi i tij është vetëm fillimi, pastaj nga puna e tij do të shihet se sa e kemi pasur seriozisht dhe kujt vërtet i ka dhimbsur çështja e dëbimit, dhe kush e ka pasur veç politikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën. Zoti Zemaj po ashtu e ka kërkuar fjalën. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryesues!

Është evidente se ne nuk dëshirojmë t'i përziejmë gjërat, kështu siç po tentohet të krijohet një lloj pasqyre e ndarjes, apo e përjashtimit selektiv. Qeverinë e shohim si qeveri, nuk i shohim ministrat e kësaj partie apo të asaj partie, kjo është një qeveri e kësaj mazhorance, e cila nuk i ka numrat për ta kaluar një vendim, e para. E dyta, deputetët tanë i kanë dhënë plotësisht përkrahje në Komisionin Funkcional këtij propozimi, pa i përsëritur arsyet pse dhe pa dashur që të kthehemi prapa në shkaqet të cilat kanë sjellë deri këtu ku jemi.

E dyta, i dhamë përkrahje që kjo pikë të shmanget nga Rregullorja, e të futet si prioritet. Krejt ajo çfarë po kërkojmë është që t'i vëmë para përgjegjësisë ata që e sabotuan hyrjen në rend dite të pikës për komisionin hetimor. Kjo është përgjegjësi e mazhorancës, nuk po flas për deputetët individualisht. Kështu që renditeni pikën e tanishme me këtë vendim, ne do ta votojmë me gjithë përkrahjen dhe gjithë deputetët që i kemi të pranishëm. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Jo, unë e mora fjalën, zoti kryesues, për ta sqaruar zotin Sherifi se tha që Partia Demokratike e Kosovës nuk e ka votuar. Ju kisha ftuar të gjithëve kolegë, që të flisni kur të jeni të informuar, jo kur jeni të painformuar. Votimi që nuk ka kaluar i ka marrë 56 vota pro, prej të cilave 21 janë vota të koalicionit qeverisës, 8 janë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe 2 abstenime.

Ju e dini që fillimi i seancës ishte fillim i vazhdimit dhe shumë prej deputetëve nuk ishin këtu. Tri herë është votuar, s'ka kaluar, ndërsa LDK-ja i ka pasur 12 vota pro. Unë e di që këta janë 27. Përgjegjësia mund të jetë e tyre aq sa është e Kuvendit pse s'ka arritur ta kalojë një vendim. Nëse prej 27 deputetëve, kanë votuar veç 12, atëherë qysh mund të kërkojnë përgjegjësi prej kujt do tjetër? Unë ju tregova, e keni regjistrin zyrtar të votimit dhe pikërisht për ta sqaruar

këtë e kërkova zyrtarisht dhe janë 35 vota pro që i ka dhënë opozita, veç 12 janë të LDK-së. Ndërsa janë 21 të koalicionit, e prej tyre shumica janë të Partisë Demokratike të Kosovës, jo të tjetërkujt. Kështu që ju lus të jeni të kujdesshëm kur thoni “e ka bojkotuar”, ose “s’e ka bërë...”, ose “ashtu, kështu...”

Do të thotë, shumica absolute e deputetëve të PDK-së që kanë qenë këtu të pranishëm e kanë votuar, sepse edhe qëndrimi im si shef i grupit ishte i tillë, andaj mos manipuloni dhe të jemi të kujdesshëm me fjalën publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Kryetar!

Unë nuk kam autoritet sa të kërkoj lista, siç paska zoti Krasniqi, në sekondë zyrtarisht t’i kërkojë dhe menjëherë ta dijë kush ka votuar për, kush kundër, kush ka abstenuar. Unë në fjalën time iu referova asaj që tha kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Avdullah Hoti, dhe votimit të parë, të dytë dhe të tretë, ku vazhdimisht mbetej numri në 58, 59, edhe pse hynin herë pas here deputetë që vraponin dhe votonin për. Pra, dikush kujdesej ta tërheqë kartelën. Unë nuk thashë që kryetari i Grupit të PDK-së tha “mos votoni”, unë nuk thashë që ishte qëndrim i PDK-së për të mos votuar, por përshtypja u krijua nga ajo që tha dhe nga ajo që unë po mund të vrojtoj këtu, sepse unë nuk kam autoritet t’i marr letrat, por po mund...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Zemaj kundër Memli Krasniqit.

ARMEND ZEMAJ: Jo, kolegu ynë Bilalli pak a shumë e shpjegoi edhe raportin, por edhe atë çfarë u deklarua. Unë nuk deklarova, as Lidhja Demokratike nuk deklaroi që dikush me emër të veçantë e sabotoi, por Partia Demokratike, shefi i grupit, e mori përgjegjësinë.

Sido që të jetë, në Kuvend tash janë 64 a 65 deputetë, ashtu siç po na njofton Administrata. Hidheni në votim, ne jemi në rregull.

KRYESUESI: Fjalën e ka... Bilall, e kërkova prapë? Ok! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Unë më shumë e kisha kërkuar mirëkuptimin e të gjithë deputetëve dhe ju kisha lutur, kryesues, pse të mos hidhet edhe një herë në votim, meqenëse kemi numër të mjaftueshëm. E votojmë, se pesha e Agjencisë së Akreditimit është tepër e rëndësishme dhe është mirë që kjo pikë e rendit të ditës sot të kalojë.

Kështu, e hedhim edhe një herë në votim, ia japim dritën jeshile. Të gjithë jemi pajtuar që të ketë komision hetimor, kjo punë ecën në drejtimin e vet dhe shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Memli, e tha më herët. Pse kanë munguar tre deputetë, kjo nuk do të thotë, unë s'kam marrë pjesë në votim, por nuk isha në sallë. Kështu që nuk është ndonjë problem i madh. Hidhe në votim, e votojmë edhe një herë e vazhdojmë tutje, që ta përfundojmë historinë e Agjencisë së Akreditimit.

Edhe sa i përket asaj që u tha më herët, asnjë prej këtyre anëtarëve kandidatë nuk është i subjekteve politike, ta kuptojnë të gjithë. Edhe në CV-të e tyre, shumica prej tyre janë doktorë shkence, pavarësisht që ndoshta jo në cilësinë e lartë që të gjithë do të donim të jenë, por po që se ua shikoni CV-të, secili është më i mirë se tjetri. Faleminderit!

KRYESUESI: Emilija Rexhepi, urdhëro!

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

S obzirom na funkcionalnost Ministarstva obrazovanja i Kosovske Agencije za akreditaciju, i predloga od strane Funkcionalne komisije za obrazovanje koliko je važno da to danas izglasamo, ja prosto ne mogu i dalje da razumem našu Vladu, jer je njen predlog ova imena koja su ovde zabeležene, odnosno devet profesora doktora, bez obzira dali dolaze iz nekih političkih partija, oni su verovatno stručna ne zalazeći u njihovu stručnu spremu. Ja prosto ne mogu da verujem da nijedan od ovih nije pripadnik nekih drugih zajednica.

Pa, zar mi gospodo nemamo stručne ljude, nemamo profesore, nemamo doktore, koji mogu direktno uticati na kvalitet akreditacije? Mi kao Bošnjačka zajednica smo već pet šest godina unazad imali problem sa Agencijom za akreditaciju u vezi otvaranja novih smerova, pravni i ekonomski, i nismo u tome uspeli. Sada ponovo imamo jedan predlog od devet osoba koji danas trebaju ovde da se glasaju. Nemam ništa protiv tih osoba, ali zar je moguće da nijedan pripadnik bošnjačke, turske, aškalijske, egipćanske, ili bilo koje druge zajednice koja živi na Kosovu ne može dati svoj doprinos?

Ja se ovde pitam, kako ćemo mi pripadnici manjinskih zajednica uopšte da glasamo ovaj vaš predlog danas koga smo dobili od strane Funkcionalne komisije za obrazovanje, a ne znamo ni ko je tu od pripadnika manjinskih zajednica kao član. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Ju keni bërë tani kërkesa të ndryshme, ose për ta rikthyer votimin sa i përket çështjes së komisionit. Ne më herët, dua ta përsëris, i kemi pasur në sallë 67 deputetë që kanë votuar dhe kanë hyrë pastaj edhe nja 4-5 të tjerë, e kam përsëritur prapë. Gjendja me vota ka qenë e njëjtë. Kështu që unë po e hedh në votim çështjen e Këshillit të Cilësisë dhe pastaj, në qoftë se ju mendoni që duhet ta hedhim paraprakisht në votim, në qoftë se ju mendoni se unë duhet ta hedh edhe një herë në votim, këtu janë kryetarët e grupeve

parlamentare, mund të deklarohen. S'po e hedh në votim atëherë a ta kthej, a mos ta kthej. Unë e kam përfunduar me atë votim. E hedh këtë që e diskutuam deri tash dhe është ai...

Atëherë, kërkoj nga përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e dëshiron fjalën sa i përket kësaj që u diskutua deri tash. Jo? Atëherë, në vazhdim kërkoj deklarinimin me votim për miratimin e rekomandimit të Komisionit Funkcional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Tregoni kush s'ka kartelë, nxirreni kartelën prej aty dhe ata që s'kanë kartelë votojnë me dorë. Dua të shoh kush paraqitet pa kartelë, kush s'ka kartelë? Dauti, Donika dhe... tre deputetë janë pa kartelë.

Edhe një herë e përsëris votimin. Votojmë tani!

Kanë votuar 48 me kartelë, 3 janë pa kartelë, prej tyre 45 janë për, 3 kanë abstenuar, nuk ka pasur as kuorum të votimit, sepse bëjnë 51 vota që kanë votuar, kështu që gjendja është e tillë.

Vazhdojmë me shqyrtimin e ligjeve.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Tahiri, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Republika e Kosovës në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile qëndron mjaft mirë në nivel rajoni dhe më gjerë, falë angazhimit të vazhdueshëm të mekanizmave të zbatimit të ligjit, si dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky bashkëpunim vazhdon të jetë pjesë e agjendës sime si ministër i Drejtësisë në kuadër të këtij bashkëpunimi. Pra, para së gjithash, të hyjmë në marrëveshje bilaterale me shtetet e rajonit, shtetet e Bashkimit Evropian, si dhe në rrafshin global, në përgjithësi. Rrjedhimisht, sot paraqes

para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferim të personave të dënuar.

Qëllimi i këtij traktati është përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e drejtësisë, vendosjen e drejtësisë dhe rehabilitimi social i personave të dënuar, duke ekzekutuar sanksionet penale për shtetin e vendbanimit të përhershëm të personit të dënuar.

Të nderuar deputetë,

Kjo marrëveshje e rregullon ekzekutimin e vendimeve të Gjyqësorit me transferim të personit të dënuar në rastet kur personi shtetas i shtetit administrues është duke e vuajtur dënimin në shtetin dënues dhe kërkon transferim te shteti administrues me qëllim të rehabilitimit dhe risocializimit sa më të mirë.

Marrëveshja gjithashtu i përcakton edhe rregullat dhe procedurat për parashtrimin e kërkesës për ekzekutimin e vendimit si dhe zbatimin e dënimit.

Të nderuar deputetë,

Hyrja në marrëveshje bilaterale nga Republika e Kosovës me shtetet e tjera është një indikator i rëndësishëm që fuqizon subjektivitetin ndërkombëtar të vendit tonë.

Andaj, bazuar në fakte se kjo marrëveshje prek të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ju ftoj për miratim të Projektligjit për ratifikim të traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga grupet parlamentare, kryetarja e Komisionit Funksional, zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në bazë të nenit 60 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19. 3. 2018 Komisioni për Legjislacion shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar dhe vendosi që t'i rekomandojë seancës që të miratohet ky projektligj për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar.

Duke qenë se është një traktat, ne si komision nuk kemi mundësi të ndërhyjmë në tekstin e marrëveshjes dhe e kemi analizuar natyrisht dhe përkundër faktit që s'kemi të drejtë të bëjmë ndërhyrje, e konsiderojmë që është i pranueshëm, andaj dhe u bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit që të votohet si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e përkrah ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar, por edhe për këtë çështje, sikur edhe për të gjitha çështjet e tjera, pa përfunduar, pas pasur vendimmarrje për çështjen për të cilën ne biseduam më herën për Komisionin Hetimor nuk marrim pjesë në votim në asnjë nga pikat e tjera të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar dhe i rekomandon Kuvendit dhe kolegëve deputetë që ta përkrahin këtë traktat.

Kjo i plotëson kushtet në parim dhe mendoj që është në interes të dy shteteve që të votohet.

Ne e dimë që edhe në bazë të Rregullores së Punës, neni 60, që procesi i projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një votimi.

Andaj, është mirë ta votojmë tash, sepse nuk kemi kohë ta nxjerrim në votim sa herë të duam. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes, zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar Projektligjin numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar, po ashtu ka analizuar edhe marrëveshjen ndërkombëtare.

Në parim Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah votimin për këtë projektligj dhe për këtë marrëveshje. Mirëpo unë në emër të Grupit Parlamentar kam edhe dy çështje të tjera që duhet t'i ngre në lidhje me këto çështje.

Më 24 nëntor 2017 janë nënshkruar dy marrëveshje ndërkombëtare me Hungarinë në Prishtinë nga Ministria e Drejtësisë. Këto janë marrëveshja e traktatit mbi ekstradimin ose për ekstradimin që nuk dimë pse nuk ka ardhur projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje në seancë, edhe këtë projektligj që tani ne do ta shqyrtojmë dhe sigurisht do ta votojmë.

Pse i them këto? Edhe pse nga përmbajtja, qëllimi, mënyra e zbatimit dhe elementet e tjera themelore këto dy marrëveshje janë krejtësisht të ngjashme, natyrisht secila me specifikat e veta, është interesante pse nuk sillen të njëjtën ditë, është një çështje parimore, për ratifikim.

Për nga struktura përmbajtjesore të dy këto marrëveshje janë në përputhje të plotë me dokumentet bazë, me Konventën e Këshillit të Evropës mbi ekstradimin të Parisit të vitit 1957 si dhe me traktatin model mbi ekstradimin të vitit 1990, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet Rezolutës 45/116.

Po ashtu, edhe Marrëveshja për transferimin e personave të dënuar është në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës të Strasburgut, të miratuar më 1983, sikur edhe me Marrëveshjen model për transferimin e të burgosurve të huaj dhe rekomandimet që jepen në lidhje me këtë çështje me marrëveshjen model të miratuar në njërin nga Kongreset e Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimit të autorëve të krimit, edhe kjo është e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme në vitin 1997, janë bërë edhe amendamentimet.

Pse u cekën këto gjëra? Legjislacioni i BE-së nuk përmban dokumente të veçanta të cilat rregullojnë këto çështje as për ekstradimin dhe as për transferimin të personave të dënuar.

Prandaj, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të vendeve të BE-së, qofshin ato bilaterale apo multilaterale, si brenda, ashtu edhe jashtë BE-së, lidhen duke u bazuar në dokumentet e cituara më lart, sepse ato pranohen si dokumente me vlerë universale për çështje të diskutuara edhe nga BE-ja, edhe nga vendet e BE-së veç e veç. Përveç rezervave, për të cilat disa nga vendet e BE-së mund të kenë në lidhje me çështje të caktuara.

Prandaj, nëse këto fusha nuk janë të mbuluara me ndonjë legjislacion specifik të BE-së, atëherë duket krejtësisht e pavlefshme dhe e habitshme të konstatohet sikur në deklaratën e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me ‘acquis communautaire’ të BE-së si dhe me opinionin ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, të lëshuar nga Ministria e Integritimit Evropian, se këto projektligje nuk cenojnë parimet themelore të legjislacionit të BE-së, apo projektligji në fjalë nuk është në kundërshtim me parimet bazë të ACI-së të BE-së. Kur në BE vetë në opinionin ligjor dhe në deklaratën e përgjithshme thuhet se asnjë nga lista e dokumenteve primare dhe sekondare të BE-së nuk zbatohet në këtë rast.

Konstatimi i drejtë në opinionin ligjor të përputhshmërisë domethënë një konstatim do të duhej të tregojë burimi i këtij legjislacioni, e ai burim është Këshilli i Evropës dhe dokumentet bazë të

Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe kjo do të duhej të konstatohej se marrëveshjet ndërkombëtare të vendeve të BE-së me vendet e tjera, edhe me Kosovën, nuk janë legjislacion specifik i BE-së, por kanë burimin në dokumente të tjera.

Prandaj, duke u nisur nga sa u tha më lart, edhe në projektligje duhet të ceket burimi i normës ligjore dhe tekstit si dhe obligimi ndërkombëtar për të lidhur marrëveshjet ndërkombëtare bazuar në parimet e njohura dhe të pranuara, të cilat njëkohësisht përbëjnë edhe bazën e parimeve të Bashkimit Evropian në lidhje me çështjet në fjalë.

Krejt për fund, edhe një herë po e përsëris Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah miratimin e këtij projektligji bashkë me marrëveshjen, mirëpo me vërejtjen që në deklaratën e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe në opinionin ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian të ceken në mënyrë transparente burimet e marrëveshjeve të cilat janë bartur edhe janë nënshkruar nga Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina, Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit të Deputetëve të Pavarur ne e mbështesim marrëveshjen dhe do të votojmë pro saj. Mirëpo e mbështesim qëndrimin që e shprehu Lidhja Demokratike më herët.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaliaj, në emër të AAK-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahim Projektligjin për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi ekstradimin e personave të dënuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër ka një sqarim.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti Kurteshi,

Është ashtu siç e thatë ju, në kohë i kam proceduar të dy marrëveshjet, edhe për ekstradim, edhe për transferim.

Mirëpo arsyeja pse sot nuk e kemi në rend të ditës Marrëveshjen për ekstradim është pikërisht për faktin se në Komisionin për Legjislacion nuk i ka marrë 2/3 e votave të nevojshme dhe besoj që në mbledhjen e ardhshëm shkon edhe ti e voton dhe besoj që e kemi në rend të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka kuorum të mjaftueshëm, do të vazhdojmë shqyrtimin e ligjeve, pastaj e caktojmë kohën kur do t' i votojmë edhe ato që mbetën pa votuar më herët.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjykatat

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në rrafshin praktik ky projektligj ka unifikuar ndryshime të shumta të përkohshme që i janë bërë legjislacionit të kësaj fushe, duke sjellë në mënyrë të unifikuar të gjitha parimet dhe strukturën unike të pushtetit gjyqësor në një akt të vetëm, duke garantuar kështu sigurinë juridike të tij.

Të nderuar deputetë,

Çdo dispozitë e vendosur në këtë projektligj, ashtu si dhe dy të tjerat që do t'i kemi në shqyrtim sot, është në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare që burojnë nga opinionet e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve evropianë, raportet e Komisionit të Venedikut dhe rekomandimet e Kievit.

Të njëjtat janë hartuar në atë mënyrë që t'u japin zgjidhje afatgjate dhe të kontribuojnë në krijimin e një tradite juridike, të cilën Republika e Kosovës duhet ta ndërtojë pikërisht përmes një gjyqësori efikas, transparent, llogaridhënës, në veprimtarinë e të cilit kanë besim të gjithë qytetarët e Republikës sonë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë projektligj është arritja e një standardi bashkëkohor të transparencës, ku për dallim nga ligji aktual, ky projektligj që e kemi përpara i obligon të gjitha gjykatat, nga ajo Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme t'i publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen zyrtare në afat prej 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimet në pajtim me legjislacionin në fuqi. Duke siguruar njëherësh mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke pasur parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm që po adresoj përmes këtij projektligji është edhe rritja dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi.

Projektligji ofron fleksibilitet në themelimin e gjykatave themelore apo degëve, si dhe ndryshimin e juridiksionit territorial të tyre kur vlerësohet se ka nevojë të themelohet dega apo gjykatë e re themelore, apo që e njëjta nga gjykatat ekzistuese në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës përkatëse.

Përkatësisht janë ristrukturuar dhe sqaruar në tërësi procedurat e themelimit të degëve apo gjykatave themelore.

Këto dispozita e sjellin në një dimension të ri konceptin se si është parë dhe si duhet të shihet pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të Kosovës që kurdo që shtrohet nevoja për shërbime të gjyqësorit, institucionet tona t'ua mundësojnë që këto shërbime t'i marrin sa më afër që është e mundur.

Ka qenë kërkesë imja si ministër i Drejtësisë që fizionominë e gjyqësorit ta tejkalojmë në botëkuptimin tradicional si shpërndarës i drejtësisë dhe të marrë tiparin e shpërndarësit të shërbimeve sa më afër qytetarëve të vendit.

Viti që e lamë pas shënon integrimin e plotë të sistemit të gjyqësorit dhe atij prokurorial në tërë territorin e Republikës sonë.

Në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësi, ky projektligj mundëson themelimin e divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut, pra në pajtim me ligjin për ratifikim të marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Po ashtu ky projektligj do të nxisë përmirësimin e cilësisë së personelit të gjyqësorit, pasi që janë rishikuar kriteret për t'u zgjedhur gjyqtarët, duke ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë e rritjes së konkurrencës.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, ky projektligj për të zgjedhur gjyqtarë në Gjykatën e Apelit kërkon që së paku pesë vjet përvojë pune, për dallim prej këtij që është aktualisht në fuqi kërkon 10 vjet. Ndërsa për gjykatës në Gjykatën Supreme kërkohen tetë vjet përvojë në vend të 15 vjetëve sa kërkon ligji aktual.

Këto ndryshime të kriteve rrisin dukshëm numrin e kandidatëve gjyqtarë që mundësojnë të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, përkatësisht në Gjykatën Supreme.

Pra, do të ketë më shumë konkurrencë dhe kësi soji pritët përmirësim i dukshëm i cilësisë në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Mbi të gjitha, kjo u mundëson gjeneratave të reja të jenë më ambiciozë dhe të sjellin dijeninë, kompetencën dhe cilësitë e tyre brenda sistemit gjyqësor, duke rrënuar kështu përfundimisht përvojën e deritanishme, ku këto kritere u janë pamundësuar të rinjve tanë profesionistë të qasen në sistemin gjyqësor, e rrjedhimisht kanë pamundësuar nxitjen e shkollave të reja të mendimit brenda këtij sistemi.

Projektligji po ashtu rregullon çështjen e angazhimit të gjyqtarëve të aktiviteteve jashtë punës primare, përfshirja në veprimtaritë profesionale të gjykatësve është vendosur të miratohet paraprakisht nga ana e kryetarit të gjykatës dhe kryetarët e gjykatave me aprovim të Këshilli Gjyqësor, gjithmonë me përputhje me Kodin e etikës dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve.

Pra, ky ndryshim nuk i lejon gjyqtarët apo kryetarët e gjykatave në diskrecionin që të vendoset për angazhimin në veprimtari profesionale pa aprovim kur kjo është arritur sepse eliminon apo minimizon rastet e konfliktit të interesit dhe ndalon veprimtarinë gjatë orarit të punës.

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se përmes këtij projektligji bashkërisht po u ofrojmë qytetarëve tanë sistem gjyqësor dhe Republikës sonë një mundësi të mirë për të deshifruar në mënyrë konkrete standardet e ndarjes së pushteteve, transparencës së gjyqësorit dhe përgjegjësitë dhe efikasitetin e tij.

Ju ftoj ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Komisioni FunkSIONAL, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19. 3. 2018 e ka shqyrtuar Projektligjin për gjykatat dhe i ka rekomanduar seancës që të miratohet në parim. Natyrisht, në emër të grupit do të flas më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

E dëgjuam edhe elaborimin e ministrit, ka kohë që domosdoshmëria e ndryshimit të Ligjit për gjykatat është dashur t'u përshtatet kohës dhe rrethanave, sidomos me ndryshimet e reja që janë përkrahur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por edhe nga ajo që ka dalë nga implementimi i ligjit të plotë mbi të gjitha që po e quajmë çdo herë 'reformë në drejtësi'.

Janë 2-3 elemente që unë do t'i përmend, tash kjo varet edhe nga vullneti edhe i komisionit, po mbi të gjitha në këtë strategjinë e plotë që ka paraparë edhe Ministria e Drejtësisë për fuqizimin ta quaj rendit dhe ligjit në vend dhe avancimin e rolit të gjykatave në Republikën e Kosovës.

Eliminimi i Departamentit për çështje administrative nënkupton nga ajo që ka qenë njëterritoriale dhe tash decentralizimi i saj, mendoj që këtu duhet të kemi një lloj shpjegimi më të gjerë, më të arsyeshëm, në raport me avokaturën shtetërore që e ka Republika e Kosovës dhe mbulueshmëria që bëhet nga avokatët, duke marrë parasysh që decentralizimi i Departamentit administrativ kërkon fuqizim më të madh të avokaturës shtetërore. Kjo nëse nuk garantohet, atëherë mendojmë që buxheti i Republikës së Kosovës do të dëmtohen në masë të madhe.

Dy pika të tjera që unë do t'i ngre dhe që besoj që grupi ynë parlamentar përmes deputetëve, të cilët kanë shprehur interesimin edhe nga kërkesat, ka të bëjë me pagat e gjyqtarëve, të cilat është proklamuar se do të ketë ndryshim të ligjit, i cili e sanksionon rritjen dhe lëvizjen e pagave të gjyqtarëve brenda këtij ligji.

Këtu duhet të mendojmë shumë mirë të mos presin gjyqtarët tanë që të jenë nën ndikimin e rritjes apo mosarritjes së pagave të qeveritarëve, por kjo duhet shikohet dhe të rregullohet me ligjin e tyre, me Ligjin për gjykatat.

Dhe, pjesa e dytë është në komunat e reja dhe degët që kërkohen të themelohen në komuna të reja.

Tash këtu më lejoni t'i theksoj ankesat dhe kërkesat që kanë dalë, për shembull, nga Komuna e Hanit të Elezit në raport me komunën që ne i kemi dhënë të drejtë Komunës së Junikut që ta ketë degën e vet. Jo për shkak paralelizmit, por për shkak të nevojave dhe interesit të qytetarëve që të ofrojnë shërbime sidomos në sektorin e gjykatave. Këto janë 3-4 pika që bashkërisht me sponsorizuesin, nuk do të thotë që mund t'i bëjmë të veçanta dhe në mënyrë të njëanshme për ta ruajtur strukturën edhe logjikën e vetë ligjit dhe me Komisionin për Legjislacion, si komision i kësaj fushe.

Kështu që ne do t'u japim përkrahje me logjikën e njëjtë edhe dy pikave paraprake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, ka vlerësuar se Projektligji për gjykatat i plotëson të gjitha kushtet ligjore që të miratohet në parim nga ana e Kuvendit.

Megjithatë, duke qenë në procedurën e shqyrtimit parlamentar, ky projektligj do të jetë objekt i diskutimeve e konsultimeve.

Dua shkurtimisht të theksoj se miratimi i tij është në interes të funksionimit të sistemit të drejtësisë në mënyrë të pavarur e të paanshëm dhe krijon të gjitha kushtet që pushteti gjyqësor të ushtrohet në mënyrë efektive nga ana e gjykatave.

Me këtë projektligj gjykatat do të organizohen dhe do të funksionojnë në pajtim me përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe kjo do të ndikojë që në punën e tyre të zbatojnë në mënyrë të dukshme edhe parimet themelore ndërkombëtare në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Me këtë rast shpreh vlerësimin e lartë për Ministrinë e Drejtësisë që me përkushtim ka arritur të finalizojë pakon e ligjeve gjyqësore, të cilat njëkohësisht nënkuptojnë edhe kryerjen e detyrave dhe obligimeve që i ka vendi ynë në raport me Raportin e Progresit të vitit 2016.

Ky projektligj, mes tjerash, synon të rrisë transparencën e punës së gjykatave, një kusht ky shumë i domosdoshëm për të arritur besueshmërinë dhe efikasitetin, po ashtu heq kriterin e moshës për t'u zgjedhur gjyqtar dhe kjo pa dyshim do të ndikojë që të rritet konkurrenca në mesin e profesionistëve që plotësojnë kushtet që të mund të konkurrojnë që të përzgjidhen gjyqtar.

Adresohet edhe shqetësimi i njohur përmes këtij ligji që për shkak të kriterëve për përvojën e punës për t'u zgjedhur gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Duke u rritur numri i gjyqtarëve që mund të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, do të ketë shumë më shumë konkurrencë dhe përmirësim të cilësisë në gjyqësor.

Ky projektligj rregullon edhe disa segmente të tjera me rëndësi, për të cilat edhe ne shpresojmë, do të japim kontributin tonë gjatë leximeve.

Ndërsa sot e mbështesim këtë projektligj, duke vlerësuar që si e tillë është shumë i rëndësishëm dhe përfaqëson reformën e duhur në sistemin e gjyqësorit.

Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë projektligj në këtë fazë në parim dhe kërkon nga kolegët deputetë që ta miratojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Para se të dal te shqyrtimi i Projektligjit për gjykatat, vetëm dua të bëj disa sqarime. E para, Vetëvendosje nuk do të përkrahë asnjërën prej pikave, në fakt, nuk do të votojë për, kundër ose abstenim, për shkak të qëndrimit tonë si kundërshtim i qëndrimit të PDK-së për formimin e Komisionit Hetimor për deportimin e shtetasve turq. E dyta, ministri i Drejtësisë foli pak për marrëveshjen për ekstradim me Hungarinë më herët dhe tha që Komisioni për Legjislacion s'ka pasur kuorum, kjo nuk është e vërtetë.

Për Komisionin për Legjislacion flas unë, në qoftë se je i interesuar, mund të më pyesësh në seancë se si është qëndrimi i komisionit. Ka pasur gjashtë vota për, pra nuk i ka pasur 2/3 e anëtarëve të komisionit, rrjedhimisht i ka rekomanduar seancës që të mos votohet. Pra, tashmë e kemi proceduar për seancë dhe nuk është e vërtetë që nuk ka pasur kuorum.

Po kthehem te shqyrtimi i Projektligjit për gjykatat dhe diskutimin tim po e nis për një problem që ka të bëjë me përfshirjen e përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë në dialogun e Brukselit, ku si pasojë janë bërë shumë koncesione dhe është ndarë në dysh sistemi i drejtësisë. Sipas ligjit në fuqi, pra Ligjit për gjykatat që aktualisht është në fuqi, ne kemi një Gjykatë të Apelit dhe atë në Prishtinë. Gjykata e Apelit që vlen për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pavarësisht se në cilën komunë janë. Në vitin 2013 kur u ratifikua marrëveshja e dëmshme, siç quhej në atë kohë "Marrëveshja e parimeve", e njëjta parashihte të jetë edhe një Gjykatë e Apelit në Veri dhe ajo do të vrente vetëm për serbët. Pra, gjykatë me karakter monoetnik.

Që në atë kohë, nga ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, mendohej të shitej si Divizion i Apelit, por është njësoj problem dhe është po ashtu jokushtetuese, pavarësisht që Kuvendi i Republikës së Kosovës e pati ratifikuar atë marrëveshje, ne e kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese, por Gjykata Kushtetuese ka krijuar precedent tepër të rrezikshëm dhe ka hequr dorë që ta vlerësojë aspektin kushtetues të asaj marrëveshjeje. Por, po ashtu Gjykata Kushtetuese kur është deponuar Marrëveshja për 'Zajednicën' aty e ka kundërshtuar karakterin monoetnik rrjedhimisht, edhe rregullimi aktual ku është një Gjykatë e Apelit, vlen vetëm për serbët, është kundërkushtetuese. Më kujtohet shumë mirë që edhe në foltoren e Kuvendit, por edhe në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion, në atë kohë ministri i Drejtësisë thoshte që ajo mënyrë e negociimit është në përputhje me legjislacionin në fuqi, edhe me Ligjin për gjykatat.

Pra, këtë e ka deklaruar edhe ministri Abelard Tahiri në Komisionin për Legjislacion, kur e kemi ftuar për të diskutuar për çështjet e drejtësisë dhe tani në projektligjin aktual, siç e përmendi edhe zoti Tahiri, është paraparë një dispozitë shtesë, ku legalizohet karakteri monoetnik, siç e përmenda edhe më përpara dhe Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar si shkelje kushtetuese.

Negociatat e Brukselit dhe koncesionet që janë bërë e kanë ndarë në dysh sistemin e drejtësisë, dhe sidomos kur është pranuar edhe për të njohur aktgjykimet e gjykatave paralele, kjo është

goditje për sistemin e drejtësisë dhe goditje për sovranitetin e vendit. Këtë e ka pranuar edhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, ku në komision ka deklaruar që po ekziston ajo marrëveshje që njihet aktgjykimet e organeve paralele. Zoti ministër, sepse në atë kohë kur ju kam pyetur juve keni thënë që nuk e di që është e vërtetë kjo gjë, po ta konfirmoj, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor e ka pranuar që është negociuar që të njihen, pra është rënë dakord, në fakt, që të njihen vendimet e gjykatave ilegale paralele.

Sot po diskriminohen qytetarët e Republikës së Kosovës për shkak se një qytetar i Pejës, një qytetar i Gjakovës, i Prizrenit, i Gjilanit, i Besianës detyrohet të vijë në Prishtinë për shkak të ankesave në Gjykatën e Apelit, ndërsa qytetarët serbë e kanë të dera Gjykatën e Apelit. Kjo është në shpërputhje edhe me Kushtetutën, kështu nuk integrohen as serbët dhe nuk e di pse, zoti ministër, po qeshni. Duhet marrë më seriozisht punën që po e bëni. Neni 3 thotë: “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”. Asnjërin prej këtyre parimeve sot s’e ushtron sistemi gjyqësor, me ligj po, shumë mirë është e shkruar, por në fakt realiteti është i hidhur, pra as sot nuk është unik, pasi që e keni ndarë përmes koncesioneve në Bruksel, s’është i pavarur, sepse e keni kapur, sepse pikërisht është ky sistem i drejtësisë që i amnistion të korruptuarit dhe në vazhdimësi keqpërdoren nga pushteti për të arrestuar aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, madje ua monton edhe dosjet.

Sot janë studentët në paraburgim, skandali i fundit ishte kur u dërguan në paraburgim prej një muaj gjashtë studentë, vetëm pse paskan bërë zhurmë ku po shënonin 8-vjetorin e themelimit të SKV-së. Ku keni parë, more, kështu?! Qysh, more, mund të thuhet që sistemi gjyqësor është apolitik, ku në vazhdimësi shërben si mashë për të arrestuar aktivistë dhe studentët, në këtë rast, të Universitetit të Prishtinës. Prandaj, po e shfrytëzoj rastin këtu për të bërë thirrje për përgjegjësi, për të gjithë policët që kanë ushtruar dhunë, por po ashtu Gjykata e Apelit duhet ta zhbëjë këtë vendim skandaloz. Më tej, neni 10, degët e gjykatave themelore, paragrafi 8 që pak e ngriti edhe zoti Zemaj. Gjykata Themelore e Ferizajt e ka degën në Kaçanik, për komunën e Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit. Unë kam pasur kontakte me kryetarin e Hanit të Elezit, zoti Rufki Suma, ai ka kërkuar zyrtarisht që kjo të ndryshohet, pra që edhe Komuna e Hanit të Elezit të ketë degën e vet, sepse siç keni parë në draftin e Ligjit për gjykatat, ka komuna që kanë më pak banorë, por e kanë degën në komunat përkatëse, ndërsa konsideroj që Hani të Elezit i është bërë në këtë rast padrejtësi.

Prandaj, edhe ne do të deponojmë amendament dhe do ta adresojmë në grupin punues. Pastaj, është nevoja për shtimin e bashkëpunëtorëve profesionalë. Në Ligjin për Prokurorin e Shtetit unë kam propozuar një amendament, ku secili prokuror duhet të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional. Për gjyqtarë ndoshta duhen dy për shkak të volumit dhe angazhimit të madh që kanë, prandaj ne si grup parlamentar do të kërkojmë që edhe te gjykatat, pra edhe gjyqtarët të kenë së paku nga një bashkëpunëtor profesional. Po ashtu, sot s’ka një Gjykatë Speciale që

merret me krimin dhe korrupsionin, s'ka as departament të veçantë përbrenda qoftë Prokurorisë që do të hetonte rastet e korrupsionit, qoftë gjykatave në këtë rast, që do të gjykonin rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Madje, as në këtë projektligj nuk parashihet një departament i veçantë që do të merret me rastet e korrupsionit.

Unë konsideroj që është e rëndësishme, ne kemi pasur takime të shumta me prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët na kanë njoftuar për sfidat dhe problemet për hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit. Ka pasur gjyqtar dhe prokuror që thotë kur t'i vijë një dosje që ka të bëjë me krimet ekonomike, pra: korrupsion, keqpërdorim të detyrës zyrtare, nuk janë të aftë sa duhet apo profesionistë për ta hetuar apo për ta gjykuar këtë. Prandaj, konsideroj që profilizimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve për të hetuar rastet apo për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Po ashtu, në këtë projektligj është hequr 25%-shi. Mandatin e kaluar e patëm krijuar një standard jashtëzakonisht të mirë, ku gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët punojnë jashtë punës së tyre si gjyqtarë, ta zëmë, mund të jenë ligjërues, por nuk mund të fitojnë më shumë se 25% të pagës bazë, në këtë rast gjyqtarit, por edhe për prokurorët njëjtë. Tash kjo është hequr, gjyqtarët, sipas këtij drafti, mund të fitojnë sa të duan dhe nuk ka asnjë kufizim në këtë drejtim. Prandaj, konsideroj që ka bërë gabim Ministria e Drejtësisë, pra që e ka hequr dhe kjo duhet të kthehet siç ka qenë në grupet punuese.

Edhe një herë, qëndrimi ynë është kundër këtij projektligji, për arsye që i përmenda, por siç e përmenda qëndrimi i Grupit Parlamentar është që sot të mos marrim pjesë fare në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Fjalën e ka Shqipe Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të Grupit të Pavarur i Deputetëve.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Para se të flas për ligjin për të cilin ministri i Drejtësisë bëri thirrje të votohet, dua t'ju përkujtoj edhe juve, edhe ministrit, se koalicioni qeverisës nuk i ka as dhjetë deputetë në sallë, e kjo tregon edhe seriozitetin e koalicionit. Përderisa shumica e deputetëve të opozitës janë këtu, deputetët e koalicionit nuk janë. Prandaj, nuk e di se si do të siguroni tashmë edhe funksionalitetin e Kuvendit dhe lëre më të Qeverisë.

Sa i përket projektligjit, në parim i ka disa përparësi në krahasim me ligjin e vjetër, do të thotë i bën disa përmirësime, njëri nga të cilët është ai për krijimin e më shumë degëve të gjykatave themelore, e që nënkupton ofrimin e qasjes së qytetarëve në drejtësi, në këtë rast në gjykata, por në nivelin themelor të saj më afër dhe kjo është për t'u përshëndetur, ndonëse pajtohem me vërejtjet e dy grupeve të mëhershme parlamentare nga opozita se çështja si ajo e Hanit të Elezit

duhet të kihet parasysh dhe të vihen kritere të qarta se kur një komunë mund të ketë një degë të Gjykatës Themelore. Ky projektligj megjithatë i ka dy probleme të theksuara. E para, është për faktin se nuk e kufizon pjesëmarrjen e gjykatësve në angazhime të tjera jashtë orarit, siç ka qenë në projektligjin e kaluar dhe mendoj se kjo duhet të merret në konsideratë seriozisht, sepse shumë shpesh gjykatësit kanë zvarritur me vite lëndët e tyre për shkak edhe të angazhimit të tyre në punët e tjera, sidomos në universitete apo kolegje të tjera private.

Por, problemi më i theksuar i këtij projektligji mbetet neni 21, përkatësisht pika 2 e këtij projektligji. Përderisa në themelimin e Gjykatës Themelore jepet edhe është i arsyeshëm numri i rritjes së degëve, nuk është e njëjta edhe për Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit është një dhe unike, ajo ka selinë në Prishtinë, por pika 2 e nenit 21, kërkon themelimin e një divizioni të veçantë në pjesën Veriore të Mitrovicës. Pa e shpjeguar më tutje se cila do të jetë as arsyeshmëria, e besa as detyrat konkrete të këtij divizioni. Natyrisht se ne e dimë që kjo është pjesë e marrëveshjes së arritur në Bruksel, por në vazhdimësi është folur dhe janë bërë përpjekje për integrimin e të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh gjuhën që flasin apo etnisë, të cilës i përkasin, e kjo veçanërisht duhet të vlejë kur vjen fjala për qasjen në drejtësi. Në këtë rast po bëhet një diskriminim, sepse një numri të caktuar të qytetarëve po u bëhet më e lehtë qasja në drejtësinë, në këtë rast në Gjykata të Apelit dhe e njëjta nuk vlen edhe për qytetarët e tjerë, por për më tepër, kjo në vend që të ndihmojë integrimin, në fakt po i shërben më shumë thellimit të ndarjeve, edhe atë ndarjen në baza etnike.

Prandaj, ky nen është jashtëzakonisht problematik dhe bie në kundërshtim me parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit në drejtësi dhe për shkak të kësaj ne nuk mund të ofrojmë mbështetjen tonë për këtë projektligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht kisha dashur t'ua bëj me dije kolegëve se kur flasim për marrëveshje ndërkombëtare, është mirë ta dimë se pikërisht ato që në fillim të realizimit të tyre janë burim i së drejtës. Ta mbajmë mend, marrëveshjet ndërkombëtare janë burim i së drejtës. Përndryshe, për projektligjin në lexim të parë në emër të grupit parlamentar e mbështesim, por edhe si anëtar i Komisionit për Legjislacion personalisht e kemi dhënë kontributin, por ndërmjet dy leximeve do ta japim kontributin edhe në ato plotësim-ndryshime që mund t'i bëjmë gjatë punëve dhe amendamentimit ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Para se të filloj në lidhje me temën, kam një vërejtje shumë serioze për kryesuesin e mëparshëm të seancës. Zoti ministër i Drejtësisë në lidhje me çështjen e caktuar kishte një sqarim, pa marrë parasysh nëse pajtohem apo s’pajtohem unë, por në lidhje me atë që e thashë unë. Unë kërkoj fjalën për sqarim në lidhje me çështjen, edhe për shkak se kryesuesi i seancës nuk është i interesuar, nuk sheh, nuk do të shohë, për shkak të një inati primitiv që mund ta ketë si person, nuk e jep fjalën në lidhje me një çështje të caktuar, edhe kjo është absolutisht një arrogancë primitive në formën e shprehjes “nuk ta jap fjalën”.

Kjo është e ndaluar, unë e kuptoj çka është duke ngjarë, por kjo është një arrogancë primitive. Ai nuk është këtu, po më vjen keq, mirëpo kjo nuk është e lejuar.

Tash po filloj me çështjen për të cilën jemi duke diskutuar, ky është Ligji për gjykatat. Përveç vërejtjeve që mund të ketë, janë teknike, gjuhësore, logjike, edhe të formave të tjera, për të cilat ne mund të japim amendamentet më vonë, ne kemi vërejtjet parimore që e hedhin poshtë bazën e këtij ligji si pjesë të ndarjes së gjyqësorit të Republikës së Kosovës në baza etnike. Nuk është vetëm një nen, janë disa nene. Unë po filloj nga neni 5, përbërja e gjyqësorit. Se qeveritë e mëparshme dhe kjo qeveri e kanë shumë seriozisht me ndarjen etnike të Kosovës, i kemi dy paragrafë. Paragrafi 1, i nenit 5 thotë: “Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht”. Kjo nuk u është dukur mjaft, kanë shkuar në paragrafin e dytë për ta forcuar këtë edhe të tregojnë që shumë seriozisht e kemi ndarjen etnike të gjyqësorit thotë: “Përbërja e gjyqësorit pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilës gjykatë”.

Domethënë, këtu s’kemi të bëjmë me profesionalizmin, me drejtësinë, këtu kemi të bëjmë me ndarjen etnike të njërit nga pushtetet në Republikën e Kosovës. Kjo duket e rastësishme, mirëpo nuk është fare e rastësishme. Ne kemi nenin 21, paragrafi i dytë që ka të bëjë me Gjykatën e Apelit. Edhe ky nen me këtë paragraf dëshmon atë që thuhet në nenin 5 në të dy paragrafët. Një, në mënyrë konkrete dhe specifike e ndan gjyqësorin, gjyqësori i Kosovës nuk është më unik, por më shumë se kjo ka diçka tjetër. Për shkak të bisedimeve me Beogradin, apo me Serbinë, sido që t’i themi, janë marrë kushtëzime apo vendime që janë krejtësisht të paligjshme dëshmon kjo. Në të vërtetë, krijimi i Bashkësisë së komunave serbe me një statut, siç thonë ata që e mendojnë si Kushtetutë e tyre, bëhet vetëm plotësimi i pushtetit të tretë në Republikën e Kosovës që e do për vete ‘Zajednica’ serbe, sepse në dy pushtetet e para sa i përket Ekzekutivit tashmë është rregulluar kur përbërja etnike i njërive policore në Veri duhet të jetë me shumicë serbe dhe drejtori duhet të jetë serb.

Nëpërmjet Gjykatës së Apelit, përveç se duhet të shfaqet përbërja etnike në pjesën e Gjykatës së Apelit në atë pjesë të Kosovës, sigurisht edhe kryetari i gjykatës duhet të jetë serb, ky është

domethënë gjyqësori. Kurse, Legjislativi do të jetë statuti që e nxjerrin ata për ta kompletuar njëlloj shtetësie të tyre brenda Kosovës me të tri llojet e pushtetit.

Ne kemi edhe një çështje që është krejtësisht gjeografike. Kemi nenin 9 dhe nenin 10, për ndarjen e degëve të gjykatave themelore. Kjo shkon në drejtimin e kësaj ndarje etnike. Në nenin 9, pika 2.2. përmendet një vendbanim serb, Verboci, që nuk është as njësi administrative, as nuk përbën kurrgjë, as nuk është komunë, përmendet se aty do të duhej të ishte një pjesë e Gjykatës Themelore, dega nga Gjilani. Kjo është e çuditshme sa larg shkojnë me këso finesash që nuk duken brenda tekstit. E njëjta degë, apo sido që t'i themi, sido që të quhet, mandej nuk përmendet në nenin 10, në pikën 3.3. Janë të çuditshëm, por këto mund të rregullohen. Por, tendenca e krijimit të këtyre, të ndarjes së gjykatave, të humbjes së karakterit unik në Kosovë është e qartë përmes këtij ligji.

Një çështje krejtësisht profesionale. Ne kemi nenin 34, ku trajtohet domethënë çështja edhe e bashkëpunëtorëve profesionalë. Mirëpo, askund nuk tregohet a do të ketë shtim të numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë në gjykatat e Kosovës. Sigurisht, nëse hiqen këto mangësi që i përmendëm sa i përket ndarjes etnike, edhe unë shpresoj shumë se ato do të hiqen, shpresoj se hartuesit e ligjit do t'i kenë parasysh të gjitha këto vërejtje, duhet të mendohet edhe për ngritjen profesionale të gjykatave tona, duke shtuar numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë për çdo gjykatës. Nëse për prokurorët thuhet se duhet të kenë së paku një bashkëpunëtor profesional, edhe numri i lëndëve gjyqësore është shumë më i madh, dy, trefish më i madh, atëherë në gjyqësor gjithsesi duhet të futet si normë që çdo gjykatës në Republikën e Kosovës duhet të ketë një apo dy bashkëpunëtorë profesionalë që merren në mënyrë ekskluzive vetëm me shqyrtimin e lëndëve gjyqësore dhe jo me çështje administrative, të rregullohet statusi i këtyre bashkëpunëtorëve profesionalë që ata të kenë një status të veçantë, sepse do të duhen edhe kriteret për përzgjedhjen e tyre, sepse ata do të punojnë drejtpërdrejt si dorë e djathtë e çdo gjyqtari në Republikën e Kosovës.

Këto ishin vërejtjet parimore sa i përket përbërjes, tekstit edhe përmbajtjes të këtij ligji, nëse këto vërejtje përmirësohen në të ardhmen, sigurisht do të ketë edhe vërejtje të tjera të natyrës gjuhësore, teknike, të cilat mandej përmes amendamenteve mund të rregullohen. Prandaj në këtë formë unë nuk e jap votën për këtë projektligj.

KRYETARI: Arbërie Nagavci, fjala për ju! Bëhet gati Drita Millaku, në fund Fitore Pacolli-Dalipi.

ARBËRIE NAGAVCI: Të nderuar kolegë!

Ky projektligj, përkundër ndryshimeve që parasheh dhe plotësimit të disa çështjeve të rëndësishme, përsëri nuk arrin të adresojë dhe të gjejë një zgjidhje për numrin e madh të lëndëve

që nuk janë trajtuar ndër vite, edhe pse gjykimi për një kohë të arsyeshme është e drejtë e garantuar me ligj dhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës.

Vonesa në shqyrtimin e rasteve dhe numri i madh i lëndëve të patrajuara ka qenë një ndër problemet kryesore që vazhdon ta përcjellë sistemin gjyqësor që kur mori kompetenca nga ndërkombëtarët. 342 mijë e 590 mijë lëndë vazhdojnë të mbesin të pazgjidhura në gjykatat themelore, në atë të Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Kjo shifër është nxjerrë nga vetë raporti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës deri në muajin shtator të vitit të kaluar. Përkundër kësaj situatë dhe këtyre shifrave, projektligji nën nenin 7, qasja në gjykata pika 2, parasheh se çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtën në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Dhe, pika e pestë, e të të njëjtit nen, parasheh se të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase, për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve. Ashtu sikur mund të vihet re, në këto dy raste, por edhe askund në projektligj nuk ka asnjë mekanizëm apo siguri për trajtimin me kohë të lëndëve.

Më tutje do të veçoja dhe disa nene, të cilat mendoj se duhet të rishikohen ndërmjet dy leximeve.

Neni 14, i cili ka të bëjë me kompetenca, përkatësisht përgjegjësitë e kryetarit të Gjykatës, fillimisht në lidhje me këto përgjegjësi të kryetarit të Gjykatës duhet theksuar se pasi kompetencat dhe përgjegjësitë janë të shumta, duhet të parashihen edhe pozitat, apo personat kompetentë që do të ndihmonin në kryerjen me sukses të detyrave të tij, si për shembull nënkryetari, zëvendësi apo bashkëpunëtorët profesionalë që i përmendi edhe kolegja ime, Albulena.

Më tutje, pika e dytë e këtij neni, kryetari i gjykatave themelore mund ta autorizojë punësimin, masat disiplinore dhe përfundimin e personelit jogjyqësor në përputhje me rregulloret e zbatueshme për personelin, duhet të rishikohet dhe të plotësohet, përkatësisht të riformulohet, pasi është e pakuptimtë si shprehje “përfundimi i personelit jogjyqësor”.

Do të veçoj edhe pikën 3 të këtij neni, i cili flet për autoritetet e përgjithshme administrative dhe përgjegjësitë që të sigurojë administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha degët, departamentet dhe divizionet e Gjykatës. Por, as ky nen e as projektligji nuk i përcakton përgjegjësitë për rastet e mosveprimit, apo te vonesat në trajtim të rasteve.

Në lidhje me këtë dua të sjell në kujtesën tuaj skandalin me lëndën e Antigona Morinës, kur Gjykata në Rahovec e zhduku ankesën për vdekjen e saj. Antigona, e cila vdiq gjashtë vjet më parë, tri ditë pasi u martua, për shkak të hemorragjisë së vazhdueshme dhe bashkëshorti i saj u

shpall i pafajshëm, edhe pse nuk i kishte ofruar ndihmë mjekësore të ndjerës, i njëjti ishte deklaruar në Prokurori se sipas traditës të ndjerën Antigona e kishte dërguar te shehu ditën e dytë të martesës.

Besoj që ministrit i kujtohet se në sirtarët e Gjykatës në Rahovec një vit ka qëndruar ankesa e Prokurorisë kundër aktgjykimit për vdekjen e Antigona Morinës, por kjo ankesë figuronte vetëm se ishte e pranuar dhe regjistruar, ndërsa dosja mungonte komplet. Dua të sjell në kujtesë po ashtu edhe rastin e Diana Kastratit, së cilës iu shkel e drejta bazike për jet, pikërisht për shkak të dështimit të sistemit të Gjyqësorit për t'iu përgjigjur kërkesës së saj për të lëshuar urdhrin mbrojtës për viktimat e dhunës në familje, ashtu siç parashihet me ligj.

Këto raste janë pasojë e drejtësisë jofunksionale e, fatkeqësisht, edhe ky projektligj nuk po i adreson dhe nuk ka mekanizma që do ta përmirësonin punën e Gjyqësorit në këtë drejtim.

Një çështje tjetër që mendoj se duhet adresuar është se në disa raste projektligji, për shembull neni 15, pika 1.3, nenet 20, 22 dhe në mjaft nene tjera përdor shprehje si “çështje tjera të parapara me ligj”, “përcaktohet me ligj”, ose “nëse nuk parashihet ndryshe ligji”, pa u theksuar asnjëherë se për cilin ligj bëhet fjalë. Dhe, po ashtu, është edhe kërkesa që gjyqtarët me aprovimin e kryetarëve të gjykatave dhe kryetarët me aprovim të Këshillit jashtë orarit të punës marrin pjesë në veprimtari që janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe në këtë rast kërkohet aprovimi paraprak.

Nëse kemi të bëjmë me aktivitete që janë jashtë orarit të punës dhe veprimtari të janë në përputhje me Kodin Etik dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve, atëherë konsideroj se nuk është e nevojshme të merret aprovimi, andaj edhe kjo pikë duhet të hiqet fare.

Fare në fund, pa dashur të zgjatem për shqetësimet tona lidhur me pikën e dytë të nenit që parasheh se në kuadër të Gjykatës së Apelit themelohet Divizioni i Gjykatës së Apelit për Mitrovicën e Veriut, pajtohem me ato që i përmendi zonja Haxhiu dhe deputeti Kurteshi dhe parashtoj se kjo çështje është krejtësisht e gabuar, andaj edhe është e papranueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Drita Millaku e ka fjalën. Pas Fitores, u lajmërua Milaimi.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë dhe kolegë deputetë,

Para meje, kolegu Sami Kurteshi dha disa vërejtje për kryesuesin që e seancën deri tani, por unë i kam disa vërejtje tani për kryetarin e Kuvendit këtu, i cili para disa ditësh, derisa mbanim seancën parlamentare për demarkacionin, pa fije turpi i shau të gjithë deputetët këtu dhe desha t'i them: Zoti kryetar, nuk ta kemi borxh, se s'i ke marrë votat e qytetarëve për t'ua sharë robtë e deputetëve. E para pikë, një herë ti diqysh të shkon edhe për... i shfrytëzon këto situata të tilla. Nuk është hera e parë që e heq maskën tënde dhe e tregon fytyrën e vërtetë që e ke. Nuk është në

rregull, sepse e kemi kuptuar vonë, për ta thënë të drejtën nuk e kemi kuptuar gjatë seancës, derisa na arrestuan e kuptuam që i kishe bërë këto fyerje. Për besë, nuk do të kishe shpëtuar kaq lehtë sikur të kishim dëgjuar.

Tani po kaloj te projektligji...

KRYETARI: Veç pak! Veç pak, zonjë! Zonjë, sikur të kesh lidhje bre ti diçka me mua!? Unë me ty s'kam kurrfarë lidhje, dhe ç'ke me mua, se më sakatove... Këqyre çka, edhe pak, kjo fjala e fundit, ngadalë. Këqyre, për të shpëtuar e për të mos shpëtuar, veç Zoti i madh e ka në dorë, por ruaju...

DRITA MILLAKU: E rëndësishmja është se nuk...

KRYETARI: Fol ti patriot, fjala për ty është... Cili je ti, qysh e ke emrin?

DRITA MILLAKU: Jo, jo, veç pak, mos ma ndërprit fjalën, të lutem!

KRYETRARI: Hajde ti Zyrap, a qysh e ke emrin?

DRITA MILLAKU: Nuk të kam thënë deri në ditën e sotme se nuk kam pasur rast, derisa e kam marrë fjalën për të ta thënë. Jo që më ka mbetur merak, por më ka mbetur merak të ta them në fytyrë, kështu. Tjetra, atë çka... jo që kam diçka konkrete me ty, por ti ke konkrete me ne. Nuk të lejojme të na shash familjet dhe robtë tanë.

KRYETARI: Valla më sakatove krejt, konkrete po ...

DRITA MILLAKU: Për besë, po ta jap fjalën, shqyr Zotit që nuk të kam dëgjuar se atë gazin lotsjellës në gojë ta kisha futur, tjetër send s'kisha mund të bëj, veç atë po.

KRYETARI: A e përdor me gojë shumë, a?

DRITA MILLAKU: Deri në ditë të sotme s'ka dalë njeri të shajë, as ty nuk do të kisha lejuar.

KRYETARI: Dëgjo, kujdes me shprehje, se për besë tash ky është Kuvend, duhet ruajtur...

DRITA MILLAKU: Nuk të kisha lejuar, as nuk të lejoj të shash me këso fjalësh. Përdori ku të duash, por jo në Kuvend.

E tash të kaloj te Projektligji për gjykatat, se për ty thashë e ke treguar fytyrën tënde sa herë që ka situata të tilla.

Tash te Projektligji për gjykata. Në parim nuk është mirë të ndryshohen shpesh ligjet, sidomos ato që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve, në veçanti Ligji për gjykatat, sepse te qytetarët po krijohet një konfuzion. Siç dihet, deri në vitin 2010 ekzistonin disa lloje të gjykatave, Gjykata për Kundërvajtje, Gjykatat Komunale, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme, ndërsa në Ligjin për gjykatat nr. 03/L-199, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2011, rregullohet më mirë organizimi i gjykatave, si: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, siç e kanë këtë organizim një numër i madh i shteteve.

Me Projektligjin për gjykatat nr. 06/L-054 është hequr Departamenti Administrativ, që ekzistonte për Ligjin e deritanishëm për gjykatat, që ishte si departament vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe që vepronte për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Tash për këtë projektligj çështjet administrative apo lëndët administrative kryhen apo shqyrtohen nga Departamenti i Përgjithshëm në çdo gjykatë themelore në Republikën e Kosovës. Kjo e rëndon punën e gjyqtarëve dhe efikasitetin e kryerjes së këtyre lëndëve dhe mund të zvarriten, siç është traditë në vendin tonë, që me vite të mbeten pa u shqyrtuar shumë lëndë nga gjykatat. Faleminderit!

KRYETARI: Sali Zyba e ka fjalën.

SALI ZYBA: Mirë që ma mësove emrin, kryetar i Kuvendit, nëse e ke parë aty edhe më mirë, por është mirë ta mësosh përmendsh, sepse ke për t'u ballafaquar me fakte e me argumente.

Edhe unë e kam shqetësimin për mënyrën e komunikimit, keqpërdorimin e foltores, të cilën nuk është hera e parë që e ke keqpërdorur foltoren e Kuvendit, në këtë rast pozitën për të cilën nuk je i thirrur ta keqpërdorësh aty, e në veçanti për mënyrën dhe qasjen edhe herën e kaluar, kur ke ofenduar, me gjithë ankesat tona edhe procedurale, nuk je tërhequr prej fjalëve tua, nuk ke kërkuar falje asnjëherë, as para qytetarëve, as për ne deputetët. Kështu që e ke vërejtjen e fundit, personalisht nga unë, për ofendimin tonë që na e ke bërë atë ditë. Në daç merre kërcënim, në daç mos e merr.

Kështu që qasjen që e ke ti për deputetët na detyron të kundërpërgjigjemi në këtë formë. Faleminderit për mirëkuptim ju të tjerëve!

KRYETARI: I kishin pas thënë Lasgush Poradecit ta shkruajë një poezi nga partia - komiteti në atë kohë, dhe i thonë shkruaje një poezi për atë tunelin si shkon për Pogradec. Jo, tha, pasi e shkroi, ai komisari politik tha s'ishte shumë i kënaqur... Dëgjo, unë po mundohem goxha shumë ta ruaj dinjitetin, edhe timin, edhe tuajin. Por, ruajeni nga pak tuajin dhe timin, kjo është për fund, për arsye se të gjithë jemi qenie njerëzore.

Besë, atëherë fjalën e merr Fitorja, ashtu-kështu se je lajmëruar. Po, tash kam thirrur Fitore Pacollin pothuajse që nga fillimi.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Së pari, kryetar i Kuvendit, duhet të kesh kujdes me gjuhën që përdor dhe duhet të kërkosh falje kurdoherë që ofendon.

Po kthehem te vërejtjet sa i përket Projektligjit për gjykatat. Shqetësuese mbetet neni 21, pika 2, dhe ky ligj nuk duhet të kalojë me këtë pikë dhe këtë sqarim e dhanë shumë mirë edhe deputetja Albulena Haxhiu, si dhe deputeti Sami Kurteshi. Nuk do të ndalem në këtë, mirëpo do t'i jap disa vërejtje për pikat tjera.

Neni 30 i këtij ligji, pra “paga dhe kompensimi gjyqësor”, pika 1, në këtë ligj nuk përcaktohet fare paga e gjyqtarëve të gjykatave themelore, pra duhet të përcaktohet dhe të jetë 90% e pagës së kryetarit të gjykatave themelore dhe këtu propozoj që të bëhet ky ndryshim. Duhet të shtohet një pikë, pra pika 1.7, paragrafi 1, ku thuhet se të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore do ta pranojnë një pagë ekuivalente prej 90% të pagës së kryetarit të Gjykatës Themelore.

Neni 35, pika 4, këtu është cekur shumë mirë se gjyqtarët nuk komentojnë në medie përmbajtjen, provat dhe vendimet e cilësdo lëndë, gjyqtarët nuk përfshihen në çfarëdo komunikimi “ex parte” me askënd lidhur me lëndët, mirëpo ky ligj nuk e ka paraparë ndalimin e komunikimit “ex parte” të kryetarëve të gjykatave themelore. Raportet ndërmjet gjykatës dhe palëve duhet të bëhen sipas rregullave dhe procedurave të procedurave të gjykatës dhe komunikimi “ex parte” i kryetarëve të gjykatave me palët duhet të ndalohet për të siguruar paanshmërinë e gjykatës dhe ruajtjen e besueshmërisë dhe transparencës.

Prandaj, propozoj që nenit 14 - kompetencat dhe përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, t'i shtohet pika 9, ku thuhet se gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në çfarëdo komunikimi “2ex parte” me askënd lidhur me lëndët. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim, po ia japim fjalën Besës, pastaj ty. Edhe kështu, je deputeti i fundit. Besa Gaxherri, pastaj Milaim Zeka.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e mora fjalën që të reagoj në emër të Grupit të Grave Deputete, ndërsa ajo e cila nuk pajtohet le të deklarohet, e ju lutem mos më ndërhyini.

Zoti kryetar!

Përdorimi i gjuhës suaj banale dhe denigruese dhe e cilitdo deputet këtu, është i papranueshëm. Pa marrë parasysh, ju jeni kryetar i Kuvendit dhe kur ndonjëri prej nesh këtu devijon, ose degradon, ne presim prej teje që t'ia ndërpresësh fjalën, ose të marrësh masa, e jo të përdorësh

gjuhë çfarë dëgjuam sot nga ju. Andaj, kërkoj që t'i kërkonti falje Kuvendit, e në radhë të parë grave deputete këtu. Në të kundërtën, kërkoj nga të gjitha gratë që ta lëshojmë seancën.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri, e vlerësoj shumë dinjitetin tuaj.

Ajo çfarë prapë dua të them, nuk e besoj se do të shkelë më këmbë e kryetarit të Kuvendit në këtë ulësen ku jam unë që është munduar më shumë ta ruajë dinjitetin dhe ta fyejë vetveten nganjëherë e të lejojë. Çdo sjellje imja mundohet t'u përmbahet edhe rregullave që janë institucionale, në të njëjtën kohë edhe njerëzore.

Unë asgjë nuk përmenda, as të rëndë. Tha “në gojë”, thashë “me gojë po rëndon çdoherë”. Kjo është. Edhe dëgjo, unë mund të kërkoj falje në çdo fyerje që e prek botën femërore një milion herë dhe nuk me vjen turp dhe të përulem për atë pjesë, por në pjesën kur në mënyrë të vrazhdë, një herë, dy herë, dhe pastaj abuzimi që bëhet me gratë deputete nga grupet parlamentare, kjo s'më pëlqen. E kam thënë edhe herën e kaluar, thojeni burrisht kur të ketë diçka. Nganjëherë mund, qenie njerëzore jemi, gabojmë, s'gabojmë... por ajo që është kryesore ta ruajmë një minimum respekti është mirë. E, kjo, shprehje të tilla, pastaj përmendja e emrit dhe pastaj më vonë, jo se nuk ka qenë emri yt, ka qenë i tjetërkujt, Hashimi, Selmani, Ramizi, Kadriu pastaj, këto sende janë të rënda.

Sido që të jetë, secili e bartë përgjegjësinë e vet. Në qoftë se ka diçka për të kërkuar falje, dëgjomë edhe një herë zonja Gaxherri, jo për shkak se dua ta lë vetëm kuptimin e reagimit, por unë, jo që të jap përkrahje, por e lëshoj edhe vetë sot kryesimin e seancës, por në asnjë moment nuk ishte qëllimi i fyerjes së dinjitetit të ndonjë gruaje, por po të thotë një grua në mënyrën e tillë, dëgjo, është pak jodinjitoze. Jodinjitoze! E kjo në qoftë se “a e merr me gojë” po rëndon, po e ripërsëris, po rëndon shumë. Pastaj, “s'kishe mundur të shpëtosh...”, janë gjëra që nuk thuhet nga dinjiteti i dikujt që është serioz, si qenie serioze. Thashë dhe për këtë arsye dëshiroj dhe faleminderit që më dhe mundësi për sqarim. Në qoftë se e dëshiron prapë fjalën që e kërkoje, urdhëro prapë, zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Zoti kryetar!

Nuk ka qenë sot rasti i vetëm që kolegja ime ndoshta u drejtua jo në formë protokollare, siç duhet, por këtu ka deputetë, sidomos të gjinisë suaj, të cilët vërtet përdorin fjalë banale në Kuvend, ndërsa ju jeni kryetar i Kuvendit. Të gjithë ne mund të gabojmë, edhe një herë po e përsëris, ndërsa ju nuk mund të gaboni dhe nuk mund të bëni gjëra të tilla dhe nuk duhet të lëshoheni në nivel të tillë, prandaj je kryetar i Kuvendit. Edhe një herë kërkoj nga ju që duhet të kërkonti falje dhe kërkoj nga ju, që jo vetëm ju, po asnjë deputet, mos pranoni që të përdorë fjalë banale në Kuvend.

KRYETARI: Zonja Gaxherri, edhe një herë po e ripërsëris: Pajtohem plotësisht që s'është mirë të përdoren, dhe pjesa e dytë, në qoftë se është ndërlidhur diçka që e ka fyer dinjitetin e grave, po shprehja e cila u përdor ishte shumë specifike, ishte e rëndë dhe ndoshta dikush mund tani ta keqpërdorë shprehjen time. Kjo, në qoftë se ka konotacion të fyerjes, se po t'i thuash dikujt "lëre, është kryetar i Kuvendit, po vetëm një përfaqësues i zgjedhur i popullit, se "s'ke për të shpëtuar" dhe "në gojë", megjithatë edhe unë e kam një grua në shtëpi. Të jemi korrektë. Zonja Gaxherri, edhe unë e kam një grua në shtëpi. Faleminderit, falje një milion herë në aspektin njerëzor edhe gjinisë së butë, falje një milion herë në qoftë se ka konotacion keqpërdorimi, por jo ajo personale, ta kesh parasysht zonja Gaxherri. Jo!

A e mbyllim këtë çështje si debat, nëse doni sa të doni e lëmë, sa të dëshironi e lëmë. A po doni ta tejkalojmë, apo doni ta hapim si debat? Jo unë as s'hapi, as s'mbylli, ju jeni vetë deputetë, bile në këtë aspekt e lejoj edhe Rregulloren deri në fund. A kthehemi në ligj?

Milaim Zeka e ka fjalën, pastaj për fund Ganimetja për ligj, por jo për këtë çështje, se s'po kam dëshirë të mbahet më shumë, pa dëshirën time.

Në emër të grave, por po e mbyllim me kaq edhe mundësisht kisha pasur dëshirë, zonja Gaxherri, se ua ndala tash këtyre mos, që pjesa tjetër politike le të bartet jashtë sallës së Kuvendit. Kjo është. Zotëri Zeka, fjala për ju dhe nuk ka tjetër diskutues për çështje të këtij projektligji.

MILAIM ZEKA: Në radhë të parë, kryetar, nuk po të jap vërejtje, por merrma si këshillë.

Jeni kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe çdo modesti e jotja personale mund të konsiderohet nga deputetët e ndryshëm injorantë si budallallëk. Dhe, ju nuk keni nevojë as të jeni modest, për t'u tutur e di që s'i tutesh bash kurrkujt hiç, as kurrkush s'do të kishte mundur as në gojë, as te këmbët të ta gjuante gazsjellësin. Kur ke sharë, a ke bërë mirë, a ke bërë keq, e di ti vetë. Unë për vete një herë jam shprehur keq, kam kërkuar falje publike, prapë kërkoj, se babagyshi im ndjesë pastë, nganjëherë thoshte, "Sa shqiptari lyp vrarë, Kragujevci plumba nuk prodhon". Tash vrasje s'ka, por sa kush lyp për ta sharë, ne duhet ndenjur 24 orë, bash kërthiza na kupë veç duke sharë, po e kemi lënë s'po shajmë më. Se po ta dija që unë fitoj vota në mandatin e ardhshëm, ndoshta ty s'kisha mundur për të të rënë, veç sekretarit aty afër teje kisha ardhur e i kisha rënë dy herë kinse po të mëshoj ty, por nuk do të na votojnë më njerëzit as për rrahje, as për sharje, por çfarë jemi duke nxjerrë ligje, e çka jemi duke bërë për qytetarët e shkretë që u ka ardhur jeta te maja e hundës.

Njerëzit janë duke e pritur liberalizimin e vizave veç për të ikur nga këtu, sepse ne ua kemi mbyllur të gjitha shtigjet e jetës qytetarëve tanë. Më së pari, debatet të cilat ne po i zhvillojmë

këtu për fushata politike janë debate që po sjellin te qytetari vetëm dëshpërim, humbje të shpresës dhe kurrfarë perspektive, e para.

E dyta, sa i përket ligjit. Unë nuk e kam fijen e dyshimit tek ligji, i cili na ka ardhur këtu nga ministri i Drejtësisë. Ministri edhe di anglisht, edhe këtë ligj e ka bërë bashkë me ekspertë ndërkombëtarë të Brukselit dhe ekspertët amerikanë. Kështu që ligji është super i mirë, e çështja e zbatimit të ligjit është tjetër muhabet.

Vasllav Haveli ka pas thënë në një deklaratë, njerëzit që lexojnë nga pak e citojnë sot e kësaj dite, që komunizmi ka rënë vetëm si sistem, por komunizmi nuk ka rënë nga mendja dhe truri i njerëzve, të cilët kanë jetuar nën sistemin komunist. Ne kemi sot gjykatës, që çfarë të duash ligji bëje, edhe prokuror, ai ligjin e zbaton, e përkthen sipas mënyrës së funksionimit të trurit të tij. Disa kolegë deputetë treguan për disa lëndë dhe folën konkretisht për lëndë të X-it e të Y-it, unë po ju tregoj se në praktikën e Gjyqësorit të Kosovës ekzistojnë aktgjykime të formës së prerë, ku asnjë palë nuk ka marrë pjesë në asnjë gjykim, as pala paditëse, as pala e akuzuar.

Por, po e përfundoj këtu, se këtë ligj me kësmet të Zotit do ta votojnë ata që do të votojnë, por kam prapë një sugjerim për juve si kryetar, por edhe për kryetarët e partive politike, edhe për kryeministrin e Kosovës, për partinë AAK, që të jemi më të disiplinuar në pjesëmarrjen tonë në Kuvend. Me të vërtetë është mahnitëse në aspektin pozitiv edhe qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i deputetëve që qëndrojnë në sallë, edhe i deputetëve të Vetëvendosjes dhe të Grupit të Pavarur, ndërsa ne të cilët kemi qenë gjysmë elefanti, e tani jemi shndërruar “kurrkah hiç”, me 53 vota, as nuk rrimë në sallë, as nuk marrim pjesë në votime dhe plus kacafytemi me opozitën, që ia kemi nevojën për votim.

Ne sot, për fatin e keq, nuk arritëm ta kalojmë propozimin e ministrit të Arsimit, i kemi vetëm edhe dy ditë. Prandaj, edhe një herë po u bëj thirrje shefave të grupeve parlamentare, edhe Lidhjes Demokratike, që për hir të interesit të shtetit të Kosovës ta tejkalojmë këtë situatë.

Personalisht unë dhe Nisma e kemi mbështetur krijimin e grupit hetimor nga Lidhja Demokratike e Kosovës, prandaj edhe një herë po bëj thirrje publike që t'i lëmë inatet për hir të interesit të përgjithshëm kombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka diskutues të lajmëruar për projektligjin. Ministër, fjala për ju!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Po dua të ndërlihem me atë të parën, që e theksoi Armendi, çështja e Departamentit të Administratës.

Ne kemi pasur debat të gjerë se shumë vende edhe në rajon, duke përfshirë edhe Shqipërinë, e kanë gjykatë të veçantë, është Gjykata Administrative.

Tash decentralizimi i këtij departamenti prej Themelores në Prishtinë, edhe nëpër gjykata të tjera themelore e vështirëson punën e avokatëve, por e lehtëson punën e qytetarëve.

Në anën tjetër, e lehtëson edhe punën e Gjykatës Themelore në Prishtinë që është e stërngarkuar, tejet e ngarkuar.

Me këtë qëllim është bërë dhe nuk kemi shkuar me propozimin e themelimit të një gjykate administrative, siç e ka Shqipëria.

Në Ligjin për avokaturën shtetërore që kam përfshirë në agjendën legislative për vitin 2018 adresohet po ashtu edhe çështja e avokatëve që ndërlidhet me këtë çështje.

Unë mendoj që po u ofrojmë qytetarëve një mundësi më të mirë që ai i Dragashit ta adresojë çështjen në Prizren ose i vendeve të tjera dhe të mos jetë gjithmonë në Prishtinë, se Gjykata Themelore në Prishtinë është e stërngarkuar, nëse mund të them, jo për fajin e tyre, në fakt, mirëpo për fajin më shumë tonin si institucione, sot ajo gjykatë e ndërton edhe imazhin jo të mirë për gjyqësorin në përgjithësi në Republikën e Kosovës.

Unë mendoj që ky hap e lehtëson punën e kësaj gjykate dhe nuk dua të paragjykoj, sepse kam pasur edhe njerëz ekspertë që më kanë pyetur a mendon që ka gjyqtarë të kualifikuar t'i trajtojnë këto lëndë nëpër gjykata të tjera themelore.

Unë nuk dua të marr guximin e të vlerësoj që Gjykata Themelore në Prishtinë është më e përgatitur ose janë më të mirë se sa ata të Themelores në Prizren, në Mitrovicë apo në cilindo vend tjetër.

Sa i përket çështjes që u ngrit rreth departamentit që gjykon lëndët e Prokurorisë Speciale, edhe unë në fillim të mandatit tim kam theksuar që është e pakuptimtë, se ne kemi Prokurori Speciale, kemi prokurorë specialë dhe nuk kemi Gjykatë Speciale në Republikën e Kosovës. Tash një lëndë që përgatitet shumë mirë nga prokurorë specialë që marrin edhe shtesa, duhet shkuar ndoshta të trajtohen në Gjakovë, ndoshta prej gjyqtarëve që nuk janë special, janë të rëndomtë, dhe nuk e di lënda mund të bie poshtë krejt si pasojë e ekspertizës, ndoshta edhe çdo të gjyqtarëve që s'janë të përgatitur t' i trajtojnë këto lëndë. Për këtë arsye këtë çështje ia kemi lënë rishikimit funksional dhe besoj që do të dalë si rekomandim prej reformës që jemi duke e ndërmarrë që çështja e Gjykatës Speciale del si rekomandim për themelimin nga rishikimi funksional që është duke ndodhur realisht.

Sa i përket çështjes së 25%-shit, pajtohem plotësisht, ka qenë propozim edhe i gjyqtarëve, edhe i prokurorëve që të hiqet kjo, për shkak se ka pasur sipas tyre edhe informalitet, ku nuk janë deklaruar të hyrat e tyre dhe në Ligjin për prokurorin e shtetit e kemi rikthyer, pajtohem plotësisht dhe besoj që edhe këtu do të pajtohemi që ta rikthejmë ashtu qysh ka qenë, meqenëse e kemi rikthyer në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit.

Sa i përket çështjes së përbërjes etnike, që u theksua, unë këtë çështje ju ftoj të gjithëve se këtë çështje e rregullon Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 104, pra pika 3, ku thotë: “Përparja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse, pra para dhënies së propozimit për emërim dhe riemërim Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse”. Nuk kemi zbuluar asgjë të re në këtë projektligj, thjesht i jemi referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nëse mendoni që duhet ndryshuar kjo çështje, atëherë besoj që kur të vijë koha e ndryshimeve kushtetuese mund ta adresoni si të tillë.

Bashkëpunëtorë profesionalë, deri tani shumica, një pjesë e madhe e juve keni qenë edhe në legjislaturat e kaluara dhe nuk është ngritur asnjëherë si temë, domethënë ka qenë përkushtimi im prej ardhjes si ministër i Drejtësisë dhe për vitin 2018 janë 300 vende të reja për gjyqtarin, për prokurorinë që janë bashkëpunëtorë profesionalë, që janë zyrtarë ligjorë, bashkëpunëtorë mbështetës, gjyqtarë, sepse numrin e prokurorëve e kemi arritur dhe nuk kemi nevojë të shtojmë tutje, mirëpo numri i bashkëpunëtorëve profesionalë për vitin 2018 dhe zyrtarëve ligjorë shkon në afro 300 për të dy këshillat, edhe Këshillin Gjyqësor, edhe Këshillin Prokurorial.

Dhe jam i përkushtuar, është zotim imi publik që deri në përfundim të mandatit çdo gjyqtar në Republikën e Kosovës do të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional.

Nuk mendoj që është mirë të sanksionohet kjo me ligj, të jetë 1, 2, apo 3, kjo është çështje që e rregullon këshilli. Unë mendoj që këto çështje duhet t’ia lëmë këshillit, si Këshillit Gjyqësor, edhe Këshillit Prokurorial, mirëpo ne si institucione duhet të ndajmë buxhet të mjaftueshëm vit për vit që deri në fund të këtij mandati çdo gjyqtar dhe prokuror të ketë bashkëpunëtor profesional të mjaftueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi për votim i projektligjit në parim.

Janë 52 deputetë në sallë, do ta lëmë për momentin kur të bëhemi 61 deputetë.

Do të vazhdojmë votimin në paketë, kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që mundësisht në orën 19:30 t’i thërrasin deputetët të votojnë.

Urdhëro, zonja Haxhiu, jemi te pjesa e votimit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E para, s'ka votim në pako, siç deklaruar në pako, secili projektligj votohet veç e veç.

Por, po ashtu të keni parasysh që ne tash më kemi një qëndrim politik, ne nuk do të përkrahim as për, as kundër, as abstenim, derisa PDK nuk ndryshon qasje sa i përket formimit të Komisionit Hetimor për deportimin e gjashtë shtetasve turq. Pra, kur të jepet mbështetja për këtë komision, natyrisht që edhe ne do të rishqyrtojmë qëndrimin tonë dhe në 19:30 kjo nuk mund të bëhet për shkak të këtij qëndrimi politik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ta sqaroj për hir të korrektësisë, nuk thashë se do të shkojë në paketë votimi, po zakonisht është praktikë parlamentare që të votohen në kohë të caktuar, tek e fundit ju e vendosni, unë mendova veç për mirëkuptim në orën 19:30, pasi do të vazhdojmë seancën, po në fund të fundit, seanca e vendos mënyrën edhe të votimit për secilën. Memli Krasniqi, fjala për ju.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht s'po kuptoj a s'po më kuptojnë shqip disa deputetë, nuk janë këtu, a s'po dëgjojnë, a janë manipulantë të lindur dhe s'dinë çka të bëjnë tjetër përveç t'i shtrembërojnë fjalët edhe të mundohen të rrejnjë opinionin publik. Këtu nuk ka shpjegim tjetër.

Përndryshe shpjegim racional s'ka nëse të thotë deputetja Haxhiu që PDK-ja ta ndërrojë qëndrim. Unë shqip po tregoj, që ku i keni votat e PDK-së për atë komision, pse s'i keni pasur deputetët tuaj, ju dhe të tjerët, ajo çështje tjetër. Krejt grupet kanë mungesë të deputetëve, mos lypni veç prej PDK-së kur i keni saktësisht të ditura sa ju kanë munguar juve si Vetëvendosje, sa LDK-së, sa grupeve të tjera, edhe PDK-së i kanë munguar po ashtu sepse ishte fillimi i vazhimit të seancës. Është e paturpshme kjo qasje kështu të thuhet PDK-ja, kur unë po ju tregoj shqip, tri votime PDK-ja, unë jam shef i Grupit të PDK-së, e kam votuar, mos bëni hajgare, të jeni të paktën korrektë sa i përket votimit.

Kryetar, nëse nuk ka kuorum qysh po shihet, mund ta përfundojmë pjesën e diskutimeve, ndoshta të vazhdohet seanca me votime prej nesër në 10:00 dhe normalisht të votohen krejt ato që nuk e kanë marrë shumicën e deputetëve për të qenë votimet e vlefshme. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, replikë! Armend, të bëhesh gati, fjala për ju pastaj.

Regjia, Albulena Haxhiu fjalën e ka.

ALBULENA HAXHIU: Nuk e kuptoj cili është sikleti i zotit Krasniqi, edhe në qoftë se i shohim diskutimet e paradites e kuptojmë që PDK-ja po do ta bllokojë krijimin e këtij Komisioni Hetimor, bazuar edhe në deklaratimet e përfaqësuesit të PDK-së në Komisionin për Legjislacion

dhe kur shtohet këtu qëndrimi për ta dërguar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, s'ka punë këtu Gjykata Kushtetuese, sa objekt për Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj, edhe një herë, ne do të rikthehemi në votim të secilës pikë atëherë kur vendoset formimi i Komisionit Hetimor si pikë e parë e rendit të ditës, pra kur ajo çështje të vendoset në votim edhe një herë. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm diçka, ne jemi duke rrëshqitur tash te mënyra e votimit, a dëshironi të vazhdojmë në lexim të projektligjeve, kështu-ashtu shkojmë deri ku të mundemi, pastaj...

Armendi e ka fjalën, Bilall, duhet t'ia jap fjalën Armendit.

Shkojmë me replikë, pastaj shkojmë te Armendi, apo dëshironi të futemi drejt në diskutime se u bënë pesë deputetë tash aktualisht. A e doni fjalën gjithsesi, po është vetëm çështje e replikës kjo, është çështje e replikës Bilall, ke të drejtë, po replikë Hajdar Beqa, vazhdon Armend Zemaj, Bilall Sherifi, Teuta Haxhiu, Memli prapë e ka kërkuar fjalën.

HAJDAR BEQA: Kryetar i Parlamentit,

Unë nuk po e kuptoj zonjën Haxhiu, nuk është zëdhënëse as imja, as e Partisë Demokratike, unë e thashë qëndrimin tim jo si Parti Demokratike po si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës konsideroj që problemi që ishte, komisionin e kemi përkrahur të gjitha partitë, edhe Partia Demokratike, problemi ishte kryesuesi apo kryetari i komisionit, dhe e them që është shkelje ligjore për formimin e komisioneve parlamentare sipas nenit 10: “Nuk i takon as iniciuesit ta ketë kryetarin, nuk i takon as mazhorancës, në këtë rast Qeverisë”.

Sipas meje, arsyetimi është aty që e ka kërkuar seancën LDK-ja bashkë me Vetëvendosjen dhe deputetët pa grup.

Andaj, unë konsideroj që është shkelje ligjore dhe nuk e mbështes një diçka që mendoj që në start fillojmë të krijojmë me shkelje ligjore, kjo ishte ajo çka thashë unë.

Kurse Partia Demokratike, e tha edhe kryetari i grupit, e ka mbështetur edhe atë ditë, sepse pa votat e Partisë Demokratike nuk kishte kaluar komisioni, edhe sot e ka mbështetur Partia Demokratike dhe nëse e marrim me statistikë sa vetë kemi qenë në sallë, më së shumti ka votuar Partia Demokratike. Faleminderit!

KRYETARI: E kam edhe Memlin pastaj, kundër-replikë. Albulenë, kundër-replikë, Memli Krasniqi pastaj kundër-replikë. Edhe mbyllet, s'keni më të drejtë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë po e them me përgjegjësi të plotë që s'ka shans Hajdar Beqa të ketë qëndrim individual, pa ia kërkuar këtë ju si kryetar Kuvendi, në këtë rast si kryetar i partisë së zotit Beqa.

Unë e njoh aq sa kam pasur mundësi në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion dhe në seanca parlamentare, s'ka hiç shans të ketë ky mendim të vetit.

Dhe tjetra, e sugjeroj zotin Beqa ta kryejë edhe një herë Fakultetin Juridik, ta marrë edhe një herë një diplomë, se përnjëmend ka probleme serioze me interpretimet që i bën. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ke të drejtë, zoti Beqa, për kundër-replikë.

Vetëm pak, për konsum politik mund të flasë çdo kush, komisioni do të krijohet gjithsesi, sot a nesër, a kurdo. Urdhëro, Memli Krasniqi, kundër-replikë.

Po shkojmë me kryetar të grupeve parlamentare.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar, a bën kundër-replikën ta thotë Hajdar Beqa, unë veç desha të them pa votat e PDK-së as atë ditë nuk kishte kaluar komisioni, këta krejt e dinë. Elmi Reçica bile e ka çua dorën se s'ka pasur deputetë as atë ditë që të kalojë komisioni. Ka kaluar me votën e 61 të PDK-së dhe normalisht që është krejtësisht e pakuptimtë kjo farë loje e pingpongut për t'u munduar të pengohet puna e Qeverisë duke u thirrur në diçka për të cilën krejt fajtorë janë njëjtë, sikur secili grup parlamentar, sepse s'i kanë pasur deputetët asnjëri grup këtu.

Unë kisha kërkuar, zoti kryetar, minutazhit tim t'ia japësh Hajdar Beqës, sepse ishte shumë i drejtpërdrejtë kritika e profesoreshës Haxhiu.

KRYETARI: Vetëm pak, po kërkoj falje, Hajdar. Çështja e gjykimit individual është çështje e gjykimit individual, megjithatë ne e kemi Rregulloren, nuk ke të drejtë. Nënkryetar, kur të vish ti jepja fjalën, nuk ka të drejtë në bazë të Rregullores, Hajdar të lutem për mirëkuptim, ta ruajmë pak një rend.

Armend Zemaj e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

ARMEND ZEMAJ: Së pari, nuk jemi të interesuar të krijohen përshtypje të përplasjeve politike, nuk ishit këtu, kryetar, gjendja ishte që mospjesëmarrja në votim, të pranishëm ishim 67 deputetë, pavarësisht ne nuk po dëshirojmë as nuk jemi të thirrur për identifikim personal se kush ka marrë pjesë në votim dhe kush nuk ka marrë, sepse prania ishte, edhe tash është prania.

Nëse ekziston vullneti nga ju, ju kisha lutur që dy pikat t'i riktheni, të hedhen në votim dhe të kalojmë me procedimin e ligjeve, s'ka nevojë të pritet 19:30 hiç, të pranishëm janë 64 deputetë në sallë.

KRYETARI: Administrata, Armendi e ka bërë një numërim, a është e vërtetë, se ne projektligjin që e kaluam. Daut Haradinaj, Bilall Sherifi, shkojmë në ndërkohë.

60 janë aktualisht.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe më herët gjatë procesit të votimit, edhe proceduralisht, më falni, krejt çka ndodhi sot ishte mungesa e numrave, kaloi apo nuk kaloi. Shumica që kanë votuar kanë qenë pro krijimit të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Në momentin që ka deputetë në sallë, e që nesër po supozojmë në orën 10:00 vazhdon votimi, mund të procedohet votimi i krijimit të atij komisioni, do të thotë ne kemi pasur një hendikep se a duhet ta udhëheqë atë komision Vetëvendosja apo Grupi i Pavarur, meqenëse kryetarja e komisionit na e ofroi dëshminë, atëherë ne nuk kemi asnjë shqetësim.

Sa u përket njerëzve kush ka marrë pjesë ose jo, nuk është rasti i parë që një pjesë shumë e madhe e deputetëve nuk marrin pjesë në votim, është e drejtë e deputetit se si vendos.

Por, nëse flasim për numrat e pranisë, këtu shumica e atyre që janë sot pjesë e koalicionit qeverisës i kanë dhënë votën për, do të thotë nuk ka pasur deputet në sallë, i cili nuk ka votuar për.

Njëjtë ishte edhe agjencinë, po ju duhet ta kuptoni, ne nuk jemi kundër, nesër do të krijohet, e tha mirë edhe Memli, e tha edhe kryetari i Kuvendit, të gjithë jemi dakord që ai komision të krijohet, edhe për 24 orë nuk besoj që ndryshon situata.

Pra, nesër në mëngjes hidhet në votim, e votojmë për, vazhdojmë procedurën, e votojmë pikën e dytë, e kështu me radhë që kanë mbetur edhe ligjet për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Shqipe Pantina, Bilall Sherifi, se m'u ankua, paska kërkuar moti Grupi i Deputetëve të Pavarur.

SHQIPE PANTINA: Prapë nuk po e dimë te cila pikë e rendit të ditës jemi.

Pas përfundimit të Projektligjit për gjykatat, ministri, siç e përcakton Rregullorja, e përmbylli diskutimin dhe tani ne kemi kaluar te pika ku diskutohet rendi i ditës, pikë e cila ka përfunduar paradite.

Zoti kryetar,

Ju jeni përgjegjës për mbarëvajtjen e seancës dhe Rregullorja përcakton që kur deputetët dalin nga pika e rendit të ditës t'u merret fjala. Në këtë rast disa prej deputetëve nga të gjitha grupet parlamentare dolën nga rendi i ditës dhe ju po e vazhdoni diskutimin, kur janë një numër i ligjeve për të cilat ne s' po mund të diskutojmë, e si rrjedhojë mandej as s'po mund të votojmë, sepse deputetët ndoshta edhe me të drejtë po mërzhiten dhe po e lëshojnë sallën.

Kështu që ju lutemi, të kthehemi t'i diskutojmë projektligjet, se në fund të fundit, kjo është detyra jonë primare. Faleminderit!

KRYETARI: Para se të vazhdoj te kryetarët e grupeve parlamentare, zonja Pantina jemi duke shkuar në pika të rendit të ditës, ato të cilat i keni përcaktuar vetë, Kryesia, në fakt, pastaj edhe seanca këtu, të cilat i ka futur. Nuk ka pasur kuorum të votohen disa nga ato.

Në momentin kur e kam parë projektligjin, të cilin e kaluam tash pak më parë, në pikën e pestë të rendit të ditës, kërkova mirëkuptim, në bazë të Rregullores nga kryetarët e grupeve parlamentare, sillni deputetët, të jemi 61, në mënyrën që të votohen projektligjet, ose të paktën në orën 19:30, kur ne përfundojmë trajtimin e tyre, të paktën të votohet. Ndërkohë, në momentin që bëhen 61, unë do t'i vej edhe një herë të gjitha në proces të votimit. Në qoftë se ka pasur keqkuptim nga kolegja deputete herën e kaluar, nuk shkojnë në pako, po shkojnë secili një për një, në momentin që janë 61 deputetë.

Sa janë aktualisht?

Të merrem vesh, jemi në pikën e pestë, e kemi përfunduar. Bilall Sherifi, fjala për ju. Ndërkohë e marrim gjendjen.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Nuk do të përfshihem në debatin mbi personin, as mbi individin, me sa dimë ne deputetët në komisione nuk përfaqësojnë vetveten. Kemi deputetë të pavarur që nuk janë anëtar të komisioneve pikërisht sepse nuk kanë grup. Vota në komision nuk është votë individuale, është votë partiake dhe kjo, kryetar, është fakt. PDK-ja në komision ka votuar kundër interpretimit që i dha komisioni.

Pra, ky është fakt, s'është manipulim, sepse fjala më e dashur kohëve të fundit është të shpallësh të tjerët manipulantë, manipulues. Është fakt që në komision PDK-ja, përfaqësuesit e PDK-së, njëri ka votuar kundër, tjetri ka abstenuar. Nuk është interpretim imi, është fakt, unë veç po e sjell në seancë në mënyrë verbale, sepse në mënyrë të shkruar do t'ju vijë nga Administrata e Kuvendit, një.

Dy, fakt është që për shkak që nuk kaloi komisioni, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e votoi Këshillin e Cilësisë, edhe kjo është fakt, nuk është interpretim.

Për të dalë nga kjo situatë, kryetar, arsyeja pse ka ardhur deri këtu është se u tha që interpretimi i komisionit një herë duhet të shkojë në Kryesi, pastaj Kryesia ta sjellë në seancë.

Unë ju lus, ju ftoj, si të doni quani, thirrni mbledhjen e Kryesisë tash, menjëherë, këtu janë anëtarët e Kryesisë, merreni në dijeni interpretimin e Komisionit, silleni pastaj siç e keni marrë vendimin në mënyrë unanime për ta dërguar në komision, silleni po ashtu në mënyrë unanime ose me shumicë votash sërish në seancë dhe kjo çështje votohet. Pastaj do të hapet rruga që në ora 19:30 të votohet edhe komisioni, edhe ligjet, edhe të gjitha. Kjo është e vërteta, ashtu së paku qysh unë i kam parë faktet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë nga grupet parlamentare, po i shoh deputetët, janë deputetët Teuta dhe Blerim, pastaj fillojnë të gjithë kolegët deputetë, të keni parasysh. Dauti, në emër të kujt foli? Atëherë paska ndodhur një keqkuptim.

Teuta Haxhiu, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Nga kjo që u tha më herët unë pjesërisht pajtohem me atë çka e tha Shqipja, sepse ju ia kaluat fjalën ministrit, e dihet në bazë të Rregullores që pas fjalës së ministrit nuk ka më diskutime. Por është mirë që të diskutohen ligjet që janë me radhë dhe votimi të ndodhë nesër prej orës 10:00. Ne tash po futemi në një pikë që u diskutua shumë më herët, e aq më tepër me shumëçka që më së pakti i takojnë Kuvendit të Kosovës dhe me të drejtë qytetarët në një debat parlamentar në Gjilan kanë thënë që nuk po mundemi as t'i lejojmë fëmijët, e aq më tepër po irritohemi edhe ne kur po ju shohim në Kuvend.

Prandaj, rrjedha e seancës le të jetë ashtu siç i ka hije dhe le të dihet kur jemi në rend dite.

Pra, ta lëmë votimin për nesër në orën 10:00, le të diskutohen të gjitha ligjet në mënyrë që të bëjmë diçka, për ndryshe jemi në pikën e parë, është ligji i parë që ne jemi duke diskutuar prej orës 10:00, është 18:30 tash. Atëherë çfarë seance, përderisa presin edhe shumë e shumë seanca të tjera.

KRYETARI: Në momentin që i kemi 61 deputetë, futemi në votim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

60 deputetë jemi, ta dini.

Ju lutem, kryetarët e grupeve, sillni kolegët deputetë.

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Në kuadër të pakos së ligjeve për Gjqësorin, përkatësisht për pikën gjashtë, po shqyrtojmë Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ky projektligj është hartuar dhe finalizuar nga Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet të cilit janë paraparë disa dispozita të reja, të cilat Këshillit Prokurorial të Kosovës i mundësojnë kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave kushtetuese në mënyrë më efikase. Dëshiroj të theksoj se disa nga çështjet më të rëndësishme, të cilat i përmban Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës janë: e para, mandati i anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe puna me orar të plotë. Përmes propozimeve të bëra në këtë projektligj, përpos kryesuesit të këshillit, me kohë të plotë në këshill do të punojnë edhe kryetari i Komisionit për Çështje Normative, si dhe ai për vlerësimin e performansës së prokurorëve dhe do të pezullojnë punën e tyre si prokurorë deri në përfundimin e mandatit të tyre si anëtarë të këshillit.

Ky angazhim me kohë të plotë i kryetarëve të komisioneve do të sigurojë hartimin dhe miratimin në kohë të akteve nënligjore të këshillit, efikasitet më të madh të punës së administratës prokuroriale, kryerjen e përpiktë të detyrave të kryetarëve të komisioneve, ashtu siç është paraparë me ligj dhe me aktet nënligjore të Këshillit Prokurorial të Kosovës. E dyta është formimi i Zyrës për verifikim prokurorial. Projektligji për Këshillin Prokurorial parasheh funksionimin e Zyrës për verifikim prokurorial, i cili është në harmoni të plotë me rekomandimet e Kievit, të cilat parashohin prerogativa të kufizuara për punën e kësaj zyre, konkretisht kontrollimin mbi të kaluarën potencialisht kriminale të prokurorit dhe hapa të tjerë diskualifikues që mund të rrjedhin nga kontrolli i bërë nga ana e policisë.

Më tutje, projektligji parasheh mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve joprokurorë të Këshillit Prokurorial, si dhe mundësinë që përmes aktit nënligjor Këshilli Prokurorial të përcaktojë

angazhimin e bashkëpunëtorëve profesionalë, duke përcaktuar statusin e tyre, kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes. Konsideroj se miratimi i këtij projektligji është hap i rëndësishëm, i cili i mundëson Këshillit Prokurorial të Kosovës, por edhe sistemit prokurorial, të jetë më efikas në kryerjen e detyrave kushtetuese, andaj ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për shqyrtim në parim të projektligjit. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Albulena Haxhiu, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3. 4. 2018 e shqyrtoi Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që të miratohet në parim ky projektligj.

Vetëm një çështje duhet adresuar, ka të bëjë me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve që e parasheh edhe projektligji aktual, që është një nen sa i përket përgjegjësisë disiplinore, në këtë rast, të prokurorëve. Komisioni për Legjislacion ka votuar kundër, pra i ka rekomanduar seancës që të mos votohet Projektligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për arsye të cilat do t'i themi natyrisht kur ai projektligj të vijë si pikë e rendit të ditës. Dhe, në qoftë se edhe seanca e refuzon votimin e atij projektligji, sigurisht që duhet të bëhen ndryshimet në përputhje me qëndrimin kundër Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ka qenë vërejtje që është dashur të fuqizohet Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe jo të lihet te Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial përgjegjësia disiplinore, andaj edhe grupi punues duhet ta ketë parasysh këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër!

Ashtu siç e potencova edhe paraprakisht, ne jemi për avancimin në reformë të sistemit të drejtësisë në tërësi, por edhe nga ky ligj, edhe nga ligji që vjen pasues për Këshillin Gjyqësor, por edhe atë nga gjykatat dhe ju e përmendët që është në procedurë të hartimit edhe Ligji për avokaturën shtetërore, nënkupton që duhet të ketë bashkërendim të këtyre ndryshimeve. Edhe kryetarja e komisionit e potencoi ligjin që avancojnë punën e prokurorëve dhe të gjyqtarëve. Mbi të gjitha, neve na intereson performansa e prokurorëve, por edhe përgjegjësia disiplinore.

Ne japim përkrahje në këtë formë në parim. Ju duhet ose të vendosni një datë të hyrjes në fuqi tërësishme për të gjitha këto ligje, derisa të ketë harmonizim të plotë, përndryshe do të ketë prapëseprapë diskrepancë ndërmjet ligjeve, të cilat ne sot po i lexojmë, apo edhe të tjerave që vijnë dhe janë të ndërlidhura qoftë me punën e prokurorëve, qoftë me avancimin apo edhe zgjerimin e kompetencave në fushën e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor. Ky është sugjerimi i njëjtë që vlen edhe për ligjin tjetër që është për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ligji që është për përgjegjësinë disiplinore ngërthen në vete më shumë se sa tash që po flasim për këto dy shtylla. Por, sido që të jetë, ne i përkrahim këto ndryshime edhe brenda Këshillit Prokurorial, edhe pse, të jem i sinqertë, unë kam pritur pak më shumë te pjesa që lidhet me vlerësimin e performansës edhe te mënyra se si ata do ta mbikëqyrin punën e performansës së prokurorëve në tërësi, në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Kryetar, faleminderit!

Para se të dal te tema përkatëse, unë e them atë me përgjegjësi të plotë se edhe mendimi është i garantuar, por edhe e drejta e votimit të deputetit, edhe si parti, por edhe si deputet, e ka të garantuar me Kushtetutë të Republikës së Kosovës. Unë nuk e di, zonja Haxhiu ose mësuesja Albulenë, çka po bën, po e luan zëdhënësin edhe timin personal, por edhe të Partisë Demokratike. Nuk paguhet për këtë punë dhe e kisha lutur, s'është imja të bie në nivel të Albulenës, e kam parë edhe në komision nuk ka ndonjë qëndrueshmëri, menaxhon me emocione, replikon me të gjithë.

Nëse është për vlerësim, unë jam shumë optimist se asnjë profesor s'e kishte vlerësuar me një notë pozitive, por prapë nuk dua të merrem me këtë. Kur fol Albulena për mendim ndryshe, të paktën s'ka të drejtë të flasë, se një parti të tërë e kanë prishur për mendime ndryshe, të paktën atë çka kanë në opinion publik, por megjithatë unë nuk po e them këtë, jam shumë optimist që Albulena as testin PISA nuk e kalon, por as në Fakultetin Juridik po të hyjë në test real nuk kalon për t'u regjistruar.

Unë do të flas për ligjin konkret, prej temës sot më shumë kanë dalë deputetët e Vetëvendosjes se sa të tjerët, ne i kemi ligjet përkatëse dhe jam shumë i interesuar që Parlamenti të rri në temë e të mos flasim për secilën pikë 'hajt pak', të flasim dëshira apo të flasim me emocione të deputetëve apo të deputeteve për interesa shumë personale edhe të ndërrojë kahen seanca.

Projektligjin në fjalë për Këshillin Prokurorial të Kosovës e kemi shqyrtuar në komision dhe e vlerësojmë se sot duhet të marrë mbështetjen e nevojshme nga kolegët deputetë, në mënyrë që në fazën mes dy shqyrtimeve ta shfrytëzojmë si mundësi për të dhënë kontributin tonë si deputetë, në mënyrë që ky projektligj të miratohet. Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës po ashtu nuk është rishikim apo plotësim i ligjit në fuqi, por është projektligj i ri, me dispozitat e të

cilit sigurohet unifikimi i ndryshim-plotësimeve në një tekst të vetëm, me qëllim që i njëjti të jetë më lehtë i zbatueshëm. Përmes këtij projektligji janë qartësuar kompetencat e këshillit dhe është e harmonizuar me legjislacionin përkatës në fuqi. Nevojat për ndryshim brenda këtyre ligjeve janë paraqitur shpesh, pasi që asnjëherë deri tani nuk është bërë një rishikim sistematik i këtyre ligjeve, por janë ndryshuar apo plotësuar ato dispozita të nevojshme për t'u adresuar një situatë të caktuar, e shfaqur në terren. Prandaj, tani është një mundësi shumë e mirë që si pako t'i trajtojmë, t'i shqyrtojmë dhe të japim kontributin tonë për miratimin e këtyre ligjeve.

Bazuar në nevojat aktuale të sistemit të drejtësisë për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien, por edhe si kriter i vendosur në kuadër të proceseve integruese dhe që evidentohet edhe në Raportin e progresit të vitit 2016, mbështetja jonë për pakon e ligjeve të gjyqësorit është vendimtare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë ligj dhe do ta japë kontributin e vetë mes dy leximeve. Andaj, edhe një herë e përshëndes ministrin e Drejtësisë dhe ministrinë për një punë që e ka bërë shumë efektive, edhe te ato që po duan deputetët t'i politizojnë, siç është rasti të Ligji i gjykatave. Ministria e Drejtësisë te prokuroria e ka hequr prapen e 25%-shit, e kemi konsultuar edhe ministrin, edhe ministrinë, dhe do të ndodhë njëjtë edhe te gjykatat, nuk është mirë vetëm hajt kishe po bëjmë poenë politike, por të japim kontribut.

Unë edhe një herë i ftoj deputetët që ta mbështetin këtë projektligj, i cili është shumë i rëndësishëm për fushën e drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi, pastaj Shqipe Pantina e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka trajtuar, e ka shqyrtuar këtë projektligj me shumë kujdes edhe në procesin e punës në komision, edhe më vonë, edhe në parim kur të vijë koha e votimeve të gjitha këtyre ligjeve e veprimeve të ndryshme të komisioneve, Lëvizja Vetëvendosje rekomandon që ky projektligj të votohet. Mirëpo, megjithatë janë disa vërejtje që ne i kemi shprehur, sigurisht edhe do t'i shprehim gjatë shqyrtimit për leximin e dytë të këtij ligji, e këto kanë të bëjnë në shumë raste me saktësi logjike, me saktësi gjuhësore të përdorimit të drejtë të koncepteve që nganjëherë disa nga normat i bëjnë ose të pakuptueshme, ose të palogjikshme, ose kundërthënëse. Ne i kemi një varg vërejtjesh në nene të ndryshme, ato vërejtje sigurisht ne do t'i përcjellim gjatë amendamentimit të tekstit të këtij ligji, mirëpo ka edhe gjëra të tepërta, unë këtu po e vërej vetëm një çështje, sigurisht edhe Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe ministri është këtu, që t'i vërejnë ato, t'i marrin dhe sigurisht gjatë përpunimit t'i mënjanojnë disa gjëra që janë të tepërta. Për shembull, është neni 7, pikat 1.7 dhe 1.9 kanë të njëjtën përmbajtje dhe vetëm janë një përsëritje, që është krejtësisht e panevojshme.

Këtë sigurisht do ta marrin parasysh dhe do t'i kenë parasysh të gjitha këto vërejtje. Po ashtu, pikat prej 1.14, 1.15, 1.16, që kanë të bëjnë me miratimin e Kodit të Etikës, në të vërtetë janë vetëm përsëritje të disa gjërave që mund të futen në një pikë dhe mandej të specifikohen për kategori të ndryshme të personave që punojnë në prokurori. Kemi edhe gjëra, domethënë që janë të përcaktuara me ligje të tjera dhe janë përsëritje në këtë ligj, sidomos është pika 1.18, në nenin 7. Kemi edhe vërejtje të tjera që hyjnë në këtë kategori. E ceka një herë, po e them edhe një herë, kemi të bëjmë me saktësimin gjuhësor dhe saktësimin e përdorimit të koncepteve që ndikojnë qoftë në logjikën, qoftë në përmbajtjen, apo qoftë në radhitjen e normave në këtë ligj. Sidoqoftë, Lëvizja Vetëvendosje rekomandon që kur të vijë radha e votimit të votohet në parim ky projektligj, sepse nuk ka vërejtje të rëndësishme parimore që ky ligj të rishqyrtohet në thelb. Faleminderit!

KRYETARI: Shqipe Pantina, fjala për ju!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi i Deputetëve të Pavarur, në parim, e mbështet Ligjin për Këshillin Prokurorial, megjithatë janë disa çështje në ligj dhe shpresoj që gjatë procesit të shqyrtimit në komision do të shqyrtohen, në veçanti dhe shpresoj që ministri mund edhe tani të na japë arsyetimin.

Unë kam një vërejtje që ka të bëjë me nenin 8, përkatësisht pikën 6 të këtij ligji, e cila thotë se 'anëtarët e këshillit me orar të plotë nuk mund të ushtrojnë edhe detyrën e prokurorit në asnjë zyrë të prokurorisë'. Është fjala, pra, për anëtarët e këshillit që janë prokurorë. Në fakt, ne kemi mungesë të prokurorëve në ushtrimin e detyrave të tyre, tani unë nuk e kuptoj pse këta prokurorë, të cilët janë anëtarë të këshillit, nuk mund të merren me lëndët. E kuptoj se ndoshta numri i lëndëve me të cilët ata duhet të merren mund të jetë i kufizuar, por që ata të mos merren fare me lëndë, kjo nuk duket të ketë kuptim, e para. Dhe, e dyta, një çështje, pasi këtu u fol edhe për një pako të ligjeve që e rregullojnë sistemin e drejtësisë në përgjithësi e edhe punën e prokurorëve.

Janë dhënë një numër i madh i vërejtjeve, në veçanti nga organizatat joqeveritare, ato që e monitorojnë sistemin e drejtësisë, se ka shumë raste kur prokurorët heqin dorë nga lënda në fazën finale të hetimeve dhe ka raste kur një lëndë, ta zëmë, ka kaluar nëpër duart e deri në gjashtë prokurorëve dhe nuk është finalizuar për t'u sjellë në gjykatë. Ministër, kjo duhet të rregullohet disi. Tash, ndoshta kjo bëhet me çështjen e disiplinës së prokurorëve, por është e pakuptimtë që një prokuror të heqë dorë nga lënda në fazën finale dhe kjo ndoshta edhe bëhet qëllimshëm, por unë nuk dua të paragjykoj, por që po e vonon shumë zgjidhjen e lëndëve dhe, natyrisht, pastaj po krijohen probleme në gjithë sistemin e drejtësisë, ku lëndët vjetërsohen për shkak se ato asnjëherë nuk arrijnë të finalizohen dhe të sillen në gjykatë. Kjo nuk ndodh vetëm te prokurorët, e njëjta ndodh edhe nga gjykatësit.

Një gjykatës, pasi kryen një numër seancash, bile pasi dëgjon edhe të gjithë dëshmitarët, në fund vetëm në fazën finale, kur duhet të jepet vendimi, ai ose ajo heq dorë nga lënda. Kështu që ju lutem t'i keni këto çështje parasysh dhe të gjendet edhe një formë e sanksionimit që gjyqësori ynë të bëhet më efikas, përndryshe, në parim, ne e mbështesim projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Blerim Kuçi, bëhet gati Bilall Sherifi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë parlamentar në parim do ta votojë këtë projektligj dhe do ta japim kontributin tonë në Komisionin Legjislativ. Mirëpo, unë e mora fjalën dhe kërkova një mirëkuptim prej kolegëve të mi, edhe prej zëvendësshefes së grupit, e kam një propozim konkret për Komisionin për Legjislacion.

U propozoj grupeve parlamentare t'i tërheqin anëtarët e këtij komisioni, sepse puna e këtij komisioni nuk është efikase. Assesi, asnjëherë, sa herë kemi pasur debat për projektligje, të cilat janë të fushës të këtij komisioni, nuk na kanë lehtësuar, është vërejtur që nuk kanë harmoni në këtë grup, nuk punojnë si grup dhe çdoherë 50% të kohës na e marrin me debate mes anëtarëve të komisionit. Unë jam anëtar i një komisioni dhe dua ta falënderoj edhe zotin Abdixhiku që kemi krijuar një klimë ku ne punojmë si grup. Aty ka debat, ka debat profesional, shteren debatet dhe vijmë me një qëndrim këtu para jush. Ky komision përveçse nuk ia ka lehtësuar punën e Kuvendit, ka krijuar një lloj hutie, bëhet një debat i cili vërtet nuk ka kuptim, shumica e anëtarëve të këtij komisioni bëjnë amendamente sa për të thënë që kanë bërë amendamente, sepse ato kanë mundur t'i shqyrtojnë brenda si kolegë.

Edhe ky debat i sotshëm, edhe debatet e mëhershme brenda anëtarëve të këtij komisioni janë të pakuptimta. Unë e kuptoj edhe garën për votë, edhe garën për të thënë e për të mos bërë kurrgjë, por vërtet nuk ka kuptim të na merret koha. I propozoj së paku kryetares së komisionit dhe kryetarit të Kuvendit që ky komision të shkojë t'i rregullojë raportet diku me ndonjë vikend, a nuk e di, sepse ka nevojë për harmoni, që t'i rregullojë raportet në mes vete. Së paku, nuk ka kuptim që këto debate të këtij komisioni, në këtë formë, të ndodhin nëpër këto seanca. Nuk ka kuptim se çdoherë anëtarët e këtij komisioni bëjnë amendamente, të cilët kanë mundur t'i koordinojnë brenda komisionit. Pra, seriozisht po u propozoj edhe një herë grupeve parlamentare, shefave të grupeve parlamentare që t'i shqyrtojnë, t'i tërheqin anëtarët e vet nga ky komision. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Meqë është bërë zakon kur nuk të jepet fjala në replikë, kur dikush i referohet fjalës tënde, kur e marrim fjalën për pika të zakonshme, themi ‘para se të dalim te ajo pikë’. Edhe unë, para se të dal te pika, po i them disa fjalë.

Kryetar, replikë nuk jepet vetëm kur të përmendet emri, por edhe kur dikush i referohet asaj që ti ke thënë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, unë kërkoja replikë, nuk ma dhatë, tash po e them atë që e pata ndërmend ta them. Deputeti, po, është i pavarur dhe mandati i tij i buron nga qytetari dhe Kushtetuta i jep të drejtë të ketë mendimin e tij dhe votën e tij në Kuvend sido që t’ia ketë qejfi dhe bindja, por jo në komisione parlamentare, sepse aty përfundon mandati i deputetit, fillon mandati i përfaqësuesit të një grupi parlamentar. Natyrisht që secili deputet pastaj ka të drejtë edhe në komision të votojë si të dojë, por nuk mund të thotë unë këtu e votoj ndryshe, ndërsa qëndrimi i partisë qenka ndryshe, nuk shkojnë këto. Aty u dha në emër të PDK-së vota kundër, ndërsa në emër personal, tha, unë do ta dërgoj në Gjykatë Kushtetuese, nuk po i hyj në hak asgjë. Në emër të tij tha, jo në emër të PDK-së, pra në emrin personal tha do të shoh mundësinë për ta dërguar këtë interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është në të drejtën e tij, por jo të më drejtohet mua që nuk kam shkelur asgjë, sepse unë kam të drejtë të kem mendim dhe votën time. Jo në komisione, kemi deputetë të pavarur, por nuk janë në komisione pikërisht sepse mendimi i tyre i pavarur nuk mund të hyjë në komisione.

Në komisione hyn mendimi dhe qëndrimi i grupit parlamentar, cilido qoftë ai. Sa i përket ligjit në fjalë, sigurisht që edhe Nisma e ka mbështetur në komision dhe do të vazhdojë ta mbështesë edhe mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Tani jemi në radhën e përfaqësuesve, deputetëve, në fakt. Fitore Pacolli-Dalipi e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,

Këshillit Prokurorial Kushtetuta e Kosovës i ka dhënë autoritet dhe kompetenca të plota, pra për të qeverisur me sistemin e drejtësisë në Kosovë, ashtu që të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit prokurorial. Por, pavarësisht kësaj, Raporti i Progresit për vitin 2016 dhe raportet e tjera të organizatave ndërkombëtare dhe atyre lokale kanë listuar një varg vërejtjesh sa i përket sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm, siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligj.

Raporti i Progresit i vitit 2016 ka theksuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të hartuar rregullore dhe për të marrë vendime në përputhje me hierarkinë aktive të akteve normative, po ashtu ka konstatuar se nuk ka kapacitet për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre. Pra, raporti vazhdon të theksojë se ka dështuar në mënyrë të vazhdueshme në kryerjen e obligimeve dhe kompetencave kushtetuese lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin e

prokurorive. Pra, nuk kanë ndërtuar mekanizma efikas për të ushtruar kontroll mbi prokuroritë. Sipas raportit në fjalë dhe raporteve të tjera ndërkombëtare dhe atyre lokale, pavarësisht se Këshilli Prokurorial ka miratuar një numër të rregulloreve dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe mediet, ka mungesë të vullnetit të sistemit prokurorial për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut.

Edhe në këtë projektligjin e ri mungojnë dispozitat lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, si dhe nuk ka ndonjë mekanizëm efikas të kontrollit. Po ashtu, mungojnë dispozitat që e matin punën e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryetarëve të prokurorive. Prandaj, është shumë me rëndësi që çfarëdo ndryshimi që bëjmë në këtë projektligj t'i marrim parasysh vërejtjet, sidomos ato që vijnë nga Bashkimi Evropian.

Përkundër obligimeve ligjore, politikave të miratuara nga këshilli dhe deklaratave të vazhdueshme në publik për luftimin e korrupsionit pa kompromis, në praktikë sistemi prokurorial vazhdon të sfidohet me mungesë të rezultateve konkrete. Pra, nëse i marrim të gjeturat e shumë raporteve të publikuara, sidomos raportit të fundit nga tre ekspertët evropianë, atëherë konstatimi është se luftimi i korrupsionit është i koncentruar kryesisht në profilin e ulët dhe të mesëm dhe gjetjet e monitorimit të këtyre raporteve tregojnë se rastet e profilit të lartë të gjykuara në vitet e fundit kanë përfunduar pa marrë ndonjë vendim konkret. Kështu që është me rëndësi vërejtjet që janë dhënë nga këto raporte të merren parasysh dhe ky ligj të plotësohet, në mënyrë që të sigurojë paanshmërinë dhe të ketë efekt në punën dhe luftën kundër korrupsionit.

Janë disa vërejtje që i kam vërejtur në këtë ligj. Pra, është neni 21, Njësia për Verifikim Gjyqësor, që është nen pothuajse i njëjtë, nuk e di a është kopjuar nga ky ligj dhe është vendosur në Projektligjin për Këshillin Gjyqësor, mirëpo thotë se procedura për verifikimin e së kaluarës së kandidatit duhet të bëhet me kujdes maksimal dhe në mënyrë strikte, në pajtim me parimet e sundimit të ligjit. Këshilli mund të kërkojë një kontroll standard për dosje penale dhe baza të tjera, që mund ta diskualifikojnë kandidatin nga Policia.

Pra, neni 21, pika 1, duhet të riformulohet komplet, për shkak se lë të kuptojë që Policia mund ta diskualifikojë kandidatin apo kandidatët e tjerë. Policia nuk duhet të ketë mundësi të diskualifikojë kandidatë, por mund të ofrojë të dhëna rreth së kaluarës së kandidatit, të cilat pastaj mund të rezultojnë me diskualifikimin e kandidatit. Faleminderit!

KRYETARI: Drita Millaku në radhë, bëhet gati Albulena Haxhiu. Në qoftë se ka tjetër deputet, apo s'ka të tjerë të lajmëruar.

DRITA MILLAKU: Sipas këtij projektligji, Këshilli Prokurorial i Kosovës do t'i kishte trembëdhjetë anëtarë dhe ndër ta edhe një anëtar nga shoqëria civile. Siç parashihet në

nënparagrafin 3.3 të nenit 8 të këtij projektligji, në të cilin shkruan se përveç që duhet plotësuar kushtet e parapara, duhet të plotësohet edhe një kusht, e që është përkrahja e së paku pesë organizatave joqeveritare që merren me fushën e drejtësisë.

Ky është një rregull, sepse e ndërlikon zgjedhjen e një anëtari jo paraprak, duke u bazuar në faktin se OJQ-të mund të themelohen me një procedurë të thjeshtë dhe anëtari i tillë mund të na dalë edhe më partiak sesa që mund të mendohet, siç kemi pasur edhe raste të mëhershme.

Në paragrafin 6 të nenit 20 të këtij projektligji shkruan që Këshilli Prokurorial harton rregullore të veçantë për procesin e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve nga komunitetet joshumicë. Kjo është e padrejtë, sepse për shqiptarët duhet të përdoren kriteret më të ashpra, ndërsa për komunitetet që të zbuten ato kriteret, vetëm për ta arritur së paku 15%-shin e përbërjes së prokurorëve.

Ashtu siç parashihet në paragrafin 5 të nenit 20 të këtij projektligji, duke pasur parasysh që Republika e Kosovës është shtet i qytetarëve të saj me të drejta të barabarta, atëherë nuk duhet të zbuten kriteret vetëm për plotësimin e kuotës. Pra, kuota respektohet, por kriteret e rekrutimit të jenë të njëjta për të gjithë.

Në nenin 28 të këtij projektligji janë paraparë kriteret për vlerësimin e performancës së prokurorëve, por një nga kriteret që parashihet në paragrafin 2.7 të këtij neni është edhe sjellja e prokurorit jashtë zyrës. Ky kriter është i paqartë dhe si rrjedhojë si paragraf nuk ka nevojë të ekzistojë, sepse në mënyrë arbitrare mund të nënshkruhet ndonjë prokuror pa e pasur paraprakisht të parashkruar se çka përfshin apo nënkupton sjellja jashtë zyrës. Do të mjaftonte që një prokuror të ketë integritet personal, siç parashihet në paragrafin 2.8 të këtij neni, e jo të ekzistojë edhe ky paragraf, nëse nuk është e drejtë dhe etike.

Në nenin 9 të këtij projektligji janë të përcaktuara rastet e papajtueshmërisë për të qenë anëtar i Këshillit Prokurorial. Në nënparagrafin 1.4 shkruan se anëtarë të Këshillit Prokurorial nuk mund të jenë personat që punojnë në administratë, përfshirë edhe personat që kryejnë detyra në Qeveri, apo në organet administrative dhe në themelatat e themeluara me Kushtetutë. Fjala “themelatë” është e pakuptimshme dhe mendoj se është abstrakte, që nuk përkufizon diçka konkrete dhe çka përfshin, pra cilat do qofshin ato institucione apo organe shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja e fundit e paraqitur është zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Së pari, vetëm një koment shkurtimisht te përkufizimet.

Ajo çfarë po ndodh në vazhdimësi është që ministri të caktuar, kur po procedojnë projektligje në Kuvend po e parashohin edhe një nen për përkufizimet, por po ashtu po ndodh edhe që të mos

kemi fare përkufizime. Por, ajo çfarë ka ndodhur edhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, përkatësisht projektligjin, edhe atë për Këshillin Prokurorial, janë përkufizime që shumë prej tyre janë të panevojshme. Për shembull, thuhet çka është Kushtetuta, çka është Presidenti, Kuvendi, Këshilli, kryesues, anëtar i këshillit, ditë, sekretariati, dhe të tjera... Por, përmendet edhe përkufizimi Qeveri, në anën tjetër askund në projektligj, as në KGJK, as në KPK, nuk flitet asgjë për Qeverinë. Nuk e di pse, ndoshta e keni pasur në ndërdije, por besoj se është e panevojshme.

Po kthehem te neni 5 i projektligjit që ka të bëjë me përgjegjësinë personale të anëtarëve të këshillit. Thuhet se anëtarët e këshillit nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet. Mendoj se është goxha problematike nëse lejohet si formulim i tillë. Po për mendimet, për veprimet, por jo edhe për vendimet. Ka anëtar këshilli që vendos diçka që është në shpërputhje me Kodin Penal, në shpërputhje me detyrat e tij si anëtar i këshillit, andaj natyrisht se ai duhet të ndiqet penalisht.

Rregullim ndryshe është tek Ligji për Këshillin Gjyqësor, thuhet se në qoftë se e shkel ligjin në mënyrë të paqëllimshme, por nuk besoj që ndonjë gjyqtar do ta pranojë që e ka shkelur në mënyrë të qëllimshme ligjin. Prandaj, besoj se kjo duhet të adresohet, pajtohemi për mendimet dhe veprimet, por jo edhe për vendimet që janë në shpërputhje me përgjegjësinë si anëtar i këshillit.

Pastaj, ajo çfarë e vlerësoj është raporti i Këshillit Prokurorial në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në mandatin e kaluar kam bërë përpjekje maksimale që Këshilli Prokurorial i Kosovës të sjellë raport lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet, sepse ne si deputetë s'mund të dimë se cilat i kanë sfida, në qoftë se ata s'e kanë paraprakisht një raport për Kuvendin e Republikës dhe këtu është adresuar kjo.

Tek neni 10 thuhet që anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi shkarkohen nga detyra në pajtim me dispozitat e këtij ligji me propozim të këshillit. Tash, ne kemi edhe anëtarë që i zgjedh Kuvendi, kemi raste jo të mira sa i përket Këshillit Gjyqësor, kur për anëtarët të cilët i ka zgjedhur Kuvendi, ndonëse ata kanë qenë në shkelje flagrante të ligjit dhe Kushtetutës, për shembull, kemi pasur raste kur një anëtar i këshillit që është votuar nga Kuvendi, në të njëjtën kohë ka qenë edhe anëtar në listën për zgjedhje në listën për kandidat në zgjedhje të Serbisë, në partinë e Vuçiqit. Prandaj, unë kam kërkuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës ta adresojë këtë dhe besoj se kur kemi të bëjmë me anëtarë që i zgjedh Kuvendi duhet që komisioni përkatës, në këtë rast Komisioni për Legjislacion ta bëjë propozimin për shkarkim.

Sa i përket asaj që e shtroi deputetja Pacolli, është e vërtetë, sepse unë e pashë nenin 21, është Njësia për Verifikim. Për bindjen time është shumë problem në qoftë se i japim kompetencë Policisë për ta diskredituar një gjyqtar, apo një prokuror. Këtu duket se është bërë një lloj vetingu, por jo veting, sepse është goxha e butë si dispozitë, prandaj duhet të riformulohet.

Edhe diçka sa i përket deklaratës së zotit Kuçi, pati akuza për Komisionin për Legjislacion. Unë e ftoj zotin Kuçi që ta bëjë një kërkesë për debat parlamentar lidhur me punën e Komisionit për Legjislacion, kur të dojë ai, nëse e do edhe nënshkrimin tim e jap, por për mua është e papranueshme tendenca për ta mbytur zërin kritik karshi projektligjeve që i sjell Qeveria në Kuvend. Të mos mendojë zoti Kuçi se do të mund që Komisionin për Legjislacion ta shndërrojë si një vegël të Qeverisë. Asnjëherë, për sa kohë është Vetëvendosje në kryesim të këtij komisioni, asnjëherë s' do të mund që komisionin apo komisionet tjetra t' i shndërrojë në vegla të Qeverisë. Kosova është republikë parlamentare, Qeveria duhet t' i raportojë këtij Kuvendi dhe Qeveria duhet të jetë në mbikëqyrje të Kuvendit.

Prandaj, mua më vjen keq në qoftë se ai hidhërohet me kritikën e mia në raport me projektligjet apo me mendimet tona si anëtarë të komisionit në Komisionin për Legjislacion, por deklarata e tij, që për bindjen time është e ultë, madje edhe e gërditshme, nuk mund t' i ndryshojë asnjëherë qëndrimet, edhe në qoftë se ai bën kritika të tilla, që për mua janë të pavlera. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Do të mundohem t' i adresoj disa prej çështjeve, në fakt shumicën prej çështjeve që u nxorën nga deputetët. Po filloj me atë të deputetes Pantina, kur flet për numrin e prokurorëve.

E nderuar deputete,

Deputetë,

Ju njoftoj se Republika e Kosovës i ka 203 prokurorë dhe ky numër cilësohet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës si numër i mjaftueshëm i prokurorëve në Republikën e Kosovës dhe nuk do të ketë nevojë për rritje të numrit të tyre. Ndërsa, në anën tjetër, jemi shumë keq me numrin e gjyqtarëve, pra Republika e Kosovës i ka 25 gjyqtarë në 100 mijë banorë. Është numri më i ulët në Evropë, madje edhe më së keqi edhe në rajon. E kemi Maqedoninë, që i ka 35 gjyqtarë në 100 mijë banorë dhe unë shpresoj që në këto dy vjetët e ardhshme do ta adresojmë. Jemi në proces të rekrutimit të gjyqtarëve të rinj, në këtë rast Këshilli Gjyqësor, me përkrahjen buxhetore që i kemi bërë për këtë vit dhe besoj se do ta përmirësojmë këtë numër.

Është parë të jetë e nevojshme dhe e rëndësishme që dy kryetarët e komisioneve, pra kryetari i Komisionit për Çështje Normative dhe i Vlerësimit të Performansës të jenë me orar të plotë, së bashku me kryesuesin në Këshill. Pra, prej 13 anëtarëve këta të tre të jenë me orar të plotë, për shkak të rëndësisë së këtyre dy komisioneve. Kjo ka ardhur si rekomandim edhe nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe pa dyshim se nuk do ta zbehë numrin e punës së prokurorëve. Thashë, ne e kemi 203 numrin e prokurorëve dhe është vlerësuar si numër i mjaftueshëm.

Sa i përket çështjes së llogaridhënies dhe disa prej çështjeve që i shtroi zoti Zemaj, pajtohem plotësisht me të, që nëse ne s'arrijmë t'i votojmë të gjitha këto projektligje, pra në pako, që e kemi përfshirë edhe Ligjin për përgjegjësi disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, nuk besoj se do ta arrijmë efektin që po e kërkojmë.

Ligji për përgjegjësi disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë pikërisht adreson çështje që kanë dalë nga Raporti i Progresit 2016 sa i përket llogaridhënies dhe kontrollit më efektiv të prokurorëve nga Këshilli Prokurorial. Unë jam i gatshëm që në seancën e radhës, apo kurdo që të hyjë, ta diskutojmë nen për nen, se është tepër i rëndësishëm, ta ngremë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në nivel të këtyre dy këshillave. Pra, të rritet llogaridhënia e tyre dhe njëkohësisht edhe këshillat, edhe Këshilli Gjyqësor, edhe Këshilli Prokurorial, të jenë më efikas.

Çështja e Policisë është një çështje që del te rekomandimi i Komisionit të KIEV-it, nuk është se ka ardhur nga qielli për ne që ta involvojmë këtu në Policinë e Kosovës. Do të jetë pa dyshim edhe deri në një nivel ku mund të involvohet Policia e Kosovës, mirëpo në asnjë rrethanë nuk e kemi parë si një tendencë e një agjencie ligjzbatuese, në këtë rast të Policisë së Kosovës, për ta dëmtuar reputacionin a imazhin a çfarëdo qoftë të prokurorit, ose të gjyqtarit. Ne kemi njësi të verifikimit, edhe për gjyqtarë, edhe për prokurorë, mirëpo nuk është e rregulluar me ligj. Tani, pra, me këto dy ligje po e rregullojmë çështjen e njësisë së verifikimit, edhe për gjyqtarë, edhe për prokurorë. Pra, po e përligjim nëse mund të themi këtë institucion që veç ekziston në kuadër të këtyre dy këshillave.

Nuk e di nëse mbeti ndonjë çështje pa e adresuar prej këtyre? Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, pas diskutimit të përfaqësuesit të Qeverisë asnjëherë s'e kemi pasur praktikë që rreth projektligjit t'ia japim fjalën dikujt. Unë po mundohem të jem i njëjtë, bile me pozitën pak më i ashpër, me opozitën më tolerant. Po e lëmë, pasi jemi në proces. Keni mundësi, kemi ligje të tjera apo projektligje, pastaj e shfrytëzon...

Urdhëro, urdhëro, veç të mos keqpërdoret pastaj për të tjera raste.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Nuk po e di. Unë e kam Rregulloren e Kuvendit dhe e di se sa herë që ka diskutime lejohet replika, kur i referohet çështjes.

Kur po flasim për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar që të mos përkraket si i tillë. Dhe, pse? Për shkak se për ne si komision ka qenë i papranueshëm roli i Ministrisë së Drejtësisë në këtë drejtim. Për shembull, një qytetar i Republikës së Kosovës ka ankesa në një gjyqtar apo një prokuror. Ai duhet ta dërgojë ankesën te ministri i Drejtësisë, e pastaj ministri i Drejtësisë ta dërgojë në Këshillin

Gjyqësor, ose në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kjo është e pakuptimtë. Çfarë roli ka këtu Ministria e Drejtësisë?

Së pari ka pasur një tendencë që Zyra e Prokurorit Disiplinor të fuqizohet nëpërmjet ligjit të veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor. Unë e di që ka jashtëzakonisht shumë probleme te Zyra e Prokurorit Disiplinor. Jashtëzakonisht shumë. Por, në qoftë se ne do ta kishim propozuar një ligj, e kishim fuqizuar atë zyrë, natyrisht që do të ishte si alternativë më e mirë se kjo që e keni propozuar ju. Pastaj, ka qenë një tendencë që komplet Ministria e Drejtësisë ta marrë nën kompetencë të saj përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Është hequr dorë nga ajo dhe mirë keni bërë, por edhe me propozimin që e keni sjellë e keni fuqizuar jashtëzakonisht shumë Ministrinë e Drejtësisë.

Prandaj, kjo është arsyeja se përse Komisioni për Legjislacion nuk e ka pranuar si propozim të këtillë. Kur të hiqet “Ministria e Drejtësisë,” ndoshta edhe do të ndryshojë qëndrimi i komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Po, vetëm një sqarim. Kur e kërkon fjalën tjetër herë, kërkojeni replikë, jo për çështje. Se për replikë, tash e merr fjalën edhe ministri për kundër-replikë. Kjo që të thotë jemi brenda kornizës, por e kërkoje për çështjen. Kundër-replikë!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E para, unë nuk jam me mandat të përjetshëm këtu dhe besoj pas meje, si ta kryej mandatin, vjen dikush tjetër, nëse s’e marr edhe një të dytë.

Sa i përket çështjes së involvimit të ministrit, në këtë rast jo vetëm të ministrit, por edhe Avokati i Popullit, pra e kanë si instrument në rast se vjen çfarëdo ankese nga institucioni, nga qytetarët e Kosovës, ne mund t’i drejtohem Gjykatës Supreme me atë ankesë. Pra, ky është një instrument që është konsultuar ngushtë, edhe Komisioni Evropian, edhe partnerët tanë ndërkombëtarë, që kanë punuar në këto projektligje, dhe absolutisht nuk bie ndesh me punën, as të ministrit, as nuk ndërhyjnë në pavarësinë, as të Gjyqësorit, as të Prokurorisë. Dhe, për këtë arsye mendoj se nuk është një çështje, mirëpo nëse ju deputetët e Kuvendit të Kosovës mendoni se është mirë ta ketë vetëm Avokati i Popullit, unë jam në rregull, shkojmë në atë formë.

Por, unë mendoj që është mirë që kjo çështje t’i takojë ministrit të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit. Thashë, nuk është mandat i përjetshëm.

KRYETARI: Zoti ministër, faleminderit! Në rrethana të këtilla... Administrata, sa deputetë i kemi? 44. A vazhdojmë më tutje? Vazhdojmë! Në lexim të parë të projektligjit, edhe kështu keni mjaft kohë, po tash... Sami, nuk kam të drejtë, se jua kisha dhënë fjalën gjithë ditën. Po, replikë a? Jo, jo me ligjin më vonë, po në qoftë se ke replikë, më vjen keq, zoti Kurteshi, por po

vazhdojmë me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, pastaj shfrytëzojeni edhe këtë pikë të rendit të ditës, flitni edhe për këtë që e kaluam.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Më lejoni që si pikë në vijim të rendit të ditës të paraqes para jush për miratim Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ky projektligj ngjashëm si tri projektligjet tjera, kanë qenë pjesë e pakos së ligjeve të Gjyqësorit, të cilat si pako i kanë harmonizuar normat ligjore me ato kushtetuese.

Siç e dini, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është një kategori kushtetuese, përgjegjësia e të cilit lidhet me administrimin dhe zbatimin e politikave për sistemin gjyqësor, në mënyrë që sistemi gjyqësor dhe veprimtaria e tij të jenë në përputhje të plotë me vizionin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për një sistem të pavarur, efikas dhe të përgjegjshëm.

Në këtë projektligj ndryshimet themelore që janë paraqitur kanë pasur për qëllim definimin akoma më të qartë të rolit dhe mandatit kushtetues të Këshillit Gjyqësor, rritjes së pavarësisë, efikasitetit, por edhe llogaridhënies së tij. Vlen të theksohet se ky projektligj po ashtu është unifikues në raport me ndryshimet e shpeshta që i janë bërë ligjit aktual. Në mesin e ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj janë këto si në vijim:

- mandati i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe puna me orar të plotë,

- mandati i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor është harmonizuar me amendamentin e 25-të të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nëpërmjet të cilit shumica e anëtarëve të Këshillit zgjidhen nga Gjyqësori, në mënyrë që të sigurohet pavarësia më e madhe brenda pushtetit gjyqësor,

- orari i punës së anëtarëve të këshillit tani e tutje do të jetë me kohë të plotë, jo vetëm për kryesuesin e këshillit, por edhe për kryetarin e çështjeve normative, si dhe për vlerësimin e performansës së gjyqtarëve. Nëpërmjet angazhimit me orar të plotë të kryetarit të Komisionit për Çështje Normative do të sigurohet hartimi dhe miratimi me kohë i akteve nënligjore të këshillit,

duke mos e përjashtuar hartimin e politikave, që do ta udhëheqin punën e këshillit dhe do të sigurojnë efikasitet më të madh të punës së Administratës së gjyqësorit.

Duke marrë parasysh që Komisioni për Vlerësim të Performansës së Gjyqtarëve do të jetë mjet kyç nëpërmjet të cilit gjyqtarit do t'i mundësohet ngritja brenda sistemit, por edhe shkarkimi eventual, përkushtimi me orar të plotë i kryetarit të komisionit do t'i sigurojë kryerjen e përpiktë të detyrave të këtij komisioni, ashtu siç është e paraparë me ligjet dhe aktet nënligjore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni i ri i përhershëm për trajnime, kompetencat për organizimin dhe përcaktimin e politikave për trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve nuk kanë qenë të qarta për të gjitha palët, sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Projektligji për Këshillin Gjyqësor parasheh dispozita të qarta në lidhje me kompetencat për caktimin e politikave për trajnim të gjyqtarëve, që përtej çdo dyshimi i përkasin Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Po ashtu, ky projektligj parasheh formimin e komisionit për trajnime brenda këshillit, që do t'i koordinojë çështjet lidhur me nevojën për trajtimin e ndërmjetëm të Këshillit me Akademinë e Drejtësisë.

Formimi i Zyrës për Verifikim Gjyqësor, Projektligji për Këshillin Gjyqësor parasheh funksionimin e zyrave për verifikim gjyqësor, i cili është në harmoni të plotë me rekomandimet e KIEV-it, të cilat parashohin prerogativa të kufizuara për punën e kësaj zyre, konkretisht kontrollimin mbi të kaluarën potenciale kriminale të gjyqtarit dhe hapat tjerë diskualifikues që mund të rrjedhin nga kontrolli i bërë nga Policia.

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e përpjekjeve institucionale për fuqizimin e strukturave kushtetuese, siç është Këshilli Gjyqësor i Kosovës, konsideroj se këto ndryshime të parapara me këtë projektligj do të arrijnë një hap më tutje drejt avancimit të veprimtarisë së këtij këshilli dhe drejt pavarësisë së tij. Të jemi sa më efikas dhe të përgjegjshëm karshi qytetarëve. Andaj, ju ftoj që ta përkrahni në lexim të parë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Albulena Haxhiu, si kryetare e Komisionit FunkSIONAL, e paraqet dhe e arsyeton raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3. 4. 2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe vendosi që t'ia rekomandojë seancës që të miratohet në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e përfaqësuesve apo grupeve parlamentare. Armend Zemaj, fjala për ju, në emër të grupit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Armend, Arbeni më ka kërkuar, duhet “grupi më i madh parlamentar”, a je i kënaqur?

ARMEND ZEMAJ: Janë çështje të cilat pothuajse janë të njëjta, të cilat i parashtrova sa u përket edhe trupave tjerë që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë në vend, në raport edhe me Këshillin Prokurorial, por kjo vlen edhe për Këshillin Gjyqësor.

Ne jemi të interesuar, e mbi të gjitha insistojmë në pavarësinë e këtyre dy këshillave. Mbi të gjitha, ajo që është primare është drejtësia efikase. Kjo sigurohet nëpërmjet funksionimit më të mirë të gjykatave, që nënkupton gjyqtarët në Republikën e Kosovës, duke përfshirë tërë territorin e Republikës së Kosovës, kështu që besojmë në maturinë e tejshtuar edhe të Komisionit Funkcional, të anëtarëve të Komisionit Funkcional që do të jenë shumë syçelë, ta quaj, në atë se të gjitha këto propozime që jepen të kenë një logjikë të njëjtë, edhe të përafrimit të ideve, sepse ka edhe ide që janë më shumë progresive edhe që do ta avancojnë këto dy trupa, kështu që ne japim përkrahje, në parim, në lexim të parë.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Nezir Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Rishikimi i fushës së gjyqësorit, në të cilën bën pjesë Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, do të ketë kuptimin e vërtetë veçmas për faktin që përmes tij do të realizohet unifikimi dhe harmonizimi me Kushtetutën i ndryshimeve që kanë ndodhur më herët.

Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës e kemi shqyrtuar në komision dhe në grup parlamentar. E vlerësojmë se sot duhet ta ketë mbështetjen e nevojshme nga deputetët, në mënyrë që fazën në mes dy shqyrtimeve ta shfrytëzojmë si mundësi për të dhënë kontributin tonë, në mënyrë që ky projektligj të miratohet.

Me këtë projektligj janë bërë disa ndryshime të rëndësishme, të cilat edhe i adresojnë disa nga sfidat që Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka hasur deri më tani.

Është paraparë me të drejtë përgjegjësia e këshillit për inspektim gjyqësor, një kompetencë e papërcaktuar dhe e paushtruar deri më tani si dhe mënyra e lirimit nga detyra e gjyqtarëve, pa nevojë që gjyqtari të shkarkohet për fatin e mungesës së bazës ligjore, edhe atëherë kur në mënyrë të rregullt përfundon punën, për shembull, me rastin e pensionimit, e disa çështje të tjera që ministri i potencoi.

Si të tillë, ne në parim do ta përkrahim dhe kërkojmë të gjithë deputetët ta mbështesin në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Albulena Haxhiu, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Lidhur me çështjen që e ngriti zoti Zemaj, e ka diskutuar Komisioni për Legjislacion që Ligji për Këshillin Gjyqësor, por edhe ai për Këshillin Prokurorial të ndjekë logjikë të njëjtë. Prandaj, jemi dakorduar që një grup punues ta ketë në kompetencë që t'i trajtojë këto dy projektligje, për shkak se duhet të ndiqet linja e njëjtë dhe ndryshimet e njëjta sikur në Këshillin Gjyqësor, po ashtu edhe në Këshillin Prokurorial.

Sa i përket Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes e përkrah.

Më lejoni që shkurtimisht t'i them disa prej çështjeve, të cilat ne i konsiderojmë që duhet të shqyrtohen, apo për të cilat do të bëjmë amendamente.

Sa u përket përkufizimeve, vlen e njëjta, pra Qeveria askund nuk përmendet në këtë projektligj, prandaj edhe nuk duhet të jetë si përkufizim.

Neni 5 ka të bëjë me përgjegjësinë personale të anëtarëve të këshillit, e që është paragrafi 2, thuhet që 'anëtarët e këshillit nuk do të gëzojnë imunitet në bazë të paragrafit 1 të këtij neni dhe do të mund të shkarkohen atëherë kur bëjnë shkelje të qëllimshme të ligjit'.

E përmenda edhe më herët, është goxha problem të vlerësohet se a e ka shkelur apo jo një anëtar i këshillit me qëllim ligjin.

Prandaj, duhet të shmangemi nga formulime të tilla, por duhet ta ndjekim logjikën që kurdo një anëtar i Këshillit Gjyqësor bën shkelje të ligjit, atëherë natyrisht që ai duhet të japë përgjegjësi për këtë.

Tek neni 8, paragrafi 5: "Anëtarët e këshillit mund të jenë edhe persona që nuk janë gjyqtarë, por që janë juristë të jashtëm", nuk e kuptoj si terminologji çka nënkupton me 'jurist të jashtëm',

‘jurist të jashtëm’, ‘të brendshëm’ si është puna, ndoshta ministri i Drejtësisë mund të na arsyetojë këtë përkufizim, për shkak se pastaj paraqet probleme se çka konsiderohet ‘jurist i jashtëm’.

Pastaj është neni 10, paragrafi 10: “Anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi shkarkohen nga detyra në përputhje me dispozitat e këtij ligji me propozim të këshillit”. Mendoj që duhet të parashihet në atë mënyrë që kur anëtarët zgjidhen nga Kuvendi, për shkeljet eventuale duhet që Kuvendi t’i propozojë këshillit që të shkarkohen të njëjtit apo të shkarkojnë direkt nga Kuvendi, ashtu edhe si zgjidhen.

Pastaj është neni 11. 2.6 dhe paragrafi 3, ka një përsëritje. Për shembull, thuhet në nenin 11: “Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i këshillit i drejtohet së paku një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me performansën e sistemit gjyqësor”. Është edhe në paragrafin 3, e njëjta thuhet: “Kryesuesi i këshillit i drejtohet Kuvendit së paku një herë në vit lidhur me sistemin gjyqësor”, pra duhet të hiqet njëra.

Pastaj është neni 13, 1.2 dhe 1.3 përfundimi i mandatit.

1.2 është me humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre muaj për shkaqe mjekësore të vërtetuara. Aktualisht situatën në Këshillin Gjyqësor e kemi që përfaqësuesja që është zgjedhur nga Kuvendi, unë kam kërkuar nga Këshilli Gjyqësor që të shkarkojë të njëjtën, por që s’kanë vepruar. Fare nuk është e rregullt në takimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Dhe në pyetjen time kryesuesit të Këshillit Gjyqësor se a është e rregullt, më është thënë që jo. Pse, sepse deklaron që është e sëmurë. A i keni kërkuar vërtetime mjekësore? Jo. Ndërsa këtu parasheh, por edhe ligji aktual parasheh që kjo duhet të jetë e vërtetuar.

Unë e kam përmendur edhe në komision, edhe për një mungesë në shkollë, natyrisht që mësuesi ta kërkon edhe udhëzimin e mjekut që ke munguar, e lere më kur je anëtar i Këshillit Gjyqësor dhe s’kërkojnë llogari në Këshillin Gjyqësor për një anëtare serbe, që është e përfaqësuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Po ashtu, parashihet dështimi i vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e këshillit më gjatë se tre muaj. Unë jam e bindur që ka pasur shkelje të vazhdueshme këtyre dispozitave, mirëpo që nuk janë respektuar asnjëherë.

Pastaj e kemi nenin 15, paragrafi 3, kuorumi dhe vendimmarrja thuhet: “Kryesuesi gjegjësisht zëvendëskryesuesi kur udhëheq mbledhjen e këshillit voton i fundit”, pse duhet të votojë i fundit, ai duhet të votojë në kohën kur votojnë edhe anëtarët e tjerë të këshillit, sepse nuk ka kuptim. Madje kjo nuk shihet askund, kudo që funksionojnë komisionet, bordet, ku do tjetër, votohet në të njëjtën kohë sikur edhe anëtarët e tjerë të këshillit.

Pra, këto janë disa nga vërejtjet tona si grup parlamentar, për të cilat natyrisht që do të bëjmë vërejtje, në qoftë se i njëjti kalon në parim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi i Deputetëve të Pavarur në parim e mbështet projektligjin me vërejtjet të cilat duhet të shqyrtohen në komision.

Megjithatë, te neni 8 po ashtu ne kemi një çështje për ta ngritur, e ndoshta ministri mund të japë edhe sqarimet a arsyet pse qëndrojnë kështu.

Të paktën, sistemin e drejtësisë duhet të mundohemi ta ndërtojmë të atillë që qytetarët të kenë mundësi të gjykohen nga gjykatës profesionistë, pa e marrë parasysh se cila është prejardhja e tyre etnike apo gjuhësore.

Ne e përkrahim atë që thuhet në nenin 8, pikën 2 që Këshilli Gjyqësor megjithatë të ketë një përfaqësim dhe të përfaqësojë natyrën shumetnike të Kosovës, por mënyra e zgjedhjes siç është përcaktuar me pikën 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni duket që thellon apo e vë theksin te natyra etnike, e jo te përgatitja profesionale e gjykatësve.

Pse unë si deputete e shumicës nuk mund ta kem mundësinë ta votoj një gjykatës ose një përfaqësues në Këshillin Gjyqësor, i cili vjen nga një grup tjetër etnik, sepse këtë në bazë të pikës 1.2, të nenit edhe 1.3, në fakt 1.3 dhe 1.4 nuk ma mundëson.

Më lejoni t'i lexoj, prapë po them, ministër, ndoshta ju mund të na jepni edhe sqarime. Thotë: “Dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë dhe të paktën njëri prej tyre të dyve duhet të jetë gjyqtar”.

E njëjta është edhe tek pika 1.4 ku thotë: “Dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera dhe të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtar”.

Pra, pse përzgjedhja, jo vetëm ata që zgjidhen, por ata që i zgjidhin, këtë rast deputetët, përcaktues duhet të jetë baza etnike.

Njëjtë është te neni 2.2, ku i zgjedhin të gjithë deputetët.

Unë mendoj që ne duhet të krijojmë një sistem gjyqësor, siç e thashë, që kriter të jetë përgatitja profesionale dhe kriteret e tjera siç janë të përcaktuara më lart për të qenë gjykatës.

Por nëse duam të ndërtojmë një Republikë të qytetarëve të Kosovës, sa më shumë që është e mundur duhet të heqim dorë nga përfaqësitë, siç është ato etnike, e ngjyrës apo kështu me radhë dhe të ndërtojmë një sistem të kriterëve profesionale dhe të integritetit siç kërkohet në pozita të tilla. Por sa më shumë që të vëmë theksin te kriteri etnik, ne vetëm po krijojmë ndarje, e jo integrim, siç edhe jemi përcaktuar me Kushtetutë, siç edhe na kërkohet nga shumë organizma ndërkombëtarë.

Kështu që unë besoj se gjatë leximit të dytë, gjegjësisht gjatë shqyrtimit në komisione kjo çështje të zgjidhet dhe të vëmë në rend të parë kriteret profesionale, ashtu siç janë të përcaktuara, ta zëmë, me shtatë pozita të tjera, ku kriter janë përfaqësimi i nivelit të gjykatave, e jo ai etnik apo gjuhësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Duke dashur të ndërlidhem me kryetaren e komisionit, që me një ton çoroditës, se nuk po dua t'i them diçka tjetër, iu drejtua deputetit Kuçi, meqë nuk ishte i pranishëm.

Është faktike se në Komisionin për Legjislacion të gjitha bisedat dhe takimet, por edhe vendimet dhe rekomandimet kur po vijnë në Kuvend po interpretohen 2-3 herë çka kemi folur në komision. Kjo do të thotë është edhe ajo dëshmia se në komision po heqim keq nganjëherë për të marrë veprime e rekomandime ndoshta për shkak të kryeneçësisë të deputetëve pozitivë - opozitë.

Forma që drejtohet se “askush nuk do të mund të luajë me Komisionin për Legjislacion sa të jetë Lëvizja Vetëvendosja aty”, nuk shkon. Komisioni është i Kuvendit, nuk është i asnjë partie politike dhe se në atë komision, nëse nuk ka konsensus pozitiv, se ne jemi të thirrur të punojmë aty për interesa të vendit, jo të ndonjë subjekti politik, mendoj se i kemi tejkalluar autorizimet tona, sepse ne edhe po të duam të shkatërrojmë gjithçka aty, i kemi votat për të kaluar gjithçka çka duam. Mirëpo konsensusi dhe profesionalizmit brenda komisionit duhet të na prijnë e t'u drejtohem sa më mirë ligjeve, edhe ky projektligj që e kemi para vete të jenë më të mira për qytetarin dhe për vetë kontributin që duam të japim si Kuvend në fushën e drejtësisë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në shqyrtim të parë Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. I jam mirënjohës ministrit, po edhe vetë anëtarëve të Këshillit Gjyqësor që ne si komision bashkëpunojmë ngushtë me ta, kanë qenë edhe i janë përgjigjur sa herë i ka thirrur kryetarja e komisionit dhe kanë qenë të pranishëm me neve që ky ligj ta marrë formën e vet dhe të ecë përpara.

Kontributin do ta japim ndërmjet dy leximeve, besoj se edhe komisioni, po edhe subjektet politike në të ardhmen do të punojnë në amendamentimin e tij, të vijë në lexim të dytë dhe të kalojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Edhe Nisma e mbështet projektligjin, për të cilin tani jemi duke debatuar.

Mes dy leximeve do të japim pikëpamjet tona, nëse kemi diçka ndryshe nga ministri apo ministria.

Mirëpo, atë që e kam thënë në komision, desha të përsëris edhe këtu në seancë.

Shpeshherë ligjet na vijnë në përmbajtje sipas programit dhe bindjeve të mazhorancës, Qeverisë, sepse në Komision nuk mund të kundërshtoj në parim një ligj nëse ministrat e mi e kanë votuar në Qeveri. Pra, ligjet zakonisht në Kuvend, në komision vijnë nga Qeveria, sponsorizuar nga mazhoranca, por kjo nuk vlen për deputetët e opozitës, ata natyrisht që kanë të drejtën e tyre të kundërshtojnë edhe qasjen, edhe mënyrën, edhe pikëpamjen që e mbron mazhoranca. Ajo që shpeshherë kemi telashe me ligjin është më shumë ajo që, do të thosha, vijnë pak a shumë jo të përkthyer mirë, jo të harmonizuara mirë, por jo me qëllimin, domethënë me qëllim, edhe atje kam qenë dakord, edhe këtu.

Prandaj, i kam thënë ministrit një rast, po e them edhe kësaj radhe tash publikisht në seancë që ka nevojë urgjente atë armatë të administratës që e ka t'ia ngrejë performansën, t'i dërgojë nëpër kurse, ku ta di unë, t'u ndihmojë atyre që të aftësohen që së paku një ligj që e përkthejnë ta sjellin të harmonizuar mirë në komisionin, sepse shpeshherë komisioni duhet të bëjë punën që është dashur ta bëjë administrata atje. Është mirë të shfrytëzohet kjo për të matur performansën e secilit atje. Çka bën ai atje nëse ligji vjen në atë mënyrë qysh nuk duhet të vijë.

Edhe nja 2-3 fjalë rreth pavarësisë së gjyqësorit. Ja në Kosovë ka gjyqësori pavarësi, ja askund në rajon, nuk di, nuk marr përgjegjësi të flas se si është në shumë vende. Po atë pavarësi nga zinxhirët, nga ato zinxhirë që i ka në kokë, s'mund t'i bëjmë ne.

Në Kroaci ne ishim në një vizitë, ku aty mësuam se ende kryeprokurorin e shtetit e zgjidhte Parlamenti, në Kosovë është harruar ajo kohë kur janë zgjedhur gjykatësit dhe kryeprokurori apo prokurorët nga Parlamenti.

Pra, unë nuk di a ka ndërhyrje më të madhe nga politika në gjyqësor kur kryeprokurori, zgjedhja e tij varet nga vota e deputetëve. Pra, unë nuk di çka bëhet prapa perdeve derisa një kryeprokuror vjen aty.

Nëse e marrim në aspektin përmbajtjesor, formal, ligjor, si prokuroria, si gjyqësori në përgjithësi kanë pavarësi të jashtëzakonshme ligjore. Askush nuk mund, në asnjë moment t'u ndërhyjë në punët e tyre. Nëse ata dëshirojnë vetë të lejojnë jo me ligj, po pa ligj të ndërhyjë dikush, është diçka tjetër.

Prandaj, mendoj që janë disa çështje për të cilat nëse politika vazhdimisht anatemohet, vazhdimisht sulmohet se e ka kapur gjyqësorin, atëherë le të thuhet hapur që kjo nuk ndodh përmes ligjeve, kjo nuk ndodh përmes aspektit formal juridik, kjo ndodh përmes ndejave private, ndejat private mua s'më obligojnë të kontrolloj askënd çka bën a nuk bën.

Le t'i këpusin, le të çlirohen ata nga zinxhirët e mentalitetit, po i referohem tash kolegut Milaim Zeka, të sistemeve të kaluara, kur edhe pa e thirrur fare politikanin, ata kanë dëshirë, ministri, ku ta di unë, shpeshherë kanë dëshirë të dinë mendimin e tyre për një çështje.

Domethënë kjo ka të bëjë më shumë me mentalitet, me mendësi, se sa me detyrim ligjor që ata të japin raport dhe të marrin këshilla apo sugjerime nga politika.

Ne jemi në rrugë të drejtë sa i përket formalizimit, sa i përket rregullimit formal të pavarësisë së gjyqësorit në përgjegjësi, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial dhe të gjitha segmenteve të tjera, por njerëzit aty nuk mund asnjëherë t'i instruktojmë se si duhet të sillen. Nëse ai e shfrytëzon atë pavarësi, e shfrytëzon, nëse nuk e shfrytëzon, nuk ka ligj në botë që mund ta detyrojë atë ta shfrytëzojë atë të drejtë.

Prandaj, janë ato matjet e performansave, përmes të cilave Këshilli Gjyqësor e mat performansën e gjykatësve, Këshilli Prokurorial të prokurorëve, e kështu me radhë.

Mendoj që duke u vetëfajësuar më shumë se sa kemi përgjegjësi, marrim një barrë të cilën realisht nuk e kemi. Mund të ketë individ të caktuar, qoftë në Parlament, qoftë në Qeveri, qoftë nëpër institucione të tjera, por politika në përgjegjësi nuk ka instrumente në dorë, përmes të cilave e dirigjon, e kontrollon gjyqësorin, këtë duhet ta themi me zë të lartë, sepse përmes këtyre matemi edhe sa i përket liberalizimit të vizave, edhe sa i përket rrugës tonë integruese në integrimet euro-atlantike.

Nuk është mirë që ne të themi se gjyqësori nuk është i pavarur, është i kapur, në ato përmasa, e pastaj të tjerët na thonë se ju vetë po thoni që është i kapur, "pra shkoni, çkapene, pastaj ejani".

Ta përmbyll këtë, unë nuk mendoj që tërë klasa politike duhet të fajësohet për shkak që një, dy apo tre politikanë të fuqishëm mund të ndërhyjnë në punët e sistemit të drejtësisë, qoftë te ndonjë prokuror, qoftë te ndonjë gjykatës, pastaj për të përgjithësuar se krejt sistemi i drejtësi na qenka i kapur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Unë parimisht po e mbështes fjalën e zotit Sherifi sa i përket përgatitjes dhe hartimit të teksteve të projektligjeve, përkthimit, përshtatjes gjuhësore dhe rregullimit gjuhësor.

Vërtet ne kemi probleme të natyrave që ndoshta edhe nuk janë të shqyrtimit ligjor, por edhe të shqyrtimit gjuhësor.

Megjithatë ka shumë shpesh koncepte që përdoren gabimisht ose janë përkthyer gabimisht, edhe ato e ndryshojnë përmbajtjen dhe thelbin e tekstit, e teksti shndërrohet në normë, e ajo normë duhet të zbatohet. Ky është problemi.

Një çështje tjetër, unë për herë të parë në këtë Parlament po dëgjoj, kjo më erdhi çudi, e dëgjova prej zotit Kuçi, se bëhen shumë amendamente që nuk bëhen në komision, se bëhen pasandaj dhe se këtu po punohet e dikush po do të tregojë që po punon.

Megjithatë, po i them zotit Kuçi dhe të gjithëve, ne i kemi dy role këtu: një të punojmë, t'i përcjellim seancat dhe t'i shqyrtojmë temat, dhe dy, të merremi me politikë. Punë të tjera nuk kemi, nëse mua më thotë dikush t'i po merresh me politikë, atëherë ai merret me diçka tjetër, biznes a diçka tjetër. Unë merrem vetëm me politikë dhe në kuadër të një komisioni merrem me shqyrtimin e ligjeve. Unë do të bëj amendamente aq sa ka nevojë një ligj ose mua ma merr mendja dhe do ta ngre gishtin ashtu.

Unë e them që nuk asnjë tekst që nuk e përpunojmë, e nëse dikujt ajo i duket e tepërt, le të thotë 's'dua të punoj unë'.

Mirëpo vërejtje të tilla që nuk kanë të bëjnë me thelbin e punës të një deputeti mua më duken jashtëzakonisht të tepërta dhe të rrezikshme.

Po dal te ligji. Ne e kemi shqyrtuar shumë herë edhe në Lëvizjen Vetëvendosje, unë po dal konkretisht te neni 3, pika 1.4, ne parimisht kemi thanë se e përkrahim këtë.

Po pika 1.4 thotë: 'siguron që gjykatat të ndjekin parimet' dhe tani dalim te thelbi. A është përkthim i keq apo nuk di çka është, për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore. Jo, bre, këto nuk janë parime. Parimet e gjyqësorit gjatë marrjes së vendimeve janë: proporcionaliteti dhe mosdiskriminimi, këto janë dy kategori kushtetuese që duhet të respektohen gjithmonë, po parimet themelore të marrjes së vendimeve janë të mos diskriminohen njerëzit dhe çdo vendim që merret të jetë proporcional me ligjin dhe me veprën e kryer, kjo është çështja.

Kur them te çështjet e rregullimit të gjuhës, t'i marrin këto konkretisht.

Ne e kemi përdorimin e fjalës, konceptit 'aftësi' te neni 20, pikat 2.3, 4,5,6 dhe te neni 28 prej pikës 1.1 deri në pikën 1.6. Megjithatë fjala 'aftësi' është një koncept që nuk kuantifikohet, kush i mat aftësitë e dikujt tjetër, këtu është fjala për përgatitjen profesionale.

Përgatitja profesionale kuantifikohet në forma të ndryshme përmes diplomave, përmes kurseve, përmes përvojës, po jo aftësia, sepse aftësinë qysh e mat, kush e mat, kush thotë ky është më i aftë, ai tjetri është pak më i aftë, atë e cakton dikush tjetër.

Kjo është ajo që sigurisht e ka pasur në mend edhe zoti Sherifi, edhe unë mendoj se duhet të kemi kujdes.

Te neni 9, unë po dal një nga një dhe po i shqyrtoj çështjet.

Neni 9, pika 1.5 thotë: "Themelatat", edhe ky është një përkthim i keq, janë organet administrative, "themelatat e themeluara nga Kushtetuta". Këto janë institucionet, nuk ka asgjë tjetër. Këto janë ato vërejtjet që duhet të ndryshojnë në kuptimin e normës vetëm pse janë përkthyer gabimisht, ose dikujt s'i ka rënë ndërmend. Nuk ka diçka tjetër këtu dhe nuk duhet të ndihemi keq nëse i bëjmë këto.

Ne e kemi edhe nenin 10, paragrafi 7, thotë: "lista për mbledhjen e Kuvendit". Çka domethënë kjo? Për seancën e Kuvendit, apo për cilën mbledhje të Kuvendit, këto duhet të sqarohen. Tash ne mund ta shohim edhe përkthimin anglisht, edhe në gjuhën serbe, mirëpo ne po nisemi nga gjuha shqipe. Tash le të na tregojnë saktësisht nga vjen përkthimi, nuk e kemi asnjë problem. Unë e dëgjova edhe zotin ministër që tha "ne i marrim legjislacionet ndërkombëtare". Mirë zoti ministër, është shumë e mirë dhe ne e dimë cilat janë, vetëm bëhuni transparent, tregojuni deputetëve cilat ligje, cilat norma ndërkombëtare, ose të vendeve perëndimore që janë të mira i merrni ju, që ne t'i krahasojmë. S'ka kurrjë të keqe aty.

Por mos i mbani misterioze "ne i marrim ato", sepse ka raste kur ne i dimë se cilat i keni marrë, ose nuk i keni zbatuar. Prandaj, kjo është mirë për deputetët, sepse deputetët mandej e kanë të qartë për çka është fjala. Ne i kemi edhe format tjera, çështjet tjera, po dal te neni 21. Te neni 20 në të vërtetë, pika 1.7. thotë "për sjelljet jashtë zyrës". Kjo ka të bëjë edhe me përkthimin e njëjtë ose me tekstin e njëjtë me Ligjin për Këshillin Prokurorial. Në të vërtetë, i njëjti tekst veç është bartur në të dy ligjet. Çka domethënë "sjellje jashtë zyrës"? Kush e mat? Si e mat? Domethënë, këto janë disa gjëra që janë problematike. Te neni 21 i kemi paragrafët 1 dhe 3, që janë relativisht problematikë. Paragrafi 1 ka të bëjë me një lloj vetingu, kurse te paragrafi 3 kemi diçka të paqartë që duhet të rregullohet. Thotë "ndalohet kryerja e kontrolleve të tjera nga çdo shërbim sigurie, përpos kontrollit të kërkuar nga Këshilli, sipas paragrafit 1 të këtij neni". Kurse, këtu, në paragrafin 1 thotë "diskualifikimin e kandidatit nga Policia". E arsyetoi pak më parë

ministri te Ligji për Këshillin Prokurorial, mirëpo shprehja “mund ta diskualifikojnë kandidatin nga Policia” është e rëndë, e rrezikshme dhe e pasqaruar.

Bëni përpjekje ta sqaroni në aspektin gjuhësor dhe kjo mund të jetë. Policia mund të dërgojë të dhëna në vendet ku institucionet kompetente atë e bëjnë, por nëse e leni drejtpërdrejt dijeni se e keni bërë një punë të keqe në vend të punës të mirë. Ne kemi edhe te neni 32, paragrafi 2, ku përdoret shprehja, në vend “sjellje të kundërligjshme” përdoret “sjellje kriminale”. Edhe këtë ne e përdorim nganjëherë, ndoshta edhe më shpesh, mirëpo në ligj kjo t’i mvishet një gjykatësi ose prokurori është pak problematike, sepse edhe sjellja kriminale hyn në kuadrin e veprave të kundërligjshme, penale, të rënda, ose të lehta, sidoqofshin. Te neni 33 e kemi një çështje në paragrafin 2, që është e paqartë, thuhet “kryetarët e gjykatave themelore dhe një gjyqtar mbikëqyrës nga secila gjykatë themelore”. Nuk është e qartë, a vjen nga një gjykatës mbikëqyrës, apo vijnë të gjithë gjykatësit mbikëqyrës nga të gjitha gjykatat themelore, por mirë është të sqarohet. Këtë mundësi ta sqaroni, është punë e lehtë.

Edhe, në fund, në nenin 34, pika 1.2., në fund kemi të bëjmë me Sekretariatit e Këshillit, fjalia e fundit është: “Propozimet dhe iniciativat e Sekretariatit, pas miratimit nga Këshilli, përgatiten dhe i dërgohen Këshillit për miratim”. Kjo është tautologji që s’ka kuptim. Dy herë, “pas miratimit nga Këshilli përgatiten dhe i dërgohen Këshillit për miratim”. Hiqeni këtë tautologji gjuhësore që është tautologji nga përkthimi dhe vijnë gjërat në vend. Këto janë ato vërejtjet që ne duhet t’i kemi parasysh dhe unë pajtohem me vërejtjen e zotit Sherifi. Ne e kemi shprehur këtë disa herë në komision, qëllimi nuk është për dëmtim, për të votuar kundër, ose kundër pozitës, ose kundër opozitës. Qëllimi është të bëjmë ligje të mira dhe ato t’i përkrahim dhe t’i sjellim këtu që të përkrahen nga të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, replikë! Ia ka përmend emrin. Shiko, mos u ngatërro me Samiun, ju jeni dosta.

BILALL SHERIFI: Jo, për dost nuk e ndërroj hiç, nuk diskutohet.

Zoti kryesues,

Më shumë e mora fjalën jo për ta kundërshtuar Samiun, por e keni bërë si praktikë ta interpretoni Rregulloren veç kur të përmendet emri, tash për shembull u përmend në kontekst pozitiv, s’kishte nevojë fare për replikë, këtë desha ta them.

Por, në komision e kam thënë disa herë, ministrit po ia përsëris edhe një herë. Shpeshherë grupet punuese që krijohen pas leximit, pasi na vjen, krijohet përshtypja që ata detyrohen të shndërrohen jo në grupe punuese, por në grupe hartuese të ligjit, aq shumë punë u del, për shkak të shumë mangësive, defekteve që kanë projektligjet kur vijnë. Kjo nuk ka të bëjë me idenë e ligjit. Ideja e ligjit është e mirë, por kur vijmë deri te detajimi, specifikimi, aty haset në probleme. Dhe, prandaj ta thashë dhe po ta përsëris edhe një herë, merrni masat ju lutem që ata

që merren me këtë punë, le të merren përnjëmend. Jo veç shkel e shko, hidhe se pastaj atje deputetët s'kanë tjetër punë edhe e rihartojnë ligjin. Praktikisht shpeshherë ligjet rihartohen në komisione, prandaj po them merreni këtë si këshillë, jo si kritikë, jo si qortim. Thjesht, si një këshillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Përkundër ndryshimeve që janë bërë në shkurt 2016, pra me amendamentimin e neni 108 të Kushtetutës, sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe Komisionit Evropian, kur Kuvendi e pati miratuar një ndryshim pozitiv kushtetues për përbërjen e Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kur shumica e anëtarëve të tij tani zgjidhen nga anëtarët e Gjyqësorit, ky amendament ka pasur qëllim ta forcojë pavarësinë e Gjyqësorit nga ndikimet politike, i cili edhe ka qenë hap i mirëpritur.

Mirëpo, pavarësisht kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vazhdon të mbetet i rrezikuar nga pazaret politike dhe në këtë mënyrë është vështirë që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të veprojë në mënyrë të pavarur, të bëjë emërimin e anëtarëve dhe gjyqtarëve bazuar në kritere të qarta dhe profesionale. Sipas organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Raportin e Progresit, janë evidentuar ndërhyrjet politike, e sidomos ndërhyrjet e partive politike, të cilat i negociojnë në mënyrë të fshehtë propozimet e kandidatëve, të cilët pas emërimit do të jenë më të vëmendshëm ndaj interesave të një partie të caktuar politike.

Prandaj, për këtë arsye, për të bërë pushtetin gjyqësor, kushtetutshmërisht dhe ligjërisht të pavarur, konsideroj se është e domosdoshme të bëhet plotësim-ndryshimi i nenit 108 të Kushtetutës, ndonëse kërkon amendamente kushtetuese, mirëpo është e rëndësishme për shkak se do ta bëjë Këshillin Gjyqësor të Kosovës më të pavarur. Këshilli Gjyqësor tashmë, siç është përcaktuar me nenin 108 të Kushtetutës, përbëhet nga 13 anëtarë. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjidhen në këtë mënyrë: Pra, shtatë anëtarët do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e Gjyqësorit, dy gjyqtarë të Gjykatës Supreme, dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, tre gjyqtarë të gjykatave themelore, ndërsa dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtar. Kështu vazhdojmë me katër anëtarët tjerë, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara apo të garantuara të komunitetit serb, dhe dy anëtarë tjerë, të cilët janë për vendet e rezervuara të komuniteteve tjera.

Pra, kjo ishte ashtu siç është. Propozimi është që Këshilli Gjyqësor të vazhdojë t'i ketë 13 anëtarë dhe anëtarët të kenë mandat 5-vjeçar, por të zgjidhen në këtë mënyrë - nëntë anëtarë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e Gjyqësorit, si në vijim: dy gjyqtarë të Gjykatës Supreme,

dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, tre gjyqtarë të gjykatave themelore dhe, përveç kësaj, në përbërje të Këshillit Gjyqësor duhet të ketë edhe profesorë të së drejtës dhe anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile, prandaj propozimi është që dy anëtarët e tjerë, një të vijë nga universiteti, pra profesor i drejtësisë, dhe një anëtar nga shoqëria civile. Dhe, me ndryshimet i bie që prej gjashtë anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, të zgjidhen vetëm katër anëtarë, dy nga deputetët shumicë, një anëtar nga deputetët, të cilët mbajnë vendet e rezervuara dhe një anëtar e zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera. Pra, ky ishte propozimi i parë.

Propozimi i dytë është për nenin 25, i cili flet për riemërimin e gjyqtarëve. Unë propozoj që të mos aplikohet më riemërimi i gjyqtarëve, siç e kemi pas tre vjetëve për shkak se gjyqtarët, të cilët emërohen për tre vjet dhe pastaj riemërohen kanë mundësi që të bien pre e ndikimeve politike, në mënyrë që të riemërohen prapë në pozitën e kërkuar. Dhe, kjo do të zgjidhë nëse gjyqtarët emërohen me mandat të përhershëm, bazuar në propozimet e Këshillit. Pra, kjo duhet të bëhet, sepse riemërimi pas tre vjetëve ndikon negativisht në pavarësimin e Gjyqësorit. Sipas praktikës evropiane, në përgjithësi, emërimet bëhen me mandat të përhershëm, sepse periodat provuese për gjyqtarët në detyrë janë problematike nga këndvështrimi i pavarësisë së Gjyqësorit. Dhe, kjo është në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë dhe Komisionit të Venecias. Komisioni i Venecias konsideron se vendosja e periudhave provuese mund ta minojë pavarësinë e gjyqtarëve, pasi ata mund të ndjehen nën presion kur të vendosin për raste të caktuara.

Po ashtu, për shkak se ne nesër do ta marrim Raportin e Progresit dhe nuk e dimë se çfarë do të ketë brenda tij, pra i cili e përcakton rrjedhimisht fatin e Kosovës në integrimet evropiane dhe, po ashtu, edhe do të kenë ndikim në liberalizimin e vizave, do t'i përmend disa prej vërejtjeve, të cilat janë dhënë nga Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian 2016, në mënyrë që çfarëdo ndryshime-plotësime që bëhen në këtë ligj t'i kenë parasysh këto vërejtje. Pra, Raporti i Progresit 2016 ka raportuar që sikur edhe Këshilli Prokurorial, edhe Këshilli Gjyqësor kanë miratuar dokumente strategjike, rregullore, vendime, mirëpo të gjitha këto janë bërë me një vonesë të konsiderueshme, pra që kanë pasur ndikim negativ në funksionimin e Gjyqësorit të Kosovës. Po ashtu, Raporti i Progresit 2016 ka theksuar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për të hartuar rregullore dhe për t'i marrë vendimet në përputhje me hierarkinë e akteve normative, si dhe për ta monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre.

Një tjetër kritikë apo vërejtje që ka dalë nga Raporti i Progresit 2016 thekson se Administrata e Drejtësisë është e ngadalshme dhe joefikase, dhe nuk ka llogaridhënie të mjaftueshme nga zyrtarët gjyqësorë, e kjo është si pasojë e mungesës së vullnetit të sistemit gjyqësor për të qenë transparentë dhe llogaridhënës para publikut. Po ashtu, janë ngritur çështjet si mungesa e fondeve dhe mungesa e mjaftueshme e burimeve njerëzore dhe, mbi të gjitha, është përmendur influenza politike. Pra, të gjitha këto vërejtje duhet të trajtohen me kujdesin më të madh që në

ligjin të cilin do ta votojmë në të ardhmen për Këshillin Gjyqësor të Kosovës të përcaktohen qartë dispozitat, të cilat sigurojnë ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe të përcaktohet mekanizmi efikas për kontroll dhe mbrojtjen nga ndikimet politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjala e fundit është e ministrit Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

E nderuara deputete Pacolli,

Nuk e di a je e vetëdijshme, mirëpo ti sapo bërë propozime për ta ndryshuar Kushtetutën. Kjo është kategori kushtetuese dhe përzgjedhjen e këtyre anëtarëve e përcakton Kushtetuta dhe ajo që është në ligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kur flisje ti, deputeti afër teje qeshte sepse e dinte që është kategori kushtetuese dhe s'mund të ndryshohet, por ne jse s'është me rëndësi. Kjo njëkohësisht është edhe përgjigje për zonjën Pantina sesi zgjidhen anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Është neni 108 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pika e gjashtë, që e përcakton zgjedhjen e secilit anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Kur flasim për bashkëpunimin me BE-në, pa dyshim që gjithmonë kur flas në bashkëpunim nuk u referohem vendeve të ndryshme anëtare, qoftë Bullgarisë, Spanjës, apo Gjermanisë, mirëpo gjithmonë i referohen Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe bashkëpunëtorëve që i kemi, pra ekspertëve në Zyrën e BE-së në Republikën e Kosovës.

U mundova ta bëj njëfarë gjithëpërfshirje, sepse edhe ministrja Albena po më bën presion të mos e zgjas se e ka projektligjin në rend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren e Planifikimit Hapësinor, zonjën Albena Reshitaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për veprimtarinë hidrometeorologjike.

Hartimi i Projektligjit për veprimtari hidrometeorologjike është parë si i nevojshëm, pasi gjatë implementimit të ligjit ekzistues nr. 02/L-079 për veprimtari hidrometeorologjike është vërejtur se ekzistojnë mangësi në definimin dhe harmonizimin e veprimtarisë hidrometeorologjike konform politikave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Meteorologjisë dhe legjislacionit vendor.

Ky projektligj i referohet veprimtarisë hidrometeorologjike, aktivitetet e së cilës janë me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës sa i përket mbrojtjes së mjedisit, jetës dhe pasurisë së njeriut nga pasojat e fatkeqësive dhe katastrofave natyrore me origjinë nga dukuritë meteorologjike dhe hidrologjike, si dhe në përdorimin racional të resurseve ujore, kushteve të motit dhe klimës, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj e përcakton qartë institucionin përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e veprimtarisë hidrometeorologjike në Kosovë; i përcakton detyrat dhe obligimet e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, që është përgjegjës për kryerjen e veprimtarisë hidrometeorologjike; e rregullon mënyrën e kryerjes së veprimtarive hidrometeorologjike, sistemin e paralajmërimit të hershëm, ekspertizën, produktet dhe shërbimet që ofrohen nga këto veprimtari për të mbështetur me informacione institucionet qendrore, ato lokale dhe publikun, si dhe institucionet rajonale, e në përgjithësi ato ndërkombëtare; mënyrën e informimit dhe raportimit për të dhënat hidrometeorologjike të cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut.

E rregullon përmbushjen e obligimeve ligjore për monitorimin e ajrit, ujit dhe cilësisë së dheut. E rregullon harmonizimin e Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike me legjislacionin e vendit, rregulloret e Organizatës Botërore të Meteorologjisë, si dhe standardet e Bashkimit Evropian. Me aprovimin e këtij projektligji do të krijohen mekanizma dhe instrumente që do të kontribuojnë në administrimin dhe menaxhimin më të mirë të veprimtarive hidrometeorologjike, siç janë avancimi i sistemit të monitorimit dhe parashikimit të dukurive dhe elementeve hidrometeorologjike në sistemin e paralajmërimit të hershëm dhe në zbatimin e standardeve operative në shkëmbimin e informacioneve hidrometeorologjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet të cilave do të kontribuojë edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut.

Andaj, të nderuar deputetë ju bëj thirrje që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Daut Haradinaj, a është këtu? Zonja Besa Gaxherri atëherë, në emër të komisionit, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Ligjin për meteorologjinë dhe në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, pra para shqyrtimit të parë të projektligjit, në mbledhjet plenare, e shqyrtoi projektligjin në parim më 9 mars 2018, dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandimin që ligji në fjalë të miratohet në parim.

Zoti kryesues, mund ta marr fjalën edhe në emër të grupit parlamentar pasi edhe ashtu qenkemi në rend ne?

Njëkohësisht, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për veprimtaritë hidrometeorologjike dhe vlen për të thënë se ky ligj ka për qëllim ta përcaktojë mënyrën e kryerjes së veprimtarive hidrometeorologjike, sistemin e paralajmërimit të hershëm, ekspertizën, produktet dhe shërbimet që ofrohen nga këto veprimtari për t'i mbështetur me informacione institucionet qendrore, lokale dhe publikun, si dhe institucionet ndërkombëtare e rajonale. Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet në parim këtë ligj, por po e përsëris dhe një herë që për shkak të bojkotit, mospjesëmarrjes në votim për komisionin hetimor në këtë seancë, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk do të marrë pjesë në asnjë pikë të rendit dhe votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Gaxherri! Radha është e përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Edhe Partia Demokratike e Kosovës, ose më konkretisht Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për veprimtaritë hidrometeorologjike dhe i jep mbështetje këtij ligji.

Edhe ne si grupet tjera parlamentare për shkak të bojkotit nuk do të marrim pjesë në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Arbërie Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar Projektligjin për veprimtarinë hidrometeorologjike. Komentet do t'i paraqesim ndërmjet dy leximeve dhe në këtë fazë e përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu, në emër të Grupit të Deputetëve të Pavarur, e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Edhe Grupi i Deputetëve të Pavarur e ka shqyrtuar këtë projektligj. Pasi është leximi i parë, ne këtu i kemi edhe disa të themi vërejtje, të cilat është me interes ndoshta t'i theksojmë, mbasi është ministrja këtu.

Është fjala që në nenin 6, pika 1.8., ku është e paraparë domethënë mbrojtja nga breshri, gjithashtu në lidhje me mbrojtje nga breshri merret edhe neni 22, parandalimi i breshrit, mirëpo këtu figuron në ligj, ndërkaq në Kosovë nuk kemi asnjë sistem të mbrojtjes nga breshri. Nuk di si rregullohet kjo çështje, por mendoj se sidomos zhvillimi i bujqësisë në rajonet kryesisht bujqësore është shumë e domosdoshme që të kemi sisteme mbrojtëse kundër breshrit. Ligji e parasheh, por nuk ekzistojnë pajisje dhe sisteme.

Mendoj se duhet gjetur një mënyrë se si të funksionalizohet kjo. Disa vende tjera të rajonit e kishin të organizuar në formë të agjencisë së veçantë, Agjenci Kundër Mbrojtjes nga Breshri, dhe mendoj se edhe Kosova duhet ta themelojë një agjenci të tillë, sepse dëmet që mund të shkaktohet nga breshri në rajonet me bujqësi intensive mund të jenë shumë të mëdha. Gjithashtu, është me rëndësi sa i përket nenit 25, te transparenca e të dhënave. E di që shumica e njerëzve, të cilët kanë nevojë për të dhënat hidrometeorologjike, zakonisht duhet t'i paguajnë këto shërbime nga Instituti Hidrometeorologjik, mirëpo unë kërkoj që nga këto tarifa të lirohen sidomos universitetet, apo më mirë të themi studentët, të cilët kryejnë punime apo hulumtime në temat e tyre bachelor apo master, në mënyrë që të mos u bëhemi atyre ngarkesë, sepse shumica e hulumtimeve apo punimeve shkencore që bëhen në bujqësi varen nga kushtet klimatike dhe pa të dhëna të motit, të klimës, domethënë të temperaturës dhe reshjeve, nuk mund të bëhet një punim në bujqësi dhe një qoftë se një student ngarkohet për t'i marrë këto të dhëna, mendoj se është një ngarkesë tepër e madhe për studentin kosovar.

Sa u përket disa gabimeve drejtshkrimore apo shtypi, unë po i theksoj vetëm në pika të shkurtra, mbase do të kemi rast sigurisht edhe në komision, por po e përmendi se te neni 3, te përkufizimet, pika 1.22., në rreshtin 15 është përdorur fjala "aerodrom", po shihet që është nga përkthimi, sigurisht e kanë marrë nga fqinjët, duhet të zëvendësohet me fjalën "aeroport".

Neni 8 gjithashtu ka probleme në pikën numër 1, rreshti numër 9. Neni 15, rreshti numër 2. Neni 19, neni 33 dhe neni 35 kanë gabime gjuhësore. Unë me qëllim i theksova, nuk shkova në detaje, por që dikush që i dëgjon mendoj që duhet të ndërtojë në këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën, në emër të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për veprimtarinë hidrometeorologjike. Ne do ta përkrahim, do ta votojmë ndërsa të gjithë kontributin do ta japim në komisionin parlamentar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi, në emër të Nismës, e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Po, edhe Nisma Socialdemokrate e Kosovës e mbështet Projektligjin të cilin e debatuar deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: A jeni regjistruar si socialdemokratë atje në Këshillin Qendror të Zgjedhjeve. Lutë, a ke bërë kërkesën për diskutim? Zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuar ministre,

Dy-tri fjalë për ligjin, së pari ekzistojnë dy çështje që krijojnë një konflikt ndërmjet ligjeve tjera. Është çështja e testimi dhe kalibrimit të instrumenteve matëse. Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për metrologjinë dhe i vetmi institucion i autorizuar për testim dhe kalibrim që mund t'i autorizojë laboratorët tjerë është Agjencia e Metrologjisë dhe me këtë ligj nuk mund t'i jepet një e drejtë apriori që është e rregulluar me një ligj tjetër.

E njëjta çështje ka të bëjë edhe me akreditimin. Në ligj thuhet që laboratorët do të akreditohen nga një trup kredibil e tjera, por duhet të jetë e qartë që kjo duhet të bëhet nga Drejtorja e Akreditimit, e cila është po ashtu në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Një çështje tjetër ka të bëjë me autorizimet që jep ministrja dhe ankesat në lidhje me ato autorizime. Në projektligj është e paraparë që ministrja ta formojë komisionin dhe prapë në ankesë, prapë ministrja ta formojë komisionin. Unë besoj që kjo çështje nuk funksionon si duhet. Do të ishte dashur, po flas së paku sipas praktikave që unë kam përdorur, në shkallën e parë sekretari në bashkëpunim me ministren ta formojë komisionin, e nëse ka ankesa, atëherë ministrja formon komisionin. Plus në projektligj askund nuk ceket e drejta e atij që i refuzohet autorizimi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Supreme.

Një çështje tjetër që ka të bëjë është obligimi i të gjithë qytetarëve që kanë prona të tyre që t'ua mundësojnë kalimin apo përdorimin e atyre pronave për kryerjen e veprimtarive meteorologjike dhe hidrologjike, por në realitet askund nuk përmendet kompensimi i dëmit. Një pronë nuk mund ta shfrytëzojë askush përderisa nuk kompensohet dëmi eventual që mund të kryhet.

Një çështje prapë tjetër ka të bëjë me programin e zhvillimit të veprimtarive kërkimore. E kam parë që ju e keni paraparë që kjo të shkojë në Qeveri, e unë personalisht besoj se s'ka nevojë ky program të shkojë në Qeveri, por do të ishte dashur që IMHK-ja të jua prezantojë juve si ministre dhe ju ta aprovoni atë program që mos të ngarkohet Qeveria me disa programe, gjë që natyrisht nuk besoj që janë në interesin e gjerë që ta shqyrtojë e gjithë Qeveria.

Dhe, e fundit ka të bëjë me gjobat. Nuk kam parë ligje tjera në praktikën tonë, është rasti i parë që shoh diferencë të madhe të gjobave, 1:20. Po flasim për gjobë që është 500 -10 000 euro, apo është tjetra 30 - 500 euro. Kemi 250 - 5 000 dhe është 50 - 1 000. Domethënë këtu është diferenca 1:20. Më e vogla që çdokush mund ta dyshojë është që çdo inspektor që shkon ka hapësirë shumë të madhe për manipulim në kuadër të kësaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Bilalli ka kërkuar replikë. Zotit Sherifi, fjalën!

BILALL SHERIFI: Po, shoku djathtist i majtë, edhe në KQZ jemi regjistruar si parti socialdemokrate. Faleminderit!

KRYESUESI: Milaim, a deshe edhe ti si i djathtë të lajmërohesh?

MILAIM ZEKA: Kryesues, kemi qenë në KQZ. Na kanë thënë, ditën kur Xhavit Haliti ta lëshojë PDK-në, do të na regjistrojnë si socialdemokratë.

KRYESUESI: Unë s'po replikoj me ty, s'kam hesap.

E kam pasur mundësinë prej fillimit, por s'më është dukur fort... Kush e ka tash fjalën? Ministre, e dëshironi fjalën? Jo.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren Reshitaj, që në mungesë të zotit Haradinaj, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqë është shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me numër 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës, ne e kemi sjellë në Parlament. Meqë ka kaluar në komisionin përkatës, atëherë ju ftoj që ta aprovoni këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! A dëshiron dikush ta marrë fjalën sa i përket ligjit?

Njëherë e ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Nait Hasani, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, ministër!

Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka kërkuar që të kalojë në parim në Kuvend, që atëherë ta plotësojmë me ndryshimet dhe amendamentimin e ligjit. Unë flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ashtu që pajtohemi që do t'i japim plotësim-ndryshimet gjatë punës në komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të PDK-së, Naiti e ka kryer. Në rregull! Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, zoti Ramadani.

VALON RAMADANI: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës, parimisht duhet të ketë një justifikim shumë të fortë që një legjislaturë me propozim të Qeverisë ta lëvizë Agjencinë e Statistikave të Kosovës nga varësia e Kuvendit në vartësinë e një ministrie.

Varësia nga Parlamenti nënkupton kushtin minimal për paanshmërinë dhe rëndësinë e institucionit.

Në lidhje me mandatin trevjeçar të drejtorit të përgjithshëm për këtë pozicion dhe rëndësinë që ka është tepër i shkurtër. Zakonisht, nëpër vende tjera, mandati është pesë vjet, me të drejtë përsëritjeje. Po ashtu ka vende që mandatin e drejtorit të përgjithshëm e kanë shtatë vjet, kjo për të siguruar që ndërrimi i pushteteve nuk do të sillte ndikime në statistikat zyrtare. Varësia e ASK-së nga një ministri do ta zbriste në një nivel më të ulët institucional nga ky që është aktualisht dhe do të sillte vështirësi në garantimin e mbledhjes së të dhënave të nevojshme për të prodhuar statistika dhe në ushtrimin e rolit koordinues të sistemit kombëtar statistikor.

Një pikë tjetër për diskutim për ta garantuar paanshmërinë është roli dhe funksionet e Këshillit të Statistikave. Ato mund të fuqizohen për të garantuar paanshmëri.

Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur diskutime publike lidhur me këtë projektligj një vit më parë dhe nga diskutimet u pa qartë se ka shumë defekte thelbësore në aktivitetin e ASK-së dhe se lidhja me pushtetin nuk ka sjellë gjë tjetër, përpos manipulimin e statistikave zyrtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit ministre që e ke marrë përgjegjësinë që ta prezantosh këtë ligj!

Unë e respektoj vullnetin tuaj, megjithatë ka çështje për të cilat do të duhej që këtu ta jepnin arsyetimin e tyre, ose kryeministri, ose ministri i Administratës Publike, sepse ata janë njohës të fushës.

Me gjithë respektin për ju, pasi ju e keni marrë barrën edhe të flisni në emër të Qeverisë, atëherë unë shpresoj që ju edhe do t'u përgjigjeni disa prej çështjeve që janë ngritur në projektligj. Është një përparësi që tendenca që Agjencia e Statistikave të Kosovës, e që është një agjenci goxha e rëndësishme, të bartet te Ministria e Financave, tashmë është kthyer sërish në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, siç përcaktohet me nenin 5 dhe në këtë e mbështetim.

Megjithatë, në nenin 9 të këtij ligji thuhet kështu: “Qeveria së bashku me ASK-në, do të thotë Agjencinë e Statistikave të Kosovës, nënshkruajnë marrëveshje mirëbesimi në të cilën dakordohen për zbatimin e kodit të praktikave evropiane për statistikave zyrtare”.

Tani, Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron në kuadër të Qeverisë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Pse një agjenci, pse një institucion i cili është në vartësi të Qeverisë, duhet të nënshkruajë marrëveshje mirëbesimi? Kjo është një praktikë, e cila ka ndodhur edhe më herët, kur dy organizma, në këtë rast siç është agjencia që edhe më keq, është në varësi të Qeverisë, nënshkruan marrëveshje mirëbesimi. Këtu nuk ka nevojë për marrëveshje, sepse ligji e detyron ta zbatojë në këtë rast edhe Kodin e Mirësjelljes. Pra, një praktikë e tillë nuk është fare ligjore dhe duhet të hiqet bile edhe nga ligjet tjera, e lëre më në këtë ligj.

Dhe, një çështje tjetër, e për deputetët të cilët ndoshta nuk janë as pjesë e komisionit, besoj se kjo është edhe me rëndësi të shpjegohet se çka keni dashur të thoni me nenin 12, i cili thotë kështu: “Paragrafi 3 i nenit 12 të ligjit bazik fshihet në tërësi”. Ky nen si i tillë nuk ka kuptim. Unë e kam shtruar këtë çështje edhe në komision, por edhe këtu në seancë. Ose duhet të silllet bashkë me projektligjin, i cili propozon plotësim-ndryshim edhe të ligjit bazë, që deputetët të dinë se çka po fshihet. Në këtë rast, ju po kërkonit të votojmë diçka për të cilën ne nuk e dimë, sepse nuk po na njoftoni. Çfarë kërkohet të fshihet me këtë projektligj?

Pra, ministri i Drejtësisë shkoi, sepse, me sa di unë, ata do të jenë sponsorizues të Ligjit për akte normative, por Qeveria këtë çështje duhet ta rregullojë. Kur ligjet vijnë në plotësim-ndryshim duhet të japin sqarim, të paktën, se çfarë kërkohet të fshihet, siç është rasti me nenin 12 të këtij projektligji. Përndryshe, pjesa tjetër është kryesisht ndryshime teknike, të cilat kërkojnë që projektligjet, sidomos terminologjia, të harmonizohet me standardet e Eurostat-it dhe në këtë e mbështetim. Kështu që në parim e mbështetim projektligjin, por duhet të ndryshohet formati i projektligjeve kur janë në plotësim-ndryshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë shpresoj që deputetët do ta amandamentojnë dhe do t'i sjellin në terezi edhe këto të meta që po thoni ju. I fundit është zoti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me qëllim të përmbushjes së nevojave me të dhëna statistikore, si dhe për shfrytëzuesit vendorë në Republikën e Kosovës, por edhe për shfrytëzuesit ndërkombëtarë në fushën e statistikave është i nevojshëm krijimi i një sistemi të qëndrueshëm statistikor, institucional dhe profesional.

Pa një qëndrueshmëri institucionale e profesionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sistemi statistikor i Kosovës mund të ballafaqohet me rreziqe dhe probleme të theksuara. Tash Kosova është në procesin e përafrimit me BE-në, me objektiv të qartë për afrimin e plotë me legjislacionin dhe përvojat e BE-së. Në këtë kontekst, harmonizimi i Ligjit për statistikat zyrtare me pjesë të Rregullores së BE-së 223/2009 përbën një objektiv dhe arsyetim të kësaj iniciative të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit aktual për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Elementet kryesore të cilat i karakterizojnë ndryshimet në Ligjin për statistikat zyrtare janë elemente që i funksionalizojnë proceset e brendshme në ASK, duke bërë të mundur rritjen e efikasitetit organizativ dhe funksional në përmbushjen e nevojave të shfrytëzuesve me të dhëna statistikore, të besueshme, të krahasueshme dhe në kohë për vendimmarrësit, respektivisht hartuesit e politikave socio-ekonomike në Republikën e Kosovës.

Elementet e propozuara për ndryshim dhe plotësim po ashtu kanë për qëllim përafrimin me legjislacionin e BE-së në fushën e statistikave, si për shembull:

1. Harmonizimi i parimeve të statistikave zyrtare me ato të Eurostat-it, përkatësisht me kodin e praktikës evropiane;
2. Fuqizimi i pavarësisë institucionale dhe profesionale të bartësve për prodhimin e statistikave zyrtare;

3. Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me institucionet vendore;
4. Përcaktimi i qartë i vijës raportuese institucionale të bartësve të statistikave zyrtare; dhe
5. Fuqizimi i rolit koordinues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në kuadër të sistemit statistikor të Kosovës.

Ndryshimet dhe plotësimet e vendosura në këtë projektligj janë bazuar edhe në dokumentet e rëndësishme që i kanë aprovuar institucionet e Republikës së Kosovës, siç është Marrëveshja për Stabilizim-Asociim dhe plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Ndryshimet në Ligjin për statistikën zyrtare janë më tepër në aspektin funksional organizativ sesa në aspektin material, andaj si të tilla këto ndryshime nuk kanë implikime financiare në Buxhetin e Kosovës, por zhvillohen në kuadër të buxhetit të rregullt të ASK-së.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah këtë plotësim-ndryshim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës. Si? ... edhe pikën e dhjetë të rendit të ditës...

Naiti! Kështu ma kanë bërë kështu dhe unë s'e di çka është kjo, por... Propozues është komisioni dhe në fund dikur e ka fjalën Qeveria për ta dhënë mendimin e vet për propozimin e Naitit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Nait Hasani, që në cilësinë e propozuesit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kryetarin, ministren, kolegët deputetë!

Në komisionin tonë është ndërmarrë iniciativa për themelimin ose krijimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe ne kemi bërë plotësim-ndryshimin, amendamentimin e ligjit të kaluar, që është ligj i Kuvendit të Kosovës, është nga komisioni dhe në të gjitha këto ndryshime kemi propozuar që të vijmë në lexim të parë që ta kemi mundësinë edhe një herë t'i hyjmë amendamentimit të tij, nëse ka nevojë, nga ato që i kemi paraparë ne.

Në emër të komisionit do të flasë edhe Shqipja. Unë vetëm e lexoj që si rekomandim e kemi që të miratohet në parim ky projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! E hap debatin për projektligjin. Grupi Parlamentar i LDK-së. Shqipja? Ok! Në rregull, atëherë Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Vetëm të sqaroj, në emër të komisionit, siç e prezantoi edhe kryetari, do t'i theksoj ndryshimet kryesore që ne i kemi bërë në këtë projektligj, pasi ne jemi hartues të këtij projektligji.

Fillimisht, unë dua ta falënderoj edhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, por natyrisht edhe kolegët nga komisioni, sepse është ligj në të cilin ne e kemi kaluar me unanimitet secilin nen. Do të thotë se ka pasur një konsensus bukur të madh në procesin e hartimit të këtij projektligji. Ndryshimet kryesore që prezantohen dhe kjo është për deputetët, janë kryesisht tri, megjithatë unë i ftoj deputetët që ta lexojnë dhe pas kalimit në leximin e parë të na i japin edhe komentet dhe vërejtjet e tyre.

Por, ajo që ne kemi synuar të arrijmë me këtë projektligj është:

E para, të rritim paanshmërinë dhe nivelin e profesionalizmit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil dhe këtë e kemi bërë duke i rritur kriteret. Tani, ndërmjet tjerash, për t'u bërë anëtar i Këshillit të Pavarur kërkohet që të kenë edhe provimin e jurisprudencës, gjë e cila nuk ka qenë në ligjin e kaluar, pasi vendimet që merren nga ky këshill, ndonëse janë vendime administrative, ato konsiderohen si vendime të shkallës së parë dhe mund të ankimohen në gjykatë vetëm si nivel i shkallës së dytë.

Çështja e dytë, ndryshimi i dytë që kemi bërë, sërish për të arritur paanshmërinë e anëtarëve është rritja e mandatit nga 3 në 5 vjet për anëtarët e Këshillit të Pavarur, por pa pasur të drejtë rizgjedhjeje. Kjo për arsye se shpeshherë anëtarët, duke tentuar që ta fitojnë edhe një mandat dhe duke e ditur se mandatin e fitojnë me votat e deputetëve, kanë ndikuar në punën e tyre profesionale.

Dhe, çështja e tretë dhe kryesore që ka bërë është edhe për rritjen e zbatueshmërisë së vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Ne këtu çdo vit e diskutojmë raportin e këshillit dhe një nga çështjet dhe shqetësimet që ata ngrenë në vazhdimësi është se vendimet e tyre nuk zbatohen nga institucionet qeveritare, komunale, apo të gjitha ato institucione që kanë të punësuar anëtarë të Shërbimit Civil. Në rastet kur këta shërbyes civilë i fitojnë çështjet edhe në gjykata, pastaj institucionet detyrohen që ata t'ua paguajnë në retrospektivë pagat deri në dy apo tre vjet, me ç'rast edhe dëmtohet Buxheti i Shtetit.

Një masë që ne kemi tentuar ta rregullojmë është nëpërmjet sanksioneve për zyrtarët që nuk i zbatojnë vendimet e këshillit. Pra, tani përgjegjësia, përveç që është e institucionit për t'i zbatuar vendimin e këshillit, ajo bie edhe mbi titullarin e institucionit, që e nënkupton ministrin në rastin kur ajo është në kuadër të Ministrisë apo kryetarin e Komunës, kur anëtari i Shërbimit Civil është i Komunës. Prandaj, unë i ftoj edhe deputetët tjerë që ta miratojmë në parim projektligjin, por natyrisht që propozimet e tyre t'i sjellin në komision pasi që, siç thashë, ne jemi edhe hartues të projektligjit, përveç që e shqyrtojmë atë si çdo ligj tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zoti Zemaj, dëshiron të flasësh në emër të LDK-së? Jo! Atëherë, Lëvizja Vetëvendosje, zoti Valon Ramadani.

VALON RAMADANI: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është dashur të jetë i pranishëm para nesh shumë më herët, por edhe sot kur vjen para nesh, vjen i papërbushur, sepse për të qenë ky ligj dobiprurës duhet të jetë i pasuar nga votimi i Ligjit për Qeverinë, Ligji për paga dhe me një skanim apo një përshkrim të saktë të ndarjeve nëpër pozita të punës në gjithë Shërbimin Civil.

Shërbimi ynë Civil është një mishmash i vërtetë, ku vendet e punës nuk janë të kuotuar si duhet për nga rëndësia dhe sigurisht as për nga pagat nuk janë të shpërblyera si duhet. Me hartimin dhe votimin e ligjeve të përmendura më lart njëherë e përgjithmonë do t'ia kishim lehtësuar punën këtij këshilli. Vetëm atëherë ky ligj që po e diskutojmë sot do të mund të gjente zbatimin adekuat. Në lidhje me ligjin në fjalë, po ashtu ne kemi disa propozime shtesë për përmirësimin e këtij ligji. Propozojmë që neni 8, pika 2, ku thuhet se “përbërja e këtij këshilli duhet të jetë së paku nga 2 anëtarë të komuniteteve joshqiptarë”, t'i shtohet se “ata dy anëtarë nuk mund të jenë nga i njëjti komunitet”. Kësisoj do të pamundësohej monopoli i këtyre vendeve nga komuniteti joshumicë.

Po ashtu, në të njëjtën pikë thuhet që “të ketë dy anëtarë të gjinisë femërore, sepse e pasqyrojnë karakterin gjinor të Republikës së Kosovës”. Në fakt, kjo dihet se është e pasaktë edhe për shkak të përbërjes së gjinisë femërore në shtetin e Kosovës, por edhe për shkak se dy anëtarë të gjinisë femërore nuk e plotësojnë as kuotën e 30%-shit. Më saktë, dy anëtarë janë vetëm 28% dhe se ne duhet të synojmë që përfaqësimin ta dërgojmë përtej 30%, e jo ta lëmë atë pa e përmbushur.

Po ashtu, propozojmë që neni 11, ku thuhet se “mandati i anëtarëve të këshillit të jetë 7-vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes” të ndryshohet. Mendoj se mandati 7-vjeçar është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse as institucionet apo agjencitë e pavarura nuk kanë mandate mbi 5 vjet. Pra, duhet të mbetet 5 vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër. Po ashtu,

propozojmë që ky këshill të jetë i përbërë nga individë, të cilët së paku në katër vjetët e fundit nuk kanë qenë militantë të ndonjë partie politike, apo nuk kanë garuar për ndonjë pozitë nga ndonjë parti politike. Mendoj që një kusht i tillë do t'i mundësonte këtij këshilli kaq të rëndësishëm që njëherë e përgjithmonë të garantojë një pavarësim nga politizimi, pasi pikërisht personat që dërgojnë ankesa në këtë këshill janë në të shumtën e rasteve viktime të shkarkimeve për arsye politike.

Gjithashtu, propozojmë që të njëjtin nen, pika 3, ku thuhet se “kryetari dhe anëtarët e këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile, ose shkarkimi”, të hiqet për shkak se kjo çështje është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse me nenet 75, 89, 98, 107 dhe 117 janë përcaktuar zyrtarët e lartë publikë të emëruar apo të zgjedhur, që kanë imunitet kushtetues.

Po ashtu, te neni 19 propozojmë që te procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues të ndryshohet afati te pika 6, ku thuhet se “Këshilli është i obliguar që të nxjerrë vendim për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimi të dosjes nga organi i punësimit”. Propozojmë që afati prej 30 ditësh të bëhet 15 ditë për arsye të efikasitetit për përfundimin e përzgjedhjes përfundimtare.

Gjithashtu te procedurat në rast të moszbatimit të vendimit të këshillit, ku thuhet se nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e këshillit brenda afatit të paraparë me nenin 21 të këtij ligji, kryetari i këshillit në afat prej 15 ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet ta njoftojë me shkrim kryetarin e Kuvendit, komisionin përkatës për Administratë Publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim.

Propozojmë që për shkak se deri më tani ka qenë praktikë që ankuesi, të cilit i është aprovuar ankesa, e ka njoftuar këshillin për moszbatimin e vendimit, duhet të përcaktohet me këtë ligj se këshilli është i obliguar që të përcjellë zbatimin dhe moszbatimin, në mënyrë që të procedojë hapat tjerë për moszbatim.

Po ashtu, në nenin 27 për financimin e këtij këshilli, në pikën 2 thuhet se “pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, këshilli përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili buxhet nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm. Buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e këshillit”. Mendoj se i gjithë paragrafi është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë, sepse këshilli vetëm propozon, ndërsa për ngritje apo shkurtim vendos Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Rasim Selmanaj, urdhëro! Bëhet gati Bilall Sherifi. Nuk ka asnjë deputet tjetër.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Administratë Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka vlerësuar se Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2010, ka nevojë të plotësohet dhe të ndryshohet.

Ky ligj është aprovuar në të njëjtën kohë me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në vitin 2010 në kuadër të procesit të zëvendësimit të rregulloreve të UNMIK-ut, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Duke marrë parasysh faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është institucion i pavarur i përcaktuar me Kushtetutë dhe që për punën e tij i raporton Kuvendit të Kosovës, deputetët që e kanë marrë nismën ligjore kanë vlerësuar që plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Këshillin duhet të shkojë në procedurë nga Kuvendi si sponsorizues i këtij projektligji dhe jo nëpërmjet Qeverisë.

Gjatë procesit të plotësimit dhe ndryshimit të ligjit aktual janë shtuar nene dhe shumë paragrafë të rinj, si dhe janë plotësuar dhe ndryshuar më shumë se 50% të neneve aktuale. Prandaj, në pajtim me standardet e hartimit të legjislacionit, është hartuar Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Pa dashur të përsëris ato që i tha kolegja Shqipe Pantina dhe meqenëse jemi vonuar shumë në këto orë të vona, unë e mbyll fjalën time, duke thënë se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetje këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë po e hap dhe po e mbyll me një fjalë. Po, e mbështetim. Edhe Nisma e mbështet projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Nuk kemi kuorum për votim. Jemi në pikën e 11-të të rendit të ditës.

Atëherë, kolegë deputetë, po e shoh edhe reagimin e juaj. Me mirëkuptim, ne mund ta vazhdojmë nesër seancën me pikat e rendit të ditës, aty ku kemi mbetur, nga ora 10:00. Pra, në orën 10:00. Faleminderit! Mirupafshim nesër!

* * *

E martë, më 17 prill 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 prill 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Para se të fillojmë, dua ta shfrytëzoj foltoren për t' ju thënë që një deputet i Kuvendit të Kosovës ka gënjyer dje publikisht, mbrëmë, në një emision televiziv, përmes të cilit ka thënë që mua m'i ka dhënë dikush 8 milionë marka, m'i ka dhënë Ahmet Krasniqi, është gënjeshtër e kulluar.

Është gënjeshtër prej atyre kuzhinave të tyre dhe nuk është mirë të përdoret emri i Ahmet Krasniqit të ndjerë. Në qoftë se ke argumente, zotëri i nderuar, që po i jep vetit zor që di diçka për UÇK-në dhe ke qenë diku në UÇK, unë po të them që nëse unë i kam marrë 8 milionë marka, unë prej sot nuk jam në këtë Kuvend. Në qoftë se ti ke gënjyer, a je i gatshëm të japësh dorëheqje?

Nëse ke argumente që unë i kam marrë 8 milionë, duhet ta kesh parasysh që në strukturat politike e ushtarake ka pasur bashkëpunim të ngushtë mes Qeverisë së Kosovës dhe UÇK-së dhe strukturat politike dhe ushtarake të UÇK-së nuk janë marrë me kalamajtë që kanë qëndruar nëpër thera.

Unë për të biseduar dhe për t'u marr vesh kam pasur veç një njeri, veç Bujar Bukoshin, juve nuk ju kam njohur, pasi është kryer lufta e kam ditur kush je ti.

Prandaj, të lutem, ato që janë, janë, por nuk është mirë të gënjehet opinionin, sepse ti nuk e di hiç, as s'ke qenë kurrë i pranishëm gjatë bisedimeve, as nuk i ke të dhënat e asaj pune. Po të them këtu në sallë të Parlamentit, nëse ti ke fakte t'ia prezantosh opinionit që unë kam marrë 8 milionë, po them 8 milionë, qysh ke thënë mbrëmë, unë jap dorëheqje sot. Në qoftë se nuk është e vërtetë, a je i gatshëm të japësh dorëheqje për gënjeshtren e madhe që e ke bërë publikisht.

Fjalën e ke, merre!

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për mundësinë që edhe unë ta shpreh mendimin tim.

KRYESUESI: Jo, dy minuta i ke!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Unë, nuk e keqpërdor foltoren, më fal, unë jam kryetar i seancës tash dhe po dua qysh ka rrejtur ky dje publikisht, ta demantojë sot në Kuvend, ku dua unë flas.

ANTON QUNI: Kur e kemi diskutuar Ligjin për veteranët dhe kur unë e kisha fjalën, një ndër të tjera që e kam potencuar ishte që ju personalisht keni marrë të holla nga koloneli Ahmet Krasniqi. Në atë kohë kam thënë është një pyetje një shumë shtatëshifrore, kurse mbrëmë e kam potencuar më saktësisht.

Unë nuk e di çka ka të keqe nëse ky fond është ndarë për ndihmë urgjente njësisive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk është asgjë sekrete, nuk jam i vetmi që e kam thënë, kanë folur për këtë çështje edhe shumë të tjerë, kanë folur edhe shokë tuaj të idealit, të partisë, të organizimit, e tjera, e tjera. Po nëse ju dëshironi fakte edhe më shumë, unë do t'i siguroj.

Tani nuk jam i sigurt a janë në pyetje 6, 7, 8, por mund t'i siguroj të gjitha faktet, edhe dëshmitarët, edhe protagonistët që saktësojnë me ditë, me datë, me ngjarje, me zhvillime, me vend, e tjera, e tjera, që ju këtë shumë, plus-minus, e keni pranuar personalisht me autorizimin e kolonel Ahmet Krasniqit. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë tani dua të them që ti ke gënjyer ose më mirë po të them, ke rrejtur. Ti nuk di asgjë për atë punë, as ata shokët e tu nuk dinë asgjë, se nuk kanë qenë të pranishëm kurrë, ka qenë i pranishëm Agim Mehmeti, në të gjitha bisedimet, është biseduar me Bujar Bukoshin, dhe e di Isa Mustafa. Ju të tjerët keni qenë ushtarë, keni luftuar, s'keni luftuar, është problem tjetër. Pse juve ju konvenon të flisni për njerëz të vdekur të UÇK-së dhe për juve njerëzit e gjallë nuk kanë rëndësi, ky është problemi juaj. Edhe me atë betejën që e ke bërë bashkë me të tjerët, ju askund nuk e përmendni, askund nuk e përmendni atë se kush e ka arritur marrëveshjen për të qenë bashkë. Ju nuk e dini procesin e zhvillimeve të asaj pune, as në Koshare, po as në këto të tjerat. Prandaj mos shprush, këtu mund të flasin, dy vetë janë gjallë, Bujar Bukoshi sa i përket çështjeve politike, dhe Isa Mustafa, pjesërisht për çështjet e financave që i ka bërë dhe gjallë është veç Hilmi Nebiu, e njihni Hilmi Nebiun, ai ka qenë i pranishëm gjithëherë në të gjitha takimet me Ahmet Krasniqin që e keni bërë, unë s'e mohoj atë. Por shuma që e ke thënë, nuk është e vërtetë, prandaj saktësoj, unë nuk e kam mohuar asnjëherë as bashkëpunimin me Bujar Bukoshin, as bashkëpunimin me Ahmet Krasniqin, as ndihmën që e ka dhënë Bujar Bukoshi për UÇK-në, as ndihmën jo për gatishmërinë, në të cilën e kanë penguar strukturat politike të atëhershme Ahmet Krasniqin, sepse ka një proces të caktuar për t'u bashkuar dhe unë s'kam faj për ato.

Është mirë kur të flasësh publikisht, sepse këto fjalët e marrin dheun dhe unë medieve, të cilat i komandoni ju, unë nuk kam çka u bëj atyre dhe s'e kam ndërmend të merrem me to, por po të them se çka kam bërë unë, nuk fshihem, s'jam fshehur kurrë.

Dhe, mendoj që as Ahmeti s'ka qenë në rrugë të gabueshme sa i përket përpjekjes për të bashkëpunuar dhe unë s'e kam kërkuar Ahmetin, Ahmeti më ka kërkuar mua si personi i parë i oficerëve të një grupi, se ju keni qenë tri grupe aty, tri grupe oficerësh.

Prandaj, po them që kur t'i çelim letrat, i çelim tamam dhe tani këtu unë e përfundoj se dje ke folur ti, sot fola unë, edhe s'ke më fjalë.

(Ndërprerje e incizimit)

Për qejf po e keqpërdor, bash për qejf timin.

Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i raportit të operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT sh. a. për vitin 2016

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar raportin e operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT sh. a për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, nuk ka.

Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Shala-Berisha, nuk është këtu, për arsyetimin e raportit me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

A është dikush, nuk është.

Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës sipas marrëveshjes dje, ka mbetur për të vazhduar seanca, duhet të formohet komisioni ose të futet në rend të ditës formimi i Komisionit Hetimor në lidhje me ndriçimin e rastit të debatit për gjashtë shtetasit turq.

Në sallë janë 80 deputetë.

Ka ngelur vetëm votimi, procedura e votimit, pastaj vazhdojmë me të tjera.

Duhet ta përsëris se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe Vetëvendosjes kanë kërkuar që të kalojë ky komision, të votohet, në të kundërtën nuk do t'i votojnë ligjet e tjera.

Atëherë unë jam i obliguar ta qes në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 71 deputetë, 66 deputetë janë për, 5 deputetë kanë abstenuar. Konstatoj që Kuvendi e miratoi formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq.

Ne kemi kaluar, pak e kemi shkelur Rregulloren, sepse është dashur që të jenë të prezantuar kryetari dhe nënkryetari ose kryetari i komisionit dhe nënkryetari. Më vonë, kur të vijë në rend dite është mirë që t'i kemi edhe anëtarët e komisionit, edhe këta. Faleminderit!

- Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e 9 anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Diskutime për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 16 prill, andaj sot vazhdojmë votimin për këtë propozim-vendim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, por para se të votojmë, zoti Ismajl Kurteshi, si kryetar i komisionit, ka një fjalë për të sqaruar disa çështje. Unë ia dhashë fjalën Ismajl Kurteshit.

ISMAJL KURTESHI: Vetëm një shpjegim të shkurtër.

Bazuar në Udhëzimin administrativ të MASHT-it numër 5/2018 për kriteret dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, bazuar në nenin 2, pika 4, mandati i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë do të jetë si në vijim:

Tre anëtarë ndërkombëtarë emërohen me mandat pesëvjeçar,

Tre anëtarët vendorë emërohen me mandat pesëvjeçar,

Tre anëtarët e tjerë vendorë emërohen me mandat për tre vjet, vetëm për mandatin e parë.

Përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve vendorë për herë të parë bëhet me short.

Pra, vetëm kjo, se tre emërohen për tre vjet dhe tre për pesë vjet, këta vendorët.

KRYESUESI: Unë në këto procedurat e Kuvendit që i kam përpara nuk ma kanë sqaruar këtë çështje që e ngritët ju.

Ne sot do t'i votojmë 9 anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe unë nuk e di nga buron kjo ose si është çështja.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, ligji qenka kështu siç u tha. Votojmë tash!

Kanë votuar 81 deputetë, për kanë votuar 76, kundër 2 dhe 3 kanë abstenuar. Konstatoj që Kuvendi e miratoi ratifikimin e 9 anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

4. Votimi i Projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare, pra ratifikimi i marrëveshjes kërkon 80 vota për, si dhe në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 60, paragrafi 3, procedimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e projektligjit, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 84 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar vetëm 77 deputetë, a ka pa kartelë?

E përsëris edhe një herë votimin, në qoftë se ka pasur ndonjë gabim.

Votojmë edhe një herë, regjia, përsëris votimin. Votojmë tani!

Nuk e kemi edhe një votë.

Votojmë edhe një herë. Votojmë tash!

Dikush s'po do të votojë me qëllim, po unë s'mund ta detyroj askënd, se s'kam pasqyrë që të dimë kush nuk po voton.

A jeni gati për votim, a është dikush që po vjen?

Edhe një herë e përsëris votimin, në sallë janë 82 deputetë, edhe një herë ju përkujtoj që po hyjmë në votim. Votojmë tash!

Edhe një herë, se e morëm vesh ku është gabimi.

Edhe një herë e qes në votim, 82 deputetë janë në sallë. Lus që të fillojmë procedurën e votimit. Votojmë tash!

Nuk doni të votoni, në rregull.

5. Votimi në parim i Projektligjit për gjykatat

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Kanë votuar 76 deputetë, 48 janë për, 26 kundër dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-054 për gjykatat.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

6. Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 78 deputetë, 74 janë për, 3 kundër dhe një abstenim.
Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Kanë votuar 78 deputetë, 74 vota janë për, 4 vota janë kundër, asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi në parim i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë marrë pjesë 78 deputetë, për kanë votuar 66, kundër 4, kanë abstenuar 8 deputetë.
Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-935 për veprimtarinë hidrometeorologjike.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 81 deputetë, për kanë votuar 56, kundër 7 deputetë, kanë abstenuar 18. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi në parim i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 80 deputetë, 55 vota janë për, 7 vota kundër dhe 18 kanë abstenuar. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Projektligjin numër 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i raportit të operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut - KOSTT sh.a. për vitin 2016

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar raportin e operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut të KOSTT-it sh. a për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësues të Qeverisë nuk ka, edhe një herë ftoj zonjën Shala-Berisha ose dikush që e zëvendëson atë ta marrë fjalën sa i përket kësaj. Nuk është paraqitur askush.

Atëherë nuk e nxjerrim as në votim. Në rregull, a jeni që ta votojmë?

Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, kryetarja e komisionit ka edhe dy nënkryetarë, është dashur që në mungesë të saj, në emër të komisionit të flasë dikush nga nënkryetarët nëse ata nuk janë të pranishëm.

Atëherë vetë kryetarja është dashur t'i kalojë fjalën njërit prej anëtarëve, por si duket as këtë nuk e ka bërë. Unë flas për raportin e KOSTT-it në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne po e shqyrtojmë sot raportin e KOSTT-it për vitin 2016, raport ky i nënshkruar nga kryeshefi i KOSTT-it, zoti Mustafë Hasani, i cili në vitin 2017 u shkarkua nga Bordi dhe kryesueses së Bordit të KOSTT-it, e cila me dy anëtarë të tjerë janë shkarkuar joligjshëm nga kryeministri Haradinaj po në vitin 2017.

Në vitin 2016, në mes të dy leximeve të Ligjit 05/L-085 për energjinë elektrike, Sekretariati i Komitetit të Energjisë ka kërkuar që Bordin e prodhuesit, pra KEK-ut dhe operatorit të transmisionit, pra KOSTT-it, të mos e zgjedhë i njëjti organ, Qeveria.

E gjithë kjo për të mbështetur parimet e liberalizimit të tregut të energjisë. Kështu komisioni në atë kohë i ka bërë disa ndryshime në draft-ligj me qëllim për të adresuar shqetësimet e ngritura nga Sekretariati i Komitetit të Energjisë, duke e kalua pronësinë e KOSTT-it te Kuvendi i Republikës së Kosovës, por jo edhe duke i ndërruar statusin e ndërmarrjes publike KOSTT-it, edhe pse për nga natyra KOSTT-i është një operator, ndërmarrje publike që kryen dhe jep një shërbim krejtësisht publik.

Kalimi i pronësisë i ndërmarrjeve publike te Kuvendi i Republikës së Kosovës paraqet edhe dilema kushtetuese. Sepse paragrafi 1 i nenit 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë: “Republika e Kosovës do të ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës, të cilat janë në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore...”

KRYESUESI: Zonja Bajrami, na fal, se teknika diçka nuk është në rregull, dil këtu.

Regjia, mikrofonin kryesor. Regjia, zonjës Bajrami në foltore, nëse bën.

Atëherë, pesë minuta pauzë derisa të rregullohen mikrofonat.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë, po vazhdojmë me pikën që ishim në diskutim. Tani ka ardhur edhe kryetarja e komisionit.

Zonja Bajrami ka mbetur në gjysmë me diskutim. Nëse dëshiron, mund të vazhdosh diskutimin.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Siç e thashë edhe më herët, është hera e parë që KOSTT-i i raporton Kuvendit, për shkak se në vitin 2016, në mes të dy leximeve për Ligjin për energjinë elektrike 05/L-085 Sekretariati i Komitetit të Energjisë ka kërkuar që Bordin e prodhuesit, KEK-ut dhe të operatorit të transmisionit të KOSTT-it assesi të mos i zgjedhë i njëjti organ, që është Qeveria.

E gjitha kjo për të mbështetur parimet e liberalizimit të tregut të energjisë. Kështu komisioni në atë kohë ka bërë shpejt e shpejt disa ndryshime, duke e kaluar pronësinë e KOSTT-it te Kuvendi i Republikës së Kosovës, por duke mos e ndërruar asnjëherë statusin e ndërmarrjes publike të KOSTT-it. Kjo në fakt, ka ngjallur edhe dilema kushtetuese, sepse paragrafi 1 i nenit 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë që Republika e Kosovës do të ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet publike të Republikës së Kosovës, të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Më tutje ky nen thotë se Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë në koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Sot KOSTT-i operon si ndërmarrje publike sipas Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike, i raporton Kuvendit sipas Ligjit në fuqi për energjinë elektrike dhe sipas këtij ligji që është në fuqi anëtarët e Bordit i emëron dhe i shkarkon Kuvendi, por gjithsesi duke u thirrur në ligjin e vjetër, i cili nuk është në fuqi më, tre anëtarë të Bordit të KOSTT-it i ka shkarkuar kryeministri në mënyrë të jashtëligjshme.

Të nderuar kolegë,

Pyetja është se ku jemi ne si Kuvend në raport me KOSTT-in. Tani sa i përket raportit, duke marrë parasysh ndryshimet që përmenda të bazës ligjore, në raport mungon komplet analiza dhe komentimi se si kjo bazë ligjore ka ndikuar në operimin e KOSTT-it. Për më tepër, nuk ka asnjë fjalë rreth ndikimit të procesit të shthurjes pronësore të KOSTT-it, pra ndarja operatorit të transmisionit dhe të operatorit të tregut, dhe si ky ndikim ka kaluar, domethënë pronësia nga Qeveria te Kuvendi. KOSTT-i është ndër institucionet e pakta që ka shënuar progres gjatë viteve. Ne e dimë të gjithë që në vitin 2006 kur është themeluar KOSTT-i, në atë kohë ka pasur kapacitete transmetuese vetëm 800 megavatë, derisa kërkesa për energji elektrike në vend ka qenë mbi 1 mijë megavatë.

Ne e dimë që në atë kohë nuk ka pasur prodhim të mjaftueshëm të energjisë elektrike, por edhe sikur të kishte pasur, nuk ka pasur kapacitete transmetuese KOSTT-i. Sot kapacitetet transmetuese të KOSTT-it janë 1 700 megavatë, kjo falë mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë dhe të donatorëve, të cilët me projekte të ndryshme kanë ngritur kapacitetet e KOSTT-it. Sipas KOSTT-it në raport është raportuar se për dhjetë vjet janë kursyer 25 deri në 27 milionë euro vetëm nga humbjet e energjisë elektrike. Raporti që po e shqyrtojmë paraqet rezultatet kryesore dhe të arriturat e tjera gjatë vitit 2016, siç e dimë rrjetit e energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2016 i është shtuar edhe linja e re 400 kilovoltë, linja Kosovë - Shqipëri, e cila për shkak të moszbatimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi nuk po mund të komercializohet, pasi nuk është fare në funksion dhe Kosova edhe sot e kësaj dite nuk ka arritur të anëtarësohet në ENTSO-E.

Në fakt, KOSTT-i është shumë i dëmtuar, Kosova është shumë e dëmtuar nga moszbatimi i marrëveshjeve Kosovë-Serbi dhe ata të cilët po negociojnë fshehurazi me Serbinë duhet t'i kenë parasysh këto gjëra. KOSTT-i është operator i transmisionit me humbjet më të vogla teknike në rajon dhe Lidhja Demokratike e Kosovës e vlerëson shumë këtë. Në përgjithësi, raporti që kemi para vetes ofron informata të shumta, por vërehet një bashkërendim jo i logjikshëm i tyre. Raportimi është i segmentuar dhe në shumë raste krijon konfuzion. Në pjesën e operimit të tregut neve na mungojnë të dhënat krahasuese me vite të tjera, KOSTT ka injoruar komplet faktin që është hera e parë që Kuvendi i Republikës së Kosovës merr këtë raport dhe mungesa e të dhënave krahasuese, në fakt, mund të shkaktojë konfuzion në mesin e deputetëve.

Në raport KOSTT-i ka përfshirë projekte, të cilat janë paraparë me plan-program që të përfundojnë gjatë vitit 2016, nëntë prej këtyre projekteve kanë pasur vonesa dhe në asnjë pjesë të raportit nuk është shpreh arsyeshmëria për mosimplementim komplet të këtyre projekteve. Megjithatë, sa i përket në përgjithësi raportit, edhe ne duke marrë parasysh faktin se për herë të parë këta po i raportojnë Kuvendit, mendojmë që ka informata të mjaftueshme dhe me vërejtjet që kanë marrë në komision, besojmë që raportimi i radhës do të jetë më i mirë.

Të nderuar kolegë,

Meqenëse jemi në këtë temë, unë patjetër më duhet të ngre edhe dy çështje, të cilat kanë ndodhur në vitin 2017 në KOSTT, e nuk janë pjesë e raportit. Ju e dini që Bordi ka shkarkuar kryeshefin ekzekutiv, për këtë Kuvendi i Republikës së Kosovës ka marrë një letër nga përfaqësuesi i saj, zoti Lekë Musa. Në letrën e zotit Musa ndër të tjera flitet për keqpërdorim të resurseve të KOSTT-it dhe për rregullin që është munduar në atë kohë ish-kryeshefi ekzekutiv, zoti Mustafë Hasani ta vërë. Në atë letër zoti Musa flet për performansë të mirë të zotit Hasani. Zoti Hasani ka paditur Bordin e KOSTT-it dhe është në pritje të një vendimi nga ana e gjykatës, ndërkohë nga Kuvendi i Kosovës nuk është marrë asnjë hap rreth shqetësimeve të ngritura nga zoti Lekë Musa, i cili në atë kohë ka qenë përfaqësues i Kuvendit, i deleguar aty nga zoti Veseli.

Ndodhia tjetër që ne e konsiderojmë që është shkelje ligjore, është shkarkimi i tre anëtarëve të Bordit nga ana e kryeministrit Haradinaj. Sipas Ligjit në fuqi 05/L-085 për energjinë elektrike, Bordin e emëron dhe e shkarkon Kuvendi. Ndërkohë, që kemi pasur në vitin 2017 një shkarkim të tre anëtarëve të Bordit, domethënë nga kryeministri Haradinaj. Ne e dimë që ndryshimet që janë bërë në ligjin që është në fuqi kanë qenë ekskluzivisht kërkesë e Sekretariatit të energjisë, sepse është dukur dhe është konsideruar konflikt interesi nga ana e tyre nëse Bordin e KEK-ut dhe njëkohësisht Bordin e KOSTT-it i emëron Qeveria, për këtë arsye janë bërë ndryshimet në ligj, ligji është në fuqi, ky ligj është shkelur me rastin e shkarkimit të tre anëtarëve të Bordit të KOSTT-it.

Në fakt, edhe Bordi i KOSTT-it ka bërë padi në gjykatë dhe këta presin përgjigje dhe në qoftë se merret parasysh ligji që është në fuqi, sigurisht që përgjigjja do të jetë e tyre. Raste si këto e dëmtojnë KOSTT-in, jo vetëm materialisht, por edhe në forma të tjera. Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, si gjithmonë kërkojmë nga institucionet zbatim të ligjeve në fuqi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Para se të filloj me raportin, me rekomandimet të dala nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, po dëshiroj t'i drejtohem koleges sime, Hykmete Bajrami, që s'është korrekte të flasë në emër të askujt dhe të drejtojë gisht për përgjegjësi ose për mospërgjegjësi. E dimë secili dhe e dinë të gjithë qytetarët e Kosovës sa jemi përgjegjës ne edhe si deputetë, edhe për juve sa ke qenë ministre, e tash deputete.

Unë obligimet e mia i kam deleguar, sepse kam pasur probleme shëndetësore dhe tani jam mirë këtu dhe tash më lejoni t'i kthehem raportit me rekomandime lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2016 të KOSTT-it.

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor të vitit 2017, po e ritheksoj tani jemi në prill, komisioni e ka shqyrtuar raportin vjetor për vitin 2016 të KOSTT-it dhe Kuvendit ia paraqet këtë rekomandim: të miratohet raporti vjetor për vitin 2016 i operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT me rekomandime si vijon:

1. Qeveria dhe KOSTT të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme ligjore që sa më shpejt të arrihet anëtarësimi i KOSTT-it në NSOI.

2. KOSTT-i të ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e situatës së krijuar me vendimin e gjykatës lidhur me vendimet e ZRRE-së V399-2012, për çka ky rekomandim veçse është tejkaluar.

3. KOSTT-i në raportet e ardhshme vjetore të përshkruajë me hollësi zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese dhe nevojën eventuale për ndryshime, të përshkruajë më hollësisht strukturën e personelit, si dhe raporti të ketë qasje më analitike të aktiviteteve të KOSTT-it.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit 05/L-085 për energji elektrike, në përfundim të çdo viti KOSTT paraqet në Kuvend më së largu në qershor raportin vjetor të veprimtarisë së tij për vitin paraprak. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2017 e ka shqyrtuar këtë raport, të cilin e paraqiti para deputetëve Bordi i KOSTT-it, komisioni me shumicë votash konkludoi se ky raport ofron të dhëna dhe informata të dobishme lidhur me aktivitetet e kësaj ndërmarrjeje publike dhe është në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-085 për energji elektrike dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin e raportit me rekomandime.

Dëshiroj të theksoj se për komisionin ky tashmë është pothuajse i harruar, mirëpo ky raport sipas procedurave të Rregullores së Kuvendit ka mbetur nëpër komisione të tjera, të cilat e kanë zvarritur shqyrtimin e këtij raporti, prandaj e shoh pak si me vonesë, sepse është raport i punës për vitin 2016, ndërkohë që jemi në vitin 2018. Faleminderit!

Në qoftë se më lejohet, kryetar, do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së KOSTT-it, e mbështet në parim. E mbështet faktikisht raportin e punës së KOSTT-it, meqenëse KOSTT-i për herë të parë me ligj i raporton Kuvendit të Kosovës me rastin e shthurjes së sektorit të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2016 KOSTT-i ka vazhduar punën në zhvillimin e sistemit të transmisionit me qëllim të përmbushjes së nevojave të konsumatorëve dhe palëve në tregun e energjisë. Viti i kaluar ka qenë mjaft sfidues për KOSTT-in, siç e dinë të gjithë, pasi që në vazhdimësi është punuar në përgatitjen për implementimin e projekteve kapitale me të cilat KOSTT do të ofrojë operim të sigurt dhe të besueshëm me standarde evropiane.

Me implementimin e këtyre projekteve investive KOSTT do të arrijë kriterin e sigurisë të quajtur “N1” në tërë sistemin e transmisionit. KOSTT ka pasur angazhime intensive për të mundësuar fillimin e operimit të pavarur si zonë bllok kontrollues, por përkundër angazhimit dhe të spektrit politik të Kosovës dhe për arsye të obstrukcioneve nga pala serbe, KOSTT nuk ka arritur të fillojë implementimin e marrëveshjes së kyçjes në rrjetin e transmisionit evropian. Si rezultat i këtyre pengesave, linja 400-kilovoltëshe Kosovë-Shqipëri, edhe pse është e përfunduar me kohë, nuk po mund të shfrytëzohet. Në aspektin e tregut, KOSTT-i ka vazhduar përgatitjen e kornizës

ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, ka marrë pjesë aktive në iniciativa regjionale për liberalizim të tregut dhe ndërtimin e mekanizmave për të mundësuar tregtimin e lirshëm edhe pa pengesa të energjisë elektrike.

Pra, me hyrjen në fuqi të Ligjit për energjinë elektrike janë plotësuar kërkesat e rregulloreve dhe direktivat e Bashkimit Evropian për shthurjen pronësore të KOSTT-it. Nga muaji gusht i vitit 2016 sipas Ligjit për energjinë elektrike të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Dëshiroj të përmend se me pengesat në operimin e suksesshëm të KOSTT-it në të njëjtën kohë kanë qenë edhe mosplotësimi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, i cili ka shkaktuar pengesa edhe në afarizmin edhe në performimin e KOSTT-it në këtë rast, e tash pasi që është kompletuar Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë uroj që të ecin në rrugë të mbarë. Ne kemi këtu në rend dite edhe disa interpelanca që lidhen komplet me kompleksin e sektorit të energjisë, të cilat do të ndërliken sigurisht edhe me funksionimin e KOSTT-it. Ju ftoj ta përkrahni, meqenëse komisioni unanimisht e ka mbështetur raportin vjetor të punës së KOSTT-it. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk qenka prapë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Rugova e ka fjalën. Më fal, zonja Hykmete e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

E nderuar kryetare e komisionit, zonja Berisha-Shala,

Ju nuk ishit në Kuvend kur unë fola, zoti kryesues i seancës kërkoi disa herë që dikush të flasë në emër të komisionit, unë ju uroj shërim të shpejtë, shpresoj që t'ju ketë kaluar, por sa herë që mungoni, prapë mendoj që e keni për obligim që fjalën ta kaloni te nënkryetarët, nëse nënkryetarët mungojnë, e kanë për obligim që atëherë ta kalojnë te anëtarët e komisionit. Kaq ishte, asgjë më tepër, besoj se për përgjegjësinë tonë na vlerëson dikush tjetër dhe jo ne njeri-tjetrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sala Berisha-Shala, replikë.

SALA BERISHA-SHALA: E nderuar kolege deputete,

Mos mbaj gajlen time ti hiç, kryeji punët tuaja për të cilat je e thirrur dhe sot po më detyron këtu të përdor foltoren. Sot është përvjetori i njëjës nga masakrat më të rënda, masakra e Poglekut, në të cilin edhe kam pasur obligim të jem atje dhe nuk është tragjike pse s'është kryetarja apo është,

ti ke mundur të diskutosh lirshëm. Unë i kam deleguar detyrat e mia dhe mos mbaj ti fare atë gajle.

Ty nuk ta kam përmendur emrin, sepse nuk je në hierarkinë e udhëheqjes së komisionit, ti mund të flasësh vetëm në emrin tënd dhe në emrin e grupit tënd parlamentar, në qoftë se të autorizon. Për mua janë më të rënda ato prolongime që ti ke insistuar me çdo kusht që të mos plotësohet Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që reflekton direkt në performansën e këtij institucioni shumë të rëndësishëm, se sa a e merr fjalën kryetari i komisionit apo nuk e merr në një seancë rutinë, e cila edhe tash ky raport është me vonesë duke u shqyrtuar për shkak të pengesave që ka kaluar ky raport nëpër komisione të tjera që s'janë përgjegjësi e deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Kundër-replikë, ke drejtë.

HYKMETE BAJRAMI: Asnjëherë nuk kam ndikuar që të mos ketë plotësim të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Po kërkojmë të respektohet ligji që është në fuqi, kaq po kërkojmë dhe ju nuk jeni e pazëvendësueshme. Unë me të vërtetë asnjëherë nuk kisha dashur të jem zëvendësja jote, por sot kryesuesi i Kuvendit ka dashur ta heqë pikën prej rendit të ditës për shkak se askush nuk e merrte fjalën në emër të komisionit.

Kështu që mos e mbivlerëso vetveten, i ke thënë sekretarit që nuk e qet fare në votim raportin dhe e potencuan disa herë që raporti është me vonesë, kështu që mbylle këtë pikë dhe mjaft i përdorët viktimat dhe përvjetorët për përfitime politike, turp duhet t'u vijë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse këtu vërtet dikujt duhet t'i vijë turp, është ajo që foli para meje, e tha me sinqeritetin më të lartë, sot është dashur që ky Parlament t'i mbyllë dyert në orën 10:00 dhe të gjithë të rreshtohemi në Poklek, të bëjmë nderime para atyre të rënëve që fatkeqësisht familjet e tyre nuk e kanë as nga një varr ku duhet t'u qesin lule më të dashurve tyre.

54 anëtarë të familjes Pokleku, të gjithë të varrosur në një varr dhe ne të akuzohemi pse paskemi shkuar të bëjmë nderime sot atje, është turpi më i madh që dikush në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës e thotë. Prandaj, mjaft më me turpin e vazhdueshëm që jeni duke e bërë duke akuzuar pa të drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues!

Unë mendoj që ky debat është i panevojshëm, unë i lus të gjithë deputetët që të përmbahen nga gjuha, të cilën janë duke e përdorur. Të kisha lutur deputete Musliu, e kam fjalën unë, tash nderimi më i madh i atyre viktimave u bëhet nëse të gjithë deputetët në orën 10:00 do të ishin paraqitur sot në seancë, deputetët e shumicës 2-3 orë me vonesë paraqiten në seancë, shtyhen seancat për shkak se nuk jeni të rregullt.

Nderimi më i madh i atyre njerëzve është të funksionojnë si duhet institucionet, ta kryejë secili detyrën e vet. Po të kishte pasur një organizim të duhur nga Kryesia e Kuvendit, nga institucionet e vendit, të kishim ftesë ne sot të gjithë deputetët, të gjithë do të ishim duke bërë nderime atje. Por, nuk ka rend shtëpie këtu, nuk mund të ketë asnjë seancë të rregullt, asnjë institucion nuk është duke funksionuar normalisht. Krejt çka ndodh në Kuvend është ta fyejmë njëri-tjetrin. Hapet seanca në fillim dhe kryesuesi e quan "rrenc" një deputet, nuk e përdor mundësinë që të ulen në debat e të bisedojnë mes vete. Një deputete tash i thotë tjetrës ashtu, çka është ky Kuvend kështu? Ku po shkojmë kështu?!

KRYESUESI: Njeri duhet me pas pak gjak, edhe unë kam. Ju kam duruar boll, ndonjëherë duhet të reagoj edhe unë, nuk bëhet kiameti. Keni 15 vjet që më shani dhe kurrë s'kam reaguar. Mos u bëni marak!

Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës!

Deputetë të Kuvendit,

Kabinet i Qeverisë, që mungon,

Ky raport do të duhej të ishte prezantuar vitin e kaluar dhe tani ta kemi raportin për vitin 2017, ose së paku është dashur që KOSTT-i ose ministria t'ia bashkëngjisin këtij raporti një dokument, i cili e përditëson atë. Për shkak të informatave të vonshme dhe të paazhurnuara, shumë nga këto mund të mos jenë relevante tanimë dhe mund të çojnë edhe në marrjen e hapave të gabuar e të vendimeve të dëmshme.

Për më keq, vërehet që raporti në përgjithësi është i thatë, përshkrues, pa analizën që do të jepte një pasqyrë përmbledhëse mbi performansën e kompanisë. Më shumë rrëfohen aktivitetet individuale, pjesëmarrjet nëpër konferenca, marrëveshjet, projektet teknike etj. dhe të dhënat operative-teknike, se sa rezultatet, arritjet apo sfidat e problemet qenësore të KOSTT-it, si dhe propozimet e mënyrat për zgjidhjen e tyre.

KOSTT-i prej themelimit është udhëhequr prej ekspertëve të shquar të sektorit të energjisë dhe është investuar pandërprerë në ngritjen dhe aftësimin e tyre për nevojat specifike të KOSTT-it. Në KOSTT nuk ka pasur mbipunësim dhe me ngritjen e nivelit teknik dhe teknologjik, është

zvogëluar numri i operatorëve. Për shkak të interkonjeksionit dhe rregullave strikte profesionale, sidomos të ENTSO-E puna e KOSTT-it mbikëqyret dhe kontrollohet në mënyrë rigoroze prej ekspertëve të lëmit në Evropë. Para pak javësh, për shkak të ndërhyrjes të KOSTT-it në sistem u pa se çfarë problemesh u shkaktuan në sistemin elektroenergjetik të Evropës.

Në vitin 2015 Qeveria e Kosovës e kapi për fyti KOSTT-in. Në shtator të vitit 2015 zgjidhet Bordi tërësisht politik dhe prej gjashtë anëtarëve, asnjëri nuk është ekspert i sistemit elektroenergjetik. Ky bord e zgjodhi kryeshefin ekzekutiv prej politikës, pas një kohe kryeshefin ekzekutiv, kryesuesja e Bordit dhe dy anëtarë të Bordit largohen prej KOSTT-it. Kjo lojë me kryeshefin ekzekutiv dhe Bordin kanë ndikuar në shumëfishimin e problemeve në KOSTT, e mbase edhe në këto vonesa në raportim.

Mirëpo, një muaj para atij bordi politik në Kosovë, në Bruksel qe nënshkruar marrëveshja për energjinë me Serbinë. Sipas asaj marrëveshjeje, KOSTT-i anëtarësohet në ENTSO-E, por ana fort e keqe e asaj marrëveshjeje ka qenë zyrtarizimi i kompanisë EMS për veriun e Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk është angazhuar për implementimin e asaj marrëveshjeje dhe kemi problem të rëndë si pasojë e shantazhit të Serbisë me Marrëveshjen e Brukselit. KOSTT-i duhet të funksionojë si zonë rregulluese dhe të sigurohet rregullimi sekondar Kosovë - Shqipëri, përkatësi KOSTT - OST, por për shkak të mosfunksionimit të interkonjeksionit, kjo nuk mund të realizohet. Me funksionalizimin e largpërçuesit 400-kilovoltësh janë krijuar të gjitha kushtet për funksionimin e Kosovës dhe Shqipërisë si një zonë rregulluese unike. Por, KOSTT-i nuk mund t'i alokojë kapacitetet e interkonjeksionit dhe ta rregullojë transitin e energjisë dhe humbjeve respektive.

Përkritazi me këto, në faqen 5 të raportit thuhet: KOSTT ka pasur angazhime intensive për të mundësuar fillimin e operimit të pavarur si zonë bllok kontrollues, por përkundër angazhimit edhe të spektrit politik të Kosovës dhe për arsye të obstrukcioneve nga pala serbe, KOSTT nuk ka arritur që ta fillojë implementimin e marrëveshjes së kyçjes me ENSO/E. Si rezultat i këtyre pengesave, linja 400-kilovoltëshe Kosovë - Shqipëri, edhe pse është përfunduar me kohë, nuk po mund të shfrytëzohet. Kjo dëshmon se KOSTT nuk operon dhe kontrollon në mënyrë të pavarur sistemin energjetik të Kosovës dhe se investimi në linjën 400-kilovoltëshe të interkonjeksionit Kosovë - Shqipëri është totalisht i pashfrytëzueshëm edhe në kohën që ne po flasim këtu. Madje, ka filluar kthimi i kredisë për largpërçues 400-kilovoltësh dhe në mungesë të të hyrave prej interkonjeksionit dhe transimit, kjo kredi do të kthehet prej Buxhetit, ose prej rritjes së tarifave.

Në vitin 2012 kanë përfunduar punët në sistemin SCADA/EMS. Ky sistem kompleks mundëson monitorimin dhe menaxhimin në kohë reale prej një qendre i gjithë sistemi i transimit dhe i bartjes. Pra, prej një qendre në sistemin e tensionit të lartë në Kosovë mund të kyçet, ose shkyçet çdo stabiliment largpërçues, ose transformator. Ky sistem nuk funksionon në pjesën veriore në tërësi, për shkak të Serbisë, ani pse Kosovës i ka kushtuar afro 18 milionë euro.

Në faqen 12 të raportit thuhet: “Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive edhe më tutje mbetet e papërfshirë pjesa veriore e Kosovës, ku për shkaqe veç të njohura të pamundësisë së qasjes së lirë fizike ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paketë, e nënstationit në Vallaq, e hidrocentralit të Ujmanit dhe nënstationit në Zubin-Potok.”

Në vijim po i theksoj edhe disa vëzhgime të tjera të këtij raporti. Në raport nuk ka të dhëna të detajuara për importet, përveç sasisë së përgjithshme të planifikuar 541,3 GW orë dhe asaj aktuale të importuar 632,3 GW orë, në faqen 31. Mungojnë detajet, si: kush janë importuesit; kompanitë që kanë bërë furnizimin me importe; cilat janë periudhat e importeve; ndarja në import emergjent dhe import të planifikuar; e të tjera... Në po atë faqe, pra 31, thuhet se humbjet në rrjetin e transmisionit janë 5,7% mbi ato të planifikuara, por mungon shpjegimi mbi arsyet e tejkalimit.

Në faqe 39 thuhet: “Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar, ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që i furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të parregulluar. Ferronikeli furnizohet nga KESCO me çmim të parregulluar në nivelin 220 KW”. Këtu vërehet monopoli tregtar i KESCO-KEDS dhe dështimi në liberalizimin e tregut të energjisë. Kemi çmimin e lartë dhe margjinën e fitimit të padrejtë të KESCO-KEDS në tarifata e konsumatorëve me pakicë, KEK-u rreth 30 euro MW orën, ndërkaq KESCO mbi 62 euro për MGW orë në mesatare.

Në të njëjtën faqe, pra 39 në raport, përmenden pjesëmarrës në treg, si KEK, LOMAG, KELKOS, pa dhënë informata bazike se kush janë këta operatorë dhe cili është roli dhe aktiviteti i tyre.

Pasqyrat financiare dhe treguesit tjerë relevantë e kanë humbur kuptimin për shkak të kohës kur po shqyrtohen. Është raport i vitit 2016, ndërsa ne jemi në gjysmën e dytë të prillit të vitit 2018.

Megjithatë, unë po ndalem në dy çështje:

- Humbjet teknike në vitin 2016 tregojnë rritje, që duhet të na brengosin. KOSTT-i çdo vit investon mjete të konsiderueshme. Në vitin 2016 më se 28 milionë euro me qëllim të rritjes së sigurisë së sistemit, rritjes së cilësisë së shërbimit, por edhe të zvogëlimit të humbjeve. Në vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak, humbjet janë më të larta 27,3%.

- Rritja e numrit të punëtorëve për më se 3% shpjegohet me daljen e punëtorëve në pension. Në KOSTT, me rritjen e automatizimit të pajisjeve dhe monitorimit e menaxhimit të tyre prej qendrës, zvogëlohet nevoja për kujdestari dhe manipulues e nënstatione, prandaj me pensionimin e këtyre punëtorëve duhet zvogëluar numri i të punësuarve çdo vit.

Kjo rritje si tendencë shpresojmë të mos jetë hyrje në atë që tashmë e kemi parë në Postë-Telekomin e Kosovës.

Më tej, te pasqyra e të ardhurave, Buxheti 2016, faqe 43, paraqitet zëri i rregullimit sekondar prej 3,5 milionë eurove i perealizuar aktualisht dhe fare nuk precizohet nëse do të kishte të hyra nga ky aktivitet. Kjo e lë përshtypjen e gabuar se është më mirë që KOSTT nuk ka arritur ta bëjë rregullimin sekondar.

Krejt në fund, në seksionin 2,7 - Rreziqet, në faqe 71, listohen rreziqet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet KOSTT-i tanimë, si dhe ato potenciale që mund të shfaqen në të ardhmen, pra rreziqe potenciale. As Bordi dhe as menaxhmenti nuk e thotë asnjë fjalë të vetme për propozimet, sesi të adresohen këto sfida. Ato nuk parashohin masa e mënyra që duhen ndërmarrë për t'u ballafaquar me sukses me to.

Për këto arsye, ne deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti. Fjalën e ka zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Së pari e kam një vërejtje të vogël për ju, kryesues, sepse mendoj se as këtë rast që e patëm, e as në përgjithësi nuk duhet lejuar që seanca ta marrë kahun e vet, sipas dëshirave të deputetëve individualë. Po humbim shumë kohë në disa diskutime, të cilat po i nxitin deputetët për kushedi çfarë interesi, qoftë ai personal, por gjithsesi asnjëherë në interes, as të punës së Kuvendit, e as të qytetarëve të Republikës. Kështu që, kur jemi në pika të veçanta të rendit të ditës do të duhej të përqendrohemi aty, e jo të lejojmë të flasë kushdo çfarëdo që i bie ndërmend.

Për sa i përket pikës për të cilën po flasim tash, në raportin e KOSTT-it, në vitin 2016, më saktësisht në gusht të vitit 2016, kur u hartua ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për energjinë elektrike, atëherë gjithnjë thuhej për t'i mbështetur parimet e liberalizimit të tregut dhe ofrimit të kushteve për një konkurrencë sa më të drejtë në treg, Kuvendi pati vendosur që Bordin e prodhuesit, KEK-ut, dhe atë të operatorit të transmisionit të mos i zgjedhë organi i njëjtë institucional, pra Qeveria. Duke qenë kërkesë e procesit të integritit dhe implementimit të qëllimeve të pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë, Kuvendi e pranoi që një ndërmarrje publike të vepronte në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, përzgjedhja e Bordit, pronësia dhe raportimi t'i kalojnë Kuvendit. Kësisoj, ky është raporti i parë që Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar nga organizata, ose kompania që e rregullon transmisionin në Republikën

e Kosovës, KOSTT-in, dhe tash e kemi për diskutim edhe në seancë plenare me një vonesë jashtëzakonisht të madhe.

Para se të ngre disa konkrete që ky raport i trajton është e domosdoshme ta kujtojmë shkeljen flagrante të ligjit që bëri kryeministri Haradinaj. Më 29 shtator 2017, kryeministri Haradinaj mori vendim për shkarkimin e dhjetë anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike. Në mesin e këtyre vendimeve kishte edhe shkarkime në Bordin e Ndërmarrjes Publike KOSTT, ndërmarrje kjo e cila, siç e dini, nga muaji gusht 2016 ka qenë de facto agjenci e pavarur në kompetencë të Kuvendit. Me miratimin e pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë vitin e kaluar, aksionar i KOSTT-it është Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili edhe emëron edhe shkarkon anëtarët e Bordit të KOSTT-it. Siç është përcaktuar në nenin 14, paragrafi 15 i këtij ligji, dispozitat e ligjit për ndërmarrje publike lidhur me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit, kompensimin e Bordit të Drejtorëve dhe raportimin, si dhe emërimin e komisionit të auditimit, nuk vlen për operatorin e sistemit të transmisionit. Dhe, të gjitha kompetenca ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Megjithatë, Ligji për ndërmarrjet publike vazhdon të aplikohet për të gjitha çështjet tjera, të cilat ndërlidhen me veprimtarinë e KOSTT-it.

Dispozitat e ligjit në fuqi janë të qarta, e po ashtu i njëjti përmban klauzolën standarde mbi hyrjen në fuqi të ligjit, që nënkupton se efekti juridik i ligjit ka plot përçueshmëri me skadimin e afatit 15-ditor nga publikimi në Gazetën Zyrtare. Asnjë bazë juridike nuk e ka pasur Qeveria për shkarkimin e Bordit të KOSTT-it. Në këtë kuptim, shkarkimi i anëtarëve të KOSTT-it paraqet ndërhyrje në kompetencat e Kuvendit të Kosovës. Vetëm Kuvendi i Kosovës ka autoritet ligjor për shkarkime dhe emërimë në Bordin e KOSTT-it. Ne si grup e kemi kundërshtuar këtë vendim edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe kemi kërkuar revokim të këtij vendimi.

Me sa jam në dijeni, ky komision i ka dërguar letër kryeministrit qysh në dhjetor të vitit 2017 për të kërkuar sqarim për këtë veprim, por kanë kaluar më shumë se tre muaj dhe nuk ka asnjë përgjigje nga kryeministri. Ky veprim i zotit Haradinaj është cenim i pushtetit të Kuvendit si organi më i lartë legjislativ, që i është besuar kjo kompetencë me bazë ligjore.

Ne si grup e kemi shqyrtuar raportin vjetor të KOSTT-it dhe i kemi disa vërejtje që në të ardhmen nuk do të duhej të na përsëriteshin prapë në raporte të tilla. Në përgjithësi, raporti përmban informata të shumta, por që do të duhej të ishin më mirë të organizuara. Do të ishte e domosdoshme që raporti të jetë më sqarues, me analiza më të hollësishme, me afate kohore të aktiviteteve të ndërmarra dhe rezultate konkrete. Meqë është viti i parë që Kuvendi e pranon një raport të tillë, ka qenë e domosdoshme që aty të përfshihen të dhëna krahasuese me vitet tjera. Kjo do të na ndihmonte për ta krijuar një pasqyrë më të qartë të tregut dhe fushës që mbulon institucioni.

Siç e ka vlerësuar edhe organizata INDEP, ky raport e ka respektuar pjesërisht manualin për raportim të agjencive të pavarura. Në raport është përfshirë një pjesë e asetëve që ka në posedim KOSTT-i, si dhe asetet të cilat kanë kaluar nga KEK-u në KOSTT. Është raportuar transferimi i asetëve si nënstacione 100-kilovoltëshe, ku në raport thuhet se mbetet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri, i cili do të funksionalizohet hap pas hapi. Këtu e kam fjalën në raport për tri asete të sistemit tonë energjetik, pra në nënstacionin Vallaq dhe Zubin-Potok, si dhe hidrocentralin në Ujman, të cilat realisht janë jashtë kontrollit edhe të KOSTT-it, por në përgjithësi të Republikës së Kosovës.

Problematik mbetet fakti që nuk ka një afat kohor në raport të përcaktuar nga KOSTT-i për zgjerimin e kontrollit të plotë mbi asetet e veta, e që do të na e lehtësonte edhe neve punën në monitorimin e këtij veprimi. Do të duhej të kishte edhe një plan të detajuar nga KOSTT-i për përmirësimin e asetëve të transferuara nga KEK-u, pasi gjendja e tyre paraqet kërcënim të performansës së furnizimit dhe kosto shtesë. Do të ishte e rëndësishme që në raport të përfshihej edhe një listë e të gjitha asetëve që ka në pronësi KOSTT-i. Në planin zhvillimor të transmisionit janë paraqitur projektet dhe shihet se një numër i madh i tyre nuk ka arritur të përfundojë sipas planifikimit në vitin 2016. Nuk ka të dhëna që tregojnë se përse janë shkaktuar këto vonesa. Në krahasimin që organizata INDEP u ka bërë projekteve në planin zhvillimor të operatorit të sistemit të transmisionit me raportimin që është dhënë për një pjesë të konsiderueshme është raportuar vonesë në implementim, por nuk janë sqaruar arsyet.

Është e domosdoshme që për secilën të jepen arsyet e vonesave, qoftë në fillim, qoftë në përfundim të projekteve.

Raporti po ashtu evidenton problemin e madh që kemi me futjen në funksion të linjës interkonjeksionit Kosovë - Shqipëri. Siç e dini, që të bëhet i mundur operimi i kësaj linje duhet që sistemi i transmisionit të Kosovës, pra KOSTT-i, të njihet si i mëvetësishëm nga ENSO/C, që është rrjeti i transmisioneve të Evropës. Pra, të njihet ndarja e sistemit të transmetimit të Kosovës nga sistemi i transmetimit të Serbisë. Edhe pse raportohet shkurtimisht për këtë çështje, e vlerësohet si një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme në raport, nuk ka asnjë afat kohor e as plan për ndonjë veprim, ose propozim sesi do të duhej të zgjidhet kjo çështje.

Janë bërë më shumë se një vit që nga 28 qershori 2016, që kur është bërë inaugurimi i linjës së interkonjeksionit Kosovë - Shqipëri. Bllokimi i linjës së transmetimit të energjisë Kosovë - Shqipëri ka krijuar kosto të shumëfishtë për të dyja shtetet. Humbjet vjetore të përbashkëta llogariten në 15 milionë euro, pa përfshirë këstet e borxhit, që qeveritë e të dyja anëve kanë nisur t'i shlyejnë tashmë. Dhe, këtu vjen në shprehje çështja e marrëveshjes me Serbinë, e cila në njëfarë mënyre e parasheh pavarësimin e KOSTT-it, por ky pavarësim i KOSTT-it është i lidhur me një vartësi të re të sistemit energjetik të Republikës së Kosovës, që sipas asaj marrëveshjeje do të duhej që të zbatohet, e kjo është kompania e re, që nuk do të ishte asgjë tjetër, përveçse

zgjatim i kompanisë publike të Serbisë, e që do të ofronte edhe furnizim me energji elektrike në territorin e Republikës së Kosovës, po besa, sipas marrëveshjes, do të ofronte edhe shërbime të distribucionit për pjesë të caktuara të territorit të Kosovës.

Dhe, në këtë mënyrë, edhe pse KOSTT-i do të pavarësohej formalisht nga rrjeti i transmetimit, siç shihet sot të jetë pjesë e rrjetit të transmetimit të Serbisë, realisht sistemi energjetik i Kosovës do të hapej ndaj atij të Serbisë nëpërmjet kësaj kompanie dhe kjo do ta rriste jashtëzakonisht shumë rrezikun në qëndrueshmërinë e sistemit tonë energjetik dhe do ta rriste jashtëzakonisht shumë edhe mundësinë e ndërhyrjes së Serbisë në këtë sistem të energjisë.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik vitin e kaluar i pati rekomanduar ish-ministrit të Zhvillimit Ekonomik marrjen e masave konkrete reciproke për mbrojtjen e interesave ekonomike të Kosovës. Ne nuk mund të presim pafundësisht për këtë. Është e domosdoshme që të ndërmerren masa që ta kushtëzojmë Serbinë. Ne si grup rekomandojmë koordinim shumë më të drejtpërdrejtë e më serioz me Tiranën zyrtare për të ndërmarrë masa konkrete në drejtim, së pari pavarësimin të KOST-it dhe pastaj edhe intensifikimin dhe mirëpërdorimin të rrjetit të interkonjeksionit, që do t'i lidhte dy tregjet e energjisë dhe do ta krijonte një balancë të energjisë elektrike dhe kështu do ta shfrytëzonim komplementaritetin, të cilin e kemi të dyja vendet në fushën e energjisë. Kjo edhe do të mundësonte furnizim më të mirë me energjinë elektrike, e veçanërisht siguri të furnizimit të transmetimit të energjisë elektrike, jo vetëm për rajonin, por siç u tha më herët edhe për Evropën, në përgjithësi.

Në anën tjetër, edhe nga raporti shihet që në tregun e energjisë në Republikën e Kosovës ka një monopol privat, i cili është krijuar nga privatizimi i distribucionit dhe furnizimit në vitin 2013 dhe gjithsesi përgjigja ndaj këtij monopoli privat nuk mund të jetë liberalizimi privat i tregut, por do të duhej të ishte një përgjigje tjetërfare, e ajo është që sistemin e energjisë në Republikën e Kosovës ta konsiderojmë si infrastrukturë të zhvillimit ekonomik dhe në të mirë të publikut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri! Nga AAK-ja, s'është paraqitur kurrkush. Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë po e filloj diskutimin tim rreth raportit të KOSTT-it me atë që vonesa e këtij raporti dëshmon edhe një herë që bordet dhe ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës janë minishtete, janë shtete më vete dhe ato dërgojnë raporte kur t'u teket, i përpilojnë raportet në mënyrën qysh atyre u teket, pavarësisht ka apo nuk ka argumente dhe dëshmi.

Në anën tjetër, e dëgjova kolegun tim, Visarin, i cili tha që ne në të ardhmen duhet ta kushtëzojmë Serbinë. Do të ishte një mrekulli e vërtetë, sikur Qeveria jonë të arrinte, ose

Parlamenti, që ta kushtëzonte Serbinë, por për pozicionin që jemi, për fat të keq, ne nuk po arrijmë t'i kushtëzojmë as deputetët e Listës serbe, të cilët sot, për shembull, nuk e dhanë votën për të kaluar marrëveshja ndërmjet Hungarisë dhe Kosovës, që ishte thjesht një marrëveshje për ndërrimin e të burgosurve, që i vuajnë dënimet, qoftë në Hungari, qoftë në Kosovë. Kjo është temë e rëndë. Pse? Por, sidoqoftë, nuk është diçka e mirë.

Sa i përket linjës ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, si deputet dëshiroj të them që ne në të shumtën e rasteve fajtor kryesor e lëmë Serbinë, ashtu sikur Serbia sa herë të dojë t'i rregullojë punët e veta të brendshme fajtor numër një e lë Kosovën, sepse pa e sharë Kosovën në Serbi nuk mund të fitosh vota.

E vërteta e hidhur dhe shumë e dhembshme është se në hulumtimet që i kanë bërë gazetarët e Kosovës, pengesat kryesore për këtë linjë kanë ardhur pikërisht nga Qeveria shqiptare në Tiranë. Dhe, sot, mosmarrëveshjet ose mosfunksionimi i linjës 400-kilovoltëshe ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është pikërisht pengesa e Tiranës dhe pengesa e Qeverisë së kaluar, sepse Qeveria aktuale nuk ka arritur të bisedojë rreth këtij problemi, por kanë qenë mosmarrëveshjet ndërmjet këtyre dy qeverive.

Unë po e ilustruj me një shembull këtë gjysmë-akuzë publike që po e bëj, me faktin se Pandeli Majko, zyrtar i lartë në Qeverinë e Shqipërisë, pati premtuar që më 1 janar 2018 do të hapet kufiri ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë dhe më nuk do të ketë kontroll. Kur nuk ndodhi një gjë e tillë, ai doli hapur dhe tha se këtë nuk e lejon mafia ekonomike ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Shqipërisë. Domethënë, nuk jemi ne ata, as Parlamenti, as Qeveria, që e rregullon tregun energjetik në trekëndëshin Kosovë - Tiranë - Serbi, por është një treg mbi qeveritë, që është një treg mafioz, të cilët shesin dhe e blejnë energjinë elektrike sipas interesave të tyre.

Atyre që u kujtohet, me siguri e mbajnë mend që këtë shqetësim e ka paraqitur edhe kryeministri Ramush Haradinaj në vizitën e parë që ia bëri KEK-ut. E tha publikisht për herë të parë një kryeministër, të paktën e pranoi se këtu kemi të bëjmë me një treg mafioz që e shet energjinë dhe e blen nga vendet tjera qysh t'i teket. Besoj, disa deputetëve u kujtohet ministrja, edhe pse është kohë shumë e kaluar dhe shumë e vjetër, për mua nga më të mirat që kanë pasur qeveritë e kaluara, zonja Justina Pula. Pikërisht pse ajo ka dashur ta rregullojë tregun energjetik, ajo më kurrë s'ka marrë vota, as s'ka ardhur në Parlament. Ajo ka qenë personi i parë që e pati denoncuar marrëveshjen e dhembshme ndërmjet Ferronikelit dhe KEK-ut, e Ferronikeli për tetë vjet me radhë ka blerë energji elektrike 1 MW me 33 euro dhe të njëjtin MW Qeveria dhe shteti i Kosovës e ka blerë jashtë territorit të Kosovës me një kosto prej 120 eurosh. Domethënë, në momentin që energjia ka ardhur prej Rumanisë, ose prej Serbisë, dhe ka hyrë në transmetuesin e Kosovës me çmimin 120 euro, kjo energji nga KEK-u në Obiliq i është dërguar Ferronikelit me çmimin 33 euro. Domethënë, ka qenë një çmim fiks.

Prandaj, mbi bazën e kësaj po e përfundoj fjalimin tim, duke theksuar edhe një herë qëndrimin tim edhe të Nismës, se ne jemi për atë që në mënyrë sa më të shpejtë ta bëjmë privatizimin e të gjitha ndërmarrjeve publike, ngase nga përvoja e kaluar të gjithë e dimë se vetëm në ato prona që ne i kemi quajtur “prona të dërzhavës”, në ato prona është vjedhur dhe në ato prona po vazhdon të vidhet. Është vjedhur dhe po vidhet në Postë-Telekomin e Kosovës, po vazhdon të vidhet në Vala, po vazhdon të vidhet KEK-u. Prandaj, në qoftë se arrijmë t’i privatizojmë ndërmarrjet publike sa më shpejt, atëherë mund ta stopojmë një hajni të tillë, përndryshe do të vazhdojë kështu edhe nja 10-20 vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e shqyrtojmë një raport vjetor të një ndërmarrjeje publike, siç është operatori i sistemit të transmissiionit dhe të tregut KOSTT, që është një operator jashtëzakonisht i rëndësishëm për jetën e qytetarëve, për cilësinë e jetës së qytetarëve, e në veçanti për ekonominë e vendit.

Është shqetësuese që në këtë shqyrtim, diskutim, por edhe orientimet për të ardhmen e këtij raporti të një prej ndërmarrjeve publike jashtëzakonisht të rëndësishme, bordin e së cilës e emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk është i pranishëm asnjë ministër i Kabinetit qeveritar. Ky është joseriozitet, është qasje joserioze, së pari ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës, si të zgjedhur dhe përfaqësues të popullit, dhe kjo e tregon papërgjegjësinë dhe humbjen e rrugës së kësaj Qeverie, sepse këtu është dashur të jetë së paku ministri i Zhvillimit Ekonomik, po edhe ministra të tjerë të linjës që kanë të bëjnë me dikasteret ekonomike dhe aspekte të ngjashme zhvillimore për vendin.

Ky raport vjen me vonesë, nuk ka informata të sakta, janë informata të mangëta, ka vakum dhe diskrepancë mes informacioneve që janë sjellë në këtë raport, mungon vizioni dhe strategjia për orientim në të ardhmen të një ndërmarrje publike kaq të rëndësishme për jetën, por edhe për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Është më se e vërtetë që ka edhe probleme politike, ka keqmenaxhim, ka neglizhenca, ka keqpërdorime dhe unë dua të besoj që një herë e përgjithmonë Kuvendi i Republikës së Kosovës që i zgjedh anëtarët e Bordit menaxhues të KOSTT-it, po edhe të kompanive të tjera publike, të adresojë në mënyrë të saktë dhe me kompetenca dhe orientime të qarta dhe të mbikëqyrë që është detyrë jona kushtetuese e ligjore një herë e përgjithmonë këto kompani publike që ndikojnë drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve të Kosovës, në cilësinë e jetës së tyre, në zhvillimin e ekonomisë dhe fushave të tjera.

Pse nuk po implementohet projekti i largpërçuesit 400 kilovolt me Shqipërinë? Kush po e pengon? Kujt po i shkon në llogari ky prolongim? I dimë problemet me fqinjët tonë verior, Serbinë, i dimë problemet që KOSTT-i nuk mund të operojë fare në pjesën veriore, por vërtet këtu bëhet fjalë për një mafi të tregut të energjisë, për një mafi ekonomike dhe populli dhe shteti më i varfër në Evropë paguan tarifën më të larta të energjisë elektrike në kontinent.

Definitivisht tani si deputet dhe qytetar që ua paguaj këto shërbime këtyre ndërmarrjeve publike, çfarë po ndodh dhe çfarë duhet të bëjmë?

Shihet haptas që ka monopol të tregut të energjisë në Kosovë dhe janë 4-5 kompani me emra të përveçëm nga ekonomia dhe politika që ka të bëjë edhe me rajonin, jo vetëm me politikanët shqiptarë, e po më duket që ka ardhur koha t'i adresojmë dhe duhet të marrim masa efektive, duhet t'i shporrim këta matrapazë që po e zhgërryjnë ekonominë dhe cilësinë e jetës të familjeve, të bizneseve dhe të ekonomisë së vendit.

Duhet ta ndërtojmë një kulturë të kontinuitetit institucional. Vjen Qeveria e re në mënyrë jo të ligjshme i shkarkon tre anëtarë të Bordit, po nuk po më intereson i cilit subjekt politik është, e shkarkon drejtorin ekzekutiv të KOSTT-it një doktor shkence të ekonomisë, i cili filloi t'ua rruhdë shpenzimet enorme dhe të shfrenuara këtyre anëtarëve të këtij Bordi dhe elementeve të tjerë që e kanë dëmtuar këtë ndërmarrje publike.

Prandaj, çka të themi në fund. Kërkoj që ky Parlament t'i kthehet punës normale, t'i kthehet detyrës kushtetuese dhe obligimit karshi qytetarëve të vendit që e kemi dhe këto tema që na prekin të gjithëve, t'i trajtojmë si qytetarë pa ngjyrimet politike.

Unë uroj që drejtori ekzekutiv, profesor doktor Mustafë Hasani, që do ta fitojë gjyqin dhe ai Bord i politizuar, i cili tani e padit Qeverinë, e ka marrë një hap joligjor dhe tani për një hap joligjor që e bëri kjo Qeveri që erdhi tani dhe ku shkojmë kështu me këtë logjikë, me këtë logjikë komplet antiligjore dhe klandestine.

Uroj që KOSTT-i dhe institucionet kompetente që e mbikëqyrin punën e tij thjesht t'i dhënë rekomandimet e nevojshme dhe ky institucion kaq i rëndësishëm për tregun e energjisë në Kosovë t'i kthehet normalitetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Elmi Reçica e ka kërkuar fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Përshëndetje kolegë deputetë,
Përshëndetje për të gjithë qytetarët e Kosovës,

Realisht ne jemi duke trajtuar një pikë që është shumë me rëndësi dhe që çon peshë dhe u deklaruan edhe kryetarja e komisionit, edhe në emër të Komisionit Funkcional, po edhe në emër të grupit parlamentar.

Nuk kisha në plan të diskutoj, mirëpo po më pengon një çështje, e cila po diskutohet për herë të dytë këtu.

Çështja e shkarkimit të kryeshefit ekzekutiv të KOSTT-it.

Ata të cilët e përmendën paraprakisht që është shkarkuar, se kush e ka shkarkuar, kush ka qenë kryetar i Bordit, me iniciativën e kujt është shkarkuar dhe të mos derdhin lot krokodili tash këtu.

Nuk është e ndershme, nuk është në rregull, nuk është as e moralshme që të hapet kjo temë, ndërsa e dinë saktësisht kush e ka shkarkuar, me iniciativën e kujt dhe pse e ka shkarkuar.

Është e vërtetë që është një betejë ligjore dhe ajo është çështje e institucioneve të gjyqësisë, po krejt ata që folën në emër të ish-kryeshefit kanë mundur ta pengojnë shkarkimin e tij dhe esenca është që ne duhet ta diskutojmë raportin këtu, i cili ka të dhëna të bollshme dhe në të cilin raport ne duhet të bazohemi dhe duhet ta kalojmë, këtë desha ta them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rugova ka replikë.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po, ne e dimë kush ka qenë kryetar i Bordit dhe ne jemi vetëkritikë dhe personalisht e potencova, nuk më intereson cilit subjekt i përkasin, kanë menaxhuar keq dhe e kanë shkarkuar një njeri profesionist, i cili ka filluar të vejë rregull në atë institucion, ka filluar t'i ruajë asetet dhe buxhetin e atij institucioni dhe ata njerëz që e kanë bërë atë shkarkim i ka paditur në gjyq dhe do të përballen me drejtësinë. Edhe kryeministri ka bërë gabim dhe shkelje ligjore pse e ka shkarkuar këtë Bord. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Zoti Rugova, diskutoni këtë çështje brenda subjektit tuaj, absolutisht diskutoni brenda subjektit tuaj dhe ju jeni ata të cilët e keni shkarkuar këtë drejtor, njerëz që ju i keni mbështetur dhe ai është thirrur në institucione dhe individ të caktuar dhe mesazhin ua ka treguar të gjithë atyre të Bordit se në emër të kujt po shkarkohet ai.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shala-Berisha e ka fjalën, e fundit është.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Në cilësinë e kryetares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, ku edhe vinë këto raporte, për hir të së vërtetës dhe njoftimit të drejtë të opinionit publik, të cilët na përcjellin këtu. Disa parafolës më herët iu referuan se agjencitë e pavarura, përfshirë edhe këtë institucion, raportojnë kur të donë, bëjnë çka donë, sillen si pashallëqe e kështu me radhë, kjo është e pavërtetë.

Fjala është për KOSTT-in tani që e kemi në diskutim, raportin e punës e ka sjellë me kohë në Kuvend bazuar në ligjin që e rregullon. Këta në qershor të vitit kalendarik i përfundojnë raportet e punës dhe i dorëzojnë në Kuvend.

Më 30 qershor e kanë dorëzuar raportin në Kuvendin e Kosovës, ne e dimë se ka qenë koha pas zgjedhjeve parlamentare, domethënë të vitit 2017. Komisioni parlamentar në momentin kur është konstatuar Kuvendi dhe trupat e Kuvendit, siç janë komisionet funksionale, e ka shqyrtuar me kohë këtë raport dhe e ka shqyrtuar po e përsëris edhe një herë që të përcjellin diskutimet e kolegëve të tjerë që flasin veç atë që e paramendojnë vetë, më 15 dhjetor e ka shqyrtuar komisioni, e ka miratuar.

Prandaj, vonesat pse sot në prill të vitit 2018 diskutohet ky raport kanë mbetur te Komisioni i Buxhetit, i cili nuk e di për çfarë arsye apo ndoshta për shkak të volumit të punëve që e ka pasur nuk e ka futur në rend dite me kohë dhe sigurisht që do të tingëllojë se është raport i sjellë me vonesë.

Raporti i plotëson të gjitha kriteret ligjore, i ka të dhënat relevante, është raport i vitit të punës për vitin 2016, jemi në vitin 2018, prandaj nuk është mirë të fliten të pavërteta, për çka unë e përgëzoj edhe KOSTT-in, me gjithë vështirësitë që i ka pasur karshi relacioneve të brendshme e të jashtme, e ka bërë një punë të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli është lajmëruar, veç me vonesë je lajmëruar, Islam.

ISLAM PACOLLI: Me rëndësi është të lajmërohesh, zoti kryesues!

Faleminderit, kryesues!

Me të vërtetë të flasësh për raportin e vitit 2016, është goxha i vonuar dhe nuk ia vlen të flitet për të.

Po ajo që po më intereson mua, çështja e rregullatorit, njerëzve që kanë marrë vendime për ndëshkimin e qytetarëve duke i fryrë faturat, a është marrë ndonjë hap në këtë drejtim?

Dhe, e dyta, a ka marrë ndonjë vendim Qeveria që ta kompensojë qytetarin, të cilin e ka mbingarkuar me kosto, të cilën nuk e ka shfrytëzuar?

Nëse jo, unë kërkoj nga Qeveria që ta ndërmarrë këtë hap dhe t'u kthehen të hollat atyre qytetarëve që u janë marrë padrejtësisht, për arsye që qytetari asnjëherë nuk është furnizuar në mënyrë adekuate me energji elektrike dhe është mbingarkuar me koston, të cilën nuk e ka shfrytëzuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. E kemi kuorumin e duhur për ta votuar raportin.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Përgatitemi për votim, regjia, besoj, që jeni gati, votojmë tani:

Si zakonisht kur nuk duan ta identifikojnë votën, i kemi 64 këtu, po nuk po donë të votojnë.

Votoni kundër, po nuk bëhet kiameti, veç ta kalojmë, të mos e sjellim edhe një herë, kush do kundër, kush do për.

Kemi kuorumin e mjaftueshëm, i kemi 74 deputetë.

Ju lus që të përgatitemi për votim, regjia, votojmë tani:

Faleminderit!

Kanë votuar 74 deputetë, për janë 47, kundër janë 24 dhe 3 abstenime.

Konsideroj që Kuvendi e miratoi raportin e operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut KOSTT sh.a. për vitin 2016 me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Sipas marrëveshjes në mes të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe kryetarit të Kuvendit, pika dymbëdhjetë e rendit të ditës ka mbetur të shqyrtohet në një mbledhje tjetër më vonë.

13. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Përfaqësues të Qeverisë nuk paskemi. Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Sala Berisha-Shala, që ta arsyetojë dhe ta paraqesë raportin e komisionit.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2018 e shqyrtoi listën

e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të propozuar nga Qeveria më 22 janar 2018 dhe vendosi këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohen gjashtë kandidatët e propozuar nga Qeveria për anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si vijon:

1. Hasime Mazreku,
2. Skender Komoni,
3. Ranko Gjokiq,
4. Qemajl Bahrami,
5. Bekim Selimaj dhe
6. Avni Ajdini.

Qeveria e Republikës së Kosovës në kundër të përgjegjësive të veta ka nxjerrë vendimin dhe i ka propozuar Kuvendit këta kandidatë dhe komisioni menjëherë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën që u përmend më lart konstatoi se kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, andaj propozon Kuvendit ta miratojë listën e kandidatëve të propozuar nga Qeveria për këtë bord.

Dëshiroj ta shfrytëzoj rastin që t'i bëj ftesë Qeverisë që sa më parë t'i sjellë të gjitha propozimet dhe të plotësohen ato agjenci që ende kanë vakum të plotësimit të bordeve me kandidatë të propozuar.

Ju ftoj, të nderuar kolegë deputetë, që ta miratojmë këtë listë, e cila është mbështetur unanimisht nga kolegët e mi deputetë, të cilët i falënderoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

LDK-ja, Avdullah, nuk doni të flisni? Jo.

Atëherë, zoti Memli Krasniqi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për sa na përket neve, e mbështesim edhe atë që e tha kryetarja e komisionit dhe mendojmë që duhet të kalojë në votim dhe e mbështesim me votë formale.

KRYESUESI: Vetëvendosje nuk është paraqitur, e doni fjalën? Jo! Dardan Sejdiu, Grupi i Deputetëve të Pavarur.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Veç për sqarim, kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik tha që është përkrahur njëzëri, por nuk e kuptova a e kishte fjalën për komision apo e kishte fjalën për deputetë? Ajo nëse ka të bëjë me komision, aty jam nënkryetar, kemi qenë dakord që ta procedojmë në Kuvend, por jo ta përkrahët, veç të jetë në procedurë, sa për sqarim për deputetë të tjerë.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur.

As përfaqësuesin e Qeverisë nuk e kemi në sallë.

Dikush tjetër nuk është paraqitur.

74 deputetë janë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Nuk ka votues të mjaftueshëm, nuk ka kuorum.

Atëherë, para se të shkojmë në pauzë, propozoj ta bëjmë një votim të fshehtë të dyja përnjëherë.

14. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovë dhe

15. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Administrata i ka përgatitur fletëvotimet të gjitha, mirë është që grupet parlamentare t'i propozojnë anëtarët e Komisionit votues.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, kë e propozon? Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Deputetin Fidan Rekalii.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Ne e propozojmë si anëtare Evgjenia Thaçin.

KRYESUESI: Zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetin Valon Ramadanin.

KRYESUESI: Deputetët e Pavarur, kë e kanë?

SHQIPE PANTINA: Deputetin Salih Salihu.

KRYESUESI: Në rregull, AAK-ja, Dauti e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Deputetin Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Lista serbe, Slavko, zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa Srpske liste predlaže uvaženu koleginicu Jelenu Bontić. Hvala!

KRYESUESI: Nisma, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Deputetin Enver Hotin, kryesues.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”. Ndoshta bashkëngjitet “6+”, e propozojnë dikë.

Atëherë lus teknikën që të fillojnë përgatitjet, edhe anëtarët e komisionit që t’i zënë vendet e votimit.

* * *

KRYESUESI: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-146, për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e drejtorit të kësaj agjencie nga dy kandidatët e propozuar.

Komisioni ka propozuar dy kandidatura, njëri prej të cilëve duhet të zgjidhet, janë:

1. Arbër Hadri dhe
2. Driton Mulaj.

Ndërsa, po ju jap sqarimin tjetër ju njoftoj se në pajtim me nenin 10.1., 10.5., 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve, Kuvendi duhet të zgjedhë tre anëtarë me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë nga kandidatët e propozuar.

Kandidatët janë:

1. Violeta Hyseni-Kelmendi dhe
2. Shqipe Breznica.

Për një anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit serbë propozohen kandidatët, si në vijim:

1. Maja Slaviq dhe
2. Nenad Janiqeviq.

Për një anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve tjera, propozohen kandidatët, si në vijim:

1. Biroll Urxhan dhe
2. Mejdin Salihi.

Nëse janë deputetët e “6+” i lus që të marrin pozicion në komision. Tani po filloj të ju ftoj një nga një:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalu, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

E konstatoj që Bahrim Shabani është anëtar i komisionit në emër të “6+”.

* * *

KRYESUESI: Komisioni është i gatshëm. Regjia, ju lutem, hapeni mikrofonin për komisionin.

SALIH SALIHU: Atëherë, të nderuar deputetë, po e bëjmë leximin apo numërimin e votave për kandidatë për drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës:

Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,

Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Arbër Hadri,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,

Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
Arbër Hadri,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri,
E pavlefshme,

Na duhet një konsultim i vogël.

E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
Driton Mulaj,
E pavlefshme,
Driton Mulaj,
Arbër Hadri dhe
Driton Mulaj.

KRYESUESI: Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, fjalën komisionit, ju lutem!

SALIH SALIHU: Atëherë, të nderuar kolegë, Komisioni votues për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatin e votimit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Në mbështetje të neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Votues i formuar me vendim të Kuvendit më 17 prill 2018, në përbërje nga një përfaqësues nga secili grup parlamentar, s'po i numëroj me emra.

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 17 prill 2018, konstaton se:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë:

- Të pavlefshme janë 27 votime.
- Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Arbër Hadri i ka fituar 23 vota,
2. Driton Mulaj i ka fituar 42 vota.

Anëtarët e komisionit janë nënshkruar dhe gjithçka ka shkuar në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që sa u përket dy kandidaturave për mbikëqyrjen e komplekseve, respektivisht Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës nuk ka fituar asnjëri. Përsëritet konkursi.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, ju lutem fjalën komisionit.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA : Faleminderit, i nderuar kryesues!

Tani do t'i lexojmë rezultatet për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieeve.

Votat e para janë këto:

Violeta Hyseni-Kelmendi,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mejdin Saliji,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
E pavlefshme,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mejdin Saliji,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,

Maja Slaviq,
Mejdin Saliji,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mejdin Saliji,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mejdin Saliji,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Biroll Urxhan,
E pavlefshme,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Nenad Janiçeviq dhe
Mejdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Biroll Urxhan,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mejdin Salihi,
Shqipe Breznica,
Mejdin Salihi,
Maja Slaviq,
E pavlefshme,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,

Maja Slaviq,
Mejdin Salihi,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mejdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq,
Mejdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq,
Birol Urxhan,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Birol Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq,
Birol Urxhan
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq
Birol Urxhan,
Shqipe Breznica,
Mehdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq,
Birol Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi

Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Shqipe Brenzica,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Nenad Janiqeviq,
Biroll Urxhan
Violeta Hyseni-Kelmendi
Biroll Urxhan
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Nenad Janiqeviq,
Mehdi Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan.
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
E pavlefshme.
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Mehdin Salihi,

Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urqan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq
Mehdin Salihi,
Shqipe Brenzica,
Maja Slaviq,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq
Biroll Urxhan
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq
Mehdi Salihi,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Shqipe Breznica,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mehdi Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Bioroll Urxhan,
Shqipe Breznica,
Mehdin Salihi
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq

Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Shqipe Breznica,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Maja Slaviq,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
E pavlefshme,
Shqipe Breznica,
Shqipe Breznica,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Mehdin Salihi,
Shqipe Breznica,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan,
Violeta Hyseni-Kelmendi,
Maja Slaviq,
Biroll Urxhan.

KRYESUESI: Regjia, fjalën Komisionit!

EVEGJNI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,

Komisioni votues për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve, paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve

Në mbështetje të neneve 65 dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 10.1, 10.5, neni 11, 13 të Ligjit 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit më 17 prill 2018, me përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve, në seancën plenare, të mbajtur më 17 prill 2018, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë, të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë janë, si në vijim:

1. Violeta Hyseni-Kelmendi i ka fituar 54 vota dhe
2. Shqipe breznia i ka fituar 28 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit serb janë, si në vijim:

1. Maja Slaviq i ka fituar 58 vota dhe
2. Nenad Janiqeviq i ka fituar 3 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuara për një anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve tjera janë, si në vijim:

1. Birol Urxhan i ka fituar 36 vota dhe
2. Mehdi Salihi, ka fituar 25 vota.

Faleminderit!

KRYESUESI: Në bazë të raportit të Komisionit votues, konstatoj: Zonja Violeta Hyseni-Kelmendi zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar me mandat trevjeçar.

Zonja Maja Slaviq zgjidhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit serb me mandat trevjeçar.

Ndërsa për kandidatët e komuniteteve konkursi duhet të përsëritet, sepse asnjëri nuk i ka fituar votat e duhura.

Me kaq unë e përfundoj pjesën e paradites. Në orën 17:00 vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Kryeministri nuk është këtu për interpelancë. Kryeministri ka kërkuar zyrtarisht që interpelanca me kryeministrin të mos mbahet sot për arsytet që i ka dhënë dhe ka kërkuar që të shtyhen dhe s'mund të vijë.

Kemi interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, kemi debat parlamentar sipas Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kemi debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Ganimete Musliu, Salih Salihu, Driton Çausi e të tjerë.

Debat parlamentar me kërkesën e deputetes Shqipe Pantina, mbështetur nga 11 deputetë nënshkrues.

Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur nga pesë deputetë në lidhje me sigurinë e fëmijëve për përdorimin e internetit në Kosovë.

Tani të gjitha këto debate në qoftë se mund të arrijmë t'i mbajmë, ndoshta është mirë që kryetarët e grupeve parlamentare të thonë diçka, në qoftë se kanë ndonjë mendim. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Kryesues!

Unë sugjeroj që ta kryejmë edhe pikën 16, që është formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe gjithashtu të votojmë për pikën që hyri në rend dite për Komisionin Hetimor Parlamentar për rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Dhe, propozoj që debatet dhe interpelancat t'i lëmë për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë që të vendoset koha e mbajtjes së këtyre debateve dhe interpelancave. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe një herë Avdullah, e pate fjalën për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe të Komisionit Hetimor? A po mendon tani të vazhdojmë? Mirë, po nuk di a kemi deputetë, s'ka problem. Nëse ka deputetë të mjaftueshëm, po.

Numëroni sa deputetë janë në sallë dhe bjerini ziles, se disa kanë shkuar për drekë dhe mendojnë që në orën 17:00 mund të kthehen. Nëse doni, presim nja 10 minuta, thirrni kolegët tuaj, le të vijjnë për të votuar. Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Është e qartë që kjo seanca atë ditë kur e kemi vendosur që ka qenë seancë disaditore për vetë faktin që ka pasur shumë pika të rendit të ditës dhe që janë përfshirë pesë interpelanca dhe katër debate parlamentare.

Por, sido qoftë, unë besoj që ne duhet të vazhdojmë me seancën ashtu siç edhe është vendosur në Kryesi sipas këtij rendit të ditës. U njoftuam që kryeministri ka kërkuar që të shtyhen interpelancat e kërkuara ndaj tij, por unë besoj që ne mund të vazhdojmë me pikën që është në radhë, numër 16, dhe pastaj dalim te pika 21, që është interpelanca e ministrit të Shëndetësisë dhe të vazhdojmë me katër debatet parlamentare, si dhe të votojmë siç e keni vendosur të votojmë pastaj për Komisionin Hetimor, siç tha zoti Hoti.

Ma merr mendja që edhe nëse duhet të mbetemi pak më gjatë, siç mbetëm dje, dhe të vazhdojmë po ashtu edhe nesër, do të ishte mirë që të mundohemi ta përfundojmë këtë seancë dhe këto pika të rendit të ditës, sepse nga ajo çka po informohemi, pak formalisht e pak jo formalisht, besoj që janë edhe së paku 2-3 seanca të jashtëzakonshme në proces dhe të mos na kthehet situata që e kemi pasur gjithë këtë vit që të na mbeten 3-4 seanca në gjysmë.

Unë jam që të jepet pauza, të kthehemi në orën 17:00 dhe të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, ashtu siç i kemi miratuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Glauk, a ke ti diçka për të thënë?

GLAUK KONJUFCA: Do të ishte mirë që sot sidomos të përfundonte përcaktimi i përbërjes së Komisionit Hetimor, për arsye se nëse kjo shtyhet deri në fund të seancës apo për ndonjë ditë tjetër, unë mendoj që do t'i pamundësohej puna këtij komisioni. Pa u vendosur kush do ta drejtojë, pa u vendosur pozitat kryesore dhe që ky komision ta merrte legjitimitetin e plotë, nuk mund ta fillojë punën gjatë kësaj jave.

Pra, do të ishte shumë mirë që ne të vazhdonim me themelimin e këtij Komisioni Hetimor për rastin e depërtimit të gjashtë shtetasve turq dhe pastaj kryeministri do të ishte mirë që të ishte i pranishëm në këto interpelanca, të cilat tashmë i kemi thirrur.

Vendosja e datës 24 prill nga kryeministri si dita pas së cilës mund të marrë pjesë nëpër interpelanca është me të vërtetë joserioze dhe është shqetësuese nga kuptimi i shtyrjes për një javë ditë të interpelancave, për arsye që ne e dimë fare mirë, është e përshkruar me Kushtetutë që puna kryesore e Qeverisë është për të ardhur në Kuvend të Kosovës. Jo të mos punohet në Qeveri, të punojë në Qeveri, por Qeveria e ka në përshkrim të punës kur të punojë, që në momentin kur zyrtarisht je i thirrur në interpelancë, ajo konsiderohet njëra prej punëve më të rëndësishme të Qeverisë. Nuk është na këtu që bëjmë llafe kot me Qeverinë, por është dhënie e

Ilogarisë. E dhënia e Ilogarisë të Qeverisë në Parlament është njëra prej aspekteve më të rëndësishme të punës së Qeverisë. Kështu e kuptoj unë punën e Qeverisë.

Nuk është Qeveria veç të shkojë e të mbyllet në Kabinetin qeveritar dhe të lëshojë dekrete me nënshkrime e për të marrë vendime. Është edhe për të dhënë përgjegjësi këtu për punët që i kryen dhe për ato vendime që i merr, nëse ne e konsiderojmë si deputetë të rëndësishme këtë gjë.

Pra, arsytimi i Qeverisë që “nuk kam kohë, shihemi pas 10 dite, shihemi pas një jave” unë nuk mendoj që funksionon në asnjë vend demokratik ky raport, që është vendosur këtu ndërmjet Qeverisë sonë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, po konsideroj që ndoshta do të kishte qenë mirë që kryeministri ta gjejë një kohë që gjatë këtyre ditëve të jetë këtu, mundësisht deri të premtën të kryhen këto interpelanca dhe këto debate parlamentare.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu, në emër të Grupit Parlamentar të Pavarur.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Është tejet e rëndësishme që ky rend dite të përfundojë, pra të trajtohen temat dhe në parim jam dakord që të vazhdojmë në orën 17:00, por gjithashtu është tejet e rëndësishme që në interpelanca të jenë ata që janë të ftuar në interpelancë. Pra, në këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj është i ftuar në katër interpelanca, secila prej tyre është më e rëndësishme se tjetra dhe secila prej tyre është temë, e cila është akute dhe duhet të trajtohet me shpejtësi.

Së paku tema të cilën ne si grup e kemi ngritur, tash e tri javë pret për t’u trajtuar, e është nënshkruar në dhjetor 2017, pra kontrata me Controur Global.

Jemi që seanca të vazhdojë në orën 17:00 dhe jemi që të trajtohen temat siç duhen dhe kryeministri të jetë i pranishëm.

Nëse kryeministri e ka një arsye që të mos jetë këtu sot, vazhdojmë me tema tjera dhe nesër vazhdojmë me interpelanca, pra kur kryeministri të jetë këtu.

Mendoj që kjo javë duhet të përdoret dhe të kalojmë nëpër këtë rend dite, ta përfundojmë këtë rend dite, që të futemi në një cikël normal të diskutimeve për ligjet, e pse jo edhe nëse ka nevojë për seanca tjera të jashtëzakonshme për tema që po na shpërfaqen dita-ditës.

Pra, si Grup i Deputetëve të Pavarur jemi të interesuar që sot të vazhdojmë me seancë në orën 17:00, ndërsa për interpelanca ato të mbahen në momentin kur kryeministri të jetë këtu.

I bashkëngjitem mendimit të zotit Gonjufca që arsyetimet e kryeministrit që nuk mund të jetë në seancë deri më datën 24, përveçse janë të papranueshme sa i përket idesë së Republikës çfarë e kemi këtu, gjithashtu janë problematike sa i përket rëndësisë që i kanë temat të cilat po i trajtojmë.

Pra, mospranim e këtij këtu dhe injorimi i këtyre temave tregon për mosgatishmërinë, e pse jo edhe mospërgjegjësinë e tij për t'u ballafaquar me argumente që mendoj do të ndihmonin edhe në vendimmarrjen e Qeverisë. Fundja, ky është koncepti i një Republike parlamentare dhe koncepti edhe i një mekanizmi, i cili kontrollon punën e Qeverisë. Sot, gjatë gjithë ditës, asnjë ministër nuk ka qenë, me përjashtime të shkurtra dhe kemi trajtuar projektligje që besoj secili prej tyre do të kishte mundësi të merrte diçka të mirë, si sugjerimet që i dhanë deputetët. Për të përfunduar, pra, duhet të vazhdojmë seancën në orën 17:00 dhe duhet t'i mbajmë interpelancat këtë javë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi qenë në Kryesi, shefat e grupeve parlamentare, edhe nënkryetarët, edhe kryetari, kemi propozuar madje javën e kaluar që të mbahen interpelancat, të gjitha, ditën e premte, nuk ka pasur gatishmëri nga një pjesë e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe tash ankohen pse po vonohen. Normalisht që Qeveria ka agjendën e vet, institucionet duhet të komunikojnë mes vete, në mënyrë që t'i harmonizojnë agjendat dhe jo për inate t'i shtyjmë seancat ose të kërkojmë patjetër një ditë të caktuar, pavarësisht prej mundësive që janë. Unë mendoj që duhet një komunikim më i mirë yni, pa dallim, qoftë pozitë, qoftë opozitë, sepse në fund të fundit, kryeministri u përgjigjet interpelancave, u është përgjigjur edhe deri tani. Por, me këto interpelanca po më duket është tepruar, sepse thirren pesë përnjëherë që është problem edhe të përgatiten deputetët për pesë interpelancat, edhe Qeveria po ashtu. Prandaj, ju lutem, kurseni pak kohën, kurseni temat, sepse ka nevojë vërtet të flitet për tema në të cilat mund të kontribuojnë të gjithë.

Tani e kemi këtë situatë, unë jam që të kemi formimin e Komisionit ad hoc, siç u tha, po ashtu Komisionit Hetimor, pse jo. T'i shqyrtojmë këto, por që temat e tjera mund të mbesin edhe për nesër e më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për faktin se sot në mungesë të funksionimit të teknikës humbëm shumë kohë, është mirë që së paku nga ora 17:00 deri në orën 19:00 të vazhdojmë punën me pikat e rendit të ditës, ku ka të

bëjë me debate, sepse debatet për nga natyra mund të zhvillohen edhe pa qenë përfaqësuesit e Qeverisë këtu dhe mund të ndërpriten në orën 19:00 ose 19:30, pastaj të vazhdojmë nesër në orën 10:00, derisa të përfundojnë debatet. Nesër mund t'i kryejmë debatet, pastaj brenda javës të shohim në bashkëpunim me kryeministrin se kur mund të jetë ai këtu për të filluar punën e interpelancave, sepse jam i sigurt që edhe interpelancat të shumta në numër nuk do të mund të përfundojnë për një ditë, mbase jo edhe për dy ditë, për faktin se 4-5 interpelanca deri në tri orë zgjat një interpelancë, nëse kemi parasysh pastaj pushimin e drekës e kështu me radhë, dy ditë sigurisht do t'i marrin vetëm interpelancat.

Nëse arrijmë ta përfundojmë deri të premten këtë rend të ditës kaq të ngjeshur, do të isha i kënaqur. Besoj që edhe të gjithë deputetët do të ishin të kënaqur, sepse do të përbënte një efikasitet vërtet shumë të madh nëse këto pika të rendit të ditës, pesë interpelanca, katër debate, do të mund të përfundonin brenda tri ditëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Thjesht, për të qenë korrekt në diskutimin që ka ndodhur në mbledhje të Kryesisë së Kuvendit, zoti Isufi na ka prezantuar ditën e premte si të vetmen mundësi për të ecur përpara. Në parim kjo është problematike kur kryeministri i cakton agjendë Kuvendit. Pra, si qasje është problematike, ne kemi filluar punën dje, sot, nesër përsëri tri ditë kaluan, pra veç të premten ka pasur mundësi të trajtohen temat. Kuvendi është i interesuar t'i trajtojë temat, interpelancat nuk kanë ndodhur në të njëjtin minutë, në të njëjtën ditë, kërkesat për interpelancë, por kanë ndodhur varësisht prej situatës dhe rrethanave që janë krijuar dhe që janë mbledhur është deri diku edhe përgjegjësi e mospasjes së hapësirës së kryeministrit, ashtu bile po shprehet, për të qenë këtu, për t'i trajtuar temat.

Pra, të mos e vendosim diskutimin në njëfarë, kështu bardh e zi, sepse nuk është ashtu, është thënë të premten mundet, aty është edhe kryetari i Kuvendit, ka qenë i pranishëm, të premten mundet ose nuk mundet, nuk e dimë kur mundet tashmë. Dhe, kjo nuk është qasje, e cila i bën nder as Kuvendit, as Qeverisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë po them një mendim timin nga praktika që edhe e kam parë. Mendoj këto katër debate që janë, ne do të kishim mundësi shumë lehtë që të merremi vesh që kryetarët e grupeve parlamentare të flasin 10 minuta ose përfaqësuesit që duan të flasin në emër të grupeve parlamentare dhe ta reduktojmë kohën në pesë minuta të diskutimeve, ndoshta kishim mundur t'i kryejmë brenda ditës ose brenda dy dite.

Përndryshe, në qoftë se e lëmë 10 minuta, është problem, kjo sa për ta pasur parasysh që mund ta propozoni edhe këtë. Zakonisht në diskutimet 10-minutëshe më shumë se gjysma shkon

diskutime ‘hajt pak’, elektorale, se sa në temë. Po, sidoqoftë, është e drejtë të diskutojmë çka duam. Nëse doni ju, mund të propozoni mbas pauzës për ta reduktuar kohën. Çështjen që e kërkoi zoti Hoti, unë s’kam kurrnjë kundër, por nuk ka kuorum në sallë për t’u votuar, është më mirë të shkojmë në pauzë dhe t’i thirrni deputetët, të gjitha palët, brenda një ore, besoj, të gjithë mund të vijnë në sallë dhe pastaj e miratojmë ose e nxjerrim në votim edhe këtë çështje. Në qoftë se jeni dakord, në qoftë se jo...

Atëherë, po e ndërpremë, pra, Memli e ka një minutë. Albert, më fal! Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Unë prapë po e përsëris, ne jemi për t’u kthyer në orën 17:00, të vazhdojmë duke u nisur prej mënyrës siç kemi vepruar edhe dje. Pika e parë që do të duhej të kthehen në votim është: Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sepse ka pasur votim jovalid dhe kur të kalojë ky votim, atëherë mund të kalojmë te formimi i Komisionit ad hoc, edhe te përbërja e Komisionit Hetimor.

Besoj që ashtu do të kishim mundësi të kishim votime të suksesshme për të tri çështjet dhe të vazhdojmë me interpelancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Më fal, Kinolli nuk ka diskutuar në emër të grupit.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Ne si Grup Parlamentar “6+” jemi të interesuar që pas pauzës të vazhdojmë me rendin e ditës dhe, po ashtu e respektojmë vullnetin e shumicës së kolegëve deputetë. Nëse janë të gatshëm të vazhdojmë, edhe ne jemi të gatshëm të vazhdojmë me rendin e ditës siç e kemi para vetes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim, a deshe ti? Shkurt bjeri!

MILAIM ZEKA: Kryetar, e kam një lutje, meqenëse puna e përkthimit është puna më e rëndë, nuk është kurrkush në sallë që ka nevojë për përkthyesit, ndoshta është mirë ata të shkretit të lirohen kur s’është Lista serbe këtu.

KRYESUESI: Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 17:00. Edhe një herë po ju lus, thërrisni deputetët të vijnë në sallë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Tani ndoshta do të ishte mirë të fillojmë debatin, meqenëse është ministri i Shëndetësisë këtu, nëse bëhet kuorumi e ndërpreme në gjysmë dhe votojmë ato çështje që kemi për t'i votuar. A jeni dakord kështu t'ia bëjmë?

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Po vazhdojmë seancën me pikën e 21-të të rendit të ditës, kuptohet kishim në plan të fillojmë me formimin e Komisionit Hetimor, por po presim derisa të bëhen deputetët.

21. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës

Kemi interpelancë të ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimeve shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka ushtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismajli, lidhur me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës. Ju njoftoj që në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Ftoj deputeten, zonjën Fatmire Kollçaku, nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, si propozues i interpelancës, ta marrë fjalën.

Zonja Kollçaku, keni dhjetë minuta kohë!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Tash e 15 vjet tema ndoshta më e përfolur është mosimplementimi i njërit prej ligjeve më bazike që kanë të bëjnë direkt me jetën e njerëzve apo shëndetin tonë, është mosimplementimi i ligjit për sigurimet shëndetësore. Dhe, ky dështim mund t'u faturohet të gjitha qeverive të mëparshme. Qysh në janar të vitit 2005 në Kuvend të Republikës të Kosovës është dashur të miratohet Ligji për sigurimet shëndetësore dhe tash 13 vjet ne do ta kishim një ligj të zbatueshëm, por siç e dini, përkundër faktit që më vonë, shumë më vonë është miratuar një ligj për sigurimet shëndetësore, ai ende nuk po implementohet. Prandaj, në bazë të nenit 65.9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje thërret në interpelancë ministrin e Shëndetësisë, zotin Uran Ismajlin, për çështjen

në vijim mbi sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Do të thotë, siç thashë, edhe parakusht për implementimin e ligjit për sigurimet shëndetësore është edhe SISH-i, faktikisht rritja e sëmundshmërisë është e tillë, sa që të gjithë ne mund të kontribuojmë në të ashtuquajturin “SISH” me të dhënat që i disponojmë vetë, nga familjet, nga lagjet, sepse e dimë se aq shumë janë në rritje sëmundjet, në veçanti ato kronike jongjitëse dhe ato malinje, aq është shqetësuese dhe nevoja për implementimin e këtij ligji dhe presioni për zbatimin e tij vetëm sa do të jenë në rritje.

Si arsyetim ne paraqesim para Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, në seancën plenare, vërtet do t’ ju rikujtoj që ky Kuvend në seancën plenare të mbajtur më 14 shkurt të vitit 2017, pas interpelancës së zhvilluar me ish-kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, në lidhje me përgjegjësinë mbi ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës, me propozim edhe atë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe në harmonizim me grupet parlamentare të PDK-së, LDK-së, AAK-së, Nismës dhe “6+”, miratoi Rezolutën numër 05/L-009, në të cilën kërkohej:

1. Kërkohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të përgjithshëm të fondeve të ndara për sistemin e informimit shëndetësor, SISH, prej fillimit të implementimit të projektit e deri në fund të muajit dhjetor 2016. Për këtë të përgatitet një raport me shkrim për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
2. Funkcionalizimi dhe shtrirja e plotë e sistemit informativ shëndetësor me plan dhe kalendar publik,
3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë në Kuvend në baza të rregullta tremujore për funksionalizimin e sistemit informativ shëndetësor. Që nënkupton që edhe deri tani këtu është dashur të raportohet edhe nga ministri aktual.
4. Qeveria të shqyrtojë mundësinë e rritjes së buxhetit në mënyrë të vazhdueshme për shërbimet shëndetësore, barnat dhe materialit harxhues deri në funksionalizimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësore,
5. Plotësimi i parakushteve të parapara me Ligjin për sigurimet shëndetësore para fillimit të mbledhjes së premieeve dhe
6. Publikimi i dokumenteve me qëllim të informimit të publikut për çmimoren, kategoritë dhe përfshirjen në pagesa dhe ata që lirohen.

Nga kjo rezolutë deri tani, përpos raportit të realizuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, pikat e tjera ende edhe sot nuk janë të realizuara, përveç një rritje simbolike të buxhetit, por që fatkeqësisht nuk po rezulton i mjaftueshëm, sepse aktualisht pothuajse në të gjitha institucionet shëndetësore kemi mungesë edhe të barnave bazike nga lista esenciale, njëra ndër to është edhe insulina që aktualisht nuk gjendet në shumë institucione shëndetësore, që është, e dini, një ilaç bazik për ata që vuajnë nga diabeti.

Nën dy, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë ende nuk kanë publikuar asnjë dokument zyrtar, ku bëhet i qartë kalendari i punimeve lidhur me funksionalizimin e sistemit informativ shëndetësor.

Nën tre, po ashtu, edhe pas raportit të auditorit të përgjithshëm, ku janë evidentuar shkelje të rënda në procesin e implementimit të SISH-it, nuk ka nga Qeveria e Kosovës asnjë masë të marrë për zyrtarët e përfshirë në këtë aferë, po ashtu nuk ka njoftim nëse Qeveria e Kosovës ka proceduar në Prokurori ndonjë nga gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm.

Nën katër, në planin legjislativ të Kuvendit dhe Qeverisë është vendosur për rishikim të Ligjit për sigurimet shëndetësore. Ndërkohë që fondi i parashikuar si agjenci e Ministrisë së Shëndetësisë prej 12 muajsh vijon shpalljen e konkurseve për punësimin e stafit. Midis tyre në këto konkurse u punësuan vitin që shkoi familjarët e ish-kryeministrit dhe tani kryeministrit aktual, në pozita shumë të rëndësishme, siç është edhe pozita e drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në kuadër të agjencisë për financimin e shëndetësisë.

Nën pesë, në rezolutën e Kuvendit është kërkuar që para se të fillohet në çfarëdo mekanizimi që lidhet me Fondin e sigurimeve shëndetësore, duhet të plotësohen parakushtet e vendosura në Ligjin aktual të sigurimeve shëndetësore. Këto parakushte lidhen pashmangshmërisht me hartimin e protokolleve shëndetësore, pa të cilat nuk mund të funksionojë asnjë sistem informativ dhe me vetë sistemin informativ. Pa këto fondi apo çdo mekanizëm tjetër kryen vetëm punë paralele, të padobishme dhe në shpërputhje me vijën profesionale shëndetësore. Do të thotë, ajo që është më bazike, protokollet, e di çdo profesionist shëndetësor në bazë, të cilit pastaj vijnë të gjitha procedurat mungojnë dhe shtrohet pyetja, si ka mundësi që të vazhdohet puna në mungesë të këtyre protokolleve, kur e dimë se vetëm disa prej tyre, do të thotë simbolikisht janë hartuar.

Nën gjashtë, Qeveria e kaluar në kundërshtim me këtë rezolutë pati hartuar Rregulloren nr. 04/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Fondit të sigurimeve shëndetësore. Është miratuar në mbledhjen e 140 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendim nr. 03/140, më 5. 4. 2017, Rregullore të cilën edhe Qeveria Haradinaj po e mban në fuqi, derisa procesi për sigurimet shëndetësore është tepër larg si pasojë e mosfunksionalizimit të sistemit informativ.

Po ashtu, parakusht i patejkalueshëm, së bashkë me hartimin e protokolleve, është edhe lista apo çmimorja për të gjitha shërbimet që i ofron edhe SSHKUK-ja, por edhe të gjitha nivelet e tjera, si ai primar, sekondar dhe terciar, që nënkupton që protokoli, çmimorja duhet të përgatiten edhe nga niveli primar i shëndetësisë, pra në nivelin komunal.

Mungesa e sigurimeve shëndetësore publike, situata e mjekimit adekuat të pacientëve në Republikën e Kosovës po vështirësohet nga dita në ditë, në mungesë të edhe SISH-it, edhe të ligjit për sigurimet shëndetësore. Në kushtet kur Kosova është vendi më i varfër në regjion, por edhe në Evropë, me jetëgjatësinë mesatare më të ulët, me investimin më të ulët në sektorin shëndetësor në raport me Bruto Produktin Vendor, si dhe i vetmi vend në rajon pa sigurime shëndetësore. Qasja joserioze jo vetëm që nuk siguron të drejtën elementare për të marrë shërbime shëndetësore që bën pjesë në të drejtën themelore të njeriut, por varfëron akoma më shumë popullatën ashtu të varfër, duke pasur parasysh impaktin e drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Po ashtu, në kushtet e moskontrollit total ndaj institucioneve private të sigurimeve shëndetësore po vjelin të ardhura, të cilat merren drejtpërdrejt nga qytetarët, deri në momentin kur këta nuk shndërrohen në pacientë. Rastet më të shpeshta rezultojnë me ndërprerje të kontratës për sigurim shëndetësor privat, kur konstatohet se personi është duke u trajtuar nga ndonjë sëmundje kurimi të cilës kushton. Ju lus një vëmendje të veçantë për këtë çështje.

Sigurimet private, të cilat e mbajnë monopolin aktualisht në mungesë të zbatimit të ligjit për sigurimet shëndetësore publike, abuzojnë në të shumtën e rasteve ndoshta ka përjashtime, por ne si Kuvend do të interesohemi dhe do t'i ftojme këtu përgjegjësit të raportojnë për ndërprerjen e kontratave të të gjithë klientëve, të cilët në vitin e ardhshëm duhet të vazhdojnë një kurim më të shtrenjtë, ndërsa u ndala te sigurimet private, sepse, edhe një herë po e cek, operojnë në mënyrë të pavarur. Ndoshta, ato japin ndonjë llogari në aspektin financiar, por në aspektin etik profesional mungon komplet transparenca dhe llogaridhënia. Për këtë mund ta pyesni këdo që njihni në rastet konkrete dhe ndërprerjet e njëanshme të klientëve, që përgjatë shumë viteve kanë qenë të siguruar. Kjo duhet të ndërpritet njëherë e përgjithmonë dhe kontratat njëvjeçare duhet të shndërrohen, së paku, në kontrata pesëvjeçare, që së paku klienti të përfitojë diçka nga shuma të cilën e deponon çdo muaj në këto kompani private.

Qeveria e kaluar pati njoftuar më 10 gusht 2006 se kishte marrë vendimin që të fillohet me mbledhjen e premieeve për sigurime shëndetësore, Vendimi nr. 03/104 dhe si datë për këtë është caktuar 1 janari i vitit 2017. Lidhur me këtë vendim Qeveria pati hartuar koncept dokumentin për sigurime shëndetësore, Vendimi nr. 05/110, ku nga njëra anë bëhet përpjekje për t'u arsyetuar vendimi për mbledhjen e premieeve, dhe nga ana tjetër vihen në pah vështirësitë që paraqet implementimi i këtij vendimi, për shkak të mungesës së parakushteve të nevojshme për zbatimin e sigurimit shëndetësor.

Vendimin për mbledhjen e premieeve Qeveria e Republikës së Kosovës e pati mbështetur në Ligjin për sigurimet shëndetësore nr. 04/L-249, respektivisht neni 12, paragrafi 1, ku saktësohet që ato mund të fillojnë të mblidhen vetëm pasi që të jenë plotësuar parakushtet për zbatimin e sigurimit shëndetësor të specifikuar në nenin 38 të dispozitave kalimtare. Në këtë kuptim ligji qartë e detyron Qeverinë për plotësimin e parakushteve para se të fillojë mbledhja e premieeve. Ato janë:

1. Grumbullimi i premieeve do të fillojë vetëm pasi që lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare, për atë vit fiskal të jetë miratuar sipas nenit 14 të këtij ligji;

3. Lista e shërbimeve pa pagesë nga neni 7 i këtij ligji të jetë e definuar, çmimi i çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor për atë vit fiskal të jetë i dakorduar;

4. Bashkëpagesat në nivelet e tjera të bashkëfinancimit të jenë të dakorduara;

5. Së paku 75% të punësuarve në sektorin publik dhe në ndërmarrjet e regjistruara private dhe publiko-private me TVSH të deklaruar dhe me qarkullim më të madh se 50 mijë euro, të kenë marrë kartelë të sigurimit shëndetësor, ose mjet tjetër të verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor; dhe

6. Së paku 75% të individëve që u përkasin kategorive të liruara u është dhënë kartela e sigurimit shëndetësor, ose mjet tjetër i verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurim shëndetësor.

15. Rikujtojmë edhe një herë se krijimi i këtyre parakushteve është i lidhur ngushtë me funksionalizimin e SISH-it, sistemit informativ shëndetësor, i cili përfshinë të gjitha modalitetet, duke filluar nga lista e shërbimeve, çmimorja e çdo shërbimi, regjistrimi i personalit shëndetësor, regjistrimi i pacientëve, sistemi i referimit, udhërrëfyesit klinikë, regjistri i barnave, deri të siguria e të dhënave.

16. Sipas Planit të Veprimit të implementimit të SISH-it të publikuar në strategjinë e sistemit të informimit shëndetësor 2010-2020 nga Ministria e Shëndetësisë, aktualisht SISH-i do të duhej të ishte në fazën finale të implementimit të tij, gjë që nuk përkon aspak me situatën aktuale, ku i tërë plan veprimi i paraqitur në këtë strategji ka mbetur në letër dhe nuk është bërë realitet.

Për këtë arsye në mungesë të funksionalizimit të SISH-it dhe në mungesë të parakushteve të përcaktuara me nenin e sipërpërmendur, vendimi që ka marrë Qeveria Mustafa në lidhje me fillimin e mbledhjes së premieeve ka qenë në kundërshtim me Ligjin për sigurime shëndetësore, po ashtu edhe vijimi i punës nga Fondi për Sigurimet Shëndetësore dhe pagesa nga Buxheti i shtetit për të punësuarit aty dhe çdo veprim i mëtutjeshëm përbën shkelje ligjore të

rëndë, sa i takon Ligjit për sigurime shëndetësore dhe Rezolutës së Kuvendit të paraqitur më lartë.

Në vend se të vijonte me punësimet në Fondin për Sigurimet Shëndetësore që po përgatitet të mbledhë premiumit dhe po piloton në gjashtë komuna, siç deklaroi ushtruesi i detyrës së këtij fondi, pa plotësuar standardet e domosdoshme të sistemit të sigurimeve, çdo qeveri e përgjegjshme do të ishte marrë seriozisht dhe pa vonesa me faktorët që ndikuan në mosrealizimin e SISH-it, duke adresuar shqetësimet e kërkesat e vazhdueshme për kontroll e hetim në drejtim të aktorëve përgjegjës, respektivisht zbatuesit e projektit të financuar nga Buxheti i Kosovës ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe të ndihmuar nga donacionet e LUX-Development.

Në fund të interpelancës do ta paraqesim edhe një mocion që besoj, se nëse dakordohemi me grupet tjera, ta miratojmë së bashku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e ministrit të Shëndetësisë, zotit Uran Ismajli, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me çështjet e ngritura për interpelancë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit shumë!

Më vjen mirë që jam ftuar në këtë interpelancë, që të diskutojmë për dy procese shumë të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës, pra për Sistemin Informativ Shëndetësor dhe Fondin për Sigurime Shëndetësore.

Nga gjashtë pika të rezolutës të cilën deputetja e përmendi dhe mbi bazën e së cilës jam ftuar të raportoj, disa janë plotësuar, një pjesë e tyre janë në proces dhe vetëm për një nga to nuk mund të thuhet se është arritur progres.

Po filloj nga e para, ku auditimi është kërkuar me rezolutë dhe është bërë, kopjet e raportit të auditimit tashmë janë dorëzuar.

Sa i përket pikës së dytë të shtrirjes dhe funksionalizimit të SISH-it në gjithë Republikën e Kosovës, fatkeqësisht ajo nuk është arritur dhe kjo është një bazë e debatit që do ta kemi sot. Sa i përket raportimit të ministrit për çdo tremujor, kjo është gjysmë e plotësuar. Kam ardhur këtu dhe besoj se do të vazhdoj që çdo tremujor të paraqitem për të diskutuar.

Rritja e buxhetit, që ka qenë një ndër pikët, po ashtu me iniciativën time ajo ka ndodhur. Ju e dini që për vitin 2018 kemi rritur buxhetin, ku në krahasim me vitin e kaluar është bërë për 21%, investimet kapitale janë rritur nga 10 në 24,6 milionë euro, ndërsa furnizimi për barna është rritur

buxheti mbi 36%, si dhe është siguruar një buxhet për marrjen e 300 mjekëve dhe infermierëve të rinj në punë gjatë këtij viti. Pra, pika e 4-të që ka pasur të bëjë me rritjen e investimeve në sektorin e shëndetësisë është arritur.

Sa u përket pikave të tjera që kanë të bëjnë me parakushtet, besoj se do të flasim gjatë këtij debati.

Në këtë interpelancë janë bërë gjithsej 18 pyetje, të cilat unë i kam grupuar sipas temave në mënyrë që ta kemi një diskutim më të strukturuar. Temat janë: Sistemi informativ shëndetësor; Fondi për Sigurime Shëndetësore; udhërrëfyesit klinikë dhe protokollat; si dhe ndërlidhja e tyre në sistemin shëndetësor.

Sa i përket Sistemit Informativ Shëndetësor, ju e thatë që ky është një projekt që ka filluar para shtatë vjetësh dhe nuk është implementuar ende në 30%-shin e paraparë. Ministria e Shëndetësisë ka nisur projektin për implementimin e Sistemit informativ shëndetësor në vitin 2011 dhe është paraparë të kryhej në tri faza, ku në dy fazat e para përfshinte implementimin dhe pilotimin e sistemit në 30% të vendit dhe kjo është paraparë deri në fund të vitit 2014. Faza e 3-të që përfshinë implementimin e sistemit në gjithë territorin e vendit, parashihej të përfundojë në vitin 2020. Asnjërin fazë të këtij projekti unë nuk e kam gjetur të realizuar plotësisht, ashtu siç ishte e planifikuar me dokumente strategjike.

Disa ilustrime në pesë institucione shëndetësore ku është shtrirë SISH-i, është konstatuar se vetëm 39% e pacientëve janë evidentuar në sistemin informativ, pra një përqindje shumë e ulët.

Natyrisht nuk duhet hedhur gjithnjë gurë e baltë mbi projektin, ka pasur edhe një pjesë e mirë ka qenë fakti që është iniciuar si ide, janë bërë dokumente strategjike, është bërë përpjekje që të arrihet, mirëpo raporti i bërë nga Zyra e Auditorit na ka treguar se ky proces prapëseprapë ka pasur shumë të meta. Ndër to, për shembull, shpërndarja e infrastrukturës fizike është dashur të bëhet në vitin 2011, mirëpo nuk është bërë deri në vitin 2013. Hardueri i vendosur në vitin 2013 ka filluar realisht të përdoret me 3 vjet vonesë, në vitin 2016. Edhe sa i përket softuerit ka pasur vonesa të shumta. Kontrata është nënshkruar me vonesë, në shkurt të vitit 2014, dhe sërish me vonesë në vitin 2016 ka filluar implementimi i këtij procesi. Pra ka pasur ngecje gjatë tërë këtyre shtatë vjetëve të cilat i kemi kaluar.

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë që në Ministrinë e Shëndetësisë janë trashëguar shumë të meta që për shtatë vjet e kanë shoqëruar këtë projekt, por do të ndalem, nuk do të flas më shumë për to. Do të ndalem te disa që janë të rëndësishme, besoj, për mbarëvajtjen e këtij projekti në të ardhmen. Një ndër to ka qenë edhe një e gjetur nga Auditori, që ka pasur të bëjë me funksionalitetin e Këshillit Nacional

për Sistemin Informativ Shëndetësor, të cilën tash ministria që drejtoj e ka rifilluar dhe do ta bëjmë takimin e parë më 24 prill.

Këshilli Nacional për Sistemin Informativ do të punojë intensivisht dhe do të ndërlihdë disa detyra, përfshi edhe rekomandimet e dala nga Auditori. Ky këshill do të dalë me një plan veprimi, që do të paraqitet saktë, buxheti që do të jetë për tërë përfundimin e këtij projekti, resurset humane që janë të nevojshme, institucionet dhe përgjegjësitë e tyre që janë të përfshirë në këtë projekt dhe afati kohor deri në fund të implementimit të Sistemit Informativ Shëndetësor.

Këshilli Nacional i SISH do të ketë para vetes edhe një dokument shumë të rëndësishëm. Gjatë kësaj kohe ministria ka arritur të hartojë një plan, i cili parasheh që brenda 18 muajsh të realizohet implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor në tërë Kosovën. Gjatë këtyre 18 muajve parashihen qartë të gjitha aktivitetet që duhen përfunduar. Po ashtu, duhet kuptuar që Ministria e Shëndetësisë ka pasur mungesë të stafit në departamentin e SISH-it, gjithsej 6 persona të punësuar. Ky numër tani është pothuajse i dyfishuar, pra është 13, më shumë se i dyfishuar, është 13, si dhe jemi duke pritur në rekrutim të dy ekspertëve të lartë të teknologjisë informative, që financohet nga Banka Botërore. Pra, do të ketë një ekip të mjaftueshëm, të cilët do ta jetësojnë këtë projekt shumë të rëndësishëm.

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi të bëhet një dallim, që është shumë i madh e që po krijon keqkuptime, sa i përket dallimit në mes të Sistemit Informativ të Shëndetësisë dhe Sistemit Informativ të Fondit.

Sistemi Informativ Shëndetësor menaxhon pacientët dhe proceset brenda institucioneve shëndetësore, ndërsa Sistemi Informativ i Fondit lidh fondin dhe institucionet shëndetësore dhe bën pagesën në bazë të shërbimeve, pra dallojnë në funksion njëra nga tjetra. Mungesa e Sistemit Informativ Shëndetësor nuk është rrjedhimisht pengesë për krijimin e sigurimeve shëndetësore. Pra, sigurimet shëndetësore janë të mundshme edhe pa SISH-in, nuk është ajo që është diskutuar deri më tani. Këtu ka ndodhur një keqkuptim. Kjo është vërejtur edhe në Rezolutën e Lëvizjes Vetëvendosje, ngase pyetjet e parashtruara për këtë interpelancë janë bërë duke nënkuptuar që sigurimet shëndetësore nuk do të mund të krijohen pa u krijuar fillimisht SISH-i. Kjo nuk qëndron të jetë ashtu.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, parashtruesit e interpelancës kanë paraqitur edhe disa pyetje, sipas të cilëve sigurimet shëndetësore, ose SISH-i, nuk mund të realizohen pa pasur protokolle mjekësore. Edhe kjo është e pasaktë, nga se sigurime shëndetësore shfrytëzojnë një sistem të klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ose siç njihen me shkurtesën “kodet ICD”. Ky sistem përdoret për rimbursim, në këtë rast për pagesat e institucioneve shëndetësore kur atë kryejnë shërbime mjekësore.

Hartimi i udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike nuk radhitet si parakusht për ndërtimin dhe funksionalizimin e Fondit shëndetësor. T'ua jap disa shembuj për këtë çështje. Për shembull, Estonia ka bërë hartimin e protokolleve në vitin 2011, gjersa së paku 10 vjet më herët e kishte themeluar Fondin për Sigurime Shëndetësore. Në Holandë, iniciativa për zhvillimin e protokolleve kishte filluar në vitet e '90-ta, rreth 50 vjet pas themelimit të fondit të tyre shëndetësor. E njëjta është edhe sot në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose në Francë, ku protokollat zhvillohen me qëllim të uljes së kostos sa u përket sigurimeve shëndetësore. Ndërlidhja ndërmjet protokolleve dhe krijimit të sigurimeve shëndetësore nuk qëndron si e tillë.

Në pyetjet e interpelancës po ashtu, është ngritur dhe çështja e strukturës së fondit dhe Rregullores së punës. Përmbajtja e Rezolutës së 14 shkurtit 2017 nuk i referohet strukturës së Fondit për Sigurime Shëndetësore, gjë që nënkupton se nuk e kufizon ndërmarrjen e veprimeve për organizimin e brendshëm të Fondit të sigurimeve shëndetësore. Andaj, janë të pasakta lidhshmëritë e tyre në këtë pyetje të Rezolutës. Ky proces dhe plotësimi i parakushteve të kërkuara me këtë Rezolutë duhet të konsiderohen si procese të ndara. Njëra adreson substancën, ndërsa tjetra adreson administratën dhe burimet njerëzore.

Në mënyrë që fondi të bëhet funksional kjo rregullore aktualisht është e domosdoshme. Pa bazën ligjore, që ofrohet me këtë rregullore e që hap rrugë për organizim të brendshëm, nuk mund të arrihet plotësimi i parakushteve të listuara në Ligjin për sigurimet shëndetësore. Funksionalizimi i Fondit për Sigurime Shëndetësore ka filluar me miratimin e Statutit dhe ka vazhduar me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

Të nderuar deputetë,

Është folur po ashtu, ndër pikat që janë folur kanë qenë edhe parakushtet që janë të lidhura me mbledhjen e premieeve.

Më lejoni të jap një shpjegim për to. Këto parakushte janë duke u përmbushur me një shpejtësi shumë të madhe. Ta marr për shembull,

- Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, ajo është e kompletuar, tanimë këto shtat muaj është kompletuar.

- Lista e shërbimeve pa pagesë sipas nenit 7, po ashtu tanimë është e kompletuar.

- Çmimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor është përcaktuar dhe jemi në fazën e testimit të tij.

- Niveli i bashkë-pagesës është themeluar në grupin punues dhe deri në shtator të këtij viti do të finalizohet udhëzimi.

Siç shihet, gjatë këtyre shtatë muajve është bërë një progres në shumicën e pikave që kanë të bëjnë me Fondin për Sigurimet Shëndetësore, por më e rëndësishmja është se është bërë progres edhe në ato që nuk janë të parapara me ligj e që janë të domosdoshme. Për shembull:

- Është trajnuar i gjithë stafi dhe tash jemi në fazën e trajnimit të avancuar. Pa staf të mirëfilltë e profesional e dimë se nuk do të mund të kemi një administratë efektive dhe efikase në realizimin e sigurimeve shëndetësore.

- Është finalizuar Udhëzimi Administrativ për rimbursimin e barnave jashtë-spitalore. Kjo krijon bazën ligjore, që disa kategori të pacientëve të shkojnë në barnatore e të marrin barna pa pagesë.

- Kemi angazhuar ekspertë ndërkombëtarë për ta bërë gati funksionalizimin e Sistemit Informativ të Fondit, ku do të përfshihet edhe E-receta, që qytetarëve të mos u shkruajmë barna me receta letre, por t'u jepet në barnatore me kartelë dhe pa pagesë.

Të nderuar deputetë, sigurimet shëndetësore janë brengë e mijëra qytetarëve. Sigurimet shëndetësore për kohë të gjatë janë konsideruar si çelës për zgjidhjen e të gjitha problemeve në sektorin e shëndetësisë, si pagesat e mjekëve, investime në spitale, çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e menaxhimit të institucioneve shëndetësore. Por, qëllimi kryesor i sigurimeve shëndetësore nuk është ky. Nuk janë institucionet shëndetësore që janë në pah të sigurimeve shëndetësore, por janë qytetarët e saj. Pra, sigurimet shëndetësore janë zgjidhje për familjet kosovare, që nuk i kanë kushtet për ta paguar shërimin për qytetarët, të cilët shërimi mjekësor i varfëron, ua harxhon kursimet dhe ndoshta edhe kapitalin familjar.

Sigurimet shëndetësore janë mburojë financiare për qytetarët. Si e tillë duhet dizajnuar dhe si e tillë duhet implementuar. Sigurimet shëndetësore nuk kanë nevojë të mbeten peng të projekteve të SISH-it, protokolleve, ose rregulloreve.

Duke lejuar menaxhimin e Fondit të sigurimeve që të zhvillojë sistemin e vet elektronik me miratimin e udhëzimit për të parandaluar çfarëdolloj vjedhjeje në emër të çmimeve të rritura të barnave e duke krijuar barra të mëdha financiare fondit, duke krijuar pako bazike të shërbimeve shëndetësore e duke vendosur kosto për to, rruga është shumë më e thjeshtë dhe më e afërt për ta jetësuar këtë kërkesë të madhe, që e kanë qytetarët tanë për sigurime shëndetësore.

Unë jam i vetëdijshëm që ky është një projekt shumë i vështirë, por përkundër zërave skeptikë jam i bindur se nëse e thjeshtojmë rrugën, siç e thash më lartë, bashkërisht do ta realizojmë këtë projekt të madh gjatë kësaj legjislature dhe gjatë këtij mandati qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare, respektivisht e deputetëve që duan të inkuadrohen në diskutim. E dini minutazhën, në qoftë se doni t'ua përsëris secilit grup sa ka, po ua përsëris.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka 40,5 minuta; Grupi Parlamentar i PDK-së ka 28 minuta; Grupi Parlamentar Vetëvendosje ka 28,5 minuta; Grupi i Pavarur ka 18 minuta; Grupi Parlamentar i AAK-së ka 16 minuta; Grupi Parlamentar Lista serbe ka 15 minuta; Nisma ka 9 minuta; Grupi Parlamentar “6+” i ka 9 minuta dhe pa grup parlamentar kanë 9 minuta.

Tani në emër të LDK-së, e ftoj zotin Haxhi Avdyli ta marrë fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Shëndetësisë në këto 18 vite të ekzistencës sonë si shtet i ka munguar prioriteti qeveritar dhe si pasojë e kësaj Kosova ka humbur hapin në ngritjen e një sistemi funksional, shëndetësor dhe institucione cilësore. Me një financim më të ulët në Evropë për shëndetësi është e pamundur që ne të ofrojmë shërbime shëndetësore cilësore, me resurse humane të qëndrueshme dhe të sigurojmë qasje të barabartë në shërbime efektive.

Reforma shëndetësore ka ngecur dhe sot jemi i vetmi vend pa sigurime shëndetësore dhe jemi, jo vetëm me mungesë të sigurimeve shëndetësore, por jemi edhe vendi me nivelin më të ulët të financimit në shëndetësi. Sot, gjendja në shëndetësi është e keqe si pasojë e shumë mungesave, duke filluar nga mungesa e barnave na ato më bazike, si shiringat, e deri te mungesat disamuajshe të insulinave, citostatikëve, e tjera.

Reforma financiare e filluar e cila do të parashikonte ndërrimin e pagesës nga buxheti në sigurime ka ngecur dhe afatet po shtyhen edhe më tutje, si pasojë e mosgatishmërisë dhe joseriozitetit tonë për t'u marrë me këtë reformë. Sigurimet shëndetësore tani janë në pikën pothuajse zero, përkundër që edhe nga shumë vite përpara kemi filluar me reforma, por ende nuk kemi arritur që t'i bëjmë hapat e duhur. Prandaj, sot edhe Sistemin E Informimin Shëndetësor si një pararendëse e sigurimeve shëndetësore e kemi në pikën zero dhe si pasojë e saj është vështirë që edhe sigurimet shëndetësore të japin një sukses të parashikuar.

Si pasojë e financimit të ulët sot aparaturat diagnostiko nëpër spitale janë të vjetruara dhe si pasojë e kësaj kemi pritje të gjata. Vetëm një shembull e kemi që ta marrim, kur në tërë Kosovën kemi vetëm një rezonancë magnetike dhe pritjet për të shkojnë nga disa muaj në disa vite. Po ashtu, edhe pritjet për ekzaminime tjera diagnostiko shkojnë me vite dhe si pasojë e kësaj edhe

këto ekzaminime po e humbin kuptimin, sepse sëmundjet nuk po presin kaq gjatë që ne t'i diagnostikojmë dhe pastaj të fillojmë me shërimin e tyre.

Po ashtu, sot kemi edhe lista të pritjes së pacientëve për operacione në shumicën e sallave të operacionit, të cilat shkojnë nga disa muaj në disa vite. Shëndetësia primare ka disa përmirësime në nivel të komunave. Mund të themi se pjesa më e mirë dhe më e suksesshme e shëndetësisë, sot mund t'i themi që është stafi mjekësor apo resurset humane, të cilat janë në nivel të detyrës. Po ashtu mund të themi se sot Qendra emergjente dhe intensivja akoma janë në objekte të vjetra dhe s'po mund të kryejnë funksionet e tyre në përpikëri kur dihet se këto dy reparte apo klinika janë shumë të rëndësishme.

Prandaj, ne si LDK dhe si deputetë, propozojmë që Qeveria dhe institucionet tona ta marrin seriozisht dhe të fillojnë me rritjen serioze të buxhetit për shëndetësi, duke filluar me buxhetin për SHKSUK-në, për spitalet rajonale dhe institucionet tjera. Po ashtu, kërkojmë që të bëhet rritja e grandeve specifike për komunat për shëndetësi, të rritet buxheti për sigurimin e 100%-të të furnizimit me barna nga lista esenciale, fuqizimin e kapaciteteve diagnostiko në radiologji dhe laboratorë, rritjen e buxhetit për ato që sot po flasim, për Sistemin e Informimit Shëndetësor, sepse me këtë buxhet është e pamundur që të funksionalizohet edhe ky sistem, përmirësimin e kushteve të punës dhe stimulimin financiar për profesionistët shëndetësor dhe atë, gjithmonë duke u bazuar në performansën e tyre.

Ne duhet të jemi të gjithë bashkë, që sa më shpejt të fillojmë dhe të punojmë në themelimin e funksionit të Fondit të sigurimeve shëndetësore, por edhe të fillojmë edhe me disa reforma të tjera që duhet të bëhen karshi sigurimeve shëndetësore, se nuk janë vetëm sigurimet shëndetësore ato që kanë me na i zgjidhë të gjitha problemet e shëndetësisë si me një shkop magjik. Një prej tyre është edhe organizimi i institucioneve shëndetësore, duke filluar nga SHKSUK, pastaj definimi i raporteve Fakultet i Mjekësisë - QKUK, funksionalizimi sa më i shpejtë i projekteve të filluara si Qendra Emergjente, Qendrës për Kirurgji të Fëmijëve, Kardiokirurgjisë e Onkologjisë. Po ashtu, kërkohet që ne karshi reformave të cilat i kemi filluar me krijimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore dhe Sistemit të Informimit Shëndetësor të punojmë edhe në drejtimit tjera, duke rritur buxhetin derisa të fillohet me sigurime shëndetësore. Një prej tyre është që të fillohet edhe me zhvillimin e programeve për pacientët dhe fëmijët, të cilët kanë nevojë për trajtim më modern dhe më të nevojshëm.

Duhet të investojmë dhe ta rritim buxhetin për vitet e ardhshme në promovimin shëndetësor dhe zbulimin e hershëm të sëmundjes.

Ne para se të fillojmë edhe me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, sepse tërë energjinë po e orientojmë aty, fillojmë edhe në riorganizimin e Ministrisë së Shëndetësisë, duke e funksionalizuar dhe duke ndryshuar përbërjen e saj sipas nevojave të reja dhe në këtë drejtim

është bërë një hap i duhur, siç është funksionalizimi i odave të mjekëve dhe të kalohen kompetencat e tyre dhe një sërë kompetenca si në edukim të vazhdueshëm, si në licencim, të kalohet në oda të mjekëve dhe në këtë mënyrë, kjo reformë të vazhdohet në drejtim të riorganizimit total të shëndetësisë.

Investimi më i madh që tani i duhet Kosovës është edhe investimi në resurse humane, duke investuar në shkollim, por edhe në edukimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe krijimin e specialistëve të rinj, sipas nevojave të sistemit shëndetësor.

Neve na duhet edhe një plan strategjik, ndoshta edhe për dekadën e ardhshme, për nevoja për resurse humane, të cilat në shëndetësi shpeshherë nuk kanë qenë të planifikuara si duhet, duke dhënë një shtim të numrit të specialistëve në një sektor dhe mungesa të tjera në një sektor tjetër.

Po ashtu duhet të rregullojmë edhe problemin e sektorit farmaceutik, i cili është duke ngecur shumë dhe është bërë një objekt i keqpërdorimeve dhe korrupsionit të vazhdueshëm në shëndetësi.

Ne duhet ta revidojmë sa më shpejt listën esenciale dhe do të duhej të formulojmë politikat e reja në prokurimin e barnave, por edhe rritjen e kontrollit në këtë sektor, i cili shpeshherë ka munguar dhe është objekt i keqpërdorimeve.

Normalisht ne në Kosovë i kemi prodhuar disa dokumente dhe këto dokumente duhet të rishikohen, të shikohet sa kemi arritur t'i përmbushim ato. Një prej tyre është strategjia sektoriale e vitit 2014-2020 dhe në këtë drejtim, nga aty të nisemi dhe të shohim ku kemi mbërritur dhe çka duhet të përmirësojmë.

Pse jo bashkërisht të gjitha partitë, gjithë profesionistët, gjithë aktorët që merren me shëndetësi, si nga klinika, si nga shoqëria civile, si nga shoqata të ndryshme të fillojmë një reformë të mirëfilltë të sektorit të shëndetësisë, duke filluar nga krijimi i fondeve të sigurimeve shëndetësore dhe, pse jo të formohet një këshill nacional mbipartiak, i cili do të ndihmojë që kjo reformë të bëhet një herë e përgjithmonë, sepse kjo po i kushton së pari popullit tonë, qytetarëve tanë, nesër do të na kushtojë edhe neve.

I nderuar ministër,

Duke u bazuar në fjalën tuaj, ju e përmendët që mund të fillohet me sigurime shëndetësore edhe kur nuk kemi SISH, kur nuk kemi udhërrëfyes. Unë mund të them që ndoshta mund të fillojmë, po në shekullin XXI, në dekadën thujtash të dytë, kur çdo gjë po shkon duke u digjitalizuar, kur kemi digjitalizim të çdo gjëje, nga telefonat, nga bankat, nga çdo gjë, ende të flitet që ne mund t'i bëjmë sigurimet shëndetësore pa e bërë një sistem të informimit shëndetësor, ku do të inkorporohesh në të gjitha shërbimet, pagesat, në këtë mënyrë sigurimet shëndetësore janë të

destinuara të dështojnë nëse në fillojmë mbledhjen e premieeve pa e inkorporuar në tërësi sistemin e informimit shëndetësor.

Nuk e di pse ne e bëjmë kaq të vështirë sistemin e informimit shëndetësor, kur më një investim më të madh qeveritar kjo mund të realizohet, sepse janë gjera të prekshme, hardveri, softveri, edukimi i kuadrove dhe shpërndarje e të gjitha këtyre kompjuterëve nëpër spitale e institucione shëndetësore dhe këto do të bëjnë që sigurimet shëndetësore të funksionalizohen si është më së mirë.

Unë nuk pajtohem që ne të fillojmë me mbledhjen e premieeve pa filluar sistemi i informimit shëndetësor, sepse mund të na ndodhë si në shumë shtete të bllokut lindor, si Moldavia dhe Shqipëria që nuk e ka arritur të realizojë sigurime shëndetësore, mund të dështojmë, e neve do të na kushtojë më shumë nëse fillojmë t'i qasemi seriozisht krijimit apo instalimit të sistemit të informimit shëndetësor në tërë Kosovën.

Edhe një herë, ne të gjithë këtu tani duhet të flasim jo vetëm si politikan të partive, por si qytetar dhe si pacient të mundshëm dhe të jemi bashkërisht të shikojmë çka mund të përmirësojmë në këtë sektor dhe si mund ta japim kontributin tonë.

Deri më tani në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, i cili udhëhiqet nga deputetja Besa Baftiu, kemi dhënë një kontribut profesional dhe është udhëhequr shumë mirë nga ajo, por edhe gjithë kolegët të cilët janë aty nuk e shikojmë se cila parti jemi, por si mund të kontribuojmë që t'i ndihmojmë përmirësimit të këtij sistemi shëndetësor, duke i ndihmuar edhe ministrit ndonjëherë, duke i dhënë edhe vërejtje, kritika, por edhe sugjerime që besoj që edhe ministri i merr ato parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina, nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Faleminderit, kryesues!

Diskutimin në lidhje me interpelancën me ministrin e Shëndetësisë po fillojmë pas një debati të gjerë që Komisioni për Shëndetësi dhe deputetët kanë pasur me ministrin aktual të Shëndetësisë në të gjitha takimet prej se është zgjedhur ai me Komisionin Parlamentar, ku në veçanti jemi interesuar për sistemin e sigurimeve shëndetësore që prej fillimit dhe ai gjithnjë na është përgjigjur në mënyrë pozitive.

Megjithatë, çështja e fundit sigurisht është rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për fondet e ndara të sistemit të informimit në shëndetësi prej fillimit të implementimit të këtij projekti dhe funksionalizimi i shtrirjes së SISH-it, pra sistemit të informimit në shëndetësi.

Sipas planeve të parapara dhe raportimi i tij është i paraparë edhe me Rezolutën numër 05/L-009 e të miratuar më 14 shkurt të vitit të kaluar. Është një detyrim që ministri e ka.

Rezoluta kërkon që Qeveria ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së buxhetit për shërbime shëndetësore, për barna dhe materiale harxhuese deri në funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, plotësimin e parakushteve të parapara me Ligjin për sigurimin shëndetësor para fillimit të mbledhjes së premiumeve, informimin publik për çmimoren dhe kategoritë e përfshira me pagesë, sidomos kategoritë të cilat do të lirohen nga premiumi.

Ministria e Shëndetësisë ka filluar qysh në vitin 2011 implementimin e SISH-it, kur kishte paraparë që kjo të kryhet në tri faza.

Dy fazat e para do të përfshinin pilotimin dhe implementimin e sistemit të informimit dhe do të përfshinte 30% të territorit të vendit tonë nga viti 2011 deri në vitin 2014.

Faza e tretë do të ishte implementimi i sistemit në gjithë vendin dhe ajo do të kryhej në vitin 2020.

Fatkeqësisht auditimi vërtetoi se SISH-i nuk ka qenë plotësisht funksional dhe rezulton se nuk ka qenë efikas dhe efektiv në planin e implementimit, deri në vitin 2014 deri në 30% të përfshirjes, nuk ka arritur të implementohet.

Kjo ngecje ka shkaktuar dhe moszhvillimin e implementimit të sistemit të informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, që do të thotë se ka munguar parakushti për funksionimin e këtij projekti.

Për implementimin e strategjisë së SISH-it në Republikën e Kosovës, të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë në periudhën 2010-2020 ka pasur marrëveshje bilaterale për ta ndihmuar formimin e këtij sistemi edhe në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Luksemburgut.

Qeveria e Luksemburgut ka thënë 6 milionë e 500 mijë euro, ndërsa Qeveria jonë ka siguruar një milion e 300 mijë euro për ta realizuar këtë, fatkeqësisht këto nuk janë realizuar ashtu si kemi planifikuar.

Planifikimi, koordinimi dhe aktivitetet e Ministrisë së Shëndetësisë për implementimin e SISH-it nuk kanë qenë mirë të organizuara.

Këshilli Nacional i SISH-it është zgjedhur për katër vjet me vonesë dhe ai nuk ka arritur të realizojë dhe të rishikojë udhëzimet administrative të SISH-it dhe të bëjë azhurnimin konform

strategjisë së planit të veprimit, ku duhet të përcaktoheshin përgjegjësitë dhe obligimet e palëve përgjegjëse për implementimin e SISH-it.

Gjithashtu në bazë të planit të veprimit, planifikimit dhe realizimit të burimeve financiare e njerëzore është paraparë një kosto prej 15.9 milionë për implementimin e përgjithshëm të SISH-it për vitet që i përmenda 2010-2020.

Deri në vitin 2016 janë realizuar vetëm 6,5 milionë, ose 47% e projektit, nga këto 76% janë realizuar për aktivitetet e ndërlidhura me SISH-in, ndërkaq 24%, ose 417 milionë euro për projekte të tjera që nuk kanë qenë të lidhura me SISH-in, siç janë pagesat për vendime gjyqësore, për furnizimin e rëntgenit në QKUK, për furnizimin me digjital ultrasound, për përpilimin e termave reference, pastaj projektit ideor dhe sanimin e ashensorëve në QKUK, e programe të tjera, vetëm që të mos mbesin pa u harxhuar këto mjete.

Në raportin e Zyrës së Auditimit informohemi edhe për disa veprime të tjera për koordinimin dhe organizimin e SISH-it, domethënë SISH-i ka lidhur marrëveshje deri tani me Agjencinë e shoqërisë së informacionit, e cila udhëheq dhe mbikëqyr zbatimin e projekteve që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit në institucionet publike dhe është shumë e domosdoshme kjo marrëveshje.

Me Agjencinë për Regjistrimin Civil dhe me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave gjithashtu një marrëveshje tepër e domosdoshme, sepse të dhënat gjithnjë janë të fshehura.

Përveç rrjetit të dobët dhe kompjuterëve të vjetruar, sepse ata qëndruan gati tre vjet pa u përdorur, mosnjohjes së punës dhe programit joefikas të mësimin të vazhdueshëm për përdorimin e kompjuterëve, ne kemi edhe mangësi të tjera që lidhen me këtë çështje.

Për shembull, sistemi informativ i menaxhimit të stokut farmaceutik ishte një ndër problemet që e penguan zhvillimin e këtij programi.

Si u tha më lart, shihet se me gjithë përpjekjet dhe shpenzimet që u bënë deri në vitin 2017, implementimi i SISH-it vazhdon me shumë vonesë dhe me shumë mangësi.

Ministri i ri, zoti Uran Ismajli, i cili nuk dha shumë fjalë dhe nuk ka shumë premtime për implementimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore, megjithatë nisi një punë të mbarë, të cilës edhe duam t'i besojmë, sepse filloi konsolidimin e sistemit, duke u konsultuar edhe me ekspertë të jashtëm dhe me përvojat e vendeve që këtë sistem e kanë realizuar.

Nga gjashtë pikat e rezolutës, të cilën e ka nxjerrë ky Kuvend, mbi bazën e së cilës pra është thirrur edhe kjo interpelancë, disa janë plotësuar, vetëm një ka mbetur e porealizuar dhe nuk ka pasur progres.

Auditimi i Zyrës Kombëtare ka dhënë edhe një bazë të mirë që ta kuptojmë më mirë gjendjen reale se ku ndodhemi me projektim për implementimin e sistemit informativ shëndetësor.

Një ngarkesë nga rezoluta ka të bëjë edhe me temën e shtrirjes së sistemit informativ, e cila deri tash nuk ka ndodhur, pra nuk kemi pasur një shtrirje të duhur.

Kërkesë nga rezoluta ka qenë edhe shtimi i fondit, të buxheti. Në këtë mandat ne kemi një shtim të buxhetit, pra në vitin 2018 kemi një rritje të buxhetit për 200 milionë euro në shëndetësi, në përgjithësi, në tërë vendin, ose një buxhet shtesë që do të thotë 21% krahasuar me buxhetin e vitit paraprak.

Gjithashtu janë shtuar mjetet për investime kapitale në shumë prej 126%, ose nga 10 milionë në 24.6 milionë euro.

Janë rritur edhe grantet për shëndetësinë primare për 9%.

Janë siguruar mjetet për punësimin e 100 mjekëve dhe 100 infermierëve të rinj, të gjithë e dimë se kjo ka qenë një mangësi e madhe në sistemin shëndetësor dhe kërkesë e sistemit, sidomos për mjekë të rinj dhe për infermierë.

Janë rritur 36% mjetet për furnizimin me barna esenciale krahasuar me vitin paraprak.

Sistem informativ shëndetësor, sa folëm deri më tani, kujtoj se i ka munguar edhe draft-raporti. Në bazë të draft-raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për tre muaj, kur u botua ky draft-raport ministri aktual kishte vetëm tre muaj përvojë pune në ministri.

Megjithatë ne sot mund të themi se sistemi shëndetësor është një sistem i cili kërkon shumë mjete, kërkon donatorë dhe raporti i Zyrës për shpërndarjen e infrastrukturës nuk ka qenë në rregull.

Këtu dikush foli për softwert e vjetruar dhe nevojën që ata të përtërihen. Ky sistem gjithnjë kërkon edhe mirëmbajtjen.

Rekomandimet që kanë dalë nga auditori e kanë shtyrë në veprim ministrinë dhe tani unë do t'i përmend vetëm disa rezultate që ka arritur ministria për këtë kohë sado të shkurtër, ose premtimet që ajo jep për realizimin e këtij sistemi.

Ministria ka hartuar planin, i cili ia ka dorëzuar tek donatorët për koment dhe pritjet që mbreta 18 muajve të realizohet sistemi informativ shëndetësor në tërë Kosovën dhe kjo është një gjë që nuk është vetëm premtim por kujtoj mund të jetë edhe realitet.

Qatë këtyre 18 muajve parashihen aktivitete të qarta, të cilat duhet të përfundojnë. Auditori ka vërejtur jofunksionalitetin e Këshillit Nacional për sistemin e informimit shëndetësor dhe në ministri tani është themeluar ky këshill që të jetë funksional dhe strukturë e domosdoshme që anëtarët e saj të fillojnë një aktivitet të dendur për ta realizuar programin.

Takimi i parë i këtij këshilli do të mbahet brenda disa ditësh, më 24 prill.

Këshilli Nacional për sistemin informativ ka detyrat e tij për t'i plotësuar rekomandimet që dalin nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ky këshill duhet të bëjë planin e veprimit që është shumë e rëndësishme, në mënyrë që të përcaktojë edhe buxhetin që ministrisë i nevojitet për implementimin e sistemit informativ shëndetësor dhe ky plan deri tani nuk ka qenë në asnjë mandat në qeverisje.

Kostoja do të mundësojë që të bëjmë edhe një program të buxhetit për pesë vjetët e ardhshme, shumë i domosdoshëm në çdo sistem të tillë shëndetësor.

Gjithashtu të realizohet një program që është kapital në shëndetësi, duhet të ketë edhe kapacitete. Deri tani në Departamentin e Sistemit Informativ kanë punuar gjashtë persona, ndërkaq parashihet që të punësohen edhe trembëdhjetë.

Ministria është në proces të bashkëpunimit me dy ekspertë të avancuar të teknologjisë informative që janë me kontratë të Bankës Botërore, e që konsiderohet shumë e domosdoshme për realizimin e këtij projekti.

Ekziston një dallim i rëndësishëm mes sistemit informativ shëndetësor dhe sistemit informativ të Fondit shëndetësor.

Këto dy mund të jenë edhe të integruara, por mund të veprojnë edhe veç e veç.

Në ministri mendohet se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja derisa ta përfundojë, e ka minutazhin e grupit.

FLORA BROVINA: Mungesa e sistemit informativ nuk është pengesë për rikrijimin e sigurimeve shëndetësore.

Ne mund të fillojmë me sigurimin e fondit ose edhe vetë Qeveria të ndajë mjete për fondin, sepse kështu është vepruar edhe në shtetet që kanë qenë në fillësën e parë.

Sigurimi shëndetësor nuk mund të jepet pa pasur protokolle dhe kjo thuhet se nuk qëndron.

Sigurimi shëndetësor mund ta shfrytëzojë klasifikimi ndërkombëtar të sëmundjeve, i njohur si ICD. ICD përdoret për rimbursim dhe në këtë rast pagesat e institucioneve shëndetësore kur ato kryejnë në shërbime mjekësore deri në të gjitha protokollet.

Nëse presim deri në përfundim të protokolleve, atëherë mund të vonohemi për sigurimin e Fondit shëndetësor.

Plotësimi i parakushteve të cilat kërkohen me sigurimin shëndetësor nuk mund të realizohen pa një rregullore. Tani në ministri është hartuar edhe është miratuar në Qeveri Rregullorja e Fondit për Sigurime Shëndetësore. Pa këtë bazë ligjore nuk mund të fillonte as organizimi i brendshëm.

Funksionimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore ka filluar me miratimin e statutit dhe vazhdon me Rregulloren e sistemimit të vendeve të punës.

Stafi i pranuar në Fondin e Sigurimit Shëndetësor është 27 veta dhe me rishikimin e buxhetin pritet të pranohen edhe 20 punëtorë të tjerë.

Deri më tani Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka pasur një numër shumë të vogël, prandaj edhe nuk ka qenë funksional.

Sistemi i informimit shëndetësor nuk është i domosdoshëm për t'u ndërtuar Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Gjatë këtyre shtatë muajve, 50% të parakushteve për funksionimin e sistemit shëndetësor janë përfunduar, duke përfshirë edhe paketën baza të përfitimeve, listën e shërbimeve pa pagesë, çmimet e shërbimeve, nivelin e bashkëpagesave dhe të tjera.

Edhe disa organe që i përmendën kolegët e mi, për shembull, funksionimin e Odës së mjekëve, e të tjera, të domosdoshme për vlerësimin e punës së kuadrit shëndetësor, tanimë janë bërë funksionale.

Drejtimi i stafit ka përfunduar dhe trajtimi me ekspertë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kam ankesa edhe nga grupi. Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjendja në shëndetësinë e Kosovës është jashtëzakonisht e keqe, për këtë jemi të gjithë dëshmitarë. Edhe vetë fakti që figura politike kërkojnë shërim jashtë vendit, duke anashkaluar atë të Kosovës, më së mirë e konfirmon këtë, shpesh edhe me paratë e buxhetit të Kosovës.

Kjo vlen edhe për çështjen për të cilën po flasim sot, pra SISH-in dhe Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Është shumë me rëndësi që përveç konstatimeve, të kërkojmë edhe përgjegjësi politike, administrative dhe penale për dështimet e deritanishme dhe keqpërdorimet që janë bërë në proces. Sa për krahasim, niveli i shëndetësisë sot, apo niveli i sistemit informativ shëndetësor në shëndetësinë sot është niveli i shkollës fillore dhe patë nuk ka përparim të sistemit shëndetësor. Kot flasim për nivele më të mëdha, kot flasim për reforma. Herë-herë ju, pra Ministria e Shëndetësisë, mundoheni të kamufloni situatën e rëndë në shëndetësi duke u thirrur në sukseset e kohëpaskohshme të mjekëve apo edhe të grupeve të mjekëve. Kjo nuk është asgjë tjetër përveçse përjashtim në gjithë krahurën e sistemit shëndetësor.

Prandaj, edhe është jashtëzakonisht e rëndësishme që sistemi shëndetësor dhe shëndetësia në përgjithësi të vendoset në prioritet të parë për këtë qeveri. Nuk është faji vetëm i kësaj ministrie, apo i kësaj qeveri pse ne ndodhemi këtu. Të gjitha qeveritë shëndetësinë nuk e kanë pasur prioritet dhe e kanë parë si një shans për të zhvatur ca para këtu-aty, apo për të rehatuar familjarë, ilakë apo militantë partiakë. Prandaj, shumë shpesh pacientët nuk vdesin nga sëmundjet si rezultat i dështimit të sistemit, por siç thotë populli jonë vdesin nga “egjeli”, me përjashtime tek-tuk, kur dështimi shpërthen si bombë, siç ishte rasti me vdekjen e tre pacientëve për shkak të anestetikëve fals apo në rastet e rralla kur familjarët nuk lëshojnë pe deri në zbulimin e plotë të arsyes së vdekjes së familjarit të tyre.

Qëllimi, por edhe detyra e sistemit shëndetësor është të ofrojë shërbime shëndetësore adekuate. Të ofrojë shërimin e plotë apo përmirësimin e kualitetin e jetës së pacientëve dhe thënë shkurt të shpëtojë jetë. Dështimi i sistemit shëndetësor do të thotë humbje jetë të qytetarëve, e mosndëshkimi i këtyre qytetarëve do të thotë se dikush është më i rëndësishëm se jetët e qytetarëve tanë. Duhet kuptuar se joefikasiteti dhe joefektiviteti në shëndetësi ka kuptim krejt tjetër prej fushave të tjera, përderisa tjetër kund dështon projekti, dështimi në shëndetësi domethënë humbje jete të qytetarëve. Pyetja më legjitime për këto dështime të vazhdueshme është se ato a po ndodhin për shkak të paafësive të përgjegjësve, apo se këto dështime po i konvenojnë dikujt?

Mendoj se të dyja nga pak. Përgjegjësve në të gjitha hallkat e institucioneve shëndetësore, përveç paaftësive e mospunës, shpesh u ka konvnuar mungesa e rregullit dhe anarkia. SISH-i, përveç tjerash, mundëson menaxhimin efikas të stokut farmaceutik, menaxhimin e të hyrave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Si të implementojnë diçka që potencialisht parandalon apo zbulon hajnitë me barna? Si të pajtohemi me një sistem, i cili na pengon me menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore, duke rehatuar ilake e militantë partiakë, si zyrtarin e lartë për fotokopje në një ministri tjetër.

Ministria e Shëndetësisë, si palë përgjegjëse për procesin e funksionalizimit të SISH-it në Kosovë, duhet të propozojë, të hartojë, të aprovojë dhe sigurimin në zbatimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit lidhur me zhvillimin e këtij sistemi. Se sa joserioze ka qenë puna e deritanishme për SISH-in, ndër të tjera dëshmohet edhe me faktin se nga buxheti i dedikuar për të, 24% e pagesave të bëra s'kanë të bëjnë asgjë me SISH-in, por si, për shembull, rasti i renovimit, i sanimit të ashensorëve të QKUK-së. Në të njëjtën kohë ka munguar mbështetja me staf që është planifikuar me planin e veprimit në emër të vetë kufizimeve buxhetore.

Kjo vetëm se dëshmon se në rastin më të mirë ka munguar trajtimi i SISH-it si prioritet. Prandaj, kjo duhet të ndërpritet dhe ne ju ftojmë të miratoni rekomandimet tona, në mënyrë që të fillojmë me reforma të thella në shëndetësi, drejt përmirësimit të gjendjes së saj. Sa më parë, aq më mirë, do të jetë më lehtë, më lirë dhe, çka është me më rëndësi, me më pak vuajtje të qytetarëve tanë, qoftë si pacientë, qoftë si familjarë të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

I nderuar ministër Ismajli,

E drejta për sigurim shëndetësor, si e drejtë elementare e njeriut, është e rregulluar me norma ligjore, si vendore, po ashtu edhe ndërkombëtare.

Edhe pse me vonesë, Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka miratuar Ligjin për sigurimet shëndetësore me qëllim të sigurimit të qasjes më të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve cilësore, kujdesit shëndetësor. Në bazë të këtij ligji, sigurimet shëndetësore janë sigurime shëndetësore të obligueshme dhe vullnetare, mirëpo sot pjesa më e madhe e qytetarëve, apo 95% ende nuk kanë sigurime shëndetësore publike. Ndërsa, vetëm 5% e qytetarëve që punojnë në organizata ndërkombëtare apo edhe një pjesë që financiarisht qëndrojnë më mirë kanë sigurime shëndetësore private. Mungesa e sigurimeve shëndetësore është një padrejtësi e madhe që po u bëhet qytetarëve tanë për shkak të paaftësisë, papërgjegjësisë, si dhe keqmenaxhimit që po i bëhet sektorit të shëndetësisë tash e sa vjet. Qytetarët kanë qenë të

mashtuar në vazhdimësi, sepse u është premtuar jo vetëm në fushata zgjedhore, por edhe gjatë qeverisë së kaluar shumë herë janë dhënë data të fillimit të mbledhjes së premiumeve dhe fillimit të sigurimeve shëndetësore, siç ka qenë data 1 janar 2017, më pastaj më 1 korrik 2017, edhe pse ishim të bindur se nuk mund të fillojnë, pasi që nuk ishin plotësuar kushtet, të cilat janë të domosdoshme për këtë, e që i parasheh Ligji për sigurime shëndetësore.

Bile në legjislaturën e kaluar, kur kishim interpelancë për sigurime shëndetësore pata thënë se sigurimet shëndetësore qytetarët nuk do t'i kenë deri në fund të mandatit të Qeverisë Mustafa, gjë edhe e cila ndodhi. Me të marrë mandatin e Qeverisë koalicioni PAN, ministri i Shëndetësisë e para që bëri konstatoi një gjë, të cilën qytetarët tanimë e dinin dhe e përjetonin çdo ditë. Ministër, ke thënë se shëndetësia është aq e rëndë sa që ti do t'ia gjesh ilaçin. Mirëpo, e kam një pyetje për ta gjetur ilaçin, duhet ditur diagnoza, nuk e di a e ke gjetur diagnozën, duke pasur parasysh se po bëhen tetë muaj të qeverisjes Haradinaj e gjendja nuk ka ndryshuar, ndonëse siç po deklaroheni se jeni duke punuar në këtë drejtim për të përmirësuar gjendjen në shëndetësi, po së paku pacientët ende nuk shohin një gjë të tillë, sepse po detyrohen të blejnë prej gjilpërave deri te barnat, të cilat kanë kosto shumë të shtrenjtë.

Prandaj, mungesa e sigurimeve shëndetësore po u kushton jo vetëm qytetarëve tanë, por edhe buxhetit të Republikës së Kosovës. Për çdo vit ndahen miliona euro për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike. Po ashtu, janë dhënë miliona euro si nga buxheti, po ashtu edhe nga donatorët për implementimin e sistemit informativ shëndetësor, por sot ky sistem është në fazën e parë, gjë të cilën na e argumentoi edhe Raporti kombëtar i auditimit për efikasitetin dhe efektivitetin e SISH-it. Në këtë raport thuhet se ka pasur keq menaxhim, nuk ka pasur koordinim në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe palëve përgjegjëse, në këtë projekt ka pasur keq menaxhim dhe keq përdorim të mjeteve financiare, nuk është punuar sipas planit të veprimit për implementimin e SISH-it të publikuar në strategjinë sektoriale për sistemin informativ shëndetësor 2010-2020, ku sipas këtij plani SISH-it do të ishte në fazën përfundimtare.

Ne, ministër, e kemi diskutuar në komision, por besoj që është mirë që edhe deputetët që janë të pranishëm, por edhe qytetarët të dinë, për këtë arsye unë e kam bërë disa pyetje:

1. Për ç' arsye ky sistem ka ngecur së implementuari sipas strategjisë së paraparë për SISH-in? Cilët janë faktorët që ndikuan në mosrealizimin e tij?
2. Pse në pilot-projektin për SISH që ka qenë paraparë për Qendrën Klinike Universitare, ky sistem ka ngecur, ndërsa në Spitalin e Prizrenit dhe në mjekësinë primare në Prishtinë ka funksionuar më mirë?
3. Sa dhe cilat nga 24 rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit janë adresuar nga ana e ministrisë suaj?

4. Meqenëse ka dyshime për keqpërdorime të fondeve të ndara për SISH, a keni kërkuar si ministër kontroll dhe hetim në drejtim të aktorëve përgjegjës?

5. Kur qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë sigurime shëndetësore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj, në emër të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të gjithë duhet ta pranojmë se shëndetësia ka qenë një sektor, i cili vërtet nuk është udhëhequr si duhet, nuk është qeverisur si duhet, është keqqeverisur, është keqmenaxhuar dhe ka qenë i keqfinancuar. Elemente, të cilat kanë bërë që sistemi shëndetësor vërtet të jetë i dështuar.

Shpeshherë për plot çështje që kanë qenë çështje të rëndësishme së veçantë kemi ngritur edhe shqetësimet tona. Shëndetësia është me një infrastrukturë jo të mirë krahasuar me vendet e rajonit, s'po flas për më gjerë, nëse e shohim nivelin e infrastrukturës në shëndetësinë kosovare vërtet është tmerruese. Shpeshherë kemi ngritur shqetësimet edhe për buxhetin e lartë që po shpenzohet për trajtim të pacientëve jashtë Kosovës, sepse ky buxhet ka marrë një shumë të konsiderueshme të parave nga Fondi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe tash po dua ta përgëzoj funksionalizimin e Kardiokirurgjisë, e cila po punon 24 orë dhe buxhetit të Kosovës dhe buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë po i kursen rreth 1 milion euro për një periudhë mjaft të shkurtër.

Po mendoj që nëse vazhdojmë me këtë ritëm të funksionalizimit të të gjitha sistemeve, të cilat marrin një sasi të konsiderueshme të buxhetit për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore, do të bëhet mirë, sepse kursejmë buxhet dhe njëkohësisht investojmë në ato reparte dhe në ato njësi në të cilat po shpenzohen para më shumë.

Ka qenë ndoshta nismë edhe e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, duke e parë që nuk po funksionalizohet dhe nuk po implementohet sistemi i SISH-it, që kemi kërkuar dhe auditimin. Objektivi i këtij auditimi është të vlerësojë nëse Ministria e Shëndetësisë, bashkë me palët përgjegjëse të përfshira në këtë projekt, a kanë arritur koordinimin e aktivitetit të nevojshme, duke filluar nga planifikimi, sigurimi i infrastrukturës ligjore dhe asaj fizike, sigurimin e resurseve financiare dhe njerëzore, krijimin e mekanizmave monitorues dhe raportues si parakushte për të siguruar një implementim efikas dhe efektiv të sistemit të informimit shëndetësor. Sistemi i informimit shëndetësor është dashur të fillojë së implementuari në vitin 2011, implementimi i sistemit është paraparë të kryhet në tri faza: faza A, B dhe C.

Dy fazat e para kanë përfshirë pilotimin dhe implementimin e sistemit në 30% të territorit të vendit dhe vlerësimin e pilotimit në fund të vitit 2014. Ndërsa, faza e tretë përfshin implementimin e sistemit në gjithë territorin e vendit, i cili është i paraparë të realizohet deri në vitin 2020. Këshilli Nacional për sistemin informativ shëndetësor sipas planit është dashur të

themelohet në vitin 2011, përderisa është themeluar me 4 vjet vonesë, kjo ka ndikuar që të gjitha aktivitetet e tjera, sipas Planit të veprimit, të implementohen me vonesë. Nuk e ka hartuar Udhëzimin administrativ 11, 2013 në harmoni me strategjinë dhe planin e veprimit. Udhëzimi aktual nuk i bën të qarta përgjegjësitë e palëve përgjegjëse për implementimin e SISH-it, përderisa sipas këtij udhëzimi të dhënat shëndetësore menaxhohen nga institucionet shëndetësore veç e veç. Kjo formë është në kundërshtim me synimin strategjik për menaxhimin e të dhënave me sistem të centralizuar.

Ka dështuar në krijimin e mekanizmit monitorues për punën e implementimit të SISH-it, takimet e deritashme i ka mbajtur ad hoc, janë mbajtur vetëm pesë takime, i fundit është në prill të 2017-ës, është mbajtur me një vit vonesë. Këshilli Nacional për sistemin e SISH-it ka dështuar t'i adresojë ngecjet dhe të arriturat e implementimit të projektit dhe në çdo takim, rekomandimet janë përsëritur të njëjta dhe jo profesionalisht. Koordinimi i aktivitetit ndërmjet SISH-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë është tejet i mangët dhe ka shkaktuar ngecje serioze. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si aktor kryesor në implementimin, bartjen e të dhënave nga institucionet shëndetësore në sistemin e centralizuar, nuk është përfshirë në fazën pilot. Nuk është përfshirë asnjëherë në implementimin deri në maj të vitit 2017. Ende SISH është e pamundur të shfrytëzohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik që është institucion qendror dhe shumë i rëndësishëm në implementim.

Sipas planit financiar, deri në momentin e auditimit është realizuar vetëm 47% e projektit. Realizimi sipas planit deri në periudhën e raportimit, janë 13.7 milionë, të shpenzuara 6.5 milionë. Ka shkelje drastike në menaxhimin e kontratave, mallrat janë pranuar vetëm nga një person dhe pa komision për pranim teknik. Ende janë të ekzekutuara kontratat pa pranim teknik, si mjet ligjërish shumë i rëndësishëm. 24% e pagesave janë kryer për kontratat, të cilat nuk janë paraparë në Planin e SISH-it. Ngecjet në sigurimin e personelit adekuat për mbështetje të projektit nga të gjitha institucionet implementuese, si Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave. Për shkak të mosdefinimit të duhur të përgjegjësive, Agjencia e implementimit ka blerë disqet dhe licencat, më 2014, me vonesë trevjeçare, si pasojë e mosmarrjes së licencave me kohë.

Meqenëse nga raporti i monitorimit i kemi rekomandimet, faqja 42 e raportit, që kanë shumë rekomandime, por janë nxjerrë disa me interes. Të hartohet apo të rishikohet plani i veprimit duke pasur parasysh vonesën rreth 4-vjeçare. Të përditësohet Udhëzimi administrativ në harmoni me strategjinë dhe planin e veprimit. Të funksionalizohet SISH-i dhe të veprojë në bazë të përgjegjësive që ka, në të kundërtën, të përgjigjet para organeve kompetente. Të krijohet infrastruktura e nevojshme hapësinore, teknologjike dhe informative për funksionim të projektit. Të koordinohen aktivitetet dhe të marrin urgjentisht përgjegjësi të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse. Të ofrojnë raport financiar në baza të rregullta dhe të specifikohen burimet e mjeteve sa të buxhetit, sa të donatorit. Të aftësojmë personelin shëndetësor për zbatim të SISH-

it. Të bëjmë plan konkret për përfshirjen edhe të sektorit privat shëndetësor në SISH, pasi që mund të ketë problem serioze në këtë sektor të lidhura me projektin. Për shkak të rëndësisë së projektit në ofrim të shërbimeve shëndetësore të qytetarëve, të krijohet një komision parlamentar qeverisës për mbikëqyrjen e projektit. Për shkak të rëndësisë së projektit në ofrim të shërbimeve shëndetësore të qytetarëve, të raportohet në periudhat tremujore apo gjashtëmujore nga ministri.

Me rëndësi është që e kemi gjendjen faktike dhe tash mbetet që ministria të fillojë të implementojë rekomandimet e dala nga raporti i auditimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë do të flas në emrin tim personal, në emër të grupit do të flasë Enveri. E po mundohem pak ta thjeshtësoj punën e diskutimit për dy arsye: e para, besoj që fjalën “interpelancë” ndoshta mund të na e shpjegojë Muharrem Nitaj, edhe si gjuhëtar, edhe si gazetarë, çka domethënë së pari “interpelancë”?

Kur e ftojmë një ministër në interpelancë, pse e ftojmë ne ministrin? T’i japim mend? Kur s’kemi as për vete! Apo t’i kërkojmë përgjegjësi? Këtë s’po e kuptoj, domethënë po i mbajmë ‘ders’ atij, e ai e di më mirë se ne se në ç’gjendje katastrofale është shëndetësia. Për t’i mëshuar trup, zoti ministër, kështu edhe unë të të jap pak mend, mendoj që ajo sëmundja patologjike e qeveritarëve, e ish- ministrave edhe disa ministrave e deputetëve aktualë është shumë e thjeshtë. Ne kemi pasur ministra që kanë dhënë mësim në pesë universitete, e kurrë s’i kanë takuar studentët e vet. Po të ishte ndarë sektori publik i shëndetësisë, ama ta bësh atë duhet pasur guxim, të mos thërrasin shefat e partive e të të thonë: “Mos, se bëhet nami”. Po të ishte ndarë sektori publik nga sektori privat që të mos punojnë mjekët në pesë spitale e të shkojnë në Qendër Klinike Universitare vetëm për të marrë pacientë, një, dy, vetëm sa për t’i prishur aparaturat e incizimit dhe të diagnostikimit, gjendja në shëndetësi 40% do ishte më e mirë.

Njerëzit e Partisë Demokratike të Kosovës, një deputet i Partisë Demokratike të Kosovës dhe një deputet i minoriteteve kanë votuar kundër ndihmës austriake për atë aparat që po rri që 4-5 vjet në Austri dhe nuk është sjellë në Kosovë. Këtu duhet të bëhet një debat, pse ka ndodhur diçka e tillë?! E treta, do të jetë gjithmonë problem në shëndetësinë e Kosovës kur mjekët që s’kanë haber në punën e menaxhimit të një spitali ose të një reparti, i udhëheqin spitalet, por edhe repartet. Në vendet perëndimore ka mundësi që mjeku është drejtor i një spitali, ka mundësi që shefi i një klinike është mjek, por kurrë pa e kryer minimum gjashtë muaj një kurs për aftësimin e tij qysh menaxhohet një spital ose një repart.

Dhe, sa u përket sigurimeve shëndetësore, do ishte shumë e thjeshtë: ata që janë të papunë paguajnë kur hyjnë në spital 5 euro, dhe Ministria e Mirëqenies Sociale e bën rimbursimin.

Krejt në fund, se s'po dua ta zgjas, po ta jap një rekomandim, një këshillë: është shumë me vlerë dhe respektim i të drejtës elementare të një pacienti, në qoftë se Ministria e Shëndetësisë i trajnon mjekët dhe motrat medicinale për mënyrën e komunikimit me gazetarë. Jemi i vetmi vend në kontinentin e Evropës ku gazetari hyn në Emergjencë dhe e incizon pacientin e përgjakur, ku gazetari hyn dhe e fotografon pacientin në sallën e operacionit, kjo është edhe shkelje flagrante e të drejtave të njeriut, edhe budallallëk e mungesë totale e profesionit të tyre, por ne budallain duhet ta ndalim, s'duhet t'ia çelim derën e Emergjencës dhe të hyjë ai e të fotoj në aksident e ta shohin fëmijët babën ose nënën duke u bërë operacion, ose që ne shpeshherë nëpër medie lexojmë rreth diagnozës të pacientëve.

Këto ishin kështu pak muhabetë, jo për të dhënë mend, por këshilla, se je ministër, lodhesh, i ke 2 milionë probleme, a shëndetësia është bash katastrofë. Muharrem, më fal që ta përmenda emrin.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën tash pas të gjitha këtyre fjalëve që u bënë, pastaj me radhë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit,

Ta bëjmë edhe një përmbledhje mbi bazën e diskutimeve që ndodhën, në mënyrë që, siç tha edhe deputeti Zeka, të mos jetë veç e njëanshme. Nuk fola për mungesat e mëdha që janë trashëguar në Ministrinë e Shëndetësisë me kohë të gjatë, mungesë të investimeve, mungesë të pajisjeve, aparateve, personelit mjekësor, mekanizmave për mbrojtjen e çmimeve të barnave, domethënë mungesa të mëdha, të cilat i kemi trashëguar. Mirëpo, ajo e cila dëshiroj ta ritheksoj edhe një herë që është realisht objekt i kësaj interpelance, që sigurimet shëndetësore nuk mund dhe nuk kanë nevojë të mbesin peng i SISH-it.

SISH-i është, ta bëjmë dallimin ndërmjet Sistemit Informativ të Fondit dhe Sistemit Informativ Shëndetësor. Më falni, ka të bëjë me konceptin, domethënë po i përziejmë dy funksione që janë të natyrës të ndryshme. Unë nuk po mundohem t'ia kaloj dikujt e t'i them që ai e ka pasur gabim, ose një parti e ka pasur gabim. Mirëpo si koncepte janë të ndara njëra nga tjetra. Sistemi i Fondit i ndihmon edhe Fondit, edhe personelit shëndetësor të krijojë një lidhje për transaksionin që e paguan mbi bazën e shërbimit dhe i përdor kodet ICD, të cilat janë kode pikërisht për rimbursime.

Pra, e vendos atje kodin, kodi tregon çfarë diagnoze ka pasur, çfarë trajtimi i është dhënë, ajo shkon në sistem të informimit të Fondit, le të themi, i është bërë një operacion i caktuar, Fondi e paguan për atë operacion të caktuar, pra nuk ka nevojë të ketë sistem të informimit shëndetësor brenda, a është mirë me pas? Është mirë me pas. Mirëpo, nevoja më e madhe është nevoja për sigurime shëndetësore, se sa për SISH. Prandaj, kjo ka qenë arsyeja pse ne e kemi ndarë, eksperti i Bankës Botërore është këtu, ka ardhur dhe e ka bërë revidimin e termeve të referencës, do të

vijë prapë për ta përfunduar. Na i ka ndarë paratë Banka Botërore për të krijuar SIF-in dhe do të na japë mundësinë që të krijojmë këtë parakusht. Mos t'i përziejme konceptet njëri nga tjetra.

Sa u përket disa çështjeve që u ngritën, rezonanca magnetike është e vërtetë që nuk ekziston, nuk ekzistojnë dy, është vetëm një. Këtë vit e kemi paraparë për ta blerë dhe ta vendosim në QKUK, që të mos krijohen pritje të gjata. Lista esenciale nuk është reviduar që nga viti 2012. Unë e kam filluar procedurën për ta reviduar, jam në proces që pesë muaj për revidimin e listës esenciale. Ka qenë proces i vështirë, më kanë thënë njerëzit largohu nga ai proces, nuk është mirë me e bë, është i vështirë me u bë, s' do të mund ta çosh deri në fund, por ai do të përfundojë dhe do të shkojë deri në fund, sepse vendimi dhe vullneti im e besoj që edhe i ju të gjithëve është që ta shohim një rregullim më të mirë, sa u përket barnave.

Një deputet këtu e ngriti, se nuk kanë dashur ta bëjnë sepse kanë pasur hajni në barna. Unë nuk e di cila ka qenë motivi mbrapa, një informatë mund t'ua jap. Kosova dhe Bjellorusia janë të vetmet vende që sot nuk kanë asnjë mekanizëm të kontrollit të barnave. Javën e kaluar, pra këtë javë, unë kam pasur një debat publik, e kam finalizuar Udhëzimin Administrativ, i cili e vë tavanin e çmimeve, i krahason me pesë vende të rajonit me vende të rajonit dhe nuk lejon çmimin i cili shitet në Kosovë dhe e tejkalon çmimin e mesatares së rajonit, nuk e lejon të blihet. Pra, është hera e parë, pas gjithë këtyre viteve, që ne kemi një mekanizëm sa u përket çmimeve të barnave dhe do të paguajmë çmimin që është në treg dhe në treg të rajonit. Pra, nuk do ta lëmë mundësinë që disa kompani të bëjnë marrëveshje në Kosovë, ta ngritin çmimin, sepse ne do ta krahasojmë me çmime të rajonit. Pra, nuk do të jenë në gjendje ata ta kontrollojnë secilin çmim në rajon.

Një përgjigje të shpejtë, deputetja më pyeti, cila është diagnoza, i thashë të gjitha se ka mungesa të mëdha. Një ndër zgjidhjet është që të shihet ku ka pasur realisht pengesa, siç thashë, kjo e legjislaturës, domethënë ku kemi pasur shpenzime shumë të mëdha si në çështjen e barnave, ose një shpenzim tjetër shumë i madh që ka qenë në sëmundje të zemrës, pra në rastet e stentimeve, po ta jap veç një shembull, Ministria e Shëndetësisë ka paguar 375 mijë euro në shkurt të vitit të kaluar, sivjet ka paguar, në këtë vit domethënë ka paguar 6 500, në shkurt të këtij viti ka paguar 6 500. Vjet i kemi paguar 358 mijë euro për këtë shërbim, të cilin e kemi krijuar për 24 orë. Pra, qëllimi ka qenë në ato vende ku e kemi pa që ka pasur me të vërtetë një humbje shumë të madhe për sistemin, ta përmirësojmë. Nuk po them që i kemi zgjidhur të gjitha problemet, vetëm sa u përket pajisjeve po ju them, se është hera e parë që blihen pajisjet, në QKUK të paktën, nga menaxhmenti i QKUK-së e kam informatën, ku është pyetur secili drejtor i Klinikës se çka u mungon.

Nuk janë bërë planifikimet në bazë të një zyre diku që ka planifikuar, se çka i nevojitet atje doktorit, por i është bërë pyetja: Çka të nevojitet ty? Dhe, kemi filluar t'i blejmë pajisjet me të madhe për QKUK, që t'i krijojmë shërbimet që na nevojiten.

Sa u përket pyetjeve tjera, disa u shtruan, por besoj se do t'i shtjellojmë me kalimin e kohës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj është paraqitur.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë shpresova që Milaimi të paktën nuk do ta bënte të njëjtin gabim. Edhe ai filloi pak a shumë të mos e kuptojë esencën e interpelancës dhe edhe ai filloi pak a shumë të flasë dhe të shpërfaqë ekspertizën e tij për problemet e shëndetësisë.

Me aq sa kuptohet e unë besoj, për shembull, që deputetët e kuptojnë interpelancën, bile në shumë vende është e lidhur edhe me mocionin e votëbesimit dhe detyra e deputetëve është t'i kërkojnë sqarime e shpjegime, ose Qeverisë, ose në rastin konkret ministrit të Shëndetësisë. Nuk po e vërej nga të gjithë folësit e deritashëm, që po i kërkohet një gjë e tillë. Secili prej tyre në fjalime më të gjata se dhjetë minuta po flasin se sa ata i njohin problemet e shëndetësisë. Po japin sqarime dhe shpjegime vetë.

Zoti ministër,

Ne jemi vendi i vetëm që nuk kemi sigurime shëndetësore. Interpelanca sot është tepër akademike, është tepër teorike. A ka mundësi që ju të dilni në foltore dhe të thoni, për shembull, pse Kosova nuk ka sigurime shëndetësore dhe kur, vëlla, qytetarët e Kosovës do të kenë mundësi që ta realizojnë këtë të drejtë që është e drejtë normale për qytetarët në të gjitha vendet e Botës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash zonja Kollçaku e ka fjalën dhe pastaj u jep përgjigje të dyve.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj!

Njëra nga arsyet pse edhe institucionet si Fondi Monetar e Banka Botërore dhe moszbatimi deri tani i këtij ligji është edhe vet fakti i riskut kontribuues përfitues. Domethënë, gjithnjë është dhënë kjo, se edhe rreziku nga falimentimi i fondit, në këtë rast. Prandaj, është tepër e rëndësishme të mos bazohemi ne vetëm në sistemin informativ të fondit, që është vetëm një skelet, por në SISH-in, sistemin informativ shëndetësor, sepse na jep të dhënat komplete, jo vetëm të abuzimit, si me thënë, nga sistemi në këtë rast, por është për ta mbrojtur edhe sistemin shëndetësor, edhe pacientin, në këtë rast klientin apo atë që përfiton.

Do të thotë, ju e dini se do të bëhen kontraktime të shërbimeve shëndetësore, si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorët privat. Pa e pasur ne një pasqyrë shumë të qartë komplete, si prej licencimit të çdo mjeku, institucioneve, funksionimit, mbikëqyrjes, të gjitha komplet ato çka i referohen sistemit informativ shëndetësor, ne nuk kemi mundësi koston me e pas parasysh edhe abuzimet në këtë rast.

Prandaj, qëndrojmë në çdo presje në çdo pikë të asaj që kemi thënë, se parakusht është sistemi. Nuk mjafton ISD-ia apo klasifikimi internacional i sëmundjeve, se nuk mundesh ti t'i referohesh diagnozës. Ju e dini që kemi një apendicit, një operim të zorrës qorre, po çka me bë intervenimeve para dhe pas komplikimeve, infeksioneve që mund të rezultojnë dhe kanë një kosto shtesë? Nuk mund ju të llogaritni vetëm koston në bazë të diagnozës.

Çështja është që thjesht, ministër edhe ju, kur e kemi bërë edhe këtë interpelancë ka qenë edhe një dyshim, se a ka falimentuar ideja apo po hedhet komplet projekti i deritanishëm i Sistemit Informativ Shëndetësor dhe a do të fillohet me një pilot projekt tjetër? Ju sot na dhatë një informatë, të them, inkurajuese, që ju po parashihni një 18 muajsh që ky të fillojë të zbatohet, që për mua është tepër optimist, sepse siç e pamë edhe nga vetë raporti i auditorit edhe krejt kjo deri tani kanë kaluar vite, edhe pse kemi pasur edhe mbështetje nga Luksemburgu dhe një pjesë nga Qeveria e Kosovës edhe deri tani as vet pilot-projekti që ka qenë 30% e mbulesës së institucioneve shëndetësore nuk është arritur të mbulohet. Ndërsa për 18 muaj ne presim që kjo të realizohet. Ne do ta mirëpritim këtë dhe do të ishim shumë të gëzuar sikur kjo të ndodhë, mirëpo bazuar në krejt historikun edhe të mosimplementimin e Ligjit për sigurim shëndetësor, fillimisht me vite prolongimi i miratimit të tij e pastaj edhe pas miratimit moszbatimi i tij, edhe parakushti që qëndrojmë, po them edhe një herë, nuk mjafton. Ju e thatë mirë, duhet të bëhen pagesat, është sistemi informativ i shërben vetë fondit, por nuk i disponon me të gjitha informatat, që ne të kemi një kontinuitet edhe një siguri kur të fillojë ligji që pas dy-tri vitesh nuk do të na falimentojë fondi, sepse risku siç e thashë gjithmonë qëndron te ajo sa kemi ne kontribuues dhe sa kemi përfitues, që dihet se përfitues do të kemi shumë, po kontribuues pak, bazuar edhe në pagat e ulëta, mundësinë e ulët të financimit nga Buxheti dhe shumë probleme tjera, që deri tani, tash e 20 vjet, sidomos siç thashë prej 1 janarit të vitit 2005, në vend se në atë kohë të miratohej Ligji për sigurime, i cili ka qenë këtu në Kuvend dhe nuk ka arritur deri më sot ai të implementohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, i ke dy replika nga dy minuta.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Deputet Nitaj,

Po besoj se një pjesë e përgjigjes që ma kërkuat, pse nuk u bë, qëndron në këtë fakt që ne sigurimet shëndetësore po shkojmë duke i komplikuar, jo duke e thjeshtësuar. Në qoftë se ICD-kodet përdoren nga të gjithë për rimbursimin, për shembull veç ICD-10 ka 69 mijë kode, pra 69 mënyra për ta marrë pagesën, që tregon se sa komplekse është mundësia për t'i rimbursuar paratë.

Kjo përdoret prej sigurimeve shëndetësore dhe unë nuk po them se SHIS-i nuk është i rëndësishëm, në asnjë moment nuk e thashë. Unë thashë, që sigurimet shëndetësore janë të mundura të krijohen nëpërmjet fondit të sistemit informativ të fondit, i cili i lidh.

Sa i përket mundësisë për të krijuar shpenzime të mëdha në fond, udhëzimi administrativ për çmime që e kam nxjerrë ka pasur pikërisht edhe këtë komponentë, që ne mos të kemi një treg të egër të barnave, të cilin ne më pastaj nuk mund ta kontrollojmë, se nuk ke ligj si ta ndalësh. Sigurimet shëndetësore ne i bankrotojmë, në qoftë se apetiti politik i yni nuk është për t'i lejuar të gjithë që të mos paguajnë. Kur të vijë ligji këtu e shohim se si do të shtyhem, "fute këtë kategori, fute edhe atë kategori...". Po ua marr një shembull, në Kroaci janë 3.5 miliardë euro, që jepen për buxhet të shëndetësisë, 65% të popullatës nuk paguajnë kurrëgjë. Ka qenë kompromis politik, por sot nuk po mund të paguajnë kurrëgjë. Prandaj, sigurimin shëndetësor nuk e falimenton kostoja e shërbimeve, në kuptimin sepse ajo llogaritet, për një operacion llogaritet, ajo është kostoja bazike e shërbimeve, caktohet çfarë shërbimi mund të marrësh në secilin repart, i vendoset çmimi secilit asaj dhe fondi paguan në bazë të kësaj çmimoreje, kur ta kontraktojë, ka kontraktuar për 200 operacione, në qoftë se janë nga kaq para, ta bën shumën sa i ke bërë edhe t'i jep, e thjesht është. Problemi ka me qenë kur ta biem ne këtu ligjin, ose kur të vendosim t'i shtojmë kategoritë, ajo ka me qenë. Në qoftë se, pyetni IMF – Fondin Monetar Ndërkombëtar, problemin kryesor e ka aty. Sot, problemi i Kroacisë është aty, i njëjtë.

Prandaj ta thjeshtojmë, kodet që janë të përdorura në mbarë Botën është mirë t'i përdorim edhe ne. Ministria e Shëndetësisë, tash po them se i ka përkthyer shumicën e kodeve, domethënë janë të pranishme në ministri, mos ta humbë atë të mirë që është bërë. Ne jemi afër, në qoftë se e thjeshtojmë pak këtë punë, nuk mundemi sigurimin shëndetësor ta përdorim për zgjidhjen e të gjitha problemeve në shëndetësi. Sigurimin shëndetësor ne është mirë me ia dhënë natyrën e sajë çfarë e ka. Natyra e saj është mburoja financiare për njerëzit, pra që të kenë mundësi ta marrin një shërbim e të mos varfërohen, që është një gjendje reale e Kosovës.

Në qoftë se ju pritni, që ne t'i bëjmë disa projekte kapitale, SISH-in ta fusim në të gjitha vendet, t'i bëjmë nga 25 module për secilin, ta bëjmë SIF-in, ta integrojmë SIF-in me SISH-in e më pastaj ta bëjmë sigurimin shëndetësor, konsideroj pa kokëfortësi, ose pa dëshirë polarizimi, konsideroj se kjo strategji është e gabueshme. Ky është mendimi im, pas gjithë asaj analize që e kam bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro...!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Pyetja magjike, kur po fillojmë, më e vështira, por në anën tjetër edhe më kuptimplotë ndoshta. Unë besoj që sigurimet shëndetësore kanë me fillua me një formë pa mbledhjen e premieeve ende, me një formë për rimbursimin e barnave në fund të këtij viti. Pse po e them këtë? Kur merremi me shumë probleme të Ministrisë së Shëndetësisë, sektorit të shëndetësisë, ka aq shumë probleme, deputetë, që nuk di ku t'ia fillosh. Qëllimi im ka qenë që ato që na kanë krijuar shpenzime më të mëdha, 80% të shpenzimeve që dalin nga xhepi i pacientëve sot janë barnat. Domethënë, 80% e shpenzimit janë barnat.

Prandaj, qëllimi i parë i fondit është që ta krijojë një modul që i lidhë barnatoret në Kosovë dhe që qytetarët tanë, posa t'u shkruhet receta ata të shkojnë ta marrin barin me kartelë pa pagesë. Kjo do të jetë faza e parë, që realisht e mëson edhe fondin që të bëjë transaksione financiare e në anën tjetër t'ua lehtësojë pacientëve jetën, familjeve, se ti e ke një pacient në shtëpi dhe vuan e gjithë familja.

Faza e dytë do të jetë kontraktimi, që do të bëhet vitin e ardhshëm, kontraktimi dhe shërbimet shëndetësore me të gjitha institucionet shëndetësore në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, të mbeta borxh ty, se... i ke katër minuta në dispozicion.

ENVER HOTI: Faleminderit!

Mirë është që jemi në këtë interpelancë. Ministër, faleminderit!

Sistemi informativ shëndetësor nuk është realizuar, edhe pse ishte planifikuar më herët.

Në bazë të raportit të auditimit është evidentuar se nuk ka pasur vullnet të realizohet Sistemi Informativ i Shëndetësisë. Raporti i auditorit ka evidentuar shumë të meta, që nga mos sigurimi i parave të cilat Qeveria shihet që s'ka pasur vullnet deri te devijimi i parave të destinuara për këtë sistem dhe shumë elemente të tjera, që e kanë penguar. Ne mund të konstatojmë tani, besoj që pajtohet edhe ministri, se nuk ka pasur vullnet nga menaxhmenti, po ndoshta edhe nga interesa të ndryshme.

Unë do të dal edhe përtej kësaj teme që është thirrur këtu. Investimet në QKUK janë bërë vazhdimisht dhe janë bërë goxha të mëdha. Gjendja, ministër, nuk është e mirë në Qendrën Klinike Universitare, ju e dini. Si në aspektin e objekteve, në funksionimin e tyre, në konfigurimin e të gjitha atyre reparteve, deri te pajisjet apo aparaturat, për të cilat janë shpenzuar para dhe nuk janë funksionale. Ky është një konstatim, të cilin ju e keni thënë edhe në Komisionin për Shëndetësi.

Sa u përket barnave, qytetarët duhet ta dinë se mbi 30 milionë euro barna janë shuma vjetore. Ju e thatë edhe vetë se 80% të shpenzimeve që i bëjnë pacientët janë për barna. Çka është duke ndodhur këtu? Çka është duke ndodhur në radhë të parë me atë shumë të madhe 30 milionë eurosh dhe prapë ka mungesë të barnave esenciale, prapë ka vonesa, prapë ka edhe në prokurim dhe çdo kund ka një përfitim të hatashëm të interesave, të cilat shumë po e rëndojnë gjendjen e qytetarëve dhe që është një turp i madh që të përfitohet dhe të fitohet në një shumë kaq të madhe, në kurriz të atyre që kanë aq shumë nevojë, të njerëzve të sëmurë.

Unë do të ju pyes juve se kur do të fillojë realizimi i sigurimeve shëndetësore. Mendoj se për këtë u shtrua edhe një pyetje nga parafolësit dhe është mirë ta dimë, sepse disa herë keni thënë se duhet filluar me një pilot projekt dhe ne nuk e kemi shumë të qartë se çka duhet të ndodhë aty.

Po ashtu, raporti i auditimit na ka sjellë një gjendje të keqe në shëndetësi, ju vazhdoni ende të veproni me pozitat e ushtruesve të detyrave. Ka gjendje e cila ka pasur vërejtje që nga rekrutimi i personelit në shëndetësi. Unë dua të konstatoj. Kemi respekt për të gjithë ata gra e burra që punojnë në shëndetësi, por vërtet shëndetësia është rënduar si rezultat i menaxhmentin dhe interesave të të fortëve brenda sistemit të shëndetësisë. Edhe ai kuadër që është, tashmë është i pakënaqur dhe ka filluar të ikë nga vendi.

Prandaj, ministër, unë do të ju pyes përpos temës, se kur do të fillojë, a do të jeni në gjendje që të largoni interesat e të fortëve? Kjo do të ishte detyra juaj primare dhe të ju jepni hapësirë njerëzve, që të punojnë aty. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Zoti Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam mirëpritur këtë interpelancë, që të debatojmë me ministrin, të shqyrtojmë e analizojmë, të japim ide dhe bëj apel për një konsensus të plotë të të gjitha grupeve politike këtu në Kuvend. Plot fat, që në këtë legjislaturë të Kuvendit janë 11 mjek të profileve të ndryshme të të gjitha subjekteve politike, në fakt 12 mjek.

Unë dua të besoj se kemi mjaft kapacitete politike, intelektuale e ekspertizë, që t'i japim sugjerime të nevojshme ministrit të shëndetësisë dhe ta mbështesim atë, sepse dua të besoj se më në fund ky Kuvend i është kthyer normalitetit, problemeve jetike për qytetarët. E tani, kur po flasim për një temë jashtëzakonisht të ndjeshme këto 18 vjet në liri, siç është Sistemi Shëndetësor në vend dhe përkujdesja shëndetësore, por edhe cilësia e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në vend në të tri nivelet.

Zoti ministër,

Si udhëheqës i Sistemit Shëndetësor në vend sigurisht se keni sfida para vetes. Është një problem goxha kompleks i grumbulluar për vite të tëra dhe këtu nuk dua të jap adresa, por konsideroj se spektri politik me dallime të vogla e ka një peshë përgjegjësie, sepse që nga viti 2002 në shëndetësi dhe arsim i kemi pasur duart e lira, edhe në atë kohë si institucione të përkohshme vetëqeverisëse nën administrim ndërkombëtar e në veçanti, qe një dekadë shtet.

Te Fondi për Sigurimet Shëndetësore shtatë vjet 7 milionë euro të shpenzuara dhe duhet ta krijojmë një logjikë të kontinuitetit institucional dhe të memories institucionale, të punëve të mira që janë kryer dhe t'i ndajmë nga ato mangësitë, vakumet dhe ato përgjegjësitë politike dhe institucionale. Është hera e katërt, mbase, që nga foltorja e këtij Kuvendi i kam kërkuar 100 milionë euro buxhet për Ministrinë e Shëndetësisë, jo për ministrin Uran Ismajli, po për ministrin

e Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, sepse jemi të gjithë pacientë të mundshëm. Dhe, një ministër pa një mbështetje, pa një vullnet politik të kryeministrit dhe në vitin 2018 në prag të përfundimit të dekadës së dytë të mileniumit të tretë, nuk ka shëndetësi cilësore pa mjete buxhetore.

Prandaj, Fondi për Sigurime Shëndetësore është një projekt kompleks. Konsideroj që edhe këto shtat vjetët e fundit nuk ka pasur analiza kredibile të studimit të fizibilitetit për orientimin politik, financiar, strategjik, të zbatimit të tij. Faza e parë apo pilot projekti në 30% të territorit të Republikës së Kosovës është implementuar me 39%.

Zoti ministër, këtë statistikë të implementimit merreni si parakusht, si përvojë, si mostër, sepse pa një pikë reference nuk mund të shkoni tutje. Është sugjerim kolegjial, profesional por edhe si një njeri që tani më shumë se një dekadë e gjysmë merrem me hartim, menaxhim po edhe monitorim të politikave shëndetësore në Sistemin Shëndetësor në vend. Në këtë kuptim, projekti i fizibilitetit dhe ato informata që na i keni dhënë në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ato stabilimente që janë blerë, qoftë me para të Buxhetit të Kosovës apo edhe me para të donatorëve, të cilët duhet t'i falënderojmë, thjesht duhet t'i gjeni mekanizmat që t'i fusni në punë.

Unë konsideroj që një nga elementet më të rëndësishme të Sistemit Informativ Shëndetësor është softueri. Çfarë softueri do të aplikojmë, kapacitetet e tij, por është edhe një gjë tjetër, personeli shëndetësor, emancipimi dhe edukimi praktik, trajnimi i atyre njerëzve, sepse duhet punë, vullnet e përkushtim, që thjesht ky sistem të implementohet.

Ministër, konsideroj që 18 muaj është një limit optimal, por unë konsideroj që do të hasësh në vështirësi rrugës për ta implementuar plotësisht. Unë kam deklaruar edhe në Kuvend, që nëse ne e implementojmë kah pranvera e vitit 2020 komplet Sistemin Informativ Shëndetësor në vend do të ishte një e arritur serioze dhe atë, nëse çdo gjë shkon sipas planit dhe në qoftë se, Qeveria e Republikës së Kosovës vërtet do ta ketë prioritet Sistemin Shëndetësor në vend dhe përkujdesjen normale shëndetësore për qytetarët e vendit. Në këtë kuptim, unë sot dua t'i inkurajoj të gjithë punëtorët shëndetësorë që do të jenë pjesë aktive në realizimin e këtij projekti. Të gjithë njerëzit e tjerë, qoftë të politikës, qoftë profesionistët, qoftë njerëz të tjerë nga fusha të tjera që eksperiencia e tyre është e nevojshme.

Por, ministër, mos e harro një gjë. Ka shtete në rajon që kanë financuar, e kanë realizuar tërësisht në aspektin teorik legjislativ, por edhe të pajisjeve sistemin shëndetësor dhe nuk u ka vajtur mbarë. Do të thotë frika jonë nga përvoja e vendeve të caktuara në Evropën Juglindore është si një sugjerim, edhe profesional, edhe politik, por edhe ligjor që e kemi si deputetë edhe si njerëz që vijmë nga fusha e shëndetësisë.

Krejt çka dua të them, gjendja në SHSKUK nuk është e mirë, unë sot i kam vizituar dy klinika, vazhdojnë pritjet, vazhdojnë rendet dhe radhët e gjata të pacientëve të lodhur nga një mungesë e një menaxhimi më efikas, më operativ dhe më kreativ, thjesht, unë mendoj që komplet energjia juaj dhe e stafit tuaj duhet të orientohet te SHSKUK-ja, por edhe te spitalet rajonale.

Prandaj, me kuptimin më të mirë të fjalës, sot duhet të kërkoj nga të gjithë, nga deputetë, nga kryeministri, nga Kabineti qeveritar, nga punëtorët shëndetësorë që si pacientë të mundshëm të këtij vendi të kontribuojnë të gjithë që sistemin informativ shëndetësor ta implementojmë në tërësi. Sigurime shëndetësore, kolegë të nderuar, ka pasur edhe para se të futet në punë kompjuteri në shtetet me demokraci të zhvilluar.

Edhe sistemi informativ i fondit e ka rolin e vet, por ministër, nuk do t'i ndaja këto dy sisteme dhe ecja në mënyrë lineare, angazhimi që këto dy sisteme të implementohen në mënyrë paralele, garanton për një sistem të funksionimit të sistemit informativ shëndetësor.

Por dua ta nënvizoj edhe një herë, pa vullnet politik, pa limite të studiuara mirë kohore dhe pa mbështetje buxhetore, kam frikë se do të zhgënjeheni edhe ju, edhe punëtorët shëndetësorë, por edhe pacientët potencialë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit!

Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

Përshëndetje për ministrin e Shëndetësisë,

Dhe një përshëndetje e veçantë shkon për të gjithë punëtorët shëndetësorë që edhe në këtë moment, derisa ne po diskutojmë, ata e kryejnë detyrën e vet me nder dhe me përkushtim. Kam besim që mbi 95% të punëtorëve dhe profesionistëve shëndetësorë janë duke punuar në mënyrë profesionale me përkushtim, duke u kujdesur për qytetarin dhe për të sëmurin.

E falënderoj Lëvizjen Vetëvendosje, doktoreshën Kollçaku për mundësinë që të sensibilizohet kjo temë në Kuvendin tonë dhe t'ia mundësojë ministrit të shpalosë identifikimin e problemeve, të cilat i ka hasur gjatë marrjes së mandatit deri më tash. Sigurisht që po shihet prej të gjithë aktorëve dhe partive politike që do të ketë mbështetjen e fuqishme në drejtim të realizimit të objektivave, po them të këtij tash, të ministrisë dhe të Qeverisë për të ngritur cilësinë dhe punën në sistemin shëndetësor, për të cilën të gjithë jemi të vetëdijshëm se nuk është duke funksionuar mirë.

Serioziteti dhe qasja serioze e ministrit, bashkë me ekipin e tij, na lë të shpresojmë që do t'i qaset në mënyrë serioze dhe me mbështetjen dhe me buxhetin e rritur që e ka do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e shumë çështjeve dhe problematikave në shëndetësinë tonë.

Më vjen keq që jemi duke folur vetëm për dy segmente të fragmentizuara, se sistemi informativ shëndetësor po edhe ligji për sigurime shëndetësore janë dy segmente që normalisht edhe paraardhësit e ministrit kanë ndikuar, punuar dhe kanë lënë gjurmë në tentimin për t'i realizuar këto dy sisteme. Kisha pasur dëshirë prej ministrit të dëgjoj që a nuk janë realizuar sistemi informativ shëndetësor dhe ligji për sigurime shëndetësore bashkë me fondin që nuk ka pasur menaxhim adekuat, që nuk ka pasur resurse të mjaftueshme njerëzore, apo që është pengesë prej grupeve të interesit për t'u realizuar këto dy sisteme, se shumica e njerëzve që po diskutojmë këtu të deputetëve po e konsiderojnë që janë shumë të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe nuk bën ndoshta edhe ata që janë të interesuar për t'i keqpërdorur gjërat, edhe kanë penguar realizimin e sistemit informativ shëndetësor që nganjëherë më vjen turp prej donacioneve që na i ka dhënë Qeveria e Luksemburgut, po edhe aktivitetet që janë zhvilluar në këtë drejtim e për kaq shumë kohë të mos realizohen. Dëshiroj sukses në planifikimin për t'i realizuar këto dy sisteme, po shoh që do ta kesh mbështetjen e të gjithë deputetëve.

Në qoftë se ka nevojë, edhe për luftimin e atyre grupeve të interesit që i pengojnë këto sisteme, jam i sigurt që do ta kesh mbështetjen e Kuvendit, po edhe sigurisht edhe të Qeverisë.

Sistemi farmaceutik është sistem që është duke çaluar që sa kohë, nuk është farë shpikjesh e madhe të dish që prej grupeve të caktuara të interesit janë duke penguar prej procesit të prokurimit të barnave, krijimit të listës esenciale, deri te importimi legal e jolegal, çudia më e madhe është kur pacientët tanë në barnatore tona të zakonshme e gjejnë një barë që e blejnë me një euro, për të cilën në qendrat tona shëndetësore paguhet me 30 e më shumë euro.

Janë segmente që janë duke punuar me përkushtim, kisha shfrytëzuar rastin ta përgëzoj Klinikën e Onkologjisë për punën shumë të madhe dhe të kujdesshme që e bënë edhe për trajtimin e pacientëve me sëmundje shumë të rënda të këtij lami. Po gjithashtu edhe Kirurgjinë, Peditrinë, Neonatologjinë, Psikiatrinë, Neurologjinë, se kanë punë dhe përballen me qytetarë që janë më specifikë për trajtime të domosdoshme të tyre.

Diku mbi 80 milionë jepen ose blejmë shërbime shëndetësore jashtë Kosovës. Ekipi juaj a ka bërë ndonjë kalkulim që a janë ato shërbime shëndetësore që nuk ofrohen në Kosovë, apo janë shërbime shëndetësore që qytetarët tonë për shkak të gjendjes më të mirë materiale dalin dhe i shpenzojnë ato të holla për shërbime të cilat kishin mundur të ofrohen në qendrat tona shëndetësore apo janë krijuar vija të përhimëta për t'i mundësuar shpenzimin e atyre të hollave jashtë prej disa “profesionalistëve shëndetësorë” që ndoshta e keqpërdorin etikën mjekësore dhe profesionin.

Është vërejtur puna juaj me disiplinë në Qendrën Klinike, duke filluar prej orarit të punës dhe te përkushtimi ndaj pacientëve, është vërejtur një përsheptim i krijimit të odave të mjekëve, që me siguri edhe ato do të japin rezultate në rritjen e cilësisë së punës, po edhe trajnimeve dhe edukimeve të vazhdueshëm në drejtim të përsosjes profesionale dhe qasjes ndaj pacientit.

Është fakt që një kohë të gjatë mjekët tanë dhe personeli tjetër shëndetësor nuk ka marrë pjesë, ose shumë pak prej tyre kanë marrë pjesë nëpër përsosje, konferenca e trajnime të ndryshme dhe jemi në rrugë të drejtë.

Zoti ministër,

Ju kisha lutur personalisht, në çdo moment që keni nevojë për përkrahjen e Grupit Parlamentar të partisë tonë, por po e shoh edhe të gjithë Kuvendit, ju lutem të na drejtoheni.

Ky sistem shëndetësor nuk rregullohet për një vit, dy e për tri, jam shumë i kënaqur në qoftë se për katër vjet i arrijmë ato që nënkuptohen parametra që qytetarët ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Që qytetari ynë të mos brengoset ku po shërohet, të mos frikësohet se a do të ketë mjete të mjaftueshme, mund të themi që edhe shteti ynë po duket se është shtet i pasur, se edhe në shtetet më të zhvilluara, në qoftë se nuk ke mjete financiare, nuk trajtohesh nëpër klinika, a spitalet tona i trajtojnë të gjithë qytetarët, të gjithë vizitorët, edhe të huajt që janë në kalim e sipër nëpër Kosovë dhe për ato nuk kompensojnë apo nuk kompensohen.

Andaj besoj që është çështja te menaxhimi, te kontrolli, kontrollin mund ta ushtroni me resurset të cilat i keni në disponim apo me të cilat duhet t'i plotësoni, se kontrolli është ai që e rrit cilësinë e punës.

Në qoftë se ke nevojë edhe mbikëqyrje, sigurisht do të kesh mbikëqyrje edhe prej grupeve nga Komisioni për Shëndetësi, do të jetë një lehtësim ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Po flas nga pozita e një njeriu që nuk i takon mjekësisë, po shërbime të mjekësisë i merr rregullisht.

Deri tash unë e dëgjova pjesën teorike dhe legjislativë, mirëpo nga ajo që dëgjova, ishin disa konstatime interesante.

Sistemi i shëndetësisë në 18 vjetët e fundit është lënë anash, unë e krijova përshtypjen sikur ka ardhur prej qiellit, domethënë nuk po dihet prej kujt është lënë anash?

Del se ka grupe të interesit, po çka janë ato grupe të interesit që po e dëmtojnë sistemin e shëndetësisë, askush nuk po thotë? A mund të jetë kjo ajo që po e quan Raporti i Progresit “krim i organizuar”? A ka mundësi të jetë ai? Domethënë, diçka ka këtu, se ato grupe të interesit e kanë një interes, ja të vjedhin, ja të mashtrojnë, ose diçka, e ata që punojnë në këtë formë janë krim i organizuar, edhe tash duhet parë te sistemi shëndetësor a kemi të bëjmë vetëm me krimin e organizuar privat apo edhe institucional? Këtë s’po e thotë askush!

Qe 18 vjet kush e ka sjellë këtë sistem shëndetësor në këtë gjendje?

Sistem shëndetësor që thotë e ka financimin më të ulët në Evropë, ato i dëgjova tash zyrtarisht.

Thotë, përveç që e ka financimin më të ulët në Evropë, më së pakti jepen për kokë banori, me gjasë, nuk ka fond për sigurime shëndetësore, nuk ka sistemi informativ shëndetësor.

Tash për mua lindin pyetjet si pacient krejt të thjeshta.

Qysh është e mundshme, tash po e pyes drejtpërdrejt ministrin. Kur është e mundshme të ndryshojë kjo gjendje? Për shembull, unë të shkoj në Klinikën Kirurgjike të QKUK-së dhe të mos më thuhet se nuk ka jod, qysh po e quajnë, “Bekadin”, a çka është?

Gjatë luftës në spitalet provizore të UÇK-së ka pasur jod për shërimin e plagëve, në QKUK nuk ka jod, jo rregullisht, po ngjan që nuk ka jod!

S’po dua të përmend emra, shkoj në operacion në QKUK dhe thonë duhet t’i blesh penjtë. Çka do të thotë kjo? Nëse s’i blen penjtë, veç të prej, të lë çel dhe bë çka të duash! Kjo i intereson pacientit: kur do të ndodhë të shkosh në sallën e operacionit dhe të mos i thuhet “shko blej penj”, ose shko blej mjete për mpirje.

Është çështja e sigurimeve shëndetësore, ne jemi i vetmi vend në Evropë që s’kemi sigurim shëndetësor, kjo është njëra pyetje. Këtë e bën edhe përpara.

Po si pacient mua më intereson: Çka do të kem unë si pacient pasi të ketë sigurim shëndetësor? A do të detyrohem t'i blej krejt barnat, dhe t'i paguaj përsëri shërbimet, si është kjo punë?

Çështja tjetër, thuhet se ne japim shumë para jashtë për shërbime shëndetësore, vërtet për mua është absurd i llojit të vet.

Ne jemi vendi më i varfër në Evropë, pa sigurime shëndetësore, me shërbimet mjekësore më të varfra në Evropë, kurse i paguajmë shërbimet më të shtrenjta në Evropë. Për një operacion të njëjtë thjesht në Zvicër njeriu ka paguar dyfishin më të ulët të çmimit se në Kosovë për heqjen e një bengu, që i thonë, i cili del në lëkurë.

Prandaj, çështja për mua është edhe kjo: kur do të ketë sigurime shëndetësore që të shkoj te mjeku, të marr barna, dhe pastaj nëse nuk më ndryshon gjendja, shkoj te mjeku tjetër dhe më thotë: hiqi këto barna s'kanë lidhje me sëmundjen që e ke. Kush t'i ka dhënë këto barna, dhe pastaj të merren barna të tjera. A është kjo në kuadër të atij sistemit informativ shëndetësor që e cakton njëherë, ose shkon në spital pacienti, ose ka radhë, ose është prishur mjeti, dhe thotë: a di çka, këtu kallaballëk i madh, s'po punon ky farë instrumenti, eja aty te ordinanca private dhe ta tregon edhe rrugën, edhe vendin, edhe orarin kur punon.

Këto janë pyetjet për mua si pacient: kur do të lirohem unë si pacient nga këto barra që 20 vjet pas luftës? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Deputeti Hoti i ngriti disa çështje, e mandej shkurtimisht në qoftë se arrij, edhe për shkak të kohës.

E para, është e vërtetë që ka pasur investime në QKUK, por duhet folur drejt që investimet nuk kanë qenë të bollshme, po në anën tjetër, edhe administrata për t'i ruajtur investimet që janë bërë, nuk ka qenë mënyra si është dashur.

Pra, veç para dy javësh është miratuar struktura e re organizative e SHSUK-së, e cila krijon një administratë të re për QKUK-në, një administratë e cila ka për detyrë t'i kryejë funksionet e mirëmbajtjes të sistemit. Pra, të mos i bie barrë mjekut ose personelit shëndetësor që të merret me higjienën, a është furnizimi në rregull, po të koncentrohet vetëm në shërbimin mjekësor që e jep dhe administrata të jetë administratë profesionale që e bën mbarëvajtjen dhe që investime që bëhen, pajisjet, mirëmbajtjet e të gjitha ato. Pra, në qoftë se jemi duke investuar, tani kemi filluar të investojmë. Kujt po i investojmë? Çka në qoftë se ne pas dy vjetësh bëjmë një raport të auditimit, siç e kemi me SISH-in dhe na del që nuk kemi qenë në rregull.

Sado që varet nga vullneti im, në qoftë se nuk krijohet struktura administrative profesionale, nuk kemi bërë asgjë.

Pra, fokusi im është që ta bëjmë një herë atë strukturë administrative, që në momentin kur vijnë pajisjet, e veç janë duke u blerë, ta kemi një ndryshim të gjendjes.

Sa u përket barnave, pajisjeve dhe interesit kërkove të dish ka apo jo.

Deputet, ne kemi pasur edhe shumë debate në Komision Parlamentar, ju e dini është një mit, ta quaj kështu, në Kosovë kur është çështja e rregullimit të çmimeve të barnave, gjithnjë është thënë: mos u fut aty, është det i thellë, s'do t'ia dalësh, do të të ndalin. Ne e kemi pasur një dëgjim publik, dëgjimi publik u ka treguar me fakte të gjithë njerëzve të cilët shesin barna. Nuk jemi kundër tyre, veç nuk duam të blejmë më shtrenjtë se që e blen një pacient në Kosovë, privat, ose një pacient në Maqedoni, në Mal të Zi ose në Shqipëri. Nuk e blejmë, si shtet nuk e blejmë asnjë cent më shtrenjtë. Ky është vullneti yni, është vendimi yni. Dhe këtë le të jetë çfarëdo lloj force në anën tjetër, nuk mund të na zbrapsë prej kësaj situatë.

Unë po e them publikisht, edhe fjalën time e mbaj 'dorzan', para juve, po prej kësaj nuk zbrapsem, domethënë nuk ka interes që mund të më zbraps nga diçka që e di që është e drejtë për neve si shtet, por edhe për popullin tonë.

Zoti Rugova i përmendi disa gjëra, e para ke pilot-projektin. Natyrisht që gjërat të cilat janë të mira, në asnjë formë... Unë punoj në administratë publike gati më shumë se një dekadë, domethënë nuk jam pa përvojë në administratë publike.

E di që nuk ka ministër që i fillon dhe i përfundon të gjitha, domethënë një ministër i fillon, tjetri i përfundon, disa ai vetë i përfundon, e kështu me radhë.

Mirëpo në SISH ky ka qenë pilot-projekt, pra është konsideruar që të marrim ato që janë më të mirat, të këqija t'i largojmë dhe të vazhdojmë me të, gjithnjë në mësimet që janë mësuar mbi bazën e këtij pilot-projekti.

Është e vërtetë, e përmende punën e menaxhimit, unë prapë e thashë, nuk ka pasur strukturë menaxheriale, nuk ka strukturë menaxheriale të mirë nëpër spitale tona, duhet folur drejt. Gjithçka është koncentruar kah mjekët, t'u jepen shërbime mjekëve, që është e natyrshme, pa krijuar staf profesional që ata të mos kenë nevojë t'i mbajnë mend proceset organizative, kjo është diçka që jam duke e fuqizuar tani.

Më the po ashtu "ruaju zhgënjimit"! Unë e di pak a shumë ku jam, çfarë ministrie kam marrë, e di që ka qenë një ministri me shumë probleme. Ne thamë që të gjithë i kemi fajet, dikush më

shumë, dikush më pak. Ne si parti është hera e parë që e marrim Ministrinë e Shëndetësisë, unë e kam ditur që PDK-ja po e merr, e kam ditur me çfarë barre e marr, me çfarë morie problemesh e marr. Në asnjë moment nuk kam zhgënjim nga ajo që e bëjmë çdo ditë dhe nuk do të zhgënjehem për aq kohë.

E para, sa e kemi një kësi vullneti nga të gjithë, por edhe e dyta, nga energjia ime, e di që nuk do të ndalem për të punuar në arritjen e kësaj.

Zoti Kurteshi, kur do të ndryshojë gjendja? Varet qysh e këqyr.

Gjendja në disa vende është shumë e keqe, edhe unë nuk pajtohem me to.

E para, e përmende furnizimin. Ne kemi ardhur në një situatë ku kontratat të cilat i ka pasur Ministria e Shëndetësisë janë tejkaluar disa fish, natyrisht s'kam mundur ta shkel ligjin, është dashur t'i ndërpres të gjitha.

Por çka ka ndodhur është që unë kam bërë diçka dallim, kam bërë edhe një hulumtim të tregut, sa kushtojnë ato barna të blihen? Pra nuk jam futur menjëherë t'i blej, edhe pse më kanë bërë presion që t'i blej më shpejt se po mbesim, po atë presion unë e kam kuptuat të dyfishtë: është presion për t'i bërë dikujt kontratën me çmim më të lartë, unë s'kam dashur ta lejoj atë.

Është e vërtetë që për momentin jemi duke paguar diçka, po jemi duke u ruajtur në afatgjatë të krijojmë një normë të re, normë është që shteti i Kosovës nuk ka para t'i japë dikujt më shumë se meriton, kjo është ajo normë.

Shteti i Kosovës nuk do t'i japë para dikujt më shumë se meriton.

Këtu jemi duke i blerë, jemi në proces të vlerësimit të 300 artikujve dhe të gjitha këto do ta ndryshojnë gjendjen.

Mirëpo në disa vende ka ndryshuar, po ta jep një statistikë. Në Kardiologjinë invazive janë bërë 600 koronografi, 31% të tyre janë bërë pas orës 22:00, domethënë kjo nuk ka ndodhur më herët, 31% të tyre njerëz pas orës 22:00 kanë shkuar, me familjarë, nuk e kanë ditur a shpëton apo jo, kanë hyrë dhe kanë marrë shërbimin. Janë bërë 167 stentime që është mbi një milion euro vlera, domethënë janë kursyer qytetarët, nuk i kanë dhënë prej dorës së vet, domethënë këto janë shpenzime të mëdha të cilat janë kursyer.

Por nuk kemi mbërritur atje ku po duam, e kemi planin, është duke u punuar çdo ditë për të, muajve dhe javëve që vijnë do të shohim ndryshimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Ministër,

Në fakt, kryesues, minutat që i keni paraqitur aty, kam më shumë, faleminderit!

Ministër, faleminderit që jeni këtu dhe po përgjigjeni për atë sa mundeni për një temë, e cila tash e 18 vjet lëngon mbi këtë shoqëri.

Në fakt, unë në vitin 2012 kam shkruar një shkrim me titullin “Shërimi i shëndetësisë” dhe sot duke e parë që do të ndodhë kjo interpelancë, e rilexova.

Mund t’ju them me shumë zemërim që jo shumë gjëra kanë ndryshuar dhe diskutimin tim do ta bëj mbi ato pesë gjëra, të cilat i kam parë në vitin 2012, e të cilat po besoj që edhe sot janë valide dhe janë, si të themi, themel për një shëndetësi publike, e cila ka kuptim.

Pra diskutimin e kam kryesisht të orientuar mbi rregullimin e shëndetësisë publike dhe rrugën përpara për t’u sigurua që shumica e qytetarëve të kësaj Republike të kenë qasje në shërbim apo në shëndetësi të mirëfilltë.

Në orën 8:00 të mëngjesit, ministër, një mik imi ndodhi para një spitali në Shkup, spital publik dhe ashtu siç ishte dakorduar me doktoreshën 80 kilometra më larg prej Prishtinës.

Jo pse ishte dëshirë e tij, po pse ishte imponim dhe këtë e bëri në kërkim të shërimit, por jo veç në Shkup, po në secilën qendër rajonale dhe qendër evropiane mund të gjeni qytetarë të Republikës së Kosovës duke kërkuar shërim. Kjo është gjendja tash e 18 vjet. Pra, për afërsisht dy orë më larg Prishtinës shpërfaqet në tërësi sfida, problemet që i kemi ne tash e 18 vjet në shëndetësinë kosovare. Për mua është tmerrues jo vetëm dështimi në ndërtimin, konsolidimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor, por që besa, sot këtu është goxha tmerruese edhe fakti që ka subjekte që kanë menaxhuar së paku për tetë vjet shëndetësinë dhe përsëri argumentojnë mbi dështimet në sistem. Pra, kanë qenë vetë pjesë e ndërtimit të këtij sistemi dështues.

Në këto udhëtime normalisht shumë prej këtyre qytetarëve nuk mund të llogarisin në përkrahje të shtetit, pra përkrahje nga buxheti apo çfarëdo lloj përkrahjeje tjetër, shumë prej nesh kërkojmë shërim prej xhepit tonë. Disa prej nesh e kemi atë mundësi, disa jo. Dhe, Kosova të vazhdojë të jetë i vetmi vend në këtë pjesë të Evropës, në mos edhe më gjerë, i cili nuk ka skemë të sigurimeve shëndetësore, ndonëse ju këtu po prezantoni një plan apo afat kohor më shumë se plan, pa sistem të integruar të informatave për pacientë, pa librezë apo kartela shëndetësore dhe, rrjedhimisht, edhe pa historik shëndetësor të qytetarëve të kësaj Republike. Për më tepër, ministër, ju e dini këtë, kemi mungesë të procedurave, të proceseve, por edhe rregullave të

thjeshta të protokollit për trajtimin e pacientëve dhe, gjithashtu e thatë edhe vetë, që kemi mungesë të barnave në spitale e në SHKSUK.

Por, jo vetëm kaq, kemi mungesë të përkrahjes për hulumtime shkencore aq të nevojshme për të ndihmuar zhvillimin e vazhdueshëm të doktorëve, sidomos në nivelin terciar. Dhe, këtë kryesisht mjekët në Republikën e Kosovës e kompensojnë duke u financuar nga ata që shesin barna, e fatkeqësisht po shndërrohen mjekët në atë që në gjuhë ndërkombëtarisht po thuhet “drugpushers”, ata që shtyjnë barna, pra jo njerëz që shërojnë pacientë, por njerëz që shtyjnë barna. Dhe, sot fatkeqësisht situata në shëndetësi vazhdon të jetë e rëndë, kredibiliteti i sistemit, besoj që është një prej sfidave kryesore, është buzë greminës. Kemi pacientë të pakënaqur me shërbimet shëndetësore në sektorin publik dhe rrjedhimisht, meqë janë të pakënaqur, orientimi i tyre në sektorin privat ose jashtë vendit vjen si pasojë e humbjes së besimit në institucionet të shëndetit publik.

Në fakt, kjo situatë do të vazhdojë derisa ka mungesë të një strategjie dhe një vullneti të mirëfilltë për tejkalimin e kësaj situata, unë po dua të besoj që ju sot këtu po mundoheni të na tregoni që keni një strategji, e që besa, në mënyrën se qysh po flisni, duket se edhe vullnet keni, por është e pamjaftueshme, sepse mendoj që jeni duke dhënë përgjigje për pyetje shumë specifike, e sot do të ishte shumë me rëndësi të na tregoni si e shihni ju sistemin shëndetësor publik 18 muaj më vonë. Pra, ju thatë 18 muaj do të bëni sistemin e sigurimeve shëndetësore, do të zbatoni këto reformave, për mua si deputet është tepër e rëndësishme të na shpjegoni si do të duket ky sistem sa i përket shëndetit publik.

Por, për të argumentuar që sistemi shëndetësor në Kosovë ka 18 vjet që vazhdon të jetë një nga pjesët më të neglizhuara të shoqërisë, do të flas vetëm për pesë pika. E besoj që janë pesë pika që mund të zgjidhen shumë lehtë, ministër, me vullnetin politik, me përgjegjësi të Qeverisë dhe me një program zhvillimor sa i përket sistemit shëndetësor publik. Po i marr me radhë:

1.Republika e Kosovës është i vetmi vend në rajon, i cili nuk ka skemë të sigurimeve shëndetësore dhe kjo vazhdon të jetë edhe sot, dhe menjëherë po ju bëj pyetjen sa i përket kësaj. Cili mendoni që do të jetë primi total vjetor nga skema e sigurimeve shëndetësore, shuma totale e akumuluar nga kontributet e skemave shëndetësore dhe si do të duket, apo si do të reflektojë kjo në buxhetin vjetor të kësaj Republike?

2. Republika e Kosovës është i vetmi vend në rajon, i cili nuk ka historik shëndetësor të qytetarëve të vet. Për ta shpjeguar këtë, pra të integruar po flas, sistem të integruar për historikun shëndetësor të qytetarëve. Pra, sa herë një qytetarë viziton një mjek, atë gjithëherë do ta pyesin: a je alergjik? A mos ke diabet? Çfarë tipi të gjakut ke? Pra, edhe nëse ka qenë dje, përsëri kur shkon nesër, përsëri do t'ia bëjnë këto pyetje. Kemi, pra, mungesë të historikut të secilit pacient,

e rrjedhimisht meqë unë di pak prej kësaj teme, sepse në këtë temë tash e 15 vjet e dëgjoj në shtëpi çdo ditë.

Secili qytetar kur shkon te mjeku s'ka lidhje a ka qenë te i njëjti mjek dje, shkon për herë të parë të mjeku. Duke qenë kështu nuk kemi informacion të qytetarëve sa i përket shëndetit të tyre. Pra, nuk kemi të dhëna për ta, nuk kemi mundësi t'i përpunojmë ato të dhëna, nuk kemi si t'i mbledhim ato të dhëna, kështu që nuk kemi si të bëjmë planifikim të mirëfilltë për llojin e trajtimit në një mënyrë sistematike të merremi me shëndetin e qytetarëve.

3. Asnjë qeveri deri më tani nuk është përkujdesur që shëndeti i qytetarëve të trajtohet në mënyrë të sistemuar dhe me protokolle, e kam të qartë që disa protokolle tashmë janë bërë, por për 18 vjet protokollat për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, e që janë aq të zakonshme në secilin vend rreth nesh, pra secili vend rreth nesh i ka këto protokolle, ne nuk i kemi. Si pasojë, secili mjek ka të drejtë dhe liri ta trajtojë sëmundjen siç dëshiron, apo sipas idesë së tij, pra cili protokoll është më adekuat në kohën në të cilën është. Pra, një mjek ka lexuar një protokoll më të avancuar nga, themi, një databazë ndërkombëtare, një mjek nuk ka mbërritur ta lexojë dhe kemi dy trajtime të ndryshme për një çështje fare të njëjtë, komplet të njëjtë. Pra, edhe jep terapi si e mendon që duhet të jetë dhe këtu ka, besoj, rol industria farmaceutike shumë, se cila është terapia, e cila duhet të japë mjeku në mungesë të protokolleve. Dhe, në fund normalisht nuk regjistrohet askund.

Për aq sa mjekët janë profesionistë, aq janë edhe njerëz, të cilët sikur të gjithë ne, mund të gabojnë dhe pikërisht për shkak të kësaj na nevojiten protokolle, procese e rregulla pune në çdo institucion shëndetësor dhe në çdo kontakt me pacientë. Këtu besoj është edhe një prej politikave, të cilat me një, të themi, azhurit të madh duhet t'i trajtoni. Në mungesë të këtyre protokolleve përgjegjësia nuk mund t'u vendoset mjekëve dhe për 18 vjet kemi parë një zhurmë, betejë, ku kemi bërë, të themi kështu, luftë të pakompromis kundër mjekëve, sepse problemet na qenkan te mjeku, e jo te mosndërtimi i një sistemi të mirëfilltë shëndetësor, i cili i ka në vete këto tri elemente.

Ju e përmendët, edhe kjo pyetje sa u përket protokolleve, kur mendoni që do të finalizohet apo së paku kur mendoni që do të ecim përpara sa i përket organizimit, sistemimit të protokolleve në shëndetësinë kosovare?

4. Asnjë Qeveri deri më tani nuk e ka trajtuar furnizimin e shëndetësisë publike me barna dhe me mjete të duhura për kohën dhe sasinë e duhur. Ju i trajtuat disa tema që, disa si të thuhet, probleme që ndërliken me furnizim me barna. Pyetja ime është e thjeshtë: në bazë të çfarë informacioni po e bëni revidimin e listës së barnave esenciale? Çfarë informacioni po përdorni? Pra, nëse nuk kemi informacion për pacientë, nëse nuk kemi informacion për llojin e sëmundjeve

që lëngojnë mbi këtë popullatë, nëse nuk kemi informacion çfarë barna po jepen, si e ndërtojmë listën e barnave esenciale dhe sa do të kushtojë kjo? Sa do të jetë kursimi, sipas jush?

Dhe, në fund, e përmenda edhe temën e përkrahjes së hulumtimeve shkencore në mjekësi. Mendoj që kjo është një prej punëve që gjithashtu ka efekt të drejtpërdrejtë në kthimin e kredibilitetit në shëndetësi. Një shëndetësi terciare, në të cilin mjekët nuk janë të angazhuar në hulumtime shkencore, pjesë e diskutimeve ndërkombëtare mbi trajtimet dhe mënyrën se si trajtohen sëmundjet apo gjendjet në të cilat vijnë pacientët, besoj që gjithmonë do të jenë pas edhe rajonit, por edhe pas në trajtimin e temave, të cilat besoj që mund t'i trajtojnë. Asnjë qeveri, me sa e di unë deri më tash, dhe do të kisha pyetur këtu: a ka fond për hulumtime shkencore që Ministria e Shëndetësisë mendon ta ndërtojë apo do ta ndërtojë dhe nëse e ka, si mendon të trajtojë këtë? Unë besoj që këtu qëndron edhe një prej pikave problematike në shëndetësi. Financimi i hulumtimeve që bëhet nga ata që shtyjnë me barna përpara.

Si përfundim, në prill të vitit 2018, qytetari i këtij vend nuk ka historik shëndetësor, nuk ka sigurim shëndetësor, nuk ka barna dhe mjete esenciale në spitale dhe ende duhet të udhëtojë jashtë vendit për të gjetur shërim. Dhe, në këtë minutë të mbetur i kam edhe tri pyetje që besoj që janë të rëndësishme për ju, sepse po dua të kuptoj edhe idenë se si e keni të ecim përpara, pra kështu unë e shoh interpelancën, t'i trajtojmë temat problematike dhe t' ju shohim se si mendoni të ecim përpara.

Sa kohë mendoni që do të marrë ndërtimi i databazës së qytetarëve, historikut të databazës, unë nuk po i jap emër. Po pyes sa kohë do t' ju marrë derisa të ndërtoni databazën për secilin qytetar të kësaj Republike? Emrin lërbani si të doni, por ka të bëjë me historik të qytetarëve.

E dyta, kur mendoni të filloni me mbledhjen e kontributeve për sigurime shëndetësore?

E treta, kur mendoni të përdorni këto mjete për të bërë pagesën me anë të sistemit të fondit?

Dhe, e fundit fare, çfarë rregullash përdorni për të vendosur barna esenciale, çfarë barna mund të futen në listën e barnave esenciale, duke e pasur përvojën e insulinës deri para nja 2-3 muajsh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem, ia lejon, në qoftë se ka pyetje.

DARDAN SEJDIU: Pra, me çfarë rregullash do të sigurohemi që barnat që futen në listën e barnave esenciale plotësojnë kriteret të standardet e duhura për të dhënë terapinë për qytetarët? Përvojën që e kemi pasur me insulinën, besoj është një mundësi e mirë për të reflektuar që të

vendosim një kriter, i cili është nacional dhe i pranueshëm për ne, qoftë “European Drug Association”, qoftë “Federal Drug Association” apo edhe ndonjë e ngjashme.

Thjesht, të sigurohemi që kemi cilësi dhe jo vetëm çmim. Faleminderit, ministër!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën, në qoftë se dëshiron të përgjigjet.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, zoti Sejdiu!

Realisht ngritët shumë çështje, por le tentojmë t’i japim disa nga përgjigjet. E para, sa i përket databazës, e cila krijohet, po ashtu e përmendët edhe idenë që ku i marrim të dhënat për krijimin e politikave, të dhënat për shëndetin publik.

ICD kodet janë po ashtu një databazë, e cila përdoret për shëndetin publik. Pra, kur dihet diagnoza, kur dihet tretmani, dihen edhe llojet e sëmundjeve, të cilat ne i kemi në shëndetin publik dhe arrijmë të krijojmë politikëbërje mbi bazën e atyre kodeve. Prandaj, me sistemin informativ të fondit, edhe kur bëjmë pagesën, po ashtu mblidhen informata sa u përket njerëzve se çfarë sëmundje kanë apo si e kemi shëndetin.

Sa u përket protokolleve, protokollet ne i kemi filluar, i kemi bërë një numër të tyre këtë vit, nuk kemi saktë, domethënë nuk ka pasur për vite të tëra, por çka është me rëndësi diçka, protokollet shërbejnë në dy dimensione: e para për kualitetin e shërbimeve, pra që ta ngremë kualitetin e shërbimeve dhe, në anën tjetër, të ulim shpenzimet. Unë prapë them që natyrisht, mjekët tanë kanë edukim të duhur për t’iu përgjigjur sëmundjeve, por protokollet e standardizojnë, duke arritur që ta rrisim kualitetin e shërbimeve aty ku mund ta shohim. Është proces që do të vazhdojë, pra nuk mund ta jap një datë, për arsye se është proces që kalon nëpër revidim gjatë tërë kohës.

Pyete për barna dhe revidimin e listës esenciale. Këtu kemi pasur një debat mjaft të madh dhe për këtë e kam ftuar Organizatën Botërore të Shëndetësisë, tri herë kanë qenë në Kosovë. Revidimi i listës esenciale do të bëhet në bazë të udhëzimeve të OBSH-së. OBSH-ja, edhe ashtu prodhon lista esenciale për gjithë botën, domethënë i vendos udhëzimet për listat esenciale. Pra, do ta kemi, ta them, mentorimin e organizatës kryesore ose organizatës primare për listën esenciale. Natyrisht, kjo do të bëhet me një komitet, në të cilin të gjithë ata që hyjnë duhet të nënshkruajnë që nuk kanë konflikt interesi, pra do të nënshkruajnë dëshmi nën betim që nuk kanë konflikt interesi, por do të jenë në mbikëqyrje të OBSH-së.

Sa u përket kontributeve dhe buxhetit, ne e kemi një parallogaritje rreth 130 milionë euro që do të mblidhen nga premiumet dhe, natyrisht që këtë e ka bërë fondi, ende nuk kemi diçka ekzakt, sepse nuk është bërë, është bërë vetëm në bazë të, ta quaj, në bazë të parallogaritjeve të para. Më pyetët si do të duket sistemi pas 18 muajsh?

Shiko, sistemi pas 18 muajsh për mua është një sistem shëndetësor, në të cilën nuk do të kemi raste, ku një klinikë e Gastroenterologjisë sot në Kosovë, në QKUK, i ka dhjetë specialistë dhe t'ua bëjmë një pyetje, sa pajisje i ka endoskopike për të mundur të bëjnë kontrollimin? Zero! Domethënë, dhjetë specialistë sot janë dhe nuk e kanë asnjë pajisje. Ne e kemi filluar blerjen, i kemi dhënë buxhetin dhe udhëzimet për ta blerë. Pra, shoh një shërbim pas 18 muajve kur do të ketë shërbime të duhura, ku pagesat e mjekëve tanë specialistë nuk do të jenë 630 euro, sepse ata bëjnë një sakrificë të madhe akademike dhe nuk paguhen në bazë të tregut çka i paguan. Ne duhet të jemi vetëkritik këtu, duhet krijuar kushte më të mira për ta, një sistem shëndetësor i cili nuk i ka më së paku mjekët në 1 mijë banorë në regjion. Ne kemi më së paku mjek në 1 mijë banorë, jo në sistem, ku ne nuk mund t'u krijojmë ensentiva specialistëve tanë për të mbetur në Kosovë.

Një sistem shëndetësor, ku qytetari ynë nuk do të duhet të mendojë a ta shesë shtëpinë për t'i bërë operacion prindërit e tij. Mbas 18 muajve konsideroj që ne duhet ta krijojmë një lloj garancie shtetërore për shërbimet që qytetari ynë ka nevojë t'i bëjë. Është e vërtetë që ka pasur shumë trajtime jashtë vendit, ne kemi bërë një sistem online, ku të gjitha trajtimet jashtë vendit tani futen aty për aty dhe ka transparencë të plotë. Nuk ka njeri këtu në sallë ndoshta që nuk e ka marrë ndonjë telefonatë a e njihni dikë se e kam dorëzuar një letër për trajtim jashtë vendit. Nuk ka nevojë të na thërrasë kurrkush veç neve që kemi të njohshëm, secili qytetar i vendit që vjen atje duhet pasur një njeri që i rri atij gati. Ai sistem ia krijon mundësinë të gjitha dokumentet t'i vendosë, t'i shohë a janë të kompletuara dhe nuk ka mundësi t'i bëjë dikush padrejtësi, për arsye se sistemi është online, është i ruajtur dhe nesër e auditojmë në qoftë se dikush e ka tejkualuar rendin apo jo.

Pra, si e tillë kemi nxjerrë një databazë cila klinikë ka dhënë më së shumti para për shpenzime jashtë vendit? Këtë ia kemi dorëzuar QKUK-së, ju kemi thënë këto klinika janë duke na bërë shpenzime. Na tregoni pse po bëjnë shpenzime? A s'keni pajisje? A s'keni njerëz? Apo ju vyejnë trajnime? Pra, në një formë, kemi filluar të avancojmë që ato që i kanë ndodhur mikut tënd, e nuk ka asnjë mik ndoshta që s'i ka ndodhur ose vetë familjarit që nuk kemi kërkuar trajtim jashtë vendit dhe këtë nuk e kanë kërkuar njerëzit nga dëshira. Kurrkush nuk i hip veturës të shkojë në Maqedoni nga dëshira, por nga mungesa e besimit që është krijuar në sistemin shëndetësor për vite me radhë. Ne duhet ta kthejmë atë besim me investime, t'i mbështesim mjekët tanë, por natyrisht, të krijojmë edhe sisteme transparente për pacientët tanë. Të mos ndihet ai i anashkualuar, se kur të shkojë atje, duhet ta njohë një mjek. Jo, kur të shkojë atje, krejt çka i vyen është të vendosë emrin e tij dhe të presë në radhë për rend.

Ky është sistemi që e pres unë pas 18 muajve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Emilija Rexhepi. Imet, a dëshironi ta merrni fjalën tash, a nga fundi, pasi ke qenë ministër. Si të doni, e vendos vetë, në qoftë se dëshiron, e ke menjëherë. Zonja Emilija një herë, pastaj Imeti vendos.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala, predsedniče Parlamenta!

S obzirom da nam je na dnevnom redu danas je na interpelanca Ministra zdravlja, ne želim da se ponavljam što se sve moje kolege danas iznele u vezi svih problema sa kojima se naši zdravstveni sistem na Kosovu suočava, slažem se sa svima njima, počev od najobičnijih medicinskih usluga našim građanima, nedovoljnog medicinskog materijala za hitnu intervencije, nedovoljnog stručnog osoblja, a još veći problem predstavljaju doktori, koji bez ikakvog moralne, humane a pre svega ljudske odgovornosti obavljaju svoju dužnost kao što to čine neki hirurzi u prizrenskoj bolnici, smatrajući da je to njihov privatni biznis, ne poštujući pacijenta kao u kakvom se životnom položaju njegov život nalazi. To sam se lično uverila i doživela pre dve nedelje, podneo sam žalbu direktora u bolnici i tražila odgovornost kao običan građanin, nisam htela da se predstavim da sam poslanik u parlamentu Kosova, nego sam posmatrala sa strane kako se pojedini doktori odnose prema pacijentima čiji je život ugrožen, a posebno prema starcima koje dolaze sa sela a nemaju novac da plate počev od jedne obične injekcije i šprica.

Poštovani ministre, ja vas znam dugo godina i pratim vaš trud i rad u ovom sazivu Vlade, kao načina koji želite da poboljšate zdravstveni sistem na Kosovu. Zahtevam javno od Vas da hitno intervenišete oko funkcionalnosti familijarnog zdravstvenog centra u Rečenu, nedavno službeno posetili taj centar, želim informisati o decenjskom problemu jednom medicinskom fenomenu kojeg nekog svesnog godinama unazad ne može da rešite ili ne želi to da uradi radi svojih ličnih interesa.

Znate li da na primer naše najveće Bošnjacko selo Gornje Lubinje, koji broji više od tri hiljade ljudi a udaljeno od grada Prizrena više od 20. km, nema nikakvih zdravstvenih usluga, ambulanta ne radi, doktora nema, niti medicinskog tehničara. To isto važi i za sva druga ostala sela kao što su Donje Lubinjo, Panjenje, Bregoštolovtica, Grnčare i druge. Sva ta sela u Župskom i Podgorskom kraju. Iako bi po zakonu trebalo da ambulante u većine selima rade po dve smene sa adekvatnim stručnim osoblje, kao što su doktori, stomatolozi, medicinski tehničari. Kao predstavnik Bošnjaka u parlamentu Kosova godinama sam iznosila ovu problematiku kako bi smo pronašli najbolje moguće rešenje, ali nisam nailazila na razumevanje niti opštinskih struktura vlasti, niti ministarstva zdravlja.

Što je bilo na nama mi smo zajedno sa diraktorijatom zdravlja u Prizrenskoj opštini nekoliko godina unazad izgradili ambulante po našim selima, ali to ništa ne znači za to što su one zatvorene. Te Vas molim ministre da ovu našu problematiku shvatite jako ozbiljno, jer na tom području živi više od 15 hiljade stanovnika, a familijarni zdravstveni centar u Rečanu nije

kazneni centar za medicinsko osoblje koji rade u Prizrenu i po kazne ide na rehabilitaciju gore, i posle toga se ponovo vraća na svoje radno mesto.

Zahtevam od Vas fond za otvaranja novih radnih mesta, najmanje 3. doktora, 2. stomatologa i 10. medicinskih i stomatoloških tehničara, kako bi centar u Rečanu radi u 24. časa, ambulante u dve smena, posebno u selima koje broj e više od dve do tri hiljade stanovnika.

Direktorijat zdravlja u opštini Prizren želi da finansijski pomogne u rešavanju ovog problema, ali nam to nije dovoljno i tražimo i vašu pomoć, ali i pomoć međunarodnih organizacija, ambasada, kako bi se formirao jedan zajednički fond radi otvaranja novih radnih mesta, stručnim osobama koji će profesionalno pružati redovne usluge svim našim građanima. Nadam se da ćete vi kao novi ministar zdravlja izaći nama u susret pronaći najbolje moguće rešenje za više od 15. hiljade stanovnika Bošnjaka, ali ostalih zajednica koji žive tamo, i svi zajedno rešiti ovaj zdravstveni problem kako naš građani ne bi bili diskriminisani po pitanju pružanja zdravstvenih sluge, a pre svega mislim na stare ljude, na trudnice i decu kojima ta pomoć od životne važnosti jer oni moraju putovati 20. km dnevno čak i za jednu injekciju do regionalne bolnice u Prizrenu, i to više mi ne smemo da dozvolimo i svi smo odgovorni za takvo stanje.

Poštovani ministre, samo da kontrolišete fond za renoviranje i farbanje fasada i dvorišta dva do tri puta godišnje u opštini Prizren, odnosno pranja novca po svim ambulantama i bolnici u Prizrenu, rešićete ovaj naš problem zajednice kojeg mi imamo 18. godina posle rata, a takođe o današnje interpelance zahtevam da u preporuci obavezno uđe ovaj naš problem kao prioritetan koji zahteva hitno intervencije Ministarstva zdravlja, jer je u pitanju više od 15 hiljade ljudskih života ugroženo. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, a po vazhdojmë, zoti Imet Rrahmani e ka fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti kryetar, për respektin që më ofruat mundësinë që të zgjedh kur ta marr fjalën.

Faleminderit zoti ministër për praninë këtu, sepse po del që të gjithë ministrat e fundit të Shëndetësisë janë shumë përgjegjës ndaj obligimeve, që kanë ndaj Kuvendit!

Unë dua ta përmend këtu edhe zotin Agani, që ta lidh me fjalimin tim, i cili ka kontribuar shumë në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë, sidomos me miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë në mandatin e tij. Natyrisht se këto ligje ne jemi munduar t'i implementojmë në mandatin tonë, t'i shtyjmë përpara dhe të kontribuojmë në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë dhe jam shumë i lumtur që edhe sot në këtë debat po vërtetohet një çështje, që e kam thënë edhe më herët se shëndetësia ka shumë specifika dhe është shumë komplekse, si dhe kërkon përkushtimin e të gjithëve që ajo të vendoset në

binarë të mirë, në binarë të shëndetshëm dhe të arrihen rezultate që do ta rrisin kënaqshmërinë e qytetarëve të Kosovës për shërbime.

Unë në fjalimin tim do të përpiqem t'i jap disa shpjegime, të cilat nuk dua të kuptohen në asnjë formë si kritika, ose mbrojtje për atë që kam bërë unë në mandatin tim, sepse konsideroj se është bërë mjaft dhe jam në njëfarë mënyre edhe krenar për punën që kam bërë, sepse brenda mundësive sa kemi pasur si qeveri i kemi shtyrë shumë procese përpara.

Asnjë nga diskutuesit nuk e tha një çështje, që mendoj se duhet të thuhet, sepse është një punë që bëhet në institucionet tona shëndetësore, por në formë manuale dhe ajo është ekzistimi i sistemit të informimit shëndetësor klasik. Të gjithë ne që jemi profesionistë shëndetësorë këtu e dimë se kur na vijnë pacientët, ne e plotësojmë një fletë kompjuterike dhe ajo dërgohet, përpunohet, ose informatat përpunohen nga punëtorë të ndryshëm në njësitë përkatëse të institucioneve tona shëndetësore dhe grumbullohen në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ku është departamenti i veçantë i Sistemit të Informimit Shëndetësor.

Çka ne po pretendojmë me strategjinë, e cila është aprovuar para shumë vitesh? Ta kemi një sistem të informimit shëndetësor elektronik të integruar, i cili do të mundësonte që të kemi shënime të sakta, në kohë më të shpejtë dhe reale për gjithë atë që ndodh në sistemin tonë shëndetësor. Sistemi i Informimit Shëndetësor është bashkinvestim edhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës, por edhe i Qeverisë së Luksemburgut, respektivisht Luksdev-it. Deri tash janë investuar mbi gjathtë milionë euro dhe mund të them që ato investime kanë shkuar edhe në ngritjen e kapaciteteve teknike në Ministrinë e Administratës Publike, respektivisht në data-bazën në qendrën atje, në data-qendrën, por edhe në rritjen e kapaciteteve, edhe teknike, edhe profesionale, brenda Ministrisë së Shëndetësisë.

Krejt ai aktivitet ka rezultuar me fillimin e pilotimit të sistemit, i cili u tha këtu që ka pasur pengesa më shumë në QKUK. E kam thënë publikisht para gazetarëve edhe ditën kur e kemi përruar pilotimin, po e them edhe sot, një përqindje e vogël, fatmirësisht shumë e vogël, e punëtorëve shëndetësorë nuk janë të interesuar që të funksionalizohet komplet Sistemi i Informimit Shëndetësor, sepse Sistemi i Informimit Shëndetësor nxjerr në pah të gjitha të mirat dhe të këqijat e çdonjërit, punën dhe mospunën, angazhimin dhe mosangazhimin, profesionalizmin dhe joprofesionalizmin e çdonjërit. Por, ky është një segment, ndërsa pengesa më e madhe e implementimit të këtij sistemi, implementimit fillestar të themi, sepse këtu po bëhet nganjëherë një keqkuptim, Sistemi i Informimit Shëndetësor duhet të implementohet ashtu qysh është menduar në fillim, por ai gjithmonë do të zhvillohet me module të reja.

Çdo procedurë e re, e cila do të bëhet në klinikat tona, në spitalet tona nga profesionistë shëndetësorë, e do edhe zhvillimin e modulit të vet dhe këto module do t'i inkorporohen Sistemit të Informimit Shëndetësor. Do të thotë, nuk është shumë e thjeshtë. Dhe, kjo fazë e pilotimit që

ka shkuar mirë në Komunën e Prishtinës dhe në Prizren ka mbuluar rreth 62-63 institucione shëndetësore. Ka shkuar mirë, është vlerësuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë, edhe nga donatori Luksdev, se mund të shkohet më tutje. Mund të shkohet më tutje. Kjo “mund të shkohet më tutje” na ka bërë neve në Ministrinë e Shëndetësisë në atë kohë, domethënë në vitin 2016, që bashkë me ekspertët e Luksdev-it dhe me ASHI-në, përfaqësuesit e ASHI-së, të bëjmë termet e referencës për shpalljen e tenderit për shtrirjen e rrjetit në zonën e mbetur, në 70%-shin e mbetur dhe 30% e zonës pilot.

Se sa është problematik implementimi i një projekti të tillë të madh, unë po jua them që gati një vit po bëhet dhe ende nuk ka një vendim për kompaninë fituese për SISH-in. Nuk është faji po besoj te Ministria e Shëndetësisë, sepse kemi thënë që ligji, ose trajtimi i problematikave të shëndetësi me Ligjin aktual të prokurimit publik nuk u shkon përshtati reformave dhe nuk u shkon për shtati zgjidhjes së të gjitha problemeve në Ministrinë e Shëndetësisë.

Por, unë dua që ta inkurajoj ministrin që brenda mundësive që ka të bëjë zgjidhje edhe për mirëmbajtjen e zonës pilot dhe të bëjë mundësisht të fascilitojë në zgjidhjen, ose përfundimin e tenderit dhe në shtrirjen e harduerit në zonën e mbetur. Krejt kjo do ta zgjidhte edhe problemin e krijimit të asaj kartelës së pacientit.

Unë desha të them edhe diçka që u tha këtu nga disa diskutues, po them një e pavërtetë, Këshilli Nacional për Sistemin e Informimit Shëndetësor është takuar në baza të rregullta dy herë brenda vitit. Pse nuk është takuar shtatë muajt e fundit, sigurisht se zoti Ismajli ka përgjigje.

Do të kaloja te çështja e sigurimeve shëndetësore. Unë kam këtu disa dilema. E di që është punuar shumë dhe e kemi lënë në faza të avancuara, edhe procesin e fillimit të mbledhjes së premiumeve, edhe krijimin e një infrastrukture për të filluar më mirë dhe në mënyrë efikase zhvillimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

E para, zoti ministër, ne bashkë me Komisionin Parlamentar të përbërjes së kaluar jemi pas dakorduar që me urgjencë të bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore. Pse ka ardhur deri te kjo? Ka ardhur pas zbërthimit në detaje të ligjit që e kemi bërë, me të gjithë aktorët që janë kontribuues në implementimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore. E kemi bërë koncept-dokumentin, e kemi kaluar në Qeveri, e kemi bërë grupin punues dhe grupi punues i ka bërë ndryshimet e nevojshme, ka kaluar ligji në Qeveri, por ju, me marrjen e mandatit, Qeveria aktuale, ndoshta jo ju personalisht, e keni hequr prej planit legjislativ. Dhe, tash, me sa e di, është paraparë diku në pjesën e dytë të vitit që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit. Ky plotësim dhe ndryshim i ligjit ka qenë nevojë, sepse ekspertët e ndryshëm të institucioneve të ndryshme kanë vlerësuar se disa nene të tij janë pengesë kur të fillojë implementimi.

Unë po habitem se si nuk e keni proceduar menjëherë në plotësim-ndryshim.

E dyta, është brengosëse pse u suspenduan proceset e rekrutimit të stafit. Ne për vitin 2017 kemi pas planifikuar edhe 26 pozita të reja dhe në fund të 2017-tës ka pasur të arrijë numri në 50. Në ligjin aktual të Buxhetit për vitin 2018 ju nuk parapatë +25 vende tjera, që do të thotë në fund të vitit 2018 do të bëheshin 75, ose 75 persona të punësuar në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

E treta, është që këshilli përgatitor për funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore me kalimin e statutit në Qeveri, që ka ndodhur në Qeverinë e kaluar, është dashur me një vendim Qeverie të avancohet në Bord të Fondit. Kjo nuk ka ndodhur.

Gjithashtu, një komponentë shumë e rëndësishme që ne e kemi filluar ta pilotojmë faktikisht, që shkon në përkrahje edhe të projektit të Bankës Botërore, është pagesa për performansë, duke u bazuar në kapitacion. Është duke u pilotuar në gjashtë komuna dhe nga manuali që është punuar nga ekspertët e Bankës Botërore ne e kemi përzgjedhur vetëm një indikator si të mundshëm, e që i jep përgjigje edhe asaj brengës se kur do të fillojë evidentimi i çdo qytetari për mjekun e vet. Ne e kemi bërë vetëm një indikator dhe ai është regjistrimi i qytetarëve për QMF. Për çdo qytetar të dokumentuar që është evidentuar, komunat pilotë marrin nga 2,4 euro. Këtë vit, më 2018, ka qenë e planifikuar që këtij numri prej 6 komunave t'i shtohen edhe 14 të tjera dhe kjo është njëra nga hallkat, pothuajse të vetme, që lidh Mjekësinë Familjare me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Pse nuk u bë kjo?

Dua të theksoj edhe diçka. U përmendën protokollat. Në vitin 2015, ne e kemi formuar Komitetin Nacional për hartimin e protokolleve dhe udhërrëfyesve klinikë, i kemi bërë edhe komisionet përkatëse. Me sa di unë, disa protokolle janë hartuar, disa edhe në kohën tuaj. Dua të them se ata që nuk janë profesionistë shëndetësorë, t'u them se hartimi i një protokollit të këtillë të mirëfilltë merr kohë shumë dhe nuk mund të bëhet shumë shpejt.

Edhe një gjë, zoti ministër, nëse keni ndryshuar na e thoni, por ne në kohën tonë, me rekomandimin e ekspertëve, pagesat që do t'i kishim bërë me kontratë institucioneve shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore do të ishte bërë me sistemin e DRG-ve, që është sistem më i thjeshtë, përdoret nga shumë vende dhe ne jemi pas përcaktuar për sistemin australian të DRG-ve. Nëse keni ndryshuar diçka, unë ju them se keni bërë gabim, sepse kjo forma me ISD është shumë më e komplikuar dhe do të ketë probleme më të mëdha gjatë pagesës së shërbimeve që jua bëjnë institucionet shëndetësore.

Është edhe një diçka që duhet ta kuptojmë. Sigurimet shëndetësore nuk janë vetëm në shërbim të qytetarëve që kanë nevojë. Natyrisht se qendra duhet të jetë qytetari dhe pacienti, por nëpërmjet sigurimeve shëndetësore pretendohet që të krijohet një sistem tjetër më i sigurt i financimit, i cili do ta rriste buxhetin e shëndetësisë. Vlerësohet se në vitin e parë të premieeve diku 50 milionë,

e në vitet tjera, kur të stabilizohen të gjitha rrethanat dhe të evidentohen të gjithë, atëherë do të mblidheshin diku 100-120 milionë. Dhe, kushdo të lirohet, zoti ministër, është paraparë të bëhet testi i varfërisë, e nëpërmjet këtij testi, që ne e kemi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e kemi pas bërë marrëveshjen, është dashur të shkohet tutje. Nuk e di ku keni mbërri, është mirë të na thoni se çfarë ka ndodhur me testin e varfërisë. Sikur që ju kisha lutur të na thoni se ku do t'i merrni fondet që do ta mbuloni koston e rimbursimit të barnave, që po donit ta filloni para se të fillojë mbledhja e premieeve.

Edhe e fundit, një minutë për të ua lënë kohë kolegëve tanë, kisha thënë kështu: Thatë se nuk janë bërë investime në QKUK dhe në spitalet tjera gjatë mandatit. E thatë më vonë që është bërë. Unë po i referohem asaj të parës dhe po i përmend disa çështje. E para, është duke u ndërtuar Qendra Emergjente, Spitali i Ferizajt, për të cilin tash është nënshkruar kontrata, edhe tenderi, edhe projekti, dhe kjo është bërë prej nesh. Është blerë aparaturë për fëmijë dhe të porsalindur në vlerë 1,7 milion euro dhe janë pajisur të gjitha klinikat, Klinika e Pediatriisë dhe e Neonatologjisë në Prishtinë, dhe repartet pediatrike në spitalet e përgjithshme.

Janë ndërtuar dy objekte të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik po ndërtohen, një në Ferizaj dhe një në Gjilan. Është përgatitur terreni për Spitalin Pediatrik. Është bërë përkrahja materiale për Kardiologji dhe Kardiokirurgji e punëtorëve shëndetësorë për të krijuar shërbime të qëndrueshme. Ne e kemi hapur Kardiokirurgjinë, s'ka pasur të tillë.

Unë jua kisha bërë një pyetje: Sa po kushton tenderi për t'i përgatitur hapësirat për koronarografin e ri, sepse këtu u tha nga një deputet që nuk është votuar Ligji për kredi të butë me Austrinë, i cili brenda atij ligji me 390 000 euro ne kemi pas për t'i rregulluar të gjitha. Kam edhe shumë pyetje të tjera, por po ua lë kolegëve kohën, nëse u ka mbetur fare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Xhelal Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!

Unë vetëm desha ta pyes zotin ministër për disa gjëra.

Ju po deklaroni se jeni duke punuar në përmirësimin e sistemit. Gjatë punës suaj, ju besoj se keni hasur në dështime dhe në keqpërdorime të ndryshme. Pyetja ime është: A keni dërguar ndonjë lëndë për dështimet, më mirë thënë keqpërdorimet, që keni vërejtur ju të mëparshme, por edhe të tanishme, në Prokurori?

Dy, ju thatë se ka harduer të vjetër tri vjet, i cili s'është përdorur. Në qoftë se një kompjuter sot kushton njëmijë euro, a thua sa do të kushtonte i njëjti i ri pas tre vjetësh? E gjitha kjo është humbje monetare. A duhet të japë dikush llogari për këtë?

Dhe, po ashtu, mua po më befason se me sa lehtësi po e shtyni implementimin e Sistemit Informativ Shëndetësor, duke qenë se ai është së pari planifikim, e së fundmi edhe raportim, që i bie se është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm për Sistemin Shëndetësor, apo me thënë më ndryshe, është edhe themeli, edhe kulmi i gjithë atij sistemi.

Ju përmendët vetëm çmimet e barnave, se po punoni në rregullimin e kësaj çështjeje. Por, po ashtu, nëpër raportime të ndryshme flitet për shpërputhje edhe në sasi në mes prokurimit, sasive nëpër depo dhe nëpër reparte të ndryshme, ku ato barna apo medikamente duhet të përdoren. Çka do të bëni ju për këtë?

Dhe, për fund, edhe vetë Raporti i Progresit i sotëm e ka vërejtur mungesën e të dhënave të bazuara për Sistemin Shëndetësor, ku përmendet edhe vetë Sistemi Informativ Shëndetësor si një nevojë jashtëzakonisht e madhe për t'u implementuar sa më shpejt. A pajtoheni ju me këtë dhe çfarë do të bëni?

KRYETARI: E shoh nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Ministri që dëshiron kur dëshiron, por Haxhi Avdyli, i pashë edhe kolegët, grupi parlamentar ka të drejtë në minutat e veta, deputeti edhe dy herë mund të flasë nëse ata pajtohen ndërmjet vete. Haxhi Avdyli e ka fjalën, regjia!

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

I nderuar ministër,

Në raportimin tuaj në Komisionin për Shëndetësi në vitin e kaluar, në fundvit, keni thënë se në shkurt të vitit 2018 do t'i dërgoni emrat për anëtarë të Bordit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Tani jemi në prill, pse nuk i keni dërguar? Çka është duke ndodhur, që ende nuk po konstituohet Bordi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore? Nënpyetja tjetër është se çfarë plani dinamik keni për konstituimin e Bordit edhe me kuadro tjera, të cilat janë të nevojshme për konstituimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. E thatë më herët që do të keni rimbursim të barnave nga ky fundvit. Sipas një statistike, diku 100 mijë receta në ditë shkruhen në Kosovë. Si do të arrini t'i menaxhoni këto? Cili është ai plani dinamik se çka do të rimbursoni dhe a do të mundni, prapë po kthehem te ajo çështja e parë, që pa Sistemin e Informimit Shëndetësor dhe Sistemin e Informimit Shëndetësor në farmaceutikë të arrini t'i rimbursoni këto barna, por edhe mijëra shërbime, të cilat do të bëhen në muajt dhe javët gjatë trajtimit. Si do të arrihet që nëpërmjet letrave në këtë kohë, ende të vazhdojmë që t'i rimbursojmë këto?

Meqenëse unë e kam mbajtur fjalimin, këto ishin vetëm si nënpyetje. Edhe një pyetje të fundit: Po dua ta di, më herët në QKUK ka pasur greva, ka pasur kërkesa, ka pasur pakënaqësi nga kuadrot shëndetësore, cili është plani juaj për pagesat për kuadrot e specializuara, siç janë specialistët? Si do të arrini dhe cila do të jetë baza e pagesës së tyre sipas performansës, apo do të

jetë rritje lineare dhe përafërsisht kur planifikoni që këto kuadro më se të nevojshme për mbajtjen e këtij sistemi shëndetësor ta marrin pagën e merituar? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I keni krejt minutat. Më falni, në bazë të minutave, Salih Zyba nga Lëvizja Vetëvendosje. Më fal, nga AAK-ja, Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit!

Për mua mjaftojnë vetëm 55 sekonda.

Dardan Sejdiu e përmendi, por shkoi e më shtyni të flas, edhe ne po flasim për çështjen e ministrit, për kompetencat e ministrit.

Dardan Sejdiu ka qenë në pushtetin lokal dhe ka pasur shumë kompetenca, sidomos për mjekun familjar, Mjekësinë Familjare, ku krijohet baza e historisë së një pacienti. Baza e shëndetësisë është te mjeku familjar. Këtu e kam edhe një komshi afër, edhe Rasim Selmani ka qenë kryetar dhe nuk e di çfarë ka bërë në këtë aspekt, por edhe unë kam qenë kryetar dhe kemi bërë shumë pak.

Baza e shëndetësisë është në pushtetin lokal. Të gjithë sot e kemi pasur orientimin te pushteti qendror, por baza e shëndetësisë, sigurimi shëndetësor, historiku i një pacienti, kostoja e një pacienti, preventiva, janë në pushtetin lokal. Por, po më vjen keq që Dardani shkoi, se do ta bënim një debat edhe më të mirë.

Kurse, për ministrin, megjithatë, jo për ta mbrojtur, ministër i ke thënë dy data, dy prerje - "Sigurimi shëndetësor fillon në fund të vitit dhe pas 18 muajve do ta keni një përmirësim të dukshëm". Së paku kjo interpelancë për mua do të jetë e rëndësishme, do të t'i mbaj në mend këto dy prerje. Të tjerat, është një fjalë "Ruaj, se prej fjalëve të mira deri te puna e mirë është një bjeshkë e tërë". Mos e harro këtë! Faleminderit!

KRYETARI: Salih Zyba e ka fjalën. Besa, bisedo, Emilija e ka edhe një minutë, pasi e ka të vetëm grupin, nëse ua jep... Replikë, pasi po e merr fjalën, veç me Emilijen kryeje. Emilija pa grup edhe tre minuta në fakt i paska, s'di çka u bë, në qoftë se dëshiron. Salih Zyba fjala për ju, pastaj Besa Baftiu, pasi të merret vesh me të pavarurit...

SALIH ZYBA: Të dashur qytetarë,

Të nderuar të pranishëm,

Zoti ministër, të përgëzoj të paktën për entuziazmin e treguar këtu, për optimizmin që ke për disa prej planeve.

Ju e paraqitët një afat për planin prej 18 muajsh. Kanë kaluar 18 vjet dhe qeverisjet e kaluara nuk kanë mundur ta realizojnë një plan, për të cilin ju jepni afat 18 muajsh. Ju përgëzoj për këtë afat,

por kjo më bën të mendoj se mos ka zgjidhje para këtij afati, sepse është një premtim i porealizueshëm, u ngjan fushatave paraelektorale.

Zoti ministër,

Në fjalën e parë hyrëse ju i përmendët 4 nga 5 pikat e Rezolutës, e cila më 14 shkurt 2017 në këtë Kuvend është marrë si vendim. Më 14 shkurt 2017 nuk ke qenë ti ministër, por as unë në këtë pozitë si deputet, mirëpo e përmendët, e prej të pestave, po filloj me të parën. Thatë: Auditimi është bërë. Është bërë auditimi, por unë kam një shqetësim se për këtë auditim do të bëhet një auditim për këtë auditim. Domethënë, nuk ka paraqitje si duhet, duke filluar prej tekstit, ose prej mungesës së tri faqeve, faqe 6, 7, 8, deri te mënyra që do ta paraqes.

Ju thatë SISH-i, e latë të kuptohet që s'është realizuar. Të paktën prej se keni ardhur ju si ministër, asnjë hap nuk është bërë si SISH. Nuk ka vazhduar as mirëmbajtja. Të paktën, merreni sugjerimin e pararendësit tuaj, kur tha që të vazhdoni në mirëmbajtje të sistemit, sepse aty janë numëruar shumë humbje, së paku janë 4 mijë punëtorë të shëndetësisë që kanë punuar në këtë sistem, janë 7 muaj mungesë të implementimit, ose të vazhdimit të punës dhe është një buxhet, i cili po u mungon komunave, përkatësisht shëndetësisë, përmes një projekti që ka qenë nëpërmejt Bankës Botërore, e cila e ka mbështetur secilin evidentim në SISH.

Ju thatë se raportimi po ndodh. Raportimi me këtë rezolutë ka qenë tremujor. Nëse i thuhet interpelancës raportim, atëherë kërkojmë nga Sekretaria e Kuvendit që çdo tre muaj të parashohë nga një interpelancë për ju.

Rritja e buxhetit për 21%, e përmendët në fillim. Po, ka ndodhur me një vendim të Qeverisë, por kjo rritje në mungesë të përdorimit të Sistemit Informativ Shëndetësor lë hapësirë apo ka dyshime, që mundëson për keqpërdoruesit, në këtë rast nëpërmjet këtyre fondeve për rritje në këtë mënyrë të buxhetit.

Implementimi i SISH-it, si projekt i fundit që ka qenë edhe me mbështetje të huajve, të donatorëve, e ka pasur projektin 2010-2020. Nuk e kuptoj arsyen pse mu në këtë fazë, me ardhjen tuaj si ministër, e keni neglizhuar ose nuk e keni vazhduar mundësinë e mirëmbajtjes apo avancimit të sistemit, duke pasur për bazë se projekti ka qenë deri në vitin 2020.

Për sigurimet shëndetësore folët po ashtu me optimizëm për diçka, por për bazën e të dhënave, apo po e marr një shembull, për kartelën e pacientëve kam pasur një përvojë në Prizren në spitalin regjional qysh në vitin 2007 ka pasur kartelë të pacientit, kartelë shëndetësore. Ndërsa sot janë degraduar këto forma, në vend se të avancohen format, qoftë te sistemi, qoftë te format e tjera.

Ju e përmendët që keni lansuar një sistem online për shërbime jashtë vendit. Ky sistem nuk u është dashur qytetarëve që ta shohin veten ku janë në pritje, po u duhet një sistem informativ, sistem i informimit shëndetësor, i cili realizon projektin komplet të integruar të të gjitha fushave, edhe për barna, edhe për forma të tjera.

Ndërsa thatë se, nëse një qytetar e gjen veten që i ka kaluar renditja, the të lajmërohet se do të ketë procedim.

Kjo Qeveri aktualisht, përmes vendimeve të veta, ka bërë përjashtim të qytetarëve që presin.

E kemi rastin konkret, përkundër se është bashkëvendës, ish-kryeministri me vendim arbitrar, me vendim të Qeverisë anashkalohet përkundër krejt pritjeve të qytetarëve në listën për shërbime.

Ndërsa këtu e keni lansuar ditë më parë edhe menaxhimin e kontratave të barnave. Asgjë nuk është në funksion kjo, përpos një evidencë, një njoftim me datat për të cilat nuk është e avancuar.

Të gjitha këto që i keni përmendur ose që i keni lansuar ditëve të fundit në emër të avancimeve, do të duhej të ishin pjesë e sistemit informativ shëndetësor. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju. I kemi edhe tre deputetë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Njëri nga deputetët e ngriti çështjen e rasteve në prokurori, unë po ju them atë që e besoj dhe që e bëj çdo ditë.

Ne kemi pasur disa raste të skandaleve, të cilat kanë qenë më 2016-2017, për të cilat janë suspenduar njerëzit dhe janë paraqitur rastet në prokurori.

Ka pasur raste të kontratave të tjera, të cilat kanë pasur dyshime për abuzime, janë paraqitur rastet në prokurori.

Dallimi i vetëm ka qenë që unë nuk i kam bërë me pompozitet sa herë që i kam dërguar në prokurori, kjo ka qenë e vetmja, sepse nuk konsideroj që unë jam ministër që kam nevojë të tregoj se po dërgoj lëndë në prokurori, ky ka qenë dallimi im.

Unë konsideroj që organet e drejtësisë duhet ta bëjnë punën e vet, gjersa unë shkoj në atë vend për ta avancuar një sistem, natyrisht si gardian ta ruaj nga çfarëdo lloj keqpërdorimi.

Pra, jo sot, por çdo ditë, për aq kohë gjatë këtij mandati katërvjeçar që shoh diçka që është rast ose objekt për prokurori, nuk hezitoj, as nuk më trembet syri ta dërgoj atje.

Këtu duhet të ndihen keq ata që kanë konsideruar të abuzojnë me paranë publike ose të mashtrohet institucioni publik. Tani unë thashë i kam dorëzuar, nuk është imja të tregoj me numër, se nuk jam prokuror, thashë i kam dorëzuar, bile edhe publikisht ka qenë ajo punë, po nuk kam numër 77, nuk kam numër 77 të them i kam dërguar, e mandej të bëhet temë se çka u bë me to? Unë po them që ato të cilat janë dërguar, janë dërguar, edhe nëse bëhen nesër 15 a 17 a 220, nuk është me rëndësi, kushdo që bën abuzime do ta paraqes, veç ta dini që me pompozitet nuk e bëj. Nuk mund të them se i kam dërguar kaq vetë në prokurori unë dhe lëvdomëni për atë punë.

Po ju them edhe diçka, ndoshta 18 muaj është optimiste, po 18 vjet nuk janë bërë udhëzime administrative për çmime të barnave. Unë e kam bërë për gjashtë muaj, 18 vjet nuk është bërë, për gjashtë muaj u bë.

Pra, nuk u bë për 18 vjet sistemi 24 orë për stentim, u bë për më pak se tre muaj.

Pra, ka optimizëm, është e vërtetë që ka optimizëm, unë besoj që do të mobilizoj boll njerëz, një ndër ata njerëz jeni edhe ju, që e doni këtë ndryshim dhe që do të jeni në mision për përmirësimin e shëndetësisë.

Abuzim thatë sa i përket neglizhimit të SISH-it dhe mirëmbajtjes. Dëgjoni, është mirë të dihen të gjitha informatat, unë nuk fola shumë, edhe pse u përmend, 69 mijë euro ka qenë mirëmbajtja mujore për 30% të sistemit. Deputet, po e përsëris edhe një herë: për 30% ka qenë 69 mijë euro mirëmbajtja, që i bie për 30% të sistemit unë është dashur të paguaj një shumë marramendëse, për të cilin nuk kam qenë i gatshëm, sepse vetë më ka dhënë të drejtë edhe raporti i auditimit, që për atë sistem projekti nuk është bërë në rregull dhe unë nuk mund ta mirëmbaj një projekt që nuk është në rregull. Nuk i harxhoj gjysmë milionë euro për të thënë po e vazhdoj një punë që e ka nisur dikush para meje. Me këtë logjikë, secila punë e keqe që është, duhet të vazhdojë prapë. Unë thashë, punët e mira nuk i lë në gjysmë, i vazhdoj, nuk e atribuoj suksesin tim, e atribuoj suksesin e të gjithë paraardhësve të mi.

Sa i përket asaj se nuk u është dashur qytetarëve sistemi online, ndoshta nuk t'u ka dashur ty sistemi online, sistemi online u duhet njerëzve.

Ministria e Shëndetësisë ka pasur njerëz, 20-30 vetë që kanë dalë jashtë çdo ditë dhe kanë pritur për një lajm të vogël: a e kam emrin, a u janë pranuar dokumentacionet dhe çdo ditë kanë ndërruar ata. Unë po them 20-30, e të mos them sa telefonata është bërë.

Prandaj, u bë si nevojë, si kërkesë e qytetarëve. A është dashur të bëhej një SISH, është dashur. SISH-i ka qenë deri më 2020, po ne jemi më 2018 dhe sot e kemi në raport të auditimit që thotë 30% nuk është kryer.

Prandaj, unë nuk mund ta lë qytetarin të endët rrugëve e korridoreve të ministrisë me një shpresë që do të bëhet një SISH, i cili e shoh këtë që mund ta bëj për tri javë ditë. Në qoftë se mund ta zgjidh për tri javë, e zgjidhi për tri javë ditë, në qoftë se nuk mundem, jap një afat më të gjatë.

Edhe e fundit është për menaxhimin e barnave. Dëgjoni, unë jam duke e rregulluar gjithë ciklin e barnave, sepse siç thashë edhe më herët, 80% e shpenzimeve të xhepit të qytetarëve janë nga barnat.

Kjo nënkupton rregullimin e çmimeve, revidimin e listës esenciale, si hallkë të fundit edhe furnizimin edhe distribuimin. Pra, në secilën repart do të investoj në krijimin e një barnatoreje, e cila do të jetë me kontroll të qasjes, pra nuk do të ketë qasje gjithkush, e cila do të ketë kamerë dhe cila do të ketë një kompjuter që sa herë dikush të marrë barna nga aty, të regjistrohet.

Pra, tani jemi në fazën e planifikimit për shtrirjen e kontrollit në të gjitha repartet. Mirëpo, çfarëdo që të kisha bërë në distribuim dhe furnizim pa i rregullua çmimet, është si të gjuash kripë në deti, sepse atje ishte krijuar një shpenzim marramendës, e unë këndej isha munduar t'i furnizoj spitalet ose institucionet shëndetësore.

Për bord është dorëzuar, në këtë mbledhje të Qeverisë kalon, edhe për rritjen e rrogave pyete, po ashtu.

Unë e përmenda, për këtë e ndajmë, po besoj, që rritja e rrogave duhet të ndodhë, kjo na u kërkua ta bëjmë nëpërmjet ligjit për kategorizimin, e cila është pjesë e reformës së administratës publike. Ne i kemi dhënë propozimet tona, jemi duke punuar me grup punues.

Sa u përket specializantëve, po ashtu jam duke ndryshuar një Udhëzim administrativ, të cilin e nënshkruaj këtë javë, i cili më krijon mundësi për t'i paguar specializantët tanë, të cilët janë duke punuar dhe nuk kanë mundur të paguhen.

Ka qenë një tentativë edhe të ministrit të kaluar për t' paguar, është një tentativë imja edhe tani të paguhen, jemi duke u munduar ta bëjmë kornizën legjislativë që na lejon t'i paguajmë të gjithë ata që janë në trajnim në QKUK dhe realisht punojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj, nga LDK-ja. Armend, nuk e di edhe sa minuta i ke.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Do të mundohem të jemi i shkurtër, sepse edhe në aspektin profesional e thanë kolegët e mi deputetë që vijnë nga fusha përkatëse. Faktikisht unë kam pasur taksiratin që të jem goxha gjatë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të dëgjoj ministrat një pas një. Pothuajse nga

interpelanca e kaluar e vitit 2017, 90% edhe ato që i diskutuat sot, zoti ministër, bile-bile, edhe Sadik Idrizi si kryetar i komisionit, isha anëtar i saj, edhe ai duke i përcjellë temat e njëjta.

Unë problemin e shoh në dy aspekte, të cilat pa u eliminuar këto, edhe sigurimet shëndetësore do të jenë të dështuara. Pse po e them këtë?

E para, shëndetësia mendoj që po vuan nga klanet kriminale që qëndrojnë prapa kompanive farmaceutike, edhe që janë të ndërlidhura me politikën. Kjo ka qenë temë, është e njohur dhe këto ndikime nuk e kanë lënë dhe nuk po e lënë që të zhvillohen sigurimet shëndetësore.

E dyta, është që bizneset e mëdha, në prapavijë, ta quaj kështu, janë bërë pengesë edhe do t'i kesh pengesë që duhet të paguajnë në dhënien e premimeve shëndetësore. Tash këto janë dy fakte që pa u eliminuar këto dy barriera, unë nuk besoj dhe as nuk do të insistoj, po edhe ju në ato premtimet ligjore, të cilat akoma s'po arrini ta ndryshoni ligjin, defektet apo relacionin që është me Administratën Tatimore, në regjistrin civil, e cila ka mbetur pezull, po them prapë nga viti i kaluar i interpelancës dhe premtimet, sepse ligji pati kaluar në atë kohë në Qeveri dhe asnjëherë nuk u soll në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo është gjendja, gjendje të cilën duhet ta eliminoni.

Ajo çka mua po më pengon është që po duket krejt shëndetësia ndërlidhet me QKUK-në. Nuk është krejt shëndetësia vetëm aty, është pak më e gjerë, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, edhe primarja, edhe sekondarja, edhe shëndeti publik. Kështu që mos u kufizoni vetëm në QKUK, po duket se jeni duke bërë qëndrim ditor atje, në Qendrën Klinike Universitare, ndërsa në Republikën e Kosovës njerëzit ballafaqohen me probleme të mëdha, e kishin edhe problemin duke u munduar jo që po e quani, po besoj rregullimi e çmimeve, ndërsa problemi që ndodhi me njerëzit me dializë ishte fatkeqësisht edhe kërcënime, që njerëzit mund të pësonin me jetë derisa të rregullohet çështja e tyre.

Kështu që luftoni për të parën, rregulloni këtë strategji, qoftë me Prokurorinë e Shtetit, në relacionin institucional, kërkoni edhe ndihmën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe tek atëherë besoj që ju mund të arrini që të filloni. Unë nuk po kërkoi datë, sepse do të ishte e paimagjinueshme as tash që të kërkohet datë kur ju do të filloni, as nuk do të insistoj, po me eliminimin e këtyre besoj që edhe data do të jetë më e përafuar, edhe qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë mundësi të kenë qasje në këto shërbime shëndetësore. Faleminderit!

KRYETARI: Besa Baftiu, po më intereson a jua dha Emilija minutat. Një minutë jua dha, po urdhëroni, Besa Baftiu, një minutë.

BESA BAFTIU: Falënderoj Emilijen, meqenëse ne si grup i kemi shfrytëzuar minutat.

Unë diskutimin tim e kam bërë, mirëpo u ndërlidha me diskutimin që e bëri zoti Kuçi, i cili kritikoi qeverisjen në Komunën e Prishtinës sa i përket sektorit të shëndetësisë.

Për sa i përket asaj që ka kompetenca, Komuna e Prishtinës e ka dhënë shembullin se si qeveriset apo si menaxhohet shëndetësia.

E ka ngritur cilësinë e shëndetësisë dhe shërbimeve shëndetësore në komunën e Prishtinës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih Zyba e ka fjalën.

SALIH ZYBA: Zoti ministër,

Unë nuk iu referova në asnjë moment si duhet raportit të auditorit, mirëpo tash po më detyron ta lexoj. Në faqen 31, në paragrafin 3, thuhet: “Kontrata për mirëmbajtje dhe implementimin e SISH-it skadon në muajin shtator 2017” dhe Ministria e Shëndetësisë nuk ka planifikuar e as vendosur të vazhdohet apo jo.

Ndërsa në faqen 4, rekomandimet kryesore, po ta them veç rreshtin e parë, thotë: “Qeveria e Kosovës të prioretizojë implementimin e sistemit informativ shëndetësor”. Atëherë, më thuaj, të pakën, mos është në ato tri faqe që po i mungojnë raportit në faqet 6, 7 apo 8 ajo kërkesë apo rekomandim për ndërprerje të funksionimit të sistemit informativ shëndetësor. Faleminderit!

KRYETARI: Elmi Reçica, pastaj ministri në fund.

ELMI REÇICA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Zoti ministër Ismajli,

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të këtij vendi,

Veçanërisht ju punëtorët e shëndetësisë, mjekë, infermierë dhe të gjithë të tjerët.

Mendoj që kjo interpelancë me ministrin Ismajlin është një nga debatet që vërtet e ka tërhequr vëmendjen, ka qenë një debat shumë i qetë dhe relativisht i argumentuar. Dhe, mendoj që kjo i duhet këtij Parlamenti dhe gjatë këtij debati dhe gjatë argumentimit të çështjeve, është parë që zoti Ismajli është i përgatitur dhe është i vendosur që ta ndryshojë gjendjen. Vlerësimet e para shihen dhe mund të bëhen shumë lehtë që ka lëvizje dhe ka ndryshime. Ne inkurajojmë që ai të vazhdojë dhe sigurisht që është parë që do ta ketë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, e të gjithë deputetëve.

Unë mendoj që zoti Ismajli nga shumë çështje, të cilat i ka përmendur edhe më herët, por nuk e dëgjova që i ka përmendur sot, për Spitalin e qytetit të Prishtinës. Besoj që e ka me prioritet dhe

është shumë me rëndësi, një nga çështjet që do të ndikonte shumë pozitivisht në shumë probleme që ndodhin brenda QKUK-së dhe shumë çështje, të cilat mund të trajtohen në Spitalin e Prishtinës do të duhej të jetë një nga prioritetet dhe mendoj që është shumë e domosdoshme. Mirëpo, në kuadër të spitaleve të reja duhet ta theksojmë një çështje, e cila edhe u shtrua këtu edhe u diskutua jo në formën e duhur, dhe jo me sinqeritet. Ferizaj është qyteti i tretë për nga banorët, ndërsa është i dyti për nga kontributi në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Është një regjion që ka diku 250 mijë banorë dhe e ka një spital që është i vendosur në maternitet.

Kryetari i Kuvendit dhe disa prej atyre që kemi qenë bashkë në luftë e dinë që është zhvendosur Spitali Ushtarak i Zonës Operative të Nerodimës, se Ferizaj s'ka pasur më herët spital dhe është bërë spitali që është spital funksional, mirëpo nuk ka hapësirë të mjaftueshme. Dhe, në vitin 2013, në rishikimin buxhetor, ne kemi propozuar dhe është vendosur që të ndërtohet ai spital. Ka qenë të planifikuara 20 milionë euro, mirëpo pas ndryshimit të pushtetit në vitin 2013, më 1 dhjetor ka filluar të ndryshojë çdo gjë. Është ndryshuar një herë vendi, pastaj projekti, pastaj është bërë projekti i parë, i dytë, i tretë dhe shumë projekte tjera. Ndoshta është fati i zotit ministër aktual që ta fillojë këtë spital dhe po shihet që e ka pritur ardhjen e tij si ministër dhe besoj që shumë shpejt do të fillojmë, meqë e kemi votuar në buxhet dhe është planifikuar saktësisht shuma për këtë vit dhe vitet vijuese. Por, dua të them diçka, spitali për katër vite është sabotuar dhe është bojkotuar. Përndryshe, po të mos kishte ndodhur kjo, ai spital tash do të ishte shumë funksional dhe për këtë arsye do të duhej që ata, të cilët e kanë bërë këtë punë, të jenë kritikë dhe vetëkritikë dhe ta thonë këtë publikisht.

Ne jemi përpjekur vazhdimisht dhe kam bërë dy pyetje parlamentare, një për ministrin e Shëndetësisë, një për ministrin e FSK-së, a lejohen spitalet civile të ndërtohen në një bazë ose afër bazës ushtarake, ku ka dy poligone qitjeje, ku ka shumë çështje tjera që janë të pazgjidhura dhe pikërisht kjo ka qenë ajo që nuk e ka lejuar që të fillojë së ndërtuari Spitali Rajonal i Ferizajt. Përndryshe, është shumë i domosdoshëm dhe ka nevojë që sa më shpejt të fillojë dhe sa më shpejt të përfundojë.

E inkurajojmë ministrin e Shëndetësisë dhe Komisionin Parlamentar që është i ngarkuar për këtë çështje që këto gjëra, të cilat u diskutuan dhe besoj që do të kemi edhe konkluzione që do të jenë të detyrueshme për të gjithë, edhe për Qeverinë, por edhe për të gjithë ne që të punojmë të gjithë bashkërisht, ta ndryshojmë atë gjendjen, e cila tashmë është aktualisht. Dhe, gjendja ka filluar të ndryshohet, për këta muaj dhe për këtë kohë vërehet, hetohet se në çdo vend dhe në çdo klinikë shihet që ka lëvizje pozitive. Besoj fuqishëm që nëse zoti Ismajli e ka mbështetjen e sinqertë nga të gjithë ne, do ta bëjë atë, meqë është i dëshmuar si menaxher i mirë dhe besoj që do ta përmbyllë atë çfarë e ka thënë këtu dhe besoj që do ta përmbyllë atë çfarë e ka deklaruar edhe më herët në debate publike, në intervista dhe në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! S'ka më deputetë të paraqitur. Nga "6+", Albert i ke 30 sekonda, zonja Kollçaku përgatitesh, si thirrëse e seancës në emër të Lëvizjes Vetëvendosje. Urdhëro, 30-sekondëshin e zotit Kinolli, ju kisha lutur!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Unë desha vetëm në përfundim të kësaj interpelance, ta përsërisht vërtet gjithë diskutimin dhe debatin shumë konstruktiv me rekomandime, që besoj janë ndihmuese edhe për ministrin, dhe t'i them ministrit që në vazhden e këtyre ndryshimeve që tashmë i ka filluar dhe të shumë ndryshimeve të rëndësishme që i paralajmëroi, ta ndryshojë edhe mbiemrin e vet nga Ismaili në Ismajli, sepse e ka më lehtë që ta ndryshojë ky mbiemrin e vet, sepse t'ia mësojnë mbiemrin krejt deputetët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Armend, po e shoh 43 sekonda i ke, mjaft janë.

ARMEND ZEMAJ: Po i shfrytëzoj 43 sekonda, për një mesazh që ministrin të mos e pengojë mazhoranca.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Kollçaku, fjala është për ju si propozuese e interpelancës.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Sa më duket, kryetar, nuk ka kushte, sepse nuk ka kuorum për t'i votuar rekomandimet. Ne e kemi edhe një propozim që në seancën e parë të radhës t'i harmonizojmë këto rekomandime me grupet tjera parlamentare...

KRYETARI: Më fal se po të ndërhyj, ne do të kemi vazhdim të seancës, pastaj brenda asaj seance unë do t'i kërkoj për t'i votuar në momentin që do t'i kemi 61 deputetë. Ju lutem, vetëm për njoftim.

FATMIRE KOLLÇAKU: Mirë, unë po i lexoj, por qëllimi ishte edhe që të harmonizohen, meqenëse e kishim një vërejtje për një pikë, unë mendoj se është tema e rëndësisë nacionale dhe është shumë me rëndësi që të votohet nga të gjithë dhe meqenëse edhe debati ishte i tillë, u pa që nuk kishim kundërshtime të mëdha ndërmjet nesh, por kryesisht të gjithë ishin të interesuar që më në fund të fillojë jetësimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe rëndësia e Sistemit Informativ Shëndetësor si parakusht kryesor për implementimin e mirëfilltë të këtij ligji, se ne e dimë që ai mund të fillojë edhe me sistemin informativ të fondit, por assesit të jetë i plotë dhe ashtu siç duhet.

Do të thotë, mocioni ynë fillon me këto pika:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të fillojë me funksionalizimin dhe shtrirjen e plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe të bëjë publik kalendarin e aktiviteteve.
2. Qeveria e Kosovës të implementojë 22 masat e rekomanduara nga Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar në dhjetor 2017,
3. Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, Oda e Profesionistëve Shëndetësorë dhe SSHKUK të hartojë dhe të përgatisë parakushtet për Sistemin Informativ Shëndetësor, ku përfshihen: lista e shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor në Kosovë, në institucionet publike e ato private, kontrolli, licencimi i të gjithë profesionistëve shëndetësor që i plotësojnë kushtet në sektorin publik dhe privat, krijimi i regjistrit shtetëror të punonjësve shëndetësorë në të gjitha institucionet publike dhe private, ndërtimi i sistemit të referimit të pacientëve, hartimi dhe zyrtarizmi i udhërrëfyesve klinikë, si dhe regjistri shtetëror i barnave,
4. Rishikimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore, i parashikuar në Programin legjislativ për në qershor të vitit 2018, të paraprihet nga një komision ad hoc i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku do të hartohen propozimet nga të gjitha grupet parlamentare dhe në bashkëpunim të ngushtë me specialistë shëndetësorë financiarë dhe të informatikës,
5. Kuvendi i Kosovës t'i kërkojë Bankës Qendrore të Kosovës të paraqesë jo më vonë se 60 ditë pune raport të detajuar për financat dhe operacionet e kompanive të sigurimit të licencuara që ofrojnë dhe sigurimet private shëndetësore dhe
6. Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në raportin e performancës së Auditorit të Përgjithshëm, t'i adresojë në institucionet e drejtësisë rastet e shkeljeve dhe të dëmit financiar nga mosimplementimi me kohë i projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Uran Ismajli, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjet e ngritura për interpelancë, në qoftë se dëshironi. Po, urdhëroni, shfrytëzoni në bazë të Rregullores.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Atëherë, që s'flas, nuk flas.

KRYETARI: Kështu është radhitja, për ta ditur. I nderuar, të kam pasur edhe koleg të Kryesisë, veç në bazë të këtij procesi po shkojmë. Bile, i paska dhjetë minuta. Për atë arsye, ia shtova zonjës Kollçaku, ministri i paska edhe 15. Po, vetëm a më lini një minutë, zoti Konjufca, pasi e kanë shkruar këta, e sqarojmë proceduralisht. A merret koha të cilën e ka shfrytëzuar?

(Debat nga salla)

Ministri qenka, është dashur më herët. Unë ia kam dhënë fjalën propozuesit më herët, tash në qoftë se ministri do, shkurt, se edhe kështu opozita s'po mund shumë të të dëgjojë. Po i shoh kah fundi, por në qoftë se do tani propozuesja, në bazë të Rregullores ta lëmë prapë në fund. E lamë në fund.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Atëherë, kryetar!

KRYETARI: Zoti Kurti, qysh të dëshironi, veç le të shkojë debati mirë. Rregullat janë kështu, para zonjës është dashur ta marrë fjalën ministri. Por, po e merr prapë, për atë thashë. Urdhëroni zoti ministër, fjala për ju, pastaj për zonjën Kollçaku, në qoftë se dëshiron.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit shumë, për debatin. Shihemi në debatet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të gjithë kanë folur. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në bazë të nenit 44.4 të Rregullores së Kuvendit, e ka propozuar për miratim një mocion, të cilin do ta hedh në votim në momentin kur të jenë 61 deputetë brenda kësaj seance, ta kini parasysht.

Ndërkohë, grupet parlamentare, nuk e di nëse e kanë kryer harmonizimin, që të mos e hedh në votim... atëherë e bart para votimit. Unë do të kërkoj, nëse propozuesja dëshiron ta ketë një harmonizim, apo dëshiron ta hedh në votim në formën si e ka bërë? Urdhëroni, zonja Kollçaku!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Unë edhe në fjalën time e ceka që interesi ynë është që ta harmonizojmë dhe ta votojmë të gjithë, sepse është një temë e rëndësisë nacionale dhe ai është qëllimi ynë, të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo ishte edhe ideja, por ju kisha lutur që si propozuese të harmonizoheni me grupet parlamentare në mënyrë që nesër ne do të vazhdojmë në orën 10:00, se siç po e shoh jeni lodhur, ose nëse dëshironi vazhdojmë me debate. Vazhdojmë?

A ka mundësi grupet parlamentare, këta që janë, veç ta di. Vazhdojmë, vazhdojmë, unë jam i gatshëm të vazhdoj. Vetëm pak! Unë po e shoh një reagim, "të vazhdojmë... të mos vazhdojmë..."

Sipas Rregullores ne vazhdojmë, por edhe pak, në fund të fundit, edhe pse nuk ka kuorum, unë e pyes këtë pjesën e deputetëve që janë këtu. Me shumicë të këtyre që janë aktualisht, vazhdon a s'vazhdon! Jo, i kemi të gjitha kushtet për vazhdim, por a ka mundësi deklarimet e grupeve parlamentare, Armend, Memli, Glauk, vetëm t'ua dëgjoj qëndrimin. Në qoftë se ka diskrepancë, shkojmë në një votim formal. Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së propozojmë që seanca të ndërpritet dhe kur Qeveria të jetë e pranishme, në bazë të kërkesave të deputetëve dhe të interpelancave të kërkuara, ne mund të vazhdojmë. Nuk mund të vazhdojmë as nesër në orën 10:00, nëse ju si kryetar i Kuvendit, si Kryesi, nuk e garantoni praninë e Qeverisë, ashtu siç ishte debati paraprak.

Kështu që ne nuk mund të punojmë në këtë formë. Ishte ministri, përfundoi interpelanca, u nxorën rekomandimet, ka harmonizim të qëndrimeve. Nuk ka kuorum për t'i votuar dhe në këtë formë ne nuk mund të punojmë, qoftë edhe në pjesën e debatit, e cila mund të zhvillohet edhe pa praninë e një pike, e cila është e veçantë, pa praninë e Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi, fjala për ju! Glauk, bëhu gati!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është që të vazhdojë kjo seancë sipas rendit të ditës. Për katër debatet parlamentare me radhë nuk është e domosdoshme prania e Qeverisë. Ministri i Shëndetësisë e kreu interpelancën e vet, për interpelancat e kryeministrit jemi dakorduar që të shtyhen për një ditë tjetër. Janë tashmë edhe disa pika tjera që kanë mbetur pa u votuar, që votohen kurdo që të ketë kuorum, prej asaj për Projektligjin e ratifikimit të Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferim të personave të dënuar, Bordin e Agjencisë së Privatizimit, e kështu me radhë... Por, meqenëse ekzistojnë kushtet që të vazhdojë debati parlamentar, ne besojmë se është e domosdoshme, besoj edhe e nevojshme, që të vazhdojmë me debat. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Konjufca, fjala për ju!

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që në këtë Kuvend më së paku jemi që të flasim vetë me vete dhe me njëri-tjetrin. Këtu duhet të ketë mbi të gjitha prani të Qeverisë dhe i vetmi që ishte sot i pranishëm këtu ishte ministri i Shëndetësisë. Shumicën e ministrave të Qeverisë as që i kemi parë sot të pranishëm prej mëngjesit. Kështu që ma merr mendja që duke u nisur prej kësaj, seanca duhet të vazhdojë në një ditë tjetër, kurdo që do të vendosë Kryesia e Kuvendit, qoftë edhe nesër prej mëngjesit.

Mirëpo, as debatet parlamentare nuk duhet të mbahen pa praninë e Qeverisë. Ne nuk jemi këtu që mbi të gjitha të debatojnë grupet parlamentare me njëri tjetrin. Ju e keni lexuar edhe Raportin e Progresit, që sapo doli. Raporti i Progresit thotë që nuk ka llogaridhënie dhe dhënie të përgjegjësisë në Kuvend të Kosovës nga Qeveria. Në pyetjet parlamentare të qeveritarëve, niveli i përgjigjeve është shumë i ulët, prej ministrave dhe prej kryeministrit. Kështu matet demokracia, me raportin ndërmjet Qeverisë dhe Parlamentit.

Nuk matet demokracia a qëndrojmë ne në Kuvend deri në 24 të natës. Nuk është kjo demokracia se deri në orën sa shtyhem duke ndenjur në Kuvendin e Kosovës. Nuk është esenca e parlamentarizmit dhe e demokracisë kjo, por është se sa i kemi marrë dhe i kemi thirrur në përgjegjësi ministrat, çfarë debatesh kemi bërë dhe çfarë rekomandimesh që votohen këtu prej Parlamentit zbatohen prej Qeverisë. Ky është niveli i demokracisë, se tash të mos i shesim mend këtu njëri-tjetrit sa jemi të qëndrueshëm, deri në sa të natës jemi për të ndenjur, për të debatuar, sepse kjo nuk është esenca e demokracisë.

KRYETARI: Salih Salihu, nga Grupi i Deputetëve të Pavarur.

SALIH SALIHU: Edhe ne jemi që debati apo seanca të vazhdojë nesër, me shpresë që përfaqësuesit nga Qeveria të jenë të pranishëm, sepse po shihet se edhe interpelancat, por edhe debatet janë të rëndësishme. Ne e kemi, për shembull, një debat që ka të bëjë me mishin e importuar dhe këtu përgjegjës është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, e cila është në kompetencën e Kryeministrit dhe është e pakuptimtë të diskutohet për këtë çështje pa qenë i pranishëm askush nga Qeveria, apo nga Kryeministria.

Prandaj, duke konsideruar që nesër dikush vjen, mendoj që nesër nga ora dhjetë të vazhdojmë me këto pika. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Salihu, veç të lidhem me zotin Zemaj, as kur ka qenë kryeministër Isa Mustafa, s'ke mundur ta sjellësh, Ramush Haradinajn është edhe më zor. Por, unë s'marr garanci si kryetari Kuvendit ta sjellë Qeverinë. Vendimmarrja mbetet për seancë. S'marr garanci, se Armendi e tha më herët, por unë s'marr garanci. Por, tash shkojmë te aleanca. Zoti Isufi!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë të shihen kushtet e punës në Kuvend, po ashtu edhe në raport me Qeverinë një komunikim më i mirë, në mënyrë që institucionet të mund të funksionojnë.

Unë po ju lajmëroj që nesër zoti Haradinaj është në Shkup, nuk është në Kosovë. Prandaj, kijeni parasysh edhe agjendën e Qeverisë që ndërlihet edhe me interesat e Kosovës, edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, edhe në të gjitha aspektet dhe të mos imponojmë nganjëherë agjenda, të cilat nuk përputhen ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë. Nuk po dua ta përsëris atë që ka qenë i gatshëm zoti kryeministër të vijë, qëllimisht është shtyrë interpelanca. Tash, nëse shkojmë "mujtas" siç thonë, nuk është mirë, por unë konsideroj që kushte ka për debat, nëse duan deputetët, nëse s'duan e shtyjmë për tjetër ditë, nuk prish punë.

KRYETARI: Urdhëro, zoti Enver Hoti. Fjala për ju, në emër të Nismës.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Duke e marrë parasysh rëndësinë e pikave që janë ngrehur për debat, nga grupet parlamentare dhe nga deputetët e Parlamentit, mendoj se debati është mirë të vazhdojë. Qeveria e dëgjon zërin tonë, mandej marrim përgjigje gjithsesi. Ne absolutisht jemi këtu për të debatuar. Qeveria do ta ketë parasysh zërin që do të burojë nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, nuk ka... Armend, dëshiron edhe një herë të kontribuosh? Urdhëro, para se ta vëmë në votim me këta deputetët që i kemi të pranishëm.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar,

Unë desha të replikoj, se për kontribut po shihet se është pak problem në këto orë dhe në këto kohë.

Unë nuk e kërkova kryeministrin, të them të drejtën, e kërkova Qeverinë. I ka nja 5 zëvendëskryeministra, nja 23 ministra, 70-80 zëvendësministra, bile ndonjë këtu të ulet për fushën e vet, për të cilën është kërkuar interpelanca, se s'jemi duke e kërkuar gjithë Qeverinë, se edhe ashtu nuk e zë, edhe po të duam ne t'i sjellim, s'kemi ku t'i ulim këtu.

KRYETARI: Veç sa për njoftim, zëvendësministrat nuk kanë të drejtë, se ndoshta do të kishin ardhur.

Atëherë, kështu. Unë po e shoh që nuk ka konsensus fare. Po ta vëmë në votim është veç sa njëra palë ta mundë tjetrën, Thjesht... Unë e hedh në votim, dalin dy më shumë, dalin ata që s'kanë dashur ta vazhdojnë...

A vazhdojmë nesër në orën 10:00, të mos maltretohemi. A e lëmë në orën 10:00?

Në 11:00, veç ju lutem të vini në 11:00, dhe i thërras me seriozitetin e plotë edhe i bashkohem thirrjes së kolegëve deputetë, që ministrat të jenë të pranishëm, veçanërisht ata me natyrën e punës të të cilëve debatohet, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjet përkatëse të debateve. Faleminderit! Mirupafshim nesër në orën 11:00!

* * *

E mërkurë, më 18 prill 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 dhe 17 prill 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Hap punimet e seancës plenare të Republikës së Kosovës, e filluar më 16 dhe 17 prill 2018.

Gjatë seancës së djeshme kanë ngelur tri votime pa përfunduar, akoma nuk kemi kuorum për t'i hedhur në votim.

22. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjimimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosjes, Glauk Konjufca dhe 14 deputetë nënshkrues, kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjimimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror.

Tani Glauku nuk qenka këtu. Sami Kurteshi e ka kërkuar fjalën.

SAMI KURTESHI: Zoti kryesues, momentalisht kryetari i Grupit Parlamentar nuk është këtu, unë mendoj se do të ishte mirë të shtyhet, sepse ai nuk mund të vijë edhe për një kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk të kuptova qysh të shtyhet, sa, e di kohën kur vjen, apo të dalim në pikën tjetër?

Po e presim për dy minuta.

Unë e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zotin Glauk Konjufca, që në emër të prozuesit të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar dhe konform situatës së krijuar gjatë gjithë kësaj kohe, besoj që Glauku do të sqarojë si është situata. Zoti Glauk, e ke fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë,

Kjo kërkesë është dërguar faktikisht në Kuvend më 9 mars dhe ka kaluar më shumë se një muaj prej kur kjo kërkesë është dërguar, më pastaj pati ndodhur, siç e dimë, edhe kalimi i demarkacionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe pse Lëvizja Vetëvendosje i është

drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me kalimin e kësaj marrëveshjeje për përcaktimin e vijës kufitare mes Malit të Zi dhe Kosovës.

Lëvizja Vetëvendosje në Gjykatën Kushtetuese i ka ngritur dyshimet e veta për shkelje të bazuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ne mendojmë që kriteret e pranuar nga Komisioni Shtetëror, i cili është udhëhequr nga zoti Meha, ka pranuar kritere, të cilat e kanë dëmtuar integritetin territorial të Kosovës dhe në këtë kuptim, mendojmë që është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, kjo kërkesë, të cilën ne e kemi drejtuar në Kuvend të Republikës së Kosovës, pika e dytë e saj mendoj që është e rëndësishme.

Kjo pikë ka të bëjë me hetimin parlamentar për marrëveshjen për gjithë rrjedhën nëpër të cilën ka kaluar ky proces dhe përcaktimin e rolit dhe përgjegjësi të faktorëve të involvuar në procesin e shënimit të vijës kufitare mes Malit të Zi dhe Kosovës, duke filluar prej negociatave, të cilat kanë filluar në vitin 2013 mes delegacionit të Malit të Zi dhe Komisionit Shtetëror të Kosovës, e deri te kalimi i saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kështu që kryeministri sërish nuk është këtu, ky debat nuk do të mund të mbahet, unë konsideroj, pa kryeministrin.

Megjithatë, konsideroj që nevojitet krijimi i një Komisioni Hetimor Parlamentar sa i përket demarkacionit.

Edhe pse demarkacioni ka kaluar, Gjykata Kushtetuese është duke e shqyrtuar lëndën tonë, përveç kësaj ne sërish insistojmë që janë bërë shumë gabime dhe do të kishte qenë mirë që Parlamenti ta hetojë krejt procedurën prej kur kanë filluar negociatat mes dy komisioneve shtetërore.

Kështu që ndoshta kjo do të kishte qenë më së mirë të shtyhet si debat parlamentar dhe si miratim i kësaj rezolute. Mirëpo unë nuk mendoj që i ka humbur aktualiteti aspak.

KRYESUESI: Domethënë je dakord sot të hiqet nga rendi i ditës për një seancë tjetër kur ka nevojë.

Atëherë me kërkesë të propozuesit tërhiqet kërkesa për debat parlamentar të kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje në lidhje me të gjeturat e raportit të Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror. Kërkesa mund të përsëritet për ndonjë seancë tjetër, sipas situatës.

23. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetëve Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Driton Çausi, në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë

Në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 11 prill 2018 me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të PDK-së dhe Deputetëve të Pavarur u vendos që të mbahet vetëm një debat parlamentar në seancë parlamentare. Pra, kanë qenë disa kërkesa ose dy kërkesa, më mirë të themi, dhe deputetët e Kuvendit, zonja Ganimete Musliu, zoti Salih Salihu, zoti Dardan Sejdiu dhe 23 deputetë të tjerë nënshkruar kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me skandalin e mishit të prishur, të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë e sigurisë së ushqimit në Kosovë.

Ftoj zonjën Musliu dhe, pastaj edhe propozuesit e tjerë, të cilët i janë bashkëngjitur debatit, sipas radhës të tre të përgatiten për të diskutuar, por në radhë të parë zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Duke ndjekur me shqetësim raportimet e medieve dhe shqetësimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës, më 14 mars kam marrë një iniciativë që të iniciohet një debat parlamentar dhe të diskutohet lidhur me skandalin ose të ashtuquajturin ‘skandali i mishit të prishur në Kosovë’.

Me këtë rast dua t’i falënderoj kolegët e mi deputetë për mbështetjen që më dhanë në këtë iniciativë dhe për të mos u hyrë në hak, dua t’i përmend me emra: Memli Krasniqi, Xhevahire Izmaku, Safete Hadërgjonaj, Mërgim Lushtaku, Flora Brovina, Blerim Kuçi, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka, Haxhi Shala, Labinot Tahiri, Luljeta Veselaj-Guta, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Daut Haradinaj.

Një javë më pas edhe Grupi i Pavarur i Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga zoti Driton Çausi dhe deputeti Salih Salihu kanë bërë kërkesën e njëjtë, meqë jemi pajtuar ta fuzionojmë në një debat të vetëm dhe të japim rekomandimet për këtë debat.

Prandaj, unë sot në emër të grupit iniciues do ta shpall të hapur debatin me fjalën time dhe rekomandimet. Pastaj, në fund do t’i lejojmë Grupit të Pavarur të Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që t’i prezantojnë para deputetëve në mbyllje të këtij debati.

Të nderuar deputetë,

Ka mbi një muaj që vendi ynë është përballur me shumë informata e me shumë dezinformata rreth të ashtuquajturit ‘skandal i mishit në Kosovë’.

Jemi dëshmitarë të pamjeve të tmerrshme televizive dhe medieve në përgjithësi dhe kjo ka shqetësuar me të drejtë qytetarin e Republikës së Kosovës dhe neve si përfaqësues të vendit.

Lajmi që në Kosovë ka hyrë mish me afat të skaduar nga Belgjika ka më shumë se një muaj që ka goditur opinionin në masë shqetësuese dhe që nga plasimi në medie i këtij lajmi e deri më sot ende vazhdon të jetë lajm kryesor në çdo debat.

Fatkeqësisht, ende nga askush nga ne nuk është thënë fuqishëm se për këtë problem jemi duke folur me dy vjet vonesë dhe, mbi të gjitha, është dezinformuar mjaft shumë opinionin publik dhe janë dëmtuar mjaft shumë edhe ata prodhues vendorë, të cilët ofrojnë produkte cilësore në Kosovë.

Për të arsyetuar atë që thashë më lart, se jemi duke folur me vonesë, më lejoni që të informoj opinionin se ky mish për herë të parë ka tentuar të hyjë të Kosovë në muajin shtator të vitit 2016. Pra, e them me vetëdije se ka tentuar të hyjë dhe jo se ka hyrë në Kosovë, sepse Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me sukses e ka parandaluar hyrjen e atij mishi në Republikën e Kosovës.

Tentativa e dytë është bërë në muajin gusht të vitit 2017, ku në të dyja rastet ky mish është zbuluar dhe asgjësuar nga inspektorët e agjencisë.

Në të dyja rastet është njoftuar Agjencia Federale për Siguri të Zinxhirit Ushqimor të Belgjikës, në vendin e origjinës, nga ku ishte nisur ky mish për t'u importuar në Republikën e Kosovës.

Sipas informatave që kemi nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në rastin e parë ka ardhur vetë zyrtarja belge për vërtetimin e gjendjes faktike dhe bashkërisht është bërë kontrolli i ngarkesës.

Ndërsa në rastin e dytë nuk kanë ardhur direkt, por kanë konfirmuar pranimin e njoftimit dhe me këtë rast shteti belge ka filluar hetimin dhe ka marrë masa konkrete ndaj kompanisë në shtetin e tij, ndërsa agjencia ka vazhduar me veprime konkrete, ku është bërë asgjësimi i mishtit në Kosovë.

Pra, duhet ta themi zëshëm se në të dyja rastet është bërë asgjësimi i mishit të importuar nga Belgjika dhe nuk është lejuar të hyjë në Kosovë, për këtë mendoj që duhet të vlerësohet puna dhe angazhimi i inspektorëve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Shteti belge, konkretisht parlamenti dhe mediet belge Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës e vlerësojnë pozitivisht që ka arritur me profesionalizëm të parandalojë që ky mish të

futet në Kosovë, ku është dhënë mesazh i qartë se Kosova ka ekspertë dhe staf profesional që ta ruajë dhe ta mbrojë konsumatorin nga rreziku i importeve të tilla.

Gjatë periudhës njëmuajore, apo thënë më saktë pas aktualizimit të skandalit të ashtuquajtur ‘mishi i Belgjikës’ në supermarketet e disa komunave të Kosovës, pa dashur t’i përmend me emra, sepse kjo duhet të mbetet punë e prokurorisë dhe e gjyqësisë, nga inspektorët komunalë u konfiskuan dhe u asgjësuan tonelata të shumta të mishit me afat të skaduar që nuk i plotëson as standardet minimale për konsum.

Raportimet e tilla nëpër medie tregojnë më së miri për gjendjen e rëndë të sigurisë së ushqimit në Kosovë dhe kërkojnë vëmendje urgjente nga institucionet e vendit në përgjithësi.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë, përkundër vullnetit dhe profesionalizmit që kanë, për shkak të kapaciteteve të mangëta nuk po arrijnë t’i plotësojnë mjaftueshëm nevojat e kontrollit të ushqimit në Kosovë. Dikush mund t’i quajë edhe të dështuara përpjekjet e agjencisë për të pasur në kontroll sigurinë e ushqimit, por do të ishte e padrejtë që gishti të drejtohet vetëm te bartësit e këtij institucioni dhe stafi i tij.

Secili nga ne duhet të angazhohemi dhe t’i përmbushim detyrat që jemi të obliguar t’i kryejmë.

Qytetarët janë të rrezikuar çdo ditë nga produktet ushqimore që importohen në Kosovë dhe jo vetëm të mishit. Toksina, pesticidet, metalet e rënda, hormone, antibiotikë e elementë të tjerë kancerogjenë janë rrezik permanent për shëndetin tonë.

Një kujdes i veçantë dhe kontroll i rregull duhet të bëhet edhe në thertoret vendore, të cilat janë rrezik potencial për bartjen e sëmundjeve të ndryshme.

Edhe produktet e qumështit duhet të trajtohen me shumë kujdes dhe kontroll të shtuar, meqë kemi raste të shumta të pakënaqësive të qytetarëve që nga trajtimi i tyre në raftet e supermarketeve, e deri tek cilësia e dyshuar e këtyre produkteve.

Pa dashur të zgjatem shumë dhe duke besuar në punën dhe angazhimin e secilit prej juve, kolegë deputetë, para se të kryqëzojmë secilin përgjegjës institucional, kërkoj që të kontribuoni në këtë debat dhe të ofroni zgjidhje konkrete për eliminimin e problemeve me të cilat po ballafaqohemi çdo ditë.

Vetëm duke u liruar nga ngarkesat e politikave ditore dhe kufijve partiakë, ne mund të jemi të sinqertë ndaj vetvetes dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarëve të vendit.

Sot, në këtë temë me shumë se kur duhet të lihet anash politika ditore e partiake dhe të bëhemi bashkë për të ofruar zgjidhje para se lufta e shijshme e tryezave tona të marrë përmasa shqetësuese për të gjithë ne.

Si iniciuese e këtij debati, e mbështetur nga kolegët deputetë që i përmenda më herët, propozoj të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për financat e pushtetit lokal, i cili në mënyrë formale-juridike mundëson transferimin e të gjithë inspektorëve përkatës dhe kompetent nga niveli lokal tek ai qendror.

Kjo do të mundëson rritjen e efikasitetit për ushtrimin e kontrollit zyrtar të integruar, që nënkupton inspektim, monitorim, auditim, mostrim në fushën e sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë ligjore për t'i garantuar konsumatorit ushqim të sigurt, të përshtatshëm dhe që mbështetet plotësisht me Ligjin e ushqimit.

Mbështetje më të madhe buxhetore për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në realizimin e mandatit të saj si dhe, në veçanti të ndahet buxhet në mbështetje në linja të caktuara për pajisje të nevojshme dhe të sofistikuar për trupat inspektues për mbështetjen e kontrolleve zyrtare.

Në asnjë mënyrë nuk duhet të anashkalohej as laboratorit i ushqimit dhe veterinarisë, si njësi e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky laborator ka nevojë sistematike për furnizim të pajisjeve, mirëmbajtje të pajisjeve dhe reagjentëve laboratorikë.

Avancimin e mëtejshëm të metodave testuese në përputhje me standardet dhe kërkesat e kohës, ku pa dyshim rezultatet e tij janë tregues i performansës së kontrolleve zyrtare nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë përmes mostrave zyrtare dhe sistemeve të vetëkontrollit nga operatorët e biznesit dhe ushqimit.

Të nxisim bashkëpunimin nga niveli qendror tek ai lokal për konsolidimin e zyrave regjionale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë,

Të zhvillojmë kampanja vetëdijësuese që qytetarët e Republikës së Kosovës të jenë sa më të kujdesshëm për ushqimet që zgjedhin për tryezat e tyre dhe gjithsesi duhet të bëhet mbështetja e agjencisë me personel profesional, me theks të veçantë ose konkretisht duhet thënë, me inspektorë dhe veterinerë të profesionalizuar.

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë kërkoj mbështetjen tuaj dhe argumentet tuaja që sa më shumë të bëjmë më të mirën e mundshme që në të ardhmen ta ndihmojmë këtë agjenci dhe ta mbrojmë shëndetin e qytetarëve nga rreziku permanent që është duke u kanosur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Më fal! Kush e do fjalën? Fjalën e ka Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova më shumë se një vit është duke u marrë me tema “të mëdha”, institucionet e Republikës së Kosovës janë duke krijuar mjegull, por me punë të përditshme jetike për popullatën nuk është duke u marrë fare. Kjo është një dëshmi konkrete sot që asnjë anëtar nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është këtu për të marrë pjesë në këtë debat dhe në këtë temë kaq të rëndësishme.

Kosova po rënkon nga arsimi jocalësor, nga shëndetësia jocalësore dhe mungesa e sigurimeve shëndetësore, me drejtësi të kapur nga grupet e pushtetarëve, me ekonomi të dobët, me papunësi të lartë, me shpenzime buxhetore të pakontrolluara dhe të paarsyetuara dhe, mbi të gjitha këto, qytetarët e Republikës së Kosovës ballafaqohen edhe me ushqim jocalësor, e jo të sigurt. Qeveria jonë, Presidenti dhe mazhoranca pakicë e koalicionit qeverisës, edhe atëherë kur nuk ka asnjë arsye, provokojnë dhe shkaktojnë skandale që opinioni dhe ne të merremi me sanimin dhe monitorimin e këtyre skandaleve, duke i lënë anash gjërat esenciale për jetën, si në këtë rast sigurinë dhe kontrollin e ushqimit.

Janë më shumë se dy muaj që mediet tona e kanë sensibilizuar skandalin e importeve të mishit dhe produkteve të tyre me afat të skaduar në Kosovë. Në bazë të këtyre raportimeve shihet qartë se importi i mishit dhe produkteve të tij, dhe industria e mishit është një krim i organizuar, i cili e rrezikon drejtpërdrejt jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Duke e pasur parasysh relevanten e kësaj teme dhe rrezikun për popullatën, unë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e shtrova këtë çështje në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambient më 27 mars 2018, dhe kërkova që urgjentisht ta ftojme kryeshefin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë që të raportojë para komisionit. Komisioni e aprovoi kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe të nesërmen, më 28 mars 2018, kryeshefi ekzekutiv i AVUK-ut ka raportuar para Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Ambient.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbledhja të cilën e kam kryesuar unë ka filluar me pyetjet e secilit anëtar të komisionit për shqetësimet që i kishim në lidhje me skandalin e mishit dhe produkteve të tij. Po citoj disa nga pyetjet, të cilat i parashtrua, dhe asnjëra nuk mori përgjigje: Pse nuk është ndaluar mishit pa afat të përdorimit në Dogana nga inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë? Sa është sasia e mishit të importuar dhe nga cilat kompani është importuar? Cilat markete apo mishore e kanë shitur mishin e tillë? A po zhvillohet operacioni i inspektimit në tërë territorin e Kosovës? Cilat janë fabrikat e mishit, të cilat janë inspektuar dhe janë evidentuar parregullsitë dhe janë ngritur padi? Sa licenca janë tërheq për shkelje të tilla? Çfarë masash konkrete dhe urgjente po merren me ndalimin e shitjes së këtyre produkteve? e të tjera.

Kolegë deputetë,

Asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk ka marrë përgjigje të saktë dhe të qartë për këto çështje që i ngritëm. Thënë të vërtetën unë kam dalë nga ajo mbledhje më e zhgënjyer sesa kur kemi hyrë në të. Bazuar në këtë situatë zhgënjyese, unë në emër të komisionit kam kërkuar nga kryeshefi i Agjencisë së AVUK-ut që të na i dërgojë përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të komisionit me shkrim. Në vend të këtyre përgjigjeve, kryeshefi ekzekutivë i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, më 5 prill 2018, na ka dërguar një material prej 8 faqesh, në të cilin e përshkruajnë punën e Agjencisë për vitin 2017. Në faqen e tetë të këtij materiali, informatë lidhur me rastin e mishit me afat të skaduar nga importi, përshkruhet rasti i eksportuesit “Veviba” nga Belgjika dhe importuesit “Beni sh.p.k.” nga Suhareka, si dhe eksportuesi i “Vall Omell” dhe importuesi “Euro Ida” nga Rahoveci, masat që janë ndërmarrë për këto dy kompani dhe me kaq përfundon njoftimi për skandalin e mishit.

Nga ky material informues nuk marrim asnjë informatë më të rëndësishme nga ato që i kemi marrë nga mediet çdo ditë dhe kjo është vërtet shqetësuese. Ankesat e AVUK-ut se numri i inspektorëve është i vogël dhe ligji nuk i obligon inspektorët komunal që ta koordinojnë punën me inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë është kundërtënëse me vetë këtë material që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë na ka dërguar. Për shembull, te raporti i Inspektoratit Sanitar gjatë vitit 2017, janë kryer thonë 2 821 inspektime, që pjesëtuar për 365 ditë i bie pak më shumë se 7 inspektime në ditë, e kjo është vërtet shumë pak. Si dhe duke dashur që secili të krijojë territorin e vet të krimin të organizuar bazuar në korrupsion institucional, atëherë inspektorati komunal nuk bashkëpunon me inspektoratin qendror për t’i ruajtur këto territore për vete. Asnjë pengesë nuk duhet të paraqesë ligji për t’i koordinuar punët e inspektoratit komunal me atë qendror.

Çdo inspektim dhe raport inspektoratit komunal duhet të dërgohet te kryetari i Komunës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe çdo gjë do të ishte e koordinuar dhe kishte qenë në kontroll. Ky çakordim dhe anarki nuk bëhet pa qëllim dhe dikush duhet të japë përgjegjësi. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është institucion që përfshin fushën e gjerë të sigurisë për ushqim. Kjo agjenci duhet të punojmë me shumë përgjegjësi, sepse nga ajo varet jeta dhe shëndeti i popullatës. Ne nuk mund të ndalemi vetëm te skandali i mishit dhe produkteve të tij, kemi probleme edhe qumështin dhe produktet e tij, siç e kishim rastin me vajin e palmës. Kemi problem me të gjitha gjërat ushqimore që importohen dhe tregtarët importuesit tanë, duke dashur që fitimin ta kenë sa më të lartë, marrim produkte me afate të shkurtër të skadencës, ose me afat të skaduar dhe pastaj i mbulojnë ato me tiketa false dhe i shesin ato me çmime të larta si ushqim cilësor. Dhe, këtë gjë e kemi provuar secili nga konsumatorët, edhe ne ndër ta.

Prandaj, qytetari i Republikës së Kosovës ushqehet me ushqimin më të shtrenjtë në Evropë, por me cilësinë më të dobët në Evropë, për shkak të papërgjegjësisë së importuesve dhe për shkak se institucionet tona kompetente janë të korruptuara dhe nuk e zbatojnë ligjin me të cilin janë të

obliguar që ta mbrojnë konsumatorin dhe popullatën, në përgjithësi. Nga realiteti që e kemi në tregun ushqimor në Republikën e Kosovës shohim se produktet vendore janë shumë më të sigurta dhe më cilësore sesa ato që importohen. Andaj, Qeveria e Kosovës duhet të jetë përgjegjëse që prodhuesit vendorë t'i mbështesë dhe importuesit t'i mbajë nën kontroll dhe t'i sanksionojë në bazë të ligjit.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe Inspektorati komunal janë përgjegjës jo vetëm për cilësinë e ushqimit, por edhe për higjienën e institucioneve publike dhe private. Janë përgjegjës për shëndetin e kafshëve, shpezëve, peshqve, bletarisë, për ushqimin e tyre. Ky popull ka të drejtë të ushqehet sigurt dhe me ushqim cilësor, ndërsa institucionet tona kanë obligim të ofrojnë siguri dhe cilësi për vendin, e jo të bëjnë pazare e të korruptohen duke e rrezikuar jetën e popullatës.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon nga organet përgjegjëse që të respektohet ligji, kërkon nga organet e drejtësisë që të merren me këtë fushë seriozisht dhe të mos bëhen pjesë e krimit të organizuar, i cili po e shkatërron popullatën dhe po e gërryen vendin.

Lidhja Demokratike është tejet e shqetësuar dhe shumë skeptike që kjo Qeveri do të merret me luftën e këtyre dukurive, sepse po i bie se do të ishte marrë me luftimin e vetvetes. Andaj, ne kërkojmë që kjo Qeveri sa më shpejt të japë dorëheqje dhe vendi të shkojë në zgjedhje për të pasur zgjidhje të problemeve kuptohet në krye me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Andin Hoti, e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë kur përsëritem disa herë dhe nuk realizohet bëhem goxha bajat, s'di qysh po bëheni bajat që përditë ta përmendni rrëzimin e Qeverisë.

I nderuar kryesues,

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të respektuar,

Meqenëse sot po diskutohet për skandalin e mishit dhe pasi jam pjesë e Komisionit të Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe për Mjedis e Planifikim Hapësinor, në të cilin ne e kemi pasur një takim me kryeshefin e AVUK-ut për këtë çështje, dua të bashkëngjitëm në këtë shqetësim të qytetarëve të Kosovës.

Në fakt, ky rast nuk mund të quhet vetëm skandal. Pa e paragjykuar si rast penal, jam i bindur që përbën krimin më të rëndë që mund t'i bëhet shoqërisë. Nuk ka krim më të rëndë sesa helmimi

me paramendim i qytetarëve, sesa vrasja e mbarë popullit me tregtimin e produkteve të tilla. Sot shumë kompani, të cilat shesin produkte ushqimore nuk e plotësojnë as kriterin bazë, i cili është higjiena, dhe për këtë mund të marrim fakt edhe skandalin e fundit në të cilin janë gjetur minj dhe insekte tjera. Në fakt, duke mos preferuar të flas vetëm me thashetheme, unë personalisht kam hasur disa herë insekte në produkte ushqimore, të cilat i kam blerë vetë. Dhe, për fat të keq, ka shumë pak progres në këtë drejtim. Kompanitë të cilave u është gjetur mish i prishur, kompanitë të cilat importojnë dhe shesin pa problem në Kosovë produkte ushqimore të prishura, edhe pas skandaleve që krijojnë, ato vazhdojnë të operojnë pa problem në Kosovë edhe më tutje.

Dhe, kjo është e dhimbshme. Kjo e tregon fuqinë politike që ato kompani kanë te ne dhe mbi ne. Mirëpo, unë e kam edhe një shqetësim tjetër krahas kësaj, dhe ai ka të bëjë me kompanitë e ndershme, të cilat operojnë në Kosovë. Në rastin e fundit dhe rastet tjera që qytetarët hasin po dëmtohen rëndë edhe kompanitë vendore, të cilat punojnë ndershëm. Unë habitem shumë sesi ato nuk e ngrenë zërin.

Unë e ftoj AVUK-un nga këtu, edhe në komision e kam bërë të njëjtën gjë, që urgjentisht ta marrin seriozisht punën e tyre që të kenë angazhim më të madh, që urgjentisht të krijojnë planin e veprimit, duke filluar nga rekomandimet që u jepen kompanive për higjienë, për pajisje të ndryshme e tjera. Gjithashtu, i ftoj të gjitha inspektoratet adekuate që urgjentisht t'i ndër marrin masat më të ashpra që parashikojnë ligjet tona për këto kompani.

Po ashtu, nga takimi që kemi pasur në komision, AVUK-u është shprehur i shqetësuar dhe ka pas kërkesë që numri i inspektorëve të rritet, meqenëse është i vogël, prandaj unë e ftoj Qeverinë e Kosovës që t'ua plotësojë kërkesën e tyre për rritjen e numrit të inspektorëve.

Ndërsa inspektoratet përkatëse t'i kryejnë rigorizisht detyrat e veta, në mënyrë që ndëshkimet të jenë maksimale. Përndryshe, ato kompani që punojnë ndershëm pse duhet të vazhdojnë ta bëjnë këtë. Pra, ne duhet t'i mbrojmë bizneset që operojnë ndershëm, ata që i kanë qytetarët dhe shëndetin e tyre para fitimit dhe maksimalizimit të fitimit në kurriz të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje, kryesues!

Është për të të ardhur keq që në këtë debat kaq të rëndësishëm të mungojë kryeministri, e lëre më që të mos jetë asnjë ministër këndeje mbrapa.

Skandali i mishit të prishur që përfshiu Belgjikën dhe importuesin e këtij mishi - Kosovën, përveç që është shqetësues, është edhe alarmant, pasi ky skandal ndërkombëtar prek drejtpërdrejt shëndetin e qytetarëve tanë. Nëse e shohim raportin e gazetës flamane "Het Laatste Nieuws", thuhet që mishi që është eksportuar në Kosovë në vitin 2016, nga kompania belge "Vebiba",

ishite 12 vjet i vjetër dhe paramendoni qytetarët e shtetit tonë, fëmijët tanë, prindërit tanë, familje të tëra nëpër gjithë Kosovën kanë konsumuar mish 12 vjet të vjetër.

Ky është krim dhe krimi duhet ndëshkuar.

Pas skandalit të mishit që mori përmasa të gjera në Evropë dhe në botë, në Kosovë, atëherë organet tona përkatëse u kujtuan ta kontrollojnë mishin nëpër marketet tona, e sikur të mos zbulohet ky skandal në Belgjikë, qytetari i Kosovës do të kishte vazhduar të ushqej me mish 12 vjet të vjetër, gjë e cila edhe tani që flasim nuk është plotësisht e sigurt, sepse nuk kemi asnjë garanci që tregu ynë është i sigurt. Janë drithëruese faktet që paraqet dëshmitari i mbrojtur belg në një televizion në Belgjikë në lidhje me mishin që ishte eksportuar në Kosovë. Citoj: “Në mishin që është eksportuar në Kosovë nuk rridhte gjak i zakonshëm, por ngjyra e gjakut ishte e gjelbër”. Kjo është e tmerrshme!

Për mua është qesharake deklarata e zëdhënësit të Agjencisë Kosovare të Ushqimit dhe Veterinarisë, zoti Lamir Thaçi, se shumica prej këtyre që kanë ndodhur janë spekulime për shkak se krejt ky zhvillim ka ndodhur prej autoriteteve kosovare dhe ne e kemi njoftuar Belgjikën që kjo kompani ka bërë falsifikim. Asgjësimi i atij mishi dhe ngarkesën e parë e mishit nga kjo kompani ne e kemi ndalë në kufi dhe e kemi asgjësuar”. Kjo ka ndodhur në vitin 2016, atëherë si është e mundur që pas këtij skandali, tonelata mish të prishur dhe pa afat u zu nëpër shitoret tona?!

Ky mish i zënë si ka hyrë në Kosovë dhe si është hedhur në treg? Edhe për këtë duhet të tregojë Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë. Dhe, pasi të tregojë për këtë vendim të parë, kush është ky person i cili nuk mund të jetë më edhe drejtuesi i kësaj agjencie? Pas skandalit të krijuar, ministri belg i Bujqësisë, Denis Dugarm, e ka quajtur kompaninë “Vebiba” e ka quajtur kompani që ka përdorur metoda mafioze të shitjes së mishit duke rrezikuar jetën e qytetarëve të vendit. Shtrohet pyetja: Cilat janë kompanitë nga Kosova që kanë përdorur dhe po përdorin metoda të tilla? A janë evidentuar nga organet kompetente masat që duhet ndërmarrë të gjitha këto?, duhet ta kenë një shpjegim.

Merreni me mend po flitet për një skandal që gjenezën e ka në vitin 2016, e tani jemi në vitin 2018.

Pra, brenda dy vjetëve, në Kosovë kanë hyrë me tonelata mish të prishur dhe pa u vërejtur nga askush, si dhe këtë mish e kanë konsumuar qytetarët e Kosovës, dukuri për të cilën të gjithë kemi të drejtë të besojmë se rëndom ka ndodhur edhe para vitit 2016. Unë dyshoj se këtu ka mish të importuar edhe nga vendet tjera, një shembull i shkurtër: në supermarketin “ETC” në Prizren gjatë një kontrollimi të inspektorëve komunalë në frigoriferët e tyre është gjetur një depo mishi gjedhi me afat të skaduar para një viti, të importuar nga Polonia, por i njëjti sipas raportit të

Inspektoratit të Prizrenit është prishur më herët nga moskushtet e ruajtjes. Nëse e shikojmë procedurën e kontrollit sesi kontrollohet mishi i importuar, shohim se e tërë përgjegjësia në këtë proces bie mbi Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, pasi procedurat janë kështu: kontrollin e parë në Doganë e bëjnë inspektorët e veterinarët e Doganës, pastaj përcjelljen nga Dogana deri në depo dhe hapjen e tij e bëjnë inspektorët regionalë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa inspektorët komunalë bëjnë vetëm inspektimin e depove, thertoreve, lokaleve dhe fabrikave të përpunimit.

Pra, i tërë sistemi është nën kontrollin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Nga e gjithë kjo zhurmë me mish, ne e kemi kuptuar se i tërë sistemi është potencialisht nën kontroll dhe nuk ka mundësi për keqpërdorime, përpos kur lëshimet bëhen me urdhër të dikujt tjetër. Këtë po e themi, sepse askush nuk mund të shkojë, po e zëmë në Belgjikë të blejë mish në cilëndo kompani sipas dëshirës, këtë nuk e lejon AVUK-u, sepse AVUK-u e ka një listë të kompanive, të cilat i plotësojnë kriteret e kualitetit dhe importit. Importi, pra, mund të bëhet vetëm nga kompanitë që gjenden në listë.

Unë e kam një pyetje, meqë deri tani na përcollën aferat me mish të importuar me afat të skaduar, me miell me afat të skaduar dhe të destinuar për kafshë, tani kemi dyshime edhe për importin e qumështit, qoftë të freskët, por edhe pluhur: A duhet që edhe në produktet tjera të ndodhin njëherë aferat apo helmimet, e pastaj ta kërkojmë fajtorin? Pas gjithë këtyre aferave, sinqerisht dyshoj se jemi bërë deponi e ushqimeve me afat të skaduar nga e gjithë Evropa. Statistikat të shqiptarëve që mjekohen jashtë shtetit janë të frikshme, të cilët vuajnë me kancer, ku 80% e pacientëve që shërohen nga kanceri në Shqipëri janë nga Kosova, 50% që mjekohen nga kanceri në Maqedoni janë po ashtu nga Kosova, si dhe në Institutin Onkologjik në Beograd janë 3 800 pacientë që trajtohen nga kanceri, pra shqiptarë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Tregu i Kosovës ka vite që furnizohet me ushqime të dyshimta dhe është bërë vend i sigurt për plasimin e këtyre prodhimeve që nuk kanë vend në tregjet e vendeve ku ato edhe prodhohen. Skandali i importit të mishit të skaduar nga Belgjika nuk është skandal i vetëm, as i pari, dhe kam frikë se nuk do të jetë as i fundit i kësaj natyre.

Që nga paslufta në Kosovë futen ushqime të skaduar e të kualitetit shumë të dobët. Ende është i freskët rasti i miellit të kafshëve që është shitur si miell për njerëz. Nuk janë për të injoruar edhe informatat se në Serbi vija të veçanta prodhojnë ushqim ekskluziv për Kosovën dhe ekskluziviteti ka të bëjë me kualitetin e dobët të produkteve ushqimore që i dërgojnë vetëm për Kosovë, por jo edhe për tregun e tyre. Jam i sigurt se të gjithë neve na ka rënë të hasim në çmime

tepër të ulëta të produkteve ushqimore, si për shembull mishi me çmim 3 euro ose buka me çmim 15 centë. Vetë këto çmime flasin për kualitetin e dobët të këtyre prodhimeve.

Qytetarët e Kosovës me vite të tëra po ushqehen me prodhime që e shkatërrojnë shëndetin e tyre. Megjithatë, për këtë dëm të madh që po u bëhet qytetarëve të vendit askush nuk merr përgjegjësi, askush nuk e ndien veten fajtor, të pafajshëm e shpallin vetveten Agjencia e Ushqimeve dhe Veterinarisë, Doganat, inspektorët e tregut, prokurorët, gjyqtarët dhe të gjitha institucionet, të cilat paguhen për ta mbrojtur qytetarin në çdo aspekt dhe sidomos në aspektin e ruajtjes së shëndetit të tyre.

Në këtë rast hesht edhe Qeveria e Kosovës, e cila e ka për obligim që të reagojë dhe të kërkojë që të ndërmerren masa ndaj të gjithë atyre që paguhen nga qytetarët dhe lejojnë që të dëmtohet shëndeti i tyre për hesape të panjohura për mua, por sigurisht që këto janë llogaritë e individëve në dëm të interesave të përgjithshëm. Pavarësisht krejt këtyre, qytetarët edhe më tutje vazhdojnë të ushqehen me ushqime që nuk e plotësojnë asnjë standard, e faji mbetet jetim. Deri kur kështu?! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu, si ushtrues i kërkesës për debat e ka fjalën. Kërkoj falje se unë e kuptova gabimisht të parën.

SALIH SALIHU: Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Kohëve të fundit publiku është alarmuar nga disa skandale të raportuara nëpër medie, që lidhen me importin e mishit me afat të skaduar nga vendet tjera në Kosovë.

Menjëherë pas publikimit të lajmit për mishin nga Belgjika, inspektorët e Agjencisë së Ushqimit të Veterinarisë dhe ata komunalë u aktivizuan në të gjitha komunat dhe tanimë pothuajse nuk kalon java pa u zbuluar sasi e mishit të prishur nëpër marketet e qendrave të Kosovës. Duhet theksuar se të gjitha importet e produkteve ushqimore me origjinë bimore dhe shtazore, si dhe prodhimi i ushqimit vendor, në bazë të Ligjit për ushqim, obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë që të mbajë nën kontroll sigurinë ushqimore, që nënkupton ta kontrollojë cilësinë dhe higjienën e ushqimit, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të hanë ushqim të shëndoshë.

Por, një gjë e tillë nuk po ndodh. Ajo çka po ndodh me cilësinë e mishit të importuar në Kosovë është tepër shqetësuese dhe e rrezikshme për shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Aktualisht, Kosova importon sasi të larta të ushqimit për të cilat besohet se nuk i përmbushin kriteret minimale për cilësi dhe siguri, pra janë jashtë çdo norme të cilësisë. Në këtë kuptim, mallrat e ardhura në Kosovë besohet se prodhohen në linja të veçanta, të dedikuara për tregun e Kosovës. Me mungesë të funksionimit të institucioneve të vendit, sidomos Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe Doganave të Kosovës, vendi ynë Kosova është bërë poligon i futjes së

mallrave me cilësi dhe siguri ushqimore të ulët të ushqimit nga vendet fqinje dhe më gjerë duke e rrezikuar seriozisht shëndetin publik të qytetarëve tanë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë u themelua në vitin 2001, dhe që nga atëherë kjo agjenci nuk arriti të konsolidohet dhe ta kryejë detyrën e vet sipas ligjit, përkundër thithjes së mjaftueshme të fondeve. Madje, kjo agjenci edhe 17 vjet pas themelimit detyrohet t'i dërgojë mostrat e produkteve të ndryshme ushqimore për analiza jashtë vendit, që përbën një kosto shtesë për këtë agjenci. Që nga viti 2010, kjo agjenci e ka në krye një njeri, që si duket po arrin mirë t'i menaxhojë skandalet e njëpasnjëshme, që shkakton kjo agjenci.

Nuk kalon vit që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të mos jetë pjesë e ndonjë skandali. Kujtojmë sëmundjet gungore të gjedhëve, gruri i importuar për ushqim të kafshëve, fidanët e mjedrave të sëmura me kancer, mbi 400 mijë të tilla, qumështi pluhur, vaji i palmës, vezët industriale, mjalti industrial, misri me afat toksinë, pesticidet dhe tash së fundmi edhe mish i importuar nga Belgjika. Të gjitha këto janë produkte që servohen në tavolinën e çdo ekonomie familjare. Pra, të dashur kolegë, edhe familjarët tanë, fëmijët e juaj dhe fëmijët e mi ushqehen, në qytet apo në shtëpi, me këto produkte ushqimore.

Laboratori i mikrobiologjisë së ushqimit në Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë në vitin 2017 ka analizuar vetëm 350 000 mostra gjithsej. Ndërsa, në Kosovë hyjnë rreth 40 milionë kilogramë mish, 30 milionë prej tyre janë mish i bardhë i pulës, ndërkaq 10 milionë kilogramë mish gjedhi. Pra, kjo i bie që në çdo 100 tonë është bërë vetëm një analizë, është fjala vetëm për mishin. Përveç kësaj, në vitin 2017 kemi këto importe të produkteve ushqimore dhe që nuk është zhvilluar asnjë analizë e këtyre produkteve nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Zogj njëditorë hyjnë në vit rreth 2,3 milionë pa asnjë analizë në Kosovë. Mish peshku 1,2 milion kilogramë në vit pa asnjë analizë, gjedhe të gjalla 17 508 copë pa asnjë analizë, përveç atyre që zihen në kufi, që janë të obliguar pastaj t'u nënshtrohen analizave. Qumësht 30 milionë litra në vit, mjaltë 200 000 kilogramë në vit, vezë 2,7 milionë copë në vit, aditiv 4 milionë kilogramë në vit, ose 4 mijë tonë, kuptohet pa asnjë analizë. Të gjitha këto janë produkte që hyjnë në Kosovë pa asnjë analizë.

Të gjitha këto produkte hyjnë në Kosovë pa ndonjë kontroll për hormonet, të cilat mund të shkaktojnë çrregullime trupore, e as për toksina që helmojnë organizmin e njeriut dhe as për bakteret, që mund të shkaktojnë sëmundje te njeriu. Nga kompania e dyshimtë "Veviba" nga Belgjika janë importuar në vitin 2016 diku rreth 63 mijë kilogramë, ndërkaq Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë thotë se i ka zënë vetëm 20 mijë kilogramë. Këto janë shënime që i kam marrë nga Doganat e Kosovës për vitin 2016, që ka eksportuar kjo kompani mish në Kosovë, domethënë më shumë se 40 mijë kilogramë janë futur në tregun e Kosovës si mish i prishur.

Duhet të kujtojmë që edhe Komisioni Evropian në raportin e vitit 2016 për Kosovën përmend se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk është në përmbushje të detyrave që ka, duke theksuar se Kosovës i mungojnë standardet minimale dhe masat përmbushëse në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mirëqenies dhe mjedisit. Sot, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është në kompetencën e Kryeministrit, por i lë anash totalisht, duke mos kërkuar përgjegjësi nga ata. Pra, nga niveli i rëndësisë, ky institucione është njëra ndër agjencitë më të rëndësishme, madje mendoj se është më i rëndësishëm se sa AKI-ja, pasi lidhet me sigurinë nacionale të shëndetit publik të qytetarëve tanë, duke e mbuluar sektorin e ushqimit të importuar dhe vendor që në vlera ekonomike kap shifrën prej rreth 1,2 miliard euro.

Prandaj, është e papranueshme që përkundër rëndësisë për shëndetin dhe ekonominë e vendit, që për këtë institucion, edhe pas këtyre skandaleve, të mos kemi asnjë reagim nga Qeveria.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë bashkë me kolegët e mi, ju lusim që këtë temë ta trajtojmë me seriozitet të lartë dhe në fund t'i nxjerrim rekomandimet që e ndihmojnë këtë agjenci, që të konsolidohet plotësisht me pajisjet e nevojshme laboratorike, por edhe me kapacitete humane, profesionale e menaxheriale, të ndërgjegjshme e të vetëdijshme për rolin e këtij institucioni në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të Kosovës, por edhe të ekonomisë së vendit tonë.

Pra, unë kërkoj që ky menaxhment i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Bordi të shkarkohen, sepse nuk ka kuptim të ekzistojë edhe 17 pas luftës dhe në ende të ushqehemi dhe të mos mund të konsolidohen për t'i kontrolluar të gjitha ushqimet që hyjnë në Kosovë.

Ju lutem, nga mediet, për shembull, nëpër portale i gjeni 0,99 centë një kg. suxhuk, një kg. mish, ky nuk është produkt që duhet të konsumohet në Kosovë. Prandaj, nuk ka gjasa të prodhohet dhe për këtë arsye e kisha parë shumë të rëndësishme që me kujdes, të gjitha grupet parlamentare, të ulemi dhe t'i japim disa rekomandime që ta shpëtojmë edhe agjencinë, por edhe shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihu! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë që edhe si komision parlamentar i kemi ndërmarrë veprimet e mundshme sa na jepet mundësia ligjore. E kemi pasur edhe një inspektim në AVUK. Natyrisht që kontribuuesi kryesor i këtij opinionit, ose sensibilizimit të opinionit kanë qenë mediet, dhe jo institucionet tjera. Për të mos e kryqëzuar shumë AVUK-un dhe për shpjegim të opinionit publik, në 33 komuna të Kosovës janë vetëm 11 inspektorë. Do të thotë, është një gjendje jo e mirë.

Shumica prej laboratorëve, që i përmendi edhe profesor Salihu, janë donacione të Ambasadës gjermane, Ambasadës amerikane, por shumë pak janë të Kosovës. Sa i përket politizimit, që e dëgjova një kolege timen, më vjen keq, por, me sa e di unë, kryeshefin e AVUK-ut e ka emëruar Qeveria e kaluar dhe ai është ende. Por, nuk është mirë që ta kryqëzojmë atë personalisht. U tha më parë “kontrolli në kufi”, kontrolli në kufi bëhet me inspektimin e inspektorëve të AVUK-ut brendapërbrenda pikës kufitare. Këtu është një rrjet, sipas meje, i krimit të organizuar, që vjen prej pikës kufitare deri te marketet dhe, me sa di unë, edhe profesor Salihu, edhe vetë Besa e dinë që ka raste në Prokurori që janë duke u hetuar një numër shumë i madh, qoftë i trafikantëve, qoftë edhe i atyre që i kanë ofruar në treg.

Më lejoni veç të ju ofroj disa statistika. Vetëm për vitin janar-mars 2018 janë asgjësuar 81 mijë kilogramë produkte ushqimore të natyrave të ndryshme, janë asgjësuar mbi 80 mijë kilogramë mish i kuq, kemi me mijëra kilogramë mish të bardhë, të gjitha këto të konfiskuara dhe të gjitha këto janë në institucione përkatëse të hetuesisë. Ka pasur rreth 11 mostra që kanë shkuar në laboratorë të ndryshëm, prej tyre 1 477 kanë dalë që nuk i plotësojnë kushtet për të qenë në treg. Është e vërtetë që kanë tentuar, sidomos këtë vit të bëjnë diçka, por gjendja nuk është hiç e kënaqshme. Pyetja kryesore është, çka nëse e ndërrojmë menaxhmentin? A mund ta arrijmë qëllimin tonë të përbashkët?

Në bazë të informatave që i posedojmë, Kosova ka kapacitet ta mbajë veten me mish të kuq vetëm 31 ditë, e i bie që 11 muaj të tjerë e marrim jashtë. Krejt ato pamje që i pamë, që i tregoi edhe profesor Salihu, janë të vërteta dhe nuk ka logjikë sot në tregun e Kosovës të jetë 1 euro kilogrami i mishit. Do të thotë, ne vetë duhet ta kuptojmë se çfarë gjendje e kemi.

Në fund, profesor Salihu nuk e tha edhe një detaj. Ne akoma në vitin 2017/18 nuk e kemi as Ligjin e bukës. Ne blejmë bukë, por nuk e dimë sa peshon ajo bukë. 1 kg i themi, por s’është e vërtetë, as 400 gramë s’i ka. E të mos flasim për cilësinë, që me të vërtetë duhet ndërmarrë masat. Në fund të kësaj seance unë kisha apeluar edhe te kolegët e mi, që janë edhe anëtarë të komisionit, ta bëjnë një draft, një propozim, të vijmë në konkludime, ta nxjerrim një rezolutë dhe t’i obligojmë institucionet që të ndërmarrin masa urgjente në këtë drejtim.

Ju e dini që e kemi pasur një situatë jo të kënaqshme, sidomos në regjionin e Dukagjinit, siç është quajtur ajo e famshmja “gongola” a si quhet, ju e dini më mirë, që i ka shkaktuar shumë probleme regjionit, e besa ndoshta edhe në nivel Kosove dhe u ka krijuar hapësirë edhe atyre kontrabanduesve ilegalë që të sjellin produkte jocilësore në tregun tonë. Tash nuk e di se çfarë ka qenë gjendja në vitin 2015, 16, ose 17, por këto statistika të vitit 2018 janë shqetësuese në rast se vetëm për tre muaj janë asgjësuar 80 mijë kilogramë mish. Do të thotë, duhet urgjentisht ndërmarrë masat dhe në të njëjtën kohë dua të ju them edhe një gjë publikisht, kemi me qindra denoncime te Ministria e Bujqësisë, te dikasteret e granteve dhe subvencioneve, të cilat asnjëherë nuk janë transparente, asnjëherë nuk bëhen publike, asnjëherë nuk dihet se kujt ia japin, edhe

nëse ka hetuesi, publikisht i bëj thirrje që të shkojnë e t'i hetojnë dhe t'i shohin çfarë janë duke bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Si deputet, në emër të Nismës për Kosovën, këtë çështje e kam trajtuar më 30 nëntor 2016. Mua më vjen keq që ne vetëm kur ndodhin skandalet që lidhen me Kosovën dhe bëhen të mëdha në Perëndim, atëherë merremi më seriozisht.

Unë qysh në nëntor të vitit 2016 e kam ngrehur këtë shqetësim dhe unë do t'i citoj disa nga fjalët e mia që i kam thënë atëherë, konsumimi i produkteve me afat të skaduar e vë në pikëpyetje shëndetin e qytetarëve, nga ç'gjë edhe rrjedhin shumë sëmundje kancerogjene. Po më vjen keq që dy vjet më vonë, nga kolegët po përsëriten me të drejtë këto shqetësime.

Atëherë iu pata referuar disa titujve të medieeve që shkruanin për mishin me afat të skaduar dhe thënë të drejtën, njëri nga këta protagonistë të këtyre produkteve të skaduara ishte zëvendësministër, kështu që mbeti në heshtje. Atëherë iu pata referuar medieeve dhe po i citoj edhe tash. Është gjetur në ETC mish pa afat, të cilit nuk i dihet prejardhja, pata thënë. 20 tonë mish gjedhi është bllokuar në Vërmicë, pasi është tentuar të futet ilegalisht në Kosovë. 20 tonë mish pule ndalohen të hyjnë në tregun e Kosovës. Zbulohet depo ku ndërrohet afati i produkteve të mishit. Ishin disa nga fjalët e mia, me të cilat u jam referuar medieeve që kanë shkruar më 2016.

Mirëpo, thënë të drejtën, gjithë këto shqetësime që i kam ngrehur atëherë kanë hasur në vesh të shurdhër. Druaj se edhe ky debat edhe rezoluta eventuale me rekomandimet që mund të dalin nga kjo seancë mund të hasin në vesh të shurdhër, sepse importuesit e produkteve të dyshimta dyshoj se janë të lidhur me personat përgjegjës nëpër institucione, të cilët jo që nuk kanë ditur se si është gjendja me mishin me afat të skaduar dhe produktet tjera.

Unë pres nga Instituti për Mbrojtjen e Shëndetit Publik të dalë me statistika më të qarta për opinionin dhe për institucionin dhe t'u ofrojë institucioneve kompetente të dhëna se cilat janë ato sëmundje shqetësuese që i kanë kapluar qytetarët e Kosovës nga produktet me afat të skaduar dhe produkte të dyshimta. Në njërin nga seancat e mëhershme kam folur edhe për vajin e palmës, vaj i cili përdoret në shumë produkte në Kosovë dhe që tashmë nuk është ndonjë zbulim epokal, sepse nga ky produkt i dyshimtë rrjedhin sëmundje kancerogjene, për të cilat një kolegj foli edhe me shifra të sakta për këtë sëmundje që e ka kapluar Kosovën.

Unë në njërin nga seancat e mëhershme kam folur edhe për përdorimin e narkotikëve, që e përbën edhe një shqetësim shtesë në gjithë gamën e shqetësimeve që ka qytetari i Kosovës dhe që ne me të drejtë duhet që, përpos t'i diskutojmë, t'i trajtojmë dhe t'u bëjmë zgjidhje.

E përmenda edhe çështjen e përdorimit të narkotikëve, sepse druaj që në një periudhë të afërt do të kemi seancë të jashtëzakonshme dhe do të flasim e të kërkojmë rezoluta dhe vendime lidhur me këtë preokupim qytetar, prandaj kisha kërkuar nga institucionet, nga personat përgjegjës, kudo që janë, që seriozisht t'u kthehen punëve të veta dhe t'u kthehen çështjeve shqetësuese të qytetarëve dhe t'i lënë politikat e mëdha, sepse nën hijen e politikave të mëdha shumë probleme që kanë qytetarët kanë mbetur në hije dhe kostoja është gjithmonë në kurrizin dhe në lëkurën e qytetarëve.

Mendoj se sa u përket produkteve të mishit duhet të bëhet një strategji e Qeverisë, që subvencionet nga Ministria e Bujqësisë të shkojnë në adresa të cilat e ofrojnë kultivimin e blegtorisë, kështu që të mos bëhemi shumë të varur edhe prej vendeve aziatike për këto produkte, sepse koha po tregon se shumë produkte që vijnë nga vendet e huaja janë produkte të dorës së tretë apo të katërt, kështu që ne si shoqëri po e pësojmë dhe pësimi e ka një kosto edhe buxhetore, sepse nga produktet me afat të skaduar po rrjedhin shumë sëmundje dhe nga sëmundjet pastaj po atakohet, përpos buxhetit të familjeve, edhe buxheti i shtetit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka Duda Balje, prej Grupit Parlamentar "6+".

DUDA BALJE: Zahvaljujem predsedavajuća!

Poštovane kolege,

Nakon dobijene informacije iz medija o svemu što se dešavalo vezano za meso i produkte mesa, Komisija za ljudska prava održala je niz sastanaka na ovu temu i dobili smo veoma veliki broj informacija direktno od kompetentnih ljudi, koji su bili povezani sa ovom problematikom.

Ubrzo posle alarma koji se desio na medijima, posetili smo Agenciju za veterinu i razgovarali direktno sa samim direktorom. Posle tog sastanka, ono što je bilo jasno jeste da je direktor odgovorno tvrdio da nijedan kilogram mesa sa pređenim rokom nije ušao na Kosovo, i naravno žalio se na jako mali broj inspektora, negde 10, 11, koji rade na centralnom nivou, i izneo zahtev da mu se pomogne da se inspektori sa lokalnog nivoa transferišu na centralni, kako bi se posao olakšao.

Dojam sa tog prvog sastanka bio je takav da se nekako krivica prebacivala na biznis subjekte. Zbog toga smo ubrzo odlučili da kao komisija, s obzirom na to da smo konstatovali među sobom da je došlo do kršenja ljudskih prava, jer se na stolovima stanovnika Kosova nalazilo meso i

produkti od mesa, koji nisu bili adekvatni za ishranu, organizovali smo jedan okrugli sto, na kome smo pozvali sve subjekte, znači i biznis subjekte, i carinu, i centralne inspektore, i lokalne inspektore, svi smo bili na jednom mestu i debatirali na ovu temu. Bilo je evidentno da su se loše stvari desili, bilo je evidentno da ne postoji dobra saradnja između biznis subjekta i inspektora na lokalnom nivou. Naravno, svako ju tom momentu branio sebe.

Ono što hoću da kažem da su zatvorene fabrike u opštini Prizren, koja se tretira kao jedna od opština na Kosovu, koja se najviše bavi mesnom proizvodnjom, zatvorena su četiri fabrike u tom momentu dok smo mi imali taj sastanak, i bilo je jasni da je sud uzeo u obzir i da će vršiti istraživanje onih ljudi, koji su napravili takvu vrstu nepravde prema stanovnicima Kosova.

Ono što želim da podvučem jeste da smo na tom sastanku imali i veoma veliki broj firmiša i fabrikanta, koji se bave preradom mesa i koji poseduju jako dobre fabrike, koji su uložili i koji nisu nikad vršili ovakvu vrstu nepravde, i mislim da njima dugujemo izvinjenje, s obzirom na to da je ovakva vrsta hajke medijske pokrenuta i da je to naravno, da se to dotiče njih i da se naravno žale da im je prodaja jako opala.

Trebamo biti svesni da nismo možda ovde dovoljno kompetentni da sudimo. Opet podvlačim, jeste da se desilo skandal, ako to možemo tako da definišemo, ali trebamo biti oprezni prema domaćim proizvođačima i domaćim firmišima, koji vrlo savesno obavljaju svoj posao.

Ja se nadam da će sud do kraja završiti posao onako kako treba, i da oni koji su prekršili zakon i uvredili trpezu kosovara, odgovarati adekvatno, a takođe se nadam da će naši firmiši i fabrikaši koji se bave preradom mesa ne ometano moći dalje da nastave onako kako su radili i do sada, i mislim da trebamo raditi dosta na tome da Kosovo povрати poverenje u domaće proizvode, jer da budem iskrena, stvarno postoje ljudi koji dobro i savesno obavljaju svoj posao, i kome trebamo mi potrošači Kosova i stanovnici Kosova ukazati poverenje. Hvala!

KRYESUESJA: Hvala, Duda! Fjalën e ka deputeti Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha të kontribuoj pak në diskutimin për çështjen që është shumë me rëndësi dhe u ngre këtu.

Brenga ime kryesore për fillim kishte për të qenë që ky skandal u prezantua nga mediet, që nuk do të thotë se ka ndodhur tash dhe se kjo problematikë është e tanishme, por është dashur të shpërthejë në medie dhe të bëhet problem, që të diskutohet edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Çfarëdo që të them, unë i përsëris kolegët e mi që diskutuan më herët, por dua t'i theksoj disa çështje rreth cilësisë së ushqimit që konsumojmë ne në Kosovë. U fol shumë për vajin e palmës, duhet të themi se përdoret si ushqim, edhe në vendet tjera është i lejueshëm, por është i lejueshëm në përmasa të kontrollueshme dhe të caktuara. Është shumë e thjeshtë të zbulohet dhe të evidentohet se kush janë importuesit më të mëdhenj të vajit të palmës në Kosovë dhe cilat industri, ose cilat biznese prodhojnë ushqim e që mund ta përdorin vajin e palmës si përbërës.

Meqenëse u tha që Inspektorati Sanitar dhe ai i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë është në numër shumë të vogël, atëherë të fokusohen te importuesit më të mëdhenj dhe te prodhuesit që e përdorin dhe do të gjendet saktë se sa përdoret vaji i palmës në kondita të lejuara. E them edhe një herë, e përsëris që lejohet, por lejohet në kondita të caktuara dhe në sasi të caktuar.

U përmend këtu edhe cilësia e bukës. Shtrohet një pyetje tjetër, një çështje, si është e mundur që një kilogram miell të kushtojë 60 centë, e shpesh diku-diku u tha që buka kushton 15 centë, që mund të blihet me 15 centë. Shtrohet pyetja sa ka miell në atë bukë? Sa është përqindja e aditivëve, që i shtohen bukës si prodhim final që e konsumojmë? Ka informacione që doza e aditivëve mund të jetë mbi 75 herë më e madhe sesa e lejuara.

Kur jemi te industria e bukës, unë si konsumues, si gjithë të tjerët, sepse shumë pak po e shfrytëzojmë të bëjmë bukë në shtëpi, e shoh shpesh që nuk respektohen as masat elementare sanitare gjatë ofrimit të shërbimit në furrat e bukës, shto këtu mungesën gjithëherë pothuajse të kontrolleve të punëtorëve që punojnë aty dhe të përdorimit të dorëzave, ose mjeteve tjera që do të garantonin pastërtinë e produktit që ofrojnë.

Gjithashtu u tha që dhe është për t'u brengosur shumë që numri i inspektorëve në të gjitha komunat në Kosovë është tejet i vogël, bile-bile meqenëse u tha këtu një shifër, ajo mezi po kaluaka në shifra dyshifrore. Plus percepticioni është që edhe po flitet që pothuajse të gjithë janë të korruptuar. Përpos numrit të vogël, këta inspektorë janë të detyruar që në vazhdimësi të shkojnë nëpër gjykata të ndryshme për t'i mbrojtur gjobat e tyre që ua shqiptojnë bizneseve. Pra, janë të pamundësuar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke shkuar nëpër gjykata dhe duke i mbrojtur vendimet e tyre të mëhershme.

Do të shtroja pyetjen, pse të gjeturat, ose pse gjobat që u shqiptohen bizneseve nuk bëhen transparente? Sikur të bëheshin transparente, atëherë sigurisht se konsumatori vetë do të ndërmernte masa që t'i ndëshkonte të gjitha bizneset që nuk kanë kujdes në ofrimin e shërbimit, respektivisht të ushqimit cilësor.

Ne jemi dëshmitarë që edhe duhet të inspektohen patjetër edhe lokalet që ofrojnë ushqim të gatshëm, të cilin e konsumojnë qytetarët e Kosovës. Ka shumë lokale të cilave u ndalet uji dhe

nuk kanë burim alternativ të ujit, e ofrojnë shërbim, ofrojnë ushqim. Bile-bile ka edhe më drastike, skandaloze të themi, kur ka biznese që ofrojnë shërbim dhe nuk kanë nyja sanitare.

Unë do të ngrehja edhe një çështje që e dëmton shumë shëndetin, e qytetarëve e që shpesh e kemi diskutuar edhe këtu, edhe në instanca tjera, çështja e duhanit. Unë nuk po dua të hyj në atë sesa respektohet dhe qysh Ligji për kontrollin e duhanit, por vetëm po e them një çështje që është shumë brengosëse. Ka biznese tregtare, afër shkollave që i ndajnë pakot e cigareve dhe ua shesin nga një cigare fëmijëve tanë. Pra, janë rekrutues direkt të duhanpirësve, ndajnë nga një cigare e ua shesin fëmijëve.

Natyrisht që kjo seancë, ky diskutim, është ngritur për cilësinë e mishit, por nuk mund të ndahet vetëm cilësia e mishit nga krejt ajo se çka po ndodh me cilësinë e ushqimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Radhën e ka Luljeta Veselaj-Gutaj. Pse replikë, a ta ka përmendur emrin. Dy minuta i ke për replikë.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese, për mundësinë që ma dhe të replikoj. Nuk dua të replikoj me atë qëllimin e mirëfilltë, por dua të sqarohem për atë sa i përket dhe duke pasur parasysh që i nderuari ka qenë edhe ministër i Shëndetësisë dhe është mjek, e unë e di që sidomos mjekët flasin me analiza e nuk japin receta veç sa të thuhet kështu, po më dhemb barku, po ia shkruaj një recetë, ose po më dhemb koka, apo diçka. Është mirë të ketë raporte të inspektorateve, inspektorate në Kosovë ka shumë, sidomos në nivel komunal, po edhe në nivel të Qeverisë, e nuk përkujtojnë ato që i tha i nderuari paraprakisht që 75 herë ka më shumë aditiv në ato që parashihet brenda bukës.

Po të kishte 75 herë më shumë aditiv, unë jam shumë i sigurt se jo vetëm banorët e Kosovës që ushqehen në këto furra, po ndoshta edhe fqinjët përreth, të shteteve përreth, do të shkonin te mjekët apo do të kishin pasoja shëndetësore. Kështu që është mirë të ketë fakte dhe argumente.

Po ashtu, të gjithë punëtorët që punojnë u përmbahen të gjitha kritereve që parashihen edhe në aspektin shëndetësor, të gjithë kanë kontrollime sistematike. Po, në anën tjetër, po dua të them që sot nëse i shihni furrat, janë më të mira se institucionet e Kosovës, janë më të pastra se institucionet e Kosovës, edhe se barnatoret, edhe si klinikat që punojnë mjekët aty. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kundër-replikë, fjalën e ka Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Unë thashë që kam informacione, mund t'i kem të gabueshme. Ti, zoti deputet, nëse i ke të sakta, na thuaj sa është më tepër sesa që është e nevojshme dhe e lejueshme?

Po unë e ngrita çështje, si është e mundshme që me 60 centë kilogrami i millit, të blihet buka për 15 centë. Sa është aditivi që shtohet?

Unë kam qenë ministër i Shëndetësisë dhe kam udhëhequr edhe Këshillin Nacional për Ligjin për kontrollin e duhanit, dhe e di se çka kanë diskutuar aty inspektorët e AVUK-ut që janë pjesëtarë, edhe inspektorët sanitarë që janë pjesëtarë të atij këshilli dhe cilat janë shqetësimet që ata i kanë ngritur në atë këshill.

Edhe ato çka po i them janë më të sakta, edhe për duhanin, por e ngrita dilemën për bukën. Nëse ju keni informata të tjera, na i thoni këtu.

Po unë e di që numri, u tha këtu edhe në ekspozenë ose në fjalimin e propozuesit për debat që numri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Për hir të korrektësisë pajtoj me kolegun që e ngriti shqetësimin, kolegu mjek atje, e di që janë çështje profesionale, ndoshta nuk ishte dashur të përgjigjem e të hyj në këto çështje, po ndoshta është me interes pak, bile t'i dimë këto sende.

Një kilogram miell kushton në Kosovë 25 centë, ndërkaq është problemi që nga një kilogram miell krijohen tri bukë, sepse një kilogram miell ndahet nga 333 gramë dhe rrjedhimisht 50% shkon ujë dhe buka në fund, si produkt final, del diku 400-450 gramë. Çka do të thotë se furrarët nga një kilogram miell 25 cent, i nxjerrin tri bukë që i shesin nga 20 centë, 60 centë.

Ndërkaq sa u përket aditivëve, diku rreth 4 mijë tonë aditiv hyjnë në Kosovë në vit, ndërkaq konsumi vjetor i Kosovës është 400 mijë tonë grurë, që i bie se 10% përdoret aditiv që është një sasi tepër e madhe. Aditivët e rritin vëllimin e bukës për të krijuar një përshtypje se buka është e madhe, ndërkaq pesha është shumë e vogël.

Faktikisht është një farë lloj mashtrimi te konsumatori, sepse kur i qet shumë aditiv, e rrit vëllimin e bukës, ndërkaq pesha është shumë e vogël, buka në Kosovë shitet me njësi dhe qytetari e blen si një bukë, po e blen një bukë që ka 400 gramë, jo një bukë që i ka 700 gramë.

Për këtë ne kemi iniciuar një projekt-propozim të një ligji për t'i caktuar ato farë standarde sa do të ketë peshë buka minimale të shitet në Kosovë dhe çfarë vëllimi duhet të ketë, në mënyrë që të mos mashtrohet më tutje konsumatori. Këtë desha ta them, kërkoj falje ndoshta që interferova mes jush. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Luljeta, urdhëroni! Të lutem Luljetë, Imet Rrahmani, një minutë e ke.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, koleg Salihu!

Edhe diskutimi im, edhe shqetësimi ishte në fushën bash ku e përmendët ju dhe e cekët. Unë nga aspekti shëndetësor them që masat, ju e thatë, e vërtetuat, janë më shumë se të lejueshme te aditivëve në bukë dhe janë të dëmshme. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESJA: Urdhëro, Luljeta!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: E nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë situata e krijuar në opinionin publik për produktet e mishit të prishur që e ka kapluar tërë vendin javët e fundit nuk është vetëm alarmante, por është më shumë se kaq, më shumë se shqetësuese e dëshpëruese, sepse kemi të bëjmë drejtpërdrejt me rrezikimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Personalisht si qytetare, në radhë të parë, por edhe si deputete jam e shqetësuar tej mase me vetë faktin se ky rast e vë në lajthitje shumë të madhe zbatimin dhe zbatuesit e ligjit lidhur me produktet dhe të drejtën e konsumatorit.

Ditë më parë, ashtu siç e tha edhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, bashkërisht edhe me anëtarët e komisionit kemi zhvilluar një tryezë diskutimi bashkë me përfaqësuesit e bizneseve të produktit të mishit dhe kryeshefin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë lidhur me cilësinë dhe sigurinë e këtij produkti në vend.

Nga Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë kemi pasur deklarime se nuk është lejuar hyrja e mishit të prishur në Kosovë dhe produktet e mishit në Kosovë janë të sigurta.

Po sipas kësaj agjencie, në gjithë territorin e Kosovës ka pasur inspektim të mishit në mënyrë sistematike dhe inspektorët kanë zbuluar dhe kanë ndaluar produktin, i cili pa pretenduar të futet në Kosovë nga kompania “VEVIVA” me seli në Belgjikë.

Në anën tjetër, nga mediet e ndryshme po thuaj se çdo ditë kemi parë se janë publikuar pamje të ndryshme të mishit të prishur në markete të ndryshme, në thertore, në fabrika të ndryshme, në qytete të ndryshme të Kosovës.

Dëshmitë e deritashme, edhe këtu në këtë seancë gjatë diskutimit, po edhe nga informacione të ndryshme tregojnë se deri tash kemi statistika të produkteve të prishura dhe statistika, të cilat na sjellin në nivel të lartë rrezikun nga produktet e mishit të skaduar në vend.

Ajo çka më intereson mua, besoj edhe secili qytetar i Kosovës, është të dinë të vërtetën rreth cilësisë dhe sigurisë së ushqimit që konsumojmë çdo ditë në tryezat tona dhe në familjet tona.

Për t'ua argumentuar qytetarëve të vendit tonë se institucionet përgjegjëse kanë marrë masa të duhura ndaj këtyre kompanive, të cilat kanë punuar në mënyrë të parregullt dhe të paligjshme, është shumë e rëndësishme të dalin listat publike të firmave, të cilat kanë bërë shkelje ligjore duke sjellë produkte më afat të skaduar qoftë nga mishi apo edhe produkte të tjera ushqyese, të cilat janë konsumuar nga qytetarët.

Po ashtu, mendoj se në qoftë se bëhen publike listat e këtyre firmave, ne do t'i fuqizojmë bizneset e produkteve vendore të mishit dhe të produkteve të tjera në vend, të cilat punojnë në mënyrë të rregullt dhe të përgjegjshme, sepse duke folur me të përgjithshmen, ne po i dëmtojmë edhe ato biznese dhe firma vendore, të cilat me të vërtetë punojmë me përgjegjësi.

Një rekomandim tjetër që ka dalë edhe si kërkesë e agjencisë, po edhe përfaqësuesve të cilët merren me produkte vendore të mishit, është që të shtohet numri i inspektorëve në nivel qendror dhe në nivel lokal.

Unë besoj shumë se në fund të kësaj seance, ne të gjithë bashkërisht duhet të dalim me një rezolutë dhe me rekomandime konkrete, të cilat do të gjejnë zbatim në institucionet përgjegjëse. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Adem Mikullovc. Urdhëroni!

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, kryesuese!

I përshëndes të gjithë deputetët,

I përshëndes ministrat kudo qofshin në këtë moment, e që nuk janë në sallë.

T'ju thënë të drejtë, duke i dëgjuar këto diskutime, po më kap tmerrri dhe po frikohem: a thua, çka po hamë e çka do të ndodhë me neve?

Në një moment mendova se s'ka mbetur tjetër, pos të ha bukë thatë. Mirëpo doli doktori dhe tha që edhe drithi blihet nga Serbia, është i skaduar, është ushqim për shtazë dhe atë bukë po e hamë ne.

Unë mendoj që nuk do të humbim shumë kohë rreth diskutimeve, duke numëruar të gjitha të metat, të gjitha trazirat, të gjitha, si të them, kriminalitetin që po ndodh me ushqim. Po sa më

parë ta marrim një rezolutë, një rekomandim urgjent, t'i drejtohem Qeverisë me kërkesë urgjente që të shtohet numri i kontrollit, numri i inspektorëve e çka di unë që kjo punë një herë e përgjithmonë të pastrohet.

Kjo është më e rrezikshme dhe më urgjente se sa demarkacioni, se sa komunat e Asociacioni i komunave serbe e sa formimi i ushtrisë. Kaq desha të them.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Çaushi.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kolegë deputetë,

Është shumë e rëndësishme që ky debat po bëhet sot në Kuvendin e Kosovës për shkak se mendoj që gjendja në të cilën ndodhet siguria e shëndetit publik jo vetëm sot, po kisha thënë lirisht gjatë gjithë periudhës së pasluftës, do të duhej të përbënte një situatë të jashtëzakonshme në secilin vend, ku do të kishim institucione serioze të shëndetit publik, mirëpo edhe ato siç janë, ato që trajtojnë epizotitë, shëndetin e kafshëve dhe parandalimin e shpërndarjes së sëmundjeve zootike.

Do të ishte shumë e gabuar që apriori të merrnim në mbrojtje Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, duke u thirrur në skandalin e mishit të importuar nga Belgjika, për shkak se nëse e shohim në vazhdimësi punën e kësaj agjencie, ky do të mund të ishte i vetmi sukses gjatë mandatit të kryeshefit aktual, po them, edhe pse i kaluar nuk ka qenë fare më i mirë, pra në tetë vjetët e fundit.

Për shkak se këtu u dhanë disa argumente, bile edhe fjalë mirënjohje për parandalimin e hyrjes të kësaj sasive të mishit, unë do të shmang atë që kisha në plan të them për mishin, do të përmend ose do të rendis disa probleme të tjera që do të përbënin arsye të mjaftueshme që menaxhmenti aktual shumë vjet më parë të mos ishte në detyrën e tij.

Po filloj nga disa sëmundje, të cilat janë zootike, pra po transmetohen te njerëzit nga kafshët dhe të cilat i kemi të pranishme, ku nuk kemi pasur asnjë sukses në çrënjosjen e tyre, siç ka bërë pjesa më e mirë e kontinentit të Evropës dhe në parandalimin e transmetimit te njerëzit.

Kemi sëmundjen e brucelozës, ka çdo vit dhjetëra pacientë që vuajnë nga kjo sëmundje, ata që mund të kenë informacione, e dinë që është sëmundje jo lehtë e trajtueshme, pra merr të paktën tre muaj trajtim, e në raste të rënda mund të ketë pasoja të përhershme të sterilitetit, probleme nervore, kockat, e të tjera.

Ekziston një udhëzim administrativ që agjencia do të duhej të shpallte zona të lira nga kjo sëmundje dhe kjo nuk ka ndodhur, edhe pse për vite me radhë nga viti 2004 miliona euro

shpenzohen në vaksinimin dhe asgjësimin e kësaj sëmundjeje. Pra nuk kemi pasur asnjë sukses të dukshëm, përderisa sëmundja gjendet te pacientët në spitale të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Ngjashëm ndodh me tuberkulozin, ke kemi rënie të tuberkulozit, mirëpo shkalla është prapë shumë e lartë, janë mbi 700 pacientë në vit nga tuberkulozi, e dimë që një prej burimeve të tuberkulozit është gjedhi, është mish i gjedhit. Por, kjo nuk mund të parandalohet, kur nga agjencia nuk kemi asnjë të dhënë të saktë për thertoret, pra për mishin që prehet në thertoret tona, se sa kontrollohen për sëmundjen e brucelozës. Është shumë e lehtë e identifikueshme kur e kontrollojmë një kadavër, ose një kafshë pas therjes, mirëpo kjo nuk ndodh, pra janë mbi 50 thertore të licencuara, ku nuk ka kontroll dhe ky mish përfundon në treg.

Tjetra, çdo mbetje nga thertoret aktuale të licencuara dhe sigurisht të palicencuara përfundon në deponitë e zakonshme anembanë Kosovës.

Pra, e dini që kemi problem me qentë endacakë, kjo i bie që këto sëmundje lirisht pa asnjë pengesë shpërndahen te të gjithë, në të gjitha pjesët e Kosovës, e dimë që deponitë e zakonshme kur ka reshje të shiut bartin këta shkaktarë dhe këto mikrobe në ujëra nëntokësorë, të cilët përfundojnë në ujëra të pijshëm përfundimisht pa asnjë masë parandalimi.

Kemi sëmundje që, e kam thënë edhe pra dy dite, në Bashkimin Evropian konsiderohen si ekzotike, ashtu quhen për shkak se përveç të dhënave teorike nga shekujt e kaluar, nuk kanë njohuri për shkak se janë çrrënjësuar dekada më parë, të tilla i gjejmë në Kosovë.

Nëse do të kishim një funksionim të mirë të institucioneve të shëndetit publik dhe institucioneve hulumtuese, besoj që lirisht, përveç se do të shpallnim një gjendje të jashtëzakonshme, do të konstatojmë se të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe ne, përballemi me armë biologjike.

Tash pse nuk trajtohet kështu, e dhashë një arsye, nuk kemi të dhëna të mira nga institutet hulumtuese dhe arsyeja kryesore besoj është se për dallim prej toksinave vdekjeprurëse të menjëhershme, pasojat që vijnë nga kjo mungesë e kontrollit dhe mungesë e parandalimit marrin vite. Shumë nga këta shkaktarë, mikrobe, toksina, hormone, antibiotikë, kanë pasojat që i shohim pas 10 a 20 vjetëve ose më tepër.

Mirëpo, kur e kemi këtë informacion, atëherë besoj që duhet të bartin përgjegjësinë dhe ta trajtojmë ashtu si e meriton këtë situatë.

Pra, do të ishte e padrejtë që kjo që u shpërfaq me mishin e importuar, të kalonte pa asnjë masë nga një institucion, i cili bart peshën më të madhe të përgjegjësisë, i cili ka dështuar në çdo aspekt në funksionin e tij.

Një problem tjetër që prapë do të përbënte arsye për shkarkimin e këtij menaxhmenti para shumë vitesh janë aflatoksinat, besoj ju kujtohen skandalet me aflatoksina.

Ka pasur nja 3-4 raste kur janë ndaluar këto produkte, mirëpo asnjëherë për shkak se janë identifikuar nga Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë. Ka qenë rasti i aflatoksinave në vitin 2013 në qumësht, kujtoj aflatoksinat janë substanca kancerogjene me potencial shumë të fortë, konsiderohen tepër të rrezikshme.

Në vitin 2013 janë identifikuar në qumësht nga autoritetet boshnjake, pastaj janë parandaluar ose janë larguar nga raftet në Kosovë.

Në vitin 2014 janë identifikuar nga autoritetet gjermane, janë larguar nga misri në Kosovë.

Më vonë kemi pasur raste prapë me biskota të ndryshme të produkteve serbe, janë identifikuar në Serbi, domethënë agjencia ka luajtur vetëm rolin e njëfarë polici ose njëfarë inspektori, pa dije profesionale dhe vetëm ka bërë largimin e përkohshëm të këtyre produkteve nga tregu.

Problemi i antibiotikëve nuk ka kontroll mbi sasinë e antibiotikëve në ushqim.

Në Bashkimin Evropian, ku kontrolli është shumë i rreptë, në viti janë mbi 20 mijë raste fatale nga rezistenca ndaj antibiotikëve.

Pra, për shkak të konsumit të antibiotikëve me anë të ushqimit, bakteret krijojnë një rezistencë të antibiotikët, nuk funksionojnë më.

Ballkani është vendi me antibiotik-rezistencën më të lartë, besoj Kosova ka më të lartën në Ballkan për dy arsye, një se s'kemi asnjë kontroll nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për antibiotikë në ushqim dhe, e dyta, për shkak se fatkeqësisht ende lejohet që secili nga ne të blejmë antibiotikë dhe kështu i plotësojmë dy kushte ideale për antibiotikë-rezistencë.

Kemi raste të pacientëve nga Kosova, ju kujtohet kirurgu Riza Binishi, po me siguri shumica nuk identifikohen, të cilët përfundojnë me infeksione shumë të lehta fatale, për shkak të rezistencës ndaj antibiotikëve.

Nuk kemi asnjë kontroll mbi hormone, një pjesë e madhe e mishit që vjen, po kthehem tash te mishi që vjen nga Brazili, dihet që është vend që pa pengesa të mëdha ligjore përdor hormone.

Në SHBA nuk ka rregullim të tillë, në SHBA edhe mish ose në ushqimin e kafshëve përdoren antibiotikët, përderisa në Bashkimin Evropian janë të ndaluara.

Nuk kemi asnjë kontroll mbi pesticidet, nëse bëni një hulumtim të thjeshtë, do të shihni se fermerët tanë fatkeqësisht në masë të madhe përdorin në shumë raste shumëfishin e pesticideve të lejuara. Mirëpo, nuk kemi asnjë ide as nga mallrat e importuara se sa është përqendrimi i pesticideve, të cilët normalisht në Bashkimin Evropian janë të rregulluara.

Unë besoj ka diku një vit e gjysmë që në rastin e sëmundjes gungullore kam kërkuar një trajtim më serioz nga ky institucion, po edhe nga Qeveria për punën që mendoj që ka pasoja të vetëdijshme ose të pavetëdijshme kriminale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, fatkeqësisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Faleminderit që po e kryeson seancën dhe po na thirr më shpesh ne grave të flasim, se zakonisht na lënë kah fundi, se duhet të flasim burrat në fillim.

Mishi dhe produktet e tij që vijnë në Kosovë, kryesisht nga SHBA-ja, Bashkimi Evropian dhe Brazili, duhet të kontrollohen sipas standardeve të BE-së.

Çdo ngarkesë e importuar me mish dhe produktet e mishit duhet t'i nënshtrohet kontrollit të inspektorëve veterinarë në kufij.

Së pari, duhet të fillojë procedura e kontrollit që dëshmon sigurinë e produktit për konsum, pastaj duhet të fillojë kontrolli i identitetit, krahasimi i dokumentacionit me mallin e deklaruar në ngarkesë.

Ndërsa faza e tretë është kontrolli fizik dhe analizat laboratorike.

Pas tërë këtij kontrolli, inspektorët duhet të marrin mostrat për analiza laboratorike, e në rast që analizat nuk dalin në rregull, produktet nuk duhet të lejohen të shiten.

Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë në të gjitha rastet kur has në produkte të dyshimta duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme, duke bërë edhe asgjësimin e tyre.

Po ashtu, të gjitha bizneseve, të cilat kanë tentuar të shesin produkte të dyshimta, duhet t'u dërgohen fletëparaqitjet në gjykatë.

Thertoret, nga të cilat lejohet importi për në Kosovë, duhet të jenë të licencuara dhe të aprovuara nga Bashkimi Evropian, çka do të thotë, nëse një prodhues i mishit nuk ka licencë për eksport në BE, nuk mund të eksportojë as në vendin tonë.

Mirëpo, ajo që është e evidente te kosovarët është mungesa e vetëdijesimit të qytetarëve për të paraqitur rastet kur ata hasin në produkte të dyshimta.

Shpesh ndodh që kompanitë, të cilat importojnë produkte nga vende të ndryshme të rajonit dhe të Bashkimit Evropian, nuk janë të interesuara për cilësi dhe siguri, po vetëm për përfitime materiale.

Në Belgjikë javët e fundit ka shpërthyer skandali në lidhje me cilësinë e mishit që konsumojnë qytetarët. Pas zbulimit se firma "Veviba", një nga furnizuesit më të rëndësishëm, ka funksionuar në kushte të papranueshme sanitare dhe ka manipuluar me përmbajtjen e mishit.

Ky skandal ka prekur edhe shumë vende të Evropës, që dyshohet se kanë konsumuar kësi lloj mishi.

E paprekur nuk ka mbetur as Kosova. Madje kosovarët dyshohet se kanë konsumuar goxha mish të tillë të ardhur nga Belgjika.

Dogana e Kosovës duhet të kontrollojë produktet e mishit në kuadër të tarifimit dhe vlerësimit të saktë.

Kurse për cilësinë e importit të ushqimit dhe të mishit përgjegjëse është Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë.

Para se të fillojë zhdoganimi i mallrave ushqimore, duhet të inspektohen dhe të paraqiten në certifikata për secilin import të produkteve ushqimore, certifikata që lëshohen nga AVUK-u, kurse nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të tregojnë dhe kanë treguar se në vitin 2016 në Kosovë janë asgjësuar 20 mijë kilogramë mish i prishur që janë importuar nga mishtorja e Belgjikës "Veviba". Siguria e ushqimit është përgjegjësi e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, siguria e ushqimit duhet të jetë përgjegjësi nacionale dhe institucionale. Përgjegjësia kryesore për sigurinë e ushqimit mbetet tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, e cila duhet t'i shtojë kontrollet në tregun e brendshëm, e po ashtu, edhe në kufij, për të pasur ushqime të sigurta.

Po ashtu, AVUK duhet të marrë më shumë mostra për analiza të ushqimeve. Nuk duhet të arsyetohen moskontrollat e ushqimeve me mungesë të numrit të inspektorëve fitosanitarë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të marrë masa në kufij në moslejimin e produkteve me cilësi të dyshimta në vend. Në këtë agjenci duhet të angazhohen më shumë dhe të mos lejojnë hyrjen brenda të një produkti me cilësi të dyshimtë, produktit duhet t'i bëhen analiza në terminal dhe nëse nuk është në rregull, ai të mos lejohet të hyjë në tregun vendor. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Time! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Në radhë të parë mendoj, qytetarë të nderuar, që në Kosovë është krijuar një sistem i krimit të organizuar dhe rrallëherë është faji te individi. Faji është te sistemi që është ndërtuar i tillë që nga paslufta me ndihmën e UNMIK-ut, me ndihmën tonë, pastaj edhe me ndihmën e EULEX-it.

Unë dëgjova këtu deputetët të ndryshëm, të cilët vazhdimisht po thonë që kishte qenë mirë për ta ndërruar Qeverinë. Ju garantoj që Qeveria do të ndërrohet, se s'ka qare pa u ndërruar, më së largu edhe një vit, por problemet do të vazhdojnë prapë kështu, sepse është ndërtuar sistemi keq, se kur u ndërrua kjo Qeveria unë kam menduar personalisht që kryeministri Haradinaj do të ketë fuqi për të bërë ndryshime radikale. Po qysh, çka, si të nxirren njerëzit prej pune? Po të hyjmë këtu thellë-thellë, del problem shumë i madh. E ka qenë një luftëtar, gjatë luftës, po e tregoj një histori që e kam dëgjuar nga dy deputetë të Parlamentit, por nuk po ua them emrat, se njëri nuk është e tjetri është në sallë, një histori brilante. Një snajper, ushtar i UÇK-së, thoshte: "E merrja në thumb ta vrisja Zoranin, po si ta vraja Zoranin, kur kam shitur cigare me të, kam bërë tregti të cigareve. E merrja në thumb Jovanit, po qysh ta vraja Jovanin, edhe me të kam bërë biznes".

Problemi është që po të hyjmë në njëfarë rëntgeni, gjysma e deputetëve dalin që kanë shitore, shesin vetë mish të prishët, shesin mallra të prishura, ka deputetë që kanë firma të ndërtimit, ndërtojnë lidhje e pa lidhje që po u bë ndonjë termet, rrëzohen të gjitha. Ka deputetë që merren me naftë, me barna, këtu është problemi i sistemit. Domethënë sistemi është krijuar gabim. Po, unë po e them një diçka, përpara 5-6 muajve në këtë foltore, në qoftë se iu kujtohet ndonjë deputeti, kam paraqitur problemin e mishit që po hyn pa kontroll, bile kam përmendur që kam informacione që në Kosovë shitet mish i minjve të detit. Ata, këqyre, a po e sheh, Mimosës po i duket çudi, edhe mua më është dukur shumë çudi kur kam marrë informacion, Mimosë. Ai mishi i bardhë, e keni parë të pulave, kaq gjoks i pulës, ku ka gjoks të pulës kaq. Domethënë, është, po, po, është shumë e vërtetë, dhe hiç s'u bë e madhe, s'u bë kjo punë e madhe se ne kemi ngritur tema këtu, por nuk është bërë e madhe.

Tani është bërë e madhe pse disa medime e kanë nxitur. Që përgjegjësia kryesore është te Agjencia për Kontrollimin e Produkteve, kjo nuk ka kurrfarë dileme. Por, tani kryeministri, nuk e

di, në qoftë ju opozita nuk protestoni, unë po i bëj thirrje kryeministrit ta shkarkojë komplet Bordin e Agjencisë Ushqimore, se jo që duhet të shkarkohen, po ata është dashur vetë të japin dorëheqje, pa e shkarkuar hiç është dashur të japin dorëheqje, por këtu vetvetiu lind një pyetje: si ka mundësi që ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës po shqetësohemi tani vetëm për mishin, e nuk jemi shqetësuar kur në Kosovë hyjnë me tonelata qumësht pluhur? Pyetni doganat, kush e rren popullin e Kosovës që po prodhojnë qumësht të Kosovës, a qumështi vjen krejt pluhur në Kosovë! Shko, pyetni, po këtu është zinxhiri i krimit prej dogane e deri te Inspektorati, e deri te Agjencia e Ushqimit, e tani hop i lidhur edhe me do portale, që i dhënë ata, e ndezin këtë farë pune, sepse edhe disa portale i shantazhojnë kompanitë të ndryshme që u thonë: “Në qoftë se ti nuk më jep kaq para”, siç është rasti i shantazhimit që ia kanë bërë “Viva Fresh”-it, po flas me emër. Ia kanë bërë një portali, i kanë thënë: “Na e ke ndaluar sponsorizimin, atëherë do t’i nxjerrim skandalet”.

Prandaj, t’i hyjmë, ta hetojmë edhe pluhurin kush e prodhon këtu produkt qumështi që rren që ne po prodhojmë qumësht origjinal. Tjetra, te buka që e tha ish-ministri edhe profesori i nderuar atje. Është shumë e vërtetë, para 4 vjetëve e kemi bërë një hulumtim, që buka fryhet pesë herë mbi mesatare dhe tharmi i bukës i cili përdoret për fryrjen e bukëve është kancerogjen. Unë nuk pres të marr vota prej furrtarëve, hiç asnjë ata që shesin bukë false asnjë votë të mos ma dhënë, as nuk pres të marr vota prej naftëtarëve që Kosova me 10 mijë kilometra katrorë i ka 1 mijë e 200 pompa të benzinës. Suedia me 362 mijë km katrorë i ka veç 400 pompa të benzinës. Po, po do të shohim kur të vijë edhe Ligji për naftë si do të luftohet kush t’i mbrojë, se gypat këtu fillojnë, në Parlament. Do të dalin t’i mbrojnë se thotë unë e kam filanin jaran, filani më jep naftë e benzinë pa para, filani i jep partisë time. Kështu është edhe te mishi. Këtu më mirë ky popull është qysh ka thënë Enver Hoxha të hajë bari, bari të livadheve tona, se sa të hajë mish të prishur e të bëhet kanceri në Kosovë sikur puna e gripit.

Tani lind pyetja: a e pyesim ne veten, si ka mundësi që në çdo dy metra të ketë barnatore? A pyesim veten si ka mundësi të japin licenca këta jaranët e mi në Prishtinë për masazh, relaks, se na kanë dalë krejt sendet e tjera aty te masazhi. A? Jo, edhe ai është ushqim, po ushqim i bardhë ai, mish i bardhë i pulës, aty te ushqimi jam duke qëndruar. Kështu që të mos bëhemi ne këtu hipokritë e të luajmë rolin e budallait kishe nuk po e dimë çka është duke ndodhur në Kosovë, se Kosova është si madhësi gjeografike sa një ‘shopping center’ në Berlin. S’është Kosova më e madhe, Kosova është shumë e vogël në qoftë se duam t’i mëshojmë drejt! E tash, kush i mbron këto në Parlament interesat e x-it dhe të y-it, ai është problem tjetër që ne duhet pastaj të dalim dhe të bëjmë një hulumtim.

Prandaj, po e mbyll këtë fjalim timin, duke i kërkuar Qeverisë, edhe kryeministrit të Kosovës që të marrë masa edhe ta shkarkojë Bordin e Agjencisë për Ushqim, por me një kusht që ta lavdërojë opozita kryeministrin e Kosovës, jo t’i thotë pastaj pse e shkarkove. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Replikë, Mimoza Kusari-Lila!

MIMOZA KUSARI-LILA: E falënderoj kolegun Milaim Zeka që ma përmendi emrin. Përndryshe, arsyeja që u befasova është për termin që e përmendi “mi i detit”, por befasi nuk mund të kemi me vendimet e kësaj Qeverie. Kjo Qeveri nuk ka pasur guxim as edhe më të voglin ndryshim ta bëjë prej cilësdo skemë mafioze që ekziston sot në shtetin tonë, e nuk mund të presim asnjë vendim as për shkarkimin e shefit të AVUK-ut, se me siguri, kryeministri duhet ta pyesë atë shefin tjetër të vet që e ka, Presidentin e vendit: a bën të shkarkohet shefi i AVUK-ut? A na prishet matematika e koalicionit? Dhe, në fund Qeveria, e kemi kuptuar, që s’është për interes të shtetit, por për të partive politike. Ndërsa, sa u përket krejt të tjerave që u përmendën në debate më herët, edhe për miellin, edhe për të tjerat, mendoj se krejt e kanë një emërues të përbashkët. Mungesën e kontrollit të mirëfilltë që ndodh në Kosovë që të gjithë jemi të vetëdijshëm edhe për faktin se si ndodh rrjedha e mallrave, rrjedha e parasë, si ndodh pasurimi i individëve, në veçanti, në shoqëri brenda Parlamentit të Kosovës, brenda Qeverisë, dhe cili është vullneti i organeve të rendit për t’i ndjekur këto raste?

Çka ka ndodhur me mishin e prishur është vetëm shpërfaqja e mjerimit të shumicës së qytetarëve të Republikës së Kosovës para fytyrës së ne të tjerëve që ishte dashur t’i mbrojmë ata. Se, në fund, e di që askush prej neve nuk shkon në “Viva Fresh” ose në “ETC” ose kudo që është blerë ai mish ose ai suxhuk, me 99 cent ta blesh kilogramin, po i kanë vendet e veta të besueshme ku marrin, e dinë që erën e mishit e ndiejnë vetëm ata që me siguri rrojnë me pagë minimale, me shtesa sociale ose e kanë minimumin e të hyrave që mund t’i ketë një qytetar i Kosovës. Të mos shesim demagogji, por nëse ka interesim për masa të mirëfillta, dihet cilat janë ato masa dhe dihet ku duhet kërkuar llogaridhënia për secilin që e mban përgjegjësinë për sigurinë e ushqimit në këtë vend.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka nënkryetari i Parlamentit, zoti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kemi diskutuar edhe dje, edhe sot po diskutojmë për tema tepër të rëndësishme që janë të lidhura me shëndetin e qytetarit, me shëndetin e secilit njeri që jeton në Kosovë, por edhe me shëndetin, besa të shumë përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare që janë në Kosovë, jetojnë dhe ushqehen këtu.

Kemi folur për kontrollin e naftës një herë dhe, çuditërisht kontrollin e naftës e bëjnë eksportuesit e naftës, pastaj ia kanë lënë doganës që s’e kontrollon hiç, sepse nuk ka, besoj, as laborator të përshtatshëm për t’u bërë kontrolli i naftës. Po, po, dal te ushqimi ose tek ilaçet që dje biseduam për çështjen e shëndetësisë dhe problemet me të cilat përballet shëndetësia e Kosovës.

Ne jetojmë këtu, në qoftë se dikush mendon që s'ka korrupsion në shëndetësinë e Kosovës, unë mendoj ose është i marrë, ose s'ka sy, ose s'ka vesh, ose s'ka shkuar kurrë dikush i rrethit familjar të tij në kontroll te mjeku, se ne kur shkojmë na bëjnë hyzmet, edhe na qesin kafe, edhe s'na i marrin paratë. U tha që të shkosh te dy mjekë, t'i japin dy receta me ilaçe të ndryshme, edhe po i more të gjitha ato ilaçe, po i pive, besoni që nuk dëmtojnë hiç, e dini pse? Se ato nuk i kanë përbërësit e caktuar me ISO standarde të Evropës për shërim, por janë të prodhuar enkas nga mafia e ilaçeve për Kosovë.

Po flasim për kontrollin e mishit dhe mirë që dëgjova që duhet të kontrollohet edhe mishi që vjen nga Amerika, që vjen nga Evropa, nga Brazili dhe është mirë që ta kontrollojnë. Por duhet t'ju them që ka mish, ka kilogram mishi që prodhohet në Amerikë dhe në Japoni, quhet 'Kobe', që një kilogram mish të tillë kushton më së paku 540 euro për një kilogram.

Ne, fuqia jonë, mundësia jonë nuk është ta eksportojmë këtë lloj mishi, po edhe sikur ta eksportonim këtë, mirë është të kontrollohet edhe ai. Problemi është krejt Evropa importon mish nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Argjentina dhe Irlanda, kryesisht, tri shtete ose tri vende që e kanë mishin më të mirë për evropianët dhe që e përdorin evropianët, por besoni që ky mish prodhohet enkas me porosi për shtetet e veçanta, dhe shtetet e veçanta të Bashkimit Evropian kanë standard dhe recepturë më së pari të ushqimit të gjedheve që e hanë dhe pastaj kontrollojnë prodhimin edhe të qumështit, edhe të mishit, me standardet e tyre dhe tek pastaj e hedhin në treg. Mish i që ka ardhur në Kosovë, nuk është mish i Evropës, është mish, po mendoj unë, i rezervave të ndonjë shteti të ushtrisë, ku e di unë, që nuk i plotëson standardet për asnjë vend në botë për njerëzit, prandaj për të mos hyjmë te buka, te nafta, te perimet që hamë, se po flasim për mishin, por s'po flasim për perimet edhe pemët që i hamë me plot pesticide dhe janë të dëmshme, të mos u përzihem specialistëve të fushës për këtë çështje, por janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, në qoftë se merren para kohe ose derisa e kanë të caktuar atë pasi të përdoret.

Ne kemi pasur problem me këto agjencitë e pavarura, si po i quajmë, që janë shumë të varura, por megjithatë unë mendoj që duhet t'i vëmë pikë kësaj pune. E di që ne s'e kemi fuqinë këtu që jemi, por ne duhet të bëjmë presion te Qeveria, së pari që ta rregullojë Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, që është bashkë dhe mendoj që s'duhet të jetë bashkë. Ne e kemi pasur një debat të gjatë në Parlament edhe kush duhet, në varësi të kujt duhet të jetë kjo agjenci, ka pasur mendime që Agjencia e Veterinarisë të jetë në Ministrinë e Bujqësisë, ky tjetri në Ministrinë e Shëndetësisë, është arritur kompromis, mendoj në kohën e koalicionit LDK-PDK që të jetë pranë Kryeministrit dhe ashtu ka mbetur. Unë nuk e di si funksionon, por ajo që do të insistoja edhe nga Qeveria, edhe nga ne të gjithë që të luftojmë fort, të mos flasim vetëm për t'ia mbushur mendjen dikujt që po i mbrojmë interesat e qytetarëve. Ashtu siç do të dëshiroja që të mos flasim për hatër të atyre që janë të implikuar në këto çështje, që e dëmtojnë interesin e qytetarëve, por të luftojmë fort që të krijojmë institute me laboratorë të specializuar, me qëllim që asnjë produkt bujqësor, blegtoral, as naftë, as veçanërisht ai i ilaçeve, të mos kalojë pa u kontrollua cilësia e tij.

Në qoftë se këtë e bëjmë edhe investojmë për t'i bërë këta laboratorë që i kanë të gjitha vendet në botë, ne s'i kemi, inspektorët që nuk kanë kurrëgjë, ndoshta kanë ndonjë termometër t'ia matin temperaturën mishit, por laboratorë të mirë besoj që s'kanë, nuk mund të konstatojnë asgjë.

Doganat, çka mund të bëjnë? Sa lloj ndalesash i ka një import që bën, qoftë i prodhimit të mishit, naftës, pemëve, perimeve, i produkteve të tjera, të cilat ndeshen me njeriun, por edhe ato që ndeshen me kafshët, edhe me gjedhet, që ne nesër i presim. Ndërsa, dua t'i them Milaimit, se s'di çka përmendi miun e detit, ka pula të mëdha, ne i kemi pulat e vogla, por ka edhe pula të mëdha që prodhohen për mish dhe e kanë atë farë gjoksin e madh, kështu që nuk janë minj, nuk e besoj që ka eksportuar dikush minj. Ky është mendimi im, në qoftë se Qeveria, edhe ne, nuk ia miratojmë Qeverisë buxhetin, edhe njerëzit, edhe laboratorët e specializuar, neve prapë do të na tregojë tash ndoshta jo Belgjika, po na tregon Italia, na tregon Polonia nga importojmë mish shumë ne, s'e përmendi kurrkush Poloninë, importojmë edhe nga vendet e tjera, veç desha edhe diçka të shtoj nga ajo që e kam diskutuar një herë me një mikun tim që punon në Rumani dhe merret me këtë çështje.

Sot asnjë rumun nuk është i papunë, ne qeshim me ta, por asnjë rumun nuk është i papunë dhe kanë ardhur këtu të kërkojnë punëtorë, sepse e kanë bërë një sistem të lidhur me shtetin gjerman dhe po ndalem te mishi. Prodhonjë viça për "Steak House" të Gjermanisë që janë restorantet më të përhapura të mishit në Gjermani dhe i kanë kredituar bujqit t'i rritin dhe ua blejnë viçat. Ata janë të punësuar pranë tyre, por edhe ushqimin e tyre ua kontrollojnë përmes inspektorëve që i kanë aty, sepse ushqimin duhet ta prodhojnë ata për bagëtitë, përmes të cilave ushqehen njerëzit. Në qoftë se ne ushqimin nuk e përndjekim nga hapi i parë, kur fillon prodhimi, që nga fara, edhe produkti final që përdoret për ushqimin e njerëzve, ne prapë bëjmë gabime, ne prapë nuk i realizojmë qëllimet tona.

Nuk e besoj që ka ministër, ose ka deputet që është i interesuar ta dëmtojë shëndetin e qytetarëve.

KRYESUESJA: Faleminderit, nënkryetar! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Disi po ndërlidhen temat dhe debatet, edhe pse dje kishim një interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, por pasi që po flasim për shëndetin, për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, ekziston një fakt që terminologjia e krimit të organizuar nuk kufizohet vetëm në trafikimin e lëndëve narkotike, qenieve njerëzore dhe kriminalitetet e tjera, që janë lëndimi trupor apo humbja e jetës së njeriut.

Është fakt, evidente që krimi i organizuar është i shtrirë në dy segmente, atë që e thamë dje, në kompanitë farmaceutike, duke importuar qoftë barna, të cilat e lëndojnë shëndetin dhe mënyrën

edhe me çmimet enorme të centralizuara dhe kjo që po flasim, që ka një muaj, skandali i mishit të importuar. Esenca ekziston te një shtyllë kryesore që ndërlidhet me atë që thanë njerëzit e fushës, që është agjencia në fjalë, inspektoratet, qofshin qendror dhe komunal, por mbi të gjitha, kjo është më shumë te ata që importojnë, sidomos ato megakompanitë e mëdha që kanë monopol dhe që direkt janë të involvuara në blerjen, shitjen, distribuimin, deri edhe te manipulimi përmes doganave dhe pjesës tjetër që ndërlidhet me kontrabandat në kufijtë që janë pak më lehtë, e që importi i mishit ndodh para syve të këtyre aktorëve që janë të obliguar ta respektojnë ligjin, mbi të gjitha, ta ruajnë shëndetin publik të qytetarëve tanë.

Ajo çka kemi parë dhe çka është e garantuar tashmë që para syve të njerëzve ka ndodh, sa për këtë efikasitet dhe sa për këto masa që kanë ndodhur deri më tani, ne kemi dëgjuar edhe raste kur është shitur, po e quaj edhe në gjuhën popullore lopë e coftë është shitur, është ngritur aktakuzë, por nuk ka pasur masë ligjore, e cila e ka dënuar atë akt. Kjo e tregon nivelin dhe përgjegjësinë institucionale, edhe të Inspektoratit, edhe të Prokurorisë, edhe të Gjyqësisë, edhe të Qeverisë, edhe të Kuvendit, edhe të komisioneve mbikëqyrëse. Nëse nuk ka masa adekuate dhe nëse nuk arrihet një sistem efikas i kontrollit, mbi të gjitha nëse nuk fuqizohen mekanizmat e kontrollit, domethënë në këtë skemën e përgjithshme të parandalimit të importit edhe të mishit, por edhe të kontrollit të brendshëm të mishit, qytetarët dhe vetë ne, sepse jemi qytetarë të këtij vendi, do të përballemi me të njëjtin ushqim dhe të njëjtën arsye të humbjes së jetës së shumë njerëzve nga sëmundje të ndryshme, që vijnë nga ky mish i kontaminuar, nga lloj-lloj mishrash të kontaminuara dhe ushqime tjera, që fatkeqësisht njerëzit e fushës i theksuan, duke filluar edhe nga qumështi dhe elementet tjera, që e përbëjnë qumështin.

Kështu që Kuvendi duhet që urgjentisht ta krijojë një trupë, e cila do ta kishte njëlloj mbikëqyrjeje të kontrollit mbi këta mekanizma dhe do ta kishim një raport të saktë në harmoni edhe me institucionet tjera, duke e marrë një qëndrim të përbashkët sesi të dalim nga kjo gjendje. Kështu që ndikimi i jashtëm, edhe në agjenci, edhe në Qeveri, edhe në Kuvend do të jetë joefikas për ta parandaluar, qofshin edhe këta shembujt e mirë që u dëgjuan sesi shtetet tjera ushqehen dhe sesi shtetet tjera garantojnë ushqim cilësor dhe efikas.

Ky lloj skandali që ka dalë në sipërfaqe, që fatkeqësisht ka qenë gjithmonë i përfolur dhe i folur edhe nga qytetarët, sepse vetë çmimet e kanë treguar se çfarë cilësie dhe me çfarë ushqehemi, është tregues i qartë që ekziston një neglizhencë e madhe, e cila në logjikën e luftimit të krimit të organizuar dhe të korrupsionit është joefikase për parandalimin e saj. Unë mendoj dhe kërkoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës të jetë më efikas në mbikëqyrjen detyrimisht të kësaj fushe, ndoshta edhe në baza tremujore, duke kërkuar raporte të sakta, të cilat do të bëheshin edhe publike, pavarësisht tendencës nga dikush që të fshihen ose minimizohen brenda institucionit të Agjencisë dhe institucioneve tjera, që janë të thirrura për zbatimin e ligjit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka kërkuar fjalën shkurt për diçka.

DAUT HARADINAJ: Kryesues!

Në shumicën e rasteve kur ka pasur debate, në fund është nxjerrë një rezolutë. Unë e kam një propozim për kolegët e mi deputetë. Pse nuk e krijojmë një komision parlamentar hetimor, i cili do t'i mbikëqyrte prej pikës doganore deri te AVUK-u, inspektorët lokalë dhe rrjetin e merketeve të shitjes. Do të ishte shumë e udhës që ne në fund ta propozojmë një komision parlamentar hetimor me një afat të përkohshëm, i cili do t'i merrte të gjitha mostrat dhe do të na i sillte këtu. Të njëjtën kohë, natyrisht se Ekzekutivi duhet t'i respektojë edhe vendimet të cilat do t'i nxjerrim ne në fund të seancës. Por, i ikim tendencës që dikush po tenton ta politizojë, sepse edhe më herët e dëgjuam dhe prapë po e përsëritim. Ne kemi edhe deputetë që kanë markete dhe u janë asgjësuar me mijëra kilogramë mish, pikërisht në ato markete.

Ne e kemi një kryesues të AVUK-ut, ose një kryeshef të AVUK-ut, të emëruar nga Qeveria Mustafa, bile ka pasur një vonesë shumë të gjatë derisa është emëruar. Ne kemi deputetë që kanë qenë ministra këtu, e shumë, e shumë, të mos hyjmë tash e t'i përsëritim. Po i shohim shumë të gatshëm për të kritikuar, por jo për të ofruar zgjidhje. E propozojmë një komision parlamentar hetimor, le t'i shohim detajet, bile është më lehtë sesa të hetohet rasti i gylenistëve, sepse ka të shkruara, ka mostra, duhet shkuar dhe shikuar sa janë respektuar, kemi ligj të ushqimit, domethënë të gjitha këto i kemi me bazë ligjore, kështu që është shumë e thjeshtë. Në fund të seancës e propozojmë një komision parlamentar hetimor, ia japim një afat 30-ditor që t'i marrë mostrat e t'i sjellë në Kuvend dhe të vijmë në një konkluzion përfundimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas renditjes, zonja Famire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Përveç faktit që predispozitat gjenetike mund të mundësojnë që ne të sëmuremi nga disa sëmundje, fakt i pamohueshëm është se shëndeti ynë sot është ajo se çfarë hamë, çfarë thithim (e dimë ajrin siç ishte këtu dhe një debat që e patëm për ndotjen e ajrit) dhe në fund produktet medicinave, apo ilaçet që ne i marrim kinse për trajtimin e këtyre sëmundjeve dhe në fund përfundojmë ashtu siç nuk ishte dashur, me substanca të ndryshme të dëmshme kimike që i futim në organizmin tonë.

Nuk është se jemi aq të zotët në zbulimin e aferave siç është kjo, sepse zakonisht këto afera zbulohen në vendet e origjinës, siç është edhe në këtë rast që Agjencia Federale e Ushqimit në Belgjikë e kishte zbuluar se kjo firma e apostrofuar e ka eksportuar një sasi të madhe të mishit, jo vetëm në Kosovë, por edhe në shtetet e ndryshme të Evropës Juglindore. Pastaj, ndodh që autoritetet tona alarmohen dhe bëjnë disa përpjekje me publicitet, ku asgjësohet një sasi e mishit, e kur veç mishit e sasia e madhe tashmë ka hyrë në tregun e Kosovës dhe ka përfunduar në tryezat e qytetarëve dhe dëmi tashmë është bërë.

Do të thotë, jo vetëm që ky mish e ka një skadencë katastrofale që e shkakton veç afati i tij, por edhe vetë kushtet e transportit. Duhet të jemi koshientë se si është transportuar, si është ruajtur. Aq është e rëndësishme, sa që edhe një mish me afat, në qoftë se nuk transportohet në kushte siç kërkohet me temperaturë të caktuar, me një transport adekuat, ai do të jetë i prishur kur të vijë në tryezën tonë.

Krejt rastësisht po flasim për mishin. Këtu duhet të flasim për komplet ushqimin që ne e konsumojmë. Është sekret publik që ne shkojmë në shtete tjera dhe i shohim ato në qendrat e ndryshme tregtare produktet 'bio'. Në vend se ne si shtet ta stimulojmë prodhuesin vendor që të prodhojë produkte të sigurta, krahas fushatave vetëdijesuese, e nuk them që edhe produktet vendore duhet të mos jenë të kontrolluara, por me fushata vetëdijesuese të ndikojmë që jo vetëm në rritjen e produktit vendor, por edhe që cilësia e atyre produkteve të jetë e mirë dhe që ne të orientohemi te tregtarët vendorë, te prodhuesit vendorë, që të dimë, tek e fundit, çfarë po konsumojmë.

Si eksperte e shëndetësisë publike me siguri të plotë them se konsumatori ynë është plotësisht i pambrojtur. Nëse bazohemi në faktin se nga bakteret, viruset, parazitët dhe substancat kimike shkaktohen më se 220 sëmundje, mund të mendoni se si është shëndeti ynë nëse vihet në pikëpyetje kontaminimi me cilindo prej këtyre agjensëve.

Ne e dimë se përveç që nuk kemi kontroll adekuat në Doganë, paramendoni mishi për të cilin ne po flasim, fillimisht ka hyrë në Kosovë me një çmim 93 centë, pastaj në sasinë tjetër 1,13 centë dhe 1,77 centë. Vetë fakti se sasia e parë ka hyrë me një çmim të tillë, ose kur shitet me një çmim simbolik në treg, duhet ditur si po abuzohet me situatën dhe varfërinë që është në Kosovë, sepse dihet që një konsumator, i cili nuk ka mundësi të konsumojë mish të kualitetit, që në disa raste e tregon edhe çmimi, por jo gjithnjë, duhet ditur se ai do të shkojë e ta blejë atë produkt. Nuk është obligim i tij të mendojë ai se çfarë po blen. Është obligim i shtetit, duke filluar prej Doganës dhe inspektorëve, të cilët fatkeqësisht janë të paktë në numër. Çfarë po bëjmë ne që ta rritim numrin e inspektorëve, që në fakt janë njerëzit kryesorë përgjegjës për ta ditur së paku, pak a shumë, sesi është situata në treg. Unë thashë, komplet ushqimi është i kontaminuar.

Sëmundshmëria në rritje - ne folëm dje, pse është ky shqetësim i madh për sigurime? Pse është ky shqetësim i madh për shëndetësinë? Sepse, fatkeqësisht, ushqimi tash është ndotësi, apo shkaktari numër një i rritjes kaq enorme të sëmundshmërisë dhe jo vetëm sëmundjeve banale, siç është diarreja akute apo barkqitjet, për çka e kemi ende vendin e parë, fatkeqësisht, në Evropë, por edhe për sëmundjet siç janë ato malinje, sepse kjo ndotje e madhe dhe ajo çfarë po konsumojmë tashmë reflektohet edhe në rritjen e madhe të sëmundjeve malinje, që është aq shumë e pranishme, me gjithë faktin që ende nuk e kemi regjistrin e kancerit dhe ta kemi një situatë apo një pasqyrë të sigurt se çfarë po konsumojmë.

U fol edhe vetëm po e përmend një produkt, siç është vaji i palmës, për të cilin shumë pak është ditur në tregun e Kosovës, por fatkeqësisht tanimë po favorizohen produktet që e kanë një sasi të madhe të vajit të palmës. Produktet e qumështit, që në vend se ta favorizojmë prodhuesin vendor dhe të ketë interes që ta ofrojë një qumësht të cilësisë së mirë, ne marrim produkte zëvendësim për këto që e kanë një sasi aq të madhe të një produkti, i cili nëse e tejkalon sasinë prej 20% shndërrohet në një produkt kancerogjen. Për këtë nuk shqetësohet askush. Kur shpërthejnë këto afera, ne merremi një ditë, por fatkeqësisht mund të konstatoj se edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës për temat që vijnë nga domeni i shëndetësisë publike dhe shëndetit të njeriut nuk ka interes të debatohet, flasim sa për të thënë diçka dhe kur të përfundojë debati, krejt mbetet që të merren ata që pastaj kur i kanë pasojat në shëndetin e vet janë të interesuar të flasin për këto tema, ndërsa të tjerët që nuk e kanë për momentin shqetësim nuk e kanë edhe aq me interes.

Do të thotë, rritja e kontrollit në Dgana, rritja e numrit të inspektorëve krahas fushatave vetëdijesuese, sidomos te prodhuesit vendorë, por edhe te tregtarët, të cilët me pafytyrësi aq të shprehur janë në gjendje t'i mbulojnë afatet e kadencës në produkte nëpër marketet që vetëm një konsumator, i cili është vetë i ndërgjegjshëm për shëndetin e vet, sepse ju duhet ta humbni një gjysmë ore në marketet tona duke e kontrolluar secilin produkt për afatin e skadencës. Dihet se në të gjitha shtetet, vetë tregtarët i kontrollojnë produkteve të cilave u afrohet afati i skadencës dhe i fusin në një vend të caktuar me çmim më të ulët, sepse u është afuar afati që konsumatorët të kenë qasje në ato produkte dhe t'i marrin me kohë, duke mos pritur që pastaj tregtarët e pandërgjegjshëm t'i mbulojnë me etiketa tjera, kinse ato produkte pastaj kanë afat tjetër të skadencës. Këto janë keqpërdorime që po ndodhin dhe po ashtu direkt janë pasoja në shëndetin tonë.

U thanë shumë gjëra paraprakisht, prandaj mendoj se e kemi obligim si Kuvend që të nxjerrim edhe rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës që shumë me seriozitet ta trajtojë këtë çështje, sepse do të kemi probleme shumë më të mëdha në të ardhmen dhe të mos presim që afera të tilla të zbulohen nga vendet e origjinës, por ne të merremi me shëndetin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Memli. Le të përgatitet...

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Realisht sot është temë jashtëzakonisht e rëndësishme, për të cilën besoj se pajtohemi që e ka një relevancë për jetën e secilit qytetar të Kosovës dhe për familjet e të gjithë neve këtu dhe të gjithë atyre që po na ndjekin e që s'po na ndjekin, normalisht edhe për pjesëtarët e Qeverisë ka relevancë, pavarësisht që vetëm ministri i Drejtësisë është këtu. Dhe, ka shumë gjëra për të cilat mund të flasim, sepse ky debat parlamentar nisi për skandalin e mishit të prishur që erdhi nga

Belgjika dhe pastaj u zgjerua te çështje që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme të ushqimit dhe me cilësinë e ushqimit që ne e konsumojmë.

Andaj, është e kuptueshme që ka shumë çështje, tema e nëntema, të cilat po diskutohen, dhe unë do të mundohem që ndoshta vetëm disa prej tyre t'i prek dhe ta përfundoj me disa rekomandime konkrete, të cilat shpresoj që një pjesë së paku të harmonizohen dhe të përfshihen te rekomandimet që dalin në fund të këtij debati, apo ndoshta konkretisht ka nevojë për disa gjëra që edhe të saktësohen.

Sidoqoftë, po flasim më së shumti për punën e mishit dhe më lejoni të them që nga të gjitha të dhënat e këtyre viteve të fundit, më shumë se 60% e mishti të importuar në Kosovë vjen nga dy vende, nga Brazili dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. U tha nga njëri nga parafolësit që në këto dy vende, që janë dy ndër prodhuesit më të mëdhenj të mishit në botë, nuk është se veç te ne janë duke shitur mish, janë duke shitur mish në krejt botën, bashkë edhe me Argjentinën që e përmendët ju zoti kryesues, por edhe me Uruguajin që nuk e përmendët dhe me disa shtete të tjera.

Është e vërtetë që në krahasim me rregullativën e Bashkimit Evropianë janë goxha më liberalë në mënyrën sesi bëhet trajtimi i gjedhëve para therjes së tyre dhe pastaj edhe përpunimi i mishit. Jemi mësuar të gjithë ne që të flasim për rregullativën e BE-së, e kemi edhe obligim kushtetues e ligjor që edhe legjislacionin ta kemi në pajtim me këtë dhe mendoj se kështu duhet të vazhdojë, por ne pikërisht problemin e patëm me një prodhues të Bashkimit Evropian dhe atë nga kryeqendra e Bashkimit Evropian, me një prodhues belg, i cili nuk i ka shitur mish veç Kosovës, por edhe shumë vendeve tjera, siç u zbulua nga hetimet që u publikuan pikërisht nga Belgjika.

Pra, paragjykimin ne s'duhet ta kemi me vendin e origjinës, prej ku na vjen një prodhim, qoftë mish apo diçka tjetër, por ne duhet që besimin tonë ta lidhim me kontrollin që ua bëjmë prodhimeve ushqimore, qofshin ato me prejardhje shtazore, bimore apo tjetër dhe që hyjnë në Kosovë.

Unë besoj se pajtohemi që ne sfidën dhe problemin kryesor e kemi këtu. Kjo lidhet me situatën e krijuar ndër vite, qoftë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për të cilën do të flas shkurtimisht, por edhe tek autoritetet e tjera, qofshin ato inspektuese, apo që kanë përgjegjësi të kontrollit të tregut të shëndetit publik, e kështu me radhë. Megjithatë, kur flasim për këtë çështje duhet të jemi pak më të saktë. Ky problem që u zbulua, ky skandal që u tha me të drejtë, nuk u zbulua në vendin e origjinës, është zbuluar në vendin e destinimit, në Kosovë. Nëse i keni përcjellë ato diskutime që janë bërë në Belgjikë dhe hetimet atje kanë rrjedhë pikërisht për shkak të kontrollit të gjetjes së inspektorëve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në pikën kufitare, ku është tentuar që të importohet ky mish me afat të skaduar. Pra, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e ka ndaluar këtë mish dhe ky mish nuk ka arritur në tryezat e Kosovës, që është

lajmi i mirë. Por, cili është lajmi i keq? Ka lajme të këqija që i dimë, ka lajme të këqija që nuk i dimë. Frika ime si konsumator, në këtë rast, është për ato që nuk i dimë.

Çështja që është ngrehur në ndërkohë është se në muajt e fundit, në javët e fundit, veçanërisht pas vetëdijesimit me rastin e Belgjikës, ne kishim konfiskim të mishit me afat të skaduar në shumë komuna të Kosovës dhe pyetja që shtrohet me të drejtë është a ka hyrë ky mish me afat të skaduar apo ka skaduar në ndërkohë dhe është prishur në depo dhe në ato vende ku mbahet?

Unë jam i bindur që mishi nuk ka hyrë me afat të skaduar, sepse e shihni edhe punën që është bërë në kufi dhe një numër jashtëzakonisht i madh i kontroleve, por problemi është diku tjetër, problem për të cilin tash sot këtu u bë trend me thënë “kam pas folur”, “kam pas folur”... Kam pas folur edhe unë për këtë farë pune, ka të bëjë me mungesën e rregullativës për importimin e prodhimeve me afat të caktuar para skadimit të afatit të përdorimit. Pra, problemi është se në Kosovë nuk ekziston legjislacion dhe rregullativë, e cila thotë se një produkt për të hyrë, për t’u importuar në Kosovë duhet t’i ketë minimum tre muaj afat të përdorimit. Në Kosovë mund të hyjnë mallra edhe me një ditë afat. Sot është i 18-ti, mund të hyjë prodhim të cilit nesër i skadon afati dhe ky s’është faji i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Ky është faji ynë, se ne bëjmë ligje në këtë vend. Është Kuvendi i Kosovës, kjo legjislaturë, e kaluara, ajo para kësaj dhe të gjitha ato më herët.

Pra, dua të them se është më së lehti ta bëjmë tabelë qitjeje Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë, edhe kryeshefin e saj e Bordin e të gjithë ata njerëz, por cilat janë arsyet? A janë fajet e këtyre, apo fajet ndoshta të skenës politike, në përgjithësi? Unë jam për t’i kritikuar natyrisht, sepse ka hapësirë për kritikë, edhe pse edhe arsyet kam qejf zakonisht kur ta japim kritikën t’i analizojmë pak, të dihet pse ka ardhur te arsyet, një prej tyre e përmenda dhe thashë se jemi fajtorë bashkërisht, por jam edhe për t’i vlerësuar, sepse edhe raporti për vendin që u publikua dje, realisht e vlerëson progresin që është bërë në sektorin e sigurisë ushqimore. I përmend edhe sfidat, normalisht, por përmendet edhe progresi. E vërteta është që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka sfida dhe probleme të mëdha, me të cilat ballafaqohet dhe unë besoj që të marrim ndoshta shkas nga ky diskutim, të kërkojmë përgjegjësi dhe punë më të madhe prej tyre, edhe prej Qeverisë realisht, që të ketë një vëmendje dhe një kujdes më të madh, edhe prej kësaj Qeverie, edhe realisht ndoshta të përmirësohet edhe gabimet e asaj Qeverie, që kam qenë edhe unë pjesë e saj, sepse edhe në të kaluarën Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk është mbështetur. Unë po jua kthej në vëmendje, në kujtesë, rastin që u përmend, sëmundjen e lëkurës gungore të gjedhëve.

Nja gjashtë muaj na kanë kaluar me Agjencinë e Ushqimeve dhe me Ministrinë e Bujqësisë pa pasur kompetenca, si ish-ministër drejtpërdrejt në çështjet e veterinarisë, për ta bindur Qeverinë që duhet ndarë disa fonde për të blerë vaksina për ta bërë vaksinimin total të fondit të gjedhëve në Kosovë. Dhe, kjo është bërë me vonesë. Megjithatë, kanë ngordhur 1 500 gjedhe dhe kurrë sot

e kësaj dite s'është bërë kompensimi i fermerëve, përkundër që Qeveria ka marrë vendim për këtë çështje.

E shfrytëzoj rastin ta ftoj këtë Qeveri që së paku obligimin e papërbushur të Qeverisë së kaluar ta realizojë dhe t'u dalë në fjalë fermerëve që janë prekur nga sëmundja e lëkurës gungore të gjedhëve. Por, të themi që në vitin 2017 nuk ka pasur asnjë ngordhje. E kjo a është meritë e Agjencisë e Ushqimit dhe Veterinarisë, a duhet vetëm t'i akuzojmë? Është meritë, absolutisht, sepse në vitin 2017 nuk ka qenë asnjë rast i konfirmuar. U përmend me shumë të drejtë suxhuku 0,99 centë ose edhe 1,50 euro, edhe kjo është lirë, por kjo nuk është përgjegjësia e AVUK-ut. Në këtu po flasim për vendosje në treg. Këtu kemi të bëjmë me përgjegjësi të Inspektoratit të Tregut, i cili realisht lë shumë për të dëshiruar me punën që e ka bërë dhe unë besoj se Ministria e Tregtisë dhe ministri aktual duhet ta marrë edhe me përgjegjësi më të madhe punën që bën Inspektorati i Tregut, por po ashtu edhe Gjyqësori, sepse sa dënime janë bërë në këtë vend për ato markete, ose për ata tregtarë që kanë vendosur çfarëdo lloj produktesh në treg, të cilave u ka skaduar afati dhe ka pasur raste e raste që janë bërë mediale, të cilat janë njoftuar ata që e kanë përgjegjësi mbrojtjen e konsumatorëve, kanë shkuar edhe në gjykata dhe unë s'besoj, të paktën s'jam i informuar që është dënuar dikush. Dhe, pa pasur dënime të cilat i parasheh legjislacioni aktual, unë po frikohem që nuk do të ndryshojnë mendjet.

Meqenëse jam në fund të kohës, po i lexoj shkurtimisht disa prej rekomandimeve:

1. Në Kuvendin e Kosovës të vijë sa më shpejt për miratim Ligji për ushqim. Është i kryer, është i proceduar, ka qenë në Qeveri në momentin kur është shpërndarë Parlamenti, është kthyer në Ministrinë e Bujqësisë. Duhet të vijë sa më parë edhe ta miratojmë atë ligj.

Kjo do të mundësojë kthimin e Agjencisë së Ushqimit e Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë, sepse aty do të ketë një funksionim shumë më të mirë, sesa tash që është në ZKM, e realisht kurrkush nuk merret drejtpërdrejtë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

2. Duhet transferimi i inspektorëve komunalë të bëhet në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë sa më shpejt, se edhe Raporti i Progresit tash e katër vjet me rend e kërkon këtë çështje. Kjo e mundëson një sistem të integruar të kontrollit të ushqimit, që ende nuk është ashtu si duhet.

3. Pastaj duhet të vendosim afate minimale për importin para afatit të skadimit për prodhime, rritje të buxheteve dhe kapaciteteve njerëzore në Agjencinë e Ushqimit bashkë me kapacitetet laboratorike, fuqizim të mëtutjeshëm të Institutit Bujqësor të Kosovës dhe bërjen e tij laborator referent në nivel vendi. Rritjen e buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë në program të zhvillimit rural, konkretisht masat për shtimin e prodhimit të mishit vendor kanë filluar, kanë dhënë efikasitet, duhet të rriten, por po ashtu edhe kapacitetet për përpunimin e mishit vendor, në

mënyrë që të rritet prodhimtaria, përpunimi dhe konsumi i mishit në Kosovë, sepse do të jetë shumë më i sigurt, besoj unë.

Dhe, në fund, ndjekja ligjore e kompanive vendore që importojnë edhe vendosin në treg produkte ushqimore të dyshimta dhe me afat të skaduar.

Kjo besoj se do të jetë një prej pikave tepër të rëndësishme dhe të cilat unë besoj se duhet t'u rrimë gati. Dhe, në fund, të mos rrezikojmë duke folur në përgjithësi për probleme të sigurisë ushqimore, realisht thotë populli t'u nxirret faqja e zezë fermerëve të vyeshëm të Kosovës dhe kompanive të ndershme prodhuese dhe përpunuese, të cilat në Kosovë punojnë me djersë, punojnë me nder dhe realisht na ofrojnë prodhime jashtëzakonisht cilësore, qofshin prodhime të mishit, qofshin prodhime të qumështit, qofshin pemë, perime e kështu me radhë, duke i thënë disa çështje që ndonjëherë po na i serojnë grupet e interesit, po na i serojnë mediet, ndoshta pa vetëdije, siç është çështja e qumështit pluhur, e vajit të palmës e çështje tjera, të cilat absolutisht duhet të trajtohen e të hetohen dhe të merret përgjigje legale, por jo pa e bërë përjashtimin e fermerëve dhe kompanive përpunuese të ndershme në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Driton Çausi e ka një fjalë shkurt, sqarim. Urdhëro!

DRITON ÇAUSHI: Shumë shkurt!

Arsyeja pse në pjesën e parë të fjalës sime nuk u ndala te mishi, besoj që qëllimi, motivi im ishte i thjeshtë, për të shpërfaqur para shumë prej kolegëve tanë që ndoshta rastis që nuk kanë pasur mundësi të merren me këtë temë, rreziqet me të cilat përballen të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për gjithë këto vite të pasluftës dhe ngecjet e dukshme në sigurinë, ose sigurimin e njëfarë sigurie ushqimore nga institucionet përkatëse. Do të ishte e padrejtë të thuhet se kjo mund të shfrytëzohet për arsye politike.

Unë u ndala pikërisht te faktet dhe konsideroj se do të ishte politike kur shumë nga ne fillojmë ta amnistojmë institucionin më të rëndësishëm, i cili ka dështuar për gjithë këto vite për të siguruar jetën e qytetarëve të Kosovës, që është misioni formal i këtij institucioni, pra i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Edhe duke u thirrur në bazë ligjore, besoj se bëjmë shmangie me vetëdije, ose pa vetëdije, nga realiteti.

Nga viti 2009 e kemi një Ligj për ushqimin, i cili parasheh integrimin e inspektorëve komunalë në kuadër të AVUK-ut. Nuk ka ndodhur gjatë gjithë kësaj kohe. Pra, për 9 vjet, Agjencia është thirrur në sukseset e saj dhe nuk ka arritur t'i sigurojë këta inspektorë, mandej a ka pafytyrësi më të madhe sesa kur në Komisionin tonë për Bujqësi, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, në paraqitje publike, kryeshefi thotë "garantoj që s'është futur asnjë kilogram mish i skaduar", në secilën paraqitje të tij thotë "është e pamundur me dhjetë inspektorë ta mbulojmë gjithë Kosovën". Tash, cila është e vërteta? Është tallje me opinionin publik kur thuhet gjëra të tilla.

Unë jam kundër një komisioni parlamentar hetimor për shkak se nuk mendoj se kemi kapacitete për ta bërë një hetim të një institucioni hulumtues, siç është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, por unë mendoj se ka arsye të mjaftueshme, shumicën besoj që i thashë, do të kisha mundur të vazhdoj shumë edhe më tutje, të cilat thirren në organet e drejtësisë, ta hetojnë aktivitetin e kësaj Agjencia, e cila merr miliona nga Buxheti i Kosovës, nga taksapaguesit dhe nuk arrin bazë minimale që të sigurojë një ushqim të shëndoshë, ose një bazë minimale të sigurisë së shëndetit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, po shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj,

Jemi të angazhuar me këtë temë të rëndësishme, po shihet edhe nga numri i deputetëve që janë në sallë, veçanërisht nga përbërja e Qeverisë që është duke i dëgjuar shqetësimet e përfaqësuesve të popullit.

Fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedavajući,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

U potpunosti podržavam današnju debatu koje je posvećena skandalu uvoza mesa, koje je se našem tržištu nalazi već dve godine, i koji narušava zdravstveni život svih nas. Veliko uznemirenje građana odnosno celokupno društvo oka pojave raznih slika po medijama i portalima uslikane po velikim marketima gde svi možemo videti razne insekte, miševe po frižiderima ili magacinima raznih prodavnica.

Kao predstavnik naroda u ovom parlamentu pitam predstavnike Vlade, koji danas nisu tu, verovatno i ova tema nije interesantna, oni se navodno bavi visokom politikom. Konkretno Agenciju za hranu kako je to meso ušlo u našu državu, na kom graničnom prelazu, tražimo imena carinara i sanitarnih inspektora koji su dozvolili uvoz tih produkta.

Zatim u kojim se sve marketima tih mesnih proizvodi raspodelili, da li su lokalni inspektori po gradovima izvršili kontrolu, imaju li predsednici opština raport, odnosno izveštaj šta se sve prodaje po našim marketima.

Kontroliše li agencija za hranu rokove ili etikete koji se postavljaju na produkte kojima je vremenski rok upotrebe istekao, i samim tim mogu biti kancerogena sastavljena od raznih bakterija, toksina, pesticida i drugih teških metala.

Mi gospodo na Kosovu imamo najskuplju hranu u Evropi ali je sigurno naj nekvalitetnija, ne samo meso, nego i svih ostalih produkti organskog karaktera.

Ne smemo štiti privatne biznise pojedinaca bez obzira koji su. Narušavajući tako zdravstveno stanje naših građana, a sa ovom lošom politikom ne damo prostora ni volje našim ljudima koji žele da se bave proizvodnjom čiste hrane, uzgojem stoke i čistog i kvalitetnog mesa, koji će sigurno biti puno kvalitetnije i jeftinije nego ovo meso koje uvozimo.

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Svi zajedno moramo delovati za ustavimo ovaj organizovani kriminal hrane ne samo mesa, nego i brašna, zejtina, mlečnih proizvoda i pomognemo našoj domaćoj proizvodnji putem subvencija, bez povratnih grantova od strane centralnih lokalne vlasi, ali tražiti i veću transparentnost od strane nadležnih organa, ali i njihovo odgovornost za celokupnu situaciju na terenu.

Prebacivanje odgovornosti od jedne na drugo agenciju ili instituciju ne smemo prihvatiti ovo aktualno stanje haotično, i parlament treba tražiti celokupno odgovornost za ugroženo stanje svih naših građana na teritoriji Kosova. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Lutfi Zharku, a është këtu, nuk është. Enver Hoti, nuk është. Hajdar Beqa, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Realisht unë i përgëzoj iniciuesit e këtij debati që e kanë thirrur sot për debat seancën parlamentare, konsideroj që është shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh edhe temën për të cilën po diskutojmë.

Sa i përket jo vetëm skandalit të fundit të mishit, sepse ajo ishte publike, transparente, ishte në medie dhe ka qenë çdo gjë e pasqyruar për qytetarët e Republikës së Kosovës. Por, është shumë me rëndësi që qytetarët ta dinë që edhe të gjithë artikujve ushqimorë në u ka skaduar afati, kemi plot raste që është krijuar panik se kemi ushqime që importohen me afat të skaduar.

Dëgjova këtu disa kolegë, se nuk e pata në plan të flas, unë mendoj që nga ky debat duhet të dalim me rekomandime konkrete, çka i duhet agjencisë shtetërore për të funksionuar më mirë, çka i mungon, dhe a është problemi në mungesë të kuadrit, të menaxhimit, të buxhetit apo numrit të inspektorëve?

Edhe një informatë tjetër mendoj që vlen për t'u theksuar që AVUK-u e ka informuar shtetin e Belgjikës për problemin e mishit, e jo Belgjika AVUK-un, domethënë duhet ta kemi të qartë edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, nëse është meritë, është meritë e institucioneve tona që kanë informuar institucionet e Belgjikës për një gjë të tillë, për mishin e ardhur jociësor dhe që i ka dalë afati në Republikën tonë.

U tha këtu numri i vogël në bazë të agjencisë që ka raportuar dhe në bazë të informatave që kemi janë 11 inspektorë veterinerë që merren me kontrollin operativ të biznesit, ku 40 prej tyre i mbikëqyrin 40 përpunues të veve, 50 përpunues të mishit dhe 40 përpunues të qumështit.

Është numër shumë i vogël, janë edhe 14 inspektorë veterinerë kufitarë që kontrollojnë ngarkesa gjatë importit, në bazë të agjencisë, ne edhe te kontrolli i qumështit, edhe i ushqimit, po edhe i importit, është një numër i vogël.

Ne i kemi 37 komuna, me ligjin aktual inspektorët komunalë duhet të kalojnë në agjenci, sepse këtu u fol edhe për duhanin, realisht është kompetencë e komunave dhe konsideroj që komunat në bazë të informatave që i kemi kanë diku 100 inspektorë komunalë dhe mendoj që për të qenë më afektivë duhet kaluar në Inspektoratin e shtetit, në këtë rast në Agjencinë e AVUK-ut.

Këtu patëm njerëz të fushave, ekspertë të fushave të ndryshme, po çështja e ushqimit është shumë e rëndësishme se ndikon në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe nëse neve na servohet një ushqim jo me afat, jociësor, atëherë kemi probleme edhe me shëndetin e qytetarëve dhe me çdo gjë në këtë vend.

Prandaj, është temë e mirë dhe mendoj që duhet të harmonizojmë konkluzat. Unë mendoj që në fund do t'i kem rekomandimet që të rritet numri i inspektorëve, të kalojë numri i inspektorëve komunalë në inspektorë të AVUK-ut dhe të shikojmë edhe rekomandime të tjera, me të vetmin qëllim që agjencia të shërbejë me mirë.

Unë mendoj që njëra prej segmenteve të shtetit që ka funksionuar mirë është Agjencia e Veterinarisë. Ne duhet të shqetësohemi atëherë kur s'kemi informata nga agjencia, jo kur kemi. Edhe një herë po e përsëris, është për t'u vlerësuar kur agjencia ose inspektorët e Republikës së Kosovës e gjejnë një veprim jo të mirë dhe atë veprim e dërgojnë te organet përkatëse, e pastaj duhet të merret edhe hetuesia, edhe policia, prokuroria dhe gjykatat.

Unë nuk dua ta zgjas shumë, e thanë kolegët e tjerë, por mendoj që nga kjo seancë duhet të dalim rekomandime konkrete, për ta ndihmuar agjencinë e shtetit në të mirën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, është çështje tepër e rëndësishme që po diskutohet sot në seancën e Kuvendit dhe është e papranueshme që as kryeministri Haradinaj, por po ashtu as ministri i Bujqësisë e as ai i Shëndetësisë nuk janë të pranishëm në këtë seancë.

Sa herë flitet për tema të tilla në Kuvendin e Republikës së Kosovës, apo të ngjashme me këto, në mungesë të argumenteve ne akuzohemi që po e politizojmë çështjen, kështu ndodhi edhe sot nga deputetët e mazhorancës, ku pati një përpjekje për ta devijuar çështjen dhe për t'i akuzuar deputetët e opozitës.

Së pari, është e vërtetë që çështja që sot po e diskutojmë është e rëndësishme, por ajo me çka ne nuk pajtohemi është relativizimi i kësaj çështjeje dhe tendenca e vazhdueshme që edhe në këtë seancë të amnistohen përgjegjësit. Pra, në vazhdimësi deputetët e grupeve parlamentare, po flas sidomos për grupet parlamentare që kanë qenë pjesë e qeverisjes, tentuan të amnistojnë përgjegjësit, madje këtë e bërë edhe thirrësja e kësaj seancë në fjalën hyrëse të saj, zonja Musliu.

AVUK-u do të duhej, në fakt, të ishte agjenci komplet i pavarur, madje edhe pavarësi financiare dhe staf në përputhje me kompetencat që i ka.

Gjatë kohës sa ishte kryeministër Hashim Thaçi, AVUK-u nga Ministria e Bujqësisë kaloi në Zyrën e kryeministrit dhe, në vend se të fuqizohej, meqë ka qenë apo janë dokorduar, ka pasur një konsensus që të shkojë në Zyrën e kryeministrit, në vend që të fuqizohej, ajo u keqpërdor pikërisht nga Thaçi për interesat e tij dhe partisë së tij. Pra, e mbajti në kontroll të plotë këtë agjenci dhe të gjitha shkeljet aty, duhet thënë hapur, bëhen nga persona e lidhur me PDK-në.

PDK dje tha se nuk e ka pasur asnjëherë Ministrinë e Shëndetësisë, rrjedhimisht ua faturonte të tjerëve problemet në shëndetësi, ani pse e drejtonte Qeverinë, e tash për AVUK-në kush është përgjegjës? Edhe Memli si ministër i Bujqësisë në një mandat, por edhe Thaçi si kryeministër kanë përgjegjësi për këtë.

Shtrohet pyetje pse s'është bërë rregullativa, pse nuk e ka sjellë Zyra e kryeministrit prej kaq vitesh, pse s'i keni adresuar sfidat e AVUK-ut, këtë s'e ka bërë as Thaçi, këtë s'e ka bërë as Memli sa ka qenë ministër, këtë s'e ka bërë as LDK-ja, këtë nuk po e bën as Aleanca, pra as kryeministri Haradinaj.

Meli ka punuar pikërisht, sepse duhet paraprakisht të destinonte mjetet për vaksina dhe jo ad-hoc, sepse vaksinat porositen për parandalim.

Inspektorati i Tregut, AVUK-u dhe MTI-ja janë rrjet i madh i mafisë, bashkë me doganat, deri dje të kontrolluara drejtpërdrejt nga PDK-ja, apo ish-drejtori Rafuna.

Në qoftë se AVUK-u shkon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, kjo bëhet edhe më keq, edhe më keq se sa që është aktualisht. Pra, do të duhej të ishte institucion komplet i pavarur dhe do të mund t'i raportonte vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Subvencionet dhe masat për prodhimin e mishit duhet ndërruar rregullat që kanë vendosur për kushtet e subvencionimit dhe të mos i vjedhin ato.

Duhet të shkoj edhe këtu diçka, sepse pati edhe deklarata të përfaqësuesve të LDK-së, thua se këta s'kanë pasur asnjëherë përgjegjësi në raport me këtë.

Duke e harruar faktin që kryeministër i vendit në mandatin e kaluar ishte Isa Mustafa, pra kryetar i partisë së tyre dhe nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim në raport me këtë.

Madje, e ka riemëruar zotin Gjinovci si kryeshef të AVUK-ut, sepse nuk ka pasur guxim ta largojë atë, as Haradinaj s'po ka guxim ta largojë atë.

Prandaj, po them, unë e di një shembull në Komunën e Prishtinës, për kopshtet, gjegjësisht ushqimin për fëmijët në kopshte. Derisa ka ardhur qeverisja e Vetëvendosjes në Prishtinë, pastaj kjo i është marrë "Beni Donës", ka pasur raste të shumta kur punonjësit e kuzhinës kanë thënë që mishi që po u servohet fëmijëve nuk është i mirë dhe s'ka pasur asnjë reagim nga përfaqësuesit e LDK-së, kur e kanë qeverisur Komunën e Prishtinës. Vetëm Vetëvendosje ka qenë shembull se si duhet ndërmarrë veprimet në këtë drejtim.

Dhe tjetra, ne këtu flasim kot në qoftë se në fund nuk vendosim për ta shkarkuar zotin Valdet Gjinovci, qe tetë vjet është në krye të kësaj agjencie, qe tetë vjet dhe këtu është e papranueshme qasja për të amnistuar atë person për shkak se prokuroria do të duhej të niste menjëherë hetimet në raport me shefin e AVUK-ut, Inspektoratin e Tregut dhe doganave.

Pra ne duhet t'i kërkojmë zotit Haradinaj ta shkarkojë atë. Po ashtu MTI duhet ta shkarkojë inspektorin e tregut.

Zoti Haradinaj, Daut Haradinaj, në këtë rast e kam fjalën, më përpara e përmendi Komisionin Hetimor. Kjo është veç për ta neglizhuar çështjen, për shkak se të gjitha detajet dihen tash këtu, nuk ka punë këtu Komisioni Hetimor, këtu ka punë Prokuroria. Prokuroria menjëherë duhet të nisë hetimet lidhur me këtë, sepse jemi tepër vonë.

Prandaj, te rekomandimet pa tjetër duhet të shtohet edhe dorëheqja, shkarkimi në fakt i kryeshefit të AVUK-ut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Replikë zoti Krasniqi, edhe Ganimetja.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

E çuditshme është qysh një deputet dy mandate mund të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës, të udhëheqë Komisionin për Legjislacion e të mos marrë vesh asgjë prej ligjeve.

Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë, siç e shpengove më duket ti në fjalimin tënd, me një kompromis që, edhe unë mendoj se ka qenë i gabueshëm, e kam thënë disa herë, është vendosur nën Zyrën e kryeministrit dhe, për fat të keq, Ministria e Bujqësisë as në mandatin tim, e as tash e as në të kaluarën kurrë s'ka pasur asnjë lloj kompetence ndaj AUV-së dhe e vetmja formë e bashkëpunimit ka qenë vullneti për të mundur të shtyhen përpara proceset që kanë qenë të ndërlydhura.

E përmendi çështjen e vaksinimit, është e vërtetë s'ka pasur asnjë përgjegjësi Ministria e Bujqësisë për atë punë, edhe një ministër neglizhent ka mundur të thonë nuk është përgjegjësi imja, sepse është dashur të merrej Zyra e kryeministrit me atë punë. Po përkundër kësaj, ne jo njëherë, po me dhjetëra herë jemi marrë, kemi bërë presion, i kemi ndarë mjetet, i kemi transferuar prej Ministrisë së Bujqësisë në Agjencinë e Ushqimit vetëm që të mundë t'u dilet në ndihmë fermerëve të prekur prej sëmundjes së lëkurës gungore te gjedhi, gjë që ka rezultuar suksesshëm, siç thashë, sepse vitin e kaluar asnjë rast me këtë sëmundje nuk është shfaqur në Kosovë dhe e mira është që tashmë kjo çështje ka përfunduar në vitin e kaluar.

Por, përkundër mendimeve të ndryshme që ne mund t'i kemi dhe që janë absolutisht të kuptueshme, tendenca për të thënë që diçka zgjidhet me shkarkimin e një njeriu, është tendencë politike, asgjë më shumë, është tendencë për linçimin e personave të caktuar, po nuk është tendencë për të kryer punë, kjo është çështja.

Ndërsa nëse duam përnjëmend ta ndihmojmë sigurinë ushqimore në Kosovë, ne duhet të rrisim kapacitetet edhe buxhetore, edhe institucionale, edhe njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ke të drejtë, nëse do, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë filloj të marr Memlin seriozisht vetëm kur të adresojë problemin nga koka, pra ky duhet të na tregojë që a do të votojë për rekomandimin për shkarkimin e zotit Gjinovci. Ky duhet të na

tregojë se a do t'i kërkojë prokurorisë llogari dhe hetime, në fakt, në raport me përgjegjësit, sepse kjo është çështja. Qe tetë vjet është i paprekshëm ai person. Nuk ka guxuar as Thaçi, për shkak se është njeri i tij, as Ramushi, as Mustafa. Pra, vetëm atëherë kur ti të votosh për shkarkimin e këtij personi, të gjitha masat e tjera i ndërmarrim si Kuvend, të gjitha masat e tjera, por duhet së pari të kërkojë shkarkimin e tij. T'i kërkojë Haradinajt për ta shkarkuar atë person dhe pastaj filloj të të marr seriozisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit Kujtim Shala, për kurajën që me jep sa herë që të dal në foltore.

Dola t'i përgjigjem koleges sime që tha në fjalën hyrëse 'amnistoj'. Sinqerisht po them që sa vjet jam në politikë, po e shoh që alfa dhe omega e politikëbërjes së Vetëvendosjes është Hashim Thaçi. Dhe, bota juaj sillet komplet rreth Hashim Thaçit.

Nëse ke qenë e vëmendshme dhe e ke dëgjuar me vëmendje fjalimin tim, unë s'kam amnistuar askënd. Përkundrazi, kam qenë goxha shumë kritike dhe i kam kërkuar edhe hetuesisë, i kam kërkuar edhe prokurorisë, edhe gjyqësisë.

Mirëpo në fjalën tuaj ma mbushe mendjen se je bazuar komplet në leximin e titullit të lajmit të gazetës "Expres", sepse ata e kishin qasjen pikërisht sikur tënden, se unë sot kam folur si zëdhënëse e AVUK-ut.

Unë nuk mund ta luaj as prokurorin, as gjykatësin, thjesht dhe nëse mendoni që agjenda juaj politike sot, unë thashë në fillim të fjalës sime, është mirë të dalim mbi politika ditore dhe partiake, sepse është një temë shumë e ndjeshme dhe e rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe nëse mendoni që zgjidhja është që ne të kërkojmë dorëheqjen ose shkarkimin, me theks të veçantë, po kërkon të zotit Gjinovci, e keni shumë gabim.

Thjesht, do t'u japim mundësi dhe hapësirë edhe një periudhë kohore atyre kontrabanduesve dhe atyre keqbërësve në Kosovë që ta zhvillojnë tregun e lirë.

Ne do të krijojmë kushte të punës, së pari si institucione, pastaj të lypim llogaridhënie dhe përgjegjësi nga ata që i drejtojnë këto institucione.

Nuk mundemi ne, nëse s'kemi inspektorë të mjaftueshëm, të kërkojmë më shumë se sa ka bërë deri më tash AVUK-u. Thjesht, ne duhet të krijojmë kushte, të ndajmë buxhet si Parlament, të kërkojmë që të rritet numri i inspektorëve, të bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit, pastaj eja e vendosim bashkë se çka do të bëjmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po ta heq merakun, zonja Musliu, sepse portalin që ti e përmende, unë s'ia përmenda as emrin, sepse kam kontest me të, kam padi civile dhe as nuk e klikoj asnjëherë dhe as nuk jap prononcim për këtë portal, për këtë po ta heq merakun.

Unë të dëgjova ty me vëmendje, dhe unë po ta bëj një pyetje: a ke ti një emër konkret që është përgjegjësi kryesor për këtë situatë të krijuar? A ke vetëm një emër konkret, kush është ai përgjegjës për situatën e krijuar? Pse more s'është ndalur kontrabanda deri tash, pse nuk është ndalur deri tani? Njësoj, po flitet për vite të tëra, dhjetë vjet janë në pyetje këtu.

Memli më parë tha që, qëllimisht po e përmend emrin, për shkak se tha...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Nuk është seancë pyetjesh, është debat. Të lutem, mos na e prishni rendin, janë duke pritur të tjerë deputetë. Fjalën e ka Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Me të vërtetë është çështje tejet e rëndësishme dhe mbi të gjitha e ndjeshme, kështu që pajtohem se ndoshta ministrat do të duhej të ishin këtu, edhe për faktin se edhe ne këtu, po mbi të gjitha qytetarët janë të shqetësuar, sepse bëhet fjalë për ushqimin, diçka të cilës nuk i shmangemi. Shqetësimet mund të jenë nganjëherë edhe frika të panevojshme, por ne kemi pasur nevojë që ministrat, jo vetëm ai i Bujqësisë, por edhe i Tregtisë dhe i Industrisë, sepse një pjesë e përgjegjësisë bie edhe mbi Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, po edhe i Shëndetësisë të jenë këtu të paktën për të na ofruar informacione, të cilat ndoshta do t'i hiqnin disa nga dilemat, por do të na ndihmonin edhe neve të gjejmë, kushtimisht po them, fajtorin real, edhe pse nuk besoj që ekziston vetëm një fajtor, këtu ka shumë fajtorë, por t'i adresonim drejt shqetësimet që i kemi dhe, mbi të gjitha, të mundohemi të gjejmë një zgjidhje. Sepse ne mund të flasim dhe po flasim tërë ditën për problemin, por vetvetiu nuk e sjell zgjidhjen, edhe zgjidhen duhet ta bëjmë ne.

Tash pa dashur t' i përsëris të gjitha ato që u thanë më herët dhe përgjegjësitë që unë mendoj me të drejtë u hodhëm mbi Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, pasi që është institucioni që ka përgjegjësinë më të madhe, por natyrisht nuk është përgjegjësi i vetëm në këtë fushë.

Nuk u përmend vetëm një institucion deri më tash, e që unë mendoj se megjithatë e ka një pjesë të fajit në këtë zinxhirin e institucioneve që janë përgjegjëse mbi të gjitha për sigurinë tonë, në këtë rast po flasim për sigurinë e shëndetit.

Gjatë hulumtimit për këtë temë unë doja të dija se si funksionon te ne e drejta e mbrojtjes së konsumatorit, sepse mbi të gjitha, ne jem edhe konsumatorë, të gjitha këto ushqime, shumicën prej tyre i blejmë dhe automatikisht e fitojmë, të them ashtu kushtimisht, edhe epitetin e konsumatorit dhe ekziston një departament në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i cili e ka përgjegjësi mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit dhe në pikën e dytë të të drejtave që ata i kanë bërë publike në WEB faqen e tyre, thuhet: “Konsumatorët kanë të drejtë për t’u mbrojtur nga rreziku për jetë dhe shëndet, edhe pronën mes tjerave” dhe unë nuk e di se çfarë ka bërë ky departament.

Përderisa Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit të Republikës së Shqipërisë qysh në dhjetor kishte ndërmarrë një fushatë për t’i ndërgjegjësuar qytetarët për cilësinë e ushqimit dhe në veçanti cilësinë e mishit, edhe pse ajo nuk ishte temë siç është tani. Kurse, departamenti ynë, përkundër faktit se ne për çdo ditë shohim publikimet e qytetarëve që fotografojnë dhe i bëjnë publike ushqime të tëra, jo vetëm mish, por edhe ushqime tjera me afate të skaduara, nuk kemi parë se ky departament të ndërmarrë masa se mbi të gjitha, prapë po them, është departament për mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit.

Unë mendoj se ministri i Tregtisë dhe Industrisë, përveç atij të Bujqësisë dhe Shëndetësisë, dhe mbi të gjitha përveç kryeministrit, në zyrën e të cilit vepron Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, do të duhej të ishin këtu, e para, e të na informonin se çfarë po bëjnë dikasteret që ata drejtojnë, por e dyta të merrni përgjegjësi dhe detyra konkrete edhe nga Kuvendi dhe kushdo që në fund i përmbledh rekomandimet, qoftë për një rezolutë, apo çfarëdo dokumenti tjetër që ne do të nxjerrim sot si Kuvend, unë mendoj se nuk duhet ta largojë nga përgjegjësia edhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, jo vetëm për faktin që nën këtë ministri veprojnë Inspektorati i Tregut, por edhe për faktin se ata janë të përgjegjshëm drejtpërdrejt edhe për mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Kuçi!

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe ky debat vërtetoi se ky problem ka ekzistuar tash e 18 vjet pandërprerë, domethënë ka pasur vazhdimësi të këtij problemi. Jo për të bërë amnisti, por për herë të parë mekanizmat tonë qeveritarë e kanë kryer së paku një punë, kanë pasur guximin dhe përkushtimin për t’u marrë me këtë temë.

Ndoshta jo me kapacitetet e duhura, por për herë të parë në masë të tillë është bërë, është vërejtur një përkushtim dhe një guxim i mekanizmave tanë qeveritarë për t’u marrë me këtë temë. Unë po e shtroj këtë problem në një dimension tjetër, jo në aspektin e shëndetësisë, që normalisht në aspektin e shëndetësisë është një dëm i madh për qytetarët, por edhe në aspektin ambiental, por problemi qëndron edhe në aspektin ekonomik. Shumë fermerë për të cilët ne, sidomos kohëve të

fundit, ndajmë me qindra-miliona euro për ta, ata nuk kanë mundësi të qëndrojnë në këtë treg të pabarabartë, sepse hyrja e mishit me kualitetet e tilla dhe në formën ilegale i dëmton ata. Ky Kuvend, me propozimin e Qeverisë, ndan, edhe një herë po them, qindra-miliona euro për fermerët tanë, në fakt ne po ua pamundësojmë që fermerët tanë të ekzistojnë në këtë treg të paqëndrueshëm. Ky është një dëm i madh në aspektin jo vetëm buxhetor, sepse i ndal përkushtimin e tyre, vullnetin e tyre për t'u marrë me këtë biznes.

Ne e kemi krijuar ambient të tillë që ata të mos mund t'i gëzojnë ato benefite që i gëzojnë nëpërmjet buxhetit. Ne i dhamë disa rekomandime, por unë po përiqem t'i rendis: e para, prioritet janë rekomandimet që kanë të bëjnë me fushën tonë. Ne jemi Legjislativ dhe së pari duhet krijuar infrastrukturë të tillë ligjore, që mekanizmat tanë shtetërorë ta kryejnë punën e vet.

E dyta, të ndahet buxhet për sistemin e kontrollit në këtë fushë për t'i dhënë buxhet shtesë, pse jo edhe përgjegjësi. Përgjegjësia do të vijë e treta, dhe duhet pasur përgjegjësi aq sa kanë. Një deputet e tha "pse të mos krijohet edhe komision hetimor?". E di që ndoshta është bërë e tepërt, është demoduar kjo çështja e komisioneve hetimore, por për këtë çështje pse jo të ketë edhe komision hetimor? Normalisht i ftojme edhe prokurorët që ta nxitin, ta kryejnë punën e vet, duke u bazuar edhe në këtë debat.

Pra, rekomandimet tona, në fakt edhe të miat, janë që e para ta krijojmë infrastrukturën ligjore të përshtatshme që mekanizmat tanë shtetërorë të kësaj fushe ta kryejnë punën e vet. E dyta, të shtojmë buxhet për këta mekanizma shtetërorë, të merren në përgjegjësi të gjithë ata, të cilët nuk e kryejnë punën e vet konform ligjit, dhe pse jo në qoftë se e kemi vullnetin, në qoftë se duam të zgjedhim, ndoshta është momenti më i duhur të kemi edhe komision hetimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e zotit Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Tema për të cilën po flasim këtu si zakonisht në Kuvendin e Kosovës po trajtohet në mënyrë parciale dhe, po ashtu, nga këndvështrime të ngushta politike, të momentit në të cilin ndodhemi. Mendoj se çështja që trajtohet seriozisht duhet të shihet në të gjitha dimensionet e saj. Dimensio i parë i trajtimit është tregu potencial i mishit në Kosovë. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, në Kosovë me rreth 1 900 000 banorë, secili banor në vit konsumon rreth 22 kg mish gjedhi. Pra, rreth 22 kg mish gjedhi për person në Kosovë.

Çmimi mesatar i mishit të gjedhit në Kosovë konsiderohet të jetë rreth 4,70 euro. Nëse kjo shumëzohet, pra 1 900 000 x 22 kg x 4,70 euro për kilogram, i bie që tregu është rreth 196 milionë euro në vit. Pra, po flasim për një treg për 190 milionë euro në vit konsum të mishit të gjedhit, nuk po flasim për lloje të tjera të mishit. Dhe, këtu tash lind problemi dhe nga këndvështrimi im ky është problem, i cili duhet të trajtohet në tri elemente kryesore.

Elementi i parë është krimi i organizuar ndërkombëtar. Pra, ka një interesim ndërkombëtar për shitje të mishit, i cili nuk i plotëson kushtet dhe është gjetur treg në Evropën Juglindore, dhe më saktësisht në Kosovë. Pra, një prodhues i mishit, në këtë rast konkret në shtetin e Belgjikës, me vullnet kriminal ka shitur mish, i cili nuk i plotëson kushtet për të dalë në treg. Blerës nga Kosova dhe rrjet zinxhiror blerësish nga Kosova kanë importuar mish, i cili nuk i plotëson kushtet për të dalë në treg, nuk i plotëson kushtet për t'u importua në Kosovë dhe këtu kemi tri lloj institucionesh, të cilat kanë dështuar.

I kemi institucionet vendore të Kosovës, institucionet vendore të shtetit shitës dhe kemi institucionet ndërkombëtare të verifikimit të tregjeve ndërkombëtare. Pra, këtu kemi problemin shumë më të multiplifikuar, sepse bëhet fjalë për një treg potencial rreth 200 milionë euro në vit. Nuk bëhet fjalë shakash këtu për interesa të individëve, ose për diçka tjetër. Dhe, meqenëse ne jemi këtu për t'u marrë me probleme sistimore, ne duhet të shohim se si të rregullohet ky problem sistemor. Dhe, nëse ju kujtohet në vitin 2008, ndër problemet e para që janë hasur ka qenë problemi i tendencës së marrjes së kontrollit të tregut të mishit nën përkujdesjen, sidomos të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nën përkujdesjen e Qeverisë në atë kohë. Ju kujtohen vargjet e protestave të kompanive në Kosovë dhe po ashtu protestat e prodhuesve të mishit dhe importuesve të mishit në Kosovë.

Problemi është shumë i thellë, sepse interesi ekonomik është jashtëzakonisht i madh dhe këtu kemi rrjet ndërkombëtar të krimit të organizuar të tregtisë me produkte të mishit dhe me mish, i cili e rrezikon drejtpërdrejt sigurinë e qytetarëve të Kosovës, prandaj njëri prej elementeve kryesor në ndikimin e rritjes së sëmundjeve të kancerit dhe sëmundjeve tjera në Kosovë janë produktet e ushqimit. Produktet e ushqimit në Kosovë të cilat merren janë të rrezikshme, të pakontrolluara dhe të pacertifikuara. Dhe, këtu e kemi një varg institucionesh vendore, të cilat kanë dështuar. Fokusi ynë kryesor është te institucionet vendore, të cilat kanë dështuar. Ka dështuar Qeveria e Kosovës, në kuadër të saj është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë dështuar Doganat e Kosovës, të cilat kanë për qëllim ta verifikojnë dhe kontrollojnë çdo produkt, i cili hyn në kufi të Kosovës. Pra, ato e kontrollojnë në kufi. Ka dështuar Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, e cila po ashtu në kufi e kontrollon ushqimin dhe kontrollon brenda territorit të Kosovës. Ka dështuar Inspektorati i Tregut të Kosovës, i cili kontrollon nëse produktet në treg i përmbajnë kriteret, të cilat ato proklamojnë që duhet t'i kenë. Ka dështuar Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe një varg agjencish tjera, sepse në Kosovë është ndërtuar sistem jofunksional me qëllim që të kemi këso lloj veprimesh në tregun e Kosovës dhe të ketë këso lloj përfitimesh.

Pra, bëhet fjalë për një treg jashtëzakonisht të madh, i cili po i rrezikon qytetarët e Kosovës dhe flitet për bashkëpunim kriminal ndërkombëtar dhe për një rrjet vendor të shpërndarjes të këtyre produkteve që nuk i plotësojnë kriteret për të dalë në treg dhe për një viktimë masive, pra flitet për dëm masiv ndaj qytetarëve të Kosovës, sepse këto produkte janë produkte jashtëzakonisht të

rrezikshme, sepse nëse e marrim të mirëqenë analizën e Ministrisë të Bujqësisë, e cila thotë se çmimi mesatar i mishit të gjedhit në Kosovë është rreth 4,70 euro, si ka mundësi që mishit të dalë në treg me 90 centë, me 80 e 70 centë.

Pra, në produktet e mishit këtu hyn në sistem rrjeti i organizuar kriminal vendor dhe sistemi i organizuar kriminal ndërkombëtar. Dhe, duhet bashkëpunim ndërkombëtar për ta luftuar këtë krim të organizuar dhe duhet shqyrtim i tërësishëm i sistemit të kontrollit dhe të verifikimit në Kosovë. Ka dështuar sistemi i kontrollit dhe verifikimit, dhe kjo është fatkeqësi e madhe, sepse dëmi është jashtëzakonisht i madh dhe është dëm ciklik, jo vetëm në treg, por edhe në shëndet, edhe në sistemin shëndetësor, edhe në sistemin e mirëqenies sociale dhe në tërësi i ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë qytetarët e Kosovës.

Prandaj, duhet të merret seriozisht kjo çështje dhe duhet të shihet në aspektin sistemor, duhet të shihet në aspektin kriminal dhe duhet të shihet në aspektin kriminal ndërkombëtar dhe pastaj në fund të garantojmë që e kemi një shtet i cili kujdeset për qytetarët e vet dhe i cili e parandalon këtë zinxhir kriminal që të mos paraqitet në sistemin tonë dhe të mos i dëmtojë interesat e Kosovës. Pra, mendoj se jemi para një sfide jashtëzakonisht të rrezikshme dhe është problem i cili i ka 20 vjet e tash ka dalë, sepse Belgjika paska vlerësuar ose vërejtur se produkt jociësor po shkon me sasi të madhe drejt Kosovës, ka hulumtuar dhe e ka parë se po rrezikohet shëndeti i qytetarëve të këtij vendi. Por, sistemi ynë në tërësi ka dështuar. Ky është problemi kryesor. Ka dështuar dhe këtu hyn elementi tjetër i rëndësishëm. Përderisa ka një treg kaq të madh me rreth 200 milionë euro në vit qarkullim, normalisht që hyjnë edhe interesat financiare të titullarëve dhe të të punësuarve në këto institucione, të cilat janë të thirrura për kontroll dhe verifikim të produkteve dhe këto janë elemente të korrupsionit dhe normalisht sa më shumë është presioni financiar, aq më lart ngrihet niveli i korrupsionit, prandaj institucionet e shtetit, Prokuroria patjetër dhe njësitë e specializuara të hetimit të policisë të hetojnë deri ku ka mbërri kjo sëmundje kanceroze e korrupsionit në produktet e ushqimit në sistemin kosovar. Dhe, këtu normalisht që janë të përfshira të gjitha kompanitë e mëdha dhe normalisht që janë të përfshira shumë institucione dhe ky rrezik është rrezik jashtëzakonisht i madh me të cilin ne duhet të merremi dhe të shohim se si ta zgjidhim si Kuvend.

Kuvendi ka përgjegjësi direkte, sepse ka lejuar të ndërtohet një sistem jofunksional. Qeveria ka pasur vullnet të mos e luftojë këtë dukuri, sepse ka transaksione jashtëzakonisht të mëdha financiare dhe kompanitë kanë përfituar direkt prej këtyre veprimeve kriminale që i kanë realizuar. Pra, duhet t'i marrin të gjitha përgjegjësitë dhe të prodhohen pasojat e një realiteti të ri në këtë fushë dhe parandalimit të këtij rreziku për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të përpiqem që disa nga vërejtjet dhe sugjerimet e kolegëve deputetë të mos i përsëris, por është një temë shumë e qëlluar. Të njëjtin shqetësim muaj më parë e kam ngrëhur në këtë foltore në deklaratimet jashtë rendit të ditës sa u përket problemeve, të cilat janë në veçanti pas skandalit me mishin që ka rrjedhur nga kompania “Veviba” e Belgjikës.

Kam kërkuar në atë diskutim që të bëhet publike se sa mish nga kjo kompani është futur në Kosovë përpara se të ndalohej dhe të bëhej publike. Unë jam i bindur plotësisht që Doganat e Kosovës kanë informacione të duhura, të cilat mund t’i bëjmë publike, sepse është shumë në interesin tonë, në veçanti të qytetarëve që t’i ditë edhe kompanitë vendore, të cilat kanë qenë dhe janë të lidhura me kompanitë tjera ndërkombëtare që kanë futur produkte të tilla jocalësore dhe të dëmshme për shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Gjithashtu, është me rëndësi që institucionet përkatëse të drejtësisë të merren me këto kompani, sepse përpara këtij skandali të mishit ne e kemi pasur edhe një skandal tjetër me mishin e pulës dhe gjithashtu rezulton se kjo lidhshmëri e këtyre kompanive vendore sa i përket distribuimit dhe shitjes së produkteve ushqimore, të cilat e dëmtojnë shëndetin e qytetarëve tanë, e kanë një lidhshmëri ndërmjet tyre dhe këto kompani, edhe pse po bëhen publike, edhe pse po fillojnë proceset hetimore ndaj tyre, nuk po kanë masa ndëshkimore.

Dua të shfrytëzoj rastin këtu meqë e kemi ministrin e Drejtësisë të pranishëm, Kodi Penal i Kosovës, respektivisht neni 267, parasheh dënime shumë të vogla për ata të cilët prodhojnë apo vënë në qarkullim artikuj ushqimorë. Pra, këta artikuj ushqimorë të dëmshëm për shëndetin e qytetarëve tanë tregtohen nëpër dyqanet tona, dhe ata të cilët i vënë në qarkullim asnjëherë nuk kanë pësuar masa ndëshkimore penale. Edhe ato masa ndëshkimore që parashihen me Kodin Penal për një tregtim të tillë të ushqimit janë prej 3 muaj deri në 3 vjet burgim. Dhe, rezulton që këta biznesmenë të fuqishëm, ashtu siç e tha zoti Gashi, që tregtojnë për afërsisht 200 milionë euro në vit, këta biznesmenë të suksesshëm kanë mundësi që të interferojnë në gjykata dhe këto lëndë vetëm të pushohen për gjashtë vjet në gjykata dhe të parashkruhen të gjitha lëndët e kontrabandimit të ushqimit në Kosovë.

Dhe, kjo ka bërë që të rritet edhe më shumë kontrabandimi me produktet ushqimore me mish dhe me produkte tjera ushqimore.

Pra, si është e mundur që Dogana e Kosovës ta lejojë zhdoganimin e mishit me për afërsisht 90 centë dhe derisa një mish i tillë në tregun e Kosovës tregtohet me afërsisht 5 euro, ose mish i gjallë i viçit me 2,20, ndërsa mishin i gatshëm të vijë nga Belgjika me 90 centë. Si është e mundur që Doganat e Kosovës ta kenë më mirë të rregulluar tregtimin e automjeteve dhe nuk lejojnë zhdoganimin e një automjeti nën çmimin real të tregut dhe e ka më të rregulluar me certifikatë

regjistrimi tregtimin me automjete se sa zdoganimin për produkte ushqimore. A është kjo rëndësia që institucionet tona dhe ne vetë si deputetë, përveç deklarimeve politike, nuk bëjmë asgjë më shumë që ta vëmë në kontroll sa i përket aspektit të cilësisë produkteve ushqimore?

Unë i dëgjova edhe diskutimet tjera të kolegëve deputetë këtu, por dua ta theksoj një rast që më ka ndodhur vite më parë para se të jem deputet. Derisa isha duke e zhdoganuar një makinë time në agjenci shpedicioni, aty erdhën disa kompani, të cilat ishin duke tregtuar qumësht pluhur, qumësht pluhur i cili ishte destinuar për Kosovë, por ishte ndalur në një vend transit para se të arrinte në Kosovë. Qumështi atje ishte ndalur, sepse kishte përmbajtje radioaktive. Dhe, në shpedicionin e Kosovës ndryshohen dokumentacionet sa i përket origjinës së ardhjes së atij produkti. Produkti e kishte origjinën nga Ukraina, qumësht radioaktiv me përmbajtje radioaktive - qumësht pluhur, ndërsa i ishte ndërruar dokumentacioni se gjoja po vjen nga një vend i Bashkimit Evropian. Derisa të tjerët ia kanë kushtuar rëndësinë më të madhe sa i përket mbrojtjes dhe shëndetit të qytetarëve tanë, atëherë cila është përgjegjësia jonë në këtë aspekt të rritjes së kësaj.

Do ta lidh këtë diskutimin edhe me debatin për Sistemin e Informimit Shëndetësor. Sikur ne ta kishim funksional Sistemin e Informimit Shëndetësor, i cili po zvarritet tani e shtatë vite dhe nuk ka ndonjë shpresë që të përfundojë edhe nja 3-4 vjet të ardhshme me këtë elan të punës. Dhe ndoshta është interes edhe i dikujt që të zvarritet edhe më tutje, sepse nëse e kemi funksional Sistemin e Informimit Shëndetësor, atëherë ne mund ta përcjellim edhe sëmundshmërinë dhe pastaj t'i gjejmë edhe shkaktarët, t'i hulumtojmë shkaktarët e rritjeve të sëmundjeve të caktuara, ashtu siç janë sëmundjet kancerogjene dhe të tjera.

Pra, duke e prolonguar një projekt shumë madhor, që është Sistemi i Informimit Shëndetësor, ne e pamundësojmë edhe përcjelljen e faktorëve, të cilët përcaktojnë rritjen e sëmundshmërisë. Dhe, nëse ne arrijmë ta bëjmë funksional edhe Sistemin e Informimit Shëndetësor, atëherë ne rezultojmë që t'i hulumtojmë edhe shkaktarët e rritjes së sëmundshmërisë. Po e marr një shembull, ne diskutuam sot edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi për një problem, i cili ka qenë evident, ka qenë i pranishëm edhe në medie, dhe problemin e insulinës biosimulare, e cila është ofruar në klinikat tona si insulinë humane dhe pasojat për shkak të malverzimeve që i ka bërë Ministria e Shëndetësisë vitin e kaluar, dhe vite më parë, janë me pasojat për shëndetin e shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe, unë gjithsesi kërkoj që Kodi Penal i Kosovës të parashohë rritjen e dënimeve më të mëdha për ata që tregtojnë produkte dhe i vënë në qarkullim produktet ushqimore, të paktën mos të jenë ndër dhjetë vjet, sepse parashkrimi i lëndëve pastaj do të kërkonte 20 vjet. Sepse, me këtë elan të punës të gjykatave tona çdo lëndë do të parashkruhej, sepse mesatarja e trajtimit të një lëndë nëpër gjykatat tona është 8-10 vjet.

Dhe, kështu si është me këtë dënim të vogël, maksimum tre vjet, i bie që të gjitha këto lëndë, edhe të kontrabandimit, të falsifikimit të barnave, edhe të kontrabandimit të produkteve

ushqimore të parashkruhen të gjitha. Prandaj, pasi jemi në një fazë të trajtimit të Kodit Penal, nga ministri i Drejtësisë kërkoj që këtë ta ketë parasysh, sepse aktualisht më sanksionues është falsifikimi i parave nëse dikush i ka bërë fals 20 euro, mund të dënohet deri në dhjetë vjet. Por, nëse ka tregtuar ose ka falsifikuar 20 pako me barna, apo 20 tonë mish, dënohet deri në 3 vjet. Pra, mendoj që kjo duhet të ndryshohet dhe të rriten masat ndëshkimore për ata që tregtojnë dhe kontrabandojnë produkte të dëmshme ushqimore dhe farmaceutike.

Dhe, edhe një herë kërkoj nga Doganat e Kosovës që t'i bëjnë publike kompanitë, të cilat i kanë tregtuar këto produkte ushqimore dhe të bëhet publike edhe për dyqanet e marketet, në të cilat është hasur mish i kontrabanduar, mish i me afat të skaduar. Është e vërtetë që ka edhe deputetë që janë pronarë kompanish të tilla dhe pavarësisht kësaj ne duhet ta bëjmë një komision hetimor, i cili ka për ta hetuar gjithë këtë proces, sepse ushqimi është përbërësi kryesor i shëndetit të qytetarëve tonë dhe ne duhet t'u ofrojmë atyre ushqim kualitativ. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përmbi tri orë dëgjuam shumë argumente dhe qëndrime të ndryshme. Pyetja ime është kjo: A nuk po e kuptojmë realitetin, në të cilin ne po jetojmë, apo na mbyti demagogjia e hipokrizia gjithandej?

Realiteti të cilin ne po e jetojmë është se shteti nuk është dizajnuar për qytetarin e ta mbrojtë atë, por është dizajnuar që t'i shërbejë e ta mbrojtë të fortin. Kjo edhe e tregon karakterin e këtij shteti. Ky shtet është bërë për t'i mbrojtur oligarkët. Po flasim për krim të organizuar këtu, e krim të organizuar aty, gjithkund krim të organizuar, veç shteti po na del shtet i paorganizuar.

U përmendën më herët 11 inspektorë në nivelin qendror. Hajde të merremi pak me matematikë. Prej tyre i bie që gjithmonë njëri është në pushim vjetor, që do të thotë i kemi dhjetë inspektorë efektivisht. Dikush prej tre kohë pas kohe sëmuret dhe po e llogaritim nëntë inspektorë e gjysmë. Në qoftë se një ekip duhet të përbëhet patjetër prej dy inspektorëve, i bie që ne kemi më pak se pesë ekipe në terren. Në qoftë se i kemi dy ekipe paradite, një pasdite dhe një ekip gjatë terrenit, imagjinojeni se si këto ekipe mund ta kontrollojnë ushqimin gjithandej Kosovës.

Prandaj, më herët fola për karakterin e këtij shteti, apo për fokusin se ku shteti është i interesuar që të investojë, që të punojë. Në vitin 1983, në Prishtinë, Komuna e Prishtinës i ka pasur 13 inspektorë sanitarë. Asokohe e kemi pasur vetëm "Gërminë", "Zhitoprometin", "Voçarin", disa qebaptore e çajtore. Në vitin 2013, Komuna e Prishtinës i ka pasur vetëm tre inspektorë sanitarë dhe dhjetëra-mijëra biznese, që është dashur të kontrollohen nga këta tre inspektorë sanitarë. Kjo prapë tregon për karakterin e shtetit.

Para diku rreth dy vjetësh, Ministria e Tregtisë së bashku me Bankën Botërore e patën marrë iniciativën për një projektligj për Inspektoratin. Paramendojeni, dëshironin që t'i obligonin me ligj inspektorët që ta lajmërojnë subjektin që do ta inspektonin dy javë para inspektimit dhe atë vetëm me leje apo autorizimin e shefit, apo të drejtorit. Kjo e tregon tendencën për mbrojtjen e biznesit me çdo kusht, edhe atyre bizneseve manipulative, në kurriz të kontrollit të atyre bizneseve. Bile-bile, në këtë kuadër edhe bënë shumë propagandë për nevojën për “doing business”.

Tash pak për mishin apo skandalin e mishit që u përmend më herët. Në Belgjikë është vërtetuar se kompania “Veviba” i ka dërguar tre kamionë të plotë, në total afro 70 mijë kilogramë në Kosovë para shtatorit 2016, që pastaj janë shitur në tregun kosovar. Nuk dihet zyrtarisht nëse mishi i dërguar ka qenë i prishur, mirëpo çmimi i blerjes për kilogram të atij mishi lë shumë vend për dyshime. Çmimi i blerjes ka qenë prej 0,90 euro deri në 1,30 euro për kilogram dhe kjo, sipas raportimit të medieve belge dhe Insajderit. Çmimi mesatar në tregun belg për mish viçi apo lope sillet nga 2,6 euro - 4,75 euro për kilogram për “çerekat” e mishit, siç quhet, ku afërsisht 20% e peshës është asht. Çmimi mesatar në tregun belg për mish viçi apo lope të pastruar nga ashti fillon me 4 euro deri në 20 euro kilogrami.

Fakti që mishi ka qenë i ngrirë nga viti 2004 nuk është problematik, nëse është respektuar temperatura e ngrirjes -18 gradë C. Kompania “Euro Ida” nuk e ka lajmëruar rastin, malli është ndaluar nga Dogana dhe është inspektuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ku është konstatuar edhe gjendja e mishit. Pas kësaj është lajmëruar FAV-ja belge apo Agjencia Belge për Sigurimin e Ushqimit, e cila ka dërguar inspektorët e vet në Kosovë. Me këtë rast, aty është vërejtur se mishi ka qenë i ripaketuar dhe se i gjithë mishi nuk e ka prejardhjen vetëm nga Thertorja “Veviba”, por edhe nga thertore të tjera belge, të cilat pastaj “Veviba” i ka paketuar apo ripaketuar këto produkte mishi.

Problemi në Belgjikë në raport me “Veviba” nuk qëndron te mishi i ngrirë apo kualiteti i mishit, mirëpo te ripaketimi dhe rietiketimi që u bë në mënyrë të dyshimtë. Fakti që pas konstatimit se “Veviba” i ka falsifikuar datat dhe etiketat është cilësuar si skandal dhe prandaj kjo kompani është mbyllur menjëherë. Më falni, nuk është mbyllur menjëherë, por është lënë të punojë deri në janar dhe shkurt 2018. Domethënë, dy vjet pas falsifikimit. Pas kontrollit në kompaninë “Veviba”, në janar dhe shkurt, janë gjetur shkelje serioze me etiketime, ku nga kontrollimi i 200 paletave të mishit 138 kanë pasur gabime serioze. Kompania “Veviba” e ka shpallur falimentimin menjëherë dhe i gjithë mishi që është gjetur aty është dërguar për asgjësim. Tash, çka është bërë me mishin që ka mbërrirë në Kosovë dhe i cili ka dalë në tregun e Kosovës dhe me çfarë çmimi është shitur?

Mendoj se është koha e fundit për reforma të thella, ku qytetarin dhe interesin e tij e vendosim mbi të gjitha dhe ku njëherë e përgjithmonë gjenden fajtorët dhe ndëshkohen. Ju e dini shumë

mirë funksionimin e gjykatave të Kosovës momentalisht. Shumica absolute e lëndëve të këtilla shkojnë në parashkrim. Prandaj, nuk është i rëndësishëm vetëm ndërrimi i Qeverisë, por edhe më i rëndësishëm është ndërrimi i mentalitetit qeverisës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sveçla! Fjalën e ka zoti Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë konsideroj se për tema të tilla, që prekin shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve, duhet të tregojmë kujdes pak më të madh dhe seriozitet pak më të madh si të zgjedhur të popullit, sepse vërtet çështja e skandalit të kompanisë belge me këtë sasi të mishit me afat të skaduar tregon për një gjendje goxha agonie të këtij shteti.

Duke qenë se jetojmë këtu, kemi familje dhe jemi konsumatorë të përditshëm, unë do të flas shumë shkurt. Në të gjitha këto skandale të këtyre mallrave me afat të skaduar nuk ka asnjë logjikë, as juridike, as institucionale, që sasi të tilla, kontingjentet e tilla të mishit me afat të skaduar t'i kalojnë tre filtra dhe të depërtojnë në filtrin e katërt apo të pestë deri te konsumatori. Nuk ka logjikë, as institucionale, as juridike, vetëm një raport që flet për diku 70 mijë kilogramë.

Ju lutem, ne nuk jemi shtet me 50 milionë banorë. Jemi me statistika zyrtare më pak se dy milionë dhe depërtimi i kontingjenteve të tilla në këtë shkallë është më tepër se alarm për institucionet.

Çështja e dytë dhe shqetësimi i dytë që dua ta ngre ka të bëjë me mosfunksionimin e hallkës institucionale, që nënkupton Zyrën e Kryeministrit, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe hallka e parë e mbrojtjes së shëndetit të konsumatorit, që është në Doganë, në të gjitha pikat doganore, ku inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë i kanë pikat e veta dhe janë të obliguar sipas ligjit që ta kontrollojnë çdo produkt ushqimor që ligji i autorizon dhe është përgjegjësi ligjore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Nuk dua të lëshohem në emra, por po diskutoj si konsumator, si qytetar, si prind dhe po diskutoj si deputet i zgjedhur, sepse duhet ta kemi një gjë parasysh. Pas të gjitha këtyre shkeljeve flagrante, pas kësaj kontrabande, qëndron politika, qëndrojnë aktorë politikë që kanë emër dhe mbiemër dhe tani nuk është çështje e Legjislativit dhe unë hezitoj që këtë foltore ta përdor dhe të involvohem në çështje të Gjyqësorit, por këtu është një mal me dokumentacion për Prokurorinë e Shtetit dhe është një alarm edhe për profesionistët. Më duket se e kemi vetëm një ekspert të veterinarisë, zotin Çausi, këtu të cilin e dëgjova me vëmendje dhe ky diskutim dhe diskutimet tjera që po i bëjmë për mbrojtjen e shëndetit të përgjithshëm të popullatës, në cilën adresë po shkojnë? Në veshë të shurdhër? A do të merret dikush me këto rekomandime dhe cili është atëherë roli i të zgjedhurve të popullit dhe i Parlamentit?

Edhe një herë po i drejtohem Kryeprokurorit të Shtetit, sepse ky është rrezikim masiv i shëndetit të popullatës. A ka gjë më të rëndësishme, më të përgjegjshme dhe më të shenjtë se shëndeti i shtetasve të Republikës së Kosovës?

Prandaj, ne mund të debatojmë me orë të tëra këtu, por pa filluar drejtësia t’i godasë, sepse këta janë më tepër se kriminelë që na i helmojnë fëmijët, na i helmojnë fëmijët, dhe t’i demaskojmë edhe ne gjithsesi, dhe t’i demaskojmë edhe njerëzit e politikës, që janë hallkë zinxhirore me institucionet përgjegjëse. Prandaj, u dërgojmë apel këtyre politikanëve të papërgjegjshëm që janë pas kësaj mafie të ushqimeve dhe institucioneve, sepse ky vend, ose ka institucione, ose nuk ka. Ky shtet, o funksionon, o nuk funksionon! Ne sot paradite, si Komision për Shëndetësi, e kishim shefin e Agjencisë për Produkte Medicinale. Është për të të ardhur keq që të gjitha medikamentet që hyjnë në Kosovë, hyjnë sikur ne të jemi ndonjë organizatë joqeveritare apo shoqatë bamirëse, që secili donator vjen dhe dhuron nga diçka.

Njëherë e përgjithmonë, në këto debate, në këto interpelanca, duhet t’i themi Qeverisë, ose kryeje punën, ose liroje vendin, vjen dikush tjetër që ka përgjegjësi pak më të madhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Më lejoni që të ju informoj rreth një çështjeje, që mendoj se na takon edhe neve ta shqyrtojmë dhe ta dënojmë një akt tepër të rëndë antidemokratik, do ta quaja antievropian, dhe do ta quaja pa ndonjë moral politik.

Sot kryetari i Parlamentit të Kroacisë ka qenë në vizitë në Serbi dhe përderisa ka qenë brenda në Parlament, zoti Vojislav Sheshel, e quajmë si të doni, kriminel lufte i dënuar me dhjetë vjet burg, e ka thyer atë shtizën e flamurit kroat dhe e ka përdhosur flamurin, e ka shkelur me grupin e vet parlamentar dhe delegacioni i Kroacisë e ka ndërprerë vizitën në Beograd dhe është kthyer në Kroaci.

Kryetari i Parlamentit të Kroacisë e ka gëzuar mbështetjen e shtetit të vet dhe të deputetëve të Parlamentit të Kroacisë dhe po e them këtë për faktin se shumë herë edhe ne po ballafaqohemi me probleme, të cilat i takojnë, ose janë vepra të nacionalizmit të tipit “Milosheviq e Sheshel”, por besoj se na takon edhe neve që ta dënojmë si akt, të gjithë së bashku. Mendoj se mjafton që Parlamenti i Kosovës është dakord, ose e dënon aktin si të tillë, duke e ndërprerë vizitën e një kryetari të Parlamentit të një shteti fqinj, të një shteti që e kanë njohur njëri-tjetrin.

Po vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka zoti Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Unë po përpiqem të mos e zgjas shumë fjalën time, sepse sot u thanë shumë fjalë.

Unë i përgëzoj iniciuesit e kësaj çështjeje, edhe pse konsideroj se është dashur shumë më herët, duke e pasur parasysh faktin se që nga viti 2016 kemi shumë raste mediatike dhe transparente që i ka bërë AVUK-u dhe institucionet tjera. Mirëpo, sido që të jetë, më mirë vonë se kurrë.

Konsideroj, po ashtu, që shumë kolegë thanë, ndër të tjera, për të mos e zgjatur atë çka thanë të tjerët, dua ta mbështes fjalimin e shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për ato që tha dhe ta mbështes kërkesën e deputetit Haradinaj për një hetim më të thuktë, më të mirë parlamentar në lidhje me gjithë ato që janë bërë për produktet e mishit.

Me pak fjalë, pa dashur të replikoj me dy parafolës, edhe pse m'u dha rasti shumë pak që të replikoj dhe pastaj ata vazhduan, duke ardhur nga një zonë që merret me bukë dhe janë bukëpjekës me traditë, por jo t'i mbroj ata për çështje të votave, siç tha zoti Milaim Zeka, por për hir të parimit dhe për hir të asaj se buka është ushqimi kryesor i njeriut dhe secili nga ne qytetarët e Kosovës, por edhe të botës, në baza ditore ushqehemi me këtë produkt. Mund ta them me plot përgjegjësi se nuk qëndrojnë të dhënat që i theksuan, as ministri i Shëndetësisë, e as zoti Milaim Zeka. Po ashtu, profesori i çështjeve bujqësore e tha shumë qartë se nga një kilogram miell dhe çështjen e çmimit sa bukë mund të dalin varësisht nga gramët. Por, unë e them shumë qartë atë se duke iu referuar zotit Zeka, nëse ai konstatoi se pesë herë rritet apo fryhet buka, unë i them se kjo s'qëndron, sepse po të ishte një bukë 10 cm e fryrë dhe nëse rritet me aditiv pesë herë, i bie që një bukë të jetë e lartë 50 cm. Unë nuk di ku ka parë këso buke, në Kosovë nuk ka. Mund të ketë të gjata, janë të njohura ato bukët franceze, që mund të jenë 50 cm apo 70 cm, por janë shumë të holla.

Po ashtu, edhe ministri që tha se bukët janë me aditiv 75 më shumë se doza e lejuar, edhe këtë e them në bazë të Rregullores për aditiv, ku nuk kufizohet përdorimi i tij. Dua ta përmend edhe faktin se edhe kripa është një lloj aditivi dhe është aditiv dhe këtu nuk ka sasi të caktuar apo të paracaktuar sa kripë duhet të ketë në bukë, kur e dimë se secili nga njerëzit e përdor atë në bazë të shijes së vet.

Aditivi është një produkt jashtëzakonisht i shtrenjtë dhe qëllimi dhe përdorimi i tij ka të bëjë me shijen që ia jep bukës dhe është mundësi më e lehtë të punohet ajo bukë. Kështu që nuk mund të konstatoj, ose nuk mund të pajtohem me konstatimet që i bënë dy kolegët e mi më herët. Nuk po dua të merrem me çështje politike, por neve na takon si deputetë, si institucioni më i lartë politik i këtij vendi, që nëse përmendim emra të politikanëve apo të dikujt, është mirë të flasim konkretisht për kë është fjala, sidomos t'u drejtohem organëve të Prokurorisë, e jo të merret një deputet apo një politikan, e të mos përmendet emri. Mund të jetë shumë afër tyre i ulur, mund të jetë në këtë sallë, por mund të jetë edhe jashtë institucionit tonë.

Po ashtu, unë dua të them se as Partia Demokratike e Kosovës, as unë si deputet, nuk jemi për amnistinë e asnjë përgjegjësi, përkundrazi do të kërkoj detyra shtesë, do të kërkoj vlerësim të performancës së punës së çdo drejtuesi të institucionit dhe punëtorëve që punojnë aty. Duke pasur parasysh që i referohemi të gjithë AVUK-ut, e konsideroj të arsyeshme që ne ta kemi një debat edhe më të thellë për këtë, edhe një komision hetimor, i cili do ta shohë punën dhe problemet e sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm për ne, për shtetin, e sidomos për shëndetin e qytetarëve tanë. Duke pasur parasysh faktin se përbëhet nga 11 veta, nga 11 persona, është e pamundur të mbulohet një territor sa është Kosova sot me këtë numër. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Natyrisht se pajtohemi me shumicën dërrmuese të kritikave që u dhanë, por ajo që besoj se duhet të theksohet po ashtu është fakti që gjendja e vështirë e popullsisë sonë nuk vjen thjesht vetëm nga mungesa e kriterëve, rregullave, komisioneve e mekanizmave shtetërorë, por vjen edhe nga varfëria e përhapur. Atëherë kur shumica dërrmuese e popullsisë, shumicën dërrmuese të herëve që shkon në vetëshërbim e blen mallin ekskluzivisht për shkak të çmimit më të lirë, natyrisht se nuk mund të presim shëndet të popullsisë dhe ky është problemi, për bindjen time themelore. Pra, varfëria e thellë, varfëria e përhapur, i kushtëzon njerëzit.

Njerëzit nuk janë të kushtëzuar vetëm nga importuesit që nuk kontrollohen në Kosovë, por janë të kushtëzuar edhe nga varfëria që kanë. Bashkimi Evropian e definon privimin material apo skamjen, si një situatë kur një individ nuk mund t'i përballojë të paktën katër prej dhjetë kategorive në vijim: të paguajë qira, fatura apo këste të kredisë, të mbajë shtëpinë të ngrohtë, të mbulojë shpenzimet e papritura; të hajë mish apo peshk çdo dy ditë, një pushim njëjavor jashtë, të ketë një veturë, makinë larëse, televizor me ngjyra apo telefon.

Pra, prej këtyre dhjetë kategorive, nëse qytetari nuk i ka së paku katër prej këtyre, konsiderohet që është i privuar materialisht, ose jeton në skamje. Një pjesë e mirë e popullsisë sonë jetojnë në skamje, sepse nuk është e logjikshme që qytetari ynë e blen kilogramin e mishit me një çmim aq të ulët, siç e shpjegoi deputeti Xhelal Sveçla, veçse prej një kushtëzimi të jashtëzakonshëm material në të cilin ai ndodhet.

Pra, me një bazë materiale kaq të ulët, ku qytetarët rregullisht i blejnë mallrat duke u bazuar në çmimet e tyre e jo në cilësinë, në vlerën e madje as nevojat që kanë, nuk mund të presim as emancipim, por as shëndet të popullsisë. Rrjedhimisht, unë nuk besoj që gjërat kryhen veçse me gjyqë, e me gjykata, e me prokurorë, e me polici, por çështja e varfërisë së përhapur të popullsisë duhet të adresohet, sepse nuk është mungesa e shtetit të së drejtës i vetmi faktor, është prania e

varfërisë së thellë, e skamjes së qytetarëve tanë, të cilët e durojnë këtë varfëri dhe janë të kushtëzuar në zgjedhjet të cilat i bëjnë.

Në këtë kuptim, ne duhet të mirëkuptim për njerëzit, të cilët janë të kushtëzuar nga rrethanat e vështira jetësore ose për ata që i vuajnë pasojat e zgjedhjeve të gabuara që kanë bërë në jetë.

Ky mirëkuptim yni duhet të shprehet në politika sociale në programe të partive politike, në njëjërën anë dhe, në ndarjet buxhetore në qeverisje, të cilat formohen pas zgjedhjeve, në anën tjetër.

Po nuk e trajtuam problemin edhe nga pikëpamjet e drejtësisë sociale, por vetëm nga pikëpamjet e drejtësisë gjyqësore, nuk do të gjejmë zgjidhje.

Ne mund të kemi të drejtë gjithë ditë me kritikën e mungesës së rendit, ligjit, shtetit të së drejtës, por nuk u shoqërua kjo edhe me një shtet social, që adreson në mënyrë prioritare varfërinë, papunësinë e madhe, shtrëngesat e bazës së ulët materiale, nuk do të gjejmë zgjidhje.

Edhe një herë po them, problemi kryesor për bindjen time është që shumica dërmuese e qytetarëve nëpër vetëshërbimet tona i blejnë mallrat duke ua shikuar veç se çmimet, duke e marrë vetëm çmimin më të ulët, pa e parë importuesin, cilësinë, përbërësit e atij malli që e blejnë.

Rrjedhimisht, për ta rregulluar këtë gjendje, përveç se duhet të merremi me mekanizma të munguar shtetërorë, duhet të merremi edhe praninë e varfërisë te popullsia jonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar kryetar Veseli,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që po na ndiqni,

Nga shumë deklaratimet e mia publike, kam thënë se shumë tema të cilat na vijnë në agjendë janë më pak prioritare se sa sot, këtë temë që po e diskutojmë.

Të gjithë pajtohem se para shëndetit, të jetuarit dhe të ushqyerit e shëndetshëm, nuk vjen asnjë prej këtyre si prioritet i parë.

Skandali i mishit, i cili ka plasur është fakt që tregon se është mbushur kupa dhe nuk zë më.

Pa dashur të përsëris ato që kolegët deputetë deklaruan në fjalimet e tyre, konkretisht si deputet i këtij Kuvendi të Kosovës kërkoj nga institucione ku ndodhen, nga Qeveria dhe nga zinxhiri i institucioneve dhe organeve përgjegjëse që të ndërmerren masat dhe hapat e duhur, qoftë të vënies para drejtësisë së personave përgjegjës, si dhe rritjen e kontrollit të asaj se çfarë hyjnë në vendin tonë dhe çfarë hanë qytetarët e Kosovës, pa përjashtim.

Fatbardhësisht, është parandaluar nga inspektorët tanë që ky mish të mos servohet para familjeve tona, në tryezat tona.

Po, pa e tepruar edhe më shumë në diagnostikimin e çështjes për të cilën po flasim, mendoj se nevojitet të plotësojmë infrastrukturën ligjore, e cila ashpëron masat për ata që tentojnë të fusin mallrat e ushqimit të dyshimtë në vendin tonë.

Organet ekzekutive, Qeveria dhe institucionet përgjegjëse të tjera, fjala vjen, dogana, Agjencia e Veterinës së Ushqimit të Kosovës, Inspektorati duhet të kenë nën kontroll të rreptë dhe të monitorojnë dhe të vlerësojnë se çfarë është i standardit dhe cilësisë, qoftë ai i ushqimit apo i mallit të ndonjë natyre tjetër që hyn në tregun e Kosovës.

Ngritja e kapaciteteve të institucioneve kontrolluese e inspektuese në vendin tonë, si në aspektin e burimeve njerëzore dhe atyre profesionale, është e domosdoshme.

Fjala vjen, me një numër të vogël të inspektorëve nuk mund të kesh kontroll efikas të asaj që konsumojmë ne si shoqëri.

Një propozim konkret, hera e parë që dëgjohet, është pajisja e doganierëve dhe inspektorëve me kamera personale që kur dalin në inspektim në terren, atë që e kontrollojnë, të jetë e regjistruar për t'u verifikuar kurdoherë. Kjo do t'i mënjante parregullsitë dhe dyshimet eventuale të secilit, do të pamundësonte futjen e mallrave në të zezën dhe atyre jociësore në Kosovë.

Në anën tjetër, do t'i mundësonte një konkurrencë të barabartë të bizneseve dhe të tregut brenda territorit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për çështjen në fjalë duhet të unifikojmë dhe të mos politizojmë, duhet që pa dallime të përpiqemi dhe të angazhohemi përfundimisht të bëjmë diçka të shënuar dhe në dobi të qytetarëve tanë, të shëndetit tonë, të familjeve tona dhe të gjithë qytetarëve.

E kemi rastin që me veprimet që do t'i ndërmarrim, ta përmirësojmë jetën në të mirë të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Milaim Zeka, replikë!

MILAIM ZEKA: Jo, kryetar, Në atë që e tha Neza, njëmend po dysjoj që ky ose ka punuar në furrë, ose ka furrë të bukës, e para.

E dyta, desha ta demantoj Nezën që tha ushqimi kryesor i shumicës prej neve është buka, prej nesh ushqim kryesor këtu si deputetë është mishi, ne bukë rrallë hamë.

Edhe sa i përket tharmit, është shumë e vërtetë ajo që e kam thënë që përdoret përtej çdo norme, këtë ma kanë thënë ekspertë të ndryshëm, edhe profa më tha pak e ke rritur, veç tri herë i qesim, jo pesë, po nuk ka rëndësi. Domethënë i qesin mbi mesatare dhe ajo jep direkt kancer, shkakton kancer, këtë nuk e kam nxjerrë prej vetes, po e kam dëgjuar prej ekspertëve që ma kanë thënë në Kosovë.

Prapë po them, ka furrtarë shumë të ndershëm, nuk e bëjnë të gjithë, por një pjesë e bëjnë dhe ata që e bëjnë, nuk pres të më votojnë.

Dhe, e treta, i dashuri Nezë, unë e përmenda edhe një fakt tjetër që hyn shumë qumësht pluhur në Kosovë. Merri statistikat sa hyn tharm i bukëve brenda një viti, sa hyn qumësht pluhur dhe pastaj do e shihni rezultatin e tmerrshëm në Kosovë se çka hamë e çka pimë.

Edhe fare në fund po them që ka dalë një statistikë që 340 ushtarë italianë kanë vdekur nga kanceri për shkak të ushqimit në Kosovë dhe të uraniumit dhe këtë temë kur nuk e kemi diskutuar. Këto janë shifra zyrtare që i ka dhënë Organizata e Kombeve të Bashkuara.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Unë i them zotit Milaim, të dashurit Milaim që ndihem shumë krenar që e përfaqësoj atë pjesë dhe sinqerisht e di këtë zanat, të mos them ndër më të mirët, po mbi mesatare jam, këtë profesion e kemi prej stërgjyshit, babagjyshit, babës, krejt ajo zonë e punon shumë, nuk kanë pasur të shkretit mundësi kurrë në punë të shtetit të punojnë asnjëherë, për mbijetesë ka qenë, dhe unë jam shumë krenar për këtë.

Sa i përket tharmit, po të ishte tharmi kancerogjen, unë nuk di qysh do të mund të jetonim në Kosovë ose unë me 48 vjet që kam hëngër bukë, qysh kisha mundur të jetoj nga diçka që është kancerogjene. Nuk ka mundësi logjike kjo, ose jo vetëm në Kosovë, po edhe në botë, ai tha përdoret edhe në SHBA, edhe në Evropë, edhe diku tjetër, s'ka mundësi të jetë kjo.

Për qumështin, unë nuk di, Milaim, qumështin e pi, po nuk di ta përpunoj as të bëj diçka për të, për bukën e them me përgjegjësi. Ato që i ke thënë, nuk qëndrojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sot pothuajse nuk ka mbetur asgjë pa u thënë nga deputetë, në përgjithësi, të të gjitha grupeve parlamentare dhe ajo së paku si emërues i përbashkët i krejt kësaj është që gjendja është shumë e rëndë, shumë e keqe dhe që duhet të merren masa urgjente që të ndërpritet kjo indiferencë shoqërore në përgjithësi, indiferencë institucionale në këtë çështje.

Në fund të fundit, këtu jemi pothuajse pak a shumë të barabartë, të gjithë e konsumojmë këtë ushqim, të gjithë herët apo vonë, pak apo shumë, biem në kurthin e mishit apo të të gjitha llojeve të produkteve ushqimore, të cilat u tha që janë edhe kancerogjene, edhe të dëmshme, edhe shkaktojnë rënie të imunitetit, edhe shkaktojnë sëmundje nga më të ndryshmet.

Pra, le ta shfrytëzojmë këtë moment të debatit gjithëpërfshirës që të gjithë ta kryejmë detyrën tonë, siç na takon edhe me ligj, po siç na takon edhe si parti politike, edhe si grupe parlamentare. Gjithsesi që Qeverisë i takon më shumë të bëjë në këtë drejtim për faktin se instrumentet e shtetit i ka në dorë, për faktin se vendimmarrje u takon atyre.

Ne sot mund të nxjerrim një rezolutë, mund të nxjerrim rekomandime, mund të nxjerrim përfundime, por vendimet dhe ekzekutimet e vendimeve gjithsesi që i takojnë Qeverisë t'i bëjë.

Unë besoj shumë që tani në përfundim do të mblidhen përfaqësuesit e grupeve dhe do të gjejnë një emërues të përbashkët se çka t'i prezantojnë Kuvendit, çka të votojnë në bashku që t'i jepet fund kësaj mënyre të trajtimit të kësaj çështjeje.

Nuk do mend, as nuk ka nevojë të përsëritet që dikush po fiton nga kjo, por le të jenë të sigurt edhe ata që janë duke përfituar nga kjo, se kjo do të shprehet edhe në shëndetin jo vetëm të popullatës, edhe në shëndetin e tyre, edhe në shëndetin e familjarëve të tyre, edhe në shëndetin e fëmijëve të tyre, sepse të gjithë jetojmë në këtë vend.

Kemi shpeshherë iluzionin se tani kemi më shumë zgjedhje, mund të kemi më shumë zgjedhje në markete, po të gjitha marketet kanë të njëjtin furnizues, në fund të fundit, apo kanë furnizues të njëjtë, të cilët furnizohen nga jashtë dhe u pa dhe u tha edhe këtu që, edhe ata jashtë nuk janë aq imun nga korrupsioni, nga krimi i organizuar, sepse rrjeti i krimit të organizuar në Kosovë që merret me këtë çështje është lidhur ngushtë me rrjetin e krimit të organizuar që funksionon jashtë, qoftë në Evropë, qoftë në Brazil, qoftë në SHBA.

U përmendën këtu linjat e veçanta të prodhimit për tregje, të cilat janë më pak të kontrollueshme apo fare të kontrollueshme.

Ne e dimë që Brazili dhe SHBA-ja prodhon shumë mish, edhe Urugai, edhe Argjentina, por për tregjet të cilat kontrollohen më shumë, më mirë, edhe ata kujdesen që të mos dërgojnë, sepse çdo kapje e një transporti do të penalizonte kompaninë me muaj apo me vite, për të mos pasur të drejtë më të eksportojë mallra të cilat janë të dëmshme apo të rrezikshme për shëndetin.

Këtu le të ndajmë më shumë buxhet, le të merret një vendim që të ndahet më shumë buxhet, të ngrihen kapacitetet e kontrollin në doganë, në shitore, në thertore, kudo që ka nevojë dhe të jeni të sigurt që pa kaluar një vit, nëse vendoset që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin e duhur, së paku me seriozitetin e nivelit të alarmit, të cilin e dhamë sot këtu dhe janë duke dhënë mediet në përgjithësi pothuajse disa muaj, të jeni të sigurt që brenda një periudhe shumë të shkurtër njëvjeçare do të vërehet ndryshimi, do të vërehet dallimi edhe në produktet që do të hyjnë në Kosovë, do të vërehet dallimi edhe në shëndetin publik, sepse të gjithë e dimë që ushqimi, siç e tha kolegu Kamish, është një nga përbërësit kryesorë të ushqyerit, dhe duhet të investojmë që ta mbrojmë ushqimin nga kontrabandistët, nga krimi i organizuar që së paku aty të mos e lëmë të fusë duart, ta nxjerrim nga ky treg dhe do ta shohim të gjithë së bashku që edhe vizitat nëpër spitale, edhe vizitat nëpër qendra të mjekësisë familjare do të jenë më të pakta.

Unë uroj që këtu, ashtu siç kemi qenë kritikë ndaj dukurive negative, të jemi unikë edhe në arritjen e qëndrimeve të përbashkëta, në mënyrë që Qeverisë t'i japim detyrë të ndajë fonde dhe të merret më seriozisht me këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ahmet Isufi, nuk qenka këtu, atëherë e fundit propozuesja, Ganimete Musliu, e ka një propozim.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që ta falënderoj secilin debutues sot për kontributin e dhënë në këtë debat, pavarësisht debatit që ishte bukur i ashpër. Unë mendoj që qëllimi ynë ishte i përbashkët, ishte parandalimi ose thjesht eliminimi i situatës që është krijuar aktualisht në Kosovë dhe frikës që është krijuar në sigurinë e ushqimit.

Unë si iniciuese e këtij debati, bashkë me Grupin e Pavarur të Deputetëve, ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që bashkërisht t'i harmonizojmë rekomandimet tona, të cilat do t'i drejtohen Qeverisë.

Edhe një herë, si deputete e këtij Kuvendi, por besoj që këtë shqetësim e ndajnë të gjithë deputetët sot me mua, shpreh dëshpërimin e madh për mungesën e Kabinetit qeveritar gjatë gjithë kohës kur ne po debatonim.

Ndërsa, më lejoni që për opinionin, po edhe për vete, ta falënderoj shumë ministrin Abelard Tahiri, i cili gjatë gjithë kohës ishte me neve sot në seancë.

24. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues, në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur nga 11 deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me korrupsionin, si kriter për liberalizimin e vizave.

E ftoj deputeten Shqipe Pantina, që në emër të propozuesit t'i paraqesë çështjet, për të cilat është kërkuar debati parlamentar. Zonja Pantina, e keni fjalën!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Po të ishte korrupsioni kriter, besoj moti e kishim marrë liberalizimin e vizave, po kriter është luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar.

Të nderuar kolegë,

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës mbi kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, ne i kemi parashtruar Kuvendit kërkesë për të organizuar debat lidhur me luftimin e korrupsionit, si kriter për liberalizimin e vizave.

Qytetarët e Republikës së Kosovës janë të vetmit në Evropë, të cilët nuk mund të udhëtojnë lirshëm në vendet e BE-së, për shkak se Kosova ende i nënshtrohet regjimit të vizave.

Komisioni Evropian, në vlerësimin e fundit të tij, kishte vlerësuar se Kosova i kishte edhe dy kushte për të përmbushur, në mënyrë që qytetarët e saj të gëzojnë lëvizjen e lirë.

Ishte ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Pas ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit më 21 mars të këtij viti, pa dashur të thellohemi se sa e dëmshme ishte kjo marrëveshje, kushti i vetëm i paplotësuar për liberalizim të vizave mbetet luftimi i krimit dhe korrupsionit.

Është më se e domosdoshme që Republika e Kosovës të ndërmarrë pa vonesë të gjitha veprimet e nevojshme për të përmbushur kushtin e luftës kundër krimit dhe korrupsionit dhe është përgjegjësi e këtij Kuvendi të diskutojë dhe të hartojë strategji të duhura që të sigurojë përmbushjen e këtij kriteri.

Për këtë arsye, në emër të Grupit Parlamentar të Deputetëve të Pavarur ne kërkojmë që kjo çështje të diskutohet në debat parlamentar, ku bashkërisht edhe me grupet e tjera parlamentare, të nxjerrim përfundime me detyra konkrete për institucionet e vendit, përgjegjëse për luftën e korrupsionit dhe krimit, siç parashihet në nenin 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Korrupsioni, sipas definimit të përgjithshëm, nënkupton shfrytëzimin e resurseve publike dhe të pushtetit për përfitim personal apo të grupit të ngushtë.

Është një formë e pasinqertë dhe e pandershme e veprimit nga një person, të cilit i është dhënë besimi për një punë të caktuar.

Pra, me një fjalë, korrupsioni është një e keqe, nga e cila tenton të përfitojë ai që e kryen veprimin korruptiv, por humbjet dhe pasojat i bart e gjithë shoqëria.

Korrupsioni, pra, si një e keqe, nga e cila pasojat po i vuajmë të gjithë, e përfitues janë vetëm disa, duhet luftuar dhe si problem tashmë i rëndë i shoqërisë sonë këtë luftë duhet ta bëjmë të gjithë.

Luftimi i tij nuk duhet të bëhet për shkak se tashmë ai është një kusht për liberalizimin e vizave, sepse ky duhet të jetë synimi ynë nëse duam të funksionojmë si shoqëri e shtet i civilizuar e modern.

Megjithatë, tashmë është fakt se luftimi i korrupsionit është vënë edhe kusht nga institucionet e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të gëzojmë lëvizjen e lirë pa viza në vendet anëtare të saj.

Prandaj, po e marrim si shkas, në mënyrë që të debatojmë se si mund ta luftojmë këtë të keqe.

Ne jemi të vetëdijshëm se Kuvendi i vetëm nuk mund ta luftojë korrupsionin, por ai si organi më i lartë vendimmarrës në vend duhet të marrë përgjegjësinë kryesore dhe rolin udhëheqës në këtë luftë, duke kërkuar përgjegjësi dhe llogari nga institucionet që janë drejtpërdrejt përgjegjëse.

Dhe, mbi të gjitha, duke qenë vetë si institucion i përgjegjshëm dhe llogaridhënës dhe të luftojë korrupsionin brenda vetë Kuvendit.

Para këtij debati grupi ynë i deputetëve kemi organizuar një tryezë me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të përfshira në aktivitetet që kanë qëllim luftën e korrupsionit dhe unë dua t'i falënderoj të gjitha këto organizata, jo vetëm për kontributin e tyre në tryezë, por edhe për punën që bëjnë në vazhdimësi në luftë kundër korrupsionit.

Të gjetura nga raportet që këto organizata i kanë publikuar janë vërtet shqetësuese.

Nuk ka asnjë sferë të jetës tonë shtetërore e institucionale ku nuk hasen veprime korruptive; në arsim, në shëndetësi, në biznes, e mbi të gjitha në institucione shtetërore.

Tashmë janë disa aktivitete, procese, në institucione që vetëm kur përmenden, të asociojnë me fjalën korrupsion, siç është, për shembull, fjala 'prokurim' apo tjetra 'tender'.

Procesi i prokurimit në institucionet publike, si ato të nivelit qendror, e po ashtu edhe ato të nivelit lokal, është bërë një oazë e korrupsionit dhe kjo nuk është vetëm perceptim.

Tashmë ka dhjetëra raste nëpër prokurori e gjykata për vepra korruptive me tenderë.

Përderisa deputetë, ministra e zyrtarë të tjerë institucionalë deklarojnë çdo vit pasurinë, zyrtarët e prokurimit që menaxhojnë miliona euro, nuk e bëjnë një gjë të tillë. Ndërsa perceptimi publik është se shumë nga këta zyrtarë brenda një afati kohor të shkurtër kanë rritje krejtësisht të pajustificueshme të pasurisë së tyre.

Një lloj procesi të vetingut, i cili duhet të ndodhë pa tjetër, duhet t'i nënshtrohen edhe zyrtarët e prokurimit.

Por, institucionet kryesore që duhet të luftojnë korrupsionin janë pa dyshim organet e drejtësisë: prokuroria dhe gjyqësori, sepse nuk mund të kryhet një vepër korruptive, e cila të mos ketë elemente të veprës penale.

Gjyqësori ynë ka dështuar në luftën kundër korrupsionit, po për fat të keq, nuk janë të vogla rastet kur edhe vetë janë përfshirë në vepra korruptive. Prandaj, ata e bartin një barrë të madhe të fajit, edhe për fatin pse ne sot nuk gëzojmë liberalizim të vizave.

Komisioni Evropian ka evidentuar 39 raste, të cilat drejtpërdrejt lidhen me procesin e liberalizimit të vizave, e nga të cilat, sipas Këshillit Gjyqësor, vetëm gjashtë prej tyre kanë marrë vendim të formës së prerë.

Ndërsa sipas Këshillit Prokurorial, për tri nga këto raste kanë pushuar fare hetimet, përderisa për një rast janë pezulluar ato. Ndërsa, pesë raste të tjera janë ende në fazën hetimore apo parahetimore.

Për më tepër, është tejet shqetësuese kur prokurorë apo gjykatës tërhiqen nga rastet që i kanë nën hetim, respektivisht nën gjykim, në fazën pothuajse përfundimtare, atëherë ku do të duhej të jepej verdikti.

Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se gjyqësori është i pavarur në punën e tij dhe nuk duhet të ketë ndërhyrje politike dhe mu këtë i kërkojmë Gjyqësorit, pra të mos ndikojë nga politikanët në punët e tyre dhe t'i përmbahen parimit se para ligjit të gjithë janë të barabartë.

Të nderuar kolegë,

Unë ju ftoj të gjithëve që në diskutimet tuaja të paraqitni edhe propozime e rekomandime, të cilat ne do t'i përfshijmë në versionin përfundimtar të një dokumenti, qoftë rezolutë apo të ngjashme, e që ne propozojmë ta nxjerrë ky Kuvend. Disa prej rekomandimeve, gjegjësisht propozimeve që ne i japim të jenë pjesë e këtij dokumenti janë:

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të rritet buxheti dhe të ngritën kapacitetet profesionale për sektorin e drejtësisë, gjegjësisht Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor. Disa hapa tashmë janë ndërmarrë, ne kemi në shqyrtim Ligjin për Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor, megjithatë këto nuk duken të jenë të mjaftueshme.

Ne si Kuvend u bëjmë thirrje organeve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, që të jenë më efikase në zgjidhjen e rasteve që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ne kërkojmë nga Qeveria hartimin dhe procedimin në Kuvend brenda këtij viti kalendarik të projektligjeve që lidhen me forcimin e masave në luftën kundër korrupsionit, gjegjësisht pakon e ligjeve antimafia, Projektligjin për vetingun, si dhe Projektligjin për financimin e partive politike. Ne kërkojmë depolitizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera të pavarura. Kuvendi, po ashtu kërkon që memorandumit i mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar për bordet të zbatohet në tërësi.

Këto janë vetëm disa nga propozimet që ne i japim dhe ne ju ftojmë që diskutimet tuaja të jenë konstruktive dhe, mbi të gjitha, të japim propozime konkrete, të cilat në fund si Kuvend do t'i votojmë dhe do t'ua rekomandojmë edhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Pantina! Fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i LDK-së, a do të flasë dikush?

Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Është për t'u respektuar kërkesa e deputetëve që kërkojnë edhe debat parlamentar për një çështje, e cila është e rëndësishë së veçantë dhe është bërë pengesë për ecjen e Kosovës drejt integriteteve evropiane, siç është korrupsioni në institucionet tona, por edhe pjesa tjetër që lidhet me kriteret për liberalizim të vizave, si detyrë e dalë nga rekomandimet e Komisionit Evropian, por mbi të gjitha, si synim yni që krimi i organizuar dhe korrupsioni të luftohen në mënyrë permanente.

Ato çka i tha kolegja Shqipe Pantina ekzistojnë dhe janë pjesë e detyrimeve dhe e përditshmërisë që përballen institucionet tona, mbi të gjitha ata që me të vërtetë e dëshirojnë sundimin e rendit dhe të ligjit në vend. Pjesa tjetër që ndërlidhet me përmbushjen e detyrave, përpos aspektit legjislativ, i cili është i kënaqshëm, pjesa tjetër e veprimeve adekuate edhe sot e kësaj dite, edhe nga publikimi i raportit që tash është në duart e institucioneve tona, tregon qartë që ne kemi mungesë të rezultateve konkrete në luftimin e dukurive negative, mbi të gjitha të korrupsionit, si gangrenë e cila është bërë përditshmëri dhe e cila faktikisht përkrahet nga njerëzit e politikës, mbi të gjitha edhe nga ata që janë vetë në institucionet qeverisëse, duke marrë parasysh edhe aktakuzat e fundit që janë të ngritura për afëra korruptive.

Dhe, tash si Kuvend besoj që edhe në debatet e tjera ne duhet të jemi jo vetëm debatues në këtë formë, por të insistojmë në rezultate, duke bashkërenduar aktivitetet dhe duke rritur ndikimin pozitiv edhe mbi atë që ne e quajmë kategorinë kushtetuese e pavarur, siç janë organet e drejtësisë. Ajo çka është parë dhe është dëgjuar edhe kohët e fundit, tregon që këto çështje do të jenë problem në ecjen e Kosovës dhe në përmbushjen e kriterit për liberalizim të vizave, siç është korrupsioni.

Rastet e fundit, tentimi qoftë për t'i mbyllur apo edhe qoftë edhe për t'i politizuar ato që quhen 'afëra të mëdha korruptive' nga njerëz të politikës, të implikuar në krim të organizuar, në shpëlarje të parave, në shitje të pronave, kanë lënë shije të keqe dhe do të jenë problematike edhe në imazhin, pasqyrimin dhe në ndjekjen e mëtutjeshme të rasteve, po e përdor si terminologji "të peshqve të mëdhenj", pa e dalluar korrupsionin nga baza që quhet i imtë dhe deri te tenderomania e madhe që përflitet në institucionet e Republikës së Kosovës. Kuvendi nga ky pozicion besoj që do të duhej jo vetëm të jetë ngritës i zërit, por përcjellje e rekomandimeve të qarta dhe një lloj kërkesë e raportimit, përpos pjesës së detyrimeve të komisioneve funksionale, të jetë edhe pjesa proaktive e debateve dhe përmes ministrive të linjave.

Sot e kemi të pranishëm ministrin e Drejtësisë, i cili në vazhdimësi e ka proklamuar, nuk do ta quaj me fjalë, luftimin e kësaj, apo vullnetin që të shprehë edhe të inkurajojë edhe këshillat gjyqësorë dhe Këshillin Prokurorial që të jenë më proaktive në eliminimin apo edhe në minimizimin e asaj që quhet 'rec-records' tash si kusht i vënë nga Komisioni Evropian, por edhe raste të tjera që dalin në vazhdimësi dhe që ndërlidhen me njerëzit e politikës.

Kështu që insistimi ynë për njerëz me duar të pastra nuk është vetëm thirrje, kjo po shihet që është më shumë detyrim, është më shumë se sa vlerë dhe vullnet. Ne inkurajojmë Qeverinë, i bëjmë thirrje edhe nga ky pozicion që sa më shpejt të jetë, në mënyrën se jo vetëm është bërë tepër detyrim, por mbi të gjitha të shihet vullnet që ndikimi mbi politikën, ndikimi i politikës mbi drejtësinë nuk është vetëm interferim i drejtpërdrejtë, por edhe lirimi i pozicioneve, të cilat e krijojnë një pasqyrë lehtësuese që njerëzit e drejtësisë mund të marrin vendime pa interferim të organeve qeveritare, çfarëdo niveli qofshin ato.

Kështu që nesër ne po presim edhe për një zberthim, tash të të gjeturave të Raportit të progresit që mbi të gjitha janë më shumë se sa detyrim dhe, krahas kësaj debati parlamentar besoj që rekomandimet duhet të jenë shumë të qarta, shumë afatshkurtra dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta japë kontributin e tij në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj!

Unë e kam një lutje, mos e hapni shumë atë gamën e akuzave, po koncentrohuni në qoftë se ka diku, kanë emër, mbiemër, edhe njerëzit, edhe institucionet. Tani unë dëgjova edhe këtu që deputetët kanë, s’di çka thanë, gjithçka kishin, nëse ka dikush, jemi 120 deputetë, bëjmë me gisht, ka mundësi të debatohet për individin, individi për vete, institucioni të përballet me akuzat, nesër, sot, s’është me rëndësi shumë, por jo kështu, se po mendojnë edhe qytetarët që përnjëmend krejt deputetët, krejt kush punon në institucione të shtetit është hajn, është i korruptuar, është s’di çka, s’e di a kemi mirë kështu, a jo? Në qoftë se është mirë, vazhdoni. Faleminderit!

Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Detyrimisht, ne përcaktojmë rolet dhe detyrimet, edhe mandatin çfarë e kemi si deputetë, duke u munduar ta ruajmë pavarësinë mes institucioneve, sepse edhe në aspektin e pjesës profesionale, si legalistë po mundohemi ta ruajmë atë baraspeshën mes asaj që po e quajmë ‘mosndikim i drejtpërdrejtë në drejtësi’. Nëse doni emra për raste të caktuara, unë po e përmend vetëm një, që përmendet në të gjitha raportet ndërkombëtare, të cilat e shohin si pengesë ecjen e Kosovës në liberalizimin e vizave. Është rasti i fundit, rasti “Toka”. Tash nëse doni ju, zberthejeni vetë kush qëndron prapa atyre dhe kush janë të akuzuarit në atë rast?

KRYESUESI: Në rregull, por nuk është Qeveria në rastin “Toka”, këtu është problemi. Ajo është në proces, tani në qoftë se hapim ‘petën e lakrorit’, dalin sende shumë, a po di?. Po, të koncentrohemi në tema, në tema konkrete, jo gjerë se duhet hapur ‘petën e lakrorit’, del baltë në të gjitha anët. Zoti Krasniqi, e ke fjalën!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë besoj që edhe nëse e hapim ‘petën e lakrorit’, nuk bëjmë ndonjë gabim shumë të madh, por problemi është që të jemi konkretë në ato që i themi dhe nëse dikush do ta marrë ndonjë farë krediti partiak ose politik, të paktën le të ketë kurajën e të flasë me emra, le të ketë kurajën të flasë me raste konkrete, ashtu pastaj do t’ia bëjmë të gjithë, pavarësisht që mund të dukemi sikur jemi në ndonjë farë kryeprokurorie, por sidoqoftë, është në mandatin e secilit të flasë ashtu siç mendon.

Në këtë fjalë hyrëse në emër të grupit parlamentar, unë do të fokusohem pak a shumë tek pjesa e përgjegjësisë të Qeverisë, përkundër faktit që Qeverinë në këto tri ditë nuk kemi arritur shumë ta shohim, përveç ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shëndetësisë gjatë ditës së djeshme. Sidoqoftë, Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj të punës ka paraparë si një nga objektivat kryesore dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar vazhdon të mbetet një prej sfidave kryesore të vendit tonë dhe është prioritet i vazhdueshëm i institucioneve të Republikës së Kosovës, përkundër që në të kaluarën janë ndërmarrë masa përkatëse, institucione të caktuara realisht nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme diku në hetimin, e diku në luftimin e korrupsionit, duke përfshirë edhe zbatimin e dobët të legjislacionit, i cili megjithatë është legjislacion në pajtim me rregullativën e Bashkimit Evropian.

Sidoqoftë, unë besoj që Qeveria aktuale është duke treguar vullnet dhe përkushtim në luftën kundër korrupsionit, veçmas për sa i përket fushës së drejtësisë, duke ndërmarrë tashmë nisma ligjore shumë të rëndësishme, të cilat unë besoj janë premtuese edhe në kuptimin e eliminimit të zbrazëtirave ligjore dhe institucionale, të cilat deri më tani janë evidentuar edhe nga ne, por edhe nga monitoruesit dhe raportuesit ndërkombëtarë si pengesa për të arritur rezultatet, të cilat i presim dhe i dëshirojmë të gjithë.

Përmirësimi dhe forcimi i kornizës legjislative dhe institucionale për luftimin e korrupsionit do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin ndërmjet institucioneve për zbatimin e kornizës legjislative dhe strategjike lidhur me këtë qëllim. Megjithatë, bazuar në të dhënat e raporteve të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, vërehet se nevojiten përpjekje të përbashkëta të sistemit të drejtësisë, por edhe të mekanizmave të tjerë që kanë për mision luftën kundër korrupsionit, në mënyrë që të ndërtohet një sistem më i fuqishëm institucional që prodhon rezultate konkrete në këtë betejë dhe që përfundimisht krijon dhe e rrit besimin e qytetarëve në institucionet dhe në sistemin e drejtësisë. Këto janë edhe rekomandime që dalin edhe nga Raporti për vendin, i publikuar dje nga Komisioni Evropian dhe për të cilin unë besoj që do të kemi mundësinë që të diskutojmë më gjerësisht ditët në vijim.

Tashmë, pra jemi edhe dëshmitarë që Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë disa reforma shumë të rëndësishme legjislative që ndërlidhen edhe me Agjendën për reforma evropiane, për reformimin

e sistemit të drejtësisë, duke hartuar dhe propozuar politika të reja për institucionet kryesore që janë bartëse në sistemin e drejtësisë, për fillimin e nismave ligjore që ndërlidhen konkretisht me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, atë që e po quajnë “pakoja e ligjeve antikorrupsion”, rishikimin e legjislacionit penal dhe fillimin e procesit të rishikimit funksional në sektorin e sundimit të ligjit, në të cilin proces unë besoj që Ministria e Drejtësisë, së bashku edhe me Qeverinë në përgjithësi, por edhe me institucionet e tjera, do të rishikojë edhe shumë mekanizma aktualë që realisht kanë mandatat të paqartë, e në raste të caktuara edhe përplasje të mandateve, të obligimeve dhe përgjegjësi të tyre. Sepse, duket se mungesa e objektivave të sakta nga institucionet kryesore për të krijuar mekanizma efikas për luftim të korrupsionit dhe krijimi i organeve të shumta e kanë ndërlidhur deri diku identifikimin e institucioneve përgjegjëse dhe kanë bërë që rezultatet e përgjithshme të mos jenë të kënaqshme, në raste të shumta, janë edhe të dobëta.

Si grup parlamentar, po e ritheksoj që ne i mirëpresim këto nisma legjislative dhe shpresojmë që do të ketë mbështetje, siç ka pasur deri më tash edhe nga grupet e tjera parlamentare, me shpresën që të njëjtat do të kenë efekte pozitive, avancuese në disa aspekte, si për shembull, në rregullimin e politikave ndëshkimore, duke përfshirë zyrtarët e lartë publikë, ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të Administratës Publike, si dhe forcimin e besimit të qytetarëve në këto institucioneve, edukimi i Administratës Publike, por edhe i qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktualë antikorrupsion, duke përfshirë përgjegjësitë dhe obligimet e secilit, rritje e transparencës përmes zbatimit të legjislacionit përkatës në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore dhe institucionale, rritje të transparencës dhe forcimit të integritetit të institucioneve në raport me zyrtarët që janë pjesë të tyre dhe kështu me radhë.

Unë besoj që gjatë diskutimeve deputetët kolegë do të flasin edhe më tutje për çështje konkrete, por për fund, dëshiroj t'i ftoj të gjithë kolegët që të kemi konsensusin e nevojshëm për miratimin e këtyre nismave ligjore, që shumica prej tyre janë përgjigje ndaj sfidave dhe nevojave për luftën kundër korrupsionit, por edhe krimit të organizuar, në mënyrë që si vend të avancojmë tutje në këtë agjendë, përkundër gjetjeve, të cilat e vlerësojnë se ka pasur një progres në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, e keni fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, ne e kemi propozuar një interpelancë sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, por ajo u shty për shkak se i pranishëm nuk ishte kryeministri Haradinaj, për shkak se do të duhej që kjo temë të trajtohej me interpelancë, për shkak se e thërrasim në përgjegjësi Qeverinë, prandaj edhe ka qenë e udhës të diskutohet qoftë në interpelancë me kryeministrin, siç e kemi bërë ne, qoftë interpelancë me ministrin e Drejtësisë apo edhe ministren e Integriteteve.

Sidoqoftë, po flas në emër të grupit parlamentar dhe sigurisht që pjesën dërrmuese të çështjeve i kemi adresuar edhe në rekomandimet e interpelancës sonë, por besoj që, meqë po mbahet ky debat, është e rëndësishme të thuhet disa gjëra: e para, s'ka asnjë dyshim që sot krimi i organizuar dhe korrupsioni mbetet ndër problemet kryesore të vendit tonë dhe ne si grup parlamentar, por as qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kanë parë një qasje ndryshe as nga Qeveria Haradinaj, në raport me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por as qeveritë e kaluara.

Pra, keni parasysh, në vazhdimësi flitet se si duhet të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni, por në anën tjetër, nuk kemi parë veprime konkrete për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Dhe, sot kjo është e pamundshme, për shkak se sistemi i drejtësisë është ngufatur dhe i njëjti nga njerëzit e pushtetit, qeverive të ndryshme, duke nisur nga Qeveria Thaçi, për të vazhduar me qeveritë e tjera nuk e kanë lënë sistemin e drejtësisë për të vepruar, nuk e kanë lënë që sistemi i drejtësisë të bëjë punën ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi. Pra, duhet të thuhet hapur, binomi drejtues qeverie apo shtetit, me Devollët, Zhugollët, me shumë të tjerë, janë pikërisht dëshmia pse qeveritë nuk e luftojnë korrupsionin. Domethënë, se aq shumë është shteti i kapur dhe pse në Kosovë ka dështuar të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Në fakt, ajo çfarë është bërë janë krijuar shumë institucione, është ndarë përgjegjësia në shumë institucione, Task Forca, Agjencia Kundër Korrupsionit, Prokurori, Polici, arsyeja për këtë ka qenë pikërisht që të shpërndahet faji dhe askush të mos marrë përgjegjësi në raport me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këtu u përmend nga kryesuesi i seancës të flasim me emra. Nuk është sekret që në Kosovë ka qeveritarë që janë pasuruar, siç thuhet "brenda natës", kanë krijuar pasuri të pajustificueshme dhe as nuk u është konfiskuar pasuria e këtyre njerëzve dhe as nuk janë duke u hetuar apo akuzuar për veprat e tyre korruptive. Dhe, vetëm kjo Qeveri i ka 3 ministra me aktakuza për rastet e korrupsionit dhe ditën kur kryeministri Haradinaj e votoi Kodin Penal, i cili parasheh që njerëzit, të cilët kanë aktakuza për korrupsion të mos mund t'i mbajnë postet që i kanë, ai tha që nuk i shkarkoj ministrat pa vendime gjyqate.

Edhe Ministria e Drejtësisë, në fakt, ka bërë arnime, në vazhdimësi arnime dhe jo adresim të çështjes, sa për t'u dukur që kinse ne po e luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Zonja Pantina e përmendi në fillim të fjalës saj Ligjin për konfiskimin e pasurisë, në qoftë se nuk e di, unë po e bëj të ditur që Vetëvendosje e ka proceduar në Kuvend Ligjin për konfiskimin e pasurisë të pajustificueshme dhe ai projektligj sa më parë duhet të na vijë neve si deputetë të Kuvendit për ta shqyrtuar. Për shkak se ajo çfarë është e rëndësishme, është që të forcohen kompetencat e prokurorisë, por që barra e provës të vendoset tek i dyshuari. Në kohën sa ministër i Drejtësisë ishte Hajredin Kuçi, ky Kuvend pati votuar Projektligjin për zgjerimin e kompetencave për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe asnjë rast i vetëm nuk është adresuar me atë ligj, që gjashtë vjet prej se është në fuqi, në pyetjet tona karshi Këshillit

Prokurorial, na është thënë që as edhe një rast i vetëm nuk është adresuar me atë ligj, ndonëse në atë kohë thuhej se do të bëhej nami me hyrjen në fuqi të atij ligji.

Pra, nuk ka pasur vullnet për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, nuk kemi parë qasje ndryshe nga asnjëra qeveri, as nga PDK, as nga LDK, tash as nga AAK, përkundrazi kemi parë sistemin e drejtësisë teksa merret me aktivistët e deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, për veprime politike qoftë në Kuvend, qoftë jashtë tij, por jo me hetim të ‘jakave të bardha’, sepse po, korrupsion ka në arsim, ka në shëndetësi, ka kudo, por problemi kryesor është korrupsioni i “jakave të bardha”, apo siç quhen “peshqit e mëdhenj”. Pra, sistemi i drejtësisë ka heshtur karshi këtyre “peshqve të mëdhenj” dhe është për keqardhje që rastet e korrupsionit sot qëllimisht lihen të parashkruhen dhe për rastet e korrupsionit jepet dënimi me kusht, si për shembull sot ndaj Agim Shahinit, dënim me kusht. Kjo është që të stimuloj për t’u korruptuar, domethënë kështu ka vepruar në vazhdimësi sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Pra, është e rëndësishme të kemi vullnet, së pari, sa i përket vetingut, nuk ka ligj për veting. Vetingu nënkupton reformë rrënjësore në sistemin e drejtësisë, ku do të vlerësoheshin detajisht gjyqtarët, prokurorët, por natyrisht do të ishte e mirë që të ketë veting edhe për policinë. Pra, nuk ka një Ligj për veting, po vetingu nënkupton reformë rrënjësore në sistemin e drejtësisë. Ajo çfarë duhet theksuar këtu është që vetëm në qoftë se hyjmë në ueb-faqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e shohim pasurinë e zyrtarëve të lartë, vetëm ajo çka është deklaruar. Vetëm ajo çka është deklaruar, për shkak se ka raste të shumta kur fare nuk e deklarojnë, sidomos pasurinë që e kanë jashtë vendit, por edhe që pasurinë e qesin tek miqtë, familjarët dhe pastaj ajo nuk pasqyrohet në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Më tej, nuk duhet të ketë shumë agjenci, shumë institucione, kinse po e luftojmë korrupsionin. Duhet të jetë një dhe i vetëm e i fuqishëm, me prokurorë e gjyqtarë të profilizuar, e kemi diskutuar edhe ditë më parë, në kohën kur e diskutonim Projektligjin për gjykatat, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Por, edhe diçka në fund, një Qeveri që ka njerëz përbrenda vetes që kanë aktakuza për korrupsion nuk mund ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin. S’mund se duhet të nisë prej vetes. Tash, në qoftë se e lufton Qeveria Haradinaj, sistemi i drejtësisë duhet t’i fusë gjashtë a shtatë persona në burg, t’ua konfiskojë pasurinë atyre. Por, këtë nuk e bëjnë as Haradinaj, as Mustafa, as Thaçi, as Veseli, asnjëri prej tyre. Kjo është dëshmuar.

Pra, i vetmi subjekt politik që përnjëmend e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin është Vetëvendosje. E keni parë, 70 dosjet e Mustafës në qeverisjen në Prishtinë, me të cilat sistemi i drejtësisë nuk është marrë fare me to. Nuk ka nevojë fare të hulumtohet shumë, e shoh Prishtinën, ndërtimet pa leje që janë bërë në Prishtinë, për të kuptuar sesa është korruptuar qeverisja e Isa Mustafës. Pra, këto subjekte politike, që flasin për luftim të krimit të organizuar dhe korrupsionit, nuk e kanë pasur interes luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sepse janë të zhytura thellë në korrupsion dhe ky vend mund të këndellet dhe sistemi i drejtësisë mund

të reformohet apo transformohet, për shkak se ka shumë probleme, vetëm kur në krye të qeverisjes vjen Vetëvendosje me njerëz të pastër, që edhe i konfiskojnë pasuritë e pajustificuara dhe ata të cilët e kanë keqpërdorur parandë publike do të shkojnë prapa grilave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën. Në rregull, Shqipja e ka fjalën. Më fal, fjalën e ka kërkuar zoti Hoti, dy minuta, në qoftë se bën t'i lejohen. A replikë, pate ti? Në rregull, fjalën e ka Shqipja.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Në fakt, një prej propozimeve që ne japim është edhe hartimi i një ligji për vetingun. Vetingu është proces, megjithatë duhet të bëhet me ligj dhe tashmë Kuvendi ynë apo Qeveria, nëse e harton atë, do ta kishte më të lehtë, sepse Republika e Shqipërisë tashmë e ka hartuar një ligj të tillë dhe është Ligji nr. 84/2016. Po pra, vetingu duhet të bëhet edhe me ligj dhe ne rekomandojmë që të hartohet ligji për vetingun. Faleminderit!

KRYESUESI: E përkthejmë prej sllovenishtes...! Zoti Hoti, e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj për të bërë debat përmbajtjesor për këtë pikë le të bëhemi racionalë, të mos bëjmë fushatë. Unë pajtohem plotësisht që të dalim me emra, kushdo në çfarëdo rasti që ka, por të jemi konkretë dhe pastaj të bartim përgjegjësi për fjalën publike që e themi.

Propozimi im është ky, kjo pikë e rendit të ditës lidhet edhe me pikën 20 dhe gjithashtu është tanimë një kërkesë e dorëzuar në Kryesinë e Kuvendit për një debat parlamentar për Raportin e Progresit, ku temë kryesore do të jetë përmbushja e kushteve për liberalizim të vizave, përfshirë luftën kundër korrupsionit. Prandaj sugjerimi im për deputetët dhe të gjitha grupet parlamentare është që ne të dakordohemi që këtë debat ta bëjmë bashkë edhe me pikën 20 dhe ta bartim në seancën që besoj për nesër, ose të premten, kurdo që caktohet nga Kryesia e Kuvendit, në bazë të kërkesës së parashtruesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vetëm nëse kërkuesit e debatit mund ta bëjnë një kërkesë të tillë, mund ta ndërpresim, përndryshe ne kemi hyrë në seancë, s'kemi shans për ta ndërprerë debatin. Shqipja e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Shiko, është një dallim ndërmjet interpelancës dhe debatit. Arsyeja pse ne kemi thirrur debat dhe jo interpelancë është se besojmë se nuk është përgjegjëse vetëm Qeveria për luftimin e korrupsionit. Natyrisht se Qeveria ka rol të padiskutueshëm, sepse, për fat të keq, është një nga institucionet ku korrupsioni është më i theksuar, por janë edhe institucionet tjera përgjegjëse, përfshirë Kuvendin, i cili ka obligime në procesin e luftimit të krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

E dyta, e thashë edhe në fjalën time, unë besoj se luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk duhet të shihet vetëm si kusht që na është vënë nga institucionet e Bashkimit Evropian për ta gëzuar lirinë e lëvizjes pa viza në vendet anëtare të BE-së. Luftimi i krimit të organizuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Shqipe, nëse bën, është një propozim i zotit Hoti. Arsytimi yt është me vend, për mua, por a je për ta ndërprerë debatin, apo jo? Ose e vazhdojmë, ose s'e vazhdojmë. Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Ne mund ta ndërpresim debatin me kusht që ta vazhdojmë si debat, sepse interpelanca, siç thashë, e ka minutazhin e kufizuar dhe ua kufizon shumë deputetëve të drejtën për t'i dhënë mendimet, e pse jo edhe rekomandimet e tyre. Dhe, siç thashë, interpelanca e thërret në përgjegjësi vetëm Qeverinë, e ne mendojmë Qeveria se nuk është e vetmja përgjegjëse, ndonëse ndoshta kryesorja. Kështu që ne jemi dakord që ta ndërpresim debatin këtu, por të vazhdojë prapë si debat, e jo vetëm si interpelancë, siç thashë, për shkak të minutazhit të kufizuar që e kemi.

KRYESUESI: Po, zonja Haxhiu, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Vetëm sa i përket propozimit të zotit Hoti. Ne natyrisht, në qoftë se parashtruesja e këtij debati pajtohet që kjo çështje të zhvendoset, i përket asaj dhe jo neve, por që nuk po kërkohet që kjo të zhvendoset te interpelanca, për shkak se interpelanca është çështje tjetër. Te kërkesa për debat të jashtëzakonshëm për Raportin e Progresit, që e ka iniciuar Vetëvendosje me mbështetjen edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të një deputeti të Grupit të Deputetëve të Pavarur. Prandaj, kërkesa proceduralisht nuk më duket e arsyeshme, por vetëm në qoftë se parashtruesja pajtohet.

Dhe, sa i përket replikës për zonjën Pantina, që Shqipëria e ka. Është e vërtetë që Shqipëria e ka Ligjin për vlerësimin kalimtar, siç thuhet, të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por ai ka qenë ndër ligjet e fundit që e ka bërë Shqipëria. Pra, para saj kanë qenë edhe 8 apo 9 ligje të tjera, sepse ka pasur reformë rrënjësore të sistemit të drejtësisë dhe pastaj ka përfunduar te çështja e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, unë besoj se roli i Qeverisë në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit është i jashtëzakonshëm. Prandaj, e thashë që ne s'presim që kjo Qeveri të mund bëjë diçka në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mua nuk po më duket se u dakordua, sepse ne kemi hyrë në seancë. Nëse e ndërpresim seancën dhe e konsiderojmë të përfunduar, unë jam dakord. Në qoftë se jo, vazhdojmë me debatin, se nuk mund ta shtyjmë për "kalendrat greke" siç thonë, debat pas debati. I kemi edhe sa debate të tjera dhe Shqipja po thotë të bëjmë debat - jo interpelancë, por

debat. Ato janë çështje për të cilat duhet të keni marrëveshje, duhet të mbajmë mbledhje në Kryesi prapë, duhet të rivendosim në Kryesi, ose kuorum s'kemi për ta votuar një gjë të tillë. Kështu që i vetmi person apo të vetmit persona që mund të flasin dhe ta bëjnë këtë është Shqipja, nëse thotë, e ndërpresim debatin. Po, zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Atëherë, nëse pajtohet deputetja Pantina, unë propozoj që ky debat të jetë pjesë e debatit në seancën e jashtëzakonshme për raportin e Bashkimit Evropian për Kosovën që të caktohet, le të themi të premtën, varësisht kur vendos Kryesia, nëse deputetja Pantina pajtohet me këtë propozim. Pra, debat në kuadër të asaj seance.

KRYESUESI: Zonja Pantina, edhe një herë, veç mos...

SHQIPE PANTINA: Vetëm edhe një herë, të lutem, se po mundohem të jem sa më e qartë. Unë jam plotësisht dakord që ne të debatojmë për Raportin e Progresit, ndonëse duken të ngjashme dhe janë të ndërlidhura, nuk është e njëjta temë. Ajo që po kërkojmë ne, kemi marrë shkas se është kusht për liberalizim të vizave, por korrupsioni është ndër problemet kryesore që e kemi në shoqëri dhe ky Kuvend duhet të diskutojë si të dalim prej këtij rrethi, në të cilin nuk është përgjegjës vetëm Kuvendi, nuk është përgjegjës vetëm Qeveria, janë edhe institucionet tjera, sidomos Gjyqësori. Megjithatë, na takon neve të diskutojmë, të debatojmë dhe mundësisht të dalim edhe me një strategji të caktuar.

Kështu që unë jam për vazhdim të debatit dhe edhe një herë, ndoshta Albulena nuk më ka dëgjuar me vëmendje kur unë e kam propozuar pakon e ligjeve, në mesin e të cilave është Ligji për vetingun, sepse edhe ai duhet të rregullohet disi, sesi duhet të bëhet si proces, dhe Ligji për financimin e partive politike. Ne propozojmë të vazhdojmë debatin. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull, vazhdojmë. Fjalën e ka zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: E mora fjalën sepse shpesh po e shoh se disa kolegëve po ua jepni fjalën, edhe pse nuk janë as në emër të grupit parlamentar, as nuk janë shefa të grupeve parlamentare.

Kjo është e thjeshtë. Ne jemi në rend dite, e vazhdojmë, ose nuk e vazhdojmë. Në qoftë se ekziston mundësia për ta ndërprerë, për shkak të gjatësisë së kësaj seance, atëherë do të ishte në rregull. Pra, po propozoj që sonte ta ndërpresim debatin e ta vazhdojmë një ditë tjetër, se vërtet ka disa ditë, është dita e tretë, që po vazhdojmë me punë. Por, propozuesi vendos për të mos u tërhequr prej debatit, kurse a të vazhdojmë sot apo jo, vendosim ne që jemi këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Por, ne kemi hyrë në seancë. Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Kryesues!

Së pari po e filloj me juve, që thatë “me fol konkretisht”. Unë mundohem shumë të të dëgjoj dhe të mbaj në mend. Na ke pas dhënë një këshillë, që unë e konsideroj shumë të vlefshme, para nja dy-tre muajve, pate thënë “me bo me hy e me këqyr kush ka licenca të naftës, që s’kanë as pompa të benzinës”, the “na luan mendja e kresë”.

Tash, unë për hatër tëndin dua të flas fort me emra.

Së pari, Bekim Haxhiu nuk është në sallë, ka dalë, por parëz duke kaluar këtu më tha, “unë po e di për kë fole, se këtu është njëri që shet mish”. Përnjëmend nuk janë krejt deputetë, por janë disa. Edhe unë s’fola për krejt deputetët, por fola për disa që merren edhe me mish, edhe me ndërtime false, edhe me ata gypat e naftës e të benzinës, edhe me telefoninë mobile, edhe me Z-Mobile, që e mjel Valën sikur lopën. Imagjinojeni ta blejë një lopë një fshatar e t’i qesë lopës të hajë e të mbetet familja jote pa qumësht, e qumështin t’ia japë Z-Mobile. Këtë krim e kanë bërë këta të Vala 900.

Tani ne po themi, korrupsion... Po bota këto fenomenet e mëdha i sheh.

E tash, të dal më konkretisht, edhe Albulena, edhe Sami Kurteshi, që është atje në këmbë, edhe unë, e kemi ditur që ky vend është fundosur në momentin kur e kanë zgjedhur kryeprokuror kriminelin më të madh, Hilmi Zhitinë, pas luftës. E kanë zgjedhur kryeprokuror, Dardani e njeh, se është i atij rrethi, Flamur Kelmendin, që na ka dënuar e na ka sakatuar prej Ramdan Shalës e deri te Rifat Birinxhiku e Salih Kabashin, e Destan Bujupi, i cili ka qenë analfabet dhe ky i thotë në aktakuzë “ke lexuar literaturë armiqësore, ke lexuar ‘Zërin e Kosovës’ dhe ke lexuar ‘Lirinë’”. Ky çohet në sallë, thotë “po, s’di bre të lexoj”. Eh, i thotë “nuk ke lexuar, por ke dëgjuar kur Milaim Zeka i ka lexuar”. Shih çfarë akuze i ka bërë! “Ai ka lexuar, ti ke dëgjuar”, edhe 4 vjet burg.

Eh tash, po shkojmë më tutje. E kam një këshillë, e kam një propozim, që kur të takohemi ne me këta ndërkombëtarët, të mos u tutemi fort, por t’u kallëzojmë që arkitektë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar në Kosovë janë UNMIK-u dhe EULEX-i, e ne i kemi flladitur me peshqirë. Domethënë, ne ua kemi mbajtur “zhagun”. Liderë të ndryshëm politikë e kanë ndier kënaqësinë më të madhe kur e kanë gjetur një gjykatës e një prokuror që ia kanë zënë bishtin me derë. Nuk ke mundur të bëhesh gjykatës a prokuror pa ta nxënë këta bishtin dhe të thonë “ngadalë, a e din çka ke bë ti në të kaluarën, por ne nuk po bëjmë zë, kështu që rri e mos fol”.

Tani, shkatërrues i Postë-Telekomit të Kosovës është suedezi Gerard Fisher, me britanikë e me zviceranë. Xho Trashler ka qenë drejtor i KEK-ut, ka qenë gjerman, ka vjedhur 6 milionë euro, i ka hedhë në konto në Spanjë. Shkojmë më tutje, Mishel Sveçin ka qenë guvernator i Bankës së

Kosovës, krejt shpëlarjet e parave, krejt faqet e zeza, krejt hyrjen e parave të Lindjes e të Perëndimit e të asaj i ka lejuar ai, i cili ka qenë francez.

Unë s'kam shpëlarë para me ta, prandaj po flas. Tani, Maricio Salustro, gjykatës i cili i ka dënuar me sytë mbyllur ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë gjykatës në kohën e UNMIK-ut, prej aty ka kaluar kryeprokuror në EULEX dhe e ka pasur pseudonimin “Doktori” në rrjetin e kriminelëve të EULEX-it. Një shef i Policisë e ka pasur pseudonimin “Pacienti”. Pacienti i ka çuar viktima “Doktori”, u ka ngrehur aktakuza njerëzve faj e pa faj dhe paratë ua ka marrë nëpër anije në Shqipëri. Këtë e dëshmojnë prokurorë, e dëshmojnë gjykatës të EULEX-it. Jonatan Rathel ka qenë njëri prej kryeprokurorëve kryesorë, së bashku me zonjën Arna, po ashtu kanë qenë të korruptuar. E kanë pasur në tavolinë dosjen se kush e ka thyer Dhomën e Dëshmive në Polici. I kanë ditur me emra, me mbiemra, i kanë ditur edhe vrasjet kush i ka bërë dhe kurrë nuk janë marrë me këto hetime.

Prandaj, po them në fund që kur rrimë me të huajt, t'u tregojmë që s'jemi bash “balosha”, i dimë edhe ne do gjëra, që në korrupsionin këtu kanë qenë të përzier edhe ambasadorë të fuqishëm perëndimorë. Për shembull, ne e dimë si e ka marrë autostradën “Bechtel&Enka”. Ne e dimë cila ambasadë ka intervenuar për t'u shitur e për t'u falur KEDS-i. Ne e dimë që Zhbogari, ai “demokrati” i madh, që ka ardhur të na mësojë neve këtu, edhe si slloven, edhe nga Brukseli, sesi ndërtohet sistemi i demokracisë në Kosovë, e ka marrë edhe në telefon Radiotelevizionin, drejtorin e përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës, Mentor Shalën, edhe ka intervenuar, ka bërë presion për gjëra tjera.

Një ambasador shumë i fuqishëm, zoti kryesues, i një vendi perëndimor, ka shkruar letër në Radiotelevizionin Publik të Kosovës dhe ka përcaktuar se cili gazetar t'i udhëheqë debatet politike gjatë fushatave zgjedhore. Imagjinoni, ju që keni jetuar në Zvicër, po të dilte ndonjë letër e ndonjë ambasadori që i jep urdhra televizionit të një vendi demokratik se kush duhet ta udhëheqë një debat, lëre që do të bëhej skandal, po ai ambasador do të shkarkohej dhe do të kthehej prej nga ka ardhur.

Prandaj, për ta përfunduar kështu, ne është mirë që kur të takohemi me këta të Brukselit e me të ambasadave të huaja, qysh e kam pasur një takim unë para një shtatë-tetë ditësh në “Swiss Diamond”, kur ka qenë ambasadori italian, ambasadori britanik, ambasadori gjerman, ambasadori austriak edhe francez, thashë “Sarkozi as nuk është kosovar, as shqiptar, Sarkozin po e akuzoni që i ka marrë 50 milionë prej Gadafit. E keni akuzuar edhe Zhak Shirakun, që ka vjedhur në të '79-rën kur ka qenë kryetar i Komunës së Parisit, por a e di ku është dallimi ndërmjet atyre dhe neve? Te ne sa më shumë që vjedh bëhesh më jaran me disa prokurorë e disa hetues të Policisë, ndërsa atje po të kapën përfundon karriera jote”.

Në këtë pikë pajtohem me të gjithë ata deputetë që thonë që është tepër emergjent reformimi radikal i sistemit të drejtësisë.

Shpresoj që ligjet të cilat na kanë ardhur në propozim nga ministri i Drejtësisë të na ndihmojnë në këtë drejtim. Më fal kryesues që e gjata ndoshta me emra, por hatri yt! Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqë po thuhet se duhet ta vazhdojmë, atëherë po e vazhdojmë debatin. Veç unë kisha thënë që si deputetë të Parlamentit të Kosovës të mos flasim për perceptimet, por të flasim për argumentet, për faktet, për elemente të cilat vërtet e bëjnë adresën e drejtimit të temës në të cilën jemi. Ne veç e kemi edhe kusht për liberalizimin e vizave luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhet të kërkojmë dhe të insistojmë nga Qeveria, në këtë rast edhe nga Ministria e Drejtësisë që pakoja ligjore, e cila është ofruar në Kuvendin e Kosovës të jetë e zbatueshme dhe institucionet përgjegjëse t'i bëjnë veprimet e duhura, në mënyrë që të mos flasim më tutje për krimin e organizuar, korrupsionin, si një dukuri e cila vërtet e shqetëson opinionin e Kosovës.

Unë e di se shumë vende të rajonit janë ballafaquar me këtë problematikë dhe ballafaqohen edhe tani, madje ka edhe më të kriminalizuara se Kosova, por padrejtësia që i është bërë Kosovës në disa aspekte, qoftë në liberalizimin e vizave, që është dashur ta ketë Kosova, qoftë në integrimet që do të duhej të ndodhnin, janë pikërisht për shkak se mekanizmat ndërkombëtarë, që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në Kosovë, më shumë kanë kontribuar në ngatërrimin e çështjeve, sesa që i kanë zgjidhur ato dhe madje nganjëherë janë bërë edhe bashkëveprues me përfaqësues të institucioneve tona.

Rekomandimet që dalin nga ky debat është mirë të jenë të sakta dhe që i adresojnë problemet e theksuara në drejtim të institucioneve që duhet t'i zgjidhin. Nuk është mirë që njerëzit, ose përfaqësuesit e institucioneve të flasin për perceptime, sepse qytetarët kanë të drejtë të kenë perceptime, por nuk kanë të drejtë përfaqësuesit e institucioneve t'i ushqejnë qytetarët me perceptime. Kanë të drejtë të nxjerrin fakte e argumente, të cilat i bëjnë veprimet e duhura.

Në fund po them se është mirë që gjithçka që është për luftë kundër krimin të organizuar e korrupsionit të adresohen institucionet e vërteta, që e kanë për detyrë ta bëjnë luftën kundër këtyre dukurive dhe jo të përgjithësohen e të humbet kohë, veç sa për të bërë debat. Shpresoj që pakoja e ligjeve që është ofruar në Kuvend dhe që do të përfillet nga institucionet relevante do të mundësojë që edhe kjo çështja ta marrë kahun e duhur pozitiv në luftë kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Që në fillim të fjalës sime po e them atë që e tha edhe zoti Hoti, me të cilin pajtohem plotësisht, meqë gjatë ditëve në vazhdim ne do t'i kemi pothuajse tri pika të njëjta që do të diskutohen. Njëra që lidhet me Raportin e Progresit për Kosovën, e për të cilën Komisioni për Integritet Evropian po ashtu ka rekomanduar që të trajtohet në seancë e të diskutohet raporti i fundit, ku preket edhe çështja e kriterit për liberalizimin e vizave, që është luftimi i krimit të organizuar dhe të korrupsionit dhe po ashtu edhe interpelanca e kryeministrit dhe debati i sotëm.

Prandaj, rasti që e patëm sot kur deputetja Musliu dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur i harmonizuan debatet, mendoj që duhet të funksionojë edhe në raste të tjera, kur ne nuk diskutojmë për tema të njëjta për tri ose katër ditë me radhë, sepse kështu besoj që do të jemi më produktivë nëse për të njëjtën temë kemi diskutime më konstruktive dhe që lidhen konkretisht me temën.

Megjithatë, meqë kërkesa e zonjës Pantina lidhet me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave, unë do t'i them dy-tri fjalë në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integritet Evropian.

Ne disa herë e kemi pasur në dëgjimet e Komisionit për Integritet Evropian ministrin Abelard Tahiri, i cili vazhdimisht ka qenë i hapur që të flasë lidhur me pakon e re ligjore që ka ardhur në Kuvend, e që është njëra prej pakove për fuqizimin e sundimit të ligjit si kriter kryesor për procesin e liberalizimit të vizave.

Konsideroj që kalimi i demarkacionit e ka krijuar një momentum të ri për ta kthyer vëmendjen drejt përmbylljes, ose pikës kryesore, që është edhe luftimi i krimit të organizuar dhe të korrupsionit si kriter që lidhet me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar natyrisht që është njëra prej sfidave dhe kriterëve të përhershme të institucioneve të Republikës së Kosovës për ta fuqizuar sundimin e ligjit, dhe jo vetëm për ta fuqizuar përafrimin e tyre me agjendën e integriteteve evropiane.

Po e them që pakoja e re e ligjeve për Gjyqësorin, e cila synon ta rrisë efikasitetin, përgjegjësinë, transparencën dhe llogaridhënien ka qenë jashtëzakonisht inkurajuese. Po ashtu, edhe rishikimi i Kodit Penal dhe Kodi i Procedurës Penale është për t'u vlerësuar. si dhe rritja e dënimeve për veprat penale të zyrtarëve të lartë, të cilat pika janë prekur edhe në Raportin e Progresit për Kosovën dhe do të diskutohen edhe në seancën e radhës.

Një numër i madh i plotësim-ndryshimit të ligjeve dhe ligjeve si nisma ligjore që ministri Tahiri i ka sjellë në Kuvend për ta fuqizuar sundimin e ligjit si njërin prej pikave kryesore që lidhet me procesin e liberalizimit të vizave.

Konsideroj që ne si deputetë duhet të jemi të gjithë të vëmendshëm që këto ligje të cilat votohen në Kuvend, e që lidhen me agjendën e reformave evropiane, por gjithsesi edhe me procesin e ndarë të liberalizimit të vizave, të jenë ligje që mund të implementohen dhe të kenë mekanizma të implementimit më të fuqishëm, meqë në të kaluarën Kuvendi ka miratuar ligjet të cilat kanë qenë pjesë e agjendës së reformave evropiane, mirëpo të cilat kanë çaluar në implementim sa i përket fuqizimit të sundimit të ligjit.

Prandaj, diskutimin tim do ta ndal këtu, unë shpresoj shumë që rekomandimet që do të dalin nga ky debat të jenë rekomandime konstruktive dhe të jenë rekomandime të cilat ky Kuvend do t'i miratojë dhe do të arrijnë që ta kenë edhe implementimin e tyre. Diskutimin do ta vazhdojmë gjatë ditëve në vazhdim, kur flasim pak më detajisht për Raportin e Progresit për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Pas kalimit të demarkacionit me Malin e Zi është krijuar një situatë e re dhe memontum i ri për të gjithë ne që ta kthejmë edhe një herë vëmendjen tonë drejt përmbushjes së kriterit të fundit për liberalizim të vizave, atë të luftimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Natyrisht që e kam për të qartë dhe vazhdoj të sqaroj se lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar është një sfidë dhe proces i përhershëm që do të vazhdojë edhe pas liberalizimit të vizave.

Megjithatë, me përmbushjen e këtij kriteri mund të konfirmoj para jush se institucionet e sistemit të drejtësisë janë të mobilizuar si kurrë më parë.

Ju e dini që për plotësimin e këtij kushti në kuptimin e përgjithshëm ka dy komponenta që ndajnë ndërmjet vetes përgjegjësitë.

E para, është komponenti e politikëbërjes që i përket Ministrisë së Drejtësisë, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës,

Dhe e dyta, komponenti i zbatimit të ligjit, ku hyjnë organet e pavarura të zbatimit të ligjit, përkatësisht shtylla e tretë e pushtetit - gjykatat e prokuroritë.

Sot unë do të flas ekskluzivisht për komponentin e parë, atë të politikëbërjes që ndërlidhet me punën time si ministër i Drejtësisë.

Masat e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë në aspektin e politikëbërjes, të cilat ndikojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe rrjedhimisht në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, e që po ashtu janë indikatorë të mirëfilltë për liberalizim të vizave, janë adresuar nga tri perspektiva.

E para, adresimi i rekomandimeve nga raporti i vendit për vitin 2016.

E dyta, përmbushja e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim, përkatësisht përmbushja e obligimeve të Agjendës Evropiane të Reformave.

Dhe, e treta, avancimi i bazës ligjore që ndërlidhet me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe të krimin të organizuar.

Në adresimin e obligimeve nga raporti i vendit, agjendës së reformave evropiane dhe masa të tjera kundër korrupsionit ka pasur disa kërkesa dhe rekomandime ndaj të cilave unë nuk kam qëndruar asnjë moment indiferent, por i kam adresuar me kohë dhe me një dinamikë të përshpejtuar. Në mesin e këtyre janë: fuqizimi i Gjyqësorit. Në raport me këtë, me qëllim të fuqizimit të Gjyqësorit, është hartuar pakoja e ligjeve të Gjyqësorit, që përfshin Projektligjin për Këshillin Gjyqësor, Prokurorial, Projektligjin për gjykatat dhe ai për përgjegjësi disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë.

Nga kjo pako ligjore, që mundëson rritjen e efikasitetit, sigurojmë pavarësi të plotë dhe rritim transparencën për përgjegjësinë dhe llogaridhënien në sistemin gjyqësor dhe atij prokurorial. Tashmë ju falënderoj juve që i keni votuar tri nga këto katra që i kemi kaluar në lexim të parë.

Një indikator tjetër i rëndësishëm që e tregon gatishmërinë tonë për një Gjyqësor të pavarur dhe efikas dhe të përgjegjshëm është rritja e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial.

Të nderuar deputetë,

Nga rekomandimet themelore që lidhen ekskluzivisht me luftën kundër krimin të organizuar dhe të korrupsionit ka qenë edhe rishikimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale.

Sot konfirmoj para jush se puna në hartimin e ndryshimeve në Kodin Penal ka qenë intensive, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe ndryshimet e rekomanduara kanë qenë aq të thella sa e kanë prodhuar një strukturë pothuajse tërësisht të re të Kodit Penal.

Me këto ndryshime sa u përket veprave që hyjnë në kuadër të krimit të organizuar dhe korrupsionit janë rishikuar dhe hartuar 19 nene për të mundësuar ndjekjen më efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po ashtu, janë rritur afatet e parashkrimit për veprat e natyrës korruptive, duke bërë të pamundur që personat e akuzuar për vepra korruptive të shpëtojnë ndaj ballafaqimit me drejtësinë.

Me Kodin Penal janë përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga koncept-dokumenti për suspendimin e zyrtarëve publikë në rast të ngritjes së aktakuzave për korrupsion, ku janë propozuar ndryshimet që ia ndalojnë personit zyrtar ushtrimin e funksionit në Administratën Publike apo shërbim publik deri në 10 vjet nga aktgjykimi dënues.

Dënimet për vepra penale që ndërliken me korrupsion kudo që ka mundur dhe ka qenë e përshtatshme janë rritur. Tashmë ky kod është miratuar në Qeveri dhe është në procedurë të mëtutjeshme që të jetë para jush, të nderuar deputetë.

Të nderuar deputetë,

Me intensitet të lartë është duke u punuar edhe në hartimin e ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, në të cilat do të reflektohen të gjitha masat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ku do të mundësohet fleksibilitet më i madh në punën e organeve të zbatimit të ligjit.

Aspekti i dytë i rëndësishëm në adresimin e politikave legjislativë është edhe përmbushja e Agjendës së Reformave Evropiane. Në kuadër të ERA-s, kanë qenë tri obligime të Ministrisë së Drejtësisë.

E para, amendamenti i Ligjit për prokurorin e shtetit. Ky projektligj tashmë është miratuar përfundimisht nga Kuvendi i Kosovës dhe ndryshimet që janë bërë do të mundësojnë efikasitet më të madh në punën e Prokurorisë Speciale të republikës së Kosovës, shtimin e numrit të prokurorëve në këtë prokurori dhe administrimin më efikas të çështjeve që bien në kompetencën e kësaj prokurorie.

E dyta, hartimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Po ashtu, ky projektligj është hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe tashmë është miratuar përfundimisht nga Kuvendi. Ky projektligj paraqet theksin kryesor në aspektin parandalues në konflikt të interesit dhe është në harmoni të plotë me kërkesën e Agjendës së Reformave Evropiane.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i këtyre dy ligjeve dhe përfshirja e koncept-dokumentit në Kodin e ri Penal shënon përmbushjen e obligimeve të Ministrisë së Drejtësisë në raport me Agjendën e Reformave Evropiane.

Me qëllim të fuqizimit të sundimit të ligjit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Ministria e Drejtësisë, përveç obligimeve të ERA-s dhe raportit të vendit, ka identifikuar edhe masa tjera legislative që ndikojnë në këtë drejtim.

Vëmendje e veçantë u është kushtuar projektligjeve për Agjencinë Kundër Korrupsionit, si dhe deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publik, mbrojtjes së informatorëve dhe kompetencave të zgjeruara të prokurorëve dhe gjyqtarëve në konfiskimin e pasurisë.

Ligjet e lartpërmendura përbëjnë pakon e ligjeve kundër korrupsionit. Kësaj pakoje i është dhënë prioritet absolut në raport me agjendën legislative të Ministrisë së Drejtësisë.

Me Projektligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit është duke u bërë rishikimi i kompetencave dhe mandatit të agjencisë.

Ndryshimet ligjore do ta definojnë përfundimisht mandatin e agjencisë, si dhe do t'i standardizojnë procedurat e deklarimit të pasurisë, veçmas në aspektin e verifikimit të prejardhjes së pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë.

Të nderuar deputetë,

Këtu kemi nevojë për ndryshme jashtëzakonisht të mëdha, sidomos të zyrtarëve të lartë që deklarojnë pasurinë, ku kemi mbi 1 000 asamblistë në Republikën e Kosovës që e deklarojnë pasurinë dhe kemi shumë inspektorë të rëndësishëm në nivele rajonale, të cilët nuk janë të përfshirë në listën të cilët duhet ta deklarojnë pasurinë. Pra, pikërisht do të jetë e kundërta besoj, por do ta trajtojmë bashkërisht dhe së shpejti do ta sjellim në Kuvend.

Projektligji i ri për mbrojtjen e informatorëve do t'i definojë standardet dhe të gjitha procedurat e ekspozimit të keqpërdorimeve dhe të gjitha procedurat e mbrojtjes së informatorëve.

Ndër proceset e rëndësishme, të cilat jemi duke i kaluar, është rishikimi i politikës së sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, masë kjo tepër e rëndësishme në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Për ta adresuar këtë i kemi themeluar grupet punuese dhe po ashtu në bashkëpunim të plotë me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë jemi duke punuar në draftin final të ndryshimeve në Projektligjin e ri për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë.

Deputetja Haxhiu me të drejtë tha se nga viti 2013 është në fuqi Ligji për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë dhe tha se nuk i është referuar asnjëherë, por duhet të jenë të sigurtë se të paktën në një rast të vetëm i janë referuar dhe një zyrtari të lartë të shtetit të Kosovës i është konfiskuar pra pasuria në bazë të këtij ligji.

Të nderuar deputetë,

Për fund, më lejoni të ju siguroj se angazhimi ynë i përbashkët me aktorë tjerë, siç janë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Kryeprokurori i Shtetit, Gjykata Supreme e tjerë janë duke ecur në drejtimin e duhur.

Një mesazh i fuqishëm është dërguar tashmë te të gjithë mekanizmat që kanë përgjegjësi në avancimin e rasteve të shënjestruara që ndërlidhen me liberalizimin e vizave.

Jam shumë optimist se do të ketë progres në këtë drejtim.

Të nderuar deputetë,

Ju siguroj se proceset që kemi para nesh nuk na kanë zë në befasi. Kemi qenë tejet të angazhuar dhe jemi të përkushtuar që kjo dinamikë e punës ta ruajë kursin e vet në këtë drejtim dhe unë si ministër i Drejtësisë do ta japë maksimumin tim.

Edhe nja 2-3 fjalë sa i përket vetingut, që pa dyshim është një prej proceseve më të rëndësishme dhe është debatuar shumë kohëve të fundit.

Të ju them të drejtën, tash e shtatë muaj sa jam ministër i Drejtësisë, nuk mendoj që vetingu është zgjidhje për Republikën e Kosovës.

Mendoj që ajo që do të ndihmojë fuqizimin e sundimit të ligjit do të jetë rritja e numrit të gjyqtarëve në Republikën e Kosovës. E kam thënë edhe më herët, edhe në seancën e kaluar, jemi vendi me numrin më të vogël të gjyqtarëve për kokë banori në Evropë. I kemi 25 gjyqtarë në 100 mijë banorë. Në Maqedoni, shteti ynë fqinj, i ka 35 gjyqtarë në 100 mijë banorë. Ne jemi më së keqi.

Ai proces pa dyshim që duhet të fillojë, vetingu pra. Për ju që e dini, deputetë të nderuar në vitet 2010-2011, e kemi pasur një proces të tillë, kanë mbetur disa prokurorë dhe gjyqtarë jashtë sistemi në atë periudhë, ka edhe emra që dihet se kush ka mbetur jashtë atij sistemi, mirëpo para se të hymë te vetingu ne duhet ta rritim numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë, duhet ta rritim numrin e zyrtarëve ligjor, duhet ta rritim numrin e gjyqtarëve.

Pra, ne do ta fuqizojmë Gjyqësorin para se të hymë në një proces të tillë. Verifikimi pra është tejet i rëndësishëm, tejet i domosdoshëm, mirëpo fuqizimi i Gjyqësorit është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A e kreve? Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën, nga Lëvizja Vetëvendosje.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Korrupsioni dhe krimi i organizuar në Kosovë është një dukuri mjaft e përhapur dhe bashkëjeton shumë mirë me qeveritë tona.

Republika e Kosovës ka mjaftueshëm organizma shtetërorë për luftimin e kësaj dukurie. Pra, janë Prokuroria, Policia, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe janë mbajtur mjaftë tryeza, grupe punuese dhe takime të funksionarëve shtetërorë kompetentë për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pra, sa i përket anës formale jemi në rregull me ligj, por nuk na mungojnë as organet e nevojshme, e as rregullativa ligjore për ta luftuar këtë dukuri, por problemi qëndron në vullnetin politik, i cili po mungon dhe kjo për arsye të thjeshtë, sepse këta që duhet t'i shtyjnë gjërat përpara janë vetë të korruptuar.

Sistemi i gjyqësisë është një sistem, i cili është i korruptuar, sepse është i zgjedhur nga politika. Pra, përveç që është i korruptuar, është edhe i shantazhuar dhe ata të cilët e kanë emëruar kërkojnë favore dhe me rastin e emërimit këta e humbin pavarësinë, ndërsa këta që i emërojnë janë të korruptuar dhe pasi në dorën e tyre është emërimi i këtij sistemi, krejt këta e shfrytëzojnë dhe atë pa mëshirë.

Veç një shembull po jua them: Rasti i kryeprokurorit Lumezi, gjashtë muaj e zvarritën, “po të bëjmë, s’po të bëjmë” dhe pastaj pas gjashtë muajve e futën në kllapën e vet dhe i thanë tash po të bëjmë.

Kur hyn në kllapën e tyre duhet shkuar për peri, pra duhet qëndruar gatitu.

Në të gjitha vendet e rajonit janë bërë reforma në organet e rendit me qëllim të freskimit dhe të shkëputjes së lidhjeve me krimin. Kjo te ne nuk po ndodh, dhe nuk do të ndodhë për arsye se këta krerë të politikës edhe janë të dëgjueshëm, e tani janë edhe të fuqishëm.

Pra, për të dyja rastet e kemi një kauzitet të situatës, “ne ty do të zgjedhim, të bëhesh i dëgjueshëm”, ndërsa me kalimin e kohës për shkak se është arritur të mbledhim informacione të shumta, siç thanë edhe nga parafolësit e mi, ata që i emërojnë bëhen tani edhe të fuqishëm. Barazimi është “t’i vidh, ne vjedhim; t’i hesht, ne heshtim.

Policia e Kosovës akoma nuk ka arritur të zbulojë vjedhjen e Dhomës së Dëshmive. Shtrohet pyetja, si mund të presim ata që e luftojnë krimin e organizuar t’i luftojnë të tjerët? Pra, nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. E unë po ju them se kjo vjedhje nuk do të zbulohet kurrë nga këta

njerëz dhe arsyeja është se kjo nuk është vjedhje, por është marrje, zhdukje e provave, dhe atë me pëlqimin dhe me bashkëpunimin e EULEX-it.

U pa edhe në rastin e parë që drejtësia vendore i mori kompetencat e EULEX-it, rasti TOKA. Me urgjencë u lanë të mbroheshin në gjendje të lirë të pandehurit. Ky është një mesazh shumë i keq dhe një praktikë e keqe.

Të dashur deputetë,

Korrupsioni është i pranishëm në të gjitha segmentet e shtetit të Kosovës. Përveç në organet e rendit të drejtësisë, është këmbëkryq edhe në arsim, shëndetësi, ministri të ndryshme, agjenci të ndryshme shtetërore. Pra, korrupsioni te ne ka kaluar në kulturë qeverisëse dhe për këtë arsye ne i kemi të gjitha këto probleme. Kemi problem edhe me testin e PISA-s, edhe me furnizimin me barna, edhe me furnizimin me rrymë, edhe me furnizimin me ujë, me punësim, dhe në marrjen e dokumenteve të ndryshme. E ku jo?

Të nderuar deputetë,

Bashkësia ndërkombëtare ka dhënë kusht që të luftohen krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Unë mund të them se është një aksion i pamundur, sepse krimi i organizuar dhe korrupsioni janë mishëruar me organet e shtetit në të gjitha nivelet dhe kjo e vështirëson punën, sepse kjo qeverisje do të duhej ta luftojë vetveten.

Për liberalizimin e vizave kusht gjithmonë ka qenë luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsioni. E vonë është sponsorizuar nga tanët dhe është vënë edhe demarkacioni, por po shihet që përderisa për demarkacionin nuk lanë gurë pa lëvizur dhe u arrit, për këtë tjetren nuk ka zell për ta luftuar, por ka vetëm fjalë dhe konferenca dhe nuk mungojnë kurrë, mirëpo nuk do të arrihet kurrë, nuk do ta luftojnë kurrë pra krimin dhe korrupsionin, dhe atë e kemi pothuajse në të gjitha nivelet, si ato horizontale, ashtu edhe ato vertikale.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Po ju them se nuk ka luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit derisa i kemi në pushtet kriminelët dhe të korruptuarit.

Prandaj, urgjentisht duhet t'i heqim këta nga pushteti dhe shihni se Kosova ka djem dhe vajza që do ta udhëheqin shtetin e Kosovës me dinjitet dhe me vendosmëri. Fillimisht duhet çuar këta në burg, për t'u çliruar dhe për të punuar si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të paktë të Qeverisë,

Them që Qeveria e Kosovës çdo ditë e më shumë është duke u bërë në njërin anë e papërgjegjshme e në anën tjetër shumë shpesh edhe arrogante.

Kryeministri i Kosovës sot nuk është këtu. Në fakt, s'është asnjë prej zëvendësve të tij, me sa di unë nja pesë i ka, nëse nuk ka më shumë, dhe nuk po e kuptoj cili është roli i këtyre zëvendëskryeministrave nëse asnjëri prej tyre nuk vjen në seanca të rregullta të Kuvendit, e të mos flasim për ministrat, e kështu me radhë.

Më duket që fenomenin e korrupsionit nuk mund ta diskutoj vetëm si një fatkeqësi natyrore ose si diçka, e cila është në gjenet e këtij vendi, ose të këtij populli.

Mendoj që asnjëra as tjetra s'është. Pra, nuk jemi të korruptuar për shkak se njerëzit e Kosovës janë njerëz në parim të korruptueshëm, por mbi të gjitha e para gjithash jemi të korruptuar, ose thënë më mirë e kemi këtë nivel të korrupsionit për shkak të politikës që është ndjekur nga misionet ndërkombëtare, e pastaj nga qeveritë vendore, politikë e cila është kryekëput neoliberales shpronësuese.

Më së shumti korrupsion kemi pasur për shkak dhe nëpërmjet procesit të privatizimit dhe kjo nuk ka ndodhur veç në Kosovë, por në shumicën e vendeve të cilat edhe janë anëtarësuar tash në Bashkimin Evropian, që e kanë pasur një proces të privatizimit, ku bazamenti i tij ka qenë politika neoliberales, është shoqëruar me rritje të korrupsionit.

Prandaj, sot korrupsioni në Kosovë është edhe më i madh se sa ka qenë në vitet 2000, 2002, 2004. Për shkak se është përcjellë nga kjo politikë, e cila e ka pasur thelbin kryesor shpronësimin dhe shpunësimin në të njëjtën kohë të njerëzve në Kosovë.

Kështu që nuk duhet vetëm vajtuar, por duhet kuptuar që njerëzit që janë korruptuar janë korruptuar edhe për shkak se kanë zgjedhur politikë neoliberales, kanë përfaqësuar politikë neoliberales dhe e kanë dëmtuar shtetin, e pastaj kanë përfituar edhe për vete, por kjo është diçka e cila ka ndodhur në vende tjera, dhe në vend se Kosova të mos e përcjellë një gjë të tillë, sepse ka pasur mundësi ta shohë, ta lexoj dhe t'i vizitojë këto vende për ta parë që një gjë e tillë do ta arrijë korrupsionin, e ka zgjedhur këtë për shkak se ka pas edhe interesa të ngushta ndonjëherë.

Segment tjetër që u theksua sot nga ministri i Drejtësisë, me të cilën në disa pjesë nuk u pajtova, mendoj që kemi problem me gjyqtarët, dhe e kemi në dy nivele.

Në nivelin e parë është që asnjëherë nuk u bë një ligj i lustrimit, dhe mendoj që kjo ka bartur pasoja edhe në drejtësinë e mëvonshme.

Gjyqtarët të cilët kanë bërë vepra penale kriminale, sido që t'i quajmë, në sistemin e kaluar, janë shantazhuar dhe janë kërcënuar nga zyrtarë të pushtetit, të cilët kanë ardhur në pushtet nga krahu tjetër, ose nga kampi tjetër - kampi i rezistencës, qoftë ai paqësor, apo i armatosur, dhe ka pasur një paqe ndërmjet atyre të cilët kanë qenë kundërshtarë në një periudhë tjetër. Duke qenë kështu, këta e kanë shantazhuar gjyqtarin dhe më vonë gjyqtarët i kanë shantazhuar po të njëjtit për shkak se kanë filluar të kenë mundësi e procese nëpërmjet të cilave do të kishin mundur t'i dëmtojnë.

Në këtë kuptim, mendoj që vetingu sigurisht që nuk është masa kryesore, por varet ministër se çfarë lloji të vetingut bën. Për të thënë jemi për ose kundër, besoj që duhet parë çfarë po duam ta bëjmë, qysh po duam ta bëjmë dhe pastaj mund të pajtohemi nëse duhet një i tillë, ose jo.

Ai që ka qenë në vitin 2010 nuk ka sjellë rezultat. Mund të themi edhe se ka qenë gabim, por nuk ka sjellë rezultat dhe këtu pajtohem qysh e thatë edhe ju.

Pjesa e dytë për gjyqtarët është sa i përket pjesës së dytë pasurisë së pajustificueshme. Në vendet që e kanë bërë vetingun, ku kriter ka qenë justifikimi i pasurisë, siç e dini shumë gjyqtarë kanë humbur vendet e punës, sepse kanë bërë aq shumë pasuri, sa nuk kanë mundur ta justifikojnë dhe si rezultat i kësaj kanë dhënë dorëheqje të parakohshme. Mendoj që kjo do të ndihmonte. Unë e di që kemi mungesë të gjyqtarëve dhe pajtohem me ty, por kjo nuk nënkupton që ne duhet t'i mbajmë gjyqtarët qoftë të korruptuar, qoftë të shantazhuar dhe nuk jam këtu duke bërë një kalkulim se në secilin sistem ndodh që ka të tillë, por po them që ka në përqindje të madhe për shkak të fenomeneve që i kemi pasur në Kosovë. Segment tjetër që është jashtëzakonisht problematik, e për të cilin mendoj që na duhet më shumë punë, janë policia dhe prokuroria. Pa prokurori dhe pa polici efikase, por mbi të gjitha shumë më të drejtë e shumë më pak të korruptuar, nuk ka shans për vendime të drejta të gjyqtarëve.

Pra, pa një vendim të prokurorit për t'u nisur një hetim, as policia s'mundet, por pa një polici, e cila siguron vendin e ngjarjes, provat dhe ka vullnet ta luftojë atë, nuk ka shans të shkohet as në aktakuzë. E njëjta vlen edhe për prokurorët, të mos e përsëris, edhe prokurorë kemi të kohës, të sistemit të kaluar, edhe prokurorë, të cilët mund ta vërtetojmë kur të doni, por nuk mund ta justifikojnë pasurinë që e kanë krijuar. Ndoshta ne, shteti, institucionet, nuk mund ta dëshmojmë që ata e kanë fituar përmes veprave penale, sepse janë kujdesur, por unë jam i sigurt që ata nuk mund ta justifikuar qysh i kanë bërë ato para. Kjo është arsye e mjaftueshme, minimalisht, ta humbin vendin e punës. Kështu që mendoj që duhet ta shohim seriozisht një proces të vetingut për këtë punë. Policia jonë është polici shumë e kriminalizuar, nuk po e them veç që ta gjeneralizoj, në Raportin e Progresit, në raportin e State Departamentit për Kosovën, Kosova

mbetet ende një prej vendeve që prin si vend transit sa u përket trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikëve.

Kushdo që ka lexuar pak në këtë fushë e di që nuk mund të jesh vend duke prirë në rajon për trafikim të qenieve njerëzore dhe të narkotikëve pa pasur dorë policia. Pra, në asnjë vend nuk ndodh dhe gradualisht policia, sikur edhe në Kosovë, prej një policie më pak si institucion i korruptueshëm, gjithnjë e më shumë do ta shohim një polici gjithnjë e më të korruptuar. Nevojitet ndërhyrje në këtë pjesë, sepse kjo është hallka e parë e zinxhirit në drejtim të luftimit të krimit dhe korrupsionit. Jam dakord që disa ligje janë duke u bërë, jam dakord që disa ligje tashmë kanë ardhur, disa prej tyre janë të domosdoshme dhe të drejta, por besoj që thelbi i asaj që unë po dua ta them këtu ka të bëjë me diçka që është përtej ligjeve. Pra, ligjet, infrastruktura është e domosdoshme për ta luftuar krimin dhe korrupsionin dhe çka do tjetër, por pa pasur vullnet politik, s'bëhet.

Unë mendoj që nuk ka vullnet politik as në këtë Qeveri, as qeveritë e kaluara për ta luftuar krimin dhe korrupsionin, kështu besoj unë, edhe kështu po na del edhe rezultati. Kemi pasur një rast, ku të gjitha organizatat, të cilat matin edhe perceptimin e korrupsionit, edhe korrupsionin, si të thuhet jo vetëm në nivel perceptimi, e që e kanë vlerësuar pozitivisht, ka qenë qeverisja në Prishtinë. Pra, me ndërrimin e qeverisjes në Prishtinë dhe me një vullnet politik për luftim të krimit dhe korrupsionit, në thelb ka ndërruar kjo qasje dhe këtë po dua ta them. Krejt këto që i folëm janë të rëndësishme, por nuk do të ndodhë asnjëherë derisa njerëzit, të cilët janë përgjegjës në drejtimin politik, s'po flas për një ministër ose s'po flas për një komandant policie, por vullnetin politik, nuk është e mundur një gjë e tillë të ndodh. Po, ligjet po i miratojmë, besoj që Kodi i ri Penal do të vijë prej asaj që kam dëgjuar në paraqitjet tua publike, po pres ta lexoj se mund të jetë keqkuptim qysh unë e kam kuptuar. Por, po dua t'ju paralajmëroj që konceptualisht kam problem me mënyrën qysh ju i jeni qasur Kodit Penal sa i përket segmentit të luftimit të krimit dhe korrupsionit. Besoj që do ta diskutojmë pasi ta lexoj, se do të jem më i saktë.

Ajo që unë po kam frikë është që kjo Qeveri dhe ky sistem politik që ka elemente të shtetit autoritar ose gjysmautoritar, si vjen edhe në raporte, po tenton të ndërtojë infrastrukturë, e cila do të përdoret si instrument për shantazh të kujtdo që i intereson pushtetit, qofshin ata biznesmenë, profesionistë, kundërshtarë politikë ose çka do tjetër. Kjo është përcjellë në krejt vendet që kanë pasur politika neoliberales, se politika neoliberales sjellin klasë politike gjysmautoritare, sepse autoritarizmat më s'po i lë bota, aq më shumë për vende të vogla, të cilat pastaj kanë bërë eliminime politike jo vetëm ndaj kundërshtarëve, por edhe ndaj segmenteve të tjera të shoqërisë. Kështu që shpresoj që do ta diskutojmë dhe ta shohim, besoj që nëse do ta keni vëmendjen e duhur, mund të kemi edhe plotësime të Kodit Penal të Kosovës dhe besoj që aty mund të kemi disa ndërhyrje si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Po dua të dal te vetingu, mendoj duhet të jemi të qartë, para se të fillojë një proces i tillë, më i rëndësishëm është rekrutimi i gjyqtarëve të rinj përmes një procesi jo siç ka ndodhur deri tani, mirëpo përmes një procesi të verifikimit, i cili do të arrijë të sjellë figura kredibile, figura të përgatitura mirë profesionalisht që u përgjigjen nevojave tona. Pastaj, pasi ta arrijmë një nivel të mirë të numrit të gjyqtarëve në nivel të Republikës, mendoj që duhet të fillojë procesi i vetingut edhe për këta që kanë qenë më herët. Pra, gjithmonë duke i plotësuar nevojat që i kemi. Për ta dhënë një shembull, e kam theksuar edhe në seancën e kaluar, ne kemi Prokurori Speciale, prokurorë speciale, të cilët paguhen jashtëzakonisht mirë, ku merren me krime të rënda serioze, por në anën tjetër, nuk kemi një gjykatë speciale që i trajton këto lëndë, dhe unë kam ngritur këtu dhe do ta adresoj gjatë mandatit tim. Unë besoj që vërtet na u kanë bërë shumë këto gjykata speciale, por na duhet një gjykatë speciale, e cila i trajton këto lëndë, sepse sado mirë që përgatiten nga ata prokurorë, ajo në fund të ditës mund të trajtohet në një gjykatë themelore, ndoshta nga jo shumë njerëz kompetentë, qoftë ajo e Gjilanit, Gjakovës, qoftë e Mitrovicës dhe të mos arrijë efektin e duhur.

Ndërsa, sa i përket Kodit Penal dhe Kodit të procedurës penale, unë mund të them që në Kodin Penal gjatë kësaj periudhe kanë punuar 160 ekspertë, shumë prej tyre edhe të huaj që kanë qenë të angazhuar ndihmë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga Komisioni Evropian. Ka qenë një proces gjithëpërfshirës dhe unë mendoj që pas përfundimit të Kodit të procedurës penale, ne do t'i vendosim në një dimension të ri, në një nivel tjetër politikat tona, qasjen tonë në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. A është e nevojshme rishikimi i politikës së sekuestrimit të pasurisë së paligjshme ose të pajustificuar, pa dyshim dhe atë jemi duke e bërë. Do të trajtohet në dy forma: në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin e veçantë për kompetenca të zgjeruara për prokurorë dhe gjyqtarë. Kodi i procedurës penale, përfundimi i tij po ashtu është aq i rëndësishëm, qe po jua jap veç një qasje time që unë mendoj që do të duhet të ndodhë dhe do të propozoj të ndodhë, pastaj vendosni ju. Unë mendoj që ne duhet ta sanksionojmë dhe shkalla e dytë, pra Apeli të mos mund ta kthejë më shumë se një herë një lëndë, sepse ne e patëm një raport nga Avokati i Popullit tash së fundi dhe e pamë që 8 vjet është mesatarja e një procesi gjyqësor në Republikën e Kosovës. Vërtet është e tepërt, është e gjatë, është e stërzgjatur dhe ne duhet t'i sanksionojmë pra. Apeli ta kthejë herën e parë dhe të mos ketë mundësi ta rikthejë dhe herën e dytë në rigjykim.

Tash, ndoshta mund të thotë dikush që është kundër të drejtave të njeriut apo diçka tjetër, mirëpo ne po kemi probleme shumë serioze, domethënë me këto që i kemi aktualisht dhe duhet të marrim masa, por Kodi i procedurës penale do t'i adresojë shumë çështje që ndërliken me këto procedura dhe besoj që do t'u përgjigjen nevojave tona. Edhe një herë, pra vetingu është i domosdoshëm, mirëpo jo në këtë periudhë, jo para se ta rrisim numrin e gjyqtarëve. Republika e Kosovës ka numër të mjaftueshëm të prokurorëve, është vlerësim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i kemi 203 prokurorë dhe kaq është i mjaftueshëm. Ne kemi nevojë për gjyqtarë të rinj, për bashkëpunëtorë profesionalë, për zyrtarë ligjorë, zyrtarë mbështetës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Molliqaj ka replikë.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Dy çështje shpejt: nuk pajtohem, ministër, që duhet ta bëjmë rekrutimin, pastaj vetingun, për shkak se nuk mendoj që janë procese përjashtuese për njëri-tjetrin dhe për shkak se nëse e ke përcjellë dhe besoj që e ke përcjellë, procesi i vetingut merr kohë. Pra, nuk është që sot ne vendosim dhe një muaj bëhet ligji dhe fillojmë. Edhe deri të miratohet ligji, deri të hartohet ligji, deri sa të fillojnë afatet kohore, deri sa të mbërrijmë te pika e fundit që një gjyqtar, po supozojmë, të dalë nga puna për shkak të këtij procesi, shkojnë vjet. Kështu që deri atëherë unë jam i sigurt si shtet i Kosovës mund ta bëjmë rekrutimin. Kështu që mos e shtyni vetingun, meqenëse po thoni që është i domosdoshëm, për arsye se jemi duke u marrë me rekrutim, sepse kemi kapacitete ose do të duhej të kishim kapacitete t'i bëjmë të dyja dhe na nevojiten.

Rekrutimi nuk e zvogëlon korrupsionin, ndërsa ky tjetri po. Absolutisht qasje të tillë kam parë problematike, një prej tyre e the sot, po, po them e flasim kur vijnë Kodi Penal dhe Kodi i procedurës penale. Për mua është e papranueshme të zvogëlohet e drejta në Apel më shumë se një herë, për shkak se kemi mungesë të efikasitetit. Të drejtat e njeriut dhe e drejta për gjykim të drejtë është më e rëndësishme se sa vonesat dhe nëse ne shkojmë, sepse nuk po na funksionon sistemi, është joefikas, e problemi nuk është te ligji, po te fryma që është ndërtuar që e zbaton ligjin, që janë përgjegjësit në këtë punë, kjo është rrezik. Kështu që sigurisht që unë jam kundër në parim që të bëjmë një ndalesë të tillë. Kam edhe shumë çështje të tjera, për të cilat po besoj që do t'i diskutojmë në nivel të argumenteve dhe besoj që do të mbërrimë ta bindim njëri-tjetrin, sepse Kodi Penal dhe Kodi i procedurës penale janë përtej mandatit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Për mua është shqetësues motivi, arsyeja që u përmendën këtu pse duhet luftuar korrupsionin. U tha këtu nga disa parafolës se korrupsionin duhet luftuar, sepse e kemi kusht për liberalizimin e vizave, kjo të bën të mendosh se po bëjmë përpjekje ta kamufllojmë një luftë për një problem që është shumë serioz në këtë vend. Unë mendoj që ne së pari duhet ta kuptojmë se korrupsioni është i dëmshëm për këtë vend dhe kjo duhet të jetë arsyeja kryesore pse duhet ta luftojmë korrupsionin. Se në Kosovë ka korrupsion, pajtohen të gjithë, madje edhe vetë të korruptuarit.

Se korrupsioni është shtrirë horizontalisht dhe vertikalisht, pothuajse në të gjitha poret e jetës, edhe kjo është një e vërtetë e pamohueshme. Se shtrirja aq e gjerë është vetë pengesa për ta luftuar këtë dukuri kaq të dëmshme, është po ashtu e vërtetë. Kjo situatë, në të cilën gjendemi, më kujton një pyetje të një peshkatari të ri, të cilit i rrezikoheshin peshqit nga prishja dhe pyet se

çka duhet ndërmarrë për t'i mbrojtur ata? Kur dikush i tha se duhet t'u hedhet kripë, ai pyeti: çka duhet të bëjmë nëse prishet edhe kripa?

Kolegë të nderuar deputetë,

Siç po duket, në Kosovë është prishur edhe kripa, por megjithatë nuk duhet të heqim dorë nga lufta kundër korrupsionit. Për ta luftuar korrupsionin patjetër duhet 't'i hiqet peta lakrorit'. Janë ngopur qytetarët e Kosovës me deklarata pompoze për shpalljen e luftës korrupsionit nga përgjegjësit për pengimin e korrupsionit ose nga vetë të korruptuarit. Së pari duhet të konstatohet se korrupsioni nuk e pengon vendin tonë vetëm për liberalizimin e vizave, por korrupsioni pengon edhe në investimet e huaja në Kosovë, ndikon edhe në cilësinë e dobët të investimeve në infrastrukturë të çfarëdo lloji, ndikon edhe në shërbimet e dobëta shëndetësore dhe në cilësinë e dobët në arsim, në punën në administratë dhe gjyqësor, pra në të gjitha sferat e jetës.

Korrupsioni nuk është i lartë për shkak të mungesës së ligjeve ose nismave deklarative që nuk kanë munguar në këtë vend. Korrupsioni është i lartë për shkak të mungesës së vullnetit të përgjegjësve institucionalë, korrupsioni që i ka karakterizuar të gjitha qeveritë e gjertanishme nuk mund të luftohet nga përgjegjësit për praninë e korrupsionit, e aq më pak nga ata që janë vetë të korruptuar dhe tani paraqiten si luftëtarë të korrupsionit. Korrupsionin do ta luftojnë vetëm ata që nuk janë të korruptuar, që kanë vullnet dhe guxim ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar që po ia zë frymën këtij vendi. Korrupsioni duhet të luftohet jo pse është kusht, po se është pengesë për jetë normale në këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Unë po filloj dhe po shpresoj që ministri i Drejtësisë e dëgjon, ishte çështja e një fakti që e përmendi, me të cilin pajtohem dhe veç po e korrigjoj pak. Mesatarja e një procesi gjyqësor në Kosovë, fatkeqësisht, është pak më e lartë se 8.5 vjet, fatkeqësisht. Fatkeqësia tjetër është se nuk kemi të bëjmë me kthimin nga shkalla e dytë, nga Apeli, por fatkeqësia është se pritet shumë gjatë për futjen në radhë të trajtimit të çështjeve në gjykatat themelore, ky është problemi kryesor.

Nëse marrim mesataren evropiane, mesatarja evropiane, hiq Rumaninë dhe Bullgarinë, të them që janë në mesin e shteteve të Unionit Evropian, është maksimumi 200 ditë të zgjidhjes së një lënde ose të marrjes së një vendimi në shkallën e parë, prej ditës së dorëzimit të kallëzimit penal apo çfarëdo qoftë të formës së inicimit të një lënde gjyqësore. Kjo është çështja, kjo ndryshon në Kosovë, sepse në Kosovë, në të vërtetë, kemi raste kur pritja është mbi 5 vjet. Edhe më shumë se 5 vjet, dhe kemi raste kur parashkruhen lëndët, sepse kanë kaluar çdo afat. Unë mendoj se kjo nuk mund të bëhet as me këto reforma që i kemi filluar, as me ndonjë reformë tjetër. Ne kemi

pasur këtu edhe propozime të ndryshme, por me gjendjen e gjyqësorit, tani unë s'po flas për më vonë, e forma të korrupsionit, por me gjendjen e gjyqësorit tani nuk mund të priten reforma që garantojnë të drejtat e njeriut, s'po flas për liritë, por për të drejtat e njeriut, edhe e drejta themelore e njeriut në një shtet ligjor është e drejta që ia jep gjykata. Kjo kështu është, nuk është ndryshe, sepse çdo e drejtë dhe çdo liri themelore është e kodifikuar.

Prandaj, flasim për të drejtat e njeriut, nëse këtu ka zvarritje qysh i shohim ne, kjo është shkelja më e madhe e të drejtave të njeriut, ka qenë edhe përpara, është edhe tash, zvarritjet janë të natyrave më të ndryshme, nuk po dua të hyj aty. Prandaj, nuk e shoh reformën që synon, zoti ministër i Drejtësisë, nuk e shoh si të vlefshme edhe është shkelje e të drejtave të njeriut, sepse në një shtet ligjor çdo njeri ka të drejtë t'i përdorë të gjitha mjetet juridike derisa të shteren ato, po shpresoj ndonjëherë derisa të bëhemi palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, e mandej ata na i tregojnë edhe disa gjëra që ne nuk i kemi këtu.

Në të vërtetë ne po flasim për korrupsionin, çka është korrupsioni, në thelb? Korrupsioni në thelb është veprim mashtrues i përfitimit të zyrtarit duke keqpërdorur detyrën zyrtare, kryesisht përmes mitos. Mirëpo, mito nuk është gjithmonë para drejtpërdrejt në dorë, janë shërbime, janë veprime të ndryshme, nga më të ndryshmet, por në të vërtetë keqpërdoret detyra e zyrtarit që është e kodifikuar në shtetin ligjor. Një zyrtar që kërkon çfarëdo të mire tjetër përveç asaj që ia cakton ligji për të kryer detyrën me të cilin e ka ngarkuar ligji, ky është korrupsioni. Edhe unë them që nuk ka asnjë fushë të organizimit institucional në Republikën e Kosovës ku nuk është i përhapur ky fenomen, kjo dukuri.

Pajtohem me atë se shqiptari, por asnjë popull tjetër, për të mos qenë racist, nuk e ka në gjen korrupsionin. Korrupsioni lind nga pozita e të fortit dhe nga pozita e atij që ka mundësi ta keqpërdorë. Natyrisht që korrupsioni ka 100 fytyra të ndryshme, por unë po përmend vetëm diçka çka ne i kemi përmendur këtu, po nuk i themi. Është mungesa e transparencës së institucioneve, është mungesa e përgjegjësisë së institucioneve, në të vërtetë, institucionet i përbëjnë njerëzit, i përbëjnë përgjegjësit, ata që e keqpërdorin detyrën. Është konflikti i interesit, është fshehja e pasurisë, është mungesa e qasjes në informata që i mbulojnë, duke filluar nga çdo institucion që e kemi ne në Republikën e Kosovës. Kjo nuk është e rastësishme, kjo është rrënjësuar në mënyrën e funksionimit institucional në Republikën e Kosovës. Nuk kemi të bëjmë vetëm me korrupsionin e madh, në krye, ose me korrupsionin e vogël, në rrugë aty diku, por kemi korrupsionin në format më të ndryshme, sepse ka filluar të bëhet kulturë e veprimit institucional. Ky do të jetë problemi ynë kryesor, problem që është jashtëzakonisht i madh.

Ju e mbani mend, edhe unë e mbaj mend, më së paku dhjetë herë prej kreut të shtetit është folur për 'zero korrupsion', dhe çka bëjmë? Pas shumë vjetësh ne vijmë edhe bisedojmë për korrupsionin e nivelit të lartë që na thonë edhe të tjerët. I kemi disa institucione, duke filluar prej presidentit të shtetit e poshtë, që kanë krijuar institucione kundër korrupsionit, për luftë kundër

korupsionit. Ku jemi? Sot po diskutojmë për korupsionin. Natyrisht e ka iniciuar dikush tjetër, në një formë opozita, por pozita nuk po e mohon se ka korupsion, ky është problemi. Kjo është një gjendje shumë e rëndë, unë pak po e shoh që ka mbetur numër i vogël i kolegëve, edhe jemi lodhur, por po e tregoj një çështje, një anekdotë, një mesele, si e thonë në popullin tonë, për të qeshur pak:

Një nën dhe një djali, fukarenj dhe djali për çdo ditë i thoshte nënës: “Hajde harrnomi pantollat, hajde bre nënë se mbeta cullak. Dikur asaj i vjen në maje të hundës: O bir, po na më shumë po rrimë cullak, se sa me pantolla, se këta pantolla nuk harrnohen më, s’ke ku i harrnon”.

Domethënë, duhet të blihen të rinj, ky është problemi. Ne duhet ndryshuar sistemin e veprimit dhe organizimit institucional për të zhdukur dukuritë që na kanë kapluar.

Dikush thotë po bën me gisht! Për besë në këtë vend ka 20 vjet që është bërë me gisht, nja 18 vjet, por mungon hallka kryesore e përgjegjësisë, dhe hallka kryesore e përgjegjësisë është, unë s’po shkoj te presidenti i shtetit, por po shkoj te Gjyqësori.

Një shtet që nuk ka drejtësi institucionale, vjen në këtë gjendje. Ne nuk e kemi pasur një gjyqtar, po them, dhe një prokuror në këtë vend që ka guxim ta kapë këdo qoftë në çfarëdo pozite dhe ta nxjerrë në bankën e të akuzuarve për keqpërdorim të detyrës zyrtare, jashtë asaj që ia lejon ligji, duke i thënë se këtë e ndalon ligji dhe kjo është e dënueshme. S’kemi pasur rast, s’ka, sepse s’kemi veting, s’kemi reformë. Një çështje shumë e rëndë, domethënë, çka ka ngjarë? Korupsioni ka bërë të mundur që kjo shoqëri ta humbë besimin një herë në institucione, mandej në shtet, mandej edhe në relacionet, në raportet ndërnjerëzore. Është një sociolog gjerman, Niklas Luman, që tregon çka është besimi. “Besimi është reduktim i raporteve njerëzore”. Çka domethënë kjo? Nëse ne i besojmë gjyqësorit, për besë, nuk kemi problem të veprojmë shumë lehtë sot për ta nxjerrë një dokument, të fitosh një të drejtë, e shumë qytetarë e kanë humbur besimin se mund ta fitojnë të drejtën, duhet shkuar e ecur nja dhjetë zyra, e të nxjirren nja dhjetë dokumente, që në fund të konstatohet se kurrkush nuk është kompetent dhe kurrkush nuk është fajtor për atë që ka ngjarë. Ky është problemi.

Unë mendoj se ka probleme sistemi. Sistemi i qeverisjes duhet të ndryshohet, duke filluar nga drejtësia. Ne e kemi humbur besimin në drejtësinë institucionale, e drejtësia institucionale na karakterizon neve ndryshe, sepse e kemi humbur besimin edhe në drejtësinë shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Meqenëse m'u referua dy-tri herë, e ndiej obligim.

I nderuar zoti deputet,

Në radhë të parë nuk pajtohem me ty që këto reforma që i kemi ndërmarrë, qoftë në ristrukturimin e Gjyqësorit se nuk do të japin efekte, edhe politikat penale që i kemi ndërmarrë, besoj që do të japin efekte dhe ajo do të jetë në fund të ditës diçka që do ta prekin qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sa i përket efikasitetit, besoj se je i vetëdijshëm, e di edhe ti, jo në të gjitha gjykatat në Republikën e Kosovës e kemi nivelin e njëjtë të punës. Më së keqi jemi në Prishtinë. Pra, në Prishtinë është një ngarkesë tejet e madhe. Në Prishtinë, qytetarët presin jashtëzakonisht shumë, për dallim ta zëmë prej Prizrenit, ku në dy vjetët e fundit në Gjykatën Themelore në Prizren as edhe një lëndë e vetme nuk është përshkruar. Domethënë, në Prizren nuk duhen më shumë se dy muaj për t'u trajtuar lëndët që hyjnë në proces. Pra, është një shembull jashtëzakonisht i mirë i punës, por normalisht nuk e ka ngarkesën që e ka Prishtina.

Me ligjin e ri që e sollëm për gjykatat, mendoj se kemi arritur ta decentralizojmë dhe njërin prej departamenteve që është tejet i rëndësishëm, pra ai për çështje administrative, do të decentralizohet dhe do të jetë edhe nëpër gjykatat tjera themelore dhe besoj që kjo do ta rrisë pak, ta lirojë Komunën prej kësaj ngarkese që e ka tani.

Një prej çështjeve që unë vazhdoj të këmbëngul, që është më e rëndësishmja, është rritja e numrit të gjyqtarëve në këtë vend. Pa dyshim, edhe procesi i rekrutimit ndoshta do të ndryshojë, të mos jetë ky i njëjti që e kemi pasur deri tani, të arrijmë të kemi figura kredibile që do të kenë efikasitet më të madh në punën e tyre. Mirëpo, me këtë numër që e kemi, ne nuk mund të presim mrekulli. Me këtë sistem çfarë e kemi, nuk mund të presim mrekulli. Do të vazhdojmë. Pra, i kam ndërmarrë këto reforma dhe një prej çështjeve që e konsideroj më të rëndësishme është rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit, që besoj se do ta prodhojë një strategji se si duhet të veprojmë më tutje: a i duhet Kosovës Gjykatë Speciale, a i duhet Kosovës Gjykatë që adreson çështje komerciale, që e kemi pasur deri në vitin 2013 dhe më nuk e kemi. Dhe, të gjitha këtyre pyetjeve besoj se kjo strategji do t'u japë përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

(Debat në sallë)

Ka të drejtë në replikë. Zotit Kurteshi e ka fjalën për replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Nuk është ndonjë replikë për kritikë, ose kundërshtim. Problemi themelor, zoti ministër, është se ne e kemi numrin më të ulët të gjyqtarëve në Evropë. Pajtohem. Është diku ndërmjet 17 dhe 18

për kokë të banorëve, apo diçka ashtu. Por, ne nuk kemi bashkëpunëtorë profesionalë, që është problemi më i madh, në një. E dyta, pse unë po them drejtësia? Sepse të gjithë ne këtu po të mos besonim në një drejtësi, që është sado kudo institucionale, nuk guxojmë as të kontaktojmë me njëri-tjetrin, të ndërtojmë raporte ndërnjerëzore.

Po jua përmend një rast që është tragjik në Kosovë, por nuk ka përfunduar në mënyrë tragjike me vrasje, mos e kuptoni ashtu. Tani e katërbëdhjetë vjet, një njeri sillet nëpër gjykata të Kosovës, sepse një gjykatë në Kosovë e ka shpallur të vdekur këtu në Prishtinë, për t'ia marrë pasurinë edhe tani e katërbëdhjetë vjet nuk ka gjykatës që guxon t'i dënojë kolegët e vet, të cilët e kanë shpallur të vdekur. Ky është problemi. Edhe ai ka humbur, ai vdes tash se është në moshë. Ky është problemi. Qysh ta ndërtojmë ne një sistem që t'i besojmë drejtësisë institucionale? Ne mund të mos pajtohemi për gjëra të ndryshme, por drejtësinë duhet çuar përpara. Ne duhet të ndërtojmë drejtësi të vërtetë, që është institucionale, e bëhet edhe shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për fund, zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Unë edhe një herë dua të them se ne kemi marrë më shumë, ka pasur më shumë interes edhe për diskutim, dhe kemi marrë më shumë rekomandime se si të luftohet korrupsioni nga organizatat joqeveritare, sesa dëgjuam sot, sepse ndonëse secili deputet tha që të japim propozime konkrete, unë munda ta dëgjoj vetëm një propozim konkret dhe ai në fakt u dha nga ministri, të cilin do ta them më vonë.

Por, zoti ministër, e kam edhe një, nuk po dua ta quaj replikë me ju, sidoqoftë një mospajtim. Ju thatë se duhet të rritet sidomos numri i gjyqtarëve dhe është propozimi ynë i parë, ngritja e kapaciteteve për sistemin e drejtësisë, në përgjithësi. Megjithatë, kjo nuk besoj se do ta forcojë vullnetin dhe mbi të gjitha gjyqtarëve u duhet guximi për ta luftuar seriozisht korrupsionin dhe, sidomos, kur janë në pyetje figura të larta, apo siç quhen njerëz të fuqishëm. Ndryshe nuk e di si shpjegohet fakti se një gjyqtar pas rreth njëzet seancave dëgjimore dhe pasi i ka dëgjuar mbi njëzet dëshmitarë heq dorë nga rasti dhe nuk e nxjerr vendimin përfundimtar. Ose, kemi raste kur një lëndë kalon nëpër duart e gjashtë prokurorëve të ndryshëm, sepse ata heqin dorë nga hetimet, nuk i mbyllin hetimet për mungesë provash, por heqin dorë nga lënda dhe nuk ngrenë aktakuzë, po ashtu sepse të përfshirë në rastet e tilla janë “njerëzit e fuqishëm”.

Prandaj, përveç gjyqtarëve të rinj, e ndoshta edhe prokurorëve, ndonëse ju konkludoni se nuk ka nevojë, neve na duhen njerëz që kanë njerëz që e kanë vullnetin dhe, mbi të gjitha, e kanë guximin për ta zbatuar ligjin për punë për të cilën ata janë të thirrur. Ndryshe, nëse u mungon ky guxim, mendoj se nuk e kanë vendin në sistemin e drejtësisë.

Unë edhe një herë i ftoj kolegët e mi që propozimet e tyre t'i dërgojnë me shkrim dhe, si duket, as nuk kemi kuorum për t'i votuar këto propozime dhe nesër në fillim të seancës ne do t'i japim edhe një herë propozimet e përfshira dhe i vetmi, siç thashë, propozim që dëgjova ishte që të rishqyrtohet edhe një herë Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit dhe në mesin e zyrtarëve që e deklarojnë pasurinë dhe prejardhjen e saj të përfshihen edhe inspektorët dhe ne po ashtu propozojmë që këtu të përfshihen edhe zyrtarët e prokurimit. Përndryshe, ne qëndrojmë prapa rekomandimeve tona dhe, duke përfshirë edhe të tjerat që do të ofrohen nga deputetët apo grupet parlamentare, propozoj që nesër t'i hedhim për votim kur ta kemi kuorumin e nevojshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë konsideroj që edhe për këtë pikë të rendit të ditës debati ka përfunduar.

25. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur nga pesë deputetë nënshkrues, në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë

Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Sinqerisht, duke ditur se sot e tri ditë rresht deputetët kanë qëndruar deri vonë dhe me kërkesën edhe të kolegëve të mi deputetë që e kanë nënshkruar këtë iniciativë për debat parlamentar, unë e kam një kërkesë që debati të tërhiqet për nesër. Orën e propozoni kur të doni.

Për mua nuk është problem, unë jam këtu, por disa deputetë që kanë qenë edhe nënshkrues, kërkuan që... Le të vendosin deputetët, tek e fundit, le të pyeten grupet parlamentare, të lutem! Unë po propozoj të tërhiqet për nesër. Tani, nëse pajtohen edhe të tjerët, si të doni.

KRYESUESI: Nesër s'ka seancë. E kryejmë sonte, se nesër s'ka seancë. Mund ta tërheqësh krejt, por ta shtysh s'mundesh.

TEUTA HAXHIU: Jo, ta tërheq, s'vjen në shprehje, sepse nuk e kemi bërë sa për politikë, por për ta shtyrë për nesër, ose për të premtën...

Edhe një herë, i nderuar zoti Hoti, edhe një herë thashë kolegët e mi nga Komisioni Parlamentar kanë qenë nënshkrues bashkë me mua për këtë debat parlamentar. Meqë kërkesa ishte edhe nga ata që e kanë nënshkruar, unë e bëra këtë propozim, përndryshe unë jam këtu. Tani le të vendosin grupet parlamentare.

KRYESUESI: Konsideroj që po e tërhiqni pikën e rendit të ditës dhe ky është vendimi, në qoftë se ju doni, në qoftë se jo atëherë po e vazhdojmë seancën. Asnjë gjë s'ka më, nuk ka ndryshim,

sepse ne jemi në seancë dhe sonte do të përfundojë kjo pjesë e seancës. I kemi interpelancat me kryeministrin, e kemi interpelancën me Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes dhe të tjerat interpelanca mund të vijë sonte, kështu që mos... T'i kryejmë sonte këto pika të rendit të ditës. Paska mjaft deputetë për debat dhe më mirë është për ne.

E ke fjalën, nëse do ta prezantosh pikën e rendit të ditës, ose nëse do ta tërheqësh. Si të duash. S'mund ta shtysh! Unë e mbyll seancën dhe ty kur të të vijë rendi mund ta bësh kërkesën për së dyti. Po, fjalën ta jap, por ky është rregulli. Ti s'mund ta shtysh kur të duash, mund veç ta tërheqësh. Regjia, jepja fjalën zonjës Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: OK, vetëm të kuptohemi! Unë thashë që jam këtu, se në fund të fundit pëlqimin dhe miratimin e mora prej kolegëve që kanë nënshkruar. Nëse jeni gati, atëherë vazhdojmë, e në fund të fundit nënkryetari nuk mund të vendosë kur ta mbajmë debatin, jemi ne që vendosim.

Edhe një herë, unë e vazhdoj, nëse grupet parlamentare nuk kanë mendime tjera. Unë do të doja t'i marrim mendimin e grupeve, por megjithatë nënkryetari po e shfrytëzon të drejtën e ulëses në atë kolltuk. Atëherë... Jo, ta tërheq, vetëm të jemi të qartë, unë nuk e tërheq.

(Debat në sallë)

Në rregull! Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, në këtë atmosferë siç po shihet, unë besoj që të gjithë jemi seriozë, e di që është lodhje, por kërkoj falje që është një temë për të cilën besoj se të gjithë pajtohemi se është shqetësuese. Për të mos ardhur në situatën siç ndodhi në debatin para këtij, pra që pas dy-tri diskutimeve erdhi në shprehje për ta ndërprerë, atëherë unë mendoj se ajo është joserioze. Ky ishte qëllimi im. Përndryshe, vazhdojmë, por jo pse tha nënkryetari.

Në një konferencë të mbajtur në muajin shkurt, të organizuar nga MASHT-i, unë isha pjesë e asaj konference dhe sinqerisht nga shumë diskutime aty, ishte vërtet një shqetësim që e përjetova unë, në radhë të parë edhe si nënë, por edhe si deputete dhe ajo ishte shtytja kryesore që unë ta thërras një debat me temën "Siguria e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë".

Së pari, edhe një herë i falënderoj të gjithë kolegët e mi deputetë nga Komisioni për Arsim që m'u bashkëngjitën në këtë kërkesë.

Me një studim të bërë nga dy organizata joqeveritare në Kosovë, nga Organizata "Save the Children" dhe "Qendra për Studime të Avancuara, FIT", konfirmojnë se fëmijët në Kosovë janë përdorues shumë aktivë të internetit dhe kryesisht atë e përdorin për qëllime argëtuese dhe komunikim. Nga 1 150 fëmijë të anketuar nga komunat më të mëdha në Kosovë, ka rezultuar se 93% e tyre e përdorin internetin, ndërsa 45% e tyre kalojnë më shumë se një orë online. Shumica

e fëmijëve kanë raportuar se aktivitetet e tyre më të preferuara në internet janë rrjetet e ndryshme sociale.

Nga hulumtimi në fjalë del se ka mangësi të theksuara të përfshirjes së prindërve dhe mësuesve në monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve në përdorimin e internetit dhe kështu, çdoherë e më shumë fëmijët janë duke e përdorur internetin në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrjen e të rriturve.

Është bërë shumë e vështirë për të rriturit që t'i monitorojnë aktivitetet e fëmijëve në internet, e sidomos me faktin se shumica e fëmijëve kanë raportuar që përdorimin e internetit privatisht e bëjnë në dhomat e tyre apo nëpërmjet telefonave të mençur mobilë. Fëmijët e përdorin internetin në vendet publike apo edhe në kompjuterë të përbashkët, siç janë shokët apo nëpër kafene private, prandaj është shumë e vështirë që ta kenë një qasje në përmbajtjet më të papranueshme që mund t'i hasin ata gjatë kycjes në rrjetet sociale.

Andaj, në anën tjetër, rreziku është shumë i madh dhe kur ata përdorin kompjuterë privatë, pasi janë më pak të mbikëqyrur. Në përgjithësi, përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë është shumë i personalizuar dhe në këtë mënyrë qasja dhe përdorimi i internetit është shumë vështirë të monitorohet nga mësimdhënësit, apo nga prindërit. Shqetësimi më i madh yni në lidhje me sigurinë e fëmijëve në internet fokusohet në rrezikun që fëmijët mund të takojnë dikë online, i cili pastaj mund t'i abuzojë në takimet ballë përballë. Rezultatet nga ky hulumtim tregojnë se ky shqetësim nuk është krejtësisht i pabazë, pasi fëmijët në Kosovë takohen vazhdimisht me njerëz të panjohur nga interneti.

Fëmijët në Kosovë e përdorin kryesisht internetin për të komunikuar me të tjerët, sepse përdorimi i rrjeteve është aktiviteti më i preferuar i tyre, ku 84% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë llogari aktive në Facebook dhe Tweeter. Gjithashtu, 32% e fëmijëve nën moshën 13-vjeçare, të cilët kanë më pak informata rreth rregullimit të parametrave të privatësisë së profilit personal, kanë pohuar se kanë më shumë se 400 shokë në rrjetin social. Rrjetet sociale ofrojnë platformë të komunikimit, e cila lehtë mund të keqpërdoret nga të rriturit dhe mund të nxisë apo të ndikojë te keqbërësit që t'i ngacmojnë fëmijët tanë, duke lënë kështu pasoja serioze te ata.

Informacionet e marra nga ky hulumtim tregojnë se është e zbatueshme që fëmijët në Kosovë të posedojnë informacione personale: fotografi, emrin e shkollës, adresën e saktë në profilet e tyre në rrjetet sociale, duke i bërë ata të jenë objektiv relativisht i lehtë për keqbërësit në internet. Të gjeturat tregojnë se 58% e fëmijëve kanë komunikim në internet me dikë që nuk e njohin, nuk e kanë njohur më parë, pra personalisht kanë kontakt me ta. 69% e këtyre fëmijëve janë takuar me dikë të panjohur nga bisedat në internet. Në pyetjen se sa njerëz të panjohur kanë takuar në këtë mënyrë, pra kjo pyetje përfshin vetëm fëmijët që kanë pohuar se kanë takuar një të panjohur në internet, del se 44% e fëmijëve kanë deklaruar se e kanë takuar një, ose dy të panjohur; 20%

kanë takuar tre ose katër të panjohur; 11% kanë takuar deri në pesë apo gjashtë të panjohur; 16 kanë takuar më shumë se dhjetë të panjohur.

Kjo tregon se 81 fëmijë apo 16% prej atyre që kanë pasur kontakte me persona të panjohur takohen me më shumë se dhjetë njerëz të panjohur në vit. Kur kjo krahasohet me pjesën tjetër të Evropës, ku 77% e fëmijëve kanë deklaruar se takohen me më pak se 4 të panjohur në vit, del se fëmijët tanë në Kosovë janë më shumë të rrezikuar nga takimet me njerëz të panjohur në internet.

Përveç analizimit të numrit të njerëzve që ata takojnë, është e rëndësishme të kuptojmë dhe vlerësojmë se si fëmijët e perceptojnë rrezikun kur të takohen me njerëz të panjohur nga interneti. Takimi me njerëz të panjohur mund të mos jetë fare i dëmshëm dhe ta rrisë rrethin e miqve dhe të shoqërisë, por takime të tilla rezultojnë edhe shumë të rrezikshme, pasi që fëmijët mund të takohen me kriminelë apo keqbërës të ndryshëm.

Fëmijët e anketuar në pyetjen se në dymbëdhjetë muajt e fundit a keni takuar dikë në këtë mënyrë, që ju ka shqetësuar juve, për shembull ngacmuar, nervozuar, mërziur apo lënduar, nga të gjithë fëmijët që kanë takuar persona të panjohur në internet, 48% e tyre kanë deklaruar se kanë qenë të shqetësuar nga këto takime. Siç është pritur, pra edhe moshë më e re e tyre ka qenë 9-12 vjeç, që janë shqetësuar më shumë nga takimet me të panjohurit. Takimi i shpeshtë me të panjohurit nga rrjetet sociale paraqet rrezik serioz për fëmijët dhe mund të shpjerë deri te ofendimi, ngacmimi, shqetësimi, madje edhe te dhunimet e tyre. Kur besimi i fëmijës të jetë fituar nga i rrituri apo keqbërësi dhe takimi të jetë caktuar, fëmija është në rrezik të madh nga dëmi fizik dhe psikologjik.

Profile të rrejshme mund të krijohen shumë lehtë dhe keqbërësit mund të gënjejnë për moshat e tyre, në mënyrë që t'i mashtrojnë fëmijët tanë. Përkundër kësaj, përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë duhet të forcohet, e jo të kufizohet, por njëkohësisht duhet të jetë i sigurt.

Vetëdijesimi i shoqërisë për rreziqet e mundshme, përmirësimi i programeve për siguri në internet dhe njohja më e mirë e përdorimit të internetit nga familjarët janë mënyrat më të duhura që mund të rezultojnë në përdorimin më të mirë dhe më të sigurt të internetit nga fëmijët. Parandalimi i abuzimeve të fëmijëve kërkon motivim aktiv dhe vigjilencë. Nuk është një obligim dhe përgjegjësi e të gjithëve, e në veçanti e individëve apo edhe familjarëve, por në përgjithësi e gjithë shoqërisë. Nuk mund të merret kjo si një punë vetëm e ofruesve të internetit, ose prindërve, apo organizatave të ndryshme, shkollave dhe medie, por kjo është një çështje e gjithë shoqërisë dhe atë në partneritet që të sigurojmë që fëmijët tanë të jenë më të sigurt.

Duke qenë se rekomandimet u janë përcjellë besoj të gjithë deputetëve, unë megjithatë po i lexoj dhe pres që këta deputetë ose kolegë që janë këtu të kontribuojnë edhe me rekomandime të tjera.

1. Rekomandoj që institucionet përgjegjëse, në radhë të parë Qeveria, e Republikës së Kosovës, obligohet që të mbrojtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Valentina Bunjaku.

VALENTINA BUNJAKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Realisht, kolegja paraprake ka mbledhur nënshkrimet për të debatuar për sfidat dhe problemet e fëmijëve që qasen në internet. Siguria e fëmijëve në internet është sfidë globale, sidomos në dekadën e fundit të zhvillimit aq të hovshëm të medieve sociale dhe përdorimit masiv të celularëve me qasje kudo dhe kurdo në internet. Por, vendet e zhvilluara, jo vetëm se kanë hartuar shumë ligje të veçanta në mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve në internet, por edhe kanë investuar financiarisht shumë, duke realizuar shumë programe vetëdijesimi për fëmijët, prindërit dhe edukatorët.

Kosova e ka bërë një strategji të quajtur Strategjia shtetërore për sigurinë kibernetike dhe Planin e veprimit në vitet 2016-2019, e botuar në dhjetor të vitit 2015, ku flitet për mbrojtjen e fëmijëve nga materialet e papërshtatshme në internet dhe rreziqet tjera të shkeljes së privatësisë së fëmijëve. Por, ajo strategji duhet të plotësohet edhe më shumë me hapa të tjerë konkretë nga Kuvendi, Presidenca, OJQ-të, organizatat, mediet, prindërit, mësimdhënësit, edukatorët dhe nga e gjithë shoqëria në përgjithësi. Kjo strategji duhet të shoqërohet edhe me një fond të veçantë të trajnimeve, të programeve të ndryshme për prindërit dhe edukatorët, për t'i shfrytëzuar dhe mbrojtur fëmijët nga peshkimi kudo nëpër internet dhe si t'u shmangen lloj-lloj rreziqeve që mund t'u vijnë fëmijëve nga qasja online në internet, pa monitorimin e vazhdueshëm të të rriturve.

Sa i përket legjislaturës për mbrojtjen e fëmijëve dhe sigurisë së tyre në internet, Kosova direkt apo indirekt ka disa akte apo ligje që i sigurojnë fëmijët në internet, duke u nisur nga Kushtetuta e deri te Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligji për parandalimin, luftimin e krimit kibernetik, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i drejtësisë për të mitur, e tjera... Megjithatë, Kuvendi i Kosovës mund ta miratojë një ligj të ri, që merret veçanërisht drejtpërdrejt në mënyrë të detajuar vetëm me sigurinë e fëmijëve në internet.

Ne kemi hulumtuar në disa vende për ligje të tilla dhe kemi hasur në emërime, si Ligji i mbrojtjes së privatësisë së fëmijëve në internet apo Ligji i privatësisë online.

Një ligj si ky mund të hartohet edhe në Kosovë, ku krijohet infrastrukturë e plotë ligjore për të siguruar qëndrimin e fëmijëve në internet.

Këto ligje do të specifikonin edhe mbrojtjen e fëmijëve, sidomos në moshën 13-vjeçare, pasi që këto grupmosha janë më të rrezikuara, pa përjashtuar edhe fazën e fillimit të adoleshencës.

Pra, Kosova duhet të pasurohet me ligje të tjera mbi sigurinë e fëmijëve në internet, por edhe t'i zbatojë ligjet për t'i mbrojtur fëmijët nga rreziqet dhe nga përdorimi i internetit.

Me ligjin e ardhshëm që mund të hartojmë, duke emëruar edhe në versionin tjetër si Ligji për siguri për mbrojtjen e privatësisë të fëmijëve në internet, duhet të përcaktohet kategorish mbrojtja e privatësisë së fëmijëve, duke ua ndaluar operatorëve, agjencive të ndryshme të marketingut, administratorëve, e të tjera faqeve të ndryshme mbledhjen apo përdorimin e informacionit personal të fëmijëve, si një emër apo një adresë, numër telefoni apo edhe shumë informata të tjera pa pëlqimin e prindërve. Këtu duhet të përfshihet edhe ndalimi i menjëhershëm i kërkimit aq të madh të informacioneve dhe detajeve për përdoruesit nga administratorët e faqeve në internet, vetëm sa për të shfrytëzuar apo për të luajtur një video lojë online.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, bashkë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe njësitë e veçanta në kuadër të policisë dhe kundër krimeve kibernetike, duhet të organizojnë sa më shumë bashkëpunime me organizata joqeveritare, institucione parashkollore, shkollore dhe projekte të veçanta vetëm për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve në internet.

MASHT mund të organizojë seminare me edukatorë, me mësimdhënës, por edhe me prindër rreth mënyrës më të shëndetshme të sigurisë së mbrojtjes së fëmijëve në internet.

Jo vetëm gjatë qëndrimit në internet brenda shtëpisë, po kurdo dhe kudo që janë ata dhe kanë qasje në internet, në hapësira publike apo edhe në shkolla.

Të nderuar deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Përfundimisht duhet plotësuar legjislaturën për mbrojtjen e fëmijëve në internet edhe me ligje të reja, por edhe duke marrë masa konkrete në trajnimin dhe vetëdijesimin e edukatorëve, prindërve, mësimdhënësve, edukatorëve dhe kujdestarëve të fëmijëve.

Teknologjia e komunikimit është zhvilluar shumë dhe ka tejkalluar zotësinë teknologjike të të rriturve. Prandaj, shteti duhet ta ndihmojë shoqërinë në përballimin e këtyre sfidave të reja, të cilat janë shumë të rrezikshme për moshat e reja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Mexhide Mjaku.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në përgjithësi, ky shqetësim i ngritur dhe që po e diskutojmë sot në Kuvend, konsideroj që nuk është vetëm shqetësim i vendit tonë, sepse ne kemi si informatë se të gjitha shoqëritë në vende të ndryshme po përballet me këtë sfidë.

Interneti është bërë pjesë e përditshmërisë sonë dhe pothuajse nuk ka shtëpi apo familje që nuk e përdor atë sot. Ndërsa sot po diskutojmë për një temë të caktuar, për sigurinë e fëmijëve nga përdorimi i internetit.

Sigurisht që të gjithë e dimë se fëmijët janë ajo pjesë sociale që është më shumë e lidhur me mjetet elektronike dhe që është në të njëjtën kohë duke përfituar dhe pësuar prej kësaj epidemie masive elektronike.

Pa dyshim, kur flasim për pasojat, nuk duhet t'i ndajmë nga përfitimet. Kostot dhe përfitimet e fëmijëve nga kjo lidhje deri në varësi nga mjetet dhe lojërat elektronike janë të dyanshme.

Nga njëra anë, kemi një proces të përshpejtuar të zgjerimit të njohurive dhe akselerimit të dijeve nga fëmijët, por nga ana tjetër, duket se po shfaqen deformime fizike dhe sociale, të cilat po dëmtojnë zhvillimin e natyrshëm të fëmijëve pikërisht për shkak të qëndrimit pasiv.

Po ashtu po shfaqen tendenca të të mësuarit dhe përshtatjes së tyre me jetën në vetmi, me tastierë përpara dhe kufje në vesh, të cilat ka shumë mundësi të bëjnë vetminë, egoizmin dhe asocialitetin një tipar konsistent të tyre.

Ideja se mjetet elektronike janë bërë edukatorë alternativë të fëmijëve është një psikologji e gabuar dhe njëherësh një mentalitet përtac i prindërve të lodhur edukativisht që kanë humbur interesin për t'u marrë me fëmijët e tyre, për të bërë rolin e determinuar të edukatorit shtëpiak.

Nuk ka mjet që zëvendëson kujdesin e natyrshëm të familjes dhe afinitetin organik të prindërve, po shpeshherë disa prindër në mungesë të kohës për t'iu përkushtuar fëmijëve zgjedhin kujdestarin edukativ si mjet për t'i qetësuar ata.

Tjetra, koha familjare ka marrë më shumë dimension fizik dhe jo një dimension shpirtëror.

Pamja tipike e një familjeje postmoderne është ulja në dhomën e ndenjes, ku secili përdor pajisjen e tij elektronike, celularin, ajpedin, llaptopin, tabletin, e të tjerë.

Sipas disa studimeve, interneti përdoret më shumë për rrjete sociale dhe për lojëra se sa për një lundrim në internet të karakterit edukues.

Ndërsa në institucionet shkollore nxënësit informohen më shumë për internetin në lëndën e TIK-ut, mirëpo konsideroj se nevojitet një koordinim më i mirë i Ministrisë së Arsimit dhe organizatave të caktuara, ku do të duhej të mbahen seminare dhe trajnime të ndryshme në shkollat tona, me qëllim të njoftimit dhe edukimit të gjeneratave të reja mbi përdorimin dhe kyçje në internet, pasi popullata më e cënueshme janë të rinjtë dhe fëmijët, të cilët shpeshherë bien pre e ‘bullizmit’, ngacmimeve, kërcënimeve dhe mashtrimeve të ndryshme.

Vetëdijesimi i shoqërisë për rreziqe të mundshme, i përmbajtjen ilegale në internet, mbrojtjen e të dhënave personale, rregullimin e industrisë së telekomunikacionit, zhvillimin e politikave adekuate, përmirësimin e programeve për siguri në internet dhe njohja më e mirë e përdorimit të internetit nga familjet, janë mënyra të duhura që mund të rezultojnë në përdorim më të mirë dhe më të sigurt të internetit nga ana e fëmijëve.

Andaj, fillimisht si rekomandim kërkoj që Qeveria të sjellë në Kuvend Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve, duke ditur se për përmbajtja e tij në këtë projektligj, gjegjësisht në nenin 33, parasheh masa kundër faqeve të internetit. Kështu që është e nevojshme që të silllet para kohe, në mënyrë që si komision të vazhdojmë punën.

Përpos këtij rekomandimi, kemi edhe rekomandimin tjetër, institucionet arsimore, familja, organizatat e ndryshme biznesi dhe gjithë shoqëria në përgjithësi duhet të promovojnë gjithnjë e më tepër rritjen e ndërgegjësimin për sigurinë e fëmijëve nëpërmjet takimeve të posaçme, organizimit të seminareve me prindër e të rritur, si dhe komunikimit të përgjegjshëm në çdo klasë me nxënësit e arsimit bazë.

Nga ana tjetër, një detyrë jo më pak e rëndësishme u lihet institucioneve qendrore dhe lokale që qendrat e internetit apo internet kafet të detyrohen me ligj të vendosnin filtrat apo programe sigurie në kompjuterët që frekuentohen nga adoleshentët.

Një tjetër rekomandim i ri për nga përvoja, por i domosdoshëm për nga konteksti ku jetojmë, duhet të jetë ngritja e qendrave të këshillimit për fëmijët, të cilët kanë qenë pre e drejtpërdrejtë e abuzimeve gjatë përdorimit të internetit ose ndërthurja e punës këshilluese e psikologëve apo punonjësve socialë, të zhvillojnë aktivitetin e tyre pranë këtyre shkollave për të sensibilizuar edhe më tepër këta adoleshentë ndaj rreziqeve që sjell interneti i pakontrolluar.

Rekomandim për familjet është që në ambientet familjare qasja në internet të sigurohet në ambiente të përbashkëta, në mënyrë që fëmijët të jenë lehtësisht të kontrollueshëm gjatë kohës në navigimit në internet, ose duke instaluar filtrat e sigurisë.

Edukimi dhe shkolla janë aktorët që duhet të fillojnë sa më shpejt reflektimin e dukurive negative që vijnë si pasojë e ndryshmeve teknologjike dhe të informacionit, ato duhet të

përmirësojnë kurrikulat shkollore lidhur me teknologjinë e informacionit, internetin si dhe personeli përkatës i kësaj lënde të jetë i kualifikuar.

Rritja e fushatës së ndërgjegjësimit për rreziqet që sjell një përdorim i pakontrolluar i internetit, jo vetëm në ditët e caktuara, por në mënyrë permanente dhe jo vetëm në ambientet e shkollës, por edhe në media dhe formave të tjera të komunikimit.

Bashkëveprim më i mirë midis komunitetit të prindërve dhe mësuesve për më shumë siguri, më shumë kulturë dhe rezultate të mira për fëmijët tanë, më të reja që sjell çdo ditë e më shumë teknologjia dhe përdorimi i internetit, edhe fëmijët duhet mësuar se si dhe sa duhet ta përdorin internetin, duhen kontrolluar në një farë mënyre dhe duhet komunikuar me ata për rreziqet.

Për fund, mund të them se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë mocion me rekomandime dhe sigurisht që përpos rekomandimeve që i përmenda më parë, edhe deputetë të tjerë kolegë do të kenë rekomandime të tjera, të cilat do t'i harmonizojmë si grupe parlamentare në fund të këtij debati.

Më lejoni të them se fëmijët janë pasuria më e vlefshme e Kosovës, pasi që ata përfaqësojnë të ardhmen e vendit tonë.

Për më tepër, fëmijët janë anëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë dhe mbrojtja e tyre nga krimi duhet të jetë prioritet për të gjithë ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja Vetëvendosje, në emër të së cilës e kam marrë fjalën, konsideron se kjo është një ndër çështjet shumë të rëndësishme, prandaj e konsideroj të gabuar insistimin tuaj, zoti kryesues, që ky debat të ndodhë në këto orë të vona, kur një pjesë e madhe e deputetëve nuk janë këtu dhe këta që janë këtu janë të lodhur, prandaj sigurisht kjo do të ndikojë edhe në nivelin, edhe në cilësinë e debatit në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme për gjeneratën më të re të këtij vendi, siç u tha edhe nga parafolësit.

Sido që të jetë, përdorimi i pakontrolluar i internetit nga fëmijët dhe të rinjtë tanë është bërë problem shumë serioz në këtë vend, me të cilën askush nuk është marrë seriozisht, përveç konstatimeve të kohëpaskohshme se interneti është shumë i dëmshëm kur përdoret në formë të pakontrolluar, sidomos nga fëmijët e moshave të reja, të cilët vetë nuk janë në gjendje të selektojnë dhe të përzgjedhin materiale, të cilat atyre do t'u ndihmonin për informata që u duhen në jetë, por ata merren me çështje të cilat atyre u duken atraktive, e ndonjëherë ato janë edhe të dëmshme, e shpeshherë mund të jenë edhe të rrezikshme për fëmijët tanë.

Për pengimin e kësaj dukurie duhet një mobilizim i të gjitha segmenteve që ndikojnë në edukimin e fëmijëve, siç janë në radhë të parë prindërit që ndodh shumë shpesh të mos jenë të kujdesshëm sa duhet që t'i kontrollojnë fëmijët e tyre, derisa ata e përdorin internetin bazuar në vullnetin dhe dëshirën e tyre.

Shkollat dhe institucionet e tjera sociale janë shumë të rëndësishme që të ndikojnë në vetëdijesimin e fëmijëve që të përdorin internetin vetëm për atë që konsiderohet se u ndihmon atyre dhe të mos teprohet, në mënyrë siç po ndodh shpesh.

Natyrisht që për pengimin e kësaj dukurie kaq negative duhet të bëjmë përpjekje të ndikojmë edhe përmes ligjeve që duhet të nxjerrë ky Kuvend, por prapë po them se roli i prindërve, i shkollave dhe institucioneve të tjera sociale është i pazëvendësueshëm dhe nuk ka mundësi asnjë ligj t'i zëvendësojë ata.

Mendoj që do të ishte e udhës që edhe përmes ligjeve t'i obligojmë shkollat që të ndikojnë te fëmijët, duke mbajtur ligjërata të rregullta për kontrollimin e përdorimit të internetit, duke i vetëdijësuar ata se përdorimi i tepërt është i dëmshëm dhe për t'i bindur se interneti duhet të përdoret vetëm në masën që është e lejueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Me të vërtetë, përdorimi i pakontrolluar i internetit është një problem global dhe shumë i dëmshëm. Është shqetësuese se sipas disa studimeve është konfirmuar se fëmijët në Kosovë, sikur edhe fëmijët e tjerë, janë përdorues shumë aktivë të internetit. Ne këtë e vërejmë edhe në familjet tona dhe vërtet është shqetësuese se nga prindërit nuk monitorohet se për çka po e përdorin internetin fëmijët.

Andaj, debati i sotëm është më se i qëlluar dhe vërtet duhet të gjithë të angazhohemi që përdorimi i internetit të jetë i monitoruar dhe normalisht që i përkrahim rekomandimet.

Në një farë forme është krijuar një varësi e fëmijëve në përdorimin e internetit dhe është fatkeqësi, sepse në familjet tona fëmijë që ndoshta ende nuk kanë filluar as shkollën, dhuratat e para që u blihen nga prindërit janë telefonat dhe normalisht prej aty fillon keqpërdorimi i internetit.

Përpos përfitimeve në aspektin pozitiv, duhet të mbahen aktivitetet vetëdijësuese për fëmijët se përdorimi i tepërt i internetit është i dëmshëm.

Shumë shpejt në planin legjislativ pritet të vijë në Kuvendin e Kosovës Ligji për mbrojtjen e fëmijëve dhe anëtarët e komisionit kur të silltet ky ligj gjatë amendamentimit duhet saktë të amendamentojnë, në mënyrë që ky ligj të jetë edhe i zbatueshëm në praktikë.

Mirë që sot kemi teknologji të avancuar, por keqpërdorimi i kësaj teknologjie vërtet është shqetësuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Këta pak që kemi mbetur këtu,

Sot po debatojmë për një çështje që vërtet nuk është vetëm problem i Kosovës, por është një problem global, por unë do ta kisha përfshirë në fjalën time jo vetëm varësinë ndaj internetit, po në përgjithësi varësinë ndaj të gjitha mjeteve elektronike, sepse interneti është një dritare përmes së cilës fëmijët mund të bien në kontakt me gjërat, të cilat nuk janë në gjendje pastaj të gjykojnë si çdo i rritur, prandaj ekziston edhe rreziku që të bien pre e varësisë ndaj asaj që ata e konsumojnë përmes internetit. Po nuk është më pak e rëndësishme edhe ajo tjetra, siç janë lojërat elektronike, për të cilat nuk u nevojitet internet për të luajtur, por e kanë në kompjuter apo e kanë në atë që quhen ‘lojëra në smartfonë’, në telefona të mençur.

Pra, kjo është një problem që nuk lidhet vetëm me internetit, por e tejkalon edhe varësinë ndaj internetit.

Të mos kemi iluzione se këtë problem do ta zgjedhim me një ligj. Ligji natyrisht që ndihmon shumë në kufizimin nga mbrojtja e disa faqe, ueb-sajte, por nuk e mbron, s’ka ligj që mund ta edukojë fëmijën, secilin fëmijë në Kosovë.

Pra, përgjegjësia kryesore megjithatë mbetet te prindërit, mbetet te babai, te nëna, mbetet te kujdestarët e tyre të drejtpërdrejtë.

Dhe, shpresa se përmes një ligji do të shpëtojmë nga kjo e keqe globale edhe ne këtu në Kosovë, është një iluzion që mund të na kthehet në bumerang. Pra, të gjithë ata që kanë mundësi të blejnë një kompjuter, që kanë mundësi të blejnë një smartfon, siç e tha kolegja Timja fëmijëve të tyre, kanë mundësi edhe të blejnë programe dhe t’ua instalojnë në lloptopë apo në kompjuterët e tyre shtëpiakë, edhe programe përmes të cilave i monitorojnë fëmijët e tyre se në çfarë web faqesh po lundrojnë, po hyjnë, sa qëndrojnë, çka marrin nga ato, dhe jo detyrimisht fëmijët të dinë se janë të monitoruar. Pra, nuk është mirë të shpresohet që këtë problem do ta zgjidhin qoftë edhe përmes një ligji, qoftë edhe përmes shtrëngimit të masave që nëpër internet kafet të detyrohen të

vendosin bllokada ndaj shumë faqeve, të cilat mund të jenë indoktrinuese dhe të dëmshme për fëmijë.

Pra, le t'i kryejmë të gjitha punët që na takojnë, ne e dimë që në këtë kohë me një shkallë dhe dinamikë më të madhe, ku stresi është shumë më i madh në shoqëri, edhe prindërit shpesh i anashkalojnë detyrat e tyre të përditshme që kanë në edukimin dhe në kujdestarin e fëmijëve dhe duke dashur të blejnë paqen me fëmijën, qetësi në shtëpi, shpeshherë i lejojnë që ata të hyjnë në mënyrë të pakontrolluar e të pakufizuar nëpër internete.

Le t'i kryejmë pra secili obligimet tona në raport me fëmijët, shteti atë që e ka përmes ligjit dhe shkolla përmes edukimit, përmes arsimimit dhe në familje përmes kontrollit rigoroz, sepse në fund të fundit, fëmijët para se të jenë të shkollës, para se të jenë të shtetit, para se të jenë të shoqërisë, ata janë tanët, ata më shumë se që i do shoqëria, i duam ne, prindërit, babai, nëna dhe shpesh ne i ngatërrojmë dëshirat e fëmijëve me nevojat e tyre.

Fëmijët shpesh mund të kenë dëshira të çuditshme, por nuk kanë nevojë për ato dëshira, prandaj janë prindërit aty që t'u kufizojnë dëshirat, të cilat janë nevojë dhe nevojat të cilat mund të jetë edhe si dëshirë, por jo dëshira të cilat fare nuk janë nevojë e tyre dhe ne shpeshherë mbyllim një sy dhe i lejojmë ata që të hyjnë në internet vetëm e vetëm që ne të kemi paqe apo qetësi në familje.

Është një skeç, më duket "Stupcat" e kanë vënë në skenë që është jashtëzakonisht tregues për realitetin tonë, kur shkojnë disa njerëz në një familje mysafirë dhe ai ua heq kabllon nga priza që të mos kenë internet, me idenë që të fillojnë të bisedojnë me njëri-tjetrin. Aty e sheh kur sapo mungon interneti, ata në vend se të bisedojnë, siç kishin biseduar përpara, fillojnë të ngatërrohen dhe ky shkon prapë e vë në prizë kabllon dhe fillon interneti të funksionojë dhe aty prapë kthehet qetësia. Pra, ka një varësi jo vetëm të fëmijëve, varësia është edhe te të rriturit, ku rëndësi ka që ne të rrimë me atë që nuk e kemi aty dhe fare nuk rrimë me atë që e kemi aty.

Pra, le t'u kushtojmë më shumë kohë dhe kujdes fëmijëve në shtëpitë tona, sepse nëse ne nuk rrimë me ta dhe rrimë me dikë tjetër përmes smartfonëve, edhe ai do të rrijë me dikë dhe zakonisht ai zgjedh pastaj të rrijë me dikë që nuk e ka aty, edhe ai ka nevojë të ketë jetë sociale.

Le të marrim përgjegjësitë që na takojnë që më shumë kohë të kalojmë me fëmijë duke biseduar çka ai ka bërë gjatë ditës, qoftë për shkollë, qoftë në kohën e lirë me shokë, me sport, me çka është marrë. Kam përshtypjen që po kërkojmë përgjegjësitë tona si prind në përgjegjësi t'i hedhim diku tjetër, t'i kryejë shoqëria, t'i kryejnë institucionet shtetërore, ato nuk i kryejnë, ata e bëjnë pjesën e tyre, por pjesa më e madhe megjithatë mbetet te përgjegjësit, që janë prindërit, kujdestarët e tyre të drejtpërdrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fidan Rekaliu e ka fjalën.

FIDAN REKALIU: Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Me gjithë të mirat që ka përdorimi i internetit në vendin tonë, ai gjithsesi ka edhe të metat e veta. Përdorimi i pakontrolluar dhe i pamasë nga të gjithë shkakton probleme të natyrës fizike, emocionale dhe psikologjike.

Ky problem bëhet edhe më i theksuar nga fëmijët, të cilët janë të ekspozuar në masë të madhe nga përdorimi i pakontrolluar i tij. Rastet e paraqitura kohët e fundit, sikur rasti i të ashtuquajturit “Balena blu”, kanë prekur emocionalisht dhe na kanë frikësuar të gjithë ne për rrezikun real që mund të ketë përdorimi i pakontrolluar i internetit nga fëmijët.

Ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të tilla duhet të jetë temë e interesit nacional, sigurisht barra kryesore për kujdesin në këtë drejtim u takon prindërve, të cilët duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrën se si fëmijët e tyre përdorin internetin.

Cilat faqe ata i vizitojnë dhe kohën e shpenzuar në të. Mirëpo, karshi kësaj, institucionet e vendit duhet të jenë të gatshme ta përcjellin dhe të preventivojnë sa më shumë që të jetë e mundur raste të tilla. Pas familjes, barra dhe përgjegjësia u bie institucioneve të rendit, policisë dhe organeve të tjera, të cilat me kujdes duhet të vëzhgojnë faqet e caktuara të internetit, të monitorojnë profilet e dyshimta në Facebook, Instagram dhe në rrjetet e tjera sociale, të cilat shfaqin qasje të abuzimit me fëmijë dhe të rritur në çfarëdo forme.

Duhet hulumtuar politika të caktuara, të cilat nuk janë në kundërshtim me lirinë e shprehjes, por që kufizojnë deri në ndalesën e formës së prerë të faqeve që kanë tendencë të abuzimit të çfarëdo forme të fëmijëve dhe të të rriturve. Një përgjegjësi e veçantë i takon Ministrisë së Arsimit, e cila përmes personelit arsimor duhet të sigurojë që fëmijët të jenë të vetëdijesuar për rreziqet që sjell përdorimi i pakontrolluar i internetit, i konsumimit të krejt asaj që ai ofron. Orë të tëra duhet t’u kushtohen këtyre temave, por për këtë fillimisht duhet trajtuar stafi arsimor shkollor. Kjo problematikë sjell edhe një herë në pah nevojën e pasjes së psikologëve në shkolla, të cilat do të mund t’i qaseshin këtij problemi në mënyrë shumë më profesionale. I takon Qeverisë së vendit që t’i qaset seriozisht mbrojtjes së fëmijëve online, përmes krijimit të mekanizmave që do të përfshinin edhe përfaqësues nga bota akademike, shoqëria civile, media si faktorë të rëndësishëm në këtë drejtim.

Në këtë mekanizëm do të përfshiheshin edhe ekspertë të fushës së teknologjisë, të cilët do të ishin në gjendje t’i japin rekomandimet konkrete për hapat, të cilët duhet t’i ndërmerrnim. Ne presim ndërmarrjen e hapave konkretë nga Qeveria e Kosovës në adresimin e kësaj problematike dhe vlerësoj iniciativën e deputetëve për këtë temë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dragusha e ka fjalën.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë që jeni këtu,

Çdo temë që diskutohet në këtë Kuvend është e rëndësishme, e konsideroj si të shumë të rëndësishme, në mënyrë që të përmirësohet jeta e qytetarëve të vendit tonë, e sot po flasim për mbrojtjen e më të dashurve tanë, fëmijëve.

Ne jetojmë në një epokë që quhet “epokë digjitale” dhe një numër shumë i madh dhe në rritje i fëmijëve e përdorin internetin. Sot fëmijët në shumë vende të botës, por edhe në Kosovë, fillojnë ta përdorin internetin shumë herët, përpara se të fillojnë të shkruajnë dhe të lexojnë, duke përdorur mjete të ndryshme të teknologjisë dhe kalojnë një kohë të konsiderueshme duke lundruar në internet. Por, të mos harrojmë se interneti është një mjet mjaft i fuqishëm me mundësi shumë të mëdha për të mësuar, për të përmirësuar aftësi dhe për të fituar njohuri të reja. Megjithatë, së bashku me mundësitë, vijnë edhe rreziqet.

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohen fëmijët gjatë përdorimit të internetit janë shumë dhe evoluojnë çdo ditë, por mendoj se këto janë tri kategoritë më të përhapura: e para, përmbajtja e rrezikshme dhe kontakti me të panjohur. Këtu përfshihen ekspozimi ndaj pornografisë dhe asaj që quhet “Cyber Booling” që nënkupton poshtërim, tallje, ofendim, shqetësim përmes internetit. Kategoritë tjetër janë rreziqet që kanë të bëjnë me konsumatorin, për shembull, marketing online për produkte të papërshtatshme për fëmijë. Një kategori tjetër janë rreziqet që kanë të bëjnë me privatësinë dhe sigurinë, duke përfshirë përdorimin e rrjeteve sociale pa qenë në gjendje të kuptojnë mjaftueshëm pasojat potenciale afatgjata.

Unë këtu dua t’i përmend disa raste, më të famshme, ku janë shkelur privatësia dhe siguria e përdoruesve të internetit. Të gjithë jemi të familjarizuar me rastin e ashtuquajtur “Blue Whale”, ose si është përkthyer në shqip, “Balena Blu”, i cili është një rrjet social, ku ndjekësit, kryesisht fëmijë dhe të rinj, inkurajohen, për të mos thënë shtyhen që t’i ndërmarrin disa hapa në faza të ndryshme. Të shikojnë filma me përmbajtje të rëndë psikologjike, filma horrorë, t’i presin duart me zhiletë, të shpohen me gjilpëra, deri te hapi ekstrem, ku inkurajohen që të bëjnë vetëvrasje. Mirëpo, kjo nuk është e vetmja sfidë online, me të cilën bota e civilizuar është përballur.

Mandej kemi raste të tjera të indoktrinimit të të rinjve me ide të dëmshme politike, filozofike, fetare, e tjerë. Kjo ka ndodhur edhe në Kosovë, rasti i ISIS-it është një rast konkret i rekrutimit të të rinjve nga mbarë bota, ku përmes rrjeteve sociale, përmes internetit është bërë përhapja e ideve dhe është bërë thirrja për bashkëngjitjen në luftën në Siri, apo për të kryer sulme terroriste kudo që ata gjenden.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Adresimi i rreziqeve që fëmijët hasin gjatë përdorimit të internetit është prioritet në politikat e qeverive demokratike në mbarë botën, e ashtu duhet të jetë edhe në Kosovë. Kjo nënkupton ballafaqimin me një numër të madh të sfidave, siç janë: si të zvogëlohet rreziku pa u zvogëluar benefitet që fëmijët gëzojnë nga përdorimi i internetit? Si të parandalohen rreziqet, ndërkohë që ruhen vlerat thelbësore për të gjithë përdoruesit e internetit, duke përfshirë edhe vetë fëmijët? Si të sigurohemi që politikat që i mbrojnë përdoruesit e internetit nga rreziqet e ndryshme janë brenda kornizës dhe kushteve, të cilat kanë bërë që ekonomia përmes internetit të lulëzojë?

Meqenëse rreziqet që mund të hasin fëmijët gjatë përdorimit të internetit janë të ngjashme me ato që hasin në jetën e përditshme, jashtë internetit, atëherë në shumicën e vendeve konsiderohet se ajo që është ilegale offline, duhet të jetë ilegale edhe online. Legjislacioni kosovar në fusha të ndryshme të së drejtës, sigurisht që përfshin një varg dispozitash, me anë të të cilave synohet të mbrohen përdoruesit e internetit në përgjithësi dhe të parandalohen krimet kibernetike, mirëpo me sa unë kam informacion, nuk ekziston ndonjë normë apo ndonjë strategji, me anë të së cilës në mënyrë specifike do të mbroheshin fëmijët nga rreziqet potenciale, nga interneti. Kam hasur në doracakë të ndryshëm informues, ku tentohet të informohen fëmijët për rreziqet e mundshme online, mirëpo mendoj se ato nuk janë të mjaftueshme. U përmend Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, apo edhe ligjet e tjera, të cilat do të mund t'i qaseshin këtij problemi, sepse fëmijët kanë të drejtë në mbrojtje dhe siguri online.

Këto ligje, pavarësisht se si do të vendoset, do të duhej të marrin parasysh të gjitha rrethanat, nevojat dhe të gjitha rreziqet e mundshme, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja adekuate e fëmijëve tanë. Sigurisht që përveç Qeverisë, edhe prindërit, edukatorët, kujdestarët, bizneset dhe shoqëria civile mund të ndihmojnë shumë që fëmijët të përfitojnë në mënyrë të sigurt nga interneti, duke marrë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre nga rreziqet online. Është konstatuar se në vendet ku edukimi i fëmijëve që ka të bëjë me internetin dhe teknologjinë është i mirë, në ato vende ku fëmijët kanë më shumë kontakt me kompjuterë në shkollë, aftësitë e tyre digjitale janë më të mëdha, rreziku është më i vogël. Pra, edukimi ka rol pozitiv në mbrojtjen nga rreziku online, ky është një aspekt që Qeveria e Kosovës duhet ta ketë parasysh, sepse në këtë mënyrë fëmijët vetëdijesohen për rreziqet dhe mënyrën se si ata të mbrohen.

Aktivitetet e tjera do të mund të ndërmerreshin, për shembull, kampanjat për ngritjen e vetëdijes në shkolla, në media dhe institucione të tjera, të cilat do t'i bënin fëmijët të mendojnë se si t'i mënjanojnë situatat problematike online, ose të parandalojnë përsëritjen e tyre. Unë si deputete e këtij Kuvendi do të mbështes çdo rekomandim që del nga ky debat dhe lus edhe institucionet e tjera të Kosovës të marrin këtë debat seriozisht, po ashtu të shikojnë dhe rregullativat e Bashkimit Evropian, të cilat e trajtojnë këtë çështje, sepse vetë Bashkimi Evropian, duke pasur

parasysh numrin në rritje të fëmijëve, të cilët kanë qasje me internet, tentojnë ta normojnë këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë të pranishëm,

Pajtohem me atë që e përmendën parafolësit në lidhje me këtë temë, të cilët e thanë se është një çështje shumë e rëndësishme, sepse bëhet fjalë për sigurinë e fëmijëve tanë, por fatkeqësisht po duket që kjo nuk është e rëndësishme sikur edhe të gjitha temat e tjera për Qeverinë dhe për ministrat, gjë që konsideroj që vërtet duhet të jetë brengë për secilin prej qytetarëve.

Duke qenë se interneti si një shpifje dhe mjet komunikimi, argëtimi, përdoret në mbarë botën, si i tillë ai nuk është një risi as për fëmijët dhe të rinjtë tanë, për më tepër është një nevojë e domosdoshme për ata. Sigurisht që fëmijët kanë të drejtë të marrin informacione dhe përmbajtje të përshtatshme për moshën e tyre dhe zhvillimet në fushën e teknologjisë kanë gjeneruar mundësi të reja edhe për ta, përfshirë edhe të drejtën për të prodhuar dhe shpërndarë informacione dhe për të gjeneruar ide. Tani dhe fëmijët dhe të rinjtë tanë janë protagonistë të internetit dhe jo vetëm përdorues që marrin informata nga të tjerët. Sigurisht se interneti ofron mundësi të pakufizuar e në kohë reale, si dhe mundësi për zhvillim intelektual e për argëtim.

Por, nga ana tjetër, si çdo e mirë tjetër edhe mundësi që ofrohet në shërbim të nevojave dhe kërkesave të publikut, edhe këtu jo rrallëherë përballemi edhe me anë të errëta dhe rreziqet që interneti ka për fëmijët dhe të rinjtë tanë. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë në vitet e fundit shoqërohet njëkohësisht edhe me ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve që shfaqen si rrjedhojë e lundrimit jo të sigurt të tyre në internet. Andaj, ne duhet që sa më parë të marrim masa, në mënyrë që të sigurojmë fëmijët tanë në këtë drejtim, ata të mos shqetësohen, ofendohen, apo të ngacmohen nga përdoruesit e tjerë. Sipas një studimi të bërë nga organizata “Walt Dision”, rreziqet kryesore të perceptuara nga vetë fëmijët në lidhje me përdorimin e internetit janë ato që lidhen me përmbajtjen, me sjelljen dhe me kontaktet. Duhet theksuar se lehtësitë për të pasur qasje në burime të ndryshme të informacionit dhe të argëtimit, nga ato të besueshme deri te faqet pirate dhe të palicencuara, dëshmon rrezikun ndaj të cilit janë ekspozuar fëmijët dhe ndikimin e tyre negativ në zhvillimin psikologjik dhe mendor të fëmijëve.

Rezultatet e hulumtimeve të deritanishme flasin për shtimin e dukurisë së dhunës online, pikërisht edhe në kontekstin arsimor. Përkundër se në dhjetor të vitit 2013 kishte filluar një projekt dyvjeçar, që i kishte dy komponentë: mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet, vetëdijesimin dhe fuqizimin dhe, pos kësaj ishte aprovuar plani strategjik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet 2015-2019, rezultatet lënë shumë për të dëshiruar dhe sfidat

vazhdojnë të mbesin të njëjta. Akoma edhe sot mbetet sfiduese mbrojtja e mangët që ofron legjislacioni aktual nga rreziqet online, masat për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet joadekuate ose të rrezikshme për ta, raportimi i rasteve të abuzimit online, si dhe moszbatimi i legjislacionit në fuqi.

Edhe pse në Kosovë ka legjislacion specifik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet, siç ishte Ligji për krimet kibernetike, mungon legjislacioni sekondar që i operacionalizon veprimet dhe si ndodh me shumicën e ligjeve të tjera, edhe ky ligj nuk po gjen zbatim në praktikë. Në një raport që kishte për qëllim të hulumtojë se si fëmijët e përdorin internetin dhe t'i identifikojnë rreziqet e mundshme në lidhje me aktivitetet online të fëmijëve, të realizuar nga Qendra për studime të avancuara "Save The Children", gjetjet e studimit sugjerojnë se fëmijët në Kosovë janë përdorues shumë aktivë të internetit, por se atë e përdorin kryesisht për qëllime argëtuese dhe për komunikim. Shumica e fëmijëve kanë raportuar se aktivitetet e tyre më të preferuara në internet janë rrjetet sociale YouTube dhe dëgjimi i muzikës.

Ka mungesë të theksuar të përfshirjes së prindërve dhe mësuesve në monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve në përdorimin e internetit dhe kështu çdoherë e më shumë fëmijët janë duke e përdorur internetin në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrjen e të rriturve. Anketa me 1 150 nxënës të moshës 9 deri 16 vjeç u realizua në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës dhe tregon se vetëm 35% të nxënësve ndihen shumë të sigurt gjatë përdorimit të internetit. Prej tyre, 41 të anketuar e pranojnë se kanë shikuar përmbajtje pornografike, pra po flasim për fëmijë të moshës 9-16 vjeç, ndërkaq 28 prej tyre janë deklaruar se kanë përjetuar dhunën verbale përmes internetit. Shumica e fëmijëve kanë deklaruar se janë më kompetentë se sa prindërit e tyre në përdorim të internetit. Andaj, me urgjencë duhet të rritet vetëdijesimi i prindërve ndaj rreziqeve që fëmijët mund të hasin gjatë përdorimit të internetit.

Rritja e njohurive të përgjithshme rreth përdorimit të tij, mënyra se si të bllokojnë ueb faqe të dëmshme dhe kontrollimi për rreziqet e tjera të mundshme duhet të jenë një ndër shtyllat kryesore për fushatat e ngritjes së vetëdijes te prindërit. Mësuesit, po ashtu, kanë një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve për sigurinë në internet, por në këtë ankesë fëmijët kanë raportuar se në përgjithësi mësuesit u ndihmojnë atyre t'i identifikojnë rreziqet në internet, por se nuk u shpjegojnë se çfarë duhet të bëjnë në rast se përballen me përmbajtje shqetësuese në internet, e këto raste nuk janë të pakta. Pra, me gjithë vullnetin e mirë, akoma nuk mund të thuhet se shkollat janë të përgatitura për t'i aftësuar fëmijët që të mbrohen nga rreziqe të ndryshme që sjell rrjeti global.

Të gjitha këto të dhëna flasin në favor të nevojës që të shfrytëzohet konteksti arsimor, pra shkolla, ku fëmija e kalon një pjesë të mirë të ditës, për të ndërtuar kapacitetin e fëmijëve t'i kundërvihet rreziqeve që vijnë nga interneti. Duke ditur se në nivel kombëtar qeveria është përgjegjëse për kornizën ligjore dhe rregullative sa u përket mbrojtjes së fëmijëve, përmbajtjes

ilegale në internet, mbrojtjes së të dhënave personale, rregullimin e industrisë së telekomunikacionit dhe zhvillimin e politikave adekuate, pasi që është institucioni kryesor për ofrimin e sigurisë në internet për fëmijët, Qeveria sa më parë duhet të inkurajojë dhe të financojë më shumë aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj sigurisë në internet të fëmijët, vetëdijësimit për mësimdhënësit dhe prindërit dhe ndihmës së tyre në përkrahjen që duhet t'u japim fëmijëve.

Po ashtu, është shumë e rëndësishme që Qeveria të zhvillojë legjislacion për qasjen në faqen me përmbajtjet pornografike. Shumë shtete, përfshirë edhe Britaninë e Madhe, kanë politika të tilla, të cilat do të duhej të zhvilloheshin edhe në Kosovë. Një detyrim tjetër po aq i rëndësishëm e emergjent është që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të punojë në zhvillimin e mekanizmave të vetëmbrojtjes dhe vetëpërgjegjësive për fëmijët, të cilët kohët e fundit po përballen gjithnjë e më shumë jo vetëm në dhunën verbale, por edhe me atë fizike që pason si rrjedhojë e aktivitetit të tyre, kryesisht në rrjetet sociale. Është shumë e rëndësishme t'i edukojmë fëmijët tanë që të jenë përdorues të përgjegjshëm të internetit dhe t'i informojmë ata për rreziqet e mundshme, të cilat mund ta kërcënojnë sigurinë e tyre dhe kjo duhet të jetë njëra ndër detyrat prioritare të Ministrisë së Arsimit.

Inkurajimi i fëmijëve për të mësuar më shumë rreth rreziqeve lidhur me keqpërdorimin e informacioneve personale, efekteve të 'cyber' dhunës, si dhe pasojat e takimeve me persona të rinj, mund të jenë mekanizma shumë të mirë të vetëmbrojtjes, të cilat mund të promovohen nga ministria dhe nga shkolla. Ministria po ashtu duhet të iniciojë dhe të mbështesë bashkëpunimin në mes të prindërve, mësuesve, shoqërisë civile dhe të gjitha palëve të tjera me interes në krijimin e kushteve më të favorshme për përdorimin më të sigurt të internetit, me aktivitete vetëdijësuese dhe me udhëzues për prindërit dhe mësuesit, si dhe të bëjë mbikëqyrjen e aktiviteteve të fëmijëve në internet. Ashtu edhe aktivitetet që mundësojnë që industria të informojë mbi vendosjen e filtrave dhe mundësive të rregullimit të privatësisë.

Përndryshe, ne mund të shënojmë Javën e internetit të sigurt, mund të aprovojmë strategji, por nuk do t'i mbrojmë fëmijët tanë nga rreziqet me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë dhe do të dështojmë në krijimin e një ambienti të sigurt për ta. Pra, këto veprime duhet të jenë veprime konkrete, emergjente dhe të ndërmarra me seriozitet dhe përkushtim nga të gjithë ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Së pari, më lejoni t'i falënderoj të gjithë deputetët që qëndrojnë në këto orë të vona tri ditë radhazi dhe të gjithë diskutuesit që i kushtuan vëmendje kësaj teme shumë të rëndësishme. Kujtoj që Kryesia e Kuvendit ka gabuar që këtë temë e rendit në numrin 25 dhe, aq më tepër që

në ditën e tretë të maratonës së mbledhjeve në Kuvend, kjo diskutohet në numër kaq të vogël të pjesëmarrjes së deputetëve, të cilët sigurisht janë lodhur, por edhe nuk e kam kuptuar se është një ndër temat shumë të rëndësishme. Neve nuk na mjafton vetëm të themi se fëmijët janë ardhmëria e Kosovës dhe se ata meritojnë vëmendje, por këtë vëmendje vërtet t'ua kushtojmë atyre.

Po flasim për një temë shumë të rëndësishme dhe shumëdimensionale, për legjislaturën, e cila duhet të ekzistojë dhe të përputhet me legjislacionin edhe të BE-së, por edhe shumë masa të tjera mbrojtëse në kuadër të institucioneve që merren me fëmijët në përgjithësi dhe në mbrojtjen e fëmijëve, por gjithashtu, nga sa u tha në diskutim, nuk u diskutua për shëndetin e fëmijëve në shumë dimensione. Së pari, qasja në internet dhe përdorimi i tepërt i mjeteve elektronike, sikur janë telefonat e mençur, duke filluar nga moshë shumë e re, edhe parashkollore, madje-madje do të kisha thënë prej moshës 2-vjeçare, si ndikon në shëndetin e këtyre fëmijëve dhe përdorimi i këtyre mjeteve çka ndikon në psikikën dhe në shëndetin e fëmijëve.

Së pari, duke i përdorur këto mjete, fëmijët sikur na sinjalizojnë se kanë mangësi emocionale në familjet e tyre, ata kanë mangësi të shoqërimin me moshatarët e tyre dhe e ndiejnë këtë nevojë, por së dyti, përveç sa u tha këtu për rreziqet, ata shfaqin edhe varësinë emocionale dhe varësinë në përgjithësi, që është një e metë e madhe në shëndetin e tyre që do të shfaqet më vonë gjatë rritjes, gjatë periudhave të ndryshme delikate të rritjes, sikur është moshë e adoleshencës, por edhe më tutje. Dëmtimet e tjera që ndodhin me përdorimin e pakontrolluar dhe të gjatë janë edhe të natyrës thjesht mjekësore, sikur është dëmtimi i shikimit, nga dëmtimi që rrjedh nga rrezatimi nga këto mjete, siç janë telefonat e mençur, pastaj dëmtimi i qëndrimit të boshtit të kurrizit, të gjymtyrëve, duke i përdorur vazhdimisht këto dhe në orare shumë të gjata.

Largimi i fëmijëve nga mjetet shumë të nevojshme, siç është libri, sepse duke i përdorur këto mjete, ata s'kanë kohë të merren me librin, me kreativitete të tjera që janë shumë të domosdoshme për moshën. Unë do të thosha, është një pasqyrë e çuditshme kjo në Kosovë, derisa neve flasim për mbrojtjen e fëmijëve, kemi dy kategori, për të cilat duhet ndryshe të flasim, për njërin dhe tjetrën. Derisa ballafaqohemi me një standard shumë të ulët, ku fëmijët, kur flasim për fëmijët ne duhet të mendojmë se ata jetojnë në një varfëri të skajshme dhe problemi i tyre është ushqyeshmëria e mirë dhe, në anën tjetër, kemi kategorinë tjetër të fëmijëve, të cilët në përqindje shumë të madhe përdorin në mënyrë shumë të pakontrolluar mjetet sikur që është jo vetëm interneti, por edhe telefonat, sikur t'i kenë lodra dhe kjo tregon se kemi shumë nevojë për emancipimin dhe shtimin e rolit edukues të familjes së re, vërtet familjet sot ndoshta nuk ka mjaftë kohë, por ajo ka edhe përgjegjësinë ligjore që të kujdeset më shumë në edukimin dhe ngritjen e fëmijës në formë të shëndoshë.

Unë pajtohem me të gjitha sa u thanë këtu, se mjetet elektronike dhe përdorimi i internetit dhe pajisjeve të ngjashme, sikur janë telefonat e mençur, ndikojnë edhe pozitivisht, sepse kjo është e njohur kudo në botë, por dëmi që ato nëse nuk kontrollohen dhe nuk përdoren në mënyrë të

kontrolluar, jo vetëm programet, por edhe qasja e gjatë në këtë mjete dhe dëmi që shkaktojnë në shëndetin janë të pakthyeshme. Prandaj, shoqëria duhet t'i përcaktojë normat ligjore dhe rregullat, si dhe të punojë shumë më shumë në edukimin e prindërve, sidomos të edukatorëve, mësuesve dhe të jetë më përgjegjëse ndaj fëmijëve, sepse këtë e kemi obligim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Sot po debatohet për një temë shumë të rëndësishme - sigurinë e fëmijëve në internet.

Interneti është një mjet komunikimi dhe hulumtimi në shumë fusha të rëndësishme, mirëpo ajo që dua ta theksoj unë si deputete është shqetësimi ynë shoqëror e prindëror. Çka ne mund të bëjmë që ky mjet teknologjik të përdoret dhe të shfrytëzohet në mënyrë sa më adekuate dhe më të dobishme nga fëmijët tanë, pasi dihet shumë mirë se interneti gjen përdorim mjaft të madh dhe masiv në të gjitha shtresat e shoqërisë, sidomos në ato kategori të ndjeshme, siç janë të miturit dhe adoleshentët.

E rëndësishme për ne si përfaqësues të qytetarëve është që të ndërmarrim nisma të reja ligjore, por edhe vetëdijësim sa më të madh, si nga institucionet shkollore, ashtu edhe nga vetë prindërit, në mënyrë që ky përdorim i fëmijëve të sjellë përfitime për ta në shumë sfera kërkimore e shkencore, pastaj të shërbejë edhe për kërkime pune. Ndikimi i teknologjisë në jetën e fëmijëve dhe adoleshentëve në Kosovë është duke u rritur. Sot është vështirë të definohet se cila është teknologjia e mjaftueshme, që një fëmijë duhet ta përdorë. Në bazë të hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe në këtë rast organizata FIT, në vitet 2012-2014 ka dalë që fëmijët në Kosovë janë mjaft aktivë në internet, bile krahasuar edhe me mesataren e fëmijëve të Evropës ka dalë që fëmijët kosovarë e përdorin internetin shumë më shumë.

Rreth 90% e fëmijëve të moshës 9-16-vjeçare e përdorin internetin, gjysma e tyre qëndrojnë më shumë se katër orë në ditë në internet. Fëmijët duhet të dinë se shumë nga aktivitetet në internet u ofrojnë atyre njohuri të mira dhe të dobishme, mirëpo në të njëjtën kohë shumë prej këtyre aktiviteteve përmbajnë edhe rrezik potencial për fëmijët, siç u tha edhe nga parafolësit.

Komunikimet globale në shkëmbim të përvojave të ndryshme të mos mbeten shkak për dëmtimin dhe shkaktimin e pasojave të dëmshme për fëmijët të cilët gjatë përdorimit online të internetit mund të kenë qasje edhe në ueb-faqe me përmbajtje materiale të dëmshme, apo edhe ueb-faqe që nxitin urrejtje ndëretnike dhe proklamojnë situata të vrazhda negative dhe shoqërore.

Por infrastruktura ligjore duhet t'i mundësojë kësaj fushe censurimin e shumë materialeve të natyrave të tilla që lanson në internet, pra të mundohemi që përdorimin e internetit nga fëmijët

tanë ta bëjmë më të sigurt dhe më të padëmshëm, si dhe të rritim vetëdijesimin për sigurinë e fëmijëve në internet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nezir Çoçaj e ka fjalën. Pas Nezirit është Ganimete Musliu.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Unë do të përpiqem t'i bie shkurt, por shqiptarët kur të përpiqen t'i bien shkurt, flasin më gjatë. Sido që të jetë, faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të flas për disa hulumtime, përkatësisht e kam përgatitur materialin duke u bazuar në hulumtimet që i ka bërë Instituti Pedagogjik i Kosovës, në vitin 2016. Është një doracak i mirë për mësues, për gjuhën e urrejtjes së nxënësve në mediet sociale, si dhe udhëzues për nxënës për përdorim të internetit për klasat 3-5, përkatësisht udhëzuesi për internet nr. 2, për nxënësit e klasave 6-9, dhe udhëzuesi për prind, që e ka botuar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2017.

Sido që të jetë, shpresoj që ky material pak a shumë t'u hyjë në punë atyre që na dëgjojnë, e sidomos prindërve që kanë disa probleme lidhur me internetin. Pra, sot po jetojmë në kohën e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe komunikimi digjital thuajse e zë vendin e parë në relacion me çdo lloj komunikimi tjetër.

Tanimë përdorimi i internetit ka përfshirë përmasa të mëdha, si në familje, në shkollë, punë e kudo tjetër. Po aq sa janë mundësitë e mëdha të përdorimit, aq janë edhe mundësitë e keqpërdorimit dhe të abuzimit. Duke pasur parasysh se jetojmë në epokën digjitale, duhet përkushtim maksimal në përdorimin e drejtë dhe racional të internetit dhe të teknologjisë informative, në përgjithësi.

Fëmijët po shpenzojnë shumë kohë në internet dhe shpesh qëllimet e përdorimit nuk janë në suaza të normales, gjë që po ndikon negativisht në rritjen e mbarë e të suksesshme të tyre. Përveç që shpenzohet shumë kohë në rrjetet sociale, pa i njohur mirë rregullat e përdorimit, minimizimi i kohës së leximit të librave shkollorë dhe qëndrimi ulur gjatë dhe pa aktivitete fizike rezulton me uljen e rezultateve të arritshmërisë, si dhe me rreziqe për shëndetin. Kështu që përfundimisht dëmet janë sa fizike, aq edhe intelektuale.

Shpesh fëmijët dhe adoleshentët nuk janë të vetëdijshëm për veprimet e tyre online dhe për pasojat negative, psikologjike dhe sociale që i sjellin ato, qoftë atyre personalisht, familjeve apo edhe shoqërisë, në përgjithësi. Rreziqet e përdorimit të internetit përfshijnë përmbajtjet e dëmshme, dhunën, ngacmimet, takimet me njerëz të panjohur, publikimi i të dhënave personale

në profilet e tyre e tjerë. Duke e përdorur internetin për mësim, lojë, marrje të informacioneve, bashkëpunim dhe komunikim, fëmijët mund të arrijnë rezultate të mira në mësim, do të fitojnë shkathtësi në komunikim e në të shprehur, do të bëhen më kreativë, do të bëhen më të ditur dhe më të përgatitur, do ta njohin botën dhe do të jenë më të dobishëm. Pra, përdorimi i duhur i internetit nënkupton zhvillim intelektual, emocional dhe social të tyre.

Ndërkaq, përdorimi i tepërt dhe pa qëllim arsimor i dëmton ata edhe në aspektin intelektual, në kuptimin e rënies së rezultateve dhe ngecjeve drejt arritjeve në mësim.

Familja, shkolla dhe shoqëria kanë përgjegjësi në edukimin e fëmijëve, në mënyrë që atyre të mos u cenohet zhvillimi fizik dhe intelektual. Këto duhet të trajtohen me kujdes nga institucionet tona edukativo-arsimore dhe ato ekzekutive, të ketë udhëzime përmbajtësore, në mënyrë që të krijohet një kulturë e dobishme e përdorimit të teknologjisë informative. Por, përtej fitimeve të mëdha që vijnë nga përdorimi i internetit, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, rritja e shërbimeve në internet dhe aplikacioneve të tjera, për fat të keq, kjo rritje në përdorim nuk është shoqëruar me masat e nevojshme për t'u mbrojtur nga rreziqet që sjell kjo teknologji, veçanërisht për fëmijët.

Është fakt se zhvillimi dhe shpërndarja e internetit ecën shumë më shpejt se masat mbrojtëse nga keqpërdorimi i tij. Së pari, ekziston një risk shumë i madh për ngacmime seksuale në internet, ekziston gjuha urrejtëse, që pastaj nxit dhunë psikike, por edhe fizike, te fëmijët. Përdorimi i mjeteve të ndryshme digjitale, si interneti, telefonat mobilë, video-lojërat, u mundësojnë fëmijëve dhe të rinjve qasje në nxjerrjen e informacioneve të rëndësishme në fusha të ndryshme: shkollim, dije, komunikim, zbavitje e shumë gjëra të tjera, të cilat vështirë se do të mendoheshin vite më parë. Shumë informata, madje mund të arrihen pa u përfillur moshë.

Nisur nga ky fakt, del se një numër i madh i fëmijëve as që mund ta mendojnë jetën e tyre pa profil në rrjetin social, të shpërndarjes së fotove, lojërave dhe mesazheve të ndryshme. Shumë nga ta bëjnë edhe hapjen e profileve duke dhënë të dhëna personale jo të sakta, ngase u jepet e drejta nën moshën 18-vjeçare.

Në Kosovë, gjendja është alarmante, ngase edhe fëmijët e moshave mjaft të vogla kanë hapur një faqe profili në Facebook dhe pastaj po del se fëmijët mund të abuzohen, qoftë online, dhe pasojat pastaj t'i kenë në jetën reale. Është përgjegjësi e madhe e familjes që të përkujdeset për fëmijët dhe t'i mësojë ata për sigurinë në internet, mirëpo jo të gjithë prindërit mund të kenë njohuri dhe të ecin në hap me zhvillimet teknologjike. Pra, MASHT-i dhe IPK-ja kanë nxjerrë doracakë dhe udhëzues për nxënës, mësues dhe prindër, që kanë për qëllim që të lehtësojnë punën e prindërve apo edhe të kujdestarëve ligjorë në edukimin e fëmijëve rreth mbrojtjes në internet. Si i tillë, ky udhëzues ka dy objektiva:

1. T'i informojë prindërit se për çfarë e përdorin internetin fëmijët e tyre dhe cilat janë rreziqet potenciale gjatë përdorimit të tij; dhe

2. T'i këshillojë prindërit dhe edukatorët se çfarë mund të bëjnë ata për t'i mbrojtur fëmijët nga rreziqet e ndryshme dhe si t'i ndihmojnë ata të përballen me rreziqe të tilla.

Qëllimi i udhëzuesit për prindër është që të ketë partneritet të fortë me komunitetin e prindërve dhe në bashkëpunim me mësime të arrijnë ta ndërtojnë një kulturë të shëndoshë të fëmijëve tanë për përdorimin e internetit në mënyrë të dobishme, duke qenë të mbrojtur nga rreziqet online. Kështu të fëmijët duhet të kultivojmë komunikimin e mirë dhe ndjenjën e kontrollit mbi veprimin e tyre online, duke promovuar sjellje të shëndosha dhe korrekte të komunikimit, përdorimit të internetit në çfarëdo relacioni. Gjithashtu, gjatë përdorimit të pakontrolluar të internetit fëmijët nuk e ruajnë privatësinë e tyre e të familjes duke komunikuar me të panjohur, gjë që shpie gjer në ekspozimin ndaj rreziqeve tjera, si dhuna, trafikimi, grabitja, ekspozimi ndaj përmbajtjeve pornografike dhe abuzimeve të tjera online.

Edhe pse u nguta, kolegët pak më ngutën, duke lexuar më shpejt kështu, besoj se të gjithë jemi lodhur, por ka qenë një temë jashtëzakonisht interesante. Unë dua ta pranoj se e mbështes pa rezervë këtë mocion përmbajtjesor dhe rekomandimet, të cilit i ka prirë iniciuesja e këtij mocioni përmbajtjesor dhe me mbështetjen e Komisionit për Arsim. Kërkoj nga Qeveria dhe institucionet relevante që konform kritereve dhe standardeve të BE-së të hartojnë strategji dhe platforma për përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të përgëzoj për qëndrimin tënd stoik gjatë gjithë ditës, fare pa asistencë. Them sinqerisht po them, dua t'i përgëzoj edhe iniciuesit e këtij debati. Është kjo një temë shumë e rëndësishme dhe që do të duhej të trajtohet me seriozitetin më të madh sot në Kuvend dhe nga institucionet e vendit. Fatkeqësisht, siç shihet, në sallë nuk ka më shumë se 20 deputetë. Mungon komplet Qeveria, mungojnë nënkryetarët e Kuvendit, të cilët sot do të duhej të ishin këtu dhe për mua është një shqetësim.

Një temë, siç është siguria, ose thjesht siguria nga rreziku i fëmijëve në internet do të duhej ta kishte vëmendjen e jashtëzakonshme nga shteti dhe trajtimin adekuat. Mundësia për ta zhvilluar një debat në këto orë të vona është vetëm sa për sy e faqe dhe sa për ta konsumuar një pikë të rendit të ditës, që është shqetësim dhe që duhet të mos përsëritet më si veprim i tillë. Unë besoj që Kryesia e Kuvendit, e cila ka marrë një mandat për koordinimin e seancave dhe vendosjen e rendit të ditës, duhet të jetë më efikase në punën e saj, sepse jo rrallë po na ndodh neve si deputetë të kritikohemi për paaftësi dhe për efikasitet në punë pa fajn tonë.

Nuk kemi nevojë t'i kemi 26 pika të rendit të ditës dhe të mos e përfundojmë asnjë. Ne kemi folur vetë me vete tash e tri ditë pa u ndalur deri në këtë kohë, ndërsa nuk kemi mundur ta marrim asnjë vendim. Sot po diskutojmë për një temë shumë të rëndësishme, që fatkeqësisht nuk ka as transmetim direkt në televizion, dhe kjo ndoshta ka bërë që shumë deputetë edhe ta lëshojnë sallën sot. Mendoj që nëpërmjet këtij debati, përveçse do të nxirren rekomandimet, është dashur që thjesht ta bartnim edhe një mesazh dhe ta sensibilizonim opinionin, shoqërinë në përgjithësi, e në veçanti t'i sensibilizonim prindërit, të cilët e kanë rolin kryesor në ruajtjen e fëmijëve të tyre nga rreziqet permanente.

U tha nga parafolësit e mi dhe konkretisht shumë mirë e përshkroi edhe zoti Çoçaj në fjalimin e tij, sepse janë nxjerrë shumë dokumente që e rregullojnë këtë çështje, mirëpo unë mendoj që edukata bazë duhet të vijë nga prindërit dhe gjithsesi edhe nga mësimdhënësit. Kemi shumë raste në Kosovë, kur fëmijët janë abuzuar direkt nga mësimdhënësit e tyre, duke u nxjerrë në mënyrën më të pahijshme në internet dhe pastaj fëmijët janë bërë edhe subjekt i talljes nga shoqëria dhe i kanë sjellë deri në një situatë, e cila nuk ka ndikuar pozitivisht në fëmijën dhe ka marrë masa shpeshherë ndoshta edhe tragjike.

Se a janë fëmijët të rrezikuar, pajtohemi të gjithë se janë të rrezikuar, mirëpo nuk mund të kërkojmë nga shteti, kur ne e dimë shumë mirë se shumë prindër, pa dashur të them të gjithë, por ka shumë prindër që ne i kemi parë vetë në shumë postime tonat personale, që i bëjmë si deputetë në rrjetet sociale, hyjnë komentojnë në gjuhën e tyre më banale. Dhe, po të hysh ta shikosh shoqërinë e atyre personave që komentojnë, fyejnë e shajnë në mënyrën më të ulët denigruese, e sheh që miq ose shokë të përbashkët në Facebook i kanë fëmijët e tyre, bashkëshortet e tyre. Janë të parët ata që i lexojnë komentet e tyre aq denigruese dhe pa dashur edhe fëmija do ta marrë atë rrugë dhe atë këshillë.

Prandaj, apeli im sot është që prindërit të kenë kujdes të shtuar vetë fillimisht në përdorimin e medieve sociale, në këtë rast të internetit, sepse unë konsideroj që neve si shoqëri na ka rrëmbyer shpejt ky zhvillim teknologjik, që është nevojë e domosdoshme e kohës, por megjithatë ne nuk dimë ta japim vetë personalisht shembullin më të mirë para fëmijëve dhe të miturve në shtëpi, e të mos flasim pastaj edhe për institucione.

Edhe një herë unë e shpreh shqetësimin tim që debatet e rëndësishme së tillë, siç po diskutojmë sot në këto orë të vona, të mos vendosen në rend të ditës vetëm sa për t'u thënë e sa për t'u tejkualuar dhe për ta mbushur kuotën e debateve, por të trajtohen në pjesën më të rëndësishme të ditës, kur ne do të mund ta japim mesazhin e duhur e të marrim vendimet e duhura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Derisa po flisnim në pikën para kësaj, njëri prej kolegëve deputetë tha se ushqimi është baza kryesore e të ushqyerit. Nuk ia zë për të madhe, s'ka faj, mbas dhjetë orësh debat mund të rrëshqasim edhe aq keq e rëndë. Po e dëgjoj edhe kolegen Musliu, tha “tri ditë kemi folur vetë me vete”, por as ajo nuk u ngop dhe foli nja 5-6 minuta vetë me vete.

Faleminderit shumë për këtë debat që e kemi pasur. Ishalla në debatet tjera dhe në ditët tjera, do të jemi më të efektshëm. Por, mos harroni se pas tri ditësh, mesatarisht nga dhjetë orë debat, është bukur problematike që secili prej nesh të jetë i kthjelltë dhe të thotë diçka të mençme. Jam shumë i lumtur që jam i fundit në këtë seancë maratonike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S'je i fundit. Tash është Teuta e fundit. Zonjës Haxhiu, fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, sinqerisht në numër jo të mjaftueshëm, por i falënderoj të gjithë ata që e morën fjalën. Nuk pajtohem me kolegun tim të partisë, zotin Nitaj, sepse të gjitha diskutimet sot ishin vërtet shumë përmbajtjesore. Ata që duan të jenë efektivë janë në çdo moment dhe ata që nuk duan të jenë ndoshta shpeshherë qëndrojnë edhe njëzet orë, por nuk janë fare këtu.

Dhe tani më lejoni që para se t'i përmend rekomandimet, sinqerisht t'i falënderoj edhe koleget deputete që e përmendën se insistimi i nënkryetarit për t'u mbajtur debati sonte dhe mbi të gjitha i shefit parlamentar, meqë e prita një numër të rekomandimeve apo një diskutim të tij përmbajtjesor të zotit Hoti, të profesorit të nderuar, i cili insistoi shumë që të mbahet ky debat, por ai në fakt menjëherë iku.

Prandaj, edhe një herë po them që fëmijët janë fëmijët tanë, fëmijët e Kosovës dhe të gjitha diskutimet ishin shumë përmbajtjesore dhe shumica e tyre u përmendën edhe në rekomandimet që unë i kam propozuar. Prandaj, në pamundësi për t'i lexuar në fjalën e parë, po i lexoj tani rekomandimet, duke u thënë edhe atyre që e morën fjalën që ato do t'i harmonizojmë dhe do t'i nxjerrim për votim në seancën e radhës.

1. Institucionet përgjegjëse të ofrojnë internet të sigurt për shkollat, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqet që kanë përmbajtje joadekuate për fëmijët;
2. MASHT, DKA-ja, shkollat, të aktivizojnë aktivitete vetëdijesuese për prindër, mësimdhënës dhe nxënës për rreziqet që vijnë nga keqshfrytëzimi i internetit;
3. Të organizohen trajnime obligative për zhvillimin e kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut në shkolla dhe mbrojtja nga rreziqet në internet;

4. Udhëzuesit për përdorim të sigurt të internetit të promovohen edhe nga mësimdhënësit, që obligohen t'i shfrytëzojnë si burime alternative gjatë procesit të mësimdhënies;
5. Hartimi i rregulloreve në nivel shkolle, që t'i rregullojnë çështjet e përdorimit të internetit brenda hapësirave shkollore;
6. Shërbimet profesionale brenda shkollës të krijojnë mekanizma për ta adresuar dhunën që buron nga keqshfrytëzimi i internetit, fuqizimi i ekipeve për ndërmjetësim ndërmjet bashkëmoshatarëve;
7. Plani zhvillimor i shkollës të plotësohet me masa dhe veprime konkrete për rritjen e sigurisë në shkollë, duke përfshirë masa konkrete për parandalimin e dhunës nga keqshfrytëzimi i internetit;
8. Të organizohen debate dhe programe edukative nëpër medie, televizione nacionale dhe medie të tjera, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për përdorimin e drejtë të internetit;
9. Këshilli i Prindërve dhe familjarëve nga profesionistët që punojnë me fëmijë për monitorim të fëmijëve gjatë përdorimit të internetit të sigurojnë përdorim të drejtë të internetit nga fëmijët;
10. Të vetëdijesohen prindërit dhe t'i monitorojnë fëmijët që të mos përdorin informata të rrejshme për të hapur profilet e tyre si të rritur, pasi shumica e kompanive të rrjeteve sociale e kanë të rregulluar çështjen e profileve për të mitur nën moshën 14 vjeç;
11. Të parandalohet me ligj çështja e shantazhit nëpërmjet rrjeteve sociale, pasi është dukuri e shprehur te fëmijët dhe të vetëdijesohen për këtë çështje.

Ka edhe rekomandime të tjera. Është edhe një rekomandim, po ashtu nga zoti Nitaj, i cili ka propozuar ndalimin e përdorimit të telefonave të mençur “smartphone” për nivelin e shkollimit fillor. Unë bashkë edhe me rekomandimet që disa prej tyre i kam shënuar, pres që t'i harmonizojmë bashkërisht dhe t'i nxjerrim në seancën e radhës.

Edhe një herë, faleminderit shumë për diskutimet tuaja me shumë përmbajtje!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kanë përfunduar të gjitha pikat e rendit të ditës. Unë do ta përfundoj seancën këtu. Tri pikat që kanë mbetur për votim do të ngelin që të caktohen në mbledhjen e Kryesisë, bashkë me interpelancat me kryeministrin, zotin Haradinaj, si dhe besoj se edhe nisma për debat lidhur me Raportin e Progresit do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, kur ta caktojë kryetari, sipas kërkesës që bëhet. Faleminderit! Mirupafshim!

* * *

E enjte, më 26 prill 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17 dhe 18 prill 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 16 prill dhe vazhduar më 17 dhe 18 prill 2018.

Fillojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

13. Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Jemi te votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

A jemi gati për votim? Votojmë tash!

Ju vetë po e shihni rezultatin e votimit, 49 deputetë kanë votuar, 45 për, asnjë kundër dhe 4 abstenime. Nuk ka kuorum.

Po votojmë edhe një herë, po në mos pastë numër të deputetëve të votimit, pastaj kalojmë në votime të tjera.

Edhe një herë do të votojmë, për arsye se mbetet çështja e hapur në qoftë se nuk votojnë.

86 deputetë janë aktualisht në sallë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

50, plus dy deputetë pa kartelë 52, 53. Megjithatë s'kam nevojë ta konfirmoj rezultatin, për arsye se nuk kemi pjesëmarrje në votim.

4. Votimi i Projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

86 deputetë janë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë,
88 deputetë janë në sallë, 79 kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Duhet 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, do të thotë 80 deputetë.

Po e vë edhe këtë pikë të rendit të ditës edhe një herë në votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Kemi të njëjtën situatë, në rrethana të tilla me 79 deputetë nuk kalon.

Atëherë më vonë e vejmë edhe një herë në votim, po sido që të jetë, dy votimet kanë të njëjtin status, nuk kanë vendimmarrje për shkak të mungesës së kuorumit në votim.

16. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie nga radhët e komunitetit shqiptar.

Grupet parlamentare që i kanë propozuar deputetët për anëtarë të këtij komisioni janë:

Grupi Parlamentar i LDK-së, Armend Zemaj, zëvendëskryetar i parë, Fidan Rekaliu, anëtar.

Grupi Parlamentar i PDK-së, Nezir Çoçaj, anëtar, Blerta Deliu-Kodra, anëtare.

Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, Adem Mikullovc, anëtar, Valon Ramadani, anëtar.

Grupi i Deputetëve të Pavarur, Shqipe Pantina, anëtare.

E ftoj Grupin Parlamentar të AAK-së që ta propozojë një deputet, kryetar të komisionit. Zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Zoti Rasim Selmanaj.

KRYETARI: Rasim Selmanaj, është në të njëjtën kohë edhe kryetar i këtij Komisioni ad hoc.

Po ashtu Grupi Parlamentar Lista serbe e propozon një anëtar, zoti Simiq.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Srpske liste predlaže Jasminu Živković. Hvala!

KRYETARI: Jasmina Zhivković është automatikisht zëvendëskryetare e dytë e komisionit.

Grupi Parlamentar Nisma, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Ne zakonisht në komisione i dërgojmë Milaim Zekën, për shkak se është anëtar i Komisionit Parlamentar për Media, prandaj e thashë.

KRYETARI: Zoti Milaim Zeka është anëtar i komisionit.

Grupi Parlamentar “6+” ju lutem, zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e propozon Albert Kinollin.

KRYETARI: Zoti Albert Kinolli është anëtar.

Prandaj, në rrethana të tilla procedojmë në votim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Me 78 vota për, Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar që të veprojnë në përputhje me nenin 11 4ë Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

21.Votimi i mocionit nga interpelanca, në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës

E ftoj deputeten Fatmire Kollçaku që në emër të propozuesit të mocionit ta paraqesë tekstin e harmonizuar nga grupet e tjera parlamentare.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të rishikojë funksionalizimin dhe shtrirjen e plotë të sistemit informativ shëndetësor dhe të bëjë publik kalendarin e aktiviteteve,

2. Qeveria e Kosovës të implementojë 22 masat e rekomanduara nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor dhjetor 2017.

3. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Oda e Profesionistëve Shëndetësorë dhe SSHKUK të hartojnë dhe të përgatisin parakushtet për Sistemin Informativ Shëndetësor, ku përfshihen lista e shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor në Kosovë në institucionet publike dhe ato private, e më pas licencimi i të gjithë profesionistëve shëndetësorë që i plotësojnë kushtet në sektorin publik dhe atë privat.

3. Krijimi i regjistrit shtetëror të punonjësve shëndetësorë në të gjitha institucionet publike dhe private, ndërtimi i sistemit të referimit të pacientëve, hartimi dhe zyrtarizmi i udhërrëfyesve klinikë dhe regjistri shtetëror i barnave.

4. Kuvendi i Kosovës i kërkon Bankës Qendrore të Kosovës që Kuvendit t'i paraqesë jo më vonë se 60 ditë pune raport të detajuar mbi financat dhe operacionet e kompanive të sigurimeve të licencuara, të cilët ofrojnë sigurime private shëndetësore.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në raportin e performansës së Auditorit të Përgjithshëm, të adresojë në institucionet e drejtësisë rastet e shkeljeve dhe të dëmit financiar nga mosimplementimi me kohë i projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

78 deputetë kanë votuar, 74 për, 2 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi mocionin e propozuar nga Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje të harmonizuar me grupet e tjera parlamentare.

23. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë

Ftoj deputeten Ganimete Musliu, që në emër të propozuesit të debatit ta paraqesë tekstin e rekomandimeve të harmonizuara edhe me grupet e tjera parlamentare.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pas debatit gati pesë orë atë ditë për problemin e mishit të prishur ose skandalin e mishit të prishur nga Belgjika dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesit e grupeve parlamentare kemi arritur në përfundim që t'i nxjerrim këto gjashtë rekomandime.

1. Kryeministri të marrë masa adekuate ndaj përgjegjësve, Bordit dhe menaxhmentit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë,
2. Organet e drejtësisë të fillojnë menjëherë hetimet ndaj institucioneve përgjegjëse publike dhe subjekteve private që sjellin në treg produkte të dyshimta.
3. Të bëhet mbështetje më e madhe buxhetore për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë për konsolidimin e saj me pajisje laboratorike, pajisjen e inspektorëve me kamera personale, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shtimin e stafit me inspektorë.
4. Në funksion të rritjes së transparencës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të pasqyrojë të gjitha të dhënat e veprimtarisë të inspektorëve në baza ditore në Web faqen e saj.
5. Të rishqyrtohet legjislacioni përkatës që saktëson periudhat kohore minimale para skadimit të afatit të përdorimit të produkteve ushqimore që importohen në Republikën e Kosovës, dhe
6. Të rritet mbështetja financiare për masat mbështetëse të programit për zhvillim rural që rrit prodhimin vendor.

Këto rekomandime janë hartuar nga propozuesit e debatit dhe gjithashtu janë harmonizuar me grupet parlamentare, të cilat kanë qenë pjesë e këtij dokumentacioni.

Ju ftoj t'i votoni.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, ftoj regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tash:

Kanë votuar 76 deputetë, të gjithë janë për.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi rekomandimet e propozuara në lidhje me skandalin e mishit të prishur të arritur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë.

24. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave

E ftoj deputeten Shqipe Pantina, që në emër të propozuesit të debatit të paraqesë tekstin e harmonizuar me grupet e tjera parlamentare. Urdhëro, Shqipe!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ne e kemi dërguar propozim-rezolutën te të gjitha grupet parlamentare dhe pasi që nuk kemi marrë ndonjë vërejtje ose koment, po konkludojmë se tashmë deputetët janë pajtuar me këtë, ose grupet parlamentare, sidoqoftë unë po i lexoj edhe një herë propozimet.

Në mbështetje të nenit 65, paragrafi 1 i Kushtetutës mbi kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe neni 6, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, pas debatit parlamentar të zhvilluar në vazhdimin e seancës plenare të datës 18 prill 2018, sipas kërkesës së Grupit të Deputetëve të Pavarur dhe të harmonizuar me grupet parlamentare, propozojmë këtë:

REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të rritet buxheti dhe të ngrihen kapacitetet profesionale për sektorin e drejtësisë, Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor.

U bëjmë thirrje organeve të drejtësisë, Prokurorisë dhe gjyqësorit, që të jenë më efikas në zgjidhjen e rasteve që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Kërkon nga Qeveria hartimin dhe procedimin në Kuvend brenda këtij viti kalendarik të projektligjeve që ndërlidhen me forcimin e masave në luftë kundër korrupsionit, përkatësisht pakon e ligjeve antimafia, përfshirë Projektligjin për vetingun, si dhe Projektligjin për financimin e partive politike.

Kërkon depolitizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera të pavarura.

Kuvendi kërkon që memorandumit i mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të zbatohet në përpikëri.

Ju ftoj, kolegë deputetë, që ta votojmë këtë projekt-rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Atëherë, procedojmë. Fjalën e ka deputeti Adem Mikullovc, thotë që ka një vërejtje lidhur me rekomandimin.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Teksti që na është dhënë përpara si rezolutë po ndryshon, një tekst që e kam në dorë, prej tekstit që e lexoi deputetja para meje. Nuk është në tërësi, nuk është i njëjtë. Kaq pata!

KRYESUESI: Shqipe, ju lus që të jepni një sqarim lidhur me këtë pretendim.

SHQIPE PANTINA: Teksti që deputeti e ka më herët është propozimi për debat, mirëpo nga diskutimet që kanë dalë këtu, disa prej propozimeve tona janë parë që nuk e kanë mbështetjen, prandaj e kemi hequr njëri prej propozimeve, përderisa tekstin që e lexova tani grupet parlamentare e kanë pasur të shpërndarë me e mail dhe deri dje në orën 16:00 ne nuk kemi pranuar asnjë vërejtje dhe tek sot, pasi nuk pranua vërejtje, ia kemi përcjellë sekretarisë për ta përkthyer dhe për t'ua shpërndarë deputetëve në kopje fizike.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Tanimë është ndërtuar një praktikë e mirë, ta quaj, kështu dhe raporteve kolegjiale që sa herë të kemi debate, kur kërkohet harmonizim i qëndrimeve, qofshin ato edhe rekomandime, të deleguarit e grupit ose përfaqësues të grupeve ulen dhe i diskutojnë rekomandimet.

Ne nuk kemi dërguar, në fakt, deri në ditën e djeshme, sepse esenca ka qenë që të ulemi dhe t'i harmonizojmë qëndrimet, edhe pse nga debati shumica këto çka i tha kolegjia Shqipe janë qëndrime të përbashkëta.

Kështu që nëse është e arsyeshme, unë kërkoj që kjo pikë të zhvendoset për një konsultim paraprak dhe të gjitha grupet ta japin kontributin e tyre, nëse kanë diçka për t'i shtuar apo për t'i hequr. Të mos harrojmë që ka debate, ka interpelanca të së njëjtës natyre, edhe rekomandimet tani janë të duplikuara për tema të njëjta.

Kështu që edhe më vonë kur kemi diskutim rreth përfundimit të interpelancës dhe rekomandimeve në fjalë, ju do të shihni që ka propozime të njëjta.

E kisha lutur edhe propozuesen që për një gjysmë ore ta zhvendosë këtë pikë, t'i harmonizojmë këto qëndrime, sepse të harmonizuara nuk janë as qëndrimet për tema të tjera deri më tani, ashtu siç e kuptova edhe nga kolegët e mi deputetë.

KRYESUESI: Faleminderit, për sqarimet! Meqë ka një propozim konkret deputetit Zemaj, na duhet qëndrimi i propozuesit.

SHQIPE PANTINA: Natyrisht, ne e kemi shprehur vullnetin tonë për harmonizim, siç thashë, edhe duke dërguar me shkrim propozimin, sidoqoftë, ne jemi dakord që të ulemi edhe një herë dhe ta hedhim edhe një herë në propozim pas një ore, pas konsultimit edhe me grupet e tjera. Mirëpo unë i ftoj grupet e tjera që ta caktojnë një person, me të cilin ne do të ulemi prej secilit grup dhe t'i harmonizojmë propozimet.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zemaj edhe një herë e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Sa herë e kërkoj, sipas Rregullores, kuptohet. Ne propozojmë, edhe ashtu ka qenë i propozuar dhe ka biseduar në emër të grupit, Driton Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: E propozoj vetveten.

KRYESUESI: Propozim interesant.
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kë propozoni?

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Unë propozoj deputetin Hajdar Beqa.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju kërkoj falje, sepse e ngatërrova radhën, do të duhej që përfaqësuesit të PDK-së t'ia jepja fjalën para përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

Grupi i Deputetëve të Pavarur, Shqipe Pantina.
Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Aleanca propozon Muharrem Nitën.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, Igor Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Poštovani predsedavajući, hvala vam!
U ime Poslaničke grupe Lista srpska, predlažemo gospodina Zoranu Mojsilovića.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Nisma, Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!
Deputetin Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Unë nuk e propozoj vetveten, e propozoj Duda Baljen.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ju do të zhvilloni konsulta që të harmonizoni tekstin, kjo pikë e rendit të ditës, sipas marrëveshjes, zhvendoset për fund të kësaj seance.

25. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë

Ftoj deputeten Teuta Haxhiu që në emër të propozuesit të debatit të paraqesë tekstin e harmonizuar me grupet parlamentare.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Gjatë fjalës së koleges Shqipe Pantina, pothuajse e njëjta situatë është edhe me debatin që e kemi zhvilluar sa i përket kësaj teme.

Ne si grup parlamentar, edhe unë kam kërkuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'u dërgojnë një e mail të gjitha grupeve parlamentare më 20 prill dhe sinjerisht të gjitha grupet parlamentare e kanë pasur shkresën zyrtare nga grupi ynë dhe nuk kemi marrë asnjë rekomandim.

Por, para se ta merr fjalën, në bisedë me përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të LDK-së, kanë kërkuar që t'i harmonizojmë rekomandimet, kështu që unë kërkoj mirëkuptimin po ashtu dhe jam e gatshme t'i harmonizojmë, duke dërguar edhe grupet parlamentare përfaqësuesit e tyre, do të mblidhemi dhe po e njëjta gjë do të ndodhë sikur me debatin paraprak, prandaj nuk do t'i lexoj rekomandimet, meqë të gjithë i kanë pasur, por po presim pas harmonizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, secili grup parlamentar duhet të propozojë përfaqësuesin. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush e do fjalën? Avdullah Hoti!

AVDULLAH HOTI: Po, Fidan Rekaliu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës?

MEMLI KRASNIQI: Ne propozojmë Mexhide Mjaku-Topallin.

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje?

GLAUK KONJUFCA: Zonjën Arbërie Nagavci.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi i Deputetëve të Pavarur?

DARDAN SEJDIU: Propozojmë Faton Topallin.

KRYESUESI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kush e do fjalën?

AHMET ISUFI: Teuta Haxhiu.

KRYESUESI: Lista serbe?

IGOR SIMIĆ: Hvala, predsedavajući!

U ime poslaničke grupe Srpska lista predlažemo poslanicu Jelenu Bontiq.

KRYESUESI: Faleminderit! Nisma?

BILALL SHERIFI: Haxhi Shalën e propozojmë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Ne e propozojmë deputetin Danush Ademi.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, tani kjo do të jetë pika e fundit e rendit të ditës të kësaj seance. Unë lus përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të koordinojnë punën dhe të harmonizojnë tekstin.

Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratiket të Kosovës, zoti Avdullah Hoti, e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Në mungesë të deputetit Fidan Rekaliun, propozojmë Valentina Rexhepin që të jetë në këtë grup.

KRYESUESI: Faleminderit!

- Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjastë shtetasve turq

Kuvendi, në seancën e mbajtur më 17 prill 2018, e ka miratuar mocionin e parashtruar nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Avdullah Hoti, që të radhitet në rend dite formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me dëbimin e gjastë shtetasve turq më 29 mars 2018. Mbi këtë bazë, unë ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Avdullah Hoti, që të

marrë fjalën në cilësinë e propozuesit dhe të paraqesë propozimin për kryesuesin e komisionit dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të mbarojë mandati i komisionit, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ne kemi pasur një debat për këtë çështje, besoj është shterur debati atëherë dhe i falënderoj të gjithë deputetët për mbështetjen e rekomandimeve, për krijimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar. Baza ligjore për formimin e këtij komisioni është i specifikuar në nenin 77 të Kushtetutës, në nenin 71 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe neni 4 i Ligjit për hetim parlamentar.

Çështja për hetim është definuar në rekomandimin numër 4 të Kuvendit që është votuar, ku thuhet në mënyrë specifike: “Kuvendi e mandaton Komisionin Hetimor Parlamentar që ta shqyrtojë përputhshmërinë e procedurave të ndjekura lidhur me këtë rast me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi”.

Në debat kemi arsyetuar nevojën e themelimit të këtij komisioni, ne propozojmë që afati kohor për punën e këtij komisioni të jetë një muaj. Përbërja e komisionit në bazë të Ligjit të jetë 11 anëtarë, sipas përbërjes së komisioneve të tjera parlamentare. Kryetari i këtij komisioni të vijë nga Lëvizja Vetëvendosje, ne si Grup Parlamentar i kemi dhënë dy propozimet tona: deputetit Driton Selmanaj dhe deputeti Anton Quni dhe propozojmë që deputeti Driton Selmanaj në bazë të ligjit të jetë zëvendëskryetar i këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, më lejoni t’ju njoftoj se ky komision, sipas propozuesit, do të ketë 11 anëtarë. Grupet parlamentare që i kanë propozuar deputetët për anëtarë të këtij komisioni janë si në vijim, bashkë me emrat: Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar deputetin Driton Selmanaj për zëvendëskryesues të komisionit dhe deputetin Anton Qunin për anëtar. Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar deputetët Hajdar Beqa dhe Ganimete Musliun, anëtarë. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar deputetët Xhelal Sveçla dhe Sami Kurteshi, anëtarë. Ka një ndërhyrje nga shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Ju e thatë që janë anëtarë, prej të cilëve udhëheqësi i komisionit do të jetë Xhelal Sveçla.

KRYESUESI: Kryesues i komisionit. Faleminderit! Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur ka propozuar deputetin Dardan Molliqaj, anëtar. Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar deputetin Muharrem Nitaj, anëtar, ndërsa kërkohet nga grupet e tjera parlamentare që t’i propozojnë deputetët për anëtarë të këtij komisioni.

Tani vazhdojmë sipas radhës, ftoj kryetarin ose përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Listës serbe që të propozojë deputetin për anëtar të këtij komisioni.

IGOR SIMIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poslanička Grupa Srpska Lista za člana ove ad hoc komisije će predložiti naknadno, napismeno ćemo poslati predstavnika.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Grupi Parlamentar Nisma propozon deputetin Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Dhe, Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar “6+” ende nuk e ka emrin, nuk e kemi caktuar, s’jemi dakorduar ende se kush do të na përfaqësojë në këtë komision. Ndërkohë, do të japim emrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas radhës duhet të marrim edhe qëndrimet e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Së pari, Lidhja Demokratike e Kosovës. Nuk ka. Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që dhe në pjesët e para disa ditëve kur ka filluar kjo seancë kemi pasur diskutim rreth kësaj çështjeje, se s’ka arritur të marrë shumicën formale dhe unë edhe sot po ju them që Partia Demokratike e Kosovës do të votojë për këtë komision, por vetëm pasi të kalojnë pika e parë dhe pika e dytë e rendit të ditës, të cilat u bojkotuan në votim nga ana e një pjese të deputetëve të opozitës. Kështu që edhe ne nuk do të marrim pjesë në votimin e kësaj pike, para se të votohet qoftë pro ose kundër, le të kalojnë ose le të refuzohen ato dy pikat e tjera, ashtu siç kemi deklaruar edhe herën e kaluar. Besoj kjo është edhe në frymën e temës së ditës së djeshme të bashkëpunimit konstruktiv dhe të konsensusit, pavarësisht qëndrimeve që i kemi.

Andaj, unë shpresoj që do të mund t’i kalojmë ato dy pika në mënyrë që të kalojë edhe formimi i komisionit, për të cilin tashmë jemi dakorduar të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Unë po mendoj që kjo ishte shkas i Partisë Demokratike për të mos e votuar komisionin, i cili është shumë i rëndësishëm për ta hetuar këtë çështje dhe problem i cili ndodhi në Republikën e Kosovës. Ju është mirë t’i shpalosni atëherë emrat, me ulëse të

deputetëve që nuk kanë votuar. Sa i pashë unë qëndrimet e grupeve parlamentare për ligjin në fjalë, pra po flitet për Ligjin për të huajt dhe marrëveshjen me Hungarinë, ma merr mendja që edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe Lëvizja Vetëvendosje shpалosën qëndrimet e tyre që janë pro votimit të këtyre pikave.

Kështu që atëherë mund të jenë deputetët e Listës serbe që nuk kanë votuar, apo dikush tjetër, ma merr mendja që kjo po shfrytëzohet vetëm si shkas nga ana e Partisë Demokratike, vullneti i të cilës nuk është për të votuar hetimin e rastit të dëbimit të Gylenistëve, sepse unë ndoshta edhe mund ta kuptoj Partinë Demokratike, figura të saj mund të kenë përgjegjësi për këtë që ka ndodhur me rastin e deportimit të shtetasve turq.

KRYESUESI: Faleminderit! Po, replikë ka kërkuar përfaqësuesi i PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Zoti Konjufca, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës flas unë, nuk flet ti. Unë isha shumë i qartë në atë që thashë. Kur të kalojnë pikat 1 dhe 2, atëherë kalojnë, mos fol vetëm për njërin, fol për të dyja. Pika e dytë është Bordi i Agjencisë së Privatizimit të Kosovës. Kam qenë i qartë edhe në ditët e kaluara, kur ka filluar kjo seancë, jam i qartë edhe sot. Kështu që çështjet e tjera që ju i ndërlidhni me paragjykime janë e drejtë juaja, por nuk qëndrojnë dhe nuk janë të vërteta aspak.

KRYESUESI: Glauk Konjufca, kundër-replikë.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, kjo seancë plenare le ta regjistrojë këtë konstatim: që Partia Demokratike e Kosovës po e kushtëzon krijimin e një Komisioni kaq të rëndësishëm Hetimor Parlamentar, që ky nuk ka qenë qëndrimi i saj i mëparshëm, por vetëm kur po e kupton se është në prag krijimi i këtij komisioni, po zbulon shkaqe, të cilat nuk janë të vërteta dhe të cilat u formuluan këtu tash për tash. Mendoj që kjo është vetëm një alibi e Partisë Demokratike për të mos i dhënë rrugë, për të mos i hapur rrugë krijimit të këtij komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Grupi Parlamentar Deputetët e Pavarur.

DARDAN SEJDIU: Në lidhje me çka? Nxirre në votim edhe një herë dhe shohim.

KRYESUESI: Në rregull, Dardan! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës? Muharrem Nitaj, me sa shoh, e ka kërkuar fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam shumë dakord me atë që po e deklaron Glauku që është shumë i rëndësishëm formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, por njëkohësisht është shumë i rëndësishëm edhe ratifikimi i

traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë, si dhe votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Nëse e keni ndërmend të silleni seriozisht dhe të mbështesim çështjet që janë të rëndësishme edhe për shtetin e Kosovës, edhe për këtë Parlament, atëherë të votojmë të gjitha çështjet njëhën pas tjetrës dhe të mos akuzojmë se dikush po e kushtëzon votimin e një komisioni me disa çështje të tjera.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, po ashtu, nuk do të marrë pjesë në votim për krijimin e Komisionit Hetimor, jo se keni telashe me përbërjen e komisionit ose me arsyen që ky komision të hetohet, mirëpo nuk duam, për shembull, që të jemi pjesë e disa pazareve që disa çështje të rëndësishme të mos kalojnë, e disa të tjera po. Votojmë kur kalon pika e parë dhe e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, a e dëshironi fjalën? Jo! Nisma? Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Nëse nuk gaboju, ideja e kundërshtimit të votimit herën e parë nga kolegët nga LDK-ja ka qenë jo pse kanë qenë kundër, së paku nuk kam dëgjuar deri më tash kundër të kësaj përbërje të pikës që ka të bëjë me 6 anëtarët e Bordit, por thjesht për të demonstruar se mazhoranca nuk mund të kalojë asgjë vetë, pa mbështetjen, pa marrjen së paku pjesë në votim të deputetëve nga opozita, kjo prandaj është shtyrë deri më sot.

Mendoj që nga dita e djeshme kemi një moment së paku të ri në bashkëpunimin pozitiv-opozitiv rreth disa çështjeve dhe do të ishte mirë që t'i kthehemi votimit, kush është për, le të votojë për, kush është kundër, le të votojë kundër çështjes në fjalë, në mënyrë që të mos bëhet si çështje që do të bllokonte formimin e komisionit. Në fund të fundit, edhe nëse nuk pajtohemi me ata emra, për hatër, për nder, në funksion, për hir të komisionit që është shumë i rëndësishëm, le ta kalojë Lidhja Demokratike e Kosovës, le të votojë pikën në fjalë dhe të kalojmë te kjo, sepse mendoj që nëse do të duhej ta shihnin edhe si sakrificë, që këta emra të shkojnë atje, le ta shohin edhe si sakrificë në funksion të formimit të komisionit. Për ndryshe, nëse nuk vendos kështu, Grupi i Nismës nuk ka qëndrim, unë do t'ua lë deputetëve veç e veç të vendosin a duan të votojnë, apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", a e dëshironi fjalën? Jo! Atëherë, propozuesi, iniciuesi, ka kërkuar fjalën, zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në cilësinë e propozuesit të kësaj pike, duke parë tash hezitimin e disa grupeve parlamentare dhe duke i kushtëzuar gjërat, të cilat në praktikë nuk duhet të ndodhin, sepse ne kemi dhënë mbështetjen plotësisht për pikën e parë që është Ratifikimi i Traktatit ndërmjet Kosovës dhe Hungarisë, kemi qëndrim tjetër për pikën e dytë, por ajo është çështje e grupit tonë parlamentar. Pra, në cilësinë e propozuesit të këtij komisioni, ne e tërheqim nga votimi dhe do të fillojmë mbledhjen e nënshkrimeve, me 40 nënshkrime do të sjellim në Kryesi të Kuvendit këtë komision dhe pastaj nuk është në diskrecionin e asnjë grupi parlamentar për të mos e votuar këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Memli Krasniqi e ka fjalën, replikë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Kjo s'ka të bëjë me kurrfarë lloj kushtëzimi, ashtu qysh po mundoheni ta interpretoni, kjo ka të bëjë me ftesën që deputetët ta kryejnë mandatin e tyre, sepse është e pakuptimtë, për mos thënë diçka tjetër, të jesh fizikisht këtu dhe të mos ushtrosh detyrën, përgjegjësinë dhe privilegjin, besa, të votimit. Ne s'po i ftojmë të votojnë pro, nuk po e votojmë mbështetjen e propozimit të Qeverisë, ne po i ftojmë vetëm të marrin pjesë në votim. Le të votojnë kundër, por jo ta bllokojnë punën e Kuvendit dhe punën e Qeverisë, duke mos marrë pjesë në votim. Atëherë është krejtësisht e kuptueshme që të veprohet me të njëjtën monedhë dhe kështu nuk shkojmë askund, sepse s'kryhet asnjë punë.

Do të ishte krejtësisht e thjeshtë që të kthehet në votim, siç u votua dy herë më herët, edhe pika e parë, edhe pika e dytë, të kalojnë pavarësisht qëndrimeve që i kanë deputetët veç e veç dhe pastaj të votohet edhe për komisionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Avdullah Hoti dhe një herë. Ju lus që të jeni i qartë në atë që do të propozoni edhe për seancën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Mandati i deputetëve është i lirë, nuk e përcakton as zoti Krasniqi, as unë, e askush në këtë Kuvend. Ajo çka do të ishte e logjikshme për funksionim të Kuvendit, kryeministri është këtu, nuk e ka Qeverinë legjitime me 61 vota, nëse doni logjikë të funksionimit të institucioneve demokratike, ai duhet sot të kërkojë votëbesimin vetë këtu, prandaj ne edhe një herë e tërheqim këtë pikë nga rendi i ditës, nga procesi i votimit. Do ta procedojmë në bazë të procedurave në Kryesi të Kuvendit me 40 nënshkrime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, propozuesi ka tërhequr nga rendi i ditës këtë pikë.

17. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, lidhur me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë. Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Propozuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në dhjetë minuta dhe në fund të debatit deri në pesë minuta, kjo sipas nenit 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Në bazë të nenit 44, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Ramush Haradinaj e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjet e ngritura në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha e dhënë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është si në vijim: Grupi Parlamentar i LDK-së, 27 deputetë, 40,5 minuta. Grupi Parlamentar i PDK-së, 23 deputetë, 34,5 minuta, minus 6,5 minuta për kryeministrin, do të thotë mbeten 28 minuta. Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, 19 deputetë, 28,5 minuta. Grupi Parlamentar Deputetët e Pavarur, 12 deputetë, 18 minuta, Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 11 deputetë, 16,5 minuta, minus 3 minuta për kryeministrin, mbeten 13.5 minuta. Grupi Parlamentar Lista serbe, 10 deputetë 15 minuta, minus 2,5 minuta për kryeministrin, mbeten 12.5 minuta. Grupi Parlamentar Nisma, 6 deputetë, 9 minuta, minus 1,5 për kryeministrin, mbeten 7,5 minuta. Grupi Parlamentar “6+” me 6 deputetë ka të njëjtën formulë, ndërkaq pa grup parlamentar janë 6 deputetë, të cilët në total kanë 9 minuta.

Atëherë, sipas radhës dhe në përputhje me Rregulloren e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zotin Glauk Konjufca, si propozues i interpelancës që të marrë fjalën. Zoti Konjufca ka në dispozicion dhjetë minuta. Faleminderit!

GLAUK KONJUFCA: Kjo interpelancë ishte thirrur më 5 mars, tash data është 26 prill, i bie që 51 ditë kanë kaluar që nga koha kur është parashtruar kërkesa, me të vërtetë këto vonesa po na ndodhin edhe për shkak të agjendave të Qeverisë. Do të kishte qenë mirë që Qeveria të ishte më e disiplinuar në shfaqjen e saj përpara Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që ne të mund t'i zhvillojmë këto diskutime, të cilat mendojmë që trajtojnë tema të rëndësishme.

Kjo është një temë e rëndësishme, sepse kemi të bëjmë me prodhimin e energjisë elektrike, mirëpo gjatë muajve shkurt dhe mars u raportua që sidomos nëpër komunat Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj dhe Drenas, si dhe nëpër fshatra të komunave të tjera të Kosovës ka pasur ndërprerje të mëdha të energjisë elektrike. Gjashtë vjet pas privatizimit të rrjetit të shpërndarjes, orët e ndërprerjes së energjisë elektrike në gjithë territorin e vendit nuk janë ulur, përkundrazi në

periudhën e pikut orët e ndërprerjeve janë rritur. Ulja e humbjeve teknike dhe komerciale ose, thënë më saktë, e vjedhjeve që ndodhin, e vjedhjeve të energjisë elektrike, edhe të mospagesave nuk kanë asnjë përmirësim, përkundrazi raportimet e ZRRE-së tregojnë për raporte në favor të periudhës kur kompania ishte në pronësi publike.

Faturat e mospagimit dhe të vjedhjes të energjisë që po i shpërndahen paligjshmërisht çdo konsumatori, treguan që edhe përmes vendimit apo opinionit që dha Avokati i Popullit, e më pastaj edhe vendimi i gjykatës që pasoi atë, tregoi që kjo gjë është e padrejtë dhe duhet një ndërhyrje nga ana e Qeverisë së Kosovës për ta përmirësuar këtë gjë. Në këto gjashtë vjet prej privatizimit të KEDS-it çmimi i energjisë elektrike sipas kërkesës së konsorciumit “Limak&Çalik” është rritur katër herë deri tash, pra prej vitit 2012. Kjo me arsyetim të gënjeshtërt që mbulimi i kostove dhe defektet në gjenerim të energjisë janë të nevojshme për ta përballuar koston. Siç e dini importi i energjisë elektrike për vitin 2017 ka qenë 68 milionë euro, kurse që nga viti 2011 Kosova i ka shpenzuar 300 milionë euro, apo mbi 300 milionë euro për import të energjisë elektrike.

Ne kemi avantazhin të prodhojmë rrymë me çmim të ulët, për shkak të burimeve që i kemi, por në fund po del që së pari qytetarët po paguajnë shumë shtrenjtë për çmimin e energjisë elektrike, e dyta që nuk po furnizohen me rregull as ekonomitë familjare e as bizneset dhe, e treta, që nuk e kemi as në pronësi publike rrjetin e distribucionit, pra, i cili u privatizua. Ne kemi kuptuar që paligjshëm, edhe pas privatizimit u kuptua që disa prej hidrocentraleve të vogla që i ka pasur në pronësi KEK-u, pronësi publike, i janë dhënë investitorit privat dhe nuk ka pasur investime serioze sa i përket rrjetit, edhe pse në kontratë i ka të planifikuara diku rreth 20 milionë investime, le të themi, për çdo vit. Raportimi që bëhet në Zyrën e ZRRE-së për këto investime nuk vërteton se këto investime po kryhen në mënyrë të rregullt dhe pasqyrat që paraqiten mund të jenë po ashtu të pavërteta. Ndërkohë, që nuk po merret asnjë masë konkrete mbi sigurimin e prodhimit të energjisë dhe sërish importi po bëhet pa planifikim paraprak, duke na shkaktuar shpenzime shumë të mëdha në buxhetin e shtetit.

Së pari, Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar rregullisht prej vitit 2015, se Qeveria në bashkëpunim me KEK-un do ta fillonte rindërtimin e Termocentralit Kosova A, pra rindërtimin e plotë të tij, jo thjesht rivitalizimin. Kjo në përputhje edhe me një studim shumë të qëlluar të Kompanisë Bilfinger, e cila përputhej edhe me konstatimet e ekspertëve të KEK-ut. Ky rindërtim i kapaciteteve do t’ia jepte Kosovës sigurinë e plotë të prodhimit të energjisë elektrike dhe një kalendar të qartë për planin e investimeve të reja.

Kur Isa Mustafa, kryeministri i Qeverisë së kaluar, ishte takuar me kancelaren Merkel, ajo e ka pas dhënë qartë propozimin që këto kapacitete të rindërtohen, ashtu siç pati propozuar edhe Kompani Bilfinger, por Qeveria e Kosovës shkoi me një plan krejtësisht tjetër, plan i cili do ta dëmtojë shumë Kosovën, pra plani i kontratës me Contour Global. Rindërtimi i Kosovës A do të

na jepte së pari prodhim të sigurt të energjisë elektrike, kohën e nevojshme për ta nxjerrë në remont Termocentralin Kosova B, financat e mjaftueshme për të filluar me ndërtimin me kapital publik të Termocentralit Kosova e Re dhe kështu do ta shmangnim edhe një kontratë shumë abuzive, që e pati nënshkruar Qeveria e Kosovës.

Aktualisht, situata me prodhimin e energjisë elektrike është shumë alarmante, gjendja në Shipitullë dhe hapja e Minierës së Re është një tjetër krizë e shkaktuar nga veprimet e Qeverisë së Kosovës. Vitin që shkoi, kryeministri Haradinaj mori vendim për t'ua kompensuar të gjitha ndërtimet në zonën e mbrojtur ekonomike në Shipitullë. Ne mendojmë se ky vendim ka qenë i gabueshëm. Të gjithë jeni në dijeni se në Shipitullë janë bërë ndërtime abuzive, duke e ditur saktë se aty një ditë do të shpronësoheshin ato për të filluar hapjen e minierës. Edhe pse kishte dy vendime të Qeverisë, një në vitin 2004 dhe tjetri në vitin 2009, që i ndalonin ndërtimet në këtë zonë, në zonën e mbrojtur ekonomike, as Qeveria, e as komuna atje nuk i ndaluan ndërtimet pa leje, të cilat i kushtuan milionë Qeverisë së Kosovës dhe për të cilat kurrë as drejtësia nuk e ndërmori ndonjë hap për t'i hetuar dhe për ta dhënë të themi një konstatim se kemi të bëjmë me një krim të organizuar.

Vendimi i Qeverisë për Shipitullën dhe kompensimin e ndërtimeve abuzive atje ka shkaktuar një precedent të rrezikshëm, sepse çdokush tash mund të ndërtojë ilegalisht në një zonë ku ka informacion se do të hapet minierë dhe Qeveria në njëfarë mënyre e ka dhënë shembullin se është e gatshme për kompensim. Ne kemi të dhëna se as vlerësimi i vlerës së ndërtimeve nuk u është lejuar vlerësuesve, të cilët do të duhej të ishin të licencuar për këtë gjë dhe se ndaj tyre dhe punonjësve të KEK-ut ka pasur kërcënime për të cilat ende nga institucionet e sigurisë nuk janë ndërmarrë masa.

Po ashtu, ka indikacione serioze se gjatë shpronësimit dhe kompensimit është konsumuar një vepër e rëndë penale, duke i kaluar paratë te personi që e ka titullin e pronësisë dhe me atë noterial, i zoti i tokës po ia shpërndan llogaritë bankare zaptuesve të pronës së tij, të cilët kanë ndërtuar pa ligjshëm në të, e që ka qenë e mbrojtur nga shteti dhe e rezervuar për ta ndërtuar aty Minierën e Re. Tash, kush e merr përsipër të deklarojë dhe të vendosë për kahjen e re të minierës me këto kushte, që i ka krijuar Qeveria e Kosovës. Me t'u vendosur kahja, menjëherë aty do të nisnin me siguri ndërtime tjera pa leje dhe askush nuk po e ngre këtë problem. Dalja nga kjo gjendje mund të bëhet kështu, sipas propozimit tonë:

- Rindërtimi i Kosova A;
- Planifikimi për remont i Kosova B;
- Ndërprerja e kontratës me Contour Global;
- Vendosja nën mbikëqyrje strikte të investimeve të KESCO-s për rritjen e shpërndarjes dhe kontrollin për shkyçje të rrymës, si dhe për riparime apo mbikëqyrje e plotë për vlerat e humbjeve teknike;

- Rishikim në themel i rasteve sipas secilës komunë të vjedhjeve dhe mospagimit arbitrar të rrymës dhe heqjen si kategori të humbjeve komerciale nga ZRRE-ja dhe mosshpërndarja në faturat e qytetarëve të tjerë, të cilët e paguajnë rregullisht energjinë elektrike.

Në fund do ta propozojmë një mocion, i cili do ta përmbyllë këtë interpelancë për kryeministrin, por besoj se kur t'i vijë radha propozimit të rekomandimeve tona, atëherë do të bisedojmë edhe me grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Haradinaj, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me çështjet e ngrehura për interpelancë. Kryeministri do të ketë kohë 15 minuta për fjalën e tij.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Tani e di që s'praktikohet si procedurë, por tri interpelanca, të tria e kanë energjinë si tematikë, po t'i bënim bashkë do të kursenim kohën tuaj, kohën tonë e të qytetarëve.

Sido që të jetë, me sa kuptova, e para ka të bëjë me ndërprerjet energjetike, që kanë ndodhur në një periudhë të caktuar kohore, e pastaj sponsorizuesi, në këtë rast zoti Konjufca na elaboroi zhvillimet që kanë ndodhur në energji, krejtësisht me të dhëna të gabuara. Jam i bindur se e bën qëllimshëm, sepse e di të vërtetën, por demagogjia e partive s'ka kufi dhe... pse jo?

E para, dua ta shpjegoj pak a shumë gjendjen e energjisë me dy tri fjalë, çfarë ka ndodhur. Kjo vlen për të gjithë që dëshirojnë ta dëgjojnë. Qeverisjen e kemi marrë në shtator, në mes të shtatorit, ka qenë i harxhuar thëngjilli rezervë që parashihet të ketë rezerva për situata të caktuara, e njëkohësisht ka pasur për t'u ndërprerë mihja, për shkak se nuk ka pas ndodhur zhvendosja e atyre që ka qenë e paraparë të ndodhë, në mënyrë që të mihej, të nxirrej qymyri e të prodhohej energjia. Nëse dikush e gjen që nuk është kështu në këtë Kosovë, urdhëroni! I madh e i vogël në këtë Kosovë e di se ka qenë kështu. Besoj edhe në Vetëvendosje, në atë që ka mbetur Vetëvendosje, secili e dini që ka qenë kështu. Mund t'i pyetni në KEK, mund t'i pyetni banorët, mund ta pyetni kë të doni se a ka qenë kështu. Domethënë, është e vërtetë që në shtator, kur është marrë qeverisja Haradinaj, s'ka pasur qymyr rezervë dhe s'kemi guxuar të mihim më, sepse s'i kanë pas hequr familjet prej aty. Pra, familjet kanë qenë në shtëpitë aty, s'kemi pasur ku të mihim.

Cilat kanë qenë opsionet për Qeverinë e vendit? Kushdo të kishte qenë, Isa Mustafa, Ramush Haradinaj a një tjetër, më vonë a më herët a... Ose të bazoheshim në import, e importi të çelnin vende pune të tjerët, ose të ndërmerrim diçka. Gjatë kohës sa kam qenë unë në qeverisje asnjë shtëpi s'ka arritur të ndërtohet, se unë i kam pasur veç dy-tri javë. I kam gjetur aty krejt atë gjendje siç është. Në emrin tuaj, të popullit të këtij vendi, i kemi hyrë bukur si trup kësaj pune, me ditë e net, me orë të tëra kemi kaluar me ta aty në vend, ata janë njerëz të këtij vendi, edhe

Shipitulla, edhe Hadja. Dikujt i duket se janë kriminelë e kanë bërë krime, por janë çuar prej tokës së vet. Ne kompensojmë këtu autorrugë, kompensojmë për gjithçka tjetër, normalisht që i kemi kompensuar edhe ata. Tarifat kanë qenë të praktikuara njëherë më 2014, të njëjtat tarifa, siç ua kemi dhënë atëherë. E keni shembullin e një lagjeje, quhet Shalë, me sa di unë. Tash për këtë pjesë, pra kjo është e vërteta, kemi arritur të prodhojmë energji të Kosovës, qymyr s'kemi bërë rezervë ende, por ka filluar procesi.

Ne e prodhojmë energjinë e lirë me qymyr, pra më të lirën, 6,6 centë e kemi çmimin, Serbia e ka sa ne, tjetërkush jo. Ky është çmimi i energjisë në Kosovë, nuk është rritur deri tash. Të shohim si do të rrugëtojmë.

Pak fjalë për ndërprerjet. Edhe pse ka pasur investime në sektorin e energjisë në rrjetin e shpërndarjes, po vetë rrjeti, përfshirë edhe pajisjet e gjenerimit edhe ato të sistemit të shpërndarjes në Kosovë janë shumë të vjetra. Çka nënkupton kjo? Kushdo e di sa të vjetra i kemi disa shtylla diku-diku, disa trafostacione, disa tela, e qysh është gjendja. Nuk po them se është mirë që është ashtu, por rrjeti është i vjetër. Përveç ndërprerjeve që kanë qenë të planifikuara, e që unë mund të ju them se ne kemi ngritur qendër kujdestarie për ta përcjellë pse po ndodhin këto ndërprerje dhe i kemi ndenjtur gati KEDS-it, KOSTT-it e ZRRE-së e KEK-ut, pse ka ndërprerje, i kemi mbikëqyrur pra dhe jemi interesuar për to. Në një pjesë na janë dhënë shpjegime që janë të planifikuara, për shkak se ndodhin investime, riparime, që nuk e di a ka qenë krejt ashtu. Një herë kam thënë që dikush duhet të japë llogari për këto. Një pjesë na kanë thënë se është mbingarkesë, s'po e mban rrjeti, në disa raste na kanë thënë edhe mungesë besa, se s'kanë importuar atëherë kur vareshin nga importi, e kështu me radhë... Ka pasur, pra mbingarkesë, djegie e tjera...

Në total, rreth energjisë është edhe ministri këtu dhe ka kolegë të tjerë që janë më në temë. Ajo që dëshiroj të them është që gjendja nuk është e lehtë as tash. Nuk do të shkojë aq thjesht rikthimi i Kosovës në energji, mirëpo Kosova prej një konsumatori megjithatë është kontribuues në energji për vetveten. Me investimin e ri, këtë që po kërkoni për ta anuluar, mund edhe të kalojë në treg, pra të kthehet në një fuqi energjetike. Kuptohet që energjia e ripërtërishme e kapaciteteve ekzistuese është në fazën... së pari, energjia e ripërtërishme gjithkush e di vlerën e saj, jemi të hapur për të, si për solar, si për erë, e lloje të tjera të energjisë. Atë ofertën e gjermanëve e kam pas dëgjuar edhe unë që ka ekzistuar, unë s'e kam gjetur në tavolinë. S'e di as çka është realisht, veç e kam dëgjuar në diskutime.

Ajo që e kam gjetur në tavolinë unë është një diskutim nja dhjetë vjet me amerikanët për t'ia nisur njëfarë pune, por afro-largo, afro-largo, më ka rënë hise ta mbyll, e kam mbyllur. Mendoj se përkundër diskutimeve, që unë i mirëpres, dhe pikëpamjet që i kanë njerëzit, e vërteta qëndron se është një lajm i mirë për Kosovën, edhe në energji, edhe në dimensionet tjera. Përndryshe, alternativa ka qenë në pakufi për të mbetur të rrezikuar për energji, pra gjithë kohën ne të blejmë

nga të tjerët, e të mos arrijmë ta prodhojmë tonën, se renovimi ose i A-së, ose i B-së, ta zëmë, se e kemi rinovuar veç B-në, ne B-në e kemi funksionale, po ajo nuk e ka jetën aq të gjatë. A-ja dihet si është, prapë s' do të mjaftonte për nevoja të tregut të Kosovës. Me këtë 500-sh, përkatësisht me 450-sh efektiv ne kthehemi në treg.

Kjo është e vërteta dhe ajo që më bën përshtypje, besoni, nuk e kam veç për shkak se Qeveria është në këtë rast pala tjetër, por ju kisha lutur, vlerësojini disa veprime që janë bërë për hatër të fëmijëve të këtij vendi. Pra, një Kosovë që ka qenë kryesisht në duart e atyre që kanë importuar energji, sot është një Kosovë që prodhon energji të vetën. Prodhimi e ka një kosto, i ka problemet, zhvendosja e ka një kosto, ka probleme. Sot kanë protestuar disa këtu para Qeverisë, nesër do të protestojnë disa të tjerë, por Kosova furnizohet me energji të prodhuar në Kosovë. Ky është realiteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Tani është radha e kryetarëve, ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot është e vërtetë që në rend dite i kemi tri interpelanca për gjendjen në sektorin e energjisë, një kjo që ka filluar, e ftuar nga Lëvizja Vetëvendosje, për reduktimet e ashpra të energjisë elektrike. Tjetra është e ftuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ka të bëjë ekskluzivisht me ndarjen e 1 milion eurove për mbulimin e shpenzimeve për muajin mars të energjisë elektrike për katër komunat veriore, pas largimit të këtij shpenzimi nga faturat e qytetarëve të ndershëm, të cilët rregullisht e kanë paguar energjinë elektrike pa e ditur në fakt që një përqindje e aty është për qytetarët e katër komunave të veriut, që nuk paguajnë. Dhe tjetra, e thirrur nga Grupi i Deputetëve të Pavarur, që ka të bëjë me kontratën me Contour Global për ndërtimin e Kosovës së Re.

Në fakt, të tri këto çështje janë të ndërlidhura dhe sado specifike që do të mundohemi të jemi për temat specifike, ne prapëseprapë do t'i përziejmë, siç u pa edhe nga parafolësit, sepse këto janë të ndërlidhura dhe trajtojnë çështje të një sektori, sektorit të energjisë që është shumë i rëndësishëm.

Të nderuar kolegë,

Energjia elektrike është kusht i domosdoshëm për mirëqenie dhe për zhvillim ekonomik. Sot kur vendet e zhvilluara dhe ato të rajonit po flasin për energji të ripërtërishme, po flasin për masa të

avancuara të mbrojtjes së ambientit, ne fatkeqësisht dy dekada pas lufte, edhe sot e kësaj dite përballemi me reduktime të ashpra të energjisë elektrike.

Është e vërtetë se nuk ka asnjë studim gjithëpërfshirës për të parë se cilat kanë qenë dëmet nga reduktimet e energjisë elektrike, por pavarësisht mungesës së të dhënave, ne të gjithë e dimë që në Kosovën e pasluftës nuk ka asnjë familje në Kosovë, e cila nuk është dashur të investojë për ta blerë një gjenerator, në mënyrë që të mos ngelë në errësi. Nuk ka asnjë biznes në Kosovë që nuk është dëmtuar rëndë nga reduktimet e energjisë elektrike. Në fakt, bizneset dhe familjet po vazhdojnë të dëmtohen edhe sot, për shkak se reduktimet e energjisë elektrike po vazhdojnë.

Të nderuar kolegë,

Në studimet që janë bërë viteve të fundit po përmend një studim të Odës Ekonomike të Kosovës, është një intervistë që çdo tre muaj bëhet me 700 biznese në Kosovë. Në top-dhjetë barrierat e të bërit biznes renditet energjia elektrike. E para është reduktimet, e dyta është energjia jokualitative, që do të thotë që kur ajo ndërpritet, vjen pastaj ose me tension shumë të lartë, ose me tension shumë të lartë, që shkakton dëme të mëdha në makinerinë prodhuese. E treta janë tarifatat verë-dimër, të cilat janë harmonizuar kohëve të fundit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, por megjithatë është bërë një shtrenjtim, domethënë tarifatat e shtrenjta të dimrit janë shpërndarë në 12 muajt e vitit. Tjetra është maksigrifi, që është një pajisje mbeturinë e sistemit të kaluar, do ta elaboroj më vonë. Dhe në fund është kategorizimi në A+, të cilin e bën KEDS dhe KESCO.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe një barrierë tjetër, që sot e kanë bizneset, e që janë investimet të cilat ato i bëjnë për zgjerim të kapaciteteve energjike, trafostacionet që ato investojnë me rastin e hapjes së kapaciteteve prodhuese, fabrikave u duhet të investojnë vetë, në momentin e kyçjes KEDS i detyron që këto asete të kalojnë në pronësi të KEDS-it.

Të nderuar kolegë,

Me të gjitha këto, prodhimi në vendin tonë është i vështirë. Prodhuesit sot për shkak të këtyre problemeve nuk janë konkurrentë në treg. Ka raste të shumta të raportuara për defekte enorme në makinerinë prodhuese, për shkak të këtyre problemeve. Sot ka qindra lëndë në gjykata nga operatorët ekonomikë, të cilët e kanë paditur KEDS-in, respektivisht KESCO-n që është e njëjta kompani, për dëmet që u janë shkaktuar këtyre.

Shoqatat e biznesit raportojnë se që nga paslufta bizneset në Kosovë kanë investuar rreth 50 milionë euro në gjeneratorë, e ku janë kostot e karburantit? Pra, barrierat kryesore sot për zhvillimin e bizneseve është energjia, është mungesa e saj dhe problemet tjera, të cilat i përmenda. Bizneset sot po përballen me këto probleme, ashtu siç janë përballur 20 vjet më parë.

Para tri dekadave, shpenzimi i energjisë elektrike në Kosovë ka qenë 70:30 në favor të shpenzimit nga industria. Për këtë arsye, tarifat kanë qenë të tilla, që industria e ka subvencionuar shpenzimin e energjisë elektrike të ekonomive familjare. Sot ky raport është 70:30, por jo në raport të shpenzimit nga industria, fatkeqësisht është në favor të shpenzimit në ekonomi familjare. Por, tarifat nga ZRRE-ja janë ende të njëjta. Sot 30% e industrisë subvencionon energjinë elektrike, ose 70% të shpenzimit të energjisë elektrike në ekonomitë familjare dhe sot për këtë arsye bizneset nuk janë konkurrenente.

Të nderuar kolegë, maksigrafi është një pajisje, siç e thashë se është nga koha e kaluar, atëherë kur humbja e një ndërmarrjeje është subvencionuar me fitimin e një tjetre dhe ne e dimë që pikërisht për shkak të këtyre problemeve sistemi si i tillë është bllokuar dhe ka kolapsuar. Maksigrafi mat maksimumin që e shfrytëzon një ndërmarrje, qoftë edhe në fillim të muajit, qoftë edhe vetëm për një ditë dhe atëherë KESCO e faturon ndërmarrjen, thua se ajo ka shpenzuar, e ka përdorur energjinë elektrike me atë maksimum. Edhe nëse ndërmarrja fare nuk punon 29 ditë tjera, fatura i vjen sikur ajo ta ketë përdorur energjinë elektrike maksimale, që ndonjëherë gjatë muajit e ka regjistruar maksigrafi.

Kategorizimi A+ i bën bizneset që ato të paguajnë shuma marramendëse, para kesh, avancë në KESCO, në mënyrë që ato të kategorizohen në A+, që të mos kenë reduktime pa paralajmërim, por bizneset raportojnë se këto reduktime ndodhin. Sektori i energjisë, për të cilin ne po flasim nuk është aspak i mirë, në fakt gjendja është rënduar me privatizimin e distribucionit nga kompania “Limak&Çalik”, e cila e ka në pronësi jo vetëm distribucionin, por edhe është pronare e 100%-të e aksioneve të KESCO-s, që është kompani e furnizimit, e që e ka komplet monopolin e furnizimit në treg, pavarësisht se ZRRE-ja del publikisht dhe thotë që ne e kemi bërë liberalizimin e tregut prej 1 prillit 2017.

Të nderuar kolegë,

Kur është bërë privatizimi i rrjetit shpërndarës më 2013 në mënyrë të mistershme janë privatizuar edhe katër hidrocentrale të vogla. Këto hidrocentrale në atë kohë kanë qenë të koncensionuara, me kontratën e privatizimit koncesionet kanë kaluar këto kontrata të koncesionit kanë kaluar te kompania turke dhe gjithashtu pas përfundimit të kontratave të koncesionit, sipas kontratës së privatizimit, kalojnë edhe asetet e katër hidrocentraleve.

Kapaciteti prodhues i energjisë elektrike të këtyre katër hidrocentraleve, në kohën kur është bërë privatizimi raportohet të ketë qenë 10 MW orë energji elektrike. Sot pas investimeve që i kanë bërë kompanitë private nëpërmjet kontratave të koncesionit, thuhet se kapaciteti i tyre është 14 MW energji elektrike.

Gjithashtu vlerësohet se përafërsisht vlera e këtyre katër hidrocentraleve është rreth 20 milionë eurove, ndërkohë që komplet Distribucioni me së bashku katër hidrocentralet është privatizuar

për 26,3 milionë euro. Kemi qenë në opozitë, e kemi kundërshtuar shumë, por s'kemi mundur asgjë të bëjmë nga pozicioni i opozitës.

Siç e përmenda, liberalizimi i tregut të energjisë që ka ndodhur nga viti 2017 është vetëm një farsë. Ne de facto kemi monopol të energjisë, sepse me kontratën e privatizimit që është bërë, e është privatizim i dëmshëm, askush nuk mund të arsyetohet, KEK-u e ka obligim që gjithë energjinë fillimisht t'ia japë KESCO-s, e cila është siç thashë 100% në pronësi të KEDS-it. Nëse KESCO nuk e dëshiron këtë sasi të energjisë, atëherë ajo mund t'ua japë të tjerëve, por siç e kemi parë, nga raportimet e ZRRE-së janë edhe pesë operatorë të tjerë të licencuar për furnizim me energji elektrike, asnjëri prej tyre nuk është funksional, sepse ata nuk mund të marrin energji nga KEK-u. KEK-u e ka obligim t'ia ofrojë vetëm KESCO-s dhe në rast se importojnë atëherë çmimi nuk është i leverdishëm dhe me këto kushte ata assesi nuk mund të gjejnë konsumatorë në Kosovë. De facto, ne kemi monopol të furnizimit dhe assesi nuk mund të bëjmë liberalizimin e tregut të energjisë.

I nderuar kryeministër,

Neni 114, nëse nuk gaboj, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit kërkon që Kosova të bëjë liberalizimin e tregut të energjisë dhe ja ku jemi këtu, po flasim për reduktimet. Pyetja është, pse? A është kjo përgjegjësi e KEK-ut, e KOSTT-it, e KEDS-it apo e KESCO-s, e cila është kompani private 100% në pronësi të KEDS-it.

Sipas informatave që ne kemi nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, KESCO e ka obligim ligjor furnizimin me energji elektrike bazuar në nominimet me KEK-un, të cilat bëhen një ditë më herët, do të thotë çdo ditë për ditën vijuese KESCO bën kontratë për furnizim me energji elektrike me KEK-un, i bën nominimet.

Në qoftë se KEK-u i tregon paraprakisht se s'ka aq energji sa kërkon, KESCO e ka për obligim që atë energji elektrike ta importojë, por gjithsesi t'i furnizojë të gjithë qytetarët dhe të gjitha bizneset në Kosovë.

Në këtë rast nuk ka asnjë problem, në fakt, nuk ishte dashur të ketë problem, ishte dashur që sa herë që KEK-u nuk prodhon me kapacitete të plota, KESCO ta importojë energjinë elektrike.

Në rast se paraqiten në KEK avari, domethënë kur KESCO i bën nominimet, e bën kërkesën paraprake dhe në ditën tjetër KEK-u nuk ka mundësi, sepse bie ndonjëra nga blloqet, siç edhe ndodh, atëherë këtu intervenon KOSTT-i, i cili në tetë orët e para të avarisë e ka për obligim t'i furnizojë qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse e tërheq rrymën drejtpërdrejt nga rrjeti interkonektiv dhe më vonë ia faturon KEK-ut.

Mirëpo, çfarë po ndodh? Ne e dimë që ka avari në KEK, por këto avari nuk janë kaq të shpeshta, ajo çfarë ne shohim është që KESCO nuk i bën llogaritë mirë për ditën vijuese se sa energji ka nevojë ose me qëllim nuk i bën mirë.

Të importojë nuk ka llogari, për shkak se çmimi është i shtrenjtë dhe i duhet ta paguajë po në kohën e importit me para kesh, atëherë në këtë formë, mënyra më e mirë dhe më e leverdishme për këtë kompani private është që të vijnë në shprehje reduktimet. Ato janë joligjore, janë të dënueshme nga Rregullatori i Energjisë, por KESCO i bën këto reduktime duke u thirrur në riparimin e rrjetit të distribucionit dhe po ia hedh këtë për mrekulli, sepse Zyra e Rregullatorit të Energjisë deklaron se ata i kanë kapacitetet e kufizuara për të inspektuar KESCO-n nëse me të vërtetë reduktimet në Kosovë po bëhen për shkak të mirëmbajtjes së rrjetit.

Në fakt, ne e dimë që nuk po ndodh ashtu. Sot ka reduktime gjithandej dhe ne nuk shohim punëtorët e kompanisë private që po investojnë në rrjet, domethënë reduktimet bëhen për t'i mbrojtur fitimet dhe për të mbrojtur kesh-in e kompanisë private.

Edhe një çështje tjetër që duhet të ngritët, është diskriminimi që u bëhet qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes reduktimeve.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë që më së paku reduktime ka në Prishtinë, jo pse kompania KESCO ka ndonjë respekt të veçantë për qytetarët e Prishtinës, por për shkak se këtu reagimi është shumë më i fortë, këtu është koncentrimi i klasës politike, i mediave dhe i të gjithë të tjerëve.

Ata të cilët sot ngelin më shumë në errësi, janë zonat rurale dhe komunat e tjera.

Të nderuar kolegë,

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës rekomandojmë që, në fakt, ZRRE-ja të punojë më shumë rreth inspektimeve. Ne rekomandojmë që shkycjet në emër të mirëmbajtjes që i bën KESCO fillimisht të aprovohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, gjithashtu kërkojmë nga ZRRE-ja të shqyrtojë reduktimet, çmimin e lartë të energjisë, tarifat verë-dimër, ku është bërë një shtrirje e çmimit të shtrenjtë në 12 muajt e vitit, menjëherë të kërkojmë të largohet maksigrafi nga të gjitha ato kompani, ku është i pranishëm dhe gjithashtu të mos lejohet më kategorizimi i qytetarëve dhe kategorizimi i bizneseve në A+, sepse nuk ka masa të monitorimit dhe ajo nuk implementohet, në fakt është shkelje e kontratave individuale që KESCO i ka me operatorët ekonomikë.

Besoj që në përfundim të debatit ne do të ulemi edhe me parashtruesit e interpelancës që të kontribuojmë me rekomandimet tona, ndërkohë që për çështje të tjera do të flasim në dy interpelancat e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e do fjalën, urdhëro!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, në shtator, edhe një herë e përsëris, gjendja në energji ka qenë ajo që e thashë më herët, të mos e rikthej.

Vërtet nuk po e them atë as të tregoj sa keq ka qenë, sa punë të madhe kemi bërë, po ka qenë ashtu, atë gjendje e kemi gjetur.

Nuk po kthehem prapa kush çka ka bërë që gjendja të mos jetë ashtu ose kush çka ka bërë që gjendja të jetë ashtu në energji, por e vërteta është ajo, dhe askush s'mund të ikë.

Ka disa probleme me energji në Kosovë, edhe janë serioze ato probleme.

Marrëdhëniet kontraktuale me shpërndarësin, KEDS-in, janë marrëdhënie të trashëguara, i kemi, i ka gjetur edhe qeveria para meje, i kam gjetur edhe unë.

Njëkohësisht rrjeti, investimet në rrjet, e dimë që janë proces jo i lehtë dhe nuk ka dikush që nuk e di në Kosovë sa humbim ne nga këto ndërprerje. Janë rreth 300 milionë humbje për sektorin privat pikërisht për shkak të ndërprerjeve, të mungesës së energjisë.

Nëse shkojmë me trendin çka ka bërë kjo Qeveri për këta shtatë muaj ose tetë, sa janë bërë, ka shpresë që më në fund kjo temë po zgjidhet.

Nëse e marrim parasysh që nga një vend që ka qenë i paraparë të bankrotojë në energji, vetëm të importojë, prapë po jua përsëris, kështu ka qenë, e sot prodhon energji, tani ballafaqohemi me marrëdhëniet me shpërndarësin, po edhe KOSTT-i, edhe ZRRE-ja janë organizatë që ju i mbikëqyrni, pra ju jeni pronarët e tyre, thirrni, pyetni, merrni raportimet e tyre. Unë do t'i mirëpres të gjeturat që i bëni dhe çfarëdo vendimesh që merrni lidhur me këto tema po ashtu do t'i zbatoj.

Ajo që po dua ta them është, për fat, çmimi i energjisë sot nuk është më i madh se sa çmimi i energjisë të ndonjë qeverie paraprake, cilëso qoftë.

Gjendja me furnizim me energji nuk po them që është më e mirë se sa në kohën e qeverive paraprake, por mos e harroni një gjë, ka mundur që të kishim energji të importuar, e paranë tonë ta nxirnim jashtë, fatmirësisht energjia është e Kosovës, dhe ky është dallimi, pra kjo është e vërteta.

Duke qenë kështu, nuk jam kundër që t'i gjejmë të gjitha ato mundësi ku mund të përmirësohet gjendja, edhe kudo që organi rregullativ dhe KOSTT-i gjejnë hapësira veprimi dhe i nxjerrin detyrat për Ekzekutivin, unë i zbatoj me respekt.

KRYESUESI: Faleminderit! Hykmete Bajrami ka replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Faleminderit, i nderuar kryeministër,

Edhe ne po kërkojmë përgjegjësi prej institucioneve, të cilat janë përgjegjëse.

Edhe unë e thashë që kemi qenë në opozitë në momentin kur është privatizuar distribucioni, rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike.

Por besoj që nuk duhet t'i pengojë askujt që të flasim për këto tema në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe personat që kanë qenë përgjegjës për nënshkrimin e një kontrate të tillë t'i bëjmë përgjegjës para institucioneve, të cilat duhet të kërkojnë përgjegjësi.

Kam kërkuar atëherë, gjatë kohës sa kemi qenë në qeverisje jam përballur çdo ditë me problemet e ndërmarrjeve private, kam ftuar në çdo takim që e kam pasur me biznese përfaqësues të KEDS-it, janë zgjidhur aty-këtu probleme individuale, por ne kërkojmë qasje shtetërore.

Unë isha e qartë, rekomandimet i bëra për Zyrës e Rregullatorit të Energjisë, sepse nga pozicioni i Qeverisë që e kemi pasur na kanë thënë që ne i raportojmë Kuvendit dhe jo Qeverisë.

Po dua t'ju them edhe një gjë, shpeshherë Qeveria ndërhyr në punën e institucioneve, të cilat i raportojnë Kuvendit. Nëse doni që t'ju bind me këtë, vendimi i vitit 2012 i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Vendimi nr. 399, i cili ka futur energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat e veriut si humbje politike, është bërë me kërkesë të ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në atë kohë, një vit përpara se të privatizohet distribucioni. E keni në arsyetim të vendimit krejt këtë çka po e them dhe thuhet "duhet ta rrisni nivelin e humbjeve të lejuara, sepse nëse e lëmë nivelin që ju e keni aprovuar paraprakisht, KEDS nuk mund t'i realizojë investimet e parapara", do të thotë Qeveria...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala. Urdhëro!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Ministër i Zhvillimit Ekonomik Lluka,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe ju të pranishëm,

Dua ta përsëris kryeministrin që tha më herët se tri interpelancat e kërkuara, interpelanca në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë, kërkuar nga Lëvizja Vetëvendosje, interpelanca pasuese në lidhje me ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro KOSTT-it për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji në katër komunat e veriut si dhe interpelanca tjetër, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë Contour Global, të gjitha këto kanë mundur të përfshiheshin në një debat të vetëm, mirëpo kjo të bënë të kuptosh se grupet parlamentare më tepër e kanë qëllimin të dalin në media dhe të flasin më shumë, sepse do të diskutojmë plot 9 orë në këto interpelanca dhe jam e bindur që do të kemi përsëritje në secilën, diku rreth 90%. Sidoqoftë, kështu ka vendosur Kryesia, kështu kanë vendosur nënshkrimet e deputetëve, është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit, uroj të dalë diçka e mirë dhe e hairit në këtë drejtim për qytetarët e Kosovës.

Po flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës natyrshëm shpreh shqetësim për reduktime të ashpra të energjisë elektrike që zakonisht ndodhin në kohën e pikut, në kohën e dimrit, në janar dhe shkurt dhe, siç e përmendi kërkuesi i interpelancës, tani jemi në fund të prillit dhe po i diskutojmë këto reduktime dhe këto reduktime nuk kanë ndodhur vetëm këtë vit, po prej pas luftës e tutje qytetarët e Kosovës përballen me reduktime të ashpra të energjisë elektrike. Ajo që është me e keqe, në një kohë ka qenë një skemë e reduktimit të ashtuquajtur A,B,C dhe që gjithmonë disa komuna, po e përmend unë në këtë rast, komunën prej të cilës vij unë, Drenasi, nuk ka qenë as në A, as në B as në C, po diku në Zh dhe qytetarët e asaj ane shumë pak kanë pasur rrymë, mund të them brenda shtatë ditëve, e mos të mos flas për brenda 24 orëve brenda një dite.

Tani këtu në kërkimin e interpelancës është theksuar, është potencuar se janë përballur disa komuna me këto reduktime të ashpra, siç janë Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj dhe Drenasi dhe fshatrat e tyre përreth, domethënë problemi po vjen duke u zvogëluar, po shpresoj, kështu po dua të shoh pozitivisht.

Të nderuar kolegë,

Që të jemi më seriozë në këtë çështje, duhet trokitur në derën e duhur. Ne e dimë shumë mirë se Kosova e ka bërë shthurjen e sistemit energjetik, ne i kemi disa institucione, të cilat merren me sektorin e energjisë, e të cilat kanë obligim ligjor të bashkëpunojnë mes vete dhe të ofrojnë zgjidhje për të plotësuar mozaikun e tërë kompleksit energjetik.

E kemi Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, e cila i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, e cila raporton një herë në vit, është si obligim kushtetues t'i raportojë Kuvendit për punën njëvjeçare të saj, mirëpo nuk ia ndalon askush Kuvendit dhe deputetëve që në çdo kohë, çdo herë edhe t'i vizitojë ata, po edhe t'i thërresë ata në raportim para deputetëve dhe para komisionit.

Po ndalem prapë te Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Ne si deputetë, siç e përmendi edhe kryeministri, së pari duhet të bëjmë me gisht prej vetvetes dhe të kërkojmë nga vetvetja se sa jemi në nivel të obligimeve tona? Së pari në relacion me qytetarin, i cili na ka besuar ta përfaqësojmë këtu. Po e them këtë qëllimisht, sepse Zyra e Rregullatorit të Energjisë gati një vit ka qenë në një vakum institucional, në mungesë të Bordit, për arsye se ky Kuvend, pa dashur t'i dalloj deputetët, e dinë të gjithë ata, nuk e ka parë të arsyeshme ta plotësojë Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, sikur ndodhi edhe sot, që e kemi të njëjtin institucion që i raporton Kuvendit, siç është AKP-ja, edhe ajo përballet me mungesë, ka vakum të plotësimit të Bordit dhe deputetët abstenuan për ta plotësuar atë vakum institucional.

Nesër, sigurisht, zoti kryeministër, do të të ftojme ty prapë këtu me nënshkrime e të të themi pse nuk po punon AKP-ja? Pse janë të gjitha ato ankesa? Pse janë ato të gjitha parregullsi? E ndërkohë që dëshirojmë ta drejtojmë gishtin e fajësisë diku tjetër, po jo nga vetvetja.

T'i kthehem sistemit energjetik. Është KOSTT-i, një institucion i rëndësishëm, i cili me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, nga prilli i vitit 2017, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe askush nuk na ndalon të kërkojmë llogari nga KOSTT-i dhe të marrim informacione të nevojshme, t'i zbërthejmë dhe t'i përkthejmë në gjuhën të cilën e kuptojnë edhe qytetarët e Kosovës, sepse unë këtu po vërej se është një gjuhë që qytetarët e Kosovës nuk e marrin shumë vesh, çka, kujt i faturohet rryma, amvisërisë, bizneseve, siç e përmendi një parafolës këtu, e unë po dua ta zbërthej në zhargonin popullor. Sipas koleges sime deputete po i bie që me ligj është e rregulluar që bizneset të paguajnë për qytetarët e thjeshtë për amvisëri, çka unë po kuptoj se po kërkon të kundërtën, e ndërkohë sigurisht që do të ishte e papërbalueshme ndoshta edhe për qytetarët e thjeshtë, edhe për konsumatorët e thjeshtë që energjinë elektrike e shfrytëzojnë vetëm për ndriçim dhe për asgjë tjetër.

Ne si deputetë ndoshta do të duhej në një kohë, kur ndryshojnë rrethanat, edhe ekonomike, të mendojmë fort mirë edhe për këtë çështje që të mos dëmtohen asnjëra palë, as bizneset, ose konsumatorët e mëdhenj energjetikë, e as konsumatorët e vegjël, siç janë qytetarët e thjeshtë. Në këtë drejtim, në kompleksitetin e sistemit energjetik, është edhe KEDS-i, i cili është i obliguar t'i furnizojë me energji, është edhe KEK-u, më pastaj janë institucione shumë të rëndësishme Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila i zhvillon, i bën politikat për energjinë elektrike si dhe është Kuvendi që është i obliguar t'i mbikëqyrë edhe Qeverinë, edhe këta dy mekanizma ose agjenci të pavarura që i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.

Shumë jam e bindur që do të pajtoheni edhe ju se përmes fjalës tonë, që të mos them përmes zhurmës që do ta bëjmë në Kuvend, nuk zgjidhen problemet e qytetarëve të Kosovës.

Mosvotimi, po i kthehem edhe një herë, apo më mirë të thuhet pengesa për t'i plotësuar ato vende, që është detyrë e parë e deputetëve, në institucione të pavarura, neve do të duhej të na

bënte shumë të ndërgjegjshëm dhe të mos kërkonim nga dikush tjetër pse nuk është në rregull kjo apo ajo punë?

Partia Demokratike e Kosovës është shumë e bindur se pavarësia energjetike është një shtyllë shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës që do të nënkuptonte edhe një farë pavarësie ekonomike.

Dhe, lufta jonë bashkërisht, edhe si deputetë, edhe si institucione qeveritare, do të duhej të ishte në këtë drejtim, që të krijojmë pavarësi, të mos kërkojmë pavarësi tjetër. Ne e dimë shumë mirë, edhe me rastin e problemeve që ballafaqohet KOSTT-i, që është një interpelancë në vazhdim, se çka do të thotë, çfarë lobimi të fuqishëm bëjnë të tjerët që neve të na e krijojnë një varësi energjetike, e pastaj të luajnë me neve si të donë, të na lënë një ditë krejt edhe në terr dhe të mos mund as të diskutojmë e t'i shpërfaqim shqetësimet tona.

Ne si Kuvend duhet ta mbajmë natyrisht të përgjegjshëm, por edhe ta vlerësojmë punën e institucioneve të pavarura, siç është Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe KOSTT-i. Në komisionin parlamentar e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2017, që pritet të vijë edhe në seancë dhe të diskutohet, dhe do të përsëriten sigurisht të njëjtat çështje.

Unë, për hir të opinionit publik dhe qytetarëve, do ta sjell këtu të shkëputur një pjesë nga raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që është faqe 40 për deputetët, të cilët e kanë shqyrtuar këtë raport që ka të bëjë me monitorimin e ndërprerjeve të energjisë elektrike. Natyrisht që këtu flitet për vitin 2017, mirëpo ne prej pasluftës ballafaqohemi me të njëjta ndërprerje të energjisë elektrike.

Dhe, në këtë faqe thuhet se “bazuar në të gjeturat nga monitorimi i ndërprerjes së energjisë elektrike për muajt tetor, nëntor të një viti paraprak, 2016, ZRRE-ja e ka përgatitur një raport, i cili së bashku me shkresën përcjellëse të Rregullatorit në pajtim me rregullat, përmasat administrative dhe gjobat i është dërguar KEDS-it që t'i mundësohet komentimi dhe eventualisht kundërshtimi i të gjeturave.

Bordi, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjigjeve ndaj raportit të Rregullatorit lidhur me inspektimin e ndërprerjeve të planifikuara, sepse KEDS-i, siç e përmendi edhe kryeministri, e siç e dimë edhe ne, planifikon reduktimet, mirëpo në bazë të këtij hulumtimi të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka dalë se shpesh KEDS-i ka bërë reduktime të atilla, të paplanifikuara, dhe është arsyetuar para ZRRE-së se është neglizhencë e punëtorëve të tij, për çka qytetarët e Kosovës nuk kanë faj dhe secili duhet ta marrë përgjegjësinë mbi vete që e ka edhe të përshkruar me ligj.

Kështu Bordi në asnjë rast dhe në asnjë fakt nuk ka mundur, në fakt, KEDS-i nuk ka mundur t'i kundërshtojë argumentet e gjetura të raportit të Rregullatorit dhe në një mbledhje të mbajtur ka nxjerrë njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për ndërprerjet e planifikuara të ndërmarra nga ana KEDS-i, në këtë mënyrë, konform dispozitave ligjore, të dhëna me Ligjin për rregullatorin e energjisë dhe të rregullës për masat administrative dhe gjoba, ZRRE ka marrë vendim mbi shqiptimin e gjobës ndaj kompanisë kosovare të distribuimit me energji elektrike, KEDS, për shkeljet e bëra gjatë ndërprerjeve të energjisë elektrike në shumën prej 45 mijë eurosh.

Është e vërtetë se numri i ankesave të paraqitura në ZRRE-ja nga ana e konsumatorëve është në rënie e sipër. Ne jemi dëshmitarë të asaj se çfarë reduktimesh të ashpra ka pasur në vitet 2014, 2015, 2016, e kështu me radhë.

Krejt është e natyrshme që edhe numri i ankesave vjen duke u zvogëluar.

Po ajo që ne si deputetë na takon është të dimë se si po analizohen ato ankesa, si po përfundojnë dhe cila është përgjigjja ndaj konsumatorëve të dëmtuar?

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të kisha dëshiruar ta zgjas më shumë, vetëm se kërkoj që të gjithë bashkërisht të jemi unikë, sepse ne jemi këtu për qytetarët e Kosovës, pa dallim ngjyrimeve politike duhet të punojmë bashkërisht.

Unë me një koleg timin, me Dardan Sejdiun, sapo jemi kthyer nga një takim i rëndësishëm nga Brukseli, atje nuk pyesin në cilën parti je, po Kosova merr poenë negativë. Natyrisht që së pari duhet të jemi ne të përgjegjshëm, edhe si individ, edhe si institucione të punojmë bashkërisht dhe pastaj kemi kohë dhe mënyra të tjera se si t'i bindim qytetarët për të na votuar dhe besuar.

Në këto tema jam e bindur se nuk do t'ia mbushim mendjen ndonjë qytetari të thotë që unë jam më i mirë apo jo, qytetarëve ua mbushim mendjen duke punuar për ta për çdo ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Albin Kurti në emër të grupit e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Kabinet i Qeverisë,

Kosova aktualisht nuk e ka një strategji zhvillimore, për të cilën do të kishin punuar dhe dakorduar qoftë subjektet politike, qoftë profesionistët më të shquar të vendit.

Mospasja e strategjisë zhvillimore na ka sjellë në pikën që në 10 vjetët e fundit kemi lëvizur nga ndërtimi i kapaciteteve të reja prej 3 000MW, tek ato që po pretendohen tani me kontratën abuzive me Contour Global, në 500MW.

Shtrohet pyetja, sa kapacitete të reja i duhen Kosovës, jo për vitin në vijim, por për 20 vjetët e ardhshme? Sa furnizim do t'i nevojitet industrisë minerare dhe si do ta kemi këtë industri? Sa furnizim do t'i nevojitet industrisë ushqimore të prodhimit dhe bujqësisë? Dhe, si do t'i kemi këta sektorë? Sipërmarrjet, popullsia në përgjithësi si konsumatore, e kështu me radhë?

Në Kosovë, energjia e cila shpenzohet për amvisëri është 7-8 herë më e madhe sesa ajo për industri. Ndërkaq, në Maqedoninë fqinje ky raport është përgjysmë, pra 50% : 50%. Pa një strategji zhvillimore nuk mund të bësh asnjëherë planifikim të duhur të sektorit energjetik, qoftë atëherë kur ndërton, apo atëherë kur dëshiron të furnizosh në mënyrë të rregullt.

Për këto dhe për përgjigjet e tjera, qeveritë, të paktën nga viti 2008 e këtej, kanë qenë shumë shpesh jo vetëm të paqarta, por edhe të dëmshme. Në vend se të ndërtohej politikë me kah zhvillimor, pushteti e privatizoi një pjesë shumë të rëndësishme të KEK-ut, Rrjetin e Shpërndarjes, por edhe Furnizimin madje. Pasojat e këtij veprimi i vuajmë edhe sot e kësaj dite.

Në vend se të hartonte planet zhvillimore të sektorit të energjisë, vijojnë të hartohen strategji ku planifikohet dekomisionimi i Kosovës A pa asnjë planifikim serioz se ku do ta gjejmë energjinë elektrike në ndërkohë.

Në vend se të mobilizohen fondet publike për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese energjetike dhe jo vetëm për autostrada, nënshkruhet një kontratë, e cila i shkakton dëme të mëdha Kosovës dhe atë me një privat, të cilit nuk ia dimë as pronarin, as strukturën e kapitalit, e as prejardhjen e tij. E, dëmet janë së paku të trefishta:

1. Rritja enorme e çmimit të energjisë elektrike;
2. Falja e tokës, me ç'rast 15 hektarë tokë pronë të KEK-ut shitet për vetëm 10 euro një kompanie private, dhe
3. Shteti e merr tërësisht përsipër rrezikun dhe në të njëjtën kohë ia garanton edhe shitjen e plotë të prodhimit privatit, edhe fitimin prej 18,5% të shkallës së kthimit të brendshëm në kapital.

Duhet të thuhet se aktualisht në Qeverinë e Kosovës nuk ka kapacitet njerëzor në nivel politik e profesional që e njeh sektorin e energjetikës, e aq më pak që është autoritet në këtë fushë. Profesionalistët më të zotë të Kosovës në energjetikë janë jashtë sistemit publik. Avni Kurshumliu u nda nga kjo jetë, duke u përpjekur zyrë më zyrë për t'u treguar qeveritarëve tanë, madje dhe

ish-bashkëpartiakëve të tij nga LDK-ja se është në interes të Kosovës rindërtimi i Kosovës A. Dhjetëra profesionistë të tjerë prej vitesh kanë dhënë zgjidhje e formula sesi duhet të ecën përpara Kosova në energjetikë.

Pikërisht mendimi dhe studimet e tyre nuk u morën parasysh. Ndodhi e kundërta. Çdoherë u bënë plane financiare-okulte të zhvatjes nga kamionët që heqin djerrinën, e njohin shumë mirë këtë temë deputetë e ish-deputetë të partisë në pushtet, të partisë-shtet, dhe jo vetëm, mandej te shitja e energjisë elektrike këtë më së mirë e njeh kushëriri i presidentit aktual, Nijazi Thaçi, zyrtar shumëvjeçar në KEK, e deri tek importi i energjisë elektrike, fusha ku më së shumti janë të ngatërruara lidhjet biznese në dëm të Kosovës me Serbinë, në kuadër të asaj që do të mund ta quanin mafi energjetike ballkanike.

Asnjë bord i KEK-ut, përfshirë edhe atë kohë kur drejtohej nga ndërkombëtarët, nuk ka pasur guxim t’u bëjë ballë zhvatjeve të tilla. Përkundrazi, të gjithë, gati pa asnjë përjashtim, më së paku kanë përfituar nga marrja me çmim prej 10 euro metri katror të banesave, dikur në pronësi shoqërore të KEK-ut, e më së shumti janë bërë aksionar pasi kanë qenë sekserë të blerjes e shitjes së energjisë, karburantit që përdoret për punën në termocentrale dhe tenderëve multimilionësh të riparimeve në elektrana.

Prej më shumë se 7 vjetësh i kemi dëgjuar deklaratimet e zotimet se në këtë muaj e atë muaj do të fillojë nga operimi Interkonjeksioni me Shqipërinë. Njëherë u justifikuan që Shqipëria po e vonon ndërtimin, por ja që Shqipëria e përfundoi atë. Ka tre vjet që deklarohet se së shpejti do ta zgjidhim këtë ngërç. Por, në vend të zgjidhjes, kjo çështje shkoi në negociata teknike e politike në Bruksel. Prej andej, në vitet 2015-2016, negociatorja bashkë me ish-drejtuesit e KOSTT-it, të shoqëruar edhe me përfaqësues të KEDS/KESCO deklaruan se “u caktua kufiri energjetik” Kosovë-Serbi. Por, pak kohë pas këtyre deklaratimeve, u pa qartë se asnjë kufi nuk ishte vendosur. Përkundrazi, ishte premtuar hapja e “Elektro-Severit”, kompanisë shtetërore të Serbisë që donte të licencohej në Kosovë si kompani paralele me gjithë sistemin energjetik të Kosovës. Po ashtu, u pa qartë se Serbia, edhe pse ra dakord sipas negociatorëve se po të pranohej “Elektro-Sever” do ta lejonte anëtarësimin e Kosovës në ENTSO-E, pra rrjetin evropian të Operatorëve të Transmetimit, kjo nuk ndodhi. Madje, Serbia kundërshtoi edhe më fort pas kësaj.

Kosova dhe Shqipëria kanë marrë kredi për ta ndërtuar interkonjeksionin nga KfW, por ky sistem ende nuk është në punë. Në këto kushte Kosovës ia bën rregullimin sekondar të energjisë Serbia, sepse, siç e dimë, energjia që prodhohet nga qymyri ka nevojë për t’u balancuar në rrjet nga një burim i prodhimit të energjisë së prodhuar nga uji apo burime të tjera. E, Kosova vetë nuk e ka këtë mundësi. Për këtë shërbim të deklaruar, Serbia nuk e ka paguar gati kurrë transitin për eksportin e importin e energjisë nëpërmjet Kosovës.

Përveç kësaj humbjeje të madhe, varshmëria e sistemit energjetik të Kosovës nga Serbia, nuk po ndalet edhe 10 vjet pas pavarësisë. Në vend se ne sot të ishim duke e ndërtuar kompaninë e përbashkët Shqipëri-Kosovë për prodhimin e energjisë elektrike dhe tregun e përbashkët të saj, ne ende jemi duke u marrë me çështjen se ku është kufiri energjetik i Kosovës.

Në këtë kuptim, sa herë që sistemi i prodhimit në Kosovë ka avari, e këto po bëhen gjithnjë e më të shpeshta nga mosmenaxhimi i duhur, Operatori i Sistemit blen energji me çmime shumë shpesh tepër të larta, meqë “avaria” nuk “dihet kur ndodh”. Në vend të kësaj, sistemi do të duhej të ishte i mbrojtur nga sistemi energjetik i Shqipërisë, sistem i cili do ta furnizonte menjëherë Kosovën në çfarëdo rrethane e për çfarëdo emergjence.

Po ashtu, mosplanifikimi i duhur i importit të energjisë referuar kushteve aktuale të prodhimit dhe gjendjes që ka Kosova është i pajustificueshëm. Çfarë detyre tjetër kanë këto institucione që paguhen kaq bujarisht nga të ardhurat publike, përpos që të bëjnë planifikimin e importit të energjisë, ta kontraktojnë atë, për shembull, me kontrata afatgjate me Shqipërinë, me çmime të favorshme, të cilat sigurohen nga kontraktimi me kohë? Prodhimi i energjisë nga qymyri ka edhe avantazhe tjera, përveç çmimit të lirë të supozuar. Madje, avantazhi kryesor është që të dihet saktë sa prodhon dhe sa mbulon nga kërkesat e rrjetit për secilën periudhë të vitit energjetik.

Pra, Kosova me këtë sistem që ka, në parim do të duhej ta dinte saktë se sa do të importojë për çdo vit. Ky sistem nuk varet nga kushtet klimatike, por nga planifikimi shkencor e teknologjik i punës së secilit termocentral, planeve të tyre të remontit, nxjerrjes dhe përpunimit të qymyrit dhe politikave menaxheriale të drejtuesve të KEK-ut. Çdo dalje nga ky kalendar është më së paku mungesë e thellë profesionalizmi, e, siç e dimë të gjithë, edhe një aferë e re në kurriz të vetë KEK-ut dhe ekonomisë sonë. Kjo situatë është duke u komplikuar më tej me kontratën famëkeqe të Contour Global. Nga ky lloj i kontratës dilet në përfundim se çmimi i supozuar i energjisë ka për t'u rritur.

Aktualisht, kostoja e operimit të “Kosova A” dhe “Kosova B”, që nënkupton çmimin e energjisë elektrike, është në nivelin e 28,93 euro për MWh. Në rast se nuk ndërtohet termocentrali i ri dhe kapaciteti prodhues mbetet ky që është tani, por me përllogaritje të normës së inflacionit prej 3%, çmimi i energjisë elektrike deri në vitin 2021 do të arrijë deri në 33,53 euro për MWh. Kontrata me Contour Global parasheh çmimin prej 80 euro/MWh të energjisë elektrike. Kjo është alarmante dhe e papranueshme. Çmimi mesatar vjetor i importit të energjisë për këto 7 vjet ka qenë 59 euro.

Të nderuar deputetë,

Ka kuptim të eksploatohet toka e Kosovës, të merret barra e zhvendosjes së fshatrave të tëra, të rrezikohet megjithatë edhe me ambient, edhe me shëndet, me justifikimin se në popullsinë tonë të varfër çmimi i energjisë elektrike del shumë më lirë se importi dhe jemi të kushtëzuar fatalisht.

Por, nëse ne e lejojmë një kontratë të tillë do të bënim një atentat total ndaj gjithë sistemit energjetik të Kosovës. Sepse, do të përfundojmë duke prodhuar energji elektrike, madje edhe shumë më të lartë sesa çmimi i importit.

U përmend se duhet të bëhet shpronësimi dhe kur kemi bërë shpronësimin për autostradë, përse të mos bëjmë edhe shpronësime për ndërtimin qoftë të kapaciteteve energjetike, apo të këtilla kur duam t'i zgjerojmë mihjet për të prodhuar. Por, e dimë prej raporteve të ndryshme, jo vetëm mediave, se bëhet fjalë, jo vetëm për banorë të hershëm, por bëhet fjalë edhe për zaptues të vonshëm. Dhe, shpronësimi nuk do të duhej t'i barazonte të gjithë ata. Nuk është e drejtë t'u thuhet që po e shpronësojmë dikë, i cili është për dekada të tëra banor në atë vend, sikur dikë i cili pas vitit 2009 shpejt e shpejt e ndërtoi një shtëpi, në mënyrë që ta bëjë këtë dallaveren, i cili i legjitimohet, e madje edhe i shpërblehet me shpronësimin aktual. Ato rreth 260 shtëpi, sa janë, nëse nuk gaboj, duhet trajtuar rast pas rasti, sepse është padrejtësi shtesë që u bëhet nëse të gjithë barazohen njësoj, pavarësisht nëse janë banorë të hershëm, apo zaptues të vonshëm.

Kur vraponin ish-ministri Beqaj e ish-kryeministri Thaçi për të privatizuar KEDS/KESCO, propaganda në të gjitha mjetet e komunikimit publik, por sidomos në foltoren e Kuvendit, ishte kjo: “Vetëm me privatizimin e rrjetit do të sigurojmë:

1. Uljen e humbjeve teknike dhe ‘komerciale’, pra vjedhjet;
2. Investimet e nevojshme në rrjet;
3. Furnizim të pandërprerë me energji elektrike”.

Asnjëra prej këtyre nuk është arritur. Përkundrazi, secila prej këtyre çështjeve ka degraduar dhe ka nxitur problemeve të reja.

Furnizimi me energji elektrike nuk po garantohet. Përkundrazi, çdo vit thellohet ky problem, siç e pamë dhe gjatë muajve me temperatura të ulëta, fshatrat tona po mbeten gjithnjë e më keq të furnizuara. Aty nuk po bëhen investime, sepse kompania private nuk ka interes që për shembull për 10 shtëpi të vendosë trafo të re apo të bëjë ndonjë investim. Sepse, kompania private, siç e kemi thënë edhe në vitin 2012, kur urdhërohej rrahja dhe arrestimi i deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje që protestonin kundër shitjes së Distribucionit dhe Furnizimit, ajo kompani private pra e sheh vetëm “faturën”, e mandej i bën llogaritë nëse ka interes në një zonë, apo jo. Problemi është se kush e mbron interesin tonë që në çdo fshat e zonë të Kosovës të ketë dritë, të ketë ngrohje e të ketë rrjet?

Privatizuesi, jo! Rregullatori, jo! Qeveria, jo se jo! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Prezantimin e zotit Kurti, në periudhat kohore që i përmendi, e kam zor ta përcjell në të gjitha ato periudha, mirëpo janë disa konstatime paqëndrueshme për periudhën kohore kaq mujore sa jemi këtu dhe habitem që ky s’di ta bëjë shkoqitjen hiç. E di që di, por habitem që s’ka pak guxim politik ta bëjë njëfarë shkoqitje. Të thotë “po, kemi dëgjuar që s’ka pasur qymyr, që kemi pasur për të bankrotuar në energji, e që kemi pasur të importojmë nga diku dhe që ka qenë gjendja ashtu në këtë vend dhe që të kemi parë kryetar i Qeverisë, që në emrin tim, pra edhe tuajin, ke shkuar, ke qëndruar me ata njerëz atje, në mensë”. Kemi fol, njerëz të këtij vendi, kemi bërë dert, kemi gjetur një dalje.

Nuk e kuptoj pse s’guxoni ta përmendni a ta thoni se e keni parë në medie, e keni dëgjuar në televizion, keni dëgjuar njerëz... Unë i kuptoj krejt, veç nuk e kuptoj qysh dikush mund t’ia ndjellë ose të lutet për vendin e vet që të mos prodhojë energji e të importojë! E qysh nuk e kupton që kjo i ka ndodhur vendit të vet, shyqyr Kosova po prodhon energji, kurse probleme ka, se i kemi trashëguar që 20 vjet dhe bukur zor e kemi që t’i qesim krejt në të terur. Duhet t’i grahim punës për ta bërë këtë. Po më habit kjo, më besoni! S’di qysh dikush mundet pa e parë, pa e konstatua, pa e ditë që kjo ka ndodhur. Të thuhet pastaj që është abuzive kontrata me Contour Global, shikoni, hyni pak kalkulimeve, unë nuk e di kush po jua jep këto të dhëna e këto kalkulime, por hyni pak e shihni. E di Dardan, e ke rendin, por ta kanë marrë këta kolegët tu, ta kanë marrë temën krejt.. e harxhuan, s’di sa ka për të të mbetur. Mirëpo, shikoni ç’është problemi i Kosovës, për t’i thjeshtësuar gjërat shumë më së shumti. U tha që Kosova s’ka strategji. Në fakt, ne kemi shkruar plot strategji, por problemi ka qenë te zbatimi i tyre, te kapaciteti zbatues, ose te fuqia jonë, se strategji plot kemi. Nuk ka qeveri që s’e ka bërë nga një, dyvjeçare, trevjeçare, shtatëvjeçare, sa të duash kemi. Problemi është te zbatimi. Pse nuk është zbatuar 2000-shi e 1000-shi, pse kemi mbërrirë në 500? Mos e harroni një gjë, por të mos e bënim i këtë, do të kishim mbetur pa asnjë.

Se gradualisht është duke u hequr interesimi për investim në qymyr. Disa institucione monetare nuk kanë pasur hiç ndërmend të na e japin kredinë sikur të mos e nënshkruanin vjet me investitorët, në këtë rast. Nuk e kuptoj unë koston, çmimin të gjithë e kemi shqetësim, edhe të rrezikuar jemi edhe tash për rritje të çmimit, kemi luftuar të mos rritet çmimi gjatë gjithë kësaj kohe, por mos harroni që ne kemi importuar rrymë gjatë kësaj kohe me çmim më të shtrenjtë sesa do ta prodhohim ne vetë. Pra, gjatë këtij dimri kemi importuar rrymë me çmim më të shtrenjtë sesa ajo që e prodhojmë ndonjëherë. Për ta siguruar një pavarësi energjetike, ajo është edhe sovranitet. Ajo është edhe integritet territorial pastaj, se shumë pasoja që i kemi sot e interkonjeksion, devijimet e dini pse po vijnë, i kemi pas kaq vjet tash, kanë dalë në lëndinë, jemi duke u ballafaquar me to. Keni të drejtë aty kur folët për ndërhyrjet në tregun e energjisë. Është e vërtetë, jemi duke i sanuar nëse mbërrijmë, na duhet edhe pak kohë, kohë s’po na vyen po s’po mbërrijmë ta kryejmë më shpejt, se do të duhej të kryhet më herët.

Por, ju lutem, kam mirëkuptim për plot defekte në proces, në temën e energjisë ka vend për kritikë. Pak a shumë nuk po arrijmë që ta kuptojmë kujt po i dhemb edhe ku po i dhemb, besoni s'po ju rrej, po habitem ku po ju dhemb, vëlla, kur kemi ardhur në shtator, kam shkuar në KEK, më kanë thënë “zotëri, s'kemi qymyr, nuk kemi qymyr, s'ka qymyr, shiko sipërfaqen, ja ku janë shtëpitë, të gjitha autoritetet ju kanë thënë s'guxoni të mihni te shtëpia atje”. Atë gjendje e kam gjetur unë. Ajo ka qenë Kosova jote, e imja, e gjithkujt. Në atë Kosovë ashtu, duke qëndruar me ata njerëz, duke bërë çka duhet, kemi mbërri t'i zhvendosim ata njerëz, kemi mbërri të mihim, po prodhojmë, e ndoshta një ditë do të kemi ndonjë rezervë shtesë dhe do të mund edhe të eksportojmë qymyr. Pra, kjo është e vërteta që ka ndodhur gjatë kësaj qeverie, nëse do ta pranojë dikush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka kërkuar fjalën për replikë.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Së pari, ne kemi pikëpamje shumë të ndryshme. Ju e dini që nuk besoj që kjo Qeveri është e re qysh mendoni ju që është e re. Në mandatin e kaluar, në legjislaturën e pestë shteti ishte i kapur, dhe unë vazhdoj të besoj që është ende shteti i kapur. Dhe, për mua kjo nuk është një Qeveri e ri. Mund të ketë fytyra tjera, por fytyrat tjera nuk e bëjnë qeverisjen tjetër. Këtu kanë defiluar si në sfilatë ministra e kryeministra, por orientimi s'ka ndryshuar.

Unë nuk jam në Kuvend për t'i vlerësuar fytyrat, por politikat, dhe ato s'po i shoh duke ndryshuar. E minimumi çka është dashur të bëni ju, që thoni jeni kryeministër tjetër fare, krimin e organizuar paraprak është dashur ta denonconi me emër, mbiemër, shifra, data. Nuk e keni bërë. Nuk e keni bërë! A di çfarë arkivi të krimin ka në Qeverinë e Kosovës? Është detyrë e juaj si kryeministër i ri që ta denonconi, t'i hapni dosjet dhe të fillojë të veprojë Prokuroria. Ju e keni marrë njëfarë mënyre stafetën në të njëjtin rreth, e po thoni “a s'po më shihni që e kam fanellën ndryshe?”. Për mua s'është e rëndësishme, rrethi i njëjtë, ajo stafetë. Nuk është as reformë, e lëre më transformim, për të cilin ka nevojë vendi. Ky është ndryshim i madh për ju, se jeni ulur në karrigen e kryeministrit, por jo për Kosovën. Ju po dëshironi që ndryshimi që ju ka ndodhur juve të na e bartni krejt neve. Jo, për neve s'ka ndryshim, ka ndryshim për juve, keni qenë në atë ulëse, keni ardhur në këtë ulësen këtu. Po, kjo s'ka të bëjë me neve, s'ka të bëjë me vendin, me popullin, me politikat, po orientimin, dhe unë të vlerësoj këtu.

Dhe, më falni se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Po, mund nga koha e grupit parlamentar. Ju lutem, ia vazhdoni kohën!

ALBIN KURTI: Strategjia energjetike në Kosovë ka ardhur në Kuvend, pasi është nënshkruar marrëveshja me Contour Globalin. Kjo tregon çfarë respekti, përkatësisht mungese të respektit kemi ne për strategjinë, të cilën vetë e përpilojmë. Marrëveshja me Contour Globalin është nënshkruar në dhjetor të vitit të kaluar, strategjia energjetike ka ardhur në këtë vit, kjo s'ka kurrfarë kuptimi. Pra, unë nuk po kërkoj veç të na respektoni ne, por respektojeni edhe veten pak më shumë, sepse nëse ju nënshkruani një herë një marrëveshje me Contour Globalin 1,3 miliard euro, prej të cilëve Contour Globali ka veç 300 milionë, e për 1 miliard i vyen garancia e shtetit tonë, në të cilën po del që Contour Globali beson më shumë se ne vetë, se ne nuk po i mobilizojmë fondet publike, po themi "hajde privat, na shpëto ti ne prej vetvetes sonë", e pastaj vjen njëfarë strategjie energjetike, kësaj i thonë zero me xhufkë. Zeroja e me xhufkë, megjithatë është zero, edhe pse e ka xhufkën.

Dhe, në fund, natyrisht që duhet të bëhen ato shpronësime. Unë vetëm bëra thirrje që shpronësimet të mos barazohen. Ata njerëz, të cilët do të kompensohen nuk janë të barabartë, ka midis tyre njerëz të ndershëm që janë banorë të hershëm dhe ka zaptues të vonshëm, që nuk do të duhej t'u jepej kompensimi material, por përkundrazi të fillojnë procese të drejtësisë ndaj tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Po, kryeministër e keni fjalën përsëri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Albin, shumë i mirë je në punën tënde, edhe ta pranoj në shumë drejtime, por ka diçka që s'po qëndron. Dole të flasësh për ndryshim, fole për ulëse; një andej, një këndej. Mirë, ke të drejtë, por nëse po flasim për temën e energjisë, ka ndryshuar Qeveria o Albin Kurti, kanë ndryshuar kolegë qytetarët e Kosovës. Kanë ndryshuar, po ti s'po donë ta shohësh, se s'mund ta shohësh, se ke probleme për ta parë. Nuk është veç problemi i ulëseve, por është problemi që një punë që ka ndodhur në këtë vend s'po mbërrin ta shohësh.

Nëse trendi i qeverisjeve deri në ardhjen time ka qenë që Kosova të mbetet pa qymyr për të prodhuar energji e pa njerëz të vendosur, me ditën time ka ndryshuar. E ka pa krejt kjo Kosovë, e kanë parë krejt ata që i janë gëzuar, edhe ata që s'i janë gëzuar, se ka që s'iu kanë gëzuar asaj që Kosova nuk po importon, por po prodhon. Është e drejtë e jotja të mos e shohësh, por qytetarët, populli, Kosova e kanë parë që ka ndodhur kjo dhe është e vërtetë që ka ndodhur, dhe është ndryshim. Kush është dëmtuar me këtë rast? Ndoshta ndonjë sektor i krimit, e kam përshtypjen që mund të jeni të lidhur me ta, se po ju dhemb. Jo, besoni, dikush po, se dikujt është kah i dhemb që Kosova po prodhon energji e s'po importon, e ndoshta këta importuesit paskan qenë diku të lidhur me ju, se nuk ke guxim...

Po s'po di burrë, ti s'po e sheh, po dyshoj, unë veç po dyshoj, s'po di emra, besom po t'i dija do t'i thosha, një sikur ta di ta them. Veç pasi s'po ke guxim ta pranosh që ka ndodhur kjo, paske ndonjë hile, ndonjë sponsorizim dikah, s'po di prej atyre fondacioneve të largëta që po thirren në

mbrojtje të ambientit, ndërsa e di që s'e kanë për ambient, por kanë të bëjnë për diçka tjetër, se kanë dashur që ne të blejmë rrymë prej disa tjerëve. Edhe unë e shoh që është ai ndikim.

Dëgjo, veç një sekondë! Shumë thjesht është: Në energji ka ndryshuar! Nëse në temat tjera jo, në energji ka ndryshuar. Pra, një trend të energjisë që e keni pasur dhe këtu keni qenë ju, keni mundur edhe atëherë ta ngrini zërin, pse ka qenë kështu? Shiko, a e di si e kam marrë vesh unë këtë? Më kanë ardhur prej NATO-së, prej instancave të sigurisë të krejt vendit, krejt të jashtmit më kanë thënë Eshiko se je në bankrot energjetik, se filan ditën mbyllet.

Kam mbajtur takime në gjysmë të natës atje, që të mos ndodhë bankroti, të mos konkludohet që s'po prodhon Kosova. Ky është ndryshim substancial i vërtetë, ka ndodhur. Vazhdo të mos e shohësh, por janë dy milionë njerëz që e dinë që ka ndodhur.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti, ju keni të drejtë ta merrni prapë fjalën, por nga koha e grupit tuaj parlamentar. Sipas Rregullores, gjatë interpelancave ka të drejtë ta marrë kohën e grupit parlamentar, sa herë ta kërkojë fjalën.

ALBIN KURTI: Së pari, kryeministri po thotë se “ka pasur të ndodhë bankroti, e unë e kam parandaluar”. Unë besoj që kur vijmë në një zgrip të tillë, secili kryeministër do ta bënte këtë, sepse s'kishim ku të shkojmë më në fund, sepse kishim mbërri në fund. Fundi të ka qëlluar në mandatin tënd, edhe e bëre. Cilido të kishte qëlluar në mandat do ta kishte bërë më në fund, por kjo është tepër vonë, tepër pak. Kjo për mua është brengosëse, sepse kjo tregon sa të ulëta i keni ambiciet për vendin. “Unë e kam parandaluar apokalipsin!” Po, edhe dy dekada pas çlirimit të Kosovës e një dekadë pas shpalljes së pavarësisë ne t'i gëzohemi si sukcesi të madh mbijetesës, a? Mungesës së bankrotit t'i gëzohemi si sukses, a? Këto janë pritje dhe ambicie shumë të vogla për vendin.

Por, fatkeqësia e këtij vendi është që politikanët tonë në Kosovë kanë ambicie shumë të mëdha për vete, e për vendin i kanë të vogla. Vendi veç të mos bankrotojë, e unë të ngjitem ku s'ka më lart, ky është problemi. Le t'i kemi ambiciet e mëdha për vendin, e le t'i kemi ambiciet e vogla individuale, atëherë bëhet progresi dhe atëherë do ta kemi zhvillimin, i cili qëndron.

KRYESUESI: Kryeministër, e keni prapë fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, te ambiciet, besoj që të gjithë i kemi nga pak, dikush më shumë, dikush më pak, të gjithë i maskojmë me diçka. Dikush i maskon me një barazi sociale, t'u japë të gjithëve nga pak për t'i kënaqur të gjithë, dikush i takon një spektri politik, jam deklaruar me vullnet vetë i djathtë politik për të krijuar profit, për t'i lejuar njerëzit të krijojnë, për t'u zhvilluar e të ecën vendi. Edhe i respektoj ata që e zbatojnë teorinë e barazisë sociale, se mendoj që është në rregull.

Mirëpo, të thuash se është ambicie e vogël që ta ndalësh bankrotin energjetik, domethënë sa pa ndjenjë je ndaj asaj teme. Nuk është e vogël, zotëri, nuk është e vogël. S'ka pasur të keqe më të madhe që ka mundur të ndodhë në atë kohë dhe s'ka pasur ngjarje më të mirë që ke mundur t'ia japësh vendit tënd atë ditë. Në fakt, nuk është një ditë, se ende nuk është kryer, ende është problem ajo punë, ende duhet punuar.

Po, politikanët janë karrieristë, çdo tjetër, secili, të gjithë jemi besoj këtu, se për ata edhe jemi ulur këtu, por marrja e drejtimit në energji për Kosovën dhe ajo që për dikë është "kontratë abuzive", Contour Global është një ambicie plus pra, jo vetëm për t'u kthyer në prodhim, por ndoshta një ditë edhe fuqi energjetike. Kjo është ambicia. Tani për këtë akuzohem se është abuzive, ndërsa për atë që e kemi nxjerrë gjendjen... Pse kisha pasur dëshirë që unë kam parë vepra të mira të oponentëve politikë, të ndonjë kryetari të komunës a ndokujt, kur ka qenë e mirë, më ka pëlqyer.

Në Kosovë, bukur pak kanë qenë njerëzit në atë kohë kur ka ndodhur kjo. Bukur pak ka qenë numri i njerëzve që kanë qenë me kokë në minierë që të mos ndodhë bankroti, por disa e kanë bërë për hatër të këtij vendi, në emër të këtij vendi e në emër të këtyre njerëzve. Sot është e tejkaluar dhe flasim për të dhe unë nuk e kam paketuar, t'ia bëj ndonjë "piar" a ndonjë gjë më shumë, por po ju them të drejtën, me orë të tëra kam kaluar me ata njerëz. Dikush po mendon se plot prej tyre janë matrapazë, ka profiterë e.... Shiko, edhe mund të ketë. Edhe s'po them që s'ka ndonjë, por shumica e atyre njerëzve kur i kanë lëshuar tokat i kam parë, kanë qarë në zyrë, për t'u çuar prej truallit të vet, prej aty ku i kanë varret. Disa prej tyre i dini, janë me emra, nuk po e cek kush. Veç etiketimi i gjithë kësaj pune të vendit tuaj, për shkak se është e një kampi tjetër politik... Mosni, se kështu nuk besoj se do t'i fitoni votat. Nëse dini ta bëni dallimin, kjo ka ndodhur në rregull, kjo është keq, kjo është mirë, po! Nëse shkojmë me këtë logjikë, besoni nuk e di se qytetari do ta përkrahë dikë kështu.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti prapë e ka kërkuar fjalën.

ALBIN KURTI: Çfarëdo sentimentalizmi i ndonjë varri që ka qëlluar në ndonjë pronë që duhet të shpronësohet, nuk mund ta delegjitimojë kërkesën dhe pyetjen time mbi atë që nuk duhet kurrsesi të barazohen banorët e hershëm me zaptuesit e vonshëm. Unë fare nuk po them se nuk duhet të ketë shpronësim. Natyrisht që duhet të ketë shpronësim, por barazimi është legjitimim i krimin të mëhershëm që është bërë prej atyre dhe një përsëritje e tillë në Kosovë. Kjo është e para.

E dyta, unë jam kritik, por unë jam për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike në Kosovë. Në alternativën qeverisëse të Vetëvendosjes thuhet 2x300MW, por duke mobilizuar edhe fondet publike. Disa herë këtë alternativë unë e kam shpalosur pjesë-pjesë edhe në Kuvendin e Republikës. Pra, ne jemi për ndërtimin e kapaciteteve energjetike, por me para të gatshme të

shtrosh asfalt, e të thuash se ne nuk mund ta bëjmë vetë çështjen e ndërtimit të kapaciteteve të energjisë elektrike, por duhet ta marrim një fond investiv prej jashtë, privat, pra për gjenerim, për prodhim, të mos e shpenzosh paranë e gatshme e ta shpenzosh për asfalt, është moskuptim elementar i ekonomisë, jo vetëm për pikëpamjen time. Kjo s'ka të bëjë me "e majtë", ose "e djathtë". As të djathtit nuk bëjnë çfarë bëni ju. Të djathtit janë në pushtet në plot vende të Bashkimit Evropian, por nuk e bëjnë këtë që e keni bërë ju.

Ndërkaq, sa për atë se me kë është e lidhur Vetëvendosja, meqenëse e kritikon këtë gjë, ato janë shpifje të cilat ju korrespondojnë juve dhe nga përvoja politike e di që çdoherë kur nuk ka argumente kundër nesh, na vishen etiketa, në mënyrë që të mos dëgjohet se çka ne po themi, por vetëm të keqinterpretohet se kush ne jemi.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri, edhe një herë!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po mundohem ta përcjell dhe të kyçem vetëm në atë që është me rëndësi të kyçem.

Argumentet - i kemi, apo nuk i kemi? Unë i kam përcjellë sa ishte koha e kësaj krizës energjetike dhe lufta për t'u prodhuar, për të mos mbetur ne në import. Edhe i kam parë plot reagime, në raste të caktuara i kam pritur, e në raste të caktuara jam befasuar prej nga kanë ardhur, s'e kam pritur edhe nga kanë ardhur. Kjo është interesant. Sot nuk po hyj më në detaje, por mund të më vijë dita ndonjëherë edhe ta them.

Pastaj, i kam parë edhe kritikën për termocentralin e ri. Shiko, ka diçka, një kontratë për një termocentral, një paketim i një kontrate, nuk është çështje e dy ditëve. Unë jam gjetur para një situatë, një përgatitje dhjetëvjeçare, ose të vendos, ose për të rënë. Dhe, ti bashko fonde të publikut pastaj, përgatit edhe një nisje të re dhe shiko kur e bën. Deri në atë kohë ne ku ta marrim energjinë? Ta marrim te komshiu? Shiko, nuk po them unë që në kohë je tre-katër vjet përpara me këtë. Ndërsa, paratë në infrastrukturë kanë qenë po ashtu të parapara, të kontraktuara e të dedikuara dhe për të mos ia ikur vendit tim, për të mos e lënë vendin tim të varet nga një "B", që po ashtu s'është e përjetshme, por ende është funksionale, dhe në një "A", që është para barotit, kemi hyrë në veprim. Sikur ne të mos e kishim bërë këtë në këtë kohë, çdo vit që vinte do të ishte më krizë energjetike e më të varur nga importi prej të tjerëve e me çmim më të lartë sesa që kemi hyrë ne në obligime për të. Kjo është e vërteta e energjisë në Kosovë.

Shiko, kanë thënë që "fukarasë i kushton kripa më shtrenjtë se zengjinit mjalti". Ne e dimë se vendet tjera bëjnë zgjidhje çfarë të duan për vete, por ne në Kosovë, në kushtet që i kemi pasur, edhe këtë investitor mezi e kemi, se asnjë s'ka mbetur të hyjë në qymyr. I fundit, i vetmi potencial për të hyrë, është fat që e kemi futur brenda dhe është fat që e kemi zënë këtë projekt

para ikjes, se do të mbeteshim pa investime të reja në energji. Do të mbeteshim prej atyre që duhet importuar.

Këto janë disa realitete, që nuk i them veç për hatër tuajin, që po i diskuton sot, Albin, ose kolegëve të tjerë, por edhe për hatër të së vërtetës. Kjo është e vërteta, ndryshe do të kishim mbetur duke e pritur energjinë prej të tjerëve, duke mbledhur para e duke çuar, siç bëjmë në marrëdhëniet në tregti, në bilancin tregtar, që e kemi me vendet tjera, do t'ia shtonim edhe këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, kalojmë te Grupi i Deputetëve të Pavarur. Në emër të Grupit Parlamentar të Deputetëve të Pavarur, fjalën e ka Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

I nderuar kryesues, faleminderit!

Të vërtetën, kryeministër, për Contour Global do ta flasim në interpelancën e thirrur për Contour Global, me ç'rast do të prezantojmë edhe një, të themi, kalkulim financiar ligjor, ambiental, e besa edhe t'i themi dëmet që mund t'i kemi karshi partnerëve tjerë, me të cilët dhe në të cilët ju po thirreni sot.

Por, unë sot, në këtë interpelancë do të flas më shumë për dy çështje. Deputetja, kolegja Sala Berisha-Shala e përmendi një vizitë në Bruksel, ku ishim së bashku. Shpresoj që është duke e dëgjuar fjalimin, meqë nuk qenka këtu. Mua më rastisi të jem në një tavolinë të organizuar nga Komuniteti i Energjisë, ku afër meje u ul një bankier i një banke zhvillimore, i cili e njihnte Kosovën që nga viti '99. Kisha fat, kishte qenë në Kosovë nga 12 qershori '99 deri diku kah fundi i vitit 2001 dhe miku i tij më i ngushtë ishte një nga menaxherët më të lartë britanikë në KEK në ato dy vjet. Dhe, ai më thoshte kështu, çfarë i kishte thënë ai menaxheri i lartë në KEK. Tha: "Çfarë janë në gjendje inxhinierët në Kosova B dhe në Kosova A të riparojnë, të vënë në funksion, të mirëmbajnë, në Britani do ta mbyllnim". Sot, 17 vjet më vonë, kryeministër, 18 vjet më vonë, KEK-u është ndërmarrja e vetme në Republikën e Kosovës që funksionon me fitim, ndërmarrje publike, përkundër punësimeve partiake, përkundër tentimit për ta zhvlerësuar deri në shitblerje.

Pra, logjika ekonomike që e keni përcjellë, jo ju, por të gjitha qeveritë, është logjikë e thjeshtë e zhvlerësimit të ndërmarrjes publike deri në shitblerje, por sot KEK-u prodhon. Prodhon më shumë se i japim ne kredi, prodhon më shumë se gjithkush kishte pasur pritje në vitin 2000/2001 kur kanë filluar investimet publike në të. Dhe, sot KEK-u, së bashku me këtë intervenimin tuaj që po e përmendni për qymyr, është në gjendje të mirëmbajë diçka për të cilën kurrkush nuk i jep kredi, që po e bën. Eh, pra duke parë që nuk po mund ta zhvlerësojmë, ne dikur, në një të kaluar

jo të largët, vendosëm ta privatizojmë, t'ia amputojmë një dorë sektorit energjetik, Distribuimin. Thamë, meqë nuk po mund ta vendosim kancerin në sektor energjetik, po ia amputojmë një dorë, dhe ajo ishte KEDS-i. Dhe, mu në të njëjtin komision, ku jam unë nënkryetar, i nderuar kryeministër, erdhi ZRRE-ja dhe na sollti një prezantim, shqyrtimi i dytë periodik për tarifën për pesë vjetët e ardhshme, që do t'u aplikohen qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në këtë prezantim na e dha një tabelë. Dhe, unë po e prezantoj këtë tabelë, kryeministër, sepse mendoj se është e rëndësishme. Edhe mënyra qysh i kemi zgjedhur anëtarët e Bordit të ZRRE-së, lë shumë për të dëshiruar. Në vend se të zgjidhen dy njerëz, ndonëse njëri prej tyre ishte edhe anëtar i PDK-së, u zgjodhën dy njerëz të tjerë që nuk kishin lidhje me industri, ndonëse konsulentët britanikë thanë se këta dy, zoti Ismajli dhe zoti Jakupi, do të duhej të ishin në Bord, i plotësojnë kushtet, e kanë CV-në, e kanë dijen për të qenë në ZRRE, Kuvendi votoi për dy të tjerë, që të jua them të drejtën nuk e di çfarë kriteresh elementare profesionale përmbushin për Rregullator.

Dhe kështu po i lexoj, këto janë komponentët për qytetarët, kryeministër, të cilat i propozon ZRRE-ja si tarifa në ndërtimin e tarifës që do të shkojë te konsumatori dhe propozimet e KEDS-it. Më ra në sy, meqë e kam njëfarë përvojë, themi ne, në financë, më ra në sy një element. Pika e tretë tha "Kosto e borxhit". Për ta thjeshtuar për qytetarët sa kushton kredia, me sa mund ta marrë KEDS-i një kredi për të investuar në këtë që s'ka investuar dhe këtu thotë 3,9 - 5,8%. Ky është propozimi i ZRRE-së. KEDS-i vjen dhe thotë "jo, jo, 7,5%", dhe ZRRE-ja ia pranon 6,5%. Dhe, unë e thërras një mik, i cili punon në njërin prej bankave komerciale dhe i them: "I nderuar, a mund të më tregosh një korporatë që s'i ka diku 80 milionë euro, por që i ka një milion euro, me sa mund sot ta marrë një kredi për ta financuar një investim për zgjerim në treg, për rritjen e të hyrave?" Tha: "Po, nëse është klient i mirë 3,7, nëse është klient jo aq i mirë, 4,5". ZRRE-ja, i nderuar kryeministër, ia ka pranuar 6,5%, ose po do t'ia pranojë 6,5%. Ky 6,5%, kryeministër, shkon në faturë.

Pra, për ta thjeshtuar, kredi prej 1 milion eurove me 6,5% e pranon, e ai dallimi prej 2%-shit në kamatë, e cila e rrit koston, i faturohet qytetarit, biznesit. E ZRRE-ja, i nderuar kryeministër, na është bërë njëfarë institucioni që secilit që pretendon të bëjë një fitim në krah të qytetarit po ia pranon matematikën.

Tutje, i njëjti institucion tha kështu: "Për të mundur për t'i reduktuar humbjet teknike komerciale", sa për informacion, deputetë të nderuar, qytetarë të nderuar, dy vjetët e fundit humbjet janë rritur. Pra, KEDS-i nuk ka qenë në gjendje t'i arrijë synimet me të cilat është nënshkruar kontrata, humbjet janë rritur, edhe teknike, edhe ato komerciale. Dhe tha: "Për të mundur KEDS-i t'i arrijë këto synime, duhet ta futim në kalkulim një faktor të efikasitetit". Tha: "OPEKS-i aktual, shpenzimet operative dhe OPEKS-i eficient, shpenzimet operative eficiente", e kanë bërë këtu një graf këta kur duan kështu ta bëjnë një prezantim të bukur bëjnë grafe dhe në njërin prej ligjëratave që i kam pasur në fakultet, thoshte "Kur do të bësh diçka të bukur, bëje një graf kështu me shumë katrorë". Edhe unë po e shoh këtu, po e lexoj, po thotë: "Faktori i

efikasiteti, përmirësimi i produktivitetit të përgjithshëm dhe heqja e joefikasitetit”. Kjo ishte formula “heqja e joefikasitetit”. Dhe, unë i bëj pyetje, shqyr që kemi dëshmitarë këtu, i them: “A ka mundësi ju kështu anëtarë të Bordit të ZRRE-së të më tregoni çka nënkupton kjo “heqje e joefikasitetit?”. A e dini cila ishte përgjigjja? Të hiqen punëtorë prej punës.

Heqja e joefikasitetit u përkthye me shkarkimin e njerëzve të mbetur pas kalimit të periudhës trevjeçare, që e ka pasur të garantuar KEDS-i, ose Kosova, me kontratë që KEDS-i s’do ta largojë askënd nga puna. Sot e kësaj dite keni vendime të gjykatave, që KEDS-i nuk i zbaton, pra për t’i kthyer njerëzit në punë.

Kur flasim për energji elektrike, kur flasim për furnizim me energji elektrike, është tepër shumë me rëndësi të definohet qartë e saktë, amputimi ka ndodhur me KEDS. Ndërsa, tentimi për ta infiltruar një temë në një sektor, i cili përkundër zhvatjes tetëmbëdhjetëvjeçare ende operon në përfitim 10 milionë euro në vit, ende gjeneron kapacitet energjetik me çmim jashtëzakonisht të lirë dhe, në fund, po e them edhe këtë, sot i nënshkrova minutat e procesverbalit, ose procesverbalin e mbledhjes së fundit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, dhe aty ua bëra një pyetje anëtarëve të ZRRE-së. U thashë: “Sipas jush, çmimi i importit të energjisë, meqë dhjetë vjetët e fundit është në rënie prej 112, sa ka qenë në vitin 2007, në diku 59 në vitin 2017 për MW-orë, a pritni që do të rritet, apo do të zvogëlohet?” Dhe, përgjigjja e tyre ishte: “Trendi është rënës dhe pritja jonë është që çmimi i energjisë elektrike për import do të bjerë”.

Pra, i nderuar kryeministër, është tepër e rëndësishme që këto institucione, të cilat pak a shumë i votojnë bordet këtu me një marrëveshje politike, së paku në atë marrëveshje politike të jetë interesi i mbrojtjes së publikut apo i qytetarëve, e jo interesi i mbrojtjes së një korporate, e cila do të marrë kredi me 7,5% prej një banke në Turqi, përndryshe nuk merr kredi këtu, por në bankë në Turqi, e financon sigurisht një institucion atje, i cili me 7,5% nuk mund ta plasojë valutën euro në tregun e vet, por e plason te ne. Dhe, në të njëjtën kohë këtë e kthejmë në faturë të rrymës për qytetarët, e kjo faturë nuk është veç për një qytetar amvisërie që e përdor një poç, një pajisje elektrike shtëpiake të amvisërisë, por janë edhe bizneset, për të cilat ju folët me shumë zell, e të cilat 13% e kostove të tyre i kanë të asociuara me faturë të energjisë elektrike.

Në momentin që tarifat e energjisë elektrike rriten për shkak të këtyre momenteve, kostoja e një biznesi të vogël dhe të mesëm për të prodhuar diçka, e ka prodhues në këtë vend, ndonëse janë ende të vegjël, e ne duhet të luftojmë që t’i bëjmë të mesëm e të mëdhenj, do të rritet. Eh, pra kapaciteti i tyre prodhues do të zvogëlohet, ose konkurrueshmëria e tyre zvogëlohet. E për të qenë konkurrentë, ata diku duhet t’i heqin shpenzimet, e siç po shihet KEDS-i e paska gjetur formulën, zvogëlimin e punëtorëve. Pra, të njëjtën formulë do të fillojnë ta zbatojnë edhe bizneset e vogla e të mesme, meqë koston për prodhim e përpunim po ua rritim me këso lloj matematikash.

Sa i përket temës së prodhimit të energjisë, besoj që interpelanca për Contour Global, jo veç se do t'ua bëjmë kritikën, por do t'u japim së paku dy mundësi për të dalë nga kjo situatë, e për të qenë prodhues të energjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ajo ideja për t'i bashkuar interpelancat ndodhi në të vërtetë. Ndodhi sepse tema po përzihet. Pra, ne kemi pasur të parën "Reduktimet dhe shkaqet e reduktimeve", tani fjalimi, ose pjesa e fjalës së zotit Sejdiu ishte kryesisht "Marrëdhënia shpërndarës - qytetarë dhe kushtet financiare të këtyre marrëdhënieve, që rezultojnë me rritje të tarifës". Pra, krejt kjo ishte tema, nga fillimi në mbarim.

Do të thotë, për reduktime të flasim ndoshta një herë tjetër, ose... Po, shumë mirë!

Sa i përket kësaj marrëdhënieje që e shpjeguat, shikoni, edhe unë kam shprehur interesim për ta parë sesi është gjendja. E vërteta është se kushtet e operimit për operatorin KEDS janë kushte që tanimë ekzistojnë, nuk janë kushte që po krijohen sot të reja. Ka shumë absurde në ato kushte, për shembull, një investitor potencial, po e përmend njërin e kam edhe mik, "Vali Ranch" në Gjilan, e ka ndërtuar një trafostacion të madh, ka bërë investime, ka ardhur prej Zvicre në një kodër mbi Përlepnicë, rreth 7 milionë investime, e ka ndërtuar trafostacionin dhe duhet t'ia qesë në pronësi KEDS-it, kurse ka investuar me para të veta, e trafostacionin dhe tokën duhet bartur në pronësi të KEDS-it. Diçka më e çuditshme që mund të ndodhë në botë.

Është zor t'ia japim një shpjegim logjik kësaj. Në vend që të shkojë ky që ia shet produktin e t'ia kryejë ato instalime, se ai e blen atë produkt, ai duhet t'i bëjë krejt ato investime dhe prapë e paguan produktin dhe, për fat të keq, te ne bizneset e paguajnë një tarifë të posaçme, më shtrenjtë se amvisëritë, që është bukur e çuditshme edhe kjo. Prej vendeve të rajonit ka ndryshime në këto raporte, ndërsa te ne gjendja është kështu. Pra, nuk po hyj t'i mbroj këto kushte, këto marrëdhënie, këta terma që i ka Kosova në obligim me një investitor. Investitori, në këtë rast KEDS, aq sa është investitor, operon në Kosovë dhe i ka disa përgjegjësi që po qe se nuk i trajtuam me të, prapë mund t'ia krijojmë ndonjë problem vetvetes. Pra, nga dëshira ndoshta për t'i zgjidhur disa probleme që po i cekim, mund të krijojmë edhe probleme të reja, se jemi diku, siç thotë populli, në gjysmën e dytë të rrugës. Ka shkuar gjysma e parë e rrugës, është kaluar periudha e parë kohore dhe kanë qenë të parapara disa obligime të ndërsjella. Tani, operatori thotë se unë s'kam mbërri ta reduktoj humbjen në masën diku 16, por jam në 23 tash. Ai thotë ashtu dhe kërkon një kompromis me vendin, në këtë rast me ZRRE-në, me vendin, po që bie në kurriz të konsumatorit.

Njëkohësisht për ta gjetur këtë balancë, atëherë ndodh ajo që thatë ju, flitet edhe për koston e parave që duhet të investohen, se pa investim nuk kemi rrjet. Kjo është pozita e Kosovës, e një Qeverie, në këtë rast është juaja, e këtij vendi, sot është njëri, nesër është tjetri.

ZRRE-ja, përkundër faktit që, dikush mund të thotë se janë këta ose ata, më kanë lënë përshtypje që janë njerëz që e njohin temën. Vetëm një gjë mendoj që ata s'kanë mundur të të ndihmojnë ty, Dardan, e mendoj që ke bërë gabim që i ke pyetur se a do të rritet çmimi i rrymës, i importit, se nuk mendoj që janë më të thirrurit të të përgjigjen. Ndoshta në KOSTT të kishin ndihmuar më shumë, se e kanë më afër gjendjen, por jo ZRRE-ja. ZRRE-ja mund të ndihmojë shumë për marrëdhëniet mes operatorëve, KEDS, ZRRE, KEK. Pajtohem me vlerësimin tuaj për KEK-un, KEK-u më ka ndihmuar, i ka ndihmuar vendit, i ka ndihmuar vetit, përgjegjësisë së vet, edhe në kohën e krizës kanë qenë korrektë të gjithë dhe mendoj që e kanë menaxhuar mirë përgjegjësinë në atë kohë.

Tani për çmimin, dikush thonë rritet çmimi se ka investim të ri, sot po themi se po rritet çmimi për shkak të koston në marrëdhëniet me operatorin ekzistues shpërndarës. Shihni, çështja e çmimit është luftë e përhershme e parametrave, e Qeveria, në këtë rast, është në anën e konsumatorit, edhe unë jam në anën e konsumatorit, se është paralajmëruar rritja prej shtatorit kur ia kam nisur punës, prej shtatorit deri më sot, ditë më ditë, është paralajmëruar kjo rritje, ende nuk ka ndodhur. Pse? Pse dikush ka qenë në anën e konsumatorit.

Kam mundur shumë lehtë të krijoj ndonjë tolerancë a diçka tjetër, po kemi qenë në anën e konsumatorit deri në këtë ditë, nuk di sa do të mund t'i mbrojmë këto pozicione, po jemi në anën e konsumatorit, besoni, në çdo diskutim.

Tani, po them nuk di sa do të mund t'i mbrojmë? Po nëse nuk ndodh shpërndarja, nëse nuk ndodh investimi, nuk e dimë atëherë a do të kemi fare energji dhe çka e pret Kosovën? Ata që janë më të thirrur duhet të na tregojnë në çfarë parametrash duhet të operojnë, pra cili është veprimi më i mençur i Kosovës në rrethana të tashme, po nuk ka zgjidhje të përkryer, ashtu si s'ka pasur zgjidhje të përkryer për të prodhuar energji, është dashur të gëlltitet diçka, si shpronësimi që u fol disa herë, çka është ligjore a më pak ligjore, ato veç prokurori i di, s'ka qysh t'i dijë një kryetar i Qeverisë kush është atje, cili? Nuk ka shans t'i dijë, prokurori mund t'i dijë, polici mund t'i dijë, s'ke qysh i di ti, dhe e ke kohën urgjent të ndërmarrësh veprime, kategorizimet, ato i bën tjetërkush.

Ne jemi në anën e konsumatorit, por duhet të dimë të veprojmë në momentin kyç çka është më reale dhe unë mendoj që ZRRE-ja mund të vijë e t'ju shpjegojë prapë juve, t'ju raportojë këtu, edhe ne jemi të interesuar të rrimë me konsumatorin.

Shikoni, unë thashë që jemi për t'i përkrahur sipërmarrësit dhe investitorët, mua më dhimbsen çka heqin sipërmarrësit në Kosovë në këto kushte energjetike, i përmenda 300 milionët e humbur.

Mirëpo, në rastin konkret, jemi me konsumatorin, pra do të luftojmë për çmim që të mos rritet. Nëse eventualisht do të ndodhë rritja, atëherë do ta konstatojmë ju, se ju jeni punëdhënësit e ZRRE-së. Pra, ajo rritje e energjisë nëse ndodh, të mos i atribuohet Qeverisë, unë do t'ju them vendosni ju, se ZRRE-ja është juaja, ju vendosni, a po a jo. Po nuk do ta marrë Qeveria përgjegjësinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu ka kërkuar të replikojë.

DARDAN SEJDIU: Kryeministër, faleminderit!

Unë mendoj që nëse jemi edhe të sinqertë, edhe seriozë, dy fjalë që po i përdor shumë kohëve të fundit, atëherë do ta kemi fare lehtë që diagnozën që e kemi të përbashkët, të aplikojmë një terapi, e cila ka kuptim.

Një terapi e cila nuk thotë amputimi ka ndodhur, e tash nuk na duhet kjo, po një terapi e cila, unë mendoj, që mund të bëhet mirë e mbarë. Sa për informim tuajin, aktualisht energjia bazë në tregun gjerman, i cili është tregu më referent në Evropë dhe për Evropën, është mes 35 dhe 40 euro megavat orë dhe kështu parashihet të jetë deri në vitin 2024.

Çmimi i blerjes së energjisë në të ardhmen asnjëherë nuk e kalon shumë prej 40 eurosh, pra çmimi i energjisë për të ardhmen, e ministri Lluka e di çka do të thotë kontrata për të ardhmen, ishte dashur, na tregon neve fare mirë e fare lehtë që në KEDS, një ndërmarrje që e kemi shitur për 26 milionë euro, jemi duke i dhënë mundësi edhe pas gati shtatë vjetësh të përfitojë tutje, e tutje, e tutje, duke na trajtuar me kamata të cilat i vendos në tarifa me çmime të papranueshme, thjesht në të njëjtin prezantim, deputetë të nderuar, në sllajdin tjetër çmimi referent i huamarrjes ka qenë 5.8 në Kosovë.

Jo, këtu është e qartë, këtu është e qartë, besoj që është e qartë, një plus një bëjnë dy, Armend, nuk bëjnë ndryshe.

Dhe, kryeministër,

Mendoj që është tepër e rëndësishme ta keni një gjë të qartë që nëse KEK-ut i garantojmë çmimin, të cilin e keni të vendosur në kontratë, të cilën do ta diskutojmë më vonë, prej 80 eurosh, për tre vjet, për orë që i prodhon, megavate, KEK-u do ta ketë ekuitetin e mjaftueshëm për t'i ndërtuar këto kapacitete.

E kështu, të nderuar deputetë, bie edhe çmimi i megavat orëve të prodhuar, sepse kostot fikse për KEK-un zvogëlohen.

Pra, keni edhe mundësinë, keni edhe mënyrën që si kryeministër të mos vazhdoni me stafetën energjetike që e kanë ndërtuar që 18 vjet qeverisjet, por të ndërtoni një model, i cili e bën Kosovën, të themi, një aktor serioz në tregun energjetik edhe për konsumatorin e amvisërisë, edhe për konsumatorin, i cili na duhet të shndërrohet në prodhues të mesëm a të madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk e di në cilat të dhëna po barazohesh, Dardan. Një tabelë këtu sapo e nxorëm, Danimarka e ka çmimin më të shtrenjtë, e dyta është Gjermania, për qytetarë, që, ju lutem, e gjeni edhe ju.

Ka diçka që është me rëndësi të dihet, në korrik të vitit 2016 Kuvendi i Kosovës ka ndryshuar ligjet e sektorit të energjisë për t'i përshtatur ato me paketën e tretë të direktivave të BE-së, të cilat më pas u shoqëruan me plotësim-ndryshime legjislativoni sekondar gjatë vitit 2017, pra, po flasim për një periudhë jo fort të largët.

Deri në prill të vitit 2017 furnizuesi publik KEDS-co e ka luajtur rolin e blerësit me shumicë dhe ka blerë energji për nevojat e të gjithë sektorit, pra KEDS-co si furnizues publik ka qenë përgjegjës për funksionimin e tregut të energjisë. Duke filluar nga prilli i vitit 2017 këtë rol e ka marrë KOST, ndërsa të gjithë aktorët e tjerë të sistemit energjetik i kanë përgjegjësitë për rolet e tyre përkatëse që dalin nga ligjet në fuqi.

Pra, ka ndodhur një ndryshim në përgjegjësitë e secilit në energji. Duke u nisur nga kjo që nga qershori i vitit 2017 çdo rënie e prodhimit të njësive gjeneruese të KEK-ut, sidomos rënieve të blloqeve nga termocentrali "Kosova B" automatikisht shkakton një mungesë të madhe të furnizimit, se secili nga këto blloqe i jep 250 megavatë, që është një e treta e konsumit në sezon.

Duke qenë kjo gjendje, duke qenë kjo situatë, edhe tarifa është vështirë të ruhet, të kontrollohet. Ne kemi pasur raste kur na kanë thirrur KOSTT-i dhe janë ankuar se nuk mund ta mbulojnë gjendjen me tarifën ekzistuese, me çmimin ekzistues që e merr konsumatori. Na kanë thënë se ne po detyrohemi të importojmë në këtë kosto. Gjatë gjithë dimrit e kemi pasur këtë presion prej tyre, ata janë gjallë, mund t'ju tregojnë vetë sa herë na kanë dërguar shkresa, kanë kërkuar takime, janë ankuar se s'po mund ta mbulojnë financiarisht gjendjen.

Periudhën që vjen, tani te tarifat, unë jam për diskutim rreth këtyre temave, mendoj që Parlamenti e ka një fuqi të jashtëzakonshme në këtë temë, duhen ta ftoni ZRRE-në dhe t'ju japë

pasqyrën e saktë për çka bëhet fjalë, atë jo vetëm në komision, por ndoshta edhe në seancë plenare, pse jo, të praktikohet një raportim.

Ne i kemi thirrur në raportim, për shembull, para disa ditësh e kemi thirrur Bordin e ri të Valës të raportojë. Gjendja nuk është e mirë, na kanë treguar si është gjendja, por nuk e kemi bërë këtë për panik apo për shfaqësim, po që ta njohim gjendjen reale dhe të ecim. E vërteta është se nuk është lehtë të sanohet një gjendje 20-vjeçare, gati është e pamundshme.

Nëse po ashtu kemi dilema që s'po përballemi pikërisht me këto situata, me këto tema, po në energji privatizimi i KEDS-it në atë kohë, t'ju them të drejtën, i kam pasur pikëpamjet e mia dhe kam qenë i ulur, ashtu si tha Albini, në atë anën tjetër.

Mirëpo, në ditën e sotme, edhe këtë KEDS, a çka po i thonë, e trajtoj si një operator në vend, me të cilin marrëdhënie duhet t'i kemi sa më kredibile, po jo në dëm të interesit të qytetarit as vendit tim.

Po megjithatë ekziston si operator, është investitor, ashtu si është, pra, në ato marrëdhëniet që i ka me vendin tim dhe duhet të jemi të kujdesshëm në operim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, urdhëro, Dardan, e ke fjalën, janë minutat e grupit.

DARDAN SEJDIU: Dakord. Kryeministër, Kosova është pjesë e Traktatit të komunitetit të energjisë dhe si pjesë e këtij Traktati ne e kemi bërë edhe Ligjin për energjinë elektrike dhe ai ligj është në përputhje me këtë Traktat, dhe objektivi i këtij Traktati është të rritet siguria në furnizim me energji elektrike përmes një tregu konkurrues panevropian.

E, në fakt, problemi ekziston që me atë çka po bëni ju tash, qoftë me kontratën, për të cilën do të flasim më vonë, qoftë me këto këtë trajtim të sektorit të energjisë, ju në vend se ta hapni tregun, po e mbyllni tregun. Kështu që sa i përket Traktatit të komunitetit të energjisë, ne jemi si Kosovë nënshkruese, po jemi në thyerje drejtpërdrejt të asaj çka kemi nënshkruar me Traktat të komunitetit të energjisë me kontratën Contour Global. Dhe, në anën tjetër, çmimi të cilit unë iu referova, është çmim në treg, i cili eksportohet, pra çmimi me të cilin tregtohet energjia dhe jo çmimi në faturat e qytetarëve, e këtu ka një dallim të madh.

Kështu që po besoj që më keni mirëkuptuar dhe kështu e shihni edhe energjinë, pra si një mall i tregtueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri prapë e do fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Prej zorit po bëhem ekspert, se nuk jam aq shumë.

E kam një pyetje për ju, Dardan, hapja e tregut nënkupton të blejmë ne prej të tjerëve. Ti po thua ne duke prodhuar, duke shkuar kah prodhimi, duke i shtuar kapacitetet e vendit, po e mbyllim tregun, pse po ia blejmë këtij, pra po i themi këtij ne ta blejmë ty, e nuk po hapemi të blejmë më larg, nuk po e kuptoj fort, se ai është import.

Nuk e di ku është dobia e vendit tonë, kjo do të ishte sikur ne të mos blujmë më në Kosovë ose të mos mbjellim, por ta hapim tregun e të blejmë nga larg. Nuk e di si mund ta ndihmojmë veten kështu?

Të paktën kjo është ajo që po e kuptoj në atë çka po thoni ju.

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka prapë fjalën.

DARDAN SEJDIU: Unë, kryeministër, po i shpërfaq kundërthëniet në mes të asaj çka keni nënshkruar me Traktat të komunitetit të energjisë, Ligjit për energji elektrike dhe marrëveshjes me “Controur Global”, nuk po flas qysh mendoj unë, këtë e kam rezervuar për pjesën tjetër të diskutimeve në interpelancë.

Pra, po ju them që ju këtu po na tregoni për Traktatin, e përmendët vetë dhe, në anën tjetër, me këtë kontratë jeni në thyerje direkt të saj dhe të Ligjit për energji elektrike.

Kjo për mua nuk ka kuptim, o veprojmë në një koncept, të cilin jemi nënshkruar, o ndërtojmë strategji, e cila është ndaras prej saj, kaq është.

KRYESUESI: Urdhëro, zoti kryeministër! Janë në kohën e grupeve parlamentare, në cilat jeni në koalicion.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nëse Kosova ia garanton çmimin një hidrocentrali në Shqipëri, i thotë po ta blej, ai hidrocentral ose Shqipëria e ka lehtë të gjejë investitor. Fajin që e ka bërë Kosova është se ia ka blerë një kompanie në vend të vet, dhe diku është dashur të blihet.

Ne ia kem blerë një kompanie në vendin tonë dhe parashihet me krejt këto rregullat që ka tregu dhe ato traktatet për të cilat ne kemi rënë në dakord. Pra, nuk kemi thyer asnjë ligj ne, asnjë rregull, e vetmja gjë është që ne nuk kemi shkuar, të mos keqkuptojë dikush, t'ia blejmë dikujt tjetër, po vetvetes. Besoj që kjo është në dobi të tregut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëshiroj t'ju sqaroj që kryeministri flet në kohën e grupeve parlamentare të koalicionit, domethënë e shfrytëzon kohën e grupeve parlamentare të koalicionit.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Bekë Berisha. Urdhëro, Bekë!

BEKË BERISHA: I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Mungesa e energjisë elektrike në vend tash e 20 vjet është temë e diskutimit, faji nuk dihet, pasi operatorët hedhin topin nga njëra kompani tek tjetra.

Është me të vërtetë turp që të flitet akoma për mungesë të energjisë elektrike. Prandaj, është dashur që ky të jetë debati i fundit për këtë temë.

Privatizimi i distribuimit dhe rrjetit, edhe pse në atë kohë KEK-u ishte profitabil, u bë në formën më të dëmshme për këtë vend. Përveç që u shit për vetëm 26 milionë kompanisë turke, po them turke, pasi akoma nuk dihet se kush realisht qëndron mbrapa saj, iu dhanë edhe 40 milionë të tjera para të gatshme me arsytetime skandaloze.

Sot është e vërtetë që nuk ka aspak kontroll se cili është fitimi real i kompanisë KEDS/KESCO, dhe kjo kompani, e cila është e obliguar me ligj t'i furnizojë qytetarët me energji elektrike, nuk është duke e kryer detyrën e vet, prandaj, në këtë pjesë duhet të merren masa.

S'është aspak e drejtë dhe ligjore që energjia e prodhuar në vend të eksportohet jashtë dhe qytetarët tanë të mbesin pa energji.

S'është e drejtë që qytetarët të paguajnë fatura të fyera të energjisë elektrike, me arsyetimin se KEDS është duke investuar në rrjet, ku të gjithë jemi të vetëdijshëm se gjoja investimet janë duke u kryer nga kompanitë e lidhura dhe nuk kanë fare kontroll mbi këto investime.

Jam dakord që të themelohet një komision, i cili do të mbikëqyrë punën e operatorit KEDS/KESCO dhe i njëjti të mbahet nën kontroll, pas deri më tani jemi të bindur se Zyra e Rregullatorit për Energji nuk e ka kryer punën e vet.

Në vend që të përkujdesen për dy milionë qytetarë, atyre u ka mjaftuar që ta rehatojnë nga një familjar në punë në KEDS/KESCO dhe, pa dyshim edhe ndonjë përfitim tjetër.

Gjithsesi mungesa e energjisë elektrike nuk ka ardhur me ardhje në pushtet të kryeministrit Haradinaj. Privatizimi i KEDS/KESCO nuk është kryer nga kryeministri Haradinaj, prandaj të jemi korrektë dhe të mos thërrasim interpelanca sa për t'i mashtruar qytetarët, mirëpo të punojmë më shumë për mirëqenien e tyre.

Meqenëse i kam edhe pak minuta, po ndërlidhem edhe me temën tjetër, që është e njëjta, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej një milion euro për KOST-in për mbulimin e shpenzimeve. Unë po e kryej tash, se është e njëjtë.

Pagesa për humbjen në veri të Mitrovicës është aplikuar që 20 vjet, pse bash në këtë moment ju ra ndër mend ta ngrini këtë temë.

Nëse thoni se s'keni pasur informata, është goxha vështirë t'ju besohet, se ju keni pasur informata bash për gjithçka.

Prandaj, zgjidhja e përkohshme afruar nga kryeministri është zgjidhja më e mirë për momentin, pasi nuk guxojmë ta rrezikojmë funksionimin e operatorit të transmisionit.

Ndërsa Qeveria duhet të kujdeset që kjo temë të zgjidhet në Bruksel.

Është e vërtetë që shumë probleme janë mbledhur në Kosovë tash e 20 vjet dhe ky nuk është faji ynë, as faji i kryeministrit aktual, ndoshta problemi është shfaqur tash, pasi dikush realisht po tenton t'i zgjidhë këto çështje dhe dikujt iu kanë prishur interesa të mëdha nëse këto tema zgjidhen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lista serbe nuk shoh askënd të pranishëm. Grupi Parlamentar Nisma, deputeti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Ashtu edhe siç pritej, tri interpelancat do të përzihen, pasi materia është thuar se e njëjtë, ka mundur të jetë veç një, po megjithatë janë çështje që e preokupojnë shoqërinë tash e 20 vjet pas luftës.

Thënë të drejtën, reduktimet që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin jo vetëm në zona të caktuara, por në gjithë Kosovën, në zonën nga vij unë ka fshatra të tëra dhe zona të caktuara industriale mbesin pa energji elektrike.

Reduktimet enorme të energjisë elektrike kanë një impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe në jetën e dinjitetshme që duhet ta bëjnë qytetarët në vendin e tyre.

Mendoj se ajo që është thënë dhe në atë që janë thirrur në kohën e privatizimit, nuk ka ndodhur, e arsyet tashmë po dihen se janë publike. Disa u thanë, privatizimi nuk ka arritur qëllimin përpos që ka thelluar dhe ka vënë në dilemë perspektivën afatgjate të shtetit tonë në aspektin e zhvillimit ekonomik, të mirëqenies sociale, por edhe në aspektin e sigurisë kombëtare.

Po mendoj se ZRRE-ja ka përgjegjësi pak më të mëdha karshi qytetarëve, konsumatorëve në përputhje me ligjin. Metodrat që po aplikohen ekskluzivisht në Kosovë nga privatizuesi i distribuimit të energjisë elektrike janë të disfavorshme dhe dëmtojnë bukur shumë edhe qytetarin, por veçanërisht edhe biznesin.

Meqë unë e kam edhe një biznes familjar, jam vazhdimisht i atakuar ndoshta shumë më pak se të tjerët, kur praktikohet maksigrifi ose edhe konstanta përmes grupeve matëse që është një praktikë që për biznesin është e papërbalueshme, dhe thjesht e ndërlidh këtë edhe me atë që e thashë në fillim, se energjia elektrike, reduktimet, çmimi i shtrenjtë ndikon drejtpërdrejt ose e atakon drejtpërdrejt zhvillimin e këtij vendi, por edhe jetën normale.

Monopoli i krijuar në tregun e energjetikës është çështje e cila duhet të analizohet dhe të studiohet te institucionet përgjegjëse, në këtë rast, te Ekzekutivi, sepse në rast se vazhdohet kësi soji, shteti me gjithë të mirat dhe të këqijat që i ka, varet nga një individ ose nga një ndërmarrje, e cila s'ka diskutim se është më shumë se e dyshimtë ajo që e ka privatizuar distribuimin e energjisë elektrike, mendoj që duhet të futet në një filtër, të një hetimi serioz, sepse ka dyshime të bazuara në të gjithë atë gamë të privatizimit që ka ndodhur dhe unë ditëve të fundit kam dëgjuar se i ka dalë gjumi prokurorit të shtetit për këtë temë dhe po shpresoj që do të dalë në dritë ajo që ka ndodhur lidhur me privatizimin.

Reduktimet që ndodhin në emër të punimeve janë të paqëndrueshme, këtë e kam vërtetuar edhe vetë në jetën e përditshme, shpesh jemi thirrur se do të ketë reduktime për shkak të punimeve, në fakt nuk ndodhin punime, është një mashtrim dhe përgjigjja e ZRRE-së dhe e mekanizmave të tjerë për këtë çështje nuk është e vërtetë. Ai që e ka privatizuar distribuimin e energjisë elektrike është duke bërë lojë me nervat e qytetarëve dhe, natyrisht ne me të drejtë dyshojmë në këtë privatizues. Veçanërisht strategjisë që u përmendën kalimthi, dhe kjo e vë në pikëpyetje për shkak se privatizuesi i energjisë elektrike dyshoj se është pjesë e mafisë rajonale të energjisë në rajonin tonë që e ka selinë në Beograd dhe jo rastësisht dështojnë të gjitha strategjitë afatmesme dhe afatshkurtra dhe për këtë unë po shpresoj se Ekzekutivi i vendit duhet të ketë strategji të qëndrueshme në fushën e energjetikës, jo vetëm për t'i përbaluar situatat emergjente që mund të krijohen, nganjëherë me qëllim nga të tjerët dhe nga ata që qëndrojnë në këtë mjegull të privatizimit, por duhet të kenë pjesë të strategjisë edhe atë se si Kosova përpos të jetë stabile, të jetë edhe shtet, i cili mund të kontribuojë në tregun e energjisë elektrike.

Mendoj se detyrimi që u bëhet nga KEDS-i qytetarëve, për të cilën foli edhe kryeministri, po më vjen mirë që një koleg i tij ka qenë i atakuar si shumë qytetarë të Kosovës, domethënë është çështje e cila duhet të analizohet dhe dikush duhet të japë përgjegjësi. Pa dashur t'i përziej edhe unë si të tjerët temat, natyrisht se këtu ka shumë çështje për t'u diskutuar, deri edhe te përgjegjësia që në fund e ka nxjerrë në pah domethënë Avokati i Popullit për inkasimin që u është bërë qytetarëve në mënyrë të padrejtë, domethënë për komunitetin serb, i cili tash e 19 vjet nuk paguan energji elektrike. Siç është edhe çështja e cila në legjislaturën e kaluar është diskutuar me të madhe në këtë seancë, njëri prej tyre kam qenë edhe unë që pastaj kam qenë i atakuar nga kjo mafi, e cila qëndron pas privatizimit, sepse unë paguaj diku rreth 25 mijë euro në vit rrymë, merre me mend, atakohem për një gjobë prej 100 eurosh deri në atë shkallë sa që legenëve të portaleve informative u jepet kënaqësi çnjerëzore pastaj për të shprehur atë injorancën njerëzore kundër individëve të caktuar, kryesisht personave publikë.

Unë mendoj se ky privatizues ka edhe një përgjegjësi dhe dikush duhet të merret me atë, sepse në legjislaturën e kaluar kemi folur për matësit elektrikë, të cilët i vjedhin qytetarët, bëjnë matjen më tepër se që duhet, të tipit "Koler", ku një institut në Holandë e ka konstatuar këtë, janë marrë masa, tre punëtorë janë arrestuar, domethënë nuk dihet se deri ku ka shkuar procesi gjyqësor i atyre që kanë licencuar këtë orë, këtë matës elektrik, por që domethënë KEDS-i vazhdon me këta matës elektrikë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk keni kohë më tepër, zoti deputet. Nëse kanë vullnet, nga Grupi Parlamentar "6+" nuk është paraqitur askush, kështu që vazhdojmë me deputetët sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Qytetari i Republikës së Kosovës, i shtetit më të varfër në Evropë, ka vjet që po vidhet paturpësisht nga kompanitë elektroenergjetike, së pari në emër të njehsorëve, në emër të tarifave, duke i fryrë edhe faturat dhe gjithmonë duke i faturuar qytetarët e përgjegjshëm dhe duke e falur qytetarin e papërgjegjshëm, i cili po e shfrytëzon rrymën në mënyrë të paturpshme.

Kjo padrejtësi e faljes në emër të të drejtave të njeriut vlen vetëm për një komunitet, kurse komuniteti shumicë po diskriminohet, edhe pse po tregon përgjegjësi. Sot, të nderuar deputetë, në shumicën e qyteteve dhe fshatrave për mospagesë e vonesë në pagesën e rrymës i ndërpritet rryma edhe në mes të dimrit dhe në të njëjtën kohë nuk japin përgjegjësi kur konsumatori paguan dhe nuk merr shërbimet nga e njëjta kompani. Në muajt e fundit kemi një keqësim të gjendjes me furnizim të rrymës në shumë lokalitete anekënd Kosovës dhe këto ndërprerje po shkaktojnë dëme ekonomike në familje dhe kompani, ku prishjet e makinerive dhe aparaturave janë të

shpeshhta. Shpeshherë kanë ndodhur edhe zjarre si pasojë e lëvizjeve të tensionit, por asnjëherë nuk dihet se a janë kompensuar këto dëme te qytetarët e saj.

Kjo kompani që u është dhuruar privatizuesve të vetmin interes e ka mbledhjen e milionave nga qytetarët, por as për së afërmi nuk janë duke i kthyer investimet në rrjet dhe trafostacione. Raportimet nga terreni flasin që kemi një gjendje të mjerë në rrjet, kemi rajonin e Hasit, ku si pasojë e tensionit të ulët dhe prishjeve kemi ndërprerje shumë të shpeshhta si pasojë e mosinvestimit në rrjet në 40 vjetët e fundit. Po ashtu, edhe rajonet e tjera, në rajonin e Prizrenit e Vrrinit e në rajone të tjera kemi ndalje të rrymës edhe kur fryn një erë e dobët. Thuhet çdo fshat ka probleme, sepse popullata është rritur, janë rritur shpenzimet në rrjet, ndërsa rrjeti ka mbetur ai i vjetri. Por, këto halle si duken nuk po e brengosin askënd dhe kur kemi një shtet që po merret me tema të tjera, kjo kompani si duket nuk po e respekton marrëveshjen e investimit në rrjet, por të vetmin interes e ka mbledhjen e borxheve, rritjen e profitit, prandaj unë mendoj si edhe shumë shtete të tjera që kanë krijuar grupe për rishqyrtimin e këtij privatizimi, edhe unë propozoj që të rishqyrtohet edhe ky privatizim dhe të shikohet sa kjo kompani po i respekton kushtet e kontratës. Nëse nuk është duke i respektuar, të penalizohet, sikur që po penalizohet qytetari kur nuk po e paguan rrymën, të penalizohet edhe kjo kompani kur nuk e respekton marrëveshjen e kontratës së saj, veçanërisht investimet në rrjet. Por, si duket, qytetari po diskriminohet dhe ka mbetur jetim nga një kompani fitimprurëse, por po diskriminohen edhe punëtorët e KEK-ut, siç u cek edhe më herët, shpeshherë kemi shkelje të të drejtave edhe të kontratës, shkelje të drejtave të punëtorit, të drejtave të Ligjit të punës dhe të drejtave të njeriut te punëtorët, të cilët shpeshherë po përjashton pa të drejtë.

Qytetari është duke e ndier këtë privatizim në kurrizin e tij, duke rritur kontrollet, duke u rritur dënimet për mospagesë dhe, në të njëjtën kohë, nuk po vazhdohet ai investim për të cilën është i thirrur, rrjeti është ai i vjetri, ndërprerjet për shkak të prishjeve më të vogla po vazhdojnë dhe ky qytetarë tani shumë shpesh janë në errësirë, ndërsa kompania po vazhdon duke i rritur profitet, por duke i dëmtuar edhe kompanitë e tjera, të cilat janë të varura nga energjia dhe duke e rritur në të njëjtën kohë dëmin që po shkakton edhe te familjet, edhe te kompanitë e tjera, të cilat janë kompani private të ngritura me mund.

Prandaj, ne duhet ta rishikojmë edhe një herë këtë kontratë, ta shikojmë sa është duke u respektuar dhe çka shkruan në këtë kontratë, veçanërisht në investimet në rrjet, të cilat nuk janë duke u kryer sa duhet dhe në shumë fshatra është rrjeti i viteve të '70-ta dhe të '80-ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga PDK-ja s'është paraqitur askush, kështu që fjalën e ka Arbërie Nagavci, nga Lëvizja Vetëvendosje.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Fakti se vetëm sot janë tri interpelanca që ndërlidhen me energjinë tregon jo vetëm rëndësinë e kësaj çështjeje, por edhe sfidat me të cilat po vazhdojmë të ballafaqohemi që kaq e kaq vjet.

Akoma edhe sot, ashtu sikur shumë vjet të kaluara radhazi janë të zakonshme lajmet si do të vazhdojnë reduktimet e energjisë elektrike, këto janë vendet që do të mbesin pa energji elektrike, rikthehen reduktimet, e kështu me radhë, edhe pse furnizimi i pandërprerë me energji elektrike është kërkesë bazike dhe elementare për një shoqëri normale. Reduktimet e ashpra të energjisë elektrike që ndodhën muajve të fundit në tërë Kosovën, në ditë të ftohta të dimrit, duke i dëmtuar kështu qytetarët anembanë komunave të Kosovës, ballafaquar me reduktime të ashpra të energjisë elektrike, duke ua vështirësuar mjaft jetën e tyre. Edhe pse reduktimet ndodhën në tërë Kosovën, më të gjatat ishin në komunat, si Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Drenas dhe sigurisht në zonat rurale. Edhe pse qytetarët jo vetëm se e kanë paguar rrymën, por kanë paguar më shumë se sa që në të vërtetë kanë kushtuar shërbimet e marra, KEDS ka vazhduar avazin e njëjtë me reduktime të paarsyeshme dhe kjo situatë e vërteton edhe një herë, përveç tjerash, edhe papërgjegjësinë e plotë të KEDS-it si shkelës i kontratës me qytetarët e Kosovës, gjegjësisht me secilin qytetar që ka paguar rrymë.

Secilit nga ne, besoj ashtu si qytetarëve iu kujtohet premtimi i PDK-së në zgjedhjet e vitit 2007 për furnizim të pandërprerë me energji elektrike dhe sidomos për heqjen e planit të reduktimeve A, B, C. Kaq vjet pas qeverisjes që bëri PDK-ja dhe gjashtë vjet pas privatizimit të ndërmarrjes, ndërprerja e energjisë elektrike vazhdon në gjithë territorin e vendit dhe jo vetëm që nuk ka furnizim të pandërprerë me energji elektrike, jo vetëm që nuk janë ulur reduktimet, por orët e ndërprerjeve të energjisë elektrike janë shtuar. Për më shumë dhe më keq, qytetarët jo vetëm që po përballen me mungesë të energjisë, por janë të obliguar të paguajnë edhe humbje teknike dhe komerciale, apo thënë më drejtpërdrejt, obligohen të paguajnë vjedhjen e rrymës nga kompanitë dhe ekonomikë joformale dhe nga qytetarët e papërgjegjshëm. Këtë e vërtetoi, për një pjesë të asaj energjie për katër komunat në Veri të vendit dhe raporti i Avokatit të Popullit, dhe pastaj vendimi i gjykatës.

Sipas raportimeve zyrtare të Zyrës së Rregullatorit, jo vetëm pse nuk ka pasur asnjë përmirësim në këtë drejtim, por përkundrazi, gjendja është edhe më keq se sa kur kompania ishte publike. Edhe pse kur KEDS-i u privatizua në mënyrë krejtësisht arbitrare, u tha se përveç të tjerave, kjo po bëhet që të garantohet furnizim i pandërprerë me energji elektrike dhe se humbjet teknike dhe ato komerciale do të reduktoheshin, kjo jo vetëm që nuk ndodhi, por anasjelltas. Vazhduan reduktimet e u rrit çmimi i energjisë për qytetarët. Për më shumë, fatura e mospagimit, e vjedhjes

së energjisë, ende sot i shpërndahe paligjshmërisht çdo konsumatori që e paguan në mënyrë të rregullt energjinë.

Përveç kësaj, në këto gjashtë vjet çmimi i energjisë elektrike sipas kërkesës së konsorciumit privat është rritur katër herë nga Zyra e Rregullatorit dhe kjo me arsyetimin fals të mbulimit të kostove nga defektet në gjenerim të energjisë.

Sikur kreativiteti që treguam për gjetjen e termit dhe për zëvendësim të fjalës që e tregon saktë situatën e vjedhjes së rrymës, pra shprehjen “humbjet komerciale”, të ishte kreativitet për gjetjet e zgjidhjeve profesionale në implementim të rendit dhe ligjit, në dënim të vjedhësve dhe në punë për vendin, e jo për interesa të grupeve të ngushta, s’do të kishim situatën ku 1/3 e rrymës së shpenzuar ua paguajmë atyre që e vjedhin. Përveç reduktimeve të rrymës, ajo që kemi parë gjatë gjithë këtyre viteve ishin konferencat e investitorëve, vizita të shumta, shpenzime të miliona eurove në import të energjisë elektrike, por jo stabilitet dhe përmirësim të situatës në sektorin e energjisë, sektor ky që është parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo mungesë e stabilitetit ndikon shumë negativisht në shoqëri. Dëmet janë të mëdha, secili nga ne e dimë për koston dhe telashet që kemi pasur në familjet tona, secili mësimdhënës e drejtor shkolle është i vetëdijshëm për minutat e humbura e planit të paralizuar për shkak të reduktimeve të rrymës, e sidomos secili biznes është i dëmtuar për këtë arsye. Përveç pasigurisë së madhe për bizneset, për shkak të rritjes së kostove duke përdorur energjinë alternative nga gjeneratorët rritet edhe çmimi i produkteve të prodhuara, gjë që ndikon në çmimin e blerjes që i dëmton konsumatorët, pra qytetarët tanë dhe, e dyta, që i bën produktet vendore jokonkurruese me produktet e importuara.

Zoti Haradinaj foli edhe për çështjen e zhvendosjes së banorëve të Shipitullës dhe vendimin për shpronësimin e pronave në Hade dhe Shipitull. Është e vërtetë se ish-kryeministri Mustafa nuk bëri një veprim të tillë, por unë e pyes kryeministrin se sa është vlera e kompensimit të pronave dhe a ka ndonjë verifikim të pronarëve? Gjegjesisht, a janë vërtet ata pronarë? Situata në terren e tregon se shumica e shtëpive aty janë bosh, aty nuk jeton askush, pasi që pronarët nuk janë banorë. Ato shtëpi janë ndërtuar pikërisht me qëllim të shpronësimit. Pra, zoti Haradinaj, a mund të na tregoni se sa është vlera e plotë e shpronësimit dhe kush janë personat që do të shpronësohen, si dhe që sa kohë ata jetojnë apo janë pronarë të atyre shtëpive?

Pra, ndërtimet e cilit vit do t’i kompensoni? Dhe, po ashtu a i njihni ju vendimet e paraardhësve tuaj, vendimin e vitit 2004 dhe atë të vitit 2009 të Qeverisë Mustafa, apo do të kompensoni edhe shtëpitë e ndërtuara pas vitit 2009, që do të ngjallte dyshime të bazuara për korrupsion, si dhe kur do ta bëni publike listën e plotë të atyre që po u kalohen paratë në llogaritë bankare, e që nuk kanë as tituj pronësie? Meqenëse folët shumë për minierën e re, zoti kryeministër, a mund të na tregoni se kur do të përfundojë studimi për minierën e re dhe kur do të fillojë të ndërtohet? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Procesi i shpronësimit, zonja Nagavci, është ky: banorët aplikojnë në një komision ndërministror dhe në KEK. KEK-u bën një kontratë me ta, e në atë kontratë parashihet çdo gjë, formën e kompensimit. Ka nga ata që s'marrin para për truall, se marrin truall, u është ndarë një tokë në Obiliq, ka nga ata që kërkojnë para për truall. Po ashtu, formulat e shpronësimit nuk janë formula që i kemi shpikur, nuk është e re formula, është e viteve të mëhershme, e përdorur. Sa është numri i tyre, nuk i kam numëruar, as s'e kam ndërmend t'i numëroj, as nuk i di emrat e tyre, as nuk i di moshën.

I kam parë përballë, kam biseduar me ta, Qeveria ka marrë vendim, ata që i zbatojnë kur e përmbyllim mund t'ju japim informata të çfarëdo natyre të doni, mundeni edhe tash të shkoni e t'i merrni informatat në KEK, jeni deputetë, shkoni e i merrni të dhënat e sakta çka është duke ndodhur me shpronësim, qysh ndodh. T'i kërkohet kryeministrit të vendit numrin e atyre që po shpronësohen, pse jo, bën, por pasi jeni deputetë, ju paguan populli, edhe lëvizini pak, shkoni e merrni informatat, se ju a japin.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli. Fatoni s'është këtu, Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit!

Edhe pse pak a shumë është meritë edhe e kryeministrit që sot na ka përzier të gjitha temat, të gjitha interpelancat, jo veç tri, por edhe këtë të katërtën, se ka të bëjë me luftën e krimit të organizuar, bile kryeministri në këtë aspekt e ka një meritë që i ka shpallur luftë krimit të organizuar në komplet sistemin energjetik, por kryeministër, nuk e di a e bërë taktikisht apo jo, po këto tema tash për neve është me rëndësi, të nderuar kolegë, që së paku rekomandimet të jenë të përbashkëta, edhe pse janë katër interpelanca, ne mund të merremi vesh që rekomandimet të jenë të përbashkëta së paku për tri interpelanca.

Iniciuesit e këtyre tri interpelancave të dakordoheshin me neve që t'i kemi rekomandimet e përbashkëta, sepse nuk ka kuptim që ato të jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën, e ka shumë mundësi. Po ashtu, unë sot nuk pashë asnjë pjesëtar të ZRRE-së, as KOSTT-it, që edhe ata janë përgjegjës dhe janë mekanizma të Kuvendit tonë. Duhet t'i thërrasim në interpelancë edhe mekanizmat, të cilët janë të këtij Kuvendi dhe janë përgjegjës për temat kaq të rëndësishme, çfarë është energjia. Pra, duhet të mësohemi t'i thërrasim në interpelancë edhe mekanizmat e tjerë. ZRRE-ja e ka, po më duket, është një përmirësim, së paku familjet, të cilat i kam pyetur sivjet, a është meritë e ZRRE-së apo e Qeverisë, familjet kanë paguar në fund të muajit shumë më pak se viteve të tjera. Nuk e di e kujt është kjo meritë, por në rrafshin praktik ka ndodhur që familjet tona për këtë dimër kanë paguar shumë më pak se viteve të tjera.

Temë tjetër që është me rëndësi është çështja e luftës, e luftimit të korrupsionit brenda sistemit energjetik, por me rekomandime. Unë edhe një herë ju propozoj që rekomandimet për këto tri tema që kanë të bëjnë me fushën e sistemit të energjisë të jenë të përbashkëta. Pra, rekomandime të përbashkëta për këto tri tema. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti, Milaim Zeka, meqë Grupi i tij parlamentar e ka shpenzuar kohën, ai do të flasë nga minutat e Deputetëve të Pavarur, sipas marrëveshjes së tyre dhe të Grupit Parlamentar “6+”. Urdhëro, Milaim!

MILAIM ZEKA: Të Grupit “6+”, e jo të Grupit të Pavarur, nejse edhe të Pavarurve e marr pak. Faleminderit!

Unë desha, zoti kryeministër, t’i diskutoj dy çështje: më la përshtypje, na e dhe një këshillë, duke thënë që jeni deputetë, paguheni dhe urdhëroni dhe shkoni në KEK merrni informacione. Sinqerisht, në qoftë se dëshiron si kryetar i Qeverisë të këtij vendi të dish, pikërisht këtu është burimi i krejt të këqijave të Kosovës. Unë po t’i them me emra që kam kërkuar që katër muaj kontratën prej ministrit të Qeverisë tënde, zotit Dardan Gashi, për KEDS-in dhe nuk ma ka dhënë. Prit, tash të tregoj pse. Kam kërkuar që pesë muaj prej ministrit Valdrin Lluka të më japë informacione zyrtare për Valën dhe Postë-Telekomin e Kosovës, asnjë informacion nuk ma kanë dhënë. Kam kërkuar prej Dardanit se ka qenë pjesë e shitjes kur është bërë KEDS-i, kur është shitur KEDS-i, për këtë kam kërkuar dhe pa u bërë publike të gjitha kontratat, qoftë KEDS-it, qoftë të KEK-ut, nuk mund të ecë ky vend përpara.

Zoti kryeministër, nuk po ju kritiko, nuk po ju akuzoj, sepse keni ardhur të vazhdoni punën e qeverive të kaluara, të cilat i kanë lënë 1 milion gozha të këqija në derën e këtij shteti, në derën e këtij vendi. Por sinqerisht, në qoftë se ju doni t’i çoni proceset përpara, atëherë duhet t’i bëni publike të gjitha kontratat. Duhet bërë publike kontratën e rrymës në mes të KEK-ut dhe “Ferronikelit”, jo vetëm të shitjes, se e shitjes veç dihet, po sot po flasim për rrymë. Zoti kryeministër, e kam thënë në këtë foltore që është blerë rryma nga Qeveria e Kosovës me 120 euro dhe i është dhënë për gjashtë vjet me radhë 33 euro çmimi fiks për megavat Ferronikelit dhe sot Ferronikeli gjoja falimentoi dhe i la mbi 1 mijë punëtorë të Drenicës pa punë.

Ky është domethënë tmerri i këtij vendi. Kam folur në këtë foltore, zoti kryeministër, për krimin e madh në Postë Telekomin e Kosovës dhe Valës 900, ku vetëm kontrata fikse, ish-drejtori i Valës së bashku me një person të vetin, i cili punon në Radiotelevizion të Kosovës, kanë krijuar 11 portale fikse, të paqena. 11 portale fikse dhe u kanë dhënë mijëra e mijëra euro muaj për muaj. Dhe, çka ka bërë, zoti kryeministër, Këshilli ndërministror yti? Kanë dashur t’ia vazhdojnë mandatin atij kriminelit, atij njeriu që ka vjedhur miliona në Valë e në Postë Telekomin e Kosovës. Tani, ju si kryetar i Qeverisë, në qoftë se dëgjoni punën tonë, fjalën tonë, argumentet tona si deputetë, atëherë duhet t’i thërrasësh ministrat, të cilët kanë votuar për vazhdimin e

mandatit të këtij njeriu. Tani kam një pyetje te KEK-u: si ka mundësi që KEK-u ka bërë kaq shkelje, kaq krime prej pasluftës e këndeje dhe të mos shkarkohet drejtori gjeneral i KEK-ut?! Po ai po të ishte shtatë herë pejgamber, e 20 herë Jezu Krisht, unë si kryeministër e kisha shkarkuar. Nuk ke drejtor prej luftës e deri sot në këto momente që po flas unë, në këtë foltore, të asnjë ndërmarrjeje publike që s'mund ta burgosësh për 20 vjet me sy mbyllur, pa prokuror hiç, sepse vetëm merrini dokumentet dhe raportet e auditorëve të përgjithshëm. Vetëm auditorët studioni, këta njerëz i çon në burg pa prokuror, por kush ka vjedhur e the sot shumë mirë aty, kush ka interesa, kush ka hëngër. Me këta e ka përzier kazanin aty, është tjetër problem. Ai është problem i Prokurorisë. Në qoftë se ka deputetë që janë të përzier në aferat e tilla, duhet të bëhen publik edhe emrat e deputetëve. Në fund po e cek një diçka, nuk di sa është e qëndrueshme, por me aq sa unë kam dëgjuar dhe duke mos harruar ta përmend kontratën, që Qeveria juaj e ka bërë me Contour Global, që unë e kam mbështetur dhe e mbështes në mënyrë absolute, se është temë shumë e gjerë pse e mbështes, sepse jam i prirë që më mirë të ketë rrymë sesa të mos ketë hiç, por unë kam informacione prej deputetëve të Listës serbe, të cilët thonë se nuk është e vërtetë që “ne furnizohemi prej KEK-ut, serbët e veriut të Kosovës”, por thotë “krejt ato fatura i kanë bërë vetëm për t'i vjedhur zyrtarët e lartë të KEK-ut”. Edhe lidhur me këtë duhet të bëhet një hetim.

Prandaj, zoti kryeministër, në qoftë se krijoni transparencë në Qeveri nëpërmjet kësaj mund ta luftojmë edhe krimin, edhe korrupsionin. Faleminderit!

KRYESES: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Procesi i shpronësimit është transparent dhe kushdo që dëshiron ta marrë vesh çka është duke ndodhur atje, s'ka nevojë për kryeministrin. Nuk është se unë po dua ta fsheh, por nëse duhet të kthehem tash në postë për ndonjërin, mund të kthehem, por ka mekanizma që mund ta gjejnë. Unë jam i bindur që nëse një grup parlamentar dëshiron të shkojë ta vizitojë KEK-un, ata i presin. Nuk janë të gjithë të një partie as atje, mezi presin të ankohen, besa edhe në Qeveri, e ndonjëherë edhe në të tjerët. Kështu që janë disa të dhëna që mund t'i merrni direkt në burim dhe jam shumë i sigurt që aty edhe mund ta krijoni një pasqyrë të caktuar.

Sa i përket vazhdimit të mandatit të drejtorit, nuk ka qenë vazhdim i mandatit, deri në zgjedhjen e të riut ka mundur të mbetet ai një muaj, 30 ditë, megjithatë është gjetur një formulë që të mos mbetet ai i mëhershmi, por të ngarkohet një ushtrues detyre. Kjo ka qenë tema.

I dëgjoj shumë konstatime të deputetëve për transparencë. Ne nuk po fshehim, por edhe kërkesat është mirë të bëhen në bazë të protokollit të paraparë. Për shembull, ministri, Milaim, më tha “ma ke dërguar veç një SMS”, tha më ke thënë “çoma filan kontratën”. Tha, “unë ta kam kthyer SMS-in, e të të them “a bën, çoma një shkresë, se ashtu është paraparë kjo punë”. Miqësisht, mundemi edhe kështu në dorë, por megjithatë protokollit është protokoll.

Shiko, unë nuk pretendoj në asnjë mënyrë që kriteret qeverisëse t'i kemi ndoshta si të Danimarkës, a si të Suedisë, a të dikujt tjetër, që ti i njeh në Skandinavi, edhe transparencën e krejt, por njëfarë korrektësie në punë do ta vendosim gradualisht përditë, e kemi përkrahjen e secilit për ta vendosur këtë korrektësi. Disa procese që kanë ndodhur në të kaluarën janë të pakthyeshme, pra nuk i kthejmë dot dhe kushedi çka të bëhet, por menjëherë kemi vendosur parametra të caktuar sesi ta garantojmë të tashmen. Edhe, për shembull, ftesat që ia kemi bërë Bordit të ri të PTK-së që të vijnë në Qeveri e të tregojnë se gjendja aty është e rëndë, nuk është bërë vetëm për ta sharë të kaluarën, se është bërë për ta krijuar tamam një formulë sesi të menaxhohet nga sot e më tutje. Sikur të mos e bënim atë, do të mund të mendonim se i kemi punët mirë atje, e të mos i kemi aq mirë. Edhe më mirë që e kemi bërë, e dimë ku jemi dhe e dimë se duhet pasur kujdes në hapat e mëtejme.

Ka plot tema të përditshmërisë që nuk po arrij as t'i shpjegoj, por po duhet të përballemi me to, t'i bëjmë. Shikoni, u fol më herët, por nuk guxoj t'i them krejt të dhënat në këtë kohë, ka diçka pse ka ndodhur edhe reduktimi i atëhershëm i tillë dy-tri ditë. Janë disa probleme të caktuara. Kur t'i kryejmë krejt, ndoshta do të vij t'i them. Një pjesë e tyre ka të bëjë edhe me disa marrëdhënie të ndjeshme, të trashëguara, jo që i kam krijuar unë e Qeveria ime, por të trashëguara. Derisa nuk i mbyllim duhet ta kemi njëfarë kujdesi, se po flasim pak a shumë për një interes nacional, që do të realizohet një ditë. Është e habitshme, që për shembull, ta kini parasysht, ne kemi marrë kredi të investojmë në transmision, ne paguajmë kamatën 1 milion euro në vit, e ai transmision s'është funksional. Kjo nuk është në këta shtatë muaj, por kjo është tani e disa vjet.

Është e habitshme pastaj, që e vërteta është se në veri ne e japim energjinë, nuk e jep tjetërkush dhe s'është mirë ta japë tjetërkush, dhe s'do të lejojmë të japë kurrkush energjinë atje, për shkak se është Kosovë si treg, mirëpo duhet të vendoset edhe rregulli i pagesave. Kemi ofruar për shpërndarës, pra për ta hapur tregun në shpërndarës, jo si KEDS-i, por në shërbime tregtare, mirëpo po na imponohet, ose po na kërkohet t'i thyejmë ligjet e Kosovës për këtë. Dhe, s'kemi arritur ta bëjmë.

Edhe ato devijimet e këqija që u lajmëruan më herët, që ndodhën jo veç te ne, por edhe në botë, janë rezultat i kësaj përballjeje se dikush ka filluar ta mbrojë interesin e të drejtën e këtij vendi. Është mbrojtur edhe në të kaluarën, ndoshta në rrethana tjera, në etapa tjera, por neve po na duhet të përballemi në këto aspekte tani.

Bazuar në këtë, kisha pasur dëshirë dhe veçanërisht ajo që më gëzon shumë është interesimi i madh për investime në energji alternative dhe po ju them se ka interesim edhe me erë, edhe shpresoj që ZRRE-ja e re, Bordi, do t'ua hapë mundësinë investitorëve, ka interesim për investime në solar, që është energji e ripërtërishme, që është energji e pastër, por Kosova kurrsesi nuk bën të heqë dorë prej burimit të vet, që është qymyri.

Do të ishte shumë gabim sikur ne të bazoheshim vetëm në energjinë e ripërtërishme, ose atë që e përmenda më herët, se s'do t'i plotësonte kërkesat tona, këtë po e them si për fund, do të ishte gabim të mos e aktivizojmë një resurs kaq të çmueshëm që e kemi, qymyrin. Kushtet për investim, shiko, kemi qenë në fund, prandaj besoni që sikur të mos vepronim edhe ato ditë do të mbeteshim pa investitorë. Dhe, herë do kurdo do ta vërtetojmë bashkë, që e kemi zënë, siç thotë populli, trenin e fundit, për të ndodhur investimi në energji, një investim që është folur prej kur unë kam kryetar Qeverie, më kujtohet, një herë më 2004 a 2005. Që atëherë kanë filluar diskutimet për investime në energji. 2004 a 2005 - 2018 bëjnë 14 vjet. Imagjinojeni sikur të na kishte ikur krejt edhe ne të bazohemi në energji. Ju e dini, ka vende sot që janë të varura në energjinë e vendeve që s'janë mike me to dhe i dini pasojat që i kanë në planin e brendshëm dhe në plan tjetër.

Është fat i madh që Kosova nuk bazohet në burime energjetike të atyre që kanë interesa tjera strategjike. Kjo e ka një kosto të vetën, se nëse do ta ruash një sovranitet të caktuar, sovranitet është edhe ekonomia, ne ankohe mi se kemi bilanc tregtar me njërin fqinj, qindra milionë deficit. Imagjinojeni sikur edhe energjinë ta blinim, çfarë do të ndodhte. Bazuar në këtë, gjendja e sotme për të cilën unë e di sesa është rëndë për shumë familje tonat për energji, kemi luftuar dhe fatmirësisht, e e falënderoj KEK-un sidomos, por edhe të gjitha mekanizmat tjerë, që nuk është rritur çmimi gjatë këtij dimri, se kemi qenë në telashe të mëdha, mirëpo gjendja e sotme në energji, kuptohet edhe rregullimi i këtyre raporteve KEDS - ZRRE - pastaj të gjithë mekanizmat tjerë, është detyrë e të gjithë neve. Edhe unë e mirëpres kontributin e Parlamentit, pra një presion i Parlamentit që të mos rëndohet qytetari, është i mirëseardhur.

KRYESUESI: Faleminderit! Miliam, s'ke kohë! Meqë është interpelancë, nuk keni të drejtë. Hykmete Bajrami e ka fjalën. Urdhëro! Atëherë, një minutë grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, urdhëro!

MILAIM ZEKA: Një minutë! E kam një propozim, kryeministër!

Unë mendoj që në çdo bord në të ardhmen, e do të duhej edhe në të kaluarën, të jenë edhe pjesëtarët e opozitës.

Anëtarë të bordit të jenë njerëzit që i propozon Vetëvendosja, njerëzit që i propozon Lidhja Demokratike e Kosovës, Grupi i Pavarur, në qoftë se duam ta luftojmë korrupsionin. Ky është propozimi im. E, ministrit i besoj në mënyrë absolute që ndoshta nuk ia kanë dhënë letrën, sepse besoj në ndershmërinë e tij, por letrën unë ia kam drejtuar më 15 mars.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Shkurt! Desha vetëm një pyetje për kryeministrin.

Kryeministër!

Gjatë të gjitha replikave dhe kundërargumenteve që i kishe me deputetët, ke folur shumë për rastin e shpronësimit dhe si e ke gjetur gjendjen gjetur në buzë të greminës. Në fakt, po krenoheni shumë me vendimin që e keni marrë.

Zoti kryeministër, unë e kam shumë të nevojshme ta di, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës nëse është e vërtetë që të gjitha shpronësimet që janë bërë nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe nga Departamenti për Shpronësim në kuadër të Ministrisë së Financave gjatë kohës së qeverisjes sonë nuk e kanë kapur asnjëherë shumën më të madhe se 4-5 milionë dhe ju e keni pranuar një shpronësim që kap shumën mbi 20 milionë euro. Po jua them edhe këtë, se kushdo që do ta kishte katërfishuar ose pesëfishuar çmimin e shpronësimit do ta rregullonte këtë çështje, në fakt në qeverisjen tonë ajo që ne kemi tentuar është që të mos lejojmë që institucionet të shantazhohen nga kushdo qoftë. Do të thotë, a mund të na tregoni për koston e shpronësimeve, që ju e keni pranuar në marrëveshje me banorët e asaj zone? Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministër, e keni përsëri fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Si ministër, s'ke nevojë për armiq. Partia jote, e nderuar ministre, jo që ka qenë e shantazhuar, por s'ka mundur ta zhvendosë një shtëpi dhe i keni lënë aty dhjetë vjet të ndërtojnë një mbi një. Domethënë, në dy vjetët e qeverisjes suaj janë ndërtuar ato dhe s'keni mundur t'i ndalni dhe janë rritur një mbi një, e s'e keni zhvendosur një, dhe e keni lënë Kosovën pa qymyr dhe pa prodhim. Mos bre!

KRYESUESI: Deputetja Hykmete Bajrami, replikë!

HYKMETE BAJRAMI: Kryeministër,

Nuk kemi qenë të shantazhuar, nuk kemi pranuar çmime eksponenciale, të cilat i keni pranuar ju. Në fakt, Komunën e Obiliqit e ka udhëhequr AAK-ja dhe në mandatin tonë ata janë përgjegjësit kryesorë që kanë lejuar ndërtimet pa leje atje. Po ju pyes edhe një herë për koston e shpronësimeve.

Në kohën tonë, shpronësimet e kanë kapur shumën prej rreth 4,5 milionë euro. Sa po ju kushtojnë juve shpronësimet? Kjo është pyetja, në të cilën insisto, i nderuar kryeministër, të më përgjigjesh.

KRYESUESI: Kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Si ta kryejnë krejt KEK-u, ju tregojnë, i kanë të dhënat, i kanë numrat, nuk e di sa bëhet. Do të bëhet aq sa bëhet. Edhe, dëgjo, ministre! 4

milione i paskëshit bërë për nja dy vjet shpronësime a, sipas kalkulimit tuaj. A e dini sa i keni bërë humbje Kosovës me gjendjen në energji? Mos harroni, dita ka shkuar deri në 1 milion.

KRYESUESI: Hykmete, urdhëro! E ke prapë fjalën me minutat e grupit parlamentar.

HYKMETE BAJRAMI: Kryeministër!

Në fakt, as unë nuk i kam të dhënat sesa kanë qenë humbjet. Unë e di që deri në këtë kohë ka pasur rezerva të thëngjillit të mjaftueshme dhe është prodhuar me kapacitetet e mundshme, që i ka pasur KEK-u, por ajo që është interesante është se si ka mundësi që po e dini me saktësi se sa ka humbur Kosova, ndërkohë që nuk jeni në dijeni se çfarë marrëveshjeje keni arritur. Cila është kostoja e shpronësimit? Ju kur i keni vënë atje firmat, po mendoj ju, stafi juaj, dhe të gjithë banorët, aty është biseduar për çmim të shpronësimit. Kjo ka qenë ajo që ka qenë diskutabile. Banorët kanë pranuar të zhvendosen, por nuk e kanë pranuar çmimin që e ka përcaktuar Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Departamenti i Shpronësimeve në kuadër të Ministrisë së Financave.

Ne ju kemi parë juve nëpër medie, ju keni shkuar, keni biseduar me ata atje dhe keni folur, edhe njëherë - përgjegjësi kryesor ka qenë Komuna e Obiliqit, që është udhëhequr nga AAK-ja edhe në mandatin e kaluar, por edhe në këtë mandat.

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Totali i shumës, kur të kryhet puna, se s'mund ta di unë pa u kryer procesi i shpronësimit. Kriteret janë vendosur, aplikon secili prej tyre. Ata që i përmbushin i nënshkruajnë kontratat me KEK-un, kur të kryhet krejt, jua jap një të dhënë, raport apo sido që e quajmë, dhe me siguri që është publik dhe është i të gjithëve.

Megjithatë, zonja ministre, është i habitshëm pra fakti se nuk ka pasur një metër kub qymyr rezervë dhe s'ka pasur ku të mihet. Kjo ka qenë gjendja e KEK-ut. Pyeteni KEK-un. Pyeteni ndonjë koleg tuajin që do t'jua thotë të vërtetën. Keni edhe në KEK njerëz që janë në LDK, me besim e me bindje. Ju tregojnë edhe ata, se nuk janë Aleancë, nuk janë njerëz që i kam çuar unë në atë punë dhe nuk i kam njohur shumicën e tyre, por gjatë bisedës me ta ma kanë treguar gjendjen se si është. Pra, Kosova ka qenë pa qymyr rezervë, pa njerëz të shpronësuar, vetëm për ta hequr dheun merr shumë kohë, ende jemi duke e sanuar atë gjendje. Dhe, për import, mos harroni dhe po ua përsëris, dita ka shkuar deri në 1 milion euro, se ma kanë thënë ata. Kjo ka qenë gjendja e Kosovës.

KRYESUESI: Hykmete, prapë e ke fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Kryeministër!

Edhe një herë po ju them që Qeveria e kaluar në krye me zotin Isa Mustafa e ka pasur të vetmin qëllim, që t'i respektojë institucionet, t'i respektojë vendimet e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Departamentit të Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Financave. Më besoni që po atë minutë që ne do të pranonim ta pesëfishonim çmimin, t'i pranonim të gjitha kriteret që i kanë kërkuar banorët e asaj zone për ato shtëpi, të cilat ne e dimë se nuk kanë qenë shtëpi, nuk janë shtëpi të banueshme, shumica e tyre janë skelete, që janë ndërtuar me qëllim të shpronësimit, edhe ne do ta kishim zgjidhur këtë problem.

Andaj, ju siguroj që kostoja e shpronësimit ka shumë mundësi që të jetë shumë më e madhe sesa humbjet, që në çfarëdo alternative ne i kishim pësuar derisa të kishin vepruar organet e drejtësisë, të gjyqësisë e policisë mbi banorët, të cilët nuk i kanë pranuar vlerësimet e institucioneve të Republikës së Kosovës. Domethënë, kjo është çështja këtu që nuk ka hapësirë për krenari këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro kryeministër, e keni prapë fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A e keni ditur ju që për katërmbëdhjetë muaj ekskavatorët nuk kanë punuar dhe a e keni ditur se sa është kostoja që këta ekskavatorë s'kanë punuar? Po ju pyes sinqerisht. Nëse e keni ditur, ose nëse s'e keni ditur, kostoja është bukur e madhe në ditë për këta ekskavatorë që s'kanë punuar. Sipas jush, respektimi i ligjit qenka i tillë, që ju s'e pranoni shantazhin e banorëve, i lini ekskavatorët pa punuar 14 muaj, Kosovës i shkaktoni humbjet enorme, po flas mbi 100 milionë në këtë rast, në emër të mbrojtjes së një ligjshmërie, sipas jush dhe po ma sugjeroni mua që është dashur të sillem me logjikën e juaj, pra në respektim të ligjit të mos ndodhë zhvendosja sot, të mos ndodhë mihja sot, të mos punojnë ekskavatorët sot. Kjo po i bie kështu, të paktën.

Kush ju ka ndalur juve, zonja ministre e atëhershme, Qeverinë tuaj, të mos i paketoni këta banorë e ta zbatoni ligjin? A kam ardhur unë të ju pengoj? Pasi qenkeni ju të ligjit e me ligj, pse s'keni zbatuar ligj pra?

KRYESUESI: Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Sepse, kryeministër, ne i respektojmë institucionet dhe kemi pritur që organet të veprojnë për t'i zbatuar, por assesi shantazhi i banorëve nuk duhet të jetë arsye për juve, kryeministër, që t'i hidhni poshtë tri vendime të vlerësimit të pronave në atë pjesë dhe ta pesëfishoni çmimin. Domethënë, justifikimi që kemi pasur kosto të mëdha dhe për këtë arsye kemi pranuar shantazhin e banorëve, kjo mos harroni që ka konsekuenca të tjera, sepse qytetarët e Republikës së Kosovës do të mendojnë se sa herë ata kanë dëshirë për çfarëdo gjëje mund t'i shtantazhojnë institucionet e Republikës së Kosovës. E ky vend ka drejtësi, ka gjyqësi dhe ka

polici, është dashur t'i zbatoni vendimet e marra dhe pastaj të vini e të tregoni me krenari se i keni zbatuar vendimet e institucioneve, e jo të një partie politike.

KRYESUESI: Kryeministër, urdhëroni për replikë!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Dallon nga pak logjika, zonja ministre, nuk po dua ta teproj në llogarinë tuaj, as të partisë suaj. E kam pasur një ministër shumë burrë të mirë, Qemajl Ahmetin, ka qenë i Gjilanit, ministër i Infrastrukturës. Na tepruan 400 milionë, nuk i shtinte në punë, shumë burrë i arsyeshëm, shumë burrë i drejtë. Pse e ceka këtë? Dallon nga pak logjika.

Zonja ministre, ministri i Policisë, a i Rendit, a qysh do ta quajmë, ka qenë i partisë suaj. Sektorët që po i cekni i keni menaxhuar, keni mundur ju ta leni Kosovën atë ditë kur ka ardhur Qeveria e re me rezervat e veta në qymyr, me familjet e zhvendosura, dhe ekskavatorët duke punuar.

Për fat të keq, kjo s'i ka ndodhur Kosovës, ia keni lënë dikujt një bombë të kurdisur të bankrotit dhe për çudi ai e ka zgjidhur. Kush jeni kundër ankohuni tërë kohën, por unë s'e kisha lënë Kosovën në bankrot ekonomik, e duke folur pallavra e qysh flasin disa këtu.

KRYESUESI: Janë paraqitur edhe dy deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, por më duhet të ju them se ju në total keni 26 sekonda: Adem Mikullovcit dhe Arbërie Nagavci. Arbërie, urdhëro! Ju lutem ia jepni një minutë kohë.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë e kërkoja fjalën menjëherë pas zotit kryeministër, por s'po më vjen keq që nuk ma dhatë fjalën, sepse patëm mundësi shumë mirë ta shohim në këtë debat, në fakt sesi ka keqqueverisur edhe LDK-ja, e si po vazhdon të keqqueverisë edhe koalicioni PDK-AAK. Në fakt, po tregohet korrupsioni i vërtetë që ka ndodhur në këtë sektor.

Zoti Haradinaj, nuk m'u përgjigjët, domethënë pyetja ime ishte ajo që pastaj e bëri edhe zonja Bajrami, pra cila është vlera e shpronësimit dhe prej cilit vit do t'i shpronësoni ju ato prona? A janë edhe ato ndërtime që ju thatë një mbi një, a do t'i shpronësoni edhe ato prona? Dhe, në anën tjetër, kur do të përfundojë studimi për minierën e re dhe kur do të fillojë të ndërtohet miniera e re, sepse ju e përmendët ndërtimin e minierës së re disa herë si sukses. Kur do të fillojë ndërtimi i kësaj miniere?

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën për përgjigje.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Në çdo detaj të shpronësimit nuk kam mbërri të hyj. Pra, nuk di si të hyj në ato specifika që po i cekni, përpos kategorizimit. Pra, ndodh shpronësimi dhe kemi për t'i respektuar standardet e Bankës Botërore për këtë temë, që obligohemi, pra janë bërë në përputhje me to.

Tani, nëse gjeni ndonjë defekt, na ndihmoni edhe neve, i ndihmoni ligjit në çdo aspekt. Nëse ka ndonjë keqpërdorim a ndonjë send, ndihmoni ligjit, nëse gjeni diçka që s'është në rregull. Kë e kam shpronësuar, të ma jepni dynjanë s'e di. Unë s'kam shkuar t'i shoh ato stalla secilën, e shtëpinë e re, e të vjetër. Edhe ato që janë mbaruar atë natë, deri atë natë, po. Atë gjendje faktike që e kam gjetur e shpronësoj, e ka shpronësuar kjo Qeveri, se ne s'kemi shkuar të bëjmë rojë atje natën e të shohim se kush e ka mbaruar, por ju siguroj që asnjë s'është mbaruar në kohën e qeverisjes sime, se s'ka pasur kur, se unë kam qenë në ditët e para të qeverisjes. Po, nëse dikush ka arritur t'i qesë tjegullat atë natë, edhe ai ndoshta ka hyrë në atë kategori. S'ke çka bën, se polic s'kam mundur të shkoj, as Policia të qëndrojë atje gjithë ditën s'ka mundur.

Tjetra që po dua ta shpjegoj, shpronësimi. Shikoni, unë e kuptoj nëse e keni hallin - a ka ndodhur korrupsion? Shikoni, se ndoshta ka. Nëse gjendet, le t'i gjejnë nëse ka korrupsion. Por, unë po ju siguroj diçka. Në standardet e Bankës Botërore, ata i përcjellin këto aspekte. Kanë ndodhur vendimet e Qeverisë, shpronësimi në kohë rekord dhe po të mos shkonim ashtu, sot ishim duke blerë rrymë nga të tjerët e duke dhënë para.

Kemi mundur të mbysim njerëz, se kemi pak fuqi, i kemi disa policë, kemi mundur me disa buldozerë ndoshta të mbysim edhe dikë në shtëpia, po duhet gjetur njëfarë marrëveshje me ta, edhe e kemi bërë njëfarë mesatare, ende nuk janë krejt të kënaqur, ka që po protestojnë, po vijnë te dera e po kërkojnë më shumë.

Kur ia nis miniera? Mirë kishte qenë po t'ia niste dje, se jemi vonuar, sa më shpejt duhet të bëhen përgatitjet dhe t'ia nisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i fundit i paraqitur është Salih Salihu, i ka dy minuta kohë. Urdhëro, Salih!

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Për fat të keq, edhe pas dy dekadave ne duhet të flasim ende për reduktimet e rrymës elektrike dhe përkundër rezervave të pafundme të thëngjillit në Kosovë.

Energjia elektrike nuk është më artikull luksi, por është artikull i domosdoshëm jo vetëm për ekonominë familjare, por edhe për zhvillimin e veprimtarive prodhuese të bizneseve si dhe institucioneve shëndetësore, hulumtuese e shkencore.

Prandaj, mund të themi që njëri nga faktorët për mungesë të investitorëve të huaj në sektorin e prodhimit është edhe jostabiliteti energjetik në Kosovë, pra reduktimet e paparashikuar, ku dëmtojnë rëndë pajisjet dhe makineritë në industrinë përpunuese.

Përderisa në vendet fqinje, konkretisht në Serbi, hapen dhjetëra-mijëra vende pune brenda një viti, te ne ikin madje edhe prodhuesit vendorë jashtë Kosovës në mungesë të kushteve të favorshme, e njëri nga këto kushte është edhe energjia elektrike.

Prandaj, zoti kryeministër, Kosovës i duhet një strategji e qëndrueshme për të stabilizuar sektorin e energjisë që, natyrisht, do të ndikojë në stabilitetin edhe ekonomik të vendit tonë.

Sa i përket pagesës apo faturimit të qytetarëve të Kosovës, pjesa veriore që nuk paguajnë rrymë, madje edhe ujë nuk paguajnë, ky është një vendim total i padrejtë dhe konsideroj se kryeministri duhet të bëjë diçka në këtë drejtim, se nuk është e drejtë, nuk është fer që të konsumojnë energjinë, të shfrytëzojnë energjinë dhe ujin dhe të mos e paguajnë e Qeveria e Kosovës t'i marrë për obligim t'i kryejë këto pagesa për pjesën veriore.

Ndërkaq paguesit e këtij buxheti, tatimpagues janë pjesa më e madhe qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ky është një vendim arbitrar i ish-Qeverisë në vitin 2014 dhe unë mendoj se ky vendim duhet të shfuqizohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. E pyes kryeministrin nëse dëshiron të marrë fjalën. Jo!

Atëherë propozuesi i interpelancës i ka pesë minuta kohë të paraqesë konkluzat dhe mocionin e mundshëm.

Kush e dëshiron fjalën? Deputetja Arbërie Nagavci, urdhëro!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse numri i deputetëve nuk është i mjaftueshëm dhe besoj që nuk do të votohet, ne po propozojmë që të harmonizojmë këto konkluzat, sidoqoftë Glauku mund t'i lexojë fillimisht dhe pastaj i harmonizojmë me grupet e tjera.

KRYESUESI: Galuk, e ke fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë mund të konstatoj se gjendja lidhur me harmonizimin e këtyre rekomandimeve është kështu:

Më duket që do të mund të arrijmë një pajtueshmëri me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me Grupin e Pavarur të Deputetëve. Nuk jam i sigurt sa u përket Nismës dhe Aleancës, e sa i përket Partisë Demokratike nuk më duket që ka një vullnet për t'i mbështetur këto rekomandime.

Kështu që, duke pasur parasysh që qëllimi ynë më i rëndësishëm është që këto të kalojnë dhe jo vetëm të lexohen, sepse t'i lexojmë është kallaj, por qëllimi dhe esenca është të votohen, të kalojnë, në mënyrë që të bëhen deri diku obliguese edhe për Qeverinë.

Unë propozoj që votimi i tyre të shtyhet deri në një harmonizim të plotë edhe me grupet e tjera parlamentare, ndoshta, të cilat janë përtej grupeve që i përenda, Lëvizjes Vetëvendosje, Lidhjes Demokratike dhe Grupit të Pavarur të Deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ne do të duhej të vazhdonim me pikën tjetër të rendit të ditës, por unë propozoj të marrim një pauzë të shkurtër deri në orën 19:30 dhe të vazhdojmë me pikën tjetër, një gjysmë ore. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,

Ju lus t'i zini vendet. Unë propozoj që të presim për kolegët tjerë edhe pesë minuta dhe pastaj, nëse s'kemi kuorum, do të detyrohemi ta ndërpresim seancën. Po ashtu, edhe kryeministri dhe asnjë përfaqësues i Qeverisë nuk janë në seancë.

Të nderuar kolegë,

Propozoj që të vazhdojmë punën. Unë e ftoj propozuesin e interpelancës, që ta paraqesë mocionin para deputetëve.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, pas dakordimit ndërmjet grupeve parlamentare Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur, këto janë nëntë rekomandime të cilat ne ua paraqesim deputetëve që t'i mbështetin.

REKOMANDIME

1. Qeveria brenda dy javësh, në bashkëpunim me menaxhmentin e KEK-ut, ta hartojë planin e masave për reagimin emergjent dhe afatgjatë për sigurimin e prodhimit të energjisë.

2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë të mos pranojë kërkesa për rritjen e çmimit të energjisë nga Kompania KEDS/KESCO.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës ta iniciojë sa më shpejt rindërtimin e Termocentralit “Kosova A”.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me KEK-u të përshpejtojë planin e remontit për Termocentralin “Kosova B”.
5. KOST-i ta realizojë kontraktimin e energjisë elektrike me Shqipërinë për periudhë afatgjatë.
6. Qeveria të ndërmarrë masa urgjente dhe t’i aplikojë ato për stabilizimin e prodhimit të qymyrit, si dhe sanimin e ndërtimeve të kundërligjshme në Shipitullë.
7. Të auditohet kontrata e privatizimit të Distribucionit nga KEDS-i, e cila nuk është bërë kurrë.
8. ZRRE-ja ta kërkojë planin e mirëmbajtjes nga KEDS-i, në mënyrë që ta kontrollojë procesin e shkycjeve që KESCO po i bën pikërisht në emër të mirëmbajtjes.
9. ZRRE-ja t’i shqyrtojë reduktimet, çmimet e larta, tarifat për biznese, që janë dukshëm më të larta, përdorimin e maksigrafit dhe kategorizimin në A+, këto që ndodhin dhe realizohen nga KEDS/KESCO.

Deri më tani, të gjitha këto rekomandime kanë arritur të krijojnë pajtueshmëri vetëm në taborin e opozitës, por do të ishte mirë që nëse mendojnë grupet tjera parlamentare, që janë rekomandime të rëndësishme, edhe nga mazhoranca, dhe që këtu ka vend për një pajtueshmëri edhe për deputetët që e përfaqësojnë mazhorancën, le të themi që ne jemi të gatshëm që të bëjmë ndonjë ndryshim, të përfshijmë edhe ndonjë rekomandim tuajin. Por, këto janë deri tash ato që kanë arritur të kenë pajtueshmëri ndërmjet tri grupeve parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në këtë pikë ne do të duhej të procedonim me votim, por në sallë janë vetëm 43 deputetë, kështu që konstatoj që ne s’mund të vazhdojmë punën. Unë jam i detyruar ta mbyll seancën.

Për kohën e vazhdimit, do të vendosë Kryesia e Kuvendit. Mirupafshim!

* * *

E enjte, më 31 maj 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18 dhe 26 prill 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikat e papërfunduara nga seanca plenare më 16, 17, 18, 20 e 26 prill 2018, si në vijim:

4. Votimi i Projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Duhet 2/3 e deputetëve, nuk janë 80, po e lëmë deri në momentin kur të bëhen 80, aktualisht janë 67.

13. Votimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Të nderuar deputetë,

Para se të procedojmë në votim lidhur me mandatin e anëtarëve të bordit, ju njoftoj se Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është bërë më 22 janar 2018, duke u bazuar në Ligjin numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 13, paragrafi, kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit emërohen me një mandat trevjeçar dhe të tjerët për një mandat dyvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Në ndërkohë, më 19 maj 2018 ka hyrë në fuqi Ligji numër 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili e ndryshon nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit numër 04/L034, kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtorët të tjerë të bordit emërohen me mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit emërohet me mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën, vetëm për konfirmim të kësaj pjese të mandatit katërvjeçar.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Ju të pranishëm,

Meqenëse për të mos u përsëritur atë që e tha kryetari i Kuvendit, zoti Veseli, se propozimi për plotësimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka ardhur në Kuvend në fillim të këtij viti kalendarik, duke ditur se në dhjetor të vitit të kaluar Agjencia e Privatizimit është pa bord dhe ne si deputetë nuk kemi arritur ta plotësojmë gjatë kësaj kohe pesë muaj me vonesë. Ndërkohë që ka hyrë në fuqi ligji, i cili e rregullon nenin për kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të Bordit të AKP-së.

Mendoj se është në të mirën e funksionimit të institucionit, në këtë rast, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit që deputetët sot të vendosin, meqenëse është në fuqi ligji, i cili e ka ndryshuar nenin me të cilin ka ardhur propozimi nga Qeveria, kështu që sot ne si deputetë mendoj që duhet të votojmë për mandatin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit bazuar në ligjin, i cili është në fuqi tani.

Ju ftoj të gjithëve për një votim pro, meqenëse kanë mbetur shumë punë pa u kryer, ky institucion ka vakum duke ditur se ka mungesë të vendimmarrjes në mungesë të anëtarëve të Bordit të AKP-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Regjia, deputetë, të përgatitemi për votim, votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 46 për, 18 kundër dhe zero abstenim, Kuvendi emëroi gjashtë anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me mandat katërvjeçar.

4. Votimi i Projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Albulena Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Më lejoni që para jush ta paraqes qëndrimin e Grupit Parlamentar lidhur me këtë çështje.

Natyrisht që ne i kemi thënë qëndrimet nëpërmjet deputetit Sami Kurteshi lidhur me Projektligjin numër 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë, për transferimin e personave të dënuar. Pra, ne konsiderojmë që është një projektligj i duhur dhe natyrisht që do ta mbështesnim, por që kërkesa e grupit parlamentar është e tillë që ne nuk mund

të votojmë për këtë projektligj në qoftë se Kuvendi nuk e mundëson kuorumin lidhur me propozimin për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Aida Dërguti.

Pra, prej momentit kur disa nga deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kanë formuar një grup të ri parlamentar, Grupi i Deputetëve të Pavarur, pozicioni i nënkryetarit të Kuvendit i takon Lëvizjes Vetëvendosje.

Më lejoni ta lexoj nenin e Kushtetutës, është neni 67, zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve dhe është paragrafi tre:

“Tre nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

Ne si grup parlamentar kemi pritur nga zonja Dërguti që në momentin kur ka dhënë dorëheqje nga grupi parlamentar do t'i lërë edhe të gjitha pozicionet që i mban në kuadër të grupit parlamentar, mirëpo kjo nuk ka ndodhur dhe pozicioni që sot mban zonja Dërguti e mban në mënyrë jokushtetuese.

Prandaj, ne kemi kërkuar shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Aida Dërguti, meqë ajo nuk po tërhiqet.

Është e qartë që dikujt përmenda Kryesisë së Kuvendit, ndoshta edhe kryetarit të Kuvendit, nuk po i konvenon që ta ketë një përfaqësues të Vetëvendosjes aty, për shkak se pastaj do ta ketë më problem edhe kryesimin e mbledhjeve të komisionit.

Ne kërkojmë që ky pozicion, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, t'i jepet Lëvizjes Vetëvendosje, ne natyrisht nuk ndërhyjmë në votën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është Kuvendi që vendos për këtë, në qoftë se zonja Dërguti ende mendon që të mos dorëhiqet. Prandaj ne nuk do të përkrahim asnjë marrëveshje ndërkombëtare në qoftë se paraprakisht nuk votohet kërkesa jonë, pavarësisht në qoftë se deputetët votojnë për apo kundër, kjo nuk ka rëndësi, do të ishte mirë që të votonin për, mirëpo megjithatë e rëndësishme është që të mundësohen 80 vota të deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Këtë çka e kërkoi kolegja, tani e kemi në rend të ditës, forma e kushtëzimeve nuk është e pranueshme, po qe se dëshirojmë, mund të bëjmë shaka dhe të hapim diskutim.

Sot e kemi si pjesë të diskutimit përmes procedurave shkojmë në këtë, pastaj shkojmë në atë tjetrën dhe të mos e komplikojmë situatën, lufta politike zhvillohet pikërisht këtu në Kuvend, është simpatike kjo.

A të është përmendur emri? Shkojmë drejt në votim. Çështja është se grupi parlamentar do të votojë, nuk do.

Ne të njëjtën kohë e kemi edhe atë pjesën e dytë të votimit. Veç Aida, s'e kam ditur se nuk ke qenë kurrë nënkryetare e Lëvizjes Vetëvendosjes, e mora vesh, se LDK-ja prej fillimit thoshte se unë e kam krijuar Vetëvendosjen.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, e thashë, vetëm pak: Votimi i projektligjit numër 06/L-061 për ratifikimin e traktit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar, duhen 2/3 e deputetëve, duhen 80 vota. Po, janë mbi 80, aktualisht janë 86 deputetë, për këtë arsye e riktheva prapë. Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar, 67 për, nuk e ka numrin e nevojshëm, duhen 80 deputetë.

24. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave

Zonja Shqipe Pantina, ju ftoj që në cilësinë e propozuesit ta paraqitni propozim-rezolutën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit! Vetëm një korigjim, është luftimi i korrupsionit si kusht për liberalizimin e vizave, jo siç është në agjendë: korrupsioni si kusht për liberalizimin e vizave.

Para se ta lexoj rezolutën, dua t'i falënderoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare, zotin Driton Selmanaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hajdar Beqën nga Partia Demokratike e Kosovës, Glauk Konjufcën nga Lëvizja Vetëvendosje, Muharrem Nitaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Enver Hotin nga Nisma Socialdemokrate dhe Fikrim Damkën nga 6+ për harmonizimin e këtyre rekomandimeve, të cilat unë tani në emër të tyre do t'i propozoj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, pas debatit parlamentar të zhvilluar në vazhdimin e seancës plenare të 18 prillit 2018, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, në emër të grupit atëherë të Deputetëve të Pavarur dhe harmonizimit të tekstit edhe me grupet parlamentare, nxjerr këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon të rritet buxheti dhe të ngrihen kapacitetet profesionale për sektorin e drejtësisë, përfshirë Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor.
2. Kërkon nga organet e drejtësisë, Prokuroria dhe Gjyqësori, që të jenë më efikase në zgjidhjen e rasteve që ndërlidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

3. Kërkon nga Qeveria hartimin dhe procedimin në Kuvend brenda këtij viti kalendarik të projektligjeve që ndërlidhen me forcimin e masave në luftë kundër korrupsionit.

4. Kërkon nga Qeveria departizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të tjera të pavarura.

Unë ju ftoj që t'i votoni këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Lidhur me vërejtjen e deputetes, ne vetëm i referohemi materialit zyrtar, ky ka qenë edhe materiali, në bazë të të cilin 11 deputetë janë nënshkruar: Kërkesë me anë të cilës kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të organizojë një debat të veçantë për korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave, Shqipe Pantina, Dardan Sejdiu, Dardan Molliqaj, Visar Ymeri, Aida Dërguti, Fisnik Ismajli, Dukagjin Gorani, Driton Qaushi, Besa Baftiu, Faton Topalli, Salih Salihu, Frashër Krasniqi. Kërkesën e ka shpalosur zonja deputet Shqipe Pantina. Faleminderit!

A shkojmë drejt votimit?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, jemi në procedurë, nuk ka më debat, më vjen keq.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, 83 deputetë janë në sallë, votojmë tash, votoni, ju lutem!

70 deputetë kanë votuar, 70 për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga deputetja Shqipe Pantina dhe deputetët mbështetës, të harmonizuar nga grupet parlamentare.

25. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë

Ftoj deputeten Teuta Haxhiu që në cilësinë e propozuesit t'i paraqesë rekomandimet.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër,

Qeveri,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit parlamentar të zhvilluar më 18 prill 2018 sipas kërkesës së grupit që ka nënshkruar, bashkë me mua, propozon këto rekomandime:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të mbrojë secilën fëmijë nga përmbajtje të dhunshme dhe të dëmshme për zhvillim, duke siguruar që institucionet përgjegjëse të ofrojnë internet të sigurt për shkolla, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqe që përmbajnë përmbajtje joadekuate për fëmijë.
2. MASHT, DKA, shkollat organizojnë aktivitete vetëdijesuese për prindër, mësime dhe nxënës për rreziqe që vijnë nga keqshfrytëzimi i internetit.
3. Të organizohen trajnime obliguese për zhvillimin e kapaciteteve të mësimeve për përdorimin e TIK-ut në shkolla dhe mbrojtje nga rreziqet në internet.
4. Udhëzuesit për përdorim të sigurt të internetit të promovohen dhe mësimeve të obligohen që t'i shfrytëzojnë si burime alternative gjatë procesit të mësimeve.
5. Hartimi i rregulloreve në nivel shkollor që të rregullojë çështjen e përdorimit të internetit brenda hapësirave shkollor.
6. Shërbimet profesionale brenda shkollës të krijojnë mekanizma për të adresuar dhënën që buron nga keqshfrytëzimi i internetit, fuqizimi i ekipeve për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve.
7. Plani zhvillimor i shkollës të plotësohet me masa dhe veprime konkrete për rritjen e sigurisë në shkollë, duke përfshirë masa konkrete për parandalimin e dhunës nga keqshfrytëzimi i internetit.
8. Të organizohen debate dhe programe edukative nëpër televizione nacionale dhe në media të tjera, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për përdorimin e drejtë të internetit.
9. Këshilli i prindërve dhe familjarëve nga ana e profesionistëve të punojnë me fëmijë për monitorim të fëmijëve gjatë përdorimit të internetit për të siguruar përdorim të drejtë të internetit nga fëmijët.
10. Të vetëdijesohen prindërit dhe t'i monitorojnë fëmijët që të mos përdorin informata të rrejtshme për të hapur profilet e tyre si të rritur, pasi që shumica e kompanive të rrjeteve sociale e kanë të rregulluar çështjen e profileve për të rritur nën moshën 14-vjeçare, dhe
11. Të sanksionohet me ligj shantazhi i fëmijëve në rrjetet sociale dhe ruajtja e privatësisë së fëmijëve gjatë përdorimit të internetit.

Duke falënderuar secilin grup parlamentar, me përjashtim të Listës serbe që nuk ka qenë atë ditë, falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar edhe gjatë debatit, por njëkohësisht edhe në harmonizimin e rekomandimeve, çka i ftoj të gjithë kolegët e mi që t'i votojnë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë do të shkojmë drejtpërdrejt në proces të votimit, lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Në sallë janë 86 deputetë. Votojmë tash! Faleminderit!

Në votim kanë marrë pjesë 70 deputetë, të gjithë janë për, Kuvendi i miratoi rekomandimet.

17. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë

Debati për këtë pikë të rendit të ditës është përmbyllur.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, në sallë tani janë 78 deputetë. Votojmë tash:

Në votim kanë marrë pjesë 60 deputetë, 47 janë për, 4 janë kundër dhe 9 abstenime, një deputet është me dorë, kështu që 61, Kuvendi i miratoi rekomandimet.

18. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5 mars 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 1 milion eurosh për KOSTT-in me qëllim mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës lidhur me vendimin e lartcekur të Qeverisë. Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë, ndërkaq që të mos përsëris, minutat janë të pjesëtuar për grupet parlamentare, sipas madhësisë, ashtu siç e përcakton Rregullorja.

Atëherë, ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Avdullah Hotin, si propozues i interpelancës, që ta marrë fjalën, vërtet fjalën do ta ketë në këtë rast deputetja Mimoza Kusari-Lila. Mimoza, keni në dispozicion 10 minuta për të bërë parashtrësën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit! Kryesues, kërkoj vetëm një përjashtim të rastit, i kërkoja edhe kryetarit për një çështje që besoj të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të

përgjegjshëm. Sot është 31 maji, Dita Botërore kundër Duhanit. Në Kosovë, për informatën tuaj 34% prej meshkujve të moshës 15 deri në 49 vjeç, 19% të femrave tymosin duhan. Me ekonomi familjare të paktën një fëmijë në moshë 0 deri 5 vjet, siç e dini edhe OBSH-ja e karakterizon duhanin si shkaktarin kryesor edhe të sëmundjeve kronike, edhe kancerit, të dy këto dukuri, të cilat janë në masë në rritje në Kosovë. Sot ju kërkuj si deputete, si kolege që ta respektojme këtë ditë dhe të paktën në ndërtesën e Kuvendit, në bufenë e Kuvendit, ku konsumohet duhani, të mos pihet duhan. Kjo është më e pakta që mund të bëjnë sot në Ditën botërore, pasi që ligjin që e ka miratuar po ky Kuvend më 22 maj 2013 e vërejmë se ka shkelje serioze në të gjitha hapësirat, përfshirë edhe këtë institucion.

Tash po vazhdoj me pikën e radhës të rendit të ditës.

Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Çlirimi i Kosovës në qershor të vitit '99 nuk e solli edhe kontrollin e plotë në territorin e Kosovës dhe asetëve të saj. Fillimisht, nga bashkësia ndërkombëtare, UNMIK-u dhe KFOR-i, si administratorë të asokohshëm të Kosovës, e pastaj e as nga autoritetet e Republikës së Kosovës të shpallur shtet nëntë vjet më vonë, më 17 shkurt 2008. Përderisa, ende në këtë Kuvend dhe shumë kuvende të tjera po diskutojmë kush ishte më trim, më i fortë, kush është më përgjegjës dhe meritë për lirinë që gëzojmë sot, shumë pak po diskutojmë se si do t'ia bëjmë çështjeve, të cilat nuk arritëm t'i përmbyllim bashkë me partnerët ndërkombëtarë që nga viti '99.

Këto çështje na kanë kushtuar dhe po na kushtojnë shumë, për 19 vjet. Ndërsa, përveç atyre që përfitojnë, tregtarët dhe mafiozët e energjisë, të gjithë të tjerët po humbin. Një prej këtyre temave, të cilët po humbim për 19 vjet është energjia elektrike. Kosova humbi kontrollin e saj të plotë mbi asetet e energjisë së shpërndarë dhe shërbimet që lidhen me të prej qershorit të '99-të, ndërsa pati gati se qasje të ndaluar në veriun e vendit pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008. Sot, edhe pse Kosova është një territor administrativ, institucionet e Kosovës, KOSTT, KEK, KEDS nuk kanë qasje në asetet e veta në veri të vendit. Sot ato mirëmbahen nga punëtorët serbë kosovarë, të cilët paguhen nga EPS-i, apo Elektroprivreda Serbie, apo edhe nga të hyrat, të cilat jashtëligjshëm mblidhen për inkasimin e rrymës, të cilën aktualisht po e furnizon KOSTT.

Në mungesë të çfarëdo kontrolli zyrtar të asokohe, KEK-u si distributor i energjisë elektrike dhe në përgatitje të procesit të privatizimit të kompanisë së distribucionit, nga këshilltarët e Qeverisë dhe transaksionit të KEDS-it, me kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të asaj kohe është kërkuar ZRRE-ja të llogariten humbjet e shkaktuara në sistem, nga mospagesa e rrymës në veri dhe të njëjtat të faturohen tek të gjithë konsumatorët e qasshëm të distribucionit. ZRRE e miratoi këtë kërkesë të Qeverisë dhe filloi zbatimin e saj, ky vendim është marrë më 6 shkurt 2012. Në anën tjetër, në kuadër të bisedimeve me Serbinë në Bruksel, më 8 shtator 2013 arrihet

marrëveshja për energjinë, e cila parasheh pavarësimin e sistemit të transmisionit të Kosovës, gjegjësisht krijimin e një kompanie të re për furnizim me energji elektrike në veri me ligjet e Kosovës, kthimin e linjave 110 KV në Vallaç, punësimin e punëtorëve të Elektroprivreda Serbie të veriut me sistemin kosovar, si dhe komunikimin dhe bashkëpunimin e të dy operatorëve të transmisionit të sistemit Kosovë-Serbi. Me fjalë të tjera, njohjen reciproke të dy sistemeve elektro energjetike.

Para tre vjetëve, më saktësisht, më 25 gusht 2015, në Bruksel janë nënshkruar dhe konkluzionet për marrëveshjen e energjisë, së bashku me marrëveshjen për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, planin e veprimit për telekomunikacionin, si dhe marrëveshjen për lirinë e lëvizjes, konkluzionet për urën e Mitrovicës. Në ndërkohë asnjë progres apo zbatim i kësaj marrëveshje nuk është realizuar, bile shumë pak u fol për të, e tëra ra nën hijen e marrëveshjes për Asociacionin e komunave serbe, ndërsa edhe sot pak e fare dëgjojmë të takohen përfaqësues të lartë të shtetit në trajtim të kësaj teme. Për moszbatim të kësaj marrëveshjeje, për vite me radhë u pagua nga xhepi i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, përveç atyre të veriut.

Në vitin 2017, më konkretisht më 4 maj Avokati i Popullit filloi betejën ligjore për të nxjerrë jashtë faturave të energjisë elektrike pagesën e humbjeve politike, siç e karakterizon Zyra e Rregullatorit të Energjisë, për konsumatorët e pjesës veriore të Kosovës dhe fitoi rastin në dy instanca të gjykimit, në Gjykatën për Konteste Administrative dhe në Gjykatën e Apelit. Me vendim të Gjykatës Supreme, e cila refuzon kërkesën e ZRRE-së për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkelje të të drejtës materiale. Pas kësaj beteje ligjore, ZRRE më 30 nëntor 2017 propozoi një zgjidhje të përkohshme, e cila nuk e pasqyron vendimin e bordit, por është udhëzim që KOSTT përkohësisht duhet të furnizojë katër komunat në veri, pa ndonjë shpjegim apo veprim se si do të mbulohen kostot për këtë energji të shpenzuar.

KOSTT, në pamundësi financiare dhe legale dhe qasjes fizike në veri, në përputhje me Udhëzimin e ZRRE-së vazhdon furnizimin me energji, duke tërhequr energji nga sistemi interkonektiv rajonal për të mbuluar furnizimin me energji në veriun e Kosovës. Më 1 dhjetor 2017 KOSTT informon kryeministrin Haradinaj, kryetarin e Kuvendit, Veselin, presidentin Thaçi, ministrin Lluka, ministrin Hamza, ZRRE-në, se humbjet e këtij institucioni do të jenë dramatike, ndërsa furnizimi i energjisë në veri do t'i kushtojë KOSTT-it 8.5 milionë euro për tre muaj të dimrit. Bazuar në çmimin e tregut në bursën e energjisë, shtesë kësaj janë edhe dëmet në pamundësinë e qëndrueshmërisë financiare të të vetmes ndërmarrje publike, e cila ka qenë deri asokohe e shëndoshë financiarisht, karshi obligimeve që ata i kanë ndaj Bankës Gjermane për Zhvillim dhe BERZH-i për mosmundësinë e mirëmbajtjes së aseteve të KOSTT-it, bashkë me funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e biznesit.

KOSTT nuk ka marrë asnjë përgjigje asokohe nga të gjithë të lartpërmendurit. Më 15 janar 2018 të gjithë personave të lartpërmendur prapë iu dërgohet edhe një letër e dytë dhe të gjithë

informohen se vendimi i gjykatës për mosfaturim të energjisë të konsumuar në veri, pamundëson KOSTT të mbulojë humbjet dhe si rrjedhojë e kësaj KOSTT duhet të tërheqë energjinë nga sistemi interkonektiv për të furnizuar veriun, por nuk do të ketë mundësi të kthejë në sistemin interkonektiv energjinë apo mjetet për atë energji të tërhequr.

Në letër gjithashtu shpjegohet se deri në fund të marsit këto humbje do të arrijnë 5 deri në 6 milionë euro. Qeveria e Republikës së Kosovës vendos më 5 mars 2018 të paguajë 1 milion euro për KOSTT për furnizim me energji elektrike të katër komunave në veri. Pas vërejtjeve që merr KOSTT nga TSO-ja evropiane apo NSI dhe problemit të njohur të vonesës së orës elektrike për gjithë Evropën.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha agjencitë dhe institucionet, të cilat merren me këtë çështje, raportojnë apo janë të autorizuar nga ky Kuvend. Për ZRRE-në dhe KOSTT, Kuvendi është pronar, ndërsa Qeveria, përveç se votohet nga Kuvendi, me rezolutë të vitit 2013 është autorizuar enkas për dialog me Serbinë. Po ky Kuvend më 9 shkurt 2018 ka mbajtur një seancë plenare dhe ka nxjerrë tri rekomandime, të cilat kërkojnë:

1. Ndaljen urgjente të praktikave të kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri.
2. Ka kërkuar nga Qeveria, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS të gjejnë mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke i trajtuar të gjithë konsumatorët të barabartë dhe
3. Ka kërkuar nga ZRRE-ja ta nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohet zbritja e tarifave që do të mundësojë kompensimin e konsumatorëve.

Por, duket se hallkat e vendimmarrjes dhe ndarjes së pushteteve nuk funksionojnë në Kosovë, siç e kuptojmë çdo ditë e më tepër. Në kundërshti me tri rekomandimet e Kuvendit dhe pa asnjë propozim tjetër alternativ dhe pa asnjë përpjekje serioze për zgjidhje afatgjate, Qeveria ndan një milion euro për KOSTT-in, për furnizim me energji elektrike për katër komunat veriore dhe e vazhdon papërgjegjësinë e saj.

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës,

Është evidente se problemet në këtë sektor janë të lidhura me mospraninë dhe administrimin institucional njëjtë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Dëmet nga kjo situatë janë të shumëfishta, por ato po i paguan qytetari i Republikës së Kosovës.

Çka vlen të përmendet? Prej vitit '99, rryma e shpenzuar në veri nuk është paguar asnjëherë. Në vitet 2008 - 2018 Kosova nuk ka marrë asnjë të hyrë nga sistemi i vet interkonjeksionit. Si

rrjedhojë e mosinkasimit të mjeteve nga trafiku i energjisë elektrike janë humbur 52 milionë euro, të cilat janë inkasuar nga Serbia. Humbin milionë të tjerë si rrjedhojë e mosfunktionalizimit të linjës së interkonjeksionit me Shqipërinë, si pasojë e moslejimit të Serbisë. Vetëm gjatë vitit 2017, dëmi total i bërë sistemit të Kosovës nga transmissioni i Serbisë është 9,7 milionë euro. Në ndërkohë, ndërmarrja publike pronare e së cilës është Kuvendi i Kosovës, transmissioni në këtë rast, më 1 tetor 2015 ka nënshkruar marrëveshje për kyçje në sistem energjetik të Kosovës në zonën e Evropës Kontinentale, por që asnjëherë nuk është funksionalizuar për shkak se ne ende jemi si nënrajon i Serbisë.

Kjo situatë e rënduar nuk është prej dje dhe nuk është as me ardhjen e kësaj Qeveri. Kjo situatë është që nga çlirimi i pjesës më të madhe të Kosovës, por jo edhe qasshmërisë sonë në veri. Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj e ndihmojnë stabilitetin energjetik të Evropës Juglindore, ndërsa rrethanat janë rënduar së fundmi. Qeveria e Kosovës në ndërkohë me vendimet e fundit, pa trajtim serioz dhe profesional, është bërë pjesë e shkeljes së dyfishtë të të drejtave të njeriut, duke faturuar tani nëpërmjet Buxhetit të Kosovës në veri, shkelëse e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës, të dala nga seanca plenare e 9 shkurtit 2018 për situatën energjetike, duke mos e zbatuar rezolutën e Kuvendit për dialogun e Serbisë, shkelëse e vendimit të Kuvendit për dialog, mbajtëse e skemës mafioze të tregtarëve të energjisë, të cilët i shesin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Lus regjinë që t'ia vazhdojë fjalën deputetes nga minutat e Grupit Parlamentar.

MIMOZA KUSARI-LILA: ...me energji me tarifa më të shtrenjta. Krejt kjo, përderisa pamundësohet funksionalizimi i linjës së interkonjeksionit me Shqipërinë dhe qasja e drejtpërdrejtë e KOSTT-it me NSOI, bëhet rrënuese e afarizmit të suksesshëm të deritashëm të KOSTT-it dhe imazhit të saj karshi institucioneve ndërkombëtare.

Me këtë interpelancë, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të rekomandojë:

- Ta obligojë Qeverinë që në afat prej një muaji të vijë me zgjidhje për situatën e krijuar, përfshirë këtu planin e kompensimeve të humbjeve të KOSTT-it, të caktuara nga udhëzimi i ZRRE-së për furnizim të rrymës në veri;
- Të llogarisë vlerën totale të pagesave për rrymën në veri dhe të kalkulojë kthimin e vlerës së papaguar për këta konsumatorë;
- T'i ndalë inkasimet ilegale, të cilat sot dikush i bën për rrymën e faturuar në veri, që e inkason, por nuk e furnizon veriun me rrymë;

- Domosdoshmërisht të kushtëzohet vazhdimësia e dialogut me zbatimin e marrëveshjes për energjinë, duke e krijuar një task-forcë të përbërë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe përfaqësues të autoriteteve të përfshira në çështje (KOSTT-i, ZRRE-ja, ARBK-ja) dhe të koordinohen veprimet për dialog të nxjerrë nga KOSTT në situatën aktuale.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Sovraniteti i Kosovës është sfiduar çdo ditë të vitit me moszbatimin e marrëveshjes së energjisë. Kosova është peng i interesave agresive dhe kriminele të Serbisë dhe interesave kriminele të disa individëve të caktuar në Kosovë, të cilët pasurohen nga shitblerja e energjisë elektrike, duke e penalizuar qytetarin e Republikës së Kosovës për paaftësinë e saj. Derisa lajmet e përditshme i kemi me emërim shtesë të zëvendësministrave, koordinatorë mbi koordinatorë dhe mbi megalomaninë e kësaj Qeverie, ne debatojmë, ose duhet të debatojmë në këtë Kuvend se kush do ta përfaqësojë Kosovën në dialog. Dhe, natyrisht, se të gjitha kompetencat për zgjidhjen e çështjes së energjisë i ka Qeveria e Kosovës, e keni kryeministrin që heq dorë nga obligimet e tij për ta përfaqësuar Kosovën në këtë dialog dhe sjell propozimin e rezolutës në Kuvend për përfaqësim të Presidentit.

Deri më tani, për informatën e të gjithë juve, duhet të dimë se KOSTT-in aktualisht e kemi me 6,1 milionë euro borxh prej marsit, prej të cilave 4,3 milionë janë nga interkonjeksioni evropian, ndërsa 1,8 nga prodhimi në KEK. Zgjidhje kësaj çështjeje nuk mund t'i jepet askund, përveçse në këtë institucion, në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Krejt çfarë duhet të bëjmë është ta marrim me seriozitet detyrën dhe kompetencën tonë, të kemi përgjegjësi më shumë se kurrë më parë. Flasim për interesin për shtetin, për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe, siç po shihet, me zgjidhjet e deritashme që i ka sjellë kjo Qeveri, zgjidhje të mirëfilltë nuk mund të ketë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjet që e ngriti përfaqësuesja e Grupit Parlamentar të LDK-së, grupit që e ka iniciuar interpelancën. Kryeministri do t'i ketë në dispozicion 15 minuta.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Deputetë të nderuar,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Medie,

Qytetarë,

E nderuar deputete Kusari-Lila,

Kolegë të LDK-së,

Të gjitha konstatimet për gjendjen në energji dhe për rrjedhën janë të sakta, pra për rrjedhën e së drejtës sonë në tregun energjetik në veri. Nuk janë të tetë muajve të fundit, janë të tetëmbëdhjetë vjetëve të fundit, siç e thatë edhe ju.

Për fat, kjo temë që ndoshta në plot etapa ka mbetur e anashkaluar, tani ka ardhur në tavolinë si problem. Problemi është shfaqur edhe për faktin se KOSTT-i ynë ka tërhequr rrymë në procedura jo aq të duhura. Rezultat i kësaj i kemi edhe ato implikimet që i kemi parë dhe diskutimet që kanë ndodhur. Jemi tani në atë momentin, ndoshta më final, se me diçka që dikur jemi mburrur se kemi arritur marrëveshje në dialog, edhe të implementohet. Marrëveshja për energji nuk është implementuar nga pala serbe, përkundrazi është bojkotuar. Motivi është shumë i thjeshtë, i qartë, ata përfitojnë 30 milionë të pastra prej nesh brenda vitit.

Kosova tani s'ka kthim prapa, përpos ta gjejë daljen nga kjo gjendje, por dalja mund të marrë një muaj, dy, tre..., por kthim prapa nuk ka. S'mund të kthehemi në gjendjen e mëhershme, kur heshtim dhe ndodh, furnizohet rryma, e nuk e paguan kurrkush. Atë edhe e ka gjetur Gjykata, që është e padrejtë, dhe njëkohësisht nuk mund ta tolerojmë në pakufi edhe pagesën prej buxhetit publik. Mirëpo, të lutur edhe nga palët, miqtë, partnerët tanë dhe ata që kanë investuar në transimion dhe miqtë tjerë, kemi bërë një zgjidhje të përkohshme. E kemi ndarë një milion euro nga buxheti i vendit, nga taksat e qytetarëve të vendit për të arritur deri te koha, por jo te kthimi prapa, por deri te koha kur zgjidhet.

Të jua them të drejtën, shumë veprime që kemi ndërmarrë në këtë drejtim ende nuk i kemi paraqitur para jush, por u jam drejtuar personalisht vendimmarrësve më kryesorë që i ka Evropa e bota në këtë temë. Mendoj se tema është aktuale dhe shpresoj se do të vijmë deri te përgjigjja. Nuk po ju them nëse e kemi në dorë përgjigjen, por shpresoj se do të vijmë. Ky debat është shumë i dobishëm dhe kjo interpelancë e ka peshën dhe vlerën e vet, sepse pikërisht e konfirmon atë që të gjithë e dimë në këtë vend, që kjo gjendje në veri s'mund të vazhdojë në pakufi. Duhet të vijë një ditë, o të shkojnë institucionet e Kosovës të vendosin rregull edhe në këtë temë, pra në tregun energjetik në veri, e ky rregull nënkupton shumë më shumë, sesa veç të dërgohen faturat, ose duhet të arrihet një dakordim pra ata që e kanë marrë përsipër ndërmjetësimin, që është Brukseli.

Ne jemi të hapur për zgjidhje, por e thashë edhe një herë, është pala serbe që e ka keqpërdorur në pakufi këtë temë dhe është toleruar prej BE-së dhe prej aktorëve të tjerë, gjë që është shumë e habitshme që po e tolerojnë ende në këtë temë, se është marrje e pastër e tridhjetë milionëve të Kosovës prej Serbisë.

Veprimi i Qeverisë së Kosovës nuk është mungesë e njohjes së temës, ose e ndonjë dobësie të caktuar që ta ndajë këtë një milion, nuk është as për t'i përkrahur këta sekserët e profiterët, është një veprim i marrë në kohë krize për ta fituar një kohë deri në zgjidhje dhe është një veprim me

vetëdije i marrë, pra nuk karakterizohet në ato tjerat. Ne nuk kemi pranuar kurrqysh ta kthejmë temën prapa në gjendjen e mëhershme, por kemi pranuar të marrim përgjegjësi për një kohë të caktuar, pas devijimeve që kanë ndodhur, që kanë mundur të kenë edhe implikime tjera.

Ju siguroj që në këtë temë secili në këtë Parlament dhe të gjithë ne e kemi një interes, është që të vendoset rregull në treg, ta shtrijmë fuqinë tonë, juridiksionin tonë, sovranitetin tonë në veri, në tregun energjetik dhe rekomandimet e karakterit për ta shtrirë këtë të drejtë dhe për ta zbatuar këtë të drejtë në gjithë Kosovën dhe në veri janë të mira. Rekomandimet tjera që mund të motivohen po nga ky rekomandim mund të na e vështirësojnë ecjen përpara deri në zbatim të kësaj të drejte të Kosovës në tregun e vet, në kapacitetet e veta, e në veri.

Unë mund të them edhe plot fjalë tjera, po e përsëris edhe një herë. Kjo është një seancë shumë e rëndësishme. Porosia duhet të jetë e qartë prej deputetëve që Kosova duhet ta vendosë të drejtën e vet në tregun energjetik në gjithë vendin, dhe në veri. Nuk mund Kosova të tolerojë në pakufi më tutje.

Ju i cekët, zonja Kusari, edhe çështjen e dialogut e të ikjes nga kompetencat... Shikoni, unë kam deklaruar edhe para se të jem kryetar Qeverie, se nuk do të shkoj të vazhdoj dialogun ekzistues, pra të Brukselit. Besoni, e keni dëgjuar shpesh prej meje, nuk është detyrë imja të shkoj tash e ta servisoj një dialog e disa marrëveshje që kanë ndodhur. Detyrë imja do të ishte t'i zbatoj nëse kemi fuqi e zotësi si shtet, nëse jemi të zotët tamam dhe ato duhet analizuar mirë nëse mund t'i bëjmë, por jo të shkoj e t'i servisojmë disa marrëveshje të arritura. Pra, nuk e kam menduar këtë si detyrë timen. Edhe platformën që e kam sjellë këtu nuk është se platforma ia jep në pronësi dialogun Presidentit. Ne kemi votuar institucione në këtë Parlament, edhe presidentë, edhe kryeparlamentarë, edhe kryetarë qeverie dhe deputetë, unë jua kam sjellë platformën si Qeveri që ta kemi të gjithë në pronësi, pra që askush të mos jetë jashtë këtij procesi.

Ju kisha lutur, dhe këtë nuk po e them për hatër timin, ju kisha lutur, mos qëndroni jashtë këtij procesi se pasojat mund të jenë të mëdha, e pastaj riparimi gati i pamundur. E kemi sprovuar këtë në lëkurën tonë nga e kaluara, nga temat e kaluara, më mirë është të ulemi në tavolinë, ftesa ime është për të gjithë pa hezitim, përfshirë edhe Qeverinë, edhe mua, edhe kushdo që ka rol, të jemi në tavolinë dhe ta dimë se nëpër çka po kalon Kosova në momentet që janë më finale për vendin, në momentet që janë jo veç për ne, por edhe për brezat tjerë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Tani ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zonja Hykmete Bajrami. Mimoza Kusari-Lila, replikë.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm shkurt!

Dy çështje, kryeministër! Faleminderit për adresimin e çështjeve dhe për praninë tuaj këtu sot!

E para është që ju e përmendët në raport me dialogun, se nuk doni të shkoni dhe t'i servisoni marrëveshjet e nënshkruara nga dikush tjetër.

Mendoj se proceset shtetërore nuk janë procese personale, është kontinuitet institucional që duhet të vazhdojë. Nëse marrëveshjet janë nënshkruar prej pozicionit të kryeministrit të vendit, ju e keni marrë karrigen e kryeministrit të vendit dhe si të tillë duhet ta vazhdoni.

Në rast se nuk jeni në dakordancë me atë çfarë ka ndodhur para ardhjes suaj, përkatësisht me kryeministrat paraprakë, atëherë duhet të propozoni zgjidhje tjera, që prapë përfshijnë vendimmarrjen tuaj. Ndërsa, për diçka të re, që nuk është bërë më herët, ose që të paktën siç e deklaruar, e kemi një situatë prej para 90 vjetëve, mua më duhet të ju bëj një pyetje shumë të thjeshtë: Çfarë ka ndërmarrë Qeveria Haradinaj për këta 8 muaj të qeverisjes, një hap të vetëm për shtrirjen e autoritetit në veri në raport me situatën energjetike, përjashto këtu arrestimin e Marko Gjuriqit dhe tërheqjen e tij zvarrë në Prishtinë, që më duket se edhe ju vetë s'keni qenë të informuar tamam deri në fund me këtë çështje, por në aspekt me situatën elektroenergjetike. Po flasim për në njëfarë forme oksigjenin e jetës, ose mbarëvajtjes së jetës, energjinë elektrike, që nëse ne do të ballafaqohemi me një "black-out", ose një ndërprerje të tillë, që mund t'i nxjerrë jashtë sistemit edhe termoelektranat e Kosovës dhe të shkaktojë humbje të paparapara, cili do të ishte reagimi juaj?

Çfarë ka bërë Qeveria Haradinaj, një, dy, tre hapa, përveç një milion eurove KOSTT-it që ta shtrijë autoritetin e vet në kthim, në posedim, në asetete të cilat sot nuk i kontrollojnë. Transmisionin në Vallaç nuk e kontrollojnë Qeveria e Kosovës, janë shtatë-tetë punëtorë të etnisë serbe, që janë kosovarë, por që i raportojnë EPS-it të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar zonja Kusari-Lila,

Sa i përket dialogut propozimi im është, unë e kam sjellë një platformë këtu dhe na ftoni ju të bisedojmë më në themel për këtë temë. Jam dakord që t'i trajtojmë të gjitha aspektet e procesit, qoftë që ka shkuar, qoftë që atij që vjen.

Ju e dini që ne si Qeveri e kemi ndërtuar një ekip, quhet teknik, por s'është teknik, e kryeson Avni Arifi. Ai shkon për t'u përballë me krejt të arriturat e deritashme të dialogut, cilat do qofshin ato, nuk ka pasur detyra për mua. Nuk e di si t'juaj them, nuk ka dalë një detyrë për mua

në tavolinë, të paktën s'e kam parë diku. Por, sa i përket Qeverisë, është një ekip serioz, janë shumë njerëz korrektë, e duan vendin e vet, i kuptojnë temat, punojnë dhe janë profesionistë nga KOSTT-i, nga KEDS-i, nga çdo trupë ekzekutive e Kosovës. Disa janë të rinj, kanë studiuar jashtë, ata i kuptojnë ato tema. Kam dëgjuar se kanë performuar mirë, i ka lavdëruar edhe BE-ja atje, ose amerikanët, ose ata që e përcjellin këtë temë.

Unë s'kam pasur ndonjë rol, s'kam ditur, veç të shkoj në turizëm diqysh... Nuk e kam fort në siklet atë punë.

Në të ardhmen, për tema të vendimmarrjes politike, nuk u kam ikur ndonjëherë temave të vendimmarrjes politike. Konstelacioni institucional ekziston. Nuk është se unë po e krijoj sot, ekziston. Nëse doni të dilni nga konstelacioni institucional, prapë vendimi juaj është i Parlamentit, por ne nisemi nga parimi bazë se e kemi këtë konstelacion.

Sa i përket energjisë, të ju them të drejtën, ne kemi bërë bukur shumë punë dhe problemi nuk do të vinte në shprehje, që do të thotë as paratë tona nuk do t'i kishim paguar me njëmilionëshin po të mos i kishim bërë ato punë. Ne i kemi përballë të gjithë me gjendjen. Është një punë voluminoze, por nuk e kam sot të gatshme për diskutim këtu dhe në publik. Pra, në etapa të caktuara, ndoshta edhe kur të kryhet kjo temë, mund të jua bëjmë një rrugëtim të asaj se kah kemi rënë për të ardhur deri te rezultati. Por, kemi punuar që kjo temë të mos mbetet e fjetur dhe të ecën. Unë mendoj se jemi në ato kohët më kritike të saj, por edhe ky debat është bukur në ato kohët kritike dhe është porosi e mirë, si për brenda, si për qytetarët në veri, si për partnerët politikë e fqinjët, por besoj se edhe për partnerët tanë BE-në e Amerikën se s'mund të vazhdojmë në pakufi me këtë temë kështu. Pra, këtu është thelbi kryesisht.

Veprime të njëanshme si Kosovë edhe mund të marrim, por edhe ato duhet t'i kemi pak a shumë të kalkuluara, se çfarë efektsh japin pas ndërmarrjes së tyre. Por, nuk janë edhe ato të përjashtueshme ndonjëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar qytetarë,

Siç e kemi parë edhe nga interpelancat paraprake, ajo e shkurtit për gjendjen e sektorit të energjisë, interpelanca e kaluar për reduktimet e energjisë elektrike të paparashikuara edhe nga shumë raportime në medie, ankesat e qytetarëve dhe të bizneseve, gjendja në këtë sektor nuk është fare e mirë. Kjo gjendje është krijuar nga vendime të gabueshme, e cila e prek jetën e secilit qytetar dhe e dëmton veprimtarinë e secilit biznes. Siç u tha sot, asetet e KOSTT-it, KEK-ut, KEDS-it, nuk janë nën kontrollin e tyre në veri. Këto mirëmbahen, nëse mirëmbahen, nga EPS-i i Serbisë dhe Kosova po humb shumë para nga moskontrolli i aseteve të veta në veri.

U raportua se nga viti 2012 janë humbur 53 milionë, meqenëse nuk kanë arritur të inkasohen, por janë inkasuar në Serbi, dhe gjithashtu janë 8 milionë në vit, që nga viti 2012, të cilat janë paguar nga faturat e qytetarëve të ndershëm për energjinë elektrike, e cila është shpenzuar nga konsumatorë familjarë dhe biznese në katër komunat veriore. Kjo përfundimisht është e papranueshme. Pas raportimeve në medie, se energjia elektrike e shpenzuar në katër komunat veriore u raportohet qytetarëve të pjesës tjetër të vendit, në maj të vitit 2017, u tha edhe më herët, Avokati i Popullit e filloi procedurën ligjore për të larguar nga faturat e energjisë elektrike pagesën e humbjeve politike, siç kategorizohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Avokati i Popullit fitoi në dy instanca të gjykimit, në Gjykatën për Konteste Administrative dhe në Gjykatën e Apelit. Gjykata Supreme e refuzoi në fakt kërkesën e ZRRE-së për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkelje të së drejtës materiale.

Se rezultat i vendimit të gjykatës për pezullim të ekzekutimit të vendimit nr. 399 të vitit 2012, më 30 nëntor, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka lëshuar një njoftim sesi të zbatohet vendimi i gjykatës dhe i ka dërguar letër KOSTT-it, KEK-ut, KEDS-it, me të cilën janë informuar të gjitha institucionet për skemën e re të tarifave, pa pjesën 3,5%. Sot nga faturat si rezultat i luftës prapë të Avokatit të Popullit është larguar 3,5% e shpenzimit të energjisë elektrike të katër komunave veriore, edhe pse ajo gjithmonë është raportuar që është 5% e shpenzimit të gjithëmbarshtëm të vendit.

Situata e krijuar nuk është aspak e mirë sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike. Pasojat janë shumë të mëdha, ndikojnë në furnizimin e asaj pjese. Pjesa e veriut vazhdon të furnizohet nga KOSTT-i me energji dhe nuk njihet prej tarifave, që kanë qenë deri më tani. Ajo vlerë është shumë e madhe, është rreth 5% e shpenzimit vjetor të energjisë në vend dhe rreth 8 milionë në vit. Saktë janë paguar 53 milionë që nga viti 2012.

Konsumatorët pagues të rrymës në faturën e tyre i kanë paguar 8 milionë në vit nga viti 2012, sepse kjo ka qenë zgjidhja më inovative e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për mbulimin e shpenzimit të energjisë elektrike në veri. Në fakt, siç thuhet edhe nga vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, kjo ka qenë kërkesë e ministrit të Zhvillimit Ekonomik në atë kohë. Sot, KOSTT-i si kompani publike është në një situatë të rëndë, sepse vazhdon t'i furnizojë katër komunat veriore dhe ajo sasi e energjisë humb, sepse tani nuk i faturohet askujt. Ne e dimë se më 8 shtator 2013 në Bruksel është arritur marrëveshja për energjinë, e cila, siç u tha, e ka paraparë pavarësimin e sistemit të transmisionit të Kosovës dhe regjistrimin e një operatori të ri për furnizim me energji elektrike, sipas ligjeve të Kosovës; kthimin e linjave 110Kv në Vallaç; punësimin e punëtorëve të EPS-it të Serbisë në sistemin kosovar dhe komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të dy operatorëve, transmisionit të sistemit Kosovë-Serbi. Mandej kjo është nënshkruar konkluzionet dhe në Marrëveshjen e gushtit të vitit 2015.

Mirëpo, kjo marrëveshje nuk po zbatohet, asnjëherë pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk është regjistruar operatori i ri i paraparë sipas marrëveshjes. Ky operator edhe sot e kësaj dite nuk pranon të regjistrohet sipas ligjeve në fuqi dhe sipas marrëveshjes së arritur në Bruksel, asaj të vitit 2013 dhe konkluzioneve të vitit 2015.

Pyetja është, pse ne presim nga Serbia që të regjistrohet një operator për veriun? Çka do të përfitonte në këtë rast Serbia dhe çka do të përfitonin qytetarët serbë të katër komunave të veriut, nëse një operator i tillë regjistrohet, kur në të kundërtën atyre u paguhet energjia elektrike nga Qeveria dhe Serbia vazhdon ta inkasojë taksën për transmision në rrjetin e KOSTT-it në territorin e Kosovës.

Kosova ka paguar 53 milionë dhe 8 milionë në vit në faturat e qytetarëve. Ne kërkojmë që kushdo që bisedon sot me Serbinë, çështja e energjisë dhe marrëveshjet për energjinë duhet të jenë temat kryesore. Nuk ka asnjë kuptim të vazhdohet me marrëveshje të tjera, nëse Serbia nuk i implementon marrëveshjet e arritura. Kjo çështje është çështje e pastër politike. LDK-ja nuk pret nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të jetë faktori kyç për implementimin e marrëveshjes Kosovë-Serbi.

Vërejtja jonë për ZRRE-në është raporti i ZRRE-së me KEDS-in. Kur është privatizuar KEDS-i është privatizuar me qëllim që Qeveria të mos vazhdojë ta subvencionojë Distribucionin, siç i subvencionon shumë ndërmarrje publike. Tash Distribucioni është operator privat, e jo publik. Ne si shtet nuk është dashur të kemi përgjegjësi për punë teknike të një ndërmarrjeje private. Por, këto sqarime duhet të gjenden në kontratën e privatizimit të distribucionit të energjisë elektrike, e cila fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite nuk është publike.

Të nderuar kolegë,

Në vendimin e ZRRE-së numër 399 të vitit 2012, pikërisht te pjesa e arsyetimit të këtij vendimi, thuhet se Zyra e Rregullatorit të Energjisë, më 24 janar 2012 ka marrë letër nga Ministria e Zhvillimit, konkretisht nga këshilltari i transaksionit, letër e cila është hartuar me kërkesë të ministrit të asaj kohe. Në letër është kërkuar që të rritet niveli i humbjeve të lejuara, të miratuara nga Bordi i ZRRE-së, më 29 dhjetor 2011. Sipas tyre, ato nivele të humbjeve të KEDS-it nuk mund t'i realizojë investimet, kështu që është kërkuar nga këshilltari i transaksionit në emër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që të rritet niveli i humbjeve teknike, do të thotë një vit para privatizimit të distribucionit i është përgatitur terreni kompanisë private dhe është thënë që KEDS-i nuk mund t'i realizojë investimet e veta në qoftë se ne nuk e rrisim nivelin e humbjeve teknike të pranuar.

A ka përgjegjësi KEDS-i ta furnizojë me energji elektrike edhe veriun? A parasheh kontrata obligime për institucionet tona që KEDS-it t'i ofrohet qasje e sigurt atje?

Kontrata e privatizimit nuk është publike, ne e kemi kërkuar këtë zyrtarisht edhe në komision dhe nuk kemi publike as sot e kësaj dite. Është dashur, në fakt, që në këtë interpelancë, kryeministër, të shoqërohemi nga ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe ndoshta ai i ka këto detaje dhe të na i bëjë sot të ditura.

Nëse aktorët, të cilët kanë qenë përgjegjës në institucione kur është privatizuar distribicioni kanë marrë obligime të tilla, Kuvendi duhet t'i dijë këto, qytetarët e Republikës së Kosovës duhet t'i dinë këto.

Ne e dimë të gjithë që rrjeti i distribicioni i energjisë elektrike është privatizuar për 26,3 milionë dhe ka arritur që në vitet e para të ketë një fitim prej 40 milionë eurosh.

Mbulimin e humbjeve teknike nuk e kemi pasur obligim ta bëjmë, nëse po, cila ka qenë poenta e privatizimit të distribucionit të energjisë elektrike?

Bordi i ZRRE-së sot duhet të vendosë dhe Kuvendi duhet ta mbajë përgjegjës që të vendoset çka është ligjore dhe çka është e drejtë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Një kompani e tillë, një rregullator i tillë nuk duhet të jetë në funksion të një kompanie private, siç është KEDS-i, ata duhet të thonë se rryma duhet të faturohet në veri dhe të gjendet mënyra e faturimit të energjisë elektrike, e cila shpenzohet atje.

Ne i gëzohemi faktit që 3,5% është larguar nga fatura e qytetarëve, të cilët e paguajnë energjinë elektrike muaj për muaj.

Mirëpo, kjo nuk është zgjidhja e problemit, tani Qeveria ka filluar të ndajë para për mbulimin e shpenzimit të energjisë elektrike në veri, në fakt është e njëjta gjë.

Paratë në buxhet, të cilat janë ndarë për shëndetësi, për arsim, tash ndahen, me vendim të Qeverisë, për mbulimin e kostos së energjisë elektrike të shpenzuar atje.

Sipas Bordit të ZRRE-së, Qeveria e ka bërë këtë edhe më herët, përveç subvencionimit të KEK-ut, por kjo flitet për periudhën kur KEK-u ka qenë një kompani e unifikuar, ku së bashku në KEK-un kanë qenë Furnizimi, Shpërndarja dhe Transmisioni.

Shthurja është bërë një herë KOSTT, pasta KEDS dhe KESKO, me ligjin e ri ne të gjithë e dimë që KOSTT-i i raporton Kuvendit të Kosovës.

Përfaqësuesit e Bordit të ZRRE-së na kanë thënë në komision se atyre nuk u intereson fare nëse distribicioni është kompani private ose publike.

Unë mendoj se ky është një gabim i madh, në mënyrën e të menduarit të një rregullatori, i cili duhet të përkujdeset për interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe përgjigjja dhe logjika e kësaj gjendet në arsyet pse e kemi privatizuar distribucionin?

Si përfundim, Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe si iniciuese e kësaj interpelance, përkrah rekomandimet dhe rezolutën dhe kërkojmë me të vërtetë që Qeveria të mos e vazhdojë asnjë formë të dialogut pa implementim të marrëveshjeve të arritura tashmë me Serbinë dhe posaçërisht të gjejmë implementim të menjëhershëm të marrëveshjes për energjinë. Gjithashtu presim që me të vërtetë të vini për një muaj me një plan detal për zgjidhjen afatgjate të këtij problemi dhe të mos vazhdojmë ta subvencionojmë energjinë elektrike në veri dhe KOSTT-in muaj për muaj me vendimet për ndarje buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryeministri, pastaj të bëhet gati përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

E nderuar deputete,

Ne kemi pasur qëndrimin tuaj, në fakt, që s'ka logjikë të vazhdojmë t'i diskutojmë temat e tjera, nëse një temë kaq jetike e energjisë nuk respektohet, nuk zbatohet marrëveshja paraprake. Ne veç kemi arritur në këtë fazë, fatkeqësisht, jo me vullnetin tonë si Kosovë, si Prishtinë, po ka një kohë që s'po ndodh më dialogu teknik pikërisht për shkak të kësaj situatë. Ne e kemi konsideruar të padobishme vazhdimin e tavolinave, ku nuk është pika e parë energjia, nuk refuzojmë tema të tjera, por duhet të jetë kjo e para.

Në fakt, pala serbe e ka riradhitur krejt agjendën, e para është Asociacioni, për fat të keq edhe evropianët kështu po e konsiderojnë radhitjen. Kemi ndërruar disa komunikime jo aq të këndshme me lehtësues të dialogut, po jemi tani në pritje të rrjedhave të mëtejme.

Edhe unë mendoj që Parlamenti ka shumë të drejtë kur insiston që s'ka logjikë të trajtohen temat me një radhitje kaq të gabuar, e të mos trajtohet me seriozitetin e vet çështja e energjisë.

Njëkohësisht, zbatimi i masës së pagesës sikur ka ndodhur një herë, një milion, ne kemi pasur kërkesa, se u përmendën shuma më herët, edhe nga zonja Kusari Lila se sa është paraparë, ne nuk kemi shkuar në atë drejtim, kemi bërë një veprim të parë për shkak të atij devijimi që ndodhi edhe një farë mënyre të shpjegojmë se Kosova është përgjegjëse, është e përgjegjshme, është korrekte, po është në zor, nuk po i bënë ato veprime prej qejfit, po nuk është ajo një masë që duhet aplikuar në vazhdimësi, po është e pamundshme të vazhdojmë ne të paguajmë nga një milion, ose sado qofshin ato, verës zbret shuma.

Pra, në fund do të arrihet marrëveshja ose duhet zbatuar ne njëanshëm të drejtën tonë në treg, se nuk do të ketë shumë alternativa në perspektivë, e mendojmë se në dobi është të arrihet marrëveshja dhe të përmbillen ato elemente të marrëveshjes që e rregullojnë tregun atje.

Nëse marrëveshja nuk është e keqe për Kosovën, e rregullon tregun, megjithatë, ia mundëson Kosovës, si operatorit që u cek, KEC-i, unë nuk i di bash detajet e kontratës së parë, as të privatizimit, po as ato, po me sa kam mundur të kyçem tani, se më ka rënë të marrë pjesë në disa takime pikërisht për çështjen energjisë së veriut.

E kam kuptuar se ne e kemi ruajtur tregun me këtë marrëveshje, pra nuk ka ndodhur ndonjë humbje e tregut, humbje e të drejtave, humbje e krejt asaj që është sovranitet yni edhe në tregun e energjisë në veri. Për këtë arsye edhe nuk po ndodh implementimi, se po të ndodhte implementimi, atëherë përmbillet çështja e sovranitetit në tregun e energjisë në veri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër Haradinaj,

Ministër,

Kolegë deputetë dhe deputete,

Ju të pranishëm,

Kjo interpelancë është thirrur më 8 mars 2018 dhe është një çështje e përkufizuar me temë të caktuar që, siç thuhet në materialin e interpelancës, për të informuar Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në shumë një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike në katër komunat në veri të Kosovës.

Sistemi energjetik është një sistem kompleks, me të cilin nuk mund të fokusohemi vetëm në çështjen e lëndës për interpelancë, pa e prekur edhe segmente të tjera, është e pamundur të përfshihen të gjitha sfidat dhe vështirësitë dhe t'i jepet kahu i duhur edhe kësaj teme, edhe këtij sistemi, sido qoftë, unë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës sot do të mundohem t'i adresoj së pari sfidat e KOSTT-it, përkatësisht Kosovës, që kanë dalë me rastin e furnizimit të pjesës veriore të Kosovës me energji elektrike.

Të nderuar,

Sistemi elektroenergjetik i Kosovës po përballlet me sfidën më të madhe që nga paslufta, e me këtë edhe KOSTT-i si ndërmarrje publike që menaxhon rrjetin elektrik transmetues të nivelit të tensionit 110 KV, 220 KV dhe 400 KV.

Sic dihet, rrjeti elektroenergjetik i KOSTT-it shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe pjesën veriore të Kosovës ku gjenden nënstationet e KOSTT-it 110.35 KV në Vallaq, që prej pasluftës ka qenë e vështirë ose thuajse e pamundshme të vizitohet dhe të mirëmbahet nga ekipet e mirëmbajtjes së KOSTT-it.

Nga ky nënstation shtrihet rrjeti i shpërndarjes, që është në pronësi të KEDS-it dhe po ashtu, edhe stafi i KEDS-it e ka pasur të pamundur të kryejë mirëmbajtjen dhe operimin e rrjetit të shpërndarjes.

Në anën tjetër, Zyra e Rregullatorit të Energjisë prej 1 prillit 2017, me fillimin e periudhës tarifore, obligimin për furnizimin e pjesës veriore të Kosovës ia kishte caktuar KOSTT-it për shkak të rrethanave të reja të krijuara me hapjen e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, për çka shumë deputetë këtu e vejnë në pikëpyetje se a ka qenë e drejtë apo s'ka qenë e drejtë.

Sipas marrëveshjes politike për energji, nënshkruar në Bruksel në vitin 2013, është dashur të regjistrohet dhe të licencohet furnizuesi me energji elektrike Elektroserver, konform ligjeve të Kosovës, për pjesën veriore të Kosovës. Një gjë e tillë sot e kësaj dite nuk ka ndodhur si pasojë e obstrukcioneve të vazhdueshme që po bën Serbia përmes operatorit të sistemit transmetues të Serbisë në mosaplikimin dhe licencimin e këtij furnizuesi.

KOSTT kishte realizuar kryerjen e obligimit të furnizimit të pjesës veriore sipas kërkesës të ZRRE-së, të cilin furnizim e kishte emërtuar si 'humbje e sistemit', ndërsa kostoja financiare për blerjen e energjisë elektrike në treg ishte paraparë të mbulohet përmes tarifave të aprovuara nga ZRRE-ja, për çka me të drejtë Avokati i Popullit e ka ngritur si çështje dhe e ka fituar lëndën në gjykatë.

Nga data 1 dhjetor 2017, pas vendimit të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe Udhëzimit të ZRRE-së që kërkonte të ndërpritet ngarkimi i konsumatorëve të tjerë me koston që i dedikohet furnizimit të pjesës veriore të Kosovës, KOSTT-i nuk ka blerë më energji për të mbuluar humbjet në veri të Kosovës.

Udhëzimi i ZRRE-së për KOSTT nuk ia ka hequr KOSTT-it obligimin për furnizimin e pjesës veriore të Kosovës, por ka udhëzuar që në bashkëveprim me institucionet e Republikës së Kosovës të gjenden mënyrat e sigurimit të buxhetit për këtë qëllim.

Nga data 1 dhjetor 2017, KOSTT, duke u bazuar në këtë udhëzim, nuk ka qenë në gjendje të blejë energji elektrike për mbulimin e humbjeve të sistemit për pjesën veriore të Kosovës, po në mënyrë të paautorizuar ka tërhequr energji elektrike nga rrjeti evropian që ka shkaktuar devijime ndaj interkoneksionit evropian dhe borxhi i grumbulluar, meqë regjistrohet përmes njësorëve të rrymës, ndaj rrjetit evropian deri më 1 mars të vitit 2018 ka arritur 113 gigavatë, që nëse e përkatëshmë në euro, janë rreth 5,5 milionë euro. Ky borxh i ngarkohet KOSTT-it, përkatësisht

Kosovës, si obligim për ta kthyer sipas programit kompensues, i caktuar nga rrjeti evropian i operatorëve të sistemit transmetues për energji elektrike.

Duke e parë situatën e krijuar, ENSI dhe presidenti i saj ka kërkuar disa herë nga KOSTT që të ndërpriten devijimet, përndryshe do të kërkojë nga rrjeti i Serbisë, si lider i bllokut rregullues Serbi, Maqedoni dhe Mali i Zi, të shkyçë linjat që lidhin rrjetin elektroenergjetik transmetues të Kosovës me rajonin.

Ky veprim po të ndodhte, atëherë Kosova do të gjendej në kolaps energjetik, meqë edhe gjeneratorët ekzistues të termocentraleve Kosova A dhe Kosova B nuk janë dizajnuar që të mbesin në punë pa lidhje me rrjetin evropian.

Duke parë vështirësitë që po kalon KOSTT-i, me kërkesë të KOSTT-it Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë një milion euro, për të cilën edhe është thirrur kjo interpelancë që të arsyetohet mbulimi i kostos së blerjes së humbjeve në sistem për pjesën veriore të Kosovës për periudhën mars 2018, në mënyrë që të evitohet shkyçjen e KOSTT-it nga rrjeti evropian elektroenergjetik dhe njëkohësisht t'i lejë hapësirë spektrit politik ndërkombëtar, kjo shumë e rëndësishme për ne, që të bëjë më shumë presion te Serbia për të zbatuar marrëveshjen e kyçjes për regjistrim e licencim të furnizuesit sipas ligjeve të Kosovës.

KOSTT-i situatën e krijuar të devijimeve e ka menaxhuar mirë, konsideroj, sidomos gjatë periudhës së marsit, duke marrë parasysh ndryshimin e imazhit para rrjetit evropian, ruajtjen dhe mosdëmtimin e procesit politik në raport me Serbinë dhe sidomos me bashkësinë ndërkombëtare, duke sqaruar shumë qartë para NSI-së dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë qëndrimin rreth shkaktarit të problemeve me devijimet ndaj interkoneksionit, kur deri në atë kohë këto institucione ndërkombëtare nuk e kishin të qartë se kush është shkaktari i problemeve, Serbia bashkë me rrjetin elektroserver të saj.

Ne si deputetë gjithmonë, po edhe si institucione të Kosovës, duhet t'i bashkërendojmë veprimet tona atëherë kur kemi mundësi në takime të ndryshme ndërkombëtare që gjithmonë t'i adresojmë këto probleme dhe t'ia bëjmë të qartë bashkësisë ndërkombëtare se kush i shkakton këto probleme në Kosovë.

Që nga 1 prill i vitit 2018 ka filluar sezoni veror elektroenergjetik, me ç'rast KOSTT prapë është duke operuar sistemin elektroenergjetik të Kosovës në rrethana të ngjashme, si deri para marsit 2018. Pra, tërë konsumin e pjesës veriore të Kosovës është duke e tërhequr nga rrjetet transmetuese të shteteve evropiane në mënyrë të paautorizuar. Në rrethana normale, kjo sasi duhet të kthehet në javën pasuese.

Që të dilet nga kjo situatë, KOSTT-it i duhet përkrahje, në këtë rast i ka ofruar përkrahje kryeministri duke i ndarë mjete, po i duhet përkrahje edhe nga Parlamenti, edhe nga ZRRE-ja, ku duhet sigurohen mekanizma adekuatë për dalje nga kjo situatë, por edhe nga faktorët ndërkombëtarë vendimmarrës duhet t'u bëhet presion më shumë që të zgjidhet ky problem njëherë e përgjithmonë, e jo vetëm ad hoc.

Nëse vazhdohet me këtë situatë të rritjes së devijimeve nga interkoneksioni, KOSTT-in dhe Kosovën mund ta sjellë në situatë tejet të pafavorshme: shkyçje fizike e rrjetit transmetues të Kosovës nga pjesa e rrjetit interkonektiv evropian, implementimi eventual i kësaj mase Kosovën nga aspekti elektroenergjetik do ta izolonte tërësisht, me ç'rast Kosova do të mbetet totalisht pa energji elektrike dhe do të cenohej funksionimi i vendit dhe funksionet vitale publike.

Pra, situata e krijuar që lidhet me furnizimin e pjesës veriore të Kosovës është tejet serioze dhe kërkon vendimmarrje adekuate nga institucionet tona, natyrisht në bashkërendim me vendimmarrësit ndërkombëtarë që e ndihmojnë dhe e lehtësojnë marrëveshjen në fjalë.

Mosadresimi i kësaj çështjeje brenda Kosovës dhe mosqartësimi adekuat i qëndrimeve me organizatat teknike ndërkombëtare mund të ketë pasoja serioze për sigurinë e furnizimit të Kosovës, ndërsa për KOSTT paraqet rrezik serioz për procesin e fillimit të punës së pavarur, konkretisht fitimin e pavarësisë energjetike të Kosovës.

KOSTT-it i duhet përkrahje institucionale nga institucionet tona vendimmarrëse, në mënyrë që të mos ketë probleme financiare, të mos humbë imazhin dhe hapat drejt anëtarësimit të saj në ENSI si dhe të bëhet zonë bllok rregullues, me ç'rast të gjitha të hyrat nga alokimi i kapaciteteve do të jenë të KOSTT-it dhe jo më tutje të rrjetit të Serbisë.

Rrjeti i Serbisë për vitin 2017 ka përfituar të hyra nga alokimi i kapaciteteve në vlerë 9.6 milionë euro, të hyra këto që i merr në emër të KOSTT-it dhe prej vitit 2008 të hyrat që i ka marrë rrjeti i Serbisë në emër të KOSTT-it me alokimin e kapaciteteve transmetuese janë në vlerë 52 milionë euro.

KOSTT-it i duhet përkrahje institucionale që del nga kjo krizë asnjëherë më shumë se sot, duke pasur parasysh zhvillimet pozitive dhe hovshme në raport me rajonin dhe Evropën dhe institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Gjermane për Zhvillim, BERZH, Banka Botërore, e të tjera, ku KOSTT-i është një storie e suksesit, megjithatë e ka menaxhuar këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë në relacion.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës kërkojmë megjithatë t'i harmonizojmë qëndrimet dhe rekomandimet, të cilat unë i dëgjova tani përmes iniciuesit të kësaj interpellance, deputetes Mimoza Kusari-Lila. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kabinet i qeverisë,

Çështja e humbjeve në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike, sidomos pas privatizimit, është edhe një veçanti e Kosovës. Vetë ekzistenca e humbjeve komerciale, si nga ana e shfrytëzuesve, ashtu nga ana e sistemit (shteti, sistemi i shpërndarjes, ZRRE etj.) është një turp për Kosovën. Mirëpo, me gjithë kritikën, nuk duhet ta bëjmë gjeneralizimin e fajit për këtë dukuri, duhet ta bëjmë një zbërthim si në strukturë, ashtu edhe në karakterin dhe llojin e abuzuesve.

Menjëherë pas luftës së viteve 1998 dhe 1999 në Kosovë, ndër segmentet më të shpeshta të ndihmave ndërkombëtare ishte energjetika. Nga termocentralet e deri te shpërndarja në nivelet energjetike më të ulëta, ishin subjekt i riparimeve dhe investimeve. E keqja është se ne tani nuk kemi ndonjë evidencë të gjendjes së përgjithshme të sistemeve energjetike dhe nuk mund të konstatojmë se sa kanë kontribuar organizatat e huaja.

Me gjithë këto raporte, ne nuk dimë sa pajime, si transformatorë, shtylla e linja janë riparuar në vitet e raportimit dhe se sa kanë mbetur për të ardhmen. Raportimet pa gjendje fillestare dhe pa atë përfundimtare nuk e kanë qëllimin e informimit me të cilin mund të përcillet progresi dhe realizimi si rezultat i investimeve, së paku jo të atyre që pretendohen.

Humbjet teknike në vitin 2014 ishin 15,56%, kurse në vitin 2015 ishin 15,45% që na shpie në përfundimin se me 20 milionë euro të investuara, janë zvogëluar humbjet vetëm për 0,11%, e që krejt është blerë për 26 milionë! Pra, nëse për rënie të humbjeve për 0,11% nevojiten 20 milionë euro, atëherë del se sistemi i shpërndarjes para privatizimit, nga viti 2006 deri në vitin 2013, me rënien e humbjeve prej 18,15% - 16,04% = 2,11%, ka bërë investim prej 380 milionë eurosh. Ky rezultat është dëshpërues, ngase po të jenë investuar këto mjete, atëherë vlera e shitjes së sistemit të shpërndarjes dhe furnizimit del qesharake për blerësin, tragjike për neve.

Edhe një konstatim: mesatarja e rënies së humbjeve teknike para privatizimit ka qenë 0,30%, kurse pas privatizimit 0,29%. Ngjashëm, edhe te humbjet komerciale, para privatizimit ishte 1,53%, kurse pas privatizimit 1,56%.

Përfundimisht, njëra nga arsyetimet kryesore për privatizim, humbjet, jo që nuk janë përmirësuar, por, në të kundërtën, janë përkeqësuar.

Çështja tjetër, kryesore, ende mbetet e hapur: me cilën drejtësi dhe legjitimitet ZRRE-ja dhe KEDS ua adreson humbjet komerciale konsumatorëve të rregullt? Në 2015 ishin 16,38%.

Tash, problemi pasaktësisht dhe padrejtësisht është vendosur në një plan tjetër. Bashkë me mospagesat në komunat veriore të vendit, shkaqet për të cilat tashmë gjithkush i ka të qarta, po mbulohet tema më e rëndësishme dhe shkelja më e madhe. Humbjet komerciale paraqiten nga Rregullatori në të gjitha komunat e Kosovës. Ato janë në fakt vjedhjet që me eufemizëm quhen ‘humbje komerciale’. Për rastin e katër komunave në veri, Avokati i Popullit e hartoi raportin, e paraqiti në Gjykatë dhe demaskoi, le të themi, deklarimin që të paktën ZRRE ka bërë ndaj kërkesave të Lëvizjes Vetëvendosje, ku thuhej se shpërndarja në çdo faturë të ‘humbjeve komerciale’, pra pagesa e rrymës së vjedhur apo të papaguar nga të gjithë në të tjerët bëhej me njoftim të Kuvendit, gjë që nuk është e vërtetë.

Në raportin e vitit 2017 të Zyrës së Rregullatorit thuhet: “Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Humbjet teknike arrijnë vlerën 12,28%, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë (humbjet komerciale) përbëjnë 17,03% të kërkesës në shpërndarje, prej së cilës energjia e pafaturuar në pjesën veriore të Kosovës përbën 5,31% (265 GWh)”.

Vjedhja dhe mospagimi i rrymës ka pasur rritje nga 16.38% që raportohej më 2015, në 17,03 %.

Në sektorin energjetik nuk janë zvogëluar humbjet, por është rritur konsumi.

Furnizimi me energji elektrike po mbahet qëllimisht mirë, sidomos në Prishtinë, ku jetojnë politikanët, biznesmenët, profesorët dhe gazetarët.

Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën rregullisht kanë tërhequr vërejtjen se te përmirësimi i kapitalit fizik rrugët i dominojnë, edhe efikasitetin e energjisë elektrike, edhe ujësjellësin, pra asfalti dominon investimet kapitale. Sipas Raporteve të Progresit vit pas viti thuhet që Kosova që të bëhet e aftë t’ia dalë me trysinë e konkurrencës dhe forcat e tregut në BE, duhet të sigurojë furnizim stabil me energji dhe t’i reduktojë humbjet e shpërndarjes. Mirëpo, çdo raport tregon se ne po ecim në kahun e kundërt.

Për bindjen time të fuqishme, pavarësisht premtimeve të kryeministrit aktual, ato nuk do të realizohen, për shkak se kryeministri Haradinaj është në një pozitë jashtëzakonisht të dobët. Ai ka një Qeveri të pakicës me 52 deputetë vetëm, në të cilën partia e kryeministrit nuk i ka as çerekun e tyre. Pra, edhe është Qeveri e pakicës, që ka më pak se 60 deputetë, i ka vetëm 52 deputetë, por prej këtyre 52 deputetëve, as çerekun nuk e ka partia e tij. Një kryeministër, në një pozitë kaq të dobët, nuk mund të na bashkojë Mitrovicën, të na integrojë veriun e ta bëjë faturimin edhe atje, apo çfarëdo premtimesh që jep për atë pjesë të territorit.

Prandaj, kritika ime është se për të mbetur Haradinaj kryeministër duhet që edhe më tutje të vazhdojë të jetë ushtrues detyre i Presidentit aktual. Avni Arifi, që e përmendi kryeministri, s'është dashur fare të shkojë në Bruksel. S'ka pasur çka të kërkojë në Bruksel ai. Duhet njëherë vlerësim mbi dialogun 2011-2017, dhe ai vlerësim le të na vijë në Kuvend. Pse të na vijë platforma e dialogut të ri, ku thuhet që Thaçi prin. Jo, jo! Njëherë një dokument zyrtar shtetëror, ku e shohim prej vitit 2011 deri në vitin 2017 çka ka ndodhur me ato 33 marrëveshje. Sepse, ka marrëveshje të kota, për shembull zyrat e ndërlihdjes Prishtinë-Beograd, ato janë kot. Ka marrëveshje kundërproduktive, fusnota. Edhe ia kanë vënë Republikës fusnotën, duke e lënë Kosovën në fakt pa Republikë, edhe Serbia na ka luftuar edhe më shumë në arenën ndërkombëtare. Sepse, ideja e fusnotës ka qenë që ne e vëmë fusnotën dhe hyjmë nëpër organizma ndërkombëtarë. Nuk ndodhi, fusnotën e kemi, në UNESCO nuk hymë. Pra, marrëveshje kundërproduktive.

Dhe, kemi pasur marrëveshje që nuk janë zbatuar: 1. energjia, 2. diplomat, 3. ura mbi Ibër, e shumë të tjera. Pra, neve na nevojitet një bilanc zyrtar shtetëror i Qeverisë së Republikës për dialogun 2011-2017 dhe ai duhet të na vijë në Kuvend njëherë. E, jo të na vijë njëfarë platforme ku shkruan që i prin edhe një herë Thaçi. Pse? Domethënë, është e domosdoshme që njëherë ta kemi bilancin. Nuk mund të shkojmë nëpër dialogë të rinj pa e sqaruar çka u bë ato 6 vjet me dialog, i cili na e pati rrëmbyer komplet neve agjendën zhvillimore të vendit tonë. Nuk flitej as për arsim, as për shëndetësi, as për bujqësi, as për kulturë, e as për shkencë, sepse dialogu ishte ai që e shterte gjithë energjinë, nervat, e kohën e Qeverisë në mandatet e kaluara.

Po ashtu, nuk është dashur as ai “Demarkacioni Meha” të na vijë këtu, pasi erdhi raportimi i “Komisionit Bulliqi”. Pas të gjeturave të “Komisionit Bulliqi”, Murat Meha është dashur të shkojë në burg, por po them edhe një herë, nuk është ky kryeministër, i cili mund ta distancojë veten nga kryeministri i vërtetë që është president dhe premtimet e tij për Veriun janë kot. Nuk ka realizim të tyre!

Unë besoj që nuk ka mundësi të rregullohet as kjo çështje pa i sqaruar kjo Qeveri, çështjet e shumta me dy elemente: i pari është KEDS-i, i dyti është Elektroseveri. Pra, nuk është e mundshme të rregullohet as situata energjetike në Kosovë, aq më pak në veri të Kosovës, pa u marrë me këtë trashëgiminë e presidentit aktual që është kryeministri përmbajtjesor dhe i cili e ka bërë këtë kryeministër ushtrues detyre. Elektroseveri nuk duhet të pranohet kurrsesi dhe nëse KEDS-i nuk i mbledh faturat nëpër veri, atëherë duhet të kthehet në pronë publike Shpërndarja dhe Furnizimi. Nëse s'e bën KEDS-i, duhet ta bëjë Qeveria.

Por, kjo nuk bëhet pa u distancuar ky kryeministri në detyrë nga kryeministri përmbajtjesor, që është edhe president i vendit. Me fjalë të tjera, ne do të miratojmë mocione, por premtimet që dëgjoni këtu nga Qeveria janë më shumë se të kota. Pra, janë kundërproduktive për shkak se Qeveria aktuale nuk është në gjendje ta bëjë prerjen me qeveritë paraprake. Asnjë udhëtim në

Bruksel, kurrfarë fillimi i dialogut nuk mund të vijë në shprehje pa bilancin 2011-2017. Dhe, nuk mund të bësh ndryshime pa u konfrontuar me trashëgiminë e mbrapshtë që është gjetur në vitin e kaluar, prej gjithë atyre viteve paraprake, jo vetëm në fushën e energjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën të replikojë. Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar Albin!

Nëse s' i mbajta në mend prej fillimit, por po ia nisi prej fundit se ti i ke më për qejf këto politike, ato ekonomike lërja ndokujt se kanë nge, se edhe unë shpesh ua lë se s'po të shkojnë diqysh, kur e shpjegoje këtë KEDS-in e ata parametrat, më dukej vetja sikur unë nganjëherë, kur po ulem e derisa po i marr vesh prej ekspertëve boll zor.

Por, për partinë, unë i kam veç 10 deputetë, të hurit e të konopit i kam, plot 20 vjet s'kanë luajt, ata janë. Edhe 9 në qofshin, beso qysh janë, qe shikoi, kam shkuar në burg, kam qëndruar 8 vjet, jam kthyer e aty i kam gjetur. Mbaji edhe ti tut nëse mund, se është mirë t' i mbash, se atëherë e kupton se për çka po flasim. Tjetra është, shikoni, unë kam kandiduar me një koalicion, e kam përbirë marren, kam rënë dakord, e kam dhënë dorën me PDK-në, me Nismën dhe kemi dalë fitues si koalicion para zgjedhjeve. Tash, a jemi ne prefekt? Garant s'jemi. Ti një parti ke qenë, e je ndarë. Edhe ne i kemi vështirësitë tona në funksionim. Por, i kemi marrë përgjegjësitë, po i mbajmë. Të thuhet se kryetari i Qeverisë e ka veç këtë numër të deputetëve, së pari Qeveria është e një vendi, e vendi e ka votuar, e mirë e keqe, ajo që është. E dyta, për disa tema, mos harroni asnjëherë, nuk janë veç të Qeverisë. Nëse e konsideroni temën e tregut energjetik në veri veç të Qeverisë, atëherë po e kuptojmë në çfarë raportesh po flasim, por nëse është nacionale, flasim. Edhe ju siguroj diçka, unë nuk dhashë ndonjë premtim, unë ju thashë veç jemi në dy mundësi, pra asnjë premtim s'jua dhashë sot këtu. I kemi dy mundësi, nëse mund të merremi vesh qysh është ajo marrëveshja energjetike, e vendosim sovranitetin tonë dhe e zbatojmë të drejtën tonë në tregun energjetik në veri. Nëse s' mund, s'na ka mbetur tjetër rrugë, e nuk e di a jemi të zotët, por s'na ka mbetur tjetër rrugë, pos ta vendosim ne vetë të drejtën tonë atje, kuptohet atëherë pa ndihmën e partnerëve, as të BE-së, as të Amerikës, por ne vetë.

Nëse na vjen ajo ditë, ulemi e bëjmë llaf të gjithë bashkë, a jemi të zotët apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, kundër-replikë ka deputeti Albin Kurti!

ALBIN KURTI: Së pari, kryeministri është dashur ta përmendë ndonjë dallim tjetër ndërmjet deputetëve tanë, se deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk janë familjarë e kushërinj të mi. Ky është një dallim shumë i madh. Pra, nuk është puna që janë të hurit edhe të konopit, por janë të shtëpisë. Domethënë, ky është dallim i madh, e para. E dyta është që edhe me dy valë të daljeve

të Vetëvendosjes, prapë kemi për të mbetur më shumë se AAK-ja. E për mbështetjen në popull, për atë as të mos flasim, ta diskutojmë, se ajo dihet.

Natyrisht që duhet të merremi edhe me çështjet ekonomike. Është e pamundshme si kryeministër të mos merreni me çështje ekonomike. Tash nëse ju nuk merreni, e unë merrem, e juve ju pengon që unë merrem, problemi është se ju s'merreni, e jo pse unë merrem. Edhe, në fund, për çështjen e negociatave, për çështjen e dialogut, ju e keni marrë stafetën prej Presidentit edhe po vazhdoni në rrethin e njëjtë. Nuk kemi pasur nevojë ta ndërrojmë Qeverinë për më shumë asfalt e më shumë koncesione Serbisë. S'ka kurrfarë kuptimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: I kërkoj regjisë që t'ia vazhdojë fjalën, meqë është interpelancë mund të flasë sa të dojë në minutazhin e grupit parlamentar.

ALBIN KURTI: Edhe një herë po e them, është Qeveri e pakicës me 52 deputetë, në të cilën partia e kryeministrit aktual në detyrë nuk e ka as çerekun dhe nga kjo pozitë shumë e dobët, ky nuk mund të bëjë asnjë gjë të madhe. Ky ka qenë i detyruar ta kalojë demarkacionin për të mbetur kryeministër. Ky është i detyruar për të hyrë në dialog me Serbinë, e për të na e propozuar këtu Thaçin si udhëheqës, për të mbetur kryeministër. Dhe, nuk është e çuditshme, sepse i gjithë synimi i tij ka qenë që të bëhet kryeministër, e jo ta bëjë kryeministrin. Unë kisha dashur shumë që Haradinaj të jetë kryeministër, por nuk është. Unë kisha dashur ky të jetë kryeministër, por nuk është kryeministër. Është në detyrë, tjetërkush është kryeministër dhe çka na vjen në Kuvend, ne e shohim që është shndërruar në korrier të Presidentit.

KRYESUESI: Urdhëro zoti kryeministër, e keni prapë fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Janë disa punë që i ka bërë Qeveria e vendit, për të cilat tregojnë se kjo Qeveri vërtet ekziston. Disa i keni votuar edhe në këtë Parlament, e dini cilat janë, s'po jua përmendi, por ka edhe tjera që janë me pikëpyetje si rasti i demarkacionit dhe keni të drejtë të keni pikëpyetje. Ajo që ka mbetur një pikëpyetje për mua, për Vetëvendosjen dhe për ty Albin është si nuk të është dhimbsur raporti i Bulliqit, kur provohej që në atë ligj të relativizohet, kur votohej.

Tani ajo më bën të dyshoj se ty s'ta ka ndie për atë punë hiç për demarkacion, shumë më pak se mua, jam i sigurt, edhe kolegëve tu që rrinë afër teje, por e keni pasur kartë, ndërsa unë po ju siguroj që jam duke punuar edhe sot dhe ta shohim si po vijnë ato rrethana, por mund të ndodhë që e drejta e Kosovës do të zbatohet në korrigjim dhe të jemi këtu. E pra, ju kam hetuar, ju kam gjetur se kur dikush në këtë Parlament e minimizonte, ju heshtnit thua që s'po ndodhë kurrëgjë.

Nuk u dhambi fare minimizimi i atij dokumenti, keni thënë veç që s'bën të përzihen, në rregull, por edhe të përzier keni mundur ta mbronni pak dokumentin, por s'jeni interesuar për atë pjesë.

E dyta, vërtet unë me Thaçin s'kam bashkërrugëtuar politikisht gjatë. Hera e parë që jemi në partneritet politik qeverisë pas nja 20 vjetëve dhe i kemi marrë përgjegjësitë çfarë i kemi dakorduar, mbetemi në ato përgjegjësi edhe me Thaçin, edhe me Veselin, edhe me të gjithë. Unë brenda shtëpisë nuk bëj lojëra dhe nuk do t'ju bëj lojëra, dhe jam me të, dhe jam me Veselin, dhe jam me PDK-në, të gjithë kur ua jap dorën jam me ta, ta kam pas dhënë edhe ty dorën një kohë, por s'mundëm ta çojmë më tutje, i ndamë rrugët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë do të jua jap fjalën prapë, por besoj që tema e interpelancës është specifike dhe kërkoj që të përqendroheni. Deputeti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Unë, pas raportit të "Komisionit Bulliqi" kurrë s'kam besuar që do të na vijë më "Meha" në Kuvend. S'kam besuar! Gjëja për mua më e çuditshme që ka ndodhur është që pas atij raporti, megjithatë vjen "Meha". Unë këtë s'kam mundur ta besoj që do të ndodhë, e para. E dyta, nuk mund të jenë edhe Bulliqi edhe Meha në të njëjtën vend. Kjo tregon që është Meha, ai i cili do të duhej sot të përgjigjej te prokurori, e te gjykatësi, e të jetë në burg, e ka kaluar këtu në Kuvend.

Nuk na janë ndarë rrugët, ju keni dalë prej rrugës. Ne kemi qenë bashkë në kundërshtim të demarkacionit "Meha" edhe të Zajednicës së Serbisë, mirëpo ju, siç thotë populli, u trashët te ne në opozitë dhe shkuat u therët te Veseli dhe te Thaçi, ky është problemi. Ju e keni keqpërdorur opozitarizmin për të shkuar në Qeveri e për t'u shitur më shtrenjtë te ata, se po të mos ishte kryeministri Haradinaj sot dikur me neve në opozitë nuk do t'i rritej vlera që ta marrin Veseli dhe Thaçi. Por, më e rëndësishmja në këtë aspekt që besoj duhet të theksohet është që ne jemi subjekt opozitar, por ne nuk kundërshtojmë për shkak se jemi opozitë. Ne jemi opozitë për shkak se kundërshtojmë. Kemi orientim tjetërfare socio-ekonomik dhe për sovranizimin e vendit. Ne kurrë nuk do ta sillnim këtu për ratifikim çfarëdo dokumenti, i cili e përmban brenda edhe "Komisionin Meha" dhe në Qeverinë e ardhshme të Vetëvendosjes do të mund ta dëshmoni para të tjerëve qysh do ta dëshmojmë ne se jemi të vetmit që e bëjmë prerjen me qeveritë paraprake. Janë ndryshuar fytyrat e kryeministrave, janë ndryshuar fytyrat e ministrave, por vrapimi në rrahë me përcjellje të stafetës nuk ka ndryshuar. Ndryshimi në vend duhet të jetë, jo vetëm me ndryshimet e kryeministrave dhe të ministrave, duhet të jetë me orientim tjetërfare. Jo më vrapim në rrahë dhe jo me stafetën që ta jep përkohësisht Presidenti aktual.

KRYESUESI: Urdhëroni zoti kryeministër, e keni fjalën prapë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Sikur të kishte qenë Shpend Ahmeti, kryetar i partisë simotër tash të Vetëvendosjes, ndoshta ju kishit thonë "me përjashtim të një pune e ke

bërë Ramush, Ligjin për Prishtinën. E ke bërë një, po nuk është i kësaj peshe”. Por, pasi nuk e ke më në parti, tash edhe atë s’po ma njeh kush, por s’ka dert.

KRYESUESI: Faleminderit! Albin Kurti, edhe një herë.

ALBIN KURTI: E vetmja zgjidhje e përkohshme është që të devijojë prej temave, por ky vetë është personifikim i devijimit. Ishte me neve, doli nga rruga, shkoi te Thaçi e Veseli dhe tash mundohet që duke devijuar nga tema të harrohet ajo çka u tha përpara. Unë po e përsëris edhe një herë, Qeveri e pakicës me 52 deputetë, ku kryeministri është veçse ushtrues detyre, sepse Presidenti aktual e ka marrë përkohësisht me qira derisa t’ia kryejë edhe Zajednicën qysh ia ka kryer demarkacionin. Ky është kuptimi. Unë nuk besoj që Ramush Haradinaj është bërë kryeministër për shkak të vizionit të tij socio-ekonomik, apo për shkak të politikave të tij arsimore, shkencore e kulturore për Kosovën.

Këtë e kanë bërë përkohësisht kryeministër Thaçi e Veseli për t’ua kryer “Demarkacionin Meha” dhe tash në radhë edhe Zajednicën e Serbisë. Kaq është kjo punë. Nuk e kanë bërë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Prandaj, shikoni, e kanë ndërruar ulësen, është ndërruar fytyra e kryeministrit. Nuk ka ndryshim të politikave. Ne këtu nuk jemi për njëri-tjetrin, jemi për qytetarët. Mirëpo, Kosova kurrë s’ka qenë më keq se kaq. Dhe, tash neve na thuhet që le ta përmendim edhe ndonjë punë të mirë që na e paska bërë kryeministri, mirëpo kjo është veçse një, le të themi, lëvizje taktike. Aq shumë ka të këqija, sa e mira është e pakrahasueshme dhe e pavlefshme. Po cilado qeveri e keqe e bën ndonjë punë të mirë. Cilado qeveri e keqe diku e bën ndonjë punë të mirë, por kjo nuk e bën qeverinë të mirë. Përkundrazi, kjo është një mënyrë që qeveria e keqe ta paraqesë veten më legjitime nëpërmjet ndonjë të mire që ta bën.

Pra, është e domosdoshme të kuptohet që Qeveria është e pakicës me 52 deputetë, por nuk po çan kokën që nuk e përfaqëson shumicën. Shteti ynë është republikë parlamentare. Në Parlament duhet shumica. Nuk e keni shumicën. Ju duhet ta keni shumicën, por nuk e keni shumicën. 52 deputetë janë.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, para se t’ia jap prapë fjalën kryeministrit, sepse e ka kërkuar, ju lus që të mos u drejtoheni kolegëve nga vendi. Mos ndërhyini, mos i pengoni! Urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Vizioni socio-ekonomik, për shembull Albin, për ty e kam, nëse e marrim Ligjin për Prishtinën. Është një ligj që vendbanimi që akomodon gati 1/3 e popullit të Kosovës, ia mundëson që të zhvillohet. Pra, është socio-ekonomi edhe kjo, ia jep kompetencat, ia jep mundësitë, i jep buxhet. Pra, 1/3 e popullit tënd e bën me mundësi më të madhe, është socio-ekonomi kjo, besoni.

Lëre që i shton edhe disa vende të punës, se edhe disa policë bëhen. Nuk është kjo shumë e vogël, ndonjë punë e vogël, ndoshta është e vogël, por s'do kishte pritur 20 vjet, a 10 sa ka qenë aty. Nuk po flas për energjinë, por ja statusi i Trepçës po vjen te ju, e ka aprovuar Qeveria, po e aktivizojmë Trepçën në at mundësinë që e kemi. Nëse është socio-ekonomia veç për ta sharë Hashimin, e kemi provuar edhe atë boll, ose për ta sharë Kadriun, i shajmë. Unë i kam bindjet e mia në tema, po punojmë për to, e kam mirëkuptimin e partnerëve, në disa raste po e gjej edhe mirëkuptimin tuaj në Parlament, ju falënderoj, domethënë edhe të grupeve parlamentare opozitare. Mirëpo, shikoni, nëse e matim vetëm me të shara, vazhdoni ju të shani, e unë po i kryej disa punë, se jemi aty. Dhe, ato punë janë në dobi të vendit, po ta jap një shembull: Kur kam ardhur unë në Qeveri, Albin, kategoritë e lirisë kanë qenë si lypës. 50 euro i kanë pasur, një herë për Bajram ua kanë dhënë në gusht, edhe kurrkah s'ka qenë gjendja.

Të gjithë kanë qenë në pikëpyetje se çka do të ndodhë me ta. Sot janë kategori ligjore, i gëzojnë të drejtat e veta. Edhe kategoritë e dhunës seksuale gjatë luftës, janë konsoliduar. Janë disa vendime, disa punë që i ka bërë kjo Qeveri, pra ajo është Qeveria e popullit, nuk është as e Ramushit, as e Hashimit, as e Kadriut, është e këtij vendi. Kam qenë para dy ditësh në Prizren, ishte bllokuar Prizreni, me një padi përkohësisht i bllokuar plani zhvillimor i Prizrenit. Jam duke punuar që ta zgjedh atë bllokadë që të zhvillohet Prizreni, se aty janë nja 200 mijë banorë. Kryetari rastësisht ishte i Vetëvendosjes, por jam duke punuar që të ecën puna. Nëse po flasim për punë, beso nuk e di qysh punohet më shumë dhe më me devotshmëri për vendin në rrethanat që i kam gjetur. Pra, ku ta marr t'i kisha 61 deputetë të Aleancës, shumë me qejf do t'i kisha pasur, por s'i kemi bërë kurrënjëherë deri sot, veç kur ka qenë Ibra në atë kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albin Kurti edhe një herë!

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Shikoni, çdo vendim politik ka pasoja socio-ekonomike, por kjo nuk është dëshmi që ke orientim dhe vizion socio-ekonomik. Pra, pasojat mund të jenë socio-ekonomike, por kjo nuk është garanci që ti ke vizion socio-ekonomik. Çdo gjë ka pasoja, e pasojat përgjithësisht janë socio-ekonomike, por kjo nuk dëshmon se ke vizion socio-ekonomik, e para.

E dyta, unë nuk po ju shaj, unë s'po e shaj askënd, veç po e përsëris që Qeveria me 52 deputetë është sharje, është ofendim, është fyerje për republikën parlamentare. Qeveria me 52 deputetë është sharje, është fyerje, ofendim për republikën parlamentare. Neni 31 i Rregullores së Kuvendit, neni 100, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë që ju mund ta testoni Qeverinë tuaj sa i përket votëbesimit që ka këtu. Në republikë parlamentare, shumica e ka prioritetin. Dhe, mungesa e shumicës është sharje për republikën parlamentare, por ju nuk po brengoseni për këtë. Sa keni qenë në parti politike, ju e keni pasur obsesionin e pozitës së kryeministrit, tash që jeni në pozitën e kryeministrit e keni obsesion çështjen e partive. Jo

Prizreni, jo Prishtina, jo kjo komunë, jo ajo komunë. Le të flasim për tërësinë, pse po flasim për komuna? A je bërë kryetar komune, a kryeministër qeverie?!

Domethënë, është e qartë që logjika partikulariste kur vjen në pozitën universale, e kur është në pozitën partikulariste, atëherë gjithmonë veç logjikë universale, derisa të vijë në pozitën partikulariste. E për atë sa jeni ju për socio-ekonominë, ja tregojuni deputetëve për shembull, sa metoda janë për ta llogaritur bruto-produktin vendor dhe na e thoni njërën prej tyre. Shumë e thjeshtë. Një kryeministër duhet ta dijë sa metoda përgjithësisht në ekonomi janë për llogaritjen e bruto-produktit vendor dhe na e thoni njërën prej tyre. Test elementar. Kaq!

KRYESUESI: Urdhëroni, kryeministër që të përgjigjeni për metodat!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më duket, në të njëjtën klasë në ekonomi jemi unë e ti, se jemi duke i mësuar në të njëjtën kohë shpenzimet, investimet kapitale dhe çka po ndodh, pastaj qysh i matim ato, tash jam duke i mësuar edhe unë si ti. Faleminderit! Publike, private, investimet po i mësojmë të gjithë.

Mirë është! Dëgjoni, edhe kemi mësuar më shumë, Lumiri do të na kishte thënë më shumë, e ka të tjerë që na ndihmojnë, Dardan Sejdiu. Po, shikoni, te puna, duhet me qenë sa më korrektë që mundem, jo për hatër veç të neve dyve, por të krejt temat e këtij vendi. Konstalacionet politike, përderisa një parti s'e ka një shumicë, janë megjithatë kompromise. Edhe qeveritë janë kompromise. Derisa një parti s'i bën 60 e sa deputetë, prapë Qeveria është kompromis, si në tema, si në kuadër, si në funksionim. E vetmja herë kur ke Qeveri qysh po mendojmë ne, është kur dikush i bën mbi 60 deputetë të partisë së vet, por prapë janë disa interesa që të obligojnë gjatë qeverisjes. Arsyeja pse i ceka komunat është për të treguar që nuk është krejt puna e kryetarit të Qeverisë marrëdhëniet ndërmjet meje e Hashimit, e Albinit e Kadriur, e Avdullah Hotit apo dikujt tjetër, por kanë të bëjnë me punë direkt për njerëz, për qytetarët. Për shembull, Ligji për Prishtinën është ligj që e rregullon jetën e kryeqytetit tonë, të banorëve të këtij vendi. Janë votuesit tuaj, të mitë, të atij... të kujtdo qofshin, më së paku të mitë. Edhe s'është punë e karakterit të tillë. Edhe në Prizren nuk kam shkuar për parti, as kurrkënd të partisë time nuk e kam takuar, më besoni, Aleancën. I kam informuar, ndoshta edhe më janë mërzurur edhe kam shkuar vetëm për temat që kanë çuar fjalë që është bllokuar zhvillimi i Prizrenit, se Infra-Kos e ka paditur komunën, ia ka bllokuar planin zhvillimor. Nuk jam konsultuar me partnerët e t'i pyes a bën, a s'bën, se s'është kryetar i partive tona, por kam shkuar për t'i ndihmuar, me ia çelë derën le të zhvillohet.

Bazuar në këtë, shiko, në temat e atij pozicionimit politik të presidentit rreth dialogut dhe këtyre pikëpamjeve edhe i kuptoj, në temat qeverisëse ju siguroj se nuk di që kush do të mund të punojë më shumë ndonjëherë. Këtë ta keni të qartë. Edhe në i paçi 70 deputetë, jo 61, s'do të mund të punoni më shumë sa u përket temave të këtij vendi, se jemi intensivë në punë, në qatë përbërje si

jemi. Edhe dua të kërkoj leje pak minuta, e kam një detyrë këtu afër, kthehem. Është në vlera të lirisë, është në ora 13:00 ndodh një ngjarje, por do të kthehem prapë në seancë. Dikush do të mbajë shënime, prapë jam këtu, nuk po ju ik, ju lutem.

KRYESUESI: Faleminderit! Albin Kurti prapë e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Unë pajtohem që Qeverisja dhe politika nuk janë vetëm marrëdhënie midis aktorëve politikë me emra të përveçëm, prandaj edhe e bëra atë pyetjen te një raport tjetër, raporti i kryeministrit me dijen. Thash sa metoda janë përgjithësisht në ekonomi për llogaritjen e bruto-produktit vendor dhe le të na e thotë njërin prej tyre. Tash po e bëj edhe pak më të lehtë, s'ka nevojë të na e thotë sa metoda, por vetëm le të na thotë sipas metodës më të lehtë që ia merr mendja atij, se si llogaritet bruto-produkti vendor. E është problem të jesh kryeministër, kur s'di si llogaritet bruto-produkti vendor. Është problem!

Nuk mund të jesh kryeministër në një vend në kontinentin evropian, po askund në Botë, e që nuk e di se si llogaritet bruto-produkti vendor, nuk mund të jesh. Mund të bësh edhe ndonjë punë tjetër. Por, jo të kryeministrit, besa as të ministrit, e besa as të politikanit.

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj që kjo pjesë e debatit u përmbyll, meqë edhe kryeministri u largua.

Vazhdojmë me qëndrimet e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar Partia Socialdemokrate, kush e do fjalën? Deputeti Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,

Ju kërkoj edhe një herë, që kur ta marrë fjalën një deputet i caktuar, të mos ndërhyri nga vendi. Shkumbin, është hera e dytë. Faleminderit! Urdhëro, Dardan!

DARDAN MOLLIQAJ: Fatkeqësisht, shkoi kryeministri, por ndoshta dikush edhe e përcjellë atë që ai tha se do të mbajnë edhe shënime.

Ajo që ne si grup parlamentar e marrim me shumë shqetësim është çështja e shpenzimeve që shteti i Kosovës i ka paguar në dy mënyra sa i përket një problemi që është rryma për qytetarët e Republikës në veri të Kosovës.

Edhe në vendet tjera, sikur edhe në Kosovë, do të ishte jashtëzakonisht e pranueshme, sikur shteti apo qytetarët tjerë japin kontribut për një pjesë tjetër, nëse kjo ka të bëjë me arsye socio-

ekonomike. Pra, ta zëmë që një komunitet i caktuar apo një grup shoqëror politik, ku ta di unë, i qytetarëve apo një komunë, gjendja e rëndë socio-ekonomike ka nevojë për solidaritet, ose për mbështetje shtetërore. Kjo nuk është rasti i veriut dhe faturave të rrymës në veri, sepse sipas Bankës Botërore, standardi i jetesës në veri është dy herë më i lartë, se sa standardi i jetesës së qytetarëve në jug. Pra, ne po paguajmë për kosto politike, jo për arsye sociale dhe ekonomike.

Për informim të qytetarëve, është se diku rreth 50 milionë euro ne i kemi paguar si qytetarë të Republikës së Kosovës përmes faturave për rrymën që është shpenzuar në veri për vitet e kaluara. Pas një vendimi të gjykatës themelore, e cila ka treguar se kjo praktikë ka qenë në kundërshtim me ligjet dhe mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe konsumatorëve në Kosovë, kjo po zëvendësohet prapë prej taksave tona, sepse prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, siç e dimë ne nga Komisioni për Buxhet dhe Financa çdo muaj po ndahen nga rezervat nga një milion euro për KOST-in.

Unë nuk e kuptoj pse duhet të bëhet kjo pagesë, kur e dimë që për rrymën që e çojmë si shtet i Kosovës në veri inkason një kompani e Serbisë atje. Pra, nuk është që qytetarët serbë në atë rajon nuk paguajnë, ata paguajnë rrymën. Rrymën e marrin prej Kosovës e paratë ia japin kompanisë shtetërore të Serbisë për rrymën që e marrin prej Kosovës. Pra, dyfish është fitimi. Ne edhe paguajmë edhe ato para i merr Serbia, pra se edhe qytetarët serbë paguajnë dhe ato para i merr Serbia. Kjo është një gjendje në të cilën ndodhemi. Tash, kemi bërë marrëveshje në 2015-ën, një në 2013-ën dhe një në 2015-ën me Serbinë për çështjen e energjisë. Përveç problemeve shumë të mëdha që i ka kjo marrëveshje, ajo nuk po zbatohet me të vetmen pikë, ku ka pak përfitim Kosova e që është kjo çështja e faturave të veriut.

Në anën tjetër, Qeveria jonë di të bëjë aksione shumë populliste. Për shembull, sikur intervenimi në veri për rastin Gjuriq, një spektakël i paparë, i panevojshëm në disa dimensione, jo intervenimi për rend dhe ligj po ai spektakli nëpër Prishtinë dhe pas një jave prapë i jep leje. Po, aty ku dëmtohet interesi jo vetëm i sovranitetit politik, si të them, por edhe interesi ekonomik, Qeveria e Kosovës thotë se nuk kemi çfarë të bëjmë.

E dëgjova kryeministrin më herët, tha: “keni të drejtë, shumë mirë që po bëhet kjo temë” dhe tha, ne duhet me i dhënë fund. Kur? Më cilën datë dhe në cilin moment politik dhe me cilin instrument politik? Apo, edhe kjo sikur plot çështje tjera që po shtyhen në raportin me Serbinë, siç është edhe çështja e ushtrisë e të tjera, do të rregullohen me këtë marrëveshjen e fundit, në mes Kosovës dhe Serbisë, e cila do të jetë edhe më e dëmshme se sa marrëveshjet paraprake.

Pra, mosintervenimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për këtë çështje dhe detyrimin e pagimit, njëherë përmes faturave rreth 50 milionë euro nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe tash përmes buxhetit të shtetit të Kosovës, përkatësisht shpenzimeve të rezervave që i ka pasur të planifikuara kjo qeveri, për grupin tonë mbetet krejtësisht e pakuptueshme dhe kallëzon

për një impotencë të paparë të kësaj qeverie dhe të qeverive të kaluara për ta ushtruar sovranitetin politik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Kosova nuk ka nevojë për spektakle politike dhe për poenë politikë. Kosova dhe Qeveria e saj ishte dashur të veprojë, t'i mbrojë interesat e qytetarëve të Republikës së saj, të cilat nuk është duke i mbrojtur.

Kështu që, besoj se edhe rekomandimet në fund që janë nga Grupi Parlamentar i LDK-së, besoj se edhe me harmonizimin do të vendosim edhe masa, po edhe data konkrete se si do të adresohet ky problem, se përveç problemeve tjera që prekin KOST-in si kompani publike, e prek Buxhetin e Kosovës çdo muaj nga 1 milion euro, të cilat ne i paguajmë për faturat në veri e në anën tjetër atë inkasim e bën kompania serbe, pra Serbia në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ishte qëndrimi i grupit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse tema bosht pak a shumë devijoi, se tash Albini s'po na lë edhe të kënaqemi nëpër disa rezultate. Ne po flasim së paku për rezultatet e zgjedhjeve të fundit, zgjedhjeve lokale, ne si Aleancë jemi kënaqur dhe kemi fituar ndoshta edhe vetëkënaqësi, por për shkak të rritjes shumë faktike, se jemi parti e parë në kuptimin e komunave të fituara. Në qoftë se, jo e para, së paku e dyta jemi. Bile, këtë kënaqësi na e jep, sepse po kemi shpresë edhe në zgjedhjet nacionale besa, të jemi parti e parë. Po, s'po na lë të kënaqen as qytetarët, që së paku qytetari me këtë qeverisje, ndoshta rastësisht po ndodh, që faturat kurrë s'i ka pasur më të ulëta për pagesën e energjisë më të ulëta se në këtë mandat.

Këto rastësisht ndodhin dhe sikur rastësisht po ndodh, e ndoshta edhe krejt rastësisht, që të hyrat shtetërore për muajt që po shkojnë, prill, mars, shkurt, janë 20% më të larta, se ndonjëherë që ka ndodhur në Kosovë. Pra, 20% të të hyrave shtetërore janë më të larta se në vitin 2017. Kjo rastësisht krejt ndodh. Rastësisht krejt po ndodh që edhe prodhuesit, kompanitë prodhuese kanë përfituar prej shumë vendimeve, që janë krijuar lehtësira sa u përket taksave të prodhuesve. Pra, kjo qeveri, krejt rastësisht i ka ulur taksat, krejt rastësisht po ndodh të rriten të hyrat. Është interesant që po ndodhin këto rastësisht. Rastësisht, kësaj qeverie do t'i ndodh e me e marr edhe liberalizimin e vizave.

Qytetari sot paguan faturë shumë më të ulët, jo 3,5%, po 40% në aspektin praktik sot qytetari paguan faturë më të ulët se sa vitin 2017. Sot, prodhuesi ka shumë benefite, se taksat i janë ulur. Sot, qytetari dhe ky shtet ka të hyra më të larta, se në vitin 2017, së paku për muajin prill, shikoni statistikën e ATK-së, prej 20%. Këto rastësisht ndodhin, rastësisht do të ndodh edhe liberalizimi i vizave, gjithçka do të ndodh rastësisht. Po së paku duhet me thënë faleminderit, që janë këto në mandatin e Ramush Haradinajt. Ndoshta janë rastësisht, po këto janë në mandatin e Ramush

Haradinajt. Përgatituni të gjithë që këso rastësi, e këso kënaqësi do të ketë shumë në këtë mandat. Kemi me pas edhe në vitin 2019, edhe në vitin 2020, pse jo edhe në vitin 2021. Edhe Beka po thotë, pse jo edhe në mandatin tjetër, se në qoftë se i shënojmë trendët e rritjes, së paku në qoftë se i marrim zgjedhjet lokale, atëherë ne presim që të jemi parti e parë.

Bile, këtë kënaqësi mos ne ndal, Albin, se jemi duke shkuar e duke u rritur, qytetarët janë shumë më në rregull se në qeveritë paraprake. Mos na e ndal këtë kënaqësi.

Nuk është tash edhe zoti Haradinaj, kryeministri, dhe krejt rastësisht për këto dua t'i them, shumë faleminderit! Ama krejt rastësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Blerim! Grupi Parlamentar Lista Serbe s'ka asnjë përfaqësues. Grupi Parlamentar Nisma, deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu devijoi totalisht tema, edhe pse interpelanca është thirrur për një milionë euro të paguara KOST-it, ku së paku ajo ideja fillestare ka qenë që të shihet se çfarë mund të bëhet, që kjo çështje të zgjidhet në mënyra tjera, sepse zëvendësim i pagesës nga ana e qytetarëve me pagesë nga buxheti është pak a shumë të heqësh barrën nga të gjithë konsumatorët dhe ta transferosh vetëm te taksapaguesi, se buxheti në fund të fundit mbushet nga taksapaguesit. Edhe Qeveria edhe ne, të gjithë e dimë, se kjo nuk është ajo zgjidhja ideale që do të duhej të zgjidhet një problem që duket në dukje të parë si problem i energjisë elektrike, i KOST-it, por në fakt është një problem politik.

Tash, të përpiqesh me terminologji dhe me argumente politike-ekonomike apo të energjisë, të trajtosh një çështje politike, siç është çështja e veriut, është sikur një diagnozë të provosh një sëmundje ta diagnostifikosh korrekte por t'i japësh trajtim të gabuar, qoftë me qëllim, qoftë pa qëllim.

Tash, unë nuk di këtu cila është ideja e interpelancës. Nëse qëllimi është thjesht të kërkohet që të ndalet kjo, atëherë do të duhej të ofrohej një alternativë. Nuk besoj se Qeveria nuk është e gatshme që të dëgjojë se cilat do të mund të ishin alternativat, që kjo çështje të zgjidhet dhe të mos rëndohen, as konsumatorët në mënyrë të drejtpërdrejtë, por as qytetarët, taksapaguesit e kësaj Republike në mënyrë të kësaj siç është duke u bërë pagesa me vendim të Qeverisë nga një milionë euro në muaj. Pra, unë nuk kam ndonjë recetë për këtë. të gjithë e dimë që kemi vështirësi në rregullimin e kësaj çështjeje të energjisë në veri, është tentuar nëpërmjet procesit të dështuar, për mendimin tim, të dialogut 2011 deri më tani që të zgjidhet kjo. Nuk kemi arritur ta zgjidhim, por fakti se nuk kemi arritur ta zgjidhim një çështje për 15 vjet nuk mund të fajësojmë pse nuk është zgjidhur tash për tre muaj apo për gjashtë muajt, në të cilët është duke vepruar kjo Qeveri.

Ne jemi të hapur që të dëgjojmë idetë, pikëpamjet, mendimet, se si mund të zgjidhet, por jo vetëm duke thënë se kjo është gabim, duhet të trajtohen të gjithë barabartë, si komunat me shumicë shqiptare, si komunat me shumicë serbe. Të gjithë e dimë këtë në teori, por në praktikë, fatkeqësisht nuk na ka funksionuar. Pra, hajde të ulemi dhe të gjejmë një modalitet të përbashkët, se si mund kjo çështje të zgjidhet. Prandaj, do të ndalem me kaq, do t'u lë kolegëve të mi të Nismës, ose dikush që ka diçka për të thënë, sepse mendoj që pjesa tjetër e debatit nuk meriton fare, as të trajtohet, as të përfshihem. Do të kemi rast kur do të vijë çështja e dialogut këtu dhe secili të tregojë se çfarë mendon dhe si e sheh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+ nuk ka asnjë përfaqësues në sallë.

Tani kalojmë te deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, desha kolegut Bilall Sherifi t'ia jap përgjigjen në atë, se deshi të dijë se çka duam të arrijmë me këtë interpelancë.

Bilall, mendoj se nëse nuk e ke kuptuar çfarë kemi dashur të arrijmë me këtë interpelancë, atëherë me të vërtetë nuk po e dimë as për çka jemi në Kuvend të Kosovës.

Ajo që është e rëndësishme të ceket është fakti, se me vendimet e veta kjo Qeveri nuk i paguan një milionë euro në muaj KOSTT-it, por ia ka paguar një herë një milion. Sot aktualisht, KOSTT-i i ka borxh 6 milionë euro për energjinë të cilën shpeshherë në mënyrë të paautorizuar e nxjerr prej rrjetit të interkoneksionit. Qeveria e cila nuk i zbaton vendimet e Kuvendit, më 9 shkurt me rezolutë të Kuvendit e ka pasur për obligim të gjejë zgjidhje për rrymën e pafaturuar në veri. Unë shul-shqip e pyeta kryeministrin, cilat vendime i ka ndërmarë për shtrirje të autoritetit në veri. Nuk u përgjigj, tha e kam dërguar Avni Arifin për të negociuar në negociata, nga të cilat janë kthyer pa asnjë rezultat ose pa asnjë sukses. Sot, nëse dikush e shtynë Kosovën, ose ia dredh bërrylin Kosovës për të bërë marrëveshje me Serbinë, Kosova duhet të silllet si shtet dhe të tregojë se cilat janë prioritetet e saj. Një prej atyre prioritetëve është normalizimi i situatës elektroenergjetike.

Shtrirja e autoritetit në veri kur po ndodhin skena, po e përmend edhe një herë, sikur arrestimi i Marko Gjuriqit, po qohemi krejt peshë me thënë që “Kosova është shtet i pavarur”, “Ne jemi këtu ata që pyeten”, E hiç më larg se shumë më pak kilometra prej Urës së Ibrit nuk shkojnë për të pasur kontroll mbi trafostacionin në Vallaç, të cilin ty ta kontrollojnë punëtorët e EPS-it. Nëse nuk është obligim i Qeverisë dhe nëse nuk është autoritet i Qeverisë me u sjellë në këtë mënyrë, me tokën e vet, me territorin administrativ që e ka për obligim, atëherë i kujt është?

Shtesë kësaj, Qeveria ka njëqind mekanizma të tjerë, të cilat mund t'i përdorë si mekanizma reciprociteti me Serbinë, duke filluar prej reciprocitetit të mallrave, ndaljes në kufi (400 milionë importojmë prej Serbisë) edhe shumë të tjera në raport me energji. Mos të harrojmë, ne e kemi një investim për të cilin kemi marrë kredi prej Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kemi marrë gjithashtu kredi prej Bankës Gjermane për Zhvillim dhe atë kredi jemi duke e paguar, por rrjetin nuk jemi duke e përdorur, sepse është duke inkasuar Serbia prapë mjete të cilat kalojnë për rrymën që kalon mbi sistemin e Kosovës.

Po, janë probleme të vjetra, por gjithashtu edhe zgjidhja e këtyre problemeve është te një adresë dhe ajo është Qeveria nëpërmjet mekanizmave të saj. Nëse Qeveria nuk mundet, ose nuk ka ide, atëherë hajde të vijmë në Kuvend dhe Kuvendi një prej masave kryesore duhet t'i bëjë që ta obligojë Qeverinë që duhet të ketë stabilitet financiar për ndërmarrjen publike të vetmen ndoshta, ose tri-katër që kanë mbetur, që janë stabile financiarisht. Krejt të tjerat kemi arritur suksesshëm t'i dështojmë, Telekomin, Postën, me radhë të gjitha janë në varshmëri prej subvencioneve të shtetit. Një e kemi edhe atë tash e shkatërruam vetë me një vendim.

Kështu që, mendoj se këtu sot duhet të dalë një prej pikave të rezolutës së Kuvendit, të dalë që dialogu nuk mund të vazhdojë në rast se nuk ka: e para, një barazim dhe e dyta, një zbatim të marrëveshjeve të nënshkuara. Marrëveshja e energjisë është marrëveshje që i sjell dobi Kosovës, por e cila nuk është zbatuar për arsye se i merr tash milionat që inkason Serbia për Kosovën. Dhe e dyta, që duhet të fillojë inkasimi i mirëfilltë. Ne duhet të ushtrojmë autoritetin. Për katër komuna në veri nuk mund të shkojmë, se s'kemi mekanizma zyrtarë shtetëror për të inkasuar mjete për rrymë elektrike. Pse ata njerëz nuk ndihen tash të sigurt për t'ua paguar rrymën, në fakt disa prej tyre edhe paguajnë rrymë, por ua paguajnë personave ilegalë, që nuk e kanë absolutisht asnjë shpenzim për atë rrymë, por që i mbledhin ato para.

Tash, nëse e kemi kryeministrin, i cili bën bisedë, ulet me Milan Radojçiqin, ose tjetrin, për tema që i duhet, për vota e për të tjera, një prej kriminelëve kryesorë në veri, hajde të ulet me Milan Radojçiqin edhe të thotë gjej se më duhen disa inkasantë në veri që mbledhin, ose inkasojnë mjete të rrymës që po na faturohet neve. Neve dyfish është duke na u faturoar rryma. Një herë na është faturoar nëpërmjet faturave të KEDS-it dhe me vendimin e gjykatës, tash po merren mjetet prej Buxhetit të Kosovës. Njësoj është ajo punë. Përveç kësaj bilanci ende më tragjik bëhet, kur jemi duke ditur se jemi duke shkatërruar ose jemi duke ndikuar për ta dobësuar ndërmarrjen, ndoshta më strategjike sa i përket energjisë dhe është rrjeti i transmisionit, ose operatori i transmisionit.

Nëse ne këtu themi, "Valla çka po duam të mbërrijmë, le të vendosin në Bruksel..." Gabim! Jemi të thirrur për të marrë vendime dhe këto vendime duhet marrë. Mendoj që thjesht duhet me e kuptua seriozitetin e situatës. Situata elektro-energjetike mund ta çojë në kolaps jo veç Kosovën, po edhe rrjetin rajonal dhe na takon neve këtu, që të vendosim. Nëse Serbia shkon deri në atë

masë sa është e papërgjegjshme, mbyllja kufirin. Shumë e thjeshtë është, ka ndodhur përpara, mund të ndodhë prapë. Mbyllet kufiri për mallra e mandej e kthen presionin në Serbi. 50 ditë kanë ndenjur, një milion euro në ditë i ke import, por e ka refuzuar kryeministri në mbledhje të Qeverisë, nuk ka dashur të merret me këtë çështje.

Atëherë, le të vijë me zgjidhje tjetër, që ai mendon se mund të ketë sukses, e jo me e bajt veç e kam dërgua Avni Arifin në Bruksel. Kjo çështje do një përpjekje politike shumë më serioze, sesa veç niveli deklarativ i dërgimit të njerëzve teknikë në Bruksel për zgjidhjen e çështjes së energjisë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Bilall Sherifi, replikë!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Unë koleges veç mund t'i them se po të kishte zbritur një njeri këtu që nuk ka qenë fare në Kosovë dhe ta dëgjonte një ligjëratë të kësaj, do të kishte thënë "Kjo është vetë mrekullia".

Mirëpo, kur e ke parasysh që ke të bësh me të njëjtit që i kanë pasur këto probleme dhe jo vetëm që nuk i kanë zgjidhur, por kanë kontribuar edhe për t'i trashur edhe më shumë dhe për t'i zmadhuar edhe më shumë, atëherë nuk ia vlen fare as të komentohet. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, sot ani, në emër të grupit parlamentar shkojnë. Urdhëro!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Po, Bilall, e kam pasur mundësinë. Kam qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë dhe nëse e mban mend, e vetmja që e kam aplikuar reciprocitetin për 50 ditë ndaj Serbisë dhe jo vetëm ndaj Serbisë, edhe ndaj Maqedonisë kur ka pasur lëvizje me mallra, edhe masat anti-damping ndaj Sllovenisë, edhe ndaj Shqipërisë, kur ka pasur gjithashtu damping në çimento e për të gjitha. Jam shumë e përgjegjshme dhe shumë e vetëdijshme edhe me negociimin e politikave tregtare. Domethënë, secili për pozitën që kemi mbajtur është mirë me mbajt edhe përgjegjësinë. Unë përgjegjësinë e mbaj dhe në bazë të përvojës nga ajo përgjegjësi, po them. Ju e keni Ministrinë e Tregtisë e Industrisë, propozoni në Qeveri të Kosovës që si kundër-argument, ose kundërmasë për Serbinë, për bllokadën shumëvjeçare që ia bën Kosovës në sektorin e energjisë, të bëjmë bllokadë të mallrave. Nuk kërset lufta, as nuk ndodh, humbin disa biznese që importojnë nga Serbia. Por, e kemi kuptuar aso kohe, që as urie nuk vdesim, as për miell nuk heqim keq, bile të kundërtën, bëhemi shumë atraktivë, kurrë më tepër nuk kemi pasur kroatë, sllovenë, gjermanë, bullgarë, që kanë ardhur në Kosovë dhe kanë synuar treg, që sot ende, fatkeqësisht, e mban Serbia në Kosovë.

Prandaj, mos t'i ikim përgjegjësisë. Përgjegjësi e mekanizma ka Qeveria, vetëm a ka vullnet politik. Po, nga ky diskutim po e shohim se nuk ka, as ide, nuk ka as vullnet politik, po as guxim për ta shtyrë përpara. Nuk mund që agjendën e Kosovës në dialog me Serbinë të na e përcaktojë dikush jashtë Prishtinës gjithmonë. Ne po diskutojmë në Parlament edhe me thënë pse po diskutojmë, është me të vërtetë absurd.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Po, bile më kujtohet edhe ajo embargoja, bllokada, reciprociteti a çka ke pas bërë me çimenton, për të cilën qenë thënë shumë gjëra, por unë nuk do t'i ricikloj këtu.

Por, jo! Unë kur thashë për atë periudhën e kaluar, unë mendova për këtë trevjeçarin e kaluar, sepse mendoj se je duke përfaqësuar edhe Grupin Parlamentar të LDK-së, besoj pikëpamjet edhe të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe për tre vjet kryeministrin dhe shumë resorë të rëndësishëm i kanë pasur dhe nuk kanë arritur t'i zgjidhin. Nuk po i fajësoj, por po them mos e fajësoni pra, edhe këtë që nuk ka mundur për gjashtë muaj t'i zgjidhë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, zonja Kusari-Lila!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Bilall, kur nuk ka argumente, njerëzit sulmojnë personalisht. Tash po u kthehem argumenteve.

Në çka të ke argumente, të lutem prezantoni, për arsye se unë insisto që ti të prezantosh argumente përse i përket çimentos në Shqipërisë, jo vetëm çimentos së Shqipërisë, po edhe nëse e ke për Serbinë, edhe për Maqedoninë, edhe për Slloveninë, mishin e pulës, të gjitha këto kanë qenë vendime të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në kohën që kam qeverisur ose kam qenë në krye të asaj ministrie.

Ndërsa, prapë po them, edhe sa u përket vendimeve të mëhershme, ne jemi ballafaquar me këtë situatë aktualisht me të cilën po e diskutojmë në mënyrë dramatike prej dhjetorit të vitit 2017, kur ka ardhur vendimi që KOSTT-i duhet ta furnizojë veriun me rrymë dhe rrjedhimisht ne po rrezikojmë KOSTT-in dhe nuk po i japim zgjidhje procesit, ndërsa gjithashtu kjo Qeveri është përgjegjëse tash që po thuhet për finalen e dialogut, ndërsa ne në finale nuk po shohim as përgatitjet nga ana e Qeverisë, e as ide se si të shkohet në finale. Kujt po ia lë Qeveria finalen e dialogut? Pjesë e dialogut ka qenë edhe marrëveshja me energjinë, nuk ka kohë më të rëndësishme, më substanciale, të diskutohet për marrëveshjet e deritashme se tash.

A e dini që shumë shpejt e diskutojmë çështjen e finales ose duhet ta diskutonim me dialogun, ndërsa për marrëveshjen e energjisë, që është e nënshkruar dhe që i ka shumë objektivat e sakta, themi se nuk kemi ide. Ide kemi, por a ka vullnet politik, po them edhe një herë, opozita nuk

merr vendime për Qeverinë, nuk është ekzekutiv, opozita mund të propozojë, kalon ligje në Kuvend, zbatimi i tyre prapë është në Qeveri.

Qeveria ka treguar që një rezolutë të Kuvendit, prapë po e përsëris, nuk e ka zbatuar, në të kundërtën, e ka shkelur pa asnjë përgjegjësi. Tash kush mund të garantojë që edhe sot një rezolutë tjetër, që e obligojnë Qeverinë të marrë masa kundër Serbisë, po gjithashtu edhe t'i aplikojë propozimet e këtij Kuvendit, do t'i implementojë kjo Qeveri. Kjo Qeveri tregon se nuk ka përgjegjësi ndaj Kuvendit. Një rezolutë për energjinë e ka shkelur, tash të dytën po e marrim prapë, do të mundohemi ta bëjmë sot, dhe çka me atë punë?

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm për Grupin Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, i kanë 6 minuta e 38 sekonda, ta keni parasysh, jeni tre deputetë, tash është Adem Mikullovc, tani do t'ia jap fjalën, po prit, zoti Mikullovc unë ta jap menjëherë fjalën, po e koordinon, pasi janë vetëm gjashtë minuta e gjysmë, është Samiu dhe ju jeni, Glauk, si ta bëj radhitjen?

Adem Mikullovc, fjala për ju! Faleminderit!

ADEM MIKULLOVCI: I përshëndes të gjithë të pranishmit, Po dua t'ju them shumë shkurt, unë kam qenë deputet edhe në kohën e komunizmit, kur në atë botë e merreshim në interpelancë ndonjë sekretar, ndonjë përgjegjës, ia numëronim të gjitha të zezat, po edhe e shkarkonin nga pozita. E tash këtu, do të bisedojmë e do të flasim zjarrtë, zjarrtë e zjarrtë, e do të mbetet prapë sikur që ka qenë, tash për tash, vetëm kaq.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Mikullovc. Enver Hoti nga Nisma, i ke 2 minuta e 52 sekonda.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Boll janë dy minuta.

Po mendoj që gjendja në KOSTT duhet të shikohet pak më ndryshe nga ajo që u fol.

Po, vendimi është i vështirë dhe e vështirëson zhvillimin e kompanisë KOSTT dhe në formë indirekte godet qytetarët e vendit, por kjo është situata dhe inkurajojmë Qeverinë që të përgatitet për masa aktive për të dalë nga kjo gjendje.

Por dua të ngre edhe një çështje tjetër, mosrealizimi i marrëveshjes energjetike që ka dalë si rezultat i bisedimeve në Bruksel, është akoma edhe më i rëndë, edhe më tepër e vështirëson gjendjen e kësaj kompanie.

Po ashtu në këtë kompani ka edhe probleme të tjera. Kompania KOSTT është para një gjendje shumë të rëndë dhe nuk pajtoj fare me disa parafolës të LDK-së që thanë po e rrezikojmë një

kompani stabile. Nuk është stabile, është para një krize ndoshta më të vështirë dhe më të rëndë se sa PTK-ja.

Nëse e marrim gjendjen brenda, ka informacione se KOSTT investon trafostacione në emër të KEC-it dhe për KEC-in.

Po ashtu diferenca mes profesionistëve, Bordit drejtues, menaxherëve, të cilët marrin paga deri në 4 mijë euro dhe nuk i marrin nga Qeveria Haradinaj, po edhe nga qeveritë e kaluara, janë probleme të cilat e vështirësojnë këtë qëndrueshmëri të kompanisë KOSTT.

Prandaj, i kisha lutur deputetët, të cilët e kanë sjellë këtë pikë të rendit të ditës për interpelancë, do të duhej të shtrohej problemi që në esencë, në themel atje, sepse gjendjen e dinë punëtorët të cilët punojnë në KEC.

Profesionistët atje janë të marginalizuar dhe kjo nuk ka lindur dje nga kryeministri Haradinaj dhe nga kjo Qeveri aktuale, është një problem i trashëguar, i cili paraqet jashtëzakonisht vështirësi për të ardhmen dhe unë dua ta potencoj edhe një herë se kjo kompani gjendet para një krize të madhe, ndoshta më shumë se sa PTK ose Posta dhe është në një rezultat jashtëzakonisht negativ.

Prandaj, të nderuar kolegë,

Do të ishte mirë të bëhej një debat, e ndoshta të shkohet edhe me një aktivitet shtesë t'i ndihmojmë të gjitha institucionet që të parandalohen ato dukuri dhe ai keqmenaxhim që është duke ndodhur në KOSTT.

Por edhe një herë po kthehem te tema, tema është e trashëguar dhe nuk mund të zgjidhet aq shpejt, siç po kërkojnë disa deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët deri dje kanë qenë përfaqësues të Qeverisë dhe kanë pasur detyra ekzekutive, të cilat kanë mbetur në gjysmë dhe nuk i kanë realizuar, po përkundrazi, pasojat e atyre vendimeve të vështira dhe vendimeve të cilat kanë qenë jashtëzakonisht joprofesionale dhe të ndikuara politikisht, tani ka ndodhur kjo situatë që është duke ndodhur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur po bisedojmë për aspekte të aseteve nacionale strategjike për problemet që i kemi në sektorin energjetik dhe për problemet që i kemi me shtetin fqinj, Serbinë, sa i takon funksionalizimit të këtij sektori për një pjesë të caktuar të Republikës së Kosovës, unë dua thjesht t'i them nja 2-3 fjalë.

Për aspekte të tilla shumë serioze ne duhet të gjejmë konsensus. Si të zgjedhur të popullit duhet të jemi më konkretë në diskutimet tona, t'i japim Qeverisë alternativa dhe thjesht ta ndërtojmë një konsensus për dalje nga ky vorbull që vendi sillet më shumë se 18 vjet, e në veçanti këto dhjetë vjetët e fundit si shtet i pavarur dhe sovran.

A kemi mundur si shtet i pavarur dhe sovran ta ushtrojmë sovranitetin në atë pjesë të vendit? Jo! Tani pa dashur të adresoj akuza në emër të asaj Qeverie apo kësaj Qeverie, është një problem jo i lehtë, është problem sensitiv, është më së paku problem teknik, por është problem shumë serioz politik, me të cilën që nga kjo periudhë më shumë se gjashtë vjet dialog nuk kemi mundur si shtet, si institucione të një shtetit të pavarur, shteti i Kosovës të vejë dorë në këto asete nacionale strategjike.

Është nënshkruar marrëveshja për energjinë me Serbinë. Çka ka ndodhur nga nënshkrimi i asaj marrëveshjeje? Ku janë limitet kohore, ku janë masat që është dashur të merren dhe kush është dashur t'i zbatojë ato? Natyrisht, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ekzekutivi i vendit, me mekanizmat dhe instrumentet kushtetuese dhe ligjore që i disponon.

Prandaj, t'i lëmë këto tema dhe të mos merremi shumë me njëri-tjetrin dhe me akuza dhe kundër akuza, po ta ndërtojmë një konsensus si Kuvend, sepse për këtë temë është miratuar, është votuar një rezolutë në Kuvendin e Republikës së Kosovës para një kohe jo shumë të gjatë.

Nga ajo periudhë kohore, sepse dihet rezoluta, institucioni më i lartë, Legjislativi i vendit e obligon dikë që t'i marrë masat konkrete përmes mekanizmave shtetërorë, a është bërë qoftë edhe një hap që të stabilizohet kjo problematikë? Jo!

Prandaj, duhet ta ndërtojmë, për interesa të përgjithshme si njerëz të zgjedhur të popullit një konsensus dhe një mekanizëm veprimi në interes të shtetit, jo të partive politike, apo cilido partner të koalicioneve qeverisëse që mund të jenë.

Dhe, mos harroni, çështja e energjetikës ka afekt direkt nesër edhe në ndërtimin e termocentralit, sepse këtu ka edhe inxhinierë që vijnë edhe nga fusha e energjetikës. Me çka do të ftohen ato turbina dhe prej cilit burim të ujit, prej Ujmanit. Në cilin pjesë të Kosovës ndodhet liqeni artificial dhe janë edhe një hallkë e tërë e këtyre mekanizmave dhe e këtyre interesave nacionale strategjike për vendin dhe a ka zhvillim ekonomik pa një furnizim stabil dhe korrekt me energji elektrike?

Është e vërtetë që është e padrejtë, është johumane që dikush të paguajë fatura në një shtet për qytetarë të një pjese të po këtij shteti.

Por është momentum i fundit që në prag të dialogut final, i cili do të jetë aspak i lehtë me Serbinë, ne si të zgjedhur të popullit të mos ndikohemi prej pazareve personale, për interesave partiake dhe dikush mund të jetë mbase me popullist dhe të flasë për një apo këtë çështje.

Kosova është keq në këtë proces. Përgatitjet nuk po i shoh aspak serioze nga institucionet relevante që kanë obligime kushtetuese, do të na vijë platforma për bisedime këto ditë, ku është konsensusi nacional, edhe energjia, edhe marrëveshja për energjinë, edhe transmissioni, edhe KOSTT-i edhe tema që po e bisedojmë sot duhet të jenë segmente të rëndësishme që ne si të zgjedhur të popullit jemi marrë vesh për një agjendë të caktuar. Ku janë vijat e kuqe që nuk guxon ky Kuvend dhe këto institucione të Republikës së Kosovës të mos i tejkalojnë?

Prandaj, duhet të jemi më kreativë, më pragmatikë, më konkretë, t'i hartojmë tri ose katër pikat e kësaj rezolute që e obligojnë Qeverinë dhe mekanizmat që i subordinohen Ekzekutivit të vendit që këto t'i zbatojë në praktikë.

KOSTT-i është në gjendje të keqe. Gjashtë milionë euro borxhe, nuk janë asgjë me çka do të përballlet në periudhat në vazhdim dhe atëherë kujt do t'i adresohemi? A jemi institucioni më i lartë legjislativ i vendit, mbase edhe institucioni kryesor, sepse ne jemi Republikë Parlamentare?

Por edhe zyrtarët qeveritarë të mos dalin në këtë foltore dhe të na tregojnë përralla, por të merren me punë konkrete, me përgjegjësitë që i obligon Kushtetuta dhe ligji.

Prandaj, lidhur me këtë çështje ta ndërtojmë një konsensus, një agjendë praktike dhe ta aplikojmë parimin e reciprocitetit.

Nuk po e zbaton Serbia një marrëveshje, po nuk e zbatojmë as ne, sepse po i themi vetit shtet i pavarur dhe sovran, të gjitha pazaret e tjera nën këtë preambulë që përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës frikësohem se do t'i dëmtojë gjeneratat e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami Kurteshi, vetëm të keni parasysh minutat që janë për Lëvizjen Vetëvendosje, edhe 6 minuta.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndoshta na jepni ju, nëse ju duken pak.

Unë po filloj për temën, po filloj me vendimin e gjykatës. Gjykata në Kosovë ka vendosur që vendimi për pagesën në pjesën veriore të rrymës është i paligjshëm. Edhe këtu nuk kemi çka të diskutohet, është një vendim i gjykatës, vendimi i plotfuqishëm, duhet të zbatohet, të ekzekutohet.

E dyta, gjykata po ashtu ka konstatuar se pagesa për shpenzimin në pjesën veriore të Kosovës ka elemente të diskriminimit, edhe ato në dy rrafshë: një, ata as nuk paguajnë dhe as nuk detyrohen.

Kurse, nën dy, në pjesën tjetër për qytetarë e tjerë të Kosovës qytetarët detyrohen të paguajnë, nëse nuk paguajnë, u ndërpritet rryma, shumë punë e thjeshtë. Domethënë ata blejnë mall, nëse nuk japin para, jua ndalin mallin, diçka më të thjeshtë nuk ka.

Çështja e tretë që ka vendosur gjykata është cenimi i pronës. Pagesat që janë bërë, qoftë edhe ky një milionësh, merret prej pronës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. A është si tatim, a është si faturë e energjisë, në çfarëdo mënyre e paguajnë qytetarët e Kosovës, u merret në mënyrë të paligjshme për dikë tjetër. Ky është veprim i thjeshtë, këtë e ka vendosur gjykata, pa ndonjë komplikim.

Prandaj, sasia e parave që duhet paguar janë pronë e qytetarëve, ajo u merret në mënyrë të paligjshme.

Edhe si konsumatorë po ashtu Gjykata ka vendosur në këtë rast, në rastin e energjisë domethënë nuk bëhet pagesa ashtu siç duhet, në mënyrë transparente dhe ne të gjithë si konsumatorë dëmtohem.

Çka është në pyetje? Përgjigjja është kjo: duke i pasur parasysh këto elemente të vendimit të gjykatës, kjo pagesë është e paligjshme, është diskriminuuese, është cenim i pronës, është cenim i të drejtës së konsumatorit.

Çka domethënë kjo? Vërtet ka një zgjidhje të thjeshtë, e mund të diskutojmë për këtë. KEDS-i nuk e ka provuar asnjëherë në pjesën veriore të shkojë të inkasojë rrymën e harxhuar, asnjëherë nuk ka provuar. KEDS-i e ka për obligim si kompani private t'i shkojë secilit konsumator e t'i kërkojë pagimin e rrymës. Nëse nuk e paguajnë, duhet t'i drejtohet Qeverisë, e Qeveria të bëjë përpjekje t'ua ndërpresë. Nëse aty ka pengesa, Qeveria e ka për detyrë me mekanizmat e vet t'i ndihmojë KEDS-it brenda territorit të Republikës së Kosovës që ta bëjë këtë punë, edhe kjo është puna më e lehtë për të mos i marrë paratë e qytetarëve.

Faleminderit, po ky është propozimi që KEDS-i së paku një herë të provojë faturimin e rrymës në pjesën veriore. Nëse ka pengesa, pastaj duhet të veprojë Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Është provuar, bre, disa herë të faturohet rryma në veri dhe kurrë nuk është realizuar. Problemi i faturave të energjisë elektrike në veri është që 20 vjet.

Unë habitem me përkushtimin e njerëzve që flasin me aq kompetencë për këtë çështje, e vetë kanë qenë pjesë e pushteteve deri sot dhe kurrë nuk janë marrë me adresimin e kësaj problematike.

Është shndërruar, zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, Parlamenti në fontanë dëshirash, çka nuk po flitet në emër të një milion eurove që Qeveria e Republikës së Kosovës ia paska dhënë KOSTT-it, që nga dialogu me Serbinë, që nga metodat shkollore të zhvillimit ekonomik, që nga përplasjet, promovimet politike në këtë Kuvend.

Ndërkohë që, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kam përshtypjen që kryesuesi i seancës parlamentare, edhe kur jeni ju, mirëpo edhe kur janë zëvendësit tuaj, nuk po e kryejnë detyrën siç duhet dhe po i lënë deputetëve që të shëtitën bash kah po kanë qejf.

Zoti deputet i Lëvizjes Vetëvendosje po thotë që vendimi është i paligjshëm dhe s'kemi çka të flasim tjetër.

Vendimi i paligjshëm për faturimin e qytetarëve të jugut për pjesën e shpenzuar të energjisë elektrike në veri është ndërprerë nga Qeveria Haradinaj, ndërkaq ne po flasim tash për çështjen e një milion eurove.

Ju mund ta merrni me mend, për shembull, e kemi një interpelancë të kryeministrit të Republikës së Kosovës për ndarjen e një milion eurove, e kemi edhe një tjetër interpelancë që e ka të njëjtën problematikë, është kontrata me Contour Global dhe faktikisht deputetët e Kuvendit të Kosovës, partitë politike në garë për të promovuar veten dhe nismat e tyre kundër Qeverisë nuk arrijnë të merren vesh as që t'i fuzionojnë dy interpelanca në një të vetme, në mënyrë që të mos na humbin kohë as neve, as qytetarëve të Kosovës.

Kërkoj, zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, që ta drejtoni seancën më me përgjegjësi dhe deputetët të fokusohen në materien, në problematikën që po e diskutojmë dhe të mos shëtitën dhe të mos lëvrojnë mbi aspekte të ndryshme, politika të ndryshme dhe ta shndërrojnë Kuvendin në platformë dhe në instrument të promovimit të tyre politik, pa u fokusuar në përmbajtje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami, po e shoh, veç minutat i merr, pastaj. Atëherë fjala për ju, Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Unë po habitem tash, zoti Nitaj, me juve, po kërkoni ndërprerjen e debatit në Parlament. Për çka jemi këtu, dhe këtë po e bëni disa herë. Edhe zoti Kuçi, edhe ju, edhe të tjerët, jo politizim, jo

popullizëm, more ne jemi këtu në Parlament të diskutojmë dhe të mos pajtohemi. Merrni një herë këtë punë seriozisht, nuk jemi në biznes, nuk të pëlqen, s'pajtohesh me mua.

Çështja tjetër është se nuk po fluturon askush. Tash pyetja konkrete: ku e merr Qeveria e Kosovës një milion euro t'ia paguajë KOSTT-it, prej cilave para? Nëse qenka fluturim, ku i merr ato, a i merr prej taksapaguesit dhe konsumatorit të Republikës së Kosovës? Ne po diskutojmë për çështje, po doni të ikni duke kërkuar nga kryetari, udhëheqësi i seancës, t'ua ndërpresë diskutimin deputetëve pa e prek kërkon. Unë jua përmenda emrat që të reagoni, të përgjigjeni në këtë pyetje: Ku merret ky një milion euro për KOSTT-in?

KRYETARI: Po, zoti Nitaj, fjala për ju!

MUHARREM NITAJ: Unë fare nuk kërkoja që të ndërpritet debati për temën, unë kërkoja diçka tjetër, por kam përshtypjen që ju nuk e keni dëgjuar fare. Fjala e juaj e parë e debatit tuaj ka qenë vendimi është i paligjshëm dhe ne s'kemi çka të diskutojmë fare për këtë temë dhe keni vazhduar dhe keni diskutuar edhe pesë minuta të tjerë duke harruar se çka thatë vetë.

Shefi i partisë sate ka folur sot për gjithçka, veç jo për energjetikën dhe jo për një milion euro.

Unë po kërkoj, zotëri, fokusohuni në materien, në temën që e kemi për debat dhe mos lëvroni në fusha të tjera. Ky ishte intervenimi im.

KRYETARI: Edhe kështu dy orë e dhjetë minuta i kemi kaluar, tri orë është interpelanca. Vazhdojmë tutje.

Milaim Zeka, në marrëveshje, ka marrë minutazhin e 6+. Urdhëro!

MILAIM ZEKA: Kryetar, duke medituuar kështu si Ethem Ramadani, bash është hera e parë që unë kurrë sot s'kam kuptuar prej që ka filluar ky debat. Domethënë, në jetën time është hera e parë që e ndjej veten komplet idiot, kështu, 100%. U fol për demarkacionin, s'u fol fare për energjinë, një.

E dyta, krejt u tha këtu se kjo Qeveri nuk i ka votat, i ka 53 numra. Po të kisha fuqi magjike e ta shpall një konkurs që opozita t'i ketë 120 deputetë, e t'i thuhet i ke gjashtë muaj, provojeni veten. Le të dalë dikush prej opozitës edhe le të më tregojë çka kishit bërë ju? A i kishit hëngër serbët me dhëmbë në veri të Mitrovicës? A mos jeni duke bërë armë bërthamore ju, që po ju frikohet Vuçiqi atje, u bë kaps në Beograd prej juve a? Ne nuk kemi helikopter për ndihmë të shpejtë, një pacient na vdes në Prizren, ne s'mund ta sjellim në Prishtinë! Po këtu është bërë modë, në vend që të flitet për gjëra konkrete për të cilat u thirr interpelanca, edhe pse edhe thirrja e interpelancës për mua është jashtë logjikës! Pse? Është thirrur në mars, tërhiqni bre nganjëherë,

u vjetrua kjo farë pune! Njerëzit po i ndërrojnë gratë kur po u vjetrohën, jo interpelancën, tërhiqe. E jo këtu 'dërt' ai, 'dërt' ai, 'dërt' ai.

Tha një deputet i Lidhjes Demokratike, nuk po ia përmendi emrin, tha të mos na kallëzojë përralla Qeveria. Përralla Qeveria, përralla opozita, përralla ne, sepse ne një detyrë e kemi pasur në këtë vend, vetëm një detyrë: ta bëjmë Kosovën shtet.

Në qoftë se e kishim krijuar Kosovën shtet funksional, nuk kishim diskutuar sot për probleme të tilla, po duke e parë krejt dynjaja që ne e keqpërdorim paranë publike, ne s'kemi shqilla funksionale, ne s'kemi shëndetësi funksionale, ne s'kemi azil të pleqve, ne nuk kemi pensione për pensionistë që e bën një pensionist ta ndijë veten me dinjitet, me personalitet, e të thotë e ka pensionin 400 euro.

Ne i kemi mizëri rrogat e policisë. Ta vizitojmë Spitalin Qendror në Prishtinë, shihni atje pacientët si vuajnë, me çka përpëlitën. Këto janë për mua problemet me të cilat ballafaqohem dhe që më mendojnë. Kjo puna e demarkacionit, puna e Veriut të Mitrovicës, po ju tregoj diçka, pa u bërë edhe një luftë e tretë botërore, harroni ju këto tema, se veç jeni duke ia lyer me akull trurin këtij populli fukara të shkretë, që atë ditë që të liberalizohen vizat, do të mundohen të ikin si të munden prej këtij vendi. Ne ia kemi gërditur jetën këtij populli, edhe me këto debate, fukarallëku në kulm, papunësia në kulm, hajnia në kulm, keqpërdorimi në kulm, e ne diskutojmë për demarkacionin e për Veriun e Mitrovicës. O, po na e ktheu Brukseli shpinën, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jo që ta ndalë Gazivodën, po ta lëshon e na merr uji deri në Prishtinë! Ne e dimë çfarë trimash kemi qenë në luftë, ne e dimë sa për qind kanë dalë në demonstratë, ne e dimë sa për qind e kanë mbështetur luftën, sa luftëtarë i kemi pas përnjëmend, krejt i dimë këto, këndeje kemi qenë.

Kur është kënduar kënga "Marshall Tita në kali të kuq" kur kemi rënë ne në burg më '81-tën, ata njerëz na kanë burgosur, na kanë persekutuar, na kanë dënuar, ata i ke në sistem. Për mua problemi i sistemit të drejtësisë në Kosovë që s'po të funksionon. Krejt gjykatësit, prokurorët, shumicën prej tyre i ke të '81-ës që na kanë dënuar. Prandaj, po e përfundoj fjalimin tim me atë, ju lutem, të paktën edhe e kisha lutur RTK-në t'i përcjellin pak seancat, por kur ka këso farë debatesh pa lidhje, mirë kanë bërë mbrëmë që e kanë lëshuar promovimin e librit të presidentit atje, na e kanë ndalur neve, se po e terrorizojmë publikun me këso temash bajate. Bile, e pyeta Kujtim Shalën, thashë: Kujto, a kuptove diçka prej këtij debati? Më tha: Milaim, bash kurrëgjë s'kam kuptuar dhe jam me grip. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Korab Sejdiu dhe Lumir Abdixhiku, janë dy deputetë, cili e merr fjalën, janë 9 minuta. Korabi, urdhëro!

KORAB SEJDIU: Fillimisht, të nderuar qytetarë dhe kolegë!

Kryetar i nderuar!

Nuk po kuptoj me kë e kemi këtë interpelancë, është shndërruar në sëmundje kronike të kësaj Qeverie që kur flasim për ta, për problemet të cilët ata nuk i adresojnë, të mos jenë të pranishëm, kështu që unë besoj se veç po humbim kohë këtu, pasi që nuk po presim asgjë, thjesht po shpenzojmë fjalë koti.

Dhe, kjo në fakt, më dërgon mua tek çështja e vendimit në fjalë, i cili assesi nuk mund të diskutohet si i izoluar, po thjesht është një simptomë e një sëmundjeje shumë më të madhe të kësaj Qeverie që ka të bëjë me qasjen e saj dhe mungesën e kapacitetit për të adresuar problemet reale, me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë dhe rrjedhimisht në mungesë të këtij kapaciteti dhe të këtyre shkathtësive, ata marrin vendime ad hoc që të gjuajnë paratë e popullit të Kosovës, të qytetarëve të Kosovës, të buxhetit të Kosovës duke u munduar t'i mbyllin vrimat aty ku hapen ditën e sodit, të nesërmen, e kështu me radhë. Unë besoj që ky është vetëm një nga shumë vendimet e papërgjegjshme, të cilat janë marrë si rezultat i pamundësisë së kësaj Qeverie që të ketë një strategji të caktuar dhe të alokojë buxhetin dhe kapacitetet financiare, burimet që i kemi për t'i realizuar ato politika zhvillimore.

Thjesht, ne jemi një vend që ka probleme goxha të mëdha, por në të njëjtën kohë kemi burime shumë të kufizuara financiare për t'i adresuar ato probleme. Njëkohësisht, kemi probleme edhe që nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me kapacitetet tona financiare, por edhe me mundësinë dhe mobilizimin tonë si shoqëri për t'ia adresuar dhe thjesht kjo Qeveri nuk është duke e bërë atë. Kështu që vetëm dëshiroj që sot t'ia përkujtoj edhe një herë Qeverisë, shpresoj që së paku janë duke e shikuar diku këtë seancë, në vend që të jenë këtu para nesh, që jemi, në fakt, punëdhënësit e tyre, që të mos mundohen që me shpenzime të kota të parasë publike, të cilat mund të shndërrohen edhe në kallëzime penale e në aktakuza, t'i mbyllim së paku në mënyrën ad hoc, në mënyrë të përkohshme problemet e mëdha të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Shumë pak kohë kam, kështu që le të jetë për ndonjë replikë.

KRYETARI: Atëherë, Ahmet Isufi, ka vetëm edhe një deputet, Lumir Abdixhiku.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne po flasim këtu për një problem të bartur dhe si problem i tillë është diskutuar edhe në të kaluarën dhe nuk është i panjohur, por nëse thuhet për veprime, është një vendim i Qeverisë, i përkohshëm, i cili është vendim që ka dashur të zbusë gjendjen sa i përket sidomos konsumatorit të ndërgjegjshëm, i cili e paguan rrymën ashtu si duhet, si një qytetar i ndershëm i këtij vendi.

Prandaj, për të mos e cenuar drejtpërdrejt atë, nga buxheti i Republikës së Kosovës i janë lëshuar 1 milion KOSTT-it, në mënyrë që vërtet të mos cenohen pikërisht ata qytetarë që i obligohen shtetit dhe ligjit.

Prandaj, duke i pasur edhe veprimet e tjera parasysht që janë bërë edhe me Haden, edhe me Shipitullën, edhe me komunikimin që nuk ka ndodhur deri tani me të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me energjinë, ne këtu duhet të japim ide se si mund të dilet nga kjo gjendje dhe të propozojmë iniciativa, të cilat e ndryshojnë gjendjen dhe jo vetëm të akuzojmë, sepse për të akuzuar kemi shumë më shumë arsye ne për qeveritë e kaluara, të cilat nuk e kanë zgjidhur këtë problem më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lumir Abdixhiku është deputeti i fundit i lajmëruar.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Unë besoj që tema e sotme kërkon më tepër seriozitet në trajtim, sepse s'është temë e vjetër, është temë e re, dhe më së paku meriton shndërrim në seancë komike dhe nuk bëhet fjalë për 1 milion euro që i japim sot. Unë kam takuar zyrtarët e KOSTT-it, të njëjtët më kanë treguar se deri në fund të vitit do të bëhen 10 milionë euro. 10 milionë euro do të jetë borxhi i Kosovës që do ta ketë, në fakt i KOSTT-it, për shërbimet në Veri.

Dhe për aq sa zgjat relacioni i tillë në Kosovë, për aq do të shtohen edhe borxhet e KOSTT-it. Tash që ta kemi të qartë, KOSTT-i është obliguar nga Rregullatori që të furnizojë Veriun me energji dhe KOSTT-i nuk prodhon energji elektrike, KOSTT-i e huazon këtë energji. Herën e fundit huazimi i KOSTT-it kishte shkaktuar një problem ndërkombëtar, ju kujtohet rasti i orëve të mbetura prapa në Bashkimin Evropian dhe si i tillë ky problem ka rrezikuar seriozisht anëtarësimin edhe të KOSTT-it në këtë rrjet evropian. Në ndërkohë, meqenëse është bërë problemi Kosovë-Serbi problem evropian, kanë filluar dhe trajtimet në këtë rrjet evropian. Një prej propozimeve që është në tavolinë, që ta dini, është i Serbisë, që rrjeti i furnizimit me energji, kufiri i Serbisë, të vendoset deri në Vallaç.

Pra, që Veriu i Kosovës të furnizohet nga Serbia. Dhe, meqë është problem evropian, një propozim i tillë nuk është se s'është konsideruar në rrjetin evropian. Natyrisht, për Kosovën një zgjidhje e tillë është e papranueshme, sepse vendosja e kufirit energjetik të Serbisë në Ibër do të nënkuptonte edhe kufij të ri politikë, dhe këtë alternativë ne natyrisht se duhet kundërshtuar sa herë që na vjen në tavolinë dhe fatkeqësisht kostoja e kundërshtimit është kompensimi financiar.

Tash janë dy alternativa në tavolinë që i kemi për të zgjidhur këtë problem, e para e pazëvendësueshme është marrëveshja e Brukselit dhe pyetja këtu është si do ta detyrojmë Serbinë të implementojë këtë marrëveshje. Unë po besoj që politika e reciprocitetit tregtar, sepse

edhe energjia elektrike është produkt, mall, ndaj Serbisë do t'i përshpejtonte përpjekjet e tyre për gjetje të zgjidhjes. Dhe, e dyta, në qoftë se ne veç duhet të japim miliona deri në zgjidhjen eventuale, ta bëjmë këtë nga Fondi i Veriut. Pra, Fondi i Veriut sot, nëse s'gaboj, i ka 11 milionë euro, borxhet e KOSTT-it do të jenë diku rreth 10 milionë euro deri në fund të vitit. Në qoftë se Fondi i Veriut i ka 11 milionë euro, e në qoftë se ne i krijojmë 10 milionë euro borxhe për qytetarët e Veriut, t'i shfrytëzojmë këto mjete, në mënyrë që të mos e ngarkojmë buxhetin e Kosovës.

Në anën tjetër, po them edhe një herë zgjidhja më afatgjate është reciprociteti ndaj Serbisë dhe implementimi i marrëveshjes tregtare atje. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Isufi, ndërkohë po e shoh emrin tuaj.

AHMET ISUFI: Është problem i mëhershëm, për shkak se të gjithë e dimë që gjendja energjetike në Kosovë nuk është e sodit, po është e bartur dhe këtë e thashë, dhe nën dy, nuk janë 10 milionë euro, po sipas kërkesës për interpelancë, thuhet shumë mirë këtu, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 1 milion euro KOSTT-it, e paragjykimi se a do të ndodhin 10 milionë, 20 milionë e të tjera, ato janë çështje të paragjykitimit që mund t'i ketë dikush.

KRYETARI: Prapë, Lumir Abdixhiku e ka kërkuar fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Vetëm për qartësim, në momentin që është bërë kërkesa, mjetet e Qeverisë janë ndarë 1 milion euro. Nga ajo ditë deri më sot KOSTT-i është në borxh 7 milionë euro. Sipas interpretimit zyrtar të KOSTT-it dhe po ju flas si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, meqë jam marrë me këtë punë, deri në fund të vitit projeksionet do të jenë 10 milionë euro, së paku.

Pra, nuk bëhet fjalë për një infuzion njëherësh prej buxhetit të Kosovës, bëhet fjalë për mirëmbajtje financiare të rregullt të buxhetit të Kosovës. Dhe, ky është problem më i madh se sa që është trajtuar deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti kryeministër, nëse dëshironi fjalën! Ky është fundi për këtë interpelancë, kryeministër. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nga ajo që u tha sot, mund ta them që totali i saj qëndron, është e vërtetë. Pra, nuk është logjikë hiç e mirë, as nuk është në rregull që Qeveria e vendit të ndajë para, të paguajë rrymën për komunat në Veri, nuk ka logjikë, pra nuk guxojmë as ta kthejmë në praktikë, as nuk guxojmë ta mendojmë si vazhdim.

Nëse Qeveria mendon se kështu vazhdon më tutje, bën gabim të madh edhe vendi, të gjithë ne bëjmë gabim. Si të dilet nga kjo gjendje, kjo është para nesh. U tha që është menduar gjatë edhe është arritur një marrëveshje për dalje nga kjo gjendje, po e cila s'po zbatohet. Çfarë mekanizmash të përdoren për ta forcuar zbatimin, edhe kjo u cek këtu. T'ju them të drejtën, aktualisht jemi shumë të varur prej vendimmarrësve të tjerë, BE-së dhe Amerikës, por kur po flasim të BE-së, mendoj shumë në rolin e Berlinit zyrtar. Unë besoj shumë që do ta kemi një përparim në këtë drejtim, po nuk ka ndodhur ende. Në rekomandime ju kisha lutur mos operoni në frymën veç sa të krijojmë tema, por shqyrtoni rekomandimet së bashku që t'i kërkohej Qeverisë të zbatohet kjo marrëveshje, nën një, nëse ekziston, pra Qeveria të zbatojë këtë, ose të zbatojë të drejtën në treg në Veri, por mos krijoni edhe obligime që ndoshta nuk përputhen me realitetin që e kemi si vend, por të ecim kah të arriturat.

Unë e di që ky debat është kërkuar edhe më herët, edhe unë e di që të gjithë ju e ndjeni këtë temë, mendoj që kjo është temë e çdokujt që jeton në këtë vend, edhe për mua s'ka qenë pozitë e lehtë, si ekzekutiv, pra kjo zgjidhje. Nuk mendoj që është në rregull Qeveria të mendojë se duhet vepruar kështu më tutje. Ka ndodhur një herë, nuk e di a do të ndodhë më, por nuk është mirë të ndodhë më. Varemi shumë nga fuqia jonë e përbashkët që a mund të kalojmë në finale të kësaj teme e të mos improvizojmë, si vendimi i Qeverisë për ta ndarë këtë shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Tani radhën e ka propozuesi, zonja Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Më duhet gjithashtu të potencoj që kryeministri e tha nuk bën, nuk është në rregull Qeveria të paguajë rrymë në Veri. Kryeministër, Qeveria ka paguar rrymë në Veri, kanë paguar qytetarët e Republikës së Kosovës. Ideja është cili është mekanizmi i Qeverisë ta ndalë këtë praktikë, mendoj që i vetmi institucion në këtë sallë, në këtë rast që i ka mekanizmat është Qeveria dhe vendimet e Qeverisë duhet reflektuar drejtpërdrejt në zgjidhje të situatës në raport me rrymën, e cila po furnizohet dhe nuk po paguhet.

Tash, në diskutimin me bashkësinë ndërkombëtare, unë e di për të sigurt që të paktën Berlioni ka qenë më shumë i interesuar që kjo çështje të zgjidhet në mënyrën më të mirë të mundshme, ndoshta më shumë se ne vetë kosovarët, një prej arsyeve ka qenë edhe investimi i drejtpërdrejtë që e kanë bërë në linjën e interkoneksionit me Shqipërinë, që nuk është funksionale as sot, nuk është lëshuar. Ndërsa, e di gjithashtu që prapë po e potencoj që ju, kryeministër, keni propozuar ose jeni tërhequr në njëfarë mënyre nga udhëheqja e dialogut, përkundrejt faktit që krejt mekanizmat për zbatimin e atyre marrëveshjeve i keni ju, gjegjësisht i udhëhiqni ju si kryeministër. Krejt çka ka të bëjë me mekanizmat të zbatimit të marrëveshjeve të arritura në Bruksel i ka Qeveria e Kosovës, nuk i ka Presidenca, as nuk i ka Kuvendi, po i ka Qeveria, se janë mekanizma zbatues, për atë quhet ekzekutiv, se i ka mekanizmat, të cilat duhet të ekzekutojnë. Edhe vendimet që do të merren sot këtu ose nëse do të votohen këtu, rekomandimet

nga interpelanca, prapë do të jenë vendime ose obligime që duhet t'i kryejë Qeveria, ne mund të propozojmë, por ju duhet t'i zbatoni.

Ndërsa, në përmbyllje janë disa pika, të cilat i propozojmë si thirrës të kësaj interpelance, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratiket të Kosovës që:

1. Të obligohet Qeveria e Kosovës që në afat prej një muaji të vijë me zgjidhje për situatën e krijuar, përfshirë këtu:

a. Planin e kompensimit të humbjeve të KOSTT-it, të shkaktuara nga udhëzimi i ZRRE-së për furnizim të rrymës në Veri,

b. Të llogarisë vlerën totale të pagesave për rrymën në veri dhe të kalkulojë kthimin e vlerës të papaguar për këta konsumatorë.

2. Të ndalen inkasimet ilegale për rrymën e faturuar në veri.

3. Domosdoshmërisht të kushtëzohet vazhdimësia e dialogut me zbatimin e marrëveshjes për energjinë, duke e krijuar një task forcë të përbërë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe përfaqësues të autoriteteve të përfshira në çështje, si KOSTT-i, ZRRE-ja, ARBK-ja dhe të koordinohen veprimet për dialog për të nxjerrë KOSTT-in nga situata aktuale.

4. Në procesin e dialogut Kosovë-Serbi të mos pranohet asnjë ndryshim i marrëveshjes për energjinë të nënshkruar më 8 shtator 2013 dhe

5. Të mbulohen shpenzimet e KOSTT-it nga tërheqja e rrymës, nga interkonjeksioni, nga Fondi i Veriut. Me këtë rast, Qeveria e Kosovës obligohet të marrë një vendim në raport me pagesën për borxhet e KOSTT-it.

Ky është propozimi, jemi të gatshëm që grupet parlamentare të propozojnë secili nga një përfaqësues që të jenë në grup për finalizim të tekstit të mocionit të interpelancës për vendimin e Qeverisë nr. 02/34 të datës 5 mars 2018.

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri dëshiron të përgjigjet në disa nga çështjet para votimit.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë vërtet e mirëpres këtë pozicion të qartë të Kuvendit që ta obligojë Qeverinë që të marrë fund situata me marrëdhëniet produkt-pagesë, dhe të drejtat që i ka Kosova në tregun e vet të energjisë në Veri.

Po i keni disa gabime në ato konstatimet tuaja, zonja Kusari Lila. Nuk janë mekanizmat zbatues në Qeveri, sepse nuk janë vendime tuajat e të Qeverisë, por janë vendime të atyre që i keni bërë bashkë në të kaluarën me Brukselin, me ata të tjerët, se të kishin qenë veç të Qeverisë kaheerë i kishim zgjidhur, po kështu procesin e kemi nxitur bashkë, është trepalësh, fatkeqësisht, unë në atë gjendje që i kam gjetur po mundohem t'i kthej, t'i bëjmë tonat, më vjen mirë që edhe Parlamenti do t'i përvetësojë këto. E vetmja pikë që më ndihmon shumë, ma merr mendja, është treshi, pika juaj. Pika numër 3 më ndihmon si Qeveri, se më obligon që unë të detyrohem të mbetem besnik i radhitjes së temave që i kemi diskutuar, e që njëra nga to është e para, pra, që duhet trajtuar, është marrëveshja për energjinë që nuk po zbatohet.

Pra, nuk është krejt kompetencë jona, se sikur të kishte qenë, s'kisha ardhur unë këtu sot para juve. E pse s'është veç imja, besoj e dini edhe ju të gjithë.

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 44.4 të Rregullores së Kuvendit ka propozuar për miratim një mocion. Kërkohet deklarimi me votim për tekstin e mocionit të propozuar. A shkojmë drejt në votim, a keni bërë? Jo, jo, a keni bërë harmonizimin? A e fusim si rregull ta bëjmë një harmonizim grupet parlamentare. Atëherë, kërkoj nga grupet parlamentare që para votimit, ta përcaktojnë nga një njeri, nga një deputet prej secilit grup parlamentar që të arrijmë një dakordim për projekt-rezolutën, e cila do të votohet.

Urdhëro, zoti Konjufca, ka diçka për të shtuar?

GLAUK KONJUFCA: Jo, vetëm pata të shtoj diçka në aspektin teknik që po na ndodh disa herë të mos e respektojmë në mënyrë pak më rigorozë Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Po insistoj, edhe këtë e kam ngritur edhe disa herë më herët që kur janë interpelancat, diskutimi të përfundohet me propozuesin e interpelancës, jo me kryeministrin. Dhe, kjo të bëhet rregull, pra që propozuesi të jetë i fundit dhe të mos jetë fjala e fundit e kryeministrit. Interpelanca është që kryeministri të flasë, po ta përmbyllë ai i cili kryeministrin e ka thirrur në përgjegjësi dhe të japë llogari. Kështu duhet të jetë gjithmonë dhe po na ndodh që dy herë të thyhet kjo rregull e dokumenteve të Kuvendit, nuk do të ishte mirë.

KRYETARI: Faleminderit! Vërejtje me vend, po ta keni parasysht. Propozuesi i interpelancës në fund do të jetë adresimi i fundit, për arsye se e kemi bërë praktikë, pas përfundimit të gjithë debatit, del edhe i drejtohet edhe një herë foltores së Kuvendit, duke u kërkuar kolegëve deputetë që ta votojnë. Kështu edhe kjo do të jetë edhe sot, po tani pasi nuk e kemi harmonizimin, në qoftë se jeni të pajtimit, e pashë edhe reagimin, shkojmë në pauzë deri në orën 15:30, në qoftë se jeni të pajtimit, si të doni vazhdojmë. Ju e vendosni si të doni?

Për harmonizim a ka, po ka reagim nga propozuesi i kësaj interpelance. Emrat nga një te zonja Mimoza Kusari-Lila, që në mënyrë që në orën 15:30, kur e vazhdojmë këtë seancë, mundësisht

zonja Mimoza Kusari-Lila ta marrë fjalën, do t'ju drejtohet juve, në mënyrë që të kemi një harmonizim të rezolutës për votim, edhe votimin pastaj. Të gjitha grupet le ta dërgojnë nga një, të mos e fus tash këtë në pjesë të seancës. Në orën 15:00? Në rregull, në orën 15:00 e vazhdojmë këtë seancë. Faleminderit! Kini parasysh, unë ose njëri nga nënkryetarët do të jetë në sallë dhe fillon, edhe në qoftë se janë dy deputetë, ne vazhdojmë me interpelancën tjetër në orën 15:00. Do të vazhdojmë me interpelancë edhe nëse nuk kemi kuorum, vazhdojmë me interpelancën tjetër, kryeministri do të jetë i pranishëm në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Po vazhdojmë me seancën. Jemi në pikën e rendit të ditës:

19. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate , në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017

Grupi Parlamentar të Partisë Socialdemokrate ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë së lartpërmendur dhe Qeverisë sonë më datën e lartcekur.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, zotin Dardan Sejdiu, si propozues i interpelancës që ta marrë fjalën. 10 minuta!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Do të mundohem që për dhjetë minuta të shpërfaq problemet dhe arsyet pse marrëveshja komerciale për Termocentralin Kosova e Re me ndërmarrjen Contour Global duhet të ndërpritet.

Diskutimi për një termocentral të ri ka filluar qysh në vitin 2002, kur u publikua raporti për asistencë teknike në sektorin e energjisë së Kosovës, që është financuar nga Banka Botërore dhe ky raport propozoi disa politika dhe mundësi të investimeve në periudhën 2002 - 2015.

Në vitin 2005 për herë të parë u hartua një strategji energjetike dhe në vitin 2005 u prezantua projekti për Termocentralin Kosova C në atë kohë prej 2100 MW me kosto prej 3,5 miliardë eurosh dhe ky numër duhet të mbahet në mend. Në vitin 2006 u krijua një komitet drejtues dhe ky komitet drejtues i shpenzoi 17 milionë dollarë për të ardhur në pikën, në të cilën jemi sot dhe në pikën në të cilën jemi sot është pasojë e disa vendimeve që janë marrë prej vitit 2009 - 2017, kur edhe është nënshkruar kontrata. Kanë ndodhur katër ndryshime, të nderuar, derisa kemi ardhur në pikën në të cilën jemi sot. Këto ndryshime kanë ndodhur përgjatë periudhës kohore 2009 - 2017.

Në vitin 2009 e kemi ndryshuar vendimin prej 2100 MW e kemi sjellë në 1000 MW, pra projekti ka filluar me 2100 ka përfunduar me 1000 në vitin 2009. Më 1 prill 2010 është marrë vendim që të bëhet 500 + 500. Në vitin 2010 më pastaj, përsëri është marrë vendimi që të ndërrohet ky kapacitet në 600 MW dhe, edhe pse ishin parakualifikuar kompanitë Qeveria e Kosovës përsëri e ndryshoi pakon tenderuese dhe e hoqi nga paketa kapacitetin aktual gjenerues “Kosovën B”, ndërsa një vit më vonë, në nëntor të vitit 2013 gjithashtu i hoqi edhe mineralet nga pakoja tenderuese.

Pra, prej vitit 2002 deri në vitin 2017 kemi filluar me 2100 MW për 3,2 miliardë euro dhe kemi përfunduar në pako tenderuese, e cila ka ndryshuar edhe pse kanë ofertuar kompanitë. Në fakt, ky proces është përcjellë edhe me dështime ligjore. Procesi i kontraktimit të kompanisë për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, përveç që ka pësuar ndryshime të shpeshta, ai është përcjellë edhe me manipulime të bazës ligjore. Vendimi i Qeverisë nr. 08/17, datë 1 qershor 2011, e anashkalon të gjithë legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe autorizon komitetin drejtues për të kryer krejt procedurat e prokurimit në përputhje me praktikën e mira dhe udhëzimet e prokurimit të caktuara nga Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar. Por, një muaj më vonë me planin e veprimit të vizionit ekonomik të Kosovës 2011 - 2014 nga korriku i vitit 2011 përmendet pikërisht ligjet që në vendimin paraparak janë anashkaluar, pra thuhet që me këto ligje do të bëhet termocentrali.

Tutje, neni 32.4 i Ligjit për prokurim publik thotë, se nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit pranohen më pak se dy tenderë të përgjegjshëm, kur është e zbatueshme kërkesa për pjesëmarrje autoriteti konkurrues duhet të anulohet aktivitetin e prokurimit.

Të nderuar deputetë,

Ofertë për Termocentralin Kosova e Re ka sjellë vetëm Contour Global, pra vetëm Contour Global ka sjellë edhe atë si pjesë e dytë e një konsorciumi, i cili ka aplikuar. Kanë aplikuar katër kompani. Contour Globali për të qenë pjesë e tenderit është dashur ta marrë një kompani, që e ka pasur emrin PPC nga Greqia, në mënyrë që t'i plotësojë kushtet. Dhe, edhe kështu e kemi thyer Ligjin e prokurimit publik.

Gjithashtu, Termocentrali i Ri po ndërtohet pa vlerësim të ndikimit në mjedis apo pa analizë të ndikimit social. Kushtetuta e Republikës së Kosovës qartazi, neni 52 i kësaj Kushtetute, paragrafi 2 dhe 3 thotë: “Në mënyrë të qartë kërkohet që të gjitha projektet me implikime në mjedis të garantojnë angazhimin e qytetarëve në vendimmarrje dhe se duhet të ketë vlerësim të ndikimit mjedisor.”

Tutje, sekretariati i komunitetit të energjisë gjithashtu ka shqyrtuar kontratën dhe, edhe pse rezultatet e saj të plota nuk janë të disponueshme për publikun, ajo ka konfirmuar në raportin e saj të monitorimit të energjisë elektrike në Ballkan, që korniza kontraktuale e fundit e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Kosovën e Re do të pengojë seriozisht zhvillimin e tregut. Pra, ne jemi palë kontraktuese në disa marrëveshje ndërkombëtare dhe me këtë marrëveshje me Contour Global e sidomos, sa i përket traktatit të komunitetit të energjisë, marrëveshjes së stabilizim asocimit dhe detyrave dhe obligimeve që i kemi marrë nga këto, ne jemi në thyerje serioze të këtyre rregullave dhe rrezikojmë përjashtimin nga komuniteti i energjisë.

Por, përveç kësaj, historikut i cili ka ndryshuar, procedurave tenderuese që kanë ndryshuar dhe implikimeve që i kemi sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me Bashkimin Evropian dhe hapjen e tregut edhe kontrata në vetvete është problematike.

Kontrata e nënshkruar i ka tetë marrëveshje. Të gjitha marrëveshjet janë në gjuhën angleze. Ende nuk janë përkthyer, ndonëse marrëveshja është nënshkruar në dhjetor të vitit 2017. Në aneks të Implementation Agreement apo marrëveshjes për implementim është kërkesa që Kosova, përkatësisht Kuvendi me anë të një garancie shtetërore, pra Kuvendi, me anë të një garancie shtetërore t'i garantojë Contour Globalit se do t'i japë për 20 vjet furnizim me thëngjill të një cilësie të caktuar, 20 vjet, furnizim me ujë të një cilësie të garantuar për 20 vjet, çmim të synuar prej 80 MW/orë e që është çmim me shumicë, pa marrë parasysh koston e futjes në operim, koston e transmisionit dhe koston e distribucionit.

Tutje, kontrata nuk parasheh fare asnjë nen për ndryshim të pronësisë. Pra, Contour Globali mund të çohet nesër në mëngjes dhe të marrë vendim që të ndërrojë pronësinë, pra ta shesë komplet projektin. Këtë veçse ka filluar ta bëjë. Në lajmet e Rojtersit e keni Contour Globalin, i cili është në tregje ndërkombëtare duke kërkuar financim ekuitetit për të financuar këtë projekt dhe mund ta ndërrojë pronësinë pa asnjë problem.

Kostoja e synuar e ndërtimit të këtij termocentrali është 1,3 miliardë euro. Çelësi me të cilin do të ndërtohet, ose synohet të ndërtohet ky termocentral është 70 : 30. 70% kredi, 30% ekuitet. 30%-shi që do të jetë financim për Contour Globalin në formë të ekuitetit i garantohet kthim i brendshëm i ekuitetit në vlerë prej 18,5%, pra për diku 400 milionë euro që ata synojnë t'i investojnë e që nuk i kanë, pra janë në tregjet ndërkombëtare duke i kërkuar ato para, financimin

e ekuitetit, kthimi i garantuar për ta është 18,5%, ndërsa 70% do t'i marrin në formë të kredisë. Në 1,3 miliard euro 70% janë afër 900 milionë euro që do të shkojnë në kredi.

Kalkulimi që bëhet në këtë kontratë është që interesi i synuar është 7,5%. 900 milionë euro me kamatë 7,5%, bëjeni kalkulimin, dalin goxha para. Qeveria përndryshe, për t'i garantuar shitjen prej 80 MW/orë të energjisë elektrike Contour Globalit ka themeluar një kompani të re. Kjo kompani e re e ka për detyrim që të blejë 450 MW apo 475 MW, varësisht se sa i prodhojnë, prej Contour Globalit me çmim të garantuar prej 80 eurosh. Çmimi i synuar apo çmimi prej 80 MW/euro gjendet në Pro Power Purches Agreement, recitali F, faqja 7. Ky çmim është më i lartë se ai i dakorduar në marrëveshjen paraprake. Në marrëveshjen paraprake ka qenë 78,6 euro/MW.

Qeveria tutje i garanton që do t'i mbulojë secilin shpenzim variabël për çdo njësi megavati të prodhuar, pra kostoja e synuar e ndërtimit, edhe pse thuhet se është 1,3 miliardë euro, me këtë kombinim 70:30 (70% kredi, 30% ekuitet) kjo kosto e ndërtimit do të shkojë jo më pak se 2,6 miliardë euro e në rastin e kalkulimit edhe të pagesave shtesë, që është dallimi në mes çmimit të tregut dhe çmimit prej 80 eurove do të shkojë deri në 4,5 miliardë euro. Kontrata është e tipit BOT (ndërto, opero, transfero) dhe kontrata e ndërtimit, operimit, është për 20 vite. Transferimi ndodh në vitin 2043. Me traktatet që i kemi nënshkruar ne, në vitin 2050 duhet të ndodhë dekarbonizimi i komplet sektorit të energjisë.

Kjo i bie që ne do të paguajmë për 20 vjet çmim të garantuar prej 80 eurove, do të sigurojmë qymyr cilësie të garantuar për 20 vjet dhe nëse këtë cilësi nuk e arrijmë, atëherë këtë cilësi duhet disi me ia kompensua, ujë me cilësi të garantuar për 20 vjet dhe krejt këto tetë marrëveshje duhet të vijnë në Kuvend këtu për t'u votua.

Çmimi për importe në pesë vjetët e fundit ka rënë çdo vit pas viti. Kemi filluar në vitin 2008 me 112 euro MW/orë energjie të importit dhe sot e kemi çmimin 56 euro për MW/orë. Kontratën po e nënshkruajmë për 80 euro MW/orë. E kam pyetur ZRRE-në në Komision për Zhvillim Ekonomik nëse presim rënie të trendit të çmimit të energjisë elektrike. Më kanë thënë, po, presim rënie të çmimit të energjisë elektrike në vitet që vijnë. Pra, trendi i çmimit të energjisë elektrike nga importi bie, ndërsa ne nënshkruajmë kontratë me 80 euro MW/orë.

Analizën që e kemi përgatitur ne, unë po i paraqes dy analiza. Njërin prej tyre do t'ua shpërndaj 120 deputetëve. Një analizë e ka përgatitur GAP-i (instituti GAP). Dhe, Instituti GAP në kalkulimet e tyre thotë, që në vitin 2023 në momentin kur futet gjeneratori i ri në prodhim me çmim të synuar prej 80euro/MW/orë, çmimi në faturat tona do të rritet për 44% dhe e shihni në graf rritjen e cila ndodh në vitin 2023, kur edhe duhet të ndodhë dekomisionimi i Termocentralit Kosova A. Pra, kemi ngritje të çmimit, ky është GAP-i.

Këtu pretendojmë të gjithë që kjo do të jetë një analizë pak më agresive. Në fakt, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik kam bërë kërkesë që të na e bëjnë raportin në të cilin tregohen implikimet apo vlerësimi indikativ i ndikimit të Kosovës së Re në çmime të energjisë elektrike. Këtë raport e ka përgatitur ZRRE-ja dhe këtë raport do t'ua shpërndaj secilit prej jush. Këtu janë edhe kostot indirekte, që unë në prezantim nuk i përmend fare e që është mihja e re, që do të kushtojë prej 300 - 500 milionë euro për ta furnizuar këtë termocentral, të cilit i paguajmë 80 euro/MW/energji.

Në ZRRE vijnë te numra tjerë. ZRRE-ja thotë në fakt, jo, çmimi nuk do të rritet për 44%, por do të rritet në tregun e shumicës me 66%, ndërsa në faturat tona do të përkthehet me 52%. Pra, KEK-u këtë analizë e bën pa i marrë eksternalitetet fare parasysh, pa i marrë parasysh fare ndikimet tjera, siç është mihja, siç është kostoja në mirëqenien sociale. Ne sot, nëse është ministri këtu, paguajmë energji elektrike për rastet sociale. E kanë një sasi të caktuar të energjisë elektrike që e paguajmë dhe e paguajmë me një çmim të caktuar. Me rritjen e kësaj, kjo ka ndikim shtesë buxhetore.

Dua në fund të flas, para se ta përfundoj këtë ekspozitë fillestare, dua të flas për kompaninë e re që po themelohet.

Kompania e re që themelohet, të nderuar deputetë, themelohet vetëm për t'i transferuar kostot dhe rreziqet nga investitori te Qeveria. Asnjë funksion tjetër nuk e ka kompania e re publike. Në fakt, i vetmi funksion është që t'i bartë kostot dhe rreziqet. Pra, kjo kompani e re do të blejë të gjithë energjinë dhe të njëjtën energji që prodhon Contour Global do t'ia shesë furnizuesve tjerë në Kosovë.

Kjo domethënë që kjo kompani e re publike do të bartë riskun kreditor, riskun operacional dhe riskun e tregut. Ky i fundit, fatkeqësisht, risku i tregut do t'i bartet komplet konsumatorëve apo qytetarëve. Qeveria do t'i ketë dy mundësi: dallimin në çmim prej diku 35 euro/MW/h që ia garantojmë Contour-it dhe çmimit të tregut, ose në buxhet, ose në faturë, se s'ka ku tjetër. Pra, ose faturat do të ngritën për 60%, ose Qeveria nga Buxheti, nga taksa, do t'i paguajë. Do t'i paguajë Contour Globalit qasjen në rrjet të gjeneratorit, kjo sot është 0,5 euro/MW/orë apo rreth 2 milionë në vit. pra, për 20 vjet nga 2 milionë euro në vjet Qeveria do t'i paguajë për Contour Globalin për t'u qasur në rrjet. As këtë kosto Contour s'e merr.

KEC-i i ekspozohet rrezikut operacional nga problemet e balancës energjetike, duke mos pasur aspak ndikim në operim të asetit. Sot KEK-u ka ndikim në operim të gjeneratorëve, pra KEK-u sa herë ka telashe me gjeneratorë ata intervenojnë. Ndërmarrja e re që themelohet nuk ka asnjë instrument në dorë, që të menaxhojë këtë gjenerator dhe çdo rrezik i cili vjen në bilancin energjetik, ne do ta paguajmë. Për ilustrim, nëse vetëm 4 herë në vit centrali bie nga dhjetë orë

kjo na kushton neve 2 milionë euro. Pra, sa herë të bie ky gjenerator ne paguajmë para në KEK, kompania e re e themeluar para dy javësh apo tri.

Përveç këtyre dhe me këtë po e përmbyll këtë pjesë, përkrahja shtetërore edhe në lirim të Contour Globalit nga TVSH, nga Dogana, nga falja e tokës për ndërtim, nga marrëveshja për furnizim me thëngjill, nga marrëveshja për furnizim me ujë të cilësisë, të gjitha këto janë barrë dhe rreziqe publike. Pra, ne kemi nënshkruar marrëveshje të këtillë. I garantojmë çmim prej 80 euro/MW/h, i garantojmë qymyr për 20 vjet të një cilësie të caktuar, i garantojmë që ne do t'ia hapim mihjen dhe kjo ka kosto prej minimalisht 300 euro, i garantojmë cilësi të ujit, i garantojmë që ia paguajmë çdo kosto që ka të bëjë me rënie të rrjetit apo probleme në sistemin energjetik dhe krejt kjo përkthehet në fund në mbi 4,5 miliardë euro për 450 MW energji elektrike.

Përfundimisht, kemi ndarje joproportionale të rrezikut të investimit, operimit dhe shitjes. Kemi transfer të plotë të këtij rreziku te Qeveria. Pra, qytetari paguan ndërtimin e këtij termocentrali me riskun më të madh në rajon, po mos të them edhe më gjerë. Projekti ka çmim jashtëzakonisht të lartë. Çmimet në tarifa do të shkojnë 52% më lartë. Energjia në tregun gjerman, meqë shumë prej jush e dini tregun gjerman e disa prej jush edhe keni jetuar atje, sot është në mes 35 - 40 euro për MW/orë dhe pritet të jetë i tillë për periudhën 2019 - 2024. Piku i çmimit është 45 - 60 MW/orë. Përndryshe, energjia e Kosovës së Re është 100% më e shtrenjtë se çmimi i tregut afatgjatë apo "forwards", nëse e blejmë rrymën në të ardhmen, se në tregjet ndërkombëtare kjo edhe ekziston, blihet "forward". Sot me këtë çmim jemi 100% më të shtrenjtë edhe nuk është në fund, as në përputhje me ligjet tona, Ligjin për energji elektrike.

Kryeministër, e diskutojmë, unë mund të jem gabim, por janë 1200 faqe kontrata të cilat janë publike të pa përkthyer. Nëse KEK-ut do ia paguanim energjinë elektrike me të cilën po e paguajmë sot, ose pretendojmë me e pagua Kosovën e Re, për më pak se tre vite KEK-u do të krijonte financa përafërsisht të njëjta sa kërkohet me investimin e ekuitetit për Contour Global, përafërsisht të njëjta dhe e kam bërë një kalkulim komplet. 450 MW/orë, 8000 orë në vit me 80 euro janë 288 milionë euro në vit. Kaq kemi me ble rrymë prej Contour Globalit. Nëse i japim KEK-ut këtë kapacitet me 50 euro MW/orë, sot e blejmë edhe më lirë, po që po ia rrisim pak çmimin, i kemi 100 milionë euro diferencë në vit e 300 milionë euro është ekuiteti që po ia kërkojmë Contour Globalit për këtë investim, ekuitet të cilin nuk e ka.

Dhe për fund, po dua të ju tregoj çfarë hapi ka ndërmarrë Republika e Bullgarisë me Contour Global. Ky është lajmi i cili ka dalë. Contour Globali në Bullgari deri në fund të vitit 2018 i hiqet çmimi i garantuar, është marrëveshje ku i hiqet çmimi i garantuar. Republika e Bullgarisë e ka ndërmarrë këtë pasi e ka nënshkruar marrëveshjen.

Unë çka po propozoj sot, kryeministër, është që të ndalim këtë projekt, t'i paguajmë 19,2 milionë euro dhe të vazhdojmë tutje me ndërtimin e kapaciteteve me anë të KEK-ut dhe me anë të

fondeve të cilat i kemi në dispozicion. Jemi shteti me likuiditetin më të madhin në rajon për kokë banori, të cilin nuk e fusim fare në përdorim për interesa publike. Faleminderit!

KRYETARI: Tani e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës që ta marrë fjalën, i ka minuta.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar, zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Dardan Sejdiu,

Ju dëgjova me vëmendje në prezantimin tuaj. Të ju them të drejtën ka shumë të pasakta dhe shumë të pavërteta në prezantimin e juaj. Për shembull po i marr disa elemente të thjeshta. Ju po thoni, ne u sigurojmë ujë dhe qymyr. Veç po ju pyes juve, a ia falim apo ia shesim si Kosovë? Çdo produkt në treg, çka të blesh, qe këtë ujë, i nderuar koleg, i ka disa parametra kur ta vësh në treg.

Ne marrim obligim. Ne shesim produkt tonin diku në Kosovë dhe marrim para si Kosovë. Shesim qymyr marrim tantimë, marrim para prej qymyrit, prej ujit. Nëse kjo është problem, se ne duhet t'ia garantojmë, atëherë edhe ky që e ka prodhuesin, ose dikush tjetër, kushdo qoftë se s'po i bëj reklamë veç këtij, edhe ai e ka dhënë një parametër për treg. Për shembull, një element.

Tjetra është, ju po thoni me e ndal këtë e me ia nisë me njëfarë projekti shoqëror. A s'po e sheh se kemi dështuar me këso farë organizatash shoqërore të menaxhimit publik deri në fund, deri në pus. Edhe ku po e gjen ti atë kapacitet, a njerëzor, a profesional, që ne të ndërtojmë termocentral. E ke Shoshtanin i Sllovenisë, e kanë nisur si ne, e kanë paraparë 600 milionë, ua ka kapur 2 miliardë. E bukur para nesh janë me disa ekspertiza e disa mundësi, s'kanë mundur ta bëjnë.

Nuk është duke ndërtuar kush në botë më prej organizatave shoqërore termocentrale, ndoshta në Kinë, po në këtë botë tonë më jo. Krejt janë në marrëdhënie, operatori i specializuar, ai që e jep punën, edhe diku gjinden financat. Janë marrëdhënie që i ka shpikur bota, as ne s'bëjmë përjashtim, s'do të mund të bëjmë.

Po i lexoj disa parime në çka është bazuar kjo kontratë dhe ky investim:

1. Më së pari, siguria e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike me një kapacitet të instaluar prej 500 MW-ve do të thotë se krijon një stabilitet të energjisë, ose të furnizimit me energji, pra stabiliteti.

2. Përballueshmëria e çmimeve për konsumatorët - Kosova e Re sipas parashikimeve dhe vlerës së investimit do të ketë një efekt të përballueshëm të tarifave të energjisë elektrike, e cila mund të ndodhë gradualisht që në afat prej 6 vjetësh, por që mund të amortizohen nëpërmjet skemave të ndryshme që i kanë, ose të instrumenteve të intervenimit publik, pra mundet.

3. Mbrojtja optimale mjedisore - Kosova e Re e dimë që është teknologjia më e mirë e mundshme. Atraktiviteti i tregut një lajm për një investim në energji 500 MW të qëndrueshëm e ndryshon karakterin e tregut tonë. Është lajm, se këtu ka stabilitet energjetik dhe atë që e kemi sot, që konstatohet se sektori privat humb rreth 300 milionë në vit nga mungesa e furnizimit stabil, të qëndrueshëm, energji elektrike ndryshon.

Rritja e investimeve ekonomike, krijimi i vendeve të reja të punës, e kështu me radhë.

Tash, çka dua të them unë për fund?

Shikoni, e para, unë nuk e kam përcjellë këtë projekt që nga nisja e vet. Në fakt, ajo që di është diku në 2004 a 2005, por ka qenë një ide krejt ndryshe. Mirëpo, me ardhjen në Qeveri unë e kam gjetur këtë në fazën finale të përgatitjes, të diskutimit edhe i kam pasur dy zgjidhje: 1) ta lëmë varur edhe pak, ta kalojmë në këtë vit dhe më të mos mund t'i sigurojmë fondet, se në BE nuk janë fort miqësor për investime në energji me qymyr; 2) ta shfrytëzojmë kohën optimale të mbetur, që të mund të veprohet.

Fatmirësisht, ka ndodhur kjo që themi tani. Kemi lajmin më të mirë të mundshëm, pra kemi investime në energji, në teknologjinë më të avancuar me një, po them ashtu, me kushte të tregut shumë rigorozë, me obligime shumë rigorozë për Kosovën. I përmendët ju ujin, qymyrin, e ka edhe plotë obligime të tjera. Kuptohet, në një marrëdhënie kaq serioze si kjo nuk hyhet.

Edhe diçka, ne vërtet japim garanci dhe Parlamenti jep garanci për këtë investim dhe konsiderohet borxh publik, por mos harroni, në rast të dështimeve, çdo veprim i deriatëhershëm i arritur e deriatëhershme e projektit i kalon në pronësi Kosovës, ndëshkueshmëria për Kosovën është e paraparë në disa milionë, sa e di unë është deri në 19 edhe me këtë Kosova nuk është palë e rrezikuar.

Duke u bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh se po hyjmë pra në një mundësi të një investimi kaq të madh, po them jo vetëm energjetik, po te investimi që është më i madhi që ka ndodhur në vend deri tash, që parashihet me qenë 1 miliardë e 300 milionë, atëherë unë mendoj se përkundër obligimeve që janë rigorozë e strikte, që dalin për ne si palë në këtë marrëdhënie është një lajm i mirë për Kosovën. I përgëzoj të gjithë që kanë punuar në këtë projekt që nga fillimi i tij, njëkohësisht i ftoj të gjithë që ta përmbysim në afatin më të shpejtë kohor, pra të mos e vonojmë veten me këtë projekt.

Ka shumë fjalë që do t'i kisha për t'i thënë edhe ka shumë njerëz që janë të kyçur rreth kësaj teme. Shikoni, është e pakuptimtë të flasësh për ambient e të thuash s'është bërë vlerësimi ambiental. Qysh mund të thuash "S'është bërë vlerësimi ambiental" i këtij projekti, kur ky po

vjen me teknologjinë më të avancuar që ekziston sot në botë. Nëse edhe ky s'u përgjigjet kritereve të ambientit, s'di më kush!

Edhe nëse hyni e vëreni ende në Evropë, unë e kam një listë kush është duke investuar, investime pra që po ndodhin në... që për shembull, Bosnjë-Hercegovina më 2016 kanë filluar, 300 MW e kanë një. Republika Srpska po ashtu e ka Ugljevikun 600 Mw me qymyr. Pra, krejt janë kah ndërtojnë në rajonin tonë. Banoviqi i Bosnjës prapë, Tuzlla e Bosnjës prapë, Kakanj i Bosnjës prapë, Plevlja e Montenegros, Kostelac i Serbisë... e ke Kollubarën.

Ne me 500 megavat qëndrojmë prapa krejt regjionit në investimet që po i bëjnë me qymyr, pra nuk është që ne jemi duke bërë dalje prej kornizave që i ka BE-ja.

Kontratën për t'ia blerë energjinë po ashtu mos e quani monopol, e nuk është, bëhet fjalë më pak se gjysmën e produktit në treg dhe nuk mund të jetë monopol.

Unë do të flas edhe më vonë, vetëm ju siguroj që ato shqetësime që i keni, nuk janë shqetësime që qëndrojnë. Pse? Kemi hyrë në një marrëdhënie shumë serioze investimesh, një lajm të mirë për Kosovës, një lajm të mirë ekonomik, parashihet të punojnë shumë njerëz, shumë kompani. Ju siguroj që ky vendim nuk është marrë për ndonjë interes të caktuar, as grupor, as të partisë, më së pakti kontribut edhe më së paku merita kam unë në të, ky projekt është afatgjatë, është i të gjithë neve, është bërë në emër të vendit, unë pres që sa më shpejt Kuvendi të ndërmarrë veprimet e nevojshme që i takojnë që të zbatohet ky projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Lumir Abdixhiku, në emër të grupit. Replikë, Dardan Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryeministër, Faleminderit!

E para, menjëherë ta zgjidhim këtë problemin e thëngjillit që blihet. Thëngjilli, i cili po thoni ju që blihet, blihet, po i kemi garantuar një cilësi të caktuar për një mihje, të cilën ende nuk e kemi hapur. I themi Contourit që ne të japim thëngjill ende pa e parë çka ka nën tokë. Hapja e kësaj mihje do të na kushtojë 300 milionë euro dhe këtë barrë e marrim ne, nuk e merr Contouri. Ajo thjesht e paguan qymyrin, për të cilën ne investojmë 300 milionë euro para publike, për diçka që ende s'e kemi hapur.

E dyta, ju po flisni shumë për termocentralet e reja nëpër rajon, unë ju kisha lutur, kryeministër, t'i lexoni raportet e ZRRE-së, janë shumë të rëndësishme. E kemi pyetur Zyrën e Rregullatorit të Energjisë çka ndodh me çmimet e energjisë elektrike në vitet e ardhshme? Na kanë thënë kështu: për shkak se kemi tash më tepricë të ofertës, çmimet do të bien, pra kjo i bie që ne do ta paguajmë çmimin më të shtrenjtë prej prodhimit tonë se sa prej importit, për shkak se i kemi

dhënë çmim të synuar prej 80 euro për megavat orë, dhe kjo 80 euro për megavat orë, edhe një herë po e përsëris, nuk merr mbi vete as koston e transmisionit, as koston e distribucionit, nuk i merr mbi vete as kostot e tjera që ndërlidhen me rregullimin e rrjetit, thjesht në terma komplet biznesi, i kemi thënë atij që po e bën këtë fabrikë, si po i thoni ju, energji, ai e ka veç ta sjellë gjeneratorin, ne duhet shkuar me rrjet në gjenerator, ai nuk merr kurrfarë përgjegjësie.

Në fund fare, i nderuar kryeministër!

Mendoj që koncepti i ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike duhet të marrë parasysh tri elemente.

E para, jemi rezerva e tretë e linjtit më e madhja në Evropë.

E dyta, kemi më së shumti kursime nacionale për kokë banori në Ballkan, dhe

E treta, kryeministër, duhet të shohim sa megavat orë ne i prodhojmë sot në këtë 450 të garantuar, çka bëjmë me gjashtë muaj verë për 800 a 900 megavat që i prodhon sot KEK-u, ku shkojnë ato 800-900 megavat që na i shet me 35 euro, çka ndodh me to? A i tokëzojmë apo i eksportojmë me 35, e ne vetë tonën e blejmë me 80.

Kështu që ky model, ky konstrukt, besoj që edhe nga Bashkimi Evropian ju kanë bërë pyetje për këtë temë, edhe pyetjet janë komplet konkrete të modelimit, 19.7 milionë është humbja sot, do të jetë 4 miliardë në momentin që fillojmë ta ndërtojmë.

KRYETARI: Kryeministri prapë e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Qymyrin qysh e përdor sot A-ja dhe B-ja është qysh e ka falur Zoti. Humbjet ose koeficientet e efijencës të A-së dhe B-së ju e dini sa janë, Dardan, sa shumë humb qymyr. Ne e dimë që kemi shumë, por e dini çfarë efijence sigurohet me këto.

Ndryshe thënë, një lëndë të parë, atë qymyrin qysh e ka falur Zoti, e aftësojmë edhe një shkallë më lart, është proces që ndodh në vendin tonë, prej nesh, prej punëtorëve tonë, pra nuk po shesim lëndë të parë bruto, po pak diçka po përpunohet. Nëse ky është problem, po ju siguroj që nëse Kosova nuk do të investojë në minierë vetë, sot ka investitorë që e kishin marrë ta hapin vetë atë minierë dhe t'ia shesin qymyrin Kosovës së Re. Është interes i Kosovës ta bëjë vetë, të mbetet pronare. Kosova mund të shesë qymyr, edhe Kosovës së Re, edhe B-së, edhe A-së, po edhe ndokujt jashtë vendit, nëse ka nevojë. Pra, është minierë e Kosovës, ne jemi pronarë, nëse kem sasi të caktuar, mund ta dërgojmë në treg ku të duam, pra s'ka logjikë që atë koeficientin që duhet dhënë ne, qenka problem. Është proces i njohur teknologjik dhe nuk është diçka e jashtëzakonshme, mund të ndodhë në vendin tonë, s'kemi pse të frikësohemi.

Shumë po flet për çmime të importit, nëse po i beson kaq shumë ZRRE-së, bravo, po nuk mendoj që ZRRE-ja jonë është aq e mençur sa të na tregojë ne qysh do të jenë çmimet në tregun evropian, global a rajonal në vitet që vinë.

Pse? Për shkak se ato varen prej shumë parametrave të tjerë, qoftë të zhvillimeve të caktuar atmosferike.

Ju e dini si rriten çmimet në Shqipëri kur s'ka të reshura, qoftë prej dimrave të fortë, qoftë prej proceseve të tjera. Nuk është se ZRRE-ja jonë na tregon ne se çfarë çmimesh ka, nëse po flasim për disa sekserë të energjisë, ata të gjithë duan të importojmë, nuk besoj që edhe ti bën pjesë në ata, se po insiston veç të blejmë, po thua çmimi i importit është i mirë. Shumë mirë, të gjithë po na thonin nuk po e mbjellim arën tonë, se po e blemë diku larg është më lirë! E po, atëherë çka po i bëjmë ne këtij qymyri, kësaj energjie.

Shikoni, unë e kuptoj që kjo nuk është një marrëdhënie e lehtë, kem hyrë në disa obligime serioze, investitori është serioz, projekti është i madh, i ka implikimet e veta si çdo projekt që ndodh. Ky projekt krijon stabilitet energjetik, pavarësi energjetike, edhe politike nesër, se nuk varem prej të tjerëve kur donë të na japin energjinë, nuk i aktivizojmë resurset e tjerëve, mos e harroni këtë, nuk mund të flasësh eksplisit për kosto, në kuadër të kësaj kosto, ku mbesin këto imputet e tjera që më pyeti ai kolegu më herët qysh bëhet GDP-ja, si matet? Ku mbesin këto imputet e tjera? Një produkt i prodhuar në vend ju e dini sa implikime të tjera i ka në ekonominë e vendit, në rritjen ekonomike, pa folur për krejt resurset, po për krejt mekanizmat e tjerë ose ekonomitë e tjera që aktivizohen.

Ne prodhojmë vetë, shikoni, nëse duam ta ruajmë çmimin, këto që po i themi ne që po prodhojmë lirë me kapacitetet ekzistuese. Ju e dini sa miliarda kanë hyrë në këto kapacitete, dikush thotë që i kanë investuar gati 20 miliardë prej pas luftës, pra nuk qenka bash energji e lirë, pse s'e kemi paguar ne, është tjetër, por po supozohet që BE-ja na ka dhënë dhjetëra milionë për t'i mbajtur këto, janë të vjetruara, s'mund të mbahen aq gjatë, nuk i ke të garantuara, nuk e ke të garantuar këtë çmim të sotshëm që po thonë 35 euro hiç. A-ja nuk është jetëgjatë, nuk është e garantuar, mund të bie, mund të dalë prej përdorimit.

Çka po ndodh me këtë? Në rast se hyn 500-shi në treg, pra mos llogarit në A dhe B, se është bukur zor t'i llogaritësh të tria, nuk do t'i kesh të tria në treg, do t'i kesh ose B-në e Kosovën e Re, ose një A të rinovuar, po s'mund t'i mbash të tria në treg, se kostoja është e shtrenjtë, se A-ja është e vjetër dhe e dimë që shkon.

Investitori ka kërkuar për një pjesë të investimit që është një kthim më të shpejtë të ekuitetit, ajo e ka shkaktuar një vështirësi për ne, ai 300-milionëshi. Aty është problemi, po, duhet të kemi

kujdes, a kemi ne instrument tonin që do të kishim pasur mundësi të ndikojmë që ta mbajmë në kontroll procesin, jo vetëm për tarifën, po për çdo aspekt tjetër.

Prapëseprapë ju siguroj që në këto kushte, ky investim jo vetëm që është në terma komerciale e terma të biznesit, në rregull për Kosovën, por është mundësia më e mirë që ka mundur ta mbërrijë Kosova në këto rrethana të investimeve në energji, pra në ato termike, me qymyr, që nuk është, e thashë edhe një herë, nuk është më e pëlqyera sot në botë.

KRYETARI: Dardan Sejdiu, prapë e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: E kisha lutur regjinë, nëse mundet, e kapëm këtë lajm në Reuters, Reuters është agjenci goxha serioze e lajmeve. Regjia, të lutem, ekranin. Faleminderit!

Thotë “Contour Global seeking equity partner for new Kosovo plant”. Pra, Contour Global këtë 300-milionëshin, për të cilin po kërkon 18,5% kthim të brendshëm, “internal relate of return”, nuk i ka paratë. Çka ka bërë? E ka marrë një kontratë, e cila i garanton 80 euro megavat orë, i garanton mihje dhe me këtë ka shkuar në sektorë financiarë e u ka thënë: “Qe ku e kam një projekt, është El Dorado” dhe tash po e kërkon partnerin për t’ia financuar ekuitetin.

Në kontratë, të nderuar deputetë, nuk ka asnjë nen, i cili ia parandalon Contour Globalit shitjen e këtij projekti, nuk ka asnjë nen, në asnjërën prej kontratave që i kam lexuar, janë tetë sosh. Në asnjërën nuk shkruan asgjë për transferim të të drejtave të projektit dhe kjo në vete nuk është problematike, por fakti që po i garantojmë ujë, qymyr, çmim, treg dhe, në anën tjetër, këtë Kosovën A, këtë Kosovën B, kaq të dobët që po themi se i kemi, sot i kemi me 10 milionë euro fitim.

Sot krijon energji elektrike, përkundër krejt telasheve që i kemi, këta inxhinierët e Kosovës e kanë ndërtuar, e kanë mirëmbajtur një diçka që as ekspertët më të mëdhenj nuk kanë besuar që mund të ndreqet e të mirëmbahet.

E unë çka po propozoj, në rezolutë do ta vendos, jo domosdoshmërisht duhet ndërtuar një model, i cili nuk ka fare risk dhe krejt riskun ua bartim qytetarëve për t’i thënë dikujt eja investo në Kosovë, kështu secili investon, nuk ka kompani në botë, e cila nuk vjen të investojë, nuk ka, për kësi modelesh, kryeministër, secila kompani vjen.

Dhe, e fundit, edhe diçka thatë, pse po i besoni ZRRE-së? Po, kryeministër, unë nisem prej një premise fare të thjeshtë: e kemi bërë një Zyrë të Rregullatorit, e cila për detyrë e ka të mbrojtë interesin publik dhe kur unë i bëj Zyrës së Rregullatorit pyetje dhe, po besoj që tanimë i keni materialet në duart tuaja, kur i bëj pyetje cili është ndikimi i termocentralit Kosova e Re në çmim, në ambient, në ekstranalitete dhe ata ma sjellin një raport, unë atij i besoj më shumë se

Contour Global. E kam pak problem të mos i besoj më shumë se Contour Global, se e kemi ndërtuar që nja dhjetë vjet për të na e dhënë këtë informacion, sepse siç e thatë edhe ju, jo secili prej neve duhet t'i dimë krejt gjërat, i bëjmë disa institucione për t'i ditur disa gjëra më shumë se ne, e kjo është ZRRE-ja.

Me këtë rast unë i besoj ZRRE-së, e jo dikujt, i cili as paratë s'i ka, e do të vijë këtu të na rrjepë e të na e rrisë çmimin e rrymës për 60% me idenë që po bëjmë investime të huaja. Këtu investim të huaj nuk ka, këtu ka para të buxhetit, të cilat vit për vit do të dalin nga 250 milionë euro për ta financuar ndërmarrjen e re që po e themelojmë, e cila e paguan diferencën e çmimit të tregut dhe 80 euro të çmimit të synuar. Këtu jemi duke bërë barrë buxhetore për 20 vjetët të ardhshme.

Të nderuar deputetë,
Është në duar tuaja ta ndalni këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Sikur të flasim në dy gjuhë të ndryshme, po më duket që unë nuk e kritikova ZRRE-në se nuk e mbron interesin e popullit, po unë veç thashë nuk besoj që janë më të mençurit ata të na tregojnë qysh do të jenë çmimet në tregun rajonal e global të energjisë në vitet që vijnë.

Nuk mendoj që ne i kemi zgjedhur për të na i treguar ata çmimet qysh janë në botë, po këtu ta rregullojnë këtë tregun e brendshëm, besoj se këto janë dy tema krejt të ndryshme, pra të mos i përziejme.

Edhe sa u besojmë atyre, dikush i paska propozuar, ju i keni votuar, po u besojmë, po nuk janë të thirrur të na tregojnë qysh do të jetë trendi i çmimeve në rajon e në botë në vitet që vijnë, nuk e dinë, nuk e di askush, besa. Mund të bëjnë parashikime, po është lotari.

E dyta, të thuhet që Contour Global nuk është investitor, të lutem, i ka 82 projekte në botë, këqyrni pak kush është, nuk është fantom, i ka 82 projekte energjetike në botë, qysh i kanë bërë, ata e dinë.

Edhe e treta, nuk është Contour Global si te ne, unë e mbaroj krejt shtëpinë, edhe dyert, edhe dritaret, edhe kulmin, edhe nxehjen, edhe ujin, krejt të tjerat, jo! Ai është operatori që ka kontraktuar me ne, ai gjen partnerë, dikush ia bie turbinën, dikush diçka tjetër, ka partnerë. Nëse kjo është lajm i keq për Kosovës, se po del një kompani me renome e po thotë se dua partnerë, se jam duke investuar në Kosovë, ai të ka bërë nder, beso, i ka kallëzuar botës që një kompani serioze është duke e bërë një projekt kaq të madh në Kosovë, dhe po lyp partnerë. Merrni edhe kështu, se ashtu është, për shembull, po të vijë Siemens-i, s'po di kush, një kompani e botës, e të

thonë po kërkojnë partnerë se po shkojnë në Kosovë, ku të jetë ashtu. Deri tash kanë ikur prej nesh, kanë dërguar edhe lajme të këqija që të mos vinë këtu, e këta po thonë: “Jem duke shkuar, a po vini?” Unë kështu e shoh këtë.

Nuk jep Kosova para, Dardan, nuk di ku po i gjen këto shifra, që ne po japim 250 milionë, tregomë edhe mua, ta di.

Ne nëse duam të investojmë si Kosovë, mund të investojmë, bëhemi aksionar, japim para. Asnjë cent nuk e jep, Dardan, Kosova, për këtë projekt, këtë duhet ta dish, nuk po bëhet me para të Kosovës.

Mund t’i themi Contour Global a po do edhe na po hyjmë aksionar, po i marrim ne hua paratë për ty, apo po t’i japim tonat a po i bëjmë vetë, po nuk është në asi marrëdhënie, është krejtësisht investim i tyre.

Ne po, japin disa garanci, nëse s’i përmbushim ato çka janë detyra tonat, edhe ai i jep nëse nuk i përmbush të vetat, pas 20 vjetësh kjo është pronë e Kosovës, si të bëhet 20 vjet është jona, po nuk dimë sa jetë prej saj, çfarë mirëmbajtje duhet atëherë, po 20 vjet e ka paraparë kohën.

Kështu që ju kisha lutur, unë e pranoj që kjo kontratë i ka do obligime rigoroze për Kosovën, po i ka se nuk është kontratë hajgare, është projekt bukur i madh, projekti më serioz që ka mundur të ndodhë, edhe obligimet janë serioze për vendin tonë e nuk është mirë ky Parlament, mos harroni, të dalim në pikëpyetje, edhe vendin, në tema kaq serioze për vete, investimet në energji i kemi jetë.

Energjia, ju e dini, është gjaku i ekonomisë, fort alternativa nuk kemi, se hidro s’kemi shumë. Ne e kemi hapur tregun për energjinë solare, për energjinë me erë, pse? Kjo 500-shi, po që nuk është 500, që do të jetë 450, edhe B-ja nuk do t’i mjaftojnë Kosovës, a A-në, ju e dini, që veç ka përfunduar jeta e saj, me zor po e mbajmë në jetë. Prapë, kur ta kemi Kosovën e Re edhe B-në, prapë do të kemi hapësirë për energji alternative, për solar, për erë, për të gjitha, po do të jemi në limit të sasisë tonë, e këto janë ato parametrat që i them.

Ju siguroj që nga ajo çka kam mundur të marr vesh, edhe për kontratën, mos harroni, e kemi publikuar kontratën, kemi kërkuar prej investitorit kontrata të publikohet.

Çka po dua të them, mendoj që është prej fitoreve që i ka mbërritur ky vend, ju lutem të mos e përziejmë me projekte të caktuara që ka pasur implikime ose dëme të tjera, kjo është fitore e këtij vendi, fitore në energji, fitore në investim, fitore në plan ndërkombëtar, ekonomik.

Po, ka obligime rigoroze, atë duhet ta pranojmë, se është projekt serioz.

KRYETARI: Lumir Abdixhiku. Dardan, urdhëro, deri sa të vijë Lumiri.

DARDAN SEJDIU: Deri sa të vijë Lumiri.

Kryeministër, ndërmarrjen e re që e keni themeluar, e keni themeluar me qëllimin që të blini rrymën direkt prej Contour Global, një ndërmarrje e re publike që është themeluar.

Kjo ndërmarrje e re publike që është themeluar do ta blejë rrymën prej Contour Global me çmim të synuar dhe nuk do të jetë as çmimi i transmisionit, as çmimi i distribucionit në çmimin që e blen kjo ndërmarrje.

Kjo ndërmarrje, këtë rrymë që e blen, kjo “Genko”-ja e reja, KEC-i, kjo këtë rrymë duhet t’ia shesë dikujt. Këtë rrymë që e shet, duhet ta shesë me çmim të tregut dhe diferenca mes 80 eurove dhe çmimit të tregut është sot 30 euro.

Arsyeja pse unë i përmend importet është të tregoj që tregu nuk është i detyruar të blejë prej KEC-it rrymën e Contourit, ai e blen me çmimin më të lirë në treg dhe këtë diferencë të çmimit të tregut dhe çmimit të synuar dikush duhet ta paguajë, e ky dikush është qytetari i Kosovë, qoftë në faturë të energjisë elektrike, qoftë në buxhet, në taksa, kaq është kjo.

Dhe e keni këtu në “Power purchase agreement”.

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Jo, shumë thjesht, Dardan, a është e vërtetë ose a ke dëgjuar a beson që për t’i mbajtur në jetë A-në edhe B-në, përpos çmimit kur janë ndërtuar këto atë kohë, që kanë kushtuar po thonë miliona, miliarda, unë nuk e di sa kanë hyrë. Nëse kanë hyrë ato, dikush i ka paguar, dikush i ka dhënë ato para.

Po të siguroj që s’e ke të garantuar këtë diferencën e këtë çmimin e 35-ve, pa investuar prapë në A dhe B-në, po njëjtë është kjo punë, shtini në të renë, ose në B-në ose në A. A-ja s’e ka jetën e gjatë, ju e dini.

Fatmirësisht reduktimi i ndotjeve është bërë prej parave të BE-së, e prej ndihmës, po nuk ke rrymë të këtij çmimi të garantuar si Kosovë.

Pra, kush merr vesh në ekonomi, e di, nuk e dimë sa kanë jetë këto, sa gjatë, ti e di që sot importojmë, edhe ti e përmende, the një herë kemi blerë 112 a 114, dikur paska rënë.

Merrni statistikën qysh variojnë këto dhe e shihni sa mesatarja prej 112 në 60, prapë diku te 80, aty po mbërrin, mes 112 e 60, aty vjen diku.

Pse po e them këtë? Shikoni, është e vërtetë që kjo marrëdhënie ka obligime rigorozë për Kosovën, të sakta, po kjo është një rrethanë që për 20 vjet hyn në një situatë stabile të furnizimit me energji, këto i ke të garantuara, as A as B-në.

Sa herë kam ardhur, ju më keni thirrur në interpelancë këtu, pse ka reduktime? Po ra blloku i A-së, ra blloku i B-së. Hajde, bëjeni një studim, sa para duhen, kam dëgjuar që ka qenë një studim për ta revitalizuar A-në, merri këto miliona të revitalizimit të A-së po i shtimë në subvencion dhe po e sheh sa ulet çmimi, nëse qenka ashtu problemi, po nuk është ashtu, nuk zgjidhen problemet ashtu.

Jemi në situatë të tregut, jemi në situatë të marrëdhënieve të tregut.

Shikoni, është e padrejtë të thuhet se me këtë investim ne e shtrenjojmë rrymën. Rrymë në Kosovë ne kemi aktualisht 2/3 e sasisë së nevojshme, të pagarantuara, të pagarantuara, se i kemi të vjetra, po prishen, nuk dihet sa gjatë do t'i kemi.

Rryma e ardhshme, pos këtyre 2/3, qoftë me solar, alternative, që është më e pastër, qoftë me erë, nuk mund të vjen nën këtë çmim që jem duke falur ne, dhe nuk e ke ende në treg. Pra, nënkupton ajo që po i jetë Kosovës është ta blejë mbi 80 euro, po nga importi dhe të varemi prej të tjerëve. Më mirë po e prodhojmë vetë, po i aktivizojmë resurset tona, po krijojmë një situatë të re ekonomike, le të punojnë disa njerëz, le të ndodhë diçka në vendin tonë.

Nëse bazohemi në këtë çka thashë, edhe pa thënë që çmimet, shikoni 35-shi është pas çmimit fillestar që dikush i ka investuar, në kohë të Titos, a të Mahmut Bakallit, a kush ka qenë atëherë, kur i kanë bërë këto, kanë kushtuar nja 2-3 miliardë, a sa ka qenë atëherë. 20 miliardë i paska investuar BE-ja, nëse kanë hyrë, 6, 8, a 10, merrni edhe këto edhe këqyr sa po të kushton sot ky çmim.

Nëse investon prej parave të tua, se më s' jep askush fal, t'i mbajmë edhe disa vjet gjallë, e sheh se çka ndodh. A është më mirë t'i mbajmë këto të vjetra kështu qysh folëm ne, a ta sjellim një kapacitet të ri, këtu është dallimi eksplicit që e kemi.

Të hyjmë në teknologjinë më të re, më të pastër, në obligime të reja, të ndodhë një investim kaq i madh që e rrit atë GDP-në që u fol më herët edhe për 2.2., vetëm ky investim e rrit edhe për 2.2. Faleminderit!

KRYETARI: Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës,

Në fakt, Kosova A kur është ndërtuar, është ndërtuar para se të shkojë njeriu në hënë, teknologjia e Kosovës është bukur e vjetër, nuk besoj që ka dyshim dikush se një termocentral i tillë meriton të përfundojë.

Tash unë besoj se projekti për të cilën po flasim sot, kaq i madh, me implikime energjetike, por mbi të gjitha financiare, sepse ky projekt nuk është vetëm energjetik, është edhe financiar.

Meriton vëmendje shumë më tepër profesionale se sa ballafaqime partiake dhe, mbi të gjitha ky projekt meriton konsensus shoqëror. Pa këtë konsensus, pa 2/3 e këtij Parlamenti, ky projekt s'mund të jetësohet asnjëherë.

Dhe, në këtë konsensus tonin ne duhet t'i shtrojmë disa premisa rreth të cilave pajtohemi fillimisht.

Para se të dalim te dallimet, hajde t'i shtrojmë disa tema rreth të cilave pajtohemi të gjithë.

Pra, cilat janë ato çështje që e kanë aprovimin tonë?

Çështja e parë rreth të cilës ne duhet të pajtohemi është se sigurimi i energjisë elektrike është prioritet nacional i Kosovës.

Pra në atë piramidën e interesave energjetike të vendit, të secilit vend, dorën në zemër, e para qëndron pavarësia e një shteti, në këtë rast pavarësia e Kosovës në furnizimin energjetik.

Shtetet s'mund të varen nga shtetet e tjera në sigurimin e energjisë bazë.

Së këndejmi, Kosova duhet të jetë e pavarur në sigurimin e energjisë elektrike dhe kjo pavarësi jona energjetike sigurohet veç me një rrugë, me prodhim të energjisë, jo me import, jo me huazim, veç me prodhim.

Dhe, nga këtu lind domosdoshmëria për të prodhuar energji elektrike në Kosovë, temë rreth të cilës, kryeministër, duhet të pajtohemi të gjithë.

Për fatin tonë të mirë ose të keq, Kosova i ka rreth 14 miliardë tonë linjit dhe kjo pasuri domosdoshmërisht e determinon edhe mënyrën e prodhimit të energjisë elektrike.

Linjiti natyrisht nuk e përjashton energjinë alternative. Do të kishte qenë naivitet i madh të besohet se energjia alternative është edhe më e lirë edhe e bollshme për Kosovën. Linjiti fatkeqësisht nuk tërheq aq shumë investitorë sot nëpër botë, por në një treg të rregulluar, siç po

synon ta bëjë Kosova, ai është profitabil. Pra, po, ne duhet të ndërtojmë kapacitete të reja, ta heqim këtë prej diskutimit, por ne duhet të mbështetemi në linjit, sepse e kemi pasuri natyrore të Kosovës dhe ne duhet të kemi pavarësi energjetike në Kosovë dhe në këtë pikë po them duhet të pajtohemi të gjithë.

Diferencat tona, megjithatë, duhet të lindin në modalitetet që i ka konstruksioni i ri, me disa prej tyre. Dhe, meqë e kemi në tavolinë një propozim, një kontratë të nënshkruar, unë do t'i shtoj disa çështje, e më pas do të jetë në kompetencën e secilit deputet t'i vlerësojë për vete. Pra, për secilin me dije bazike për termocentralin "Kosova e Re", modeli i përzgjedhur duket pak a shumë kështu: Kosova është shtet i pasur me linjit, e ka ftuar një kompani private, meqenëse deklaroi vetë se s'ka para, që mbi këtë linjit të ndërtojë, të menaxhojë, të operojë e ta mbajë si pronë të veten për 20 vjet një termocentral të ri. Tash për korrektësi, kompania e përzgjedhur nuk ndërton termocentrale. Kompania e përzgjedhur do ta kontrakttojë një kompani të re brenda vitit të parë që ta bëjë këtë ndërtim. Për gjithkënd, kjo mund të jetë edhe e habitshme, për mua është pse neve na duhet një ndërmjetësues, pse s'e kontraktujmë drejtpërdrejt ndërtuesin, por si e tillë ka qenë pjesë e pakos fillestare.

Sidoqoftë, pasi punët për ndërtim të jenë të kontraktuara në vitin 2019, ato do të përfundojnë në vitin 2023, dhe atëherë Kosova do ta ketë termocentralin e ri me kapacitet 450 megavat energji. Deri atëherë, kostot e gjithmbarshme do të jenë 1,2 miliard euro, e atë ditë do të pushojë së funksionuari "Kosova A" dhe oferta energjetike në Kosovë do të jetë pak a shumë e njëjtë.

Deri në këtë fazë, këto para po i quajmë investim, 1,2 miliard euro investim. Por, këtu lind për mendimin tim një paradoks. Kosova zotohet që për 20 vjetët e ardhshme, gjithë kapacitetin prodhues të këtij termocentrali ta blejë. Pra, marrim obligim të blejmë gjithçka që prodhon termocentrali i ri, pati s'pati nevojë për të, është ose nuk është i lirë çmimi i saj. Për këtë blerje, për këtë garantim, ne investimin e transferojmë në huazim, sepse koston e gjithë investimit, plus fitimet, po e marrim mbi vete, po e bartim te qytetarët tanë dhe për këtë do ta themelojmë një ndërmarrje publike të veçantë, puna e vetme e së cilës do të jetë blerja e kësaj energjie, asgjë tjetër. Më pas, kjo ndërmarrje do ta shesë në rrjetin e distribuimit dhe sa për krahasim, po të dhënat janë të sakta. Kosova sot e prodhon megavatit me 30 euro në çmim, e importon. Mesatarisht në pesë vjetët e fundit, çmimi i importit ka qenë 50 euro. Kjo është e dhënë e saktë, domethënë 50 euro kemi blerë energji elektrike kur e kemi importuar. Kur e kemi prodhuar, e kemi prodhuar me 30 euro. Dhe, në 20 vjetët e ardhshme do ta kontraktujmë pjesën që e prodhojmë prej "Kosovës së Re", me çmim prej 80 eurove.

Dhe, kjo blerje e garantuar sipas Zyrës së Rregullatorit do të ketë implikime në faturën finale dhe këtë e kemi borxh t'ua bëjmë qytetarëve tanë të qartë. Fatura e tyre në vitin 2023 do të ketë rritje për 60%. Kushdo që ka paguar 100 euro, do të paguajë 160 euro; kushdo që ka paguar 200 euro, do të paguajë 320 euro çmim të energjisë, sepse duhet të kthyer me garanci investimin. Dhe, këtu

lind edhe çështja që ndoshta duhet diskutuar sot. E para, pse duhet garantuar ne si Kosovë blerjen e gjithë energjisë që ky termocentral e prodhon? Pse nuk e lënë të lirë të konkurrojnë, të shesë ku të dojë, ku të mundë, me çfarë çmimi të mundë, siç bën secili investitor tjetër që vjen në Kosovë. Pse duhet t'i garantojmë treg të plotë? Dhe, e dyta, a kemi marrë ndoshta përgjigje prej Bashkimit Evropian, sepse po, sot ky është lajmi që vjen prej Bullgarisë, ku ministri i atjeshëm e paralajmëron që kontrata e njëjtë, se edhe ata e kanë një kompani të njëjtë, Contourin e kanë, kanë kontratë 20-vjeçare edhe atje, marrëveshja e njëjtë e garantimit të blerjes së energjisë do të shfuqizohet në fund të vitit. Sepse, direktivat e Bashkimit Evropian për liberalizim të tregut e kërkojnë një gjë të tillë, jo pse Bullgaria ka dëshirë, por sepse BE-ja e detyron ta bëjë një gjë të tillë.

Të mos na ndodhë edhe neve që pasi ta nënshkruajmë kontratën në fjalë, pas disa viteve të detyrojmë ta shkëputim të njëjtën dhe atëherë do të kemi një kosto shtesë natyrisht. Pra, ta mbajmë mend ditën e sotme kur po i diskutojmë këto çështje. Shumë shpejt mund të na vijë dita që ta zhbëjmë këtë kontratë dhe, e dyta, që për mua si ekonomist është befasi është pse duhet ta garantojmë kredinë e firmës private, si një shtet? Çfarë risku po i lëmë atyre në dispozicion? Pse duhet ta marrim si shtet barrën e garancisë së kredisë së investitorit privat?

Në këto pika e përfundoj këtë diskutim, edhe një herë - kapacitetet e reja janë të domosdoshme në Kosovë, energjia alternative fatkeqësisht s'është e mjaftueshme për vendin tonë, ne duhet të bazohemi në linjit, por e kam të paqartë pse duhet t'u garantojmë blerjen për 20 vjet dhe pse duhet t'u garantojmë kredinë si shtet? Pse duhet t'i marrim ne këto rreze. Pse s'e lëmë të veprojmë si çdo investitor tjetër në vend? Dhe, atëherë e quajmë investim. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, vetëm urdhëro! Bëhet gati Memli Krasniqi.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Rreth pyetjeve pse t'ia blejmë energjinë për 20 vjet, do të thotë ju e dini që njëra prej argumenteve kryesore gati të hezitimit investime është garancia, a janë investimet e garantuara diqysh dhe çka është garanci e investimit, edhe për një shumë kaq të madhe të investimit, megjithëse ju jeni më në rrjedha mendoj Lumir, edhe i kuptoni pse ndodhin këto, por neve na i vënë disa kushte më të vështira se sa ndonjë pale tjetër. Pra, blerja e energjisë është një tip garancie për këtë.

Pastaj, edhe diçka, edhe ne e kemi interes atë sasi të energjisë, se nuk kemi interes të na shkojë ndokund tjetër, ndoshta kur ne e kemi më nevojë, na nevojitet ajo, dhe pse ne të japim garanci për investime të këtilla çfarë kemi dhënë. Unë mendoj se ka qenë bukur vështirë ta paketojmë këtë investim. Ju e dini që janë disa institucione financiare të involvuara, e Banka Botërore e dini si i ka kriteret dhe e vetmja mënyrë për të ardhur deri te ky investim ka qenë që Kosova të hyjë garant, pra ta japë garancinë e vetë Mirëpo, çka është penalltia e Kosovës nëse dështon, nuk është 1,3 miliard. Në çdo variant të rrugëtimit, nëse dështon Kosova në garancitë e veta, shiko

është penalltia qysh e dimë të gjithë, ose është ndëshkimi sa është i paraparë. Mirëpo, ju siguroj që më shumë në obligime është investitori në këtë rast. Investitori vërtet ka hyrë në marrëdhënie serioze e kredibile me ne. Unë kam provuar t'i mbaj të informuar aq sa kam mbërri të gjithë, edhe pse ju thashë edhe një herë se në këtë projekt kemi punuar ekipe e ekipe të të gjitha qeverive, të gjithë kolegët, të gjithë ekspertët që janë marrë me këtë temë.

Edhe dëshiroj të them që më erdh shumë mirë ajo që e thatë më herët dhe që vërtet është ashtu. Shikoni, BE-ja i ka politikat e veta për tregun liberal ose liberalizimin e tregut në energji dhe i ka disa politikat tjera, për shembull nëse për 18 vjet i kemi humbur rreth 30 milionë, ato që i folëm më herët, e s'po na ndihmon BE-ja, na la në të, domethënë s'na ka ndihmuar për ta zgjidhur problemin e 30 milionëve që po i humbim, veç që po bëjnë gati 500-600 milionë të humbura të Kosovës. Edhe kur vjen një etapë tjetër ndoshta për anëtarësim, atëherë janë rrethana tjera dhe nuk bëjmë përjashtim si krejt bota. Por, mendoj që në kohën e tashme nuk është mirë për të krijuar pesimizëm të brendshëm në këtë projekt, e projekti është i madh, është serioz, e Kosova ka obligime, që janë shumë serioze, mirëpo është plani më i mirë, më i madh i mundshëm që ka mundur t'i ndodhë vendit, e i cili po them nuk është lajm që e ka sjellë kjo Qeveri. Kjo Qeveri veç ka qenë aty kur i ka ardhur koha të mbyllet, të mos mbetet më tutje në pritje. Pra, edhe atë është me rëndësi ta dimë të gjithë bashkë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Përmbyllja e marrëveshjeve komerciale për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" është një nga hapat shumë të rëndësishëm për të ardhmen e Republikës së Kosovës.

Energjia është kusht i pashmangshëm për të ardhmen ekonomike, por edhe politike e sociale të vendit. Arritja e kësaj marrëveshjeje është rezultat i punës shumëvjeçare të qeverive të Kosovës, ministrave dhe ish-ministrave, të shumë njerëzve e shumë ekspertëve, duke përfshirë këtu institucione të shumta ndërkombëtare që arritën t'ia sigurojnë vendit një të ardhme të sigurt energjetike me këtë projekt. Ky akt është i rëndësishëm në shumë nivele, por ato që kanë rëndësi të theksohen këtu janë: pavarësia energjetike e vendit, rritja e qëndrueshme ekonomike, vazhdimi dhe rikonfirmimi i partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe sigurimi i prosperitetit për gjeneratat e ardhshme.

Para se të flas për disa nga efektet pozitive të këtij projekti, dua ta shtroj një pyetje: Cilat janë alternativat e financimit nëse Kosova nuk i ndërton këto kapacitete të reja të gjenerimit

nëpërmjet këtij investimi nga sektori privat? Shumë lehtë mund të vihet te konkluzioni se opsionet janë të limituara dhe me më shumë rreziqe sesa efektet potenciale që mund t'i sjellë ky projekt.

E para, mosndërtimi i këtyre kapaciteteve do të nënkuptonte ekspozimin e vendit në mënyrë të pamëshirshme ndaj tarifave të importit. Sa për ta ilustruar se për çfarë risku po flasim, duhet cekur se në periudha të caktuara të pikut në sezonin e dimrit në raste ky çmim ka shkuar edhe në mbi 250 euro për megavat. E dyta, financimi nga fondet publike si opsion alternativ bart në vete rreziqe të tjera, si për shembull zhvendosjen nga presioni në tarifa, te taksat e qytetarëve. Po ashtu, bazuar edhe në studimet e Bankës Botërore, për shembull, tek projektet e natyrave shumë të komplikuar teknologjike si ky, implementimi i financimit nga fondet publike është 20% më joeficientë se sektori privat. Thënë ndryshe, kostoja e projektit do të rritej për së paku 20% më shumë.

Ja dhe një pyetje tjetër: Cilat janë alternativat në raport me burimet e gjenerimit që vendi jonë ta adresojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për qytetarët e bizneset e vendit? Ne kemi kushte të jashtëzakonshme që ta adresojmë këtë çështje nëpërmjet burimeve tona natyrore që shumë shtete nuk i kanë.

Pra, ne kemi rezerva vendore të linjtit që gjithsesi duhet të shfrytëzohen për mirëqenie ekonomike dhe sociale, duke prodhuar energji elektrike të qëndrueshme, të përballueshme dhe të sigurt për vite dhe dekada në vijim. Duke cekur këtë duhet të theksohet që përfshirja e sektorit privat në këtë projekt infrastrukturor të jetë i rëndësishëm, ndërmjet tjerash i ofron vendit tonë edhe këto: investime direkte prej 1,3 miliard euro, krijimin e 10 mijë vendeve të punës gjatë ndërtimit dhe 500 vende permanente të punës gjatë operimit. Do të sjellë në sektorë teknologji dhe ekspertizën më moderne bashkëkohore, pas 20 vjetëve ky termocentral do të kthehet i tëri në pronësi të shtetit tonë pa asnjë obligim financiar, ndërsa jetëgjatësia minimale e tij është 40 vjet. Dhe, po ashtu do të krijohet Fondi për Komunitetin prej 10 milionë eurove që, tash për tash, është gjashtëfishi i investimeve kapitale të buxhetit aktual të Komunës së Obliqit, ku do të operojë ky termocentral.

Sa u përket aspekteve financiare, duhet të theksohet qartë se projekti për Termocentralin “Kosova e Re” do të realizohet komplet nga investimet private. Qeveria e Kosovës nga buxheti i saj nuk do të shpenzojë mjete publike për këtë projekt. Investitori Contour Global do ta investojë këtë projekt, ku nga shuma e përgjithshme ata vetë investojnë 30% të kapitalit. Ndërsa, pjesën tjetër, ata do ta sigurojnë në formë kredie normalisht nga institucionet ndërkombëtare financiare, siç është partneri kyç i këtij projekti - Banka Botërore me institucionet e veta, si: MIGA, IFC, IDA, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, agjencitë e kreditimit të eksportit, EKSIM-bankat, kreditorët komercialë dhe institucionet potenciale kredituese të tjera. Duhet sqaruar edhe diçka që u përmend në këtë seancë sa i përket normës së brendshme të kthimit të IIR në kapital,

është interes që investitori kërkon ta kthejë për investimin që e bën në këtë projekt. Tash, shifrat e kërkuara fillimisht nga Contour Globali kanë qenë ndërmjet 23 dhe 27% IIR, por në marrëveshje është arritur që norma finale të jetë 18,5% dhe krahasojeni me projekte të ngjashme, mund të ju dalë që është më e vogla se të gjitha projektet e kësaj natyre në 10 vjetët e fundit.

Por, sidoqoftë, ajo që duhet sqaruar, është se kjo normë e interesit është e aplikueshme vetëm për 30% të mjeteve të totalit të projektit, pra mjeteve që i investon direkt nga kapitali i tij kontraktori, ndërsa pjesa tjetër do të jenë kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare, për të cilat nuk aplikohet IIR, pra do të jetë me siguri nga ajo që parashihet, praktikat mund të jenë me siguri nën 7%.

Në anën tjetër, ne jemi të vetëdijshëm që eksploatimi dhe djegia e linjtit ka ndikim në mjedisin përreth nëse nuk zbatohen standarde të larta mjedisore. Deri më tani, institucionet kanë bërë hapa të rëndësishëm për t'i kufizuar sa më shumë që është e mundur emisionet nga termocentralet ekzistuese "Kosova A" dhe "Kosova B", por Termocentrali "Kosova A", siç u tha disa herë, e ka tejkaluar çdo limit të jetëgjatësisë së mundshme dhe tani ka mbërri në atë moshën që duhet të mbyllet dhe me hyrjen në punë të Termocentralit "Kosova e Re", ai do të dekomisionohet nëse nuk ndërmerret ndonjë projekt tjetër në ndërkohë. Një pjesë e madhe pothuajse e gjithë kapacitetit prodhues të Termocentralit "Kosova A" do të zëvendësohet me kapacitetet e Termocentralit "Kosova e Re", ndërsa prodhimi i energjisë elektrike dhe termike nga Termocentrali "Kosova B" do të vazhdojë me zgjatjen e operimit të tij që do të bëhet nëpërmjet planeve për rehabilitimin e plotë, nga ku emetimet e gazrave do të reduktohen sipas standardeve të caktuara nga Bashkimi Evropian.

Këta tregues në vazhdim janë dëshmia më e mirë e këtyre pritshmërive. 200 megavat energji termale shtesë për ngrohjet qendrore, jo më vetëm në Prishtinë, por edhe në qytetet përreth, 40% efikasitet në operim më shumë sesa tani, 39% më pak konsum të linjtit sesa "Kosova A", ose 25% më pak konsum sesa "Kosova B", 10% më pak konsum të ujit sesa "Kosova B" dhe 20 herë më pak emetime të pluhurit, tregues këta tepër të rëndësishëm. Ndërsa, një element i cili duhet theksuar fuqishëm po ashtu, e se nuk mund të ketë tregues më domethënës për pozicionimin e Kosovës si destinacion për investime, sesa kjo marrëveshje për Termocentralin "Kosova e Re" - investimet e huaja direkte janë të domosdoshme dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e vendeve të reja të punës. Dhe, me rritjen ekonomike dhe me këtë investim, unë besoj se ne po dërgojmë sinjal të qartë nëpër botë se jemi vend me potencial dhe shtet që ofron siguri për investime, sepse është një projekt jashtëzakonisht i madh, më i madhi që e kemi realizuar ndonjëherë.

Duke u nisur nga këto që i thashë, por edhe bazuar edhe në shumë fakte të tjera afirmative për këtë projekt gjigant energjetik, ne besojmë se ky projekt duhet realizuar sa më parë dhe e

mirëpresim faktin që më në fund jemi para zbatimit të këtij projekti madhor për energjinë dhe në përgjithësi për ekonominë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, dhe

Qytetarë të Kosovës,

Marrëveshja për Termocentralin “Kosova e Re” do të duhej ta alarmonte vërtet këtë Parlament. Kjo kontratë do të disafishojë çmimin e energjisë elektrike që në fazën e gjenerimit, gjë që do të reflektohet edhe në çmimin e saj për qytetarët e Kosovës.

Në të vërtetë, Qeveria është duke provuar ta mashtrtojë opinionin publik, duke thënë se konsumatori do të paguajë energjinë shumëfish më shtrenjtë, por nëse lexohet marrëveshja, kuptohet se qytetari prapë do ta paguajë këtë shtrenjtim, qoftë në faturat e tyre, qoftë me Buxhetin e Kosovës. Por, ajo çka u tha edhe këtu sot, pjesa më e rëndë është pra ajo që para disa ditëve Qeveria e Kosovës e themeloi kompaninë e re për distribucion, e cila do të sigurojë që tërë energjia e prodhuar e Contour Global të blihet, pa marrë parasysh nëse Kosova ka nevojë për këtë energji, apo jo. Kjo paraqet në fakt skandal në vetvete.

E para, kur Qeveria vendosi ta falë asokohe Distribucionin për Çalik, çmimi i energjisë u rrit disa herë. Furnizimi me energji nuk u përmirësua fare, dhe shumë punëtorë të KEK-ut u hodhën në rrugë. Skandali qëndron në faktin se Qeveria dje e privatizoi një kompani publike të Distribucionit dhe sot po e themelon një kompani publike të Distribucionit.

Pra, kjo nuk ka as kuptim ideologjik dhe nuk ka as kuptim ekonomik. Pse në fakt po ndodh? A ka ndryshuar diçka në Qeveri? Jo! Pse kjo kompani po krijohet pikërisht tash, kur çështja e fillimit të punimeve për Termocentralin “Kosova e Re” as që është afër, edhe sikur të fillonte ndërtimi nesër i këtij termocentrali do të duheshin rreth 4 vjet që ai të jetë funksional. Dhe, ne sot e kemi një bord të kompanisë së re publike të Distribucionit ekskluzivisht për Contour Global, i cili shumë shpejt mund të fillojë me punësimin e personelit, për të cilin mund të hapet ndonjë punë pas katër vjetësh.

Pra, këtu është një gabim në hapa, që thjesht do ta dëmtojë edhe më tutje buxhetin, ashtu siç ka ndodhur edhe me veprime të tjera të tejpunësimit në Qeveri, siç është puna edhe me zëvendësministra, koordinatorë, pastaj kemi të bëjmë edhe me tejpunësime të ndërmarrjet ekzistuese publike, në Postë për shembull, e presim shumë shpejtë që Posta të bjerë në dy gjunjët për shkak se kohëve të fundit e kemi një shumëfishim të punësimeve, në secilën zyrë janë shtuar nga disa punëtorë të rinj, dhe në vend që sot të flasim për çështjen e Contour Globalit, ne duhet

të merremi edhe me një ndërmarrje të re, e cila do ta fillojë punën së shpejti dhe do të fillojë me punësime të reja, edhe pse ata do të kenë realisht punë tek pas katër vjetësh.

Kjo është shpjeguar më herët nga Lëvizja Vetëvendosje, se marrëveshja Contour Global është një marrëveshje shumë e dëmshme për Kosovën për shkak të normës së lartë të kthimit. Republika e Kosovës do t'ia paguajë Contour Globalit të gjitha shpenzimet, plus kështet e kredisë, plus kamatën, plus fitimin, si dhe në fund edhe tatimin në fitim. Për periudhën prej 20 vjetësh, qytetarët e Kosovës do të paguajnë 5 deri në 7 miliardë euro për këtë marrëveshje. Se sa e pafavorshme për Kosovën është kjo marrëveshje mjafton të krahasohen ndëshkimet në rast të shkëputjes para fillimit të zbatimit të saj. Kosova ndëshkohet me 19,7 milionë euro, ndërsa investitori ndëshkohet me maksimumi 8 milionë euro. Këtu madje jam i mendimit që më mirë është sot t'i paguajmë këto dhe ta ndërpresim këtë kontratë, sepse dëmi që do ta sjellë kjo kontratë është shumë më i madh se ky 19,7 milionë euro që do të kishim për ta paguar tash sikur të kishim ta ndërprerë kontratën.

Sipas marrëveshjes së Contour Globalit, sigurohet shitja e tërë energjisë së prodhuar me çmimin e synuar prej 80 euro për megavat orë. Dhe, ky çmim në fakt paraqet rritje krahasuar me çmimin e dakorduar me Marrëveshje e Mirëkuptimit 2015, i cili ka qenë 78,6. Pra, edhe atëherë 78,6, tash e kemi më tepër, e kemi 80, ndonëse çmimin e tregut e kemi çdoherë rreth 50 euro për megavat orë. Sipas analizës së ekspertit të pavarur Hekuran Murati, një nga zërat e rrallë që e ka analizuar kontratën voluminoze, kostoja vjetore për konsumatorët e energjisë elektrike vetëm nga ky termocentral do të jetë së paku 240 euro, nëse ai operon me 75% të kapacitetit, dhe do të jetë 340 milionë euro, nëse operon me kapacitet të plotë për shkak të bonusit që do ta ketë prej 20%.

Me fjalë të tjera, për periudhën prej 20 vjetësh, qytetarët e Kosovës do t'i paguajnë ato 5 deri 7 miliardë euro për këtë marrëveshje. E nëse këto shifra përkthehen në tarifa të konsumatorëve, pra shuma prej 240 milionë euro i shtohet faturimit ekzistues, atëherë do të kemi të bëjmë me një rritje të faturës nga 46 deri në 81% nga niveli aktual i tarifave, varësisht prej komponimit të burimeve të ndryshme që kemi pasur nga Termocentrali "Kosova B", ose edhe nga Termocentrali "Kosova e Re". Mirëpo, një rritje kaq enorme e tarifave nuk do të mirëpritej nga konsumatorët dhe do të ishte e vështirë të arsyetohej edhe nga Zyra e Rregullatorit për Energji, e cila nivelin e tarifave e përcakton në bazë të të hyrave maksimale të lejuara.

Andaj, për ta tejkaluar edhe këtë problem është paraparë një zgjidhje, e cila paraqet pjesën skandaloze, e cila është në fakt kjo ndërmarrje e re për të cilën po flasim. Sipas marrëveshjes, Qeveria e Kosovës detyrohet që ta themelojë një kompani publike, e cila do t'i shërbejë si ndërmjetësues ndërmjet Contour Globalit dhe pjesës tjetër të tregut energjetik në Kosovë. Me fjalë të tjera, kjo kompani do të ketë për detyrë ta blejë tërë kapacitetin prodhues të termocentralit të ri, pati apo s'pati nevojë tregu i Kosovës.

Atë energji pastaj kjo kompani do t'ia shesë KEDS-it, apo edhe ndërmarrjeve tjera me çmim shumë më të lirë se kostoja. Këtë e kemi të qartë tanimë të gjithë, meqenëse çmimin e prodhimit e kemi pasur 30 dhe çmimin mesatar të importit e kemi pasur 50 euro për megavat orë kur të marrim, kur ta blejmë këtë energji nga Contour Globali, atëherë ne të tjerët do të detyrohemi ta shesim atë edhe jashtë, edhe qytetarëve me çmim shumë më të lirë, që i bie diku rreth 50 euro dhe mbase kur detyrohesh ta shesësh, shpeshherë në ato kontrata, duke pasur parasysh që në shumë raste kur kanë prodhuar shumë më tepër energji termocentralet e Kosovës janë detyruar ta shesin këtë energji jashtë me çmime tepër më të lira sesa edhe çmimi i atij që është prodhuar, pra ndër 30 euro.

Pra, shteti e merr përsipër humbjen, ndërsa Contour Globali e ka të siguar fitimin. Kjo ndërmarrje, apo Republika e Kosovës do t'ia paguajë Contour Globalit të gjitha shpenzimet, me këste të kredisë, me kamatë, me fitim, dhe në fund edhe tatimin në fitim. Të gjitha këto janë llogaritur dhe do të mbuloheshin me çmimin e synuar prej 80 euro për Mw/h.

Unë këtu do të kisha dashur, e pajtohem me fjalimin e Dardanit, ta di çka të ndodh faktikisht me këtë ndërmarrje dhe me Kosovën, përgjithësisht? Absolutisht, çfarëdo lloj rreziku që do të mund të ketë kjo ndërmarrje transferohet te Qeveria e Kosovës. Nuk mund të ndodhë askund në botë kjo. Nuk mund të ndodhë që komplet rrezikun e mundshëm të një biznesi ta bartë komplet përsipër dikush. Nëse do të kishim kompani të sigurimeve ku lista e rreziqeve transferohet te ato, kjo kushton jashtëzakonisht shumë. Ndërsa, ne e bartim përsipër komplet këtë rrezik. Kjo do të jetë drejtpërdrejt në kurriz të qytetarit. Qytetari do ta ketë përsipër ta paguajë komplet krejt rrezikun e kësaj kompanie me çmimin e lartë të energjisë që do ta paguajë.

Sipas kontratës, po ashtu për mënjanimin e hirit, KEK-u është i obliguar që t'ia sigurojë Contour Globalit hapësirat për deponim të hirit dhe të gjipsit pa asnjë cent, pra totalisht falas. Përpos çështjes së sigurimit të ujit dhe çështjes së sigurimit të qymyrit, për të cilat jam dakord me atë që u tha këtu në këtë seancë, në këtë debat, është edhe çështja tjetër, çështja e sigurimit të hirit, që bie komplet mbi Qeverinë e Kosovës obligimi për të.

Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, dy liderë kosovarë kanë udhëtuar për resorte të shtrenjta në pushime në Zvicër. Contour Global është shpërblyer me një kontratë që do ta kolapsojë Kosovën, ndërkohë që në deklaratën e vet thuhet se kompania funksionon në vende ku mund t'u ekspozohet procedimeve për korrupsion. Kjo marrëveshje nuk është dashur të nënshkruhet me këto kushte dhe si e tillë duhet të trajtohet edhe nga gjykata dhe sidomos në shitjen joligjore të tokës për ndërtimin e tij.

Ne jemi dakord që kjo marrëveshje duhet të ndërpritet menjëherë. Pajtohem në këtë pikë me Grupin Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, por unë po ashtu e kam një pyetje dhe i drejtohem Partisë Socialdemokrate në lidhje me këtë interpelancë, që është jashtëzakonisht e

qëlluar, e sidomos me të gjitha ato që u thanë nga Dardani dhe besoj se do të thuhet edhe më tej. Jemi të qartë, e kemi të qartë edhe ne, edhe shumëkush këtu, që kjo është një kontratë jashtëzakonisht e dëmshme për Kosovën dhe ne mendojmë se duhet të ndërpritet. Por,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, nëse ka ende kohë Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, mund të vazhdojë.

LIBURN ALIU: ...a besoni ju që kjo kontratë ndërpritet me këtë interpelancë? A besoni që këtë kontratë ne do të arrijmë ta ndalim thjesht me këto debate apo me këto votime të thjeshta, që do t'i bëjmë ne këtu?

Unë nuk befsohem nga kryeministri, nuk befsohem nga Qeveria. Thënë të drejtën, fyerja e madhe më ka ndodhur kur ka ndodhur demarkacioni, kur e ka sjellë kryeministri dhe është votuar demarkacioni këtu. Tash për mua nuk është befasi kjo. Unë pres që kjo me gatishmërinë më të madhe nga kryeministri të kalojë dhe të bëhet. Po ashtu, pres që edhe marrëveshjet tjera të dëmshme që do të vijnë në të ardhmen të shtyhen para, qoftë ajo e Zajednicës, e edhe të tjera me radhë. Dhe, unë nuk pres që këto ndalen me interpelanca. Nuk do të mund t'i ndalim me këto interpelanca dhe me ato rezoluta, sado të bukura që janë dhe që ne i votojmë me shumë dëshirë.

Ne do ta votojmë këtë rezolutë që do ta nxirrni nga kjo interpelancë. Pra, jemi për ndërprerje, por nuk besojmë që ndalet. Ajo që do ta ndalë janë zgjedhjet e reja. Pra, nëse duam vërtet ta ndalim, nëse vërtet doni ta ndalim të keqen, hajde e nxjerrim këtë vend në zgjedhje, e rrëzojmë këtë Qeveri. Ka mundësi! E kemi të gatshme edhe Lidhjen Demokratike, jemi të gatshëm edhe ne, hajde ta rrëzojmë këtë Qeveri, ta ndalim Contour Globalin. Hajde ta rrëzojmë këtë Qeveri dhe ta ndalim Zajednicën, që bashkë e kemi luftuar. E kemi luftuar të gjithë bashkë dhe e kemi ndaluar deri këtu. Tash është rrezik që ajo të vijë. Ajo nuk ndalet me interpelanca, e as me votime e fjalime të bukura. Për atë do të ketë nevojë të bjerë Qeveria dhe të bëhen zgjedhje të reja.

Prandaj, unë ju ftoj, hajde bashkë të hidhemi në përpjekje për ta rrëzuar këtë Qeveri, për t'i sjellë zgjedhjet e reja dhe për t'i ndalë këto të këqija, për të cilat ju jeni të bindur, siç jemi ne të bindur, që ato janë të këqija dhe nuk do të mund t'i ndalim. Çka do të mund të ndodhte? Hajde, paskan për të ndodhur zgjedhjet e parakohshme! Hajde, po e zëmë që ju jeni subjekti ri dhe keni probleme, dijeni që ka subjekte të opozitës, të cilat janë të gatshme edhe për koalicione parazgjedhore, edhe për zgjidhje çfarëdo, të cilat do të kishin për ta rregulluar këtë çështje. Por, çka është tepër e nevojshme? Është që sot të ndalet edhe Contour Globali, edhe kjo marrëveshje, të ndalet edhe çështja e Zajednicës, që po pritet të vijë.

Prandaj, dijeni që të gjitha ato që i kemi luftuar bashkë sot e kemi mundësinë prapë t'i ndalim bashkë. Dijeni që i kemi ndalë deri tash me përpjekje të përbashkëta, në kohën kur ju keni qenë

udhëheqës të Lëvizjes Vetëvendosje. Ju e keni udhëhequr Lëvizjen Vetëvendosje. Bashkë me juve e kemi ndalë. Në atë kohë, edhe Astrit Dehari ka rënë. A kupton? Hajde, hajde, i ndalim tash! Hajde bashkë. Po e ndalim Zajednicën, po e ndalim Contour Globalin! Kjo na duhet, e jo fjalime të bukura, se dakord jam me ato. Dakord jam, krejt në rregull, krejt ajo që u tha është në rregull. Dakord jemi, pajtohemi krejt, kemi për ta votuar atë rezolutë, po hajde ta bëjmë hapin konkret!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryeministri, pastaj për replikë deputeti Dardan Sejdiu.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje!

Dardan dhe Liburn,

Po ju kuptoj pse s'po mund t'i shihni disa gjëra qysh janë, jo qysh na teket për t'i parë. Për shembull, nuk mendoj që është në rregull, kur po e quajmë... kur po flasim për nder, për çfarëdo nderi, por nuk na takon ne shqiptarëve, deputetëve shqiptarë ta krahasojmë Contour Globalin me Zajednicën.

Nuk mendoj se je duke i ndihmuar as vetes, as kauzës tënde, as Zajednicës, as kundërshtimit të saj. Je gabim shumë. Mos bëj këso gabimesh të lutem, se ia shohim sherrin të gjithë, jo veç ti. Nuk është ashtu. Nuk është Contour Globali Zajednicë. Tjetër send është, krejt tjetër natyrë e problemeve, e temave.

Këto gabime na kanë lënë pa i mbërri disa qëllime, që do të mund t'i mbërrinim, të mira për vendin, se prej euforisë i kemi futur krejt në një thes. Nuk është ashtu. Ruaju! Nuk ke të drejtë. Nuk ka të drejtë kurrkush në këtë Parlament të thotë që investimi i Contour Globalit është Zajednica, hajde t'i prishim të dyja, t'i ndalim të dyja. Mos, se s'është ashtu! Këqyrni pak çka jem duke bërë. Analizojeni një grimë.

Shiko, i dashur Liburn, unë e di që e do këtë vend edhe ti dhe besoj se ka plot që e duan. Krejt jeni kah fliti të pavërteta, edhe pse po ta tregoj thjesht, bash qysh di unë, qysh ma merr mendja mua. Ne e kemi 35 euro çmimin e A-së e të B-së, dhe është çmim i lirë, po këto kapacitete janë duke vdekur, duhet futur para në to e ta rritin çmimin. Pjesën tjetër të energjisë, dëgjo, e dëgjova atë kolegun tënd, ish-kolegum, që tash po pajtohesh me të. E dëgjova më herët, tha "kur është importuar ka qenë veç 112-ve e 60". Sa është mesatarja burrë? 80! Energjinë tjetër që s'e prodhojmë ne nuk e ke me 35 euro. E atë që e kemi blerë, në vend se t'ia blejmë dikujt për atë çmim, blije bre tënden, prodhoje këtu. Ky është dallimi, o djem e çika, zonja e zotërinj. Nuk e di pse duhet të shkohet prej ekstremi në ekstrem. Kështu është e vërteta. Nëse këtë s'e keni marrë vesh, burra, s'po di... po na qorrohen sytë diku.

Mos i thuaj Contour Globalit Zajednicë, se s'është njësoj. Krejt është tjetër send. Tjetër send është. Nëse e do mendimin tim, edhe nuk jam ndonjë tradhtar, edhe s'jam ndonjë frikacak, as

s'po e bëj për hatër të dynjasë, Contour Globali është "tomahovkë", që na kanë ndihmuar më 24 mars '99. Ky është dallimi. Kur s'kemi mundur ne ta çojmë deri në breg, kanë hyrë ata, na kanë ndihmuar, kemi dalë në breg. Jemi të rrezikuar për energji në këtë vend. Nuk prodhojmë. Atë që jemi duke e marrë ne të lirë, nuk e kemi të garantuar as edhe për pesë vjet, as A-në, as B-në. S'kemi energji në këtë vend. Atë që jemi duke e blerë, jemi duke e blerë nga 80 euro.

Cili është problemi që u dashka të investohet. Më së pari s'kemi ekspertizë për ta bëjmë vetë. Më të avancuar sllovenët, ia kanë nisur ta bëjnë vetë, e kanë paraparë 600 milionë, u ka shkuar në 2 miliardë. Nuk jemi duke ndërtuar. Po merr operatorë! Po, se ai s'është "Nëna Terezë", ai është investitor, është biznes. Vjen për profit, hyn në obligime ai edhe ti me të, ky vend.

E dyta, po ju siguroj një send. Nuk di a ka vjedhur ndokush para meje, nuk e di, veç me këta nuk mund të hysh në marrëdhënie korruptive. Nuk është korrupsion, nuk është as AXOS, nuk besoj që ata para meje që kanë vjedhë, unë s'kam mundur të vjedh, burrë! Nuk kam mundur të hyj në kurrfarë marrëdhënie korruptive me këta. Jo! Jo! Nuk kam provuar, po s'kam mundur, se ndoshta e keni aty problemin. Nuk është aso marrëdhënie, besoni. Nuk është kjo, e s'di çka tjetër. Nuk është privatizimi i ndonjë kompanie këtu që ka ndodhur, kjo është marrëdhënie serioze. I kanë ligjet më strikte antikorrupsion, janë njerëzit më seriozë në atë temë, në Global. Mos, se nuk është që të futet në kallëp ashtu.

E sa për ta rrëzuar Qeverinë, kur t'i bëni numrat e rrëzoni. S'është problem hiç, s'e kam në atë temë. Ju kam thënë edhe më herët në këtë Parlament. Ja këtu jemi! Por, problemin e kemi këtu, ruajuni aman, nuk ka logjikë. Shiko, matematikë më të thjeshtë, besoni nuk ka. Nëse doni ta shihni si është, unë e di që kjo kontratë ka mundur të jetë edhe një grimë më e mirë për Kosovën, edhe ndonjë numër të na binte më tamam. Por, nuk po bëhet veç për hatrin tonë. Për t'i thënë këtë Contour Globalit, unë u ruajta deri tash, besoni, shkova me kujdes, nuk e teprova fort. Nuk është rezultat i punës sime, ju thashë më herët. Është e punuar ndër vite, ndër qeveri. E kam gjetur, ka ardhur në kohën për ta kryer. Mirëpo, t'i thuhet kësaj Zajednicë, është gabim; ose të krahasohet, të thuhet 'hajde t'i ndalim të dyja'... ndale Zajednicën, edhe mirë që është ndalur, edhe mirë që e ka gjetur gjykata ashtu, dhe shpresoj që gjykatësit e kësaj gjykate kurrë nuk do t'ia japin aprovimin asnjë zajednice që del jashtë Kushtetutës së vendit, se ata do ta japin në fund, ajo gjykatë, Gjykata Kushtetuese dhe shpresoj që ata s'e bëjnë, por nuk bënë të krahasohen.

Është shumë e thjeshtë matematika, deputetë. Shikoni, ne i kemi, me të dyja këto, me B-në dhe me këtë të renë, 980 - 1050 Mw më së shumti, maksimumi është, pa A-në. Prapë ka hapësirë për energji alternative, kush do të prodhojë solar, me erë... për krejt do të kemi nevojë. Tjetra është që ne marrim energji të lirë, se shtohet kapaciteti, por janë në fundin e jetës së vet. Nëse do t'i rinovosh, ta rritë çmimin e energjisë. Këtë që po e marrim ne të lirë, nuk mjafton. Nuk është krejt

ajo që na nevojitet, pra prapë ne e kemi 1/3-tën minimum që duhet importuar, që hynë në këtë sasi rreth 400 - 500, që duhet importuar. E atë nuk e ke me 35 kurrkund në treg.

U tha më herët që ZRRE-ja jonë ka thënë kështu - ashtu... Ku e di ZRRE-ja çmimin e energjisë në të ardhmen? Kur u bënë ata aq të zotët të na tregojnë çka po bëhet në rajon dhe qysh do të vijë vitin që vjen? Ju siguroj që ky lajm, ju them edhe një herë, dallon. Edhe në u rrëzofhtë kjo Qeveri, edhe në u rrëzofshin shumë qeveri, mos e rrëzoni këtë investim, se është në interesin e fëmijëve tanë që rriten këtu. Nuk ka logjikë të mbetemi të varur në energji ne prej fqinjëve që s'po na njohin, prej fqinjëve që po na pengojnë, prej atyre që s'po na duan. T'ua rritim ne atyre kapacitet, t'ua aktivizojmë atyre resurset dhe t'ua çojmë paratë? Nuk ka logjikë, unë nuk e di ku po i gjeni këta numra. Eh, po, më mirë do të ishte krejt hidro, më mirë do të ishte krejt solarë, më mirë do të ishte se më pak ndotëse, të gjithë e dimë këtë, por ne kemi qymyr, në të po bazohemi, atë resurs e kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Sejdiu, pastaj Liburn Aliu. Atëherë, Libruni së pari. Liburn, urdhëro!

LIBURN ALIU: E para, unë nuk thashë Zajednica dhe Contour Globali janë një. E përbashkëta e të dyjave është se të dyja janë të këqija për Kosovën. Njëra është një e keqe, tjetra është një e keqe tjetër dhe të dyja duhen ndaluar. Prandaj, ne e kemi për detyrë ta ndalim. E kemi për detyrë të flasim, e kemi për detyrë të votojmë, por e kemi për detyrë edhe të synojmë ta ndalim dhe tash e kemi një mundësi, për atë nuk po shoh që kemi ndonjë barazim, apo diçka. Nuk di cila është më e rrezikshme! Të dyja janë shumë të rrezikshme. Të dyja e dëmtojnë të ardhmen e atyre fëmijëve për të cilët po flet, të dyja e rrezikojnë madje të ardhmen.

Sa i përket “tomahovkës”, tregona nëse ne me këtë kontratë po e paguajmë “tomahovkën”, ta dimë. Le të thuhet hapur që me këtë kontratë ne po e paguajmë “tomahovkën”, por unë nuk po e di që ne po e paguajmë “tomahovkën”. Ne po e paguajmë një ndërmarrje, një biznes. Një biznes, i cili është diku, një ndërmarrje e cila nuk është shteti i Amerikës, nuk e paguajmë shtetin e Amerikës për “tomahovkën” që na ka ndihmuar. Nuk e di që na kanë ndihmuar ata për t'ua kthyer ne pastaj në këtë mënyrë, se s'di që e ka deklaruar dikush ndonjëherë këtë punë. Ndërsa, nëse do të kishte qenë kështu, hajde të mendojmë cili do të jetë obligimi ynë për ta paguar çlirimin e Kosovës që e kemi filluar vetë dhe na ka ndihmuar faktori ndërkombëtar.

Sa i përket ZRRE-së dhe pamençurisë së cilës po i referoheni të ZRRE-së, që ata nuk janë të mençur mjaftueshëm për ta ditur se cili do të jetë çmimi i energjisë në të ardhmen, neve na mjafton ta dimë cili ka qenë çmimi i energjisë tash dhe në vitet e fundit. E ju, na tregoni neve nga po e dini ju që ka me qenë përmbi 80 euro, e që neve 80 euro po na kushtuaka. Nga po dihet ajo? Nëse ne do të flisnim 112 euro që kemi për t'i paguar, ne kemi paguar në raste të pikut. Ky është momenti i pikut, momente kur ne s'kemi pasur. Ka qenë dimri, janë prishur elektranat, jemi

detyruar të marrim energji diku dhe ka mbërri çmimi në 112 euro. Kjo ka qenë e përkohshme. Kjo ka mundur të shmanget shumë lehtë në marrëveshje me Shqipërinë. Pra, ata mund t'i ndalin atje turbinat e veta, sepse i kanë hidrocentrale, e ne tonat nuk mund t'i ndalim. Ne kemi mundur të marrim energji prej tyre dhe të kemi marrëveshje me ta dhe t'u japim atyre kur ne duhet të prodhojmë patjetër natën. Një gjë e tillë nuk u bë dhe për pasojë ne kemi paguar raste nga 112 euro për Mw/h. Ama çmimi 80 euro që ne duhet t'ia garantojmë dikujt, unë nuk e kuptoj pse duhet t'ia garantojmë ne. Shumë qartë e tha edhe zoti Abdixhiku këtu. Pse ne duhet të marrim risk përsipër? Pse ata duhet ta transferojnë riskun e kompanisë së vet te qytetarët e Kosovës. Krejt qytetarët e Kosovës t'ua garantojnë atyre fitimin dhe ata asnjë risk të mos e kenë, deri as hirin, të cilin e prodhojnë. Unë këtë nuk mund ta kuptoj.

Sa i përket çështjes së vlerësimit strategjik mjedisor, jo pra vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimi i ndikimit në mjedis bëhet fjalë për kompani të vogla, për këtë rast duhet sipas ligjit të jetë vlerësimi strategjik mjedisor, por këtu është thënë gabim. Pavarësisht asaj që ata do të mund të na thonë kemi kaq emision, ose e reduktojmë kaq emisionin e pluhurit e të ndotjeve, pavarësisht këtyre, këtu ka ligj. Është Ligji i VSM-së. Të mos ia bëjmë sikur për autostradat, që deri tash i kemi ndërtuar pa leje dhe na e kanë dëmtuar urbanizmin në Prishtinë. T'ia bëjmë edhe me cilat do investime që do të vijjnë në të ardhmen. Urdhëroni, është ligji, le ta bëjë kompania, ose le të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor, e pastaj flasim. Nuk po dyshoj që mund të dalë mirë, ama nuk është bërë. Është hap ligjor, që është dashur të ndërmerret.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shumë po më vjen çudi ky diskutim, për shkak se nëse më pyet mua a po e paguajmë “tomahovkën”, pyetja ime për ty, Liburn, qysh e paguam ne atë më '99-së, më 24? Na e kanë dhënë pa para më duket. Më 24 mars '99. Nuk na kanë kërkuar para atëherë, na e kanë dhënë falas, a? Eh, shyqyr! Pra, s'kemi pasur ndonjë pazar atëherë, kanë hyrë... shyqyr! Na ka ardhur mirë! Pra, s'jemi duke paguar diçka të para 20 vjetësh, por po të tregoj që si lajm dallon, pra kjo është logjika që po e flas unë. Jo se po e paguajmë atë të atëherëshme, po as s'e kemi ditur, jemi gëzuar kur kemi dëgjuar që po bien ku kanë rënë, shyqyr që kanë rënë!

Ky lajm është një bombë energjetike, këtë desha ta them, vëllai im. Bombë energjetike. Kjo Kosovë ka qenë e paraparë të jetë veç importues dhe veç të marrë energji prej të tjerëve. Kaq! Edhe kanë rënë këta që i kanë gjuajtur “tomahovkat”, po thonë jo ngadalë, këta nuk duam t'i lëmë të bëhen të varur prej çezmës së kurrkujt, këta kanë për të qenë zotë shtëpie në vete, janë prishur me pak evropianë, janë prishur me disa, e me disa, për të ndodhur kjo. Kjo dallon pak, ta dini çka po flas. Nuk jam kah i flas krejt pahiri, janë gjëra që unë e di që sa lobimi, sa puna është dashur të bëhet nëpër institucione monetare për t'u aprovuar ky investim, se BE-ja nuk është fort merak për energji me qymyr.

Tjetra? Ne jemi duke folur për çmim, ti po thua qysh po e dimë ne çmimin në të ardhmen, e po thirrrem në të kaluarën. Me të kaluarën jam kah të flas. 112 në pik, 60 kur e ke blerë më së liri, nxirrja mesataren burrë, 80 e ke. Nxirrre vetë, 120-shi dhe 60-shi, ku i bie mesatarja? 112. 30 e ke përmbi, 20 e ke për fundi, nxirrja mesataren, i bie 84-85 bile. Çka jam duke dashur të them? Nuk e ke më këtë energji, se i ke dy kapacitete duke u përmyllur. E kanë afatin e jetës. Lumiri tha, para se të shkojë njeriu në hënë, është njëra. Ashtu i ke të vjetra. Kanë hyrë shumë para, beso, të huajat. Nisja futi tuajat, të këtij buxheti, dhe e sheh sa e ke koston. Nuk jemi kah futim të vjetra, unë s'jam kundër edhe që t'i riparojmë këto, nëse ka projekte serioze. Pse jo? S'jam kundër. S'kam qenë asnjëherë. Në tavolinë kur kam ardhur e kam gjetur një mundësi të një investimi të ri, në emër krejt tuajin, në konsultime besa me shumë prej jush i kam thënë po, por jo unë, i ka thënë ky vend. Nuk ka logjikë, besoni tjetër, pas kësaj. Kjo s'është bërë për hatër të ndonjë nomenklature politike këtu, as për hatër të ndonjë qeverie. A rri kjo, a shkon kjo, a vjen ajo tjetra... nuk është bërë për atë hatër.

Ky është projekt tjetër. Është nëse duam ta lëmë Kosovën që kur t'ia ndalin çezmën duhet ta matë çka po flet, apo jo. A është në rregull nëse raportet eksport - import i kemi këto që i kemi, t'ua shtojmë këtyre raporteve edhe blerjen e energjisë, e paranë tonë ta nxjerrim jashtë?

Këtu ka plot elemente që unë po habitem qysh nuk po konstatohen. Unë nuk po them që kjo kontratë është më e mira në botë, që do të mund ta shkruante dikush, ju thashë edhe një herë. Nuk jemi në aso pozite për t'i marrë kushtet më të mira në treg. I kemi marrë disa kushte reale, opcionale që i gjen në një treg të pazhvilluar, por nuk është kjo kontratë që t'ia shohësh këto rreziqe, e të mos ia shohësh krejt të mirat. E the një fjalë, the po i paguajmë 19 milionë euro tash edhe po hiqemi prej kontratës. A e dini çka domethënë kjo? Tërë jetën kur të hiqemi, aq është dëmi. Pra, a po e sheh, s'je në rrezik. Aq e ke rrezikun. Më në rrezik është investitori, më në obligime hyn ai, më interes ka ai të mos dalë dhe ti nuk je në rrezik, je i mbrojtur. Atë ditë që del ai drejt e në projekt, projektin e biznesit, ti e ke në pronësi. Me atë ofertë, që po thotë dikush gjejmë sa të duash investitorë në këto kushte, eh po s'qenke i rrezikuar, se si të dalë ai projekti është i yti, ia jep kujt të dush nëse del. Ashtu është. E vërteta e projektit është kjo. Nëse del ky projekt, nëse del investitori, s'mendon për ato që kemi marrëdhënie me të, projekti mbetet te na. Gjithë kohën do të kesh mundësi ta futësh në treg.

KRYESUESI: Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryeministër!

Për mua, diskutimi për termocentralin e ri në Kosovë nuk është diskutim në mes a duhet me e bë a s'duhet me e bë, është diskutim se a duhet me e bë për 4 miliardë euro, 450 Mw energji elektrike.

Pra, ju po e shoh që po keni tendencë dhe dëshirë që ta ktheni këtë diskutim mbi njëfarë fature e cila po na u lidhka ne për qafe me çmime të jashtëzakonshme. Ne, kryeministër, nëse nuk e keni harruar, e kemi paguar një autoudhë me çmim jashtëzakonisht të lartë. Ajo autoudhë ende po paguhet prej vitit 2008. As atëherë s'kam thënë që s'duhet të ndërtohet autoudha, por kam thënë që s'duhet të ndërtohet me çmimin që është ndërtuar, sepse mund të ndërtohet më lirë. Sot të njëjtën po ta them, kryeministër. Ky termocentral është me këta parametra financiarë është termocentral jashtëzakonisht i shtrenjtë, me barrë buxhetore jashtëzakonisht të madhe, me barrë në faturë jashtëzakonisht të madhe 60% rritje të konstatuar nga ZRRE-ja dhe këtë konstatim ata mund ta bëjnë, nëse nuk po mund të parashikuakan çmime në ardhmen, mund të kalkulojnë çmime në faturë në bazë të parametrave financiarë që ata i kanë parë në kontratën të cilën e keni shpalosur.

Dhe, ky parametër financiar e konstaton që fatura rritet për 60%, e nëse flasim për vende të punës dhe për këtë raportin import-eksport, nëse një prodhuesi të mesëm ia rritim faturën e energjisë elektrike për 60%, e që është burim, është kosto për të fatura, kjo i bie që edhe kostoja e prodhimit për të rritet. Eh, pra edhe kapaciteti i tij për ta zëvendësuar importe e për të stimuluar eksporte, zvogëlohet, sepse bëhet edhe më pak konkurrent karshi të tjerëve, të cilët nuk e paguajnë rrymën me këtë çmim.

Në anën tjetër, kryeministër, gjithashtu është tepër e rëndësishme që përtej këtij diskutimi që po e bëni dhe po tentoni ta bëni popullor, të kthehemi në, siç do të thoshin amerikanët, "the just" në thelbin e diskutimit.

I garantojmë cilësi të qymyrit për 20 vjet, i garantojmë cilësi të ujit për 20 vjet, i garantojmë çmim për 20 vjet dhe e pranojmë një çelës 70-30, 70% kredi, 30% ekuitet, me 18,5% kthim dhe kredia në dokumente, të cilat ju i keni bërë publike merret me 7.5%. Kur i llogarit, kostoja e ndërtimit të këtij termocentrali në rastin më të mirë është 2,5 miliardë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Lus regjinë që t'ia vazhdojë fjalën.

DARDAN SEJDIU: Në rastin më të keq është katër miliardë dhe krejt kjo, kryeministër, përkthehet në fatura.

E unë këtu sot po propozoj që të ulemi së bashku, të bëjmë modelin, i cili na siguron kapacitete energjetike, të cilat na sigurojnë edhe çmim konkurrues, duke qenë rezerva e tretë e linjitet në Evropë, duke qenë se kemi inxhinierë të mirë, përkundër asaj çka po thoni ju, KEK-u sot në këtë gjendje për shkak të inxhinierëve vendorë dhe të ecim përpara.

Pra, nuk kemi debat se a duhet ta bëjmë, kemi debat me çfarë çmimi ta bëjmë, kush duhet të bartë këtë çmim dhe si duhet ta modelojmë këtë punë.

Ndërsa Liburn i dashur, sot pika e nëntë e rendit të ditës është interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, pra edhe rezolutën tuaj edhe ne e votojmë.

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën, pastaj deputeti Liburn Aliu.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më falni, veç po jepet një përshtypje që Kosova është bashkinvestitor në këtë projekt. Qysh po e shpjegon Dardani, po i bie që ne po japim para. Të gjitha paratë që investohen diku në botë, edhe nëse e merr një kredi ti personale, private, diku, e ka një kosto të interesit.

70% të kësaj kredie koston e interesit e ka nën 7%. Ka kredi edhe më të lira në botë, po nuk jemi ne prej atyre që i marrim më të lira, se ashtu jemi, në rangimin për kapacitetet tona të caktuara.

Pjesa e 30% e ka një status tjetër, i cili e rëndon këtë marrëveshje, këtë kontratë.

Ajo që po më bën përshtypje është kur po themi se është katër miliardë. Mos harroni një gjë, rregulli i marrjes së obligimit për Kosovës, Kosova nuk merr asnjë cent obligim, e vërtetë është që Kosova e garanton çmimin, këtë çmim, por po them se ky çmim që po flasim ne është i 450 megavatëve, ne s'e bëjmë menjëherë 80 euro edhe këtë që prodhojmë, këto të A-së dhe të B-së, ne do ta lëmë këtë çmim nëse mund t'i mbajmë, po pos këtyre, që e kanë këtë çmim, ku po e gjen ti më lirë energjinë dhe çfarë efektsh ekonomike po i krijon vendit me atë energji që po e merr diku.

Së pari, pyetja është e thjeshtë: nëse s'e prodhojmë ne, a e dini ku e blejmë, ju që po i kundërshtoni këtë. A e dini ku blejmë ne energji? Shqipëria e ngratë nuk ka të na shesë, besoj e dini, ku e blejmë, nëse bashkë kështu flasim, shqip. Ju e dini ku po e blejmë, kujt po i çelim vende të punës, kujt po ia çojmë paranë tonë.

Ju deri dje keni thënë t'i ndalim produktet e Serbisë, a keni thënë? Sot po thoni mos investo, blejmë prej tij energji. Çka ndodhi me ju, vëlla, që po i ndërroni pozicionet kështu? Unë habitem me qëndrimin tuaj, besoni.

KRYESUESI: Liburn Aliu e ka fjalën, Dardan pas Liburnit i ke 56 sekonda.

LIBURN ALIU: Na doli që Lëvizja Vetëvendosje po thotë që bën të blejmë energji prej Serbisë. Pra, të mos investojmë, po të blejmë energji prej Serbisë. Atë e thatë ju, madje, madje, në qeverisjen tuaj, zoti Haradinaj, importi prej Serbisë veç sa është rritur.

Pra, importi prej Serbisë veç sa është rritur. Këtu nuk e keni ju gajlen të çështja e energjisë që importohet prej Serbisë. Ju e thatë që do të jetë ‘bombë energjetike’, unë mendoj që do të jetë një ‘bombë sociale’, do ta varfërojë shumë më tepër qytetarin se sa sot.

Ne kemi vit pas viti miliona e miliona euro që i shpenzojmë për autostrada, nuk e kemi atë kthim në zhvillim që po e presim, se s’jemi duke u varfëruar edhe më tej.

Tjetra, sa u përket punësimeve, ne e dimë si ka qenë punësimi në ndërtimin e autostradave. Komplet punët kanë qenë të nënkontraktuara të kompanitë e jashtme dhe fuqia e thjeshtë punëtore e krahut është paguar me një çmim tepër të ulët. Kur më kujtohet se kam qenë në Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, vizitat që i kemi bërë, unë mendoj që ka qenë një skllavërim tepër i rëndë dhe një pagesë tepër e ulët e punëtorëve në punë të autostradave, mendoj që do të jetë e njëjta edhe tash.

Për sa u përket të hollave, ju po thoni që ne vetë nuk po investojmë, po kush do t’i paguajë ato, zoti Ramush Haradinaj? A do t’i paguajmë ne si qytetarë me pagesën e rrymës elektrike dhe do t’i paguajnë qytetarët po ashtu përmes tatimit që Qeveria eventualisht e subvencionon atë çmim. Qeveria do ta subvencionojë, ose qytetarët do ta paguajnë drejtpërdrejt.

Pra gjithsesi në fund pagesa do të vijë përmbi 5 miliardë euro mbi qytetarët e Kosovës, sepse askush në veçanti nuk do të paguajë për atë çështje, përveç qytetarëve të Kosovës.

Këtu do ta pasurojnë dike jashtë, mbase do ta pasurojmë edhe dike brenda, po me siguri, kështu garant do ta varfërojë jashtëzakonisht tej mase qytetarin.

Kemi një tip të kontratës, e cila është tipi më i rëndë i kontratës së mundshme, për shkak se komplet riskun e bart Qeveria e Kosovës.

Unë mendoj që këtu është gabimi i parë themelor. Unë mendoj që atë çka u tha edhe më herët nga zoti Abdixhiku, çka nëse në të ardhmen do të detyrohemi ta thyejmë këtë marrëveshje, për çka se do të na obligojë Bashkimi Evropian për shkak të tregut të lirë çështjen e 80-euroshit.

Po ashtu, desha të them, ju thatë kështu, 50 euro e kemi pasur çmimin normalisht apo 60 euro dhe në pik e kemi pasur 112 euro, mesatarja i bie 80 euro. Jo, ne e kemi pasur 30 euro, 30 euro për megavat orë e kemi pasur çmimin që e kemi marrë prej termocentraleve tona.

Dhe, në rastet kur kanë pushuar së punuari ato për ndonjë defekt, është marrë 50 deri në 60 euro dhe, në raste të veçanta të pikut ka qenë 112 euro, absolutisht nuk bie mesatarja 80 apo mbi 80, si po përpigjeni ta thoni.

Tash, për sa i përket çështjes së rezolutave në lidhje me atë çka u tha me Dardanin, ne i votojmë rezolutat, ne i votojmë, ju i votoni, rezolutat janë të mira. Ne po flasim këtu, mirë është të flasim, kemi folur vazhdimisht edhe kundër marrëveshjeve me Serbinë, edhe kundër ndërtimit të autostradës atëherë, edhe kundër kostos së ndërtimit të autostradës dhe me fjalime, me sa më kujtohet mua, nuk janë ndalur.

‘Zajednica’ e demarkacioni janë ndalur ndryshe, sot s’kemi nevojë ashtu. Sot mund t’i ndalim ato thjesht, edhe ‘Zajednicën’, edhe këtë të keqe, Contour Globalin, mund t’i ndalin duke e çuar këtë vend në zgjedhje.

Edhe ne nuk jemi kundër ndërtimit të termocentraleve, edhe ne e kemi shumë të qartë që kemi një linjit dhe duhet ta shfrytëzojmë atë, se nuk mund të orientohemi krejt nga energjitë alternative. Duhet ta shfrytëzojmë linjitin, duhet të investojmë në prodhim të energjisë përmes termocentraleve, po jo përmes kësaj marrëveshjeje të pafavorshme, e cila do ta varfërojë edhe më tepër qytetarin e Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën. Regjia, kryeministri po dëshiron ta fokusojë dokumentin. Regjia, të lutem, fokusojë në ekran dokumentin e kryeministrit dhe e aktivizon foltoren.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po e lexoj atëherë, shikoni.

KRYETARI: Nuk afrohet më shumë, ta kesh parasysh, vazhdo.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, kjo tabelë flet për kapacitetet në ndërtim në rajonin për rreth nesh në qymyr, për termocentrale të reja në qymyr. Totali i kësaj: Serbia tash i ka 350 të reja në ndërtim dhe i rehabiliton 2 450. Total i mbërrin 2 750 në qymyr. Bosnja i ka 2 000 të reja që po i ndërton, i ka 350 ekzistuese, që mbërrin në 2 350, Mali i Zi 200.

Liburn, nuk mund t’i ikësh të vërtetës që nëse nuk ndërtojmë ne një kapacitet, do të blejmë kështu këtu afër, nuk do të blejmë në Shqipëri.

Unë po them që ju po lypni të blejmë në Serbi rrymën, kaq është kjo. Ja po e lypni se po doni ju, ja po donë ata që ju kanë financuar, janë sekserë diku, se këtë problem e kam pasur kur kam

shkuar t'i nxis të prodhojnë, nuk donin të prodhojnë, se dikush fitonte prej importit. Ju po thoni nuk bën të ndërtoni, mua më erdhi mirë që Dardani tha po, ndërtojmë, po me një kosto tjetër.

Ama të kërkoni ta ndalim ndërtimin, kjo po më habit shumë, nuk ka logjikë kjo.

Edhe Dardanit po i tregoj, ju po manipuloni me të dhënat, nuk po doni ta thoni të vërtetën, unë po habitem pse po veproni kështu.

Shikoni, nuk është e vërtetë, 30 euro të energjisë, kur e kam marrë këtë Qeveri, Liburn, nuk ka prodhuar Kosova, ishin ndalur ekskavatorët, ishin ndalur shiritat, krejt në import kemi qenë. Kemi mbërri të prodhojmë, po edhe kur të prodhojmë më së shumti, prapë s'ka boll, sa të duam të prodhojmë ne, këto kapacitete janë të harxhuara, do të ndalen nesër a pasnesër, një ditë po. Ajo që po dëgjon qytetari që po i thoni qytetarit po rritet çmimi, na mori në qaftë kjo Qeveri, jo. Kjo Qeveri po do ta nxjerrë në këtë vend prej ku ka qenë, ku ka qenë Kosova? Nga rënia e një turbine, tri ditë në terr, reduktive kaq orë në terr.

Çmimin e Kosovës që po thua e kemi të lirë, nuk e ke të garantuar, se kapacitetin e kemi të vjetër, do të prishen, po nuk ndërton të reja, bëhu gati të blesh në Kollubar. Nëse ai është qëllimi, në rregull jemi, shkojmë e blejmë atje.

KRYETARI: Unë po e shoh reagimin, urdhëro, Liburn, fjala për ju. Dardan, reagimet kur po i kanë, replikë, kundër-replikë, po e marr kohën e tyre.

LIBURN ALIU: Që Vetëvendosja po thotë të mos ndalet ndërtimi dhe të vazhdojmë me import, këtë po e thoni ju, atë nuk e themi ne. Ne themi që po, duhet të ndërtohen kapacitete të reja, këtu jemi dakord, ama jo me këtë kontratë.

E tash për sa i përket kësaj kontrate, deri tash Qeveria e Kosovës ka vazhduar të importojë dhe vazhdon të importojë energji nga Serbia, pse? Pse nuk importoni nga dikush tjetër?

E tash po të tregoj unë ty qysh do të na vijë puna kur të fillojë të prodhojë Contour Global, do të na e shesë me 80 euro dhe ne do t'ia shesim KEDS-it me 80 euro. Ai do të thotë: "Jo, po e marr unë prej Serbisë me 40 euro". Ne do t'i themi ok-ej, qe unë po ta shes me 35 euro për ta ndalur atë ta blejë prej Serbisë, e po qysh? Duhet shitur gjithmonë në çmimin më të ulët se sa Serbia nëse do ta ndalësh Serbinë, po nuk ndalet kështu. Pse nuk po e bën tash këtë punë, pse tash nuk po e blen prej një shteti tjetër më shtrenjtë, të japim para e të mos e blejmë prej Serbisë, pse po arsyetoheni kështu?

Tash, mundemi shumë thjesht, tregu i lirë, nuk do të thotë që ti e blen me çmimin më të ulët, nëse e ka Serbia më të ulët, e ju po e blini, pse nuk e keni blerë prej dikujt tjetër?

Dhe kur të vjen puna në fund, prapë ju do ta merrni me 80 euro, ose do ta detyroni ta blejë 80 prej Contour Globalit, ndërsa do t'ia shitni KEDS-it ose distributionit vendor që do të jetë në të ardhmen, do ta shitni me çmimin më të ulët se sa tregu që ofron, edhe më të ulët se Serbia, ose duhet ta lejoni KEDS-in të blejë prapë prej Serbisë e të shitet diku tjetër më shtrenjtë.

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri prapë e dëshiron fjalën. Për hir edhe të publikut zakonisht po e lë debatin, se e kuptojnë edhe më shumë publiku kur po fokusohen për temën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë edhe këtë herë këtë ndërhyrje, pastaj po pres deri kah fundi, se nuk ka logjikë kështu.

Liburni po thotë i japim 35, KEDS-i i jep Serbisë a ia blen Serbisë, nuk po di qysh po thua, dikujt tjetër a, e blen a e shet a? Dëgjo, nuk ka 35 më, veç ne e kemi atë, ajo hyn në treg te ne, se është yni, nuk mundemi ta qesim jashtë, duhet futur në këtë treg, se është i këtij vendi, ka obligime ndaj këtij vendi, nuk është ashtu qysh po kujtojmë ne. Ai e shti këtu, është e jona, ne jemi pronar, Kosova është pronare, nuk ia japim askujt, s'ia jep as KEDS-it, askujt hiç, nëse është nevoja, po s'mund t'ia japë Serbisë as askujt.

Tjetra, pse s'po na e shet Serbia sot për 30 euro a 35, pse po ta pret ty dakikun e po të thotë kaq e ke? Faktikisht ashtu na e bën edhe nesër, tërë jetën na e bën ashtu, jo veç ajo, gjithkush.

Shiko, me këtë ne, edhe një send, jo vetëm që pavarësohet në energji Kosova, po bukur fort e stabilizojmë Shqipërinë. Në momentet më të ndjeshme të Shqipërisë, pse s'është tash misioni në funksion, ndonjë ditë do të jetë, në momentet më të ndjeshme ia premë lakun Shqipërisë, në pozitë më kritike mundemi, se ne jemi në qymyr, edhe Shqipëria është në gjendje të ta blejë këtë tërë verën, këtë 80-shin që po flasim ne, se s'ka ku e merr më lirë askund hiç, pos prej nesh.

Kalkuloni mirë, ju lutem, këtë investim. Nuk është kontrata e përkryer, prefekt në termat më të mirë komercial e mjedisor për Kosovën, po është kontrata më e madhe e mundshme për investime në energji për të na hequr nga varshmëria energjetike, të mos aktivizojmë ne resurse të tjerëve. Njëkohësisht të kthehemi në treg energjetik ne, kjo është matematika e kësaj pune. Po, ka garanci, ka obligime. Po, se është ashtu, këto janë marrëdhënie, edhe kur të shkosh ta marrësh një kredi në bankën tonë ke garanci, ke obligime, ke kosto, ke interes. Është e ditur kjo, nuk është rregull e re.

KRYETARI: Faleminderit! Ende ka komunikim, debat, lidhur me këtë çështje. Urdhëro Liburn!

LIBURN ALIU: Prapë po kthehem te çështja e importimit të energjisë nga Serbia. 35 apo 40, apo 50, apo sa ne do të detyrohemi gjithmonë ta shesim përbrenda energjinë, të cilën e blejmë 80 euro, e do ta shesim shumë më lirë se sa tregun që do ta kemi përreth.

Marrëveshja e transmissioinit do t'i ulte ato raste të pikave kur i kemi përmendur më herët dhe të njëjtën e bën edhe tash.

Po ashtu është edhe diçka tjetër, është viti 2023, eventualisht 2024 kur do të mund të fillojë prodhimi prej Contour Globalit, deri atëherë blerjen nga Serbia ne do ta vazhdojmë.

Ju i përmendët rastet në regjion, është normale, kush ka qymyr dhe kush ka mundësi të termocentraleve, të potencialeve energjike termike, do të ndërtojnë, të njëjtën duhet ta bëjmë ne, po jo me këtë kontratë, sepse kjo kontratë do të na varfërojë.

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Në fakt, në Kuvend në këtë rast është jashtëzakonisht mirë të potencohet që këtu do të ndodhë garanci sovraniteti.

Pra, ne në marrëveshjet që i kemi para vetes do të vijë një garanci e sovranitetit, i cili kërkon votë prej deputetëve dhe kështu e ndalim. Pra, te garancia e sovranitetit me këtë votë të Kuvendit mund të ndalet kjo dhe kjo është hap i madh përpara. Pra, të mos mendojmë që nuk mund ta ndalim.

E dyta, besoj unë edhe tepër e rëndësishme, kryeministri i përmendi kapacitetet që po ndërtohen në regjion, tha 2350 megavat dhe 2750 megavat në Serbi, 200 megavat në total, po i bie diku 5200 megavat energji elektrike që po ndërtohen të rreja në treg.

Sipas logjikës ekonomike, kur ka kapacitete kaq të mëdha në treg, pra ka ofertë të madhe, çmimet bien dhe, mbi këtë logjikë ZRRE-ja ka treguar pse bien çmimet e importit dhe nëse çmimet në gjithë rajonin janë duke rënë e ne ndërtojmë kapacitete që i paguajmë me 80 euro megavat energji elektrike, po ju them këtu, deputetë të nderuar, që krejt kapacitetin e Contour Globalit do ta blejmë ne brenda, e krejt teprinë e Kosovës B, nëse veç në të mbesim, do ta tokëzojmë, sepse nuk do të kemi as treg ku ta shesim.

Pra, do të përfundojmë që krejt energjinë e ndërmarrjes publike KEK, e cila sot operon me 10 milionë euro fitim, s' do të kemi treg ku ta shesim, sepse të gjithë të tjerët e kanë tregun e mbuluar.

Pra, në fakt, çka po bëjmë, është e njëjtë siç kemi bërë me krejt ndërmarrjet publike: zhvlerësim të ndërmarrjes deri në falimentim të saj për shitblerje të sektorit privat.

Pra, kosto në fatura të popullit, e profiti në xhep të korporatës, për këtë arsye në garanci të sovranitetit ne kemi mundësinë e artë që ta ndalim këtë kontratë dhe këtë termocentral.

Ajo çka ne propozuam dhe e kemi edhe në rezolutë përpara jush, është që të ndalim këtë marrëveshje dhe të fillojmë të diskutojmë, të mendojmë e të punojmë bashkë me inxhinierë e ekspertë të kësaj Republike që të ndërtojmë kapacitete të reja energjetike, por si duhet dhe me kosto të përballueshme edhe për buxhetin, edhe për qytetarin.

KRYETARI: Haxhi Avdyli e ka fjalën. Regjia, Haxhi Avdyli është në radhë të parë.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Të nderuar qytetarë,

Qeveria aktuale ka nënshkruar një kontratë komerciale me Contour Global për termocentralin Kosova e Re, ku për impaktin ekonomik të dëmshëm u fol sot shumë, por unë dua të koncentrohem, t'i them disa fjalë për impaktin ambiental dhe shëndetësor të këtij termocentrali dhe termocentraleve ekzistuese.

Duhet ta dimë që në shumë vende evropiane kanë filluar mbylljen e termocentraleve, posaçërisht e veçanërisht për shkak të impaktit ambiental dhe shëndetësor, jo për impaktin ekonomik, sepse impakti ekonomik është evident, po shumica e shteteve janë duke i mbyllur për shkak të impaktit ambiental, duke shkaktuar dëmtimin e tokave dhe ndotjen e ajrit.

E dimë që termocentralet po shkaktojnë emetimin e ndotjeve, oksidit të azotit, oksidit të sulfurit, dioksidit të karbonit, gazrave të ndryshme, të cilat kontribuojnë edhe në krijimin e shirave acetike, po edhe po ndikojnë në ngrohjen globale, e cila është një luftë globale për ta luftuar ngrohjen.

Edhe pse duhet të themi që kapacitetet e reja kanë pajisje, filtra të rinj, të cilët e pengojnë, po prapëseprapë ajo nuk mund ta ndalë në tërësi ndotjen që mund të shkaktojë termocentrali si pasojë e prodhimit të energjisë nga qymyri.

Raportohet se qymyri përmban edhe elemente radioaktive që me djegien e saj lirohen në hapësirë dhe studimet e kryera në vendet evropiane dhe amerikane flasin që përmes qymyrit bëhet edhe ndotja e ujërave nëntokësore, po ashtu është gjetur edhe niveli i lartë i arsenit, i plumbit, të gjitha këto elemente shkaktojnë sëmundje të ndryshme kancerogjene, si ato të sëmundjeve të lëkurës, sëmundjeve të mushkërive por edhe të dëmtimit të sistemit nervor qendror.

Qymyri po ashtu lidhet edhe me shumë sëmundje, si të rrugëve të frymëmarrjes, pastaj ka ndikim edhe në moszhvillimin e fëmijëve. Është vërtetuar që ka edhe nivele të larta edhe të merkurit në ujëra.

Ne me këtë kapacitet të Contour Globalit po krijojmë një gropë të madhe dhe atë mu ngjitas në kryeqytetin e Kosovës, ku banojnë gjysmë milioni qytetarë tanë dhe doemos do të jenë ata, personat apo qytetarët, të cilët do të jenë të ndikuar drejtpërdrejt nga impaktet e kësaj ndotje. Kjo, përveç kostos që u përmend shumë, pa dashur të hyj andej, për koston ekonomike, ka edhe një kosto tjetër, koston ambientale dhe koston shëndetësore, të cilën do ta paguajnë qytetarët nga pasuria e tyre, duke shpenzuar për shërimin nga sëmundjet, të cilat do t'i shkaktojë ngritja e këtyre kapaciteteve të reja.

Ne e dimë që është e nevojshme, që energjia është qenësore për funksionimin e shtetit dhe ekonomisë, por duhet të mendojmë edhe më shumë edhe për koston shëndetësore, koston ambientale, të cilën në mënyrë indirekte do ta paguajnë qytetarët tanë nëpërmjet pagesave që do t'i bëjnë për shërimin e tyre dhe kur e marrim parasysh se investimi në shëndetësi në këto vite dhe në vitet e ardhshme nuk po parashihet të jetë kaq i madh, doemos do të repurkutohen në shpenzime shtesë nga qytetarët për shërimin e fëmijëve të tyre, shërimin e vetes dhe në këtë mënyrë do ta rrisë edhe më shumë koston e këtij termocentrali.

Prandaj, unë vetëm desha që nga një kënd tjetër ta jap edhe një pasqyrë të ngritjes së kostos për shëndetin, të cilin shpeshherë po e harrojmë dhe ky është shkaktari kryesor që shumë nga vendet evropiane dhe njëri nga shtetet, i cili prodhon më së shumti, ka prodhuar në të kaluarën nga termocentrali, siç është Franca, në vitin 2022 do ta mbyllë termocentralin e fundit në vendin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Sa thashë që s'dua të kyçem, por meqë është e re kjo çështja e ndikimit ambiental, janë disa elemente që e bëjnë ndryshimin shumë të madh të gjendjes së tashme me gjendjen e ardhme. Për shembull, kjo teknologjia e re, përpos që është e pastër, pra "Kosova e Re", edhe eficientën e shfrytëzimit të thëngjillit e ka shumë më të lartë, pra me më pak thëngjill prodhon më shumë energji, harxhon më pak thëngjill. Pra, për këtë nevojitet më pak.

Tani, është e vërtetë që minierat e qymyrit s'janë të hijshme, sidomos kur janë edhe afër kryeqytetit, por ne s'mund t'i zhvendosim ato. Pra, s'kemi ku e marrim tjetërkund pos këtu ku janë, e për fat janë afër kryeqytetit. Po ju siguroj që kalimi, ta zëmë nga cilado, ekzistuesja ose nga "A-ja", ose eventualisht edhe nga "B-ja" në të ardhmen, nëse dështon si teknologji, në këtë të rejën nuk është përkeqësim i gjendjes së ambientit dhe ju lutem, ta kini parasysh po bëhet fjalë për teknologjinë më të avancuar që është në treg. Edhe bazuar në këtë është bërë toleranca, pra tolerancën që e kanë bërë edhe institucionet e BE-së në financim, pra formula e financimit është e përbashkët me disa institucione monetare, duke pasur parasysh faktin se është teknologji e pastër.

Pra, këtu është dallimi i madh dhe ju siguroj në këtë që këtu jemi fitues. Faleminderit!

KRYETARI: Haxhi Avdyli prapë e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: E vërteta është që me ngritjen e kapaciteteve teknologjia është më afirmative, më e re dhe ndotja është më e vogël, por të jeni të sigurt kryeministër që ndotja nuk ndalet 100% dhe degradimi i tokës ka për të qenë shumë i madh afër kryeqytetit tonë, ku vetëm mihjet sipërfaqësore do ta kenë një gropë të madhe, do t'i shkatërrojë të gjitha ato urat nëntokësore dhe do t'i shkatërrojë florën e faunën afër kryeqytetit dhe në të njëjtën kohë mund të them që nuk ka teknologji që e ndal në tërësi ndotjen e ambientit dhe nuk e di sa do të jetë kjo kontratë, por do ta ketë atë kontributin për shëndetësinë në Kosovë, sepse impakti shëndetësor i “Kosova e Re”, pa marrë parasysh çfarë teknologjie përdor, do të jetë evident dhe nuk e di sa do të jetë pjesë e kontratës dhe investimi në zbutjen e pasojave të shëndetit të popullatës që jeton përreth këtij termocentrali dhe sa do të krijohen kapacitetet institucioneve shëndetësore, veçanërisht për kontrollimin dhe parandalimin e sëmundjeve, e veçanërisht të sëmundjeve të mushkërive përreth këtij termocentrali dhe kryeqytetit në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri prapë e ka fjalën. Ka minuta, ka në PDK, keni mjaft.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, se ne kemi sot miniera në funksion dhe i kemi këto gropat. Nuk po them që është mirë të vazhdohet me gropat e me minierat, s'ka qenë mirë as me plot gurëthyes, me plot ndërhyrje që kemi bërë në ambient. E kuptoj këtë pjesë. Por, nëse ne kemi rënë dakord në parim të parë që duam të vazhdojmë me energjinë prej qymyrit, disa konsekuenca janë të pashmangshme, ashtu qysh po thonë që s'ka teknologji që e heq krejt qind për qind ndotjen, gjë që është e vërtetë, por prapë nëse duam të shkojmë me qymyr, i ka disa konsekuenca, por s'kemi zgjidhje tjetër. Nuk u bë bash se po na pëlqen veç kjo zgjidhje, po s'kemi zgjidhje tjetër.

Dhe, ajo që është me rëndësi, dhe ju lutem, ta dijë qytetari, se nuk po flasim veç për ne, por ta dijë qytetari ynë, shikoni, dallimi ndërmjet kësaj që po vjen dhe këtyre ekzistuese është shumë i madh. Është i pakrahasueshëm dallimi në pastërti. Këto kanë edhe rikuperim. Pra, pos asaj që ndalet, është edhe një proces i dytë, i cili edhe një herë e rimerr ndotjen, ose e rimban. Koogjenerimi, nuk e përmendëm në fillim, ata që merren me qeverisjen komunale e dinë sa vuajmë ne për ngroje. Kur u fol për ndotjen para disa ditësh të ajrit këtu në Prishtinë dhe që u bë temë e madhe, u identifikuan plot shkaktarë të ndotjes, por njëri nga shkaktarët ishte edhe ngrohja, mënyra e ngrohjes. Po përdoret lëndë e parë për ngrohje, më kanë kritikuar mua, më kanë thënë këtu që ke dhënë qymyr për punëtorët, e Kosova thëngjillit a dikë, e po përdoret. Mos harroni që kjo e reja jep energji të lirë në koogjenerim, më të lirë sesa tash që e kemi dhe jep për krejt komunat përreth Prishtinës, përpos për Prishtinën. Bazuar në këtë, e redukton ndotjen. Pra, ndikon direkt në ndaljen e ndotjes në vend.

Kisha pasur dëshirë, po them edhe një herë që Kosova të ketë veç hidro ose energji alternative çfarëdo, por nuk jemi ata. Dihet që ne e kemi burim të energjisë qymyrin edhe nuk e di si ka për të shkuar e ardhmja, ndoshta vërtet ndalohej krejt qymyri, por ne aktualisht e kemi të bazuar në qymyr, prandaj i ka disa pasoja që vërtet i ka.

KRYETARI: Faleminderit! Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Ne jemi mësuar tash me interpelancë dhe me debate, por kjo interpelancë po më duket se është vërtet e qëlluar, edhe pse janë bërë shumë, kjo është një interpelancë që iniciuesit dhe kërkuesit e saj duhet t'i falënderojmë.

Në interpelancat tjera, në debatet tjera, tema rreth energjisë ka qenë pesë ose gjashtë herë. Disa rreth energjisë, disa i kemi pas rreth ambientit. Dhe, në të gjitha ato debate është kërkuar që Kosova ta ketë një stabilitet energjetik. Po ashtu, e kemi pasur një interpelancë dhe një debat për ambientin. Ky projekt, kjo kontratë së paku i ka dy të mira dhe atë që në vazhdimësi e kemi kërkuar si deputetë. Krijon stabilitet energjetik ose qëndrueshmëri energjetike, që ka qenë kërkesë e kamotshme rrafsh 20 e diçka vjet. Pra, deri më 2023 do të bëhen 25 vjet. Ne për 25 vjet nuk kemi pasur aftësi, as mundësi që ta gjejmë një kontratë më të favorshme. Po ta kishim gjetur, e kishim bërë. Kjo kontratë ndoshta nuk është e favorshme, por sjell stabilitetin energjetik dhe deri më tash nuk kemi pasur më të favorshme.

A do të silltet dikush në të ardhmen, çfarë do të jetë mundësia për një kontratë në të ardhmen, ai është veç një parashikim. Elementi i dytë, me këtë kontratë, shkalla e uljes së ndotjes së ambientit ose ndotjes së ajrit bie. Së paku, bie. Ne e kemi pasur një debat dhe kemi kërkuar metoda, masa për ta ulur shkallën e ndotjes së ajrit. Me këtë kontratë, ajo ndodh. Unë prita që Dardani të na thotë së paku faleminderit për këto dy çështje, për stabilitet energjetik dhe për uljen e ndotjes së ajrit nëpërmjet kësaj kontrate. Dardan, ma ke edhe një obligim, kur është bërë Ligji për Prishtinën më ke thënë që kryeministrin do ta falënderoj publikisht edhe Prishtina u bë me ligj për kryeqytetin. Nuk e ke bërë, nuk po e shoh tash Dardanin nëse është, por e ke obligim ta falënderosh kryeministrin.

Unë po i listoj edhe dy obligime tjera. Faleminderit kryeministër me këtë kontratë që e bën stabilizimin energjetik të Kosovës dhe është një mundësi për ulje të ndotjes së ambientit. Normalisht, çdo zhvillim, çfarëdo industrie, çfarë tha doktori, që do ta rrisë shkallën e ndotjes. Ndotje nuk ka në vendet e pazhvilluara. Mund të mos ketë diku në Afrikë, në ndonjë vend ku nuk ka asnjë zhvillim ekonomik, por çdo zhvillim ekonomik e ka një gradacion të ndotjes. Po, me këtë ndërtim, ne e ulim shkallën e ndotjes së ajrit. Pra, e rritim stabilitetin energjetik, e bëjmë Kosovën stabile në aspektin energjetik dhe e ndotim ajrin. Në treg ke mundur të gjeësh kontrata më të mira, por nuk ka ndodhur deri tash. Ende kurrkush nuk është afruar, në qoftë se ne si

deputetë e dimë që dikush është ofruar me një kontratë më të mirë se kjo, atëherë duhet thirrur në përgjegjësi qeverinë pse s'e ka bërë. Deri tash s'kemi pasur mundësi më të mirë.

Çfarë do të ishin edhe në të ardhmen mundësitë, ne nuk jemi paragjykses. Këtë mundësi e kemi pasur. Në qoftë se dikush mendon që duhet të kalojnë edhe 20 vjet për ta pritur një mundësi më të mirë, atëherë mund të ndodhë sikur çështja e Valës. Vala, para 10 vjetësh, vlera e saj në treg ka qenë 400 milionë euro, sot është 0 euro, ndoshta edhe me minus euro. Kjo mund të ndodhë edhe me termocentralet. Nesër, pasnesër ka mundësi që investimet në termocentrale do të jenë jo të pranueshme dhe ajo është lehtë e mundshme. Prapë, faleminderit që Dardani nuk na ka thënë "faleminderit". Ne e kuptojmë që është në opozitë dhe opozitëbërja e ka pak të vështirë të thotë "Kryeministër, faleminderit! Faleminderit edhe për Ligjin për Prishtinën! Faleminderit edhe për stabilitetin energjetik! Faleminderit edhe për një mundësi për të ulur ndotjen e ajrit në Prishtinë, në Kosovë, e sidomos në Prishtinë!". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Po filloj aty ku e la Kuçi, me faleminderit. Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjuam këtu ne në mes që jemi, sidomos ne që e marrim fjalën të fundit, kemi rastin kështu që nganjëherë të gjendemi në sandviç, se dëgjojmë pikëpamje, pikëvështrime, këndvështrime, analiza nga të dyja anët dhe tamam ta merr mendja që njëri ta mbushi mendjen, kur e dëgjon tjetrin thotë ngadalë - ngadalë se nuk është bash ashtu. Personalisht do të kisha pasur dëshirë që, duke pasur parasysh faktin që KEK-un e kemi organizatë shoqërore, qysh e tha kryeministri, dhe tha që 950 megavat prodhohen në vit nga organizata shoqërore. Do të kisha pasur dëshirë që edhe kjo, jo të fillojë të ndërtohet, por të ishte ndërtuar nga një organizatë po ashtu shoqërore, shtetërore, publike, sido që ta quajmë, në këto 15 vjetët e fundit, por nuk e kemi bërë. Dhe, duhet ta nënvizojmë pikënisjen e debatit të sotëm që nuk e kemi bërë, nuk e kemi ndërtuar, së paku nja 300 megavat për këto 15 vjet, apo po e lëmë 15, por për këto 10 vjet, nga 2008 e këndeje kur është shpallur pavarësia e Kosovës.

Pra, nuk është se dikush na ka ndalë, kemi mundur të ndajmë para nga buxheti që ta ndërtojmë edhe atë. Nuk na nevojiten kapacitete vendore për ndërtim, na nevojiten kapacitete vendore për menaxhim, por jo për ndërtim, sepse vijnë kompanitë, të cilat do t'i angazhojë edhe kjo kompani që e ka lidhur kontratën për ta ndërtuar. Pra, po të kishin shfaqur interes për ta ndërtuar një termocentral me 300, 350, 400, deri tash do të ishte kryer dhe do të ishte harruar dhe do të kishim mundur të shesim, së bashku me KEK-un, Termocentralin "A, B, B1, B2", çka do që janë, do të kishim mundur pastaj ta nxjerrim në treg dhe ta shitnim, por kjo nuk ka ndodhur, e tash jemi para një realiteti tjetër, që e kemi një kontratë për të cilën Qeveria e Kosovës, pjesë e së cilës jam edhe unë si Nismë, e kemi mbështetur. Unë kam disa pyetje, sidomos për këta kolegët, të cilët po përmendin shifra 80 euro për megavat. E kam një pyetje: A është ky çmim 80 euro për 20 vjetët

e ardhshme, apo do të variojë varësisht nga fuqia blerëse e atij 80-euroshi? A do të jetë 80 euro maksimumi, apo 80 euro fillimi? Dhe, dy: Nëse është ashtu, besojmë që fuqia blerëse 80 euro pas 5 vjetëve do të jetë 80 euro? Duke pasur parasysh që në vetvete paraja e humb vlerën, inflacioni 2-3% sa është në vit, devalvimi i çdo monedhe së paku, për aq sa unë kuptoj. Lumiri, po ia përmend emrin, mund të jetë më i mirë në këtë fushë, të na japë shpjegime, dhe tjetra, që desha të pyes: A besoni vërtet që duke pasur parasysh rritjen e nevojave të energjisë në treg, jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë, si produkt i pashmangshëm në ekonominë e secilit vend do të shkojë duke u zhvlerësuar produkti si vlerë? A vërtet besojmë që ne do të prodhojmë aq shumë sa nuk do të mund ta shesim? Dhe, a besojmë që në 10 vjetët e ardhshme, unë s'besoj, por a beson dikush në 10 vjetët e ardhshme Kosovës do t'i teprojnë 1 300 megavat që po i prodhuaka, 900 tash edhe këto 500, diku 1 300 - 1 400?

E kemi parasysh që ekonomia jonë ende nuk është ekonomi as industriale, as shumë prodhuese, është kryesisht konsumuese dhe tregtare. A vërtet mendojmë që do të na mjaftojnë këto? Besoj që të gjithë e dimë që nuk do të na mjaftojnë fare këto kapacitete, të cilat po besojmë që do t'i gjenerojnë A-ja, B-ja dhe kjo e reja. Unë, duke marrë parasysh atë që thashë, edhe po shtroj pyetje, kisha pasur dëshirë dikush që merr vesh më shumë të përgjigjet, por unë nuk besoj që pas 4-5 vjetëve kur të fillojë të prodhohet kjo energji, këto 80 euro do të jenë vlera apo fuqia blerëse që e ka sot. Pra, të mos e shikojmë, ndoshta gaboj, por unë kështu e shoh, atë fuqinë blerëse 80 euro edhe pas 5 vjetëve, e aq më pak pas 10 apo 15 vjetëve.

Do të shkojë duke u ngritur standardi, do të shkojë duke u rritur zhvillimi i ekonomisë, do ta kemi një produkt për të cilin, edhe nëse nuk kemi ndonjëherë nevojë, do të mund ta shesim, sepse sigurisht, ama pa dyshim, jo vetëm që do të ketë nevojë, por do të ketë një mungesë të këtij produkti në tregun e energjetikës.

Nëse bëjmë analiza me ofertat dhe kërkesat që sot janë në treg për pas 10 vjetëve, mendoj që e bëjmë një gabim elementar, se patëm sot mundësi të dëgjojmë edhe ligjërata elementare. Por, po them që nuk jemi më për alternativën a ta ndërtojmë vetë apo të vazhdojmë me ndërtimin e kësaj. Jemi para një alternative që të vazhdojmë ta ndërtojmë dhe të mos e humbim shansin e fundit për të filluar me ndërtimin e saj, apo ta ndalim këtë dhe përfundimisht të varemi vetëm nga blerja, vetëm nga importi i këtij produkti.

Unë do ta mbështesja atë që tha zoti Memli Krasniqi se jemi para një alternative të shkojmë drejt kolapsit, apo të fillojmë të ndërtojmë diçka. Prandaj, do të vazhdoj t'i jap mbështetje këtij projekti me të gjitha ato defekte, me të gjitha ato vështirësi të cilat edhe kryeministri dhe kolegët i thanë. Natyrisht që dilemat, siç e thashë në fillim, a ka qenë më mirë t'i ndërtojmë vetë apo nëpërmjet këtij projekti, unë i kam pasur të qarta. Që në fillim kam pasur dëshirë të ndërtohet, por druaj se më nuk jemi para një alternative të tillë. Në përgjithësi, vendi ynë, jo veç tash, por edhe në katër vjetët e ardhshme, deri sa të fillojë të ndërtohet ky termocentral, do të ketë nevojë

të madhe për energji dhe të fillojmë të shqetësohemi për atë energji për të cilën nesër mund të mos na e prodhojnë termocentralet aktuale në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Na kanë mbetur shumë pak minuta, kështu që do të mundohem ta shkurttoj dhe të mos them shumë çështje, por vetëm disa përbrenda minutave që i kam.

E para, marrëveshja me Contour Global, përveçse financiarisht është shumë e disfavorshme për Kosovën, përmban edhe shkelje serioze. Një nga shkeljet ligjore është ajo për shitjen e tokës për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”. Në marrëveshjen për transferin e tokës, për ndërtimin e termocentralit ndërmjet Contour Global dhe KEK-ut, përkatësisht në pikën 3.1 të nenit 3 të marrëveshjes thuhet se “KEK-u do ta shesë tokën prej disa hektarëve për vetëm 10 euro”. Çmimi prej 10 eurosh, edhe pse spikat si i çuditshëm, nuk është problemi i vetëm i kësaj marrëveshje.

Së pari, asnjë ligj i aplikueshëm në Kosovë nuk parasheh procedurë tjetër të transferimit të një prone shtetërore ose publike përveç me privatizim ose koncesionim, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Në anën tjetër, Ligji për investime strategjike, neni 22, pika 2 thotë shprehimisht: “Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës”. Por, po ashtu ky ligj specifikon se mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të ndërmarrjeve publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike do të rregullohet me aktet nënligjore, të cilat do të nxirren në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e ligjit përkatës për ndërmarrjet publike.

Po ashtu, është shkelje e Kushtetutës, sepse edhe Kushtetuta në nenin 121, paragrafi 2 dhe 3 e definojnë që nuk mund të mundësohet në këtë mënyrë të jepet toka, të shfrytëzohet toka.

Zoti kryeministër,

Kosova A, nëse nuk fillon rindërtimin këtë vit, bie. Kosova B duhet të shkojë në remont këtë vit, sepse po punon në kapacitet të sforcuar dhe do të bjerë nëse nuk futet në remont. Po ashtu, ky projekt fillon nga puna tek në vitin 2023 dhe pikërisht është ky projekt që na çon te blerja e energjisë nga Serbia. Contour Global duhet të njoftohet se kjo kontratë nuk vlen dhe garancinë për kredinë që e kërkoni, pra 2/3 nuk keni për ta marrë kurrë. Kurrë nuk keni për ta marrë!

Ne duam ta ndërtojmë, por me pronësi publike. Pa Kosovën A dhe me Kosovën B duke çaluar, vetëm përfytyrojemi një dimër, bie Blloku 1 i Kosovës B, Kosova A është e mbyllur, vetëm 2 qytete do të kenë drita. Ujësjellësi nuk do të punojë, pra s’do të ketë ujë, sepse funksionon me

energji elektrike, as spitalet. Pra, ju zoti kryeministër, nuk keni legjitimitet për marrëveshje të tilla, i keni vetëm 52 numra. Andaj, edhe kjo marrëveshje duhet të zhbëhet sa më parë.

KRYETARI: Bëni gajret njëri grup, jepjani edhe disa minuta... Kryeministër...!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A ta lë, nëse s'është korrekte? Në rregull jemi! Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj, jemi duke u afruar nga fundi i kësaj pike të rendit të ditës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

KRYETARI: Kemi probleme me energjinë elektrike, po lëviz...

ARMEND ZEMAJ: S'ka problem, kam minuta mjaftueshëm, kështu që edhe po të ndërpritet, e rikthej prapë fjalimin.

Kolegë deputetë,

Kryeministër,

Edhe nga kërkesa e interpelancës, sigurisht që interesimi i deputetëve besoj që është në logjikën e kërkesës së votës, duke marrë parasysh ajo që u përmend këtu, që garancia për sovranitetin do të kërkohet nga 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Unë i përgatita disa pyetje, duke menduar që ndoshta mund të marrim përgjigje për të krijuar, jo vetëm besimin për të votuar diçka që është në interes të qytetarëve të vendit, por për ta zgjidhur një problem, i cili që nga paslufta është një ndër më të njohurit - mungesa e energjisë elektrike, e qytetarët e vendit ballafaqohen me sfida të tilla. Ndërsa, nga debati që dëgjojmë sot, qoftë edhe mundësia për ta ndërtuar "Kosovën e Re" tash me këtë kontratë, na vë në një pozitë të disfavorshme të mendimit tonë duke marrë parasysh atë që u tha sot, jo atë që e kisha mendim të ngre si pyetje dhe t'ua drejtoj juve. E para është mungesa e njerëzve të Kabinetit tuaj, të cilët në mënyrë publike dukeshin bukur atë ditë kur u nënshkrua kontrata, të vizatuar përreth kryeministrit dhe kontraktuesit, ndërsa sot Komisioni Ndërministror mungon këtu për të dhënë shpjegimet e duhura, mbi të gjitha profesionale, për t'i bindur deputetët e Republikës së Kosovës se dyshimet që i ngriti në mënyrë shumë profesionale kolegu Dardan Sejdiu mund të jenë në logjikën e zgjidhjes së këtij problemi dhe afrimit me interesin që kanë qytetarët e vendit dhe grupet politike.

Pse po e përmend këtë, është se:

E para, nëse ndërpritet ky projekt, e thanë me lehtësi kolegët, për mendimin tim, fatkeqësisht, ne i humbim 19, ose 22 milionë. Kjo duket sikur është rutinë tashmë në Republikën e Kosovës. Pesë

milionë sot i kemi paguar për dëmin e atij tenderit kriminal të pasaportave, tash po kërkohet se mund të ketë edhe pagesë prej 22 milionë nëse e shkëpusim këtë kontratë, 64 milionë Behtel&Enkës, ndërsa u nënshkrua kontrata për ndërtimin e spitalit të Ferizajit 10 milionë. Kështu që, qytetarët e Kosovës po ndëshkohen me gabimet dhe me dyshimet që ne kemi rreth mundësive zhvillimore apo të investimeve edhe nga jashtë.

E dyta, ajo çka dëgjuam sot, po dal në pozitën e qytetarit, është se duket që ne po ndërtojmë termocentral për Serbinë në njërën anë, në anën tjetër duket se po ndërtojmë termocentral për ta luftuar Serbinë. Kështu po banalizohet debati, më vjen keq se s'është Liburni këtu, por krejt logjika e temës duket se ngërthen në vete që Serbia është pronare e këtij termocentrali apo edhe e këtij biznesi.

Andaj këto paragjykime duhet të elaborohen ashtu siç i elaboroi kolegu Dardan Sejdiu me argumente, e ka bindjen, bindëse dhe anën tjetër të arsyetohen nga Qeveria pse e ka nënshkruar këtë kontratë dhe pse dëshiron ta avancojë këtë kontratë. Sepse, pyetja është shumë logjike. KEK-u, thanë, prodhon 900 MW, ndërsa ne tërë kohën regjione të tëra në Republikën e Kosovës kanë mungesë të energjisë elektrike. Ne para ca kohësh debatuaam këtu në Kuvendin e Kosovës, kemi pasur interpelancë, për mungesë të energjisë elektrike. Thuhet se ka mjaft energji në rajon, domethënë të akumuluar, ka energji të mjaftueshme dhe Kosova nuk ka energji. Këto janë pyetje që mendoj se shqetësojnë edhe deputetët edhe ju si Kabinet qeveritar.

Unë e kam një pyetje për ta përfunduar, sepse më shumë i dhatë amulli këtij procesi, se sa i dhatë zgjidhje, për mendimin tim personal, mund të jem edhe i gabuar. Do të kërkoj informata shtesë për ta bindur edhe veten, sigurisht edhe përmes njerëzve që kanë punuar, që sot janë në grupin tim politik. Dyshimet që ne po lidhemi disi për këto marrëveshje dhe po e shikojmë mundësinë, në njërën anë të shkëputemi kur përfiton një grup i caktuar, në tjetrën anë me shpresë që nëse shkëputet ne do të përfitojmë, Republika e Kosovës do të përfitojë.

Mua më intereson interesi publik, interesi i përgjithshëm i qytetarëve dhe garancia që i japim këtij procesi. A mund ju të na garantoni fazën kur bëhet kjo pronësi e Republikës së Kosovës? Cila është kostoja dhe së paku në këtë fazë prej 40 vjetësh që do të funksionojë kjo, cili është përfitimi i qytetarëve të vendit në total? Domethënë, një parashikim që nuk kërkon ndonjë matematikë të rëndë për ta ditur interesin tonë, po flas në fund të fundit edhe si qytetar i këtij vendi.

Ndërsa për fund, po e përmbyll, me të vërtetë është e paarsyeshme, ku së paku ministri i Zhvillimit Ekonomik nuk është i pranishëm këtu, as ministri i Financave. Ne po flasim për kosto, po flasim për kushte të tenderimit, po flasim për subvencione, po flasim për marrjen e kredive, dikush tha “kurrë s’kemi me marrë”, unë nuk them kurrë s’kemi me e marrë, sepse kanë mbetur

që e kanë mbështetur Kosovën dhe vazhdojnë edhe atëherë kur gabojmë të na këshillojnë dhe të na mbështesin.

Për të mos ardhur deri te një konkluzion i tillë përfundimtar, unë besoj se çdo deputet i Kuvendit të Kosovës ka nevojë për këto informacione, për të mos e dhënë votën blanko apo për të mos e bllokuar një proces që mund të jetë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala e kryeministrit dhe Ilir Deda është në fund.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar zoti Zemaj,

Shiko, unë në kapacitetin tim më të mirë u mundova t'i shpjegoj ato që m'u lejuan në atmosferën që u krijua në Kuvend dhe në qëndrimet që u paraqitën.

Të ju them të drejtën, materiale me shkrim, të dhëna të tjera kemi shumë. disa prej tyre ne edhe i kemi ndarë me subjektin politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, meqenëse në atë komitetin që ju e çekët ka marrë pjesë LDK-ja në vazhdimësi dhe e ka ditur gjendjen finale të kësaj marrëveshjeje para nënshkrimit, kuptohet edhe pas nënshkrimit. Jemi konsultuar me vendimmarrësit në LDK për shkak se përpunimi i kësaj marrëveshjeje, ju thash edhe një herë, janë disa gjenerata qeverisëse. Unë e kam gjetur këtë edhe ju siguroj se edhe vet personalisht jam interesuar për ta marrë dakordimin, se a jam në rregull nëse shkoj kësaj rruge, prej subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, vendimmarrësve, ata që kanë qenë të kyçur edhe vendimmarrësve politikë.

Pse e kam bërë këtë edhe pse po e çek? Shikoni, ne... matematikat janë edhe me çka e krahasojmë, se unë nuk fola ndonjëherë edhe asnjëherë s'po dua t'i ik gjendjes reale se çka kemi arritur ne. Por, krahasimi ose alternativa e kësaj marrëveshje është për të mbetur me kapacitetet që kemi, se ne s'kemi pasur oferta tjera në tavolinë e me thënë "a ta marrim Contour Globalit apo të dikujt tjetër". Nuk ka pasur, vetëm një ka qenë edhe ajo mezi, edhe ajo ndoshta në tërheqja a ku di unë çka.

E vërteta është kjo. Sikur t'i kishim gjetur dy a tri, do ta kishim krahasuar cila është më e mirë, por nuk kemi pasur ofertë tjetër. Dhe, po mos ta bënim këtë, çka ishte alternativa? Të mbesim me këto të vjetrat që i kemi, A-në dhe B-në, të cilat janë të kushtueshme për t'i mbajtur, besa ta rrisin çmimin shumë më shumë, se sa çdo formulë tjetër dhe nuk janë të pastra, siç e dimë, dhe ka probleme tjera.

Duke qenë se është këtu unë ju lus si deputetë, të shihni në perspektivë tjetër, mos e shihni këtë në kuadër të përditshmërisë të pozitarizmit e të opozitarizmit. Ju them se ky projekt vërtet është një projekt i disa brezave qeverisës dhe është në interes të vendit edhe parametrat financiarë

tregojnë që përpos që krijojmë qëndrueshmëri të furnizimit me energji e që është e vendit, që është e prodhuar këtu, që krijojnë implikime pozitive ekonomike, megjithatë po them edhe një herë, i jep Kosovës edhe një situatë të re në planin makroekonomik, se kemi sjellë investitorë të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Kryeministër,

Kjo ndër debatet e pakta në Kuvend, të cilat duhet të jenë përjashtuese ndaj demagogjisë, populizmit dhe budallallaqëve të tjera, që i dëgjojmë këtu, duhet të jetë ky diskutim, sepse kemi për ta votuar me 2/3-at dhe ka shumë paqartësi.

Deri tash ende nuk është sqaruar shumë. Po dua ta falënderoj Dardan Sejdiun, që e ka marrë këtë iniciativë, e që e filloi në mënyrë shumë të saktë. Domethënë, ai po flet me shifra, me të dhëna, të cilat unë s'pres që ti t'i kundërpërgjigjesh, por ministrat përgjegjës të Qeverisë do të duhej të ishin këtu e të japin përgjigje.

Tash, në Kosovë prej vitit 2003 ne e dimë që nuk ekziston kurrfarë... ne nuk kemi dakordancë se si duhet të zhvillohet energjetika e Kosovës. A duhet ta zhvillojmë vet, a duhet të vijë një fond investiv, a duhet të lidhemi me kompani që e kanë atë ekspertizë nga Perëndimi, ne fare s'jemi marrë vesh. Ky debat faktikisht është duke ardhur kah përfundimi me një vendim që do ta marrë Kuvendi, kur Qeveria më në fund e sjell për ratifikim marrëveshjen me Contour Global.

Po, mua çfarë më vjen keq, është që kurrë s'jeni konsultuar me ekspertët në Kosovë, me brezin e parë të inxhinierëve në Kosovë, të cilët bashkë me gjermanët në ndërtimin e strategjisë energjetike të Kosovës, prej viteve të '70-ta, '80-ta, e tjera... Jo vetëm ju, po as Qeveria paraprake e as ajo paraprake, nuk jeni ulur me njerëz që sot janë në pension. Brezi i parë i inxhinierëve, të cilët ju tregojnë qysh ka qenë një vizion, edhe me kosto, edhe si ec kjo punë, që Kosova ta ketë pavarësinë e vet energjetike, ekspertizën e vet, që është shkatërruar në këto 20 vjet, a po? Ne s'kemi më inxhinierë, prandaj s'mund ta ndërtojmë vet, se i kemi shkatërruar në këto 20 vjet.

E tash, i kam tri pyetje:

E para: Të lutem, kryeministër, ma sqaro pse duhet fondi investiv të vijë ta ndërtojë Kosovën C? Fond investiv "Hajj Fund". Pse duhet Hajj Fund të vijë e të marrë pjesë në këtë punë?

E dyta: Sa kushton përnjëmend? Sa do të na kushtojë në të ardhmen?

Bechteli na ka kushtuar 2 miliardë euro, Bechtel&Enka, e sytë donim t'ia nxirrnim njëri tjetrit, pse Behteli të vijë të na ndërtojë rrugë të shtrenjta. Qe, sa ka me kushtua? A është 4 miliardë e gjysmë, siç po thotë Dardan Sejdiu? Sa është që i kushton Kosovës dhe qytetarëve tanë në të ardhmen, pas dhjetë vjetëve.

Edhe e treta, për të garantuar që ky shtet yni do të ketë inxhinierë të vetët ende, a ekziston strategjia për arsim të këtyre njerëzve apo jo? Ja, këto tri pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju! Nëse dëshironi, nuk është obligative.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje!

E para, me thënë që s'ka pasur konsulta, Ilir, nuk qëndron. Përmbi 20 vjet u bënë konsulta, debate e diskutime, intelektualë, ekspertë e grupe, besa kemi paguar edhe konsultime të jashtme ne si Kosovë.

Janë fajle e fajle, dokumente të gjetura, ekspertiza të punuara, s'ta merr mendja sa ka. Veç ndoshta ne s'kemi qenë fort të lidhur me këtë temë deri tash e s'na ka rënë t'i shqyrtojmë ato, po sa konsulenca e sa konsulta s'ta merr mendja. Para të mëdha janë harxhuar, të vendit e të jashtëm, ekspertë të rinj e të vjetër, plot i ke pasur të kyçur në këto tema. Të sigurt e ke. Ndonjëherë ta bëj listën se kush ka qenë i kyçur. Plot të Kosovës e të jashtëm, ndoshta jo bash çdonjëri i këtij vendi, po shumë.

Tjetra është, shikoni sa kushton, 1 miliardë e 300 milionë, asnjë cent i Kosovës. E kuptoni këtë? Domethënë, hiç mos i hyni kalkulimit tjetër. 1 miliardë e 300 milionë dollarë, asnjë cent i Kosovës. Veç garanci japim për investime. Kaq është. S'ka tjetër matematikë. Nëse e gjeni diku, më tregoni se unë s'po di që është.

E dyta, nëse doni bash të dhëna, kush është interesuar krejt kontrata, hera e parë në histori tonë, është bërë publike. S'ua kemi fshehur asnjë faqe, asnjë rresht. E di që është bërë kontrata publike. Çka po dua të them me këtë?

Shikoni, më së pari, po ju them edhe një herë, nuk është krijuar ky rezultat në këtë kohë. Janë dhjetë vjet punë, është finalizuar, ka ardhur në këtë finale. Po të mos ishte mbyllur para fundit të atij viti, ishte dashur me e lënë krejt, s'do të kishit ju nevojë ta rrëzoni se do të rrëzohej vet, s'do të hynte hiç në punë. E kemi zënë momentin, e kemi kryer.

Ju lutem, të dhëna e numra sa të doni, qe edhe këtu me vete i kam plot, ju japim, por këtij fakti s'mund t'i ikë kurrkush, as ata... Më së pari, unë s'jam duke e lavdëruar, që e kam krijuar vetë a s'e kam krijuar vetë këtë opsion, as të energjisë, as të investimeve, por jam duke e lavdëruar se

është mirë për vendin tim. E kanë krijuar para meje disa që sot s'janë aty, po ata e kanë krijuar, ata e kanë bërë.

Çfarë po dua të ju them? Nëse s'ka investim edhe të kësaj kostoje, që kostoja po e ka koston e vet të investimit, nuk është falas, s'ka investim falas në Botë, nuk e di që ka diku. Por, nëse s'e bëjmë këtë kosto, mbesim me A-në tonë, me B-në tonë, të lodhura. Nuk e dimë deri kur e si, dimrin tjetër sërish s'do të kemi rrymë, sërish do të duhet të importojmë. U tha, a është për fqinjin a kundër fqinjit? Unë as s'jam duke punuar për fqinjin, as s'jam kundër fqinjit. Jam duke punuar për vete. Po, nëse ne nuk prodhojmë në Kosovë do të blejmë te fqinji, paratë do t'i çojmë atje, dihet kjo punë, është e pastër.

Me këtë investim ne sigurojmë qëndrueshmëri të furnizimit me energji, është energji vendore, aktivizojmë resurset tona dhe e shtimë veten në treg investiv, hyjmë në hartë diku na kap radari, se vjen dikush. Këto janë numrat që po ju jap, të parët. Numrat tjerë krejt i keni transparentë, pra kush investon, cili fond, cili... qysh bashkohen këto para, Banka Botërore, ky, ai... Unë s'kam menduar që është detyrë imja sot që t'i jap këto, se i keni në ato elementet e kontratës, i gjeni, shihni ato me radhë të gjitha edhe mundemi edhe një ditë të organizojmë edhe një shpjegim të posaçëm prej ministrit të Financave a prej Valdrinit, por jam i autorizuar edhe prej atyre sot, ma kanë besuar, më kanë thënë, po të lëmë ty sot të përballesh. Valdrini është në një detyrë në Vjenë, i financave shkoi me punë tjera, nuk ndenjëm të gjithë këtu.

Ju lutem, kur vjen për 2/3-at mos e bëni gabimin e mos me e përkrahë këtë investim. Nuk është i Ramush Haradinajt, as i kësaj Qeverie, është i juaji, i fëmijëve tuaj, i furnizimit me energji. Mos e bëni këtë gabim!

Do të keni raste të tjera që t'ia paguani, ose t'ia dërgoni faturën Qeverisë “së keqe” e “të poshtër”, po mos ia dërgoni me këtë, se me këtë faturë ia dërgoni fëmijëve tuaj, të gjithë.

KRYETARI: Ilir, urdhëro!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Kryeministër,

Unë thashë, hajt pa demagogji e konkret të flasim.

Domethënë, unë s'po them se duhet të blejmë rrymë prej tjetërkujt, unë mendoj që ne është dashur të eksportojmë deri tash, po ja që s'kemi eksportuar për shkak të atyre sekserëve, që po thua ti, të cilët e kanë parë më të leverdishme me ble rrymë të shtrenjtë prej Serbisë e prej vendeve tjera, prej kujtdo që kanë blerë. Po, mua prapë nuk mu përgjigje. Domethënë, mihjen e re që do ta ndërtojmë a nuk i kushton ajo Kosovës a? Shpronësimi a nuk i kushton Kosovës, a?

Garantimi i blerjes së rrymës a nuk i kushton Kosovës a? Domethënë, nuk është 1,3 miliard dollarë, është pak më shumë, a po? Eh, nëse është më shumë, sa është më shumë? Sa është? Po, ju duhet të tregoni.

Jo, ti the 1,3 miliard dollarë. Ti po thua 1,3 miliard dollarë. Thuaje sa është totali në fund, me mihje, me shpronësim, me krejt, kur të ndërtohet. Ta dimë edhe në fund a do të eksportojmë ne rrymë me këtë, apo duhet ta blejmë ne qytetarët tonë, siç po thotë ZRRE-ja, e cila po më vjen shumë keq, ka ekspertizë. Ti s'po i beson, disa të tjerë i besojmë. Jo që po duam t'i besojmë që është e keqe, po i besojmë, se po të thotë me shifra një agjenci shtetërore, që ka me na kushtua. Në rregull bre, thuaj, nëse nuk e bëjmë këtë do të na kushtojë krejt. Po, nuk është kjo "mos i bëni dëm Kosovës duke mos e votuar", duhet më seriozisht të bëhen këto punë, se në fund do të na "e hanë" njerëzit kryet të gjithëve pas dhjetë vjetëve, kur t'u vijë fatura e rrymës.

Unë s'jam duke dashur, as me demagogji, as me popullizëm, konkretisht po pyes, sa do të kushtojë?

KRYETARI: Kryeministër, prapë. Vetëm një paralajmërim të vogël, se më duket e kemi njëfarë pritjeje, në qoftë se dëshironi të shkoni.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ti Ilir, që akuzove për demagogji, nëse çka po flas unë të është dukur demagogji, nuk mendoj që është krejt ashtu.

Edhe, pse po them ashtu? Shikoni, veç ta pastrojmë edhe një herë, edhe sa herë të doni. 1,3 është kostoja e investimit. Miniera është e Kosovës dhe ka qindra milionë, s'e kemi bërë studimin final. Ne e kemi një minierë, prej ekzistueses, e cila mund të japë qymyr Kosovës së re edhe dhjetë vjet, po prapë qare s'kemi pas dhjetë vjetësh pa e hapur një. Që të kemi qymyr pas dhjetë vjetëve pa të renë hiç, duhet me ia nisë tash, se t'i merr nja 3-4 vjet. Pra, shiheni! Hiç s'është kosto e Kosovës së Re, po është kosto. Për të prodhuar energji me qymyr duhet me pas minierë, duhet me e qelë, nëse duam. Nëse s'duam, po e lëmë, po prodhojmë prej ndonjë burimi të tretë, që s'e kemi.

Tjetra është, që po ju them edhe një herë, edhe po ua përsëris shumë herë. Ka kosto që kjo ka obligime, nuk është falas ky investim, por po e pyes secilin prej jush. Merreni A-në dhe B-në, nuk e jep totalin e energjisë, pra kemi mungesë energjie, kemi mungesë. Edhe nëse është kjo e lirë, prapë s'mjafton, se s'kemi mjaftueshëm. Rinovoje, riparoje, bëni çfarë të duash këto të tria, prapë s'ke për të pasur boll. Alternativa është, energjia alternative, po. Edhe jemi duke shkuar në atë drejtim se na nevojitet edhe ajo, por nuk mund të prodhosh energji të lirë ti, 30 a 35, qysh po supozohet këtu edhe ta ruash çmimin qysh e ke sot, se këto i ke të tjetra, s'ke qare pa shti para, ose prej tarifës, ose prej buxhetit. S'ka rrugë tjetër. Po të ketë, ma gjeni një alternativë, po jua pranoj sot.

Nuk është gjetur deri sot. Domethënë, për 20 vjet të qeverisjes në Kosovë nuk është gjetur. E vetmja alternativë që është gjetur për 20 vjet prej '99-tës, 18 a sa janë bërë, veç kjo të ka mbetur në tavolinë. Këtë e ke. Këtë e ke kontribut të krejt atyre që kanë punuar që të mos mbetemi edhe pa këtë kapacitet. Jemi nisur për 2 000, për 1 000, për asi, për kësi... kemi përfunduar në 500.

Shikoni, nëse doni të hyjmë në diskutime të tjera, ne edhe mund, por elementet janë kështu, përmbajtjesore janë. 1,3 është, e ka koston e vet, 70%. E ke Avdullahun këtu, t'i shpjegon më mirë po të çohet tash. Të sigurt e ke, e di si janë marrë, e di koston e investimit, 70% e ka nën 7% e ka koston e interesit, 300 milionë, pra rreth 30% e kësaj kredie e ka koston më të lartë, që ta rritë ty edhe koston e investimit. Kjo është gjendja.

Për këtë arsye, kur po flasim për aprovim të 2/3-ve, mos e bëni gabimin, ju lutem, kur të vijë ajo ditë, se nuk është demagogji kërkesa. Përkraheni këtë projekt, se është interes ekonomik i vendit tuaj, i fëmijëve tuaj.

KRYETARI: Faleminderit! Më duhet një konsultim, se duhet marrë vendimmarrje, edhe pse nuk ka kuorum, unë e marr vendimin, vetëm se e dëshiroj qëndrimin e juaj. Kemi dy mundësi: me e ndërpre tash, ose me vazhdua, po pastaj e vazhdojmë... Jo, se zoti kryetar, e kemi në 18:30 pritje zyrtare, në qoftë se shkojmë. Kjo prioritet për mua është Kuvendi. unë pavarësisht se jam i ftuar, por e pashë se edhe nënkryetarja e Kuvendit edhe atë kur e pyeta për vazhdimin e seancës, po ashtu ka gatishmëri të shkojë atje. Kështu që, nuk ka kush e vazhdon seancën. Në rrethana, në qoftë se ju insistoni, atëherë e vazhdojmë, por nuk lëvizim nga kjo, derisa t'i përfundojmë të gjitha pikat edhe interpelancën tjetër.

Kjo është se duhet të marrim qëndrim tani, se i kemi punët në 18:30 është ftesa. Në fund të fundit, e vazhdojmë, si të dëshironi ju. Duhet t'i kërkoj falje publike, e kam mundësi dhe ia urojmë shtetit mik Italian Ditën e Pavarësisë.

Avdullah Hoti, që ta kemi një qëndrim, a e vazhdojmë sot, nëse vazhdojmë a mos të ndalemi apo dëshironi të shkoni menjëherë në pauzë, po nesër vazhdohet prej... duhet me e përcaktua edhe kohën kur e vazhdojmë. Në 10:00, ose në 13:00. Në 10:00 duhet të jetë një nga nënkryetarët, se unë nuk do të jem në 10:00, në orën 13:00 jam unë.

Urdhëro, zoti Hoti, veç me e pas parasysh.

AVDULLAH HOTI: Po duket se ka dakordim, që nesër në orën 13:00 të vazhdohet kjo seancë dhe ta përmbyllim edhe me debatet e tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Unë personalisht jam për ta vazhduar seancën sonte, por shumica e deputetëve që përfaqësoj janë për ta vazhduar nesër në orën 13:00.

KRYETARI: Lëvizja Vetëvendosje, zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Ne jemi që seanca të vazhdojë nesër, por në orën 10:00. Nëse ju s'jeni këtu, atëherë ndonjëri nga nënkryetarët do të mund që ta drejtojë seancën, sepse kemi shumë pika dhe në qoftë se ne fillojmë në orën 13:00 prapë s'do të mund ta përmbyllim seancën dhe debatet, për të cilat jemi dakorduar.

KRYETARI: Po, i kemi shtatë orë, duhet t'i përfundojmë. Deri në orën 20:00 qëndrojmë. Ju e vendosni për orën, unë vetëm korrektësinë time e tregova, që s'mund të jem në orën 10:00. Partia Socialdemokrate?

DARDAN SEJDIU: Unë jam që ne të vazhdojmë punët. Nuk mendoj që kemi ndonjë arsye që si Kuvend të mos jemi në gjendje të vazhdojmë punimet. Në anën tjetër, nëse shumica e Kuvendit është që të vazhdojë seanca nesër, vazhdojmë nesër.

Për mua ora 10:00 është në rregull.

KRYETARI: AAK-ja, Muharrem Nitaj?

MUHARREM NITAJ: Kryetar!

Disponim i deputetëve është që të vazhdohet nesër në orën 13:00 me seancën e radhës.

KRYETARI: Nisma, ju lutem Bilall Sherifi!

BILALL SHERIFI: Vazhdojmë sipas vullnetit të shumicës, nesër në orën 13:00.

KRYETARI: Atëherë, vazhdon seanca në orën 13:00. Faleminderit! Në orën 13:00 vazhdojmë këtu ku kemi mbetur me pikat, të cilat i kemi në pritje.

* * *

E premte, 1 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18, 26 prill dhe 31 maj 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në sallë aktualisht 47 deputetë janë. Me lejen e deputetëve mund të arrijmë kuorumin, kemi mysafirë të veçantë, i sjellim prej së larti, janë fëmijët e Kosovës.

(Duartrokitje)

I përshëndes edhe i falënderoj për pjesëmarrjen e tyre sot, në të njëjtën kohë në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit ju uroj Ditën tuaj, paçi jetë të lumtur, të gëzuar dhe të mësoni shumë, ta doni Kosovën. Faleminderit!

Një nxënës na e ka lënë një fletore, unë do ta lexoj, në njërën nga shkresat e tij e paska edhe një vjershë:

“Shkronja P është vetë PAJTIMI,
që nga fundi dhe fillimi,
pesë e bukur në ditar,
për ty ndihem shumë krenar!”

Për ju ndihemi krenarë, fëmijë të Kosovës, urime! Faleminderit!

Po e vazhdojmë seancën, të keni parasysh gjuhën, fëmijët i kemi në sallë.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare. I kemi disa votime, të cilat po i tejkaloj menjëherë, pikat 1, 6 dhe 7. 58 deputetë janë aktualisht në sallë, na duhen edhe tre deputetë.

Zoti Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Me sa ditë unë, sot është vazhdimi i seancës dhe asnjë vazhdim i seancë nuk kërkon kuorum.

KRYETARI: Jo, jo, nuk ka nevojë për kuorum, po a të futemi në votim, i kemi tri çështje të mbetura, mendova se janë 61 deputetë në ambiente të Kuvendit që të futemi në votim, ose të vazhdojmë te çështja e Contour Globalit, a mund ta konsiderojmë se çështja e diskutimeve ka

përfunduar, tani jemi vetëm në votimin e rekomandimeve. Po, po edhe për këtë duhen 61 deputetë. A i kemi 61? Po!

Atëherë kisha ftuar propozuesin e projekt-rezolutës, zotin Dardan Sejdiu, që ta sjellë projekt-rezolutën, në vazhdim të seancës jemi.

Është herë e parë që administrata s'i ka specifikuar, po mirë e keni. Kërkoj falje, mund të jetë gabimi im, se po reagon administrata.

Jemi në vazhdim të seancës së djeshme, kur futemi në çdo pikë, megjithatë nuk ka gabuar administrata se kur futemi në çdo pikë, unë për secilën pikë para se ta vej në votim e përcaktoj, e kanë shkruar, për shembull, Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës të mbajtur më 20 prill, votohet tash, përcaktohet saktë. Po nuk jemi futur ende në këtë pjesë.

Dardan Sejdiu e ka fjalën për vazhdimin e seancës së djeshme. Urdhëro, zoti Sejdiu, fjala për ju!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Media të dashura,

Dje në interpelancë, të cilën po e vazhdojmë sot, u mundova të tregoj një konstrukt financiar ekonomik e energjetik, i cili nëse vazhdohet në këtë modelim dhe me këto kontura, do të sjellë implikime të jashtëzakonshme edhe ekonomike, edhe buxhetore, edhe energjetike, implikime të jashtëzakonshme negative.

Po e ripërsëris, kostoja e ndërtimit të këtij termocentrali është larg numrit që pretendohet, pra nuk është 1.3 miliardë euro, është shumë më shumë.

Çmimi i synuar prej 80 eurove për megavat orë është çmim i cili është i synuar, pra nuk është çmim tavan, por mbi këtë çmim do të vendosen edhe kostoja e transmisionit, edhe kostoja e distribucionit, edhe kostoja e balancimit energjetik, edhe kosto të tjera, të cilat lidhen me shpërndarjen e kësaj rryme.

Për më shumë, ky dokument, kjo kontratë e nënshkruar kërkon nga ne si Kuvend t'i garantojmë cilësitë e qymyrit, cilësitë e ujit, t'i garantojmë çmim për 20 vjetët e ardhshme dhe të gjitha këto, më pastaj t'i bartim me anë të një ndërmarrjeje të re publike, një ndërmarrje e cila veç një detyrë e ka, të blejë energjinë që e prodhon Contour Global, ta blej me çmim 80 euro për megavat orë dhe këtë çmim më pastaj ta plasojë në treg. Por ky çmim është në shpërputhje me çmimin e tregut, sepse është për 30 euro së paku më i lartë dhe këtë diferencë prej 30 eurove për 450

megavatë orë energji elektrike duhet ta paguajmë ne si qytetarë. Këtë pagesë do ta bëjmë qoftë nëpërmjet faturave, qoftë nëpërmes taksave tona në buxhet të Republikës.

Edhe Instituti GAP, e kam pyetur kryetarin, thotë, i kam pesë minuta si propozues.

KRYETARI: Ju lutem, pesë minuta, të rregullohet.

DARDAN SEJDIU: Instituti GAP, edhe INDEP, edhe ZRRE-ja e kanë dëshmuar me analizat e tyre që çmimi i energjisë elektrike në faturat e konsumatorit do të jetë për 52%, së paku, më i lartë e ajo që kemi sot.

Pra, në momentin kur futet ky termocentral në operim, përveç garancive që pritet që ky Kuvend t'i miratojë apo jo, gjithashtu faturat e energjisë elektrike do të jenë për 52% më të larta, dhe këto fatura të energjisë elektrike, të nderuar qytetarë, do të shpërfaqen jo vetëm tek ne si qytetarë të rëndomtë, tek amvisëritë, por edhe te bizneset.

Energjia elektrike është një prej kostove kryesore në biznesin që është prodhues apo përpunues në Republikën e Kosovës dhe duke e pasur parasysh edhe disbalancin tregtar, kjo nënkupton që edhe në aspektin ekonomik të ndërtimit të kapaciteteve prodhuese konkurrueshmëria jonë do të sfidohet jashtëzakonisht shumë.

Rrjedhimisht, të nderuar deputetë,

Me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare që është mbajtur dje dhe në diskutim me disa grupe parlamentare, unë jam i hapur që të harmonizohemi sa i përket tekstit.

Propozojmë këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përpilojë një raport gjithëpërfshirës për koston ekonomike, financiare, mjedisore e sociale të kontratës së nënshkruar me Contour Global, si dhe për mundësitë dhe efektet e shkëputjes së saj.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që të analizojë edhe modele të tjera të sigurimit të kapaciteteve që nuk rëndojnë buxhetin e shtetit dhe që kanë kosto të përballueshme për qytetarin.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës që të fokusohet në zgjerimin e investimeve nga buxheti i Kosovës për eficiencën e energjisë elektrike. Faleminderit!

Unë edhe një herë po e theksoj, jam i gatshëm që këtë rezolutë, me këto tri rekomandime, ta diskutojmë me përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare për korrektësi.

E kam diskutuar me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe e kam shpalosur me Lëvizjen Vetëvendosje, jam i gatshëm që me përfaqësuesit e secilit subjekt të ulemi dhe t'i harmonizojmë qëndrimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi te votimi.

Rregullorja e parasheh, zonja kryetare e komisionit, urdhëro fjalën për procedura, por Rregullorja kështu e parasheh.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Pak para se të fillonte kjo seancë, ne u njoftuam me tekstin e këtyre rekomandimeve dhe është e rëndësishme, besoj, që para se të vendoset në votim, të ndryshohet pika e parë, ku thuhet që “Qeveria e Republikës së Kosovës të përpilojë një raport gjithëpërfshirës për koston ekonomike financiare mjedisore sociale, pra kontratës të nënshkruar me Contour Global, si dhe për mundësit e efektet e shkëputjes së saj”, të zëvendësohet me kërkesën për “tërheqje nga kjo marrëveshje”.

Dardan Sejdiu, si shef i grupit parlamentar të grupit që përfaqëson, dje ka pasur një diskutim jashtëzakonisht të mirë, të sofistikuar. Andaj edhe ne kemi pritur si grup parlamentar që do të dalë me kërkesën për tërheqjen nga kjo marrëveshje, sepse të gjithë tashmë e dimë që marrëveshja në fjalë është kriminale, është jashtëzakonisht shumë e dëmshme dhe do t'u kushtoj jashtëzakonisht shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Andaj nuk ka kuptim që të vendoset në votim diçka në cilën asnjë pikë nuk kërkon që të tërhiqemi nga një marrëveshje kriminale.

Prandaj, ne si grup parlamentar kërkojmë nga grupi që përfaqëson zoti Sejdiu, që të ketë harmonizim dhe të vendoset si pikë e parë tërheqja nga kjo marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: E nderuar, tani ka filluar diskutimi, 4-5 deputetë janë paraqitur.

Vetëm pak, ne dje kur e përfunduam ishte ideja edhe të arrihet konsensusi, në qoftë se dëshirohet. Tash kjo situatë reale në të cilën jemi në seancë, ne do të futemi në votim, ose një mundësi është në qoftë se dëshironi edhe një pauzë. Propozuesi le të mundohet me grupet parlamentare, por po zgjatemi, se unë jua jap fjalën, po shoh Dardani prapë po reagon, Arbeni e ka kërkuar fjalën. Dardan, urdhëro, Arbeni, Fatmiri, është pastaj.

DARDAN SEJDIU: Dy gjëra, kryetar, unë isha jashtëzakonisht i qartë, unë e solla një propozim dhe kërkoja të ulemi me grupe parlamentare që ta dakordojmë, isha i qartë.

E dyta, mendoj që edhe dje e sqarova mirë, edhe është e qartë për secilin deputet, i cili është i interesuar të kuptojë pse unë e bëra atë prezantim.

Pra, kjo marrëveshje ndalet me votë, kur vjen garancia e sovranitetit.

Sot neve si deputetë na duhet të sigurohemi që t'i marrim të gjitha materialet e duhura që secili deputet, përveç atyre që tashmë janë të bindur, të binden edhe më tutje që duhet shkëputur këtë marrëveshje me votë duke mos e votua garancinë e sovranitetit.

Pra, unë besoj që garancia e sovranitetit e ndal këtë marrëveshje, vota kundër, e jo rezoluta.

Me rezolutë na duhet informacion shtesë që informon qytetarët e kësaj Republike që i informon deputetët për dëmet dhe implikimet të cilat unë u mundova t'i shpjegoj.

Propozoj edhe një herë, si thirrës i kësaj interpelance, që secili grup parlamentar të japë një emër, të ulemi së bashku, ka mjaftueshëm kuorum që të vazhdojë seanca dhe të sjellim një propozim. Faleminderit!

KRYETARI: Dje mendova se po kryhet, po e shoh edhe sot, katër deputetë janë aktualisht të lajmëruar për diskutim.

A po bëni pauzë, takoheni, merreni vesh, mirë, nuk merreni vesh, pastaj ne e vendosim në seancë, ne vazhdojmë sot të diskutojmë, po ky përfundim do të jetë. Një material duhet votuar, votohet po, jo, kjo është.

Nga një minutë, regjia Arben Gashi, përgatitet Fatmir Xhelili.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Veç desha për procedurë, m'u duk sikur nuk u kuptuam saktë, propozuesi i rezolutës kërkoi kohë shtesë të koordinohet me grupet, bile edhe me grupet e partive në pushtet, për t'i harmonizuar qëndrimet. Mendoj se është e arsyeshme, nëse mendojnë edhe grupet e tjera.

Nëse ka hapësirë për diskutim për këtë çështje, LDK-ja veç e ka dhënë përkrahjen parimisht, në emër të grupit parlamentar në këto negociata për LDK-në shkon Lumir Abdixhiku. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmir Xhelili, edhe kush shkon në emër të PDK-së, të dihet.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të nderuarit ministrat,

Përshëndetje për të nderuarit deputetë,

Mua më ka pëlqyer shumë sqarimi edhe elaborimi i zotit Sejdiu për projektin e termocentralit të ri, mirëpo kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër e medaljes është pse po lidhet te çmimi, kur nuk dihet si do të jetë çmimi pas pesë vjetësh, dhjetë vjetësh, 15 vjetësh, e para.

E dyta, çka në qoftë se ne prishim një kontratë, ku po jetë serioziteti i Kosovës për nënshkrim të kontratave dhe si marrëse e përgjegjësive dhe obligimeve ndaj kontratave, edhe cila firmë serioze do të vinte në Kosovë për të nënshkruar kontratë për një problematikë të tillë apo të ngjashme?

E treta, cilat janë investimet që duhet t'i bëjë Qeveria jonë në Kosovën B apo Kosovën A, edhe për sa kohë ato ishin riparuar me gjeneratorë të rinj për t'i rritur kapacitetet prodhuese, që Kosova të jetë e sigurt në aspektin energjetik.

Kështu që më pëlqej propozimi i parë...

KRYETARI: Faleminderit! Po më vjen keq. Propozo emrin, urdhëro, zoti Xhelili.

FATMIR XHELILI: Po propozoj tash, më mirë se Memli, nuk besoj që dikush di t'i prezantojë këto, se përafërsisht ne nuk kemi ekspertë të energjetikës këtu, Memli të shkojë në emër të grupit.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca?

GLAUK KONJUFCA: Duket fare qartë që pas qëndrimeve të tilla, të cilat në tri apo katër dimensione e shpjegojnë qartë dëmin që e sjell kjo marrëveshje për Kosovën, atëherë rrjedh konkludimi që kjo pika e parë, sidomos formulimi "Qeveria të përpilojë një raport për mundësitë e efekteve të shkëputjes së saj" mua më duket shumë e paqartë që nuk e implikon shkëputjen e kontratës, po e bën Qeverinë të mendojë.

Ne do të insistojmë që kjo pikë të jetë "shkëputje e kontratës" prej anës së Qeverisë dhe për këtë kontribut do të jetë Albulena Haxhiu aty për të negociuar dhe për ta shtyrë përpara këtë version të pikës së parë, që të jetë në mënyrë eksplicite Qeveria të shkëputet prej kësaj kontrate me Contour Global.

KRYETARI: Muharrem Nitaj, fjala për ju!

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar,

Unë besoj, për shembull, që debatin e kemi shterur dje, e konsideroj gabim edhe fjalën e kolegut Dardan Sejdiu, i cili përsëriti ato që i tha dje, nuk kishte nevojë fare, mjaftonte që t'i lexonte rekomandimet.

Ne situatën çfarë e kemi, po shihet qartë se nuk do të ketë një dakordim për rekomandimet që i ka dhënë propozuesi.

Partitë e shumicës nuk janë dakord që të vendoset as si raport, as si mundësi shkëputje e kontratës me Contour Global.

Ndërkohë që Lëvizja Vetëvendosje po shihet qartë që e kërkon prerazi të jetë formulimi që në rekomandime të kërkohet shkëputja e kësaj kontrate.

Unë besoj që ne mund të bëjmë pauzë sa të doni, po është pak e besueshme që grupet do të dakordohen për këto rekomandime.

Kështu që unë ju kisha sugjeruar që ta nxjerrim në votim ashtu siç është, në mënyrë që të procedojmë me pika të tjera.

KRYETARI: Na e jep një emër, të paktën t'i jepni mundësi konsensusit, se është rregull në procedura parlamentare.

MUHARREM NITAJ: Emri mund të jem unë, po qëndrimi është ky, shkoj kot në konsultime, nuk e pranojmë as pikën e parë siç është formuluar tani.

KRYETARI: Faleminderit, nuk prish punë kjo pjesë, vetëm e konsumoni. Pauzë nuk do të ketë, do të shkojmë në proces të votimit, po futemi në interpelancë, grupi tërhiqet, në interpelancën e re, grupi tërhiqet.

Bilall Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Po ai kushti i Glaukut praktikisht e tregoi edhe fundin e përpjekjes, ta quaj, ashtu për ta harmonizuar.

Pra, ju po na thoni hajde ta humbim edhe nja një orë kohë, unë nuk mendoj që do të shkojmë, po nëse mblidhen, do të jem unë, sepse edhe ashtu jam anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

KRYETARI: T'i jepni një mundësi. Lista serbe, kë do ta prezantoni si anëtar?

Kërkoj falje, zoti Simiq, po e shoh se edhe propozuesi po do të shkojë drejt në votë. Propozuesi në këtë rast ka një të drejtë të pashkruar, shkojmë drejt në votë, po shoh edhe grupet parlamentare, shkojmë drejt në votë. Faleminderit!

Shkojmë drejt në votë! Po, po, bën, zoti Krasniqi, atëherë edhe zoti Zemaj, nga një minutë.

MEMLI KRASNIQI: Meqenëse po kalojmë drejt në votim, edhe me propozimin që të dalim në këtë fazë nga ana e propozuesit. Unë dua ta bëj të qartë që në formën siç është, ne do t'i votojmë kundër këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Shumë shkurt, kryetar, sepse me atë çka e tha Arbeni pajtohemi plotësisht, por propozoj që t'i jepet mundësia harmonizimit të pikës së parë. Është në interes të përgjithshëm, përndryshe pyetja ime dhe kërkesa ime është kush e merr përgjegjësinë t'i paguajë 22 milionë dëme taksa të qytetarëve të Republikës së Kosovës, cili grup politik do ta merrte këtë përgjegjësi? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi e paraqiti propozimin, i cili do të jetë final, qëndrimet politike janë të partive.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, rekomandimet e propozuara nga zoti Dardan Sejdiu. Votojmë tash!

Nuk ka pjesëmarrje, po shoh, ka prani të mjaftueshme, po nuk po duan të votojnë.

Unë mund ta kthej edhe një herë, në qoftë se dëshironi? A dëshironi edhe një herë? E kemi pasur praktikë, 43 deputetë, 28 për, 13 kundër dhe 2 abstenime, votojmë edhe një herë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, të njëjtën çështje, rekomandimet e propozuara nga propozuesi Dardan Sejdiu. Votojmë tash!

Kanë votuar 55 deputetë, 35 për, 16 kundër, 4 abstenime. Me dorë për, kundër? Për! 36 deputetë për, i bie të kenë votuar 56 deputetë me elektronikë dhe me dorë. Prapë nuk ka kuorum të mjaftueshëm, mbetet për herën tjetër.

20. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, nëpërmjet një shkrese e ka njoftuar Kuvendin se për interpelancën e sotme në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar ia ka deleguar kompetencën e vet ministrit të Drejtësisë, zotit Abelard Tahiri.

E ftoj zonjën Fitore Pacolli-Dalipi si parashtruese e kësaj interpelance ta thotë se cili është qëndrimi i parashtruesit.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Në këtë interpelancë është ftuar kryeministri i Republikës së Kosovës, e jo ministri. Prandaj, ne sot nuk e mbajmë këtë interpelancë dhe e ftoj kryeministrin që të vijë në mbledhjen e radhës dhe të përgjigjet në pyetjet që i kemi ne për të, e jo ministri. Ministri mund ta ndihmojë, por jo të përgjigjet në vend të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë në bazë të këtij qëndrimi ne po e shtyjmë për një moment të radhës, në konsultime edhe me kryeministrin, këtë pikë të rendit të ditës.

Ju lutem, jemi tek votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, për çështjen e KOSTT-it.

Zonja Mimoza Kusari-Lila e ka lexuar, edhe një herë. Urdhëroni, zonja Lila-Kusari.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Dje ne jemi takuar me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Ata kanë kërkuar që ta kenë tekstin e mocionit të interpelancës me shkrim, është dërguar deri më tash, vetëm zoti Kurteshi nga Lëvizja Vetëvendosje ka dërguar komente. Nëse jeni në pajtim, unë e lexoj tekstin që aktualisht është bërë final dhe gjithashtu i thërras grupet tjera parlamentare që nuk kanë dërguar komente nëse duan që të kenë komente në tekstin që do të lexohet, atëherë t'i dërgojnë edhe mund ta lëmë votimin për një kohë tjetër.

Kryetar, a ta lexoj tekstin? Ok, faleminderit!

Teksti i mocionit të interpelancës për vendimin e Qeverisë numër 02/34, datë 5 mars 2018.

1. Të obligohet Qeveria e Kosovës që në afat prej një muaji të vijë me zgjidhje për situatën e krijuar.
2. KOSTT-i dhe ZRRE-ja ta përpilojnë planin e kompensimit të humbjeve në KOSTT të shkaktuara nga udhëzimi i ZRRE-së për furnizim të rrymës në veri.
3. Të ndalen inkasimet ilegale për rrymën e faturuar në veri nga EPS, apo operatorë të tjerë të jashtëligjshëm.
4. Domosdoshmërisht të kushtëzohet vazhdimësia e dialogut me Serbinë me mospërzierje të Serbisë në tregun e rrymës në territorin e Republikës së Kosovës.

5. Të krijohet një task-forcë, e përbërë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe përfaqësues të autoriteteve të përfshira në këtë çështje dhe të koordinohen veprimet për dialog dhe për nxjerrje të KOSTT-it nga situata aktuale.

6. Në procesin e dialogut Kosovë-Serbi të mos pranohet asnjë ndryshim i marrëveshjes për energjinë, e nënshkruar më 8 shtator 2018.

7. KEDS-i të fillojë faturimin e rrymës për të gjithë konsumatorët në tërë territorin e Republikës së Kosovës pa diskriminim, duke i trajtuar të gjithë konsumatorët pa dallime.

Ky është teksti final, nëse duan të deklarohen shefat e grupeve në raport me tekstin, apo duan ende kohë për ta dakorduar, mbetet që ju të vendosni.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari-Lila e lexoi, tanimë shkojmë drejtpërdrejt në votim.

Të nderuar deputetë,
Shkojmë votim drejt. Votojmë tash!

Kanë votuar 34 deputetë, 30 për, 2 kundër dhe 2 abstenime.

A doni edhe një herë ta fus në votim.

Nuk po votojnë. Zoti Hoti urdhëro, pastaj zoti Kurteshi.

AVDULLAH HOTI; Faleminderit!

Është hera e katërt ose e pestë që rezoluta të ndryshme të propozuara nga opozita nuk kalojnë, sepse nuk ka kuorum për të votuar, ngase pozita nuk merr pjesë.

Tash në seancën paraprake, e dini ka qenë një ligj. Leni ligjet e zakonshme, por ka qenë një ligj për ratifikimin e një marrëveshjeje dhe e kemi edhe sot në rend dite një ligj që kërkon 2/3. Duhet të kini kujdes si silleni, sepse ju vetë jeni duke e vendosur një praktikë që normalisht s'është normale dhe duhet ta përdorte opozita.

Prandaj, po besoj që jeni duke reflektuar ku jeni duke e çuar Kuvendin dhe krejt institucionet e vendit.

KRYETARI: Zoti Kurteshi, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi diskutuar dhe shkurt në lidhje me tekstin, zonja Kusari-Lila ka kërkuar që ne t'i dërgojmë komentet. Ashtu siç e tha, në mënyrë korrekte unë i kam dërguar komentet, mirëpo nuk ka komente nga partitë tjera. Pas komenteve, sigurisht meqenëse ato i përcjellin edhe qëndrimet të partive tona, ne nuk kemi takuar që ta harmonizojmë tekstin.

Prandaj, unë mendoj se ky tekst nuk është krejt i harmonizuar, sepse nga ajo që unë e pashë, domethënë ne e kemi dërguar dhe e di që jo krejt pikat tona i pranojnë, ka pika me të cilat ka mundësi që edhe ne nuk pajtohemi.

Prandaj, unë kërkoj nga propozuesja që tekstin të mos e paraqesë para se t'i thërrasë edhe një herë të gjithë, të merremi vesh përfundimisht rreth tekstit dhe mandej e hedhim në votim dhe qëndrojmë, ose nuk qëndrojmë prapa saj.

Unë mendoj se kjo është rruga anormale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një situatë reale, jo veç ndërmjet pozitës, por edhe opozitës. A ka mundësi, më mirë e lëmë një herë tjetër? Urdhëro, zonja Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI LILA: Faleminderit!

Unë gjithashtu jam për atë që ta arrijmë një konsensus për pika dhe të kemi dakordimin e të gjitha grupeve parlamentare.

Flasim për një proces të rëndësishëm nacionale, nuk flasim për agjendë politike të asnjërës parti politike, për interes të shtetit.

Prandaj, i thërras edhe një herë gjithë përfaqësuesit që i kanë deleguar partitë politike që të takohemi sot, të dakordohemi dhe tekstin e dakorduar t'ia prezantojmë seancës ose sot, ose të hënën. Po njëjtë, edhe këtë që e prezantova ishte me disa propozime të zotit Kurteshi, ndërsa nuk kemi marrë propozime të grupeve tjera parlamentare.

KRYETARI: Megjithatë, duhet pasur parasysh, 34 deputetë, me aq sa po i shoh janë më shumë ndërmjet LDK-së edhe Vetëvendosjes, që do të thotë nuk kanë votua. Merruni më mirë edhe një herë, uluni bashkë, arrijeni një konsensus. E mbaruam zoti Xhelili, Krasniqi, Isufi, një orë e humbëm më herët, të mos futemi, por të shkojmë në pikën e radhës. Po, por veç po vonohemi. Urdhëro zoti Isufi, pastaj zoti Xhelili.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Kur grupet parlamentare i caktojnë përfaqësuesit që të marrin pjesë në harmonizimin e një rezolute duhet të shkojnë dhe ta harmonizojnë duke bërë kompromise për arritjen e një

konsensusi për hartimin e rezolutës dhe votimin e saj, por jo që hartuesi me çdo kusht ta mbrojë pozicionin e vet dhe në të njëjtën kohë ta akuzojë palën tjetër se s'ka qenë e gatshme ta harmonizojë rezolutën.

Edhe dje e kemi caktuar anëtarin tonë të aleancës për Ardhmërinë e Kosovës që të marrë pjesë në takim, jo t'i çojë propozimet, por të marrë pjesë në takim, sepse kur konsultohen drejtpërdrejt është 100 herë më mirë se sa veç t'i dërgojë.

KRYETARI: Faleminderit! Po, ashtu-kështu nuk ka konsensus. Uluni edhe një herë, po humbim kohë, mua po më dhimbseni edhe, nga një minutë, nga një minutë, 4-5 deputetë janë.

A ka mundësi të kaloj pikën e radhës dhe ta arrini një konsensus bashkërisht edhe për rezolutat tjera, jo vetëm për këtë.

Po vazhdojmë me pikën e radhës e ju kisha lutur se të gjitha projekt- rezolutat kanë mbetur të hapura. Merruni edhe një herë me to, uluni grupet parlamentare, i sjellim edhe një herë në votim. Unë qëndroj pranë asaj kërkesës që të votojmë edhe për ju, ta bëjmë një votim. Po, jo, në fund të fundit le të votohet.

E përfunduar këtë pjesë të seancës.

Vazhdojmë tek pikat e papërfunduara nga seanca plenare më 3 maj 2018, si në vijim:

Aktualisht sa deputetë janë në sallë, se jemi te pika ku duhen 2/3, 80 deputetë.

76 deputetë janë të pranishëm s'po e vë fare në votim për arsye se s'kemi mjaft. Kot po e lexon, nuk ka deputetë... 76 deputetë janë. Në qoftë se dëshironi të hyni në debat, mirë e përgatitemi deri në votim. Atëherë, po vazhdojmë, po futemi në debat.

* * *

E hënë, 4 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj dhe 1 qershor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikat e papërfunduara. Do të thotë, fillojmë me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj dhe 1 qershor 2018, si në vijim:

4. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e projektligjit, konstatoj se të pranishëm në sallë janë 85 deputetë, që është numër i mjaftueshëm.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kërkojmë falje, e kemi futur në konfuzion regjinë, është prishur elektronika. Aq në konfuzion e kemi futur. A shkojmë me dorë? Nënkryetari po thotë “jo, s’po shkojmë”. Shkojmë vetëm në mënyrë elektronike.

Përgatitemi për votimin e Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, 85 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

Kanë votuar 64 deputetë, 59 për, 5 abstenim. Nuk konsiderohet votim i plotësuar në bazë të Rregullores.

Nuk miratohet ligji për shkak se s’ka pasur vota të mjaftueshme, s’kanë votuar 80 deputetë.

18. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës

I kemi përfunduar të gjitha diskutimet më 31 maj 2018. Nuk kemi mundur ta votojmë as më 1 qershor 2018, s’ka pas kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Shkojmë në votim. Përgatitemi për votim! Po zoti Kurteshi, për çka dëshironi? Urdhëro, zoti Kurteshi, por vetëm pak për çka e ka fjalën se s’po e dimë as për çka?

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne e kemi përfunduar diskutimin në lidhje me çështjen, mirëpo grupi që ka qenë i caktuar nga grupet parlamentare nuk e ka përfunduar punën në lidhje me mocionin për votim. Neve na nevojiten edhe disa minuta për ta përfunduar atë dhe mandej mund ta nxirrni në votim. Kjo është çështja, s'ka asgjë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Kurrë s'u kanë dalë ditë të tëra, ishalla ndodhë ta kryeni disa minuta. Jo, po e lë, por ishalla e kryeni. Atëherë, po e lëmë. Edhe sa dëshiron, zoti Kurteshi? Më trego, sa kohë? Jo, jo, s'prish punë! Zonja Mimoza Kusari-Lila!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Kërkoj falje, zonja Kusari-Lila, fjala jote është vendimtare, në qoftë se ti...

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Ne e kemi pasur diskutimin konstruktiv me grupin, me të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Gjithashtu jemi dakorduar që sot ta bëjmë një harmonizim të qëndrimeve. Arsyeja që nuk e kemi pasur harmonizimin është se sot kemi ardhur me një agjendë për një seancë të re. Tash u ndërrua agjenda, megjithatë edhe unë në emër të të gjithë përfaqësuesve të grupeve parlamentare që jemi bashkë në këtë grup punues, kërkoj që ta shtyjme për pak minuta, ose në një periudhë tjetër gjatë ditës së sotme. Unë besoj që mund ta arrijmë një konsensus me rekomandime të përbashkëta.

KRYETARI: Vetëm pasdite nuk i gjeni 60 deputetë. Sa? Një orë?

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar, më pak se një orë na duhet, për 30 minuta kthehem ne.

KRYETARI: Në rregull! Atëherë, vazhdojmë me votimet, e pastaj futemi në debat parlamentar. E kisha lutur zonjën Mimoza Kusari-Lila t'i ftojë përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta harmonizoni. Por, shkojmë në votim njëherë, zonja Kusari-Lila. I kemi edhe 2-3 votime, të lutem!

Atëherë, e shtyjme për afro 1 orë, deri kur të bëhet gati grupi.

19. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PSD-së për marrëveshjet komerciale ndërmjet kompanisë "Contour Global" dhe Qeverisë së Kosovës, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017

Diskutimet për këtë interpelancë i kemi përfunduar po ashtu më 31 maj. Nuk kemi pasur kuorum në vendimmarrje as më 1 qershor. A shkojmë drejt në votim? Shkojmë në votim!

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim...

E mira ishte që këtë herë reagoi kryetari i Grupit tim Parlamentar. Kryetar, unë po lodhem duke i thënë të njëjtat çështje, kisha pas dëshirë të kemi vëmendje. Zonja Sala Berisha-Shala, po ia merr vëmendjen kryetarit të Grupit. Për Contour Globalin, se edhe unë shpesh po duhet t'i përsëris të njëjtat çështje. I përsëris sa herë të duhet, por vetëm vëmendje. A shkojmë drejtë në votim?

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim!

2 deputetë i kemi me dorë, nuk kanë kartela, Zonja Millaku dhe zoti Krasniqi. Votojmë tash! Janë 87 deputetë, 2 deputetë me dorë, a dëshirojnë të deklarohen?

Kanë votuar 90 deputetë, 35 deputetë në mënyrë elektronike, dy me dorë janë për, d.m.th. gjithsej 37, kundër janë 49 deputetë, dy me dorë kundër, gjithsej 49 me elektronike një me dorë, gjithsej 50 kundër dhe 3 abstenime.

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga PSD-ja të harmonizuara me grupet parlamentare.

20. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar Vetëvendosje në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

A dëshironi ta vazhdoni Lëvizja Vetëvendosje, për arsye se kryeministri nuk është. Me aq sa e pashë reagimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryeministri mund të jetë vetëm të premtën në interpelancë, vendimi është i juaj. Ta shtyjmë? E shtyjmë! Është kërkesa e Grupit Parlamentar propozues që ta shtyjmë.

* * *

4. *Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar*

Të nderuar, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. 93 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

Me 84 vota, 2 me dorë 82 në mënyrë elektronike, 83 deputetë janë për, 2 me dorë 81 në mënyrë elektronike, një është abstenim. Kuvendi miratoi traktatin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar.

* * *

4. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar

Votojmë tash! 84 deputetë kanë votuar, 84 për, 82 në mënyrë elektronike, 2 me ngritje dore.

Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 06/L-061 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar.

Jemi në vazhdimin e seancës plenare me pikat e papërfunduara me 17, 30 maj dhe 1 qershor 2018.

* * *

E premte, 8 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj dhe 1, 4 qershor 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër i Punëve të Brendshme që jeni në sallë, shpresoj që edhe ministrat e tjerë do të vijnë për të marrë pjesë në seancë.

Kemi tri pika të papërfunduara, janë çështje votimi, akoma nuk kemi kuorumin e duhur, prandaj po futemi drejtpërdrejt në rendin e ditës me pikën:

20. Interpelancë e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj që në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë, të tjerat i dini të gjithë.

Ftoj zonjën Pacolli nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, si propozues i interpelancës, ta marrë fjalën, a është zonja Pacolli? Kush do të flasë në emër të Vetëvendosjes? Fjalën e ka zonja Pacolli.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Prova më e sigurt që dëshmon se kjo Qeveri nuk ka interes të luftojë korrupsionin është tentimi për ta fshehur atë.

Në muajin mars të këtij viti, në konferencën e organizuar për shtyp nga Lëvizja Vetëvendosje, së bashku me deputeten Albulena Haxhiu patëm prezantuar të gjeturat e raportit, për të cilin e kemi thirrur këtë interpelancë.

Pasi që kërkesa jonë për qasjen në dokumentet që posedonte Qeveria u shpërfill, pra ne u detyruam që përmes rrugëve alternative të gjenim raportin.

Të shpejta ishin rekomandimet e kryeministrit përmes këshilltarit të tij dhe ministrave përgjegjës, të cilët patën deklaruar se nuk ekziston një raport i tillë, por kur më nuk mund të mohonin ekzistimin e raportit, ata filluan të minimizonin rëndësinë e tij.

E gjithë tendenca për ta fshehur, e pastaj për ta minimizuar rëndësinë e këtij raporti, u bë për ta mbuluar gjendjen alarmuese në sistemin e drejtësisë.

Ky nuk është një raport i thjeshtë, siç tentuan ta paraqesin, përkundrazi është raport shumë i rëndësishëm. Raporti fokusohet në vlerësimin e gjendjes në kapacitetin e sistemit të drejtësisë, në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, krimin të organizuar, shpëlarjes së parave, duke përfshirë gjithë procedurën penale nga fillimi i hetimit deri te vendimi i plotfuqishëm.

Ekspertët e pavarur evropianë që bënë vlerësimin u caktuan nga Komisioni i Bashkimit Evropian, konkretisht nga Zyra e Komisionit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, i cili i kishte pajisur edhe me dokumente shtesë, në mënyrë që analiza të jetë sa më e saktë.

Qysh në fillim të raportit ekspertët konstatojnë mungesën e vullnetit për zbatimin e ligjit në Kosovë dhe mungesën e kapaciteteve institucionale dhe të përgatitjes profesionale, po mbi të gjitha vë në pah ndërhyrjet politike dhe mungesën e pavarësisë së gjyqësorit për të luftuar korrupsionin në nivelin e lartë, konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe shpëlarjen e parave.

Por, më keq raporti thekson se konfiskimi i të ardhurave nga krimi nuk është as objektiv i sistemit tonë të drejtësisë. Pra, nuk ka as bazë ligjore për konfiskimin e veprave penale dhe as mekanizma që do ta zbatonin atë.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë së fituar nga krimi, ne jemi në pikën zero, pavarësisht se çfarë thotë kryeministri dhe ministrat e tij.

Ligji për konfiskimin është vlerësuar joadekuat dhe nuk mbështet zbatimin e konfiskimit të zgjeruar si dhe konfiskimin e bazuar në vlerë dhe në mungesë të dënimit. Në fakt, ligji aktual pamundëson zbatimin e kompetencave të shtuara të konfiskimit që nuk rezulton me dënim.

Për t'i kuptuar më mirë problemet dhe mangësitë e sistemit të drejtësisë nga faza fillestare e deri te faza finale raporti vë në pah shqetësime serioze të cilat paraqiten qysh në fazën fillestare të hetimit, të cilat edhe i paraprinë procedurës penale. E këtu policia është organi primar, i cili mbledh provat dhe informatat hetuese me qëllim të përcaktimit nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm.

Ky raport ngre shqetësime të forta sa u përket autonomisë së prokurorit dhe ndërhyrjeve politike për të pushuar kallëzimet penale të policisë para inicimit të hetimeve dhe për të përfunduar hetimet pas inicimit të tyre.

Fillimisht raporti vë në pah mungesën e afatit se kur duhet të përfundojnë veprimet fillestare, në mënyrë që të iniciohen procedurat penale.

Por më shqetësuese mbetet se edhe atëherë kur fillon procedura penale me aktvendim për fillimin e hetimit të lëshuar nga prokurori, zyrtarët përgjegjës për kryerjen e hetimeve mbeten të varur në aspektin funksional nga hierarkia e policisë. Kjo ndikon negativisht në punën e prokurorit, pasi që hetuesit policorë mund të marrin urdhra kundërthënës nga eprorët e tyre.

Urdhri i dhënë nga prokurori për të thelluar hetimin mund të pengohet nga vetë hetuesit policorë, sepse sistemi aktual nuk përmban dispozita të qarta penale me qëllim të trajtimit të hetuesve që nuk i binden ose veprojnë në kundërshtim me urdhër të dhënë nga prokurori, i cili është edhe përgjegjës i hetimit.

Raporti thekson se nuk ka interesim të bëhet zgjerimi i rasteve, edhe atëherë kur ka mundësi dhe kushte për zgjerim të hetimit.

Sipas procedurave të rregullta me ligj, policia është e detyruar që brenda 24 orëve t'i dorëzojë raport policor prokurorit të shtetit, por sipas të gjeturave, Policia e Kosovës, saktësisht Departamenti i Hetimeve, i cili e trajton rreth 2000 raste në vit 20% të rasteve nuk regjistrohen në sistemin e policisë dhe si rezultat nuk referohen fare në prokurori me arsyetimin se ka mungesë të dyshimeve të arsyeshme.

Vlerësimi i dyshimit të arsyeshëm i përket vetëm policisë, e këtu qëndron problemi.

Statistikat që iu ofruan ekspertëve rreth hetimeve të filluara dhe aktakuzave të ngritura ishin të mangëta.

Në raport theksohet se nuk ishte e mundur të konstatohej sa hetime zyrtare ishin nisur dhe në çfarë faze janë.

Raporti thekson se nuk ka gatishmëri të mjaftueshme për të ndërtuar raste solide për të hetuar krerët e organizatës kriminale.

Nga prezantimi i rasteve, të cilat i kanë studiuar, autorët e raportit konkludojnë se hetimet në Kosovë kryesisht përqendrohen vetëm në nivelin e ulët të organizatës. Rastet mbahen mjaft të

thjeshta dhe nuk është treguar asnjë përpjekje për të hetuar kokat e vërteta të organizatave kriminale.

Kjo është shumë e qartë, përderisa prokurori varet nga eprorët e Policisë, hetimet e rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe konfiskimi i pasurisë së fituar nga krimi nuk do të ndodhë, pasi që pengohen qysh në fillim nga ndërhyrjet e paligjshme të kokave të krimit dhe nga zyrtarët e lartë publikë.

Të mos harrojmë këtu edhe lidhjen e ngushtë të presidentit dhe të kryeministrit me Kryeprokurorin e Shtetit dhe me eprorët e tjerë në Polici.

Pra, kjo mungesë gatishmërie për të hetuar pasurinë e krijuar nga krimi nuk është e rastësishme, sepse një sistem i pavarur dhe efikas do të hetonte edhe shefat e krimit, ish-funksionarë dhe funksionarë të lartë të kësaj Qeverie që kanë krijuar pasuri marramendëse nga krimi dhe nga zhvatja që i kanë bërë këtij vendi.

Siç duket, ndikimet nuk përfundojnë këtu, por edhe më shqetësuese mbetet mungesa e pavarësisë së gjyqësorit, veçanërisht kur ka të bëjë me luftimin e korrupsionit në nivelin e lartë.

Gjatë intervistave me gjyqtarë është kuptuar se gjyqtarët në të shumtën e rasteve punojnë nën presion, kanë pasur ndërhyrje politike, ngacmime në media, të cilat janë jashtëzakonisht të ndikuar politikisht dhe kërcënime për të ndikuar në punën e tyre.

Gjyqësori konsiderohet jetë joprofesional, joefikas, pasiv dhe, mbi të gjitha, i ndikuar politikisht dhe i korruptuar.

Raporti thekson se nuk mund të ketë luftë efikase dhe të suksesshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit pa institucione të besueshme dhe me personel profesional të plotë dhe të pavarur.

Rekomandohet që prioriteti kryesor të jetë luftimi i korrupsionit brenda institucioneve të drejtësisë, sidomos luftimin e korrupsionit në gjyqësor.

Prokuroria Speciale, e cila duhet të jetë organ plotësisht i pavarur, nuk ka pavarësi të plotë, mbikëqyret nga prokurori i shtetit, i cili është i ndikuar nga politika dhe i cili ndërhyr direkt në hetimet konkrete pa asnjë kufizim ligjor dhe paraqet diskrecion arbitrar të Kryeprokurorit të Shtetit dhe pengesë serioze në punën dhe rezultatet e Prokurorisë Speciale.

Tutje, mungesa e mbrojtjes së dëshmitarëve mbetet shqetësuese, ushtrimi i ndikimit dhe presioni politik mbi ta bën që dëshmitarët të ndryshojnë deklaratat e dhëna në gjykata ose të deklarojnë humbjen e kujtesës, veprimet e tilla tashmë janë bërë fenomen.

Kryeministër, ky raport dhe Raporti për vendin paraqet qartë se është pikërisht kjo Qeveri dhe qeveritë e mëparshme që kanë degraduar sistemin e drejtësisë.

Pra, nga ju shihet se nuk ka as vullnet dhe as guxim për të ndryshuar këtë gjendje. Kjo dëshmohet nga gjendja e rëndë me të cilën gjendet Telekom i Kosovës dhe afëra me Z-Mobile që ju jeni të njoftuar, e dini për këtë aferë.

Afera, e cila po flitet për 8 milionë euro, kjo ende nuk është publike, për rrugën e Gjilanit, edhe këtu kërkohet ndërhyrja e prokurorisë.

Ndërtimet ilegale që po ndodhen dhe shpronësimet që po u bëni uzurpatorëve.

Presioni që bëtë mbi Gjykatën Kushtetuese në rastin e shqyrtimit të vendimit për rritjen e pagave të zyrtarëve të lartë publikë, përfshirë edhe pagën tënde, kryeministër.

Vendosjen e Nijazi Thaçit në krye të KEK-ut, mosshkarkimin e ministrave Besim Beqaj dhe Pal Lekaj, që tashmë kanë aktakuzë të ngritur, e sidomos për vendimin që morët për t'i paguar "Bechtel-Enka"-s 53 milionë euro, pa kërkuar fare përgjegjësi, përderisa ne nuk kemi barna esenciale në spitalet tona dhe shumë qytetarët po jetojnë në varfëri ekstreme dhe nuk kemi as çerdhe të mjaftueshme për fëmijët e këtij vendi.

Prandaj, nëse nuk mund ta frenosh veten dhe këtë Qeveri nga ndërhyrjet dhe çështjet që u përkasin institucione të drejtësisë, vendimin më të mirë që mund ta marrësh për këtë vend dhe për qytetarët e këtij vendi është të dorëhiqesh, kryeministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete Pacolli,

U mundova ta kuptoj thelbin e kërkesës suaj, po ishte e shpërndarë, ju kishit një varg elementesh, përmes të cilave po e krijoni një pamje të caktuar ose po e prezantoni një pamje të caktuar. E kam vështirë t'ju përcjell në të gjitha ato, po për të mundur t'ju ndihmoj, besoj së shpejti do të kem një dokument si ky e do t' jua ndaj që ta keni dhe gjatë interpelancës mund të bashkëbisedojmë.

Çka është ky dokument, po jua shpjegoj ngadalë. Thotë, ky dokument është rezultat i punës së takimeve që janë quajtur të nivelit të lartë të rendit dhe të ligjit.

Në këto takime kanë marrë pjesë Doganat e Kosovës, Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme e Kosovës, Agjencia Antikorrupsion edhe partnerët ndërkombëtarë që i trajtojnë temat e rendit dhe të ligjit.

Kanë ndodhur disa takime, por në shtatë prej tyre kanë raportuar secili veç e veç, pra Dogana, Policia, Këshilli Gjyqësor, ai Prokurorial, Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme, Agjencia Antikorrupsion për gjendjen në institucione që përfaqësojnë, për vështirësitë, të arriturat ose sfidat që kanë, po veçanërisht në pikën dy, pra çka do të ndërmarrin ata që në një afat të caktuar kohor problemet me të cilat ballafaqohen në shtrimin e funksioneve të veta të ndodhin, dhe së fundi, cilat janë ato vështirësi të tyre për të cilat janë të nevojshme edhe institucionet e tjera, pra nuk mund t'i tejkalojnë vetë pa përkrahjen e institucioneve të tjera, qoftë Parlamentarit, Qeverisë, qoftë ndërsjellë, pra Policia ose Dogana pa Policinë ose anasjelltas.

Ne kemi përgatitur një dokument me krejt të gjeturat e këtyre takimeve, më vjen keq, nuk është për mosrespekt, është vetëm në gjuhën angleze, arsyeja pse është bërë në gjuhën angleze është se ka qenë në kohën e aplikimit për liberalizim të vizave dhe këtë dokument edhe tre dokumente të tjerë pra një "position paper rule of law", këtë dokument që është raport do t'ju jap shpejt, e pastaj një raport me të dhëna precize kur ka ardhur raportuesi Simon Mody për të marrë gjendjen në vend, ne i kemi furnizuar ata me materiale konkrete, me punën që ka bërë kjo Qeveri, pra Qeveria që e udhëheq në rend dhe ligj.

Në këtë raport janë të gjitha të dhënat dhe nuk është raport i ndonjë organizate joqeveritare, po është i ndërtuar nga pjesëmarrësit në takim, janë të dhënat e tyre dhe është i përkrahur nga USAID-i dhe IAR, Agjencia Evropiane e Rindërtimit, pra organizata që kanë marrë pjesë, po këtu kanë qenë edhe EULEX-së dhe mekanizma të tjerë.

Këtë dokument po e përmend për faktin se prioritet në atë kohë kishim të paraqesim gjendjen në rend e ligj në Kosovë, sfidat dhe punët që do t'i kryejmë.

Ju siguroj që ky dokument nuk është bërë të mashtrohet BE-ja, as të mashtrohet opinioni i brendshëm, është ndoshta pasqyra më reale që mund të përshkruhet gjendja në vend. Gjendja në rend e ligj nuk është e kënaqshme në Kosovë, kjo gjendje është sfidë për Kosovën, veçanërisht luftimi i llojeve të ndryshme të krimit dhe korrupsionit.

Rezultat i këtij fokusimi ka shkuar kryesisht që t'u ndihmohet institucioneve të rendit dhe ligjit, pra të gjithë atyre që u cekën që t'i ushtrojnë funksionet e veta në bazë të mandatit kushtetues e

ligjor, që ta fitojnë në tërësi fuqinë e tyre kushtetuese e ligjore, të veprojnë të pandikuar dhe të papenguar nga askush.

Për të mundur të siguruar një veprim të tillë, ashtu si po flas, jemi kujdesur po ashtu për përkrahjen financiare e buxhetore, për përkrahjen në personel dhe për të gjitha kërkesat që kanë rezultuar.

Mund t'ju them pra, që dinamika ose treguesi i asaj që po ndodh sot në rend dhe në ligj dallon nga kohët e mëhershme.

Nuk them që Kosova i ka zgjidhur problemet e korrupsionit, nuk them që ne mund të mburremi para vendeve të tjera, por në raport me gjenden e marrë dhe atë që ka ndodhur në këtë kohë, bëhet fjalë për një Kosovë tjetër, nuk është e njëjta.

Ju dëgjova për disa tema që i thatë veç e veç. Ne kemi pasur rastin, do të kemi rastin të flasim ndaras, si për PTK-në, si për pagesën për "Bechtel-Enka"-n, si për tema të tjera, po nëse mund të mbesim në materialet që i kemi para vetes, mund t'ju siguroj që, p.sh. disa të dhëna që Dogana ka bërë 443 kallëzime penale me dyshimin për dëme të shkaktuara në 22.4 milionë euro.

Janë konfiskuar të mira me vlerë prej 2.5 milionë euro, që dyshohet se janë fituar prej veprës penale nga dogana, janë iniciuar 49 raste të reja, 55 kallëzime penale, 82 kallëzime individuale që kanë rezultuar me konfiskim prej 15,2 milionë eurosh pasuri. Te Policia, për shembull, është një rritje prej 10,75 persona të arrestuar, rritje prej 65,15 konfiskim të narkotikëve, ulje prej 6,76 vjedhje të rënda, ulje prej 4.9 të aksidenteve, 438 vepra të hetuara të krimeve ekonomike dhe të korrupsionit, që po ndodhin e po hetohen, 161 raste të hetuara kundër krimit ekonomik, 166 për keqpërdorim zyrtar, 111 kundër pronës, 9 operacione policore, pastaj 91 të arrestuar, 370 kallëzime penale, 7 grupe të shkatërruara të krimit të organizuar.

Është një listë e madhe e këtyre të dhënave, janë reale, mund t'i gjeni, vetëm se nuk kemi bërë një 'pjar' të vazhdueshëm të tregojmë çka po bëjmë, se ajo është detyrë që duhet të ndodhë e duhet të kryhet. Luftë u është shpallur narkotikëve nëpër shkolla, rrjeteve të haraçit e të fajdeve, për të cilat shpesh është folur, po nuk është ndërmarre asgjë, shumica e këtyre mekanizmave kriminalë, hera e parë që po themi publikisht, janë sot në vështirësi të funksionimit ose në pamundësi të funksionimit. Pse? Sepse kjo Qeveri e ka marrë seriozisht luftën kundër krimit, kundër korrupsionit dhe kundër keqpërdorimeve në cilindo nivel.

Unë po ndalem me kaq, nëse e kam këtu raportin, do t'ju jap nga një kopje, nuk e di a ka mbërritur ta sjellë regjia, nuk e keni marrë.

Po ashtu jam i hapur për shpjegime të mëtejme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Po vazhdojmë me diskutimet e deputetëve, respektivisht grupeve parlamentare, sipas radhës Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Zemaj, po më duket, është paraqitur i parë. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Një dekadë nga shpallja e pavarësisë së saj, Kosova vazhdon të ketë vështirësi që të bëhet shtet funksional.

Krimi dhe korrupsioni, sidomos krimi i organizuar, janë dhe mbeten kërcënim për shtetin e së drejtës dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Zhvillimet e Kosovës si një shtet funksional vazhdojnë të jenë të brishta, sidomos pas ardhjes së kësaj Qeverie të koalicionit. Sistemi gjyqësor i Kosovës është larg nga përçimi i kërkesave të BE-së për t'i dhënë fund mosndëshkimit të korrupsionit ndaj profilit të lartë dhe nxjerrjes së rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në tërësi.

Me gjithë plotësimin e shumës së kushteve të përcaktuara nga BE-ja, lufta kundër korrupsionit ndaj profilit të lartë dhe konfiskimit efektiv të pasurisë së pashpjegueshme mbetet akoma një kriter i papërbushur me prioritet të lartë dhe totalisht me mungesë të vullnetit të kësaj Qeverie.

Kosova vazhdon të demonstrojë rezultate të dobëta në luftën kundër korrupsionit, në veçanti në rastet që ndërlidhen me profilin e zyrtarëve të lartë publikë.

Raporti për vendin për Kosovën konsideron se Kosova ndodhet në fazën fillestare akoma në luftën kundër korrupsionit në përgjithësi, me një progres të kufizuar.

Prandaj, vullneti i fuqishëm politik është i nevojshëm për të ndaluar këtë fenomen në mënyrë të duhur, i shoqëruar edhe me një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike që ofron rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit.

Qeveria Haradinaj, e përbërë me Kadri Veselin dhe kupolën Hashim Thaçi, bën një rekord të zi në këtë drejtim. Sikur asnjë Qeveri tjetër e pasluftës, shumë zyrtarë të saj të lartë, ministra, zëvendësministra, zyrtarë publikë janë nën akuza publike nga Prokuroria Speciale dhe nga prokuroritë e tjera themelore.

Andaj, hetimet e korrupsionit të profilit të lartë mbesin të rralla dhe deri më tani nuk kanë rezultate në dënime përfundimtare.

Gjithashtu bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorisë duhet të forcohet me anë të hetimeve të përbashkëta në rastet e korrupsionit të profilit të lartë, që është kërkesë jona dhe e BE-së.

Luftimi i kësaj dukurie mbetet një prej detyrave kryesore që do të duhej të ishte prioritet për Qeverinë dhe institucionet e drejtësisë. Edhe vlerësimet për shkallën e lartë të korrupsionit ka ndikuar që Komisioni Evropian, edhe ato raporte që u përmendën nga kolegja paraprake që duhet ta vejmë në luftimin e kësaj dukurie në top prioritet të Kosovës dhe një lidhje më të fuqishme për procesin e liberalizimit të vizave.

Tenderët dhe prokurimi publik konsiderohen dhe mbeten si problem i vazhdueshëm në angazhimin për luftimin e korrupsionit, sidomos atë të nivelit të lartë dhe këto çka numërohen skandale të vazhdueshme të kësaj Qeverie të koalicionit.

Korrupsioni në këtë nivel në sektorin e shëndetësisë, të arsimit, prapë ndërlihet me mungesën e vullnetit politik dhe mbetet vetëm në nivel të deklaratave dhe shifrave inekzistente, pa ndonjë rezultat konkret dhe pa impakt në luftimin e saj.

Keni parë nga deklaratat e fundit, nga 32 raste të listuara për target të liberalizimit të vizave, gjashtë nga ato janë me aktgjykim lirues, dhe kjo e tregon logjikën dhe funksionimin e sistemit tonë të drejtësisë dhe atë që ne e themi - ndikimin e politikës së drejtpërdrejtë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sidomos që llogaritet si pjesë e saj.

Pasojat e këtij fenomeni janë tragjike për arsye se ato ndikojnë në shërbime të cilësisë më të ulët dhe rrjedhimisht në presion dhe stres në shoqëri, gjë që po rezulton që qytetarët të dalin jashtë shtetit dhe problemi kryesor qëndron tek institucionet e larta shtetërore, te të cilat interesi privat mbizotëron në ato publik.

Sipas një hulumtimi të bërë nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, del se 85% e bizneseve të anketuara nuk e kanë raportuar korrupsionin nga frika për hakmarrje. Kjo është logjika, kjo është gjendja, këto janë rezultatet dhe numri i tyre është në rritje nuk është në zbritje, qoftë nëpërmjet nepotizmit, qoftë nëpërmjet përzgjedhjes së njerëzve, individëve në pozita, struktura, të cilat ndërlihen drejtpërdrejt me tenderomaninë, luftimin dhe mosluftimin e dukurive negative në vend.

Andaj, për fund, është tragjike për vendin, për qytetarët e Kosovës dhe për integrimi i Kosovës në familjen evropiane me këtë Qeveri me skandale të vazhdueshme, të njëpasnjëshme, e kupola e saj ishte skandali i pardjeshëm tentimi për zhvatje të Buxhetit të Kosovës, të taksave për 53 milionë, që do të duhej, jo vetëm të ishte vënie e dorës në kokë e të gjithë neve, e qytetarëve, e institucioneve, por e të gjithë atyre që tentojnë dhe vazhdojnë ta zhvatin Buxhetin e Republikës

së Kosovës pa asnjë dyshim dhe pa asnjë frikë nga drejtësia, sepse ajo që po shihet - drejtësia tash është e centralizuar, e kapur, e frikshme nga ky koalicion qeverisës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Adem Mikullovc i ka fjalën. Më fal, zoti Adem se u habita, zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër zoti Haradinaj,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tema, të cilën sot po diskutojmë është një prej temave që më së shumti diskutohet, por edhe i preokupon qytetarët e vendit dhe është një sfidë që në vazhdimësi i ka preokupuar edhe institucionet e vendit në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Që nga paslufta e deri më tani vendi ynë ka kaluar në faza të ndryshme të zhvillimit politik, ndërsa lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar e ka karakterizuar vendin përgjatë kësaj periudhe, si një ndër sfidat kryesore të shtetndërtimit.

Edhe tani pas publikimit të Raportit të Progresit, apo Raportit për vendin nga Komisioni Evropian, vendi ynë vlerësohet po aq sa ka bërë në drejtim të adresimit të gjeturave nga raporti paraprak, do të thotë nga Raporti 2016. Por, pyetja që mund të shtrojmë sot për të diskutuar është nëse të gjithë mekanizmat apo institucionet që kemi krijuar e ndërtuar janë duke arritur ta kryejnë punën e tyre dhe a e kemi një pasqyrë të qartë të shkaqeve, të cilat potencialisht pamundësojnë që këto institucione ta kryejnë në masën e duhur detyrën dhe përgjegjësinë për të cilat janë edhe përgjegjëse. E para, dua ta theksoj faktin që institucionet tona kanë punuar dhe po punojnë aktualisht në krijimin e kushteve të infrastrukturës së nevojshme ligjore, si dhe në zhvillimin e resurseve humane në ndërtimin dhe avancimin e nivelit të institucioneve të drejtësisë, por edhe të institucioneve tjera, të cilat janë të lidhura direkt në luftimin e këtyre dukurive negative.

Aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm mbetet sigurimi i pavarësisë së punës së Gjyqësorit edhe organeve të drejtësisë e të rendit, në përgjithësi. Të gjithë jemi dëshmitarë se si sistemi ynë i drejtësisë e ka kuadrin ligjor, mund të them lirisht më të avancuarin në rajon, sa i përket pavarësisë së punës së institucioneve të tij. Po vazhdojmë të krijojmë këso institucione në vazhdimësi me kushte të mjaftueshme financiare, që punonjësit e këtyre institucioneve të kenë motiv më të lartë për punën e tyre, si dhe janë zgjeruar kapacitetet profesionale në secilin institucion. Mirëpo, ajo çfarë është me rëndësi tani shohim edhe vullnet politik për avancimin e agjendës për reformë evropiane, në kuadër të së cilës lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar e zë një vend kyç, por edhe në aspektin e rishikimit të drejtësisë apo kuadrin ligjor kundër korrupsionit, në të cilin vërtet mund të shpresojmë se qytetarët tonë ta rritin besimin dhe

nivelin e kënaqshmërisë me sistemin gjyqësor dhe mekanizmat tjerë institucionalë dhe në funksionalizimin e institucioneve në përgjithësi në vendin tonë.

Unë flas tash edhe i kam përcjellë edhe ligjet, të cilat kanë ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, flas edhe si anëtar i Komisionit për Legjislacion. Ministri i Drejtësisë, zoti Tahiri, është duke e bërë një punë shumë të mirë me të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës po dëshmohet si proaktive në ballafaqimin me të gjitha sfidat të identifikuar në sistemin e drejtësisë. Nëse i shohim projektligjet, të cilat ministria i ka paraparë në Programin legjislativ të Qeverisë për këtë vit, kjo nënkupton edhe objektiva të qarta për të avancuar në tema të shumta në fushën e drejtësisë, e veçmas në disa projektligje që kanë të bëjnë direkt me masat dhe veprimet për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në vendin tonë.

Ne si deputetë do të ishte mirë që t'i trajtojmë me prioritet këto projektligje, të cilat ndikojnë direkt në luftimin e krimit dhe korrupsionit, në mënyrë që ta rritim sigurinë juridike të qytetarëve tanë dhe të mundësojmë investitorët e jashtëm dhe investitorët e brendshëm që të investojnë në vendin tonë dhe ta luftojmë edhe papunësinë, sepse krahas luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar si pikë e zezë apo si preokupim për vendin tonë apo për qytetarët tonë është edhe krijimi i vendeve të punës.

Të gjitha këto konsideroj që lidhen edhe me institucionet funksionale, por edhe me një infrastrukturë ligjore të avancuar, e cila e mundëson një jetë më të mirë për qytetarët. T'i forcojmë institucionet përgjegjëse që të jenë të pavarura në punën e tyre dhe të kemi zero tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kur them “zero tolerancë”, kjo duhet të kuptohet që të kemi edhe veprime, të mos mbajmë vetëm fjalime, por të kemi mekanizma se të gjithë ata, të cilët janë përgjegjës në këtë vend, të cilët kanë pozita publike në këtë vend, duhet të përgjigjen dhe nëse ata bëjnë shkelje ligjore duhet të kemi veprime konkrete, e jo të kemi për shembull lëndë, nëse është lënda për një zyrtar, ndoshta të paktën kështu është një perceptim i qytetarëve, nëse ka të bëjë me zyrtarë politikë, pavarësisht a janë në pozitë a opozitë, konsiderojnë që nuk shkon sistemi efikas i drejtësisë, por për qytetarët shkon shpejt. Unë konsideroj se nëse një shkelje, edhe tash me kuadrin ligjor që është i avancuar, që po vjen edhe me Kodin Penal, i cili u pamundëson zyrtarëve të lartë nëse dënohen apo e shkelin ligjin në vendin e punës, për këto dukuri negative u pamundësohet të punojnë në institucione dhjetë vjet.

Andaj, unë konsideroj që ligji duhet të jetë më i shpejtë kundër atyre që po e keqpërdorin detyrën zyrtare sesa ndoshta kundër atyre që ndoshta e kanë marrë një qerre dru, atje apo ku ta di çka.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike vazhdon të jetë i përkushtuar që t'i luftojë në çdo kohë këto dukuri negative, t'i ndihmojë institucionet e vendit për t'i luftuar këto dukuri negative që po e pengojnë zhvillimin e vendit në procesin integruar dhe që po e pengojnë kthimin e shpresës së qytetarëve, sepse pa i goditur këto në vazhdimësi, qytetarëve nuk u kthehet shpresa. Unë

konsideroj se institucionet e Republikës së Kosovës, e tha edhe kryeministri, janë në rrugë të mirë, është një dinamikë e mirë dhe andaj duhet të shkojmë me këtë jo, vetëm me moto, por edhe me veprime “zero tolerancë ndaj krimit dhe korrupsionit në vendin tonë”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje.

FITORE PACOLLI: Atëherë, kryeministër, ju po tentoni ta largoni theksin nga raporti, për të cilin të kemi ftuar në këtë interpelancë. Pra, së pari deklaruat se ky raport nuk ekziston dhe gënjyet publikisht ju dhe ministrat e tu, pra Abelard Tahiri dhe Dhurata Hoxha, se ky raport nuk ekziston dhe ne po flisnim për diçka që s’ekzistonte dhe ju nuk e dinit.

Ne të kemi thirrur në këtë interpelancë të shohim se çfarë ke ti për të thënë për Raportin që kanë bërë gati ekspertët e BE-së. Pra, nuk është diskutimi për raportin në të cilin ju po e sillni, tash raportin të cilin e ka publikuar Qeveria, ka përgatitur Qeveria, apo për Raportin e Progresit, por është fjala për raportin, i cili është përgatitur nga ekspertët evropianë, të deleguar nga Komisioni Evropian. Prandaj, ne jemi të interesuar të dimë se çka mendon ti për Raportin që e ka publikuar BE-ja dhe ti po insiston që të diskutojmë sesi ti po e sheh punën e Qeverisë, e jo si po e sheh Bashkimi Evropian. Prandaj, pyetja ime do të ishte për ju kryeministër se Bashkimi Evropian po thotë se në këtë vend nuk po luftohen korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe se nuk ka as qëllim dhe as vullnet për ta bërë një gjë të tillë, e ju po thoni të kundërtën, atëherë më tregoni kryeministër a po rreni ju, apo po rren Bashkimi Evropian? Këtu duhet të përgjigjeni, sepse ju po thoni gjëra që janë plotësisht kundër asaj që ka thënë Bashkimi Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Fjala “rren” prita që vjen dikur kah fundi i interpelancës, por pasi erdh në fillim, ndoshta po rreni ju zonja Pacolli, sepse tre janë duke folur, ju jeni një palë, Qeveria dy dhe BE-ja, tre. Pra, nuk përjashtohet mundësia që edhe ju po rreni. Tjetra, nëse për dy po thuhet cili, edhe ju jeni palë në këtë rast, mund të ndodhë që po rreni ju. Pastaj, po ju tregoj diçka tjetër zonjë. Shikoni, unë e kam marrë detyrën në shtator të vitit që shkoi, jemi në qershor të këtij viti. Unë po ju tregoj çka kam punuar për rend dhe ligj, në çka e bazoj këtë punë, këtë material nuk e kam paraparë që të shpërndahet këtu, por e kemi bërë në respektim të marrëdhënieve tona me BE-në për Agjendën Evropiane të Kosovës dhe liberalizimin e vizave.

Ata evropianë që po punoj unë me ta, nuk e di a janë dy Evropa, nuk ma kanë dhënë këtë vlerësim që po e di ti. Përkundrazi, ata për pak ditë na e japin vlerësimin që Kosova është serioze në luftim të krimit e të korrupsionit dhe e meriton liberalizimin e vizave dhe të tregohet atëherë kush po rren. Me gjasë ka për të dalë që dikush aty rreth teje, apo ti po rreni.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar PSD, e ke shtypur me kartelë të Aida Dërgutit. Ok, në rregull! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt e gjithë interpelanca po bëhet rreth një raporti të cilin ne nuk e kemi, do të ishte më e lehtë ndoshta edhe për ne, edhe për t'i dhënë komentet, vërejtjet, sugjerimet, por edhe diskutimin tonë ta bazonim mbi atë raport, pasi tema e kësaj interpelance po sillet rreth këtij raporti. Pasi nuk e kemi raportin, tash është vështirë edhe të besojmë se kush po thotë të vërtetën, kush ka të drejtë ose jo, por ajo çka dimë dhe është e sigurt është se vendi ynë megjithatë ka probleme të theksuara me korrupsionin dhe luftën e pamjaftueshme kundër tij.

Siç duket, korrupsioni aq shpesh po përmendet si fjalë, është bërë pjesë e fjalorit tonë, sa që krijohet përshtypja se është një ndër fjalët e para që edhe fëmijët sapo të fillojnë të flasin e mësojnë atë, pra një ndër fjalët e para.

Dhe, unë nuk besoj se nuk ka mekanizma të mjaftueshëm në institucionet tona për ta luftuar korrupsionin. Unë po ashtu dua të besoj se ka edhe njerëz që dinë dhe i kanë njohuritë e nevojshme për ta luftuar dhe, mbi të gjitha, edhe për ta parandaluar korrupsionin. Problemi qëndron se nuk ka vullnet. Nuk ka vullnet të mjaftueshëm në këtë shoqëri për ta luftuar dhe mbi të gjitha për ta parandaluar korrupsionin, dhe përderisa ne nuk e arrijmë një konsensus mbarë shoqëror, se kjo është një e keqe nga e cila mund të përfitojë një numër i vogël, ndonëse numër i vogël ata mund të përfitojnë shumë, humbësit janë shumëfish më të mëdhenj dhe kanë shumë më shumë për të humbur. Prandaj, nevojitet një konsensus shoqëror mbi të gjitha dhe në veçanti i institucioneve të thirrura për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, e ky duhet të jetë një synim i yni, dhe jo synim se na kërkon BE-ja për liberalizim të vizave, por sepse kështu funksionon çdo shoqëri normale, çdo shoqëri që ne e marrim si shembull dhe duam të funksionojmë si të tilla.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate e kemi organizuar edhe një debat në këtë Kuvend lidhur me çfarë duhet të bëjmë për ta luftuar korrupsionin, me theks të veçantë t'i ndërmarrim veprimet e nevojshme që sa më shpejt ta marrim dritën e gjelbër që të udhëtojmë në vendet e BE-së pa viza dhe është mirë që Kuvendi pa asnjë votë kundër i ka miratuar ato rekomandime. Ne besojmë që edhe Gjyqësori, të cilit i kemi bërë thirrje që të jetë më aktiv dhe më efikas në zgjidhjen e rasteve, në trajtimin e tyre që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, ta kryejë punën e vet. Por, para kësaj ne e kishim organizuar edhe një tryezë për të marrë shqetësimet, por edhe rekomandimet e shoqërisë civile, të përfaqësuesve të mediave se çfarë duhet të bëjmë për ta luftuar korrupsionin. Dhe, disa nga këto rekomandime i drejtohen Qeverisë dhe pasi kryeministri është këtu, unë do të doja që ta vë theksin në këto rekomandime: e para është mosfunksionimi i prokurimit elektronik për të gjitha institucionet. Pra, Qeveria çfarë duhet

të bëjë është që të sigurohet që të funksionojë prokurimi elektronik, sepse problemi më i madh kur vjen puna te keqpërdorimi, e rrjedhimisht te korrupsioni, është procesi i prokurimit.

OSHP-ja ende nuk e ka bordin e kompletuar. Aktualisht i ka vetëm tre nga pesë anëtarë dhe bordet edhe të OSHP-së, por edhe të KRPP-së, janë politike. Ka një marrëveshje ndërmjet institucioneve tona, Qeverisë, Kuvendit dhe Mbretërisë së Bashkuar që këto borde të departizohen, por siç duket as kjo marrëveshje nuk është zbatuar si duhet dhe Qeveria duhet të marrë masa që t'i departizojë bordet e këtyre ndërmarrjeve, si edhe, nëse për asgjë tjetër, si shenjë që është e interesuar ta luftojë korrupsionin. Vetëm katër zyrtarë të prokurimit janë shkarkuar deri më tani, ndonëse ka edhe kallëzime penale, besa edhe aktakuza të ngritura për rastet kur ka pasur korrupsion në procesin e prokurimit. Vetëm pesë kompani janë futur në listën e zezë, gjashtë institucione janë gjobitur me nga 20 mijë euro, për shkak se nuk i kanë respektuar procedurat e prokurimit. Dhe, këtu dëmi është i dyfishtë, sepse qytetarët dy herë kanë pësuar dhe institucionet, edhe për faktin se procedurat nuk janë respektuar, e rrjedhimisht këtu është favorizuar dikush që nuk i ka plotësuar kriteret, pra ka pasur korrupsion, dhe për faktin tjetër se pastaj janë gjobitur institucionet dhe ne është dashur të paguajmë nga xhepi ynë.

Sa i përket Gjyqësorit, është e vështirë që ne sot këtu të diskutojmë për punën e tyre, sepse ata duhet ta kenë nivelin e përgjegjësisë, sepse unë besoj që e kanë nivelin e profesionalizmit, por të përgjegjësisë që këtë punë ta kryejnë përnjëmend. Pra, këtij vendi i duhen prokurorë dhe, mbi të gjitha, gjykatës të përkushtuar, për të cilët vlen betimi se ligji është mbi të gjitha. Për fat të keq, kjo nuk ka ndodhur dhe Gjyqësori ka shumë hapësirë për t'u kritikuar. Megjithatë, ne sot jemi këtu për ta thirrur në përgjegjësi Qeverinë dhe mendoj se Qeveria duhet t'i bëjë hapat e nevojshëm për ta treguar gatishmërinë për luftimin e krimit dhe korrupsionit, dhe ndoshta një hap i mirë do të ishte, ne nuk po kërkojmë dorëheqjen e kryeministrit tani, por po kërkojmë që të paktën të fillojë ta zvogëlojë numrin e zëvendësministrave, sepse përveç që është numër tejet i madh, e nuk po bëjnë asgjë, mendoj se kjo do të ishte një shenjë e mirë që Qeveria e ka seriozisht edhe ta ruajë buxhetin, por edhe ta luftojë krimin dhe korrupsionin, sepse arsyet pse një pjesë e tyre zëvendësministrave mbajnë ato pozita, unë nuk mendoj se janë për shkak të detyrave të mëdha që Qeveria nuk mund t'i kryejë, por për shkak të rahatimit të militantëve politikë, e kjo është në vetvete edhe një formë e korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuara zonja Pantina!

Për një pjesë të madhe të punës në rend dhe ligj, po i dëgjoj njerëzit kur po thonë se e kemi obligim ose përgjegjësi kushtetuese, ose detyrë, punë si Qeveri e ndiejmë. Unë personalisht e ndiej detyrën për ta forcuar rendin dhe ligjin, për t'i forcuar institucionet e rendit dhe të ligjit, për t'ua dhënë fuqinë, për t'ua dhënë mandatin kushtetues e ligjor, mundësitë operuese që t'i kryejnë punët e veta.

Rezultat i kësaj dhe që është prioritet i kësaj Qeverie kemi orë të tëra pune për ta kuptuar njëherë gjendjen që e kemi nëpër sektorë. Nëse doni krejt atyre orëve të punës dhe jo punë dekorative për ‘piar’ nesër e keni edhe këtë material pune që është për ta respektuar, merreni e shiheni me kujdes, e shihni pse. Nuk është bërë as për këtë interpelancë, as për këtë qëllim, ka qëllim prezantimin e një gjendjeje te një palë e Kosovës në këtë rast. Jo për vetveten ne, ne që e kryejmë punën, se ne e kemi detyrë, por për t’ia dhënë një pale tjetër. Dhe, nëse e shikoni në faqe 23, i gjeni sfidat. Unë nuk kam ardhur këtu që ta fsheh gjendjen në vend, as ta zbukuroj fare, po ja për shembull merreni identifikimin e sfidave për doganat dhe shiheni listën e tyre sa janë. Me çfarë vështirësish, nëse e keni raportin, e gjeni në çfarë vështirësish janë Doganat e Kosovës, çfarë është gjendja e sotme. Një dokument, pra këtë që ua dhashë sot, sfidat, i kam edhe disa kopje në shqip nëse ju nevojiten. E shihni për Policinë e Kosovës, për shembull, njëra nga sfidat është se plot prej tyre janë afër pensionimit, e kanë kaluar moshën, nuk është bërë me kohë përgatitja e brezave tjerë. Është sfidë për Policinë tonë, e të mos flasim për aspekte logjistike, buxhetore, por shiheni sa janë. Merreni shikoni në Gjyqësor, i gjeni sfidat. I gjeni në Këshillin Prokurorial, te prokurori shtetëror, te Gjykata Supreme, te Agjencia Kundër Korrupsionit.

Pra, gjendja në Kosovë nuk është që ne të lavdërohem. Por, nëse e merrni ditën një të kësaj Qeverie, punët që janë bërë deri sot, e nëse shkoni e i pyetni po këto institucione, se dikush duhet t’i luftojë, dikujt duhet t’i besojmë, kanë për të ju thënë që nga ekzistenca jonë si institucione, në mos ndryshe, që nga pavarësia, asnjëherë s’kemi qenë më shumë në funksion tonin, të vetvetes, të përkrahur, mbështetur, të garantuar në ato punët që i bëjnë. Nëse kjo nuk çmohet, ose nuk lexohet, nuk hetohet, atëherë ose po përtoni të lexoni e të interesoheni për të vërtetën, ose s’po doni hiç ta dini. Nëse s’doni hiç ta dini, në rregull, unë s’ju mendoj më shumë. Por, ju siguroj që është bërë punë në këtë vend, në këta muaj që kanë shkuar. Rezultati i kësaj pune, që nuk ka qenë e lehtë, se nuk është lehtë për të bërë rend dhe ligj në Kosovë, se nuk e di as kur fillon, as kur mbaron as e mira as e keqja në këtë vend, por për të bërë ligj, si rezultat i kësaj e kemi marrë, pra po e them edhe një herë, pikërisht nga këta që dikush po na thotë “ua kanë dërguar një raport”, pse ta fsheh unë një raport po të ma dërgojë BE-ja, menjëherë jua kisha dhënë juve nga një kopje, ose të mos fshehë as BE-ja. Nëse ma ka dërguar mua, të jua japë juve, ose nëse e ka të na shpërndajë, unë s’jam kundër që çka do që është vlerësuar dhe është gjetur, mos sot, nesër ka për t’u ditur, por ne këto i kemi bërë për ta siguruar BE-në se ky vend e meriton liberalizimin e vizave sa i përket rendit dhe ligjit dhe luftës kundër korrupsionit.

Nuk ju fola për numrin e ligjeve, se ju mund të thoni “ligje ka pasur edhe përpara, s’janë zbatuar” e ku di unë. Ok! Por, janë të dhëna konkrete, numra, shifra çka ka ndodh. Ju siguroj që Kosova ka shumë punë në rend dhe ligj, dhe në luftën kundër korrupsionit dhe llojeve të ndryshme të krimit dhe do ta ketë shumë vështirë t’i dilet krejt në breg, ama gjendja nuk është ajo që ka qenë më herët. Ka ndryshuar gjendja në vend, përkushtimi për institucionet e rendit dhe të ligjit veç e veç, qysh i keni këtu, qysh i kanë edhe sfidat të cekura, është shumë më serioz se sa që ka ekzistuar ndonjëherë tjetër. Për këtë ju siguroj, mund t’i pyesni edhe ata vetë, shkoni te

këto institucione, nuk janë dashamirë të Ramushit e Aleancës të gjithë, po pyesni, do t'ju tregojnë qysh është marrëdhënia me këtë Qeveri, a u ndërhyjmë në punë, a u japim detyra ne apo ato ua jep ligji e Kushtetuta, a i kanë mundësitë për punë dhe a kanë fuqinë ligjore e kushtetuese të respektuar prej nesh? Këtë po e bëjmë, këto detyra janë të Ekzekutivit, se Ekzekutivi s'mund të bëjë edhe gjyqësorin, edhe prokurorin, edhe vetë të bëhet hetues e policë e t'i shtijë njerëzit në punë, nuk e bën. Po pushteti, njëri prej pushteteve, në këtë rast Ekzekutivi ua jep atë hapësirë, i respekton, i jep përkrahjen që i takon njerit prej pushteteve, në këtë rast e dimë cili është. Pse? Sepse, edhe Ekzekutivi ka instrumente, e ka policinë, e ka hetuesinë, i ka disa institucione të tjera, që megjithatë ua jep një përkrahje të konsiderueshme gjyqësorit, Prokurorisë së Shtetit e institucioneve të tjera.

Nuk ndihem fare i fyer, nuk ndihem fare i ofenduar, nuk ndihem keq kur e jepni vlerësimin se nuk është gjendja e mirë në rend, ligj dhe në luftën kundër korrupsionit, se vërtet nuk mjafton. Por, nëse mundoheni të thoni se kjo Qeveri s'ka bërë, ose kjo Qeveri e ka amnistuar, ose kjo Qeveri i është kthyer gjendjes së mëhershme, jeni gabim, se e vërteta, faktet nuk e thonë ashtu. Ka një vetëdije të ngritur me ata njerëz që punojmë në Qeveri, që nuk guxojnë të vazhdohet logjika korruptive ndoshta që kanë ndodhur në të kaluarën. Ekziston kjo logjikë, unë nuk them që nuk ndodh kurrë korrupsioni, nuk kam të drejtë ta them atë, ama është një qasje e re, është një logjikë e re, është një guxim, po them ashtu, të ecet në punë.

Shihni qasjet ndaj kompanive publike, unë do të flas dikur për PTK-në, po ne s'e kemi fshehur gjendjen, e kemi nxjerrë gjendjen si është, jemi duke punuar për ta riparuar. Po flasim për KEK-un, u fol për borxhin ndaj "Bechtel-Enka"-s, jemi të gatshëm të japim çdo shpjegim, çdo llogari, por edhe ju siguroj edhe diçka. Njerëzit që hezitojnë të heqin një plagë të vogël, ajo po rritet. Unë kur kam ardhur në këtë Qeveria, kam gjetur disa infeksione që kanë qenë duke u rritur. Kjo e "Bechtel-Enka"-s që po i dëgjoj disa që po flasin e po duan ta mbrojnë Kosovën e paranë e popullit, po të kishin dashur ta mbrojnë, e kishin kryer në kohë, s'e kishin lënë 14-shin me u bë as 15, se lëre më 50.

Mungesa e atij guximi për ta ndalë të keqen kur është nisur, e ka sjellë këtu. E unë jam në atë situatë, a ta ndal tash, a t'ia lë edhe unë dikujt më pas, kush të vijë më vonë. Po, nuk është "Bechtel-Enka" Aksos, mos e harroni këtë. Nuk janë ata. Koha është para. Krejt ajo makineri, krejt ajo ngjarje, të mos e ndërroj temën, në këtë Kosovë dikush duhet të ketë guxim të thotë po edhe jo në emër të këtij vendi, e jo të frikësohet. Nëse s'ke vjedhur, nëse s'je prapa interesave të këqija, thuaj po edhe jo. Thuaj po kur është po, thuaj jo kur është jo. Ato punë po i kryejmë në emër të këtij vendi, për këtë vend, për të mos i lënë njerëzit e këtij vendi të ngarkohen me pasoja e me dëme më të mëdha.

Unë ju siguroj edhe një herë dhe po ju them kështu më seriozisht, nuk kam dëshirë të lavdërohem, por ka sot gjyqtarë e prokurorë të këtij vendi që janë duke i besuar misionit të tyre

për të vendosur rend dhe ligj në këtë vend. Ka më shumë, janë më të sigurt, janë duke e ndier atë dhe janë duke vepruar.

Ju lutem, konfirmojeni edhe këtë, se është në të mirën tuaj e në të mirën e vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, e di që ke replikë, por veç dua ta tërheq vërejtjen se minutazhi ju ik, i ke edhe kolegët e tjerë, vetëm kaq. Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

E para, kur fola për luftën kundër korrupsionit, thashë na duhet konsensus shoqëror, që nënkupton se një njeri nuk mund të luftojë korrupsionin edhe nëse ka vullnetin, edhe nëse është “supermen”. Kështu që, prapë e theksoj se na duhet konsensus i përgjithshëm dhe jo vetëm i politikës, por edhe i shoqërisë civile, edhe i medie, e besa edhe i qytetarëve.

E dyta, unë i lexova disa nga rekomandimet që kanë dalë nga shoqëria civile që i drejtohen Qeverisë. E theksoj sërish, kryeministër, në Qeverinë tuaj keni shumë zëvendësministra për të cilët nuk ka punë. Ju po thoni se ka punë në këtë vend, ka shumë punë, por jo për zëvendësministra. Edhe mënyra se si janë emëruar dhe pse janë ata zëvendësministra aty, të jep të kuptosh se ata njerëz e kanë për qëllim përfitimin e vet e të grupit që përfaqësojnë, e jo interesin e këtij vendi. Kjo në vetvete për mua është një lloj korrupsioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, kundër-replikë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E vërtetë që korrupsioni nuk është veç i formës së përfitimit financiar, ose i vendimit a i gjykimit. Disa vendime që janë në diskrecion të një autoriteti, e kanë çmimin e vet. Atë çmim ua jep dikush në fund, ose votuesi, ose përkrasësi, ose partneri, ose pala. Kënd e ka palë Qeveria e vendit? Juve ju kemi punëdhënës, ju na e kemi dhënë punën, Parlamenti, kurse palë e kemi qytetarin.

Do të punoj, e kam thënë disa herë, do të punoj që këta zëvendësministra të respektuar t’i sjellin dobi qytetarit të vendit në tema që janë me rëndësi për vendin.

(Debat në sallë)

KRYESUESI: Ju lus, mos e ndërprisni kryeministrin, se nuk...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje, me leje, veç dëgjoni pak!

Periudha kohore e misionit, dëgjo zonja Pacolli, se është mirë atëherë t'u tregosh qytetarëve të vendit dhe kolegëve tu, se ndoshta edhe ata i ke udhëhequr gabimisht. Periudha kohore e misionit nga 25 - 29 shtator 2017. Çka të them unë ty?

(Debat nga salla)

Në atë dhjetëditëshin që ia kam nisur punës, a?

(Duartrokitje)

Qe çka kam bërë, qe, merri të dytë, shiko çka kam bërë, shiko a i gjen këto... Ndal, të lutem, se...

Shikoni, veç një sekondë, ju lutem, në këtë Parlament ju kam thënë që nëse po prisni prej meje që vij t'ju kallëzohet sa të këqij kanë qenë para meje, harrojeni. E dimë sa të këqij jemi e sa të mirë jemi, a kush jemi e kush kemi qenë. As nuk merrem me këtë. Merrni ju, ruajini, bëni çfarë të doni me to.

Dhjetëditëshin e parë të Qeverisë, nëse po prisni prej dikujt t'ju japë llogari të dhjetëditëshit të parë të Qeverisë për një raport, s'po di çfarë keni menduar, nuk është detyrë imja kjo. Mua ma ka dorëzuar edhe kryeministri në shkuarje një dosje të madhe, i kam ruajtur, s'i kam çelur ende, janë aty hala.

Shikoni, prej kohës që ia kam nisur, prej asaj periudhe deri më sot, urdhëroni, shikoni raportin, shikoni çka po del, a është mirë, a është keq, shikoni të dhënat. Në cilin do vend kërkoni e gjeni, këtu e keni, për shembull, edhe shihni çfarë është kjo që po ua bien këta, periudha 25 - 29 shtator. Unë më 11 kam hyrë në zyrë, 14 ditë i paskam pasur.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjalën e ka zoti Nitaj, në emër të grupit parlamentar.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryeministër Haradinaj,

I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,

Po më vjen pak inat që "ma dogjët kartën në xhep" lidhur me këtë raport. Thirrësi i kësaj interpelance po thirret në një raport të Zyrës së Komisionit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme të Komisionit Evropian, i cili realisht nuk ka asnjë lidhje me Qeverinë aktuale.

Çështja e korrupsionit dhe krimit të organizuar është një temë shumë atraktive sa herë duam t'i thejtmë shtizat me Qeverinë dhe Parlamenti e ka për detyrë, është mirë të diskutojmë, të flasim

pa pushim, mirëpo nuk besoj se është e ndershme që të shfrytëzohet një raport i kësaj natyre, i këtyre datave dhe i kësaj kohe dhe të thirret në interpelancë kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kjo Qeveri.

Zonja Pacolli pak më herët e përmendi një informacion, një të dhënë, tha se kjo Qeveri ka bërë presion të jashtëzakonshëm në Gjykatën Kushtetuese.

Zonja Pacolli, ju duhet të thoni se kush nga Qeveria ka bërë presion, tek cili gjyqtar, kur dhe nuk po më duket që është e ndershme të abuzoni me formulime të kësaj natyre. Është shumë mirë që përmenden të gjitha dyshimet që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin. U përmenden këtu disa, një herë 8 milionë, një herë 53 milionë, u përmend “Bechtel-Enka”, por ndoshta do të ishte mirë që zonja Pacolli ta kishte vendosur në këtë listë edhe një aferë, e cila ka dalë kohët e fundit, afëra “Pronto VV”. Nuk besoj se është mirë që ne të jemi selektivë dhe ta sulmojmë një palë, po në qoftë edhe vetëm pretendim, do të ishte mirë që ta kishin dhënë një sqarim edhe për këtë aferë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë që Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes ka sjellë këtë mundësi për interpelancë për gjendjen nëpër të cilën po kalon vendi, po ajo çfarë duhet të themi është me rëndësi se kjo gjendje nuk është se ka ardhur si rezultat i kësaj Qeverie, e cila ka vetëm 9 muaj aktivitet. Kjo gjendje është trashëguar dhe me të vërtetë mirë është të trajtohet, mirë është të diskutohet dhe mirë është të mbështeten masat dhe të shtohet vullneti politik për parandalimin dhe ndalimin e dukurive negative, siç është krimi i organizuar dhe korrupsioni në vend. Por, tentativa për të përdorur dhe manipuluar me raportet e së kaluarës këtë Qeveri dhe këtë gjendje ku jemi tani, mendoj se është përtej realitetit dhe vullnetit për të pasur një disponim real për t’ju dhënë gjërave një kah të duhur dhe një mundësi reale, të cilat do të ishin në funksion të qytetarëve dhe shtetit e të vendit.

Unë mendoj se masat që ka ndërmarrë Qeveria në sistemin e drejtësisë, masat që ka ndërmarrë për të trajtuar në mënyrë reale gjendjen sociale në vend, masat në arsim, në shëndetësi, të gjitha këto masa janë aktivitete që parandalojnë mundësinë e shtimit, ose ndalojnë aktivitetin e krimin të organizuar dhe të korrupsionit. Këtu duhet vënë theksin. Se cila do të ishte faza për t’i parandaluar, sepse organet e drejtësisë mendoj se do ta bëjnë me rritjen e kapaciteteve dhe me shtimin e atyre që i ka paraparë reforma në sistemin e drejtësisë dhe ta kryejnë punën e vet. Për këtë çështje nuk mendoj se ka nevojë të shqetësohet askush.

Mirëpo, unë do të vë theksin, se për herë të parë Parlamenti ka filluar ta marrë rolin e vet ashtu siç duhet në këtë mazhorancë, në këtë Qeveri dhe është mirë, po ajo që ne po shohim aktivitetin politik brenda Kuvendit, të opozitës aktuale, me një sasi të madhe të numrave, unë mendoj se kjo opozitë aktuale do të thosha me keqardhje të madhe, po paraqitet vetëm me një aktivitet zhurmues opozitar, i cili ka humbur rrugën e arsyes dhe mundësisë për të ardhur te temat reale që do të ishin në interes të vendit, të Qeverisë dhe për të shtuar me të vërtetë kontrollin dhe monitorimin e punës së Qeverisë.

Unë i bëj thirrje opozitës që ta shfrytëzojë këtë moment që e ka, ndoshta historik, ky Kuvend duke iu referuar numrit të madh të deputetëve opozitarë dhe mundësisë së bashkëpunimit që po jep kjo Qeveri për të bashkëpunuar me opozitën, që të ktheheni në opozitarizëm real e të hiqen nga ai opozitarizmi zhurmues dhe pa tema reale dhe mundësi për t'i trajtuar çështjet në interes të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, së pari s'është në rregull që unë e thashë raportin sot. T'ju them të drejtën, duke dalë e mora për respekt për deputetët, ju tregova çka ka raporti, pse është punuar dhe çka ka qenë qëllimi i tij. Mendoj që e ka mbërritur efektin, se palët që e kanë marrë raportin e Qeverisë, e kanë respektuar si të tillë.

E gjeta edhe një send këtu që është me rëndësi ta dini ju deputetë, nuk besoj që e keni, thotë kështu: autorët e raportit janë “zoti Maurizio Varaneze, zoti Theobil dhe zonja Kamelia Bogdan”, po pastaj vijon, thotë mohim: “Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë vetëm të autorëve dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se shprehin qëndrim zyrtar të Komisionit të BE-së”.

(Debat në sallë)

KRYESUESI: Zoti Kinolli e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër Haradinaj,

I nderuar ministër,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar 6+ dëshiroj t'i them disa fjalë lidhur me këtë temë që ka të bëjë me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.

Kjo Qeveri, e udhëhequr nga kryeministri Haradinaj, së bashku me partnerët e koalicionit, përkundër sfidave që është duke u ballafaquar me tema të mëdha jetike për vendin dhe për shtetin e Kosovës, gjithsesi ka treguar edhe përkushtimin dhe guximin e saj për t'u përballur me tema që prekin interesin e popullit të Kosovës, siç është në këtë rast edhe korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Gjithashtu, plotësisht besoj që kjo Qeveri dhe kryeministri Haradinaj është më se i vetëdijshëm që korrupsioni dhe krimi i organizuar janë dhe duhet të jenë tema kryesore për të cilat duhet luftuar, punuar dhe treguar rezultat. Jemi të vetëdijshëm që korrupsioni dhe krimi i organizuar vazhdojnë të mbesin një prej sfidave më të mëdha në Kosovë. Luftimi i këtyre dukurive, të cilat janë kancer i një shoqërie, duhet të bëhet në nivelin më të lartë dhe më të madh të mundshëm për të treguar rezultate, e që dihet shumë mirë, që lufta kundër korrupsionit është kriter kryesor për liberalizimin e vizave.

Por, luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar nga Qeveria nuk besoj se mjafton pa ndihmën edhe të neve të tjerëve, qofshim pozitë, opozitë, shoqëri civile dhe institucione të tjera. Vetëm me një përkushtim të plotë të të gjithë neve, besoj në arritjen e rezultateve të luftimit të korrupsionit. Por, Qeveria duhet të jetë prijëse, e ne t'i ofrojmë përkrahje e ndihmë në luftimin e kësaj dukurie negative.

Kur them të punojmë në luftën ndaj korrupsionit, vërtet mendoj në luftë të pakompromis, në luftë që sjell rezultate në punë, që tregojnë përkushtim e djersë. E dimë se kemi ligje të mira për luftimin e korrupsionit, por është koha e fundit që të gjithë ne të tregojmë dhëmbët në luftimin e saj dhe këto ligje të gjejnë implementim. Duke u bazuar dhe besuar në vullnetin, punën, angazhimin, përkushtimin dhe guximin e kryeministrit Haradinaj për t'u përballur me sfida të mëdha dhe që t'i zgjidhë ato, ne si Grup Parlamentar 6+ dhe si partnerë të koalicionit i japim përkrahje dhe mbështetje të parezervë në rrugëtimin tonë të përbashkët në të gjitha proceset, sikurse deri më tani për të mirën e qytetarëve dhe të mirën e vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Qytetarë të nderuar,

Kolegë,

Kryeministër, më vjen mirë që po të shohim këtu!

Kur flasim për temën e sotme, besoj se duhet ndarë në dy pjesë. Fillimisht korrupsioni dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit në aspekt të vizave, ose përmbushjes formale të kriterëve për liberalizim të vizave dhe këtë temë si çështje e diskutimit në përgjithësi.

Më lejoni t'i adresoj këto dy çështje në mënyrë të ndarë. Në të parën, sa i përket përmbushjes së kushteve formale për liberalizim të vizave, unë fuqishëm besoj se Republika e Kosovës i ka

përmbushur ato dhe, në fakt, çfarë ka ndodhur është se në vazhdimësi janë paraqitur kushte shtesë dhe po vazhdojnë të paraqiten kushte shtesë, që tregon një hipokrizi të thellë nga Evropa karshi Kosovës lidhur me këtë çështje.

Do të thotë, të njëjtat kushte, të cilat i kanë përmbushur shtetet e tjera, qytetarët e të cilave lëvizin lirshëm, ne veç i kemi përmbushur, kushtet formale, po flas. Dhe, është e padrejtë që qytetarët e Republikës së Kosovës të mbahen të izoluar, përkundër faktit që ne kemi përmbushur kushte edhe shtesë në krahasim me të tjerët dhe ne mbesim si “vrimë e zezë” dhe qytetarët tanë mbesin të bllokuar.

Sidoqoftë, pjesa tjetër besoj se ka të bëjë, ose shtylla e dytë e diskutimit tim ka të bëjë shumë më shumë me këtë, edhe pse në vazhdimësi po na jepen kushte shtesë, e ajo ka të bëjë me gjendjen faktike të luftimit të korrupsionit dhe krimit në Republikën e Kosovës. Kjo nuk është duke ndodhur në nivelin e duhur për një arsye, ajo është mungesa e vullnetit politik. Vullneti politik paraqitet në disa mënyra. Më lejoni t’i theksoj një nga një dhe e shihni edhe vetë se ku jemi:

Fillimisht buxheti: e di se menjëherë kërceni edhe do të thoni “e kemi shtuar buxhetin”, por po ju tregoj se çfarë keni bërë ju është sikur të merret një njeri që s’ka pirë ujë për tri ditë e është duke dhënë shpirt dhe t’i themi “qe një pikë ujë, po ta shpëtoj jetën”. Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës është në gjendje aq alarmante, sa shtesat që ju i keni bërë në buxhet janë të pamjaftueshme, nën një.

Nën dy, organet tona, institucionet tona të drejtësisë, në fakt, as nuk paraqesin kërkesa buxhetore në përputhje me nevojat që i kanë, sepse e dinë që u refuzohen.

Ne si Komision për Legjislacion në vazhdimësi jemi munduar edhe ato pak kërkesa që i kanë pasur për shtesë të buxhetit t’i përkrahim, mirëpo edhe ato nuk kanë gjetur përkrahje. Kështu që, po ju lus që të keni parasysh se nuk mund të thoni se keni vullnet politik për të luftuar krimin dhe korrupsionin, nëse nuk u jepni buxhet të mjaftueshëm institucioneve përkatëse.

Çështje e dytë është a i keni njerëzit e duhur në vendet që duhet për ta luftuar krimin dhe korrupsionin? Nuk besoj se i keni.

Zoti kryeministër, ju edhe vetë e keni pranuar që në dy raste të mëdha që i kemi pasur, ju keni qenë jashtë rrjedhave. Domethënë, njerëzit kanë dalë jashtë zinxhirit komandues, kanë dalë jashtë mbikëqyrjes civile, ligjore që kanë dhe ju kanë nxjerrë jashtë lojës duke tejkualuar edhe kufijtë kushtetues për të ndërmarrë veprime të caktuara. Kjo tregon se nuk kemi ne sistem të duhur për luftim të krimit dhe korrupsionit apo edhe të drejtësisë në përgjithësi.

Çështja tjetër është sa u përket veglave të punës. Është e vërtetë që në aspekt ligjor është duke u ndërmarrë shumë në këtë drejtim, ose relativisht shumë, sa i përket kuadrit ligjor e kam fjalën, mirëpo prapë pjesë e veglave të punës janë edhe buxheti, edhe mjetet e punës, të cilat nuk janë duke u alokuar.

Dhe, e fundit mbetet llogaridhënia. Më herët thatë se kanë ardhur e kanë raportuar. Është shumë shqetësuese për mua kur shoh se Qeveria thërret në raportim, shpeshherë edhe sillet sikur të jetë në njëfarë mënyre shef i Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial. Njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptoni, në fakt, edhe pamjet, se po shoh që po e mohoni, mirëpo edhe pamjet edhe për ministrin e Drejtësisë, por edhe për ju e çdokënd tjetër tregojnë qartë që ata sillen thuajse janë punëtorë tuaj. Duhet ta kuptoni që Qeveria është një nga shtyllat e pushtetit. Organet e drejtësisë natyrisht i bëjnë kërkesat e tyre nëpërmes Ministrisë së Financave, mirëpo Kuvendi është ai që mbikëqyr, sepse është institucioni më i lartë.

Unë e pashë raportin që na e sollët sot dhe, në fakt, edhe pse koha shumë e shkurtër për ta analizuar, mua mu duk si raport për vazhdimin e status-quos, që në fakt nuk tregon fare se çka është strategjia juaj për ta përmirësuar. Unë prapë pajtohem me juve, unë nuk dua të flisni për të kaluarën, krejt e dimë çka ka ndodhur në të kaluarën. Tregona çka jeni duke ndërmarrë me hapa konkretë për të pasur një strategji edhe për të zbatuar një strategji që përmirëson sistemin e drejtësisë në vend? Është tejet e rëndësishme kjo punë.

Nuk është strategji të arrestohen disa persona që janë duke u marrë me drogë, ajo është veprimtari e përditshme, po shpresoj, së paku, veprimtari e përditshme e Policisë dhe Prokurorisë. Po, çfarë po bëni ju që ta zëmë hapin, nëse veç jemi prapa? Kjo po na intereson neve.

Në përfundim, unë kisha dashur të them se në aspektin e liberalizimit të vizave, prapë po them, është hipokrizi shumë e madhe dhe unë besoj se ne të gjithë duhet të jemi unikë, pozitivë e opozitë, për t'ia bërë të qartë Bashkimit Evropian, përkatësisht vendeve që janë në zonën Shengen që nuk mund t'i zgjidhin problemet e tyre të brendshme duke shtuar kushte për ne, përkundër faktit që i kemi plotësuar të gjitha kushtet formale për të qenë qytetarët tanë të lirë të lirë të lëvizin.

Mirëpo, në aspektin e dytë se sa po luftohet krimi dhe korrupsioni në Republikën e Kosovës, unë them se jemi shumë prapa dhe kërkon mobilizim jo veç tuajin, zoti kryeministër, jo veç të pozitës, nëse ne vërtet jemi të sinqertë për këtë çështje, kërkon mobilizim të tërë shoqërisë, sepse nuk kemi kapacitete, ashtu si po duket ditëve të fundit, edhe me nënshkrime që po japim të holla koti, po duhet gjetur mënyrën më të mirë të përdoren edhe burimet financiare, edhe njerëzore që i kemi për të nxënë hapin, se jemi shumë vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën, kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar Korab,

Ju jeni jurist dhe e njihni sistemin gjyqësor, prokurorial, e njihni vendin tonë dhe e dini, po them ashtu, edhe rritjen e këtij sistemi.

Ju siguroj që kërkesat që kanë ardhur prej organizatave buxhetore, rend, ligj dhe siguri janë respektuar nga kjo Qeveri. Pyetni kolegët tuaj, unë nuk mund t'u çoj para me zor atyre, po kërkesat që ata i kanë paraqitur, janë respektuar, kjo është më se e vërtetë.

Ana tjetër është, e di që askush nuk beson e të gjithë mendojnë që unë e kam pasur hallin të rris rrogën teme, le të mendojnë ashtu, edhe ajo rritje e pagave ka pasur një qëllim, nuk kemi gjetur instrumente të menjëhershëm, kemi ndërhyrë atëherë, u shkojnë gjyqtarëve e prokurorëve menjëherë.

Dëshiroj të flas diçka dhe dua t'ju lutem edhe juve ta keni parasysht. Ne nuk mund ta mashtrojmë BE-në, Evropën, se i kanë qindra gjyqtarë, prokurorë, policë këtu. As me këtë debat nuk mund t'i bindim diçka më shumë a diçka më pak. Vlerësimet e tyre për gjendjen në rend e ligj i kanë ata të vetat, unë nuk mendoj që sot po e ndihmojmë liberalizimin apo po e rrezikojmë, çka do të themi, se i kanë mekanizmat.

Ajo që kem bërë ne si palë e përgjegjshme, që po kërkon liberalizimin e vizave për qytetarët e vet, ua kemi mundësuar atyre një pasqyrë të dhënave, të gjendjes, të takimeve dhe i kemi bërë palë.

Në çdo takim që kanë nxjerrë raport, e që është në këtë dokument, se kjo është veç një përmbledhje, kanë qenë të pranishëm EULEX-i dhe BE-ja. Asnjëherë këto takime s'janë mbajtur nga Qeveria, as të fitohet autoritet mbi Këshillin Gjyqësor, as Prokurorial, vetëm Qeveria të mund të gjejë çka i ka mundësitë që t'i ndihmojmë ata në funksionet e tyre. Edhe amerikanët kanë qenë në këto takime, dhe secili që ka raportuar ka qenë i bindur se mirë është të thuhet e vërteta, të tregohet gjendja reale.

Gjendjen për liberalizim të vizave, ju lutem, duhet ta fitojmë jo për shkak tonin këtu, po është e drejtë e qytetarëve, është liri, na intereson rendi dhe ligji e kriteret për këtë i ka përmbushur Kosova, ju siguroj që po. Kosova ka plot detyra ndaj BE-së, se nuk ndalet me kaq, nëse ne dëshirojmë të vazhdojmë agjendën evropiane të reformave edhe në administratë, prokurori e gjyqësor, reformat janë të përjetshme nëse ne duam të aplikojmë për status të kandidatit, të hapim ndonjëherë negociatat a kapitujt.

Sa i përket liberalizimit të vizave, ju siguroj që puna e paraparë është e kryer prej Kosovës, kurrë nuk është mjaft lufta kundër korrupsionit dhe kurrë s'do të ndalet. Por ju siguroj që këtë detyrë Qeveria me kujdes të madh e ka kryer.

Këto raporte që i keni ju, nuk janë të sodit, janë të para një muajve së paku, Simon Mody kur ka qenë këtu, i ka marrë me veti, kanë qenë para asaj dite.

Pse i kemi bërë kështu? I kemi bërë se BE-ja është palë, institucionet e BE-së janë palë, çdo qeveri nacionale, çdo institucion i BE-së ta ketë një pasqyrë se kënd e ka palë, ndaj kujt po i afron liberalizimin e vizave, a i shkojnë prej Kosovës më shumë refugjatë jo, se një vend kaq i përgjegjshëm, kaq i saktë, transparent, i shihni sfidat, asnjë sfidë s'e kemi fshehur. Krejt sfidat që i kemi në rend e ligj, krejt janë, nëse ka mbetur ndonjë, na e thoni se e ke edhe këta. Nuk i kemi fshehur, po kemi treguar për punën që po e bëjmë.

Ndërsa lufta për rend e ligj, lufta kundër krimit, lufta kundër korrupsionit, këto nuk ndalen asnjëherë, atë si ne, si të tjerët do ta kemi të përhershme.

Është e habitshme si është përjashtuar ose iu ka pamundësuar Kosovës të jetë anëtare e Interpolit. Kjo i bie, për shembull, të mos e lësh Kosovën të bëhet anëtare e Interpolit është si ta ndihmosh krimin transnacional. Krimi transnacional është ombrella e lartë për krimin nacional, ose është punëdhënësi, në fund të fundit, i krimit nacional. Në Ballkan ka krim transnacional, është shumë i shfaqur, e nuk është vetëm i Ballkanit, po është i sferave të tjera të botës që operojnë në Ballkan. Të pengohet Kosova të mos bëhet anëtare e Interpolit, pikërisht ajo është direkt në ndihmë të krimit.

Ne kemi kërkuar, edhe ju si deputetë, të gjithë, kudo që mbërrini, ju lutem kujdesuni që të mund ta avancojmë pozicionin tonë që një ditë të jemi anëtar të Interpolit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër në largim,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht kjo interpelancë është shumë me vend dhe po mendoj që korrupsioni dhe krimi i organizuar në Republikën e Kosovës janë dukuritë më negative dhe më të shëmtuara edhe për vetë qytetarët dhe shoqërinë, e sidomos për institucionet e vendit, duke ditur se jemi një shtet i ri dhe kemi nevojë që shteti ynë të jetë sa më i fortë dhe të ketë institucione sa më të forta dhe më të qëndrueshme.

Ajo që më duhet të them është se ne duhet ta luftojmë këtë dukuri edhe si shoqëri, edhe si institucione, gjegjësisht të gjitha institucionet, jo vetëm institucionet ekzekutive, por edhe ne si deputetë, kur dihet se Qeveria raporton te ne.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam shpresuar shumë se ne si politikanë, si qytetarë të përgjegjshëm dhe njerëz që kemi marrë mbështetjen dhe votat nga qytetarët do të flasim edhe me emra, edhe me shifra. Mendoj se vetëm në këtë mënyrë mund t'i ndihmojmë këtë dukuri që të zhduken një herë dhe përgjithmonë.

Fjalimi im ndoshta do të jetë pak i gjatë, edhe pse e kam një material të shkruar dhe do të jetë pak i gjatë, por besoj se do të keni pak durim.

Unë do të fokusohem jo 10 minuta, por ndoshta pak më tepër se 10 minuta, kam të drejtën në emër të grupit të flas.

Unë do të flas për qeverisjen e Vetëvendosjes në Komunën e Prishtinës gjatë periudhës 2013-2017, e cila qeverisje karakterizohet, siç e kanë parë edhe të gjithë qytetarët, me korrupsion, klientelizëm, nepotizëm dhe kapje institucionesh.

Këta fillimisht kundërligjshëm i kanë punësuar rreth 500 militantë të Vetëvendosjes në administratën e Prishtinës, të cilët i detyronin edhe t'i digjnin institucionet me molotov dhe sikur të ishte shteti i kapur, siç thonë, do të dilnin në publik rreth 500 'pronto' qysh u pëlqen apo qysh e ka quajtur shpesh Lëvizja Vetëvendosje.

I kanë kapur edhe ndërmarrjet publike kudo që kanë mundur dhe me militantë të shumtë e kanë mbushur edhe Ndërmarrjen Publike Banesore të Prishtinës.

Po besoj se e keni dëgjuar të gjithë këtë 'pronton' e fundit, siç e tha zoti Nitaj, të para 3-4 ditësh nga njerëzit e Vetëvendosjes.

Gjatë qeverisjes së tyre kanë bërë politikë me biznese dhe biznes me leje ndërtimore dhe kanë përfituar familjarët dhe miqtë e tyre me tenderë.

Gati krejt kubëzat e rrugëve që janë munduar kishe t'i ndërtojnë në Prishtinë janë produkte të kompanive të afërta me Vetëvendosjen ose të tyre personalisht, sikur në rastin e mjekëve të Vetëvendosjes Afrim Blyta dhe Jusuf Hulaj, ky i fundit edhe kryesues i Komitetit për Shëndetësi dhe kandidat për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje.

Këta në vend se të kujdesen për shërimin e qytetarëve, për shkak të interesave financiare dhe pushtetit të kapur në Prishtinë i kanë hyrë bizneseve edhe me beton produkte, duke abuzuar kështu me tenderë të Komunës së Prishtinës herë si kontraktorë, e herë si subkontraktorë.

Pra, me kompaninë e tyre "Rub" këta i furnizojnë me beton produkte shumicën e kompanive që marrin punime në rrugët e Prishtinës, bashkëpronarë me këta dy në kompani, u kanë dalë edhe

dokumentet nëpër media, është edhe pronari i kompanisë “Rexha”, i cili gjithashtu është mik u Hulajt dhe njëri prej përfituesve më të mëdhenj nga tenderët e Komunës së Prishtinës.

Kjo kompani ka marrë tenderin edhe për rregullimin e platosë mbi Kurriz në vlerë rreth një milion euro, e cila përplot 4-5 vjet nuk ka qenë në gjendje t’i kryejë punimet dhe vetëm qytetarët që jetojnë atje e dinë se çfarë kanë hequr prej kaosit që kishte shkaktuar.

Me produktet e kompanisë “Rub” është shtruar edhe platoja mbi kurriz, edhe sheshi “Luan Haradinaj” në Prishtinë, edhe Bulevardi “Perandori Justinian” te katedralja, pra qeverisja e Vetëvendosjes tërë këto vite i ka favorizuar vetëm bizneset e tyre dhe të afërta me njerëzit e tyre.

Pastaj kemi edhe skandalin e ish-drejtorit për investime kapitale edhe menaxhimit të kontratave, Hysen Dërmishi, i cili për një vit e kishte shpërblyer me katër tenderë, përkatësisht me rreth 1,2 milion euro kompaninë “Sopi”, ku kishte punuar edhe vetë si menaxher në vitet 2009 - 2010.

Përpos që kanë bërë kasaphane me tenderë, duke abuzuar me paranë publike, këta kanë bërë kasaphane edhe me lejet ndërtimore.

Qeverisja e Vetëvendosjes në Prishtinë u ka dhënë leje ndërtimore kryesisht financuesve të tyre, militantëve partiakë dhe familjarëve të anëtarëve të Vetëvendosjes, për të cilat ka fakte dhe dokumente zyrtare, gjë që dëshmojnë për lidhjet e grupet e tyre të interesit.

Ekzistoj ndryshime të bazuara, për të cilat janë bërë edhe kallëzime penale në Prokurori, që qeverisja e Vetëvendosjes shumicën e pazareve me leje ndërtimorë i ka bërë nëpërmjet disa kompanive projektuese, të afërta me njerëzit e partisë Vetëvendosje, të cilat ua menaxhojnë pazaret sipas metodologjisë, ua bëjnë projektet ndërtuese, ua sigurojnë lejet e ndërtimit dhe u marrin banesa, lokale ose shpërblime të tjera si kompensim për ata që u qëndrojnë pas dhe që ua lejojnë ndërtimet.

Në kohën sa ishin bashkë paturpësisht njerëzit tuaj edhe hanin darka, i ftonin licencat e dhëna me fituesit e licencave të Prishtinës nëpër lokalet e Tiranës, duke ikur kështu jashtë Kosovës që të mos i shihnin të tjerët.

Ndaj politikave të padrejta që keni përdorur në dhënien e lejeve ndërtimore në mënyrë selektive në vitin 2016 kanë reaguuar 104 ndërtues, duke deponuar ankesat në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si organ shqyrtues i shkallës së dytë, ku prej 103 prej këtyre rasteve janë kthyer përgjigje në favor të qytetarëve ose ndërtuesve, pra, duke u dhënë të drejta atyre, kurse vetëm në një rast i ka dhënë të drejtë Komunës së Prishtinës.

Është dëshmuar se Vetëvendosje ka dhënë leje ndërtimi vetëm aty ku kishte interesa politike e financiare, kurse në rastet e tjera ose nuk ua kishte miratuar lëndët qëllimisht, ose kishte nxjerrë vendime të dëmshme.

Po ta përmend, se nëse djeg, “ai që e ka mizën nën kapuç”, në 99.99% të raste që janë ankuar në vitin 2016, Komuna e Prishtinës ka bërë padrejtësi dhe ua ka mohuar atyre të drejtat si pronarë të qytetarëve.

Qytetarët e dinë se për të marrë leje prej Vetëvendosjes në Prishtinë ndërtuesit duhet t’ua japin ose ndonjë kat banese, ndonjë lokal, ose edhe shpërblime të tjera të majme.

Rendi i rritjes së pabarazisë dhe i padrejtësive që ju i keni bërë ndaj të gjithë atyre që nuk janë pjesë e Vetëvendosjes vërehet edhe në vitin 2017.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 qytetarët dhe ndërtuesit kanë deponuar 79 ankesa kundër Komunës së Prishtinës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku vetëm në katër prej këtyre rasteve i është dhënë e drejtë Komunës së Prishtinës, ndërsa në 75 prej tyre përgjigjet kanë qenë në favor të qytetarëve.

Duke mos u mjaftuar me kaq, ju keni politizuar skajshëm edhe shkollat e komunës së Prishtinës, përkundër kuadrove të mjaftueshme e të gatshme që ka komuna e Prishtinës për t’i kontribuar arsimit, ju i keni mbushur shkollat e saj me plot militantë të Vetëvendosjes nga komunat e tjera të Kosovës. Pra i keni ngufatur ato me militantët tuaj, derisa kuadrot prishtinase vazhdojnë të jenë të papunë dhe të pashpresë që ndonjëherë do t’ju vijë radha ta përmbushin veten profesionalisht.

Ua keni ndërprerë menjëherë kontratat e punës shumë drejtorëve, pa e vlerësuar fare performansën e tyre. I keni larguar drejtorët e shkollave me kriter partiak dhe keni caktuar ushtrues detyre ose keni zgjedhur drejtorë të tjerë militantë të Vetëvendosjes, duke shpërfillur edhe vërejtjet ligjore të zyrtarëve të MASHT-it në komisionet për zgjedhjen e drejtorëve.

Pra, i keni politizuar shkollat, po nuk keni qenë në gjendje të ndërtoni asnjë shkollë të re dhe kjo dëshmon më së mirë se aty i keni shërbyer vetëm vetes tuaj dhe jo qytetarëve.

Jeni treguar të paaftë për t’u shërbyer qytetarëve dhe për shkak të paaftësisë, menaxhimit të keq dhe planifikimit të dobët të buxhetit të Komunës së Prishtinës ju keni humbur mbi 100 milionë euro gjatë mandatit të parë.

Komuna e Prishtinës për ato katër vjet sa ka pasur një buxhet prej 305.52 milionë eurosh, ndërsa ka arritur të realizojë vetëm 204.47 milionë euro, duke bërë kështu që kryeqyteti të mbetet pa 101 milionë investime kapitale dhe shërbime të tjera.

Pra, Vetëvendosje e ka marrë qeverisjen në Prishtinë me një buxhet prej 80.78 milionë euro, ndërsa e ka mbyllur mandatin e parë me një buxhet prej 70.77 milionë eurosh.

Vetëm nga të hyrat vetjake humbjet e shkaktuara nga keqqeverisja e Prishtinës aso kohe kapin shumën prej 30.88 milionë euro për tre vjet e gjysmë.

Por në katër vjetët e qeverisjes kishit planifikuar edhe 141.79 milionë euro investime të ndryshme në projekte kapitale, të cilat nuk i keni realizuar fare.

Nga ato plane keni realizuar vetëm 66,50 milionë euro investime, ndërsa keni lënë pa investuar gjithsej 75.28 milionë euro të këtyre projekteve, sepse nuk keni mundur t'ua jepni çdo projekt kompanive tuaja apo të afërmeve tuaj.

Pra, zoti Dardan, besoj se si nënkryetar i di ato, edhe një herë, zoti Dardan, besoj që i dini të gjitha ato që i keni bërë, e sidomos si ekonomist i shquar edhe shifrat besoj se ju kanë lënë, e keni parë që 101 milionë euro për qytetarët e komunës së Prishtinës nënkupton jashtëzakonisht shumë, kur me 101 milionë euro kanë mund të investohen shumë e shumë e shumë investime.

Pra, zoti Dardan dhe të gjithë të tjerët, Vetëvendosja që e ka udhëhequr Prishtinën, e di që atëherë keni qenë bashkë, nuk nënkupton vetëm për ju, ju me paratë e qytetarëve keni blerë banesa nëpër Shëngjin dhe shëtitni me jahte nëpër Mal të Zi, kurse në Kuvendin e Kosovës e nëpër institucione të tjera kishit fytyrë derisa nuk ia nxorët edhe vetë llumin njëri-tjetrit.

Unë i kam edhe disa emra, por nuk po dua të bëhem shumë i tepërt, besoj se e keni pasur edhe raportin e Auditorit të Përgjithshëm, emrat dhe kontratat mbi vepra që kanë qenë rreth 500 të tjerë, e besoj se po të kishte shtet të mirëfilltë, po të kishte institucione që e ndjekin krimin, do të ishin marrë qysh moti me këto, sepse 500 persona ju, e keni parë edhe në raportin e auditimit sa ka qenë shuma complete që është keqpërdorur buxheti i qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Korab Sejdiu ka replikë, edhe Dardani ka replikë. Korabi e ka pasur më herët, po nuk e kam parë. Mirë, mirë, edhe ty ta jap fjalën, po Korabi një herë.

KORAB SEJDIU: Më falni, se ndoshta distanca pak po e huq mundësinë.

Veç shpejt për kryeministrin, tha që çdo kërkesë e njërive buxhetore që i përkasin sistemit të drejtësisë iu ka përmbushur buxheti, në fakt, në Komisionin për Legjislacion pothuajse secila

prej tyre ka ardhur me kërkesa, të cilat nuk janë aprovuar, nuk kanë kaluar dhe nuk janë bërë pjesë e buxhetit të Republikës së Kosovës, po flas në kohën kur është miratuar Ligji për buxhetin e vitit 2018.

E dyta, edhe vetë në këtë raportin që na dhe si sfida, pothuajse secila prej tyre ankohet për mungesë buxheti, për mungesë stafi dhe për mungesë të mjeteve të tjera të punës, kështu që unë s'po di qysh është kjo punë.

Edhe çështja tjetër, unë të përgëzoj që jua ke rritur rrogat ose ke tentuar t'ua rritësh rrogat gjyqtarëve, unë e përkrah shumë atë, përveç që s'kanë mjaft mbështetje, kanë edhe rroga të pamjaftueshme për pozitën dhe rolin që e luajnë, po fakti qëndron që nuk mjafton veç t'u rriten rrogat, kanë nevojë për numër më të madh të gjyqtarëve, për digjitalizim, kanë nevojë për bashkëpunëtorë profesionalë, të cilën po shpresoj që në Projektligjin për gjykatat do ta fusim si obligim për Qeverinë t'u alokohen mjetet, e kështu me radhë.

Të mos marr shumë kohë, po ideja është që të mendohet pak më gjatë, me strategji, të mendohet për buxhet më të madh, ndoshta se sa e kërkojnë vetë, sepse duhet të ketë një strategji shtetërore për përmirësim të drejtësisë në përgjithësi, që përfshin edhe luftimin e krimit e korrupsionit.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Gjatë hartimit të buxhetit është negociuar me krejt organizatat buxhetore, organizatat e rendit dhe të ligjit kanë paraqitur një gjendje të caktuar, e cila është përfshirë në atë kohë.

Njëkohësisht edhe në raste të tjera, kur kanë ardhur me kërkesa shtesë, u janë përmbushur, kemi raste konkrete, mund të jap një evidencë, po janë përmbushur edhe kërkesa të tjera.

Unë e di që ky buxhet nuk mjafton, edhe atë që ua dhamë si sfida është për t'iu treguar me çka përballet sistemi ynë gjyqësor, prokurorial, hetimet, policia, AKI-a, ushtria jonë.

Jemi në proces e sipër, se alokimi i fondeve ju e dini çfarë instrumentesh përdoren, nëse është i planifikuar me kohë, nëse është buxhet i rregullt, dy është në një ndërhyrje që mund të ndodhë, po ato janë të kufizuara, në bazë të kërkesës së posaçme, tre mund të jetë rishikimi dhe së fundi prapë buxheti që vjen, ndonjë rezervë, pra ato mundësi që janë, po vërtet institucioneve të rendit dhe të ligjit ua kemi respektuar kërkesat.

Një shembull i caktuar, ndoshta është e tepërt të thuhet, po në dogana, për shembull, uniforma nuk kanë, dogana prodhon kaq shumë para për Kosovën, kryen punë të ndjeshme e nuk kanë

uniforma, kanë mungesë të makinave, ju i shihni, nuk i kanë thënë të gjitha, i kanë disa mungesa krejt të thjeshta dhe kur i kam pyetur pse s'i keni kërkuar, thanë po kemi hezituat, ku ta di unë.

Policia e Kosovës kanë pasur orët shtesë të papaguara që 20 vjet, i kanë marrë për ato orë shtesë. Janë bërë disa ndërhyrje që kanë qenë elementare, jemi këtu për më tutje.

Jam thellë i bindur që Kosova duhet t'u japë përparësi institucione të ligjit dhe t'i përkrahë edhe me buxhet, edhe me kuadër, po kryesorja është të lihen të lira në mandatin e tyre, pra të fuqizohen në atë mandat kushtetues e ligjor.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Dua thjesht të replikoj me fjalën që e mbajti zoti Çoçaj dhe dua të jem i shkurtër e konciz.

E para, e ftoj nga këtu kryeprokurorin e Republikës së Kosovës që të intervistojë zotin Çoçaj për krejt këto dëshmi që po pretendon që i ka për keqpërdorim. Mendoj që ku më mirë se në televizion nacional dikush të prezantojë kaq shumë fakte, e ku më mirë se nga këtu kjo të përdoret për të filluar diçka që po pretendon zoti Çoçaj që ekziston. Në fakt, këto pretendime bëhen prej datës 4 janar të vitit 2014, të njëjtat fjalë përsëriten vit pas viti dhe të njëjtat fjalë janë përdorur e stërpërdorur, bile-bile sekretari i tyre ka dërguar edhe kallëzime penale në Prokurori, e që janë hedhur poshtë.

Në anën tjetër, është pikërisht kryetari Shpend Ahmeti, i cili ka ngritur kallëzime penale, për të cilat kemi vendime gjykatash, njëra ishte për mashtrim me naftë, tjetra për ndërtime pa leje dhe këtu në raportin që po na sillni sot, ato dyja janë gjithsesi të përfshira në statistikat pozitive të këtij vendi për luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Në anën tjetër, është pikërisht Komuna e Prishtinës nën qeverisjen e kryetarit Shpend Ahmeti, e cila vit pas viti vlerësohet si komuna më transparente në Republikën e Kosovës, e pra atëherë meqë Shpendi është transparent e meqë zoti Çoçaj i paska dëshmitë, kjo qenka fare e thjeshtë, le të lajmërojë në Prokurori të gjitha këto dëshmi dhe zoti Shpend Ahmeti është i gatshëm si gjithherë të përgjigjet në mënyrë të hapur.

Përfundimisht nuk ka kuptim, nuk ka kuptim që në vend të dëshmive të bëhet betejë me shpifje. Nëse ka dëshmi, vendin e thashë, nëse vazhdojmë me shpifje, atëherë të mos pritët që të bëhet diskutimi edhe racional, edhe serioz, e që besa edhe i sinqertë për temën, e cila unë mendoj është një prej më të rëndësishmeve sa i përket potencialitetit të trajtimit të sfidave në këtë Republikë.

Në fund fare, zoti Çoçaj, në Komunën e Prishtinës të gjitha raportet janë publike, siç e ka thënë edhe “Demokracia Plus” para tri jave. Në fakt, është e vetmja komunë që i publikon çdo tre muaj të gjitha raportet, në fakt, është e vetmja komunë në Republikën e Kosovës, e cila i ka të gjithë informacionin on line, me sa e di edhe Gjakova e ka këtë dhe është e vetmja komunë, Komuna e Prishtinës, e cila reagon me kohë sa u përket kërkesave të qytetarëve dhe kjo dëshmohet edhe nga raportet e organizatave të shoqërisë civile.

Unë edhe një herë të bëj ftesë ty e kryeprokurorit, shkoni, ja ti te ai, ja ai te ti, edhe këto farë akuzash e shpifje që i bëre t’i transferosh në dëshmi, e nëse qenka kjo e vërtetë, atëherë përfundojmë me luftë kundër krimit të organizuar e korrupsionit. Po fatmirësisht e kundërta është e vërteta dhe fatmirësisht qytetarët e Prishtinës këtë e kanë parë edhe gjatë fushatës që e keni bërë ju në zgjedhjet lokale, edhe në qeverisjen e kryetarit Ahmeti, po gjithsesi edhe në punët që po bëhen në kryeqytet.

E tash me Ligj të Prishtinës, në të cilin ndihmoi edhe kryeministri Ramush Haradinaj, do të ecim edhe më shpejt, edhe më mirë, e me gjasë në Prishtinë qeverisje nuk do të keni.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Dardani tha do të flas shkurt dhe konkretisht... Jo, jo, çfarë dy-tre, katër e kusur ishin, por ne jse. Sido që të jetë, e kemi të drejtën për të folur edhe në emër të grupit, kështu që kemi minutazhën, s’e kemi replikën të limituar në 2 minuta. Unë të falënderoj zoti Sejdiu, unë e di që është përgjegjësi jona publike, e thashë edhe në fillim të fjalimit tim për të folur me fakte dhe me shifra.

Besoj që i keni parë edhe raportit e Auditorit të Përgjithshëm, e Auditori i Përgjithshëm e ka një përgjegjësi të tillë që flet shumë me fakte. Ju e dini sa i keni të punësuar, sa i keni pasur të punësuar me kontrata mbi vepër, nuk ka pasur asnjë komunë dhe s’ma merr mendja asnjë institucion të tillë, e kjo praktikë ka vazhduar ende dhe po vazhdon në komunat që qeverisen, e njëjta gjë po përcillet, ajo përvojë ndoshta e keqe edhe në Prizren. Kështu që sa i përket kryeprokurorit, unë jam deputet i Kosovës, këtu jam ku të dojë ai, qysh të ketë qejf ai, kur të ketë qejf, edhe të dielën, edhe të shtunën, edhe 24, edhe 23 orë, kur të dojë ai me këto që i kam. Por, unë jam si deputet dhe si parti politike jemi të interesuar sinqerisht ta luftojmë, jo me moralizim e me demagogji, por thjesht me fakte dhe me shifra. Ju e dini që ka aktakuza të ngritura, por nuk janë pjesë e institucioneve të ndjekjes profesionale, si prokuroria dhe gjykatat që marrin vendime, por do të jem i fokusuar që t’i shikoj të gjitha këto aktpadi se si do të përfundojnë.

Unë dëshiroj që edhe prokurorët të gjejnë fakte, dhe ata që e shkelin dhe keqpërdoruesit, e sidomos këta që merren me krim të organizuar, e dini ku e kanë vendin, pavarësisht kush është,

çfarë emri, çfarë mbiemri dhe cilit subjekt partiak ka. Unë jam i interesuar për ta luftuar sinqerisht. Ne kemi pasur edhe me kolegë, edhe zoti Haxhiu e ka përmendur disa herë, Bekim Haxhiu, por edhe Milaim Zeka me fakte, dokumente dhe argumente, por të njëjtën gjë nuk e kam besuar që mund të flitet në këtë mënyrë. Unë jam për të folur në këtë mënyrë shumë hapur edhe kundër meje nëse keni diçka, ose kundër partisë sonë, ose kundër qeverisjes sonë. Keni pasur qeverisje dhe jeni marrë me demagogji, sidomos me kryetarin e Komunës së Prizrenit, që besoj që të gjithë qytetarët e dinë... Po, mua më dhemb Prizreni, sepse ka qenë Ramadan Muja dhe i dini vlerësimet që i kanë bërë për Prizrenin, e keni njeriun e juaj në Vetëvendosje dhe ka mundësi të bëhen krahasime, metoda e krahasimit është shumë e lehtë edhe kemi për ta parë, çka ka për të bërë njeriu i juaj në Prizren dhe çka ka bërë Ramadan Muja, që është një histori e gjallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,
Kabinet i Qeverisë,

Le ta shtrojmë pyetjen qysh në fillim, si bëhet që Kosova ka kaq shumë krim, e korrupsion, e dështim të sistemit të drejtësisë dhe ministrat e drejtësisë kurrë nuk u shkarkuan a dorëhoqën, asnjëri, asnjëherë? Kjo ndodh për shkak se në Kosovë nuk ka sistem të drejtësisë, sepse drejtësia është aksident, sepse padrejtësia është sistem, pra sepse në Kosovë ka sistem të padrejtësisë. E, kjo ndodh meqenëse krimi është në sistem dhe shpesh krimi i shfrytëzon edhe mundësitë e sistemit. Në fakt, kur u zunë 48 kg drogë nga Policia e Kosovës, krimi jashtë sistemit pati dështuar. Mirëpo, ishte krimi brenda sistemit ai i cili e korrigjoi këtë. Policisë së Kosovës iu vodhën 48 kg heroinë, përderisa kjo po i ruante ato. Dhe, ky nuk është rasti i vetëm i vjedhjes së Dhomës së Dëshmive, është vjedhur edhe ari aty në dhomën më të sigurt në Kosovë, siç do të duhej të ishte.

Prandaj, ne e dimë që këto kanë ndodhur në të kaluarën, mirëpo gjatë kësaj qeverisjeje 9-mujore nuk kemi përgjigje për krimet për të cilat në vazhdimësi nuk kemi drejtësi. E, drejtësia po vonohet, që do të thotë se drejtësia po mohohet, që do të thotë se krimi po gjallëron.

Nuk ka mënyrë më të mirë për ta mbrojtur krimin dhe korrupsionin sesa të thuhet që ai është kulturë. Krimi e korrupsioni janë sistem, nuk janë kulturë. Ka njerëz që paguhen dhe janë përgjegjës për ta luftuar krimin dhe korrupsionin dhe ata nuk po e bëjnë këtë. Nuk mund ta fajësojmë tash kulturën e popullit apo shoqërinë e njerëzve tonë në përgjithësi për krimin dhe korrupsionin, i cili ka adresë të caktuar se nga kush duhet të luftohet. Gjykata duhet të jetë, në një shtet demokratik, e pavarur nga Qeveria, por jo nga shteti. E kundërta vlen në Kosovë. Kemi gjykatë e gjykatës të pavarur nga shteti i Kosovës, përfshirë këtu edhe EULEX-in, pra të pavarur nga Republika jonë dhe aq të varur nga Qeveria e regjimi në fuqi.

Buxheti që ndahet për sistemin e drejtësisë është diçka më shumë se 2% dhe kjo është tepër pak, e tregon përkushtimin qeveritar për këtë dimension kaq të rëndësishëm të shtetndërtimit në Kosovë.

Është e domosdoshme që të bëhet ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për luftimin e krimit dhe korrupsionit, sepse është bërë dukuri e përgjithshme që të bëhet gjykimi në shkallë të parë, pastaj në Apel, pastaj në Supreme, pastaj gjithçka prej fillimit nëpër seanca shumë të rralla. Më tutje, probleme janë edhe dëshmitarët, të cilët dihet që flasin nëpër kafene, por jo edhe në sallë gjyqi. Mandej deklaratat ndryshohen gjatë hetimeve pa pasoja në gjyq. Nuk mjafton dija juridike, nevojitet edhe ajo mbi financat e prokurorëve dhe e gjykatësve, sepse nuk dëshmohet kollaj krimi financiar. Duhet të bëhen trajnime për gjykatës e prokurorë, përfshirë këtu edhe praktikën evropiane, përkatësisht për Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut, dhe sidomos është i domosdoshëm riorganizimi komplet i provimit të jurisprudencës.

Kapitujt më të rëndësishëm përgjatë negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dihet që do të jenë ata 23 dhe 24: Gjyqësori, Të Drejtat Themelore dhe Drejtësia, Liria e Siguria. Qeveria është për integrim në Bashkimin Evropian, unë besoj për shkak se jemi shumë larg anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Po të ishim afër anëtarësimit, Qeveria do të ishte kundër anëtarësimit. Sikur Gruevski dikur në Maqedoni, që në fakt ishte kundër anëtarësimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Qeverisë së Kosovës dhe Presidentit të Kosovës nuk u konvenon anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, sepse anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të ishte lëvizje e Kosovës majtas dhe kah rendi e ligji. Qeveria aktuale është për Bashkim Evropian vetëm se e di se as afër nuk është kjo që të ndodhë tash për tash.

Ky raport i cili është bërë nga këta tre ekspertët, është e vërtetë që e ka aty shënimin “disclaimer”. Ajo është vërejtje. Në çdo raport ka një shënim të tillë formal, kurtuazie, tamam sikur donatori kur e financon një organizatë joqeveritare dhe nuk merr përgjegjësinë për të gjitha hollësitë e atij raportit. Por, raporti është i vlefshëm dhe unë do ta kisha inkurajuar Qeverinë që të merret me të gjeturat e tij, meqenëse janë shumë problematike për shtetndërtimin, e posaçërisht për drejtësinë në Kosovë.

Për shembull, thuhet që mundësia e autonomisë së prokurorit për të hedhur poshtë raportet kriminale të Policisë, pa filluar fare hetimet në nivel prokurorie, është shumë brengosëse. Në anën tjetër, vendimi rreth ekzistimit të dyshimit ose jo, është tërësisht në duar të Policisë. Pra, nuk ka një llogaridhënie për këtë. Këto janë elemente të shtetit policor. Ose: nuk ka një definim të korrupsionit të nivelit të lartë dhe korrupsionit të zakonshëm dhe kjo është po ashtu shumë brengosëse. Ose: prokurorët janë më shumë të përkushtuar për t’i zgjidhur rastet e lehta, duke injoruar hetimin e rasteve të krimeve serioze ekonomike. Pra, ka një tendencë të përgjithshme të prokurorëve që të merren me raste të lehta, jo me raste të rënda. Ka pa fund gjetje shumë të vlefshme në këtë raport, me të cilin Qeveria do të duhej që të merrej shumë seriozisht.

Dhe, krejt në fund, kryeministri aktual i kësaj Qeverie të pakicës, ju e mbani në mend që para dy vjetësh ata që i ka sot partnerë i pati quajtur “autorë të kapjes së shtetit”. Nuk ka më shumë se dy vjet kur ky kryeministër i ka quajtur “autorë të kapjes së shtetit” ata që tash i ka partnerë në qeverisje. Unë besoj, kryeministër, që shteti është i kapur. Pyetja ime është, a besoni ju që Kosova vazhdon të jetë shtet i kapur siç keni thënë para dy vjetëve? E nëse nuk besoni, a mund të na jepni datën kur u shkap? Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar Albin!

Shumë prej konstatimeve tua janë të vërteta dhe gati të pashë si një udhëheqës, si një lider parimor, por po i bën disa gabime faktike që s’po kam qare pa t’i thënë që s’po të shkojnë për shtati. E para, as në kohë, as në hapësirë, as në çfarëdo matematike s’mund ta krahasosh një Qeveri Haradinaj me Qeverinë Gruevski. Nuk takon ta bësh. Ti mundesh, ndoshta je ekspert të gjesh diçka të ngjashme në atë qeveri me këtë, por prapë nuk është ashtu, mos bë këso gabimesh, se mund të tregoj pse nuk është ashtu.

E dyta, nëse unë dua të shkoj në Evropë, unë nuk shkoj majtas, e në ligj, por shkoj drejt, djathtas në ligj, që ka këtu pikëpamje politike të ndara, në Evropë nuk janë krejt të majtë, janë disa të djathtë, dhe e treta, hiç s’më pëlqeu që e more rolin për ta shpëtuar raportin. Lëre atë raport, u pa që ishte i shtatorit, raportet zyrtare nuk e kanë atë mohimin kur i bëjnë institucionet e tyre. Disa raporte që bëhen për ndonjë të gjetur të caktuar, e nxjerrin atë mohimin që institucionit të mos i adresojë dikush pikëpamje të caktuara, por vetëm njerëzve që i kanë shkruar. Ato përvoja i kemi kaherë, i dimë të gjithë që ndodhin. I vetmi raport zyrtar që ka Kosova është Raporti i Progresit, “Country Report” e keni, i gjeni të dhënat çka kanë thënë. Unë nuk i vë në pikëpyetje disa të gjetura që i nxjerrim nga ai raport për prokurorin, për policin, për marrëdhëniet ndërmjet tyre, unë shpesh dëgjoj, më thotë polici unë e arrestoj, por prokurori po i lëshon në procedura të rregullta, gjyqtari a dikush. I kam dëgjuar këto. Këto i kemi, s’kam pasur nevojë të shkoj te ai raporti bile që t’i shohë që janë ashtu.

Por, dëshiroj të ju them edhe diçka tjetër. Në marrëdhëniet e një kryetari të Qeverisë me Parlamentin duhet pasur disa korniza të caktuara. Unë shumicën e respektit që e bëj kur reagoj, nuk e kam veç për njërin prej nesh këtu, por e kam po edhe për shkak të 2 milionë njerëzve që janë të këtij vendi. E për këtë arsye po ju them që kjo Qeveri është thellë e interesuar, kryetari i Qeverisë, ata që punojnë me ta, për t’i afruar BE-së. Për të hyrë, nuk e di se ende s’kemi ardhur aty, por kjo Qeveri e ka interes jetik të ecën drejt BE-së. ERA, Agjendën Evropiane e kemi kthyer në planprogram tonin, partneritetin me institucionet e BE-së këtu e atje, e kemi kthyer në dinamikë të përditshme, aq sa dimë, aq sa mundemi. Nuk jemi më të mençurit në tema evropiane, por me atë kapacitet që kemi. Por, vullnetin nuk mund ta kontestosh, pyeti evropianët

këtu, pyeti evropianët tjetërkund, a është kjo Qeveri vërtet e fokusuar në zbatim të agjendës evropiane.

Nuk jemi të kënaqur me rezultate, po, por nuk është që ne po i frikësohemi të hyjmë në Evropë. Mos e thuaj këtë për këtë Qeveri. A ka qenë kështu ndonjëherë? A mund të jetë edhe në të ardhmen ndonjëherë, thuaje s'ka dert, por jo sot. Po punojmë për të shkuar kah statusi i kandidatit dhe dëshirojmë të aplikojmë kur të jetë një kohë optimale për këtë dhe nevojitet ndihma e të gjithë juve. Unë mund të ju them edhe diçka, institucionet e BE-së, por s'kam dashur ta them këtë, kanë ardhur e janë takuar me deputetët, a e di çfarë na kanë thënë? S'kanë lidhje deputetët se çka është duke ndodhur Kosovë - BE! Nuk janë duke i lexuar materiet, nuk janë duke i lexuar materialet, nuk janë duke u marrë me temat, mirë është të hyjmë në temë. Na kanë thënë edhe këtë, për fat të keq, "duhet shumë më shumë ta ndihmoni Parlamentin për ta kuptuar se çka është duke ndodhur". Gojarisht, nuk e kam me letër, s'kam të drejtë t'ua them emrin, por ma kanë thënë këtë, disa herë, "ju lutem, shkoni punoni me Parlamentin tuaj, se nuk po e përcjellin dinamikën e juaj, të Qeverisë".

Kjo është e vërteta. Shikoni, për shembull, tash kur po flasim, në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, mbledhja e ardhshme mbahet këtë të martë, është në rend ditës një pikë e rendit të ditës, është adresimi i zonjës Apostolova Qeverisë së vendit. Është vetëm për prioritetet e agjendës evropiane dhe për zbatimin e detyrave që do t'i marrë kjo qeveri.

Nuk e di ku po i gjen këto konstatime që kjo Qeveri nuk paska dëshirë ta dërgojë vendin kah BE-ja! S'po di ku po i gjen, burrë, qysh po i nxjerr! Shiko, ai është konstatimi, janë zëvendësministrat po na penguakan që të shkojmë në BE, a është aty problemi? E, po mirë atëherë kallëzoni, burrë! Mirë, mirë e kuptova.

Shikoni! Prej natyrës po ju them së pari, e kam guximin edhe qytetar, edhe njerëzor, edhe tjera. Pse dikush në këtë vend po mendon ta ndalë vendin e vet të mos shkojë drejt BE-së, ose të mos i ndihmojë vendit të vet për të shkuar drejt BE-së? Nuk po e shoh çfarë logjike kjo për të folur kështu, jo përkundrazi jemi duke bërë bukur punë, bukur sakrificë që të shkojmë kah BE-ja në kohë të duhur. Ju kisha siguruar në të që çdo ndihmesë që mund ta jepni që të shkojmë më përpara drejt BE-së, jemi për.

Për kapjen e shtetit, a është shteti i kapur, shiheni raportin, burrë, e tregon raporti, krejt t'i qet. Shihe qysh është gjendja e sfidave, ja 23, 24, 25, e sheh sa të kapur jemi? Kemi probleme me rend e ligj, edhe me çdo gjë. Kemi plot probleme në Kosovë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit, kryeministër! Për replikë, zoti Albin Kurti! Urdhëroni!

ALBIN KURTI: pikërisht për shkak se jemi shumë larg anëtarësimit në Bashkimin Evropian, është kollaj për të qenë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Sa më afër që vijmë tek anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të shfaqen grupet e interesit që s'ju konvenon Bashkimi Evropian.

Zoti kryeministër, në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ju nuk do ta mund të bënit një kontratë me Countour Globalin çfarë e keni bërë. Unë nuk po them që ju frikësoheni që të shkoni në Bashkim Evropian, nuk po them as që nuk doni të shkoni në Bashkim Evropian, por po dua të them që kur të vijmë pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian, grupe të ndryshme të interesit, edhe qeverisja e Kosovës do të ndodhen në konflikt interesit. Nuk është e rastësishme që Kroacia nuk e ka dërguar kryeministrin e vet në burg kur ka qenë 15 vjet larg anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por kur ka qenë bukur afër anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Duket që ne edhe 7, 8, 10 vjet nuk hyjmë dot në Bashkimin Evropian, prandaj është ky komoditeti ku të gjithë janë për Bashkim Evropian. Këtë po e them, s'po them që ju frikësoheni, as nuk po them që ju s'doni, por po dua të them që qysh është kapur shteti i Kosovës, kapësit e shtetit nuk do të kenë interes për të hyrë në Bashkimin Evropian. Kjo është e para.

E dyta, nuk m'u përgjigjet në pyetje, është shumë e thjeshtë dhe vendimtare. A është shteti i Kosovës i kapur? Nëse nuk është, në cilën datë u shkap? Shumë thjeshtë është kjo. Dhe, kur të afrohem kah BE-ja, të hyjmë në BE, kjo do të jetë lëvizje e majtas, se më djathtas s'ka ku shkon. Me 10% tatim nuk ka ku shkon më djathtas, domethënë tash 5%, ose 0 nuk është e mundur. Që thotë një fjalë ironike britanike "veçse vdekja dhe tatimet janë të pashmangshme, për të parën s'jemi të sigurt". Do thotë nuk mund ta bëjmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Replikë dy minuta i keni pasur. Urdhëroni, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Tani këto ditë ka qenë një debat për ambientin dhe ishte një zyrtar suedez. Natyrë më të bukur se në Skandinavi s'di që ka dhe flisnim për ambient, e po i them unë "a bën të ju pyes diçka, kjo vetëdija juaj për ambientin, a e keni pas tërë jetën, a ju ka ardhur më vonë?". Disa prej këtyre vendeve i kanë kryer disa punë në një etapë, i kanë hapur disa vende të punës, janë zhvilluar, e kanë ndotur ambientin, i kanë krijuar disa parametra, e pastaj kur i kanë kryer këto urgjenca kanë filluar të mendojnë për gjelbër, për ajër, për dieta, e ku e di unë.

Por, njëherë kanë kaluar nëpër zhvillim. Pse po e them këtë? Shikoni, në Kosovë plot gjëra që ndodhin nuk janë standarde të BE-së. Plot kompani, plot investime, plot rrethana, se sikur të ishin as s'kishim folur për to atëherë. Por, ne jemi bukur larg anëtarësimit në BE, edhe s'kemi pse të frikësohemi tash, as t'i kallëzojmë popullit që kjo klasë politike po frikësohet. Hiç mos e

tremb klasën politike, krejt kemi për të hyrë në BE, kemi për t'u kënaqur. Më mirë është për ne të hyjmë në BE më shpejt dhe le të na ndalin atëherë këto kriteret e punës që ne po i bëjmë sot, cilado qofshin. Contour Global, shiko, e kemi përsëritur edhe në të kaluarën, dhe po flas edhe një herë. Presidenti Trump tash e ka rikthyer si resurs strategjik qymyrin. Unë e di që kontinenti jonë e ka hequr, por nuk është bota në fund të fundit në ekonomi veç Evropë. E ka rikthyer me dekret qymyrin në resurs strategjik. Ka artikuj, ka publikime për këtë.

Shikoni, ne po duam të ecim edhe ne dika, se s'mund të qëndrojmë këtu ku jemi.

A është shteti i kapur, Albin? Shiko, unë kam ardhur kryetar Qeverie prej 11 shtatorit e kam marrë, s'di sa ka qenë data. Unë përnjëmend jam duke ndihmuar dhe dëgjoni, pyetni institucionet e rendit dhe të ligjit, a jam duke i ndihmuar që t'i ushtrojnë funksionet në bazë të mandatit të vet. Nuk e kam prej këtij shteti ndonjë farë behane që më mban e më shantazon, e më kushtëzon, që unë të mos ta përkrah rendin e ligjin. Nëse ka dikush një çka do qoftë, le ta qet burra, gra, çika, a ka një problem të çfarëdo natyre. Nuk më mban Hashimi, Kadriu, Albini, Avdullahu a tjetri, hiç... Hiç, mos e mbani kurrnjë, s'mund ta mbani... Por, për ato që kam hyrë në obligime, atë bisedë, atë partneritet e di që e respektoj dhe do ta respektoj.

KRYESUESJA: Faleminderit, kryeministër! Fjalën e ka deputeti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesuese!

Kjo interpelancë, normalisht edhe tema për këtë interpelancë është e rëndësishme, lufta kundër korrupsionit dhe korrupsioni në tërësi, por ajo që nuk është në harmoni me temën është raporti. Ne deri tash nuk e kemi ditur aspak për cilin raport është fjala. Edhe iniciuesja e kësaj interpelance 90% të prezantimit të vet e pati për një raport. Bile fatmirësisht tash u bëmë edhe me dy raporte, nuk patëm raporte as nga iniciuesi, e as nga Qeveria, tash i kemi edhe dy raporte, që është gjë e mirë.

Po sa i përket korrupsionit, ata që e dinë pak çka është qeverisja dhe kompetencat e një qeverisje, duhet pasur parasysh disa elemente: nën një, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është organi më kredibil që ka të bëjë me çështjen e luftës së korrupsionit, dhe me sa e di unë rekomandimet e këtij organi janë duke u zbatuar në Qeveri me përpikëri. Pra, rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, është duke i implementuar me përpikëri Qeveria.

E dyta, në raport, edhe iniciuesit e raportit thanë ka ndërhyrje në Gjyqësor. Por, çfarë ndërhyrje ka në këtë Gjyqësor, po të kishte asnjë ministër nuk do të ishte as për t'u hetuar, as për të nisur procedura për ndonjë aktgjykim. Pra, po të kishte fuqi, ose po të kishte ndërhyrje kjo Qeveri në Gjyqësor nuk kishin për të ndodhur këto raste. Ju e dini rastet e ministrave, edhe pse s'kanë të bëjnë për veprimtarinë e tyre si ministra.

Elementi i tretë është edhe kjo është shumë e rëndësishme, rritja e të hyrave vetjake. Nuk mund të ndodhë ndonjëherë në një qeveri të korruptuar të rriten të hyrat për 20%. Është e pamundur kur Qeveria ka rritje të korrupsionit, të rriten edhe të hyrat. Qeveria ka rritje të të hyrave kur, së paku është dashur të jetë ashtu, kur ka ulje të korrupsionit, e sidomos në Dogana.

Elementi tjetër që është me rëndësi, edhe iniciuesit e dinë këtë shumë mirë, janë 49 ligje që Qeveria e ka sjellë një pako të tërë drejt Kuvendit që ka të bëjë me këtë fushë. Pra, Qeveria është duke kryer punën e vet, së paku trendin e ka shumë të mirë, çfarë do të bëhet në të ardhmen ne nuk e dimë, se nuk jemi fallxhor. Por, ka të bëjë me një temë interesante që para dy ditësh e kemi pasur. Para dy ditësh kemi pas shqyrtimin e raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Iniciuesi i këtij debati, asnjë fjalë s' e ka thënë, e ky organ, kjo OSHP është organi më i përfolur në Kosovë, sa i përket korrupsionit. Para dy ditësh, as në emër të grupit, as si deputet, në këtë kuptim nuk e kanë thënë asnjë fjalë. Kam fituar përshtypjen që iniciuesit nuk duan ta luftojnë korrupsionin, por duan të hyjnë në luftë me Ramush Haradinajn si kryeministër. OK për të parën, në qoftë se e ke ndërmend me luftua korrupsionin na keni këtu edhe së bashku mund të bëjmë diçka, po shpresojmë së bashku edhe më shumë, kurse sa i përket luftës me Ramush Haradinajt në start e keni të humbur. Ju a doni ta luftoni korrupsionin a Ramushin? Për Ramushin e dini që e keni në start të humbur.

Disa kolegë të tjerë të cilët kanë qenë nëpër pozita, së paku i kemi ende të freskëta në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

E para, desha t' i drejtohem kryetarit të opozitës, Albin Kurtit, me një pyetje.

Sinqerisht, kam pritur Albin, kur ke dalë në foltore që të distancohesh prej shprehjes së deputetes së partisë tënde, që tri herë i tha kryeministrit po rren, po rren, po rren. Po të dalë një deputet i Nismës, Albin, e të të thotë që po rren, unë distancohem prej deputetëve të mi. Edhe plus, më fal, plus asaj që po diskutojmë për një raport që fare nuk i përket kryeministrit. Me ditë, më fal, kryeministri ju kallëzoi me dokument që ju po rreni, sepse është duke u bërë fjalë për një raport shumë të vjetër, po s'ka rëndësi kjo. Ne kemi luftë politike, por ta ditur që unë marr vota se i them kryeministrit "po rren", rrafsh 20 herë tash i them "po rren". S' e kam unë frikë, edhe mosha më i ri, edhe... kështu nuk ka problem, po ma merr mendja që nuk është mirë të fyhemi, është mirë të diskutojmë, e para.

E dyta, të jeni shumë të bindur ju deputetët e Parlamentit, pozitë e opozitë, që ka shumë mundësi që edhe kryeministri, edhe Dhurata Hoxha, para se ta marrin raportin ndërkombëtar, këto raporte

ua çojnë disa qarqeve të ndryshme në Kosovë e disa gazetarëve mercenarë, sepse kemi eksperiencë kur prokurorë dhe hetues të policisë për t'u bërë gjyqe publike njerëzve, më së pari ua dërgojnë gazetarëve e pastaj pala që është në pyetje i merr ato raporte.

Sa i përket çështjes a me dhënë dorëheqje ministrat, të cilët janë nën aktakuzë. Hajde, ta fillojmë nga shembulli ynë personal. Sa deputetë jemi nën aktakuzë, hajde të japim ne dorëheqje edhe shihni që do të mbetet parlamenti tangall. Po, po, krejt thatë, duke filluar prej Dardan Sejdiut e teposhtë. Dardan, ta përmenda emrin, pra. Mirë, ne kemi deputet që janë nën aktakuzë, unë kam qenë 4 vjet e gjysmë nën aktakuzën e EULEX-it. Por, dua të them edhe një diçka sa i përket Dhomës së Dëshmimeve, që kryetari i opozitës e paraqiti, ne e dimë se ajo dhomë është vjedhur në bashkëpunim me ndërkombëtarët dhe ne e dimë se nuk ka policë, nuk ka gjykatës, nuk ka prokuror që nuk ka kaluar nëpër shoshën e ndërkombëtarëve. Ama, që kryeministri s'e ka jaran prokurorin aktual, Albin, unë të garantoj, se me e pas ky ndonjë gjykatës, hiq s'e kishin lirua Enver Hasanin prej aktakuze. Jo që s'do ndoshta kryeministri, po ende s'i ka ardhur rendi, se tash është i ri në Qeveri, ende s'i ka krijuar ato rrjetet e kontakteve. Ja, Hashimi i ka jaranë. I kam minutat e...

Do të thotë që këtu është krijuar një sistem merimangë. Me e qua dikë diku të punojë për mua, kjo është e vërtetë, unë pajtohem me ju, po që kryeministri ka arritur ta bëjë jaran shefin e Policisë, një, të AKI-së, dy, edhe kryeprokurorin, 3, këtë harrojeni, se s'ka mbërri as s'ka me i ardhë rendi sa të jetë në mandat kryeministër. Se ata s'i lëshon Hashimi, harroje atë farë pune, ooo Hashimi gjallë e me t'i lëshua ata, harro, harro...

Kryetari i Parlamentit është shqetësuese kur kryetari i Parlamentit në foltore thotë: "hetues që i hetojnë krimet ekonomike janë me orë në dorë të 50 mijë a 60 mijë eurove." Ai duhet t'ia thotë emrin, jo unë, se pastaj po e hamë ne, Albin, neve po na gjuhen në shpinë. Jo, s'kam pse ma ia thënë, ia thua ti Rexhë, qe po ta përmend ty emrin, dil e thuaja në foltore. Eh, ashtu! Ia thotë Rexhep Selimi.

E tash, krejt në fund dua të vi te esenca e këtij debati, për ta mbështetur se është debat i mirë. Në gazetari Muharrem Nitaj e ka mësuar, të paktën prej BBC-së e jo në shkolla këtu ku ka qenë, në gazetari thuhet: duhet ta kontrollosh atë që ka pushtet. Lind pyetja, kush ka pasur pushtet real në Kosovë? Krejt ai raport që e kanë bërë ata ndërkombëtarë fort mirë është bërë, veç me një adresë 100% të gabueshme. Veç ta kishin drejtua raportin te EULEX-i dhe UNMIK-u. Krejt faqet e zeza këtij vendi ia ka bërë UNMIK-u dhe EULEX-i. Me korrupsion, me krim, me faqe të zeza, ooo s'kish mujt Aleksandër Lumezi me u zgjedhë edhe njëmijë vjet kryeprokuror pa aprovimin e ambasadave perëndimore të EULEX-it edhe të Hashim Thaçit. Rrafsh dhjetë ditë pa e shkarkuar shefin e AKI-së, Bashkim Smakajn, mu ndërkombëtar në restorant më ka thënë "e hëngër ky, shkoi", njëmend e hëngër tani, shkoi.

Këtu është krejt kulaçi i ndërkombëtarëve. Unë po ju them informacion, kam raport me shkrim, ia dorëzoj kryeministrit, raport sekret. Kryeprokurorja e EULEX-it, zonja Arnal, përpos që ka bërë marrëdhënie intime me një politikan, se s'po guxoj ta përmend fjalën "seks", përpos që ka bërë marrëdhënie intime me një politikan të kalibrit të lartë në një vilë në Brezovicë, i ka thënë "futja Famir Limës". Duke bërë lezet në krevat, duke thënë "futja...", ky duke i thënë asaj "futja Fatmir Limës" dhe ky...

KRYESUESI: Ndërprite, të lutem Milaim, ndërprit!. Ta kanë ndërprerë fjalën. Ndërpritja fjalën! Të lutem! Ani, atëherë vazhdo, por mos kështu me fjalë.

MILAIM ZEKA: Po, se opozita kanë qejf veç Ramushin dhe Qeverinë ta shajnë, ju nuk doni ta dini të vërtetën. Ju në mënyrë absolute s'jeni... jo, ti nuk don. Jo, konferencë për medie thërrisni ju, unë e kam veç foltoren e parlamentit. Krejt krimin e organizuar, më fal, dil e kallëzoni kush ua ka paguar juve zyrat, kallëzoni prej çka financohet Lëvizja Vetëvendosje, kush e financon, kur i financon partitë politike?

Prandaj, dil dhe kallëzoni që raporti i cili i drejtohet Qeverisë së Kosovës është raport që duhet t'i drejtohet më së pari EULEX-it dhe Brukselit. Mos të na shesin pallavra njerëzit që janë vet të përfshirë edhe në krim të organizuar e të bëjnë pastaj raporte të krimit. Kjo ishte esenca ime. Dëgjo, nuk mundemi ne të shprehemi njësoj, nuk mundemi ne të jemi të gjithë demagogë dhe hipokritë njësoj, dikush është hipokrit i kamufluar e demagog i kamufluar, ndërsa unë jam ai që jam. Unë e di çka flas, sepse kam përgjegjësi të flas para qytetarëve të Kosovës të vërtetën, se kush e ka ndërtuar sistemin e krimit dhe të korrupsionit në Kosovë.

Sa u përket gjykatave - një Prokurorisë - dy, Policisë - 3, fajin dhe krimin ekskluziv e kanë vetëm ndërkombëtarët. Foli një ambasador shumë i nderuar dhe i respektuar kundër disa medieve para dy-tri ditëve që thanë pse mediet këtu po flasin kundër serbëve. A kur të flasin mediet kundër neve kur të çohen mediet për t'i bë paçavër gjykatësit, ne heshtim. Sot që ne jemi në këtë foltore ka qenë duke u mbajtur një seancë, kur dy policë për nga dhjetë euro i kanë çuar në gjykatë e shkon shikoni lëndët në gjykatë që njerëzit kanë milionë borxhe e korrupsion e s'i prek kurrkush.

Prandaj, është mirë që kur flasim në qoftë se kemi guxim të flasim drejtë, në qoftë se s'kemi atëherë kështu po flasim deri në mëngjes. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim, përnjëmend edhe dje edhe sot, mos e tepro me fjalë banale. Zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Mendoj se... shikoni, te raportet unë... raporti i progresit ose i vendit siç quhet, raporti për vendin, jep vlerësim për disa përparime në rend dhe

ligj në Kosovë. Nuk e bëjnë për hatër tonin, e bëjnë se ndoshta edhe ka ndodhur. BE-ja jep edhe sfidat e jep vështirësitë e edhe ky dokumenti që keni më herët është po ashtu transparent. Arsyeja e transparencës është se sot në Kosovë s'mund e rrenë kurrkënd, as për gjendjen në Ligj, as për gjendjen në gjyqësor, në Prokurori, në Polici, se të gjithë ne jetojmë këtu edhe BE-ja jeton këtu.

Po ndërlihem pak me këtë që tha kolegu Milaimi. Ne na ka shkuar jeta duke i ankuar të tjerët, një herë te UNMIK-u, jo të gjithë në UNMIK kanë qenë kundër nesh, po ne u kemi pri dikah, i kemi çuar ata dikah. E tash po ankohe mi edhe në EULEX-in, po edhe në EULEX nuk kanë qenë të gjithë kundër, kanë ardhur plot njerëz me vullnet ndoshta për ta përkrahur këtë vend. Edhe tani, jemi në qershor të këtij viti, jemi veç ne, veç Kosova. Pra, as s'e ke EULEX-in, as s'e ke me dikë që mban përgjegjësi për rend dhe ligj në Kosovë.

Është shumë me rëndësi që të jemi të vetëdijshëm që i mbajmë krejt përgjegjësitë vet. Këshilla ima, ose mendimi im, se unë këshillë s'mund të jap, por mendimi im është që duke minuar nga ekzistuesja nuk e ndihmojmë mjaftueshëm veten. Ndoshta është mirë me identifikua, qoftë kuadrin e mirë, ata që kanë sukses, qoftë të arriturat e sistemit tonë të drejtësisë të rendit dhe ligjit, qoftë mundësitë që ne mund t'i ndihmojmë ata, po edhe po ashtu po flas edhe një herë, edhe me provua me e pas një fillim pa pengesa, pra për t'i hequr disa hipoteka që s'e lënë Gjyqësorin, Prokurorinë e të tjerët të ecin. Unë jam thellë i mendimit që ky Parlament është mirë ta mbyllë historinë e aktakuzave për deputetët, për shkak se nuk shkojnë të dyja, edhe aktakuzat, edhe deputetët. Edhe e drejta e deputetit në tema për të kundërshtuar e ku ta di unë, nuk bashkëjetojnë në rregull, pra diku duhet me i dhënë epilog ky Parlament kësaj pune, po flas për ato kundërshtime, për ato aktakuza që lidhen me kundërshtime politike. Është mirë ta ndalim njëherë, se po shkojmë në pakufi duke krijuar një proces që na shkakton dëm dhe na pengon për të ecur.

Në të njëjtën kohë, është mirë si vend, po flas edhe një herë, me pas kujdes. Shtrirja e juridiksionit të Kosovës në gjithë vendin, arritja në çdo pjesë të atdheut tonë e kërkon njëfarë zgjuarsie tonën e njëfarë mençurie tonën. Poenët për të arriturat mund t'i marrim paç, por unë për shembull fitoj vota për punët që i kam bërë para 20 vjetësh. Të punojmë sot, edhe nëse s'i kthejmë në votë menjëherë, do të qëllojë dikur, pas 20 a 30 vjetësh dikush do të fitojë prej tyre. Por, ne duhet po ashtu të mund t'i bëjmë disa punë, që nuk kemi nevojë me i përkthye menjëherë në votë, sepse ata që janë kundër nesh edhe ata nuk rrinë, edhe ata i kryejnë punët e veta në mënyrën më të mençme të mundshme. Faleminderit!

Ju siguroj, e dini që ka ndodhur shkëmbimi i letrave, do t'i keni zyrtare ato letra, EULEX më nuk ushtron funksione ekzekutive në Kosovë. Merr pjesë në monitorim të caktuar, por edhe monitorimin dhe çdo funksion e ka vetëm nëse e thërret Kosova edhe për këtë arsye prej mesit të qershorit duhet përgatitur të gjithë, ta kuptojmë të gjithë, që krejt përgjegjësitë në këtë vend i mbajmë ne njerëzit e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Në raportin e progresit të cilin e kemi pasur para vetes para një kohe, nga 92 faqe të shkruara 76 herë përmendet mosluftimi i korrupsionit apo lufta e hershme e korrupsionit si dukuri.

Dukuria e korrupsionit edhe aty paraqitet se është shumë e përhapur në të gjithë sektorët, por ne e dimë që Qeveria mund ta lufton korrupsionin kur e ka brenda saj, por ajo krijon mekanizma për luftimin edhe në sektorët tjerë. Është sekret publik i gjithëditur, që korrupsioni më eklatant është në prokurim dhe ka ndikime dhe përfitime individuale grupore përmes tenderëve. Kjo është sekret publik i ditur dhe i folur gjithandej. Kjo Qeveri nuk ka bërë sa duhet, ose me thënë pak, edhe sa për t'u dukur që po lufton korrupsionin dhe keqpërdorimin.

Fatkeqësisht, kjo Qeveri është bërë jo luftuese e korrupsionit, por në disa raste edhe çerdhe apo mbrojtje e korrupsionit edhe pse mund të themi që përveç keqpërdorimit të parasë publike, emërimeve të jashtëligjshme, kjo Qeveri po bashkëjeton edhe me ministra që kanë aktakuza të ngritura, edhe pse këto aktakuza nuk kanë të bëjnë ndoshta me Qeverinë e tanishme, por janë aktakuza të ngritura.

Si pritet që këta ministra ta luftojnë keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe korrupsionin e vartësve të vet, derisa vetë janë të hetuar, janë me aktakuzë. Dhe, si do të marrin masa ndaj atyre zyrtarëve të ulët, kur ministri si numër një i dikasterit mbrohet nga shefi i Qeverisë. Kemi pasur praktika të mira në Qeverinë e kaluar, kur janë shkarkuar disa nga ministrat e hetuar, e dini rastin e ministrit të Shëndetësisë, Ferid Aganit, i cili ka qenë vetëm nën hetime, pastaj ministrit Jablanoviq, por kjo praktikë nuk po vazhdohet më tutje. Si duket, kjo Qeveri ka vendosur të bashkëjetojë me korrupsionin dhe krejt kjo edhe nga mungesa e guximit, por edhe për ta mbajtur stabilitetin qeveritar, sepse i duhet që disa nga vendimmarrësit, të cilët vendosin për ministrat më shumë se sa vetë kryeministri në disa raste, siç është rasti i disa ministrave si ministri Besim Beqaj e Lluka.

Prandaj, ne sot nuk kemi nevojë sot për retorikë nëpërmjet letrave, fjalimeve, rezolutave e strategjive, por kryeministri të na tregojë edhe neve edhe tërë opinionit, a keni vendosur të vazhdoni të punoni me këta ministra që janë nën hetime dhe a do të nisni ta luftoni korrupsionin nga oborri juaj? Aty do të tregoni se keni përnjëmend të luftoni korrupsionin dhe njerëzit e hetuar. Nëse jo, atëherë si do t'i arsyetoni qindra vartës të këtyre ministrave, nëse nesër do të ketë keqpërdorime apo raste korruptive.

Në këtë raport që na e dha kryeministri, faleminderit që u mundua vetë të na i dorëzojë, takimet e nivelit të lartë për sundimin e ligjit. Në një vend e lexova, për aq sa pata kohë, se s'pata kohë krejt, shkruan për disiplinimin e prokurorëve, ku kemi edhe zvogëlim të pagave deri në 30%, por

unë e kam frikën se ky disiplinim i prokurorëve nga Këshilli Prokurorial e mekanizmat tjerë, në mos është edhe disiplinim i prokurorëve edhe për mosndjekjen e rasteve të rënda të korrupsionit që i kemi në Qeveri!

Prandaj, ne duhet t'i disiplinojmë prokurorët nëse ata nuk punojnë, por në të njëjtën kohë edhe t'i stimulojmë, që ata të kenë guximin, edhe pse në Kosovën e vogël secili njihemi me njëri-tjetrin, por ta kenë mbrojtjen e duhur këta prokurorë që ta bëjnë ndjekjen penale edhe të rasteve më të rënda të korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Fatmire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj!

Kur flasim për temën e sotme ne nuk mund ta bëjmë një “prerje cezariene” dhe të themi “mirë, kjo Qeveria ka filluar prej ditës zero dhe krejt çfarë ka ndodhur përpara nuk është temë e këtij debati”, sepse të gjitha pasojat i vuajnë edhe sot qytetarët. Për më tepër që kryeministri vjen nga një subjekt më i vogël në këtë Qeveri, por bashkëqeveris me një subjekt tjetër, i cili me vite të tëra ka qenë në pushtet. Prandaj, ne kemi plotësisht të drejtë të gjykojmë edhe nga ky këndvështrim dhe krejt masat që po ndërmerren aktualisht për luftimin e të gjitha dukurive negative edhe nga e kaluara.

Këtë do ta filloj pikërisht vetëm me një fakt, që meqenëse sferën e shëndetësisë e përcjell shumë më tepër, ta them se përse po them se pasojat i vuajmë tani. Po e marr shembull vetëm një rast që tani shumë në Qendrën Klinike Universitare janë ndërprerë operimet për shkak të mungesës së anestetikut Penthanin, i cili fillimisht është marrë me çmimin 0,37 centë dhe pastaj është rritur çmimi në 0,97 centë dhe përfundimisht, në vend se të paguhen 71 727 euro, është paguar 213 000 euro. Do të thotë, rritja mbi 150 000 euro për të njëjtin produkt si pasojë ka qenë që qytetarët kanë vuajtur pastaj për mungesën e shumë barnave tjera që kanë mundur të sigurohen vetëm nga diferenca e kësaj kostoje. Do të thotë, se e kemi pasur edhe një raport vonë të paraqitur në medie nga një institut “Kolumbus”, i cili ka paraqitur fakte që edhe ne i kemi ditur, por vetëm që i ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur, ku ka pasur raste të keqpërdorimeve, të blerjes së barnave dhe produkteve tjera, jo vetëm 100% me rritje, por edhe deri në 2 000%.

Dhe, këto janë afera korruptive, vepra korruptive, ku njerëzit e njëjtë vazhdojnë të punojnë në këto institucione. Çfarë po ndodh? Disa zyrtarë përkohësisht suspendohen, pastaj ose paguajnë gjoba, ose rikthehen si të pafajshëm, sepse gjykatat dhe sistemi i kapur i drejtësisë i zvarritë lëndët me vite dhe bien në harresë dhe qytetarët të njëjtit pastaj zyrtarë shpallen të pafajshëm dhe kalon në heshtje kjo. Prandaj, kryeministri për të dhënë prova dhe në ministratë tjera, le të na tregojë se sa njerëz të përfshirë në këto afera korruptive vazhdojnë të punojnë ende, sepse këto kontrata dikush i ka nënshkruar në të kaluarën. Ministrat kanë shkuar, nuk kanë dhënë përgjegjësi, ish-ministrat nuk kanë dhënë përgjegjësi dhe ende nuk do të japin, sepse dihet se

zyrtarët e lartë në këtë shtet nuk do të japin përgjegjësi kurrë. Disa zyrtarë, t'i quaj se nuk janë shumë të rëndësishëm, ndonjëherë edhe gjobiten, ose burgosen për një kohë të shkurtër, por zyrtarët e lartë dhe kjo është arsyeja pse ne nuk e kemi ende liberalizimin e vizave, që është dashur të ndodhë shumë më herët, sepse nuk po luftohet krimi dhe korrupsioni i nivelit të lartë. E kjo është kërkesa e Bashkësisë Evropiane.

Do të thotë, çka të themi kur një tabelë në oborrin e Qendrës Klinike Universitare thotë: “Shërbimet e pastro-skopisë dhe koronaro-skopisë nuk ofrohen”. Edhe këto janë afëra korruptive, sepse nëse një shërbim disa vjet nuk ofrohet, nuk servisohet aparatura, të lë në dyshim që dikush tjetër po i orienton pacientët nga sektori publik në atë privat. Këto janë afëra korruptive, kur rezonanca magnetike prishet vazhdimisht në QKU, ndërsa në shërbimin privat funksionon më së miri. Dhe tash, një aparaturë e re që është dashur të dërgohet në Prizren ridestinohet në SHSKUK apo më mirë të them në QKU, se është Qendra Klinike Universitare, dhe nuk jepet sqarim, kur janë bërë investime në Prizren për atë aparaturë për vendosjen e asaj aparature. Vazhdon një avaz i vjetër, që kurrkush nuk jep përgjegjësi për gjëra të tilla.

Po flasim për sistemin e drejtësisë. Le të dalë një qytetar e të thotë që nuk është i kapur, sepse zvarritja deri në tetë vjet e lëndëve flet sesi gjyqtarët nuk kanë guxim, sepse janë në ndikimin politik edhe gjyqtarët, edhe prokurorët. Nëse e ka seriozisht kjo Qeveri, duhet të alokojë buxhet shumë më të madh, t'u japë garanci gjyqtarëve dhe prokurorëve që mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, sepse duke e ditur që ndikimi i politikës është aq i madh, ne e dimë që edhe shumë vjet nuk do të ketë qasje të duhur nga gjyqësori e Prokuroria në luftimin e aferave korruptive.

Prandaj, thënë shkurt, ne për këto muaj nuk kemi vërejtur një gatishmëri që t'u qasemi aferave dhe njerëzve të nivelit të lartë të zhytur në korrupsion. Kur jep prova kjo Qeveri që do të fillojë nga ministrat, nga zyrtarët e lartë nëpër ministri, të cilët kanë aktakuza dhe hetohen, atëherë ne do të besojmë që qasja do të ndryshojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,

Kryesues,

Të nderuara deputete e deputetë,

Ne po diskutojmë për korrupsionin në Kosovë dhe mendoj që po pajtohemi edhe si pozitë, edhe si opozitë që në Kosovë ka korrupsion, këtë po e themi ne, po e thonë edhe të huajt.

Në seancën e kaluar është shqyrtuar raporti i KRPP-së dhe raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, i cili kujdeset për analizat për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik apo jep rekomandime për ndryshimet ligjore, thotë që është duke kryer punë mirë dhe në raportin, i cili ka 79 faqe, lavdërohet gjatë gjithë kohës që janë kryer të gjitha detyrat që i takojnë.

Në anën tjetër kemi Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, i cili në raportin e tij flet për shkelje jashtëzakonisht të mëdha.

Pra, si është e mundur, nga njëra anë që KRPP-ja të thotë që gjithçka është në rregull, ndërsa te Organi Shqyrtues i Prokurimit publik kemi vazhdimisht probleme. Të njëjtat probleme i kemi prej vitit 2014, '15, '16 e '17.

Problemet e shfaqura janë kryesisht projekte që kushtojnë shumë, por nuk janë efikase.

Pra, në qoftë se kemi një projekt, i cili kushton një milion, ndërsa efikasiteti i tij është vetëm 200 mijë euro, atëherë këtu vjen erë korrupsion. Kemi trajtim në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminues të atyre që konkurrojnë, pra shkelja e nenit 17, shkelen normat e transparencës dhe krahasohen gabimisht tenderët.

Kemi gjithsej 553 raste të ankesave, prej tyre 322 apo gati 60% janë shpallur si ankesa të drejta. Pra, kemi 322 raste, ku ligji nuk është zbatuar ashtu siç është dashur dhe ka vend të mjaftueshëm që Prokuroria, Policia për Krimet e Rënda t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shikuar kush ka përfituar apo kush është përpjekur që në mënyrë të paligjshëm të përfitojë nga këta tenderë.

Ajo që dua të them, zoti kryeministër, është që nuk po funksionon sistemi, problemi është që nuk ka bashkërenditje të veprimeve të KRPP-së, të OSHP-së, të Policisë së Krimeve të Rënda dhe të Prokurorisë, sepse pa bashkërenditje të veprimeve të institucioneve, atëherë shihet shumë qartë që kemi një problem të sistemit.

Ajo që unë pres nga kryeministri i Republikës së Kosovës është pikërisht që ta luajë rolin e koordinatorit, në mënyrë që problemet të cilat shfaqen në fusha të ndryshme t'i bashkërendojë, sepse këtu kemi probleme në sistem, nuk mund të luftohet korrupsioni pa u rregulluar çështja e sistemit dhe pa i kryer secila palë detyrat që i ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demalijaj, nuk është. Atëherë, zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Ministër,

Natyrisht që një temë e tillë, si korrupsioni, që është identifikuar si plagë e shoqërisë nxit diskutime edhe debate tek secili, por lufta kundër korrupsionit paraqet një rën nga sfidat me të cilat në vazhdimësi përballen qeveritë anekënd, tani një pjesë e qeverive të vendeve të botës janë në luftë permanente me këtë dukuri dhe me vendosmëri kanë arritur të minimizojnë përmasat e shfaqjes së tij në shoqëritë e tyre.

Kategoria e shteteve që sot janë përfshirë nga kjo dukuri, e ku bëjnë pjesë edhe ne se demokraci e re logjikisht do të duhej që të kishim më të lehtë përballjen, nga se pos mundësisë për të parë se si funksionon shteti ligjor, po nga këto shtete ofrohet për Kosovën asistencë në ngritjen e kapaciteteve për ta minimizuar përhapjen e korrupsionit si dukuri.

Dhe, po të përmbledhen të gjitha asistencat nga viti 2000, eksperiencia, ndihma financiare, vizita studimore që shtetet e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë ofrua Kosovës në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ne sot do të ishim vendi me më pak korrupsion në botë, po fatkeqësisht, sipas organizatave kredibile botërore që përcjellin përhapjen e kësaj dukurie, vendi ynë rangohet ndër vendet që e kanë të shprehur këtë dukuri në nivel jashtëzakonisht të theksuar.

Vendi në të cilin vidhet dhoma më e sigurt e shtetit dhe nuk ndëshkohet askush, vendi që mezi arrin 2 miliardë buxhet e qeveritarët akuzohen për qindra miliona të keqpërdorura dhe në fund lirohen të pafajshëm, vendi që institucionet kredibile ndërkombëtare i përmendin shuma parash të nxjerra jashtë vendit në mënyrë të paligjshme nëpërmjet aeroportit dhe askush nuk ndëshkohet, me të vërtetë e bën qytetarin të frikësohet me të madhe.

Juve ju kujtohet, kolegë të nderuar, para disa vjetësh Raporti i progresit ka evidentuar qartë se në aeroportin e vendit tonë janë nxënë shuma të mëdha parash që dalin jashtë vendit.

Janë përfolur edhe emrat, por askush nuk është tronditur nga kjo, nga se këto po bëhen lajme të zakonshme.

Gjithashtu si vend me cikël zgjedhor në nivel lokal dhe nacional, në kushte normale nuk do të duhej të kishim të shprehur korrupsionin në nivel kaq të lartë, pasi zgjedhësit do të ishin ata që në një farë mënyre do ta filtronin, ata të cilëve u japim besimin në mënyrë që të na përfaqësojnë, e ne pak më parë pamë se fatkeqësisht këtë vend e përfaqëson gjithkush dhe askush. Prandaj, edhe mos u habitni nga fjalimi dhe nga rezonimet e disa individëve, të cilët nuk dinë të flasin tjetër përpos të kamuflojnë problemin kryesor me banalitete, të cilat janë mendësi e tyre.

Dhe problemi më i madh, i nderuar kryesues, është pse nuk reagohej në këto raste dhe lejohet që ky Kuvend të atrofohet në mentalitetin apo në banalitetin e individëve. Është mirë të reagohej në këto raste dhe muhabetet e tilla le t'i lënë në vende që ata dëshirojnë t'i gravitojnë.

Në fakt, korrupsioni nuk është rezultat i prodhuar nga votuesi, këtë dilemë duhet hequr dhe këtë dua ta them, por kjo dukuri gjenezën e ka te partitë politike, të cilat pastaj e bartin atë në nivelet e pushteteve. Edhe në këtë rast dua ta kujtoj edhe një herë vjedhjen industriale të votave për të fabrikuar rezultat dhe njerëz, nomenklatura të cilat pastaj marrin përgjegjësi edhe natyrisht kur buron nga një fabrikim i tillë, edhe puna del e tillë. Nëse vjen me vjedhje, do të vazhdohet të qeveriset me vjedhje dhe nuk ka qasje tjetër.

Në fakt, në Kosovë ka edhe disa faktorë që kanë ushqyer këtë, të cilat në një periudhë të caktuar i kisha renditur kësi soji.

Kishte një mungesë të vullnetit politik të bashkësisë ndërkombëtare për të implementuar standardet e mirëfillta zhvillimore demokratike, kjo u kushtëzua nga një varg faktorësh, por dominues, ku natyrisht të ardhur nga substrate të ndryshme, nga vendet e ndryshme, nomenklatura ndërkombëtare ka sjellë edhe kultura të ndryshme, të cilat ndoshta nganjëherë kanë reflektuar edhe në vendet diktatoriale, të cilët edhe nuk kanë qenë fortë të interesuar për sundim korrekt dhe ku dominon rendi edhe ligji.

Mandej edhe administratat vendore janë rekrutuar nga kjo strukturë dhe i kanë shkuar prapa kësaj kulture.

Një pjesë e elitave të mirëfillta politike u tërhoqën apo abstenuan nga procesi, ato u ndodhën nën presionin e grupeve të ndryshme parapolitike, të cilat me çdo kusht donin ta merrnin pushtetin për përfitime personale. Kjo u shoqërua me forma më brutale kriminale, ku nuk kanë munguar as vrasje të deputetëve, as vrasje të kryetarëve të komunave, gazetarëve, aktivistëve të shumë politikë.

Një pjesë e administratës ndërkombëtare hyri në partneritet me këto grupe gjoja për t'i kontrolluar, po ja që shpejt u joshën nga paraja dhe u bënë grupe të përbashkëta.

Kjo strukturë tanimë e forcuar ndikoi që privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe i pasurisë tjetër të keqpërdorej skajshëm. Nëse nga ky proces është llogaritur që të punësohen afër 40%, ne e dimë as 3-4% nuk është punësuar me privatizimin e sektorit. Prandaj, kjo ka reflektuar edhe në pakënaqësi të shumta, po edhe ikjen e njerëzve nga punësimi në këto sektorë edhe natyrisht lëvizjet e tyre të sektorit publik edhe, në një farë forme, edhe nënshtrimit para partive për të arritur edhe servilizmin ndaj partive për t'u punësuar në sektorin publik.

Sektori privat i ndodhur nën tryninë e oligarkisë korruptive pjesën më të madhe të aktivitetit e zhvillon në mënyrë informale, kjo bën që ai të mos jetë regjenerues, por mbijetues.

Ky sektor nuk është atraktiv për kontingjentin e të papunëve ngase nuk kontrollohet nga shteti, i cili do të duhej të kërkonte respektim të ligjit dhe si i tillë, duke qenë diskriminues në paga edhe në çështje të tjera, ku edhe rriten problemet sociale.

Një pjesë e rrjetit të shoqërisë civile kanë shërbyer si filiale të pastrimit të parave të efektivave korruptive të UNMIK-të dhe vendorëve, e kjo kategori ka mbetur tani pa fonde dhe natyrisht edhe këta ia kanë mësyre me të madhe partive. Prandaj, si të tillë, prej nga e kanë prejardhjen, edhe vazhdojnë të punojnë.

Pak a shumë kjo është njëra nga fotografitë e zymta të vendit tonë si demokraci e re në Evropë. Natyrisht se kjo gjendje krijon premisa të reja të implikimit të strukturave kriminale, duke filluar me trafikim me njerëz, trafikim me armë, narkotikë, e të tjera.

Perspektiva demokratike natyrisht se është e cenuar skajshëm nga këto gjëra dhe, për fat të keq, në Kosovë pastaj na dalin edhe rryma ekstreme, të cilat mund t'i nxisë edhe dikush tjetër.

Përditë e më shumë krimi e korrupsioni po i zgjat këmbët edhe në institucione e pavarura të shtetit, në agjenci, polici, prokurori, gjykata, kujdesin shëndetësor, arsimin, kulturën, e madje edhe në disa projekte të cilat ne kinse ua dedikojmë heronjve në ngritjen e memorialëve të shumta që nuk përtojmë shkojmë përkulemi, ndërsa në anën tjetër, i zhvatim paratë, të cilat ndahen për ato memoriale.

Lufta kundër korrupsionit është komplekse, ajo kërkon një mori veprimesh arsimore, kulturore e politike, kur një pjesë e madhe e të cilave do të burojnë edhe nga ky vend apo nga Kuvendi.

Gjithashtu nga ky Kuvend duhet të burojnë një sistem, i cili bën regjenerimin e qelizës demokratike që thashë ajo e njerëzve që përfaqësojnë edhe njerëzve të cilët marrin guxim të flasin dhe njerëzit të cilët duhet të kërkojnë llogari dhe zbatim të ligjit.

Në këtë mënyrë, duke kërkuar respektimin e ligjit, ne i hapim rrugës ardhmërisë së vendit.

Në të kundërt, duke ndëshkuar apo edhe frikësuar ata të cilët guxojnë ta drejtojnë gishtin nga krimi dhe korrupsioni, siç e kemi edhe në raportet e Avokatit të Popullit vite më parë, kur dëshmitarët lëndohen në forma të ndryshme, kërcënohen e ndoshta edhe likuidohen, ardhmëria e fëmijëve tanë edhe të këtij vendi jashtëzakonisht është e cenuar. Vetëm me seriozitet mund t'i qasemi kësaj problematike. Në të kundërtën, veç i shërbejmë kultivimit të kësaj dukurie negative.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Zoti Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Po, po, zoti Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Jo, jo, mos, Sami, të lutem!

KRYESUESI: Xhelal Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot kjo interpelancë po mbahet për të diskutuar për nivelin e krimit dhe korrupsionit të niveleve të larta. Prandaj edhe po bisedohet për raportin e tre ekspertëve të Këshillit të Evropës, pavarësisht që po tentohet që në fillim të fshihet, e tash të minimizohet rëndësia e tij.

Megjithatë, unë do të fokusohem vetëm te kjo, krimi dhe korrupsioni i niveleve të larta.

Kryeministri në fillim të fjalës së tij na tregoi edhe në mënyrë statistikore për luftën e krimit. Por, thënë të drejtën, sot nuk është temë debati se sa hajna të druve apo kriminelë të vegjël kanë pësuar apo janë ndëshkuar nga sistemi i drejtësisë.

Unë dua të flas vetëm për një rast, i cili ka lidhje drejtpërdrejt me Qeverinë aktuale, e kjo është emërimi apo kthimi i Nexhat Krasniqit në Ministrinë e Infrastrukturës, e cila udhëhiqet nga një ministër që vjen për subjektin politik të kryeministrit.

Do të thotë, ne e dimë që Ministria e Infrastrukturës ka buxhetin më të lartë për sa i takon investimeve kapitale, diku pak nën 300 milionë euro, dhe të emërohet apo të riemërohet si drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve Publike, aty ku shumica e parave të taksapaguesve tanë janë, një i dënuar për, siç thuhet këtu, keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar në bashkëkryerje, pastaj edhe të gjykohet për marrje të ryshfetit dhe lidhje të kontratave të dëmshme dhe i njëjti person nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë caktohet si drejtor i Drejtorisë së Prokurimit në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, ministri e cila tash po përflitet për 53 milionëshin që i është dhënë “Bechtel-Enka”-s, mendoj se është dëshmi e mjaftueshme për mungesën e vullnetit të kësaj Qeverie për ta luftuar krimin dhe korrupsionin në nivele të larta.

Unë nuk e di, zoti kryeministër, se si politikisht, moralisht, po edhe juridikisht mund ta arsyetoni ricaktimin e këtij personi në një pozitë kaq të rëndësishme, kaq delikate, jo vetëm politike, po edhe ekonomike dhe potencialisht të vazhdoni ta dëmtoni buxhetin e Kosovës, i cili dorën në zemër, po plaçkitet në vazhdimësi edhe tash e tutje.

Në qoftë se ju nuk merrni masa ndaj këtij rasti, atëherë kjo është edhe një dëshmi që ju nuk jeni të gatshëm për të luftuar krimin dhe korrupsionin në nivel të lartë, por jeni të gatshëm për t'i shfrytëzuar këta persona për, siç thuhet në zhargonin popullor, “dilla të ardhshëm ekonomikë”.

Unë me vete këtu kam dosjen e gjyqimit të këtij personi, do të thotë dokumente zyrtare, për shembull, këtu është Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata e Apelit, Gjykata Kushtetuese, të cilat të gjitha një pas një kanë vërtetur se ky person është i përfshirë në afëra korruptive dhe është dyshuar për përvetësim të 180 mijë eurove.

Në qoftë se kryeministri na e dha një raport për punën e tyre, unë po dua t'ia jap kryeministrit këtë material dhe pastaj të shohim se në një afat të shkurtër çfarë do të ndërmarrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Haradinaj, kryeministri, e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Për rastin në fjalë, zoti Nexhatin, të gjithë kemi dëgjuar, i dimë proceset që i ka kaluar, mirëpo ka diçka që po ashtu na ka vënë në një situatë çfarë jemi.

Është një vendim i gjykatës të kthehet në vend të punës se gjoja padrejtësisht iu ka mohuar atij, ky bën pjesë në kategorinë e atyre njerëzve që nëse nuk e merr në vend të punës, rrogën duhet dhënë prapë, merrni me mend, pra. Tash gjykatat e vendit e kanë kthyer këtë njeri në vend të punës, nuk është përzgjedhje e re e dikujt, po është kthim, se iu ka bërë e padrejtë, ku di unë, e tjera, e tjera.

Tani, ky është një realitet, a është në rregull a nuk është, e kam zor të them në cilëndo formë, por kjo është situata, kjo është e vërteta, sipas informatës që kam unë, se ju e dini që publike kanë qenë këto procese dhe gjykata e ka kthyer këtë në vend të punës. Tash, si do të...

(Reagime nga salla)

Ju lutem, informohuni veç, ne jemi të informuar, unë këtë informatë e kam, po ju lutem informohuni edhe ju, nëse nuk është, tregoni.

Ka një gjykatë që e ka kthyer njeriun në punë, nuk e di cila është. Jo, jo, ju lutem, dëgjoni veç një sekondë.

Gjykata e ka kthyer, besoni, gjeni vetë, e keni, nëse doni. Urdhëro, Xhelal.

KRYESUESI: Replikë, zoti Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: Zoti kryeministër, unë ju dhashë një dosje me dokumente zyrtare, nuk kemi nevojë për dyshime të tjera.

Do të thotë kështu, ne mund ta kemi një marrëveshje gjentëlmene që për këtë çështje të diskutojmë pas dy javësh, për shembull. Ju informohuni, ju keni shumë zëvendëskryeministra, keni shumë ministra, shumë zëvendësministra, shumë këshilltarë, gjithë ai aparat shtetëror, i cili është nën urdhra të juaj, ju informohuni në detaje, pastaj për një afat relativisht të shkurtër e diskutojmë prapë, ne i themi argumentet tona, ju pastaj në mënyrë të argumentuar na tregoni çka keni ndërmarrë lidhur me këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, edhe një herë zoti kryeministër.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk po i mohoj, po, janë me rëndësi, faleminderit! Si informatë të parë, pasi tash e dëgjova temën, ju tregova çka di unë, me këtë nuk po insistoј që ju nuk keni të drejtë as nuk bëtë mirë që m'i dhatë këto, vetëm po ju tregoj që për këtë temë që e ngrite informatën e kam se është gjykata që e ka kthyer në punë njeriun, tash ta shohim a është ashtu a jo, e t'i trajtojmë këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Driton Çausi.

DRITON ÇAUSHI: Për shkak kohës së shkurtër, po ndalem vetëm te ky raport që na u shpërnda të gjithëve.

Kryeministri tha se përbënë pasqyrën më reale të realitetit. Megjithatë, unë nuk besoj se kur vetë bën ndonjë vlerësim për vetveten, kjo mund të trajtohet si mënyrë neutrale ose e drejtë e vlerësimit të gjendjes.

Unë mendoj që ky dokument tregon në mënyrën më të thjeshtë se si Qeveria e trajton këtë çështje, por edhe cili është respekti i Qeverisë për deputetët dhe për Kuvendin.

U përmend që nuk ka pasur mundësi të përkthehen në anglisht grafikonet, mirëpo zoti kryeministër, ju keni pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për këtë interpelancë.

Tjetra, autori këtu thuhet se është Qeveria e Kosovës, ka një zyrë që përpilon raporte të tilla, apo është gjithë Qeveria e Kosovës që merret me këto materiale, asnjë referencë tjetër.

Dhe, nëse e shihni në fund, nuk keni asnjë fusnotë, asnjë referencë të këtij dokumenti.

Shikoni, ju lutem, faqen e fundi ose të parafundit, domethënë këto janë të dhëna nga këto institucione që pritet që ne t'i marrim si të mirëqena dhe tregojnë realitetin për luftimin e korrupsionit.

KRYESUESI: Po, zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shiko Driton, faleminderit!

Po ka diçka, ky material më së pari është përmbledhje dhe tregon nga buron, pra nuk është një material studimor që i jep dikujt, i thua nxirre një gjendje, pra nuk po fshih, vetë titulli i tij po tregon takimet e nivelit të lartë, paraqitjet e këtyre institucioneve që ne duhet dikujt t'i besojmë nga pak, nëse jo krejt, e këtu janë Dogana, Policia, Këshilli Prokurorial, këto janë të gjeturat e tyre, kush i ka mbledhur në këtë dokument, janë transkriptet e takimeve dhe për t'i paraqitur këtu si duken sot pa fusnota, pa kurrgjë ,veç qysh i kanë dhënë ata, është kujdesur, na ka ndihmuar edhe USAID-i, edhe Agjencia Evropiane. Ua kemi kërkuar ndihmën dhe është zyra ime dhe janë nja 2-3 kolegë të mi, Selimi është diku këtu, ka punuar në këtë temë. Pse nuk është bërë ky material për të ardhur për këtë ballafaqim? Ta kini parasysh, për atë ju thashë me kohë, nuk dua të ju gënjej së pari, nuk është bërë për këtë seancë. Ky material është bërë për t'ua dhënë evropianëve për liberalizim të vizave, dhe evropianët e dinë që është kështu se kanë marrë pjesë në hartim, kanë qenë pjesë e këtij materiali. Na kanë ndihmuar ta bëjmë. Është bërë për t'iu paraqitur gjendjen, për të fituar në kohë, por për respekt të kësaj ngjarjeje të ditës sotme dhe ju ku të qëlloni, e kemi ndarë këtë. Nëse Parlamenti na obligon që ne ta bëjmë një raport tjetër ose nevojitet, atëherë ndoshta ka dhe, më pati pyetur një ditë Albini, tha cila metodë vlen për këtë, ndoshta ka metoda tjera për ta bërë këtë, por nuk është ai qëllim. Pra, ju lutem, ju thashë në fillim, materiali është përmbledhje e të gjeturave nga këto institucione veç e veç dedikuar palës, palë e kemi Evropën dhe çështja është liberalizimi i vizave, për t'u treguar atyre çka po bëjmë. Kjo është e vërteta.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bunjaku.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të respektuar deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në shumë raporte vendore dhe ndërkombëtare thuhet se shkalla e korrupsionit dhe krimit të organizuar është në nivelin më të lartë.

Kosova rangohet ndër shtetet më të korruptuara nga organizatat ndërkombëtare. Kosova është kushtëzuar për liberalizimin e vizave edhe në shkallën e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kosova ka krijuar aq shumë task-forca kundër korrupsionit, por asgjë nuk po funksionon. Vetëm shpenzime financiare dhe kosto për këto task-forca dhe pa asnjë rezultat.

Nëse ne konstatojmë se ka korrupsion dhe krim të organizuar në mënyrë aq të përhapur, pse atëherë nuk e kemi asnjë zyrtar të lartë duke e marrë dënimin e merituar? Pse zyrtarët më të lartë të shtetit, edhe kur janë akuzuar rëndë për korrupsion, edhe nëse janë zvarritur me vite nëpër gjykata, sërish rezultati ka qenë se ishin të pafajshëm. Ku mund t'i besohet kësaj Qeverie në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, kur zyrtarët e lartë takohen me njerëz, të cilët janë të zhytur në krim. Si mund t'i besohet kësaj Qeverie për luftimin e korrupsionit, ku një ministër aktual është në aferën "Pronto", i vjen aktakuza dhe nuk largohet nga detyra. Pse të mos largohet nga detyra, e të mos e pengojë drejtësinë që ta kryejë punën dhe të merret decidivisht me ministrat, të cilët janë në aktakuzë.

Korrupsioni vazhdon të mbetet në nivel të lartë në shumë sektorë, e sidomos edhe në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Në sektorin e arsimit, për shembull kemi pasur përjashtimin nga EQAR decidivisht me ndërhyrjen e kryeministrit në Ministrinë e Arsimit. Nuk mund të presim rezultate në asnjë sektor në arsim, sidomos në shëndetësi, nëse nuk kemi sundim të ligjit dhe të rendit. Dhe, ne mendojmë se kjo Qeveri ka mundësi që të ndikojë pozitivisht në zbutjen e korrupsionit dhe për ta përmbyllur këtë, luftimi i korrupsionit nuk duhet të bëhet vetëm sa të vijnë vizat dhe të ecim nëpër Evropë, sepse është i kundërligjshëm, i dëmshëm dhe me pasoja të mëdha për shoqërinë dhe shtetin. Korrupsioni duhet të luftohet dhe të dënohet kurdoherë, gjithmonë dhe ndaj kujtdo qoftë. Nuk duhet të ketë tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar as për zyrtarët e lartë të shtetit.

Nëse Kroacia dhe Sllovenia i vënë para drejtësisë zyrtarët më të lartë të shtetit, atë mund të bëjmë edhe ne si shtet. Vetëm zyrtarët e lartë të shtetit nuk amnistohen, e shtojmë dëshmi para vetes dhe faktorit ndërkombëtar se jemi shtet ligjor dhe i drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për t'ua përkujtuar historikisht, ne e kemi pas sjellë një ligj që kryesuesit e dikastereve duhet të dënohen, duhet të japin llogari dhe përgjegjësi para ligjit për dikasterin e vet, por fatkeqësisht deputetët nuk e kanë votuar, as ministrat e atëhershëm s'e kanë pranuar. Kështu që kjo është gjendja, e nuk mund ta ndryshojmë derisa ta bëjmë ligjin.

Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti Haliti!

Do të përpiqem që të flas shkurt dhe ta përdor njëfarë simbolike për nëntë muajt e qeverisjes së sotme. Muajin e parë do t'ia kishim falë dhe do të kisha folur për tetë muajt dhe për tetë muajt, për këtë numër tetë do t'ia kisha zgjedhur vetëm një tetë çështje, të cilat nuk kanë marrë përgjigje deri më sot, gjithsesi jo të vetmet.

Katër të parat kanë me atë që i ka trashëguar kjo Qeveri, katër të dytat kanë me ato çfarë sot po vazhdojnë edhe gjatë mandatit të kësaj Qeverie:

1. Vjedhja e dhomave të dëshmimeve, siç përmendi edhe kolegu Kurti, kanë ndodhur ku janë vjedhur ar, drogë e gjëra tjera dhe askush nuk është në burg.
2. Një ndër vrasjet e pazbuluara deri më tash, vrasja e Elvis Pistës, askush në burg.
3. Shitja dhe abuzimi me listat e veteranëve, askush në burg, madje ky abuzim po vazhdon edhe në kohën kur po flasim.
4. Skandali i pasaportave, asnjë zyrtar para përgjegjësisë, madje ka pasur edhe zyrtarë që janë avancuar në detyra deri në maje të institucioneve shtetërore.
5. I humbëm 8 200 hektarë tokë dhe askush nuk dha përgjegjësi, madje as Meha, të cilit iu përplas harta në fytyrë.
6. Nenad Rikalo ende është ministër,
7. Banditi Millan Radojçiq ende në liri,
8. Humbën 53 milionë, u tretën dhe askush nuk merr përgjegjësi.

Pra, i zgjedha këto tetë skandale si numër simbolik për tetë muaj të qeverisjes së tanishme, e ndërkohë korrupsioni po vazhdon.

KRYESUESI: Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Nëse bën pak më tepër, problemi është të Mila i paska hangër krejt minutat kështu që nëse bën pak më gjatë, përndryshe për 15 sekonda... Faleminderit!

Unë, në fakt, mendoj se korrupsioni është sëmundja më kancerogjene që ka shoqëria jonë dhe demokracia e re, e cila është duke e dëmtuar në palcë zhvillimin dhe perspektivën e këtij vendi. Por, para se të flas për rastet, për aferat e fundit, unë mendoj se korrupsioni duhet shikuar dhe rishikuar në gjenezë, dhe gjeneza e këtij fenomeni shqetësues dhe e kësaj sëmundjeje kancerogjene është që nga paslufta, që pjesa dërrmuese e aferave është bërë nga ndërkombëtarët me njerëz, të cilët janë instaluar nëpër institucione dhe që kanë qenë pjesë e regjimeve të kaluara, por për fatin e keq që pre e këtyre dy kategorive ka rënë pastaj edhe klasa e re politike, ose gjeneratat e reja nëpër institucione.

Sido që të jetë, unë mendoj se serioziteti duhet me qenë më i madh dhe natyrisht në një numër të madh ligjesh duhet të ndërhyhet në to për ta rritur përgjegjësinë e të gjitha instancave ekzekutive.

Në fakt, raportet që për fatin e keq edhe nga Kuvendi, por edhe nga qytetarët merren kalimthi raportet e Auditorit të Përgjithshëm, me vite të tëra kanë konstatuar të gjetura për keqpërdorime të ndryshme që bëhen në të gjitha njësitet buxhetore, por me këtë është dashur të merren organet e Prokurorisë, të cilët me gjasë janë në gjumë. Edhe përkundër shumë debateve që zhvillohen për raporte të ndryshme Prokuroria e Shtetit së paku deri tash nuk ka treguar ndonjë seriozitet të madh për të ndërmarrë masa dhe për t'i paralajmëruar të gjithë ata që e keqpërdorin parandë publike, se nuk e kanë vendin në institucione, por e kanë diku tjetër.

Kulmi dhe e keqja më e madhe e këtij vendi ka ndodhur me privatizimin. Domethënë, unë mendoj se herët a vonë, aktorët, ne e dimë si ka lindur dhe kush e ka udhëhequr në fillim, por aktorët që janë solidarizuar me këtë formë të privatizimit të pronës shoqërore, të pasurisë shoqërore, unë mendoj që e kanë dëmtuar shumë seriozisht perspektivën dhe të ardhmen e fëmijëve tanë dhe të shtetit të Kosovës. Është momenti për të ndërhyrë, jam shumë i shqetësuar edhe për faktin se në këtë legjislaturë jam pjesë e Komisionit për Kontrollin e Brendshëm financiar dhe kur raportojnë shumë njësi buxhetore, e aq jemi të prekur nga ajo që deri tash, se në të gjitha raportet që kanë ardhur ka shkelje të rënda dhe papërgjegjësi ekstreme të njerëzve përgjegjës, të cilët, jo që nuk janë degraduar, por thjesht janë vazhduar në pozita të njëjta edhe me dekada. Unë po mendoj, zoti kryeministër, që është momenti që të ndërhyni seriozisht, e di që organet e ndjekjes dhe të drejtësisë janë të pavarura, besoj se na dëgjojnë, por së paku ndoshta është bërë mjaft, është bërë boll në këtë drejtim dhe t'i rikthehemi, sepse e kemi obligim, siç e thashë edhe më herët, edhe para perspektivës të këtij vendi, por veçanërisht para gjeneratave të reja.

Ne si gjeneratë që jetojmë në këtë kohë, vërtet ndoshta në një sferë kemi bërë punë të mëdha, por nuk mund ta lëmë vendin të degjenerohet deri në këtë ekstrem, sa pasojat të jenë shumë afatgjata dhe të paparashikuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë është një nga temat më të rëndësishme, është diçka që na shqetëson, që prek jetën e secilit qytetar të Republikës së Kosovës.

Me një gjë pajtohemi të gjithë që për luftimin e korrupsionit duhet të ketë konsensus shoqëror, duhet të aktivizohemi të gjithë që ta luftojmë këtë të keqe. Në momentin kur ne si përfaqësues politikë fillojmë diskutimet se e keni bërë edhe ju, kjo nënkupton që ne po pajtohemi me politikat korruptive. Unë mendoj që ende në secilin subjekt politik, në disa më shumë dominojnë

njerëz të pakorruptuar, ka ende një masë kritike të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët mund t'i kundërvihen kësaj dukurie kaq negative.

I nderuar kryeministër,

Ju falënderoj që ishit shumë aktiv dhe morët mundin t'i përgjigjeni pothuajse secilit shqetësim të deputetëve të Republikës së Kosovës. Unë nuk do t'u referohem raporteve, as atyre të vjetrave, as atyre të rejave, po ju pyes për çështje konkrete, të cilat kanë ndodhur gjatë mandatit të juaj.

53 milionë euro të ndara për Bechtel&Enka nuk ka asses si të interpretohen ndryshe, përpos si rasti më i rëndë i korrupsionit. Nuk ka asnjë dokument, asnjë dëshmi që deri më tani është treguar që ky nuk është diçka tjetër, përpos pazar, edhe përpos korrupsion, për shkak se Bechtel&Enka ka pasur marrëveshje deri në janar 2018 ta përfundojë projektin dhe ata paraprakisht janë pajtuar që me një kosto prej 14,7 milionëve ta përmbyllin kontratën. Justifikimi se në qoftë se nuk ua kishim dhënë 53 milionë i kishim humbur 200 milionë në Arbitrazh është argument që nuk pinë ujë te askush, te asnjë qytetarë i Republikës së Kosovës. Si mund ju t'i prejudikoni vendimet e Arbitrazhit. Kosova sapo doli nga një rast fitimtarë, rasti i Axosit, sepse kur nuk ku ka argumente nuk humb asnjë cent, as në Arbitrazh dhe askund tjetër, po duhet ditur për t'i përfaqësuar interesat e vendit.

Rasti tjetër, po i të njëjtës ministri, është Udhëzimi Administrativ 02/2018, i cili zgjat jetën në pafundësi homologimit. Monopoli që ka ekzistuar në Kosovë tash e 20 vite që askush nuk ka mundur ta heqë për shkak të kontratës dhe dëmeve që kishin mundur të bëhen, ai monopol përfundon në vitin 2019, e ministri juaj ka nxjerrë udhëzim t'ia zgjasë jetën këtij monopoli. Merreni e shikojeni Udhëzimin Administrativ, ia siguron jetën në pafundësi këtij monopoli.

Kryeministër,

Keni falë borxhe në fillim të mandatit rreth 50 milionë euro dhe e keni tërhequr vendimin. Dilni tregoni pse e keni falur dhe pse e keni tërhequr vendimin? I keni pesë ministra në aktakuzë, e keni zhvendosur Stadiumin Kombëtar të Kosovës prej Prishtinës në Drenas për shkak të shpronësimeve, për shkak të interesave grupore dhe partiake. Vendimi i Qeverisë, përkundër disa kundërshtimeve të ministrave të Kabinetit, për të ndërtuar zonë ekonomike në Banjë të Malishevës!

I nderuar kryeministër,

Çka i vjen era kësaj, pos korrupsion që 50 hektarë tokë private të shndërrohen në zonë ekonomike? Ne e kemi një zonë ekonomike, ajo është në Drenas, ajo pjesë është shumë afër Malishevës, dhe bizneset mund të vendosen në zonën e Drenasit, është edhe projekti për zgjerim të zonës. Tash doni që të filloni edhe livadhet private t'i shndërroni në zona ekonomike dhe të hyni t'i shpronësoni 50 hektarë tokë. Me cilin studim të fizibilitetit doli që duhet të ketë zonë ekonomike pikërisht në Banjë të Malishevës?

Tjetër? Kryeministër, vendimet e Qeverisë, 500 mijë një ditë, 200 mijë një ditë, 300 mijë një ditë nga rezerva shtetërore pa kurrfarë kriteri, e keni shpenzuar rezervën shtetërore për tre muajt e parë të vitit. Çka kemi tjetër? Punësim të familjarëve, bile edhe në pozita tepër kyçe. Mosrespektim total i marrëveshjes për rekrutim që kemi me kompaninë konsulente, që është ndihmë nga Ambasada Britanike. Kthimi në punë i drejtorit të Prokurimit, kryeministër, ne e dimë, e kemi pak përvojë, gjykata thotë të kthehet në pozitë ekuivalente, por nuk thotë të bëhet drejtor i Prokurimit. E keni hequr njërin, sepse gjykata nuk supozon që Ministria e Infrastrukturës e ka pasur pozitë të zbrazët për disa vite Prokurimin. Nuk ruhen pozitat e njerëzve që janë nën aktakuza, institucionet i rekrutojnë zyrtarët dhe mandej kur ta kthejë gjykata e vë në një pozitë ekuivalente, por jo në pozitën identike.

I nderuar kryeministër,

Nëse keni mundësi për tu përgjigj në çështjet, në gjërat që kanë ndodhur në mandatin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zonja deputete!

Pati edhe raste tjera që cekën tema të këtyre nëntë muajve ose tetë muajve, edhe këto tash, shikoni e para mendoj që ne në Kosovë duhet të krenohemi me gjendjen në rend dhe ligj dhe korrupsion, në luftimin e korrupsionit. Pra, e vërtetë që nuk është gjendja ajo që duhet të jetë, e nuk besoj që këtu s'pajtohemi. Pastaj, për disa tema veç e veç, shikoni pyetja për shembull zonja deputete bëhet, a pajtoheni ju që 14 milionë ka qenë borxhi i Kosovës ndaj Bechtel&Enka, se ka thënë një koleg juaji, e nëse po a po më tregoni atëherë në bazë të cilit dokument 14 kanë qenë një herë, ta di edhe unë në çfarë kriteri është vendosur 14-shi. Ka, a? E, shumë mirë!

Edhe nëse 14 milionë paska bërë, atëherë pse s'e keni kryer në atë kohë edhe t'ia lini Kosovës një temë në tavolinë, e kur të vijë kjo qeveria tjetër të ketë mundësi të vjedhë sipas jush, por ka mundur që ta kryejë, ka mundur me qenë punë e përfunduar. Fatkeqësisht, mungesa e vendimmarrjes atëherë e ka rënduar këtë lëndë, mos e krahasoni Bechtelin me Axosin. Është gabim shumë i rëndë, nuk ka kurrëgjë të ngjashme. Bechtel ekziston që dhjetëra vjet në mos, operon globalisht. Axosi është krijuar atëherë..., ju e dini, dhe për atë ka mundur ta mundë Kosova në gjykatë, ndërsa për këtë rastin tjetër e kemi të pastër, të humbur.

Jo vetëm kaq, rrezikonim edhe investimin qindmilionësh, projektin që e kemi jetik për ta kryer, edhe lajmet ndërkombëtare qysh Kosova s'i përmbush obligimet ndaj operatorëve në bazë të kontratës. Nëse të gjitha këto mendoni që janë të thjeshta, po ju siguroj që s'ka vjedhur kush ndonjë gjë në këtë temë, se nuk mundesh të vjedhësh edhe po të duash, jo me ata. Nëse është për të vjedhur, këqyrim tema tjera, por jo aty. Po të mos e kryenim këtë, ju siguroj, e di çka po flas. E dini edhe ju që është ashtu. Kush do që ka operuar, e di Lutfiu, që ka qenë ministër, a mund të

vidhet me Bechtelin. Nuk vjedh kurrkush i Kosovës me ta, as me Contour Global, s'mund të fusë cent në xhep kush i Kosovës.

Po, janë operatorë të mëdhenj, marrim nënkontraktorë, punojnë e paguajnë tatim në Kosovë, por që vjedh dikush i Kosovës e ka korrupsion, në këtë dyja mos se nuk është ashtu, mos i futni në këtë paketë. Janë mungesë e vendimmarrjes, e ka gjëra tjera, e ndoshta gabim në kalkulime, a çka e di, si të doni thoni, veç besoni nuk ka të bëjë me vjedhje. Edhe besoni, po të mos e kryenim tash, edhe më keq do të ishim ndarë. Edhe këto kompani kaq të mëdha me kaq renome, dhe ato kontratat nuk i shkruajnë në dëm të vetes asnjëherë, i shkruajnë pastër, që kushdo që s'i respekton me ta ndahet më keq. Në fakt, kanë mundur edhe tash të na mendojnë edhe një grimë më shumë, sipas të gjitha kalkulimeve kanë thënë edhe vetë, kanë bërë njëfarë kompromisi të caktuar.

Mua s'më vjen mirë që janë ndarë ato para, se kemi pasur ku t'i përdorim, por më vjen mirë, shpresoj, që nuk e kemi bërë një dëm më të madh. Këtë 14-shin e dikurshëm, e që sot është 50, s'e kemi lënë të bëhet diçka tjetër. E kisha pasur dëshirë ta di në çfarë kriteri ka qenë 14-shi, se do të më kishte ndihmuar shumë, se as unë s'po e di atë.

Stadiumi. Stadiumi së pari ende nuk është vendosur kurrkund, ende s'është ndërtua kurrkund. Pra, s'u ndërtua kurrkund stadiumi i ngratë, është një kredi që duhet me e marrë, e butë, është një fizibilitet, është një projekt. Nuk është lokacioni i keq, edhe nuk është bërë për hatër të ndokujt, se nuk shpronësohen pronat private për stadium. Janë publike. Megjithatë, ju e dini që janë në të djathtë, ato jemi duke i ruajtur, ia kemi dhënë edhe ato që kanë qenë të dedikuara për sport ia kemi dhënë sportit. Ua kemi ofruar disa klubeve sportive ato. Problemi është shpresoj që e ndërtojmë ndonjëherë atë stadium, se është bukur projekt i madh dhe është mirë ta ndërtojmë. Kemi nevojë për një stadium të tillë dhe do të kishte qenë mirë për ta ndërtuar. Te zona ekonomike, shikoni, ministritë e linjës, për shembull një Ministri e Shëndetësisë vjen te ne thotë duhet të ndërtohet një spital, është praktikë kjo. Ministria e Tregtisë vjen me një propozim, një Kabinet qeveritar e dëgjon, ia shpreh shqetësimet përkatëse sa kushton, a kushton, a bëhet shtrenjtë, krejt normalisht dhe shqyr që janë shprehur, e nuk është bërë definitive ajo. Është një drejtim i marrë. Megjithatë duhet të vijë një ditë kostoja, e nëse kostoja s'është proporcionale me qëllimin e zonës, a me efektet ekonomike, normalisht që aty duhet të mendojmë çka të bëjmë, pra ata që vendosin.

Jam i sigurt që edhe ne duhet, kjo Qeveri duhet të mësojë edhe prej gabimeve të veta, edhe prej lëshimeve ose gabimeve të mëhershme, dhe mundësisht ajo që është më e rëndësishmja një qeverie tjetër të mos ia lërë plot tavolinën me dëme, me gabime. Shikoni, ne i kemi paguar diku rreth 5 milionë për pasaportat që po flitet, i kemi pasur të bllokuara në anët tjera, për shkak të kësaj kemi pasur të shkojmë në pakufi në bllokada e në kosto. Po të kishim hyrë në Arbitrazh me Bechtel&Enka, nuk e di ku do të kishte qenë llogaria e këtij vendi dhe analizoni të gjithë mirë e

shikoni nëse a s'është ashtu. E, i lus ata që kontraktjnë në emër të vendit të vet, në cilindo nivel kudo qofshin, ta matin mirë kontraktimin. Kontrata është bërë me një dinamikë kohore, ka pasur në atë afat kohor që ai t'i heqë pajisjet prej këtu e t'i dërgojë në Iran, a në Turqi a diku në Kaukaz a diku ku ndërton. Kanë hyrë me vetëdije këta tonët, ka ardhur puna për të paguar, i kanë thënë "jo s'mundemi tash". Ia kanë dhënë më pak, e është dashur ai të qëndrojë me krejt pajisjet e tij këtu, e po të dojë ta shkruajë një faturë tjetër ta shkruajnë këta, e atëherë e sheh ti nëpër gjykata me ligje të BE-së se si ndahesh.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën. Replikë? Po, s'e ke shtypur. A, po më fal, po! Replikë, Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër, nuk mund t'i krahasoj Bechtelin edhe Axosin se nuk i di detajet e secilës kompani, por për vite me radhë, LDK-ja, derisa është fituar rasti, është akuzuar që LDK-ja nuk ka pranuar ta aprovojë kontratën e Axosit në Kuvend edhe ne rrezikojmë t'i humbim 300 milionë euro. Edhe derisa është kryer procesi, besoni që askush nuk e ka ditur se çfarë do të ndodh, por më vonë ka dalë zoti Ismajli në televizor edhe ka thënë që nuk ka qenë fajtor Kuvendi.

Po i krahasoj si rastet, asnjëherë nuk keni as mundësi, as kapacitet, as kompetencë ta dini se çka ndodh në Arbitrazh. Ajo çka ne besojmë se the disa herë "besoni, besoni" se dëmi mund të jetë më i madh, ne u besojmë fakteve. Për 14,7 milionë në Ministrinë e Infrastrukturës ka shumë shkresa. Nuk ka asnjë shkresë dhe nuk ka asnjë nen, të cilin ministri Lekaj mund ta bazojë 53 milionëshin. Ne e kemi një interpelancë, po unë me të vërtet po konsideroj që kur flitet për korrupsion kjo duhet të jetë kryefjala e interpelancës së sotme, ndërkohë që kemi ftuar interpelancë të posaçme për atë.

Te Stadiumi ju nuk e keni zhvendosur, ju keni marrë vendim për ta zhvendosur, ajo zhvendosje është, domethënë ka një vendim të Qeverisë për t' u ndërtuar atje, e jo të ndërtohet ku ka qenë.

Në anën tjetër, thatë që po, ministrat e linjës ju bien propozime dhe ju i pranoni si të tilla. Ju jeni kryeministër dhe ju nuk mund të pranoni secilin propozim, sepse ju bartni përgjegjësinë kryesore. Besomëni, që ne me përvojën që kemi pasur me ish-kryeministrin Mustafa kemi dërguar propozime dhe ligje pa kosto buxhetore, po ato asnjëherë nuk na kanë kaluar, sepse kanë kaluar nëpër disa filtra: te këshilltarët e tij, te zyra ligjore e mandej kemi mundur t'i fusim gjërat në rend dite.

Dhe më e rëndësishmja, kryeministër, nuk më thatë se si qe puna që i falët një herë 50 e ca milionë taksa të ujit e më vonë e tërhoqët vendimin, bazuar në çka? Kush ju tha që ajo është joligjore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Sa i përket Behtel&Enkës paskëm rast me folë dhe do të flasim. Në fakt, sa i përket AKSOS-it diçka, po na del se ajo që kemi kujtua që e shpëtuam Kosovën atëherë, po del se e kemi marrë në qafë kur e kemi anuluar. Qe po ua jap një mendim timin, po ta shohim çka kemi bërë. Atëherë kemi pasur me i marrë nja 180 milionë dhe është menduar që ai është konsorcium pak i çuditshëm, ka pasur fjalë shumë, po kemi pasur t'i marrim nja 180 milionë për buxhetin tonë edhe me e privatizua. Fatkeqësisht, tash prej asaj kohe që e kemi "shpëtuar" Kosovën deri sot e kemi kryer punën me Telekomin, s'e kemi më hiç.

Sido që të jetë, këto janë rrethanat që... Marrëdhënien me Behtel&Enkën unë për vete e konsideroj më ndryshe. Konsideroj shumë më serioze dhe i respektoj si operatorë, pra nëse ka operatorë që meritojnë respektin, janë. Mendoj që e bëj edhe për të mirën e këtij vendi, jo veç timen, se në fund të fundit unë qe tetë muaj kam ardhur, s'i kam njohur përpara. Para meje ka punuar kryeministri përpara, kryeministri tjetër e me radhë.

Urdhëro? Besoj që po. E vërtetë, por kur është nënshkruar kontrata dikush është dashur me pas kujdes çka po bën.

Njëkohësisht, po ju them që marrëdhënia me ta edhe kjo nuk është bërë pa dokumente, pa fakte e letra, qysh po konstatojnë ju, zonja deputete, po ajo praktika e ministrit tuaj, ai precedenti qysh i ka konstatuar ai 14, ato kanë shkuar veç duke u bërë një mbi një. Përnjëmend po ua bëj një pyetje, pse bre atëherë s'e keni kryer atë 14-shin?

Po, a? Atë 14-shin qysh e keni lënë ju atëherë? Që dikur t'i paguajë ndoshta, ë?

(Debat nga salla)

Shikoni, shumë mirë që është kjo ndjenja për ta ruajtur paranë e popullit edhe e dimë këtë ndjenjë, besoj e dimë, e ndiejmë. Ato 50 që po thoni "pse i ke falë, i ke ndalë...", nuk i kam çuar larg, kanë qenë te populli. Këto të ujit. E në fakt, a e dini pse e kemi ndalë, e kemi anuluar? S'kishte pasur hiç nevojë me ua falë, se kishin humbur ato krejt, s'po figuronin kurrkund, se s'i kishin nxjerrë kurrë. Hiç kurrë s'ishin inkasuar, s'di sa vjet ishin prej atëherë edhe kështu që s'kishte nevojë. Si vendose, si jo, atë ishin të shlyera si borxhe.

Po, hajde për shumë tema që po i ngrini kolegë të LDK-së, ju keni qeverisur me vendin minimum nga viti '99. Këshill të Përkohshëm Administrativ, me leje në Këshill të Përkohshëm Administrativ, në Qeverinë në OKB, koalicionin Rugova-Haradinaj, Thaçi-Sejdiu, Mustafa-Thaçi. S'ka mundur kjo gjendje të vijë, kjo logjika e kontratave pa kontributin tuaj shumë të

fuqishëm. Ky që e keni para vetes që tetë muaj i ka gjetur këto në tavolinë, bomba të kurdisura. Nuk po them se i keni krejt kontributet ju, veç aty janë. Ju kisha lutur të reflektoni pak!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër,

Për hir të atyre që po na përcjellin, është mirë ndoshta të ritheksohet, se kjo seancë ishte ftuar për 28 mars 2018. Pra, më shumë se tre muaj keni hezitur dhe nuk është zhvilluar ky debat kaq i rëndësishëm për korrupsionin. Është edhe një çështje tjetër që duhet përmendur, pasi që ju iu referuat një citimi aty nga raporti i ekspertëve ndërkombëtarë, se kjo nuk paraqet qëndrimin e BE-së. Është mirë të përmendet për ata që nuk janë marrë me raporte, sepse kushdo, jo vetëm ekspertët, po edhe ata që kanë lexuar një raport me vëmendje e dinë se citime të tilla, se kjo nuk paraqet qëndrimin e BE-së, janë standarde që përmenden në secilin prej raporteve.

Për më shumë, meqenëse përmendet edhe na ndatë sot një raport dhe thatë se raporti është për të dhënat deri në vitin 2017, në raportin që ju na e ndatë sot, të gjitha shifrat dhe faktet e të gjitha tabelat u referohen rezultateve dhe sukseseve deri në vitin 2017. Pra, ky raport që ju shpërdatë sot nuk flet asgjë për kohën e qeverisjes suaj.

Dhe, që të kthehemi te qeverisja juaj edhe pse kemi një pikë për PTK-në që do të diskutohet më tutje, unë dëshiroj të ju bëj një pyetje, se sa persona janë punësuar me listë deri tani nga ana juaj në PTK? Madje, edhe dje në një deklaratë publike ju tashmë veç përgatitët opinionin se një anëtar i AAK-së do të jetë sigurisht drejtor apo udhëheqës i PTK-së dhe ju citoj, ju thatë “Pse jo? Ai është një djalë i gjallë.” , në mes tjerash.

Po ashtu, zoti kryeministër, unë kam dëshirë të ritheksoj pyetjen që ju kam bërë në lidhje me shpronësimet në Shipitullë, sepse konsideroj dhe besoj që aty ka aferë të pastër korruptive. A keni respektuar ju vendimet e qeverive paraardhëse të cilët kishin ndaluar ndërtimin në Shipitullë apo shpronësoni edhe ndërtimet që janë bërë pas marrjes së këtyre vendimeve.

Meqenëse u fol për Nexhat Krasniqin, unë vetëm dua të ritheksoj se në bazë të deklaratave të dhëna dhe publike Nexhat Krasniqit i ishte vërtetuar dënimi për keqpërdorim në të gjitha shkallët e gjykatës, përfshi edhe Gjykatën Kushtetuese dhe për më tepër, për informatën e juaj, ekzistonte edhe një vendim i cili i ndalonte Nexhat Krasniqit të hynte në zyrat e prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës, aty ku tashmë ai është caktuar drejtor apo shef i kësaj zyre. Pra, ai është kthyer në një pozitë ku buxheti është rreth 300 milionë euro, shef i prokurimit në një zyrë që do të menaxhojë me këtë buxhet është caktuar nën qeverisjen tuaj një person që është i akuzuar për keqpërdorime, i dënuar në fakt, jo vetëm i akuzuar. Për më shumë, do të përmend këtu edhe emërimin e Nijazi Thaçit, kushëririn të Hashim Thaçit, presidentit, si drejtor i KEK-ut në

qeverisjen tuaj, i cili po ashtu është i akuzuar nga Prokuroria Speciale për tri vepra penale në lidhje me keqpërdorimet me tenderë milionësh.

Zoti kryeministër, është e vërtetë që ju nga shtatori jeni në këtë detyrë dhe deri atëherë, pra kur erdhët në këtë detyrë, ju keni folur për shtetin e kapur. Unë e përsëris pyetjen që ua bëri deputeti Kurti, a jeni ju, domethënë a mendoni akoma, zoti kryeministër, se autorët e kapjes së shtetit dje janë sot partnerët tuaj në qeverisje dhe a po vazhdon edhe qeverisja nën udhëheqjen tuaj bashkë me këta pjesëmarrës dhe madje, me afëra korruptive në mënyrë edhe më agresive se sa përpara? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Punësimet në PTK. Kanë ndodhur disa punësime edhe në këtë kohë. Janë diku 40 janë të punësuar në vepër, po para se me u shkarkua drejtori Mustafa. Do të thotë, 65 të tjerë, po ashtu janë marrë në vepër, po është një ushtrues që ka qenë me zotin Mustafa që i ka marrë. Këtyre u del afati diku, se kam pyetur për këtë për disa arsye të tjera dhe janë tre të punësuar nga ushtrues detyre i ri i drejtorit i tashmi, tre. Të gjithë janë në vepër dhe u del në qershor ose në korrik. Pse kam pyetur për këtë? Për shkak se nga ndryshimet që kanë ndodhur në menaxhmentin e Telekomit, jemi të interesuar për ta parë çdo trend, çdo dinamikë.

Për Gentin, nuk e di a ke qenë drejtoreshë e arsimit, e ke pasur kolegë, mendoj se nuk është djalë i pa gjallë. Nëse është ndonjë shkelje që kam thënë se është djalë i gjallë, unë e kam koleg s'guxoj pa thënë që është.

Arsyeja pse, shikoni një dozë e transparencës që po e aplikoj nuk është shkallë e naivitetit veç, është shkallë edhe e sinqeritetit. Aleanca vërtet ka qenë në opozitë nja 12 vjet. I ka ardhur mundësia ndokujt të aplikojë, të konkurrojë, nëse i plotëson kriteret s'mund t'u themi njerëzve "rrini atje".

E dyta është... po shiko, tash unë në Kosovë jetoj, s'mund të ju rrej për ledine. Për këtë Nexhatin, vërtet edhe një herë po e them, informatën që e kam, mund të jetë edhe ajo që po thoni ju edhe që e tha zoti Sveçla më herët, informatën që e kam unë është se na e ka kthyer Gjykata. Tash, ta shohim cila qëndron dhe çka është në pyetje. Unë s'po flas më shumë.

Shikoni, nëse keni pritur prej kësaj Qeverie ta dezinfektojë Kosovën prej korrupsionit e prej kapjes së shtetit, i paskeni pasur pritjet më të mëdha se sa që i kam kapacitetet, edhe si njeri, edhe si... Por, nëse po ashtu e vlerësoni se kapja e shtetit po vazhdon njësoj edhe është më keq e diçka... mendoj se nuk e keni të drejtë këtë. Nuk është ashtu. Shikoni, nuk është veç rezultat i punës sime. Unë mendoj se është një vetëdije e shumë prej nesh që gjendja në vendin tonë duhet

të ndryshojë. Pra, nuk mund të shkojmë në logjika të gabuara më tutje, se e shkatërruam vendin, e shkatërruam veten, i shkatërruam mundësitë e këtij vendi. Po ju siguroj, që edhe këto suksese nuk janë të miat, këto që po i nxjerrim ne në evidenca, por janë të vetëdijes së gjithkujt, a është në arsim, a është në shëndetësi a kudo qoftë, në transport, a në gjyqësor a... nuk janë të Ramush Haradinajt, po është një vetëdije që po vjen, besoj.

Për raportet. Shikoni, unë për besë nuk mund të shtyhem me raporte, se mendoj që u kalua ajo pjesë, po ja ky është një raport i BE-së. Ka emër, mbiemër raporti dhe nuk e ka atë shprehjen...

Faleminderit edhe një herë, më falni!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Naser Rugova nga LDK-ja. I keni 1 minutë e 57 sekonda.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Po flasim për një temë tejet serioze. Në radhë të parë dua ta shpreh protestën time si deputet për gjuhën joparlamentare, që ka filluar të bëhet kronike në tempullin më të lartë të demokracisë së këtij shteti. Me këtë vetëdije nuk shkohet askund, as nuk luftohet korrupsioni, as nuk emancipohet elita politike, e cila ka shumë nevojë.

Atëherë, ka mungesë të vullnetit politik. Gjyqësor pasiv joprofesional i korruptuar. Vetëm gjashtë muajt e fundit janë marrë vendime nga gjyqësore për njerëz që e kanë dëmtuar shtetin mbi 300 milionë euro dhe Evropa e sheh këtë, e di këtë dhe nuk mund ta justifikojë askush që nuk ka interferime politike.

Zoti kryeministër,

Një ditë jo të largët në këtë vend, në këtë shtet ka për të ardhur një qeveri normale. Ju lutem, të keni kujdes edhe me emërimet joligjore. Detyrohet përfaqësuesja e BE-së të ju dërgojë letër për emërimet joprofesionale në dikastere të caktuara qeveritare. Emëroni të partive tuaja, por zgjidhni njerëz me CV që i plotësojnë ato kërkesa të atyre kritereve, që janë teknokratë të mirëfilltë. Edhe unë nesër e kisha emëruar një të LDK-së, por e kisha emëruar një njeri që ka kompetencë profesionale ta ushtrojë atë detyrë.

Dhe krejt në fund, duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm me ecjen tutje në rrugën e integriteteve evropiane. Kjo qasje, kjo logjikë dhe mungesa e konsensusit nacional frikohem që po na largon drejt rrugës sonë në anëtarësimin në BE. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, po jepen shifra qindra milionë, qindra milionë, qindra milionë... ndodhën këta muaj, ndodhën te ato... ndoshta edhe dikush ju beson, por mos ashtu.

Mos jepni kështu paushall numra. Krejt buxheti ynë është nja 2 miliardë. Dëgjoni, veç po ju shpjegoj diçka. Në Qeverinë e mëhershme janë humbur dy arbitrazha. Dy vendime në Arbitrazh i ka humbur Qeveria para meje edhe i kemi paguar paratë për to. Këtë Qeveri pahiri diqysh, si thoshte Kuçi, pahiri e fituam Axosin.

Ju lutem, nëse vërtet... e tashti te punësimet. Keni të drejtë, po ka nganjëherë si me thënë, tërë njerëzit kanë synuar, kanë pritur një perspektivë, një diçka dhe kuptohet që është një presion, një kërkesë, një situatë e çuditshme edhe duhet me bë kujdes çdokush edhe ne, edhe të gjithë të tjerët. Po, ju lutem në qasja e kësaj Qeverie nuk është një qasje mosrespektim ndaj gjendjes së vendit tonë, qoftë në financa, qoftë në buxhet, qoftë në ekonomi, nuk është ashtu. Nëse e shihni, merreni për shembull ministrin Hamza, shihni sa i përgjegjshëm është, sa i kujdesshëm është. Ne disa i kemi rolet e ndara. Ai Reçica, Skenderi, ai duhet të marrë sa më shumë për t'ua dërguar kategorive sociale, po dikush duhet thënë sa kemi. Po, nuk është një situatë, as jashtë kontrollit, as pa kalkulim se ku po shkojmë edhe shumica e veprimeve janë bërë në bazë të një kalkulimi se si po ecim. Edhe ka një kalkulim real në to.

Tjetra, unë nuk e di çka ndodh me mu në jetën time, as politike, as private, po nuk rri në atë Qeveri pa marrë vendime, pa hy me guxim në vendime nuk e lë edhe me e ditë që rrotullohet përmbys, se një status-quo në këtë vend nuk po na duhet asgjë. Janë duke na ikur rinia prej këtu, dikush prej frikës se po gabon... a e dini kush frikohet më së shumti, ai që ka vjedhë, burra. Ai s'guxon të shkojë atje e të qesë as po, as jo, se ka qenë në dallavere. Dikush duhet t'i marrë disa vendime në këtë vend, po - jo, po - jo, sa e ke mandatin, kur të kryhet mandati, ose përfundon në burg, ose të lavdërojnë e ta ngrenë një përmendore a diçka, po vendin s'mund ta lëmë në status quo.

Marrëdhënia me Behtel&Enka ka pasur për të shkuar në kontaminim të skajshëm e në dëme shumë më të mëdha financiare e ekonomike për këtë vend. Pse? Sepse, dikush... ka qenë 14 s'ia ka vënë drynin. Ka mundur t'ia vejë drynin qatë ditë, me thënë po, e paguajmë, po ta paguajmë filan ditën, e ka lënë ashtu... krejt ka degraduar ajo edhe unë nuk jam aq i keq, se në rrethana tjera edhe unë kisha mundur ta bëj një task-forcë edhe me thënë, pse s'u krye në atë kohë. Jo, jo, dëgjo, a e di pse s'po e bëj? Se me nis ashtu duhet veç me ndej duke kqyr përpara. Ajo që jam duke bërë është... jam duke çelur rrugën e këtij vendi për të ecur nga gjendja e sotme. Jo, jo, jo, qysh me u përsëritë? S'ka. Se, s'po lë aso marrëdhëniesh kurrkujt në tavolinë. Edhe nesër, shihni investimin në energji, qe sa vjet e kemi zgjatur ne, po bëjmë energji, s'po bëjmë... qe 10 vjet. Po e bëjmë, s'po e bëjmë, po investojmë, s'po investojmë...

122 euro, besoni, mbani mend çka po ju them, 122 euro e blen Serbia megavatin prej energjisë diellore, 122 e ka. Ne po duam të importojmë prej tyre nesër e po themi se na bie më lirë. Po, s'është ashtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Prej minutave të mia Adem Mikullovcit ia jap fjalën. S'ke më minuta.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Ramush,

Po të drejtohem me "ti", nëse më lejojnë, se po dua të të kem më të afërt e si vëllanë tim.

Para 90 vjetësh... A po më lejoni të flas? Me leje, e kam marrë fjalën..

Para 90 vjetësh, Ramush, Noli i shkroi disa vargje, të cilat thuajse i ka shkruar për ty:

“Vendi dridhej,
ai mbeti
se nuk trembej nga tërmeti.
Thonë u shtri,
e thonë u vra,
por ti s'vdiqe, or baba”.

Shumë herë prita të bjerë Qeveria jote, Ramush, po nuk ra. Deputetët serbë thanë po tërhiqen nga Koalicioni PAN. Thash, ra Ramushi, po ti nuk re. Ministrat e tu ta bënë pas shpine, i dëbuan 6 qytetarë turq me dhunë në Turqi edhe ne e morën fytyrën para krejt Evropës dhe unë thash “Ra Ramushi”, po ti Ramush nuk re. Dua të them këtu, se kur filozofi i vjetër grek, Seneka, bëri vetëvrasje ia la një letër lamtumirës Neronit ku i shkroi “Imzot, ta falë që e vrave nënën tënde, ta falë që e dogje Romën, por nuk ta falë që më detyrove të t'i lavdëroj poezitë tua”.

Unë, Ramush, ta falë që e tëhollove Buxhetin e Kosovës, ta falë që emërove një batalion zëvendësministra e këshilltarë e ku di unë, po nuk ta falë kurrë që ndërrove qëndrimin ndaj demarkacionit me Malin e Zi aq shpejt. Sa ishe në opozitë i gjuajte hartat në hava edhe skicat dhe bërtite fuqishëm “Ky kufi nuk bën të votohet!” dhe, posa u bëre kryeministër i ktheve ato harta dhe me të njëjtin vrull bërtite “Ky kufi duhet të votohet!”. Vetëvendosja nuk e votoi, e ruajti fytyrën e vet, se thonë “dy gishta fytyrë”, por Kosova humbi 8 000 hektarë tokë. Këtë, Ramush, s'mund të ta fal.

Prandaj, si miku yt, jarani yt, për të mirën tënde e kam një propozim. Dil në foltore dhe thuaju këtyre deputetëve, “Ju me votën e juaj ma dhatë postin e kryeministrit, unë atë post ua kthej, se nuk po mund të jem kryeministër, nuk po mundem, nuk po di, nuk po dua, nuk po më donë”. Jep

dorëheqje, Ramush! Kjo është për të mirën e Kosovës, për të mirën tënde personale dhe për të mirën e kombit...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I dashur Adem, Nuk... jo, jo, me ty kam konsideratë sa të duash. Para ca ditësh kemi pasur tre opsione të letrës, që i çon një qeveri qeverisë tjetër për ta informuar për marrëveshjen për kufi.

Opsioni i parë është letër standarde në këto raste, që thotë, veç si vijon: Parlamenti ynë në atë marrëveshjen tonë me tuajën e ka ratifikuar.

Opsioni i dytë ka qenë me thënë “e ka ratifikuar atë, po i ka edhe disa elemente tjera...”

Opsioni i tretë i letrës ka qenë me thënë që “Parlamenti ynë ka marrë vendim lidhur me marrëveshjen bazuar në deklaratën e dy presidentëve edhe një raport që e parasheh korrigjimin. Ju informojmë, se jemi të gatshëm për korrigjim.”

Kjo letër i ka shkuar Qeverisë së Malit të zi. Tashti, me siguri se publikohet ndonjëherë, po kjo letër i ka shkuar. Deklarimet e ndokujt tjetër për këtë temë, qysh do që e thonë kanë të drejtë, mirë e kanë. S’e di, veç po jua bëj një pyetje, a mërziteni po të ndodhë përnjëmend të korrigjohet kufiri? A është ndonjë problem? A ndodh ndonjë send e keqe, nëse eventualisht korrigjohet, çka bëhet?

Urdhëro! Eh, shyqyr pra! Anë. Këtu jemi. Ty, jo, se ti po e shoh që s’e bën... po dikush po.

KRYESUESI: Zoti Rugova, replikë. Po ta lë edhe ty, meqenëse keni qenë në debat.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Unë kur kritikoj, kritikoj fenomene, bartës të institucioneve dhe jo individë. Jam jashtëzakonisht i kujdesshëm. Në këtë kuptim, sepse nuk pata kohë të mjaftueshëm, ju lutem, shikojeni sindromën e shpronësimeve. E ka shkatërruar buxhetin e këtij shteti. Krijoni një fond për fatkeqësi elementare, sepse i kanë goditur tre muajt e fundit dy-tri komuna dhe u ka shkaktuar shumë probleme agro-prodhuesve.

E kam këtu një procesverbal nga Drejtoria për Bujqësi e Komunës së Istogut, ku 17 agro-prodhues i ka dëmtuar breshëri të lashtat e tyre 139 000 euro. Shikojeni Agjencinë e Pagesave në Ministrinë e Bujqësisë. Do të thotë, unë jam dakord që duhet të bëhet një shpërndarje emergjente

për raste të caktuara nga i pari i Qeverisë, por ju lutem, ato të shpërndahen në mënyrë racionale, në mënyrë proporcionale dhe me vend.

Prandaj, kur e potencova 300-milionëshin, thashë vendimet e gjyqësorit që po krijojnë perceptcion të keq te opinioni, te mediat, te miqtë tanë ndërkombëtarë dhe po futen në raporte zyrtare. Kjo po na degradon si vend, si shtet dhe si popull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutimet kanë përfunduar, realisht disa nga partitë politike kanë marrë pak më shumë minuta, për arsye se duhen sqaruar mes veti.

Radha është e kryeministrit që ta thotë fjalën e tij përfundimtare lidhur me debatin e sotëm në interpelancë. Zoti kryeministër, në qoftë se keni dhe dëshironi të thoni diçka si fjalë përfundimtare, jo. Në rregull.

Atëherë, propozuesi i interpelancës ka të drejtë pesë minuta, zonja Pacolli e keni fjalën.

FITORE PACOLLI: Faleminderit!

Kryeministër, në Raportin e Progresit, pra Raportin për vendin, të cilin ta kanë dhënë, ka shkruar se s'ka 'disclaimer', pra zyrtar është raporti, a e ke kuptuar a jo, po të shkruan s'ka 'disclaimer', pra zyrtar është raporti. Kështu po të shkruan, t'i nuk po dëgjon, nejtse. Duhet ta dish të bësh dallimin mes raportit zyrtar që del prej institucionit dhe raportit i cili punohet nga ekspertët e pavarur, të cilëve u kërkohet nga ndonjë institucion, cilido qoftë, që të punohet raporti, pra ka dallime.

Dhe, ne nuk kemi thënë që secili raport ka 'disclaimer', por disa kanë dhe sidomos këta të cilët punohen nga ekspertë të pavarur.

Atëherë ju fillimisht e mohuat se nuk ka raport, mirëpo gjatë debatit e pranuat disa herë se ka raport, pra publikisht duhet t'u kërkoni falje qytetarëve dhe deputetëve të cilët i gënjyet më herët për raportin.

Ju thatë se deputetët nuk janë të përgatitur dhe nuk po e përcjellin dinamikën e Qeverisë, duhet të jetë e kundërta, kryeministër, ju duhet ta përcillni dinamikën e Kuvendit, jo ne të Qeverisë.

Pasi gjatë gjithë debatit u shprehët i gatshëm të luftoni korrupsionin, atëherë unë po e ritheksoj edhe një herë se është mirë që ju t'i ftoni të gjithë deputetët e këtij Kuvendi dhe sidomos ju të jeni të gatshëm që rezolutën, e cila kalon në këtë Kuvend, ta respektoni, pra u bëni thirrje deputetëve, sepse kjo rezolutë ka për detyrë dhe ka për qëllim që të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pra, rezoluta e cila del nga ky debat ka tetë pika dhe unë i ftoj deputetët që pasi t'i kenë dëgjuar pikat që do t'i lexoj, do të mund të ofrojnë komentet e tyre dhe pastaj mund t'i harmonizojmë dhe të shkojmë në votim.

Këto rekomandime dalin nga interpelanca, e cila është thirrur tre muaj më parë, më 28 mars, mirëpo fatkeqësisht kryeministrit iu kanë dashur rreth tre muaj që të përgatitet për këtë interpelancë.

Pika e parë që del nga ky debat është që Qeveria e Republikës së Kosovës të shkarkojë nga detyra të gjithë zyrtarët e lartë, të cilët kanë aktakuza për keqpërdorim ose korrupsion nga pozicioni të cilin e mbajnë.

E dyta, Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet t'i dorëzojë brenda 15 ditëve pune raport të detajuar Kuvendit të Kosovës mbi dosjen penale të çdo anëtari të bordeve të ndërmarrjeve publike, qendrore dhe rajonale dhe kryeshefave ekzekutivë, kjo përfshirë edhe rastet që kanë vetëm aktakuzë apo në të kaluarën kanë pasur.

E treta, Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Auditori i Përgjithshëm të hartojë në përputhje me legjislacionin në fuqi raportin mbi rregullsinë, performansën dhe financat e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Këtë raport t'ia dorëzojë Kuvendit jo më larg se 90 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rezolute.

E katërta, Ministria e Punëve të Brendshme t'i dërgojë raport Kuvendit të Kosovës me gjendjen dhe rastet me aktakuzë të mëhershme dhe të tashme, pra, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Departamenti Special Antikorrupsion në Policinë e Republikës së Kosovës dhe Divizioni Kundër Krimin të Organizuar.

E pesta, komisionet parlamentare të mbikëqyrin punën e institucioneve të pavarura të zgjedhura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duhet të themelojnë grupet e punës brenda komisioneve për të përgatitur raportin me të dhënat mbi rastet dhe aktakuzat e anëtarëve të bordeve dhe drejtuesve të këtyre institucioneve.

Këto raporte të paraqiten në seancë brenda 30 ditëve si dhe t'i dorëzohen Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjashtë, Ministra e Drejtësisë, në koordinim me Komisionin për Legjislacion, të fillojë përgatitjen jo më vonë se shtatë ditë pune nga hyrja në fuqi të kësaj rezolute për nismë legislative për vlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, me theks të veçantë vetingun.

Shtatë, Qeveria e Republikës së Kosovës në fazën e rishqyrtimit buxhetor të vitit 2018 të ofrojë mbështetjen financiare për sistemin e drejtësisë për këto pika:

Krijimin e departamenteve të veçanta brenda Prokurorisë dhe gjykatave në përbërje të ekipeve të veçanta prokurorësh, hetuesish dhe gjykatës të profilizuar që do të merren vetëm me lëndët e korrupsionit.

Shtimin e numrit të stafit mbështetës, i profilizuar në këtë drejtim.

Tetë, Komisioni për Legjislacion, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës urgjentisht duhet të informojnë Kuvendin për rastet e parashkrimit në lëndët e korrupsionit, dënimet e ulëta, ato me kusht, përfshirë këtu edhe analizën për rrethanat lehtësuese në aktgjykime si dhe të dalë me rekomandime për adresimin e këtyre rasteve.

Prandaj, unë i ftoj deputetët që t'i votojnë këto pika dhe kryeministrin që të bëjë thirrje që të votohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të votuar, por para se të shkojmë në pauzë, kemi 45 deputetë në sallë.

Zonja Pacolli, më duhet të them që rezolutat duhet ta ndryshojnë praktikën, duhet ta kenë tekstin edhe deputetët. Të fillojmë të diskutojmë për së dyti veç për rezolutën, nëse nuk e keni harmonizuar, përpiquni t'i harmonizoni me grupet parlamentare në qoftë se doni t'i nxirrni në votim dhe në qoftë se doni t'u mbështeten. Në qoftë se nuk i harmonizoni, unë nuk di a e votojnë. Në rregull, unë s'kam asgjë.

* * *

E enjte, 14 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj, 1, 4, 5, 6 qershor 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë! Votojmë tani!

4. Votimi i Propozim-Rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Pas debatit në seancën plenare më 8 qershor 2018 është kërkuar që të harmonizohet teksti i propozim-rezolutës edhe me grupet tjera parlamentare. E ftoj deputeten zonjën Pacolli nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes që ta paraqesë tekstin me propozimin e rezolutës harmonizuar me grupet tjera parlamentare, Zonja Pacolli nuk është këtu, atëherë zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, deputetja Pacolli nuk është e pranishme dhe po e marr unë përsipër që t'i lexoj propozimet tona, por që paraprakisht duhet theksuar që nuk janë të harmonizuara. Prandaj, në qoftë se duan përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose nëse i kanë propozimet e tyre, ne mund të mblidhemi dhe t'i diskutojmë ato dhe t'i harmonizojmë, që qoftë se jo, atëherë neve na mbetet që t'i vendosim kështu në votim. Ndoshta është mirë paraprakisht ta kemi edhe qëndrimin e grupeve tjera parlamentare.

KRYESUESI. Në rregull, Grupi Parlamentar i LDK-së, a dëshiron të deklarohet sa i përket propozim rezolutës? Jo! PDK, jo! Partia Social Demokratike, jo! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Ne konsiderojmë se është dashur të kryhet çështja e harmonizimit të rezolutës. Nuk kemi pasur ftesë fare nga grupi parlamentar i cili e ka propozuar, prandaj konsideroj se është për të të ardhur keq pse nuk ka pasur ftesë fare grupi parlamentar që ta harmonizojë rezolutën. Faleminderit!

KRYESUESI: Nisma, zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Nuk kemi pasur ftesë për harmonizim rreth kësaj, tash për herë të parë po dëgjoj dhe nëse hidhet në votim, ju e dini që nëse nuk ka harmonizim nuk ka votë për as kundër. Nuk votoj fare.

KRYESUESI: Lista serbe, a dëshiron? Jo! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Po shoh që shumica e grupeve parlamentare në fakt nuk janë në dijeni për listën e rekomandimeve dhe nuk janë harmonizuar. Unë po propozoj që të vendoset në fund të seancës të re, të cilën do ta fillojmë pas pak si pikë e rendit të ditës dhe deri atëherë besoj që harmonizohet.

KRYESUESI: Mund ta votojmë tash, keni kalua 100 herë, derisa nuk është harmonizuar votojmë, kush do voton për, kush kundër. Zonja Haxhiu e ka prapë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Edhe një herë, nuk e di në qoftë se na dëgjuan përfaqësuesit e Nismës dhe të Aleancës, ne e shprehëm gatishmërinë për t'i harmonizuar këto rekomandime dhe jemi dakord që kjo çështje të vendoset në fund të rendit të ditës dhe të ketë një përpjekje që t'i harmonizojmë.

Megjithatë, më lejoni që për hir të transparencës dhe deputetëve të cilët nuk i kanë këto rekomandime t'i lexoj ato, e pastaj e vendosim bashkë se cilat janë propozimet, të cilat duhet të kalojnë.

KRYESUESI: Ju duhet t'i shpërndani me shkrim rekomandimet, pastaj s'ke nevojë t'i lexosh.

ALBULENA HAXHIU: I kemi shpërndarë me shkrim zoti kryesues, data 28. 3. 2018, tash ne për çdo ditë nuk mund të ua shpërndajmë. Më 28. 3. 2018, të gjithë deputetët e Kuvendit i kanë pasur në kutitë e tyre. Prandaj, nuk është korrekte që të na akuzoni neve për neglizhencë të deputetëve.

KRYESUESI: I kanë, ju merruni vesh me grupet parlamentare, takohuni, nëse i harmonizoni, unë jam dakord të shtyhet për më vonë.

ALBULENA HAXHIU: Megjithatë, në emër të grupit parlamentar... A ka mundësi zoti kryesues kur të flasë një deputet, të mos e ndërpritni. E ke të drejtën sa herë të duash të flasësh...

KRYESUESI: Jo, nuk po të ndërpres, por është bërë praktikë për gjithçka dëshiron të diskutosh. Nuk jemi në debat sa i përket kësaj, debati ka përfunduar.

ALBULENA HAXHIU: Dakord! A këtu po do ta prishësh praktikën, a? Debati ka përfunduar, por rekomandimet nuk janë lexuar në këtë seancë dhe ne si grup parlamentar e kemi të drejtën t'i lexojmë rekomandimet. Nuk e di për çka po 'sikletohesh'. Sinqerisht nuk po të kuptoj!

KRYESUESI: Unë s'kam asgjë kundër, por nuk është në përputhje me Rregulloren kjo që po e bën ti. Unë nuk po ta ndal, por nuk ta jep Rregullorja të drejtën ty sa herë të kesh dëshirë ti të diskutosh dhe për çka të kesh dëshirë. Rregullorja e thotë.

ALBULENA HAXHIU: Por, a po më lejon të flas? Këto rekomandime nuk janë lexuar asnjëherë. Prandaj në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes më lejoni që t'i lexoj para deputetëve këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i shkarkojë nga detyra të gjithë zyrtarët e lartë të cilët kanë aktakuza për keqpërdorim dhe korrupsion nga pozicioni të cilin e mbajnë.
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet t'i dorëzojë brenda 15 ditëve pune raport të detajuar Kuvendit të Kosovës mbi dosjen penale të çdo anëtari të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore dhe regjionale dhe kryeshefave ekzekutivë, kjo përfshirë edhe rastet që kanë vetëm aktakuzë, apo që në të kaluarën kanë pasur.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Auditori i Përgjithshëm të hartojë në përputhje në legjislacionin në fuqi raportin mbi rregullsinë, performansën dhe financat të Organit Shqyrtues i Prokurimit, këtë raport t'ia dorëzojë Kuvendit jo më larg se 90 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rezolute.
4. Ministria e Punëve të Brendshme t'i dërgojë raport Kuvendit të Kosovës për gjendjen dhe rastet me aktakuzë të mëhershme dhe të tashme të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Departamentit Special Kundër Korrupsionit në Policinë e Republikës së Kosovës, Divizionit Kundër Krimit të Organizuar.
5. Komisionet Parlamentare që e mbikëqyrin punën e institucioneve të pavarura të zgjedhura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet t'i themelojnë grupet e punës brenda komisioneve për ta përgatitur raportin me të dhëna për rastet e aktakuzave të anëtarëve të bordeve dhe drejtuesve të këtyre institucioneve.
6. Këto raporte të paraqiten në seancë, si dhe të dorëzohen në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

7. Komisionet si më poshtë brenda 30 ditëve pune t'i dorëzojnë raportet e detajuara të përshkruara si më lart, pra është fjala për Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Legjislacion, Administratë, Buxhet dhe Financa dhe Arsim.

8. Ministria e Drejtësisë në koordinim me Komisionin për Legjislacion të fillojë përgatitjen jo më vonë se shtatë ditë pune - nismën legjislative për vlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, me theks të veçantë vetingun.

9. Qeveria e Republikës së Kosovës në fazën e rishqyrtimit buxhetor të vitit 2018 të ofrojë mbështetje financiare për sistemin e drejtësisë, krijimin e departamenteve të veçanta përbrenda Prokurorisë dhe gjykatave në përbërje të ekipeve të veçanta prokurorësh, hetuesish dhe gjykatës të profilizuar, që do të merren vetëm me lëndët e korrupsionit.

10. Shtimi i numrit të stafit mbështetës i profilizuar në këtë drejtim.

11. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, urgjentisht duhet ta informojë Kuvendin për rastet e parashkrimit në lëndët e korrupsionit, dënimet e ulëta, ato me kusht, përfshirë këtu edhe analizën për rrethana lehtësuese në aktgjykime, si dhe të dalë me rekomandime për adresimin e këtyre rasteve.

Këto janë rekomandimet tona si grup parlamentar, edhe një herë po e theksoj faktin në qoftë se kanë propozime tjera grupet parlamentare do të mund t'i bëjnë ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju pothuajse e shprehët atë që dëshironi që ta votojmë. E kemi një mocion të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, respektivisht kryetarit të Grupit Parlamentar, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për fund të seancës.

Unë ia jap fjalën së pari zotit Elmi Reçica, pastaj zonjës Teuta Haxhiu, që ta shprehin mendimin nëse do të futemi në votim menjëherë, apo do ta shtyjme.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti zëvendëskryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të nderuar të këtij vendi,

Nuk është hera e parë që interpelancat dhe debatet parlamentare mbahen sa për opinion. Po të kishte seriozitet, tash e një javë, pra nga e premtja kanë përfunduar këto, i kishim marrë ne konkluzionet tuaja, i kishim diskutuar me grupet parlamentare dhe tash ishim marrë me konkluzione, ose me rekomandime të harmonizuar, ose do të kishte votuar secili grup në bazë të interesave dhe në bazë të asaj si e sheh realitetin.

Nuk është në rregull kjo që të na sjellin para aktit të kryer dhe nuk është hera e parë.

Nëse e keni sinqerisht dhe nëse jemi të interesuar që ta zgjidhim një çështje, duhet ta dimë që ne jemi Parlament dhe kemi opinione të ndryshme për zhvillime të ndryshme e për ngjarje të ndryshme, dhe kemi opinione të ndryshme për ngjarje të njëjta, për institucione të njëjta, dhe për këtë arsye duhet të ketë një harmonizim.

Është jokorrekte dhe është gjithmonë një angazhim i vazhdueshëm.

Katër herë i keni lexuar këto konkluzione, herë Fitore Pacolli, herë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, herë ju, e herë të gjithë, dhe ne nuk i kemi marrë si grup parlamentar e si deputetë këto çështje tjera.

Unë propozoj që kjo çështje të shtyhet definitivisht, të mos jetë fare për votim tash, se nuk është korrekte dhe nuk është në rregull kjo, në emër të grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Serioziteti i rezolutave, që vazhdimisht si deputetë jemi ankuar se nuk po respektohen nga Qeveria, po humb pikërisht në Kuvend.

Këtu ku ne po nxjerrim rezoluta joseriozitetin e tha parafolësi im, jo vetëm që janë lexuar katër herë, është transkripti, por janë hedhur në votim dhe nuk kanë kaluar se nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të deputetëve.

Prandaj, të mos e bëjmë joserioze, mbetet harmonizimi, nuk mblidhen fare dhe në seanca dalin e presin prapë harmonizim. Nuk është hera e parë që ka ndodhur kjo. Prandaj, mos luani sinqerisht lojë jo të pastër politike në Kuvend. Disa herë po lexohen të njëjtat, i kemi mësuar përmendsh. Prandaj, të mos bëhen praktika të ndryshme sipas subjekteve politike të ndryshme. More i keni lexuar, i keni nxjerrë sa herë edhe në votim dhe shihini transkriptimet, lexoni nga pak edhe ju.

Kjo është më shumë për ta fyer edhe deputetin, edhe Kuvendin. Seriozitetin e rezolutave po e humb vetë Kuvendi. Po i interesojnë opozitës, le të bëjnë lojëra, lojëra për të luajtur me ndjenja. Kemi për çka të diskutojmë, kemi shumë tema për t'i diskutuar në Kuvend.

Prandaj, të mos humbin kohë kot, bëni politikë në rrugë, bëni politikë nëpër subjektet tuaja, e mos bëni politikë jo të pastër në Kuvend.

Kjo është joserioze kryesues. Fjalën po ia jep kush po e kërkon, edhe pse është jashtë Rregullores.

Pra edhe një herë, propozuesi i ka lexuar minimum tri herë, sot u lexuan për të katërtën herë dhe janë nxjerrë në votim. Mos harroni, janë nxjerrë edhe në votim!

Prandaj, edhe kjo rezolutë, edhe rezolutat më herët, janë një praktikë jo e mirë që nuk ka ndodhur herëve të kaluara.

Prandaj, le të harmonizohen me kohë, nëse nuk harmonizohen le të nxirren në votim. Prandaj, seriozisht edhe një herë po them, të mos të kërkojmë atëherë llogari nga Qeveria pse nuk po i respekton rezolutat. Seriozitetin po ua humbim ne.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit zoti kryesues!

Po, unë i dëgjova rekomandimet, apo pikat e rezolutës, dhe për aq sa dëgjova, sa i përket Nismës ato janë të pa harmonizuara.

Pra, nuk kam as çka të ulem që të bisedojmë për t'i harmonizuar, se për aq sa dëgjova, ato janë programi qeverisës i Lëvizjes Vetëvendosje dhe unë nuk jam në Lëvizjen Vetëvendosje. Unë jam Nisma Socialdemokrate, unë jam në koalicion qeveritarë, nuk e kam atë qasje.

Nëse ata mendojnë që gjithsesi duhet aty të bëhen pjesë e Qeverisë, duhet të bisedojnë me kryeministrin Haradinaj që të bëhen pjesë e Qeverisë nëse kanë interesim, por nga pozicioni i opozitës nuk mund ta shtyjnë programin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Prandaj, në fillim u rezervova, sepse nuk e dija, tash i dëgjova të gjitha rekomandimet. Nuk mendoj që janë detyra të Kuvendit, ato janë çështje të drejtësisë, disa çështje janë çështje të drejtësisë dhe, mbi të gjitha, janë çështje standardesh.

Nëse ata mendojnë që ky standard i tyre është i domosdoshëm, është më i miri, le të garojnë, le t'i fitojnë zgjedhjet, le të bëhen pjesë e Qeverisë me këdo që dëshirojnë dhe pastaj le t'i imponojnë ato brenda Qeverisë, por jo nga pozicioni i opozitës, sepse përshtypja ime, ajo së paku qysh unë e shoh që nëpërmjet rezolutave dhe nëpërmjet rekomandimeve, qoftë nga interpelanca, qoftë nga debatet, t'i imponojnë Qeverisë programin. Qeveria e ka një program të mirë a të keq, qytetarët e gjykojnë atë.

Me shumëçka jemi të kënaqur, me shumëçka edhe ne vetë jemi të pakënaqur, por në rrugë e sipër po shpresojmë që do t'i përmirësojmë. Aty ka pika edhe jokushtetuese, askujt nuk mund t'i

ndalohet e drejta e ushtrimit të detyrës për shkak se dikujt atje i është tekur të hapë hetime, të ngre aktakuza dhe pastaj pas 10 vjetësh ta shpallë të pafajshëm dhe formalisht as edhe një “më fal” nuk i thuhet. Pra, le të mbetemi brenda kuadrit kushtetues, le ta ndalojmë ushtrimin e funksioneve me Kushtetutë të gjithë ata, të cilët kanë probleme me organin e hetuesisë apo të akuzës, le t’ia ndalojmë me Kushtetutë të merret me aktivitete, qoftë politike, qoftë të natyrave të tjera dhe pastaj jemi në rregull. Përndryshe, ajo çka unë dëgjova është e paharmonizueshme, Nisma nuk merr pjesë as në harmonizim të rekomandimeve të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, a dëshiron të japë mendimin? Jo! 6+? Jo! Kemi edhe një deputet Muharrem Nitaj, po foli Teuta në emër të grupit parlamentar, unë nuk po dua ta hap debatin. Edhe pse për një rezolutë të tillë realisht as nuk mund të harmonizohet me individë në emër të partisë, e të grupeve parlamentare, do të duhej të debatohej shumë në Parlament secili rekomandim. Ne kemi miratuar rezoluta të parealizueshme në Kuvend dhe mirë është që kur ka rezoluta të nivelit të tillë, vërtet të hapet debati lidhur me tekstin dhe jo për të bërë politikë. Zoti Nitaj e keni fjalën, shpresoj që nuk paraqiten të tjerë dhe e fus në votim.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Unë do të jem shumë i shkurtër, propozuesi, Vetëvendosje nuk e ka për qëllim që ta harmonizojë këtë rezolutë, as ta kalojë. Unë besoj, për shembull, qëllimin që e ka nxjerrë në Kuvend e ka arritur, është qëllimi i njëfarë lloj komunikimi me opinionin publik. Prandaj, në vijën e asaj që përmendi edhe zoti Sherifi, teksti është i paharmonizueshëm, s’keni çka marrim pjesë fare në të, kështu që unë ju lus që të procedoni sipas Rregullores.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, ti e ke kryer, çka do? Replikë? Zonja Haxhiu ka replikë!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Së pari, këtu problemin po duket që nuk e kanë me faktin që ne jemi joseriozë, por problemin e kanë me çështjet serioze që trajtohen në këtë rezolutë. Pra, problemin e kanë sidomos te pika e parë dhe jo vetëm e kësaj rezolute, ku i kërkohet Qeverisë shkarkimi i të gjithë zyrtarëve të lartë, pra ministrave, të cilët kanë aktakuza për korrupsion. Ju e dini shumë mirë, Qeveria Haradinaj të paktën tre persona, tre ministra kanë aktakuza për korrupsion. A po më tregoni, qysh mund të luftojë korrupsionin një qeveri që në të janë tre ministra me aktakuza për korrupsion? Dhe tjetra, po më duket pak e çuditshme, a ka një harmonizim të qëndrimeve në këtë koalicion, apo jo? Para disa ditëve ministri i Drejtësisë tha se shumë shpejt do të procedohet Kodi i Procedurës Penale në Kuvend dhe aty është një ndryshim që ata të cilët kanë aktakuza për korrupsion nuk mund të mbajnë poste publike. Jo në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale. Pra, a ka një harmonizim, sepse përnjëmend s’po ju kuptoj, dhe deklarata më skandaloze që kam dëgjuar ndonjëherë në këtë Kuvend të Kosovës është kjo e fundit: “Bëni politikë në rrugë e mos bëni politikë në Kuvend”. Sinqerisht po më befasoni me këto zbulime që po i bëni për ditë, gjeniale.

Prandaj, meqë po shoh që nuk ka një vullnet për të kontribuar në këtë çështje, në emër të Grupit Parlamentar kërkoj që ta vendosni në votim dhe është e pashpjegueshme po ashtu, që brenda një minute subjektet, si Nisma dhe Aleanca, i ndryshojnë qëndrimet. Fillimisht thanë që janë për harmonizim dhe më pas thanë janë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zonja Teuta Haxhiu dhe Bilall Sherifi.

TEUTA HAXHIU: Për dikë parimet janë parime dhe lojërat politike, të pastra politike dhe punë në Kuvend, është krejt diçka tjetër. Unë e kuptoj rolin e opozitës, përderisa joserioziteti i skajshëm i propozuesit që nuk i ka ftuar subjektet politike për harmonizim, unë nuk e di se çfarë loje është kjo. Domethënë, prej javës së kaluar interpelancë pas interpelance, lexim të rekomandimeve dhe jo ftesë subjekteve politike. Nuk u ka bërë ftesë dhe unë nuk e di për çka tjetër, pos për të marrë fjalën dhe për të thënë “hajt pak”, kjo është më shumë se “hajt pak”, por edhe “hajt pakit” i ka rënë vlera këtu pikërisht prej deputetëve që po bëjnë “hajt paka” sa për të dalë në media.

Ky është joseriozitet, problemi im kryesor, edhe një herë po them,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e keni fjalën, kundër-replikë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Shihe, kur para kamerave është në gjendje t’i ndërrojë fjalët, imagjinoni çka ndodh pas kamerave. Ajo që unë në fillim thashë, para se t’i dëgjoj rekomandimet, thashë jemi të gatshëm t’i harmonizojmë. Pra, kur i dëgjova rekomandimet, thashë s’ka këtu çka harmonizohet, janë të paharmonizueshme. Nuk ka ndryshim qëndrimi, nëse unë në fillim pa i dëgjuar tregova gatishmëri të harmonizohen, kur i dëgjova them se janë të paharmonizueshme. Imagjinoni, pra kolegë të nderuar, kur brenda një kuadri prej pesë minutave, drejtpërdrejt, t’i ndërrohet, shpif, imagjinoni çka ndodh kur ti veç me të flet në katër sy, çka ndodh pastaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konsideroj si të përfunduar, edhe pse ka qenë i përfunduar diskutimi sa i përket kësaj çështjeje. Mendoj që e meta është tek unë, po e lë, të mos e çoj tutje, sepse nuk u desh të hapen diskutimet për këtë çështje, sepse diskutimet kanë përfunduar, nuk e keni harmonizuar. Atëherë, unë e hedh në votim propozim-rezolutën nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Unë s'po ju kuptoj, a doni të votoni kundër a për? A doni ta shtyni për ndonjë seancë tjetër? Nëse doni ta shtyni për ndonjë seancë tjetër, atëherë qëndroni pranë kësaj, mos votoni hiç. Nëse doni ta hiqni ose ta votoni për ose kundër, votojeni!

78 deputetë janë në sallë. 32 kanë votuar. Prej tyre 30 janë për.

Edhe një herë e përsëris, mirë është të votoni të gjithë, për, kundër, s'është me rëndësi. Votojmë tani!

Nuk realizohet votimi.

* * *

E enjte, 28 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 31 maj, 1, 4, 5, 6, 14 qershor 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me procedimin e pikave të papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 6, 8, 14 dhe 19 qershor 2018 si në vijim.

Pika e parë e rendit të ditës që ka qenë në seancën e mbajtur më 6, 8 dhe 14 qershor 2018 nuk ka pasur kuorum për të votuar dhe është debatuar mjaftueshëm:

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës

Diskutimi për tri pikat e papërfunduara të rendit të ditës janë kryer në seancat plenare të mbajtura më 6, 8 dhe 14 qershor 2018, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Unë e kam një kërkesë nga zonja Pacolli që për këtë pikë të rendit të ditës i ka kërkuar tre minuta, meqenëse nuk ka qenë në seancën e kaluar për ta sqaruar.

Nga reagimi i deputetëve, të lutem, të më kuptosh drejt.

Atëherë, e votojmë Propozim-rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, e cila u është shpërndarë deputetëve më 19 qershor 2018.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë i kemi 65 deputetë. Votojmë tash!

Nga 65 deputetë që janë në sallë, kanë votuar vetëm 42.

Zoti Korab Sejdiu, të lutem, ulu, edhe ju që jeni mbrapa, mos diskutoni me deputetë, nuk keni nevojë, nuk jeni për atë punë aty. I keni zyrat tuaja, deputetët i kanë zyrat e tyre, ju jeni vetëm të shihni dhe të dëgjoni, jo për të na u përzier nga mbrapa në sallë, pa marrë parasysh kush çfarë funksioni ka, a është i BE-së, a është i kujt do aty! E keni bufenë jashtë dhe s'keni të drejtë të flisni me deputetë brenda në sallë. Për juve muri që na ndanë është muri që s'ka komunikim, nëse doni të qëndroni në sallë, nëse jo, merrem vesh me vendime të tjera.

Edhe një herë e përsëris votimin. Votojmë tani!

A ka dikush që nuk ka kartelë?

Mua po më çudit pse nuk po votoni. Nëse nuk votojnë 61 deputetë, prapë duhet të përsëritet në seancën tjetër e njëjta rezolutë, kështu që ju lus të votoni, për ose kundër, abstenoni, nuk ka lidhje.

68 deputetë janë në sallë.

E përsëris votimin, regjia! Nëse s'ka, më nuk e përsëris. Faleminderit!

Votojmë tani: Doktor, a je për, a kundër? Faleminderit!

Kanë votuar 63 deputetë, për kanë votuar 23, kundër 31 dhe 9 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi nuk e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*